PËRMBLEDHJE E AKTEVE NDËRKOMBËTARE PËR DREJTËSINË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

\

Qershor 2010

© i këtij botimi Qendra e Publikimeve Zyrtare

ISBN 978 – 9928 –01– 003 - 2

PËRMBAJTJA

Ligj nr.8137, datë 31.7.1996	Konventa për mbrojten e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore *Shtuar me ligjin nr.8641, datë 13.7.2000 (protokoll shtesë)* *Shtuar me ligjin nr.9264, datë 29.7.2004 (protokoll shtesë)* *Ndryshuar me ligjin nr.9453, datë 15.12.2005 (protokoll shtesë)*	9
Ligj nr.8427, datë 14.12.1998	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në organizatën ndërkombëtare të policisë kriminale, INTERPOL	37
Ligj nr.8496, datë 3.6.1999	Për ratifikimin e Konventës kuadër të Këshillit të Europës për mbrojtjen e minoriteteve"	46
Ligj nr.8497, datë 10.6.1999	Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës "Për transferimin e procedimeve në çështjet penale"	53
Ligj nr.8498, datë 10.6.1999	Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Europës "Për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale" dhe protokollin e saj shtesë *Ndryshuar me ligjin nr.9539, datë 22.5.2006*	66
Ligj nr.8883, datë 18.4.2002	Për ratifikimin e "Protokollit të dytë shtesë të "Konventës së Këshillit të Europës për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale"	79
Ligj nr.8499, datë 10.6.1999	Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës "Për transferimin e personave të dënuar"	92
Ligj nr.8512, datë 15.7.1999	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet qeverive të vendeve pjesëmarrëse në bashkëpunimin ekonomik të Detit të Zi për bashkëpunimin në luftën kundër krimit, në mënyrë të veçantë format e tij të organizuara"	100
Ligj nr.9500, datë 3.4.2006	Për ratifikimin e protokollit shtesë, për luftën kundër terrorizmit, të marrëveshjes ndërmjet qeverive të shteteve pjesëmarrëse të bashkëpunimit ekonomik të Detit të Zi për bashkëpunimin në luftën kundër krimit, veçanërisht në format e organizuara të tij	105
Ligj nr.8541, datë 21.10.1999	Për ratifikimin e "Marrëveshjes së SECI-t mbi bashkëpunimin për parandalimin dhe luftën kundër krimit ndërkufitar"	110
Ligj nr.8547, datë 11.11.1999	Për ratifikimin e Konventës "Për ndalimin e përdorimit, të magazinimit, të prodhimit dhe të transferimit të minave kundër personit (MKP) dhe për shkatërrimin e tyre"	117
Ligj nr.8623, datë 15.6.2000	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Hungarisë për bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, trafikut të drogës dhe krimit të organizuar"	127
Ligj nr.8624, datë 15.6.2000	Për aderimin në "Konventën e Hagës" "Për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit""	131

Ligj nr.8635, datë 6.7.2000	Për ratifikimin e Konventës civile "Për korrupsionin"	142
Ligj nr.8639, datë 13.7.2000	Për ratifikimin e "Kartës për organizimin e funksionimin e Qendrës Rajonale të Iniciativës së Bashkëpunimit për Europën Juglindore (Qendra SECI) për luftën kundër krimit ndërkufitar"	148
Ligj nr.8642, datë 13.7.2000	Për ratifikimin e "Konventës europiane "Për shtypjen e terrorizmit""	150
Ligj nr.8867, datë 14.3.2002	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Statutin e Konferencës së Hagës për të drejtën ndërkombëtare private"	154
Ligj nr.9230, datë 13.5.2004	Për ratifikimin e "Protokollit ndryshues të Konventës Europiane për shtypjen e terrorizmit"	157
Ligj nr.8646, datë 20.7.2000	Për ratifikimin e "Konventës europiane "Për pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit""	165
Ligj nr.8703, datë 1.12.2000	Për ratifikimin e "Konventës europiane për informimin për të drejtën e huaj"	179
Ligj nr.8705, datë 1.12.2000	Për ratifikimin e "Marrëveshjes europiane për transmetimin e kërkesave të ndihmës gjyqësore"	184
Ligj nr.8722, datë 26.12.2000	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe të lëndëve psikotrope"	188
Ligj nr.8723, datë 26.12.2000	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën e vetme mbi drogat narkotike, e ndryshuar nga Protokolli i vitit 1972 për ndryshimin e Konventës së vetme mbi drogat narkotike, 1961"	216
Ligj nr.8724, datë 26.12.2000	Për ratifikimin e "Konventës europiane për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht"	256
Ligj nr.8778, datë 26.4.2001	Për ratifikimin e "Konventës penale për korrupsionin" *Ndryshuar me ligjin nr.9369, datë 14.4.2005*	264
Ligj nr.9245, datë 24.6.2004	Për ratifikimin e "Protokollit Shtesë të Konventës Penale për Korrupsionin"	277
Ligj nr.8865, datë 14.3.2002	Për ratifikimin e "Konventës ndërkombëtare për luftën kundër financimit të terrorizmit"	281
Ligj nr.8920, datë 11.7.2002	Për ratifikimin e "Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar" dhe dy protokolleve shtesë të saj	291
Ligj nr.8945, datë 3.10.2002	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Rumanisë për bashkëpunimin në fushën e luftës kundër terrorizmit, të luftës kundër krimit të organizuar, të trafikut të paligjshëm të substancave narkotike e psikotrope dhe të veprimtarive të tjera të jashtëligjshme"	331

Ligj nr.8984, datë 23.12.2002	Për ratifikimin e Statutit të Romës për Gjykatën Ndërkombëtare Penale	336
Ligj nr.8985, datë 23.12.2002	Për ratifikimin e "Marrëveshjes europiane për personat pjesëmarrës në procedurat para Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut"	391
Ligj nr. 9019, datë 6.3.2003	Për ratifikimin e "Protokollit të mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë për zhvillimin e programeve të mbështetjes së forcave të policisë shqiptare dhe të bashkëpunimit ndërmjet të dyja vendeve në luftë kundër kriminalitetit, nëpërmjet zyrës ndërlidhëse italiane në Shqipëri dhe oficerit ose oficerëve shqiptarë të kontaktit në Itali".	395
Ligj nr.9068, datë 15.5.2003	Për ratifikimin e "Konventës europiane për vlefshmërinë ndërkombëtare të gjykimeve penale"	398
Ligj nr.9081, datë 19.6.2003	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për dorëzimin e personave në Gjykatën Ndërkombëtare Penale"	415
Ligj nr.9092, datë 19.6.2003	Për zbatimin e "Konventës për ndalimin e zhvillimit, të prodhimit, magazinimit dhe përdorimit të armëve kimike dhe për shkatërrimin e tyre"	417
Ligj nr.9094, datë 3.7.2003	Për ratifikimin e "Protokollit opsional të Konventës kundër torturës dhe trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues"	424
Ligj nr.9169, datë 22.1.2004	Për ratifikimin e Marrëveshjes shtesë të Konventës Europiane të 21 marsit 1983 "Për transferimin e personave të dënuar" ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë	435
Ligj nr.9265, datë 29.7.2004	Për ratifikimin e "Konventës Europiane "Për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme""	438
Ligj nr.9307, datë 4.11.2004	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Maqedonisë për bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar, trafikut të paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotrope e prekursorëve, migracionit të paligjshëm dhe veprimtarive të tjera të paligjshme"	442
Ligj nr.9348, datë 24.2.2005	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Bullgarisë për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet civile"	446
Ligj nr. 9359, datë 24.3.2005	Për ratifikimin e "Konventës europiane "Për marrëdhëniet me fëmijët""	454

Ligj nr.9427, datë 13.10.2005	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë të Belgjikës për bashkëpunimin policor	464
Ligj nr.9443, datë 16.11.2005	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën "Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin, në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve"	471
Ligj nr.9446, datë 24.11.2005	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën "Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës"	486
Ligj nr.9492, datë 13.3.2006	Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit	496
Ligj nr.9496, datë 20.3.2006	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Misionit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) për transferimin e personave të dënuar"	530
Ligj nr.9505, datë 3.4.2006	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit Ministror të Konfederatës Zvicerane për bashkëpunimin policor në luftën kundër krimit	535
Lig j nr.9554, datë 8.6.2006	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën "Për njoftimin dhe dorëzimin jashtë shtetit të dokumenteve gjyqësore dhe jashtë gjyqësore në fushën civile dhe tregtare"	543
Ligj nr.9725, datë 7.5.2007	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin shtesë të paktit ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike	552
Ligj nr.9726, datë 7.5.2007	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin e dytë shtesë të paktit ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike	556
Ligj nr.9753, datë 14.6.2007	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën "Për akses ndërkombëtar në drejtësi"	558
Ligj nr.9833, datë 22.11.2007	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin opsional të konventës së OKB-së "Për të drejtat e fëmijëve", për përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura	569
Ligj nr.9834, datë 22.11.2007	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin opsional të Konventës së OKB-së "Për të drejtat e fëmijëve", për shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë me fëmijë	574
Ligj nr.9838, datë 10.12.2007	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin kundër prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municioneve, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar	580

Ligj nr.9871, datë 11.2.2008	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë, si shtesë e Konventës Europiane për ekstradimin, të 13 dhjetorit 1957 dhe e Konventës Europiane për ndihmë juridike për çështjet penale, të 20 prillit 1959, që ka si qëllim të lehtësojë zbatimin e tyre"	590
Ligj nr.10 039, datë 22.12.2008	Për ndihmën juridike	602
Ligj nr.10 071, datë 9.2.2009	Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual	608
Ligj nr.10 155, datë 15.10.2009	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës për bashkëpunimin në luftën kundër krimit"	627
Ligj nr.10 182, datë 29.10.2009	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Konferencës së Hagës "Për procedurën civile"	631
Ligj nr.10 162, datë 15.10.2009	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekisë për bashkëpunimin në luftën kundër krimit"	639
Ligj nr.10 194, datë 10.12.2009	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën "Për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja në fushën civile dhe tregtare"	645

LIGJ
Nr.8137, datë 31.7.1996

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS EVROPIANE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE LIRIVE THEMELORE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Konventa për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore".

Neni 2

Ratifikohen Protokollot Shtesë Nr.1, Nr.2, Nr.4, Nr.7 dhe Nr.11 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

Neni 3

Njihet dispozita e nenit 3 të Protokollit Shtesë Nr.1, si e zbatueshme në përputhje me dispozitat e ligjit Nr.8001, datë 22.9.1995, si dhe të Ligjit Nr.8043, datë 30.11.1995, për një periudhë 5(pesë) vjeçare nga momenti i depozitimit të instrumentave të ratifikimit.

Neni 4

Duke iu referuar nenit 25 të kësaj Konvente, njihet kompetenca e Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut për të pranuar peticione nga çdo person, organizatë jo qeveritare apo grup personash, që pretendojnë të jenë viktima të një shkelje të të drejtave të garantuara në Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, si dhe në Protokollet Shtesë Nr.1, Nr.4 dhe Nr.7, për rastet kur shkelja e të drejtave të garantuara në këto dokumente ka ndodhur pasi ato kanë hyrë në fuqi për Republikën e Shqipërisë.

Neni 5

Duke iu referuar nenit 46 të kësaj Konvente, njihet në kushtet e reciprocitetit juridiksioni i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për interpretimin dhe zbatimin e Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Liritë Themelore, si dhe të Protokolleve Shtesë Nr.1, Nr.4 dhe Nr.7, për rastet kur shkelja e të drejtave të garantuara në këto dokumente ka ndodhur pasi ato kanë hyrë në fuqi për Republikën e Shqipërisë.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.1573, datë 2.8.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.20, faqe 724

KONVENTA
PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE LIRIVE THEMELORE
AMENDUAR ME PROTOKOLLIN NR. 11

Romë, 4.XI.1950

Teksti i Konventës është ndryshuar sipas dispozitave të Protokollit Nr. 3 (ETS Nr. 45), e cila hyri në fuqi më 21 shtator 1970, të Protokollit Nr. 5 (ETS Nr. 55), e cila hyri në fuqi më 20 dhjetor 1971 dhe të Protokollit Nr. 8 (ETS Nr. 118), e cila hyri në fuqi më 1 janar 1990, dhe përfshiu gjithashtu tekstin e Protokollit Nr. 2 (ETS Nr. 44) e cila, në përputhje me Nenin 5, paragrafin 3 të saj, ka qenë një pjesë përbërëse e Konventës që në datën e hyrjes së saj në fuqi, më 21 shtator 1970. Të gjitha dispozitat që janë ndryshuar dhe shtuar nga këto Protokolle janë zëvendësuar nga Protokolli Nr. 11 (ETS Nr. 155), që nga data e hyrjes së saj në fuqi më 1 nëntor 1998. Që nga kjo datë, Protokolli Nr. 9 (ETS Nr. 140), e cila hyri në fuqi më 1 tetor 1994, është shfuqizuar dhe Protokolli Nr. 10 (ETS Nr. 146) ka humbur qëllimin e vet.

Qeveritë nënshkruese, anëtare të Këshillit të Evropës.

Duke pasur parasysh Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, të shpallur nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, më 10 dhjetor 1948;

Duke pasur parasysh, se kjo Deklaratë ka për qëllim të sigurojë njohjen dhe zbatimin universal dhe efektiv të të drejtave të shpallura në të;

Duke pasur parasysh, se qëllimi i Këshillit të Evropës është që të realizojë një bashkim më të ngushtë midis anëtarëve të tij dhe se një nga mjetet për të arritur këtë qëllim është mbrojtja dhe zhvillimi i të drejtave të njeriut dhe i lirive themelore;

Duke ripohuar besimin e tyre të thellë në këto liri themelore që përbëjnë themelet e drejtësisë dhe të paqes në botë, ruajtja e të cilave mbështet kryesisht mbi një regjim politik demokratik nga njëra anë, dhe nga ana tjetër mbi një kuptim dhe respektim të përbashkët të të drejtave të njeriut nga të cilat varen;

Të vendosura si qeveri të shteteve evropiane, që shtyhen nga e njëjta frymë dhe që kanë një trashëgimi të përbashkët idealesh, traditash politike, lirie dhe shteti të së drejtës, për të marrë masat fillestare për zbatimin kolektiv të disa prej të drejtave të shpallura në Deklaratën Universale,

Kanë rënë dakord sa më poshtë:

Neni 1[1]
Detyrimi për të respektuar të drejtat e njeriut

Palët e Larta Kontraktuese i sigurojnë çdokujt brenda juridiksionit të tyre, të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Seksionin I të kësaj Konvente.

Seksioni I
Të drejtat dhe liritë

Neni 2[2]
E drejta për jetën

1. E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t'i privohet jeta qëllimisht, me përjashtim të rastit kur zbatohet një vendim gjykate pas dënimit për një krim për të cilin dënimi është parashikuar me ligj.

2. Privimi nga jeta nuk konsiderohet të shkaktohet në kundërshtim me këtë nen në rastet kur ky privim vjen nga përdorimi i forcës, që është jo më shumë se absolutisht i domosdoshëm:

[1] Titull i shtuar sipas dispozitave të Protokollit Nr 11 (ETS Nr 155)
[2] Titull i shtuar sipas dispozitave të Protokollit Nr 11 (ETS Nr 155)

a) në mbrojtje të çdo personi nga dhuna e paligjshme;

b) për të kryer një arrestim të ligjshëm ose për të parandaluar arratisjen e një personi të ndaluar ligjërisht;

c) për të kundërshtuar, në përputhje me ligjin, një trazirë ose kryengritje.

Neni 3

Ndalimi i torturës

Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose degraduese.

Neni 4

Ndalimi i skllavërisë dhe i punës së detyruar

1. Askush nuk do të mbahet në skllavëri ose në robëri.

2. Askush nuk do të shtrëngohet të kryejë një punë me dhunë ose të detyruar.

3. Për qëllim të këtij neni, termi "punë e kryer me dhunë ose e detyruar", nuk përfshin:

a) çdo lloj pune që i kërkohet të kryejë zakonisht një person të ndaluar në kushtet e parashikuara nga neni 5 i kësaj Konvente ose gjatë lirimit të tij me kusht;

b) çdo lloj shërbimi i karakterit ushtarak ose, në rastin e kundërshtarëve të ndërgjegjes në vendet ku kundërshtimi i ndërgjegjes është i njohur me ligj, shërbimi që kryhet në vend të shërbimit ushtarak të detyrueshëm;

c) çdo lloj shërbimi që kërkohet në rast krizash ose fatkeqësish, që kërcënojnë jetën ose mirëqenien e komunitetit;

d) çdo lloj pune ose shërbimi që është pjesë e detyrimeve normale qytetare.

Neni 5

E drejta për liri dhe siguri

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijojnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj:

a) kur burgoset ligjërisht, pas një dënimi të dhënë nga një gjykatë kompetente;

b) kur arrestohet ose burgoset ligjërisht për moszbatim të një urdhri të dhënë nga gjykata në përputhje me ligjin ose për të garantuar përmbushjen e një detyrimi të parashikuar nga ligji;

c) kur është arrestuar dhe paraburgosur për t'u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent, kur ka arsye të besueshme për të dyshuar se ai ka kryer një vepër penale ose kur ka motive të arsyeshme për të besuar se është e nevojshme që të pengohet të kryejë një vepër penale ose të largohet pas kryerjes së saj;

d) kur një i mitur ndalohet ligjërisht, për qëllim edukimi të mbikqyrur, ose për ndalimin e tij të ligjshëm, me qëllim që të çohet përpara autoritetit kompetent ligjor;

e) kur individët ndalohen ligjërisht për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve infektive të personave të sëmurë mendërisht, alkoolistëve, narkomanëve ose endacakëve;

f) kur një person arrestohet ose ndalohet ligjërisht, me qëllim që të ndalohet hyrja e tij e paautorizuar në atë vend, ose për një person kundër të cilit është duke u kryer një procedurë dëbimi ose ekstradimi;

2. Çdo person i arrestuar duhet të informohet brenda një afati sa më të shkurtër dhe në një gjuhë që ai e kupton, për arsyet e arrestimit të tij dhe në lidhje me çdo akuzë që i bëhet.

3. Çdo person i arrestuar ose i paraburgosur në rrethanat e parashikuara në paragrafin 1/c të këtij neni, duhet të çohet menjëherë përpara një gjykatësi ose një zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar funksione gjyqësore dhe ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në gjykim e sipër. Lirimi mund të kushtëzohet nga garanci për t'u paraqitur para gjykatës.

4. Çdo person, të cilit i është hequr liria me arrestim ose me burgim, ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirimin, në qoftë se burgimi është i paligjshëm.

5. Çdo person, që arrestohet ose burgoset në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, ka të drejtën e zbatueshme të dëmshpërblimit.

Neni 6[3]

E drejta për një proces të rregullt

1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

a) të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;

b) t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;

c) të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij ose, në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;

d) të pyesë, ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;

e) të ndihmohet falas nga një përkthyes, në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq.

Neni 7

Nuk ka dënim pa ligj

1. Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim, që në momentin kur është kryer nuk përbënte vepër penale, sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale.

2. Ky nen nuk do të ndikojë mbi gjykimin dhe dënimin e një personi për një veprim ose mosveprim, i cili, në momentin kur është kryer, quhej vepër penale sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës, të njohura nga kombet e qytetëruara.

Neni 8[4]

E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare

1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

---

[3] Titull i shtuar sipas dispozitave të Protokollit Nr 11 (ETS Nr 155)

[4] Titull i shtuar sipas dispozitave të Protokollit Nr 11 (ETS Nr 155)

Neni 9

Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes e të fesë; kjo e drejtë nënkupton lirinë për të ndryshuar fenë ose besimin dhe lirinë, qoftë individualisht ose kolektivisht, publikisht ose privatisht nëpërmjet kultit, mësimdhënies, praktikave dhe kryerjes së riteve.

2. Liria e shfaqjes së fesë së tij ose besimeve të dikujt nuk mund t'i nënshtrohet kufizimeve të tjera, përveç atyre të parashikuara nga ligji dhe që përbëjnë masa të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, të shëndetit ose të moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.

Neni 10

Liria e shprehjes

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që të kërkojnë liçencimin e ndërmarrjeve të transmetimit kinematografike ose televizive.

2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.

Neni 11

Liria e tubimit dhe e organizimit

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët, duke përfshirë të drejtën e themelimit me të tjerë të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të tij.

2. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t'u nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve. Ky nen nuk ndalon kufizime të ligjshme të ushtrimit të këtyre të drejtave nga pjesëtarë të forcave të armatosura, të policisë ose të administratës shtetërore.

Neni 12

E drejta për t'u martuar

Burri dhe gruaja, që kanë mbushur moshën për martesë, kanë të drejtë të martohen dhe të krijojnë familje, sipas ligjeve kombëtare që rregullojnë ushtrimin e kësaj të drejte.

Neni 13

E drejta për zgjidhje efektive

Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.

Neni 14
Ndalimi i diskriminimit

Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

Neni 15[5]
Derogimi në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme

1. Në rast lufte ose rreziku tjetër publik që i kanoset jetës së kombit, çdo Palë e Lartë Kontraktuese mund të marrë masa që iu shmangen detyrimeve të parashikuara nga kjo Konventë, veçse në shkallën më të vogël që e kërkon situata, me kusht që këto masa të mos jenë të papajtueshme me detyrimet e tjera sipas të drejtës ndërkombëtare.

2. Dispozita e mësipërme nuk lejon asnjë shmangie nga neni 2, me përjashtim të rastit të vdekjes që vjen si pasojë e akteve të ligjshme të luftës ose nga nenet 3, 4 (paragrafi 1) dhe 7.

3. Çdo Palë e Lartë Kontraktuese, që ushtron këtë të drejtë derogimi, mban plotësisht të informuar Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Evropës për të gjitha masat e marra dhe arsyet pse ato janë marrë. Gjithashtu, ajo duhet të informojë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Evropës për datën në të cilën këto masa kanë humbur fuqinë dhe dispozitat e Konventës vihen sërish në zbatim të plotë.

Neni 16
Kufizime ndaj veprimtarisë politike të të huajve

Asnjë nga dispozitat e neneve 10, 11 dhe 14 nuk mund të konsiderohet se u ndalon Palëve të Larta Kontraktuese që të vendosin kufizime ndaj veprimtarisë politike të të huajve.

Neni 17
Ndalimi i shpërdorimit të të drejtave

Asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk mund të interpretohet se i jep një Shteti, grupimi ose individi, të drejtë që të përfshihet në ndonjë veprimtari ose të kryejë ndonjë akt që synon cënimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë ose kufizime më të gjera të këtyre të drejtave ose lirive sesa është parashikuar në Konventë.

Neni 18
Kufiri i zbatueshmërisë së kufizimeve të të drejtave

Kufizimet e lejuara sipas kësaj Konvente ndaj të drejtave dhe lirive të sipërpërmendura nuk do të zbatohen për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat janë parashikuar.

[5] Titull i shtuar sipas dispozitave të Protokollit Nr 11 (ETS Nr 155)

Seksioni II[6]
Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut

Neni 19
Krijimi i Gjykatës

Për të siguruar respektimin e zotimeve të ndërmarra nga Palët e Larta Kontraktuese të kësaj Konvente dhe nga Protokollet e saj, krijohet Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në vijim referuar si "Gjykata". Ajo funksionon në mënyrë të përhershme.

Neni 20
Numri i gjyqtarëve

Gjykata përbëhet nga një numër gjyqtarësh i barabartë me numrin e Palëve të Larta Kontraktuese.

Neni 21
Kriteret e ushtrimit të funksioneve

1. Gjyqtarët duhet të kenë karakter të lartë moral dhe të kenë kualifikimet e duhura për ushtrimin e funksioneve të larta gjyqësore ose të jenë juristë me aftësi të shquara.
2. Gjyqtarët janë anëtarë të Gjykatës me zotësi individuale.
3. Gjyqtarët, gjatë mandatit të tyre, nuk mund të ushtrojnë asnjë veprimtari të papajtueshme me kërkesat e pavarësisë, paanësisë ose angazhimit në veprimtarinë me kohë të plotë; çdo çështje që ka të bëjë me zbatimin e këtij paragrafi zgjidhet nga Gjykata.

Neni 22
Zgjedhja e gjyqtarëve
(Shfuqizuar pika 2 me ligjin nr.9453, datë 15.12.2005, protokolli nr.14, neni 1)

1. Gjyqtarët zgjidhen nga Asambleja Parlamentare për çdo Palë të Lartë Kontraktuese, me shumicën e votave të shprehura mbi bazën e një liste prej tre kandidatësh të emëruar nga Pala e Lartë Kontraktuese.
2. Shfuqizuar me ligjin nr.9453, datë 15.12.2005.

Neni 23
Mandati dhe largimi nga detyra
(Ndryshuar me ligjin nr.9453, datë 15.12.2005, protokolli nr.14, neni 2)

1. Gjyqtarët zgjidhen për një afat prej nëntë vjetësh. Ata nuk mund të rizgjidhen.
2. Mandati i gjyqtarëve përfundon kur ata arrijnë moshën 70 vjeç.
3. Gjyqtarët qëndrojnë në detyrë derisa të zëvendësohen. Megjithatë, ata vazhdojnë me shqyrtimin e çështjeve që kanë marrë në dorë.
4. Nuk mund të largohet nga detyra asnjë gjyqtar, nëse gjyqtarët e tjerë nuk vendosin me një shumicë prej dy të tretave se ai gjyqtar nuk ka përmbushur kushtet e caktuara.

[6] Seksioni II i ri sipas dispozitave të Protokollit Nr 11 (ETS Nr 155)

Neni 24

Sekretaria dhe relatorët

(Ndryshuar me ligjin nr.9453, datë 15.12.2005, protokolli nr.14, neni 4)

1. Gjykata ka një sekretari, funksionet dhe rregullat e së cilës përcaktohen në rregulloren e Gjykatës.

2. Kur trupi gjykues përbëhet nga një gjyqtar, Gjykata asistohet nga relatorët që funksionojnë në autoritetin e kryetarit të Gjykatës. Ata janë pjesë e sekretarisë së Gjykatës.

Neni 25

Gjykata me përbërje të plotë

(Ndryshuar me ligjin nr.9453, datë 15.12.2005, protokolli nr.14, neni 5)

Gjykata, në mbledhje plenare:

a) zgjedh, për një afat prej tre vjetësh, kryetarin e saj dhe një ose dy zëvendëskryetarë, të cilët mund të rizgjidhen;

b) krijon Dhomat, për një afat të caktuar;

c) zgjedh Kryetarët e Dhomave të Gjykatës, të cilët mund të rizgjidhen;

d) miraton rregulloren e Gjykatës;

e) zgjedh Sekretarin dhe një ose disa zëvendëssekretarë;

f) Bën çdo kërkesë në pajtim me nenin 26 paragrafi 2.

Neni 26

Trupi gjykues me një gjyqtar, komitetet, Dhomat dhe Dhoma e Lartë

(Ndryshuar me ligjin nr.9453, datë 15.12.2005, protokolli nr.14, neni 6)

1. Gjykata i shqyrton çështjet e sjella para saj në trup gjykues me një gjyqtar, në komitete me tre gjyqtarë, në Dhoma me shtatë gjyqtarë dhe në Dhomën e Lartë me shtatëmbëdhjetë gjyqtarë. Dhomat e Gjykatës formojnë komitete për një periudhë të caktuar kohe.

2. Me kërkesë të Gjykatës në përbërje të plotë, Komiteti i Ministrave, me vendim unanim dhe për një periudhë të caktuar kohe, mund ta zbresin numrin e gjyqtarëve në Dhoma në pesë.

3. Kur është në një trup gjykues me një gjyqtar, gjyqtari nuk shqyrton asnjë kërkesë kundër Palës së Lartë Kontraktuese, në emër të së cilës ai është zgjedhur.

4. Gjyqtari që është zgjedhur në emër të Palës së Lartë Kontraktuese të interesuar merr pjesë si anëtar i Dhomës ose Dhomës së Lartë kryesisht. Nëse nuk ka të zgjedhur ose nëse gjyqtari nuk është në gjendje të marrë pjesë, në cilësinë e gjyqtarit merr pjesë një person i zgjedhur nga kryetari i Gjykatës nga një listë e dhënë paraprakisht nga ajo Palë.

5. Dhoma e Lartë ka në përbërje të saj edhe kryetarin e Gjykatës, zëvendëskryetarët, kryetarët e Dhomave ose gjyqtarë të tjerë të zgjedhur në pajtim me rregulloren e Gjykatës. Nëse në Dhomën e Lartë vjen një çështje në bazë të nenit 43, në Dhomën e Lartë nuk merr pjesë asnjë nga gjyqtarët e Dhomës që ka dhënë vendimin, me përjashtim të kryetarit të Gjykatës dhe gjyqtarit që merrte pjesë në emër të Palës së lartë Kontraktuese të interesuar.

Neni 27

Kompetenca e gjyqtarit të vetëm

(Ndryshuar me ligjin nr.9453, datë 15.12.2005, protokolli nr.14, neni 7)

1. Gjyqtari i vetëm mund ta deklarojë të papranueshëm ose ta heqë nga lista e çështjeve të Gjykatës një kërkesë të bërë në bazë të nenit 34, nëse një vendim i tillë mund të merret pa shqyrtim të mëtejshëm.

2. Vendimi është i formës së prerë.

3. Nëse një gjyqtar i vetëm nuk e deklaron një kërkesë të papranueshme ose e heq atë nga lista, gjyqtari ia paraqet atë një komiteti ose një Dhome për shqyrtim të mëtejshëm.

Neni 28

Kompetenca e komiteteve

(Ndryshuar me ligjin nr.9453, datë 15.12.2005, protokolli nr.14, neni 8)

1. Në lidhje me një kërkesë të bërë në bazë të nenit 34, një komitet, me votë unanime:

a) mund ta deklarojë atë të papranueshme ose ta heqë atë nga lista e çështjeve, nëse një vendim i tillë mund të merret pa shqyrtim të mëtejshëm; ose

b) mund ta deklarojë atë të papranueshme dhe të nxjerrë në të njëjtën kohë një vendim mbi themelin e çështjes, nëse problemi i përfshirë në çështjen gjyqësore, përsa i takon interpretimit ose zbatimit të Konventës ose të protokolleve të saj, është një subjekt që ka gjetur zgjidhje në praktikën gjyqësore të Gjykatës.

2. Vendimet e ndërmjetme dhe përfundimtare në bazë të paragrafit 1 janë të formës së prerë.

3. Nëse gjyqtari i zgjedhur në emër të një Pale të Lartë Kontraktuese të interesuar nuk është i komitetit, komiteti mund ta ftojë atë gjyqtar në çdo fazë të gjykimit të zërë vendin e një prej anëtarëve të komitetit, duke marrë parasysh të gjithë faktorët përkatës, duke përfshirë edhe faktin nëse ajo Palë ka kundërshtuar zbatimin e procedurës në bazë të paragrafit 1.b.

Neni 29

Vendimet nga Dhomat mbi pranueshmërinë dhe themelin

(Ndryshuar me ligjin nr.9453, datë 15.12.2005, protokolli nr.14, neni 9)

1. Nëse nuk merret asnjë vendim në bazë të Nenit 27 ose 28, ose në bazë të Nenit 28, Dhoma vendos në lidhje me pranueshmërinë dhe themelin e kërkesave individuale të bëra në bazë të Nenit 34. Vendimi mbi pranueshmërinë mund të merret veçmas.

2. Një Dhomë vendos mbi pranueshmërinë dhe themelin e kërkesave ndërshtetërore të paraqitura sipas nenit 33. Vendimi mbi pranueshmërinë merre veçmas përveç, kur gjykata, në raste të veçanta, vendos ndryshe.

3. Shfuqizuar me ligjin nr.9453, datë15.12.2005.

Neni 30

Heqja dorë nga juridiksioni në favor të Dhomës së Madhe

Në qoftë se një çështje në gjykim para një Dhome paraqet një problem serioz në lidhje me interpretimin e Konventës ose të protokolleve të saj, ose kur zgjidhja e një çështjeje mund të ketë një rezultat të papajtueshëm me një vendim të dhënë më parë nga Gjykata, Dhoma, në çdo kohë, para marrjes së vendimit, mund të heqë dorë nga juridiksioni i saj në favor të Dhomës së Madhe, me kusht që njëra nga palët e çështjes të mos ketë kundërshtime.

Neni 31

Kompetencat e Dhomës së Madhe

(Ndryshuar me ligjin nr.9453, datë 15.12.2005, protokolli nr.14, neni 10)

Dhoma e Madhe:

a) shprehet për kërkesat e paraqitura sipas nenit 33 ose nenit 34 kur njëra Dhomë ka hequr dorë nga juridiksioni sipas nenit 30 ose kur çështja i është kaluar asaj sipas nenit 43;

b) vendos për çështje që i vijnë Gjykatës nga Komiteti i Ministrave në pajtim me neni 46, paragrafi 4; dhe

c) shqyrton kërkesat për mendimet këshillimore të paraqitura në bazë të nenit 47.

Neni 32

Juridiksioni i Gjykatës

(Ndryshuar me ligjin nr.9453, datë 15.12.2005, protokolli nr.14, neni 11)

1. Juridiksioni i Gjykatës shtrihet mbi të gjitha çështjet, që lidhen me interpretimin dhe zbatimin e Konventës dhe të protokolleve që i referohen asaj siç parashikohen në nenet 33, 34, 46 dhe 47.

2. Në rast mosmarrëveshjeje për juridiksionin, vendos Gjykata.

Neni 33

Çështjet ndërshtetërore

Çdo Palë e Lartë Kontraktuese mund t'i drejtohet Gjykatës për çdo shkelje të supozuar të dispozitave të Konventës ose të protokolleve të saj, nga një Palë tjetër e Lartë Kontraktuese.

Neni 34

Kërkesat individuale

Gjykatës mund t'i paraqiten kërkesa nga çdo person, organizëm joqeveritar ose grup individësh që pretendon se është viktimë e një shkelje prej njërës nga Palet e Larta Kontraktuese e të drejtave të parashtruara nga Konventa ose protokollet e saj. Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të mos pengojnë në asnjë mënyrë ushtrimin efektiv të kësaj të drejte.

Neni 35

Kushtet e pranueshmërisë

(Ndryshuar me ligjin nr.9453, datë 15.12.2005, protokolli nr.14, neni 12)

1. Gjykata mund të marrë në shqyrtim çështjen vetëm pasi të jenë shterur mjetet e brendshme, sipas rregullave përgjithësisht të pranuara të së drejtës ndërkombëtare dhe brenda një afati prej gjashtë muajsh nga data e marrjes së vendimit përfundimtar.

2. Gjykata nuk merr në shqyrtim asnjë kërkesë individuale të paraqitur sipas nenit 34, që:

a) është anonime; ose

b) është në thelb e njëjta me një çështje të shqyrtuar më parë nga Gjykata ose që i është nënshtruar një procedure tjetër për zgjidhje ose investigim ndërkombëtar dhe nuk përmban fakte të reja përkatëse

3. Gjykata deklaron çdo kërkesë individuale të bërë në bazë të nenit 34 të papranueshme, kur mendon se:

a) kërkesa është e papajtueshme me dispozitat e Konventës ose protokollet e saj, haptazi e paarsyetuar ose abuzim i së drejtës për kërkesë individuale;

ose

b) paraqitësi i kërkesës nuk ka pësuar ndonjë dëm të konsiderueshëm, përveç kur respektimi i të drejtave të njeriut sipas përcaktimit të Konventës dhe protokolleve të saj kërkon shqyrtimin e kërkesës në lidhje me themelin e saj, me kusht që për këtë shkak asnjë çështje të mos refuzohet nëse nuk është shqyrtuar si duhet nga një gjykatë kombëtare.

4. Gjykata rrëzon çdo kërkesë që e konsideron të papranueshme në zbatim të këtij neni. Ajo mund ta bëjë këtë në çdo fazë të procedimit.

Neni 36

Ndërhyrja e palës së tretë

(Shtuar pika 3 me ligjin nr.9453, datë 15.12.2005, protokolli nr.14, neni 13)

1. Në të gjitha çështjet para një Dhome ose Dhomës së Madhe, një Palë e Lartë Kontraktuese, ku kërkues është një nga shtetasit e tij, ka të drejtë të paraqesë komente me shkrim dhe të marrë pjesë në seanca.

2. Në interes të miradministrimit të drejtësisë, Kryetari i Gjykatës mund të ftojë çdo Palë të Lartë Kontraktuese, që nuk është palë në gjykim ose çdo person të interesuar, që nuk është kërkuesi, të paraqesë komente me shkrim ose të marrë pjesë në seanca.

3.Komisioneri për të Drejtat e Njeriut i Këshillit të Europës mund të paraqesë komente me shkrim dhe të marrë pjesë në seanca në të gjitha çështjet para një Dhome ose Dhomës së Lartë.

Neni 37

Çregjistrimi i kërkesave

1. Në çdo fazë të procedimit, Gjykata mund të vendosë të heqë nga lista e çështjeve një kërkesë, kur rrethanat çojnë në përfundimin se:

a) kërkuesi nuk ka ndërmend ta vazhdojë çështjen; ose

b) çështja është zgjidhur; ose

c) për çdo arsye tjetër që, sipas Gjykatës, nuk justifikon vazhdimin e shqyrtimit të kërkesës.

Megjithatë, Gjykata vazhdon shqyrtimin e kërkesës kur këtë e kërkon respektimi i të drejtave të njeriut të garantuara nga Konventa dhe protokollet e saj.

2. Gjykata mund të vendosë rifutjen e një kërkese në listën e çështjeve, kur e konsideron se rrethanat e justifikojnë këtë.

Neni 38

Shqyrtimi i çështjes

(Ndryshuar me ligjin nr.9453, datë 15.12.2005, protokolli nr.14, neni 14)

Gjykata e shqyrton çështjen së bashku me përfaqësuesit e palëve dhe, nëse është e nevojshme, ndërmerr një hetim, për kryerjen e efektshme të të cilit Palët e Larta Kontraktuese të interesuara ofrojnë të gjitha lehtësitë e nevojshme.

Neni 39

Zgjidhjet me pajtim

(Ndryshuar me ligjin nr.9453, datë 15.12.2005, protokolli nr.14, neni 15)

1. Në çdo fazë të gjykimit, Gjykata mund të vihet në dispozicion të palëve të interesuara, me qëllim që të arrihet një zgjidhje me pajtim për çështjen mbi bazën e respektimit të të drejtave të njeriut sipas përcaktimit në Konventë dhe protokollet e saj.

2. Gjykimi i zhvilluar sipas paragrafit 1 është konfidencial.

3. Nëse arrihet një zgjidhje me pajtim, Gjykata e heq çështjen nga lista nëpërmjet një vendimi që kufizohet në një përmbledhje të shkurtër të themelit të çështjes dhe zgjidhjes së arritur.

4. Vendimi i përcillet Komitetit të Ministrave, i cili mbikëqyr zbatimin e kushteve të zgjidhjes me pajtim sipas përcaktimit në vendim.

Neni 40
Seancat publike dhe e drejta për t'u njohur me dokumentet

1. Seancat janë publike, përveç rasteve kur Gjykata në rrethana përjashtimore vendos ndryshe

2. Dokumentet e depozituara në sekretari janë të hapura për publikun, përveç rasteve kur Kryetari i Gjykatës vendos ndryshe.

Neni 41
Shpërblimi i drejtë

Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj, dhe nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.

Neni 42
Vendimet e Dhomave

Vendimet e Dhomave bëhen përfundimtare sipas dispozitave të nenit 44, paragrafi 2.

Neni 43
Kalimi i çështjes Dhomës së Madhe

1. Brenda një afati prej tre muajsh nga data e vendimit të një Dhome, çdo palë në çështje, në raste përjashtimore, mund të kërkojë kalimin e saj Dhomës së Madhe.

2. Kërkesa pranohet nga një kolegj prej pesë gjyqtarësh të Dhomës së Madhe, në qoftë se çështja ngre një problem serioz që ka të bëjë me interpretimin ose zbatimin e Konventës ose të protokolleve të saj, ose një çështje serioze të një rëndësie të përgjithshme.

3. Kur kolegji e pranon kërkesën, Dhoma e Madhe shprehet për çështjen me vendim.

Neni 44
Vendimet përfundimtare

1. Vendimi i Dhomës së Madhe është përfundimtar.

2. Vendimi i një Dhome bëhet përfundimtar:

a) kur palët deklarojnë se nuk do të kërkojnë që çështja t'i kalojë Dhomës së Madhe; ose

b) tre muaj pas datës së vendimit kur nuk është kërkuar kalimi i çështjes në Dhomën e Madhe; ose

c) kur kolegji i Dhomës së Madhe rrëzon kërkesën për kalimin e çështjes, sipas nenit 43.

3. Vendimi përfundimtar botohet.

Neni 45
Arsyetimi i vendimeve

1. Vendimet përfundimtare, si dhe ato që deklarojnë pranueshmërinë ose papranueshmërinë e kërkesave, arsyetohen.

2. Në qoftë se vendimi nuk shpreh tërësisht ose pjesërisht mendimin unanim të gjyqtarëve, çdo gjyqtar ka të drejtë të japë një mendim të veçantë.

Neni 46

Forca detyruese dhe ekzekutimi i vendimeve

(Ndryshuar me ligjin nr.9453, datë 15.12.2005, protokolli nr.14, neni 16)

1. Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të respektojnë vendimin e formës së prerë të Gjykatës në çdo çështje ku ato janë palë.

2. Vendimi i formës së prerë i Gjykatës i përcillet Komitetit të Ministrave, i cili mbikëqyr ekzekutimin e tij.

3. Nëse Komiteti i Ministrave është i mendimit se mbikëqyrja e ekzekutimit të vendimit të një vendimi të formës së prerë pengohet nga një problem i interpretimit të vendimit, ai mund t'ia referojë çështjen Gjykatës për t'u shprehur me vendim për çështjen e interpretimit. Një vendim i tillë kërkon një shumicë prej dy të tretave të përfaqësuesve që kanë të drejtë të marrin pjesë në Komitet.

4. Nëse Komiteti i Ministrave është i mendimit se një Palë e Lartë Kontraktuese refuzon të respektojë një vendim të formës së prerë të Gjykatës në një çështje ku ajo është palë, pasi t'i ketë dërguar një njoftim formal asaj Pale dhe me vendim që merret me një shumicë prej dy të tretave të përfaqësuesve që marrin pjesë në Komitet, ai mund t'ia referojë Gjykatës çështjen nëse Pala e ka përmbushur detyrimin e saj në bazë të paragrafit 1.

5. Nëse Gjykata gjen një shkelje të paragrafit 1, ajo ia referon çështjen Komitetit të Ministrave për shqyrtimin e masave që duhen marrë. Nëse Gjykata nuk gjen asnjë shkelje të paragrafit 1, ajo ia referon çështjen Komitetit të Ministrave, i cili e mbyll shqyrtimin e çështjes.

Neni 47

Mendimet këshillimore

1. Gjykata, me kërkesë të Komitetit të Ministrave, mund të japë mendime këshillimore për çështje ligjore që lidhen me interpretimin e Konventës dhe të protokolleve të saj.

2. Opinione të tilla nuk trajtojnë asnjë çështje që lidhet me përmbajtjen dhe shtrirjen e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në Seksionin e parë të Konventës dhe në protokollet e saj, ose me ndonjë çështje tjetër të cilën Gjykata ose Komiteti i Ministrave mund t'i duhet ta shqyrtojë si pasojë e ndonjë procedure të tillë, siç mund të përcaktohet në pajtim me Konventën.

3. Vendimi i Komitetit të Ministrave për t'i kërkuar Gjykatës mendime këshillimore merret me votën e shumicës së përfaqësuesve që kanë të drejtë të marrin pjesë në Komitet.

Neni 48

Juridiksioni këshillimor i Gjykatës

Gjykata vendos nëse kërkesa për mendim këshillimor që paraqitet nga Komiteti i Ministrave është në kompetencën e saj, siç përcaktohet në nenin 47.

Neni 49

Arsyetimi i mendimeve këshillimore

1. Mendimet këshillimore të Gjykatës arsyetohen.

2. Në qoftë se mendimi këshillimor nuk shpreh tërësisht ose pjesërisht opinionin e njëzëshëm të gjyqtarëve, çdo gjyqtar ka të drejtë të japë një mendim të veçantë.

3. Mendimet këshillimore të Gjykatës i komunikohen Komitetit të Ministrave.

Neni 50

Shpenzimet për Gjykatën

Shpenzimet për Gjykatën mbulohen nga Këshilli i Evropës.

Neni 51
Privilegjet dhe imunitetet e gjyqtarëve

Gjyqtarët, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e parashikuara në Nenin 40 të Statutit të Këshillit të Evropës dhe në marrëveshjet e lidhura në zbatim të këtij neni.

Seksioni III [7/8]
Dispozita të ndryshme

Neni 52[9]
Hetimet e Sekretarit të Përgjithshëm

Çdo Palë e Lartë Kontraktuese, me kërkesë të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, jep shpjegim mbi mënyrën se si e drejta e saj e brendshme siguron zbatimin efektiv të të gjitha dispozitave të Konventës.

Neni 53[10]
Mbrojtja e të drejtave ekzistuese të njeriut

Asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk duhet të interpretohet sikur kufizon ose cënon të drejtat e njeriut dhe liritë themelore që mund të sigurohen nga legjislacioni i çdo Pale të Lartë Kontraktuese ose nga çdo marrëveshje tjetër në të cilën kjo Palë e Lartë Kontraktuese është palë.

Neni 54[11]
Kompetencat e Komitetit të Ministrave

Asnjë dispozitë e kësaj Konvente nuk cënon kompetencat që Statuti i Këshillit të Evropës i jep Komitetit të Ministrave.

Neni 55 [12]
Përjashtimi i mjeteve të tjera të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve

Me përjashtim të ndonjë marrëveshjeje të veçantë, Palët e Larta Kontraktuese heqin dorë reciprokisht nga përfitimi prej traktateve, konventave ose deklaratave në fuqi ndërmjet tyre, për të zgjidhur me anë të ankimit, mosmarrëveshjet që rrjedhin nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Konvente, në mënyra të ndryshme nga ato që parashikon Konventa në fjalë.

---

[7] Titulli i shtuar sipas dispozitave të Protokollit Nr 1 (ETS Nr 155)
[8] Nenet e këtij Seksioni rinumërtohen sipas dispozitave tw Protokollit Nr 11 (ETS Nr 155)
[9] Titulli i shtuar sipas dispozitave të Protokollit Nr 1 (ETS Nr 155)
[10] Titulli i shtuar sipas dispozitave të Protokollit Nr 1 (ETS Nr 155)
[11] Titulli i shtuar sipas dispozitave të Protokollit Nr 1 (ETS Nr 155)
[12] Titulli i shtuar sipas dispozitave të Protokollit Nr 1 (ETS Nr 155)

Neni 56[13]

Zbatimi territorial

1. Çdo Shtet, në momentin e ratifikimit ose në çdo moment tjetër të mëvonshëm, mund të deklarojë me njoftim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës se kjo Konventë, në bazë të paragrafit 4 të këtij neni, do të zbatohet mbi të gjitha territoret ose mbi secilin nga territoret për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilëve është përgjegjës.

2. Konventa do të zbatohet për territorin ose territoret e caktuara në njoftim, tridhjetë ditë pas datës në të cilën Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do të ketë marrë njoftim.

3. Në territoret e lartpërmendura, dispozitat e kësaj Konvente do të zbatohen duke marrë parasysh nevojat vendore.

4. Çdo Shtet, i cili ka bërë një deklaratë në përputhje me paragrafin e parë të këtij neni, në çdo rast të mëvonshëm, mund të deklarojë në emër të një ose më shumë territoreve të përmendur në këtë deklaratë, se pranon kompetencën e Gjykatës për shqyrtimin e kërkesave të individëve, të organizatave joqeveritare ose të grupeve të individëve të parashikuara në nenin 34 të kësaj Konvente.

Neni 57

Rezervat

1. Çdo Shtet, në momentin e nënshkrimit të kësaj Konvente ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, mund të formulojë ndonjë rezervë në lidhje me një dispozitë të veçantë të Konventës, në shkallën që një ligj në fuqi në atë kohë në territorin e tij nuk është në përputhje me këtë dispozitë. Sipas këtij neni, nuk lejohen rezervat me karakter të përgjithshëm.

2. Çdo rezervë e bërë në përputhje me këtë nen duhet të përmbajë një deklaratë të shkurtër të ligjit në fjalë.

Neni 58

Denoncimi

1. Një Palë e Lartë Kontraktuese mund të denoncojë këtë Konventë, vetëm pas kalimit të pesë vjetëve nga data e hyrjes së Konventës në fuqi për këtë palë dhe me një njoftim paraprak prej gjashtë muajsh drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, i cili informon Palët e tjera të Larta Kontraktuese.

2. Ky denoncim nuk mund të ketë si pasojë çlirimin e Palës së Lartë Kontraktuese në fjalë nga detyrimet e saj sipas kësaj Konvente lidhur me çdo akt që, po të përbëjë shkelje të këtyre detyrimeve, mund të jenë kryer nga ajo përpara datës në të cilën denoncimi hyn në fuqi.

3. Nën të njëjtat kushte që ndonjëra nga Palët e Larta Kontraktuese pushon së qënuri Anëtare e Këshillit të Evropës, pushon gjithashtu së qënuri Palë në këtë Konventë.

4. Konventa mund të denoncohet në përputhje me dispozitat e paragrafëve të mëparshëm përsa i përket çdo territori për të cilin ajo ka qenë deklaruar të zbatohet në bazë të nenit 56.

Neni 59

Nënshkrimi dhe ratifikimi

(Ndryshuar me ligjin nr.9453, datë 15.12.2005, protokolli nr.14, neni 17)

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrimin e Anëtarëve të Këshillit të Evropës. Ajo duhet të ratifikohet. Ratifikimet depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

2. Bashkimi Europian mund të aderojë në këtë Konventë.

[13] Tekst i amenduar sipas dispozitave të Protokollit Nr 11 (ETS Nr 155)

3. Kjo Konventë hyn në fuqi pas dorëzimit të dhjetë instrumenteve të ratifikimit.

4. Për çdo nënshkrues që do ta ratifikojë më vonë, Konventa do të hyjë në fuqi në datën e depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit.

5. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës njofton të gjithë Anëtarët e Këshillit të Evropës për hyrjen në fuqi të Konventës, për emrat e Palëve të Larta Kontraktuese që e kanë ratifikuar, si dhe për depozitimin e mëvonshëm të çdo instrumenti ratifikimi.

Bërë në Romë, më 4 Nëntor 1950, në frëngjisht dhe anglisht, të dy tekstet janë njëlloj autentikë, në një kopje të vetme, e cila depozitohet në arkivat e Këshillit të Evropës. Sekretari i Përgjithshëm i dërgon kopje të njësuara me origjinalin secilit nënshkrues.

PROTOKOLL SHTESË
I KONVENTËS PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE LIRIVE THEMELORE, AMENDUAR ME PROTOKOLLIN NR 11

Paris, 20. III. 1952

Titujt e neneve të shtuar dhe teksti i amenduar sipas dispozitave të Protokollit Nr 11 (ETS Nr 155), që prej hyrjes së tij në fuqi më 1 nëntor 1998.

Qeveritë nënshkruese, Anëtare të Këshillit të Evropës,

Të vendosura që të marrin masa për të siguruar zbatimin kolektiv të disa të drejtave dhe lirive të tjera nga ato të përfshira në Seksionin I të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore, të nënshkruar në Romë, më 4 nëntor 1950 (në vijim e referuar si "Konventa"),

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Mbrojtja e pronës

Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cënojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera,.

Neni 2
E drejta për arsimim

Askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për arsimim. Shteti, në ushtrimin e funksioneve që merr përsipër në fushën e edukimit dhe të arsimit, respekton të drejtën e prindërve për të siguruar këtë edukim dhe arsim në përputhje me bindjet e tyre fetare dhe filozofike.

Neni 3
E drejta për zgjedhje të lira

Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të organizojnë në intervale të arsyeshme kohore, zgjedhje të lira me votim të fshehtë, në kushte që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit për zgjedhjen e organit ligjvënës.

Neni 4[7]

Zbatimi territorial

Çdo Palë e Lartë Kontraktuese, në momentin e nënshkrimit ose të ratifikimit të këtij Protokolli ose në çdo moment tjetër të mëvonshëm, mund t'i komunikojë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës një deklaratë, ku cakton masën në të cilën ajo merr përsipër të zbatojë dispozitat e këtij Protokolli në territoret e përmendura në deklaratën në fjalë, marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilave ajo siguron.

Çdo Palë e Lartë Kontraktuese që ka komunikuar një deklaratë në bazë të paragrafit të mësipërm, mund të komunikojë herë pas here një deklaratë të mëtejshme që ndryshon përmbajtjen e çdo deklarate të mëparshme ose që i jep fund zbatimit të dispozitave të këtij Protokolli mbi çdo territor.

Një deklaratë e bërë në përputhje me këtë nen, do të konsiderohet të jetë bërë në përputhje me paragrafin (1) të nenit 56 të Konventës.

Neni 5

Marrëdhënia me Konventën

Palët e Larta Kontraktuese do t'i konsiderojnë nenet 1, 2, 3 dhe 4 të këtij Protokolli si nene shtesë të Konventës dhe për pasojë do të zbatohen të gjitha dispozitat e Konventës.

Neni 6

Nënshkrimi dhe ratifikimi

Ky Protokoll do të jetë i hapur për nënshkrim për anëtarët e Këshillit të Evropës, nënshkrues të Konventës; ai do të ratifikohet njëkohësisht me Konventën ose pas ratifikimit të saj. Ai do të hyjë në fuqi pas depozitimit të dhjetë instrumenteve të ratifikimit. Për çdo nënshkrues që do ta ratifikojë më vonë, Protokolli do të hyjë në fuqi në datën e depozitimit të instrumentit të ratifikimit.

Instrumentet e ratifikimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, i cili do t'u bëjë të njohur të gjithë Anëtarëve emrat e atyre që e kanë ratifikuar.

Bërë në Paris, më 20 mars 1952, në frëngjisht dhe anglisht, të dy tekstet janë njëlloj autentikë, në një kopje të vetme, e cila depozitohet në arkivat e Këshillit të Evropës. Sekretari i Përgjithshëm i dërgon kopje të njësuara me origjinalin secilës Qeveri nënshkruese.

PROTOKOLLI NR. 4
I KONVENTËS SË MBROJTJES SË TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE TË LIRIVE THEMELORE, I CILI SIGURON DISA TË DREJTA DHE LIRI TË TJERA NGA ATO QË PËRFSHIHEN TASHMË NË KONVENTËN DHE NË PROTOKOLLIN E PARË TË KONVENTËS AMENDUAR ME PROTOKOLLIN NR. 11

Strasburg, 16. IX. 1963

Qeveritë nënshkruese, anëtare të Këshillit të Evropës,

Të vendosura që të marrin masat e përshtatshme për të siguruar zbatimin e përbashkët të të drejtave dhe lirive, të tjera nga ato që përfshihen tashmë në Pjesën 1 të Konventës së Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore, të nënshkruar në Romë, më 4 nëntor 1950 (e quajtur më poshtë "Konventa") dhe nenet 1 deri 3 të Protokollit të Parë të Konventës, të nënshkruar në Paris më 20 mars 1952,

[7] Teksti i amenduar sipas dispozitave të Protokollit Nr 11 (ETS Nr 155)

Kanë rënë dakord për sa vijon:

Neni 1
Ndalimi i burgimit për borxhe

Askujt nuk mund t'i hiqet liria për arsyen e thjeshtë, se nuk është në gjendje të përmbushë një detyrim kontraktor.

Neni 2
Liria e lëvizjes

1. Kushdo që ndodhet në mënyrë të ligjshme në territorin e një Shteti ka të drejtë, brenda këtij territori, të lëvizë lirisht në të dhe të zgjedhë lirisht vendbanimin e tij.

2. Çdo person është i lirë të largohet nga çdo vend, duke përfshirë të tijin.

3. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund të bëhet objekt i kufizimeve të tjera nga ato të parashikuara në ligj dhe të domosdoshme në një shoqëri demokratike për sigurimin kombëtar ose sigurinë publike, ruajtjen e rendit publik, parandalimin e veprave penale, mbrojtjen e shëndetit apo të moralit, ose mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.

4. Të drejtat e parashtruara në paragrafin 1, në disa fusha të caktuara, mund t'u nënshtrohen disa kufizimeve të vendosura në përputhje me ligjin dhe të justifikuara nga interesi publik në një shoqëri demokratike.

Neni 3
Ndalimi i dëbimit të shtetasve

1. Askush nuk mund të dëbohet, me anë të një mase individuale ose kolektive, nga territori i Shtetit, shtetas i të cilit ai është.

2. Askujt nuk mund t'i hiqet e drejta për të hyrë në territorin e Shtetit, shtetas i të cilit ai është.

Neni 4
Ndalimi i dëbimit kolektiv të të huajve

Dëbimi kolektiv i të huajve është i ndaluar.

Neni 5
Zbatimi territorial

1. Çdo Palë e Lartë Kontraktuese, në çastin e nënshkrimit ose të ratifikimit të këtij Protokolli ose në çdo çast tjetër të mëvonshëm, mund t'i komunikojë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës një deklaratë, ku përcakton masën në të cilën ajo merr përsipër të zbatojë dispozitat e këtij Protokolli në territoret e përmendura në deklaratën në fjalë, marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilave ajo siguron.

2. Çdo Palë e Lartë Kontraktuese që ka komunikuar një deklaratë në bazë të paragrafit të mësipërm, herë pas here, mund të komunikojë një deklaratë të re që ndryshon termat e çdo deklarate të mëparshme ose që i jep fund zbatimit të dispozitave të këtij Protokolli mbi një territor çfarëdo.

3. Një deklaratë e bërë në përputhje me këtë nen do të konsiderohet e bërë në përputhje me paragrafin 1 të Nenit 56 të Konventës.

4. Territori i çdo Shteti për të cilin gjen zbatim ky Protokoll, në bazë të ratifikimit ose të pranimit të tij nga Shteti në fjalë dhe secili nga territoret për të cilin ky Protokoll gjen zbatim, në bazë të një deklarate të nënshkruar nga Shteti në fjalë sipas këtij neni, do të konsiderohen si territore më vete në vështrim të referencave që u bëhet territorit të një Shteti në Nenet 2 dhe 3.

5. Çdo Shtet, që ka bërë një deklaratë në përputhje me paragrafin 1 apo 2 të këtij Neni, në çdo çast të mëvonshëm, mund të deklarojë në emër të një ose më shumë territore të parashikuara në këtë deklaratë, se pranon kompetencën e Gjykatës për shqyrtimin e kërkesave të personave fizikë, të organizmave joqeveritare ose të grupeve të individëve, siç parashikohet në Nenin 34 të Konventës, në lidhje me të gjitha ose Nenet 1 deri 4 të këtij Protokolli.

Neni 6
Marrëdhëniet me Konventën

Palët e Larta Kontraktuese do t'i konsiderojnë nenet 1 deri 5 të këtij Protokolli si Nene shtesë të Konventës dhe për pasojë të gjitha dispozitat e Konventës do të zbatohen në lidhje me to.

Neni 7
Nënshkrimi dhe ratifikimi

1. Ky Protokoll u paraqitet për nënshkrim anëtarëve të Këshillit të Evropës, nënshkrues të Konventës; ai do të ratifikohet njëkohësisht me Konventën ose pas ratifikimit të Konventës. Ai do të hyjë në fuqi pas depozitimit të dhjetë instrumenteve të ratifikimit. Për çdo nënshkrues që do ta ratifikojë më vonë, Protokolli do të hyjë në fuqi në datën e depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit.

2. Instrumentet e ratifikimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, i cili do të informojë të gjithë Anëtarët për emrat e atyre që e kanë ratifikuar.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, rregullisht të autorizuar për këtë qëllim, kanë nënshkruar këtë Protokoll.

Bërë në Strasburg, më 16 shtator 1963, në Anglisht dhe Frëngjisht, të dy tekstet janë njëlloj autentikë, në një kopje të vetme, e cila depozitohet në arkivat e Këshillit të Evropës. Sekretari i Përgjithshëm i dërgon kopje të njësuara me origjinalin secilit shtet nënshkrues.

PROTOKOLLI Nr.6
I KONVENTËS PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE LIRIVE THEMELORE NË LIDHJE ME HEQJEN E DËNIMIT ME VDEKJE, AMENDUAR ME PROTOKOLLIN Nr.11

Strasburg, 28. IV. 1983

Titujt e neneve të shtuar dhe teksti i amenduar sipas dispozitave të Protokollit Nr 11 (ETS Nr 155), që prej hyrjes së tij në fuqi më 1 nëntor 1998.

Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës, nënshkruese të këtij Protokolli të Konventës së Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, të nënshkruar në Romë, më 4 nëntor 1950 (në vijim referuar si "Konventa"),

Duke marrë parasysh se zhvillimet e ndodhura në shumë shtete anëtare të Këshillit të Evropës tregojnë një prirje të përgjithshme në favor të heqjes së dënimit me vdekje,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Heqja e dënimit me vdekje

Dënimi me vdekje hiqet. Askush nuk mund të dënohet me një dënim të tillë, as të ekzekutohet.

Neni 2
Dënimi me vdekje në kohë lufte

Një shtet mund të parashikojë në legjislacionin e tij dënimin me vdekje për akte të kryera në kohë lufte ose rreziku shumë të afërt të luftës; një dënim i tillë do të zbatohet vetëm në rastet e parashikuara nga ky legjislacion dhe në përputhje me dispozitat e tij. Ky shtet do t'i komunikojë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës dispozitat përkatëse të legjislacionit në fjalë.

Neni 3
Ndalimi i derogimeve

Asnjë derogim nuk lejohet në lidhje me dispozitat e këtij Protokolli në bazë të nenit 15 të Konventës.

Neni 4[8]
Ndalimi i rezervave

Asnjë rezervë nuk pranohet në lidhje me dispozitat e këtij Protokolli në bazë të nenit 57 të Konventës.

Neni 5
Zbatimi territorial

1. Çdo shtet, në momentin e nënshkrimit ose të dorëzimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit ose miratimit, mund të caktojë territorin ose territoret në lidhje me të cilët do të gjejë zbatim ky Protokoll.

2. Çdo shtet, në çdo kohë të mëpasme mund ta shtrijë zbatimin e këtij Protokolli në lidhje me çdo territor tjetër të përcaktuar në një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës. Protokolli do të hyjë në fuqi në lidhje me këtë territor ditën e parë të muajit që do të pasojë datën e marrjes së deklaratës nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë në bazë të dy paragrafëve të mësipërm do të mund të tërhiqet, në lidhje me çdo territor të caktuar në atë deklaratë, me një njoftim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Tërheqja do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason datën e marrjes së njoftimit nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 6
Marrëdhëniet me Konventën

Shtetet Palë do t'i konsiderojnë nenet 1 deri 5 të këtij Protokolli si nene shtesë të Konventës dhe për pasojë do të zbatohen të gjitha dispozitat e Konventës.

Neni 7
Nënshkrimi dhe ratifikimi

Ky Protokoll është i hapur për nënshkrim nga Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, nënshkruese të Konventës. Ai do t'i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit. Një Shtet anëtar i Këshillit të Evropës nuk mund ta ratifikojë, pranojë ose miratojë këtë Protokoll pa ratifikuar paraprakisht ose njëkohësisht Konventën. Instrumentet e ratifikimit, të pranimit ose të miratimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

[8] Teksti i amenduar sipas dispozitave të Protokollit Nr 11 (ETS Nr 155)

Neni 8
Hyrja në fuqi

1. Ky Protokoll do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason datën në të cilën pesë Shtete anëtare të Këshillit të Evropës do të kenë shprehur pëlqimin e tyre për t'u lidhur me Protokollin, sipas dispozitave të nenit 7.

2. Për çdo Shtet anëtar që do të shprehë më vonë pëlqimin e tij për t'u lidhur me Protokollin, ky do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason datën e depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

Neni 9
Funksionet e depozitarit

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do t'i njoftojë Shtetet anëtare të Këshillit:
a) për çdo nënshkrim;
b) për dorëzimin e çdo instrumenti ratifikimi, pranimi ose miratimi;
c) për çdo datë të hyrjes në fuqi të këtij Protokolli sipas neneve 5 dhe 8;
d) për çdo akt, njoftim ose komunikim tjetër lidhur me këtë Protokoll.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, të autorizuar rregullisht për këtë qëllim, nënshkruajnë këtë Protokoll.

Bërë në Strasburg, më 28 Prill 1983**,** në anglisht dhe frëngjisht, të dy tekstet janë njëlloj autentikë, në një kopje të vetme, e cila depozitohet në arkivat e Këshillit të Evropës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës i dërgon kopje të njësuara me origjinalin secilit Shtet anëtar të Këshillit të Europës.

PROTOKOLLI NR. 7
I KONVENTËS PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE LIRIVE THEMELORE, AMENDUAR ME PROTOKOLLIN NR.11

Strasburg, 22. XI. 1984

Titujt e neneve të shtuar dhe teksti i amenduar sipas dispozitave të Protokollit Nr 11 (ETS Nr 155), që prej hyrjes së tij në fuqi më 1 nëntor 1998

Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës, nënshkruese të këtij Protokolli,

Të vendosura që të marrin masat e përshtatshme për të siguruar garancinë kolektive të disa të drejtave dhe lirive nga Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore, të nënshkruar në Romë, më 4 nëntor 1950 (në vijim e referuar si "Konventa"),

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Garancitë procedurale në lidhje me dëbimin e të huajve

1. Një i huaj me qëndrim të rregullt në territorin e një Shteti nuk mund të dëbohet, veçse në zbatim të një vendimi të marrë në përputhje me ligjin dhe duhet të ketë mundësi:

a) të parashtrojë arsyet kundër dëbimit të tij;

b) të kërkojë shqyrtimin e çështjes së tij;

c) të përfaqësohet për këto qëllime përpara autoritetit kompetent ose një ose disa persona të caktuar nga ky autoritet.

2. Një i huaj mund të dëbohet përpara ushtrimit të të drejtave të renditura në paragrafin 1.a, b dhe c të këtij neni, kur ky dëbim është i domosdoshëm në interes të rendit publik ose është bërë për arsye të sigurisë kombëtare.

Neni 2
E drejta e apelit në çështjet penale

1. Çdo person i shpallur fajtor për një vepër penale nga një gjykatë ka të drejtë të paraqesë për shqyrtim përpara një gjykate më të lartë deklarimin e fajësisë ose dënimin. Ushtrimi i kësaj të drejte, duke përfshirë shkaqet për të cilat ajo mund të ushtrohet, përcaktohet me ligj.
2. Nga kjo e drejtë mund të ketë përjashtime për vepra të lehta penale, siç përcaktohen me ligj, ose kur i interesuari ka qenë gjykuar në shkallë të parë nga gjykata më e lartë, ose shpallur fajtor dhe dënuar në vijim të një apeli kundër pafajësisë së tij.

Neni 3
Kompensimi për dënimin e padrejtë

Kur një person është dënuar për një vepër penale me vendim të formës së prerë dhe kur ky dënim është anuluar më vonë, ose në rast faljeje, për shkak të një fakti të ri ose të zbuluar rishtazi që provon një gabim gjyqësor, personi që ka pësuar ndëshkimin për arsye të këtij dënimi, zhdëmtohet sipas ligjit ose praktikës në fuqi në Shtetin në fjalë, me përjashtim të rastit kur është provuar se moszbulimi në kohën e duhur i faktit të panjohur është shkaktuar tërësisht ose pjesërisht prej personit në fjalë.

Neni 4
E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë

1. Askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet penalisht nga juridiksioni i të njëjtit Shtet për një vepër për të cilën ai më parë ka qenë shpallur i pafajshëm ose dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë, në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të atij Shteti.
2. Dispozitat e paragrafit të mësipërm nuk pengojnë rihapjen e procesit, në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të Shtetit të interesuar, në rast se fakte të reja ose të zbuluara rishtazi, ose një mangësi themelore në procedimet e mëparshme janë të një natyre të tillë që mund të cenojnë vendimin e dhënë.
3. Asnjë derogim nuk lejohet për këtë nen në përputhje me nenin 15 të Konventës.

Neni 5
Barazia ndërmjet bashkëshortëve

Bashkëshortët gëzojnë barazinë e të drejtave dhe të përgjegjësive me karakter civil midis tyre, si dhe në marrëdhëniet me fëmijët e tyre, në lidhje me martesën, gjatë martesës dhe gjatë zgjidhjes së saj. Ky nen nuk i pengon Shtetet që të marrin masat e nevojshme në interes të fëmijëve.

Neni 6
Zbatimi territorial

1. Çdo Shtet, në momentin e nënshkrimit ose të dorëzimit të instrumentit të tij të ratifikimit, të pranimit ose të miratimit, mund të caktojë territorin ose territoret në të cilët do të gjejë zbatim ky Protokoll, duke përcaktuar masën në të cilën ai merr përsipër të zbatojë dispozitat e këtij Protokolli në këtë ose këto territore.
2. Çdo Shtet, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, mund ta shtrijë zbatimin e këtij Protokolli në lidhje me çdo territor tjetër të specifikuar në

deklaratë. Në lidhje me këtë territor, Protokolli hyn në fuqi ditën e parë të muajit që pason kalimin e një periudhe prej dy muajsh nga data e marrjes së deklaratës nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë në bazë të dy paragrafëve të mësipërm mund të tërhiqet ose të ndryshohet, në lidhje me çdo territor të caktuar në atë deklaratë, me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Tërheqja ose ndryshimi hyn në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe prej dy muajsh pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

4. [9] Një deklaratë e bërë në përputhje me këtë nen do të konsiderohet e bërë në përputhje me paragrafin 1 të nenit 56 të Konventës.

5. Territori i çdo Shteti për të cilin gjen zbatim ky Protokoll në bazë të ratifikimit, pranimit ose miratimit të tij nga Shteti në fjalë dhe secili nga territoret për të cilin ky Protokoll gjen zbatim në bazë të një deklarate të nënshkruar nga Shteti në fjalë në përputhje me këtë nen, mund të konsiderohen si territore më vete duke marrë parasysh referimin që i bëhet territoreve të një Shteti në nenin 1.

6.[10] Çdo Shtet që ka bërë deklaratë sipas paragrafit 1 ose 2 të këtij neni, në çdo kohë të mëpasme, mund të deklarojë në lidhje me një ose më shumë territore të parashikuara në këtë deklaratë, se pranon kompetencën e Gjykatës për shqyrtimin e kërkesave të personave fizikë, të organizmave joqeveritare ose të grupeve të individëve, siç parashikohet në nenin 34 të Konventës, në lidhje me nenet 1 deri 5 të këtij Protokolli.

Neni 7
Marrëdhënia me Konventën

Shtetet Palë do t'i konsiderojnë nenet 1 deri 6 të këtij Protokolli si nene shtesë të Konventës dhe, për pasojë zbatohen të gjitha dispozitat e Konventës.

Neni 8
Nënshkrimi dhe ratifikimi

Ky Protokoll është i hapur për nënshkrim për Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, nënshkruese të Konventës. Ai do t'i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit. Një Shtet anëtar i Këshillit të Evropës nuk mund ta ratifikojë, pranojë ose miratojë këtë Protokoll pa ratifikuar paraprakisht ose njëkohësisht Konventën. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

Neni 9
Hyrja në fuqi

1. Ky Protokoll do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe prej dy muajsh pas datës në të cilën shtatë Shtete anëtare të Këshillit të Evropës do të kenë shprehur pëlqimin e tyre për t'u lidhur me Protokollin, sipas dispozitave të nenit 8.

2. Për çdo Shtet anëtar që do të shprehë më vonë pëlqimin e tij për t'u lidhur me Protokollin, ky i fundit do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe prej dy muajsh pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

[9] Tekst i amenduar sipas dispozitave të Protokollit Nr 11 (ETS Nr 155)
[10] Tekst i amenduar sipas dispozitave të Protokollit Nr 11 (ETS Nr 155)

Neni 10
Funksionet e depozitarit

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës njofton të gjithë Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës:

a) për çdo nënshkrim;
b) për depozitimin e çdo instrumenti ratifikimi, pranimi ose miratimi;
c) për çdo datë të hyrjes në fuqi të këtij Protokolli në përputhje me nenet 6 dhe 9;
d) për çdo akt, njoftim ose deklaratë tjetër që ka lidhje me këtë Protokoll.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, të autorizuar rregullisht për këtë qëllim, nënshkruajnë këtë Protokoll.

Bërë në Strasburg, më 22 nëntor 1984, në anglisht dhe frëngjisht, të dy tekstet janë njëlloj autentikë, në një kopje të vetme, e cila depozitohet në arkivat e Këshillit të Evropës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës i dërgon kopje të njësuara me origjinalin secilit Shtet Anëtar të Këshillit të Europës.

PROTOKOLLI Nr. 12
I KONVENTËS PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE LIRIVE THEMELORE

Romë, 4. XI. 2000

Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, nënshkruese të këtij protokolli,

Duke pasur parasysh parimin themelor, sipas të cilit të gjithë personat janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë për një mbrojtje të njëjtë nga ligji;

Të vendosur për të ndërmarrë hapa të mëtejshëm për të nxitur barazinë e të gjithë personave nëpërmjet zbatimit kolektiv të një ndalimi të përgjithshëm të diskriminimit në kuadrin e Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore të nënshkruar në Romë, më 4 nëntor 1950 (në vijim referuar si "Konventa");

Duke ripohuar që parimi i mosdiskriminimit nuk i ndalon Shtetet Palë të marrin masa me qëllim që të nxisin një barazi të plotë dhe efektive, me kusht që këto masa të kenë një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit

1. Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër.

2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.

Neni 2
Zbatimi territorial

1. Çdo Shtet, në momentin e nënshkrimit ose depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, pranimit ose miratimit, mund të caktojë territorin ose territoret në të cilat ky Protokoll gjen zbatim.

2. Çdo Shtet, në çdo kohë të mëpasme, mund ta shtrijë zbatimin e këtij Protokolli në lidhje me çdo territor tjetër të specifikuar në një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës,. Në lidhje me këtë territor, Protokolli hyn në fuqi ditën e parë të muajit që pason kalimin e një periudhe prej tre muajsh nga data e marrjes së njoftimit nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë në bazë të dy paragrafëve të mësipërm mund të tërhiqet ose të ndryshohet, në lidhje me çdo territor të caktuar në atë deklaratë, me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës. Tërheqja ose ndryshimi hyn në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

4. Një deklaratë e bërë në përputhje me këtë nen do të konsiderohet e bërë në përputhje me paragrafin 1 të nenit 56 të Konventës.

5. Çdo Shtet që ka bërë deklaratë sipas paragrafit 1 ose 2 të këtij neni, në çdo kohë të mëpasme, mund të deklarojë në lidhje me një ose më shumë territore të parashikuara në këtë deklaratë, se pranon kompetencën e Gjykatës për shqyrtimin e kërkesave të individëve, organizatave joqeveritare ose të grupeve të individëve, siç parashikohet në nenin 34 të Konventës në lidhje me nenin 1 të këtij Protokolli.

Neni 3
Marrëdhënia me Konventën

Shtetet Palë do t'i konsiderojnë dispozitat e neneve 1 dhe 2 të këtij Protokolli si nene shtesë të Konventës dhe, për pasojë do të zbatohen të gjitha dispozitat e Konventës.

Neni 4
Nënshkrimi dhe ratifikimi

Ky Protokoll është i hapur për nënshkrim nga Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, nënshkruese të Konventës. Ai i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit. Një Shtet anëtar i Këshillit të Evropës nuk mund ta ratifikojë, pranojë ose miratojë këtë Protokoll pa ratifikuar paraprakisht ose njëkohësisht Konventën. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

Neni 5
Hyrja në fuqi

1. Ky Protokoll do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe prej tre muajsh pas datës në të cilën dhjetë Shtete anëtare të Këshillit të Evropës do të kenë shprehur pëlqimin e tyre për t'u lidhur me Protokollin, sipas dispozitave të nenit 4.

2. Për çdo Shtet anëtar që do të shprehë më vonë pëlqimin e tij për t'u lidhur me këtë Protokoll, ky do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe prej tre muajsh pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

Neni 6
Funksionet e depozitarit

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës njofton të gjithë Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës:

a) për çdo nënshkrim;

b) për depozitimin e çdo instrumenti ratifikimi, pranimi ose miratimi;

c) për çdo datë të hyrjes në fuqi të këtij Protokolli në përputhje me nenet 2 dhe 5;

d) për çdo akt, njoftim ose deklaratë tjetër që ka lidhje me këtë Protokoll.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, të autorizuar rregullisht për këtë qëllim, kanë nënshkruar këtë Protokoll.

Bërë në Romë, më 4 nëntor 2000, në anglisht dhe frëngjisht, të dy tekstet janë njëlloj autentikë, në një kopje të vetme, e cila depozitohet në arkivat e Këshillit të Evropës. Sekretari i

Përgjithshëm i Këshillit të Evropës i dërgon kopje të njësuara me origjinalin secilit Shtet Anëtar të Këshillit të Europës.

PROTOKOLLI NR. 13
I KONVENTËS PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE TË LIRIVE THEMELORE NË LIDHJE ME HEQJEN E DËNIMIT ME VDEKJE NË ÇDO RRETHANË

Vilnius, 3.V. 2002

Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, nënshkruese të këtij protokolli,

Të bindur se e drejta e çdokujt për jetën është një vlerë themelore në një shoqëri demokratike dhe se shfuqizimi i dënimit me vdekje është thelbësor për mbrojtjen e kësaj të drejte dhe për njohjen e plotë të dinjitetit që i përket të gjitha qenieve njerëzore;

Duke dëshiruar që të përforcojnë mbrojtjen e së drejtës së jetës të garantuar nga Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore të nënshkruar në Romë, më 4 nëntor 1950 (tani e tutje e quajtur "Konventa")

Duke vënë re se Protokolli Nr. 6 i Konventës, në lidhje me Heqjen e Dënimit me Vdekje, i nënshkruar në Strasburg, më 28 prill 1983, nuk e përjashton dënimin me vdekje në lidhje me akte të kryera në kohë lufte ose rreziku shumë të afërt të luftës;

Të vendosur për të ndërmarrë një hap përfundimtar me qëllim shfuqizimin e dënimit me vdekje në çdo rrethanë,

Kanë rënë dakord për sa vijon:

Neni 1
Heqja e dënimit me vdekje

Dënimi me vdekje hiqet. Askush nuk mund të dënohet me një dënim të tillë dhe as të ekzekutohet.

Neni 2
Ndalimi i derogimeve

Asnjë derogim nuk lejohet në lidhje me dispozitat e këtij Protokolli, në bazë të nenit 15 të Konventës.

Neni 3
Ndalimi i rezervave

Asnjë rezervë nuk pranohet në lidhje me dispozitat e këtij Protokolli në bazë të nenit 57 të Konventës.

Neni 4
Zbatimi territorial

1. Çdo shtet, në çastin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, të pranimit ose të miratimit, mund të caktojë territorin ose territoret në lidhje me të cilët do të gjejë zbatim ky Protokoll.

2. Çdo shtet, në çdo kohë të mëvonshme, mund ta shtrijë zbatimin e këtij Protokolli në lidhje me çdo territor tjetër të përcaktuar në një deklarate të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës. Në lidhje me këtë territor, Protokolli hyn në fuqi ditën e parë të muajit që pason kalimin e një periudhe prej tre muajsh nga data e marrjes së njoftimit nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë në bazë të dy paragrafëve të mësipërm mund të tërhiqet ose të ndryshohet, në lidhje me çdo territor të caktuar në atë deklaratë, me anë të një njoftimi drejtuar

Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës. Tërheqja ose ndryshimi hyn në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 5
Marrëdhëniet me Konventën

Shtetet Palë do t'i konsiderojnë nenet 1 deri 4 të këtij Protokolli si nene shtesë të Konventës dhe, për pasojë, të gjitha dispozitat e Konventës do të zbatohen në lidhje me to.

Neni 6
Nënshkrimi dhe ratifikimi

Ky Protokoll u paraqitet për nënshkrim Shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, nënshkruese të Konventës. Ai i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit. Një Shtet anëtar i Këshillit të Evropës nuk mund ta ratifikojë, ta pranojë ose ta miratojë këtë Protokoll pa ratifikuar paraprakisht ose njëkohësisht Konventën. Instrumentet e ratifikimit, të pranimit ose të miratimit, do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

Neni 7
Hyrja në fuqi

1. Ky Protokoll do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe prej tre muajsh pas datës në të cilën dhjetë Shtete anëtare të Këshillit të Evropës do të kenë shprehur pëlqimin e tyre për të qenë të detyruar nga Protokolli, sipas dispozitave të nenit 6.

2. Për çdo Shtet anëtar që do të shprehë më vonë pëlqimin e tij për të qenë të detyruar nga ky Protokoll, ky i fundit do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe prej tre muajsh pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, të pranimit ose të miratimit.

Neni 8
Funksionet e depozitarit

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës njofton të gjithë Shtetet anëtarë të Këshillit të Evropës:

a) për çdo nënshkrim;

b) për depozitimin e çdo instrumenti ratifikimi, pranimi ose miratimi;

c) për çdo datë të hyrjes në fuqi të këtij Protokolli në përputhje me nenet 4 dhe 7;

d) për çdo akt, njoftim ose deklaratë tjetër që ka lidhje me këtë Protokoll.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, rregullisht të autorizuar për këtë qëllim, e nënshkruan këtë Protokoll.

Bërë në Vilnius, më 3 maj 2002, në frëngjisht dhe anglisht, të dy tekstet janë njëlloj autentikë, në një kopje të vetme, e cila depozitohet në arkivat e Këshillit të Evropës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës i dërgon kopje të njësuara me origjinalin secilit Shtet anëtar të Këshillit të Evropës.

PROTOKOLLI NR. 14
I KONVENTËS PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE LIRIVE THEMELORE, QË NDRYSHON SISTEMIN E KONTROLLIT TË KONVENTËS

Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, nënshkruese të këtij protokolli të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, nënshkruar në Romë, më 4 nëntor 1950 (që këtu do të quhet "Konventa"),

Duke pasur parasysh Rezolutën Nr.1 dhe Deklaratën e miratuar nga Konferenca Ndërministrore Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut, mbajtur në Romë më 3 dhe 4 nëntor 2000;

Duke pasur parasysh Deklaratat e miratuara nga Komiteti i Ministrave më 8 nëntor 2001, 7 nëntor 2002 dhe 15 maj 2003, në sesionin e tij, përkatësisht në Sesionet 109-të, 111-të dhe l12-të;

Duke pasur parasysh Opinionin Nr. 251 (2004) të miratuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës më 28 Prill 2004;

Duke ditur nevojën urgjente për ndryshimin e disa dispozitave të Konventës, me qëllim që të ruhet dhe përmirësohet efikasiteti i sistemit të kontrollit afatgjatë, kryesisht për shkak të rritjes së vazhdueshme të ngarkesës së punës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës;

Duke ditur veçanërisht nevojën për të garantuar që Gjykata të vazhdojë të luajë rolin e saj të madh në ruajtjen e të drejtave të njeriut në Evropë,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1-17*

Dispozita të fundit dhe transitore

Neni 18

1. Ky protokoll është i hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, nënshkruese të Konventës, që mund ta shprehin pëlqimin e tyre për t'u detyruar nëpërmjet:

a) nënshkrimit pa rezerva në lidhje me ratifikimin, pranimin ose aprovimin; ose

b) nënshkrimit që i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose aprovimit, pasuar nga ratifikimi, pranimi ose aprovimi.

2. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose aprovimit depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës.

Neni 19

Ky protokoll hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një periudhe tremujore pas datës në të cilën të gjitha Palët në Konventë kanë shprehur pëlqimin e tyre për t'iu nënshtruar këtij protokolli në pajtim me dispozitat e Nenit 18.

Neni 20

1. Duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij protokolli, dispozitat e tij zbatohen për të gjitha kërkesat që janë në shqyrtim e sipër në gjykatë, si dhe për të gjitha vendimet, ekzekutimi i të cilave është nën mbikëqyrjen e Komitetit të Ministrave.

2. Kriteri i ri i pranueshmërisë i prezantuar nëpërmjet Nenit 12 të këtij protokolli në Nenin 35, paragrafi 3.b të Konventës nuk zbatohet në lidhje me kërkesat e deklaruara të pranueshme para hyrjes në fuqi të këtij Protokolli. Në dy vitet e para pas hyrjes në fuqi të këtij Protokolli, kriteri i ri i pranueshmërisë mund të zbatohet vetëm nga Dhomat dhe Dhoma e Lartë e Gjykatës.

Neni 21

Mandati i gjyqtarëve që kanë mandatin e parë në datën e hyrjes në fuqi të këtij Protokolli zgjatet ipso jure deri në një afat total prej nëntë vjetësh. Gjyqtarët e tjerë përfundojnë mandatin e tyre, i cili zgjatet ipso jure me dy vjet.

Neni 22

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës njofton shtetet anëtare të Këshillit të Evropës për:

a) çdo nënshkrim;

b) depozitimin e çdo instrumenti ratifikimi, pranimi ose aprovimi;

e) datën e hyrjes në fuqi të këtij Protokolli në pajtim me Nenin 19;

d) çdo akt, njoftim ose komunikim tjetër që ka të bëjë me këtë Protokoll.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar rregullisht, kanë nënshkruar këtë Protokoll.

Bërë në Strasburg, më 13 maj 2004, në anglisht dhe frëngjisht, të dyja tekstet janë njëlloj autentike, në një kopje të vetme të cilat depozitohen në arkivat e Këshillit të Evropës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës u dërgon kopje të njësuara me origjinalin të gjitha shteteve anëtare të Këshillit të Evropës.

LIGJ
Nr.8427, datë 14.12.1998

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË ORGANIZATËN NDËRKOMBËTARE TË POLICISË KRIMINALE, INTERPOL

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Organizatën Ndërkombëtare të Policisë Kriminale-NTERPOL me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi në këtë Organizatë, parashikuar në Kushtetutën e INTERPOL-it.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2278, datë 23.12.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.30, faqe 1157

KUSHTETUTA E INTERPOLIT
PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Organizata e quajtur "Komisioni Ndërkombëtar i Policisë Kriminale" do të titullohet më poshtë: "Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale - Interpol". Qendra e saj do të jetë në Francë.

Neni 2

Qëllimet e saj janë:

1. Të sigurojë dhe të nxisë sa më gjerë që të jetë e mundur bashkëpunimin e ndërsjellë midis të gjitha autoriteteve të policisë kriminale brenda kufijve të ligjeve ekzistuese në vende të ndryshme dhe nën frymën e Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut;
2. Të vendosë dhe të zhvillojë të gjitha institucionet që kontribuojnë efektivisht në parandalimin dhe luftimin e krimit ordiner.

Neni 3

Është rreptësisht e ndaluar për Organizatën të ndërmarrë çdo veprim të një karakteri politik, ushtarak, fetar apo racial.

Neni 4

Çdo vend mund të delegojë si anëtar të Organizatës çdo strukturë policore zyrtare, funksionet e së cilës të përputhen me kuadrin e veprimtarive të Organizatës.

Kërkesa për anëtarësim duhet t'i drejtohet Sekretarit të Përgjithshëm nga autoriteti qeveritar i duhur.

Anëtarësimi do të jetë subjekt i miratimit me 2/3 e shumicës në Asamblenë e Përgjithshme.

STRUKTURA DHE ORGANIZIMI

Neni 5

Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale - Interpol do të përfshijë:

- Asamblenë e Përgjithshme
- Komitetin Ekzekutiv
- Sekretariatin e Përgjithshëm
- Zyrat Qendrore Kombëtare
- Këshilltarët.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Neni 6

Asambleja e Përgjithshme do të jetë autoriteti suprem në Organizatë. Ajo përbëhet nga delegatët e caktuar nga vendet anëtare të Organizatës.

Neni 7

Çdo vend anëtar mund të përfaqësohet nga një apo më shumë delegatë; megjithatë, për secilin vend do të ketë vetëm një kryetar delegacioni, i caktuar nga autoriteti qeveritar kompetent i atij vendi.

Nisur nga natyra teknike e Organizatës, anëtarët duhet të përpiqen të përfshijnë në delegacionet e tyre sa vijon:

a) Funksionarë të lartë departamentesh që merren me çështjet policore;

b) Funksionarë, detyrat e përditshme të të cilëve janë të lidhura me veprimtaritë e organizatës;

c) Specialistë sipas pikave të rendit të ditës.

Neni 8

Funksionet e Asamblesë së Përgjithshme do të jenë si vijon:

a) Të realizojë detyrat e sanksionuara në Kushtetutë;

b) të përcaktojë parimet dhe të sanksionojë masat e përgjithshme të nevojshme për realizimin e objektivave të Organizatës sipas nenit 2 të Kushtetutës;

c) të shqyrtojë dhe të miratojë programin e përgjithshëm të veprimtarive të përgatitura nga Sekretari i Përgjithshëm për vitin që vjen;

d) të përcaktojë çdo rregullore tjetër që del e nevojshme;

e) të zgjedhë personat për të kryer funksionet e përmendura në Kushtetutë;

f) të adoptojë rezoluta dhe t'i bëjë rekomandime anëtarëve në çështje për të cilat Organizata është kompetente për t'i ndjekur;

g) të përcaktojë politikën financiare të Organizatës;

h) të shqyrtojë dhe të miratojë çdo marrëveshje që do të bëhet me organizata të tjera.

Neni 9

Anëtarët do të bëjnë gjithçka brenda fuqive të tyre, derisa kjo të jetë në përputhje me obligimet e tyre, për të vënë në jetë vendimet e Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 10

Asambleja e Përgjithshme e Organizatës do të mblidhet çdo vit në sesion të zakonshëm. Ajo mund të mblidhet në seancë të jashtëzakonshme me kërkesë të Komitetit Ekzekutiv ose të shumicës së anëtarëve.

Neni 11

1. Asambleja e Përgjithshme mund, kur është e mbledhur në sesion, të krijojë komitete speciale për shqyrtimin e çështjeve të veçanta.

2. Ajo mundet, gjithashtu, të vendosë mbajtjen e konferencave rajonale midis dy sesioneve të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 12

1. Në përfundim të çdo sesioni, Asambleja e Përgjithshme do të zgjedhë vendin ku ajo do të mblidhet për sesion tjetër.

2. Asambleja e Përgjithshme mundet, gjithashtu, të vendosë se ku do të mblidhet për sesionet e saj në dy vitet që vijnë, nëse një ose më shumë vende kanë bërë ftesë për të organizuar atë sesion.

3. Nëse rrethanat e bëjnë të pamundur apo të papranueshme që një sesion të mblidhet në vendin e zgjedhur për të, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë të zgjedhë një vend tjetër për mbledhjen e vitit tjetër.

Neni 13

Vetëm një delegat nga secili vend do të ketë të drejtën e votës në Asamblenë e Përgjithshme.

Neni 14

Vendimet do të merren nga një shumicë e thjeshtë, përjashtuar rastet kur kërkohet në bazë të Kushtetutës një shumicë prej 2/3.

KOMITETI EKZEKUTIV

Neni 15

Komiteti Ekzekutiv do të përbëhet nga Presidenti i Organizatës, 3 zëvendëspresidentë dhe nëntë delegatë.

Trembëdhjetë anëtarët e Komitetit ekzekutiv do t'i përkasin vendeve të ndryshme, duke marrë në konsideratë shpërndarjen gjeografike.

Neni 16

Asambleja e Përgjithshme do të zgjedhë, midis delegatëve, Presidentin dhe tre zëvendëspresidentët e Organizatës.

Një shumicë 2/3 do të nevojitet për zgjedhjen e Presidentit; nëse kjo shumicë nuk arrihet, në votimin e dytë një shumicë e thjeshtë do të jetë e mjaftueshme.

Presidenti dhe zëvendëspresidentët do të jenë nga vende të ndryshme.

Neni 17

Presidenti do të zgjidhet për katër vjet. Zëvendëspresidentët do të zgjidhen për tre vjet. Ata nuk do të jenë përnjëherë të rizgjedhshëm, qoftë për të njëjtin post apo si delegatë në Komitetin Ekzekutiv.

Nëse, pas zgjedhjes së Presidentit, nuk mund të aplikohen apo janë të papërputhshme sanksionimet e nenit 15 (paragrafi 2) apo neni 16 (paragrafi 3), do të zgjidhet një zëvendëspresident i katërt në mënyrë që të katër kontinentet të jenë të përfaqësuara në nivel presidencial.

Nëse kjo ndodh, Komiteti Ekzekutiv, për një periudhë të përkohshme, do të ketë katërmbëdhjetë anëtarë. Periudha e përkohshme do të mbarojë sapo kushtet të bëjnë të mundur aplikimin e sanksionimeve të nenit 15 dhe 16.

Neni 18

Presidenti i Organizatës do të:

a) kryesojë mbledhjet e Asamblesë dhe Komitetit Ekzekutiv dhe do të drejtojë diskutimet;

b) sigurojë që veprimtaritë e Organizatës të jenë konform vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme dhe Komitetit Ekzekutiv;

c) mbajë përderisa të jetë e mundur kontakte të drejtpërdrejta dhe të qëndrueshme me Sekretarin e Përgjithshëm të Organizatës.

Neni 19

Nëntë delegatët e Komitetit Ekzekutiv do të zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë tre vjeçare. Ata nuk do të jenë përnjëherë të rizgjedhshëm për të njëjtin post.

Neni 20

Komiteti Ekzekutiv do të mblidhet të paktën njëherë për çdo vit sipas vendimit të Presidentit të Organizatës.

Neni 21

Në ushtrimin e funksioneve të tyre, të gjithë anëtarët e Komitetit ekzekutiv do të veprojnë si përfaqësues të Organizatës dhe jo si përfaqësues të vendeve të tyre përkatëse.

Neni 22

Komiteti Ekzekutiv:

a) do të mbikëqyrë ekzekutimin e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme;

b) do të përgatisë rendin e ditës për sesionet e Asamblesë së Përgjithshme;

c) do t'i paraqesë Asamblesë së Përgjithshme çdo program pune apo projekt që ai e konsideron të përshtatshëm;

d) do të mbikëqyrë administratën dhe punën e Sekretarit të Përgjithshëm;

e) do të ushtrojë të gjitha fuqitë e deleguara atij nga Asambleja.

Neni 23

Në rast dorëheqjeje apo vdekjeje të ndonjë anëtari të Komitetit Ekzekutiv, Asambleja e Përgjithshme do të zgjedhë një anëtar tjetër për të zëvendësuar atë dhe që afati i tij do të përfundojë në datën e parardhësit të tij. Asnjë anëtar i Komitetit Ekzekutiv nuk mund të qëndrojë në post në rast se ai nuk do të jetë më i deleguar i Organizatës.

Neni 24

Anëtarët e Komitetit Ekzekutiv do të qëndrojnë në post deri në sesionin e Asamblesë së Përgjithshme mbajtur në vitin në të cilin mbarojnë mandatet zyrtare të tyre.

SEKRETARIATI I PËRGJITHSHËM

Neni 25

Departamentet e përhershme të Organizatës do të përbëjnë Sekretariatin e Përgjithshëm.

Neni 26

Sekretariati i Përgjithshëm do të:

a) vërë në jetë vendimet e Asamblesë së Përgjithshme dhe të Komitetit Ekzekutiv;

b) shërbejë si një qendër ndërkombëtare në luftën kundër krimit ordiner;

c) shërbejë si qendër teknike dhe informuese;

d) sigurojë efikasitetin e administratës së Organizatës;

e) mbajë kontakte me autoritetet kombëtare dhe ndërkombëtare, atëherë kur do të ketë kërkesa që lidhen me kërkimin e kriminelëve dhe që do të trajtohen nëpërmjet Zzyrave Qendrore Kombëtare;

f) prodhojë çdo publikim që do të konsiderohet i nevojshëm;

g) organizojë dhe të kryejë punën e sekretariatit në sesionet e Asamblesë së Përgjithshme, Komitetit Ekzekutiv dhe çdo përbërësi tjetër të Organizatës;

h) hartojë drafte programesh pune për vitin që vjen për t'u marrë në konsideratë dhe miratuar nga Asambleja e Përgjithshme dhe Komitetit Ekzekutiv;

i) mbajë sa më ngushtë që të jetë e mundur kontakte konstante të drejtpërdrejta me Presidentin e Organizatës.

Neni 27

Sekretariati i Përgjithshëm përbëhet nga Sekretari i Përgjithshëm dhe stafi tekniko-administrativ i ngarkuar me punën e Organizatës.

Neni 28

Caktimi i Sekretariatit të Përgjithshëm do të propozohet nga Komiteti Ekzekutiv dhe do të miratohet nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë pesë vjeçare. Ai mund të ricaktohet për terma të tjerë por duhet të lërë postin me arritjen e moshës 65 vjeç, megjithatë ai mund të lejohet të mbarojë mandatin e tij edhe pasi ka arritur këtë moshë.

Ai duhet të zgjidhet midis personash shumë kompetentë në çështjet policore.

Në rrethana të veçanta, Komiteti Ekzekutiv mund të propozojë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme që Sekretari i Përgjithshëm të shkarkohet nga posti.

Neni 29

Sekretari i Përgjithshëm pranon dhe drejton stafin, administron buxhetin dhe organizon dhe drejton departamentet e përhershme, në bazë të direktivave të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme apo Komiteti Ekzekutiv.

Ai duhet t'i paraqesë Komitetit Ekzekutiv apo Asamblesë së Përgjithshme propozime apo projekte lidhur me punën e Organizatës.

Ai do të jetë përgjegjës para Komitetit Ekzekutiv dhe Asamblesë së Përgjithshme.

Ai do të ketë të drejtën të marrë pjesë në diskutimet e Asamblesë së Përgjithshme, Komitetit Ekzekutiv dhe çdo strukture të pavarur.

Gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, ai do të përfaqësojë Organizatën dhe jo ndonjë vend të veçantë.

Neni 30

Gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, Sekretari i Përgjithshëm dhe stafi, asnjëherë nuk duhet të nxisin apo pranojnë instruksione prej qeverish apo autoritetesh jashtë Organizatës. Ata duhet të abstenojnë ndaj çdo veprimi i cili mund të paragjykojë detyrat e tyre ndërkombëtare.

Çdo anëtar i Organizatës duhet të respektojë karakterin ekskluzivisht ndërkombëtar të detyrave të Sekretarit të Përgjithshëm dhe stafit, dhe të heqë dorë nga influencimi i tyre për mospërmbushjen e detyrave të tyre.

Të gjithë anëtarët e Organizatës duhet të bëjnë gjithçka që ata munden, për të asistuar Sekretarin e Përgjithshëm dhe stafin në përmbushjen e funksioneve të tyre.

ZYRAT QENDRORE KOMBËTARE

Neni 31

Në mënyrë që të plotësojë detyrat, Organizata ka nevojë për bashkëpunimin aktiv dhe të qëndrueshëm të anëtarëve të saj, të cilët duhet që me fuqinë e tyre në përputhje me legjislacionin e vendeve të tyre të marrin pjesë aktive në veprimtaritë e saj.

Neni 32

Në mënyrë që të sigurojë bashkëpunimin e sipërpërmendur, çdo vend duhet të përcaktojë një strukturë e cila do të shërbejë si ZYRË QENDRORE KOMBËTARE. Ajo duhet të sigurojë lidhjet:

a) me departamentet e ndryshme në vend;

b) me ato struktura të vendeve të tjera që shërbejnë si Zyra Qendrore Kombëtare;

c) me Sekretariatin e Përgjithshëm të Organizatës.

Neni 33

Në rastet e atyre vendeve ku përcaktimet e nenit 32 janë të paaplikueshme ose nuk lejojnë një bashkëpunim efektiv të centralizuar, Sekretariati i Përgjithshëm do të vendosë, për alternativa të tjera të përshtatshme bashkëpunimi.

KËSHILLTARËT

Neni 34

Për çështje shkencore, Organizata mund të këshillohet me "Këshilltarët".

Neni 35

Roli i këshilltarëve do të jetë thjesht këshillues.

Neni 36

Këshilltarët do të caktohen për tre vjet nga Komiteti Ekzekutiv. Caktimi i tyre do të bëhet definitiv vetëm pas notifikimit nga Asambleja e Përgjithshme.

Ata do të zgjidhen midis atyre që kanë një reputacion të gjerë botëror në fusha me interes për Organizatën.

Neni 37

Një këshilltar mund të hiqet nga posti me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

BUXHETI DHE BURIMET

Neni 38

Burimet e Organizatës do të sigurohen nga:

a) kontributi financiar i anëtarëve;

b) dhuratat, dhuratat me testament, subvencionimet, grantet dhe burime të tjera pasi këto janë pranuar apo miratuar nga Komiteti Ekzekutiv.

Neni 39

Asambleja e Përgjithshme do të vendosë kuotat e kontributeve të anëtarësisë dhe shpenzimin maksimal vjetor sipas vlerësimit që jepet nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 40

Buxheti i Organizatës do të hartohet nga Sekretari i Përgjithshëm dhe do t'i nënshtrohet miratimit të Komitetit ekzekutiv.

Ai do të vijë në fuqi pas pranimit nga Asambleja e Përgjithshme.

Kur Asambleja e Përgjithshme nuk ka mundësi të miratojë buxhetin, Komiteti Ekzekutiv do të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm duke iu referuar linjave të përgjithshme të buxhetit të mëparshëm.

MARRËDHËNIET ME ORGANIZATAT E TJERA

Neni 41

Sa herë që e shikon të arsyeshme, duke mbajtur parasysh qëllimin dhe objektivat e dhëna në Kushtetutë, Organizata do të vendosë marrëdhënie dhe do të bashkëpunojë me organizata të tjera ndërkombëtare ndërqeveritare dhe joqeveritare.

Rregullat e përgjithshme që kanë të bëjnë me marrëdhëniet me organizatat ndërkombëtare, ndërqeveritare apo joqeveritare do të jenë të vlefshme vetëm pasi të miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

Organizata mundet, në lidhje me çështje në të cilat është kompetente, të marrë këshilla nga organizata ndërkombëtare joqeveritare, nga organizata kombëtare qeveritare apo joqeveritare.

Me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme, Komiteti Ekzekutiv apo, në raste urgjente, Sekretari i Përgjithshëm mundet që të pranojë detyra brenda kompetencave dhe qëllimeve të veprimtarive të saj, si nga institucione apo organizata të tjera ndërkombëtare, ashtu edhe në zbatim të konventave ndërkombëtare.

APLIKIMI, MODIFIKIMI DHE INTERPRETIMI I KUSHTETUTËS

Neni 42

Kjo Kushtetutë mund të amendohet me propozimin e një anëtari apo të Komitetit Ekzekutiv.

Çdo propozim për amendim të kësaj Kushtetute do t'u komunikohet nga Sekretari i Përgjithshëm anëtarëve të Organizatës për vlerësim, e pakta tre muaj përpara mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

Të gjitha amendimet ndaj kësaj Kushtetute do të miratohen nga një shumicë prej 2/3 e anëtarëve të Organizatës.

Neni 43

Teksi në frëngjisht, anglisht dhe spanjisht i kësaj Kushtetute do të konsiderohen të njëvlershëm.

Neni 44

Aplikimi i kësaj Kushtetute do të përcaktohet nga Asambleja e Përgjithshme nëpërmjet Rregullave të Përgjithshme dhe Shtesave, vendimet e të cilës do të merren nga një shumicë prej 2/3.

MASAT E PËRKOHSHME

Neni 45

Të gjitha strukturat që përfaqësojnë vendet e përmendura në Shtesën I do të konsiderohen anëtarë të Organizatës përjashtuar kur ata do të deklarojnë nëpërmjet autoritetit qeveritar të përshtatshëm se nuk mund të pranojnë këtë Kushtetutë. Kjo deklaratë duhet të bëhet brenda gjashtë muajve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute.

Neni 46

Gjatë zgjedhjes së parë do të hidhet short për të përcaktuar një zëvendëspresident, mandati zyrtar i të cilit do të mbarojë një vit më vonë.

Gjatë zgjedhjes së parë do të hidhet shorti për të përcaktuar dy delegatë të Komitetit Ekzekutiv, mandati zyrtar i të cilëve do të mbarojë një vit më vonë, dhe dy të tjerë mandati zyrtar i të cilëve do të mbarojë dy vjet më vonë.

Neni 47

Personat, të cilët kanë ofruar shërbime të gjata dhe të çmueshme në hierarkinë e ICPO-së mund të vlerësohen nga Asambleja e Përgjithshme me tituj honorifikë në hierarkinë korresponduese të ICPO-së.

Neni 48

Të gjitha pasuritë që i përkasin Komisionit Ndërkombëtar të Policisë Kriminale janë transferuar tek Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale.

Neni 49

Në këtë Kushtetutë:

- "Organizata", sa herë që do të përmendet, do të thotë Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale;
- "Kushtetutë", sa herë që do të përmendet, do të thotë Kushtetuta e Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale;
- "Sekretar i Përgjithshëm" do të thotë Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale;
- "Komitet" do të thotë Komiteti Ekzekutiv i Organizatës;
- "Asamble" apo "Asamble e përgjithshme" do të thotë Asamble e Përgjithshme e Organizatës;
- "anëtar" apo "anëtarë" do të thotë një anëtar apo anëtarë të Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale, siç përcaktohet në nenin 4 të Kushtetutës;
- "delegat" (në njëjës) apo "delegatë" (në shumës) do të thotë një person apo persona që i përkasin një delegacioni apo delegacioneve siç përcaktohet në nenin 7;
- "delegat" (në njëjës) apo "delegatë" (në shumës) do të thotë një person apo persona të zgjedhur në Komitetin Ekzekutiv nën kushtet e parashtruara në nenin 19.

Neni 50

Kjo Kushtetutë do të hyjë në fuqi më 13 qershor 1956.

LIGJ
Nr.8496, datë 3.6.1999

PËR RATIFIKIMIN E "KONVENTËS KUADËR TË KËSHILLIT TË EUROPËS PËR MBROJTJEN E MINORITETEVE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe të nenit 121 të Kushtetutës, si dhe të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Konventa kuadër e Këshillit të Europës për mbrojtjen e minoriteteve".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2396, datë 18.6.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.21, faqe 672

KONVENTA KUADËR
PËR MBROJTJEN E MINORITETEVE

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe shtetet e tjera nënshkruese të kësaj Konvente kuadër,

Duke menduar se synimi i Këshillit të Europës është arritja e një uniteti më të madh ndërmjet anëtarëve të vet, me qëllim që të mbrojnë dhe realizojnë idealet dhe parimet, që përbëjnë trashëgiminë e tyre të përbashkët;

Duke gjykuar se njëra prej metodave për arritjen e këtij qëllimi është ruajtja dhe realizimi i mëtejshëm i të drejtave të njeriut dhe i lirive themelore;

Duke dashur që të zbatojnë deklaratën e kryetarëve të shteteve dhe të qeverive të shteteve, anëtare të Këshillit të Europës, miratuar në Vjenë më 9 tetor 1993;

Të angazhuar për të mbrojtur ekzistencën e minoriteteve në territoret e tyre përkatëse;

Duke pasur parasysh se ndryshimet në historinë e Europës kanë treguar, se mbrojtja e minoriteteve paraqet rëndësi për stabilitetin, sigurimin demokratik dhe paqen në këtë Kontinent;

Duke vlerësuar se një shoqëri pluraliste dhe e vërtetë demokratike duhet që jo vetëm të respektojë identitetin etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar të çdo personi, që i përket një minoriteti, por, gjithashtu dhe të krijojë kushtet e nevojshme që u japin atyre mundësi për të shprehur, ruajtur dhe zhvilluar këtë identitet;

Duke pasur parasysh se krijimi i një klime të tolerancës dhe të dialogut është e nevojshme që t'i mundësojë shumëllojshmërisë kulturore që të jetë një burim dhe faktor pasurimi për çdo shoqëri dhe jo faktor ndarjeje;

Duke vlerësuar se ndërtimi i një Europe tolerante dhe të begatë nuk varet vetëm nga bashkëpunimi ndërmjet shteteve, por kërkon, gjithashtu, edhe bashkëpunimin ndër kufitar ndërmjet autoriteteve vendore dhe rajonale, pa cenuar Kushtetutën dhe integritetin territorial të çdo shteti;

Duke pasur parasysh Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, dhe protokollet e saj;

Duke iu referuar angazhimeve për mbrojtjen e minoriteteve në Konventat dhe deklaratat e Kombeve të Bashkuara, dhe në dokumentet e Konferencës për Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Europë, veçanërisht Dokumentin e Kopenhagës, të 29 qershorit 1990;

Të angazhuar për të përcaktuar parimet që duhen respektuar dhe detyrimet që burojnë prej tyre, me qëllim që të sigurojnë, në shtete anëtare dhe shtete të tjera, që mund të bëhen palë në këtë instrument, mbrojtjen efektive të minoriteteve dhe të të drejtave dhe të lirive të personave, që u përkasin këtyre minoriteteve në kuadrin e shtetit ligjor, respektimit të integritetit territorial dhe sovranitetit kombëtar të shteteve;

Të vendosur për të zbatuar parimet e parashtruara në këtë Konventë kuadër, nëpërmjet legjislacionit kombëtar dhe politikave qeveritare, të përshtatshme,

Bien dakord si vijon:

PJESA I

Neni 1

Mbrojtja e minoriteteve dhe e të drejtave e lirive të personave, që u përkasin këtyre minoriteteve, formojnë një pjesë përbërëse të mbrojtjes ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, dhe si të tilla, përfshihen në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Neni 2

Dispozitat e kësaj Konvente Kuadër do të zbatohen në mirëbesim, në frymën e mirëkuptimit dhe të tolerancës, dhe në përputhje me parimet e fqinjësisë së mirë, të marrëdhënieve miqësore dhe të bashkëpunimit ndërmjet shteteve.

Neni 3

1. Çdo person, që i përket një minoriteti do të ketë të drejtën që të zgjedhë lirisht për t'u trajtuar apo jo si i tillë, dhe nuk do të ketë asnjë disavantazh nga kjo zgjedhje apo nga ushtrimi i të drejtave, që lidhen me këtë zgjedhje.

2. Personat, që u përkasin minoriteteve, mund të ushtrojnë të drejtat dhe të gëzojnë liritë, që burojnë prej parimeve të parashikuara në këtë Konventë Kuadër, në mënyrë individuale, si dhe në bashkësi me të tjerët.

PJESA II

Neni 4

1. Palët angazhohen t'u garantojnë personave, që u përkasin minoriteteve, të drejtën e barazisë para ligjit dhe të mbrojtjes së barabartë nga ligji. Lidhur me këtë do të ndalohet çdo diskriminim, bazuar në përkatësinë e një minoriteti.

2. Palët angazhohen që të miratojnë, sa herë që të jetë e nevojshme, masa të përshtatshme për të nxitur, në të gjitha sferat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore, barazi të plotë dhe efektive ndërmjet personave që i përkasin një minoriteti dhe atyre që u përkasin shumicës. Lidhur me këtë ata do të marrin parasysh, në mënyrën e duhur, kushtet e veçanta të personave që u përkasin minoriteteve.

3. Masat e miratuara në përputhje me paragrafin 2 nuk do të konsiderohen si një akt diskriminimi.

Neni 5

1. Palët angazhohen të nxisin kushtet e nevojshme për personat, që u përkasin minoriteteve, për të ruajtur dhe zhvilluar kulturën e tyre dhe për të ruajtur elementet themelore të këtij identiteti, konkretisht besimin fetar, gjuhën, traditat dhe trashëgiminë kulturore.

2. Pa cenuar masat e marra për realizimin e politikës së tyre të integrimit të përgjithshëm, Palët nuk do të ndërmarrin politika apo praktika, që synojnë asimilimin e personave që u përkasin minoriteteve, kundër vullnetit të tyre dhe do t'i mbrojnë këta persona nga çdo akt, që synon një asimilim të tillë.

Neni 6

1. Palët do të inkurajojnë frymën e tolerancës dhe dialogun ndërkulturor, dhe do të marrin masa efektive për të nxitur respektin e ndërsjellë, mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ndërmjet të gjithë personave që jetojnë në territorin e tyre, pa dallim, përsa i përket identitetit etnik, kulturor, gjuhësor apo fetar të këtyre personave, veçanërisht në fushën e arsimit, kulturës dhe shtypit.

2. Palët angazhohen të marrin masa të përshtatshme për të mbrojtur personat që mund t'u nënshtrohen kërcënimeve apo akteve të diskriminimit, armiqësisë apo dhunës, si pasojë e identitetit të tyre etnik, kulturor, gjuhësor apo fetar.

Neni 7

Palët do të sigurojnë respektimin e së drejtës të çdo personi, që i përket një minoriteti, për lirinë e grumbullimeve paqësore, lirinë e organizimit, lirinë e shprehjes dhe lirinë e mendimit, të ndërgjegjes dhe të besimit fetar.

Neni 8

Palët angazhohen të pranojnë se çdo person, që i përket një minoriteti, ka të drejtën të manifestojë fenë apo besimin e vet dhe të krijojë institucionet, organizatat dhe shoqatat fetare.

Neni 9

1. Palët angazohen të pranojnë se e drejta e lirisë së shprehjes së çdo personi, që i përket një minoriteti, përfshin lirinë për të pasur mendime dhe për të marrë dhe shpërndarë informacion e ide në gjuhën e minoritetit, pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pavarësisht nga kufijtë. Palët do të sigurojnë, brenda kuadrit të sistemeve të tyre ligjore, që personat që i përkasin një minoriteti nuk diskriminohen lidhur me raportet e tyre me shtypin.

2. Paragrafi 1 nuk do t'i ndalojë Palët që të kërkojnë, pa diskriminim dhe në bazë të kritereve objektive, licensimin e radiopërhapjes dhe të televizionit, apo ndërmarrjeve të kinemasë.

3. Palët nuk do të pengojnë krijimin dhe përdorimin e shtypit të shkruar nga personat që u përkasin minoriteteve. Në kuadrin ligjor të sistemit të përhapjes së radios dhe të televizionit, ata do të sigurojnë, për aq sa është e mundur dhe duke pasur parasysh dispozitat e paragrafit 1, që personave, që u përkasin minoriteteve, t'u jepen mundësi për të pasur dhe për të përdorur shtypin e tyre.

4. Në kuadrin e sistemit të tyre ligjor, Palët do të miratojnë masa të përshtatshme për të lehtësuar kontaktet me shtypin për personat që u përksin minoriteteve, për të nxitur tolerancën dhe për të lejuar shumëllojshmërinë kulturore.

Neni 10

1. Palët angazhohen të njohin se çdo person, që i përket një minoriteti, ka të drejtën të përdorë lirisht dhe pa ndërhyrje gjuhën e vet të minoritetit, në mënyrë personale dhe publike, me gojë dhe me shkrim.

2. Në zonat, ku personat që u përkasin minoriteteve, banojnë tradicionalisht apo në numër thelbësor, në qoftë se këta persona parashtrojnë kërkesë, dhe kur ajo i përgjigjet një nevoje reale, Palët do të përpiqen të sigurojnë, për aq sa është e mundur, kushtet që mund të bëjnë të mundur përdorimin e gjuhës së pakicës në marrëdhëniet ndërmjet këtyre personave dhe autoriteteve administrative.

3. Palët angazhohen të garantojnë të drejtën e çdo personi, që i përket një minoriteti për t'u informuar menjëherë, në një gjuhë që ai/ajo e kupton, për arsye të arrestimit të tij/saj dhe për natyrën e shkakun e çdo akuze kundër tij/saj, dhe për të mbrojtur veten në këtë gjuhë, dhe, nëse është e nevojshme, me ndihmën pa pagesë të një përkthyesi.

Neni 11

1. Palët angazhohen të njohin se çdo person që i përket minoritetit ka të drejtë të përdorë mbiemrin (prejardhjen) dhe emrat e parë në gjuhën e minoritetit dhe të drejtën për njohjen e tyre zyrtarisht, në përputhje me procedurat e parashikuara në sistemin e tyre ligjor.

2. Palët angazhohen të njohin se çdo person që i përket një minoriteti ka të drejtën të shfaqë në gjuhën e vet, të minoritetit, shenja, mbishkrime dhe informacione të tjera, të një natyre personale, në mënyrë të dukshme për publikun.

3. Në zonat e banuara tradicionalisht nga një numër thelbësor i personave të minoriteteve, palët do të përpiqen, në kuadrin e sistemit të tyre ligjor, përfshirë, kur është e përshtatshme, marrëveshje me shtetet e tjera, dhe, duke marrë parasysh kushtet e tyre të veçanta, të vendosin emrat tradicionalë vendas, emrat e rrugëve dhe tregues të tjerë topografikë për publikun edhe në gjuhën e minoritetit, kur ka një kërkesë të mjaftueshme për këta tregues.

Neni 12

1. Palët, kur është e përshtatshme, do të marrin masa, në fushën e arsimit dhe të studimeve për të nxitur njohjen e kulturës, të historisë, të gjuhës dhe të besimit fetar të minoritetit të tyre dhe të shumicës.

2. Në këtë kuadër, Palët do të sigurojnë, ndër të tjera, mundësi të përshtatshme për kualifikimin e mësuesve dhe për pajisjen me tekste shkollore, si dhe të lehtësojnë kontaktet ndërmjet studentëve dhe mësuesve të komuniteteve të ndryshme.

3. Palët angazhohen të nxisin mundësi të barabarta për ndjekjen e arsimit në të gjitha nivelet për personat që u përkasin minoriteteve.

Neni 13

1. Në kuadrin e sistemeve të tyre arsimore, Palët do të njohin se, personat, që u përkasin një minoriteti, kanë të drejtë të ndërtojnë dhe të drejtojnë institucionet e tyre arsimore dhe kualifikuese private.

2. Ushtrimi i kësaj të drejte nuk do të sjellë ndonjë detyrim financiar për Palët.

Neni 14

1. Palët angazhohen të njohin se çdo person, që i përket një minoriteti, ka të drejtë të mësojë gjuhën e vet, të minoritetit.

2. Në zonat ku personat, që u përkasin minoriteteve, banojnë tradicionalisht apo në numër thelbësor, nëse ka një kërkesë të mjaftueshme, Palët do të përpiqen të sigurojnë, për aq sa është e mundur, dhe në kuadrin e sistemeve të tyre arsimore, që personat, që u përksin këtyre minoriteteve, të kenë mundësi të përshtatshme për të mësuar gjuhën e minoritetit apo për të marrë mësime në këtë gjuhë.

3. Paragrafi 2, i këtij neni do të zbatohet pa cenuar mësimin e gjuhës zyrtare apo mësimin në këtë gjuhë.

Neni 15

Palët do të krijojnë kushtet e nevojshme për pjesëmarrjen aktive të personave, që u përkasin minoriteteve, në jetën kulturore, shoqërore dhe ekonomike dhe në çështjet publike, veçanërisht për ato që ndikojnë mbi ta.

Neni 16

Palët nuk do të ndërmarrin masa që ndryshojnë përbërjen e popullsisë, në zonat e banuara nga personat, që u përkasin monoriteteve, dhe që synojnë kufizimin e të drejtave e lirive, që burojnë nga parimet e parashikuara në këtë konventë kuadër.

Neni 17

1. Palët angazhohen të mos ndërhyjnë në të drejtën e personave, që u përkasin minoriteteve, për të vendosur dhe mbajtur kontakte të lira dhe paqësore përgjatë kufijve me personat që banojnë ligjërisht në shtete të tjera, veçanërisht me ata me të cilët kanë një identitet etnik, kulturor, gjuhësor apo fetar, apo një trashëgimi të përbashkët kulturore.

2. Palët angazhohen të mos ndërhyjnë në të drejtën e personave, që u përkasin minoriteteve, për të marrë pjesë në veprimtaritë e organizatave joqeveritare, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Neni 18

1. Palët do të përpiqen të përfundojnë, kur është e nevojshme, marrëveshje dypalëshe dhe shumëpalëshe me shtetet e tjera, veçanërisht me shtetet fqinjë, për të siguruar mbrojtjen e personave, që u përkasin minoriteteve, përkatëse.

2. Kur është me vend, Palët do të marrin masa për të inkurajuar bashkëpunimin ndërkufitar.

Neni 19

Palët angazhohen të respektojnë dhe të zbatojnë parimet e parashikuara në këtë Konventë Kuadër, duke bërë, kur është e nevojshme, vetëm ato kufizime apo shmagie, që janë parashikuar në instrumentet juridike, ndërkombëtare, veçanërisht në Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, në masën që ato janë të përshtatshme për të drejtat dhe liritë që burojnë nga këto parime

PJESA III

Neni 20

Në ushtrimin e të drejtave dhe të lirive, që burojnë nga parimet e parashikuara në këtë Konventë Kuadër, çdo person që i përket një minoriteti do të respektojë legjislacionin kombëtar dhe të drejtat e të tjerëve, veçanërisht ato të personave që u përkasin shumicës apo minoriteteve të tjera.

Neni 21

Në këtë Konventë Kuadër asgjë nuk do të interpretohet se nënkupton ndonjë të drejtë për t'u angazhuar në veprimtari apo për të kryer ndonjë veprim kundër parimeve themelore të së drejtës ndërkombëtare, dhe veçanërisht kundër barazisë sovrane, integritetit territorial dhe pavarësisë politike të shteteve.

Neni 22

Në këtë Konventë Kuadër asgjë nuk kufizon apo shmang ndonjë prej të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, që mund të sigurohen sipas ligjeve të ndonjë pale kontraktuese, apo ndonjë marrëveshjeje tjetër, ku ajo është palë.

Neni 23

Të drejtat dhe liritë, që burojnë nga parimet e parashikuara në këtë konventë kuadër, në masën që ato janë objekt i një dispozite përgjegjëse në Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore apo në protokollet e saj, do të kuptohen në një mënyrë, e cila vjen në përputhje me dispozitat e kësaj të fundit.

PJESA IV

Neni 24

1. Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës do të mbikëqyrë zbatimin nga palët kontraktuese të kësaj konvente kuadër.

2. Palët, të cilat nuk janë anëtare të Këshillit të Europës, do të marrin pjesë në mekanizmin zbatues, sipas procedurave që do të përcaktohen.

Neni 25

1. Brenda një periudhe njëvjeçare pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente Kuadër, lidhur me një palë kontraktuese, kjo e fundit do t'i transmetojë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës informacion të plotë mbi masat legjislative dhe masat e tjera, të marra për zbatimin e parimeve të parashtruara në këtë Konventë Kuadër.

2. Për periudhën më pas, secila palë do t'i transmetojë Sekretarit të Përgjithshëm, periodikisht dhe sa herë që kërkon Komiteti i Ministrave, çdo informacion shtesë, përkatës për zbatimin e kësaj Konvente Kuadër.

3. Sekretari i Përgjithshëm do t'i parashtrojë Komitetit të Ministrave informacionin e transmetuar, sipas kushteve të këtij neni.

Neni 26

1. Në vlerësimin e përshtatshmërisë së masave të marra nga palët për të zbatuar parimet e parashtruara në këtë Konventë Kuadër, Komiteti i Ministrave do të ndihmohet nga një komitet këshillimor, anëtarët e të cilit do të kenë një kualifikim të njohur në fushën e mbrojtjes së minoriteteve.

2. Përbërja e këtij komiteti këshillimor dhe procedurat e tij do të përcaktohen nga Komiteti i Ministrave, brenda një periudhe njëvjeçare pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente Kuadër.

PJESA V

Neni 27

Kjo Konventë Kuadër do të hapet për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës. Deri në datën e hyrjes në fuqi të konventës, ajo do të jetë e hapur për nënshkrimin gjithashtu edhe nga ndonjë shtet tjetër, i ftuar nga Komiteti i Ministrave. Ajo i nënshtrohet ratifikimit, pranimit apo miratimit. Instrumentet e ratifikimit, të pranimit apo të miratimit do të depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 28

1. Kjo konventë do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit pasues pas periudhës 3-mujore pas datës në të cilën 12 shtetet, anëtare të Këshillit të Europës, kanë shprehur pëlqimin e tyre për të pranuar, si të detyrueshme, konventën, në përputhje me dispozitat e nenit 27.

2. Lidhur me secilin shtet anëtar, i cili shpreh më pas pëlqimin e vet për ta pranuar si të detyrueshme atë, Konventa Kuadër do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit pasues pas periudhës 3-mujore, pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, të pranimit apo të miratimit.

Neni 29

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente Kuadër dhe pas këshillimit të shteteve kontraktuese, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës mund të ftojë, për të aderuar në konventë, nëpërmjet një vendimi të marrë me shumicën e parashikuar në nenin 20, pika d të statutit të Këshillit të Europës, çdo shtet joanëtar të Këshillit të Europës, që i ftuar të nënshkruajë në përputhje me dispozitat e nenit 27, nuk e ka bërë këtë ende, dhe çdo shtet tjetër joanëtar.

2. Lidhur me ndonjë shtet aderues, i cili shpreh më pas pëlqimin për ta pranuar si të detyrueshme atë, Konventa Kuadër do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit pasues pas periudhës 3-mujore, pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, të pranimit apo të miratimit.

Neni 30

1. Secili shtet mund të përcaktojë, në kohën e nënshkrimit, apo kur depoziton instrumentin e vet të ratifikimit, të pranimit, të miratimit apo të aderimit, territorin apo territoret për të cilat ai është përgjegjës në marrëdhëniet ndërkombëtare, ku do të zbatohet kjo konventë kuadër.

2. Secili shtet mund të zgjerojë, në një kohë të mëvonshme, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, zbatimin e kësaj Konvente Kuadër në çdo territor tjetër, të përcaktuar në deklaratë. Lidhur me këto territore, Konventa Kuadër do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit pasues pas përfundimit të periudhës 3-mujore, pas datës së marrjen së një deklarate të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë sipas dy paragrafëve të mësipërm mund të tërhiqet, lidhur me çdo territor të përcaktuar në këtë deklaratë, me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Tërheqja do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit pasues pas përfundimit të periudhës 3-mujore, pas datës së marrjes së një njoftimi të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 31

1. Secila palë mund ta denoncojë, në çdo moment, këtë Konventë Kuadër nëpërmjet një nojftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithsëm të Këshillit të Europës.

2. Ky denoncim do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit pasues, pas përfundimit të një periudhe 6-mujore, pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 32

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të njoftojë shtetet anëtare të këtij këshilli, shtetet e tjera nënshkruese dhe çdo shtet, që ka aderuar në këtë Konventë Kuadër për:

a)çdo nënshkrim;

b) depozitimin e secilit instrument të ratifikimit, të pranimit, të miratimit apo të aderimit;

c) secilën datë të hyrjes në fuqi të kësaj konvente kuadër, në përputhje me nenet 28, 29 dhe 30;

ç) secilin veprim, njoftim apo komunikim tjetër, për këtë konventë kuadër.

Në prani të nënshkruesve, të autorizuar në mënyrën e duhur, kanë nënshkruar këtë konventë kuadër.

Bërë në _____, datën e , në gjuhën angleze dhe franceze, duke pasur të dyja tekstet të njëjtën vlerë, në një kopje të vetme, e cila do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'ia transmetojë kopjet e vërtetuara secilit shtet, anëtar të Këshillit të Europës, dhe secilit shtet të ftuar për të nënshkruar apo për të aderuar në këtë Konventë Kuadër.

LIGJ
Nr.8497, datë 10.6.1999

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SË KËSHILLIT TË EUROPËS "PËR TRANSFERIMIN E PROCEDIMEVE NË ÇËSHTJET PENALE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet Konventa e Këshillit të Europës "Për transferimin e procedimeve në çështjet penale", me deklarimet dhe rezervimet e bëra në këtë ligj.

Neni 2

Bazuar në nenin 18 paragrafi 2 të Konventës, Republika e Shqipërisë deklaron se kërkesat në çdo dokument tjetër, që lidhet me to, në qoftë se nuk janë paraqitur në njërën nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Europës, duhet të shoqërohen me një përkthim në gjuhën shqipe ose në njërën nga ato gjuhë.

Neni 3

Lidhur me Shtojcën II paragrafi i dytë, për qëllim të kësaj Konvente, "shtetas" do të kuptohen edhe personat pa shtetësi që kanë banim të përhershëm në Shqipëri, si dhe ata që mbajnë dy shtetësi, ku njëra është shqiptare.

Neni 4

Duke ndjekur nenin 41 dhe Shtojcën I të Konventës, Republika e Shqipërisë do të refuzojë procedimet për rastet e shkronjave “a”, “b” dhe “g”.

Neni 5

Republika e Shqipërisë refuzon të zbatojë nenet 22 dhe 23 të Konventës.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2400, datë 29.6.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.21, faqe 681

KONVENTA EUROPIANE
MBI TRANSFERIMIN E PROCEDIMEVE NË ÇËSHTJET PENALE

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës, këtu nënshkruese,

Duke pasur parasysh se qëllimi i Këshillit të Europës është arritja e një uniteti më të madh midis anëtarëve të tij;

Duke dëshiruar të plotësojnë punën që kanë bërë në fushën e të drejtës penale, me synimin e arritjes së sanksioneve me të drejta dhe më frytdhënëse;

Duke e vlerësuar të dobishëm në këtë kuptim sigurimin, me frymën e një mirëbesimi reciprok, të organizimit të procedimeve penale në nivel ndërkombëtar dhe në veçanti, duke shmangur disavantazhet që rezultojnë nga konfliktet e kompetencave,

Kanë rënë dakord si vijon:

PJESA I
PËRKUFIZIME

Neni 1

Për qëllimet e kësaj Konvente:

(a) “vepër penale” përfshin aktet që janë trajtuar nga e drejta penale dhe ato të trajtuara nga dispozitat ligjore të renditura në shtojcën III të kësaj Konvente me kusht që në rastin kur një autoritet administrativ ka kompetencën që të merret me veprën penale, personi i interesuar duhet të ketë të drejtën që çështja e tij të gjykohet nga një gjyq.

(b) “sanksion” nënkupton çdo ndëshkim ose masë tjetër të pësuar ose të vendosur në lidhje me një vepër penale ose cenim të dispozitave të renditura në shtojcën III.

PJESA II
KOMPETENCA

Neni 2

1. Për qëllimet e zbatimit të kësaj Konvente, çdo shtet kontraktues do të ketë kompetencën të ndjekë penalisht sipas ligjit të tij penal çdo vepër penale ndaj së cilës është i zbatueshën ligji i një shteti tjetër kontraktues.

2. Kompetenca dhënë një shteti kontraktues, ekskluzitivisht në bazë të paragrafit 1 të këtij neni, mund të ushtrohet vetëm në pajtim me një kërkesë për procedime të paraqitura nga një shtet tjetër kontraktues.

Neni 3

Çdo shtet kontraktues, duke pasur sipas ligjit të tij kompetencën për të ndjekur penalisht një vepër penale, për qëllimet e zbatimit të kësaj Konvente, mund të heqë dorë ose të ndërpresë procedimet kundër personit të dyshuar, i cili është duke u ndjekur penalisht ose do të ndiqet për të njëjtën vepër penale, nga një shtet tjetër kontraktues. Duke pasur parasysh nenin 21 paragrafi 2, çdo vendim i tillë, për të ndërprerë ose hequr dorë nga procedimet, do të jetë i përkohshëm deri në një vendim përfundimtar në shtetin tjetër kontraktues.

Neni 4

Shteti i kërkuar do të ndërpresë procedurat gjyqësore, të parashikuara ekskluzivisht në nenin 2, kur sipas tij e drejta për të dënuar i është hequr sipas ligjit të shtetit kërkues për një arsye përveç asaj që ka të bëjë me afatin, ndaj të cilës zbatohen në veçanti nenet 10(c), 11(f) dhe (g), 22, 23 dhe 26.

Neni 5

Dispozitat e Pjesës III të kësaj Konvente nuk kufizojnë kompetencën që i jepet një shteti të kërkuar prej ligjit të tij të brendshëm përsa i përket ndjekjeve penale.

PJESA III
TRANSFERIMI I PROCEDIMEVE

SEKSIONI I
KËRKESA PËR PROCEDIME

Neni 6

1. Kur një person është dyshuar për kryerjen e një vepre penale sipas ligjit të një shteti kontraktues, ky shtet mund t'i kërkojë një shteti tjetër kontraktues që të fillojë procedimet në rastet dhe sipas kushteve të parashikuara në këtë Konventë.

2. Në qoftë se sipas dispozitave të kësaj Konvente një shtet kontraktues mund t'i kërkojë një shteti tjetër kontraktues që të fillojë procedimet, atëhere autoritetet kompetente të shtetit të parë do ta vlerësojnë këtë mundësi.

Neni 7

1. Procedimet nuk mund të nisin në shtetin e kërkuar në qoftë se vepra penale për të cilën janë kërkuar procedimet nuk do të jetë kryer në territorin e tij dhe kur, sipas këtyre rrethanave, personi i dyshuar nuk do të jetë gjithashtu përgjegjës ndaj sanksionit sipas ligjit të tij.

2. Në qoftë se vepra penale është kryer nga një person me status publik ose kundër një personi, institucioni apo ndonjë gjëje me status të tillë në shtetin kërkues, në shtetin e kërkuar kjo vepër penale do të konsiderohet sikur të jetë kryer nga një person me status publik ose kundër një personi, institucioni apo ndonjë korresponduesi, në shtetin e fundit, ndaj atij kundër të cilit ajo është kryer.

Neni 8

1. Një shtet kontraktues mund t'i kërkojë një shteti tjetër kontraktues të fillojë procedimet në një nga rastet e mëposhtme:

(a) në qoftë se personi i dyshuar është banues i përhershëm në shtetin e kërkuar;

(b) në qoftë se personi i dyshuar është shtetas i shtetit të kërkuar ose nëse ky shtet është shteti i tij i origjinës;

(c) në qoftë se personi i dyshuar është duke vuajtur ose duhet të vuajë një dënim që përfshin heqjen e lirisë në shtetin e kërkuar;

(d) në qoftë se procedimet për të njëjtën ose vepra penale të tjera janë ndërmarrë kundër personit të dyshuar në shtetin e kërkuar;

(e) në qoftë se ai e konsideron që transferimi i procedimeve është i jusitikuar në interes të arritjes së të vërtetës dhe në veçanti, që çështjet më të rëndësishme që lidhen me provat janë në shtetin e kërkuar;

(f) në qoftë se ai e konsideron që detyrimi për zbatimin e një dënimi që mund të jetë dhënë në shtetin e kërkuar ka të ngjarë që të përmirësojë perspektivat për rehabilitimin shoqëror të personit të dënuar;

(g) në qoftë se ai e konsideron që prania e personit të dyshuar nuk mund të sigurohet në seancat e procedimeve në shtetin kërkues dhe që prania e tij vetjake në këto seanca të procedimeve mund të sigurohet në shtetin e kërkuar;

(h) në qoftë se ai e konsideron që ai vetë nuk mund të kërkojë zbatimin e një dënimi që mund të jetë dhënë edhe nëpërmjet kërkimit të ekstradimit dhe se shteti i kërkuar mund ta bëjë këtë gjë.

2. Në rastet kur personi i dyshuar ka qenë dënuar përfundimisht në një shtet kontrktues, ky shtet mund të kërkojë transferimin e procedimeve për një ose disa nga rastet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, vetëm në qoftë se ai vetë nuk mund të kërkojë zbatimin e dënimit, madje edhe duke kërkuar ekstradimin, dhe në qoftë se shteti tjetër kontraktues nuk pranon zbatimin e një vendimi gjyqësor të huaj si një çështje parimi ose refuzon të zbatojë një vendim të tillë.

Neni 9

1. Autoritetet kompetente në shtetin e kërkuar do të shqyrtojnë kërkesën për procedime të bëra në pajtim me nenin paraprirës. Ato do të vendosin në përputhje me ligjin e tyre, se çfarë veprimi do të ndërmarrin si pasojë.

2. Në rastet kur ligji i shtetit të kërkuar parashikon dënimin e një vepre penale nga një autoritet administrativ, ai shtet, sa më shpejt që të jetë e mundur, do të informojë shtetin kërkues në qoftë se shteti i kërkuar nuk do të ketë bërë një deklaratë, sipas paragrafit 3 të këtij neni.

3. Çdo shtet kontraktues, në kohën e nënshkrimit ose të depozitimit të dokumentit të ratifikimit, pranimit ose aderimit ose në ndonjë datë të mëvonshme, nëpërmjet deklaratës adresuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund të tregojë kushtet sipas të cilave ligji i tij i

brendshëm lejon dënimin e veprave penale të caktuara nga një autoritet administrativ. Një deklaratë e tillë do të zëvendësojë njoftimin e përmendur në paragrafin 2 të këtij neni.

Neni 10

Shteti i kërkuar nuk do të fillojë veprimet në bazë të kërkesës:

(a) në qoftë se kërkesa nuk është në përputhje me dispozitat e nenit 6 paragrafi 1 dhe nenit 7 paragrafi 1;

(b) në qoftë se fillimi i procedimeve është në kundërshtim me dispozitat e nenit 35;

(c) në qoftë se në datën e kërkesës, afati për procedurat gjyqësore penale ka mbaruar sipas legjislacionit të shtetit të kërkuar.

Neni 11

Përveç se çfarë është parashikuar në nenin 10, shteti i kërkuar nuk mund të refuzojë pranimin e pjeshëm ose të plotë të kërkesës, përveç njërit prej rasteve të përmendura më poshtë:

(a) në qoftë se ai e konsideron që arsyet mbi të cilat është bazuar kërkesa nuk janë të justifikuara sipas nenit 8;

(b) në qoftë se personi i dyshuar nuk është banues i përhershëm në shtetin e kërkuar;

(c) në qoftë se personi i dyshuar nuk është shtetas i shtetit të kërkuar;

(d) në qoftë se ai e konsideron që krimi për të cilin janë kërkuar procedimet është i një natyre politike, ushtarke apo financiare;

(e) në qoftë se ai e konsideron se ka arsye thelbësore për të besuar që kërkesa për procedime është motivuar për shkak të racës, besimit, kombësisë ose bindjeve politike;

(f) në qoftë se ndaj veprës penale është i zbatueshëm ligji i tij dhe në qoftë se në kohën e marrjes së kërkesës, procedimet ishin ndaluar për shkak të kalimit të afatit sipas atij ligji; neni 26 paragrafi 2 nuk do të zbatohet në këtë rast;

(g) në qoftë se kompetenca e tij është parashikuar ekskluzivisht në nenin 2 dhe në qoftë se në kohën e marrjes së kërkesës, procedimet do të pengohen për shkak të kalimit të afatit sipas ligjit të tij, do të merret parasysh zgjatja e afatit prej gjashtë muajsh sipas kuptimit të nenit 23;

(h) në qoftë se vepra penale është kryer jashtë territorit të shtetit kërkues;

(i) në qoftë se procedurat gjyqësore do të ishin në kundërshtim me angazhimet ndërkombëtare të shtetit të kërkuar;

(j) në qoftë se procedurat gjyqësore do të ishin në kundërshtim me parimet themelore të sistemit ligjor të shtetit të kërkuar;

(k) në qoftë se shteti kërkues ka dhunuar një rregull të procedurës të vendosur në këtë Konventë.

Neni 12

1. Shteti i kërkuar do të tërheqë pranimin e kërkesës, në qoftë se pas këtij pranimi, është bërë e qartë një arsye, e cila parashikohet në nenin 10 të kësaj Konvente, për të mos filluar veprimet në bazë të kërkesës.

2. Shteti i kërkuar mund të tërheqë pranimin e kërkesës:

(a) në qoftë se bëhet e qartë që prania personale e personit të dyshuar nuk mund të sigurohet në seancat e procedimeve në atë shtet ose që çdo dënim i cili mund të jetë kryer, nuk mund të kërkohet të zbatohet në atë shtet;

(b) në qoftë se përpara se çështja të jetë paraqitur në gjyq bëhet e qartë një prej arsyeve për refuzim, të përmendur në nenin 11; ose

(c) në raste tçë tjera, në qoftë se shteti kërkues bie dakord.

SEKSIONI II
PROCEDURA E TRANSFERIMIT

Neni 13

1. Të gjitha kërkesat e specifikuara në këtë Konventë do të bëhen me shkrim. Ato dhe të gjithë komunikimet e nevojshme për zbatimin e kësaj Konvente do të dërgohen nga Ministria e Drejtësisë e Shtetit kërkues, në Ministrinë e Drejtësisë së shtetit të kërkuar ose në bazë të marrëveshjes të posaçme reciproke, direkt nga autoritetet e shtetit kërkues tek ato të shtetit të kërkuar, ato do të kthehen nëpërmjet të njëjtit kanal.

2. Në raste urgjente, kërkesat dhe komunikimet mund të dërgohen nëpërmjet Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (INTERPOL).

3. Çdo shtet kontraktues, nëpërmjet deklaratës adresuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës mund të njoftojë qëllimin e tij për të adoptuar, për aq sa është i interesuar, rregullat e transmetimit përveç atyre të vendosura në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 14

Në qoftë se një shtet kontraktues vlerëson që informacioni i dhënë nga një shtet tjetër kontraktues nuk është i mjaftueshëm për t'i mundësuar atij zbatimin e kësaj Konvente, ai do të kërkojë një informacion shtesë të nevojshëm. Ky informacion mund të përcaktojë një datë për marrjen e një informacioni të tillë.

Neni 15

1. Kërkesa për procedime do të shoqërohet nga origjinali ose një kopje e vërtetuar e dosjes penale dhe e të gjitha dokumenteve të tjera të nevojshme. Megjithatë, nëse personi i dyshuar është mbajtur në arrest në pajtim me dispozitat e seksionit V dhe nëse shteti kërkues nuk ka mundësi që të transmetojë këto dokumente në të njëjtën kohë me kërkesën për procedim gjyqësor, atëherë dokumentet mund të dërgohen më vonë.

2. Shteti kërkues, gjithashtu, do të informojë shtetin e kërkuar me shkrim, në lidhje me çdo akt procedurial të kryer ose mbi masat e marra në këtë shtet pas transmetimit të kërkesës që ka lidhje me këto procedime. Ky komunikim do të jetë i shoqëruar nga dokumentet përkatëse.

Neni 16

1. Shteti i kërkuar do të komunikojë menjëherë vendimin mbi kërkesën për procedime nga ana e shtetit kërkues.

2. Shteti i kërkuar do të informojë gjithshtu shtetin kërkues për heqjen dorë nga procedimet ose për vendimet e marra si pasojë e këtyre procedimeve. Shteti kërkues do t'i transmetohet një kopje e vërtetuar e çdo vendimi të shkruar.

Neni 17

Në qoftë se kompetenca e shtetit të kërkuar është parashikuar ekskluzivisht në nenin 2, ky shtet do të informojë personin e dyshuar në lidhje me kërkesën që i është bërë për procedime, me qëllim që ta lejojë atë të paraqesë qëndrimin e tij mbi çështjen përpara se të ketë marrë një vendim në lidhje me kërkesën.

Neni 18

1. Nuk do të kërkohet asnjë përkthim i dokumenteve, në lidhje me zbatimin e kësaj Konvente, të cilat i nënshtrohen dispozitave të paragrafit 2 të këtij neni.

2. Çdo shtet kontraktues, në kohën e nënshkrimit ose të depozitimit të dokumentit të ratifikimit, pranimit ose aderimit, nëpërmjet deklaratës adresuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund të rezervojë të drejtën të kërkojë që, me përjashtim të kopjes së vendimit të shkruar të përmendur në nenin 16 paragrafi 2, dokumentet në fjalë të jenë shoqëruar nga një përkthim. Shtetet e tjera kontraktuese do të dërgojnë përkthimet në gjuhën kombëtare të shtetit marrës ose në një prej gjuhëve zyrtare të Këshillit të Europës, të cilën do ta përcaktojë shteti marrës. Megjithatë një përcaktim i tillë nuk është i detyrueshëm. Shtetet e tjera kontraktuese mund të kërkojnë reciprocitetin.

3. Ky nen nuk do të paragjykojë ndonjë dispozitë në lidhje me përkthimin e kërkesave dhe dokumenteve ndihmëse që mund të jenë përfshirë në marrëveshje ose rregullime, të cilat janë në fuqi ose që mund të përfundohen midis dy ose më shumë shteteve kontraktuese.

Neni 19

Dokumentet e transmetuara në zbatim të kësaj Konvente nuk nevojitet të njëjtësohen.

Neni 20

Palët kontraktuese nuk do të kërkojnë nga njëra-tjetra kthimin e të hollave për shpenzimet e mundshme që rezultojnë nga zbatimi i kësaj Konvente.

SEKSIONI III
PASOJAT E NJË KËRKESE PËR PROCEDIM GJYQËSOR NË SHTETIN KËRKUES

Neni 21

1. Kur shteti kërkues ka kërkuar procedime, ai nuk mund të ndjekë më penalisht personin e dyshuar për kryerjen e veprës penale për të cilën janë kërkuar këto procedime ose të kërkojë zbatimin e një vendimi gjyqësor, i cili ka qenë shpallur më parë në atë shtet ndaj tij për atë shkelje. Megjithatë, derisa të merret vendimi i shtetit të kërkuar në lidhje me kërkesën për procedime, shteti kërkues, do të ketë të drejtën për të ndërmarrë të gjithë hapat në lidhje me ndjekjen penale, pa e çuar çështjen në gjyq ose sipas rastit, duke lejuar autoritetin administrativ të vendosë për çështjen.

2. E drejta për të ndjekur penalisht dhe për ta zbatuar atë do t'i kthehet shtetit kërkues:

(a) në qoftë se shteti i kërkuar e njofton atë, në përputhje me nenin 10 mbi vendimin për të mos filluar veprimet në bazë të kërkesës;

(b) në qoftë se shteti i kërkuar e njofton atë, në përputhje me nenin 11, mbi vendimin për refuzimin e pranimit të kërkesës;

(c) në qoftë se shteti i kërkuar e njofton atë në përputhje me nenin 12 mbi vendimin për tërheqjen e pranimit të kërkesës;

(d) në qoftë se shteti i kërkuar e njofton atë mbi vendimin për të mos filluar procedimet ose për t'i pezulluar ato;

(e) në qoftë se ai e tërheq kërkesën e tij përpara se shteti i kërkuar ta ketë informuar atë mbi vendimin për fillimin e veprimeve në bazë të kërkesës.

Neni 22

Një kërkesë për procedime, që është bërë në përputhje me dispozitat e kësaj pjese, do të ketë pasojë në shtetin kërkues në zgjatjen e afatit prej gjashtë muajsh për procedimet.

SEKSIONI IV
PASOJAT NË SHTETIN E KËRKUAR NË LIDHJE ME NJË KËRKESË PËR PROCEDIMIN GJYQËSOR

Neni 23

Në qoftë se kompetenca e shtetit të kërkuar është parashikaur ekskluzitivisht në nenin 2 afati për procedimet në atë shtet do të zgjasë gjashtë muaj.

Neni 24

1. Në qoftë se procedimet janë bazuar në një ankesë të përbashkët të dy shteteve, ankesa dërguar shtetit kërkues do të ketë të njëjtën vlerë me atë të dërguar në shtetin e kërkuar.

2. Në qoftë se një ankesë është e nevojshme vetëm në shtetin e kërkuar, ky shtet mund të fillojë procedimet edhe në mungesë të një ankese, në qoftë se personi i cili është autorizuar të paraqesë ankesën nuk ka kundërshtuar brenda një periudhe një mujore nga data e marrjes së njoftimit nga autoriteti kompetent për të drejtën e tij për të kundërshtuar.

Neni 25

Në shtetin e kërkuar sanksioni i zbatueshëm ndaj veprës penale do të jetë ai i parashikuar nga ligji i tij, përveç rastit kur ligji i tij parashikon ndryshe. Në rastet kur kompetenca e shtetit të kërkuar është parashikuar ekskluzivisht në nenin 2, sanksioni i vendosur në atë shtet nuk do të jetë më i rëndë se ai i parashikuar në ligjin e shtetit kërkues.

Neni 26

Çdo akt që lidhet me procedimet, të filluara në shtetin kërkues në përputhje me ligjin dhe rregullat e tij, do të ketë të njëjtën vlerë në shtetin e kërkuar njësoj si të ishte marrë prej autoriteteve të tij, me kusht që përvetësimi i një akti të tillë nuk i jep atij një rëndësi më të madhe se sa ajo që ka në shtetin kërkues.

Çdo akt, i cili ndërpret afatin dhe që është kryer në mënyrë të vlefshme në shtetin kërkues, do të ketë të njëjtat pasoja në shtetin e kërkuar dhe anasjelltas.

SEKSIONI V
MASAT E PËRKOHSHME NË SHTETIN E KËRKUAR

Neni 27

Kur shteti kërkues bën të ditur qëllimin e tij për të transmetuar një ankesë për procedime, dhe në qoftëse kompetenca e Shtetit të kërkuar do të ishte parashikuar ekskluzivisht në nenin 2, shteti i kërkuar, me kërkesën e shtetit kërkues dhe sipas kësaj Konvente, mund të mbajë në arrest përkohësisht personin e dyshuar:

a) në qoftë se ligji i shtetit të kërkuar autorizon mbajtjen në arrest për veprën penale, dhe

b) në qoftë se ka arsye për të besuar që personi i dyshuar do të largohet ose do të shkaktojë pengimin e paraqitjes së provave.

2. Kërkesa për arrest të përkohshëm do të përmendë se ekziston një urdhër-arresti ose një urdhër tjetër, që ka të njëjtin efekt, të lëshuar në përputhje me procedurën e vendosur nga ligji i shtetit kërkues; ai do të njoftojë gjithashtu se çfarë procedimesh gjyqësore do të kërkohen në lidhje me veprën penale, si dhe kur dhe ku një vepër penale e tillë është kryer, si dhe do të përmbajë një përshkrim sa më të saktë të personit të dyshuar. Ai do të përmbajë, gjithashtu, një përshkrim të shkurtë të rrethanave të çështjes.

3. Ankesa për arrest të përkohshëm do të dërgohet direkt nga autoritetet e shtetit kërkues të përmendura në nenin 13 tek autoritetet korresponduese në shtetin e kërkuar, nëpërmjet postës ose telegramit apo ndonjë mjeti tjetër, që sjell provat me shkrim ose mjeteve të pranuara nga shteti i kërkuar. Shteti kërkues do të njoftohet menjëherë për rezultatin e kërkesës së tij.

Neni 28

Në bazë të pranimit të një kërkese për procedime të shoqëruar nga dokumentet e përmendura në nenin 15 paragrafi 1, shteti i kërkuar do të ketë juridiksionin për të zbatuar të gjitha masat e tilla të përkohshme, duke përfshirë mbajtjen në arrest të personit të dyshuar dhe konfiskimin e pasurisë në të njëjtën mënyrë siç mund t'i zbatojë sipas ligjit të tij në rastet kur vepra penale për të cilën janë kërkuar procedimet është kryer në territorin e tij.

Neni 29

1. Masat e përkohshme, të parashikuara në nenet 27 dhe 28, do të rregullohen nga dispozitat e kësaj Konvente dhe ligji i shtetit të kërkuar. Ligji i atij shteti, ose Konventa do të përcaktojnë kushtet mbi të cilat këto masa mund të bëhen të pavlefshme.

2. Këto masa do të shfuqizihohen në rastet e përmendura në nenin 21,paragrafi 2.

3. Një person i ndaluar do të lirohet në çdo rast nëse është arrestuar në pajtim me nenin 27 dhe shteti i kërkuar nuk merr kërkesën për procedime brenda 18 ditësh nga data e arrestimit.

4. Një person i ndaluar do të lirohet nëçdo rast në qoftë se është arrestuar në pajtim me nenin 27 dhe dokumentet, të cilat do të shoqëronin ankesën për procedim gjyqësor nuk janë marrë nga shteti i kërkuar brenda 15 ditëve nga pranimi i ankesës për procedime.

5. Periudha e ndalimit, e zbatuar në bazë të nenit 27, në asnjë rast nuk do të zgjasë më tepër se 40 ditë.

PJESA IV
SHUMËLLOJSHMËRIA E PROCEDIMEVE PENALE

Neni 30

1. Çdo shtet kontraktues, i cili përpara fillimit ose gjatë procedimeve për një vepër penale, të cilën ai e konsideron që nuk është e natyrës politike ose ushtarake, është në dijeni të procedimeve që presin zgjidhje në një shtet tjetër kontraktues kundër të njëjtit person në lidhje me të njëjtën vepër penale, do të vlerësojë nëse mund të heqë dorë ose të ndërpresë procedimet e tij gjyqësore, ose t'i transferojë ato tek shteti tjetër.

2. Në qoftë se ai e gjykon të kështillueshme nga rrethanat për të mos hequr dorë ose pezulluar procedimet e tij gjyqësore, atëherë do të njoftojë për pasojë shtetin tjetër sa më shpejt, përpara dhënies së vendimit në lidhje me këtë çështje.

Neni 31

1. Në mundësinë e përmendur në nenin 30 paragrafi 2, shtetet e interesuara do të përpiqen sa të jetë e mundur të përcaktojnë, pas vlerësimit të rrethanave të përmendura në nenin 8, të cilat do të vazhdojnë të drejtojnë procedimet. Gjatë kësaj procedure konsultimi, shtetet e interesuara, do të shtyjnë për më vonë gjykimin në themel pa qenë të detyruar të zgjasin një shtyrje të tillë, përtej një periudhe 30-ditore nga dërgimi i njoftimit të parashikuar në nenin 30 paragrafi

2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk do të jenë detyruese:

(a) në shtetin dërgues të njoftimit të parashikuar në nenin 30 paragrafi 2, në qoftë se gjyqi kryesor ka qenë deklaruar i hapur atje në prani të të akuzuarit përpara nisjes së njoftimit;

(b) në Shtetin tek i cili është adresuar njoftimi, në qoftë se gjyqi kryesor ka qenë deklaruar i hapur atje në prani të të akuzuarit përpara marrjes së njoftimit.

Neni 32

Në interes të arritjes së të vërtetës dhe me qëllimin zbatimin e një sanksioni të përshtatshëm, shtetet e interesuara do të shqyrtojnë nëse është e përshtatshme që vetëm njëri prej tyre të kryejë procedime dhe nëse ndodh kështu, të përpiqet të vendosë se cili shtet, atëherë kur:

(a) disa vepra penale materiale dhe cilat klasifikohen në ligjin penal të secilit prej këtyre shteteve i janë atribuar ose një personi të vetëm ose disa personave që kanë vepruar bashkarisht;

(b) një vepër penale e vetme, e cila klasifikohet në ligjin penal të secilit prej atyre Shteteve, iu është atribuar disa personave që kanë vepruar në bashkëveprim.

Neni 33

Të gjitha vendimet e arritura në përputhje me nenin 31 paragrafi 1 dhe 32 do të shkaktojnë ndërmjet shteteve të interesuara, të gjitha pasojat e një transferimi të procedimeve, siç është parashikuar në këtë Konventë. Shteti, i cili heq dorë nga procedimet e tij gjyqësore do të konsiderohet se i ka transferuar ato te shteti tjetër.

Neni 34

Procedura e transferimit e parashikuar në Seksionin II të Pjesës III do të zbatohet për aq sa dispozitat e saj janë në pajtim me ato të përfshira në këtë pjesë.

PJESA V
NE BIS IN IDEM

Neni 35

1. Një person, në lidhje me të cilën është dhënë një vendim gjyqësor penal përfundimtar dhe i detyrueshëm, për të njëjtin akt, mund të mos ndiqet penalisht, dënohet ose t'i nënshtrohet një sanksioni në një shtet tjetër kontraktues:

(a) në qoftë se ai është falur;

(b) në qoftë se sanksioni i kërkuar për t'u zbatuar:

(i) ka qenë zbatuar plotësisht ose është duke u zbatuar, ose

(ii) i është nënshtruar faljes ose amnistisë, plotësisht, ose në lidhje me pjesën e pazbatuar, ose

(iii) nuk mund të zbatohet për shkak të kalimit të afatit kohor;

c) në qoftë se gjyqi e ka shpallur fajtor të pandehurin pa kërkuar zbatimin e një sanksioni.

2. Megjithatë, një shtet kontraktues, përderisa nuk ka kërkuar procedime, nuk do të jetë i detyruar të njohë efektin e ne bis in idem në qoftë se akti që shkaktoi gjykimin është drejtuar kundër një personi, institucioni ose ndonjë gjëje me status publik, ose në qoftë se subjekti i gjykimit kishte vetë një status publik në atë shtet.

2. Përveç kësaj, një shtet kontraktues, në të cilin akti është kryer ose konsideruar si i tillë sipas ligjit të atij shteti, nuk është i detyruar të njohë efektin e ne bis in idem, në qoftë se ai nuk ka kërkuar vetë procedimet.

Neni 36

Në qoftë se procedimet e reja gjyqësore janë filluar kundër një personi, i cili në një shtet tjetër kontraktues ka qenë dënuar për të njëjtin akt, atëhere çdo periudhë e heqjes së lirisë e shkaktuar nga dënimi i kërkuar për t'u zbatuar do të zbritet nga sanksioni i cili mund të jepet.

Neni 37

Kjo pjesë nuk do të parandalojë zbatimin e dispozitave të brendshme më të zgjeruara, përsa i përket efektit të ne bis in idem që i bashkëngjitet vendimeve gjyqësore penale të huaja.

PJESA VI
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 38

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrimin ndaj shteteve anëtare të Këshillit të Europës. Ajo do t'i nështrohet ratifikimit ose miratimit. Instrumentet e ratifikimit ose miratimit do të depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

2. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi pas tre muajsh nga data e depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit ose miratimit.

3. Përsa i përket një shteti nënshkrues, që e ratifikon ose e pranon atë më vonë, Konventa do të hyjë në fuqi pas tre muajsh nga data e depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimt ose miratimit.

Neni 39

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës mund të ftojë çdo shtet joanëtar të aderojë në të, me kusht që rezoluta që përmban një ftesë të tillë të marrë miratimin unanim të Anëtarëve të Këshillit që kanë ratifikuar Konventën.

2. Një aderim i tillë do të pasohet nga depozitimi te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës, i instrumentit të aderimit, i cili do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të tij.

Neni 40

1. Çdo shtet kontraktues, në kohën e nënshkrimit apo të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, miratimit ose aderimit, mund të përcaktojë territorin ose territoret tek të cilat do të zbatohet kjo Konventë.

2. Çdo shtet kontraktues, në kohën e nënshkrimit apo të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, miratimit ose aderimit, ose në një datë të mëvonshme, nëpërmjet deklaratës drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund të shtrijë zbatimin e kësaj Konvente në ndonjë territor ose territore të tjera të përcaktuara në deklaratë për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilave ai është përgjegjës ose në emër të të cilëve është i autorizuar të veprojë.

3. Çdo deklaratë, e bërë në pajtim me paragrafin e mësipërm, në lidhje me çdo territor të përmendur në një deklaratë të tillë, mund të tërhiqet në përputhje me procedurën e vendosur në nenin 45 të kësaj Konvente.

Neni 41

1. Çdo shtet kontraktues, në kohën e nënshkrimit apo depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, miratimit ose aderimit, mund të deklarojë se ai gëzon të drejtën të bëjë një ose disa nga

rezervat e parashikuara në Shtojcën 1 ose të bëjë një deklaratë të parashikuar në Shtojcën 2 të kësaj Konvente.

2. Çdo shtet kontraktues mund të tërheqë plotësisht ose pjesërisht një rezervë ose deklaratë, që është bërë në përputhje me paragrafin e mësipërm, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, e cila do të hyjë në fuqi që nga data e marrjes së saj.

3. Një shtet kontraktues, i cili ka bërë një rezervë në lidhje me ndonjë dispozitë të kësaj Konvente, nuk mund të kërkojë zbatimin e kësaj dispozite nga një Shtet tjetër Kontraktues; megjithatë, në qoftë se rezerva e tij është e pjesshme ose e kushtëzuar, ai mund të kërkojë zbatimin e kësaj dispozite për aq sa ai vetë e ka pranuar atë.

Neni 42

1. Çdo shtet kontraktues, nëpërmjet një deklarate drejtuar në çdo kohë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund të deklarojë dispozitat ligjore që do të përfshihen në Shtojcën III të kësaj Konvente.

2. Çdo ndryshim i dispozitave të brendëshme shtetërore të renditura në Shtojcën III do t'i njoftohet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, në qoftë se një ndryshim i tillë e bën të pasaktë informacionin në këtë Shtojcë.

3. Ndryshimet e bëra në Shtojcën III, në zbatim të paragrafeve të mësipërme, do të hyjnë në fuqi në seicilin shtet kontraktues një muaj pas datës së njoftimit të tyre te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 43

1. Kjo Konventë nuk prek as të drejtat dhe angazhimet që rrjedhin nga marrëveshjet mbi ekstradimin dhe konventat ndërkombëtare shumëpalëshe në lidhje me çështje të veçanta, dhe as dispozitat në lidhje me çështje që janë trajtuar në këtë Konventë dhe të cilat janë përfshirë në konventa të tjera ekzistuese ndërmjet shteteve konraktuese.

2. Shtetet kontraktuese nuk mund të përfundojnë me njëra-tjetrën marrëveshje dypalëshe ose shumpalëshe në lidhje me çështje, që janë trajtuar në këtë Konventë, përveçse me qëllim për të plotësuar dispozitat e saj ose për të lehtësuar zbatimin e parimeve të mishëruara në të.

3. Megjithatë, në qoftë se dy ose më shumë shtete kontraktuese, do të kenë rregulluar marrëdhëniet e tyre në lidhje me këtë çështje, duke u bazuar në një legjislacion të njëjtë apo në një sistem të posaçëm të krijuar prej tyre, ose nëse do ta bëjnë këtë në të ardhmen, ata do të kenë të drejtën t'i rregullojnë këto marrëdhënie në këtë mënyrë, pavarësisht nga kushtet e kësaj Konvente.

4. Shtetet kontraktuese, duke i dhënë fund zbatimit të kushteve të kësaj Konvente në marrëdhënet e tyre reciproke në lidhje me këtë çështje, në përputhje me dispozitat e paragrafit të mësipërm, do të njoftojnë për pasojë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 44

Komiteti Europian për Problemet e Krimit i Këshillit të Europës, do të informohet mbi zbatimin e kësaj Konvente dhe do të bëjë çdo gjë që është e nevojshme për të lehtësuar një zgjidhje miqësore të çdo vështirësie që mund të lindte nga zbatimi i saj.

Neni 45

1. Kjo Konventë do të mbesë në fuqi për një kohë të pacaktuar.

2. Çdo shtet kontraktues, për aq sa është i interesuar, mund të denoncojë këtë Konventë me anë të një njoftimi adresuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

3. Një denoncim i tillë do të hyjë në fuqi gjashtë muaj pas marrjes së një njoftimi të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 46

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të njoftojë shtetet anëtare të Këshillit dhe çdo Shtet, i cili ka aderuar në këtë Konventë në lidhje me:

a) çdo nënshkrim;

b) çdo depozitim të një instrumenti ratifikimi, miratimi apo aderimi;

c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në përputhje me nenin 38;

d) çdo deklaratë të marrë në pajtim me dispozitat e nenit 9 paragrafi 3;

e) çdo deklaratë të marrë në pajtim me dispozitat e nenit 13 paragrafi 3;

f) çdo deklaratë të marrë në pajtim me dispozitat e nenit 18 paragrafi 2;

g) çdo deklaratë të marrë në pajtim me dispozitat e nenit 40 paragrafi 2 dhe 3;

h) çdo rezervë ose deklaratë të marrë në pajtim me dispozitat e nenit 41 paragrafi 1;

i) tërheqjen e çdo rezervë apo deklarate të kryer në pajtim me dispozitat e nenit 41 paragrafi 2;

j) çdo deklaratë të marrë në pajtim me nenin 42 paragrafi 1, dhe çdo njoftim të mëvonshëm të marrë në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni;

k) çdo njoftim të marrë në pajtim me dispozitat e nenit 43 paragrafi 4;

l) çdo njoftim të marrë në pajtim me dispozitat e nenit 45 dhe datën në të cilën denoncimi hyn në fuqi.

Neni 47

Kjo Konventë dhe njoftimet dhe deklaratat e autorizuara sipas saj do të zbatohen vetëm ndaj veprave penale të kryera pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente dhe për shtet kontraktuese që janë përfshirë në të.

Në prani të nënshkruesve, të autorizuar në mënyrën e duhur, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Strazburg, më 15 Maj 1972, në gjuhën angleze dhe franceze, duke pasur të dy tekstet të njëjtën vlerë, një kopje e së cilës do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'i transmetojë kopjet e vërtetuara secilës prej qeverive nënshkruese dhe aderuese.

SHTOJCA 1

Çdo shtet kontraktues mund të deklarojë që ai rezervon të drejtën:

a) të refuzojë një ankesë për procedime, në qoftë se ai konsideron që vepra penale është thjesht e një natyre fetare;

b) të refuzojë një ankesë për procedime për një akt sanksioni për të cilin, sipas ligjit të tij, mund të kërkohet të zbatohet vetëm nga një autoritet administrativ;

c) për të mos pranuar nenin 22;

d) për të mos pranuar nenin 23;

e) për të mos pranuar dispozitat e përfshira në fjalinë e dytë të nenit 25 për arsye konstitucionale;

f) për të mos pranuar dispozitat e vendosura në neni 26 paragrafi 2, aty ku ka kompetencë sipas ligjit të tij;

g) për të mos zbatuar nenet 30 dhe 31 në lidhje me një akt për të cilin sanksionet, sipas ligjit të tij ose të ndonjë shteti tjetër të interesuar, mund të kërkohen të zbatohen vetëm nga një autoritet administrativ.

h) për të mos pranuar Pjesën V.

SHTOJCA II

Çdo shtet kontraktues mund të deklarojë që për arësye që rrjedhin nga ligji i tij kushtetues mund të bëjë ose marrë kërkesa për procedime vetëm në rrethanat e përcaktuara në ligjin e tij të brendshëm.

Çdo shtet kontraktues, me anë të një deklarate, mund të përkufizojë për aqsa ka lidhje termin "shtetas" brenda kuptimit të kësaj Konvente.

SHTOJCA III

Lista e veprave penale përveç atyre të trajtuara nga ligji penal

Veprat penale të mëposhtme do të hyjnë në veprat penale sipas ligjit penale:

- Në Francë: çdo sjellje e paligjshme e dënueshme nga një (contravention de grande voirie).
- Në Republikën Federale Gjermane: çdo sjellje e paligjshme e trajtuar sipas procedurës së vendosur në Aktin mbi Dhunimin e Rregullave
- (Gesetz úber Ordnungswidrigkeiten i 24 Majit 1968 – BGBI 1968,I, 481).
- Në Itali: çdo sjellje e paligjshme ndaj së cilës zbatohet Akti Nr.317 i 3 marsit 1967.

LIGJ
Nr.8498, datë 10.6.1999

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SË KËSHILLIT TË EUROPËS "PËR NDIHMËN E NDËRSJELLË JURIDIKE NË FUSHËN PENALE" DHE PROTOKOLLIN E SAJ SHTESË

(Ndryshuar me ligjin nr.9539, datë 22.5.2006)
I përditësuar

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet Konventa e Këshillit të Europës "Për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale" të datës 20 prill 1957 dhe të protokollit të saj shtesë të datës 17 mars 1997 me rezervat dhe deklarimet e parashikuara në këtë ligj.

Neni 2
(Ndryshuar pika 2 dhe 3 me ligjin nr.9539, datë 22.5.2006, neni 1)

Lidhur me Konventën, pala shqiptare shpreh këto rezerva:

1. Sekuestrimi, konfiskimi i sendeve dhe ekzekutimi i kërkesave të tilla do të bëhen vetëm në kushtet e parashikuara në nenin 5 pika 1 shkronja "a" dhe "c".

Lidhur me Konventën, pala shqiptare deklaron se:

1. në zbatim të nenit 15 pika 6 duhet që një kopje e të gjitha kërkesave për ndihmë juridike, të komunikuara drejtpërdrejt ndërmjet autoriteteve gjyqësore, si dhe të akteve shoqëruese t'i dërgohen, në të njëjtën kohë, edhe Ministrisë së Drejtësisë;

2. Lidhur me nenin 16 paragrafi i dytë, kërkesa për ndihmë të ndërsjellë dhe dokumentet që u bashkëlidhen shoqërohen me përkthimin autentik zyrtar në gjuhën shqipe dhe, kur nuk është e mundur, në gjuhën angleze.

Republika e Shqipërisë, për dokumente më të gjata, si dhe në rastin kur marrësi është shtetas shqiptar ose kur vendbanimi i tij/saj është në Shqipëri, rezervon të drejtën për të kërkuar një përkthim autentik zyrtar në gjuhën shqipe, e përcaktuar kjo rast pas rasti.

3. Autoritetet gjyqësore, në kuptim të nenit 24 të kësaj Konvente, janë Gjykata e Lartë, gjykatat e apelit, gjykatat e shkallës së parë, Prokuroria e Përgjithshme, prokuroritë pranë gjykatave të apelit dhe prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2400, datë 29.6.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.21, faqe 697

KONVENTA EUROPIANE
E NDIHMËS JURIDIKE NË FUSHËN PENALE

HYRJE

Qeveritë që firmosin këtë Konventë, anëtarë të Këshillit të Europës;

Duke pasur në konsideratë që Këshilli i Europës ka për qëllim realizimin e një lidhjeje më të ngushtë ndërmjet anëtarëve të tij;

Të bindur se miratimi i dispozitave të përgjithshme në kuadrin e ndihmës juridike në fushën penale lejon arritjen e këtij qëllimi;

Duke patur në konsideratë që ndihma juridike është një fushë e lidhur me atë të ekstradimit, fushë e cila ka përbërë objektin e Konventës së datës 13 dhjetor 1957;

Kanë rënë dakord si më poshtë:

TITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

1. Palët kontraktuese angazhohen të japin në mënyrë të ndërsjellë, sipas dispozitave të kësaj Konvente, një bashkëpunim sa më të gjërë gjyqësor në çdo rast procedimi që lidhet me krimet në të cilat shtrëngimi është, që nga momenti në të cilin është kërkuar ndihma, kompetencë e autoriteteve gjyqësore të palës kërkuese.

2. Kjo Konventë nuk zbatohet as gjatë ekzekutimit të masës së arrestit dhe të dënimeve dhe as për krimet ushtarake që nuk përbëjnë krime të së drejtës së përgjithshme.

Neni 2

Ndihma juridike mund të refuzohet :

a) në qoftë se kërkesa i referohet krimeve që pala, së cilës i drejtohet kërkesa i konsideron ose krime politike ose krime që lidhen me krimet politike ose krimet fiskale;

b) në qoftë se pala, së cilës i drejtohet kërkesa, mendon se ekzekutimi i kërkesës mund të sjellë paragjykim të sovranitetit, të sigurisë, të rendit publik ose të interesave esenciale të vendit të saj.

TITULLI II
LETËRPOROSITË

Neni 3

1. Pala, së cilës i drejtohet kërkesa, do të ekzekutojë, sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni i vendit të saj, letërporositë që lidhen me një procedim penal që do t'i drejtohen asaj nga autoritetet gjyqësore të palës kërkuese dhe që kanë për objekt përmbushjen e akteve hetimore ose të kalimit të provave materiale që lidhen me veprën penale përkatëse, të fashikujve ose të dokumenteve.

2. Në qoftë se pala kërkuese dëshiron që dëshmitarët ose ekspertët të deponojnë pas një betimi paraprak, ajo duhet të bëjë një kërkesë me shkrim dhe, pala, së cilës i është drejtuar kërkesa, do të verifikojë nëse ligji i saj e lejon një gjë të tillë ose jo.

3. Pala, së cilësi drejtohet kërkesa, nuk mund të transferojë (ose do të kufizohet për të transferuar) kopje të thjeshta ose fotokopje të fashikujve ose të dokumenteve të kërkuara, të cilat janë të pajisura me vërtetim të barazvlefshëm me origjinalin. Megjithatë, në qoftë se pala kërkuese kërkon shprehimisht transferimin e dokumenteve origjinale, një kërkesë e tillë duhet, brenda kufijve të mundshëm, të pranohet.

Neni 4

Në qoftë se pala kërkuese e kërkon shprehimisht, pala, së cilës i drejtohet kërkesa, duhet të njoftojë për datën dhe vendin e ekzekutimit të letërporosisë. Autoritetet dhe personat në çështje mund të ndihmojë gjatë këtij ekzekutimi në qoftë se pala, së cilës i drejtohet kërkesa, do t'ua lejojë.

Neni 5

1. Secila nga palët kontraktuese mundet që, në momentin e firmosjes së kësaj Konvente ose të depozitimit të instrumenteve të ratifikimit ose të pranimit, me deklarimin direkt Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të rezervojë mundësinë për të vënë ekzekutimin e letërporosive që kanë për qëllim kontrollimin e sendeve të njërës ose të më shumë kushteve të mëposhtme:

a) Krimi, i cili motivon letërporosinë duhet të jetë i dënueshëm sipas ligjit të palës kërkuese dhe të palës e cila pranon kërkesën;

b) krimi, i cili motivon letërporosinë duhet të jetë i tillë që të lejojë ekstradimin në vendin ku drejtohet kërkesa;

c) ekzekutimi i letërporosive duhet të jetë në përputhje me ligjin e palës së cilës i drejtohet kërkesa.

2. Atëherë kur njëra nga palët kontraktuese ka bërë një deklaratë në kuptim të paragrafit të parë të këtij neni, çdo palë tjetër mund të aplikojë parimin e reciprocitetit.

Neni 6

1. Pala, së cilës i drejtohet kërkesa, mund të shtyjë pranimin e objekteve, fashikujve ose të akteve për të cilat është kërkuar komunikimi, kurdoherë që këta të jenë të nevojshëm për një procedim penal në proces.

2. Objektet, për më tepër edhe origjinalet e fashikujve dhe të dokumenteve, që janë dhënë gjatë komunikimit në ekzekutimin e një letërporosie, do të kthehen nga pala kërkuese menjëherë palës së cilës i drejtohet kërkesa, përveç se kur kjo e fundit do të heqë dorë.

TITULLI III
PRANIMI I AKTEVE PROCEDURIALE DHE TË MASAVE PARAPRAKE GJYQËSORE, DALJA E DËSHMITARËVE, EKSPERTËVE DHE PERSONAVE QË I NËNSHTROHEN NJË PROCESI PENAL

Neni 7

1. Pala, së cilës i është drejtuar kërkesa, do të procedojë në pranimin e akteve proceduriale dhe të masave paraprake gjyqësore, të cilat i janë dërguar për këtë qëllim nga pala kërkuese.

Një pranim i tillë do të realizohet nëpërmjet një tansferimi të thjeshtë të aktit dhe të masës paraprake marrësit. Kurdoherë që Pala së cilës i drejtohet kërkesa shprehimisht do të kërkojë, pranimi do të realizohet në njërën nga format që legjislacioni i palës së cilës i drejtohet kërkesa, parashikon për notifikimet të së njëjtës natyrë ose në një formë të veçantë që të jetë në përputhje me legjislacionin përkatës.

2. Prova e pranimit do të bëhet nëpërmjet një dëftese në të cilën është vendosur data dhe është firmosur nga destinatori ose nëpërmjet një deklarate të palës së cilës i drejtohet kërkesa që përcakton faktin, mënyrat dhe datën e pranimit. Njëri ose tjetri nga këto dokumente do të jetë menjëherë i transferueshëm Palës kërkuese. Me kërkesë të kësaj të fundit, Pala së cilës i drejtohet kërkesa duhet të saktësojë nëse pranimi është bërë me ligjin e saj. Nëse pranimi nuk është bërë i mundur, pala, së cilës i është drejtuar kërkesa, duhet t'i bëjë menjëherë të ditur motivin e mospranimit palës kërkuese.

3. Secila nga palët kontraktuese mundet që, në momentin e firmosjes së kësaj Konvente ose të depozitimit të instrumenteve të ratifikimit ose të pranimit, të kërkojë, nëpërmjet një deklarate të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, që letërthirrja për t'u paraqitur në gjyq, personit që i është nënshtruar një procedimi penal dhe që gjendet në territorin e tij duhet t'i transferohet autoriteteve kompetente brenda një afati të caktuar përpara datës së caktuar për t'u paraqitur në gjyq. Ky afat do të jetë i përcaktuar në një deklaratë të caktuar dhe nuk mund t'i kapërcejë 50 ditët.

Për caktimin e një afati të tillë do të kihet parasysh data e paraqitjes në gjyq dhe momenti i transferimit të letërthirrjes.

Neni 8

Dëshmitari apo eksperti që nuk do të respektojë paraqitjen në gjyq sipas një letërthirrjeje, e cila i është dërguar, nuk mund të vihet nën ndonjë masë shtrënguese apo sanksione edhe në qoftë se letërthirrja përmban urdhrat, vetëm në qoftë se ai do të hyjë vullnetarisht në territorin e palës kërkuese dhe ai do të njoftohet sërish në mënyrë të rregullt.

Neni 9

Kompensimet (dëmshpërblimi) që do të derdhen, përveç shpenzimeve të udhëtimit dhe të qëndrimit që pala kërkuese duhet të rimbursojë në favor të dëshmitarit apo të ekspertit, duhet të jenë të llogaritura nga vendi i rezidencës së tyre dhe do të likuidohen në një masë të njëjtë me atë të parashikuar nga tarifat dhe rregulloret në fuqi në vendin ku ata duhet të pyeten.

Neni 10

1. Në qoftë se pala kërkuese pretendon se paraqitja vetjake e një dëshmitari apo e një eksperti përpara autoriteteve të saj gjyqësore është veçanërisht e nevojshme, ajo duhet ta përmendi si fakt në kërkesën e pranimit të letërthirrjes dhe pala, së cilës i drejtohet kërkesa, do të ftojë këtë dëshmitar apo ekspert të paraqitet në gjyq.

Pala, së cilës i drejtohet kërkesa, duhet të bëjë të njohur përgjigjen e dëshmitarit apo të ekspertit palës kërkuese.

2. Në rastin e parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni kërkesa ose letërthirrja duhet të përmendi shprehimisht shumën e përafërt të kompensimit (dëmshpërblimit) që duhet të korrespondojë edhe me shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit, të cilat duhet të rimbursohen.

3. Pala, së cilës i është drejtuar kërkesa, me një qëllim të tillë mund t'i japë dëshmitarit apo ekspertit një paradhënie (parapagesë). Kjo do të bëhet e ditur në letërthirrjen dhe të rimbursohet nga pala kërkuese.

Neni 11

Atëherë kur pala kërkuese për të dëshmuar ose ballafaqim kërkon paraqitjen e një personi, i cili është në gjendje burgimi, ky person do të jetë përkohësisht i transferuar në territorin ku do të zhvillohet pyetja, me kusht që ritransferimi i tij duhet të bëhet në afatin e treguar nga pala së cilës i drejtohet kërkesa dhe me rezervën e dispozitave të nenit 12, në atë masë që këto të fundit do të gjejnë zbatim.

Transferimi mund edhe të refuzohet:

a) në qoftë se personi i dënuar nuk do të pranojë;

b) në qoftë se prania e tij është e nevojshme në një procedim penal që po zhvillohet në territorin e palës, së cilës i drejtohet kërkesa;

c) në qoftë se transferimi i tij do të zgjaste më tej gjendjen e tij të burgimit;

d) në qoftë se kërkesa të tjera imperative bëjnë të domosdoshme transferimin e tij në territorin e palës kërkuese.

2. Në rastin e parashikuar në paragrafin e mësipërm dhe me rezervën e dispozitave të nenit 2, kalimi tranzit i personit të dënuar nëpërmjet territorit të një shteti të tretë, pala e kësaj Konvente, dhe bazuar mbi një kërkesë, që korredon të gjitha dokumentet e nevojshme, Ministria e Drejtësisë e palës kërkuese i drejton Ministrisë së Drejtësisë së palës së cilës i drejtohet kërkesa për kalim tranziti.

Secila palë kontraktuese mund të refuzojë kalimin tranzit të shtetasve të vet.

3. Personi i transferuar duhet të qëndrojë në gjendje burgimi në territorin e palës kërkuese dhe, në rast se në territorin e palës së cilës i drejtohet kërkesa e tranzitit, vetëm në qoftë se pala së cilës i drejtohet kërkesa, nuk kërkon që ai të vihet në gjendje lirie.

Neni 12

1. Asnjë dëshmitar apo ekspert, pavarësisht nga kombësia e tij, i cili shfaqet përpara autoriteteve gjyqësore të palës kërkuese, si rrjedhojë e një letërthirrjeje për t'u paraqitur në gjyq, nuk mund të ndiqet penalisht, të mbahet në gjendje arresti ose t'i nënshtrohet ndonjë mase tjetër shtrënguese për lirinë e tij individuale brenda territorit të palës së cilës i është drejtuar kërkesa, për fakte apo dënime që janë kryer përpara nisjes së tij nga territori i kësaj pale.

2. Asnjë person pavarësisht nga kombësia e tij, i thirrur përpara autoriteteve gjyqësore të palës kërkuese për t'u përgjigjur atje, për fakte për të cilat i është nënshtruar një procedimi penal, mund të ndiqet penalisht, të mbahet në gjendje burgimi ose t'i nënshtrohet masave të tjera shtrënguese të lirisë individuale për fakte dhe dënime që janë kryer përpara nisjes së tij nga territori i palës së cilës i është drejtuar kërkesa dhe që nuk përfshihen në letërthirrje.

3. Imuniteti i parashikuar nga ky nen pushon së funksionuari atëherë kur dëshmitari, eksperti apo individi i cili i është nënshtruar një procedimi penal, duke patur mundësinë e lënies së territorit të palës kërkuese për 15 ditë pasuese pasi paraqitja e tij nuk është më e kërkuar nga autoritetet gjyqësore, edhe në qoftë se ka ngelur në këtë territor ose ka bërë kthimin pasi është lëshuar.

TITULLI IV
KARTOTEKA E GJYKATËS (ZYRA E GJENDJES GJYQËSORE)

Neni 13

1.Pala, së cilës i drejtohet kërkesa, do të komunikojë në atë masë në të cilën autoritetet e tyre gjyqësore mundet që nga ana e tyre të mbajnë edhe në një rast tjetër analog, të dhënat e kartotekës së gjykatës ose çfarëdolloj informacioni tjetër që lidhet me ato dhe që autoritetet gjyqësore të njerës nga palët kontraktuese do të kenë kërkuar për

nevojat e një procedimi penal.

2.Në raste të ndryshme nga ata të parashikuar në paragrafin e parë të

këtij neni do të kihen parasysh kërkesa të tilla në kushtet e parashikuara nga legjislacioni, regolamentet ose nga praktika e palës, së cilës i drejtohet kërkesa.

TITULLI V
PROCEDURA

Neni 14

1. Kërkesat e ndihmës gjyqësore duhet të përmbajnë treguesit e mëposhtëm:

a) autoritetin nga i cili ka ardhur kërkesa,

b) objektin dhe motivin e kërkesës,

c) për sa është e mundur, identitetin dhe kombësinë e personit në çështje dhe

d) në qoftë se është e mundur emrin dhe adresën e marrësit (destinatorit).

2. Letërporositë e parashikuara në nenet 3, 4 dhe 5 do të përmendin gjithashtu, përveç akuzës edhe një paraqitje të përmbledhur të fakteve.

Neni 15

1. Letërporositë, për të cilat nenet 3, 4 dhe 5, si edhe kërkesat e parashikuara në nenin 11, do të drejtohen nga Ministria e Drejtësisë e palës kërkuese tek Ministria e Drejtësisë e Palës, së cilës i është drejtuar kërkesa dhe do të kthehet nëpërmjet të njëjtës rrugë.

2. Në rast urgjence, këto letërporosi mund të dërgohen edhe drejtpërsëdrejti nga autoritetet gjyqësore të palës kërkuese, autoriteteve gjyqësore të palës së cilës i drejtohet kërkesa. Ato duhet të kthehen së bashku me dokumentat që lidhen me ekzekutimin e tyre sipas mënyrës së parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni.

3. Kërkesat, për të cilat paragrafi i parë i nenit 13, mund të dërgohen drejtëpërdrejtë nga autoritetet gjyqësore në zyrën kompetente të palës së cilës i drejtohet kërkesa dhe përgjigjet do të dërgohen nëpërmjet kësaj zyre. Kërkesat, për të cilat paragrafi i dytë i nenit 13, do të dërgohen nga Ministria e Drejtësisë Palës kërkuese Ministrisë së Drejtësisë të palës së cilës i drejtohet kërkesa.

4. Kërkesat për ndihmë juridike, të ndryshme nga ato të parashikuara nga paragrafi i tretë i këtij neni, ose në veçanti kërkesat për hetime paraprake për një proces penal, mund të jenë objekt komunikimi të drejtëpërdrejtë nga autoritetet gjyqësore.

5. Në rastet kur transferimi direkt është i lejueshëm nga kjo Konventë, ajo mund të bëhet nëpërmjet Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (Interpol).

6. Secila palë kontraktuese mundet që, në aktin e firmosjes së kësaj konvente ose në rastin e depozitimit të instrumenteve të ratifikimit ose të pranimit, me deklaratën drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, bën të ditur nëse të gjitha ose disa kërkesa të ndihmës juridike duhet të jenë..... nëpërmjet një rruge të ndryshme nga ajo të parashikuar në këtë nen, dhe të kërkojë që, në bazë të paragrafit të dytë të këtij neni, një kopje të letërporosisë duhet t' komunikohet në të njëjtën kohë Ministrisë së saj të Drejtësisë.

7. Ky nen nuk paragjykon dispozitat lidhur me marrëveshjet (traktatet bilaterale) në fuqi ndërmjet palëve kontraktuese, në të cilat është parashikuar transferimi i drejtëpërdrejtë i kërkesave për ndihmë juridike ndërmjet autoriteteve të palëve.

Neni 16

1.Përkthimi i kërkesave dhe i akteve bashkangjitur me to nuk do të

jetë i detyrueshëm, me përjashtim të rasteve të përmendura në dispozitat e paragrafit të dytë të këtij neni.

2. Secila nga palët kontraktuese mundet që, në aktin e firmosjes ose të depozitimit të instrumenteve të ratifikimit ose të pranimit, me deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, duke rezervuar mundësinë për të kërkuar që kërkesat dhe katet e tjera bashkëngjitur duhet të transferohen të shoqëruar nga ajo qoftë nga një përkthim në gjuhën e vet qoftë edhe nga një përkthim në cilëndo nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Europës (frengjisht, anglisht), ose në atë gjuhë që pala do të kërkojë. Palët e tjera mund të aplikojnë parimin e reciprocitetit.

3. Ky nen nuk do të paragjykojë dispozitat që lidhen me përkthimin e kërkesave dhe të akteve që u bashkëngjiten dhe që përmbahen në konventat ose në marrëveshjet në fuqi ose që do të nënshkruhen ndërmjet dy ose më shumë palëve kontraktuese.

Neni 17

Aktet dhe dokumentet, që transferohen në zbatim të kësaj konvente, do të jenë të përjashtuara nga çdo formalitet legalizimi.

Neni 18

Në qoftë se autoritetet e investuara me një kërkesë për ndihmë juridike janë inkompetente për ta ndjekur, ata do të transferojnë zyrtarisht një kërkesë të tillë autoritetit kompetent të vendit përkatës dhe, atëherë kur kërkesa do të jetë transferuar drejtëpërsëdrejti, do të njoftojnë në të njëjtën rrugë (mënyrë) palën kërkuese.

Neni 19

Çdo refuzim për të dhënë ndihmë juridike duhet të jetë i motivuar.

Neni 20

Përveç dispozitave të nenit 9, ekzekutimi i kërkesave të ndihmës juridike nuk do të bëhet asnjë rimbursim i shpenzimeve me përjashtim të atyre të provokuara nga ekspertët në territorin nga ana e palës së cilës i drejtohet kërkesa dhe nga transferimi i të dënuarve i realizuar në zbatim të nenit 11.

TITULLI VI
DENONCIMET ME QËLLIM PROCEDIMIN PENAL

1. Çdo denoncim nga njëra nga palët kontraktuese e cila synon fillimin e një procedimi penal përpara autoriteteve gjyqësore të një pale tjetër, do të jetë objekt i komunikimeve ndërmjet Ministrive të Drejtësisë. Megjithatë palët kontraktuese mund të përfitojnë nga mundësia që i jepet nga paragrafi i 6 i nenit 15.

2. Pala, së cilës e drejtohet kërkesa, do të komunikojë përfundimin denoncimit dhe atëherë, kur duhet do të transferojë masën paraprake të marrë.

3. Denoncimeve të parashikuara nga paragrafi i parë i këtij neni do të zbatohen dispozitat e nenit 16.

TITULLI VII
SHKËMBIMI I INFORMACIONIT LIDHUR ME DËNIMET

Neni 22

Secila nga palët kontraktuese do të informojë palën e interesuar për vendimet penale dhe të masave përkatëse që i përkasin shtetasve të kësaj pale dhe që kanë qenë objekt për një regjistrim në zyrën e gjendjes gjyqësore. Ministritë e Drejtësisë të palëve në fjalë do të shkëmbejnë një informacion të tillë të paktën një herë në vit. Në qoftë se personi nën një çështje është konsideruar shtetas i dy ose më shumë palëve kontraktuese, informacionet do të komunikohen nga secila nga palët e interesuara vetëm nëse një person e tillë nuk do të posedojë kombësinë e palës në territorin e së cilës është dhënë dënimi.

TITULLI VIII
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 23

1. Secila nga palët kontraktuese mundet që, në momentin e firmosjes së kësaj Konvente ose të depozitimit të instrumenteve të ratifikimit ose të pranimit, të hartojë një rezervim për një ose më shumë dispozita të përcaktuara në këtë Konventë.

2. Secila nga palët kontraktuese që do të ketë formuluar një rezervë do ta revokojë atë menjëherë sapo rrethanat do ta lejojnë atë. Revokimi i rezervave do të bëhet nëpërmjet njoftimit që i drejtohet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

3. Një palë kontraktuese që ka formuluar një rezervë për njërën nga dispozitat e Konventës nuk mund të pretendojë që pala tjetër të aplikojë këtë dispozitë deri në atë masë, që ajo vetë e ka pranuar.

Neni 24

Secila nga palët kontraktuese, në momentin e firmosjes së kësaj konvente, ose të depozitimit të instrumenteve të ratifikimit ose të pranimit, me deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, duhet të tregojë se cilin autoritet ajo konsideron si autoritet gjyqësor për efekte të kësaj konvente.

Neni 25

1. Kjo Konventë do të zbatohet në territorin metropolitan të palëve kontraktuese.

2. Ajo do të aplikohet edhe në Francë, Algjeri përsa i takon territoreve përtej detit si edhe përsa i përket Italisë, territorit të Somalisë nën administrimin italian.

3. Republika Federale e Gjermanisë mund të zgjerojë zbatimin e kësaj Konvente në "Land" e Berlinit nëpërmjet deklarimit direkt tek Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

4. Përsa i përket Mbretërisë së Vendeve të Ulta, kjo Konventë do të zbatohet në territorin europian të saj. Mbretëria mund ta shtrijë zbatimin e kësaj Konvente në Antillet e Hollandës, në Surinam dhe në Guinenë e Re Holandeze nëpërmjet një deklarate direkte Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

5. Nëpërmjet një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë palëve kontraktuese, fusha e zbatimit të kësaj konvente mund edhe të shtrihet, sipas kushteve që do të nënshkruhen në këtë marrëveshje, në territorin e njërës palë të ndryshëm nga ato që përmbahen në paragrafin 1,2,3, dhe 4 të këtij neni ku njëra nga palët garanton marrëdhëniet ndërkombëtare.

Neni 26

1. Përveç dispozitave të paragrafit 7 të nenit 15 dhe të paragrafit 3 të nenit 16, kjo Konventë abrogon, përsa i përket territoreve tek të cilat zbatohet, dispozitat që në traktatet, konventat dhe marrëveshjet dypalëshe rregullojnë ndërmjet dy palëve kontraktuese, ndihmën juridike në fushën penale.

2. Megjithatë kjo Konventë nuk do të paragjykoje detyrimet që përmbahen në ndonjë konventë tjetër ndërkombëtare të karakterit dypalëshe ose shumëpalëshe, në të cilat disa klauzola rregullojnë ose do të rregullojnë, në një fushë të përcaktuar, ndihmën jurdike lidhur me çështje të caktuara.

3. Palët kontraktuese nuk mund të përfundojnë ndërmjet tyre marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe lidhur me ndihmën juridike përveçse për të kompletuar dispozitat e kësaj konvente ose për të lehtësuar zbatimin e parimeve që përmbahen në të.

4. Në qoftë se, ndërmjet dy ose më shumë palëve kontraktuese, ndihma juridike në fushën penale do të bëhet në bazë të një legjislacioni uniform ose të një regjimi të veçantë që parashikon zbatimin reciprok të masave të ndihmës juridike në territoret tyre përkatëse, këto palë do të kenë mundësinë e rregullimit të marrëdhënieve të tyre të shumta në një fushë të tillë duke u bazuar ekskluzivisht në sisteme të tilla sipas dispozitave të kësaj Konvente. Palët kontraktuese, që përjashtojnë ose do të përjashtojnë nga marrëdhëniet e tyre reciproke zbatimin e kësaj konvente, në përputhje me dispozitate këtij paragrafi, duhet t'i bëjnë një njoftim Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 27

1. Kjo Konventë do të qëndrojë e hapur për t'u firmosur nga anëtarët e Këshillit të Europës. Ajo do të ratifikohet dhe instrumentet e ratifikimit do të jenë depozituar pranë Sekretarit

2. Konventa do të hyjë në fuqi 90 ditë pas datës së depozitimit të instrumentave të ratifikimit.

3. Përsa i përket çdo shteti firmues të kësaj konvente, që do të kenë ratifikuar kohët e fundit, ajo do të hyjë në fuqi 90 ditë pas depozitimit të instrumentave të saj të ratifikimit.

Neni 28

1. Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës mund të ftojë çdo shtet që nuk është anëtar i Këshillit të aderojë në këtë Konventë.Vendimi për një ftesë të tillë duhet të merret me një marrëveshje unanime të anëtarëve të Këshillit që kanë ratifikuar Konventën.

2. Pranimi do të bëhet nëpërmjet depozitimit, pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit, të një instrumenti pranimi, që do të ketë efekt 90 ditë pas depozitimit të tyre.

Neni 29

Secila nga palët kontraktuese mundet, përsa i takon, të denoncojë këtë konventë duke iu drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Një denoncim i tillë do të fillojë të veprojë 6 muaj mbas datës së marrjes së njoftimit nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit.

Neni 30

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'i njoftojë Anëtarëve të Këshillit të Europës dhe qeverive të çdo shteti, që ka aderuar në këtë Konventë:

a) emrat e firmuesve dhe depozitimin e çdo instrumenti të ratifikimit ose të pranimit;

b)datën e hyrjes në fuqi;

c) çdo njoftim të marrë në zbatim të dispozitave të paragrafit të parë të nenit 5, të paragrafit 3 të nenit 7, të paragrafit 6 të nenit 15, të paragrafit 2 të nenit 16, të nenit 24, të paragrafit të 3 dhe 4 të nenit 25 dhe të paragrafit 4 të nenit 26;

d) çdo rezervim të formuluar në zbatim të dispozitave të paragrafit të parë të nenit 23;

e) revokimin të bërë në zbatim të dispozitave të paragrafit të dytë të nenit 23, të çdo rezerve;

f) çdo njoftim të denoncimit të marrë në zbatim të dispozitave të nenit 29 dhe datën në të cilën ajo do të veprojë.

Me besim të nënshkruarit kanë firmosur këtë Konventë.

E bërë në Strasburg, me 20 prill 1959, në gjuhën franceze dhe angleze, të dy tekstet kanë të njëjtën vlerë, në një ekzemplar të vetëm, që do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të transmetojë një kopje origjinale qeverive që kanë firmosur dhe kanë aderuar.

DEKLARIME DHE REZERVIME TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË "KONVENTËN EUROPIANE TË NDIHMËS JURIDIKE NË FUSHËN PENALE"

REZERVIME

Neni 2

Republika e Shqipërisë do të refuzojë dhënien e ndihmës juridike në fushën penale:

a) për vepra penale të cilat nuk parashikohen si të tilla nga legjislacioni penal shqiptar në fuqi;

b) për ato vepra penale të cilat janë në proces hetimi në territorin e Republikës së Shqipërisë ose në një shtet tjetër.

D E K L A R I M E

Neni 3 paragrafi II

Sipas nenit 360 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë dëshmitari ka detyrimin dhe përgjegjësinë ligjore për të thënë të vërtetën me përjashtim të rasteve kur dëshmitari është i mitur deri në 14 vjeç.

Sekretari i gjykatës lexon deklaratën e betimit të dëshmitarit "Betohem se do të them të vërtetën të gjithë të vërtetën dhe të mos them asgjë që nuk është e vërtetë".

Pas kësaj dëshmitari deklaron "Betohem" dhe tregon gjeneralitetet e tij.

Mosrespektimi i paragrafeve 2 dhe 3 sjell pavlefshmërinë e veprimit të kryer.

Neni 8

Personi i thirrur në bazë të letërporosisë, kur paraqitet, nuk mund t'i nënshtrohet kufizimit të lirisë personale për fakte që kanë ndodhur para njoftimit për t'u paraqitur.

Paprekshmëria e parashikuar në paragrafin e mësipërm pushon kur dëshmitari, eksperti apo i pandehuri, duke patur mundësinë nuk është larguar nga territori i shtetit shqiptar, me kalimin e 15 ditëve nga momenti kur prania e tij nuk kërkohet më nga autoriteti gjyqësor ose kur, pasi është larguar është kthyer vullnetarisht.

Neni 9

Shpenzimet e bëra në territorin shqiptar mbulohen nga pala shqiptare, kur nuk ka marrëveshje tjetër.

Neni 11

Republika e Shqipërisë deklaron se ndihma e kërkuar në kuptim të nenit 11 të Konventës nuk mund të jepet.

Neni 16

Republika e Shqipërisë deklaron se do të kërkojë që dokumentet e dërguara për qëllim të kësaj konvente do të shoqërohen me një përkthim të tyre në njërën nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Europës.

Neni 24

Autoritet gjyqësore, në kuptim të kësaj Konvente, janë Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë, gjykatat dhe prokuroritë.

PROTOKOLLI SHTESË
I KONVENTËS EUROPIANE PËR NDIHMËN E NDËRSJELLTË JURIDIKE NË FUSHËN PENALE (ETS NR.99)

Strasburg, 17 mars 1978

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës, nënshkruese të këtij protokolli,

Duke dëshiruar lehtësimin e zbatimit të Konventës Europiane të Këshillit të europës, mbi ndihmën e Ndërsjelltë Juridike në Fushën Penale, e hapur për nënshkrim në Strasburg, në 20 prill 1959 (e quajtur më poshtë "Konventa"), në fushën e krimeve fisklae;

Duke e konsideruar atë si një shtesë të konsiderueshme të Konventës në disa drejtime,

Ranë dakord si më poshtë:

KAPITULLI I

Neni 1

Palët kontraktuese nuk do të ushtrojnë të drejtat e parashikuara në nenin 2.a të Konventës për të refuzuar asistencën vetëm se kërkesa lidhet me një krim i cili për palën e kërkuar konsiderohet një krim fiskal.

Neni 2

1. Në rastin kur një palë kontraktuese ka bërë ekzekutimin e letërporosisë për kërkimin ose konfiskimin e pronësisë me kushtin që krimi i cili motivon letërporosinë është i dënueshëm në bazë të të dy ligjeve, si të palës kërkuese ashtu edhe të palës së kërkuar, ky kusht përmbushet në lidhje me shkeljet fiskale nëse shkelja është e dënueshme në bazë të ligjit të palës kërkuese dhe përputhet me një shkelje të së njëjtës natyre në bazë të ligjit të palës së kërkuar.

2. Kërkesa nuk mund të rfuzohet për shkak se ligji i palës së kërkuar nuk parashikon të njëjtën taksë apo tatim doganor ose nuk përmban një taksë, tarifë ose detyrim doganor dhe të njëjtin mënyrë konvertimi siç e parashikon ligji i palës kërkuees.

KAPITULLI II

Neni 3

Konventa zbatohet edhe për:

a) Dorëzimin e dokumenteve në lidhje me ekzekutimin e një dënimi, marrjen e një gjobe ose pagesën e shpenzimeve të procesit gjyqësor.

b) Masat që rregullojnë pezullimin e shpalljes së një dënimi ose ekzekutimin e tij, lirimin me kusht, shtyrjen e fillimit të ekzekutimit të një dënimi ose ndërprerjen e një ekzekutimi të tillë.

KAPITULLI III

Neni 4

Neni 22 i Konventës plotësohet me tekstin e mëposhtëm, teksti origjinal i nenit 22 të Konventës, bëhet paragrafi 1 dhe dispozitat e përmendura më poshtë bëhen paragrafi 2.

“2. Për më tepër, çdo palë kontraktuese, që ka dhënë informacionin e sipërpërmendur i komunikon palës së interesuar, mbi bazën e kërkesës së kësaj të fundit, për çdo rast të veçantë, një kopje të dënimeve dhe masave në fjalë, si edhe çdo informacion që ka të bëjë me to, në mënyrë që t’i jepet mundësi asaj për të parë nëse këto bëjnë të domosdoshme marrjen e ndonjë mase në nivel kombëtar. Ky komunikim bëhet ndërmjet Ministrive përkatëse të Drejtësisë.

KAPITULLI IV

Neni 5

1. Ky protokoll është i hapur për nënshkrim për shtetet anëtare të Këshillit të Europës që kanë nënshkruar Konventën. Ajo i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose të miratimit depozitohen te Sekretari iPërgjithshëm i Këshillit të Europës.

2. Protokolli do të hyjë në fuqi 90 ditë pas datës së depozitimit të tre instrumenteve të ratifikimit, pranimit ose të miratimit.

3. Në rastin e një shteti nënshkrues, i cili ratifikon pranon ose miraton më vonë, protokolli do të hyjë në fuqi 90 ditë mbas datës së depozitimit të instrumenteve të saj të ratifikimit, pranimit ose të miratimit.

4. Një shtet anëtar i Këshillit të Europës nuk mund të ratifikojë, të pranojë ose të miratojë këtë protokoll pa ratifikuar paraprakisht Konventën.

Neni 6

1. Çdo shtet që është pranuar në Konventë mund të pranohet edhe në këtë protokoll pas hyrjes në fuqi të këtij protokolli.

2. Një pranim i tillë do të ketë efekt me depozitimin pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës të një instrumenti pranimi, i cili do të ketë efekt 90 ditë pas datës së depozitimit të tij.

Neni 7

1. Çdo shtet mundet, në kohën e nënshkrimit ose kur depoziton instrumentet e tij të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose të miratimit, të përcaktojë territorin ose territoret në të cilat ky protokoll do të zbatohet.

2. Çdo shtet mundet, në kohën e nënshkrimit ose kur depoziton instrumentet e tij të ratifikimit, pranimit të miratimit ose të miratimit, ose në çdo datë tjetër të mëvonshme, me anë të një deklarate të adresuar te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës, të shtrijë efektet e këtij protokolli mbi një ose disa territore të përcaktuara në deklaratë dhe për ato marrëdhënie ndërkombëtare për të cilat ai është përgjegjës, ose në ato për të cilat ai është autorizuar të ndërmarrë.

3. Çdo deklaratë e bërë lidhur me paragrafin e mësipërm mundet që, në çdo territor të përmendur në një deklaratë të tillë, të tërhiqet nëpërmjet një njoftimi të adresuar te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës. Një tërheqje e tillë fillon të ketë efekt 6 muaj pas datës së marrjes së njoftimit nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 8

1. Rezervimet e bëra nga ana e palëve kontraktuese lidhur me ndonjë dispozitë të Konventës do të jenë të zbatueshme edhe për këtë protokoll, përveç kur pala nuk deklaron ndryshe në kohën e nënshkrimit ose kur depoziton instrumentet e saj të ratifikimit, miratimit ose të miratimit. E njëjta gjë do të zbatohet edhe për deklaratat e bëra në bazë të nenit 24 të Konventës.

2. Çdo shtet mundet, që në kohën e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumenteve të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose të miratimit, të deklarojë se rezervon të drejtën:

a) të mos pranojë Kapitullin I, ose ta pranojë atë vetëm lidhur me disa krime të caktuara, ose kategori krimesh të referuara në nenin 1 ose që nuk përputhen me letërporositë për kërkim ose konfiskim të pasurisë në lidhje me krimet fiskale;

b)të mos pranojë Kapitullin II;

c)të mos pranojë Kapitullin III.

3. Çdo palë kontraktuese mund të tërheqë deklarën e bërë në përputhje me paragrafin e mësipërm me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, e cila do të jetë efektive nga data e marrjes së njoftimit.

4. Një palë kontraktuese që ka bërë një rezervim ndaj këtij protokolli në lidhje me një parashikim të Konventës ose që ka bërë një rezervim në lidhje me një parashikim të protokollit, nuk mund të kërkojë zbatimin e këtij parashikimi nga një palë tjetër, megjithatë mundet që n.q.s. rezervimi është i pjesshëm ose i kushtëzuar, mund të kërkojë zbatimin e këtij parashikimi për aq sa e ka pranuar vetë ai.

5. Asnjë rezervim tjetër nuk mund të bëhet lidhur me dispozitat e këtij protokolli.

Neni 9

Dispozitat e këtij protokolli nuk paragjykojnë rregullime të mëtejshme të tjera me marrëveshje dypalëshe dhe shumëpalëshe të lidhura ndërmjet palëve kontraktuese, në zbatim të nenit 26 paragrafi 3 të Konventës.

Neni 10

Komiteti Europian për Problemet e Krimit në Këshillin e Europës do të mbahet i informuar lidhur me zbatimin e këtij protokolli dhe do të bëjë të gjitha përpjekjet për të lehtësuar zbatimin.

Neni 11

1. Çdo palë kontraktuese, mundet përsa lidhet me të, të denoncojë këtë protokoll nëpërmjet një njoftimi të bërë te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

2. Një denoncim i tillë do të ketë efekt 6 muaj pas datës së marrjes së njoftimit nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

3. Denoncimi i Konventës passjell automatikisht edhe denoncimin e këtij Protokolli.

Neni 12

Sekretari i i Përgjithshëm i Këshillit të Europës duhet të njoftojë shtetet anëtare të Këshilllit të Europës, si dhe çdo shtet që e ka pranuar Konventën mbi:

a.çdo nënshkrim të këtij protokolli;

b.çdo depozitim të instrumenteve të ratifikimit, pranimit, miratimit ose të miratimit;

c.çdo datë të hyrjes në fuqi të këtij Protokolli në përputhje me nenin 5 dhe 6;

d.çdo deklarim të marrë lidhur me paragrafet 2 dhe 3 të nenit 7;

e.çdo deklarim të marrë lidhur me paragrafin 1 të nenit 8

f.çdo rezervim të bërë në lidhje mesa është parashikuar në paragrafin 2 të neni 8;

g.tërheqja e çdo rezerve e bërë në përputhje mesa është parashikuar në paragrafin 3 të nenit 8;

h.çdo njoftim të marrë në përputhje me nenin 11 dhe datën kur denoncimi fillon efektet e tij.

Palët e autorizuara me mirëbesim dhe mirëkuptim e kanë nënshkruar këtë protokoll.

Bërë në Strasburg me 17 Mars 1978, në anglisht dhe frëngjisht, të dy tekstet me vlerë të njëjtë, dhe një kopje e të cilave depozitohet në arkivën e Këshillit të Europës. Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të dërgojë kopje të vërtetuara të secilës, shteteve nënshkruese dhe pranuese.

LIGJ
Nr. 8883, datë 18.4.2002

PËR RATIFIKIMIN E "PROTOKOLLIT TË DYTË SHTESË TË "KONVENTËS SË KËSHILLIT TË EUROPËS PËR NDIHMËN E NDËRSJELLË JURIDIKE NË FUSHËN PENALE"

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Protokolli i dytë shtesë i "Konventës së Këshillit të Europës për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3314, datë 29.4.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.17, faqe 509

PROTOKOLLI I DYTË SHTESË
I KONVENTËS EUROPIANE PËR NDIHMË TË NDËRSJELLË NË FUSHËN PENALE

Strasburg 8.11.2001

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës, që kanë nënshkruar këtë Protokoll:

Duke pasur parasysh përgjegjësitë e tyre sipas Statutit të Këshillit të Europës;

Duke dashur të kontribuojnë më tej për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, respektimin e shtetit të së drejtës dhe mbështetjen për një shoqëri demokratike;

Duke e konsideruar këtë të rëndësishme për forcimin e kapacitetit individual e kolektiv për t'iu përgjigjur krimit;

Vendosën të përmirësojnë dhe shtojnë aspekte të caktuara të Konventës Europiane për Ndihmë të Ndërsjellë Gjyqësore në Fushën Penale, Strasburg 20 prill 1959 (këtu referuar si Konventa), si edhe Protokollit shtesë të saj, Strasburg 17 mars 1978;

Duke pasur në konsideratë Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, Romë 4 nëntor 1950, si edhe Konventën për Mbrojtjen e Personave nga Procesimi Automatik i të Dhënave Personale, Strasburg 28 janar 1981;

Ranë dakord si më poshtë:

KAPITULLI 1

Neni 1
Qëllimi

Neni 1 i Konventës zëvendësohet me dispozitën e mëposhtme:

1. Palët i japin njëra-tjetrës, sipas dispozitave të kësaj Konvente, ndihmë të ndërsjellë gjyqësore maksimale në mënyrë të menjëhershme në lidhje me veprat penale, dënimi i të cilave, në kohën e paraqitjes së kërkesës për ndihmë, është brenda juridiksionit të autoriteteve gjyqësore të Palës kërkuese.

2. Kjo Konventë nuk është e zbatueshme për arrestimet, zbatimin e vendimeve ose veprat penale sipas ligjit penal ushtarak, të cilat nuk janë vepra penale, bazuar në të drejtën penale.

3. Ndihma e ndërsjellë gjyqësore mund të jepet edhe në procedimet e nisura nga autoritetet administrative në lidhje me aktet e dënueshme si shkelje ligjore, sipas të drejtës kombëtare të Palës kërkuese ose të kërkuar, vendimi për të cilat mund të çojë në një procedim penal përpara një gjykate me juridiksion të posaçëm për çështjet penale.

4. Ndihma e ndërsjellë gjyqësore nuk refuzohet vetëm mbi bazën se ajo lidhet me vepra penale, për të cilat personi mund të konsiderohet fajtor nga Pala kërkuese.

Neni 2

Prania e përfaqësuesve të Palës kërkuese

1. Nenin 4 i Konventës shtohet me dispozitën e mëposhtme, duke e bërë nenin 4 të Konventës aktuale paragrafin 1 dhe dispozitën e mëposhtme paragrafin 2.

2. Kërkesa për praninë e përfaqësuesve të Palës kërkuese ose personave të interesuar nuk duhet të refuzohet në ato raste kur kjo prani ka të ngjarë ta bëjë zbatimin e kërkesës për ndihmë gjyqësore më të përgjegjshme ndaj nevojave të Palës kërkuese dhe si pasojë shmang nevojën për kërkesa shtesë për ndihmë gjyqësore.

Neni 3

Transferimi i përkohshëm i personave të dënuar në territorin e Palës kërkuese

Neni 11 i Konventës zëvendësohet nga dispozitat e mëposhtme:

"1. Një person i ndaluar, paraqitja personale e të cilit në gjyq bëhet për qëllime dëshmie dhe jo për t'u gjykuar, transferohet përkohësisht në territorin e Palës kërkuese, duke marrë sigurinë se ai apo ajo do të kthehet brenda kohës së përcaktuar nga Pala e kërkuar, në zbatim të dispozitave të nenit 12 të kësaj Konvente.

Transferimi mund të refuzohet kur:

a) personi i ndaluar nuk jep pëlqimin e tij;

b) paraqitja e tij apo e saj është e nevojshme për një procedim penal të hapur në territorin e Palës së kërkuar;

c) ky transferim ka të ngjarë të zgjasë periudhën e ndalimit;

d) ka arsye të forta për moskryerjen e këtij transferimi në territorin e Palës kërkuese.

2. Sipas nenit 2 të kësaj Konvente, paragrafi 1, kalimi tranzit i një personi përmes territorit të një Pale të tretë, bëhet pas paraqitjes së kërkesës, shoqëruar me dokumentet e nevojshme nga Ministria e Drejtësisë së Palës kërkuese, Ministrisë së Drejtësisë së Palës së Tretë, përmes së cilës do të bëhet tranziti. Kjo Palë mund të refuzojë të japë tranzit shtetasve të tij.

3. Personi i transferuar do të mbahet në paraburgim në territorin e Palës kërkuese dhe, kur është e mundur, në territorin e Palës përmes së cilës është kërkuar tranziti, përderisa Pala prej së cilës është kërkuar transferimi nuk aplikon për lirimin e tij ose të saj.".

Neni 4

Rrugët e komunikimit

Neni 15 i Konventës do të zëvendësohet me dispozitat e mëposhtme:

"1. Kërkesa për asistencë reciproke, si dhe informacioni spontan do të adresohet me shkrim nga Ministria e Drejtësisë së Palës kërkuese tek Ministria e Drejtësisë e Palës së kërkuar dhe do të kthehet nëpërmjet të njëjtës rrugë. Megjithatë, ato mund të nisen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga autoritetet gjyqësore të Palës kërkuese tek autoritetet e Palës së kërkuar dhe të kthehen përmes së njëjtës rrugë.

2. Aplikimet, siç parashikohen në nenin 11 të kësaj Konvente dhe nenin 13 të Protokollit të Dytë shtesë të kësaj Konvente, në të gjitha rastet do t'i adresohen nga Ministria e Drejtësisë së Palës kërkuese tek Ministria e Drejtësisë së Palës së kërkuar dhe të kthehet nëpërmjet rrugëve të njëjta.

3. Kërkesa për asistencë reciproke lidhur me procedurat, siç parashikohen në paragrafin 3 neni 1 të kësaj Konvente, mund të kalohet direkt nga autoritetet administrative dhe gjyqësore të Palës kërkuese tek autoritetet administrative dhe gjyqësore të Palës së kërkuar, sipas rastit, dhe të kthehen përmes së njëjtës rrugë.

4. Kërkesat për asistencë reciproke, të bazuara në nenet 18, 19 të Protokollit të Dytë Shtesë të kësaj Konvente, mund të nisen direkt nga autoritetet kompetente të Palës kërkuese tek autoritetet kompetente të Palës së kërkuar.

5. Kërkesat e parashikuara në paragrafin 1 të nenit 13 të kësaj Konvente mund të nisen direkt nga autoritetet gjyqësore kompetente tek autoritetet e duhura të Palës që ka paraqitur kërkesën dhe përgjigjet mund të kthehen direkt nga këto autoritete. Kërkesat e parashikuara në paragrafin 2 të nenit 13 të kësaj Konvente do të nisen nga Ministria e Drejtësisë e Palës kërkuese tek Ministria e Drejtësisë të Palës së kërkuar.

6. Kërkesat për kopjet e dënimeve dhe të masave që parashikohen në nenin 4 të Protokollit Shtesë të Konventës mund të bëhen direkt nga autoritetet kompetente. Cilido Shtet Kontraktues, mund, në çdo kohë, me anë të një deklarate adresuar Sekretariatit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të përkufizojë cilat autoritete do të konsiderohen për qëllimet e këtij paragrafi si autoritete kompetente.

7. Në raste urgjente, kur transmetimi direkt lejohet përmes kësaj Konvente, mund të kryhet nëpërmjet organizatës ndërkombëtare të Policisë Kriminale (Interpol).

8. Cilado Palë mund, në çdo kohë, me anë të një deklarate adresuar Sekretariatit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të rezervojë të drejtën për bërjen e ekzekutimit të kërkesës ose kërkesave specifike për asistencë reciproke, në varësi të një ose më shumë kushteve të mëposhtme:

a) që një kopje e kërkesës t'i niset autoritetit qendror të përcaktuar me anë të një deklarate;

b) që kërkesat, duke përjashtuar kërkesat urgjente, t'i nisen autoritetit qendror, të përcaktuar në atë deklaratë;

c) që, në rast të transmetimit direkt për arsye urgjence, një kopje do t'i transmetohet në të njëjtën kohë Ministrisë së Drejtësisë;

d) që disa ose të gjitha kërkesat për asistencë t'i dërgohen nëpërmjet rrugëve të tjera nga ato që janë parashikuar në këtë nen.

9. Kërkesat për asistencë reciproke dhe çdo komunikim tjetër, bazuar në këtë Konventë ose Protokollet e saj, mund të nisen përmes rrugës elektronike ose formave të tjera të telekomunikimit, me kusht që Pala kërkuese është përgatitur, bazuar në kërkesë, të paraqesë në çdo kohë një dokument me shkrim të saj, si dhe origjinalin. Megjithatë, cilido Shtet Kontraktues, me anë të një deklarate adresuar në çdo kohë Sekretariatit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, vendos kushtet sipas të cilave do të pranojë dhe ekzekutojë kërkesat e marra në rrugë elektronike ose në mënyra të tjera telekomunikuese.

10. Dispozitat e këtij neni nuk paragjykojnë marrëveshjet ose rregullimet bilaterale në fuqi midis Palëve, të cilat parashikojnë transmetimin direkt të kërkesave për asistencë midis autoriteteve të tyre respektive.".

Neni 5

Shpenzimet

Neni 20 i Konventës do të zëvendësohet nga dispozitat e mëposhtme:

"1. Palët nuk do të pretendojnë kundrejt njëra-tjetrës rimbursimin e ndonjë shpenzimi si rezultat i aplikimit në bazë të kësaj Konvente ose protokollit të saj, përveç:

a) shpenzimeve, si rezultat i pjesëmarrjes së ekspertëve në territorin e Palës që ka paraqitur kërkesën;

b) shpenzimeve, si rezultat i transferimit të një personi të paraburgosur në bazë të neneve 13 dhe 14 të Protokollit të Dytë Shtesë të kësaj Marrëveshjeje;

c) shpenzime esenciale ose të jashtëzakonshme.

2. Megjithatë, nëse Palët nuk bien dakord ndryshe, shpenzimet për vendosjen e një lidhjeje me video ose telefon, shpenzimet lidhur me vënien në shërbim të një lidhjeje me video ose telefon Palës që ka paraqitur kërkesën, pagesat për përkthyesit dhe dëshmitarët, si dhe shpenzimet e udhëtimit për të shkuar tek Pala që ka paraqitur kërkesën do t'i disbursohen Palës së kërkuar nga Pala që ka paraqitur kërkesën.

3. Palët do të konsultohen me njëra-tjetrën, me qëllim që të bien dakord për pagesat e shpenzimeve që pretendohen sipas paragrafit 1.c të sipërpërmendur.

4. Dispozitat e këtij neni do të aplikohen pa paragjykuar dispozitat e nenit 10 paragrafi 3 të kësaj Konvente.".

Neni 6
Autoritetet gjyqësore

Neni 20 i Konventës do të zëvendësohet nga dispozitat e mëposhtme:

"Çdo Shtet, në kohën e firmosjes ose kur depoziton dokumentin e tij të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aksesimit, me anë të një deklarate të adresuar Sekretariatit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës do të përkufizojë se cilët autoritete do të konsiderojë si autoritete gjyqësore për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje. Më vonë mund, në çdo kohë dhe në të njëjtën mënyrë, të ndryshojnë dispozitat e deklaratës së tij.".

KAPITULLI 2

Neni 7
Shtyrja e ekzekutimit të kërkesave

1. Pala që ka paraqitur kërkesën mund të shtyjë veprimin, bazuar në një kërkesë të tillë nëse veprimi mund të paragjykojë procesin hetimor, ndjekjen penale ose procedura të tjera të lidhura të ndërmarra nga autoritetet.

2. Para refuzimit ose shtyrjes së ndihmës, Pala që ka bërë kërkesën, kur është e mundur pasi është konsultuar me Palën kërkuese, do të konsiderojë nëse kërkesa mund të miratohet pjesërisht ose duke paraqitur kushte që i konsideron të nevojshme.

3. Nëse kërkesa shtyhet, duhet të paraqiten arsyet për shtyrjen, Pala që ka paraqitur kërkesën informon Palën kërkuese për ndonjë arsye që e bën të pamundur ekzekutimin e kërkesës ose që mund të vonojë kërkesën në mënyrë për një kohë të gjatë.

Neni 8
Procedura

Pavarësisht nga dispozitat e nenit 5, kur kërkesat specifikojnë formalitete ose procedura të cilat janë të domosdoshme sipas ligjit të Palës kërkuese, megjithëse të panjohur për Palët që kanë paraqitur kërkesën, kjo e fundit do të zbatojë kërkesa të tilla deri në atë masë sa që veprimi i kërkuar nuk bie ndesh me parimet themelore të ligjit të tij, derisa e kundërta nuk parashikohet në këtë Protokoll.

Neni 9
Proceset e dëgjimit me video

1. Nëse një person është në territorin e njërës Palë dhe duhet të marrë pjesë si dëshmitar ose ekspert në çështjet gjyqësore të Palës tjetër, kjo e fundit mund, kur nuk është e dëshiruar ose e mundur për personin, të paraqitet në territorin në fjalë personalisht, të kërkojë që procesi të zhvillohet me video - konferencë, siç parashikohet në paragrafët 2-7.

2. Pala që e ka paraqitur kërkesën bie dakord për zhvillimin e procesit me video-konferencë, me kusht që përdorimi i video-konferencës nuk bie ndesh me parimet e ligjit të saj dhe me kusht që posedon infrastrukturën teknike për zhvillimin e procesit.

Nëse Pala që ka paraqitur kërkesën nuk disponon infrastrukturën teknike për zhvillimin e procesit në video, konferencë, një infrastrukturë e tillë mund t'i vihet në dispozicion nga Pala kërkuese me anë të një marrëveshjeje.

3. Kërkesa për zhvillimin e procesit me video-konferencë do të përmbajë, përveç informacionit të referuar në nenin 14 të Konventës, arsyen pse nuk është e dëshiruar ose e mundur për dëshmitarin ose ekspertin pjesëmarrja personalisht, emrin e autoritetit gjyqësor dhe të personave që do të zhvillojnë procesin gjyqësor.

4. Autoriteti gjyqësor i Palës që ka paraqitur kërkesën do t'i nisë urdhëresë gjyqësore personit në fjalë për t'u paraqitur sipas procedurave që përmban ligji i saj.

5. Përsa i përket proceseve me video-konferencë, do të aplikohen rregullat e mëposhtme:

a) Një autoritet gjyqësor i Palës që ka paraqitur kërkesën do të jetë prezent gjatë procesit, do të jepet ndihma e përkthyesit nëse është nevoja dhe do të jetë përgjegjës për të bërë të mundur identifikimin e personit pjesëmarrës dhe respektimin e parimeve thelbësore të ligjit të Palës kërkuese.

Nëse autoriteti gjyqësor i Palës që ka paraqitur kërkesën është i mendimit që, për gjatë procesit, parimet themelore të ligjit të Palës që ka paraqitur kërkesën janë nëpërkëmbur, do të marrë në mënyrë të menjëhershme masa të nevojshme për të bërë të mundur vazhdimin e procesit sipas parimeve të sipërpërmendura.

b) Masat për mbrojtjen e personit pjesëmarrës në proces do të ndërmerren kur është e nevojshme me miratimin e autoriteteve kompetente të Palëve kërkuese dhe të kërkuara.

c) Procesi zhvillohet drejtpërsëdrejti ose nën drejtimin e autoritetit gjyqsor të Palës kërkuese në përputhje me ligjet e saj.

d) Me kërkesë të Palës kërkuese ose të personit pjesëmarrës në proces, Pala që ka paraqitur kërkesën do të bëjë të mundur që personi pjesëmarrës në proces të asistohet nga një përkthyes nëse lind nevoja.

e) Personi pjesëmarrës në proces mund të ushtrojë të drejtën e tij për të mos dëshmuar, e cila i lind atij ose asaj sipas ligjit të Palës që i është paraqitur kërkesa ose të Palës kërkuese.

6. Pa paragjykuar masat e rëna dakord për mbrojtjen e personave, autoriteti gjyqësor i Palës që i është paraqitur kërkesa, në përfundim të procesit do të dokumentojë minutat, të konfirmojë datën dhe vendin e zhvillimit të procesit, identitetin e personit pjesëmarrës, identitetin dhe funksionet e të gjithë personave të Palës që i është paraqitur kërkesa, pjesëmarrës në këtë proces, të hetimeve të bëra dhe të kushteve teknike nën të cilat është zhvilluar procesi. Dokumenti do të niset nga autoriteti kompetent i Palës që ka paraqitur kërkesën autoritetit kompetent të Palës kërkuese.

7. Çdo Palë duhet të marrë masat e nevojshme për të siguruar që në rastet kur dëshmitarët ose ekspertët që merren në pyetje brenda territorit të tyre, nën detyrimin për të dëshmuar në përputhje me këtë nen dhe refuzojnë të dëshmojnë ose nuk dëshmojnë të vërtetën, të zbatohet legjislacioni i tyre kombëtar në të njëjtën mënyrë, sikundër do të ndodhte nëse marrja në pyetje (dëgjimi) të bëhej sipas procedurave kombëtare.

8. Palët nën diskrecionin e tyre mund të zbatojnë parashikimet e këtij neni, në përputhje dhe në marrëveshje me autoritetet kompetente gjyqësore dhe në rastet e seancave gjyqësore me video-konferencë. Në këtë rast, vendimi për të mbajtur vide-konferencën, si dhe përcaktimi i mënyrës se si do të zhvillohet video-konferenca duhet të jenë subjekt i marrëveshjes ndërmjet Palëve të interesuara, gjithmonë në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar, si dhe me instrumentet e përshtatshme ndërkombëtare. Seancat e dëgjimit, që kanë të bëjnë me personin e akuzuar apo të dyshuar, do të zhvillohen me miratimin e tij ose të saj.

9. Çdo Shtet Kontraktues, në çdo kohë, me anë të një deklarate të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, duhet të deklarojë se nuk do të përdorë mundësinë e ofruar në paragrafin 8 për aplikimin e parashikimeve të këtij neni për rastet e zhvillimit të seancave me video-konferencë, ku përfshihet dhe personi i akuzaur ose i dyshuar.

Neni 10

Seancat e dëgjimit me anë të konferencave telefonike

1. Nëse një person ndodhet në territorin e një Pale dhe do të dëgjohet në seancë gjyqësore prej një organi gjyqësor të një Pale tjetër në cilësinë e një dëshmitari ose eksperti, mundet që, në rastet kur legjislacioni i tij kombëtar e parashikon, të kërkojë ndihmën e Palës së mëparshme për të bërë të mundur zhvillimin e seancës së dëgjimit me anë të konferencave telefonike, sikundër është parashikuar në paragrafët nga 2-6.

2. Seanca dëgjimore mund të zhvillohet me anë të konferencave telefonike, vetëm në rast se dëshmitari ose eksperti bie dakord për zhvillimin e seancës dëgjimore me këtë metodë.

3. Pala e kërkuar duhet të japë miratimin e tij për zhvillimin e seancës dëgjimore, me anë të konferencave telefonike, në rastet kur kjo nuk është në kundërshtim me parimet themelore të legjislacionit të vet.

4. Kërkesa për konferenca telefonike duhet të përmbajë, në vijim të informacionit të cilit i referohet në nenin 14 të Konventës, emrin e autoritetit gjyqësor dhe të personave të cilët do të drejtojnë seancën dëgjimore, si dhe të përmbajë një përcaktim që dëshmitari ose eksperti është i gatshëm për të marrë pjesë në një seancë me konferencë telefonike.

5. Palët duhet të bien dakord për çështjet praktike që kanë të bëjnë me seancën dëgjimore. Në rast se bien dakord për rregullime të tilla, Pala e kërkuar duhet:

a) të njoftojë dëshmitarin ose ekspertin për kohën dhe vendin e zhvillimit të seancës së dëgjimit;

b) të sigurojë identitetin e dëshmitarit ose ekspertit;

c) të verifikojë nëse dëshmitari ose eksperti bien dakord për zhvillimin e seancës me anë të mbledhjes telefonike.

6. Pala e kërkuar mund të bëjë tërësisht ose pjesërisht marrëveshjen, subjekt të parashikimeve përkatëse të nenit 9 paragafi 5 dhe 7.

Neni 11

Informacioni spontan

1. Pa paragjykuar hetimet ose procedurat ekzistente, autoritetet kompetente të një Pale mundet që, pa nevojën e një kërkese paraprake, të nisin për autoritetet kompetente të Palës tjetër informacionin e përfituar brenda kuadrit të hetimeve të kryera nga ana e tyre, kur ata vlerësojnë që zbardhja e informacionit mund të asistojë Palën marrëse në fillimin ose zbatimin e procedurave ose hetimeve që mund të çojë në një kërkesë bazuar në Konventën ose Protokollet e saj, nënshkruar nga ajo Palë.

2. Pala që siguron informacionet mundet që, në përputhje me legjislacionin e saj kombëtar, të vendosë kushte për përdorimin e informacioneve të tilla për Palën që i merr këto informacione.

3. Pala që i merr këto informacione duhet t'u përmbahet këtyre kushteve.

4. Çdo Shtet Kontraktues mundet që në çdo kohë, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të deklarojë që ai rezervon të drejtën për të mos iu përmbajtur këtyre kushteve të vendosura nga Pala që siguron informacionin sipas paragrafit 2 të mësipërm, përveç rasteve kur ai merr njoftim paraprak për natyrën e informacionit që do të sigurohet dhe bie dakord për transmetimin e tij.

Neni 12

Kthimi

1. Me kërkesë të Palës kërkuese dhe pa paragjykuar të drejtat e Palëve të treta në bona fide (mirëbesim), Pala e kërkuar mund të vendosë në dispozicion të Palës kërkuese objekte të marra me mënyra jo ligjore, me synim për t'ia kthyer pronarëve të tyre të ligjshëm.

2. Në zbatim të neneve 3 dhe 6 të Konventës, Pala e kërkuar mund të heqë dorë nga një aplikim i neneve si para, ashtu dhe pasi i janë dhënë Palës kërkuese, nëse aplikimi i neneve të tilla për pronarin e tyre të ligjshëm mund të lehtësohen nga kjo. Të drejtat e palëve të treta në bona fide nuk do të preken nga kjo.

3. Në rastin e heqjes dorë nga aplikimi i neneve, para se ato t'i kalojnë Palës kërkuese, Pala e kërkuar nuk do të ushtrojë të drejtën e sigurimit ose të drejtë tjetër rekursi të parashikuar në legjislacionin e taksave ose doganave në zbatim të këtyre neneve.

4. Një heqje dorë, sikundër është referuar në paragrafin 2, nuk do të ketë të bëjë me paragjykim të së drejtës së Palës së kërkuar për të mbledhur taksa ose detyrime të tjera tatimore nga pronari i ligjshëm.

Neni 13

Transferimi i përkohshëm i personave të ndaluar për tek Palët e kërkuara

1. Në se ka një marrëveshje midis autoriteteve kompetente të Palëve në fjalë, një Palë e cila ka kërkuar një hetim për të cilin kërkohet prezenca e personit të mbajtur në paraburgim në territorin e saj mund të transferojë përkohësisht atë person në territorin e Palës ku bëhet hetimi.

2. Marrëveshja do të mbulojë rregullimet për transferimin e përkohshëm të personit dhe datën në të cilën personi duhet të kthehet në territorin e Palës kërkuese.

3. Kur kërkohet miratimi i personit për transferimin, një dëshmi miratimi ose një kopje e saj duhet t'i dërgohet Palës së kërkuar.

4. Personi i transferuar do të mbetet në paraburgim në territorin e Palës së kërkuar dhe, kur aplikohet, në territorin e Palës në të cilën kërkohet kalimi tranzit, përveç rastit kur Pala nga e cila personi është transferuar kërkon lirimin e tij/e saj.

5. Periudha e paraburgimit në territorin e Palës së kërkuar do të reduktohet nga periudha e mbajtjes, të cilën personi në fjalë është ose do të jetë i detyruar ta kalojë në territorin e Palës kërkuese.

6. Dispozitat e nenit 11 paragrafi 2 dhe nenit 12 të Konventës do të zbatohen mutatis mutandis.

7. Çdo Shtet Kontraktues mund, në çdo kohë, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të deklarojë që para se të arrihet një marrëveshje nën paragrafin 1 të këtij neni, kërkohet miratimi, të cilit i referohet paragrafi 3 i këtij neni, ose do të kërkohet nën kushte të veçanta të bëra në deklaratë.

Neni 14

Paraqitja personale e personit të caktuar për transferim

Dispozitat e nenit 11 dhe 12 të Konventës do të zbatohen mutatis mutandis edhe ndaj personave të cilët janë në paraburgim në territorin e Palës së kërkuar, që janë transferuar në mënyrë që të vuajnë një dënim të dhënë në Palën kërkuese, ku paraqitja personale për efekt të rishikimit të gjykimit është kërkuar nga Pala kërkuese.

Neni 15

Gjuha e dokumenteve procedurale dhe vendimeve gjyqësore të nevojshme

1. Dispozitat e këtij neni do të zbatohen për çdo kërkesë për shërbim në nenin 7 të Konventës ose nenit 3 të Protokollit Shtesë.

2. Dokumentet procedurale dhe vendimet gjyqësore, në çdo rast, do të transmetohen në gjuhën ose gjuhët në të cilën ato janë lëshuar.

3. Paravarësisht nga dispozitat e nenit 16 të Konventës, nëse autoriteti që ka lëshuar dokumentet di ose ka arsye të besojë se adresati kupton vetëm ndonjë gjuhë tjetër, dokumentet ose të paktën pjesët më të rëndësishme do të shoqërohen me një përkthim në atë gjuhë tjetër.

4. Pavarësisht dispozitave të nenit 16 të Konventës, dokumentet procedurale dhe vendimet gjyqësore, për të mirën e autoriteteve të Palës së kërkuar, do të shoqërohen nga një përmbledhje e shkurtër e përmbajtjes së tyre e përkthyer në gjuhën ose një nga gjuhët e asaj Pale.

Neni 16

Shërbimi me postë

1. Autoritetet gjyqësore të ndonjë Pale mund t'u drejtohen direkt, me postë, dokumente procedurale dhe vendime gjyqësore, personave të cilët janë në territorin e ndonjë Pale tjetër.

2. Dokumentet procedurale dhe vendimet gjyqësore do të shoqërohen nga një raport i cili të përcaktojë se adresati mund të marrë informacion nga autoriteti i identifikuar në raport për të drejtat

e tij/të saj dhe detyrimet lidhur me shërbimin e dokumenteve. Dispozitat e paragrafit 3 të nenit 15 do të zbatohen për atë raport.

3. Dispozitat e nenit 8, 9 dhe 12 të Konventës do të zbatohen mutatis mutandis ndaj shërbimit me postë.

4. Dispozitat e paragrafit 1, 2 dhe 3 të nenit 15 më sipër, gjithashtu, do të zbatohen ndaj shërbimit me postë.

Neni 17

Mbikëqyrje ndërkufitare

1. Oficerët e policisë të njërës nga Palët që, në kuadrin e një hetimi penal, do të mbikëqyrin në vendin e tyre një person që prezumohet të ketë marrë pjesë në një vepër penale, ndaj të cilës mund të zbatohet ekstradimi, ose një person ndaj të cilit ka arsye të forta për të besuar se do të çojë në identifikimin ose vendndodhjen e personit të sipërpërmendur, do të autorizohen të vazhdojnë mbikëqyrjen e tyre në territorin e Palës tjetër, kur kjo e fundit ka autorizuar mbikëqyrjen ndërkufitare në përgjigje të një kërkese për asistencë, e cila është dorëzuar më parë. Kushtet mund t'i bashkëngjiten autorizimit.

Sipas kërkesës, mbikëqyrja do t'ju besohet oficerëve të Palës, në territorin e të cilës kryhet mbikëqyrja.

Kërkesa për asistencë sipas nënparagrafit të parë duhet t'i dërgohet një autoriteti të caktuar nga secila Palë dhe që ka juridiksion të japë ose të nisë autorizimin e kërkuar.

2. Kur, për arsye të veçanta urgjence, autorizimi paraprak i Palës tjetër nuk mund të kërkohet, oficerët që kryejnë mbikëqyrjen në kuadrin e një hetimi penal do të autorizohen të vazhdojnë mbikëqyrjen përtej kufijve të një personi që prezumohet të ketë kryer vepër penale të përcaktuar në paragrafin 6, duke u siguruar që të plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Autoritetet e Palës të caktuar nën paragrafin 4, në territorin e së cilës do të vazhdojë mbikëqyrja, duhen njoftuar menjëherë, gjatë mbikëqyrjes, që kufiri është kaluar.

b) Do të dorëzohet pa asnjë vonesë një kërkesë për asistencë sipas paragrafit 1 dhe që nënvizon arsyet për kalimin e kufirit pa autorizim.

Mbikëqyrja do të përfundojë sapo Pala në territorin e së cilës është duke u kryer kjo mbikëqyrje e kërkon këtë gjë, pas njoftimit të referuar në pikën a ose kërkesës së referuar në pikën b ose atje ku autorizimi nuk është marrë brenda një kohe prej 5 orësh pas kalimit të kufirit.

3. Mbikëqyrja e referuar në paragrafët 1 dhe 2 do të kryhet vetëm sipas kushteve të përgjithshme të mëposhtme:

a) Organi i policisë që kryen mbikëqyrjen duhet të ndjekë dispozitat e këtij neni dhe ligjin e Palës, në territorin e së cilës po operohet; ata (policët) duhet t'i binden udhëzimeve të organeve përgjegjëse lokale.

b) Përveç situatave të parashikuara në paragrafin 2, gjatë kohës së mbikëqyrjes, policët do të mbajnë me vete një dokument që vërteton se autorizimi është dhënë.

c) Policët që janë duke kryer mbikëqyrjen duhet të jenë në gjendje gjatë të gjithë kohës të provojnë që ata po veprojnë me autoritet zyrtar.

d) Policët që janë duke kryer mbikëqyrjen mund të mbajnë armët e tyre gjatë kësaj mbikëqyrjeje, përveç, sigurisht, kur vendoset ndryshe nga Pala e kërkuar; përdorimi i armëve do të jetë i ndaluar përveç rasteve të vetëmbrojtjes.

e) Hyrja në shtëpi private dhe vende të pacaktuara për publikun është e ndaluar.

f) Policët që janë duke kryer mbikëqyrjen nuk mund të ndalojnë ose të marrin në pyetje, dhe as të arrestojnë personin nën mbikëqyrje.

g) Të gjitha veprimet mund të raportohen tek autoritetet e Palës, në territorin e së cilës ato u kryen; policët që janë duke kryer mbikëqyrjen mund të kërkohen të shfaqen personalisht.

h) Kur kërkohet nga organet e Palës, në territorin e së cilës u krye mbikëqyrja, organet e Palës nga e cila kanë ardhur policët mbikëqyrës do të ndihmojnë në investigimin pas operacionit, në të cilin ato morrën pjesë, duke përfshirë edhe procedimet ligjore.

4. Gjatë kohës së firmosjes ose depozitimit të instrumentit të ratifikimit të Palëve, këto do të përcaktojnë, me anë të një deklarate të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të dy policët dhe organet që ata zgjedhim për qëllimet e shprehura në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni.

Në çdo kohë dhe në të njëjtën mënyrë, Palët mund të ndryshojnë termat e deklaratës së tyre.

5. Në një nivel bilateral, Palët mund të zgjerojnë hapësirën e këtij neni dhe të përshtasin masa të tjera në zbatimin e tij.

6. Mbikëqyrja e referuar në paragrafin 2 mund të ndodh vetëm për një nga krimet e mëposhtme:

- vrasje e një personaliteti publik;
- vrasje;
- përdhunim;
- djegie prone;
- falsifikim;
- vjedhje me armë dhe pranimi i mallrave të vjedhura;
- kërcënim për të marrë paratë;
- rrëmbim dhe marrje peng;
- trafikim njerëzish;
- trafikim i paligjshëm, i narkotikëve dhe substancave psikoterapike;
- përdorim eksplozivësh;
- mbartja e paligjshme e mbetjeve toksike dhe të rrezikshme;
- trafikim i të huajve;
- abuzim seksual i fëmijëve.

Neni 18

Dorëzim i kontrolluar

1. Çdo Palë merr përsipër të sigurojë që, pas kërkesës së një Pale tjetër, dorëzimet e kontrolluara mund të lejohen në territorin e saj në kuadrin e investigimeve penale mbi krimet e ekstradueshme.

2. Vendimi për të kryer dorëzime të kontrolluara do të merret sipas çdo rasti nga organet kompetente të Palës së kërkuar, duke marrë parasysh të drejtën kombëtare të asaj Pale.

3. Dorëzimet e kontrolluara do të bëhen në përputhje me procedurat e Palës së kërkuar. Kompetenca për të vepruar, drejtuar dhe kontrolluar operacionet do të jetë mbi organet kompetente të asaj Pale.

4. Në kohën e firmosjes ose depozitimit të instrumentit të tyre të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose hyrjes, me anë të një deklarate të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, Palët do të përcaktojnë organet që janë kompetente sipas këtij neni. Ato mund, në çdo kohë dhe në të njëjtën mënyrë, të ndryshojnë kushtet e deklaratës së tyre.

Neni 19

Hetimet sekrete

1. Palët kërkuese dhe të kërkuara mund të bien dakord të asistojnë njëra-tjetrën në kryerjen e hetimeve të krimeve me anë të policëve që veprojnë me identitet të fshehur, (investigimet sekrete).

2. Vendimi mbi kërkesën merret për çdo rast me anë të organeve kompetente të Palës së kërkuar, duke marrë në konsideratë të drejtën dhe procedurat kombëtare. Zgjatja e investigimit sekret, kushtet e detajuara, dhe statusi ligjor i policëve të përfshirë në investigimet sekrete do të negociohen midis Palëve, duke marrë parasysh procedurat dhe të drejtën kombëtare.

3. Hetimet sekrete do të bëhen në përputhje me procedurat dhe të drejtën kombëtare të Palës në territorin e së cilës bëhet investigimi sekret. Palët e përfshira do të bashkëpunojnë për të siguruar që investigimi sekret të përgatitet dhe mbikëqyret dhe për të bërë rregullime për sigurimin e policëve që veprojnë me identitet të fshehur ose fals.

4. Gjatë kohës së firmosjes ose depozitimit të instrumentit të ratifikimit të Palëve, këto do të përcaktojnë, me anë të një deklarate të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës organet kompetente për qëllimet e shprehura në paragrafin 2 të këtij neni. Në çdo kohë dhe në të njëjtën mënyrë, Palët mund të ndryshojnë termat e deklaratës së tyre.

Neni 20

Skuadrat e hetimeve të përbashkëta

1. Me anë të një marrëveshjeje të përbashkët, organet kompetente të dy ose më shumë Palëve mund të ngrejnë një skuadër të përbashkët investigimi për një qëllim specifik dhe për një periudhë të kufizuar, që edhe mund të zgjatet me anë të rakordimit të përbashkët, për të kryer investigime penale në një ose më shumë nga Palët që ngrejnë skuadrën. Përbërja e skuadrës do të vendoset në marrëveshje.

Një investigim i përbashkët mund të ngrihet, veçanërisht, kur:

a) investigimet e një Pale mbi krimet e rënda kërkojnë që investigimet e vështira të kenë lidhje me Palë të tjera;

b) një numër Palësh janë duke kryer investigime mbi krimet e rënda, në të cilat rrethanat e çështjes sjellin nevojën e veprimit të koordinuar dhe të përqëndruar nga Palët e përfshira.

Një kërkesë për ngritjen e një skuadre të përbashkët investigimi mund të bëhet nga çdo Palë përkatëse. Skuadra do të ngrihet në një nga Palët e parashikuara për të kryer investigim.

2. Përveç informacionit të referuar në dispozitat relevante të nenit 14 të Konventës, kërkesat për ngritjen e një skuadre të përbashkët investigimi do të përfshijnë propozime për përbërjen e skuadrës.

3. Një skuadër e përbashkët investigimi do të operojë në territorin e Palëve që formojnë skuadrën nën kushtet e përgjithshme si më poshtë:

a) Një udhëheqës skuadre do të jetë një përfaqësues i organit kompetent që merr pjesë në investigimet penale nga Pala në të cilën skuadra vepron. Kryetari i grupit do të veprojë brenda kufijve të kompetencës së tij ose të saj, sipas legjislacionit të vendit.

b) Grupi duhet të ushtrojë veprimet e tij në përputhje me ligjin e Palës në të cilën vepron. Anëtarët dhe anëtarët e bashkëngjitur të grupit do të kryejnë detyrat e tyre nën udhëheqjen e personit që i referohet nënparagrafi a, duke marrë në konsideratë kushtet e vendosura nga autoritetet e tyre në marrëveshjen e krijimit të grupit.

c) Pala në të cilën grupi vepron do të bëjë përgatitjet e duhura organizuese për të vepruar kështu.

4. Në këtë nen, pjesëtarët e grupit të përbashkët hetues nga Pala në të cilën grupi vepron janë referuar si "anëtarë", ndërkohë që anëtarët nga Palët ndryshe nga Pala në të cilën grupi vepron janë të referuara si "Palë të bashkëngjitura".

5. Palët e bashkëngjitura të grupit të përbashkët hetues do të kenë të drejtën të jenë të pranishme kur të ndërmerren masa hetimore në Palën në të cilën veprohet. Megjithatë, kryetari i grupit, për raste të veçanta, në përputhje me ligjin e Palës ku grupi vepron, mund të vendosë ndryshe.

6. Anëtarëve të bashkëngjitur të grupit të përbashkët hetimor mund, në përputhje me ligjin e Palës ku grupi vepron, t'u besohet nga kryetari i grupit me detyrën e ndërmarrjes të masave të veçanta hetimore kur kjo është aprovuar nga autoritetet kompetente të Palës ku kryhen veprimet dhe të Palës së bashkëngjitur.

7. Kur grupi i përbashkët hetimor ka të domosdoshme të ndërmerren masa hetimore në një nga Palët që ka krijuar grupin, anëtarët e bashkëngjitur të grupit nga kjo Palë mund të kërkojnë që të jenë autoritetet e veta kompetente të ndërmarrin këto masa. Këto masa do të konsiderohen në atë Palë, sipas kushteve në të cilat mund të aplikohet nëse do të kërkoheshin në një hetim kombëtar (brenda vendit).

8. Kur grupi i përbashkët hetimor ka të domosdoshme ndihmën nga një Palë ndryshe nga Palët të cilat kanë krijuar grupin ose nga një Shtet i tretë, kërkesa për ndihmë mund të bëhet nga

autoritetet kompetente të shtetit ku veprohet për autoritetet kompetente të Shtetit tjetër të interesuar në përputhje me instrumentet ose përgatitjet përkatëse.

9. Një anëtar i bashkëngjitur i grupit të përbashkët hetimor mund, në përputhje me ligjin e saj ose të tij kombëtar dhe brenda kufijve të kompetencës së saj ose të tij, t'i sigurojë grupit informacion që gjendet në Palën që i bashkëngjitet atij ose, asaj me qëllim kryerjen e hetimeve kriminale nga grupi.

10. Informacioni i siguruar në rrugë ligjore nga një anëtar ose një anëtar i bashkëngjitur ndërkohë që një pjesë e grupit të përbashkët hetimor, i cili nuk është ndryshe (në të kundërt) i gatshëm për autoritetin kompetent të Palëve të interesuara mund të shfrytëzohet për qëllimet e mëposhtme:

a) për qëllimet për të cilat grupi është krijuar;

b) në lidhje me pëlqimin e dhënë më parë nga Pala e cila dha informacionin për kapjen, hetimin dhe ndjekjen e veprave të tjera penale; ky pëlqim mund të jepet vetëm në rastet ku përdorimi i tillë do të rriste rrezikun për hetime kriminale nga Pala e interesuar apo që lidhet me të, atëherë Pala do të refuzojë ndihmën reciproke.

c) për të parandaluar një kërcënim të menjëhershëm dhe serioz ndaj sigurisë publike dhe pa paragjykim në paragrafin b, nëse hapet përsëri një hetim penal (kriminal);

d) për qëllime të tjera, në lidhje me atë që është rënë dakord mes Palëve, do të ngrihet një grup.

11. Ky nen do të jetë pa paragjykim për çdo dispozitë apo rregullim të ngritjes ose të veprimit të grupeve të përbashkëta të hetimeve.

12. Në lidhje me atë që shprehen ligjet e Palëve ose me dispozitat e çdo instrumenti të zbatueshëm ligjor që i lejon ata, mund të bihet dakord për rregullime për personat e ndryshëm nga ata përfaqësues të autoriteteve kompetente të Palëve të përcaktuara në grupet e përbashkëta të hetimeve për të marrë pjesë në aktivitetet e këtij grupi. Të drejtat që gëzojnë anëtarët apo zëvendësuesit e anëtarëve të grupit, siç parashikohet në këtë, nuk do të gëzohen nga këta persona për sa kohë nuk është rënë dakord dhe deklarohet e tillë.

Neni 21
Përgjegjësia penale e zyrtarëve

Gjatë veprimeve të referuara në nenet 17, 18, 19 ose 20, përveç rasteve kur vetë Palët kanë rënë dakord ndryshe, zyrtarët e Palës, të ndryshme nga Pala e veprimit, konsiderohen si zyrtarë të Palës së veprimit, në lidhje me krimet e kryera kundër tyre ose nga vetë ata.

Neni 22
Përgjegjësia civile e zyrtarëve

1. Në zbatim të neneve 17, 18, 19 ose 20, kur zyrtarët e një Pale veprojnë pranë Palës tjetër, Pala e parë është përgjegjëse për çdo dëm që mund të shkaktohet gjatë veprimeve, në përputhje me ligjin e Palës, në territorin e së cilës veprojnë.

2. Pala, në territorin e së cilës shkaktohet dëmi i referuar në paragrafin 1, zbaton ndaj tij të njëjtat dispozita të zbatueshme për dëmin e shkaktuar nga zyrtarët e tij.

3. Pala, zyrtarët e së cilës kanë shkaktuar dëm ndaj personit në territorin e Palës tjetër, rimbursojnë çdo shumë që është paguar për viktimat ose personat që kanë vepruar në emër të tyre.

4. Pa paragjykim në ushtrimin e të drejtave të tyre ndaj Palëve të treta dhe me përjashtim të paragrafit 3, secila Palë, në rastin e parashikuar në paragrafin 1, heq dorë nga kërkimi i rimbursimit të dëmit të pretenduar nga Pala tjetër.

5. Dispozitat e këtij neni janë subjekt i stimulimeve nëse Palët nuk bien dakord ndryshe.

Neni 23
Mbrojtja e dëshmitarëve

Nëse një Palë kërkon ndihmë, në bazë të Konventës ose njërit nga Protokollet e tij në lidhje me një dëshmitar të rrezikuar ose në nevojë për mbrojtje, autoritetet kompetente të Palës së kërkuar dhe kërkuese bien dakord për masat e mbrojtjes së personit të rrezikuar, në përputhje me ligjin e tyre të brendshëm.

Neni 24
Masat provizore

1. Me kërkesë të Palës kërkuese, Pala e kërkuar, në përputhje me ligjin e saj të brendshëm, merr masa provizore për ruajtjen e provave, të situatës ekzistuese ose mbrojtjes së interesave ligjore të rrezikuar.

2. Pala e kërkuar mund ta zbatojë kërkesën në mënyrë të pjesshme ose me kushte brenda një kohe të kufizuar.

Neni 25
Konfidencialiteti

Pala kërkuese i kërkon Palës së kërkuar të ruajë sekretin e faktit dhe thelbit të kërkesës, deri në masën e nevojshme të zbatimit të kërkesës. Nëse Pala e kërkuar nuk është dakord me kërkesën e konfidencialitetit, ajo duhet të njoftojë menjëherë Palën kërkuese.

Neni 26
Mbrojtja e të dhënave

1. Të dhënat personale të transferuara nga një Palë tek tjetra si rezultat i ekzekutimit të kërkesës së paraqitur në zbatim të Konventës ose njërit nga protokollet e saj, mund të përdoren nga Pala ku janë transferuar të dhënat vetëm:

a) për qëllime të procedurave, ndaj të cilave zbatohet Konventa ose një nga protokollet e saj;

b) për procedura të tjera gjyqësore ose administrative, që lidhen drejtpërdrejt me procedurat e përmendura në (a);

c) për parandalimin e një kërcënimi të menjëhershëm dhe serioz ndaj sigurisë publike.

2. Megjithatë, këto të dhëna mund të përdoren për çdo qëllim tjetër, nëse Pala që ka transferuar të dhënat, ka dhënë pëlqimin paraprak.

3. Secila Palë mund të refuzojë transferimin e të dhënave personale të marra si rezultat i ekzekutimit të kërkesës së paraqitur në bazë të Konventës ose njërit nga protokollet e saj, kur:

- këto të dhëna mbrohen nga legjislacioni vendas; dhe
- Pala së cilës duhet t'i dërgohen të dhënat nuk ka kufizime nga Konventa mbi Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale, bërë në Strasburg më 28.1.1981, për sa kohë që Pala në fjalë merr përsipër përballimin e mbrojtjes së këtyre të dhënave sikurse kërkohet nga Pala e parë.

4. Çdo Palë që dërgon të dhëna personale të marra si rezultat i zbatimit të një kërkese të paraqitur në kuadër të Konventës ose të ndonjë protokolli të saj mund t'i kërkojë Palës së cilës i janë dërguar të dhënat t'i japë informacion mbi përdorimin e këtyre të dhënave.

5. Çdo Palë, mundet që me një deklaratë të dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, brenda kuadrit të procedurave për të cilat mund të ketë refuzuar ose kufizuar transmetimin apo përdorimin e të dhënave personale bazuar në dispozitat e Konventës ose të ndonjë protokolli të saj, të kërkojë që të dhënat personale të dërguara një Pale tjetër të mos përdoren nga ky i fundit për qëllimet e përcaktuara në paragrafin 1, në qoftë se nuk është dhënë miraimi përkatës më parë.

Neni 27
Autoritetet administrative

Palët munden në çdo kohë, me anë të një deklarate të adresuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të përcaktojnë autoritete administrative për qëllime e përcaktuara në nenin 1 paragrafi 3 i Konventës.

LIGJ
Nr.8499, datë 10.6.1999

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SË KËSHILLIT TË EUROPËS "PËR TRANSFERIMIN E PERSONAVE TË DËNUAR"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet Konventa e Këshillit të Europës "Për transferimin e personave të dënuar" të datës 21.3.1983, me deklarimet e bëra në këtë ligj.

Neni 2

Bazuar në nenin 3 pika 3, Shqipëria deklaron moszbatimin e procedurave të parashikuara në nenin 9 pika 1 shkronja "a" të kësaj Konvente.

Neni 3

Bazuar në nenin 3 pika 4 "shtetas", për qëllim të kësaj Konvente, do të kuptohen edhe personat pa shtetësi që kanë banim të përhershëm në Shqipëri, si dhe ata që mbajnë dy shtetësi, kur njëra është shqiptare.

Neni 4

Lidhur me nenin 17 pika 3, Republika e Shqipërisë deklaron se i pranon kërkesat për transferimin e personave të dënuar dhe të dokumenteve shoqëruese, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me një kopje të përkthimit në gjuhën shqipe ose në njërën nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Europës.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2402, datë 29.6.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.22, faqe 719

KONVENTA
PËR TRANSFERIMIN E PERSONAVE TË DËNUAR

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe shtetet e tjera nënshkruese,

Duke parë se qëllimi i Këshillit të Europës është arritja e një uniteti më të madh ndërmjet anëtarëve të tij;

Duke dashur të zhvillojë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e së drejtës penale;

Duke parë se një bashkëpunim i tillë duhet t'i çojë më tej qëllimet e drejtësisë dhe rehabilitimin shoqëror të personave të dënuar;

Duke parë se këto objektiva kërkojnë që të huajve, të cilëve u është hequr liria si rezultat e kryerjes prej tyre të një vepre penale, duhet t'u jepet mundësia të vuajnë dënimin në shoqërinë e tyre; dhe

Duke parë se ky qëllim mund të arrihet më mirë duke i transferuar ata në vendet e tyre,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Përkufizime

Për qëllimet e kësaj konvente:

a. "dënim" do të thotë çdo dënim apo masë që ka të bëjë me heqjen e lirisë, të vendosur nga një gjykatë për një periudhë kohe të caktuar ose të përcaktuar si rezultat i një vepre penale;

b. "vendim" është çdo vendim ose urdhër i gjykatës që vendos një dënim;

c. "shteti dënues" është shteti në të cilin është dhënë dënimi për personin, i cili mund ose është transferuar;

d. "shteti zbatues" është shteti në të cilin personi i dënuar mund ose është transferuar për të vuajtur dënimin e tij.

Neni 2
Parime të përgjithshme

1. Palët angazhohen t'i ofrojnë njëra-tjetrës masën më të gjerë të bashkëpunimit në lidhje me transferimin e personave të dënuar në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente.

2. Një person i dënuar në territorin e një pale mund të transferohet në territorin e një pale tjetër, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, për të vuajtur dënimin që i është dhënë. Për këtë qëllim ai mund të shprehë interesin e vet tek shteti dënues ose tek shteti zbatues për transferimin e tij në përputhje me këtë Konventë.

3. Transferimi mund të kërkohet nga shteti dënues ose nga shteti zbatues.

Neni 3
Kushte për transferim

1. Në përputhje me këtë Konventë një person i dënuar mund të transferohet vetëm në kushtet e mëposhtme:

a.nëse ai person është shtetas i shtetit zbatues;

b.nëse vendimi është i formës së prerë;

c. nëse në kohën e marrjes së kërkesës për transferim, personi i dënuar ka ende të paktën gjashtë muaj të dënimit për të vuajtur apo nëse dënimi është i papërcaktuar;

d. nëse për transferimin është dhënë pëlqimi nga personi i dënuar ose kur, duke marrë parasysh moshën ose gjendjen e tij fizike ose mendore dhe, kur njëri prej të dy shteteve e konsideron atë si të nevojshme, nëpërmjet përfaqësuesit ligjor të personit të dënuar;

e. nëse veprimet apo mosveprimet, në bazë të të cilave është dhënë dënimi, përbëjnë një vepër penale në përputhje me të drejtën e shtetit zbatues ose do të përbënte një vepër penale nëse do të ishte kryer në territorin e tij; dhe

f. nëse shteti dënues dhe ai zbatues janë dakord me transferimin.

2. Në raste të veçanta, palët mund të bien dakord me një transferim edhe nëse koha që duhet të vuhet nga personi i dënuar është më e shkurtër se ajo e përcaktuar në paragrafin 1.c.

3. Në kohën e nënshkrimit apo të depozitimit të dokumentit të ratifikimit, pranimit, miratimit ose anëtarësimit, çdo shtet mund të bëjë të ditur se ai do të përjashtojë zbatimin e njërës prej procedurave të parashikuara në nenin 9.1.a dhe b. në marrëdhëniet e tij me palët e tjera, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

4. Në çdo kohë çdo shtet mund të përcaktojë, për aq sa ai është i interesuar, termin "shtetas" për qëllimet e kësaj Konvente me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 4

Detyrimi për të dhënë informacion

1. Çdo person i dënuar për të cilin mund të zbatohet kjo Konventë informohet nga shteti dënues mbi lëndën e kësaj Konvente.

2. Nëse personi i dënuar i ka shprehur interes shtetit dënues për t'u transferuar në përputhje me këtë Konventë, ai shtet njofton shtetin zbatues sa më shpejt që të jetë e mundur mbasi vendimi të ketë marrë formë të prerë.

1. Informacioni përmbledh:

a. emrin, datën dhe vendin e lindjes së personit të dënuar;

b. nëse ka, adresën në shtetin zbatues;

c. përshkrimin e fakteve mbi të cilat është bazuar dënimi;

d. natyrën, kohëzgjatjen dhe qëllimin e dënimit.

4. Nëse personi i dënuar i ka shprehur interesin e vet shtetit zbatues, shteti dënues me kërkesë i komunikon atij shteti informacionin e përmendur në paragrafin 3 të mësipërm.

5. Personi i dënuar informohet me shkrim për çdo veprim të ndërmarrë nga shteti dënues ose ai zbatues në përputhje me paragrafin e mësipërm, si edhe për çdo vendim nga çdo shtet mbi kërkesën për transferim.

Neni 5

Kërkesat dhe përgjigjet

1. Kërkesat për transferim dhe përgjigjet bëhen me shkrim.

2. Kërkesat bëhen nga Ministria e Drejtësisë e shtetit kërkues drejtuar Ministrisë së Drejtësisë të shtetit të adresuar. Përgjigjet komunikohen nëpërmjet të njëjtit kanal.

3. Secila palë mund të tregojë që ajo do të përdorë kanale të tjera komunikimi me anë të një deklarate, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

4. Shteti i adresuar njofton menjëherë shtetin kërkues për vendimin e tij nëse ai është dakord ose jo me transferimin e kërkuar.

Neni 6

Dokumentet shtesë

1. Shteti administrues i paraqet shtetit dënues, nëse kërkohen prej tij:

a. një dokument apo deklaratë që tregon se personi i dënuar është shtetas i atij shteti;

b. një kopje e ligjit përkatës të shtetit administrues, i cili parashikon që kryerja apo moskryerja e një veprimi për të cilin është dhënë dënimi në shtetin dënues përbën një vepër penale

në pajtim me ligjin e shtetit administrues apo do të përbënte një vepër penale nëse do të ishte kryer në trritorin e tij;

c. një deklaratë që të përmbajë informacionin e përmendur në nenin 9.2.

2. Nëse bëhet kërkesë për një transferim, shteti dënues i paraqet dokumentet e mëposhtme shtetit zbatues, nëse njëri prej shteteve ka bërë të ditur se ai nuk është dakord me transferimin:

a. një kopje të vërtetuar të vendimit dhe ligjit mbi të cilin ai është bazuar;

b. një deklaratë ku të tregohet se ç'pjesë e dënimit është vuajtur, duke përfshirë informacion për ndalimet paragjyqsore, shkurtimet e dënimeve, si edhe për çdo faktor tjetër që ka të bëjë me ekzekutimin e dënimit;

c. një deklaratë ku të shprehet pëlqimi për transferimin e përmendur në nenin 3.1.d dhe

d. kur është e nevojshme, ndonjë raport mjekësor apo shoqëror për personin e dënuar, informacione për trajtimin e tij në shtetin dënues dhe ndonjë rekomandim për trajtimin e tij të mëtejshëm në shtetin zbatues.

3. Secili shtet mund të kërkojë të pajiset me çfarëdolloj dokumenti ose deklaratë të përmendura në paragrafin 1 ose 2 të mësipërm para se të bëjë kërkesën për transferimin ose para marrjes së vendimit për rënien dakord për transformimin e tij ose jo.

Neni 7

Pëlqimi dhe verifikimi

1. Shteti dënues sigurohet që personi i kërkuar për të dhënë pëlqimin për transferimin në përputhje me nenin 3.1.d e bën këtë me vullnetin e tij dhe me dije të plotë për pasojat e tij. Procedura për dhënien e këtij pëlqimi rregullohet nga ligji i shtetit dënues.

2. Shteti dënues i jep mundësi shtetit zbatues që të verifikojë nëpërmjet një konsulli ose një zyrtari tjetër, për të cilin është rënë dakord nga shteti zbatues, që pëlqimi është dhënë në përputhje me kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 të mësipërm.

Neni 8

Efektet e transferimit për shtetin dënues

1. Marrja në dorëzim i personit të dënuar nga autoritetet e shtetit zbatues sjell si rezultat pezullimin e ekzekutimit të dënimit në shtetin dënues.

2. Shteti dënues nuk mund të ekzekutojë më tej dënimin, nëse shteti zbatues e konsideron ekzekutimin e dënimit si të përfunduar.

Neni 9

Efektet e transferimit për shtetin zbatues

1.Organet kompetente të shtetit zbatues:

a. vazhdojnë ekzekutimin e dënimit menjëherë ose nëpërmjet një vendimi gjykate ose administrativ, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 10;

b. konvertojnë dënimin me anë të një procedure gjyqësore ose administrative në një vendim të atij shteti, duke zëvendësuar kështu sanksionin e dhënë nga shteti dënues me një sanksion të parashikuar nga ligji i shtetit zbatues për të njëjtën vepër penale, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 11.

2. Nëse bëhet kërkesë, shteti zbatues informon shtetin dënues para transferimit të personit të dënuar, përsa i përket procedurës që do të ndiqet.

3. Ekzekutimi i dënimit rregullohet nga ligji i shtetit zbatues dhe vetëm ai shtet është kompetent për të marrë të gjitha vendimet përkatëse.

4. Secili shtet që në përputhje me ligjin e vet kombëtar nuk mund të zbatojë ndonjë nga procedurat e përmendura në pikën 1, për të ekzekutuar masat e dhëna në territorin e një pale tjetër mbi personat të cilët për shkaqe të gjendjes së tyre mendore nuk mund të dënohen për kryerjen e

veprës dhe që është i përgatitur për të pritur persona të tjerë për trajtim të mëtejshëm, mund të tregojë procedurat që ai do të ndjekë në raste të tilla, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 10
Vazhdimi i ekzekutimit

1. Në rastin e vazhdimit të ekzekutimit, shteti zbatues është i detyruar t'i përmbahet natyrës ligjore dhe kohëzgjatjes së dënimit, siç është përcaktuar në shtetin dënues.

2. Nëse ky dënim nga natyra ose kohëzgjatja nuk përputhet me ligjin e shtetit zbatues ose kur kjo parashikohet nga ligji i tij, ai shtet, me anë të një urdhri gjyqësor ose administrativ, mund të adoptojë sanksionin me dënimin ose masën e parashikuar nga ligji i vet për veprën penale. Përsa i përket natyrës së tij, dënimi ose masa, nëse është e mundur, duhet të korrespondojë me atë të dhënë nga dënimi për t'u ekzekutuar. Për nga natyra ose kohëzgjatja, ai nuk duhet të rëndojë sanksionin e dhënë nga shteti dënues dhe dhe nuk duhet të kalojë maksimumin e parashikuar nga shteti zbatues.

Neni 11
Konvertimi i dënimit

1. Në rastin e konvertimit të dënimit zbatohen procedurat e parashikuara nga ligji i shtetit zbatues. Kur bëhet konvertimi i dënimit, organi kompetent:

a. duhet t'u përmbahet konstatimeve për faktet kur ato shfaqen shprehimisht ose nënkuptohen nga vendimi i dhënë nga shteti dënues;

b. nuk mund të konvertojë një dënim me burgim në një dënim me gjobë;

c. shkurton periudhën e plotë të heqjes së lirisë që vuhet nga personi i dënuar; dhe

d. nuk e rëndon dënimin e personit të dënuar dhe nuk është i detyruar t'i përmbahet ndonjë minimumi që mund të parashikojë ligji i vendit zbatues për veprën ose veprat e kryera.

2. Nëse procedura e kovertimit kryhet pas transferimit të personit të dënuar, shteti zbatues e mban atë person në izolim ose siguron në ndonjë mënyrë tjetër praninë e tij në shtetin zbatues, derisa të dalë rezultati i procedurës.

Neni 12
Falja, amnistia, zëvendësimi

Secila palë mund të japë fjalë, amnisti ose zëvnedësim të dënimit në përputhje me Kushtetutën ose ligjet e tjera.

Neni 13
Rishikimi i vendimit

Vetëm shteti dënues ka të drejtën për të vendosur mbi çdo kërkesë për rishikimin e vendimit.

Neni 14
Përfundimi i ekzekutimit

Shteti zbatues përfundon ekzekutimin e dënimit menjëherë sapo të informohet nga shteti dënues për çdo vendim ose masë si rezultat i të cilit dënimi duhet të përfundojë.

Neni 15
Informacioni për ekzekutimin

Shteti zbatues i jep informacion shtetit dënues në lidhje me ekzekutimin e dënimit:

a.kur ai e konsideron ekzekutimin e dënimit të përfunduar;

b. nëse personi i dënuar është arratisur nga izolimi para se të përfundojë ekzekutimin e dënimit; ose

c. kur shteti dënues kërkon një raport të veçantë.

Neni 16
Tranziti

1. Secila palë në përputhje me ligjin e vet e plotëson kërkesën për kalimin tranzit të një personi të dënuar përmes territorit të tij, nëse një kërkesë e tillë bëhet nga një palë tjetër ose kur ai shtet ka rënë dakord me një palë tjetër ose me një shtet të tretë për transferimin e atij personi.

2. Një palë mund të mos pranojë të lejojë tranzitin:

a. nëse personi i dënuar është shtetas i tij, ose

b. nëse vepra penale për të cilën është dhënë dënimi nuk përbën vepër penale në përputhje me ligjin e vet.

3. Kërkesat për tranzit dhe përgjigjet komunikohen nëpërmjet kanaleve të përmendura në dispozitat e nenit 5.2 dhe 3.

4. Një palë mund të plotësojë një kërkesë të bërë nga një shtet i tretë për tranzitin përmes territorit të tij të një personi të dënuar, nëse ai shtet ka rënë dakord me një palë tjetër për transferimin nga ose në territorin e vet.

5. Pala, së cilës i është kërkuar të lejojë kalimin tranzit, mund të mbajë personin e dënuar në izolim, vetëm për atë kohë për të cilën kërkohet për të realizuar kalimin tranzit në territorin e tij.

6. Palës, së cilës i kërkohet të lejojë tranzitin, mund t'i kërkohet të japë garanci se personi i dënuar nuk do të persekutohet ose, nëse nuk është parashikuar ndryshe në paragrafin e mësipërm, që nuk do të ndalohet apo do të burgoset në ndonjë mënyrë tjetër në territorin e shtetit tranzit për ndonjë vepër penale të kryer apo dënim të dhënë para largimit nga territori i shtetit dënues.

7. Nuk nevojitet kërkesë për tranzit, nëse transporti bëhet me rrugë ajrore mbi territorin e palës dhe nuk është parashikuar ndonjë ndalim atje. Megjithatë çdo shtet mund të kërkojë me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, miratimit ose anëtarësimit, që ai të njoftohet për çdo tranzit të tillë mbi territorin e vet.

Neni 17
Gjuha dhe shpenzimet

1. Informacioni në përputhje me nenin 4 paragrafi 2-4 jepet në gjuhën e palës së cilës i adresohet ose në njërën nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Europës.

2. Me kufizimet e pikës 3 të mëposhtme nuk nevojitet përkthim për kërkesat e transferimeve ose të dokumenteve shtesë.

3. Secili shtet mund të kërkojë që kërkesat për transferim ose dokumentet shtesë të shoqërohen me një përkthim në gjuhët ose në njërën nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Europës ose në njërën nga gjuhët që ai bën të ditur me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës në momentin e nënshkrimit ose kur të depozitojë instrumentin e ratifikimit, pranimit, miratimit ose anëtarësimit. Në këtë rast ai mund të deklarojë gatishmërinë e vet për të pranuar përkthime në çdo gjuhë tjetër, përveç gjuhës ose gjuhëve zyrtare të Këshillit të Europës.

4. Përveç kufizimit të parashikuar në nenin 6.2.a, dokumentet e transmetuara në zbatim të kësaj Konvente nuk nevojitet të vërtetohen.

5. Të gjitha shpenzimet e dala si rezultat i zbatimit të kësaj Konvente përballohen nga shteti zbatues, përveç shpenzimeve të dala ekskluzivisht në territorin e shtetit dënues.

Neni 18
Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Konventa është e hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe shtetet joanëtare që kanë marrë pjesë në hartimin e saj. Ajo duhet të ratifikohet, pranohet ose miratohet. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit depozitohen tek Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

2. Kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës në të cilën tre shtete anëtare të Këshillit të Europës kanë shprehur pëlqimin e tyre për t'iu nënshkruar Konventësnë në pajtim me dispozitat e paragrafit 1.

3. Për shtetet nënshkruese që e shprehin pëlqimin e tyre për t'iu nënshtruar Konventës pas këtij afati, Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

Neni 19
Anëtarësimi nga shtetet joanëtare

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës, pasi të konsultohet me shtetet kontraktuese, mund të ftojë çdo shtet që nuk është anëtar i Këshillit dhe që nuk përmendet në nenin 18.1 të anëtarësohet në Konventë, me anë të një vendimi të marrë nga shumica e parashikuar nga neni 20.d të Statutit të Këshillit të Europës dhe me votim unanim të përfaqësuesve të shteteve kontraktuese që kanë të drejtë të marrin pjesë në Komitet.

2. Për çdo shtet që anëtarësohet, Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati prej tre muajsh pas datës së depozitimit të instrumentit të anëtarësimit te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 20
Zbatimi territorial

1. Secili shtet mund të përcaktojë territorin në të cilin zbatohet kjo Konventë në kohën e depozitimit, mirtimit ose anëtarësimit.

2. Me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës në në kohë të mëvonshme, secili shtet mund të zgjerojë zbatimin e kësaj Konvente në çdo territor tjetër të përcaktuar në deklaratë. Në lidhje me këtë territor, Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati prej tre muajsh pas datës së marrjes së një deklarate të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë në përputhje me dy paragrafët e mësipërm për territorin e specifikuar në të, mund të tërhiqet me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Tërheqja hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati prej tre muajsh pas datës së marrjes së një njoftimi të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 21
Zbatimi kohor

Kjo Konventë është e zbatueshme për ekzekutimin e dënimeve të dhëna para ose pas hyrjes së saj në fuqi.

Neni 22
Marrëdhëniet me Konventat dhe Marrëveshjet e tjera

1. Kjo Konventë nuk prek të drejtat dhe detyrimet si rezultat i marrëveshjeve për ekstradimin dhe marrëveshjet e tjera mbi bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet penale që parashikojnë transferimin e personave të ndaluar për qëllime ballafaqimi ose deponimi.

2. Nëse dy ose më shumë palë kanë përfunduar një marrëveshje ose traktat për tansferimin e personave të dënuar, apo kanë vendosur në ndonjë mënyrë tjetër marrëdhëniet e tyre për këtë çështje, apo kur kanë ndërmend ta bëjnë këtë në të ardhmen, ata kanë të drejtë të zbatojnë atë marrëveshje ose traktat në vend të kësaj Konvente.

3. Kjo Konventë nuk prek të drejtat e shteteve palë në Konventën Europiane mbi vlefshmërinë ndërkombëtare të vendimeve penale, për të përfunduar marrëveshje bilaterale dhe multilaterale me njëri-tjetrin për çështjet që trajtohen në Konventë, për të plotësuar dispozitat e saj ose për të lehtësuar zbatimin e parimeve të shprehura në të.

4. Nëse një kërkesë për transferim futet në kuadrin e kësaj Konvente dhe të Koventës Europiane mbi Vlefshmërinë Ndërkombëtare të Vendimeve Penale apo të ndonjë marrëveshjeje ose traktati tjetër për transferimin e personave të dënuar, shteti që bën kërkesën kur e bën atë, tregon se mbi bazën e cilit instrument ai e ka bërë.

Neni 23
Zgjidhje miqësore

Komiteti Europian për Problemet e Krimit të Këshillit të Europës mbahet i informuar në lidhje me zbatimin e kësaj Konvente dhe bën çfarëdo që të jetë e nevojshme për të lehtësuar një zgjidhje miqësore për çdo vështirësi që mund të lindë nga zbatimi i saj.

Neni 24
Shfuqizimi

1. Secila palë mund të shfuqizojë këtë Konventë në çdo kohë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Një shfuqizim i tillë hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati prej tre muajsh pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Siqoqoftë, kjo Konventë vazhdon të zbatohet për ekzekutimin e dënimeve të personave që janë transferuar në përputhje me dispozitat e Konventës para datës në të cilën ka hyrë në fuqi shfuqizimi.

Neni 25
Njoftimet

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës njofton shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe shtetet joanëtare që kanë qenë pjesëmarrëse në hartimin e kësaj Konvente dhe çdo shtet që është anëtarësuar në këtë Konventë për:

a.çdo nënshkrim;

b. depozitimin e çdo insturmenti të ratifikimit, pranimit, miratimit dhe anëtarësimit;

c. çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në përputhje me nenet 18.2 dhe 3, 19.2 dhe 20.2 dhe 3;

d. çdo akt tjetër, deklaratë, njoftim ose komunikim që ka të bëjë me Konventën.

LIGJ
Nr.8512, datë 15.7.1999

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERIVE TË VENDEVE PJESËMARRËSE NË BASHKËPUNIMIN EKONOMIK TË DETIT TË ZI, PËR BASHKËPUNIMIN NË LUFTËN KUNDËR KRIMIT, NË MËNYRË TË VEÇANTË, FORMAT E TIJ TË ORGANIZUARA"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet qeverive të vendeve pjesëmarrëse në bashkëpunimin ekonomik të Detit të Zi, për bashkëpunimin në luftën kundër krimit, në mënyrë të veçantë, format e tij të organizuara".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2426, datë 22.7.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.23, faqe 809

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERIVE TË VENDEVE PJESËMARRËSE NË BASHKËPUNIMIN EKONOMIK TË DETIT TË ZI PËR BASHKËPUNIMIN NË LUFTËN KUNDËR KRIMIT, NË VEÇANTI NË FORMA TË TIJ TË ORGANIZUARA

Qeveritë e vendeve pjesëmarrëse të Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi (BSEC) : Republika e Shqipërisë, Republika e Armenisë, Republika e Azerbajxhanit, Republika e Bullgarisë, Gjeorgjia, Republika Helenike,Republika e Moldavisë, Rumania, Federata Ruse, Republika e Turqisë, Ukraina, të cilat më pas do të quhen "Palë".

Duke njohur faktin se krimi kombëtar dhe ndërkombëtar, në të gjithë format e tij, përbën një rrezik serioz për shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e qenieve njerëzore dhe në të njëjtën kohë ndikon mbi themelet ekonomike, kulturore dhe politike të shoqërisë.

Duke qënë thellësisht të shqetësuar rreth shkallës dhe rrugëve të zhvillimit të krimit, në përgjithësi,

Duke vërejtur se ka raste të rritjes së lidhjeve midis trafikut ilegal të narkotikëve dhe substancave psikotrope, terrorizmit dhe krimit të organizuar,

Duke marrë në konsideratë dispozitat e dokumenteve të Kombeve të Bashkuara në sferën e parandalimit dhe kontrollit të krimit, trafikut ilegal të narkotikëve dhe substancave psikotrope,

armëve dhe materialeve radioaktive, të gjitha akteve të terrorizmit, si dhe aktiviteteve kriminale që kanë lidhje me migracionin.

Duke marrë në konsideratë dispozitat e Deklaratës së Bukureshtit e Mbledhjes së nivelit të lartë të Vendeve pjesëmarrës të BSEC më 30 Qershor 1955, Rekomandimet e Asamblesë Parlamentare të BSEC (PABSEC) 15/1996 të 12 Qershorit 1996 mbi kooperimin midis Vendeve Anëtare të PABSEC mbi luftën kundër krimit të organizuar, Deklaratën e Përbashkët të Mbledhjes së Parë të Ministrave të Brendshëm të Vendeve Pjesëmarrës në BSEC, më 17 Tetor 1996 në Jerevan, e cila u aprovua nga Kryetarët e Shteteve dhe të Qeverive të Vendeve Pjesmarrës në BSEC, më 25 Tetor 1996 më Moskë, si dhe Deklaratën e Përbashkët të takimit të Dytë të Ministrave të Brendshëm në Stamboll, më 22 Tetor 1997,

Duke i kushtuar vëmendje të veçantë bashkëpunimit ndërkombëtar në sferën e luftës kundër krimit dhe dëshirën për të koordinuar asistencë të përbashkët në këtë fushë, sa më gjerë dhe në mënyrë të efektshme, brenda kuadrit të përshtatshëm të njohjes së përgjithshme të të drejtave dhe lirive të njeriut,

Duke theksuar nevojën se çdo përpjekje për të luftuar krimin duhet të marrë në konsideratë aktivitetet e të njëjtës natyrë që zhvillohen në nivel global dhe rajonal,

Duke proceduar mbi bazën e principeve të barazisë dhe përfitimit të përbashkët,

Duke respektuar marrëveshjet ndërkombëtare dhe legjislacionet kombëtare që ekzistojnë në Vendet Pjesëmarrëse në BSEC, si dhe pa paragjykuar detyrimet e mëparshme të bazuara në marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale me vende të treta,

Ranë dakord si më poshtë :

Neni 1

Fushat e Bashkëpunimit

1.Palët do të bashkëpunojnë për parandalimin, shtypjen, zbulimin, mbylljen dhe investigimin e krimeve dhe në veçanti të:

- akteve të terrorizmit;
- krimit të organizuar;
- kultivimit të paligjshëm, prodhimit, përpunimit dhe trafikut të narkotikëve dhe substancave psikotrope;
- përpunimit ilegal, tregtimit ilegal dhe përdorimit të prekursorëve dhe lëndëve bazë për prodhimin ilegal të narkotikëve dhe substancave psikotrope;
- trafikut të paligjshëm të armëve, duke përfshirë armët biologjike, kimike dhe radioaktive, municionet,eksplozivet, materialet nukleare dhe radioaktive, si dhe substancat helmuese;
- aktiviteteve ndërkombëtare ilegale ekonomike dhe legalizimit të aktiviteteve (pastrimi i parasë) që rrjedhin nga aktivitetet kriminale, transaksione të dyshimta ekonomike dhe transaksione bankare dhe abuzime në fushën e investimeve;
- kontrabandës;
- aktiviteteve kriminale të lidhura me migracionin, kalimin ilegal të kufirit dhe trafikun ilegal të qenieve njerëzore;
- shfrytëzimit seksual të grave dhe të miturve apo fëmijëve;
- fallsifikimit të kartmonedhave, kartave të kreditit, dokumentave, sigurimeve dhe vlerave të tjera, si dhe çdo lloj dokumenti identiteti;
- krimet e dhunshme kundër jetës dhe pronës së njerëzve;
- trafikut ilegal të objekteve të trashëgimisë historike dhe kulturore, veprave të artit,gurëve dhe materialeve të çmuara, pronësisë intelektuale si dhe të çdo lloj materiali tjetër të vlefshëm;
- korrupsionit
- krimit ekologjik;
- krimit teknologjik, duke përfshirë krimin kompjuterik
- marrjes peng dhe tregtimit të njerëzve dhe organeve
- krimeve detare (grabitje detare, pirateri etj.);

- vjedhjeve dhe trafikut ilegal të automjeteve.

2. Palët gjithashtu do të bashkëpunojnë në fushat e mëposhtëme:

- edukimit, trainimit dhe rritjes së aftësive të personelit;
- bashkëpunimit në fushat e kulturës,sportit dhe sociale nëpërmjet shkëmbimit të delegacioneve;
- zhvillimit të kërkimeve shkencore me qëllim luftën kundër krimit dhe zhvillimin e sistemeve të informacionit, mjeteve të komunikimit dhe pajimeve speciale;
- bashkëpunimit në fusha të tjera me interes të përbashkët, me qëllim kontrollin e kriminalitetit në përgjithësi dhe parandalimin e krimit, si p.sh. zbulimin e personave të humbur, objekteve të humbura apo të vjedhura dhe identifikimi i kufomave.

Neni 2

Format e Bashkëpunimit

1. Bashkëpunimi midis Palëve mund të arrihet në veçanti nëpërmjet:

- shkëmbimit të informacionit dhe eksperiencës në fusha me interes të përbashkët;
- shkëmbimit të informacionit për parandalimin dhe shtypjen e çdo forme të krimit transkombëtar, në veçanti të gjitha aktet e terrorizmit, krimi të organizuar, trafikut ilegal të narkotikëve dhe substancave psikotrope, armëve dhe materialeve radioaktive,aktiviteteve kriminale që lidhen me migracionin, duke përfshirë informaconin në lidhje me rrjete individuale dhe kriminale të përfshira në krimin transkombëtar;
- planifikimin dhe adoptimin e aksioneve të koordinuara kundër rrjeteve kriminale;
- kërkimin e individëve të larguar nga hetimi i krimeve apo vuajtja e dënimit, si dhe ata që janë raportuar të humbur;
- shkëmbimin e informacionit në lidhje me figurat e reja të krimit, metodat dhe format e parandalimit, shtypjes dhe hetimit të tij;
- asistencë në hetimin e transfertave të dyshimta bankare dhe financiare, duke përfshirë ato që kanë lidhje me legalizimin e aktiviteteve kriminale;
- shkëmbimin e eksperiencës mbi përdorimin e metodave shkencore dhe teknologjike dhe mjetet për kërkimet shkencore dhe kriminalogjike, veçanërisht në fushën e hetimit dhe kontrollit të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve në përputhje me ligjet ndërkombëtare;
- shkëmbimin e informacionit në lidhje me metodat e përdorura për transportimin, fshehjen dhe shpërndarjen e drogave narkotike dhe substancave psikotrope;
- marrjen e masave të domosdoshme ligjore, administrative dhe të sigurisë në kufijtë e tyre në mënyrë që të parandalohet kontrabanda, veçanërisht të drogave narkotike dhe substancave psikotrope;
- shkëmbimin e informacionit mbi tipet e reja të drogave dhe substancave psikotrope që shfaqen gjatë trafikimit të paligjshëm, teknologjive të përpunimit hde substancave të përdorura për këto, po ashtu si dhe metodave të reja të kërkimeve të përdorura, në analizat për identifikimin e drogave narkotike dhe substancave psikotrope;
- shkëmbimin e informacionit mbi lidhjet e trafikut të paligjshëm të drogës dhe substancave psikotrope me terrorizmin dhe krimin e organizuar;
- shkëmbimin e informacionit, njohurive dhe eksperiencës në fushën e kontrollit të kufirit dhe mbështetjes materiale dhe teknike të shërbimeve kompetente për hetimin e dokumentave të fallsifikuara të udhëtimit si dhe për parandalimin e hyrjes së paligjshme të personave të dyshuar të përfshirë në akte kriminale e veçanërisht terroriste si dhe aktivitete të lidhura me migracionin;
- shkëmbimin e eksperiencës së punës, përfshirë këtu kurse, konsultime, seminare dhe kurse trainimi;
- shkëmbimin e të dhënave statistikore si dhe ligjeve dhe dispozitave kombëtare, broshurave, botimeve dhe rezultateve të kërkimeve shkencore në fushat e mbuluara nga kjo Marrëveshje;

- organizimin e mbledhjeve të ekspertëve brenda kompetencave të tyre, kurdoherë që të gjykohet nga vetë ata të jetë e domosdoshme për t'u marrë me çështje që mendohet se janë të interesit të tyre të përbashkët;

- kërkimin dhe kthimin, në përputhje me legjislacionin e brendshëm, të objekteve të vjedhura duke poseduar numra ose shenja të tyre, përfshirë këtu edhe ato me vlera kulturore dhe historike, automjeteve dhe armëve të zjarrit, si dhe dokumentave të identifikimit dhe pasaportave;

- shkëmbimin e informacionit në lidhje me qytetarët e Shteteve dhe të Palëve të tjera të dënuar për krime të kryera në territoret e Shteteve të tyre, si dhe individëve nën hetim;

Neni 3
Shpërndarjet e Kontrolluara

1. Palët do të sigurojnë sipas ligjeve të tyre të brendshme, si dhe detyrimeve ndërkombëtare, kushtet e domosdoshme për zbatimin e shpërndarjes së kontrolluar të drogave narkotike dhe substancave psikotrope si dhe prekursorëve të përdorur për prodhimin e tyre;

2. Palët do të marrin parasysh mundësinë e përdorimit të metodave të shpërndarjes së kontrolluar ndaj objekteve të tjera të përfshira në trafik të paligjshëm;

3. Palët do të angazhohen të përshtasin legjislacionin dhe praktikat, në mënyrë që të jenë bashkarisht kompatibël në nivelin e duhur, për të iniciuar dhe zhvilluar në mënyrë eficente shpërndarjen e kontrolluar.

Neni 4
Mjetet e Bashkëpunimit

1. Palët do të bashkëpunojnë në luftën kundër krimit nëpërmjet autoriteteve të tyre kompetente, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshje, subjekte të legjslacionit dhe detyrimeve ndërkombëtare të shteteve të tyre.

2. Palët do të përcaktojnë autoritetet e tyre kompetente dhe/ose pikat e kontaktit, nëpërmjet të cilëve do të sigurohet komunikimi direkt dhe nëse do të jetë e nevojshme do të shkëmbejnë oficerë ndërlidhës.

3. Secila palë do të depozitojnë në Arkiv një listë të autoriteteve kompetente dhe/ose pikave të kontaktit brenda një periudhe dy mujore nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje. Palët do të informojnë Arkivin për çdo ndryshim në listat e tyre të autoriteteve kompetente dhe ose pikave të kontaktit.

Neni 5
Kërkesa për Bashkëpunim

1. Bashkëpunimi, brenda kuadrit të kësaj Marrëveshje, do të bëhet mbi bazat e kërkesave për bashkëpunim të parashtruara nga autoritetet kompetente të Palëve të interesuara.

2. Kërkesat për bashkëpunim do të parashtrohen me shkrim. Në raste emergjence, kërkesat mund të parashtrohen verbalisht, por një konfirmim i shkruar duhet të paraqitet brenda një afati tre ditor duke përdorur inter alia, mjetet teknike të komunikimit.

3. Çdo palë mundet në mënyrë të plotë ose të pjesshme të mos pranojë një kërkesë për bashkëpunim, nëse realizimi i kësaj kërkese për bashkëpunim rrezikon sovranitetin, sigurinë, rendin publik ose interesa të tjera madhore të shteteve të tyre, ose kur bie ndesh me legjislacionin dhe detyrimet ndërkombëtare të shteteve të tyre. Mospranimi i kërkesës për bashkëpunim i dërgohet palës që e kërkon pa vonesë.

4. Autoritetet kompetente të Palëve duhet të marrin masa të përshtatshme për të siguruar realizimin e plotë dhe të shpejtë të kërkesës për bashkëpunim.

Neni 6
Grupi i Punës

Palët do të krijojnë një Grup Pune në mënyrë që të shqyrtojnë rrugët e realizimit dhe çuarjes përpara të bashkëpunimit mbi bazën e kësaj Marrëveshje dhe inter alia të paraqesin rekomandime, duke iu referuar nevojës, për protokolle shtesë së kësaj Marrëveshje ose marrëveshjeve të rejas ndërkombëtare, si dhe nevojës për të krijuar institucione të bashkëpunimit në sferën e luftës kundër krimit.

Neni 7
Gjuhët

Në mënyrë që të realizohet bashkëpunimi në kuadrin e kësaj Marrëveshje, autoritetet kompetente të Palëve do të përdorin gjuhën Angleze gjatë procedurave të shkruara, gjuhët angleze dhe ruse në procedurat gojore, edhe pse palët në mënyrë të përbashkët kanë rënë dakord ndryshe.

Neni 8
Shpenzimet

Çdo palë në mënyrë të pavarur do të mbulojë shpenzimet që rrjedhin nga zbatimi i kësaj Marrëveshje, edhe nëse është rënë dakord ndryshe në çdo rast të veçantë

Neni 9
Zbatimi i kësaj Marrëveshje

1. Zbatimi i kësaj Marrëveshje është subjekt i legjislacionit të çdo Shteti Pjesëmarrës.

2. Kjo Marrëveshje nuk do të ndikojë mbi plotësimin e detyrimeve të tjera ndërkombëtare të Palëve.

3. Informacioni dhe dokumentet e përfituara në përputhje me këtë Marrëveshje duhet të jetë konfidencial kur kjo kërkohet dhe përdoren në plotësimin e qëllimeve që do të përcaktohen nga pala dhënëse. Dokumentet dhe informacioni i marrë sipas kësaj Marrëveshje nuk do t'i transmetohet një pale të tretë pa autorizimin paraprak të Palës dhënëse.

4. Çështje të diskutueshme, të cilat mund të lindin në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshje do të zgjidhen nga palët e interesuara, nëpërmjet konsultimeve, sipas ligjeve të ndryshme të ligjit ndërkombëtar.

Neni 10
Dispozitat e Fundit

1. Sekretariati Ndërkombëtar i Përhershëm (PERMIS) do të jetë Arkivi i kësaj Marrëveshje. Origjinali i kësaj Marrëveshje, në një kopje të vetme në gjuhën angleze, do të depozitohet në PERMIS, i cili do t'i dorëzojë një kopje të çertifikatës secilës Palë.

2. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e tridhjetë pas datës në të cilën dokumenti i tretë i ratifikimit ose aprovimit është depozituar në PERMIS.

3. Për secilën Palë që do të ratifikojë ose aprovojë këtë Marrëveshje, pas depozitimit të dokumentit të tretë të ratifikimit ose aprovimit, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit të dokumentit të ratifikimit ose aprovimit nga kjo Palë.

4. Çdo Palë mund të tërhiqet nga kjo Marrëveshje nëpërmjet një njoftimi formal drejtuar PERMIS. Tërheqja do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës, në të cilën njoftimi për tërheqje është marrë prej PERMIS.

5. Çdo Palë mund të propozojë një amendament të kësaj Marrëveshjeje. Amendamente të tilla do të pranohen me konsensusin e të gjitha Palëve dhe do të hyjnë në fuqi në përputhje me paragrafin 2 dhe 3 të këtij neni.

Në prani të të nënshkruarit, duke pasur autorizimet përkatëse, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

LIGJ
Nr.9500, datë 3.4.2006

PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT SHTESË, PËR LUFTËN KUNDËR TERRORIZMIT, TË MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERIVE TË SHTETEVE PJESËMARRËSE TË BASHKËPUNIMIT EKONOMIK TË DETIT TË ZI PËR BASHKËPUNIMIN NË LUFTËN KUNDËR KRIMIT, VEÇANËRISHT NË FORMAT E ORGANIZUARA TË TIJ

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet Protokolli shtesë, për luftën kundër terrorizmit, të Marrëveshjes ndërmjet qeverive të shteteve pjesëmarrëse të Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi për bashkëpunimin në luftën kundër krimit, veçanërisht në format e organizuara të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4834, datë 25.4.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.38, faqe 1175

PROTOKOLL SHTESË
PËR LUFTËN KUNDËR TERRORIZMIT I MARRËVESHJES MIDIS QEVERIVE TË SHTETEVE PJESËMARRËSE TË BASHKËPUNIMIT EKONOMIK TË DETIT TË ZI MBI BASHKËPUNIMIN NË LUFTËN KUNDËR KRIMIT, VEÇANËRISHT TË ORGANIZUAR TË TIJ

Hyrje

Qeveritë e shteteve anëtare të Organizatës së Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi(BEDZ): Republikës së Shqipërisë, Republikës së Armenisë, Republikës së Azerbajxhanit, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Greqisë, Republikës së Moldavisë, Republikës së Rumanisë, Federatës Ruse, Serbisë dhe Malit të Zi, Republikës së Turqisë, Gjeorgjisë, Ukrainës, të quajtura më poshtë si " Palë Kontraktuese",

duke qenë Palë Kontraktuese në Marrëveshjen midis qeverive të shteteve pjesëmarrëse të bashkëpunimit ekonomik të Detit të Zi mbi bashkëpunimin në luftën kundër krimit , në mënyrë të veçantë në format e organizuara të tij, firmosur në Korfuz më 2 tetor 1998, të quajtur shkurtimisht "Marrëveshja e BEDZ-it";

duke ndjekur dispozitat e kartës së BEDZ-it, Deklaratën e Samitit Dhjetëvjeçar të Stambollit, Deklaratën e takimit të pestë të Këshillit të Ministrave të Punëve të Jashtme të shteteve anëtare të BEDZ-it bërë më datë 26 tetor 2001, si dhe Deklaratën e Këshillit të Ministrave të Punëve të Jashtme të shteteve anëtare të BEDZ-it mbi kontributin e BEDZ-it për sigurinë dhe stabilitetin, bërë më datë 25 qershor 2004, të cilët dënojnë ashpër terrorizmin ndërkombëtar si një kërcënim global për paqen dhe sigurinë;

të vetëdijshme se terrorizmi në të gjitha format dhe manifestimet e tij është një kërcënim serioz për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare, stabilitetin politik, ekonomik dhe social të Palëve, për integritetin dhe sigurinë territoriale të shteteve anëtare të BEDZ-it, si dhe për zhvillimin e marrëdhënieve miqësore dhe të fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunimit dypalësh dhe shumëpalësh ndërmjet shteteve të rajonit të Detit të Zi;

duke marrë në konsideratë dispozitat e dokumenteve të Kombeve të Bashkuara mbi luftën kundër terrorizmit dhe mbështetjen e plotë për rezolutat e Këshillit të Sigurimit në këtë fushë, në mënyrë të veçantë rezolutës 1373;

duke nënvizuar se lufta kundër terrorizmit duhet të kryhet në respektim të plotë të ligjit dhe të drejtave të njeriut;

duke konfirmuar mbështetjen e tyre të qartë për parimet universale të së drejtës ndërkombëtare,

kanë rënë dakord për sa më poshtë:

Neni 1

Për qëllime të këtij protokolli shtesë terrorizëm nënkupton ato krime që përcaktohen si të tilla në konventat dhe protokollet e Kombeve të Bashkuara mbi luftën kundër terrorizmit.

Neni 2

Palët do të bashkëpunojnë për parandalimin, zbulimin, goditjen, demaskimin dhe hetimin e akteve të terrorizmit në bazë të Marrëveshjes së BEDZ-it dhe këtij protokolli shtesë, në përputhje me legjislacionin e brendshëm, si dhe me angazhimet ndërkombëtare të tyre.

Neni 3

1. Palët do të përcaktojnë autoritetin/autoritetet e tyre kompetente dhe/ose pikën/pikat e kontaktit nëpërmjet të cilave mundësohet komunikimi i drejtpërdrejtë.

2. Çdo Palë do t'i paraqesë Depozitarit një listë me emrat dhe koordinatat e autoritetit/autoriteteve kompetente të saj dhe pikës/pikave të kontaktit brenda një periudhe dymujore mbas hyrjes në fuqi të këtij protokolli shtesë për atë Palë. Palët do të informojnë Depozitarin për çdo ndryshim në këtë listë.

Neni 4

1. Në mënyrë që të zbatojnë këtë protokoll shtesë, Palët do të ndërveprojnë në përputhje me nenin 5 të Marrëveshjes së BEDZ-it (marrëveshjes për krijimin e BEDZ-it) dhe të protokollit shtesë të Marrëveshjes së BEDZ-it, bërë në Kiev, më 15 mars 2002.

2. Nëse është e nevojshme, Palët mund të krijojnë linja komunikimi urgjente, të kryejnë takime dhe konsultime të rregullta ose të jashtëzakonshme.

Neni 5

Brenda kuadrit të Marrëveshjes së BEDZ-it dhe këtij protokolli shtesë, Palët do të shkëmbejnë informacion të interesit të ndërsjellë, në mënyrë të veçantë për:

a) aktet e terrorizmit të planifikuara dhe të drejtuara kundër udhëheqësit të shtetit, personave që gëzojnë mbrojtje ndërkombëtare, anëtarëve të misioneve dhe konsullatave diplomatike, zyrtarëve të organizatave ndërkombëtare ndërqeveritare, pjesëmarrësve në vizita shtetërore, si dhe në ngjarje kombëtare/ndërkombëtare dhe kundër zyrtarëve dhe civilëve;

b) organizatat terroriste, grupet ose personat terroristë që paraqesin kërcënim për sigurinë e shteteve të tyre, si dhe kontaktet ndërmjet këtyre organizatave terroriste, grupeve apo personave terroristë;

c) tentativat dhe aksionet terroriste të drejtuara kundër sovranitetit dhe integritetit territorial të shteteve të Palëve;

d) aktet e terrorizmit dhe kërcënimet për kryerjen e akteve të tilla në territorin e shteteve të Palëve, kundër qendrave ekonomike, teknologjike dhe ekologjike dhe sistemeve të rëndësisë jetike;

e) organizatat dhe grupet terroriste që veprojnë në territorin e shteteve të Palëve, taktikat dhe metodat e tyre, udhëheqësit, anëtarët, si dhe personat e përfshirë në dhe/ose mbështetjen e aktiviteteve të këtyre grupeve ose organizatave;

f) organizatat dhe institucionet që mbështesin terrorizmin, për mekanizmat, përhapjen dhe drejtimin e kësaj mbështetje;

g) trafikimin e paligjshëm të armëve, përfshirë municioneve, lëndëve eksplozive dhe kurtheve me eksploziva, materialeve dhe burimeve bërthamore dhe radioaktive, armëve kimike dhe biologjike dhe komponentëve të tyre, të kryer nga personat dhe grupimet e organizuara kriminale, kanalet e përdorura për transportimin e paligjshëm të tyre nëpër territorin e shteteve të Palëve;

h) burimet e zbuluara dhe të dyshuara dhe kanalet e mbështetjes financiare logjistike ose llojeve të tjera të mbështetjes materiale për organizatat dhe grupet terroriste;

i) praktikën dhe legjislacionin mbi kundër-terrorizmin.

Neni 6

Palët do të punojnë dhe do të kryejnë bashkëpunim të ngushtë, në mënyrë të veçantë për:

a) shtypjen e përgatitjes dhe kryerjes së akteve të terrorizmit, si dhe të dhënies për terroristët së ndonjë forme të mbështetjes, përfshirë mbështetjen financiare;

b) refuzimin e strehës së sigurisë për ata që financojnë, planifikojnë, mbështesin ose kryejnë akte terroriste;

c) zbulimin dhe shkatërrimin e vendeve ku kryhet stërvitja e terroristëve, planifikimi dhe përgatitja e akteve të terrorizmit, nëse paraqiten evidenca konkrete;

d) parandalimin e lëvizjes dhe shkatërrimin e segmenteve të udhëtimit të terroristëve dhe grupeve terroriste;

e) zbulimin dhe identifikimin e strukturave të përdorura nga grupet ose organizatat terroriste për fshehjen e aktiviteteve të tyre;

f) parandalimin, zbulimin dhe goditjen e mbështetjes financiare, shpërndarjes së armëve dhe municioneve, substancave eksplozive, kurtheve me eksploziva, materialeve dhe burimeve bërthamore dhe radioaktive, armëve kimike dhe biologjike dhe komponentëve të tyre, si edhe dhënien e çdo asistence për personat apo organizatat për planifikimin, përgatitjen dhe kryerjen e akteve të terrorizmit.

Palët do të njoftojnë njëra- tjetrën për rezultatet e aksioneve bashkëpunuese.

Neni 7

Palët do të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar përgatitjen e akteve të terrorizmit në territorin e shteteve të tyre, kur këto akte të terrorizmit do të kryhen në territorin e

shteteve të palëve të tjera, si edhe për të refuzuar azilin për personat të cilët kanë planifikuar, lehtësuar ose marrë pjesë në përgatitjen e akteve të terrorizmit.

Neni 8

Palët mund të bashkëpunojnë për të arritur zbatimin e këtij protokolli shtesë në format e mëposhtme:

a) arsimimin, trajnimin dhe rritjen e aftësive profesionale të personelit;

b) shkëmbimin e informacionit dhe eksperiencave në lidhje me përdorimin e metodave shkencore dhe teknologjike për kërkimet shkencore në lidhje me krimet;

c) kryerjen e trajnimeve, seminareve, konsultimeve dhe kërkimeve shkencore të përbashkëta;

d) shkëmbimin e legjislacioneve të brendshme përkatëse, të dhënave statistikore dhe analitike;

e) dhe forma të tjera të parashikuara në Marrëveshjen e BEDZ-it.

Neni 9

Informacionit dhe dokumenteve të përftuara në kuadrin e këtij protokolli shtesë do t'u jepet e njëjta shkallë konfidencialiteti nga Pala e Kërkuar që u garantohet informacioneve të tjera të ngjashme të Palës Kërkuese:

1. Informacioni dhe dokumentet e përftuara në kuadrin e këtij protokolli shtesë, si dhe informacioni mbi metodat e hetimit dhe taktikat e përdorimit të pajisjeve dhe/ose materialeve të posaçme nuk do t'u transmetohet palëve të treta pa autorizimin paraprak me shkrim bërë nga Pala Dërguese.

2. Informacioni ose rezultatet për pajtimin me kërkesën e marrë nga Pala tjetër në bazë të këtij protokolli shtesë nuk mund të përdoren për qëllime të tjera nga ato për të cilat janë kërkuar ose janë paraqitur pa autorizimin paraprak me shkrim të bërë nga Pala Dërguese.

3. Shpërndarja dhe mbrojtja e informacionit të klasifikuar do të kryhet nga Palët, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar dhe/ose marrëveshjet përkatëse ndërkombëtare.

4. Pa cenuar angazhimet ndërkombëtare në këtë fushë të shteteve anëtare, Palët në Marrëveshjen e BEDZ-it dhe në këtë protokoll shtesë, të dhënat personale të marra në kuadrin e këtij protokolli shtesë do të gëzojnë të paktën të njëjtën mbrojtje që i jep Pala Dërguese.

Neni 10

Secila Palë do të përballojë në mënyrë të pavarur shpenzimet që lindin gjatë zbatimit të këtij protokolli shtesë, me përjashtim kur vendoset ndryshe në mënyrë të ndërsjellë për raste të veçanta.

Neni 11

Me qëllim sigurimin e bashkëpunimit në kuadrin e këtij protokolli shtesë, Palët do të përdorin gjuhën angleze gjatë procedurës shkresore, gjuhën angleze dhe ruse në procedurën gojore, me përjashtim kur Palët kanë rënë dakord ndryshe në mënyrë të ndërsjellë.

Neni 12

1. Zbatimi i këtij protokolli shtesë është subjekt i legjislacionit të shtetit të secilës Palë.

2. Ky protokoll shtesë nuk do të pengojë detyrimet e tjera ndërkombëtare të shteteve palë.

3. Çështjet e diskutueshme të cilat mund të lindin në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtij protokolli shtesë do të zgjidhen nga palët e interesuara nëpërmjet konsultimeve dhe negociatave, në përputhje me rregullat përkatëse të së drejtës ndërkombëtare.

Neni 13

1. Sekretariati i Përhershëm Ndërkombëtar (SPN) i BEDZ-it do të jetë Depozitari i këtij protokolli shtesë.

2. Origjinali i këtij protokolli shtesë në një kopje të vetme në gjuhën angleze do të depozitohet pranë Sekretariatit të Përhershëm Ndërkombëtar të BEDZ-it, i cili do t'i transmetojë kopje të certifikuara secilës Palë.

3. SPN i BEDZ-it do të informojë shtetet anëtare të BEDZ-it për:

a) çdo akt firmosje;

b) çdo paraqitje instrumenti ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi;

c) çdo datë hyrjeje në fuqi të këtij protokolli shtesë;

d) çdo akt ose dokument tjetër njoftimi që lidhet me këtë protokoll shtesë.

Neni 14

1. Ky protokoll shtesë do të jetë i hapur për firmosje nga çdo shtet anëtar i BEDZ-it.

2. Pala e cila ka firmosur këtë protokoll shtesë nuk mund të bëhet palë në të nëse nuk bëhet më parë palë në Marrëveshjen e BEDZ-it.

3. Ky protokoll shtesë është subjekt ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi.

4. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit ose hyrjes në fuqi do të depozitohen te Depozitari.

Neni 15

1. Ky protokoll shtesë do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës në të cilën instrumenti i tretë i ratifikimit, pranimit, miratimit ose i aderimit depozitohet te sekretari i përhershëm i BEDZ-it.

2. Për secilën Palë, e cila ratifikon, pranon, miraton ose aderon në këtë protokoll shtesë pas hyrjes në fuqi të tij, ky protokoll shtesë do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit nga ajo Palë të instrumenteve përkatëse.

Neni 16

1. Secila Palë mund të propozojë amendamente të këtij protokolli shtesë.

2. Këto amendamente do të pranohen mbi bazën e miratimit prej të gjitha palëve dhe do të hyjë në fuqi në përputhje me paragrafët 3 dhe 4 të nenit 14 dhe me nenin 15 të këtij protokolli shtesë.

Neni 17

Çdo Palë mund të tërhiqet ose ta denoncojë këtë protokoll shtesë nëpërmjet njoftimit zyrtar dërguar Sekretariatit të Përhershëm Ndërkombëtar të BEDZ-it. Tërheqja ose denoncimi do të hyjë në fuqi brenda tre muajve pas datës në të cilën njoftimi për tërheqjen ose denoncimin merret nga Sekretari i Përhershëm Ndërkombëtar i BEDZ-it.

Dëshmitarë të sa më lart, nënshkruesit, të autorizuar ligjërisht për këtë qëllim, kanë nënshkruar këtë protokoll shtesë.

Bërë në Athinë, Greqi, më 3.12. 2004, në dy kopje të vetme në gjuhën angleze.

(Firmat përkatëse të përfaqësuesve të shteteve anëtare të BEDZ-it, Republikës së Shqipërisë, Republikës së Armenisë, Republikës së Azerbajxhanit, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Greqisë, Republikës së Moldavisë, Republikës së Rumanisë, Serbisë dhe Malit të Zi, Republikës së Turqisë, Federatës Ruse, Gjeorgjisë dhe Ukrainës, pasojnë).

LIGJ
Nr.8541, datë 21.10.1999

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË SECI-T MBI BASHKËPUNIMIN PËR PARANDALIMIN DHE LUFTËN KUNDËR KRIMIT NDËRKUFITAR"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve e marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e SECI-t mbi bashkëpunimin për parandalimin dhe luftën kundër krimit ndërkufitar".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2471, datë 28.10.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.31, faqe 1175

MARRËVESHJE
E SECI-T MBI BASHKËPUNIMIN PËR PARANDALIMIN DHE LUFTËN KUNDËR KRIMIT NDËRKUFITAR

Qeveritë që nënshkruajnë këtë dokument, në vazhdim të referuara si "Palët",

Duke dëshiruar të zmadhojnë dhe të rrisin gamën e bashkëpunimit të tyre brenda kontureve të Iniciativës së Bashkëpunimit të Europës Juglindore;

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e lidhjeve tregtare mes Palëve dhe me vende të tjera dhe duke dëshiruar të kontribuojnë në zhvillimin harmonik të këtyre lidhjeve;

Duke pranuar interesin e tyre të ndërsjelltë për të luftuar krimin ndërkufitar dhe zhvilluar një bashkëpunim më të ngushtë rajonal ndërmjet agjencive të tyre imponuese të ligjit;

Të bindur se krimi i kryer përgjatë kufijve të Palëve përbën një kërcënim serioz për sovranitetin dhe tregtinë e ligjshme dhe se ai mund të luftohet me efektivitet nga bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve imponuese të ligjit;

Duke besuar se, për të arritur këta objektiva nevojitet një ndërmarrje për të zhvilluar, në masën më të madhe të mundshme, bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve imponuese të ligjit;

Duke konsideruar krimin ndërkufitar si dëmprurës për interesat ekonomike, fiskale dhe tregtare të vendeve të tyre përkatëse;

Duke marrë parasysh marrëveshjet ekzistuese, traktatet apo rregulloret për asistencë të ndërsjelltë dhe marrëveshjet e tjera ndërkombëtare për zbatimin e ligjit, ndërkohë të pranuara nga Palët;

Ranë dakord përsa më poshtë vijon:

Neni 1
Përcaktime

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

(a) Termi "autoritete doganore dhe autoritete imponuese ndërkufitare të ligjit" do të thotë autoritete kompetente të përcaktuara nga Palët, ky përcaktim duhet konfirmuar në Sekretariatin e SECI-t dhe mund të ndryshohet me një notifikim në këtë Sekretariat;

(b) termi "krim ndërkufitar" i referohet çdo shkelje ose përpjekje për shkelje të ligjeve kombëtare dhe rregullave, shkelje të cilat synojnë në organizimin, drejtimin, ndihmsën apo lehtësimin e veprimtarisë kriminale ndërkombëtare;

(c) termi "ligje doganore" do të thotë ligjet dhe rregulloret në fuqi nga administrata doganore lidhur me importin, eksportin, tranzitin dhe qarkullimin e mallrave, sipas lidhjes së tyre me detyrimet doganore, tarifat dhe taksat e tjera apo kufizime, ndalime dhe kontrolle të tjera të ngjashme lidhur me lëvizjen e artikujve të kontrolluar nëpër kufijtë kombëtarë;

(d) termi "informacion" do të thotë të dhëna të çdo forme, dokumente, regjistrime dhe raporte apo kopje të certifikuara ose të autentikuara të tyre;

(e) termi "person" do të thotë çdo person fizik apo juridik;

(f) termi "të dhëna personale" do të thotë çdo informacion lidhur me një person fizik të identifikuar apo të identifikueshëm;

(g) termi "pronë" do të thotë pasuri të çdo lloji si dhe dokumente ligjore apo instrumentet që evidentojnë tituj ose interesa në këto pasuri;

(h) termi "masa parandaluese" përfshin:

1. ndalim i përkohshëm i konvertimit, depozitimit, lëvizjes apo transferimit të pasurisë, ose

2. marrje e përkohshme e pasurisë nën ruajtje ose kontroll, mbi bazën e një urdhëri të lëshuar nga gjykata, autoritetet kompetente apo autoritete të tjera,

(i) termi "privim" do të thotë heqje e së drejtës për atë pasuri me anë të një vendimi të gjykatës ose autoritetit kompetent, e cila përfshin edhe konfiskimin në rastet e mundshme;

(j) termi "administratë kërkuese" do të thotë autoriteti i përshkruar në nenin 1 (a) që kërkon asistencë sipas nenit 8 pika 1;

(k) termi "administratë e kërkuar" do të thotë autoriteti i përshkruar në nenin 1 (a), nga i cili kërkohet asistencë sipas nenit 8,pika 1.

Neni 2
Fusha që mbulon Marrëveshja

1. Palët, përmes autoriteteve të tyre të caktuara do të asistojnë njëra-tjetrën, në përputhje me këtë Marrëveshje për parandalimin, gjetjen, investigimin, ndjekjen dhe shtypjen e krimit ndërkufitar.

Kjo Marrëveshje nuk duhet interpretuar si paragjykuese ose ndikuese ndaj aplikimit të Traktatit të Bashkimit Europian, Marrëveshja e Shengenit e 14 qershorit 1985 dhe Konventës për Aplikimin e Marrëveshjes së Shengenit e 19 qershorit 1990, marrëveshjeve ndërkombëtare, Marrëveshjeve për Asistencë Reciproke dhe marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare për zbatimin e ligjit, ndërkohë të pranuara nga Palët, as të ndonjë asistence ligjore, marrëveshjeje, rregulloreje apo traktati që është ndërkohë në fuqi mes çdonjërës prej Palëve të kësaj Marrëveshjeje ose që mund t'u konkludohet atyre në vazhdim.

3. Çdo Palë do të zbatojë kërkesat për asistencë të bëra të qarta në këtë Marrëveshje në përputhje me ligjin e vet kombëtar.

4. Në mënyrë që të përmirësohet efektiviteti i parandalimit, gjetjes, investigimit dhe ndjekjes penale të shkeljeve kriminale ndërkufitare dhe si anëtare aktive të ICPO-Interpolit për çështjet e policisë, Organizatës Botërore të Doganave për çështjet e doganave, vendet anëtare të SECI-t do të shkëmbejnë dhe zhvillojnë informacionin kriminal në partneritet me agjencitë e tyre për imponimin e ligjit dhe Sekretariatin e Përgjithshëm të Interpolit dhe OBD.

Neni 3

Format e Asistencës Specifike

1. Në përgjigje të një kërkese apo me nismën e saj, një Palë i jep Palës tjetër asistencë në formën e informacionit që lidhet me krimin ndërkufitar.

2. Mbi bazën e kërkesës, një Palë jep asistencë në formën e informacionit të nevojshëm për të siguruar zbatimin e legjislacionit kombëtar dhe rregulloreve dhe përllogaritjen e saktë të detyrimeve doganore dhe taksave të tjera nga Palët.

3. Në përgjigje të kërkesës apo me nismën e saj, një Palë mund të japë asistencë në formën e informacionit që përfshin, por nuk kufizohet vetëm me informacionin mbi:

a) metodat dhe teknikat e përpunimit të pasagjerëve dhe ngarkesave me mallra;

b) zbatimin e suksesshëm të metodave dhe teknikave të luftës kundër shkeljeve;

c) veprimtaritë antishkelje që mund të përmbajnë vlera;

d) metodat e reja të përdorura nga kundravajtësit për të realizuar shkelje.

4. Palët do të bashkëpunojnë:

a) për lehtësimin e koordinimit efektiv;

b) për krijimin dhe mbajtjen e kanaleve të komunikimit që lehtësojnë këmbimin e shpejtë dhe të sigurtë të infomacionit;

c) sipas rregullave, dhënien reciproke të çdo lloj asistence teknike përmes shkëmbimit të njohurive profesionale, shkencore dhe teknike;

d) për marrjen në konsideratë dhe provë të pajisjeve apo procedurave të reja; dhe

e) për çdo problem tjetër administrativ, i cili herë pas here mund të kërkojë veprimin e tyre të përbashkët;

f) për implementimin e metodave të dërgesave të kontrolluara në përputhje me ligjin kombëtar të Palëve të interesuara.

5. Mbi bazën e kërkesës, Palët do të informojnë njëra-tjetrën nëse mallrat e eksportuara nga territori i njërës Palë janë importuar ligjërisht në territorin e Palës tjetër. Në qoftë se kërkohet, informacioni të përmbajë edhe procedurat që janë përdorur për çdoganimin e mallrave.

6. Mbi bazën e kërkesës, Pala e kërkuar, konform aftësisë së saj dhe brenda kufijve që lejojnë burimet në dispozicion të saj dhe në përputhje me ligjin kombëtar do të japë informacion lidhur me:

a) personat që autoriteti kërkues i njeh se kanë kryer një krim ndërkufitar ose janë dyshuar për diçka të tillë, në veçanti, për ata persona që hyjnë dhe dalin nga territori i tij;

b) mallrat, në transport apo magazinë, të identifikuara nga autoriteti kërkues si të dyshimta për trafik të jashtëligjshëm drejt territorit të tij; dhe

c) mjetet e transportit që dyshohet se përdoren për shkelje brenda territorit të Palës kërkuese.

7. Mbi bazën e kërkesës apo me nismën e saj, Palët do t'i japin njëra- tjetrës informacion që lidhet me veprimtaritë që mund të sjellin krim ndërkufitar. Në situatat kur mund të ketë dëmtime thelbësore të ekonomisë, shëndetit publik, sigurimit publik ose interesave të tjera të ngjashme me karakter jetësor për Palën tjetër, një Palë, sa herë që paraqitet mundësia, do të japë këtë lloj informacioni edhe pa qënë e kërkuar për të vepruar ashtu.

8. Në përputhje me ligjin e tyre kombëtar, Palët do të japin asistencë duke përdorur masat parandaluese dhe për transaksionet që lidhen me pronat, të ardhurat dhe/ose pasuritë monetare të përdorura për krim ndërkufitar, të përcaktuara në këto masa parandaluese.

9. Palët, në përputhje me ligjin e tyre kombëtar, mund të :

a) tjetërsojnë pronën, të ardhurat apo pasuritë monetare që u sekuestruan si rezultat i asistencës së dhënë në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje në kontroll të pronës, të ardhurave apo pasurive monetare; dhe

b) të transferojnë pronën, të ardhurën ose mjetet monetare të sekuestruara apo fitimin nga shitja e tyre, tek Pala tjetër konform kushteve që bien dakord.

Neni 4

Konfidencialiteti i informacionit dhe mbrojta e të dhënave personale

1. Çdo informacion i përfituar sipas kësaj Marrëveshjeje do të gëzojë të njëjtën shkallë konfidencialiteti nga autoriteti kërkues siç aplikohet për informacionin e ngjashëm nën administrimin e Palës që e merr atë.

2. Pa paragjykuar dispozitat e Konventës për Mbrojtjen e Personave lidhur me procesimin automatik të të dhënave personale (Këshilli i Evropës, ETS nr.108 Strasburg 28 janar 1981) të dhënat personale që do të merren nga kjo Marrëveshje do të kenë mbrojtje të paktën ekuivalente me atë që gëzojnë në Palën dërguese.

3. Informacioni i marrë në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje do të përdoret vetëm për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje. Në qoftë se autoriteti kërkues kërkon ta përdorë këtë informacion për qëllime të tjera, duke përfshirë dhe shpërndarjen në një shtet tjetër, kjo Palë duhet të marrë pëlqimin paraprak me shkrim nga autoriteti i kërkuar që furnizon informacionin në fjalë. Përdorimi në këtë rast është kushtëzuar nga kushtet që vendos ai autoritet.

4. Vetëm nëse Pala e kërkuar nuk shprehet kundër, paragrafi 3 nuk pengon përdorimin e informacionit gjatë procedurave juridike apo administrative që ndërmerren si pasojë e kryerjes së një krimi ndërkufitar. Palët gjatë regjistrimit të fakteve, raporteve apo dëshmive dhe në procedimet apo akuzat e paraqitura në gjykatë mund të përdorin si fakt informacionin dhe dokumentacionin e marrë në kuadrin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje. Përpara përdorimit do të njoftohet autoriteti kompetent, i cili ka dhënë informacionin në fjalë.

Neni 5

Përgjegjësia dhe mbrojtja legale për procesimin jokorrekt ose të paautorizuar të të dhënave

1. Çdo Palë do të jetë përgjegjëse, në përputhje me ligjin e vet kombëtar për çdo dëm shkaktuar individit si rezultat i gabimeve legale apo të inkorrektesës në të dhënat e transmetuara në Qendrën e SECI-t.

2. Vetëm Pala në të cilën ka ndodhur ngjarja, e cila shkaktoi dëmin mund të jetë subjekt veprimi për kompensim ndaj Palës së dëmtuar, e cila do të aplikojë në gjykatën që ka juridiksion nën ligjin kombëtar të shtetit të SECI-t të implikuar.

3. Një Palë nuk mund të shfajësohet se Pala tjetër i ka transmetuar të dhëna të pasakta në mënyrë që të shmangi përgjegjësinë e vet nga legjislacioni kombëtar ndaj Palës së dëmtuar. Nëse këto gabime legale apo inkorrektese ndodhin si rezultat i komunikimit të gabuar të të dhënave ose për mospërshtatje nga njëra ose më shumë Palë me detyrimet e vëna nga kjo Marrëveshje ose si rezultat i transmetimit jokorrekt apo të paautorizuar, Pala tjetër në çështje do të jetë e detyruar të ripaguajë sipas kërkesës shumën e paguar si kompensim nëse të dhënat nuk janë përdorur nga Pala në territorin e së cilës ka ndodhur dëmtimi nga thyerja e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6

Dosjet dhe dokumentet

1. Në bazë të kërkesës, autoriteti i kërkuar do të japë kopje të autentifikuara të dosjeve, dokumenteve dhe materialeve të tjera, lidhur me krimet ndërkufitare.

2. Nëse autoriteti kërkues nuk specifikon kërkesë për origjinale ose kopje, autoriteti i kërkuar mund të transmetojë informacion në bazë kompjuterike të çdo forme. Autoriteti i kërkuar, në të njëjtën kohë do të japë gjithë informacionin lidhur me përdorimin apo interpretimin e informacionit me bazë kompjuterike.

3. Në qoftë se administrata e kërkuar pranon nëpunës të caktuar nga administrata kërkuese, mund ta egzaminojnë informacionin lidhur me një krim ndërkufitar, në mjediset e autoritetit të kërkuar të bëjnë kopje të këtij informacioni apo të nxjerrin ekstrakte prej tij.

Neni 7
Ekspertët dhe dëshmitarët

1. Një nëpunës i autoriteteve të kërkuara mund të autorizohet për t'u paraqitur brenda kufijve të autorizimit të dhënë, si ekspert apo dëshmitar në proceset gjyqësore apo administrative, në territorin e Palës tjetër, lidhur me çështjet që mbulohen nga kjo Marrëveshje dhe të paraqesin dosje, dokumente apo materialet e tjera ose kopjet. Kërkesa për paraqitje duhet të tregojë specifikisht se për çfarë çështje dhe me çfarë atributesh titulli apo kualifikimi do të paraqitet nëpunësi si dëshmitar apo ekspert.

2. Pala kërkuese është e detyruar të marrë të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e sigurisë personale të nëpunësit gjatë qëndrimit të tij në territorin e atij shteti, sipas paragrafit 1 të këtij neni. Transporti dhe shpenzimet ditore të këtyre nëpunësve do të përballohen nga pala kërkuese.

Neni 8
Komunikimi i kërkesës

1. Kërkesat që rrjedhin nga kjo Marrëveshje bëhen me shkrim direkt nga nëpunësit e caktuar nga Palët në anglisht ose në gjuhë tjetër të pranuar nga autoriteti i kërkuar. Informacioni që konsiderohet i nevojshëm për ekzekutimin e kërkesës duhet të shoqërojë çdo kërkesë. Në situatat urgjente mund të bëhen dhe të pranohen kërkesat gojore, por ato duhet të konfirmohen me shkrim brenda 48 orësh. Çdo Palë duhet të emërojë një pikë të vetme nacionale të kontaktit të parë për të transmetuar dhe marrë kërkesat dhe të shpërndajë detajet e kontaktit të vet nëpërmjet Sekretariatit të Qendrës.

2. Kërkesa duhet të përmbajë:

a) emrin e autoritetit të caktuar dhe të personit aty që bën kërkesë;

b) natyrën e çështjes apo të hetimit, duke përfshirë ligjet, rregullat dhe dispozitat e tjera ligjore lidhur me të;

c) deklarimin e përmbledhur të fakteve dhe krimit ndërkufitar në fjalë;

d) natyrën e asistencës së përdorur;

e) arsyen për bërjen e kërkesës dhe për çfarë do të përdoret ky informacion;

f) në qoftë se dihen emrat dhe adresat e Palëve të përfshira në atë çështje të shkruara ashtu siç janë në dokumentet e tyre ndërkombëtare të identitetit.

Neni 9
Ekzekutimi i kërkesës

1. Autoriteti i kërkuar merr të gjitha masat e arsyeshme për ekzekutimin e një kërkese dhe përpiqet të sigurojë marrjen e të gjitha masave të nevojshme, që lidhen me atë qëllim.

2. Në qoftë se autoriteti i kërkuar nuk mund ta ekzekutojë vet kërkesën, ai duhet të ndërmarrë hapat që të kryhet ky ekzekutim si të ishte duke vepruar për vete dhe në përputhje me ligjin e vet kombëtar dhe të udhëzojë kështu autoritetin kërkues.

3. Autoriteti i kërkuar udhëheq, apo nëse është e mundur dhe në përputhje me ligjet e veta kombëtare lejon autoritetin kërkues të udhëheqë inspektimet, verifikimet, hetimet për zbulim faktesh apo ndërmarrjen e hapave të tjera hetimore, përfshi edhe pyetjen e ekspertëve, dëshmitarëve dhe personave të dyshuar për kryerjen e një krimi ndërkufitar, në përputhje me nevojat që lidhen me ekzekutimin e kërkesës.

4. Me qëllim lehtësimin e aksionit dhe në bazë kërkese, autoriteti kërkues këshillohet në avancë për kohën dhe vendin e aksionit që do të ndërmerret për ekzekutimin e kërkesës.

5. Mbi bazën e kërkesës, autoriteti i kërkuar autorizon, nëse është e mundur, deri në masën më të madhe të mundshme dhe në përputhje me ligjet e veta kombëtare, nëpunësit e administratës kërkuese të paraqiten në territorin e autoritetit të kërkuar, për të asistuar në ekzekutimin e kërkesës.

6. Autoriteti i kërkuar do të përmbushë kërkesën që kërkon ndjekjen e një procedure deri në atë masë që ajo procedurë nuk bie ndesh me legjislacionin e saj kombëtar.

Neni 10
Përjashtimet

1. Kur një autoritet i kërkuar e përcakton se dhënia e asistencës dëmton sovranitetin, sigurimin, politikën publike dhe interesat e tjera esenciale kombëtare, apo nuk përputhet me kërkesat e legjislacionit kombëtar, kjo administratë mund ta refuzojë apo tërhiqet nga dhënia e asistencës ose ta kondicionojë dhënien e asistencës me përmbushjen e disa kushteve apo kërkesave.

2. Në qoftë se autoriteti kërkues është i paaftë t'i përgjigjet administratës tjetër, kur kjo e fundit do t'i bënte një kërkesë të ngjashme, administrata kërkuese duhet ta përmendë këtë fakt, ndërkohë që bën kërkesën e saj për asistencë. Përmbushja e kërkesave të këtij lloji është në dëshirën e administratës së kërkuar.

3. Autoriteti i kërkuar mund ta shtyjë dhënien e asistencës në terren, kur kjo interferon me një procedurë investigimi në proces, një gjykim apo një operacion. Në një rast të tillë, autoriteti i kërkuar konsultohet me autoritetin kërkues për të përcaktuar nëse asistenca mund të jepet konform kushteve dhe afateve që kërkon autoriteti i kërkuar.

4. Në rastin kur nuk mund të përmbushet një kërkesë, autoriteti kërkues duhet të njoftohet menjëherë dhe t'i bëhen të ditura arsyet për shtyrjen apo mohimin e përmbushjes së kërkesës. Autoritetit kërkues duhet t'i njoftohen edhe rrethanat që mund të jenë të rëndësishme për ndjekjen e mëtejshme të asaj çështjeje.

Neni 11
Shpenzimet

1. Palët, normalisht, mohojnë pretendimet për shlyerje të shpenzimeve në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, me përjashtim të shpenzimeve për dëshmitarët, pagesës së ekspertëve dhe shpenzimeve për përkthim me shkrim dhe gojë për personat e tjerë që nuk janë nëpunës shtetërorë.

2. Në qoftë se ka apo kërkohen shpenzime të konsiderueshme dhe të një natyre të jashtëzakonshme, autoritetet konsultohen me njëra-tjetrën për të përcaktuar afatet dhe kushtet në të cilat do të ekzekutohet kërkesa si dhe mënyrën me të cilën do të përballohen shpenzimet.

Neni 12
Zbatimi i Marrëveshjes

1. Në këtë kuadër krijohet një Komitet i Përbashkët Bashkëpunimi, që përbëhet nga përfaqësues të autoriteteve të emëruar të Palëve, ku çdo Palë do të ketë një votë në Komitet. Një përfaqësues nga ICPO-Interpol dhe nga OBD do të shërbejë si këshilltar i përhershëm në Komitetin e Përbashkët të Bashkëpunimit. KPB do të mblidhet të paktën një herë në vit në një vend dhe në një datë të një axhende të fiksuar me konsensus reciprok.

2. Komisioni i Përbashkët i Bashkëpunimit, inter alia:

a) do të sigurojë funksionimin e saktë të kësaj Marrëveshjeje;

b) do të ekzaminojë të gjitha çështjet e ngritura nga aplikimi i saj;

c) do të marrë masat e nevojshme për kooperimin, në përputhje me fushën e veprimit të kësaj Marrëveshjeje;

d) do të bëjë shkëmbimin e pikëpamjeve të çdo pike me interes të përbashkët lidhur me bashkëpunimin, duke përfshirë masat e ardhshme dhe resorcet për to;

e) do të rekomandojë zgjidhje për arritjen e këtyre objektivave.

3. Komisioni i Përbashkët i Bashkëpunimit, i cili është trupi institucional më i lartë i Qendrës së SECI-t aprovon rregullat e procedurave të veta me konsensus.

4. Komiteti i Përbashkët i Bashkëpunimit do të konsultohet me agjencitë e tjera ndërkombëtare të ngjashme, si Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Europën (UNECE), Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Kontrollin e Drogës dhe Parandalimin e Krimeve (UNODCCP), OBD, Interpol dhe Europol për funksionimin efektiv të kësaj Marrëveshjeje dhe të Qendrës SECI.

Neni 13

Qendra Rajonale e Iniciativës së Bashkëpunimit për Europën Juglindore për Luftën ndaj Krimit Ndërkufitar (Qendra e SECI-t)

1. Qendra e SECI-t do të themelohet në Bukuresht, Rumani.

2. Qendra e SECI-t do të operojë në përputhje me Kartën e Organizimit dhe Funksionimit të Qendrës së SECI-t për luftën ndaj krimit ndërkufitar, e cila do të adoptohet nga Palët sa më shpejt të jetë e mundur, aneksuar dhe trupëzuar kësaj Marrëveshjeje.

3. Veprimtaria e kësaj Qendre do të koordinohet nga Komiteti i Përbashkët i Bashkëpunimit.

Neni 14

Aplikimi

Kjo Marrëveshje do të aplikohet në territoret e shteteve të çdo Pale.

Neni 15

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Në rast të një mosmarrëveshjeje mes dy a më shumë Palëve ose mes një Pale Kontraktuese dhe Qendrës lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Palët lidhur me të do të konsultohen dhe nëse do të jetë e nevojshme, do ia kalojnë mosmarrëveshjen Komitetit të Përbashkët të Bashkëpunimit për ta marrë në konsideratë dhe për veprimet e përshtatshme.

Neni 16

Hyrja në fuqi dhe përfundimi

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e parë të muajit që pason datën në të cilën tre Palë notifikojnë depozitimin e kompletimit të procedurave të tyre kombëtare për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes.

2. Për çdo shtet pjesëtar të SECI-t, hyrë në këtë marrëvshje pas hyrjes së saj në fuqi, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason datën në të cilën ky shtet notifikon depozitimin e materialeve të tij të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose hyrjes.

Për çdo shtet, veç shteteve pjesëmarrëse në SECI, vendimi për t'i lejuar hyrjen në këtë Marrëveshje pas hyrjes së saj në fuqi, mund të merret vetëm me konsensus nga vendet anëtare të SECI-t. Për ato shtete kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit që pason datën në të cilën ky shtet ka notifikuar depozitimin e materialeve të tij të ratifikimit, pranimit, aprovimit apo hyrjes.

3. Qeveria e Rumanisë do të shërbejë si Depozituese e kësaj Marrëveshjeje. Depozituesja do të informojë Palët për notifikimet e referuara në paragrafet 1 dhe 2 si dhe për datën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes.

4. Secila Palë mund të tërhiqet nga marrëveshja duke notifikuar tek depozituesi, i cili do t'i transmetojë një kopje të certifikuar çdo Pale. Tërheqja hyn në fuqi pas 3 muajve nga data e njoftimit. Procedimet në vazhdim në kohën e tërheqjes, pavarësisht do të kompletohen në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 17
Amendamente

1. Amendamente ndaj kësaj Marrëveshjeje mund të propozohen nga secila Palë. Çdo amendament i propozuar do t'i dërgohet depozituesit, i cili do t'ia komunikojë Palëve.

2. Palët do të njoftojnë depozituesin sa më shpejt të jetë e mundur për pranimin e amendamenteve të propozuara kësaj Marrëveshjeje.

3. Amendamentet e pranuara në përputhje me paragrafin 2 me konsensus do të hyjnë në fuqi në përputhje me nenin 16.

4. Nëse lidhur me amendamentet e rekomanduara ka një kundërshti të notifikuar tek depozituesi, ky amendament do të konsiderohet si i papranuar dhe do të jetë pa efekt.

Origjinali i kësaj Marrëveshjeje në kopje të vetme në anglisht do të depozitohet në Qeverinë e Rumanisë, si Depozituese, e cila do t'i transmetojë një kopje të certifikuar çdo pale.

DËSHMITARË PËR SA MË SIPËR, nënshkruesit, të autorizuar konform rregullave nga qeveritë përkatëse, firmosin këtë Marrëveshje.

Ambasador i Jashtëzakonshën dhe Fuqiplot i Shqipërisë në Bukuresht.

Marko BELLO

Bukuresht,
26 maj 1999

LIGJ
Nr.8547, datë 11.11.1999

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS "PËR NDALIMIN E PËRDORIMIT, TË MAGAZINIMIT, TË PRODHIMIT DHE TË TRANSFERIMIT TË MINAVE KUNDËR PERSONIT (MKP) DHE PËR SHKATËRRIMIN E TYRE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndër kombëtare", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet konventa "Për ndalimin e përdorimit, të magazinimit, të prodhimit dhe të transferimit të minave kundër personit (MKP) dhe për shkatërrimin e tyre".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2488, datë 23.11.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.32, faqe 1219

KONVENTA

PËR NDALIMIN E PËRDORIMIT, MAGAZINIMIT, PRODHIMIT DHE TRANSFERIMIT TË MINAVE KUNDËR PERSONIT (MKP) DHE SHKATËRRIMIN E TYRE

HYRJE

Shtetet Palë

Të vendosura për t'u dhënë fund vuajtjeve dhe pasojave të shkaktuara nga MKP, të cilat vrasin apo gjymtojnë me qindra njerëz në javë, kryesisht civilë të pafajshëm e të pambrojtur e sidomos fëmijë, pengojnë zhvillimin ekonomik dhe rindërtimin, ndalojnë riatdhesimin e refugjatëve dhe lëvizjen e njerëzve brenda vendit, si dhe kanë pasoja të rënda për vite me radhë pas vendosjes së tyre;

Duke besuar në nevojën për të bërë ç'është e mundur në ndihmesën për një punë të frytshme dhe të koordinuar për t'i bërë ballë sfidës së heqjes së MKP, të vendosura kudo në botë, si dhe për të siguruar shkatërrimin e tyre;

Me dëshirën për të bërë ç'është e mundur për të ndihmuar në përkujdesjen dhe rehabilitimin e viktimave të minave, përfshi këtu edhe riintegrimin social e ekonomik të tyre;

Duke njohur faktin se një ndalim i plotë i MKP do të përbëjë gjithashtu edhe një masë të rëndësishme në ndërtimin e masave të besimit;

Duke përshëndetur adoptimin e Protokollit për Ndalimin ose Kufizimin e Përdorimit të Minave, kurtheve dhe të tjera të ngjashme me to, siç përmendet në 3 maj 1996, në shtojcën e Konventës për Ndalimin ose Kufizimin e Përdorimit të disa Armëve Konvencionale, të cilat mund të shkaktojnë vuajtje të gjata, ose të kenë efekte diskriminuese, si dhe u bëhet thirrje për një ratifikim të shpejtë të gjithë atyre shteteve që nuk e kanë ratifikuar këtë protokoll;

Duke përshëndetur gjithashtu Rezolutën 51/45 S, datë 10 dhjetor 1996 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, e cila fton të gjitha shtetet për të vazhduar me rigorozitet dhe efikasitet zbatimin e ligjeve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare për ndalimin e përdorimit, grumbullimit, prodhimit dhe transferimit të MKP;

Duke përshëndetur të gjitha masat e marra në vitet e mëparshme, si në aspektin dypalësh ashtu edhe në atë shumëpalësh, që synojnë ndalimin, kufizimin apo pezullimin e përdorimit, grumbullimit, prodhimit dhe transferimit të MKP;

Duke nënvizuar faktin që ndërgjegjja publike karakterizohet nga parimet humanitare dhe kjo karakterizohet nga thirrja për të ndaluar plotësisht MKP, si dhe duke njohur përpjekjet e bëra për këtë qëllim nga Kryqi i Kuq Ndërkombëtar, Lëvizja e Gjysmëhënës së Kuqe, fushatën ndërkombëtare për ndalimin e minave, si dhe të shumë organizatave joqeveritare në mbarë botën;

Duke kujtuar Deklaratën e Ottavës së 5 tetorit 1996 dhe Deklaratën e Brukselit të 27 qershorit 1997, të cilat ftojnë komunitetin ndërkombëtar për të diskutuar mbi hartimin e një marrëveshjeje ndërkombëtare ligjore për ndalimin e përdorimit, magazinimit, prodhimit dhe transferimit të MKP;

Duke shprehur dëshirën për anëtarësimin e të gjitha shteteve në këto konventa, si dhe vendosmërinë për të punuar së bashku kudo ku të jenë anëtarësuar, në Kombet e Bashkuara, Konferencën për Çarmatimin, organizatat rajonale, Konferencën për Rishikimin e Konventës për Ndalimin ose Kufizimin e Përdorimit të disa Armëve Konvencionale, të cilat mund të shkaktojnë vuajtje të vazhdueshme, ose që kanë efekte diskriminuese;

Duke u bazuar në parimet e ligjeve humanitare ndërkombëtare, ku e drejta e palëve në një konflikt të armatosur për të zgjedhur metodat dhe mjetet e luftës është e pakufizuar, në parimin që ndalon përdorimin në një konflikt të armatosur të armëve, predhave dhe të metodave të luftës të një natyre që shkaktojnë vuajtje pafund, si dhe në parimin se duhet bërë dallim midis civilëve dhe luftëtarëve;

Ranë dakord si më poshtë:

Neni 1
Detyrime të përgjithshme

1. Çdo Shtet Palë nuk do të lejohet në asnjë rrethanë :

a) të përdorë MKP;

b) të zhvillojë, prodhojë, përftojë, stokojë, ruajë a të transferojë te dikush tjetër, direkt apo indirekt MKP;

c) të ndihmojë, inkurajojë a të detyrojë në çdo lloj mënyre qoftë, ndonjë tjetër për ta angazhuar në ndonjë aktivitet që ndalohet nga Shtetet Palë të kësaj konvente.

2. Çdo Shtet Palë do të marrë përsipër të shkatërrojë ose të sigurojë shkatërrimin e MKP, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente.

Neni 2
Përkufizime

1. Me "MKP" nënkuptohet një minë e caktuar që shpërthen nga prania, afrimi apo kontakti me një person dhe për pasojë shkakton paaftësinë, gjymtimin apo vrasjen e një a më shumë njerëzve. Minat e caktuara për të shpërthyer nga prania, afrimi apo kontakti me një mjet transporti, por që janë të pajisura me mjete sigurimi, nuk konsiderohen MKP.

2. Me "minë" nënkuptojmë një municion të caktuar për t'u vendosur nën, mbi apo afër tokës, ose në një sipërfaqe tjetër, me qëllimin për të shpërthyer nga prania, afrimi ose kontakti me një person apo mjet transporti.

3. Me "mjet sigurimi" nënkuptojmë mjetin që mbron minën apo pjesë të saj të bashkuara ose të vendosura nën të dhe që aktivizohet kur bëhet ndonjë veprim për ta ngacmuar me qëllim ose jo.

4. Me "transferim" nënkuptohet lëvizja mekanike e MKP brenda ose jashtë territorit kombëtar, ndryshimi i emërtimit ose i të dhënave të kontrollit, por nuk nënkuptohet transferimi i territoreve që kanë MKP të vendosura në të.

5. Me "zonë të minuar" nënkuptojmë një zonë e cila është e rrezikshme nga prania ose dyshimi se ka prani të minave në të.

Neni 3
Përjashtimet

1. Pavarësisht nga detyrimet e përgjithshme në nenin 1, ruajtja ose transferimi i një MKP për zhvillimin e stërvitjeve, pastrimin ose teknikën e shkatërrimit të minave është i lejuar. Numri i minave të tilla nuk duhet të kalojë minimumin absolut të domosdoshëm për qëllimet e mësipërme.

2. Transferimi i MKP për qëllimin e shkatërrimit të tyre është i lejuar.

Neni 4
Shkatërrimi i magazinimeve të MKP

Përveç sa thuhet në nenin 3, çdo Shtet Palë merr përsipër të shkatërrojë ose të garantojë shkatërrimin e të gjitha magazinimeve të MKP, që janë nën juridiksion ose kontroll të tij, sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 4 vjet mbas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje për Shtetin-Palë.

Neni 5

Shkatërrimi i MKP në fushat e minuara

1. Çdo Shtet-Palë merr përsipër të shkatërrojë ose të garantojë shkatërrimin e të gjitha MKP në fushat e minuara në juridiksionin ose kontrollin e tij, sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 vjet mbas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje për Shtetin-Palë.

2. Çdo Shtet-Palë duhet të bëjë përpjekje për të përcaktuar të gjitha sipërfaqet në të cilat MKP janë të njohura ose dyshohet të jenë vendosur dhe do të garantojë që të gjitha MKP në fushat e minuara janë të shënuara, monitoruara, të mbrojtura me rrethim ose mjete të tjera, të garantojë përjashtimin efektiv të civilëve deri sa të gjitha MKP të jenë shkatërruar. Shënimi i fushave të minuara duhet të bëhet sipas standardeve ndërkombëtare.

3. Në qoftë se një Shtet-Palë beson se ai do të jetë i paaftë të shkatërrojë ose të garantojë shkatërrimet e të gjitha MKP, referuar sipas paragrafit 1 brenda asaj periudhe kohe, ai mund të paraqesë një kërkesë në një nga takimet ose konferencat e Shteteve-Palë 137 për një zgjatje të afatit kohor për më shumë se 10 vjet.

4. Kërkesa duhet të përmbajë:

a – kohëzgjatjen e afatit të propozuar;

b – një shpjegim të detajuar të arsyeve për afatin e propozuar duke përfshirë:

- përgatitjen dhe statusin e punës së programeve kombëtare të çminimit;

- mjetet financiare dhe teknike të parashikuara për shkatërrimin e të gjitha MKP;

- rrethanat të cilat pengojnë aftësinë e Shtetit-Palë për shkatërrimin e të gjitha MKP në fushat e minuara;

c – ndikimet humanitare, sociale, ekonomike dhe mjedisore të zgjatjes së afatit;

d – ndonjë tjetër informacion përkatës të kërkesës për zgjatjen e afatit të propozuar.

5. Takimi i Shteteve-Palë ose Konferenca e rishikimit merr në konsideratë faktorët që jepen në paragrafin 4, vlerëson kërkesën dhe vendos me shumicë votash të Shteteve-Palë të pranishme.

Neni 6

Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ndihma

1. Në përmbushjen e detyrimeve të veta, sipas kësaj konvente, çdo Shtet-Palë ka të drejtë të kërkojë dhe të japë ndihmë, kur është e mundur, për shtetet e tjera.

2. Çdo Shtet-Palë do të marrë përsipër të lehtësojë dhe do të ketë të drejtë të marrë pjesë në shkëmbimin e pajisjeve, materialeve dhe të informacioneve shkencore e teknike që kanë të bëjnë me zbatimin e kësaj konvente.

3. Çdo Shtet-Palë që i ka mundësitë, do të japë asistencë për përkujdesjen dhe rehabilitimin, riintegrimin social dhe ekonomik të viktimave të minave dhe për programet e çminimit. Një asistencë e tillë mund të sigurohet, ndër të tjera, nëpërmjet sistemit të Kombeve të Bashkuara, institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare, rajonale e kombëtare, Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, Kryqit të Kuq Kombëtar, shoqatave të Gjysmëhënës së Kuqe dhe Federatës së saj Ndërkombëtare, organizatave joqeveritare, si dhe mbi baza dypalëshe.

4. Çdo Shtet-Palë, që i ka mundësitë, do të japë asistencë për shkatërrimin e stoqeve të MKP.

5. Çdo Shtet-Palë do të marrë përsipër të japë informacion mbi të dhënat bazë për pastrimin e minave nëpërmjet sistemit të Kombeve të Bashkuara, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me mjetet dhe teknologjitë e ndryshme që duhen për pastrimin e minave, listën e ekspertëve, agjencitë e specializuara ose pikat e kontaktit për pastrimin e minave.

6. Shtetet-Palë mund t'u kërkojnë Kombeve të Bashkuara, organizatave rajonale, Shteteve të tjera Palë ose organizmave të tjerë ndërqeveritarë ose joqeveritarë, të ndihmojnë autoritetet e tyre në hartimin e programit kombëtar për çminimin, si dhe për të përcaktuar ndër të tjera:

a) shtrirjen dhe fushën e veprimit të MKP,

b) burimet financiare, teknologjike dhe njerëzore që kërkohen për zbatimin e programit,

c) përcaktimin e numrit të viteve që duhen për shkatërrimin e të gjitha MKP në fushat e minuara që ndodhen nën juridiksionin, kontrollin apo që i përkasin shtetit palë,

d) aktivitetet që duhen kryer për të zvogëluar incidentet nga minat, të cilat shkaktojnë gjymtime dhe vdekje,

e) ndihmë për viktimat e minave,

f) marrëdhëniet midis Qeverisë së Shtetit-Palë të interesuar dhe organizatave qeveritare, ndërqeveritare dhe joqeveritare për zbatimin e programit.

7. Çdo Shtet-Palë që merr dhe jep asistencë sipas dispozitave të këtij neni do të kooperojë që programi i asistencës të zbatohet i plotë dhe sa më shpejt.

Neni 7

Masat e transparencës

1. Çdo Shtet Palë do të raportojë tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara sa më shpejt dhe jo më vonë se 180 ditë nga hyrja në fuqi e kësaj Konvente për Shtetin Palë:

a) masat kombëtare të marra për zbatimin e nenit 9;

b) sasinë totale të stoqeve të MKP që ka në zotërim apo që ndodhen nën juridiksionin a kontrollin e tij, përfshi tipet dhe në rast se ka mundësi, sasinë numerike të çdo tipi MKP që ndodhet në stoqe;

c) përcaktimin e të gjitha fushave të minuara ose që dyshohen se janë të minura, të cilat i zotëron, i ka nën juridiksion apo nën kontrollin e tij, duke përfshirë sa më shumë hollësira mbi tipin dhe sasinë e minave për çdo fushë të minuar dhe ku janë vendosur ato;

d) tipet, madhësitë dhe, kur është e mundur, numrin e të gjitha MKP të mbajtura a të transferuara për zhvillimin e stërvitjeve mbi shpërthimin e minave, pastrimin e tyre, shkatërrimin e teknikës, ose transferimin për qëllim shkatërrimi, siç lejohen nga institucionet e Shtetit Palë për mbajtjen dhe transferimin e MKP sipas nenit 3;

e) statusi i programit për lehtësimin e konvertimit ose të prishjes së porosive për prodhimin e minave;

f) statusi i programit për shkatërrimin e MKP në përputhje me nenet 4 dhe 5, përfshi hollësitë mbi metodat që do të përdoren për shkatërrimin, vendndodhjen e vendeve të shkatërrimit, si dhe masat që do të merren për ruajtjen e mjedisit;

g) tipet dhe sasinë e MKP të shkatërruara pas hyrjes në fuqi të kësaj konvente për Shtetin Palë, duke përfshirë sasinë e secilit tip të MKP të shkatërruara, sipas nenit 4 dhe 5, veç e veç dhe, kur ka mundësi, numrin e secilit tip të MKP kur shkatërrimi bëhet sipas nenit 4;

h) karakteristikat teknike të secilit tip të MKP të prodhuara, për të zgjeruar njohuritë, si dhe ato që janë në përdorim ose që zotërohen nga Shteti Palë, duke dhënë kur është e arsyeshme, lloje të tilla informacionesh që lehtësojnë identifikimin dhe pastrimin e MKP. Ky informacion duhet të përmbajë, të paktën, dimensionet, shkrehësat, lëndën eksplozive, përmbajtjen e metalit, fotografim me ngjyra dhe informacione të tjera që lehtësojnë pastrimin e MKP;

i) Masat e marra për një sensibilizim të menjëhershëm dhe efektiv të popullatës në lidhje me zonat e identifikuara sipas paragrafit 2 të nenit 5.

2. Informacioni i dhënë në përputhje me këtë nen, do të jepet nga Shtetet Palë çdo vit, duke mbuluar vitin e fundit kalendarik dhe raportohet te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara jo më vonë se data 30 prill e çdo viti.

3. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, raporte të tilla ua transmeton të gjitha Shteteve Palë.

Neni 8

Lehtësimi dhe sqarimet për zbatimin e detyrimeve

1. Shtetet Palë bien dakord të konsultohen e të kooperojnë midis tyre për zbatimin e dispozitave të kësaj konvente, si dhe të punojnë së bashku për të lehtësuar zbatimin nga ana e Shteteve Palë të detyrimeve të tyre që rrjedhin nga kjo konventë.

2. Në rast se një a më shumë Shtete Palë dëshirojnë të sqarojnë dhe zgjidhin çështje në lidhje me zbatimin e dispozitave të kësaj konvente nga një Shtet tjetër Palë, ata mund të paraqesin nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara një kërkesë për sqarim për Shtetin tjetër Palë. Kjo kërkesë duhet të shoqërohet me të gjitha informacionet e nevojshme dhe të bëhet kujdes që në të të evitohen abuzimet. Shteti Palë që merr kërkesën për sqarim duhet që brenda 28 ditëve, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, të bëjë sqarimet e nevojshme për ato çka kërkohen nga shteti që ka bërë kërkesën.

3. Në rast se shteti që ka bërë kërkesën nuk merr përgjigje nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara brenda datës së parshikuar ose e gjykon përgjigjen e dhënë si të pakënaqshme, ai, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, mund ta shtrojë çështjen në mbledhjen e Shteteve Palë. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara ua transmeton çështjen të gjitha Shteteve Palë, shoqëruar me të gjitha hollësitë që përmban kërkesa për sqarim.

4. Pa pritur thirrjen e Mbledhjes së Shteteve Palë, çdo Shtet Palë mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, që ai të përdorë kompetencat e tij për të lehtësuar sqarimin e kërkesës.

5. Shteti-Palë, që ka bërë kërkesën, mund të propozojë, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara thirrjen e një mbledhjeje të posaçme për të diskutuar mbi çështjen. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, nëpërmjet një komunikate ua përcjell këtë propozim Shteteve Palë të interesuara, si dhe të gjitha Shteteve të tjera Palë, duke nënvizuar se ai është në favor të kërkesës për thirrjen e një mbledhjeje të posaçme. Në rast se brenda 14 ditëve nga dërgimi i komunikatës, të paktën një e treta e Shteteve Palë është shprehur në favor të thirrjes së mbledhjes së posaçme, atëherë Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara thërret mbledhjen brenda 14 ditëve në vazhdim.

6. Kur mbledhja e Shteteve Palë, ose mbledhja e posaçme e Shteteve Palë, zhvillohet, së pari do të përcaktojë se si do të shqyrtohet çështja, duke mbajtur parasysh të gjitha informacionet e dhëna nga Shtetet Palë të interesuara. Si Mbledhja e Shteteve Palë, ashtu edhe ajo e posaçme, duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet për të marrë një vendim me konsensus. Në rast se një gjë e tillë është konsumuar dhe nuk ka dhënë rezultat, atëherë vendimi merret me shumicën e votave të Shteteve Palë të pranishme në votim.

7. Të gjitha Shtetet Palë do të bashkëpunojnë ngushtë me Mbledhjen e Shteteve Palë, apo me Mbledhjen e Posaçme të Shteteve Palë, duke përmbushur detyrimet e tyre në të mirë të zgjidhjes së çështjes, përfshi edhe dërgimin e misioneve të verifikimit, që autorizohen konform paragrafit

8. Mbledhja e Shteteve Palë apo Mbledhja e Posaçme e Shteteve Palë, mund të autorizojë mision vlerësimi dhe të vendosë për mandatin e tij me shumicën e Shteteve Palë të pranishme në votim. Shteti që bën kërkesën mund të ftojë në çdo kohë mision vlerësimi në territorin e tij. Një mision i tillë kryhet pa ndonjë vendim të Mbledhjes së Shteteve Palë apo të Mbledhjes së Posaçme të Shteteve Palë. Misioni i përbërë prej 9 ekspertësh, i caktuar dhe miratuar në përputhje me paragrafin 9 dhe 10, mund të mbledhë të dhëna shtesë edhe në vende të tjera të lidhura direkt me çështjen.

9. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, do të përgatisë dhe dërgojë një listë me emrat, kombësitë dhe të dhëna të tjera që lidhen me ekspertët dhe ua dërgon atë të gjitha Shteteve Palë. Secili nga ekspertët e përfshirë në këtë listë, mund të marrë pjesë në të gjitha misionet e vlerësimit, përjashtuar rastin kur një Shtet Palë e konsideron të papranueshëm. Në rast mospranimi, eksperti nuk do të marrë pjesë në misionin e vlerësimit që kryhet në territorin e atij vendi ose në ato territore që janë nën juridiksionin a kontrollin e tij.

10. Me të marrë kërkesën nga Mbledhja e Shteteve Palë, apo nga Mbledhja e Posaçme e Shteteve Palë, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, pas konsultimeve me Shtetin Palë që ka bërë kërkesën, cakton anëtarët dhe shefin e misionit. Shtete Palë që lidhen me çështjen nuk caktohen në mision. Anëtarët e misionit gëzojnë privilegjet dhe imunitetin sipas nenit IV të Konventës mbi Privilegjet dhe Imunitetin e Kombeve të Bashkuara, miratuar me 13 shkurt 1946.

11. Brenda 72 orëve nga njoftimi, anëtarët e misionit të vlerësimit do të mbërrijnë në territorin e Shtetit Palë. Shteti Palë merr të gjitha masat administrative për të pritur, transportuar dhe për akomodimin e misionit, si dhe është përgjegjës për sigurimin e misionit për sa kohë që ai do të qëndrojë në territorin e tij apo në atë territor që ai ka nën kontroll.

12. Pa asnjë paragjykim për sovranitetin e Shtetit Palë, misioni i vlerësimit mund të marrë me vete pajisjet e nevojshme që i duhen ekskluzivisht vetëm për të mbledhur të dhëna për zbatimin e detyrës. Me të mbërritur, misioni vë në dijeni Shtetin Palë për pajisjet që ka sjellë për t'i përdorur gjatë vlerësimit.

13. Shteti Palë bën të gjitha përpjekjet për të siguruar që misioni i vlerësimit të flasë me çdo person, i cili mund të jetë i aftë të japë informacione për çështjen.

14. Shteti Palë lejon misionin e vlerësimit të hyjë në zonat dhe instalimet që ai ka nën kontroll, kur kërkohen të mblidhen fakte që lidhen me të. Kjo mund të jetë edhe subjekt për t'u marrë vesh kur Shteti Palë i konsideron të nevojshme për :

a) mbrojtjen e pajisjeve, informacioneve dhe zonave delikate,

b) respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga Kushtetuta e Shtetit Palë mbi pronësinë, kërkimet apo detyrime të tjera,

c) ruajtja fizike dhe përkujdesja për anëtarët e misionit të vlerësimit.

Kur Shteti Palë paraqet probleme të tilla, ai mund të bëjë përpjekje të arsyeshme për të demonstruar mjete alternative që vërtetojnë angazhimin e tij në zbatimin e kësaj konvente.

15. Misioni i vlerësimit mund të qëndrojë në territorin e Shtetit Palë jo më shumë se 14 ditë, si dhe në një vend të veçantë jo më shumë se 7 ditë, kur nuk është rënë dakord ndryshe.

16. Çdo informacion i dhënë në konfidencë dhe që nuk lidhet me çështjen e misionin e vlerësimit, do të trajtohet në baza konfidenciale.

17. Misioni i vlerësimit do të raportojë, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara në Mbledhjen e Shteteve Palë ose në Mbledhjen e Posaçme të Shteteve Palë mbi rezultatet e vlerësimit të bërë.

18. Mbledhja e Shteteve Palë ose Mbledhja e Posaçme e Shteteve Palë, do të marrë në shqyrtim informacionin përkatës, përfshi raportin e misionit të vlerësimit dhe vendos për masat që duhet të marrë Shteti Palë, si dhe cakton edhe afatet përkatëse. Shteti Palë do të raportojë për zbatimin e secilës masë.

19. Mbledhja e Shteteve Palë ose Mbledhja e Posaçme e Shteteve Palë, mund t'u rekomandojë Shteteve Palë të interesuara rrugët dhe mjetet për sqarimin e zgjidhjen e çështjeve në shqyrtim, përfshi edhe ndërmarrjen e procedurave të përshtatshme në përputhje me ligjet ndërkombëtare.

20. Mbledhja e Shteteve palë ose Mbledhja e Posaçme e Shteteve Palë do të bëjë të gjitha përpjekjet për të marrë vendet e saj sipas paragrafit 18 dhe 19 me konsensus. Ndryshe, vendos me dy të tretat e Shteteve Palë, të pranishme në votim.

Neni 9

Masat kombëtare të zbatimit

Çdo Shtet Palë do të hartojë legjislacionin përkatës, administrativ a masa të tjera, përfshi këtu vendosjen e dënimeve penale për të parandaluar dhe dhënë fund çdo aktiviteti që ndërmerret nga persona ose në territorin nën juridiksion a nën kontrollin e tij e që i ndalohen Shtetit Palë me anë të kësaj konvente.

Neni 10

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Çdo Shtet Palë do të konsultohet dhe do të bashkëpunojë me të tjerët për të zgjidhur çdo mosmarrëveshje që lidhet me zbatimin apo interpretimin e kësaj konvente. Çdo Shtet Palë do të paraqesë të gjitha mosmarrëveshjet në Mbledhjen e Shteteve Palë.

2. Mbledhja e Shteteve Palë duhet të kontribuojë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me çfarëdo mjeti që ajo e gjykon të dobishëm, si dhe duke u bërë thirrje shteteve në mosmarrëveshje të fillojnë ndërmarrjen e procedurave të zgjidhjes, duke sugjeruar edhe afatet për çdo procedurë të rënë dakord.

3. Ky nen nuk paragjykon dispozitat e kësaj konvente në lehtësimin e zbatimit dhe sqarimit të saj.

Neni 11

Mbledhja e Shteteve PalëShtetet Palë do të takohen rregullisht me qëllim që të shqyrtojnë çdo çështje që lidhet me zbatimin e kësaj konvente përfshi:

a) funksionimin dhe statusin e kësaj konvente;

b) çështje që rrjedhin nga zbatimi i dispozitave të kësaj Konvente;

c) bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ndihma sipas nenit 6;

d) zhvillimin e teknologjisë për pastrimin e minave;

e) detyrimet e Shteteve Palë sipas nenit 8;

f) vendimet që lidhen me detyrimet e Shteteve Palë sipas nenit 5.

2. Mbledhja e parë e Shteteve Palë do të thirret nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, një vit pas hyrjes në fuqi të kësaj konvente, mbledhjet e tjera që pasojnë do të thirren një herë në vit nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, deri sa të mblidhet Konferenca e Parë e Rishikimit.

3. Sipas kushteve që jepen në nenin 8, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara mund të thërrasë mbledhje të posaçme të Shteteve Palë.

4. Shtetet jopalë në këtë konventë, si dhe Kombet e Bashkuara, institucione apo organizata ndërkombëtare, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq dhe organizata joqeveritare, mund të ftohen për të marrë pjesë në mbledhje si vëzhgues, në përputhje me procedurat e rëna dakord.

Neni 12

Konferencat e rishikimit

1. Konferenca e Rishikimit mund të thirret nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara pasi kanë kaluar 5 vjet nga hyrja në fuqi e kësaj konvente. Konferencat e tjera të rishikimit mund të thirren me kërkesën e një ose disa Shteteve Palë, por gjithnjë pa cenuar intervalin prej 5 vitesh. Të gjitha Shtetet Palë në këtë konventë do të ftohen në konferencat e rishikimit.

2. Qëllimi i Konferencës së Rishikimit do të jetë :

a) rishikimi i funksionimit dhe statusit të kësaj konvente;

b) shqyrtimi i nevojave dhe intervalit midis mbledhjeve të Shteteve Palë sipas paragrafit 2, neni 11;

c) të marrë vendime sipas nenit 5;

d) të miratojë, kur është e nevojshme, në raportin final, konkluzionet që lidhen me zbatimin e kësaj konvente.

3. Shtetet jopalë në këtë konventë, si dhe Kombet e Bashkuara, intitucionet e organizatat ndërkombëtare, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, si dhe organizatat joqeveritare, mund të ftohen në konferencat e rishikimit si vëzhgues brenda rregullave të rëna dakord.

Neni 13
Amendamentet

1. Në çdo kohë pas hyrjes në fuqi të kësaj konvente, secili Shtet Palë mund të propozojë ndryshime në konventë. Çdo propozim depozitohet dhe u bëhet i ditur të gjitha Shteteve Palë. Ai shqyrtohet në një konferencë amendimi që thirret për këtë qëllim. Në rast se shumica bie dakord brenda 30 ditëve nga marrja njoftim për propozimin, atëherë thirret konferenca e amendimit në të cilën ftohen të gjitha Shtetet Palë.

2. Shtetet jopalë në këtë konventë, si dhe Kombet e Bashkuara, institucionet e organizatat ndërkombëtare, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, si dhe organizatat joqeveritare mund të ftohen në konferencat e amendimit si vëzhgues brenda rregullave të rëna dakord.

3. Konferenca mund të zëvendësojë mbledhjen e radhës të Shteteve Palë ose të Konferencës së Rishikimit, kur për këtë është dakord shumica e Shteteve Palë.

4. Çdo ndryshim në këtë konventë do të miratohet nga shumica e dy të tretave e Shteteve Palë të pranishme dhe që votojnë për ndryshimin. Çdo ndryshim u transmetohet të gjitha Shteteve Palë.

5. Çdo ndryshim i kësaj konvente hyn në fuqi për të gjitha Shtetet Palë të kësaj konvente pas depozitimit në sekretari të dokumenteve të ratifikimit.

Neni 14
Shpenzimet

1. Shpenzimet për Mbledhjen e Shteteve Palë, Mbledhjen e Posaçme të Shteteve Palë, Konferencat e Rishikimit dhe për konferencat e amendimit do të mbulohen nga Shtetet Palë dhe ato jopalë që marrin pjesë në to, në përputhje me normat e Kombeve të Bashkuara që rregullojnë këto çështje.

2. Shpenzimet që i duhen Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara në zbatim të neneve 7 dhe 8 dhe shpenzimet për misionet e vlerësimit mbulohen nga Shtetet Palë sipas normave të Kombeve të Bashkuara që rregullojnë këto çështje.

Neni 15
Nënshkrimi

Kjo koventë, e hartuar në Norvegji më 18 shtator 1997, do të jetë e hapur për nënshkrim në Ottava, Kanada, për të gjitha shtetet nga 3 dhjetori 1997 deri në 4 dhjetor 1997, si dhe në Shtabin e Kombeve të Bashkuara në New York, nga 5 dhjetori 1997 deri në hyrjen e saj në fuqi.

Neni 16
Ratifikimi, pranimi, miratimi ose aprovimi

1. Kjo konventë është objekt ratifikimi, pranimi ose miratimi për nënshkruesit.

2. Ajo do të jetë e hapur për miratim për çdo shtet që nuk e ka nënshkruar konventën.

3. Dokumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit apo aprovimit duhen të depozitohen në sekretari.

Neni 17
Hyrja në fuqi

1. Kjo konventë do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit të gjashtë mbas muajit në të cilin është depozituar dokumenti i 40-të i ratifikimit, pranimit, miratimit apo aprovimit.

2. Për ndonjë Shtet Palë, i cili i depoziton dokumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit apo aprovimit, pas datës kur është bërë depozitimi i dokumentit të 40-të të ratifikimit, pranimit,

miratimit apo aprovimit, kjo konventë hyn në fuqi ditën e parë të muajit të gjashtë, pas datës në të cilën shteti ka depozituar dokumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit apo aprovimit.

Neni 18
Zbatime të përkohshme

Ndonjë Shtet Palë mundet që, në kohën e ratifikimit, pranimit, miratimit apo aprovimit, të deklarojë se ai përkohësisht do të zbatojë paragrafin 1 të nenit 1 të kësaj Konvente gjatë hyrjes në fuqi të saj.

Neni 19
Rezervat

Nenet e kësaj Konvente nuk do të jenë objekt rezervash.

Neni 20
Kohëzgjatja dhe tërheqja

1. Kjo Konventë do të ketë kohëzgjatje të pakufizuar.
2. Çdo Shtet Palë, në përputhje me sovranitetin e tij, ka të drejtë të tërhiqet nga kjo Konventë. Ai duhet t'ua njoftojë tërheqjen të gjitha Shteteve Palë, si dhe Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Dokumenti i tërheqjes duhet të përmbajë një shpjegim të plotë për arsyet e tërheqjes.
3. Një tërheqje hyn në fuqi gjashtë muaj pas depozitimit të instrumentit të tërheqjes. Në rast se në fund të kësaj periudhe prej gjashtë muajsh, Shteti Palë që ka bërë tërheqjen angazhohet në një konflikt të armatosur, tërheqja hyn në fuqi pas përfundimit të këtij konflikti.
4. Tërheqja e një Shteti Palë nga kjo konventë, nuk do të ndikojë në detyrën e shteteve për të vazhduar përmbushjen e detyrimeve të tyre që rrjedhin nga ligjet ndërkombëtare.

Neni 21
Sekretari

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara është njëkohësisht edhe Sekretar i kësaj Konvente.

Neni 22
Tekstet autentike

Origjinali i kësaj Konvente në gjuhët arabisht, kinezçe, angleze, franceze, ruse dhe spanjolle është autentik dhe depozitohet te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

LIGJ
Nr. 8623, datë 15.6.2000

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË HUNGARISË PËR BASHKËPUNIMIN NË LUFTËN KUNDËR TERRORIZMIT, TRAFIKUT TË DROGËS DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Hungarisë për bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, trafikut të drogës dhe krimit të organizuar".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2666, datë 24.6.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.18, faqe 867

MARRËVESHJE
MIDIS QEVERISË SË REPUBLIKËS SË HUNGARISË MBI BASHKËPUNIMIN NË LUFTËN KUNDËR TERRORIZMIT, TRAFIKUT TË DROGËS DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Hungarisë, të quajtura më poshtë "Palë",

duke kërkuar të japin kontributin e tyre në zhvillimin e marrëdhënieve dypalëshe,

të bindura për rëndësinë e bashkëpunimit në luftën dhe parandalimin efikas të krimit të organizuar, veçanërisht krimet e lidhura me drogën, terrorizmin dhe trafikun e njerëzve,

të shqetësuara për rritjen e abuzimit dhe shpërndarjes së paligjshme të drogave dhe lëndëve psikotrope në botë;

duke dëshiruar të bashkërendojnë veprimet kundër krimit të organizuar ndërkombëtar për të kufizuar përdorimin e dokumenteve të fallsifikuara të udhëtimit dhe dokumenteve që synohen të përdoren për të kryer krime;

duke marrë parasysh traktatet ndërkombëtare në fuqi mbi këto fusha;

Kanë rënë dakord si më poshtë :

Neni 1

(1) Palët duke u bazuar në kuadrin e tyre ligjor, bashkëpunojnë për parandalimin dhe luftën kundër terrorizmit, trafikut të drogës dhe krimit të organizuar .

(2) Palët do të bashkëpunojnë veçanërisht në raste të krimeve apo përgatitjeve për krim të kryera në territorin e njërës nga Palët dhe të shkëmbimit të të dhënave të kërkuara, që lidhen më territorin e Palës tjetër.

Neni 2

(1) Autoritetet kompetente të Palëve :
Përsa i takon Republikës së Shqipërisë :
Ministria e Rendit Publik,
Ministria e Punës dhe Përkrahjes Sociale,
Drejtoria e Përgjthshme e Policisë,
Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave,
Drejtoria e Policisë Kufitare,
SHIK .
Përsa i takon Republikës së Hungarisë :
Ministria e Brendshme,
Ministria e Mirëqenies Sociale,
Drejtoria Kombëtare e Policisë,
Ministria e Financave dhe Drejtoria Kombëtare e Kufirit dhe Zyra e Sigurimit Kombëtar,
Drejtoria Kombëtare e Doganave
brenda qëllimit të autoritetit dhe juridiksionit të tyre, do te bashkëpunojnë në zbatimin e drejtpërdrejtë, operativ dhe diplomatik të kësaj Marrëveshje .

(2) Organet e autorizuara të Palëve, sipas autoritetit dhe juridiksionit të tyre respektiv do të bashkpunojnë në zbatimin e kësaj Marrëvëshje në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe operative, ku sipas një plani bashkëpunimi të specifikojnë fushat e veçanta të bashkëpunimit dhe metodën e mbajtjes së kontaktit .

(3) Në mungesë të ndonjë marrëveshje tjetër, gjuha e komunikimit midis organeve bashkëpunuese do të jetë anglishtja .

Neni 3

Në përputhje me kuadrin respektiv ligjor dhe mbështetur në parashikimet e kësaj Marrëveshje, Palët për të luftuar terrorizmin do të :

(1) Shkëmbejnë përvojë profesionale dhe informacion mbi sulmet terroriste të kryera ose që parashikohen të kryen, ose personat që marrin pjesë në këto akte terroriste, mbi metodologjinë e zbatimit si dhe pajisjet teknike që do të përdoren gjatë këtij zbatimi.

(2) Shkëmbejnë përvojë profesionale dhe informacion mbi organizatat terroriste dhe anëtarët, planet dhë zbatimet e tyre për të shkaktuar dëm në territorin ose kundër intersave të Palës tjetër, për të luftuar terrorizmin ose të eleminojnë krime serioze të caktuara që cënojnë rendin publik

(3) Shkëmbejnë informacion mbi trafikun e paligjshëm të armëve , eksplozivëve dhe lëndëve radioaktive .

Neni 4

Në përputhje me kuadrin respektiv ligjor dhe për të parandaluar kultivimin, prodhimin, importin, eksportin dhe tranzitimin dhe për më tepër shpërndarjen e paligjshme të drogave, lëndëve psikotrope si dhe prekursorëve, Palët veçanërisht do të:

(1) njoftojnë njëra-tjetrën mbi të gjithë informacionin e rëndësishëm në lidhje me fshehjen që u bëhet këtyre lëndëve, mjetet e transportit, veprimet e personave të përfshirë në prodhimin dhe tregtimin e paligjshëm të drogave, vendet e origjinës dhe të mbërritjes të drogave, lëndëve psikotrope si dhe hollësirave të tjera të lidhura me këtë krim;

(2) shkëmbejnë informacion mbi metodat e zakonshme dhe karakteristikat e rëndësishme të trafikimit ndërkombëtar të drogës;

(3) shkëmbejnë konkluzione mbi kërkimet kriminalistike dhe kriminologjike në lidhje me trafikun dhe abuzimin e drogës;

(4) Të prodhojnë specimene të drogave dhe lëndëve psikotrope me origjinë biologjike ose etike të mundshme për t'u abuzuar në secilin vend ;

(5) Të shkëmbejnë përvoja në kontrollin e trafikut të paligjshëm të drogave, lëndëve psikotrope e prekursorëve duke patur parasysh mundësinë e abuzimit me to .

(6) Të zbatojnë masa të bashkërenduara policore të lejuara nga kuadri respektiv ligjor për të parandaluar prodhimin e paligjshëm të drogave dhe të lëndëve psikotrope ;

Neni 5

Palët do të bashkëpunojnë në hetimin dhe parandalimin e krimit të organizuar, gjatë kohës që do të :

(1) Njoftojnë njëra-tjetrën mbi informacione të rëndësishme lidhje me persona të përfshirë krimin e organizuar dhe lidhjet midis kriminelëve, strukturat midis tyre, strukturat e organizatave dhe grupeve të përfshira në veprimtari kriminale, sjellje tipike të grupeve të kriminelëve, faktet e gjetura, veçanërisht përsa i takon kohës, vendit dhe metodave të kryerjes krimeve, objektet e sulmuara, kushtet e veçanta, ligjet penale si dhe masat e marra;

(2) zbatojnë sipas kërkesës masa policore të lejuara sipas ligjit të vendit të Palës pritëse; në bazë të kësaj marrëveshje dhe kuadrit respektiv ligjor për hetime duke harmonizuar masat policore e të personelit, mbështetjen materialeve organizative;

(3) shkëmbejnë informacion dhe përvoja mbi metodat dhe format e reja të krimit ndërkombëtar.

(4) Shkëmbejnë të dhëna kriminalistike ose kriminalogjike dhe të dhëna të tjera që lidhen me krimet si dhe do të njoftojnë njëra-tjetrën mbi praktikat e hetimit, e metodologjive të tyre dhe pajisjet gjithmonë me mendimin për përmirësim;

(5) në bazë të kërkesës, shkëmbejnë eksperiencë dhe informacion mbi specimenet e provave materiale të mbledhura nga kryerja e krimeve ose të përdorura në krime;

(6) shkëmbejnë ekspertë për provovimin e luftës kundër krimit të organizuar, për trainimin e zgjerimin e trainimit në mënyrë që të rritet standarti i njohurive të veçanta të kërkuara mbi pajisjet moderne të kohës si dhe metodat e kërkuara dhe arritjet në teknologjinë e luftës kundër krimit;

(7) organizojnë sesione pune për lehtësimin e përgatitjeve dhe zbatimin e masave të koordinuara no nivelin e duhur.

Neni 6

Bashkëpunimi i Palëve do të mbulojë kryesisht:

1) shkëmbimin e informacionit në lidhje me kuadrin ligjor përsa i takon statusit dhe përmirësimit të rendit dhe sigurisë publike.

2) shkëmbimin e legjislacionit dhe përvojat përsa i takon të huajve dhe migracionit;

3) shkëmbimin e informacionit përsa i takon të ardhurave që nxirren nga krimi;

4) shkëmbejnë informacion mbi kontrabandën e mallrave;

5) shkëmbejnë informacion dhe përvojë kërkuar nga Pala tjetër, për të luftuar kundër trafikut të njerëzve si dhe për të parandaluar punësimin e paligjshëm.

Neni 7

Sipas kuadrit ligjor kombëtar në fuqi të secilës Palë përsa i takon respektimit të ruajtjes të të dhënave personale, do të mbizotërojnë kushtet e mëposhtme:

1) Të dhënat personale mund t'i dërgohen vetëm autoriteteve kompetente të përfshira në luftën kundër terrorizmit, drogës, krimit të organizuar dhe figurave të tjera të krimeve të parashikuara në këtë Marrëveshje. Dërgimi i të dhënave autoriteteve të tjera do të përbëjë objekt të një pëlqimi paraprak të Palës dërguese;

2) Sipas kërkesës së Palës dërguese, Pala marrëse do të japë të dhëna mbi përdorimin e të dhënave të marra dhe rezultateve të arritura me to;

3) pala dërguese do të shikojë korrektesën e të dhënave që do të dërgohen si dhe nevojën dhe përpjestimin e dërgimit të të dhënave të dërguara gjithmonë me sqarimin se cili është qëllimi i këtij dërgimi.

Për më tepër, nga pala tjetër do të kërkohen kushtet që kufizojnë dërgimin e të dhënave përcaktuar nga ligjet e brendshme. Nëse provohet se të dhënat e dërguara nuk janë të sakta apo nuk lejohej të dërgoheshin, duhet të njoftohet menjëherë Pala marrëse. Pala marrëse do të jetë e detyruar që të korrigjojë menjëherë ndonjë të dhënë të pasaktë ose të asgjesojë të dhënat që nuk lejohej të dërgoheshin, gjithnjë sipas konfirmimit të Palës dërguese.

4) Sipas kërkesës të dhënat do të merren nga persona të përshtatshëm për t'i mirëpërdorur ato dhe detyrimi për dërgimin e tyre bëhet vetëm sipas mandateve në bazë të ligjeve të vendit të veçantë. Informimi mbi të dhëna të veçanta do të bëhet sipas ligjeve të vendit që i dërgon këto të dhëna.

5) Pala dërguese, sipas dërgesës që bën, duhet të specifikojë afatet e zbatueshme për asgjesimin e të dhënave siç është përcaktuar në kuadrin e saj ligjor; çfarëdo lloj afatesh të caktohen, të gjitha të dhënat që dërgohen në lidhje me një person, duhet të eliminohen kur ato nuk nevojiten më. Pala dërguese duhet njoftuar pa vonesë për asgjesimin e të dhënave që do të marrë dhe arsyet për këtë gjë. Të gjitha të dhënat e marra do të asgjesohen me skadimin e kësaj Marrëveshje.

6) Të dyja Palët janë të detyruara të regjistrojnë dërgimin, marrjen dhe asgjesimin e informacioneve.

7) Palët janë të detyruara të mbrojnë me efikasitet të dhënat personale ndaj njohjes së paautorizuar, ndryshimit apo bërjes së tyre publike.

Neni 8

1) Palët do të dërgojnë si "sekret" të gjitha të dhënat e klasifikuara nga njëra nga Palët, në rast se ato klasifikohen si të tilla sipas normave ligjore të vendit dërgues.

2) Transferimi i materialeve dhe të të dhënave të dërguara sipas kësaj Marrëveshje, një Pale të tretë, do të përbëjë objekt të miratimit të organeve kompetente të Palës dërguese.

Neni 9

1) Palët do të ngrenë një Komitet të Përbashkët me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të organeve bashkëpunuese për të zbatuar këtë Marrëveshje; palët do të njoftojnë njëra-tjetrën përmes kanaleve diplomatike, mbi përbërjen e Komitetit të Përbashkët.

2) Komiteti i Përbashkët do të takohet të paktën dy herë në dy vjet. Secila nga Palët mund të kërkojë thirrjen e sesioneve të tjera nëse gjykohet si e nevojshme. Sesionet e Komtietit do të mbahen në mënyrë alternative në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Hungarisë.

3) Komiteti i Përbashkët do të ketë përgjegjësinë për lehtësimin e bashkëpunimit të parashikuar në këtë Marrëveshje dhe për kontrollin e efikasitetit të saj.

4) Shpenzimet për sesionet, përjashtuar shpenzimet e urdhëtimit, do të mbulohen nga Pala pritëse.

Neni 10

1) Secila palë mund të refuzojë pjesërisht ose plotësisht plotësimin e kërkesës, masës bashkëpunuese ose ndihmës, ose mund t'i vërë disa kushte këtij plotësimi, nëse kërkesa mund t'i kufizojë të drejtat kombëtare, mund t'i rrezikojë sigurinë ose interesa të tjera thelbësore të saj, ose mund të shkelë kuadrin e saj ligjor kombëtar.

2) Parashikimet e kësaj Marrëveshje, nuk ndikojnë mbi traktate të tjera dypalëshe ose shumëpalëshe të nënshkruara nga Republika e Shqipërisë, dhe nga Republika e Hungarisë.

Neni 11

Palët do të bien dakord për të emëruar reciprokisht një person të stafit diplomatik të ambasadave të tyre në vendin e palës tjetër, për të mbajtur kontakt me organin qendror kombëtar të palës marrëse.

Neni 12

1) Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e tridhjetë pas datës kur Palët reciprokisht të njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim përmes kanaleve diplomatike për plotësimin e procedurave të brendshme ligjore që kërkohen për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshje.

2) Palët do të nënshkruajnë këtë Marrëveshje për një kohëzgjatje të përcaktuar kohe. Secila Palë mund të shfuqizojë këtë Marrëveshje duke dhënë njoftim me shkrim përmes kanaleve diplomatike. Marrëveshja do të shfuqizohet gjashtë muaj pas datës së marrjes së këtij njoftimi nga Pala tjetër.

Hartuar në dy kopje në.....me..... në gjuhët shqip, hungareze dhe anglisht dhe që të tre tekstet janë të barazvlfeshëm. Në rast mospërputhjesh, do të merret parasysh teksti në anglisht.

LIGJ
Nr. 8624, datë 15.6.2000

PËR ADERIMIN NË "KONVENTËN E HAGËS" "PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE DHE BASHKËPUNIMIN PËR BIRËSIMET JASHTË VENDIT""

Në mbështetje të neneve 78,83 pika 1 dhe 21 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në "Konventën e Hagës "Për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit"".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2667, datë 24.6.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.18, faqe 865

KONVENTA
MBI MBROJTJEN E FËMIJËVE DHE BASHKËPUNIMIN PËR BIRËSIMET JASHTË VENDIT

Shtetet nënshkruese të kësaj Konvente;

Duke pranuar se fëmija, për zhvillimin e plotë dhe të harmonishëm të personalitetit të tij, duhet të rritet në një mjedis familjar, në një atmosferë gëzimi, dashurie dhe mirëkuptimi,

Duke rikujtuar se çdo Shtet duhet të marrë me përparësi masat e duhura për të mundësuar që fëmija të mbetet në kujdesin e familjes së tij të origjinës,

Duke pranuar se birësimi jashtë vendit mund të ofrojë avantazhin e një familjeje të përhershme për një fëmijë, për të cilin nuk mund të gjëndet një familje e përshtatshme në Shtetin e tij të origjinës,

Duke qenë të bindur për nevojën e marrjes së masave për të siguruar që birësimet jashtë vendit të bëhen në interesin më të lartë të fëmijës dhe duke respektuar të drejtat e tij themelore dhe që të parandalohet rrëmbimi, shitja ose trafikimi i fëmijëve,

Me dëshirën për të vendosur dispozita të përgjithshme për këtë qëllim, duke patur parasysh parimet e shpallura në instrumentet ndërkombëtare, sidomos në Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës, të 20 nëntorit 1989 dhe në Deklaratën e Kombeve të Bashkuara mbi Parimet Shoqërore dhe Juridike lidhur me Mbrojtjen dhe Mirëqënien e Fëmijëve, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me Vendosjen në një Familje Ushqyese dhe Birësimin Brenda dhe Jashtë Vendit (Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 41/85, e 3 dhjetorit 1986),

U morën vesh për dispozitat e mëposhtme:

KAPITULLI I
SFERA E KONVENTËS

Neni 1

Qëllimet e kësaj Konvente janë:

a) të merren masat mbrojtëse për të siguruar që birësimet jashtë vendit të bëhen në interesin më të lartë të fëmijës dhe duke respektuar të drejtate tij themelore, të përcaktuara në të drejtën ndërkombëtare;

b) të krijohet një sistem bashkëpunimi midis Shteteve Kontraktuese, për të siguruar që këto masa të respektohen dhe në këtë mënyrë të parandalohet rrëmbimi, shitja ose trafikimi i fëmijëve;

c) të sigurohet njohja në Shtetet Kontraktuese e birësimeve të bëra në përputhje me këtë Konventë.

Neni 2

1. Konventa zbatohet kur një fëmijë, i cili zakonisht banon në një Shtet Kontraktues ("Shteti i origjinës"), është shpërngulur, shpërngulet ose do të shpërngulet në një Shtet tjetër Kontraktues ("Shteti pritës"), ose pas birësimit të tij në Shtetin e origjinës, nga bashkëshortë ose nga një person që banon zakonisht në Shtetin pritës, ose për qëllime të një birësimi të tillë në Shtetin pritës ose në Shtetin e origjinës.

2. Konventa mbulon vetëm birësimet që krijojnë një marrëdhënie të përhershme prind-fëmijë.

Neni 3

Konventa nuk zbatohet më, në rast se pëlqimet e përmendura në Nenin 17 nënparagrafi c, nuk janë dhënë para se fëmija të mbushë moshën tetëmbëdhjetë vjeç.

KAPITULLI II
KËRKESAT PËR BIRËSIME JASHTË VENDIT

Neni 4

Një birësim brenda sferës së kësaj Konvente kryhet vetëm në rast se autoritetet kompetente të Shtetit të origjinës:

a) kanë përcaktuar se fëmija mund të birësohet;

b) kanë vendosur, mbasi janë shqyrtuar si duhet mundësitë për vendosjen e fëmijës brenda Shtetit të origjinës, se birësimi jashtë vendit është në interesin më të lartë të fëmijës;

c) kanë siguruar se

(1) personat, institucionet dhe autoritetet, pëlqimi i të cilëve për birësim është i domosdoshëm, janë këshilluar sipas nevojës dhe janë informuar siç duhet mbi pasojat e pëlqimit të tyre, pavarësisht nëse birësimi arrin ose jo në ndërprerjen e marrëdhënieve ligjore midis fëmijës dhe familjes së tij të origjinës,

(2) të tillë persona, institucione dhe autoritete kanë dhënë pëlqimin e tyre në mënyrë të vullnetshme, në formën e kërkuar ligjore dhe e kanë shprehur ose evidentuar atë me shkrim,

(3) pëlqimet nuk janë dhënë me pagesë ose kompensim të çdo lloji dhe nuk janë tërhequr, dhe

(4) pëlqimi i nënës kur është kërkuar, është dhënë pas lindjes së fëmijës; dhe

d) janë siguruar, në lidhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë së fëmijës se

1) ai është këshilluar dhe informuar në mënyrën e duhur për pasojat e birësimit dhe të pëlqimit të dhënë prej tij për birësim, në rast se ky pëlqim kërkohet,

2) janë pasur parasysh dëshirat dhe mendimet e fëmijës,

3) pëlqimi i fëmijës për birësim, në rastet kur ky birësim kërkohet, është dhënë në mënyrë të vullnetshme, në formë ligjore të kërkuar dhe është shprehur ose evidentuar me shkrim, dhe

4) një pëlqim i tillë nuk është bërë me pagesë apo kompensim të çdo lloji.

Neni 5

Birësimi në kuadrin e Konventës do të bëhet vetëm në rast se autoritetet kompetente të Shtetit pritës:

a) kanë vendosur që prindërit e ardhshëm birësues kanë të drejtë dhe janë të përshtashëm për të birësuar;

b) janë siguruar se prindërit e ardhshëm birësues janë këshilluar sipas nevojës; dhe

c) kanë vendosur që fëmija është autorizuar ose do të autorizohet për të hyrë dhe për të banuar përgjithmonë në atë Shtet.

KAPITULLI III
AUTORITETET QENDRORE DHE ORGANET E AKREDITUARA

Neni 6

(1) Një Shtet Kontraktues do të caktojë një Autoritet Qendror për t'i kaluar këtij autoriteti detyrimet që ka në bazë të Konventës.

(2) Shtetet Federativë, shtetet me më shumë se një sistem legjislacioni ose shtetet që kanë njësi territoriale autonome, janë të lira të caktojnë më shumë se një Autoritet Qendror dhe të përcaktojnë shtrirjen e funksioneve të tyre territoriale apo personale. Kur një Shtet ka caktuar më shumë se një Autoritet Qendror, ai cakton Autoritetin Qendror, të cilit mund t'i drejtohet njoftimi për transmetim Autoritetit Qendror përkatës brenda atij Shteti.

Neni 7

(1) Autoritetet Qendrore bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe nxisin bashkëpunimin midis autoriteteve kompetente në Shtetet e tyre, për të mbrojtur fëmijët dhe për të arritur objektivat e tjera të Konventës.

(2) Ato marrin drejtpërdrejt të gjitha masat e duhura:

(a) për të siguruar informacion lidhur me ligjet e Shteteve të tyre për birësimin dhe informacion tjetër të përgjithshëm, si ststistika dhe formularë standard;

(b) për të informuar njëri-tjetrin lidhur me funksionimin e Konventës dhe për të eliminuar sa më shumë çdo pengesë në zbatimin e saj.

Neni 8

Autoritetet Qendrore marrin të gjitha masat e nevojshme, drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet autoriteteve publike, për të parandaluar përfitime financiare ose përfitime të tjera të parregullta në lidhje me një birësim dhe për të mos lejuar asnjë praktikë që bie në kundërshtim më qëllimet e kësaj Konvente.

Neni 9

Autoritetet Qendrore marrin të gjitha masat e nevojshme, drejtpërsëdrejti ode nëpërmjet organeve të tjera të akredituara rregullisht në Shtetin e tyre, sidomos:

a) për të mbledhur, ruajtur dhe shkëmbyer informacion lidhur me gjendjen e fëmijës dhe prindërit e ardhshëm birësues, për aq sa është e nevojshme për realizimin e birësimit;

b) për të lehtësuar,ndjekur dhe shpejtuar procedurat lidhur me sigurimin e birësimit ;

c) për të nxitur dhe zhvilluar këshillimin lidhur me birësimin dhe shërbimet pas birësimit në Shtetet e tyre;

d) për t'i dhënë njëri-tjetrit rapotre vlerësimesh të përgjithshme mbi përvojën e birësimit në vende të tjera;

e) për t'iu përgjigjur kërkesave të Autoriteteve të tjera Qendrore ose autoriteteve të tjera publike, aq sa e lejon ligji i Shtetit të tyre, për informacione mbi gjendjen e një birësimi të veçantë.

Neni 10

Akreditimi u bëhet dhe mbahet vetëm nga organet që tregojnë kompetencë për të realizuar si duhet detyrat që u ngarkohen.

Neni 11

Një organ i akredituar

a) ndjek vetëm objektiva jofitimprurëse, sipas kushteve dhe caqeve të përcaktuara nga autoritetet kompetente të Shtetit akreditues;

b) drejtohet dhe ka një personel me persona të kualifikuar në normat e sjelljes dhe që kanë kualifikim ose përvojë për të punuar në fushën e birësimit jashtë vendit;dhe

c) i nënshtrohet mbikqyrjes së autoriteteve kompetente të atij Shteti lidhur me përbërjen, funksionimin dhe gjendjen financiare.

Neni 12

Një organ i akredituar në një Shtet Kontraktues mund të veprojë në një Shtet tjetër Kontraktues vetëm në rast se autoritetet kompetente të të dy Shteteve kanë autorizuar një gjë të tillë.

Neni 13

Emërimi i autoriteteve Qendrore dhe, sipas rastit, shtrirja e funksioneve të tyre, si dhe emrat dhe adresat e organeve të akredituara do t'i komunikohen nga secili Shtet Kontraktues Zyrës së Përhershme të Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private.

KAPITULLI IV
KËRKESAT PROCEDURIALE NË BIRËSIMIN JASHTË VENDIT

Neni 14

Personat që zakonisht banojnë në një Shtet Kontraktues dhe që dëshirojnë të birësojnë një fëmijë, zakonisht banues në një Shtet tjetër Kontraktues, i drejtohen Autoritetit Qendror të Shtetit ku banojnë zakonisht.

Neni 15

(1) Në rast se për Autoritetin Qendror të Shtetit pritës përmbushen kërkesat që aplikuesit kanë të drejtë dhe janë të përshtatshëm për të birësuar, ai përgatit një raport, i cili përfshin informacion mbi identitetin e tyre, të drejtën dhe përshtatshmërinë për të birësuar, mbi biografinë e tyre, mbi familjen dhe gjëndjen shëndetësore, mjedisin shoqëror, arsyet për birësim, mundësinë për të ndërmarrë një birësim jashtë vendit, si dhe karakteristikat e fëmijëve, për të cilët ata do të zgjidhen të kujdesen.

(2) Ai transmeton raportin e Autoritetit Qendror Shtetit të origjinës.

Neni 16

(1) Në rast se Autoritetin Qendror të Shtetit të origjinës përmbushen kërkesat që fëmija është i birësueshëm, ai:

a) përgatit një raport, i cili përfshin informacion mbi identitetin e tyre, përshtatshmërinë për t'u birësuar, biografinë e tyre, mjedisin shoqëror, historinë e familjes, gjendjen shëndetësore, përfshirë atë të familjes së fëmijës dhe çdo nevojë të veçantë të fëmijës;

b) i kushton vëmendjen e duhur edukimit të fëmijës dhe formimit të tij etnik, fetar dhe kulturor;

c) sigurohet që të jenë dhënë pëlqimet në përputhje me Nenin 4; dhe

d) përcakton, në bazë të raporteve të veçanta lidhur me fëmijën dhe prindërit e ardhshëm birësues, nëse vendosja është në interesat më të larta të fëmijës.

(2) Ai transmeton Autoritetin Qendror të Shtetit Pritës raportin e tij mbi fëmijën provën se janë marrë pëlqimet e nevojshme dhe arsyet e vendimit për vendosjen e fëmijës, duke treguar kujdes që të mos zbulojë identitetin e nënës dhe të babait, në rast se në shtetin e origjinës këto identitete nuk mund të deklarohen.

Neni 17

Çdo vendim në shtetin e origjinës se një fëmijë duhet t'u besohet prindërve të ardhshëm birësues, mund të merret vetëm në rast se:

a) Autoriteti Qendror i atij shteti ka dhënë sigurime se prindërit e ardhshëm birësues e pranojnë këtë;

b) Autoriteti Qendror i Shtetit pritës e ka miratuar një vendim të tillë, kur ky miratim kërkohet nga ligji i atij Shteti ose nga Autoriteti Qendror i shtetit të origjinës;

c) Autoritetet Qendrore të të dy shteteve janë marrë vesh që birësimi të kryhet dhe

(d) në përputhje me Nenin 5 është vendosur që prindërit e ardhshëm birësues kanë të drejtë

dhe janë të përshtatshëm për të birësuar dhe se fëmija është i autorizuar ose do të autorizohet për të hyrë dhe për të banuar përgjithmonë në Shtetin pritës.

Neni 18

Autoritetet Qendrore të të dy Shteteve ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshme për të siguruar lejimin e fëmijës që të largohet nga Shteti i origjinës dhe të hyjë e të banojë përgjithmonë në Shtetin pritës.

Neni 19

(1) Transferimi i fëmijës në Shtetin pritës mund të kryhet në rast se janë përmbushur kërkesat e nenit 17.

(2) Autoritetet Qendrore të të dy Shteteve sigurohen që transferimi të bëhet në rrethana të sigurta dhe të përshtatshme dhe, në rast se është mundur, me shoqërimin e prindërve birësues ose të prindërve të ardhshëm birësues.

(3) Në rast se nuk bëhet transferimi i fëmijës, raportet e përmendura në Nenet 15 dhe 16 u kthehen mbrapsht autoriteteve që i kanë dërguar.

Neni 20

Autoritetet Qendrore informojnë njëri-tjetrin lidhur me procesin e birësimit dhe masat e marra për realizimin e tij, si dhe mbi progresin e vendosjes së fëmijës, në rast se kërkohet një periudhë prove.

Neni 21

(1) Kur birësimi do të bëhet pas transferimit të fëmijës në Shtetin pritës dhe kur Autoritetit Qendror të Shtetit i duket se qëndrimi i vazhdueshëm i fëmijës me prindërit e ardhshëm birësues nuk është në interesat më të larta të fëmijës, Autoriteti Qendror merr masat e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës, në mënyrë të veçantë:

(a) për të tërhequr fëmijën nga prindërit e ardhshëm birësues dhe për të gjetur një përkujdesje të përkohshme;

(b) për të siguruar pa vonesë, në konsultim me Autoritetin Qendror të Shtetit të origjinës një kujdes alternativ për birësim ose, kur kjo nuk është e përshtatshme, një përkujdesje të përkohshme; birësimi nuk bëhet pa njoftuar më parë, në mënyrën e duhur, Autoritetin Qendror të Shtetit të origjinës lidhur me prindërit e ardhshëm birësues .

(c) për të rregulluar, si zgjidhje të fundit kthimin e fëmijës, në rast se këtë e kërkojnë interesat e tij .

(2) Duke pasur parasysh sidomos moshën dhe shkallën e pjekurisë së fëmijës, me të duhet këshilluar dhe kur është rasti, të merret pëlqimi i tij në lidhje me masat që do të merren në bazë të këtij Neni.

Neni 22

(1) Funksionet e Autoritetit Qendror në bazë të këtij Kapitulli mund të kryhen nga autoritetet publike ose nga organet publike e akredituara në bazë të Kapitullit III, në atë shkallë që e lejon legjislacioni i Shtetit të tij.

(2) Çdo Shtet Kontraktues mund t'i deklarojë organit ku është depozituar Konventa se funksionet e Autoritetit Qendror sipas neneve 15 deri 21, mund të kryhen në atë Shtet, në shkallën që lejon legjislacioni dhe duke iu nënshtruar mbikqyrjes të autoriteteve kompetente të atij Shteti edhe nga organe ose persona, të cilët:

a) plotësojnë kërkesat e integritetit, kompetencat profesionale, përvojës dhe përgjegjshmërinë të atij Shteti, dhe

b) janë të kualifikuar për normat normat e tyre morale dhe për kualifikimit ose përvojën në punë në fushën e birësimit jashtë vendit .

(3) Një shtet Kontraktues, i cili bën deklaratën e përmendur në paragafin 2 informon Zyrën e Përhershme të Konferncës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private mbi emrat dhe adresat e këtyre organeve dhe personave.

(4) Çdo shtet kontraktues mund t'i deklarojë organit ku është depozituar Konventa se birësimet e Fëmijëve që zakonisht banojnë në territorin e tij mund të bëhen vetëm në rast se funksionet e Autoriteteve Qendrore kryen në përputhje me paragrafin 1.

(5) Pavarësisht nga çdo deklaratë e bërë në bazë të paragrafit 2, raportet e dhëna për Nenet 15 dhe 16 përgatiten, në secilin rast, në përgjegjësinë e Autoritetit Qendror ose të autoriteteve apo organeve të tjera, në përputhje meë paragrafin 1.

KAPITULLI V
NJOHJA DHE PASOJAT E BIRËSIMIT

Neni 23

(1) Një birësim i vërtetuar nga Autoriteti Kompetent i Shtetit të birësimit, se është bërë në përputhje me Konventën, njihet nga veprimi i ligjit në Shtetet e tjerë Kontrakues. Vërtetimi përcakton si dhe kur është arritur marrëveshja, sipas Nenit 17, nënparagrafi (c).

(2) Secili Shtet kontraktues, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, njofton organun ku depozitohet Konventa mbi identitetin dhe funksionet e autoritetit ose autoriteteve, të cilët janë kompetentë në atë Shtet për të dhënë vërtetimin. Ai njofton gjithashtu organin ku depozitohet Konventa për çdo ndryshim në emërimin e këtyre autoriteteve.

Neni 24

Njohja e një birësimi mund të refuzohet në një Shtet Kontraktues vetëm në rast se birësimi bie në kundërshtim të hapur me politikën e tij publike, duke pasur parasysh interesat më të larta të fëmijës.

Neni 25

Çdo Palë Kontraktuese mund t'i daklarojë organit ku depozitohet Konventa se ai nuk është i detyruar sipas kësaj Konvente të njohë birësimet e bëra në përputhje me një marrëveshje të arritur në zbatim të Nenit 39, paragrafi 2.

Neni 26

(1) Njohja e një birësimi përfshin njohjen e:

a) marrëdhënieve ligjore prind-fëmijë midis fëmijës dhe prindërve të tij birësues;

b) përgjegjësinë prindërore të prindërve birësues ndaj fëmijës;

c) ndërprerjen e marrëdhënieve të mëparshme midis fëmijës dhe nënës apo babait të tij, në rast se birësimi ka një pasojë të tillë në Shtetin Kontraktues, kur është bërë.

(2) Në rastin e birësimit që ka për pasojë ndërprerjen e marrëdhënieve ligjore prind-fëmijë, fëmija gëzon në Shtetin pritës dhe në çdo Shtet tjetër Kontraktues ku birësimi njihet, të drejta të barabarta me ato që rrjedhin nga birësimet që kanë pasojë të tillë në secilin Shtet.

(3) Paragrafet e mësipërm nuk paragjykojnë zbatimin e çdo dispozite, që është më e favorshme për fëmijën dhe që është në fuqi në Shtetin Kontraktues, i cili pranon birësimin.

Neni 27

(1) Kur birësimi i lejuar në Shtetin e origjinës nuk ka për pasojë ndërprerjen e marrëdhënieve ligjore prind-fëmijë, ai mund të kthehet në një birësim të efektshëm në Shtetin, i cili njeh birësimin në bazë të Konventës:

a) në rast se ligji i Shtetit pritës lejon një gjë të tillë, dhe

b) në rast se pëlqimet e përmendura në nenin 4, paragrafet c dhe d, janë dhënë për qëllim të një birësimi të tillë.

(2) Neni 23 zbatohet ndaj vendimit që ndryshon birësimin.

KAPITULLI VI
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 28

Konventa nuk prek asnjë ligj të një Shteti të origjinës, i cili kërkon që birësimi i fëmijës, zakonisht banues brenda këtij Shteti, të bëhet në këtë Shtet ose që ndalon vendosjen ose transferimin e fëmijës në Shtetin pritës.

Neni 29

Nuk ka asnjë kontakt midis prindërve të ardhshëm birësues dhe prindërve të fëmijës apo ndonjë personi tjetër që kujdeset për fëmijën, përderisa të mos jenë plotësuar kërkesat e nenit 4, nënparagrafet a) deri në c) dhe të Nenit 5, nënparagrafi a; me përjashtim të rastit kur birësimi bëhet brenda një familjeje ose kur kontakti bëhet në përputhje me kushtet e vendosura nga autoriteti kompetent i Shtetit të origjinës.

Neni 30

(1) Autoritetet Kompetente të një Shteti Kontraktues sigurojnë që të mos jepet informacioni i mbajtur prej tyre në lidhje me origjinën e fëmijës, veçanërisht informacioni në lidhje me identitetin e prindit ose prindërve të tij, si dhe mbi historikun shëndetësor.

(2) Ata sigurojnë që fëmija apo përfaqësuesi i tij të kenë mundësi të njihen me këtë informacion, nën kujdesin e duhur, në rast se këtë e lejon ligji i atij Shteti.

Neni 31

Pa paragjykuar Nenin 30, të dhënat personale të grumbulluara ose të transmetuara në bazë të kësaj Konvente, sidomos të dhënat e përmendura në Nenet 15 dhe 16 përdoren vetëm për qëllimet, për të cilat janë mbledhur ose transmetuar.

Neni 32

(1) Asnjeri nuk duhet të nxjerrë përfitime të parregullta financiare ose përfitime të tjera nga një veprimtari që lidhet me birësimin jashtë vendit.

(2) Mund të bëhen ngarkim ose të paguhen vetëm shpenzimet e bëra, përfshirë honorare të arsyeshme profesionale, për personat që janë marrë në birësim.

(3) Drejtorët, administratorët dhe nënpunësit që janë marrë me birësimin nuk marrin shpërblim që është në mënyrë të paarsyeshme i lartë, në raport me shërbimet e kryera.

Neni 33

Një autoritet kompetent, i cili konstaton se ndonjë dispozitë e Konventës nuk është respektuar apo se ka rrezik serioz që të mos respektohet, informon menjëherë Autoritetin Qendror të Shtetit. Autoriteti Qendror përgjigjet për të siguruar marrjen e masave të nevojshme.

Neni 34

Në rast se Autoriteti Kompetent i Shtetit të cilit i drejtohet një dokument e kërkon këtë, atij duhet t'i jepet një përkthim i vërtetuar se është në përputhje me origjinalin. Në rast se nuk është vendosur ndryshe, shpenzimet e këtij përkthimi përballohen nga prindërit e ardhshëm birësues.

Neni 35

Autoritetet Kompetente të Shteteve Kontraktuese do të veprojnë me shpejtësi në procesin e birësimit.

Neni 36

Në lidhje me një Shtet, i cili ka dy ose më shumë sisteme legjislacioni për birësimin, të zbatuara në njësi të ndryshme territoriale:

a) çdo referencë për banesën e zakonshme në këtë Shtet interpretohet si referencë për banesën e zakonshme në njësinë territoriale të atij Shteti;

b) çdo referencë ndaj legjislacionit të atij Shteti interpretohet si referencë ndaj legjislacionit në fuqi në njësinë territoriale përkatëse;

c) çdo referencë ndaj autoriteteve kompetente ose ndaj autoriteteve publike të atij Shteti interpretohet si referencë ndaj atyre që janë autorizuar për të vepruar në njësinë territoriale përkatëse;

d) çdo referencë ndaj organeve të akredituara të atij Shteti interpretohet si referencë ndaj organeve të akredituara në njësinë territoriale përkatëse.

Neni 37

Në lidhje me një Shtet, i cili për birësimin ka një ose më shumë sisteme legjislacioni të zbatueshme në kategori të ndryshme personash, çdo referencë ndaj legjislacionit të atij Shteti interpretohet si referencë ndaj sistemit të legjislacionit të përcaktuar me ligj nga ai Shtet.

Neni 38

Një Shtet, brenda të cilit njësi të ndryshme territoriale kanë rregullat e tyre ligjore për birësimin, është i detyruar të zbatojë Konventën, ndërsa një Shtet me sistem legjislacioni të unifikuar nuk është i detyruar ta bëjë këtë.

Neni 39

(1) Konventa nuk prek asnjë instrument ndërkombëtar, në të cilët Shtetet Kontraktues janë Palë dhe që përmban dispozita për çështje që rregullohen nga kjo Konventë, përveç rasteve kur Shtetet Palë në këtë instrument kanë bërë një deklaratë të kundërt.

(2) Çdo Shtet Kontraktues mund të hyjë në marrëveshje me një ose më shumë Shtete të tjerë Kontraktues për të përmirësuar zbatimin e Konventës në marrëdhëniet e tyre të ndërsjellta. Këto marrëveshje mund të prishen vetëm nga dispozitat e Neneve 14 deri 16 dhe 18 deri 21. Shtetet që kanë përfunduar një marrëveshje të tillë i transmetojnë një kopje organit ku depozitohet Konventa.

Neni 40

Nuk lejohen rezerva për Konventën.

Neni 41

Konventa zbatohet në çdo rast kur një kërkesë e bazuar në Nenin 14 është marrë mbasi Konventa ka hyrë në fuqi në Shtetin Pritës dhe në Shtetin e origjinës.

Neni 42

Sekretari i përgjithshëm i Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private mbledh, në intervale të rregullta, një Komision të Posaçëm për të shqyrtuar funksionomin praktik të Konventës.

KAPITULLI VII
KLAUZOLA PËRFUNDIMTARE

Neni 43

(1) Konventa është e hapur për nënshkrim nga Shtetet Anëtare të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private në kohën e Sesionit të saj të Shtatëmbëdhjetë dhe nga Shtetet e tjera pjesëmarrëse në këtë Sesion.

(2) Ajo ratifikohet, pranohet ose miratohet dhe instrumentat e ratifikimit dhe pranimit ose miratimit depozitohen pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Hollandës, organi ku depozitohet Konventa.

Neni 44

(1) Çdo Shtet mund të aderojë në Konventë mbasi ajo të ketë hyrë në fuqi, në përputhje me Nenin 46 paragrafi 1.

(2) Instrumenti i aderimit depozitohet pranë të njëjtit organ.

(3) Ky aderim ka efekt vetëm për marrëdhëniet midis Shtetit aderues dhe atyre Shteteve Kontraktues, të cilit nuk kanë kundërshtim për aderimin e tij brenda gjashtë muajve pasi kanë marrë njoftimin e përmendur në paragrafin b) të Nenit 48. Ky kundërshtim mund të bëhet nga Shtetet edhe në kohën kur ata ratifikojnë, pranojnë ose miratojnë Konventën mbas një aderimi. Çdo kundërshtim i njoftohet organit ku depozitohet Konventa.

Neni 45

(1) Në rast se një Shtet ka dy ose më shumë njësi territoriale, në të cilat zbatohen sisteme të ndryshme legjislacioni për çështje që trajton kjo Konventë, ai mund të deklarojë në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit se kjo Konventë shtrihet në të gjitha njësitë e tij territoriale ose vetëm në njërën ose në më shumë prej tyre dhe kjo deklaratë mund të ndryshohet duke bërë në çdo kohë një deklaratë tjetër.

(2) Çdo deklaratë e tillë i njoftohet organit ku depozitohet Konventa dhe shpreh në mënyrë të qartë njësitë territoriale në të cilat zbatohet Konventa.

(3) Në rast se një Shtet nuk bën deklarata në bazë të këtij Neni, Konventa do të shtrihet në të gjitha njësitë territoriale të atij Shteti.

Neni 46

(1) Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit, mbasi kanë kaluar tre muaj nga depozitimi i instrumentit të tretë të ratifikimit, pranimit ose miratimit, që përmendet në Nenin 43.

(2) Pas kësaj Konventa hyn në fuqi:

a) për secilin Shtet që rrjedhimisht ratifikon, pranon ose miraton atë, në ditën e parë të muajit, mbasi kanë kaluar tre muaj nga depozitimi i instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit;

b) për një njësi territoriale, në të cilën është shtrirë Konventa, në përputhje me Nenin 45, në ditën e parë të muajit që vjen mbas mbarimit të tre muajve pas njoftimit që përmendet në këtë nen.

Neni 47

(1) Një Shtet Palë në këtë Konventë mund ta denoncojë atë me anën e një njoftimi me shkrim, drejtuar organit ku depozitohet Konventa.

(2) Denoncimi ka efekt në ditën e parë të muajit, mbasi kanë kaluar dymbëdhjetë muaj pas marrjes së njoftimit nga organi ku depozitohet Konventa. Kur në njoftim përcaktohet një periudhë më e gjatë për hyrjen në fuqi të denoncimit, denoncimi hyn në fuqi pas mbarimit të një periudhe të tillë më të gjatë, mbasi njoftimi të jetë marrë nga organi ku depozitohet Konventa.

Neni 48

Organi ku depozitohet Konventa njofton Shtetet Anëtarë të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private, Shtetet e tjera pjesëmarrëse në Sesionin e Shtatëmbëdhjetë dhe Shtetet që kanë aderuar, në përputhje me Nenin 44, përsa më poshtë:

a) nënshkrimet, ratifikimet, pranimet dhe miratimet e përmendura në Nenin 43;

b) aderimet dhe kundërshtimet ndaj aderimeve, që përmenden në Nenin 44;

c) datën kur Konventa hyn në fuqi, sipas Nenit 46;

d) deklaratat dhe emërimet e përmendura në Nenet 22, 23, 25 dhe 45;

e) marrëveshjet e përmendura në Nenin 39;

f) denoncimet e përmendura në Nenin 47.

Për vërtetim, të nënshkruarit, të autorizuar ligjërisht, nënshkruan këtë Konventë.

Bërë në Hagë më 29 maj 1993, në gjuhët anglisht dhe frëngjisht, duke pasur të dy tekstet vlerë të barabartë, në një kopje të vemte, e cila depozitohet në arkivat e Qeverisë së Mbretërisë së Hollandës dhe një kopje e vërtetuar e së cilës i dërgohet, nëpërmjet kanaleve diplomatike, secilit Shtet Anëtar të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtre Private në datën e Sesionit të saj të Shtatëmbëdhjetë dhe çdo Shteti tjetër që ka marrë pjesë në këtë Sesion.

LIGJ
Nr.8635, datë 6.7.2000

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS CIVILE "PËR KORRUPSIONIN"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Konventa civile "Për korrupsionin"".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2696, datë 17.7.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.22, faqe 1063

KONVENTA CIVILE PËR KORRUPSIONIN

HYRJE

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës, shtete të tjera dhe Komuniteti Europian, nënshkruese të kësaj Konvente;

Duke ditur që qëllimi i Këshillit të Europës është të arrijë një unitet më të madh ndërmjet anëtarëve të tij;

Të ndërgjegjshëm për rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit;

Duke theksuar që korrupsioni përfaqëson një rrezik të madh për shtetin ligjor, demokracinë dhe të drejtat e njeriut, pastërtinë dhe drejtësinë sociale, që pengon zhvillimin ekonomik dhe rrezikon funksionimin e drejtë dhe të duhur të ekonomisë së tregut;

Duke njohur pasojat e dëmshme financiare të korrupsionit ndaj individëve, kompanive dhe shteteve, si dhe ndaj instituconeve ndërkombëtare;

Të bindur në rëndësinë për një ligj civil që të kontribuojë në luftën kundër korrupsionit, veçanërisht duke bërë të mundur që njerëzit e dëmtuar të marrin kompensim të drejtë;

Duke kujtuar konkluzionet dhe rezolutën e 19-të (Maltë, 1994), 21-të (Republika Çeke, 1997) dhe 22-të (Moldavi, 1999) të Konferencave të Ministrave të Drejtësisë të vendeve të Europës;

Duke pasur parasysh Programin e Veprimit kundër korrupsionit të miratuar nga Komiteti i Ministrave në nëntor 1996;

Duke pasur gjithashtu parasysh studimin e fizibilitetit mbi hartimin e një konvente mbi kompensimet civile të pasojave që vijnë nga veprimet korruptive, të miratuar nga komiteti i ministrave në shkurt 1997;

Duke u mbështetur në rezolutën (97) 24 mbi 20 Parimet Drejtuese për Luftën kundër korrupsionit, miratuar nga Komiteti i Ministrave në nëntor 1997, në sesionin e tij të 101-të, në Rezolutën (98) 7 që autorizonte miratimin e Marrëveshjes së Pjesshme dhe të Zgjeruar për të ngritur "Grupin e Shteteve kundër korrupsionit", miratuar nga Komiteti i Ministrave në maj 1998, në sesionin e tij të 102-të dhe në Rezolutën (99)5 për ngritjen e Greko(GSHKK), miratuar më 1 maj 1999;

Duke kujtuar Deklaratën Përfundimtare dhe Planin e Veprimit të miratuar nga Kryetarët e Shteteve dhe Qeverive të vendeve anëtare të Këshillit të Europës në samitin II në Strasburg në tetor 1997,

Bien dakord si më poshtë:

KAPITULLI I
MASAT QË DUHEN MARRË NË RANG KOMBËTAR

Neni 1
Qëllimi

Secila palë pjesëmarrëse duhet të parashikojë në ligjin kombëtar rregullime efektive për personat që dëmtohen si rezultat i veprimeve korruptive, t'u japë atyre mundësi të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre, duke përfshirë dhe mundësinë për t'u kompensuar për dëmin.

Neni 2
Përcaktimi i korrupsionit

Për qëllimet e kësaj Konvente, fjala "korrupsion" merr kuptimin e të kërkuarit, ofrimit, dhënies ose pranimit drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë të një mitëmarrje ose çdo lloj tjetër avantazhi ose përfitimi që deformon kryerjen e çdo detyre ose sjellje të kërkuar nga pranuesi i mitëmarrjes, për pasojë dhe të avantazhit e përfitimit të padrejtë.

Neni 3
Kompensimi i dëmtimit

1. Secila palë do të parashikojë në ligjin e vet kombëtar, për personat që janë dëmtuar si rezultat i korrupsionit, të drejtën për të inicuar një veprim në mënyrë që të marrin kompensim të plotë për një dëmtim të tillë.

2. Një kompensim i tillë mund të mbulojë dëmtimin material, humbjen e përfitimeve dhe humbje jomonetare.

Neni 4
Besueshmëria

1.Secila palë do të parashikojë në ligjin e vet kombëtar plotësimin e kushteve të mëposhtme për të kompensuar të dëmtuarit:

i. i akuzuari ka kryer ose ka autorizuar aktin e korruptimit, ose ka dështuar në ndërmarrjen e hapave të duhur për të parandaluar aktin e korruptimit;

ii. akuzuesi ka pësuar dëmtimin; dhe

iii. ka një lidhje shkakësore midis aktit të korrupsionit dhe dëmit.

2. Secila palë do të parashikojë në ligjin e vet kombëtar, kur disa të akuzuar janë të mundshëm të dëmtojnë të njëjtën veprimtari korruptive, ata do të jenë përgjegjës së bashku dhe në mënyrë të ndarë.

Neni 5
Përgjegjësia e shtetit

Secila palë do të parashikojë në ligjin e vet kombëtar procedurat e duhura për personat që janë dëmtuar si pasojë e një veprimi korruptiv nga zyrtarët e tij gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, për të kërkuar kompensim nga shteti ose në rastin e një pale joshtetërore, nga autoritetet zyrtare të palës.

Neni 6
Harresa kontribuese

Secila palë do të parashikojë në ligjin e vet të brendshëm, që kompensimi të reduktohet ose të mos lejohet sipas rastit, kur i dëmtuari nga gabimet e veta ka ndihmuar dëmtimin ose keqësimin e tij.

Neni 7
Kufizimi në kohë

1. Secila palë do të parashikojë në ligjin e vet kombëtar që ecuria e përmirësimit të dëmtimit të jetë për një periudhë jo më të shkurtër se tre vjet nga dita që personi që e ka pësuar nga dëmtimi për t'u ndërgjegjësuar ose të bëhet i ndërgjegjshëm për dëmtimin e kryer ose kryerjen e veprimit korruptiv dhe të përcaktimit të personit përgjegjës. Megjithatë, ecuri të tilla nuk do të fillojnë pasi të ketë përfunduar kufizimi kohor i jo më pak se 10 vjet nga data e kryerjes së aktit korruptiv.

2. Ligjet e palëve që rregullojnë shtyrjen ose ndërprerjen e kufizimit kohor, kur është i përshtatshëm do të zbatohet për periudhën e parashikuar në paragrafin 1.

Neni 8
Vlefshmëria e kontratave

1. Secila palë do të parashikojë në ligjin e vet kombëtar që çdo kontratë ose pjesë kontrate për korrupsion të anullohet dhe të jetë e pavlefshme.

2. Secila palë do të parashikojë në ligjin e vet kombëtar mundësinë që të gjitha palët në kontratë, leja e të cilëve është shpërdoruar nga një veprim korruptiv, të kenë mundësinë e apelimit në gjykatë për ta shpallur të pavlefshme dhe në kundërshtim me të drejtën e tyre për t'u ankuar për dëmtimet.

Neni 9
Mbrojtja e punonjësve

Secila palë do të parashikojë në ligjin e vet kombëtar mbrojtjen e duhur ndaj çdo sanksioni të pajustifikuar ndaj punonjësve të cilët kanë arsye të dyshojnë për korrupsion dhe që këtë dyshim ia paraqesin personave përgjegjës ose autoriteteve.

Neni 10
Llogaritë dhe kontrolli

1. Secila palë në ligjin e vet kombëtar do të marrë masat e nevojshme që llogaritë vjetore të kompanive të kontrollohen dhe të japë një paraqitje të drejtë të situacionit financiar të kompanisë.

2. Për parandalimin e veprimeve korruptuese, secila palë do të parashikojë në ligjin e tij të brendshëm kontrollin për të konfirmuar që llogaritë vjetore paraqesin një gjendje të drejtë dhe të saktë të situacionit financiar të kompanisë.

Neni 11
Marrja e provave

Secila palë do të parashikojë në ligjin e vet të brendshëm procedura efektive që në një proces civil të merren prova që kanë dalë nga një veprim korruptiv.

Neni 12
Masat interim

Secila palë do të parashikojë në ligjin e vet të brendshëm dispozita për këto gjykata në mënyrë që të mbrojnë të drejtat dhe interesat e palëve gjatë procesit civil të një veprimi korruptiv.

KAPITULLI II
BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR DHE MONITORIMI I ZBATIMIT

Neni 13
Bashkëpunimi ndërkombëtar

Palët do të vendosin bashkëpunim efektiv për çështjet që kanë të bëjnë me procedurat civile të çështjeve të korrupsionit, sidomos për shërbimin e dokumenteve, marrjen e provave nga jashtë, juridiksionin, njohjen dhe forcimin e gjykimeve të vendeve të tjera dhe koston e gjykimit në përshtatje me dispozitat përkatëse të instrumenteve ndërkombëtare mbi bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet civile dhe tregtare në të cilën ato janë nënshkruese, si dhe në përputhje me ligjin e tyre të brendshëm.

Neni 14
Monitorimi

Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit (GSHKK – GRECO) do të monitorojë zbatimin e kësaj Konvente nga palët.

KAPITULLI III
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 15
Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për t'u nënshkruar nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës, shtetet joanëtare që kanë marrë pjesë në diskutimin e saj dhe për Komunitetin Europian.

2. Kjo Konventë duhet të ratifikohet, pranohet dhe miratohet. Instrumentet e ratifikimit, pranimit dhe miratimit do të depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

3. Konventa do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pasardhës pasi përfundon periudha tremujore nga data në të cilën katërmbëdhjetë nënshkruesit janë shprehur për Konventën sipas dispozitës në paragrafin e parë. Çdo vend nënshkrues, që nuk është anëtar i Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO) në kohën e ratifikimit, pranimit ose miratimit, do të bëhet automatikisht anëtar në datën që Konventa hyn në fuqi.

4. Përsa i përket nënshkruesit, i cili ka shprehur për të, Konventa do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit vijues pas mbarimit të periudhës tremujore pas datës që kanë shprehur pranimin për t'iu bashkuar konventës sipas dispozitës së paragrafit 1. Çdo vend nënshkrues, që nuk është anëtar i Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO) në kohën e ratifikimit, pranimit ose miratimit do të bëhet automatikisht anëtar në datën që Konventa hyn në fuqi.

5. Çdo modalitet për pjesëmarrjen e Komunitetit Europian në Grupin e Shteteve kundër

korrupsionit (GRECO) do të përcaktohet, në rast se do të jetë i nevojshëm, me anë të një marrëveshjeje me Komunitetin Europian.

Neni 16
Njohja e Konventës

1. Pas hyrjes në fuqi të Konventës, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës, pas konsultimeve me palët pjesëmarrëse në Konventë, mund të ftojë shtetet joanëtare të Këshillit dhe që nuk kanë marrë pjesë në diskutimin e saj, të atashohen në Konventë pas një vendimi të marrë nga maxhoranca, siç parashikohet në nenin 20.d të Statutit të Këshillit të Europës dhe me votim unanim të përfaqësuesve të palëve anëtare të Komunitetit.

2. Për Shtetin që i atashohet Konventës, ajo hyn në fuqi ditën e parë të muajit që vijon pas prezumimit të periudhës tremujore nga data e depozitimit të instrumentit për atashim pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Çdo shtet që i atashohet Konventës bëhet automatikisht anëtar i GRECO, në rast se nuk është bërë anëtare në kohën e atashimit, kur respektivisht konventa hyn në fuqi.

Neni 17
Rezervat

Nuk mund të bëhen rezerva për asnjërën dispozitë të kësaj Konvente.

Neni 18
Zbatimi territorial

1. Çdo shtet i Komunitetit Europian, në momentin e nënshkrimit ose kur depoziton intrumentet e tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose atashimit, mund të specifikojnë territorin ose territoret në të cilat do të zbatohet Konventa.

2. Secila palë mund, që në një datë të mëvonshme, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të zgjerojë zbatimin e kësaj Konvente edhe në territorin tjetër të përcaktuar në deklaratë. Për këto territore Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pasues të periudhës tremujore pas datës së marrjes së një deklarate të tillë nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm.

3. Çdo deklarim i bërë sipas dy paragrafëve paraardhës mund, përsa i përket territorit të përcaktuar në deklaratë, të tërhiqet me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Tërheqja bëhet e efektshme ditën e parë të muajit pasardhës të një periudhe tremujore nga data e marrjes së njoftimit nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 19
Marrëdhëniet me instrumentet dhe marrëveshjet e tjera

1. Kjo Konventë nuk ndikon në të drejtat e fituara që rrjedhin nga instrumentet shumëpalëshe përsa i përket çështjeve të veçanta.

2. Palët në Konventë mund të lidhin marrëveshje dy dhe shumëpalëshe ndërmjet tyre për çështje të parashikuara nga Konventa me qëllim për të plotësuar ose forcuar dispozitat e saj ose për të lehtësuar zbatimin e parimeve që përfshin ajo, ose për të mos paragjykuar ndaj objektivave dhe parimeve të kësaj Konvente, të angazhohen për t'i rregulluar këto çështje brenda kuadrit të një sistemi të veçantë me të cilin lidhet në çastin e hapjes së kësaj Konvente për nënshkrim.

3. Kur dy a më shumë palë kanë përfunduar një marrëveshje ose traktat, subjekt i së cilës është përmbajtja e kësaj Konvente ose kanë vendosur marrëdhëniet mbi këtë bazë ato duhet që të zbatojnë këtë marrëveshje ose traktat, ose ta përshtasin konform Konventës aktuale.

Neni 20
Amendamente

1. Amendamentet e kësaj Konvente mund të propozohen nga çdo palë dhe do t'u komunikohen nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës shteteve anëtare të Këshillit të Europës, shteteve joanëtare të Këshillit të Europës, që kanë marrë pjesë në diskutimin për këtë Konventë, Komunitetit Europian, si dhe shtetit që ka aderuar ose është ftuar për të aderuar në këtë Konventë, siç parashikohet në dispozitat e nenit 16.

2. Çdo amendament i propozuar nga ndonjë palë do t'i njoftohet Komitetit Europian mbi Bashkëpunimin Ligjor (CDCJ), i cili do t'i paraqesë Komitetit të Ministrave mendimin e tij për amendamentet e propozuara.

3. Komiteti i Ministrave shqyrton amendamentin e propozuar dhe mendimin e paraqitur nga Komiteti Europian mbi Bashkëpunimin Ligjor (CDCJ) dhe, pas konsultimeve me Palët në Konventë që nuk janë anëtarë të Këshillit të Europës, mund të miratojë amendamentin.

4. Teksti i çdo amendamenti miratohet nga Komiteti i Ministrave sipas dispozitës së paragrafit 3 të këtij neni dhe u dërgohet palëve për ta pranuar.

5. Çdo amendament i miratuar sipas paragrafit 3 të këtij neni do të hyjë në fuqi ditën e trembëdhjetë pasi palët kanë njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm mbi pranimin përkatës.

Neni 21
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Komiteti Europian mbi Bashkëpunimin Ligjor (CDCJ) i Këshillit të Europës do të informojë si për interpretimin ashtu dhe zbatimin e kësaj Konvente.

2. Kur lind ndonjë mosmarrëveshje midis palëve, qoftë për interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, do të kërkohet zgjidhja e mosmarrëveshjes me negociata ose mjet tjetër paqësor, sipas zgjedhjes së tyre, përfshi këtu paraqitjen e mosmarrëveshjes pranë Komitetit Europian mbi Bashkëpunimin Ligjor (CDCJ), pranë një gjykate arbitrazhi gjykimi i së cilës është i detyrueshëm për Palët ose në Gjykatën Ndërkombëtare, siç mund të bien dakord palët respektive.

Neni 22
Mohimi

1. Çdo palë mund, në çdo kohë, të dalë nga kjo Konventë me anë të një njoftimi dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Një dalje e tillë është e efektshme ditën e parë të muajit që vijon pas periudhës tremujore nga data e marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 23
Njoftimi

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të njoftojë shtetet anëtare të Këshillit dhe çdo nënshkrues ose palë tjetër në këtë Konventë për:

çdo nënshkrim;

depozitimin e çdo instrumenti ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi;

çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente sipas neneve 15 dhe 16;

çdo akt tjetër, njoftim ose komunikim që ka të bëjë me këtë Konventë.

Në prani të nënshkruesve, me autorizimin përkatës, nënshkruaj këtë Konventë.

Nënshkruar në Strasburg, nëntor 1999, në anglisht dhe frëngjisht, të dy tekstet identike, në një kopje e cila do të depozitohet në arkivin e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'ia transmetojë kopjet e vërtetuara çdo shteti anëtar të Këshillit të Europës, shteteve joanëtare të cilat kanë marrë pjesë në hartimin e kësaj Konvente, Komunitetit Europian, si dhe çdo shteti që ftohet për të aderuar në të.

LIGJ
Nr.8639, datë 13.7.2000

PËR RATIFIKIMIN E "KARTËS PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRËS RAJONALE TË INICIATIVËS SË BASHKËPUNIMIT PËR EUROPËN JUGLINDORE (QENDRA SECI) PËR LUFTËN KUNDËR KRIMIT NDËRKUFITAR"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Karta për organizimin dhe funksionimin e Qendrës Rajonale të Iniciativës së Bashkëpunimit për Europën Juglindore (Qendra SECI) për luftën kundër krimit ndërkufitar".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2701, datë 19.7.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.22, faqe 1078

KARTË PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRËS RAJONALE TË INICIATIVËS SË BASHKËPUNIMIT PËR EUROPËN JUGLINDORE (QENDRA SECI) PËR LUFTËN KUNDËR KRIMIT NDËRKUFITAR

OBJEKTIVAT E QENDRËS

1.1. Zhvillimi i marrëdhënieve të punës, efektive dhe të përbashkëta ndërinstitucionale në Qendrën e SECI, si ndërmjet ashtu dhe brendapërbrenda shteteve anëtare.

1.2. Palët ndërmjet ndërlidhësve (liasion officers) kërkojnë në mënyrë kooperative të identifikojnë, parandalojnë dhe luftojnë krimin ndërkufitar, me anë të këmbimit të informacionit dhe dokumenteve, si dhe veprimtarive të tjera të përshtatshme siç parashikohet në Marrëveshje.

1.3. Ndihmë për t'i paraprirë hetimeve doganore dhe kriminale të krimit ndërkufitar.

1.4. Identifikim, studim dhe propozime mbi çështjet që ndikojnë në cilësinë e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve ligjimponuese në nivel rajonal.

2. VEPRIMTARIA E PJESËMARRËSVE NË QENDËR

2.1. Veprimtaria e qendrës SECI është në përputhje me kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen SECI mbi "Bashkëpunimin për të parandaluar dhe luftuar krimin ndërkufitar".

2.2. Qendra SECI përdor procedurat standarte dhe sistemet teknike të ICPO-INILMPOI dhe Organizatës Botërore të Doganave për transmetimin, ruajtjen, kërkimin, rikuperimin dhe analizat e

kategorive të pranuara të informacionit që lidhen me krimin ndërkufitar në zbatim të vendimeve të Komitetit të Përbashkët të Bashkëpunimit.

2.3. Qendra SECI organizon takime pune speciale (ad-hoc) ndërkohë që në përshtatshmëri dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit kombëtar mbështet me kërkesën e tyre, veprimtari operacionale në shtetet pjesëmarrëse.

2.4. Me qëllim emërimin dhe heqjen e ndërlidhësve në Qendrën SECI, palët njoftojnë me shkrim Drejtorin e Qendrës, i cili më pas njofton Komitetin e Përbashkët të Bashkëpunimit.

3.VËZHGUESIT E PËRHERSHËM

3.1. Statusi i Vëzhguesit të Përhershëm miratohet nga Komiteti i Përbashkët i Bashkëpunimit.

4.STATUSI I QENDRËS

4.1. Qendra SECI i nënshtrohet marrëveshjes ndërmjet Komitetit të Përbashkët të Bashkëpunimit të Qendrës SECI dhe shtetit mikpritës.

5. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I QENDRËS

5.1. Personeli dhe struktura

5.1.1. Me dy të tretat e shumicës së Komitetit të Përbashkët të Bashkëpunimit zgjidhet një drejtor, kandidat i shteteve pjesëmarrëse, për të shërbyer për një mandat dyvjeçar, i cili është përgjegjës për menaxhimin dhe organizimin e të gjithë personelit të Qendrës së SECI. Drejtori mund të rizgjidhet për një mandat të dytë dyvjeçar, me dy të tretat e votave të shumicës, ose, me konsensus, për një mandat të tretë dyvjeçar.

5.1.2 Komiteti i Përbashkët i Bashkëpunimit, në bashkëpunim me Drejtorin përcakton Planin Strategjik (vizionin, misionin dhe standardet për realizimin) të Qendrës SECI.

5.1.3. Nga shtetet pjesëmarrëse, në Qendrën SECI, mund të atashohen ndërlidhës (nga dogana, policia dhe atashe të institucioneve përgjegjëse për kufirin).

5.1.4. Ndërtimi dhe mirëmbajtja e Qendrës SECI sigurohet nga shteti mikpritës. Personi ndihmës (teknik dhe administrativ) sigurohet nga shteti mikpritës, si dhe kur është e përshtatshme, nga shtetet pjesëmarrëse.

5.2 Financimi:

5.2.1. Përgjegjësia për financimin e buxhetit të Qendrës SECI përcaktohet nga Komiteti i Përbashkët i Bashkëpunimit.

5.2.2. Sistemi i financimit, planifikimit të buxhetit dhe mbikëqyrja e shpenzimeve përjashtohet dhe miratohet nga Komiteti i Përbashkët i Bashkëpunimit.

5.2.3. Paga e Drejtorit të Qendrës SECI financohet nga buxheti i Qendrës SECI, kufiri i së cilës përcaktohet nga Komiteti i Përbashkët i Bashkëpunimit.

Paga e ndërlidhësve paguhet nga shtetet përkatëse (dërguese).

LIGJ
Nr.8642, datë 13.7.2000

PËR RATIFIKIMIN E "KONVENTËS EUROPIANE "PËR SHTYPJEN E TERRORIZMIT""

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Konventa Europiane "Për shtypjen e terrorizmit"".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2704, datë 19.7.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.22, faqe 1087

KONVENTA EUROPIANE PËR SHTYPJEN E TERRORIZMIT
STRASBURG 27.1.1977

Seria e traktateve europiane Nr. 90

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës, nënshkruese të kësaj Konvente,

Duke konsideruar se qëllimi i Këshillit të Europës është realizimi i një bashkimi më të ngushtë midis anëtarëve të tij;

Të ndërgjegjshëm për shqetësimin gjithnjë e në rritje të shkaktuar nga rritja e akteve të terrorizmit;

Duke dëshiruar marrjen e masave efikase që autorët e akteve të tilla të mos i shpëtojnë ndjekjes penale dhe ndëshkimit;

Të bindur se ekstradimi është një mjet i veçantë efikas për të arritur këtë rezultat,

Kanë rënë dakord përsa vijon:

Neni 1

Për nevoja të ekstradimit midis shteteve kontraktuese, asnjë vepër penale që do të përmendet këtu më poshtë nuk do të konsiderohet si vepër penale politike, si vepër penale e lidhur me një vepër tjetër politike ose si vepër e frymëzuar nga qëllime politike:

a) veprat penale të përfshira në fushën e zbatimit të Konventës për shtypjen dhe marrjen e paligjshme të mjeteve fluturuese, të nënshkruar në Hagë më 16 dhjetor 1970;

b) veprat penale të përfshira në fushën e zbatimit të Konventës për shtypjen e akteve të paligjshme të drejtuara ndaj sigurisë së avionëve civilë, të nënshkruar në Montreal më 23 shtator 1971;

c) veprat e rënda penale që drejtohen kundër jetës, integritetit trupor ose lirisë së personave që gëzojnë të drejtën e mbrojtjes ndërkombëtare, duke përfshirë agjentët diplomatikë;

d) veprat penale që përmbajnë rrëmbim, marrje peng ose sekuestrim arbitrar personi;

e) veprat penale që përmbajnë përdorim bombash, granatash, raketash, armë zjarri automatike, ose letra apo pako shpërthyese në masën që ky përdorim paraqet rrezik për personat;

f) tentativa për kryerjen e një vepre penale të sipërpërmendur ose pjesëmarrja si bashkautor ose si bashkëpunëtor i një personi që kryen ose tenton të kryejë një vepër penale të tillë.

Neni 2

1. Për nevoja të ekstradimit midis Shteteve kontraktuese, Shteti kontraktues nuk mund të konsiderojë si vepër penale politike, si vepër penale e lidhur me një vepër të tillë penale ose si vepër penale e frymëzuar nga qëllime politike, çdo akt të rëndë të dhunës që nuk është parashikuar nga neni 1 dhe që drejtohet kundër jetës, integritetit trupor ose lirisë së personave.

2. Do të konsiderohet njëlloj lidhur me çdo akt të rëndë kundër pasurisë, veç atyre të parashikuara nga neni 1, kur ai ka krijuar një rrezik kolektiv të personave.

3. Do të konsiderohet njëlloj lidhur me tentativën për kryerjen e njërës nga veprat penale të lartpërmendura ose pjesëmarrja si bashkautor ose bashkëpunëtor i një personi që kryen ose tenton të kryejë një vepër penale të tillë.

Neni 3

Dispozitat e të gjithë traktateve dhe marrëveshjeve të ekstradimit të zbatueshme midis Shteteve kontraktuese, duke përfshirë këtu Konventën Europiane për Ekstradimin, lidhur me marrëdhëniet midis Shteteve kontraktuese, modifikohen në masën që ato janë të pajtueshme me këtë Konventë.

Neni 4

Për nevoja të kësaj Konvente dhe kur njëra nga veprat penale të parashikuara nga nenet 1 e 2 nuk figuron në listën e rasteve të ekstradimit në një traktat ose konventë ekstradimi në fuqi midis Shteteve kontraktues, ajo do të konsiderohet si të ishte e përfshirë në atë listë.

Neni 5

Asnjë dispozitë e kësaj Konvente nuk duhet interpretuar se passjell një detyrim për ekstradim nëse Shteti i kërkuar ka arsye serioze të besojë se kërkesa e ekstradimit, e motivuar për një vepër penale të parashikuar në nenet 1 e 2, është paraqitur me qëllim të ndjekjes ose të dënimit të një personi për shkaqe të racës, fesë, kombësisë ose opinioneve politike, ose kur gjendja e këtij personi rrezikon të rëndohet për njërën nga këto arsye.

Neni 6

1. Çdo Shtet kontraktues merr masa të nevojshme për të përcaktuar kompetencën e vet me qëllim të njohjes të një vepre penale të parashikuar nga neni 1 në rastin kur autori i dyshuar për veprën penale ndodhet në territorin e tij dhe kur Shteti nuk e ekstradon atë pasi ka marrë një kërkesë ekstradimi nga një Shtet kontraktues, kompetenca e të cilit për ndjekje penale bazohet në një rregull kompetence që ekziston edhe në legjislacionin e Shtetit të kërkuar.

2. Kjo Konventë nuk përjashton asnjë kompetencë penale të ushtruar konform ligjeve kombëtare.

Neni 7

Një Shtet kontraktues, në territorin e të cilit është zbuluar autori i dyshuar i një vepre penale të parashikuar nga neni 1, dhe që ka marrë një kërkesë ekstradimi në kushtet e përmendura në paragrafin 1 të nenit 6, nëse nuk ekstradon autorin e dyshuar të veprës penale, ia paraqet çështjen, pa asnjë përjashtim e pa asnjë vonesë të pajustifikuar, autoriteteve të veta kompetente për ushtrimin e ndjekjes penale. Këto autoritete marrin vendimin e tyre në të njëjtat kushte, si dhe për çdo vepër penale me karakter të rëndë konform ligjeve të këtij Shteti.

Neni 8

1. Shtetet kontraktuese u japin njëra-tjetrës, sa më shumë që të jetë e mundur, ndihmën gjyqësore në fushën penale në çdo procedurë lidhur me veprat penale të parashikuara nga neni 1 ose 2. Në të gjitha rastet, ligji i zbatueshëm lidhur me ndihmën e ndërsjelltë në fushën penale është ai i Shtetit të kërkuar. Megjithatë, ndihma gjyqësore nuk mund të refuzohet me motivin e vetëm që ajo ka të bëjë me një vepër penale politike ose një vepër penale të lidhur me një vepër penale të tillë ose një vepër penale të frymëzuar nga qëllime politike.

2. Asnjë dispozitë e kësaj Konvente nuk duhet interpretuar se ajo passjell detyrimin për të dhënë ndihmën gjyqësore nëse Shteti i kërkuar ka arsye serioze për të besuar se kërkesa për ndihmë, e motivuar për një vepër penale të parashikuar nga neni 1 ose 2, është paraqitur me qëllim të ndjekjes ose të dënimit të një personi për shkak të racës, fesë, kombësisë ose opinioneve politike, ose që gjendja e këtij personi rrezikon të rëndohet për njerën nga këto arsye.

3. Dispozitat e të gjitha traktateve e marrëveshjeve për ndihmë të ndërsjelltë gjyqësore në fushën penale të zbatueshme midis Shteteve kontraktuese, duke përfshirë Konventën Europiane për Ndihmën e Ndërsjelltë Gjyqësore në fushën penale, modifikohen, sa i takon marrëdhënieve midis Shteteve kontraktuese, në masën që ato pajtohen me këtë Konventë.

Neni 9

1. Komiteti Europian për problemet penale të Këshillit të Europës ndjek ekzekutimin e kësaj Konvente.

2. Ai lehtëson me aq sa nevojitet një rregullim me pajtim të çdo vështirësie që do të lindëte në ekzekutim të Konventës.

Neni 10

1. Çdo mosmarrëveshje midis Sheteve kontraktuese lidhur me interpretimin e kësaj Konvente që nuk është rregulluar në kuadër të paragrafit 2 të nenit 9, me kërkesë të njerës nga Palët në konflikt, do t'i nënshtrohet arbitrazhit. Secila nga Palët do të caktojë një arbitër dhe të dy arbitrat do të caktojnë një arbitër të tretë. Nëse, brenda një afati tremujor duke filluar nga kërkesa e arbitrazhit, njëra nga Palët nuk ka vepruar për caktimin e një arbitri, arbitri do të caktohet me kërkesë të Palës tjetër, nga Kryetari i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Nëse Kryetari i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut është shtetas i njërës prej Palëve në konflikt, caktimi i arbitrit do të bëhet nga Nënkryetari i Gjykatës, nëse Nënkryetari është shtetas i njërës nga Palët në konflikt, anëtari i Gjykatës me vjetërsi më të madhe që nuk është shtetas i njërës nga Palët në konflikt. E njëjta procedurë do të zbatohet në rast se të dy arbitrat nuk bien dakord për zgjedhjen e arbitrit të tretë.

2. Gjykata e arbitrazhit do ta marrë me vendim procedurën e vet. Vendimet e saj do të merren me shumicë votash. Vendimi do të jetë përfundimtar.

Neni 11

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim për Shtetet anëtare të Këshillit të Europës. Ajo ratifikohet, pranohet ose miratohet. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, ose miratimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Konventa do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës kur bëhen tre depozitime të instrumenteve të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

3. Ajo do të hyjë në fuqi ndaj çdo Shteti që do ta ratifikojë, pranojë ose miratojë i fundit, tre muaj pas datës së depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

Neni 12

1. Çdo Shtet mundet, në çastin e nënshkrimit ose në çastin e depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, pranimit ose miratimit, të caktojë territorin ose territoret ku do të zbatohet kjo Konventë.

2. Çdo Shtet mundet, në çastin e depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, pranimit ose miratimit ose në çdo moment tjetër më pas, të shtrijë zbatimin e kësaj Konvente, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, në çdo territor tjetër të caktuar në deklaratë dhe në të cilin ai realizon marrëdhëniet ndërkombëtare ose për të cilin ai është i autorizuar t'i realizojë.

3. Çdo deklaratë bërë në bazë të paragrafit të mëparshëm mund të tërhiqet, lidhur me çdo territor të caktuar në këtë deklaratë, me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Tërheqja do të ushtrojë efektet menjëherë ose në një datë të mëvonshme të përcaktuar në njoftim.

Neni 13

1. Çdo Shtet mundet, në çastin e nënshkrimit ose në çastin e depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, pranimit ose miratimit, të deklarojë që ai rezervon të drejtën të refuzojë ekstradimin lidhur me çdo vepër penale të renditur në nenin 1 që ai e konsideron si vepër penale politike ose vepër penale e frymëzuar nga qëllime politike, me kusht që ai të angazhohet të marrë në konsideratë në mënyrë të duhur, gjatë cilësimit të karakterit të veprës penale, karakterin e rëndësisë së veçantë, duke përfshirë:

a) që ajo ka krijuar një rrezik kolektiv për jetën, integritetin trupor, ose lirinë e personave; ose

b) që ajo ka prekur persona të huaj për nga qëllimet që është frymëzuar; ose

c) që mjete mizore ose të rrezikshme janë përdorur për realizimin e saj.

2. Çdo Shtet mund të tërheqë tërësisht ose pjesërisht rezervën e formuluar prej tij në bazë të paragrafit të mëparshëm me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës dhe që do të fillojë efektet e veta nga data e marrjes së saj.

3. Shteti që ka formuluar një rezervë në bazë të paragrafit 1 të këtij neni nuk mund të pretendojë për zbatimin e nenit 1 nga çdo Shtet tjetër; megjithatë, ai mundet, nëse rezerva është e pjesshme ose me kusht, të pretendojë për zbatimin e këtij neni në masën që ai vetë e ka pranuar.

Neni 14

Çdo Shtet kontraktues mund të denoncojë këtë Konventë duke i drejtuar një njoftim me shkrim Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Një denoncim i tillë do të ushtrojë efektet menjëherë ose në një datë të mëvonshme të përcaktuar në njoftim.

Neni 15

Konventa pushon së prodhuari efektet e veta ndaj çdo Shteti kontraktues që tërhiqet nga Këshilli i Europës ose pushon së qeni anëtar i këtij.

Neni 16

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'u njoftojë Shteteve anëtare të Këshillit:

a) çdo nënshkrim;

b) depozitimi i instrumenteve të ratifikimit, të pranimit ose të miratimit;

çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente konform nenit 11;

d) çdo deklaratë ose njoftim të marrë në zbatim të dispozitave të nenit 12;

e) çdo rezervë të formuluar bërë në zbatim të paragrafit 1 të nenit 13;

f) tërheqja e çdo rezerve të bërë në zbatim të paragrafit 2 të nenit 13;

g) çdo njoftim të marrë në zbatim të nenit 14 dhe datën në të cilën denoncimi do të marrë efektet e veta;

h) çdo pushim të efekteve të Konventës në zbatim të nenit 15.

Me këtë mirëbesim, nënshkruesit, të autorizuar rregullisht për këtë qëllim, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Strasburg, më 27 janar 1977, në frëngjisht dhe anglisht, të dy tekstet janë njëlloj të besueshëm, në një ekzemplar të vetëm që do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'u komunikojë nga një kopje të vërtetuar konform secilit nga Shtetet anëtare nënshkrues.

LIGJ
Nr. 8867, datë 14.3.2002

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË "STATUTIN E KONFERENCËS SË HAGËS PËR TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE PRIVATE"

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në "Statutin e Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3274, datë 19.3.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.9, faqe 188

STATUTI
I KONFERENCËS SË HAGËS MBI TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE PRIVATE

Hartuar në sesionin e 17-të, të zhvilluar në Hagë nga 3-31 tetor 1951

Qeveritë e vendeve të Republikës Federale të Gjermanisë, Austrisë, Belgjikës, Danimarkës, Spanjës, Finlandës, Francës, Italisë, Japonisë, Luksemburgut, Norvegjisë, Holandës, Portugalisë, Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës Veriore, Suedisë dhe Zvicrës;

Në vijim të karakterit të përhershëm të Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private;

Duke dëshiruar të vazhdojnë këtë karakter;

Duke shprehur, si përfundim, dëshirën për ta pajisur Konferencën me një statut;

Kanë rënë dakord për nenet e mëposhtme:

Neni 1

Qëllimi i Konferencës së Hagës është të punojë për njehsimin progresiv të rregullave të së drejtës ndërkombëtare private.

Neni 2

Anëtarët e Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private janë Shtetet, të cilat kanë marrë pjesë tashmë në një ose më shumë sesione të Konferencës dhe që kanë pranuar Kartën ekzistuese.

Çdo shtet, pjesëmarrja e të cilit, nga pikëpamja juridike, është e rëndësishme për veprimtarinë e Konferencës, mund të bëhet anëtar. Pranimi i anëtarëve të rinj do të vendoset nga Qeveritë e Shteteve pjesëmarrëse, nëpërmjet propozimit të njërit, ose disa prej tyre, me anë të një shumice votash, brenda një periudhe prej gjashtë muajsh nga data kur ky propozim iu është paraqitur Qeverive.

Pranimi do të bëhet përfundimtar nëpërmjet pranimit të statutit nga shteti i interesuar.

Neni 3

Komisioni i Përhershëm i Qeverisë së Holandës, i krijuar me Dekretin Mbretëror të 20 shkurtit 1987, me qëllim nxitjen e kodifikimit të së drejtës ndërkombëtare private, është i ngarkuar me detyrën e kryerjes së veprimeve të Konferencës.

Ky Komitet vepron nëpërmjet Zyrës së Përhershme për të ushtruar aktivitetin me të cilin është ngarkuar.

Ai do të kontrollojë të gjitha propozimet që kanë synim vendosjen në rendin e ditës së Konferencës. Ky Komitet do të jetë i lirë të përcaktojë veprimet që do të ndërmerren lidhur me këto propozime.

Komiteti i Përhershëm Qeveritar, pas konsultimeve me anëtarët e Konferencës, do të përcaktojë datën dhe rendin e ditës së sesionit.

Ai do t'i drejtohet vetë Qeverisë së Holandës për thirrjen e anëtarëve.

Sesioni i zakonshëm i Konferencës, parimisht, do të mbahet çdo katër vjet.

Nëse është e nevojshme, Komiteti i Përhershëm Qeveritar, me aprovimin e anëtarëve, mund t'i kërkojë Qeverisë së Holandës të thërrasë Konferencën në sesione të jashtëzakonshme.

Neni 4

Zyra e Përhershme do të ketë selinë e saj në Hagë. Ajo do të përbëhet nga Sekretari i Përgjithshëm dhe dy Sekretarë të shtetësive të ndryshme, të cilët do të caktohen nga Qeveria e Holandës nëpërmjet prezantimit të Komitetit të Përhershëm Qeveritar.

Sekretari i Përgjithshëm dhe sekretarët duhet të zotërojnë njohuri ligjore të përshtatshme dhe eksperiencë praktike.

Numri i Sekretarëve mund të rritet pas konsultimeve me anëtarët e Konferencës.

Neni 5

Sipas udhëzimeve të Komitetit të Përhershëm Qeveritar, Zyra e Përhershme është e ngarkuar me:

a) përgatitjen dhe organizimin e sesionit të Konferencës së Hagës dhe takimet e komisionit special;

b) punën e Sekretariatit të sesionit dhe takimet e pasqyruara më sipër;

c) të gjitha detyrat që janë të përfshira në aktivitetin e një sekretariati.

Neni 6

Me qëllim për të lehtësuar komunikimin ndërmjet anëtarëve të Konferencës dhe Zyrës së Përhershme, Qeveria e çdo Shteti Anëtar do të krijojë një zyrë kombëtare.

Zyra e Përhershme mund të komunikojë me të gjitha zyrat kombëtare të krijuara dhe me degët e organizatave ndërkombëtare.

Neni 7

Konferenca dhe Komiteti i Përhershëm Qeveritar, në intervalet ndërmjet sesioneve, mund të përgatisë projekte konventash ose të shqyrtojë të gjitha çështjet e së drejtës ndërkombëtare private që shfaqen, në përputhje me qëllimin e Konferencës.

Neni 8

Shpenzimet e veprimtarisë dhe mbajtjes së Zyrës së Përhershme dhe komiteteve speciale do të pjestohen mes anëtarëve të Konferencës me përjashtim të shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimet e jetesës së delegatëve të komiteteve speciale që do të mbulohen nga qeveritë e përfaqësuara.

Neni 9

Buxheti i Zyrës së Përhershme dhe Komiteteve Speciale do t'i paraqitet çdo vit përfaqësuesve diplomatikë të Shteteve Anëtare në Hagë për aprovim.

Këta përfaqësues do të përpjestojnë, midis anëtarëve, shpenzimet që janë përcaktuar në këtë buxhet për të ardhmen.

Përfaqësues diplomatikë do të takohen për këto çështje nën drejtimin e Ministrit të Punëve të Jashtme të Holandës.

Neni 10

Shpenzimet që rezultojnë nga sesioni i rregullt i Konferencës do të mbulohen nga Qeveria e Holandës.

Në rastin e sesioneve speciale, shpenzimet do të ndahen midis anëtarëve të Konferencës që janë përfaqësuar në këtë sesion.

Në të gjitha rastet, shpenzimet e jetesës dhe të udhëtimit të delegatëve do të mbulohen nga Qeveritë e tyre respektive.

Neni 11

Veprimtaria e Konferencës do të vazhdojë të vëzhgohet nga të gjitha pikëpamjet, me përjashtim kur kjo është në kundërshtim me këtë statut ose me rregulloret.

Neni 12

Këtij Statuti mund t'i bëhen amendamente nëse aprovohen nga dy të tretat e anëtarëve.

Neni 13

Parashikimet e kësaj Karte, në mënyrë që të bëhen të zbatueshme, duhet të plotësohen me rregulloret. Rregulloret do të përcaktohen nga Zyra e Përhershme dhe do t'u paraqiten Qeverive anëtare për aprovim.

Neni 14

Ky Statut do t'u paraqitet Qeverive të Shteteve, që marrin pjesë në një ose më shumë sesione të Konferencës. Ai do të hyjë në fuqi sapo të pranohet nga shumica e Shteteve të interesuara në sesionin e shtatëmbëdhjetë.

Akti i pranimit do të depozitohet pranë Qeverisë së Holandës, e cila do t'ua bëjë të njohur Qeverive që përmenden në paragrafin e parë të këtij neni. Në të njëjtën mënyrë do të veprohet në rastin e pranimit të një Shteti të ri, në bazë të aktit të pranimit të këtij shteti.

Neni 15

Çdo Shtet Anëtar mund të denoncojë këtë Statut pas një periudhe prej pesë vjetësh, pas hyrjes së tij në fuqi, sipas përmbajtjes së nenit 14 paragafi 1.

Njoftimi i denoncimit do t'i jepet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës, të paktën gjashtë muaj para mbarimit të vitit buxhetor të Konferencës dhe do të veprojë në fund të këtij viti, por vetëm për atë Shtet, i cili ka njoftuar për një gjë të tillë.

LIGJ
Nr.9230, datë 13.5.2004

PËR RATIFIKIMIN E "PROTOKOLLIT NDRYSHUES TË KONVENTËS EUROPIANE PËR SHTYPJEN E TERRORIZMIT"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Protokolli ndryshues i Konventës Europiane për shtypjen e terrorizmit".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4238, datë 8.6.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.38, faqe 2793

PROTOKOLL
PËR NDRYSHIMIN E KONVENTËS EUROPIANE PËR SHTYPJEN E TERRORIZMIT

(Miratuar nga Komiteti e Ministrave më 13 shkurt 2003 në takimin e 828 të Zëvendës ministrave)

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës, nënshkruese të këtij protokolli,

duke marrë parasysh Deklaratën e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës të 12 shtatorit 2001 dhe vendimin e tij të 21 shtatorit 2001 mbi luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar dhe Deklaratën e Vilniusit mbi bashkëpunimin zonal dhe konsolidimin e stabilitetit demokratik në Europën e zgjeruar nga Komiteti i Ministrave në sesionin e 110-të në Vilnius me 3 maj 2002;

duke marrë parasysh rekomandimin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës 1550 (2002) mbi luftën kundër terrorizmit dhe respektimin e të drejtave të njeriut;

duke marrë parasysh Asamblenë e Përgjithshme të Rezolutës së Kombeve të Bashkuara A/RES/51/210 mbi masat për eliminimin e terrorizmit ndërkombëtar dhe deklaratën bashkëngjitur si shtesë e deklaratës për masat për eliminimin e terrorizmit ndërkombëtar dhe Rezolutës së saj A/RES 49/60 mbi masat për eliminimin e terrorizmit ndërkombëtar dhe deklaratën mbi masat për eliminimin e terrorizmit ndërkombëtar bashkëngjitur asaj;

me dëshirën për forcimin e luftës kundër terrorizmit duke respektuar të drejtat e njeriut dhe duke kujtuar orientimet mbi të drejtat e njeriut dhe luftën kundër terrorizmit të aprovuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës më 11 korrik 2002;

duke ditur se për këtë qëllim do të ishte e përshtatshme të ndryshohej Konventa Europiane për shtypjen e terrorizmit (ETS Nr. 90) e hapur për nënshkrim në Strasburg më 27 janar 1977, që tani e tutje quhet "Konventa";

duke ditur se do të ishte e përshtatshme që të rishikohej lista e konventave ndërkombëtare në nenin 1 të Konventës dhe të parashikohej një procedurë e thjeshtëzuar për ta rishikuar atë si duhet;

duke ditur se do të ishte e përshtatshme që të forcohej ndjekja e zbatimit të Konventës;

duke ditur se do të ishte e përshtatshme të rishikohej regjimi i rezervave;

duke ditur se do të ishte e përshtatshme të hapet Konventa për nënshkrim për të gjitha shtetet e interesuara,

kanë rënë dakord përsa vijon:

Neni 1

1. Paragrafi hyrës i nenit 1 të Konventës bëhet paragrafi 1 i këtij neni. Te nënparagrafi b i këtij paragrafi, termi "nënshkroi" zëvendësohet nga termi "përfundoi" dhe nënpragrafët c, d , e dhe f të këtij paragrafi zëvendësohen nga nënparagrafët e mëposhtëm:

c) veprat penale brenda kuadrit të Konventës mbi parandalimin dhe dënimin e krimeve kundër personave të mbrojtur ndërkombëtarisht, duke përfshirë agjentët diplomatikë të aprovuara në Nju Jork më 14 dhjetor 1973;

d) veprat penale brenda kuadrit të Konventës Ndërkombëtare kundër marrjes së pengjeve të aprovuara në Nju Jork më 17 dhjetor 1979;

e) veprat penale brenda Konventës mbi mbrojtjen fizike të materialeve nukleare, të aprovuara në Vjenë më 3 mars 1980;

f) veprat penale brenda kuadrit të protokollit të ndalimit të akteve të paligjshme të dhunës në aeroporte që i shërbejnë Aviacionit Ndërkombëtar Civil, bërë më Montreal më 24 shkurt 1988;

2. Paragrafi 1 i nenit 1 të Konventës plotësohet nga katër nënparagrafët e mëposhtëm:

g) veprat penale brenda kuadrit të Konventës për ndalimin e akteve të paligjshme kundër sigurisë së vozitjes në det, bërë në Romë më 10 mars 1988;

h) veprat penale brenda kuadri të protokollit për ndalimin e akteve të paligjshme kundër sigurisë platformave të stacionuara në shtratin kontinetal, bërë në Romë më 10 mars 1988;

i) veprat penale brenda kuadrit të Konventës Ndërkombëtare për ndalimin e bombardimeve terroriste, miratuar në Nju Jork më 15 dhjetor 1997;

j) veprat penale brenda kuadrit të Konventës Ndërkombëtare për ndalimin e financimit të terrorizmit, miratuar në Nju Jork më 9 dhjetor 1999.

3. Teksti i nenit 1 të Konventës plotësohet me paragrafin e mëposhtëm:

2. Nëse nuk mbulohen nga konventat e renditura në paragrafin 1 për qëllimet e ekstradimit ndërmjet Shteteve Kontraktuese e njëjta gjë zbatohet jo vetëm për kryerjen e këtyre veprave penale kryesore si autor, por gjithashtu:

a) përpjekja për kryerjen e një prej këtyre veprave penale kryesore;

b) pjesëmarrja si bashkëpunëtor në kryerjen e një prej këtyre veprave penale kryesore ose përpjekja për kryerjen e çdonjërës prej tyre;

c) organizimi i kryerjes ose drejtimi i të tjerëve në kryerjen ose përpjekjen për të kryer njërën nga këto vepra penale kryesore.

Neni 2

Paragrafi 3 i nenit 2 të Konventës ndryshohet me përpilimin e mëposhtëm:

3. E njëjta zbatohet për:

a) tentativën për kryerjen e një prej veprave penale të lartpërmendura;

b) pjesëmarrjen si bashkëpunëtor në një nga veprat penale të sipërpërmendura ose në një tentativë për kryerjen e një vepre të tillë;

c) organizimin e kryerjes ose drejtimin e të tjerave në kryerjen ose përpjekjen për kryerjen e një prej veprave penale të sipërpërmendura.

Neni 3

1. Teksti i nenit 4 të Konventës bëhet paragrafi 1 i këtij neni dhe shtohet një fjali e re në fund të këtij paragrafi si më poshtë: “Shtetet Palë marrin përsipër t'i konsiderojnë këto vepra penale si vepra të ekstradueshme në çdo marrëveshje ekstradimi të lidhur më vonë ndërmjet tyre.”.

2. Teksti i nenit 4 të Konventës plotësohet me paragrafin e mëposhtëm:

“2. Kur një Shtet Palë që kushtëzon ekstradimin me ekzistencën e një marrëveshjeje, merr një kërkesë për ekstradim nga një Shtet tjetër Palë me të cilin nuk ka një marrëveshje të tillë, Shteti Palë i kërkuar, në çmimin e tij, mund ta konsiderojë këtë Konventë si bazë ligjore për ekstradimin në lidhje me veprat penale të përmendura në nenet 1 ose 2.”

Neni 4

1. Teksti i nenit 5 të Konventës bëhet paragrafi 1 i këtij neni.

2. Teksti i nenit 5 të Konventës plotësohet me paragrafët e mëposhtëm:

“2. Asnjë dispozitë e kësaj Konvente nuk interpretohet sikur i cakton shtetit të kërkuar një detyrim për ekstradim, nëse personi i kërkuar për t’u ekstraduar rrezikon t’i nënshtrohet torturës.

3. Asnjë dispozitë e kësaj Konvente nuk interpretohet sikur i cakton shtetit të kërkuar një detyrim për ekstradim, nëse personi i kërkuar për t’u ekstraduar rrezikon t’i nënshtrohet dënimit me vdekje, ose kur ligji i shtetit të kërkuar nuk lejon dënimin me burgim të përjetshëm, burgimit të përjetshëm pa pasur të drejtën e lirimit me kusht, përveç kur në bazë të marrëveshjeve të

zbatueshme për ekstradimin shteti i kërkuar është i detyruar të bëjë ekstradimin, nëse Shteti kërkues nuk jep garanci të tilla që konsiderohen nga shteti i kërkuar të mjaftueshme se dënimi me vdekje nuk do të jepet ose nëse jepet nuk do të zbatohet ose personi në fjalë nuk do t'i nënshtrohet dënimit me burgim të përjetshëm pa iu dhënë mundësia e lirimit me kusht."

Neni 5

Shtohet një nen i ri pas nenit 8 të Konventës, me përpilimin e mëposhtëm:

"Neni 9

Shtetet Palë mund të lidhin ndërmjet tyre marrëveshje dypalëshe dhe shumëpalëshe për të plotësuar dispozitat e kësaj Konvente ose për të lehtësuar zbatimin e parimeve që përmbahen në të."

Neni 6

1. Neni 9 i Konventës bëhet neni 10.

2. Paragrafi 1 i nenit 10 të ri ndryshohet me përpilimin e mëposhtëm:

"Komiteti Europian për problemet e krimit (KEPK) është përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të Konventës. KEPK:

a) mbahet i informuar në lidhje me zbatimin e Konventës;

b) bën propozime me qëllim që të lehtësojë ose të përmirësojë zbatimin e Konventës;

c) i bën rekomandime Komitetit të Ministrave, në lidhje me propozimet për ndryshime të Konventës dhe jep mendimin e vet mbi çdo propozim për ndryshimet e Konventës së paraqitur nga një Shtet Palë në pajtim me nenet 12 dhe 13;

d) me kërkesë të një Shteti Palë, shpreh mendimin e vet për çdo çështje në lidhje me zbatimin e Konventës;

e) bën çdo gjë që është e nevojshme për të lehtësuar një zgjidhje me mirëkuptim për çdo vështirësi që mund të lindë nga zbatimi i Konventës;

f) i bën rekomandime Komitetit të Ministrave, në lidhje me shtetet joanëtare të Këshillit të Europës për t'i ftuar të aderojnë në Konventë në pajtim me nenin 14 paragrafi 3;

g) i paraqet çdo vit Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës një raport mbi ndjekjen e parashikuar në këtë nen mbi zbatimin e Konventës.

3. Fshihet paragrafi 2 i nenit 10 të ri.

Neni 7

1. Neni 10 i Konventës bëhet neni 11.

2. Në fjalinë e parë të paragrafit 1 të nenit 11 të ri, fjalët "Neni 9 paragrafi 2" zëvendësohen me fjalët "Neni 10 e, ose bisedime". Në fjalinë e dytë të këtij paragrafi, fjala "dy" fshihet. Fjalitë e tjera të këtij paragrafi fshihen.

3. Paragrafi 2 i nenit 11 të ri bëhet paragrafi 6 i këtij neni. Fjalia "Kur nuk mund të krijohet një shumicë, arbitri ka të drejtën e votës vendimtare" shtohet pas fjalisë së dytë dhe në fjalinë e fundit fjalët "Vendimi i tij" zëvendësohet me fjalët "Vendimi i gjykatës".

4. Teksti i nenit 11 të ri plotësohet me paragrafët e mëposhtëm:

"2. Në rastin e mosmarrëveshjes ndërmjet Palëve, që janë shtete anëtare të Këshillit të Europës, kur një Palë nuk emëron një arbitër në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni brenda tre muajve nga kërkesa për arbitrazh, një arbitër emërohet nga Presidenti i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut me kërkesë të Palës tjetër.

3. Në rastin e mosmarrëveshjes ku përfshihet një Palë që nuk është shtet anëtar i Këshillit të Europës, kur një Palë nuk emëron një arbitër në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni brenda tre muajve nga kërkesa për arbitrazh, një arbitër emërohet nga Presidenti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë me kërkesë të Palës tjetër.

4. Në rastet e rregulluara nga paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, kur presidenti i Gjykatës përkatëse është shtetas i një prej Palëve në mosmarrëveshje, kjo detyrë kryhet nga zëvendëspresidenti i Gjykatës, dhe kur zëvendëspresidenti është shtetas i një prej Palëve në mosmarrëveshje, nga gjyqtari më i vjetër i Gjykatës që nuk është shtetas i ndonjë prej palëve në mosmarrëveshje.

5. Procedurat e parashikuara në paragrafët 2 ose 3 dhe 4 të mësipërm, zbatohet *mutatis mutandis* kur arbitrat nuk arrijnë të bien dakord për emërimin e një arbitri në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 8

Shtohet një nen i ri pas nenit të ri 11 me përpilimin e mëposhtëm:

“Neni 12

1. Ndryshimet e kësaj Konvente mund të propozohen nga çdo Shtet Palë ose nga Komiteti i Ministrave. Propozimet për ndryshime u dërgohen Shteteve Palë nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

2. Pas konsultimit me Shtetet Palë joanëtare, kur është e nevojshme me KEPK-në, Komiteti i Ministrave mund të aprovojë një ndryshim në pajtim me shumicën e parashikuar në nenin 20d të Statutit të Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës u paraqet Shteteve Palë për pranim çdo ndryshim.

3. Çdo ndryshim i pranuar në pajtim me paragrafin e mësipërm hyn në fuqi në ditën e tridhjetë pas njoftimit të Sekretarit të Përgjithshëm nga Palët për pranimin e tij.”

Neni 9

Shtohet një nen i ri pas nenit të ri 12 me përpilimin e mëposhtëm:

"Neni 13

1. Për të rishikuar listën e traktateve të nenit 1 paragrafi 1, ndryshimet mund të propozohen nga Shtetet Kontraktuese ose nga Komiteti i Ministrave. Këto propozime për ndryshime kanë të bëjnë vetëm me traktate që janë miratuar brenda Organizatës së Kombeve të Bashkuara që rregullojnë në mënyrë specifike terrorizmin ndërkombëtar dhe që kanë hyrë në fuqi. Ato u njoftohen Shteteve Palë nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

2. Pas konsultimit me Shtetet Palë joanëtare, dhe kur është e nevojshme me KEPK-në, Komiteti i Ministrave mund të miratojë një ndryshim të propozuar nga shumica e parashikuar në nenin 20d të Statutit të Këshillit të Europës. Ndryshimi hyn në fuqi pas kalimit të një periudhe një vjeçare pas datës në të cilën ai u është paraqitur Shteteve Palë. Gjatë kësaj periudhe, çdo Shtet Palë mund të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm për çdo kundërshtim për hyrjen në fuqi të ndryshimit në këtë aspekt.

3. Kur një e treta e Shteteve Palë njoftojnë Sekretarin e Përgjithshëm për një kundërshtim për hyrjen në fuqi të një ndryshimi, ky ndryshim nuk hyn në fuqi.

4. Kur njoftimi për një kundërshtim bëhet nga më pak se një e treta e Shteteve Palë, ky ndryshim hyn në fuqi për ato Shtete Palë që nuk kanë njoftuar kundërshtimin.

5. Kur një ndryshim hyn në fuqi në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni dhe një Shtet Palë ka njoftuar një kundërshtim për të, ky ndryshim hyn në fuqi për këtë Shtet Palë në ditën e parë të muajit pas datës në të cilën ai ka njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës për pranimin e tij."

Neni 10

1. Neni 11 i Konventës bëhet neni 14.

2. Në fjalinë e parë të paragrafit 1 të nenit 14 fjalët “Shtetet anëtare të Këshillit të Europës” zëvendësohen me fjalët “Shtetet anëtare dhe shtetet vëzhguese të Këshillit të Europës” zëvendësohet

me fjalët dhe në fjalinë e dytë dhe të tretë, fjalët “ose miratimi” zëvendësohen me termat “miratimi ose aderimi”.

3. Teksti i nenit 14 të ri plotësohet me paragrafin e mëposhtëm:

“3. Komiteti i Ministrave i Këshillit të Europës, pas konsultimit me KEPK-në mund të ftojë çdo shtet që nuk është anëtar i Këshillit të Europës, të ndryshëm nga ata që përmenden në paragrafin 1 të këtij neni, të aderojnë në Konventë. Vendimi merret me anë të shumicës së parashikuar në nenin 20d të Statutit të Këshillit të Europës dhe nga vota unanime e përfaqësuesve të Shteteve Palë që kanë të drejtë të jenë në Komitetin e Ministrave.”

4. Paragrafi 3 i nenit të ri 14 bëhet paragrafi 4 i këtij neni dhe fjalët “ose miraton” dhe “ose miratimit” zëvendësohen përkatësisht me fjalët “miraton ose aderon” dhe “miratim ose aderim”.

Neni 11

1. Neni 12 i Konventës bëhet neni 15.

2. Në fjalinë e parë të paragrafit 1 të nenit të ri 15, fjalët “ose miratimit” zëvendësohen me fjalët “miratimit ose aderimit”.

3. Në fjalinë e parë të paragrafit 2 të nenit të ri 15, fjalët “ose miratimit” zëvendësohen me fjalët “miratimit ose aderimit”.

Neni 12

1. Rezervat që i janë bërë Konventës para hapjes për nënshkrim të këtij protokolli nuk zbatohen për Konventën e ndryshuar nga ky protokoll.

2. Neni 13 i Konventës bëhet neni 16.

3. Në fjalinë e parë të paragrafit 1 të nenit të ri 16 fjalët “Palë në Konventë me [data e hapjes për nënshkrimin e protokollit që ndryshon Konventën]” shtohen para fjalës “mund” dhe fjalët “e protokollit që ndryshon Konventën” shtohen pas fjalës “miratim”. Shtohet një fjali e dytë pas fjalëve “motive politike” me këtë përpilim: “Shtetet Palë marrin përsipër t’a zbatojnë këtë rezervë me bazë rast pas rasti, me një vendim të arsyetuar rregullisht dhe, gjatë vlerësimit të karakterit të veprës penale, duke marrë parasysh çdo aspekt veçanërisht serioz të saj, duke përfshirë:”. Pjesa tjetër e fjalisë fshihet me përjashtim të nënparagrafëve a, b, dhe c.

4. Teksti i nenit të ri 16 plotësohet me paragrafin e mëposhtëm:

“2. Kur zbaton paragrafin 1 të këtij neni, një Shtet Palë tregon veprat penale për të cilat zbatohet rezerva e tij.”

5. Paragrafi 2 i nenit të ri 16 bëhet paragrafi 3 i këtij neni. Në fjalinë e parë të këtij paragrafi termi “Palë” shtohet para fjalës “Shtet” dhe fjalët “paragrafi i mësipërm” zëvendësohet me fjalët “paragrafi 1”.

6. Paragrafi 3 i nenit të ri 16 bëhet paragrafi 4 i këtij neni. Në fjalinë e parë të këtij paragrafi termi “Palë” shtrohet para fjalës “Shtet”.

7. Teksti i nenit të ri 16 plotësohet me paragrafët e mëposhtëm:

“5. Rezervat e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni qëndrojnë në fuqi për një periudhë trivjeçare nga dita e hyrjes në fuqi e kësaj Konvente në lidhje me shtetin përkatës. Megjithatë këto rezerva mund të rinovohen me afate kohore të njëjta.

6. Dymbëdhjetë muaj para datës së shfuqizimit të rezervës, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës njofton në lidhje me këtë Shtetin Palë përkatës. Jo më vonë se tre muaj para shfuqizimit, Shteti Palë njofton Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës se ai mban në fuqi ndryshon ose tërheq rezervën. Kur një Shtet Palë njofton Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës se ai e mban në fuqi rezervën, ai jep një shpjegim në lidhje me arsyet që justifikojnë vazhdimin. Në mungesë të njoftimit nga Shteti Palë, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës e njofton atë Shtet Palë se rezerva e tij konsiderohet të jetë zgjatur automatikisht për një periudhë gjashtëmujore. Kur ky Shtet Palë nuk e bën të ditur synimin e tij për mbajtjen në fuqi ose ndryshimin e rezervës para kalimit të këtij afati, kjo bën që rezerva të humbë fuqinë.

7. Kur një Shtet Palë, pas marrjes së një kërkese për ekstradim nga një Shtet tjetër Palë, nuk ekstradon një person në zbatim të një rezerve bërë në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, ai ua paraqet çështjen pa përjashtim dhe pa asnjë vonesë të panevojshme organeve të tij kompetente për qëllimin e ndjekjes penale, përveç kur shteti kërkues dhe shteti i kërkuar bien dakord ndryshe. Organet kompetente, për qëllimin e ndjekjes penale në shtetin e kërkuar, e marrin vendimin e tyre në të njëjtën mënyrë si në rastin e një vepre penale e një natyre serioze sipas ligjit të atij shteti. Shteti i kërkuar ua njofton rezultatin përfundimtar të gjykimit pa ndonjë vonesë të panevojshme shtetit kërkues dhe Sekretari i Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të cilët ia paraqesin konferencës së parashikuar në nenin 17.

8. Vendimi i refuzimit të kërkesës për ekstradim mbi bazën e një rezerve, bërë në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, i paraqitet menjëherë shtetit kërkues. Nëse brenda një kohe të arsyeshme në shtetin e kërkuar nuk është marrë asnjë vendim gjyqësor mbi thelbin e çështjes në pajtim me paragrafin 7, shteti kërkues mund t'ia njoftojë këtë fakt Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, i cili ia paraqet çështjen Konferencës së parashikuar në nenin 17. Kjo konferencë e merr çështjen në shqyrtim dhe lëshon një opinion në lidhje me përputhjen e refuzimit me Konventën dhe ia paraqet atë Komitetit të Ministrave për qëllimin e lëshimit të një deklarate mbi këtë çështje. Gjatë kryerjes së funksioneve sipas këtij paragrafi, Komiteti i Ministrave e zhvillon mbledhjen me përbërje të kufizuar të Shteteve Palë.".

Neni 13

Shtohet një nen i ri pas nenit 16 të ri të Konventës me përpilimin e mëposhtëm:

"Neni 17

1. Pa ndikuar në zbatimin e nenit 10, një konferencë e Shteteve Palë kundër terrorizmit (tani e tutje quhet "COSTER") është e përgjegjshme për të siguruar:

a) përdorimin dhe operimin e efektshëm të kësaj Konvente duke përfshirë indentifikimin e çdo problemi për këtë, në lidhje të ngushtë me KEPK-në;

b) shqyrtimin e rezervave të bëra më pajtim me nenin 16 dhe veçanërisht procedurën e parashikuar në nenin 16 paragrafi 8;

c) shkëmbimin i informacionit mbi zhvillimet e rëndësishme ligjore dhe politike në lidhje me luftën kundër terrorizmit;

d) shqyrtimin, me kërkesë të Komitetit të Ministrave, të masave të miratuara brenda Këshillit të Europës në fushën e luftës kundër terrorizmit dhe, kur është e përshtatshme, përpilimin e propozimeve për masa shtesë që janë të nevojshme për përmirësimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e luftës kundër terrorizmit dhe kur bëhet fjalë për bashkëpunimin për çështje penale, në konsultim me KEPK-në;

e) përgatitjen e mendimeve në fushën e luftës kundër terrorizmit dhe zbatimin e kushteve të referencës të dhëna nga Komiteti i Ministrave.

2. COSTER-i përbëhet nga një ekspert i emëruar nga secili Shtet Palë. Ai i zhvillon takimet një herë në vit rregullisht dhe përjashtimisht me kërkesë të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës ose të paktën e një të tretës së Shteteve Palë.

3. COSTER-i miraton rregullat e veta procedurale. Shpenzimet për pjesëmarrjen e Shteteve Palë që janë shtete anëtare të Këshillit të Europës, mbulohen nga Këshilli i Europës. Sekretariati i Këshillit të Europës ndihmon COSTER-in për kryerjen e funksioneve të tij në pajtim me këtë nen.

4. KEPK-ja informohet periodikisht në lidhje me punën e COSTER-it.

Neni 14

Neni 14 i Konventës bëhet neni 18.

Neni 15

Neni 15 i Konventës fshihet.

Neni 16

1. Neni 16 i Konventës bëhet neni 19.

2. Në fjalinë hyrëse të nenit të ri 19, fjalët “Shtetet anëtare të Këshillit” zëvendësohet me fjalët “Shtetet Palë”.

3. Në paragrafin b të nenit të ri 19, fjalët “ose miratim” zëvendësohen me fjalët “miratim ose aderim”.

4. Në paragrafin c të nenit të ri 19, numri “11” bëhet “14”.

5. Në paragrafin d të nenit të ri 19, numri “12” bëhet “15”.

6. Paragrafët e dhe f të nenit të ri 19 fshihen.

7. Paragrafi g i nenit të ri 19 bëhet paragrafi e i këtij neni dhe numri “14” bëhet “18”.

8. Paragrafi h i nenit të ri 19 fshihet.

Neni 17

1. Ky protokoll është i hapur për t’u nënshkruar nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës nënshkruese të Konventës, të cilat mund të shprehin pëlqimin e tyre se marrin përsipër detyrimin nëpërmjet:

a) nënshkrimit pa rezervë për ratifikimin, pranimin ose miratimin;

b) nënshkrimit që i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit që pasohet nga ratifikimi, pranimi ose miratimi.

2. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Këshilli të Europës.

Neni 18

Ky protokoll hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas kalimit të një periudhe trimujore pas datës në të cilën të gjitha Palët e Konventës kanë shprehur pëlqimin e tyre se marrin përsipër detyrimet e këtij protokolli, në pajtim me dispozitat e nenit 17.

Neni 19

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës u njofton shteteve anëtare të Këshillit të Europës:

a) çdo nënshkrim;

b) depozitimin i instrumenteve të ratifikimit, të pranimit ose të miratimit;

c) datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, në pajtim me nenin 18;

d) çdo akt, njoftim ose komunikim tjetër në lidhje me këtë protokoll.

Si dëshmi i kësaj, nënshkruesit, duke qenë të autorizuar rregullisht, kanë nënshkruar këtë Protokoll.

Bërë në Strasburg më …./…, në frëngjisht dhe anglisht, të dy tekstet janë njëlloj autentike, në një kopje të vetme të cilat depozitohen në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshilli të Europës u dërgon të gjitha shteteve nënshkruese kopje të vërtetuara.

LIGJ
Nr.8646, datë 20.7.2000

PËR RATIFIKIMIN E "KONVENTËS EUROPIANE "PËR PASTRIMIN, DEPISTIMIN, KAPJEN DHE KONFISKIMIN E PRODUKTEVE TË KRIMIT""

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Konventa Europiane "Për pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit"".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2708, datë 28.7.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.23, faqe 1183

KONVENTA
MBI PASTRIMIN, DEPISTIMIN, KAPJEN DHE KONFISKIMIN E PRODUKTEVE TE KRIMIT

Strasburg, 8.XI.1990
Seria e traktateve evropiane Nr. 141

HYRJE

Shtetet anëtarë të Këshillit të Evropës dhe Shtetet e tjerë nënshkrues të kësaj Konvente,

Duke konsideruar se qëllimi i Këshillit të Evropës është realizimi i një bashkimi më të ngushtë midis anëtarëve të saj;

Të bindur për domosdoshmërinë e ndjekjes së një politike penale të përbashkët që synon mbrojtjen e shoqërisë;

Duke konsideruar se lufta kundër kriminalitetit të rëndë, që është bërë gjithnjë e më shumë problem ndërkombëtar, kërkon përdorimin e metodave moderne dhe efikase në shkallë ndërkombëtare;

Duke çmuar se njëra nga këto metoda konsiston në privimin e kriminelëve nga produktet e krimit;

Duke konsideruar se me qëllim të arritjes të këtij objektivi, duhet të ngrihet një sistem i kënaqshëm bashkëpunimi ndërkombëtar;

Ranë dakord përsa vijon:

KREU I
TERMINOLOGJIA

Neni 1
Terminologjia

Në kuptim të kësaj Konvente, shprehja:

a. “produkt” tregon çdo avantazh ekonomik të nxjerrë nga veprat penale. Ky avantazh mund të konsistojë në çdo pasuri ashtu siç përcaktohet në nënparagrafin b të këtij neni;

b. “pasuri” do të thotë pasuri të çdo natyre, qoftë trupore ose jotrupore, e luajtshme ose e paluajtshme, si dhe aktet juridike ose dokumentet që vërtetojnë një titull ose një të drejtë mbi këtë pasuri;

c. “instrument” do të thotë të gjitha objektet e përdorura ose të destinuara për t’u përdorur me çfarëdo mënyre qoftë, plotësisht ose pjesërisht, për të kryer një ose disa vepra penale;

d. “konfiskim” do të thotë dënim ose masë e urdhëruar nga një gjykatë pas një procedimi lidhur me një ose disa vepra penale, dënim ose masë që përfundon me privimin e përhershëm të pasurisë;

e. “vepër penale kryesore” do të thotë çdo vepër penale në vijim të së cilës janë krijuar produkte dhe që mund të bëhen objekt i një vepre penale sipas nenit 6 të kësaj Konvente.

KREU II
MASAT QË DUHEN MARRË NË SHKALLË KOMBËTARE

Neni 2
Masat e konfiskimit

1. Çdo Palë përshtat masat ligjore dhe masat e tjera që rezultojnë të nevojshme për t’i lejuar asaj konfiskimin e instrumenteve dhe produkteve ose pasurive, vlera e të cilave u përket këtyre produkteve.

2. Çdo Palë mundet, në çastin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose të aderimit, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, të deklarojë se paragrafi 1 i këtij neni zbatohet vetëm për vepra penale ose kategori veprash penale të saktësuara në deklaratë.

Neni 3
Masat hetimore dhe masat e përkohshme

Çdo Palë përshtat masat ligjore dhe masat e tjera që rezultojnë të nevojshme për t’i lejuar asaj të identifikojë dhe të kërkojë pasuritë që i nënshtrohen konfiskimit konform nenit 2, paragrafi 1, dhe të parandalojë çdo veprim, çdo transfertë ose çdo tjetërsim lidhur me këto pasuri.

Neni 4
Kompetenca dhe teknika hetimi

1. Çdo Palë përshtat masat ligjore dhe masat e tjera që rezultojnë të nevojshme t’u dhënë atribute gjykatave ose autoriteteve të tjera kompetente për të urdhëruar marrjen në dorë të dosjeve bankare, financiare ose tregtare për të realizuar masat e parashikuara në nenet 2 e 3. Pala nuk mund të ngrejë çështjen e sekretit bankar për të refuzuar që t’u japë efekt dispozitave të këtij neni.

2. Çdo Palë merr parasysh të përshtasë masat ligjore dhe masat e tjera për t’i lejuar asaj përdorimin e teknikave speciale të hetimit që lehtësojnë identifikimin dhe kërkimin e produktit si dhe grumbullimin e provave që kanë të bëjnë me të. Ndër këto teknika, mund të përmenden urdhërat për mbikqyrjen e llogarive bankare, vrojtimi, kapja e telekomunikimeve, hyrja në sistemet informatike dhe urdhërat për të lëshuar dokumente specifike.

Neni 5
Ankimet ligjore

Çdo Palë përshtat masat ligjore dhe masat e tjera që rezultojnë të nevojshme me qëllim që personat e prekur nga masat e parashikuara nga nenet 2 e 3 të kenë të drejtë për t'u ankuar në rrugë gjyqësore për të mbrojtuar të drejtat e tyre.

Neni 6
Vepra penale e pastrimit

1. Çdo Palë përshtat masat ligjore dhe masat e tjera që rezultojnë të nevojshme për t'i atribuar aktit karakterin e veprës penale konform të drejtës së brendshme kur akti është kryer qëllimisht për:

a. kthimin ose transfertin e pasurive, për të cilat, ai që i bën, e di që këto pasuri përbëjnë produkte me qëllim që të fshihet ose të maskohet origjina e paligjshme e pasurive të tilla ose që ndihmon çdo person që është i ngatërruar në kryerjen e veprës penale kryesore për t'u shpëtuar pasojave juridike të akteve të tij;

b. fshehja ose maskimi i natyrës, origjinës, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes ose pronësisë reale të pasurive ose të drejtave të lidhur me to, për të cilat autori është në dijeni që këto pasuri përbëjnë produkte;

dhe, me rezervën e parimeve kushtetuese të saj dhe të koncepteve themelorë të sistemit juridik;

c. të fituarit, mbajtja ose përdorimi i pasurive, të cilat, ai që i fiton, i mban ose i përdor, është në dijeni, në kohën kur ai i merr, se ato përbëjnë produkte;

d. pjesëmarrja në njërën nga veprat penale të treguara konform këtij neni ose çdo shoqërim, marrëveshje, tentativë ose bashkëpunim me anë të dhënies të pranisë, të ndihmës ose të këshillave për kryerjen.

2. Me qëllim të realizimit ose të zbatimit të paragrafit 1 të këtij neni:

a. nuk merret parasysh fakti që vepra penale kryesore është ose jo në kompetencë të juridiksioneve penale të Palës;

b. mund të parashikohet se veprat penale të shpallura nga ky paragraf nuk zbatohen ndaj autorëve të veprës penale;

c. pasja dijeni, qëllimi ose motivimi, të nevojshëm si elementë të veprave penale të shpallura nga ky paragraf, mund të nxirren nga rrethanat faktike objektive.

3. Çdo Palë mund të përshtasë masat që ajo i çmon të nevojshme për t'u dhënë, në bazë të së drejtës së brendshme, karakterin e veprave penale tërësisë ose pjesës së akteve të përmendura në paragrafin 1 në njerin ose në tërësinë e rasteve të mëposhtëm, kur autori:

a. duhej t'a dinte se pasuria ishte produkt;

b. ka vepruar për qëllime fitimprurëse;

c. ka vepruar për të lehtësuar vazhdimin e një veprimtarie kriminale.

4. Çdo Palë mundet, në çastin e nënshkrimit ose në çastin e depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose të aderimit, me deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, të deklarojë se paragrafi 1 i këtij neni zbatohet vetëm për veprat penale kryesore ose kategori veprash penale kryesore të saktësuara në këtë deklaratë.

KREU III
BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Ndarja 1 – Parimet e bashkëpunimit ndërkombëtar

Neni 7

Parimet e përgjithshme dhe masat e bashkëpunimit ndërkombëtar

1. Palët bashkëpunojnë me njëra-tjetrën sa më shumë që të jetë e mundur me qëllim të hetimeve dhe procedimeve që synojnë konfiskimin e instrumenteve dhe të produkteve.

2. Çdo Palë përshtat masat ligjore dhe masat e tjera që do të jenë të nevojshme për t'i lejuar asaj, me kushtet e parashikuara në këtë kre, t'u përgjigjet kërkesave:

a. për konfiskimin e pasurive të caktuara që përbëjnë produkte ose instrumente, si dhe për konfiskimin e produkteve që përbëjnë detyrimin për të paguar një shumë parash që i korrespondon vlerës së produktit;

b. për ndihmën e ndërsjellë për qëllim të hetimit dhe të masave të përkohshme që kanë për qëllim njërën nga format e konfiskimit të përmendura në pikën "a" këtu me sipër.

Ndarja 2 – Ndihma e ndërsjellë për qëllime hetimi

Neni 8

Detyrimi për ndihmë të ndërsjellë

Palët, me kërkesë, u japin njëra-tjetrës, sa më shumë që të jetë e mundur, ndihmën e ndërsjellë për identifikimin dhe depistimin e instrumenteve, produkteve dhe pasurive që lidhen me konfiskimin. Kjo ndihmë e ndërsjellë konsiston në çdo masë që ka të bëjë me vendosjen e masës siguruese të provave lidhur me ekzistencën e pasurive të lartpërmendura, vendndodhjen ose zhvendosjen e tyre, natyrën, statusin juridik ose vlerën e tyre.

Neni 9

Ekzekutimi i ndihmës së ndërsjellë

Ndihma e ndërsjellë e parashikuar në nenin 8 ekzekutohet sipas të drejtës së brendshme të Palës së kërkuar dhe, në bazë të kësaj, dhe sipas procedurave të saktësuara në kërkesë, në masën që ato nuk janë në kundërshtim me këtë të drejtë të brendshme.

Neni 10

Transmetimi i informacioneve me nismë vetjake

Pa cenuar hetimet ose procedimet e veta, Pala mundet, edhe pa kërkesë paraprake, t'i transmetojë një Pale tjetër informacione për instrumentet dhe produktet kur ajo çmon se komunikimi i këtyre informacioneve mund të ndihmojë Palën marrëse për fillimin ose mbarëvajtjen e hetimeve ose të procedimeve, ose kur këto informacione mund të përfundojnë me një kërkesë të formuluar nga kjo Palë në bazë të këtij kreu.

Ndarja 3 – Masa të përkohshme

Neni 11

Detyrimi për të urdhëruar marrjen e masave provizore

1. Me kërkesë të një Pale që ka filluar një procedim ose një veprim për konfiskim, Pala merr masat e përkohshme që i kërkon rasti, të tilla si ngrirja ose kapja, për të parandaluar çdo veprim, çdo transfertë ose çdo tjetërsim lidhur me çdo pasuri që, më pas, mund të bëhet objekt i një kërkese konfiskimi ose që mund t'i japë rrugë plotësimit të kërkesës.

2. Pala që ka marrë një kërkesë konfiskimi konform nenit 13 merr masat e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, kur për këtë është bërë kërkesa, lidhur me çdo pasuri që është objekt i kërkesës ose që mund t'i'japë rrugë plotësimit të kërkesës.

Neni 12
Ekzekutimi i masave të përkohshme

1. Masat e përkohshme të parashikuara në nenin 11 ekzekutohen konform të drejtës së brendshme të Palës së kërkuar dhe në bazë të kësaj, dhe konform procedurave të saktësuara në kërkesë në masën që ato nuk janë të papajtueshme me të drejtën e brendshme.

2. Para se të hiqet çdo masë e përkohshme që është marrë konform këtij neni, Pala e kërkuar, brenda mundësive, i jep Palës kërkuese mundësinë të paraqesë arsyet në favor të mbajtjes së masës.

Ndarja 4 – Konfiskimi

Neni 13
Detyrimi për konfiskim

1. Pala që ka marrë nga një Palë tjetër një kërkesë konfiskimi lidhur me instrumentet ose produktet që ndodhen në territorin e saj duhet:

a. të ekzekutojë vendimin e konfiskimit që del nga një gjykatë e Palës kërkuese lidhur me këto instrumente ose këto produkte; ose

b. t'ia paraqesë këtë kërkesë autoriteteve të veta kompetente për të marrë një vendim konfiskimi dhe, kur ky është dhënë, atëherë ai ekzekutohet.

2. Me qëllim të zbatimit të paragrafit 1.b të këtij neni, çdo Palë ka kompetencë, nëse e lyp nevoja, të fillojë një procedim konfiskimi në bazë të së drejtës së vet të brendshme.

3. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni zbatohen gjithashtu për konfiskimin lidhur me detyrimin për të paguar një shumë parash që i korrespondon vlerës së produktit, nëse pasuritë mbi të cilat mund të bëhet konfiskimi ndodhen në territorin e Palës së kërkuar. Në raste të tilla, duke proceduar me konfiskimin konform paragrafit 1, Pala e kërkuar, kur pagesa nuk është bërë, mbulon kreditimin e saj me çdo pasuri të disponueshme për këtë qëllim.

4. Kur kërkesa për konfiskim cakton një pasuri të përcaktuar, Palët mund të merren vesh që Pala e kërkuar të mund të procedojë për konfiskimin në formën e një detyrimi për të paguar një shumë parash që i korrespondon vlerës së pasurisë.

Neni 14
Ekzekutimi i konfiskimit

1. Procedurat për marrjen dhe ekzekutimin e konfiskimit në bazë të nenit 13 rregullohen sipas ligjit të Palës së kërkuar.

2. Pala e kërkuar konsiderohet e lidhur nga konstatimi i fakteve në masën që këto janë paraqitur në një dënim ose vendim gjyqësor të Palës kërkuese, ose në masën që këto mbështeten në mënyrë implicite në to.

3. Çdo Palë mundet, në çastin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumenteve të saj të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose të aderimit, me një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, të deklarojë se paragrafi 2 i këtij neni zbatohet vetëm me rezervën e parimeve kushtetuese dhe koncepteve themelorë të sistemit të vet juridik.

4. Kur konfiskimi konsiston në detyrimin për të paguar një shumë parash, autoriteti kompetent i Palës së kërkuar e konverton shumën në devizë të vendit të vet sipas kursit të këmbimit në fuqi në çastin kur merret vendimi i ekzekutimit të konfiskimit.

5. Në rastet e parashikuara në nenin 13, paragrafi 1.a, vetëm Pala kërkuese ka të drejtë të vendosë lidhur me çdo kërkesë rishikimi të vendimit të konfiskimit.

Neni 15
Pasuri të konfiskuara

Pala e kërkuar disponon sipas të drejtës së saj të brendshme për të gjitha pasuritë e konfiskuara prej saj, veç kur Palët janë marrë vesh ndryshe.

Neni 16
E drejta e ekzekutimit dhe shuma maksimale e konfiskimit

1. Kërkesa për konfiskim bërë konform nenit 13 nuk prek të drejtën e Palës kërkuese të ekzekutojë vetë kërkesën për konfiskim.

2. Asgjë nuk do të interpetohet në këtë Konventë sikur kjo të lejojë që vlera totale e pasurive të konfiskuara të jetë më e madhe se shuma e fiksuar me vendimin e konfiskimit. Kur një Palë konstaton se kjo mund të ndodhë, Palët përkatëse bëjnë konsultime për të shmangur një rrjedhojë të tillë.

Neni 17
Burgimi si masë shtrënguese

Pala e kërkuar nuk mund të vendosë burgimin si masë shtrënguese dhe as të marrë ndonjë masë tjetër kufizuese të lirisë në zbatim të një kërkese të paraqitur në bazë të nenit 13 kur Pala kërkuese nuk e ka specifikuar këtë në kërkesë.

Ndarja 5 – Refuzimi dhe shtyrja e bashkëpunimit.

Neni 18
Motivet e refuzimit

1. Bashkëpunimi në bazë të këtij kreu mund të refuzohet në rast se:

a. masa e kërkuar është në kundërshtim me parimet themelorë të rendit juridik të Palës së kërkuar; ose

b. ekzekutimi i kërkesës rrezikon të prekë sovranitetin, sigurinë, rendin publik ose interesa të tjera thelbësorë të Palës së kërkuar; ose

c. pala e kërkuar çmon se rëndësia e çështjes me të cilën ka të bëjë kërkesa nuk justifikon marrjen e masës së kërkuar; ose

d. vepra penale, me të cilën lidhet kërkesa, është vepër penale politike ose fiskale; ose

e. pala e kërkuar konsideron se masa e kërkuar do të binte në kundërshtim me parimin “ne bis in idem”; ose

f. vepra penale me të cilën lidhet kërkesa nuk është vepër penale në vështrim të së drejtës së brendshme të Palës së kërkuar nëse ajo do të ishte kryer në territorin e juridiksionit të saj. Megjithatë, ky motiv refuzimi zbatohet për bashkëpunimin e parashikuar nga ndarja 2 vetëm në masën që ndihma e ndërsjellë e kërkuar passjell marrjen e masave shtrënguese.

2. Bashkëpunimi i parashikuar në ndarjen 2, në masën që ndihma e ndërsjellë e kërkuar passjell marrjen e masa shtrënguese, dhe ai i parashikuar në seksionin 3 të këtij kreu, mund të refuzohen gjithashtu në rastet kur masat e kërkuara nuk mund të merren në bazë të së drejtës së brendshme të Palës së kërkuar për qëllime hetimesh ose procedimesh, nëse kjo Palë do të kishte një çështje të brendshme të ngjashme.

3. Kur e kërkon legjislacioni i Palës së kërkuar, bashkëpunimi i parashikuar në ndarjen 2, në masën që ndihma e ndërsjellë passjell marrjen e masave shtrënguese, dhe ai i parashikuar në seksionin 3 të këtij kreu mund të refuzohen gjithashtu në rastet kur masat e kërkuara ose të gjitha masat e tjera që kanë efekte analoge nuk lejohen nga legjislacioni i Palës kërkuese, ose, sa i takon autoriteteve kompetente të Palës kërkuese, kur kërkesa nuk është autorizuar as nga gjyqtari as nga një autoritet tjetër gjyqësor, duke përfshirë këtu edhe prokurorin publik, autoritete që veprojnë në fushë të veprave penale.

4. Bashkëpunimi i parashikuar në ndarjen 4 të këtij kreu mud të refuzohet gjithashtu kur:

a. legjislacioni i Palës së kërkuar nuk parashikon konfiskimin për tipin e veprës penale, me të cilën ka të bëjë kërkesa; ose

b. pa dëmtuar detyrimin sipas nenit 13, paragrafi 3, ai do të binte ndesh me parimet e të drejtës së brendshme të Palës së kërkuar përsa i përket mundësive të konfiskimit lidhur me lidhjet midis një vepre penale dhe :

i. avantazhit ekonomik që mund të jetë përfshirë në produktin e tij; ose

ii. pasurive që mund të jenë përfshirë në instrumentet e tij; ose

c. në bazë të legjislacionit të palës së kërkuar, vendimi për konfiskim nuk mund të jepet ose të ekzekutohet për shkak të parashkrimit; ose

d. kërkesa nuk ka të bëjë me një dënim të mëparshëm, as me një vendim me karakter gjyqësor, as me një deklaratë që figuron në një vendim të tillë, deklaratë sipas së cilës janë kryer një ose disa vepra penale, dhe që ka qenë në themel të vendimit ose të kërkesës për konfiskim; ose

e. ose konfiskimi nuk është i ekzekutueshëm në Palën kërkuese, ose ai është objekt ankimi sipas rrugëve të zakonshme; ose

f. kërkesa lidhet me një vendim konfiskimi të dhënë në mungesë të personit ndaj të cilit është dhënë vendimi dhe kur, sipas Palës së kërkuar, procedimi i filluar nga Pala kërkuese dhe që ka shpënë në këtë vendim nuk ka përmbushur të drejtat minimale të mbrojtjes që i njihet çdo personi të akuzuar për një vepër penale.

5. Në vështrim të paragrafit 4.f të këtij neni, vendimi nuk konsiderohet se është dhënë në mungesë të të akuzuarit:

a. kur ai është konfirmuar ose dhënë pas kundërshtimit nga personi i interesuar; ose

b. kur ai është dhënë në apel, me kusht që apeli të jetë kërkuar nga personi i interesuar.

6. Në shqyrtimet që bëhen, për qëllimet e paragrafit 4.f të këtij neni, nëse të drejtat minimale të mbrojtjes janë respektuar, Pala e kërkuar do të mbajë parasysh faktin që personi i interesuar ka kërkuar qëllimisht t'i fshihet drejtësisë ose që ky person, pasi ka pasur mundësi të paraqesë ankim kundër vendimit të dhënë në mungesë, ka preferuar të mos paraqesë një ankim të tillë. Do të konsiderohet njëlloj kur personi i interesuar, pasi është thirrur rregullisht për t'u paraqitur në gjyq, ka preferuar të mos paraqitet ose të mos kërkojë shtyrjen e shqyrtimit të çështjes.

7. Pala nuk mund të pretendojë të ngrejë çështjen e sekretit bankar për të justifikuar refuzimin e saj për çfarëdo bashkëpunimi të parashikuar në këtë kre. Kur e drejta e vet e brendshme e kërkon, Pala mund të kërkojë që kërkesa për bashkëpunim, që do të passjellë heqjen e sekretit bankar, të lëshohet ose nga gjyqtari ose nga një autoritet tjetër gjyqësor, duke përfshirë edhe prokurorin publik, autoritete që veprojnë në fushë të veprave penale.

8. Pa dëmtuar motivin e refuzimit të parashikuar në paragrafin 1.a të këtij neni:

a. fakti që personi, që është bërë objekt i një hetimi të ndërmarrë ose i një vendimi për konfiskim i marrë nga autoritetet e Palës kërkuese është një person juridik, nuk mund të ngrihet nga Pala e kërkuar si pengesë për çfarëdo bashkëpunimi në bazë të këtij kreu;

b. fakti që personi fizik, ndaj të cilit është dhënë një vendim për konfiskimin e produkteve, më pas ka vdekur si dhe fakti që personi juridik, ndaj të cilit është dhënë një vendim për konfiskimin e produkteve, më pas është shuar, nuk mund të paraqiten si pengesa për ndihmën e ndërsjellë të parashikuar nga neni 13 paragrafi 1.a

Neni 19

Shtyrja

Pala e kërkuar mund të shtyjë ekzekutimin e masave të parashikuara në një kërkesë kur ato rrezikojnë të dëmtojnë hetimet ose procedimet e ndërmarra nga autoritetet e veta.

Neni 20
Pranimi i pjesshëm ose me kusht i kërkesës

Para se të refuzojë ose të shtyjë për më vonë bashkëpunimin në bazë të këtij kreu, Pala e kërkuar shqyrton, kur e kërkon rasti pas konsultimeve me Palën kërkuese, nëse mund t'i japë të drejtë asaj pjesërisht ose me rezervë kushtesh që ajo e çmon të nevojshëm.

Ndarja 6 – Njoftimi dhe mbrojtja e të drejtave të të tretëve

Neni 21
Njoftimi i dokumenteve

1. Palët u japin njëra-tjetrës, sa më shumë të jetë e mundur, ndihmën e ndërsjellë për njoftimin e akteve gjyqësore personave përkatës lidhur me masat e përkohshme dhe konfiskimin.

2. Asgjë në këtë nen nuk mund të bëhet pengesë:

a. për mundësinë e dërgimit të akteve gjyqësore në rrugë postare drejtpërdrejt personave që ndodhen jashtë shtetit;

b. për mundësinë e nëpunësve të ministrive, funksionarëve ose personave kompetentë të Palës së origjinës për të bërë veprime lidhur me njoftimin ose dorëzimin e akteve gjyqësore drejtpërdrejt me anë të autoriteteve konsullore të kësaj Pale ose me anë të nënpunësve të ministrive, funksionarëve ose personave të tjerë kompetentë të Palës destinatare, veç kur Pala destinatare i ka bërë një deklaratë të kundërt Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës në çastin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

3. Gjatë njoftimit të akteve gjyqësore jashtë shtetit personave përkatës që kanë të bëjën me masa të përkohshme ose vendime konfiskimi të urdhëruara në Palën e origjinës, kjo Palë i informon këta persona për të drejtën e garantuar nga legjislacioni për ankim në gjykatë.

Neni 22
Njohja e vendimeve të huaja

1. E vënë në lëvizje nga një kërkesë bashkëpunimi sipas ndarjeve 3 e 4, Pala e kërkuar njeh çdo vendim gjyqësor të dhënë në Palën kërkuese përsa i përket të drejtave që kërkohen nga të tretët.

2. Njohja mund të refuzohet:

a. kur të tretët nuk kanë pasur mundësi të mjaftueshme për të kërkuar të drejtat e tyre; ose

b. kur vendimi është i papajtueshëm me një vendim të mëparshëm të dhënë në Palën kërkuese për të njëjtën çështje; ose

c. kur ai është i papajtueshëm me rendin publik të Palës së kërkuar; ose

d. kur vendimi është dhënë në kundërshtim me dispozitat në fushë të kompetencës ekskluzive të parashikuar nga e drejta e Palës së kërkuar.

Ndarja 7 – Procedura dhe rregulla të tjera të përgjithshme

Neni 23
Autoriteti qendror

1. Palët caktojnë një autoritet qendror ose, kur e lyp nevoja, disa autoritete të ngarkuara me dërgimin e kërkesave të formuluara në bazë të këtij kreu, për t'iu përgjigjur, për t'i ekzekutuar ose për t'ua transmetuar autoriteteve që kanë kompetencë për ekzekutim.

2. Çdo Palë i komunikon Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës në çastin e nënshkrimit ose në çastin e depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose të aderimit, emërtimin dhe adresën e autoriteteve kompetente të caktuar për zbatimin e paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 24
Korrespondenca e drejtpërdrejtë

1. Autoritetet qendrore komunikojnë drejtpërdrejt midis tyre.

2. Në raste urgjente, autoritetet gjyqësore, duke përfshirë prokurorin publik, të Palës kërkuese mund t'u dërgojnë drejtpërdrejt kërkesat dhe komunikimet e parashikuara nga ky kre autoriteteve homologe të Palës së kërkuar. Në raste të tilla, një kopje duhet t'i dërgohet njëkohësisht autoritetit qendror të Palës së kërkuar me ndërmjetësinë e autoritetit qendror të Palës kërkuese.

3. Çdo kërkesë ose komunikim i formuluar në zbatim të paragrafëve 1 e 2 të këtij neni mund të paraqitet me ndërmjetësinë e Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (Interpol).

4. Kur një kërkesë paraqitet në bazë të paragrafit 2 të këtij neni dhe kur autoriteti i vënë në lëvizje nuk është kompetent për t'i dhënë rrugë, ai ia transmeton atë autoritetit kompetent të vendit të vet dhe informon për këtë drejtpërdrejt Palën kërkuese.

5. Kërkesat ose komunikimet e paraqitura në bazë të ndarjes 2 të këtij kreu, që nuk passjellin marrjen e masave shtrënguese, mund të transmetohen drejtpërdrejt nga autoriteti kompetent i Palës kërkuese autoritetit kompetent të Palës së kërkuar.

Neni 25
Forma e kërkesave dhe gjuhët

1. Të gjitha kërkesat e parashikuara nga ky kre bëhen me shkrim. Lejohet edhe përdorimi i mjeteve moderne të telekomunikimit, të tilla si faksi.

2. Me rezervën e dispozitave të pragrafit 3 të këtij neni, nuk do të kërkohet përkthimi i kërkesave ose shkresave që u aneksohen atyre.

3. Çdo Palë mundet, në çastin e depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose të aderimit, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, të rezervojë të drejtën të kërkojë që kërkesat dhe shkresat që u aneksohen atyre të shoqërohen me përkthim në gjuhën e vet ose në njërën nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Evropës ose në atë gjuhë që ajo do të caktojë. Çdo Palë mundet, me këtë rast, të deklarojë se ajo është e gatshme të pranojë përkthime në çdo gjuhë tjetër që ajo do të caktojë. Palët e tjera mund të zbatojnë rregullën e reciprocitetit.

Neni 26
Legalizimi

Dokumentet e transmetuara në zbatim të këtij kreu nuk u nënshtrohen asnjë formaliteti të legalizimit.

Neni 27
Përmbajtja e kërkesës

1. Çdo kërkesë bashkëpunimi e parashikuar nga ky kre duhet të saktësojë:

a. autoritetin që e ka bërë dhe autoritetin e ngarkuar të kryejë hetimet ose procedimet;

b. objektin dhe motivin e kërkesës;

c. çështjen, duke përfshirë aty faktet që lidhen më të (të tilla si data, vendi dhe rrethanat e veprës penale), me të cilën lidhen hetimet ose procedimet, veç në rast se kërkesa përmban një njoftim;

d. në masën që bashkëpunimi passjell marrjen e masave shtrënguese:

i. tekstin e dispozitave ligjore ose, kur kjo nuk është e mundur, brendinë e ligjit përkatës të zbatueshëm; dhe

ii. një tregues sipas të cilit masa e kërkuar ose çdo masë tjetër që ka efekte të ngjashme mund të merret në territorin e Palës kërkuese në bazë të legjislacionit të vet;

e. kur është e nevojshme, dhe kur është e mundur:

i. detaje lidhur me personin/personat përkatës, duke përfshirë emrin, datën dhe vendlindjen, shtetësinë dhe vendndodhjen e tij/tyre, dhe, në rast se është person juridik selinë e tij; dhe

ii. pasuritë, lidhur me të cilat kërkohet bashkëpunimi, vendndodhjen e tyre, lidhjet e tyre me personin/personat në fjalë, çdo lidhje me veprën penale si dhe çdo informacion që disponohet lidhur me interesat për këto pasuri që lidhen me të tjerë; dhe

f. çdo procedim i veçantë që dëshirohet nga Pala kërkuese.

2. Kur kërkesa për masë të përkohshme e paraqitur në bazë të ndarjes 3 synon kapjen e një pasurie që mund të jetë objekt i një vendimi për konfiskim që ka të bëjë me detyrimin për pagimin e një shume parash, kjo kërkesë duhet të tregojë shumën maksimale që kërkohet për t'u marrë për këtë pasuri.

3. Përveç treguesve të përmendur në paragrafin 1, çdo kërkesë e formuluar në zbatim të ndarjes 4 duhet të përmbajë:

a. në rastin e nenit 13, pagrafi 1a:

i. kopje e vërtetuar konform e vendimit të konfiskimit dhënë nga gjykata e Palës kërkuese dhe paraqitja e motiveve që janë vënë në themel të vendimit, kur ato nuk përmenden në vetë vendimin;

ii. vërtetimin e autoritetit kompetent të Palës kërkuese, sipas të cilit vendimi për konfiskim është i ekzekutueshëm dhe nuk është objekt ankimi sipas rrugëve të zakonshme;

iii. informacione lidhur me masën, gjer ku do të vejë ekzekutimi; dhe

iv. informacione lidhur me domosdoshmërinë e marrjes së masave të përkohshme;

b. në rastet e nenit 13, paragrafi 1.b, një paraqitje e fakteve të referuara nga Pala kërkuese që të jetë e mjaftueshme për t'i dhënë mundësi Palës së kërkuar të marrë vendim në bazë të së drejtës së brendshme të saj;

c. kur persona të tretë kanë pasur mundësi të kërkojnë të drejta, dokumentet që tregojnë se ata e kanë pasur këtë mundësi.

Neni 28

Të meta të kërkesave

1. Kur kërkesa nuk është konform me dispozitat e këtij kreu, ose kur informacionet e dhëna nuk janë të mjaftueshme për t'i dhënë mundësi Palës së kërkuar të marrë vendim për kërkesën, kjo Palë mund t'i kërkojë Palës kërkuese të modifikojë kërkesën ose t'a plotësojë atë me informacione suplementare.

2. Pala e kërkuar mund të caktojë një afat për të marrë këto modifikime ose infomacione.

3. Në pritje të marrjes së modifikimeve ose informacioneve të kërkuara lidhur me një kërkesë të paraqitur në zbatim të ndarjes 4 të këtij kreu, Pala e kërkuar mund të urdhërojë të gjitha masat e parashikuara në ndarjet 2 e 3 të këtij kreu.

Neni 29

Konkurrim kërkesash

1. Kur Pala e kërkuar merr me shumë se një kërkesë të paraqitura në bazë të ndarjeve 3 e 4 të ketij kreu lidhur me të njejtin person ose të njejtat pasuri, konkurrimi i kërkesave nuk e pengon Palën e kërkuar t'i trajtojë kërkesat që passjellin marrjen e masave të përkohshme.

2. Në rast konkurrimi kërkesash të paraqitura në bazë të ndarjes 4 të këtij kreu, Pala e kërkuar duhet të ketë parasysh të konsultohet me Palët kërkuese.

Neni 30

Detyrimi për motivim

Pala e kërkuar duhet të motivojë çdo vendim që refuzon, që shtyn ose që i vë kushte çdo bashkëpunimi të kërkuar në bazë të këtij kreu.

Neni 31
Informimi

1. Pala e kërkuar informon pa vonesë Palën kërkuese:

a. për dhënien rrugë menjëherë kërkesës së formuluar në bazë të këtij kreu;

b. për rezultatin përfundimtar të dhënies rrugë të kërkesës;

c. për vendimin që refuzon, që shtyn ose i vë kushte, tërësisht ose pjesërisht, çdo bashkëpunimi të parashikuar nga ky kre;

d. për të gjitha rrethanat që bëjnë të pamundur ekzekutimin e masave të kërkuara ose që rrezikojnë ta vonojnë shumë atë; dhe

e. në rast të masave të përkohshme të marra për një kërkesë të formuluar në zbatim të ndarjes 2 ose 3 të këtij kreu, për dispozitat e të drejtës së vet të brendshme që do të shkaktonin automatikisht heqjen e masës.

2. Pala kërkuese informon pa vonesë Palën e kërkuar:

a. për çdo rishikim, vendim ose fakt tjetër që i heq tërësisht ose pjesërisht vendimit të konfiskimit karakterin e ekzekutueshëm të tij;

b. për çdo ndryshim, në fakt dhe në ligj, që e bën të pajustifikuar këtej e tutje çdo veprim të ndërmarrë në bazë të këtij kreu.

3. Kur njera Palë kërkon konfiskimin e pasurive në disa Palë mbi bazën e të njëjtit vendim konfiskimi, ajo informon për këtë të gjitha Palët përkatëse për ekzekutimin e vendimit.

Neni 32
Përdorimi i kufizuar

1. Pala e kërkuar mund t'ia nënshtrojë ekzekutimin e një kërkese kushtit që informacionet ose elementet e provave të marra, pa miratimin e saj paraprak, të mos përdoren ose transmetohen nga autoritetet e Palës kërkuese për qëllim hetimesh ose procedimesh të ndryshme nga ato të saktësuara në kërkesë.

2. Çdo Palë mundet, në çastin e nënshkrimit ose depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose të aderimit të saj, me deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, të deklarojë se informacionet ose elementet e provave të dhëna prej saj në bazë të këtij kreu, pa miratimin e saj paraprak, nuk mund të përdoren nga autoritetet e Palës kërkuese për qëllime hetimesh ose procedimesh, të ndryshme nga ato të saktësuara në kërkesë.

Neni 33
Konfidencialiteti

1. Pala kërkuese mund të kërkojë nga Pala e kërkuar që ajo të ruajë konfidenciale kërkesën dhe brendinë e saj, veç kur është e nevojshme për ekzekutimin e kërkesës. Kur Pala e kërkuar nuk mund t'i përmbahet këtij kushti të konfidencialitetit, ajo duhet të informojë për këtë Palën kërkuese brenda një afati shumë të shpejtë.

2. Pala kërkuese duhet, kur për këtë i është bërë kërkesë dhe me kusht që kjo të mos bie ndesh me parimet themelorë të së drejtës së vet të brendshme, të ruajë konfidencialë të gjitha provat dhe infomacionet e komunikuara nga Pala e kërkuar, veç kur është e nevojshme për qëllim të hetimeve ose të procedimit të përshkruar në kërkesë.

3. Me rezervën e dispozitave të së drejtës së vet të brendshme, Pala që ka marrë një transmetim të vetvetishëm informacionesh në bazë të nenit 10, duhet t'i përmbahet kushtit të konfidencialitetit të kërkuar nga Pala që transmeton informacionin. Nëse Pala tjetër nuk mund t'i përmbahet një kushti të tillë, ajo duhet të informojë për këtë Palën që transmeton informacionin në afat sa më të shpejtë.

Neni 34
Shpenzimet

Shpenzimet e zakonshme të bëra për të ekzekutuar një kërkesë janë në ngarkim të Palës së kërkuar. Kur del e nevojshme kryerja e shpenzimeve të mëdha ose të jashtëzakonshme për t'i dhënë rrugë kërkesës, Palët merren vesh për të fiksuar kushtet në të cilat kjo do të ekzekutohet si dhe mënyrën sesi do të mbulohen shpenzimet.

Neni 35
Shpërblimi i dëmit

1. Kur një person ka ngritur padi mbi përgjegjësinë për dëmet që rezultojnë nga një akt ose një ometim në kuadër të bashkëpunimit të parashikuar nga ky kre, Palët përkatëse duhet të konsultohen midis tyre, dhe kur është rasti, të përcaktojnë shlyerjen eventuale të dëmshpërblimit të duhur.

2. Pala që është objekt i një kërkesë për shpërblim të dëmit detyrohet të informojë për këtë pa vonesë Palën tjetër kur kjo mund të ketë interes në çështjen.

KREU IV
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 36
Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo konventë është e hapur për nënshkrim nga Shtetet anëtarë të Këshillit të Evropës dhe për Shtetet jo anëtarë që kanë marrë pjesë në hartimin e saj. Këta Shtete mund të shprehin pëlqimin e tyre për t'u bashkuar me:

a. nënshkrimin pa rezervë ratifikimi, pranimi ose miratimi; ose

b. nënshkrimin, me rezervë ratifikimi, pranimi ose miratimi, që vijohet me ratifikim, pranim ose miratim.

2. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

3. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi ditën e parë që vjen pas mbarimit të një periudhe tremujore pas datës kur tre Shtete, nga të cilët të paktën dy Shtete anëtarë të Këshillit të Evropës, do të kenë shprehur pëlqimin e tyre për t'u bashkuar me këtë Konventë, konform dispozitave të paragrafit 1.

4. Për çdo Shtet nënshkrues që do të shprehë më pas pëlqimin e vet për t'u bashkuar me Konventën, kjo do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që vjen pas mbarimit të një periudhe tremujore pas datës së shprehjes të pëlqimit për t'u bashkuar me Konventën konform dispozitave të paragrafit 1.

Neni 37
Aderimi në Konventë

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konventë, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës mundet, pasi është konsultuar me Shtetet kontraktues të Konventës, të ftojë çdo Shtet jo anëtar i Këshillit të Evropës për të aderuar në këtë Konventë me anë të një vendimi që merret me shumicën e parashikuar në nenin 20.d të Statutit të Këshillit të Evropës dhe me unanimitetin e përfaqësuesve të Shteteve kontraktues që gëzojnë të drejtën e anëtarit të Komitetit.

2. Për çdo Shtet aderues, Konventa do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që vjen pas mbarimit të një periudhe tremujore pas datës së depozitimit të instrumenteve të aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

Neni 38
Zbatimi territorial

1. Çdo Shtet mundet, në çastin e nënshkrimit ose në çastin e depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, të caktojë territorin ose territoret ku do të zbatohet kjo Konventë.

2. Çdo Shtet mundet, në çdo çast tjetër më pas, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, të shtrijë zbatimin e kësaj Konvente në çdo territor tjetër të caktuar në deklaratë. Konventa do të hyjë në fuqi për këtë territor ditën e parë të muajit që vjen pas mbarimit të një periudhe tremujore pas datës së marrjes së deklaratës nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë në bazë të dy paragrafëve të mëparshëm mund të tërhiqet, përsa i takon çdo territori të caktuar në deklaratë, me njoftim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Tërheqja do të ketë efektet e veta ditën e parë të muajit që vjen pas mbarimit të një periudhe tremujore pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 39
Marrëdhëniet me konventat dhe marrëveshjet e tjera

1. Kjo Konventë nuk prek të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga konventa ndërkombëtare shumëpalëshe lidhur me çështje të veçanta.

2. Palët në Konventë mund të përfundojnë midis tyre marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe lidhur me çështjet e rregulluara nga kjo Konventë, me qëllim të plotësimit ose përforcimit të dispozitave të kësaj ose për të lehtësuar zbatimin e parimeve që ajo mishëron.

3. Kur dy ose disa Palë kanë përfunduar tashmë një marrëveshje ose një traktat për një objekt që mbulohet nga kjo Konventë, ose kur ato kanë vendosur sipas një mënyre tjetër marrëdhëniet e tyre lidhur me këtë subjekt, ato do të kenë të drejtë të zbatojnë atë marrëveshje, traktat në vend të kësaj Konvente, nëse ai lehtëson bashkëpunimin ndërkombëtar.

Neni 40
Rezervat

1. Çdo Shtet mundet, në çastin e nënshkrimit ose në çastin e depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, të deklarojë se do të përdorë një ose disa rezerva që figurojnë në nenet 2 paragrafi 2; 6, paragrafi 4; 14 paragrafi 3; 21 paragrafi 2; 25 paragrafi 3; dhe 32 paragrafi 2. Asnjë rezervë tjetër nuk pranohet.

2. Çdo Shtet që ka formuluar një rezervë në bazë të paragrafit të mëparshëm mund ta tërheqë atë tërësisht ose pjesërisht, duke i drejtuar një njoftim Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës. Tërheqja do të fillojë efektet në datën e marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Pala që ka formuluar një rezervë lidhur me një dispozitë të kësaj Konvente nuk mund të pretendojë për zbatimin e kësaj dispozite nga një Palë tjetër; ajo mundet, nëse rezerva është e pjesshme ose me kusht, të pretendojë për zbatimin e kësaj dispozite në atë masë që ajo e ka pranaur atë.

Neni 41
Amendamentet

1. Çdo Palë mund të propozojë amendamente ndaj kësaj Konvente dhe çdo propozim do t'u komunikohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës Shteteve anëtarë të Këshillit dhe çdo Shteti jo anëtar që ka aderuar ose është ftuar të aderojë në këtë Konventë konform dispozitave të nenit 37.

2. Çdo amendament i propozuar nga një Palë i komunikohet Komitetit Evropian për problemet kriminale, i cili i paraqet Komitetit të Ministrave mendimin e vet për amendamentin e propozuar.

3. Komiteti i Ministrave shqyrton amendamentin e propozuar dhe mendimin e paraqitur nga Komiteti Evropian për problemet kriminale, dhe mund të miratojë amendamentin.

4. Teksti i çdo amendamenti të miratuar nga Komiteti i Ministrave konform paragrafit 3 të këtij neni u transmetohet Palëve për pranim.

5. Çdo amendament i miratuar konform paragrafit 3 të këtij neni do të hyjë në fuqi ditën e tridhjetë pasi të gjitha Palët të kenë informuar Sekretarin e Përgjithshëm se e kanë pranuar atë.

Neni 42

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Komiteti Evropian për problemet kriminale të Këshillit të Evropës është i detyruar të informojë për interpretimin dhe zbatimin e kësaj Konvente.

2. Në rast mosmarrëveshjesh midis Palëve për interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, Palët do të përpiqen të arrijnë zgjidhjen e mosmarrëveshjes me bisedime ose me çdo mjet tjetër paqësor i zgjedhur sipas dëshirës së tyre, duke përfshirë këtu paraqitjen e mosmarrëveshjes Komitetit Evropian për problemet kriminale, një gjykate arbitrale që do të marrë vendime që i lidh Palët në mosmarrëveshje, Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, sipas një marrëveshje të përbashkët të Palëve përkatëse.

Neni 43

Denoncimi

1. Çdo Palë mundet, në çdo çast, të denoncojë këtë Konventë duke i drejtuar një njoftim Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

2. Denoncimi do të fillojë efektet ditën e parë të muajit që vjen pas mbarimit të një periudhe tremujore pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Megjithatë, kjo Konventë vazhdon të zbatohet për ekzekutimin e konfiskimit, në bazë të nenit 14, të kërkuar konform dispozitave të saj para se të fillojë efektet denoncimi.

Neni 44

Njoftimet

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do të njoftojë Shtetet anëtare të Këshillit dhe çdo Shtet që ka aderuar në këtë Konventë për:

a. çdo nënshkrim;

b. depozitimin e instrumenteve të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit;

c. çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente konform neneve të saj 36 dhe 37;

d. çdo rezervë në bazë të nenit 40 paragrafi 1;

e. çdo akt tjetër, njoftim ose komunikim që ka të bëjë me këtë Konventë.

Me këtë mirëbesim, nënshkruesit, të autorizuar rregullisht për këtë qëllim, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Strasburg, më 8 nëntor 1990, në frëngjisht dhe anglisht, të dy tekstet janë njëlloj të besueshëm, në një ekzemplar të vetëm që do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Evropës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do t'u komunikojë nga një kopje të vërtetuar konform secilit nga Shtetet anëtarë të Këshillit të Evropës, Shteteve jo anëtarë që kanë marrë pjesë në hartimin e Konventës dhe çdo Shteti të ftuar për të aderuar në të.

LIGJ
Nr.8703, datë 1.12.2000

PËR RATIFIKIMIN E "KONVENTËS EUROPIANE PËR INFORMIMIN PËR TË DREJTËN E HUAJ"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Konventa Europiane për informimin për të drejtën e huaj".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2828, datë 8.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.43, faqe 1960

KONVENTA EUROPIANE
PËR INFORMIMIN MBI TË DREJTËN E HUAJ

Seria e marrëveshjeve europiane nr.62Londër, 7.6.1968

HYRJE

Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, nënshkrues të kësaj Konvente,

Duke marrë në konsideratë se qëllimi i Këshillit të Europës është realizimi i një bashkimi më të ngushtë mes anëtarëve të tij,

Të bindur që krijimi i një sistemi të ndihmës së ndërsjellë shtetërore me qëllim, lehtësimin e detyrave të autoriteteve gjyqësore në marrjen e informacionit mbi të drejtën e huaj do të kontribuojë në realizimin e këtij qëllimi,

Kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1
Qëllimi i konventës

1. Palët kontraktuese marrin përsipër të japin informacion sipas parashikimeve të kësaj konvente, lidhur me legjislacionin e tyre në fushën civile dhe tregtare, sikurse dhe në fushën procedurale civile dhe tregtare dhe në fushën e organizimit të tyre gjyqësor.

2. Sidoqoftë, dy ose më shumë palë kontraktuese mund të vendosin të shtrijnë brenda tyre zbatimin e kësaj konvente në fusha të tjera nga ato të përmendura në paragrafin e mësipërm. Teksti i kësaj marrëveshjeje do t'i komunikohet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 2

Organet kombëtare të lidhjes

1. Për zbatimin e kësaj konvente, çdo palë kontraktuese do të krijojë ose caktojë një organ të vetëm (këtej e tutje të quajtur "organi pritës"), që do të ketë për detyrë:

a) Marrjen e kërkesave për informacionin sipas nenit 1 paragrafi I parë të kësaj konvente, që vijnë nga një palë tjetër kontraktuese;

b) Të veprojë lidhur me këto kërkesa në përputhje me nenin 6.

Ky organ duhet të jetë një departament ministrie, ose një organ tjetër shtetëror.

2. Çdo palë kontraktuese do të ketë të drejtën të krijojë ose caktojë një ose më shumë organe (këtej e tutje të quajtur "organe transmetues"), të ngarkuar me marrjen e kërkesave për informacion nga autoritetet e tij gjyqësore dhe t'ua transmetojë ato organit marrës të huaj kompetent. Organi marrës mund të veprojë si në organ transmetues.

3. Çdo palë kontraktuese do t'i komunikojë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës emrin dhe adresën e organit të tij marrës dhe, kur është vendi, të organit ose organeve të tij transmetuese.

Neni 3

Autoritetet e autorizuara për të bërë kërkesa për informacion

1. Një kërkesë për informacion duhet të rrjedhë kurdoherë nga një autoritet gjyqësor, edhe kur ajo nuk është formuluar nga ky i fundit. Kërkesa mund të bëhet vetëm kur një procedurë gjyqësore ka filluar.

2. Çdo palë kontraktuese mundet të tregojë, nëse nuk ka ngritur apo caktuar një organ transmetues, me anë të një deklarate të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, cilat nga autoritetet e saj do të konsiderohen prej saj si autoritete gjyqësore sipas kuptimit të paragrafit të mësipërm.

3. Dy ose më shumë palë kontraktuese mund të vendosin të shtrijnë brenda tyre zbatimin e kësaj konvente për kërkesa të rrjedhura nga autoritete të tjera nga ato gjyqësore. Teksti i kësaj marrëveshjeje do t'i komunikohet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 4

Përmbajtja e kërkesës për informcion

1. Kërkesa për informacion duhet të tregojë autoritetin gjyqësor nga rrjedh, sikurse dhe natyrën e çështjes. Ajo duhet të saktësojë sa më shumë të jetë e mundur pikat për të cilat kërkohet informacioni lidhur me legjislacionin e shtetit të kërkuar, dhe në rastin e ekzistencës së shumë sistemeve juridike në shtetin e kërkuar, sistemin juridik për të cilin kërkohet informacioni.

2. Kërkesa do të shoqërohet nga paraqitja e fakteve të nevojshme si për mirëkuptimin e saj dhe për formulimin e një përgjigjeje të saktë dhe precize. Kopje të dokumenteve mund t'i bashkëlidhen kur është e nevojshme për të sqaruar qëllimin e kërkesës.

3. Kërkesa mund të përfshijë pyetje në fusha të tjera nga ato të treguara në nenin 1, paragrafi i parë, sa kohë që ato lidhen me pyetjet kryesore të specifikuara në kërkesë.

4. Në rast se kërkesa nuk është hartuar nga një autoritet gjyqësor, ajo do të shoqërohet nga vendimi i këtij autoriteti që autorizon bërjen e saj.

Neni 5

Transmetimi i kërkesës për informacion

Kërkesa për informacion do t'i transmetohet direkt organit marrës të shtetit të kërkuar nga një organ transmetues, ose në mungesë të një organi të tillë, nga autoriteti gjyqësor nga ajo rrjedh.

Neni 6
Autoritetet kompetente për t'u përgjigjur

1. Organi marrës që ka marrë kërkesën për informacion mund ta hartojë vetë përgjigjen, ose ta transmetojë kërkesën tek një organ tjetër shtetëror ose zyrtar për ta hartuar ai përgjigjen.

2. Organi marrës mund, në raste të caktuara ose për arsye të organizimit administrativ, t'ia transmetojë kërkesën një organizmi privat ose një juristi të kualifikuar për të hartuar përgjigjen.

3. Nëse zbatimi i paragrafit të mësipërm shoqërohet me shpenzime, organi marrës, para bërjes së transmetimit të treguar në paragrafin në fjalë, do t'i tregojë autoritetit nga rrjedh kërkesa, organizmin privat ose juristin të cilit do t'i transmetohet kërkesa, dhe do të informojë autoritetin në fjalë sa më me kujdes të jetë e mundur për shpenzimet e mundshme, dhe do të kërkojë pëlqimin e tij për këtë.

Neni 7
Përmbajtja e përgjigjes

Objekti i përgjigjes do të ketë për qëllim dhënien e informacionit në mënyrë objektive dhe të paanshme për legjislacionin e shtetit të kërkuar, autoritetit gjyqësor nga i cili rrjedh kërkesa. Përgjigjja do të përmbajë sipas rastit, tekste ligjore dhe vendime gjyqësore. Ajo do të shoqërohet në mënyrën e gjykuar të nevojshme për një informim të mirë të autoritetit kërkues, nga çdo dokument tjetër plotësues, të tillë si ekstrakte nga punime doktrinale dhe materiale ligjore. Ajo mundet gjithashtu të shoqërohet nga komentarë shpjegues.

Neni 8
Pasojat e përgjigjes

Informacionet e dhëna në përgjigje nuk janë të detyrueshme për autoritetin gjyqësor nga i cili rrjedh kërkesa.

Neni 9
Komunikimi i përgjigjes

Përgjigjja do t'i drejtohet organit transmetues nga organi marrës, nëse kërkesa është transmetuar nga ky organ, ose autoritetit gjyqësor nëse kërkesa është dërguar nga ky i fundit.

Neni 10
Detyrimi për t'u përgjigjur

1. Organi marrës, të cilit i është dërguar kërkesë për informacion, nën rezervën e parashikimeve të nenit 11 do të veprojë për trajtimin e kërkesës në përputhje me nenin 6.

2. Nëse përgjigjja nuk është formuluar nga organi marrës, ky i fundit angazhohet të sigurojë që përgjigjja është dërguar në kushtet e parashikuara nga neni 12.

Neni 11
Përjashtime nga detyrimi për t'u përgjigjur

Shteti i kërkuar mund të refuzojë ndërmarrjen e veprimeve për kërkesën për informacion nëse interesat e tij preken nga çështja e ngritur në kërkesë, ose nëse ai konsideron që përgjigjja mund të paragjykojë sovranitetin ose sigurinë e tij.

Neni 12
Afati për dhënien e përgjigjes

Përgjigjja për një kërkesë për informacion do të dërgohet sa më shpejt të jetë e mundur. Sidoqoftë, nëse përgatitja e përgjigjes kërkon një kohë të gjatë, organi marrës do të informojë për këtë autoritetin e huaj kërkues dhe nëse është e mundur do të tregojë në të njëjtën kohë datën e mundshme brenda së cilës përgjigjja do të komunikohet.

Neni 13
Informacion shtesë

1. Organi marrës, sikurse dhe organizimi ose personi i cili është ngarkuar e përputhje me nenin 6 të përgatisë përgjigjen, mund t'i kërkojë autoritetit nga i cili rrjedh kërkesa, t'i sigurojë çdo informacion tjetër shtesë që ai e konsideron të nevojshëm për përgatitjen e përgjigjes.

2. Kërkesa për informacion shtesë do të transmetohet nga organi marrës në të njëjtën mënyrë sikurse parashikohet në nenin 9 për komunikimin e përgjigjes.

Neni 14
Gjuhët

1. Kërkesat për informacion dhe anekset do të jenë në gjuhën ose në një nga gjuhët zyrtare të shtetit të kërkuar, ose do të shoqërohen nga një përkthim në atë gjuhë. Përgjigjja do të jetë në gjuhën e shtetit të kërkuar.

2.Sidoqoftë, dy ose më shumë palë kontraktuese mund të vendosin të shmangen mes tyre nga parashikimet e paragrafit të mësipërm.

Neni 15
Shpenzimet

1. Përgjigjja nuk do të përmbajë pagesa të çfarëdo lloji ose shpenzime, me përjashtim të atyre të prashikuara në nenin 6, paragrafi i tretë, të cilat do të përballohen nga shteti nga i cili rrjedh kërkesa.

2. Sidoqoftë, dy ose më shumë palë kontraktuese mund të vendosin të shmangen mes tyre nga parashikimet e paragrafit të mësipërm.

Neni 16
Shtetet federale

Në shtetet federale, funksionet e organit marrës, të tjera nga ato të ushtruara sipas nenit 2, paragrafi i parë, shkronja "a", mundet për arsye kushtetuese t'i delegohen organeve të tjera shtetërore.

Neni 17
Hyrja në fuqi e Konventës

1. Kjo konventë do të jetë e hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës. Ajo mund të ratifikohet ose pranohet. Instrumentet e ratifikimit ose të pranimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Kjo konventë do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit ose pranimit.

3. Për shtetet nënshkrues që e ratifikojnë ose e pranojnë këtë konventë më vonë, ajo do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të tyre të ratifikimit ose pranimit.

Neni 18

Aderimi i një shteti jo anëtar i Këshillit të Europës

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj konvente, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës mund të ftojë çdo shtet jo anëtar të aderojë në këtë konventë.

2. Aderimi do të kryhet nëpërmjet depozitimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës të një instrumenti aderimi, i cili do të ketë efekt tre muaj pas datës së depozitimit.

Neni 19

Zbatimi territorial i Konventës

1. Çdo palë kontraktuese mundet, në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit, pranimit ose aderimit, të specifikojë territoret në të cilat do të zbatohet kjo konventë.

2. Çdo palë kontraktuese mundet, gjatë depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit, pranimit ose aderimit, ose në një datë të mëvonshme, nëpërmjet një deklarate të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të shtrijë zbatimin e kësaj konvente në cilindo territor ose territore të specifikuara në deklaratë, territore për të cilat ajo është përgjegjëse për marrëdhëniet ndërkombëtare, ose për të cilat ajo është e autorizuar të lidhë marrëveshje.

3. Çdo deklaratë e bërë në përputhje me paragrafin e mësipërm mund të tërhiqet përsa i përket territoreve të përmendura në atë deklaratë, në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 20 të kësaj konvente.

Neni 20

Kohëzgjatja e Konventës dhe denoncimi i saj

1. Kjo konventë do të mbetet në fuqi për një afat kohor të pacaktuar.

2. Çdo palë kontraktuese mundet, përsa i përket asaj, të denoncojë këtë konventë nëpërmjet një njoftimi të dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

3. Denoncimi do të ketë efekt gjashtë muaj pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 21

Funksionet e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të njoftojë shtetet anëtare të Këshillit dhe çdo shtet tjetër, i cili ka aderuar në këtë konventë për:

a) çdo nënshkrim;

b) çdo depozitim të një instrumenti ratifikimi, pranimi ose aderimi;

c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj konvente në përputhje me nenin 17 të saj;

d) çdo deklaratë të marrë në përputhje me parashikimet e paragrafit të dytë të nenit 1, paragrafit të tretë të nenit 2, paragrafit të dytë të nenit 3 dhe paragrafeve dy dhe tre të nenit 19.

e) çdo njoftim të marrë në përputhje me parashikimet e nenit 20 dhe datën në të cilën bëhet i efektshëm denoncimi.

Si dëshmi të kësaj, nënshkruesit të autorizuar si duhet për këtë gjë, kanë nënshkruar këtë konventë.

Bërë në Londër, më 7 qershor 1968, në frëngjisht dhe anglisht, të dyja tekstet njëlloj të vlefshëm, në një kopje të vetme, e cila do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'i transmetojë kopje të vërtetuara secilit shtet nënshkrues dhe aderues.

LIGJ
Nr.8705, datë 1.12.2000

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES EUROPIANE PËR TRANSMETIMIN E KËRKESAVE TË NDIHMËS GJYQËSORE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja Europiane për transmetimin e kërkesave të ndihmës gjyqësore".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2829, datë 8.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.43, faqe 1960

MARRËVESHJA
EUROPIANE PËR TRANSMETIMIN E KËRKESAVE TË NDIHMËS GJYQËSORE

Seria e traktateve europiane nr.92
Marrëveshja STE nr.92 – Transmetimi i kërkesave të ndihmës gjyqësore, 1997
Shtetet anëtarë të Këshillit të Europës, nënshkrues të kësaj Marrëveshje,
Duke konsideruar se qëllimi i Këshillit të Europës është realizimi i një bashkimi më të ngushtë midis anëtarëve të tij;
Duke konsideruar se është e dëshirueshme të eleminohen pengesat ekonomike që dëmtojnë të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës civile dhe t'u lejojë personave ekonomikisht të pafavorizuar t'u vlerësohen më mirë të drejtat e tyre në Shtetet anëtare;
Të bindur se ngritja e një sistemi të transmetimit të kërkesave për ndihmë gjyqësore të përshtatshme do të kontribuojë për të arritur këtë qëllim,
Japin pëlqimin përsa vijon:

Neni 1

Çdo person, që ka vendqendrimin e zakonshëm në territorin e njërës nga Palët kontraktuese, që dëshiron të kërkojë ndihmën gjyqësore në fushën civile, tregtare ose administrative në territorin e një Pale tjetër kontraktuese, mund të paraqesë kërkesën e tij në Shtetin e vendqendrimit të zakonshëm. Ky Shtet është i detyruar t'i transmetojë kërkesën Shtetit tjetër.

Neni 2

1. Çdo Palë kontraktuese cakton një ose disa autoritete dërguese të ngarkuara t'i transmetojnë drejtpërdrejt kërkesat për ndihmë gjyqësore autoritetit të huaj si më poshtë.

2. Çdo Palë kontraktuese cakton gjithashtu një autoritet qendror marrës i ngarkuar me marrjen e kërkesave për ndihmë gjyqësore që vijnë nga një Palë tjetër kontraktuese dhe me dhënien rrugë të tyre.

Shtetet federale dhe Shtetet në të cilët janë në fuqi disa sisteme të drejtash mund të caktojnë disa autoritete qendrore.

Neni 3

1. Autoriteti dërgues ndihmon kërkuesin me qëllim që të gjitha dokumentet, të cilat, me dijeni të këtij autoriteti, janë të nevojshme për të çmuar kërkesën, t'i bashkëngjiten kësaj. Ai ndihmon gjithashtu kërkuesin eventualisht për përkthimin e nevojshëm të dokumenteve.

Ai mund të refuzojë të transmetojë kërkesën në rast se kjo i duket atij krejtësisht e kotë.

2. Autoriteti qendror marrës i transmeton dosjen autoritetit kompetent për të vendosur lidhur me kërkesën. Ai njofton autoritetin dërgues për të gjitha vështirësitë lidhur me shqyrtimin e kërkesës, si dhe me vendimin që ka marrë autoriteti kompetent.

Neni 4

Dokumentet e transmetuara në zbatim të kësaj Marëveshjeje nuk kanë nevojë për legalizim dhe për asnjë formalitet analog.

Neni 5

Asnjë pagesë nuk do të bëhet nga Palët kontraktuese për shërbimet e kryera konform kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6

1. Me rezervën e rregullimeve të veçanta të arritura midis autoriteteve të interesuara të Palëve kontraktuese dhe të dispozitave 13 e 14:

a. Kërkesa për ndihmë gjyqësore dhe dokumentet që e shoqërojnë, si dhe çdo komunikim hartohen në gjuhën ose në një gjuhë zyrtare të autoritetit marrës ose shoqërohen me përkthim në këtë gjuhë;

b. Çdo Palë kontraktuese duhet megjithatë të pranojë kërkesën për ndihmë gjyqësore dhe dokumentet që e shoqërojnë, si dhe çdo komunikim kur ato janë hartuar në gjuhën angleze ose franceze, ose kur ato shoqërohen me përkthim në njërën nga këto gjuhë.

2. Komunikimet që bëhen nga Shteti i autoritetit marrës mund të hartohen në gjuhën ose në njërën nga gjuhët zyrtare të këtij Shteti, ose në anglisht ose frëngjisht.

Neni 7

Me qëllim të lehtësimit të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, autoritetet qendrore të Palëve kontraktuese detyrohen të njoftojnë reciprokisht njëri-tjetrin për gjendjen e legjislacionit në fushë të ndihmës gjyqësore.

Neni 8

Autoritetet e përmendur në nenin 2 caktohen me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm në çastin kur Shteti përkatës bëhet palë në Marrëveshje konform dispozitave të neneve 9 e 11. Çdo ndryshim lidhur me kompetencën e këtyre autoriteteve do të jetë gjithashtu objekt i një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 9

1. Kjo Marrëveshje është e hapur për nënshkrim për Shtetet anëtare të Këshillit të Europës, të cilët mund të bëhen palë me atë të:

a. nënshkrimit pa rezervë ratifikimi, pranimi ose miratimi;

b. nënshkrimi me rezervë ratifikimi, pranimi ose miratimi, që pasohet nga ratifikimi, pranimi ose miratimi.

2. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 10

1. Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi një muaj pas datës në të cilën dy Shtetet anëtare të Këshillit të Europës janë bërë palë në Marrëveshje konform dispozitave të nenit 9.

2. Për çdo Shtet anëtar që do ta nënshkruaj më pas pa rezervë ratifikimi, pranimi ose miratimi, ose do t'a ratifikojë, pranojë ose miratojë, Marrëveshja do të hyjë në fuqi një muaj pas datës së nënshkrimit ose të depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, të pranimit ose të miratimit.

Neni 11

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës mund të ftojë çdo Shtet jo anëtar i Këshillit të Europës për të aderuar në këtë Marrëveshje.

2. Aderimi bëhet me depozitim, pranë Sekretarit të Përgjithshën të Këshillit të Europës, të instrumenteve të aderimit që do të ketë efekt një muaj pas datës së depozitimit të tyre.

Neni 12

1. Çdo Shtet mundet, në çastin e nënshkrimit ose në çastin e depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose të aderimit, të caktojë territorin ose territoret ku do të zbatohet kjo Marrëveshje.

2. Çdo Shtet mundet, në çastin e depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose të aderimit ose në çdo çast tjetër më pas, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të shtrijë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje në çdo territor tjetër të përmendur në deklaratë dhe në të cilin ai mbulon marrëdhëniet ndërkombëtare ose për të cilin ai është i autorizuar t'i kryejë. Shtrirja ka efekt një muaj pas dorëzimit të deklaratës.

3. Çdo deklaratë e bërë sipas paragrafit të mëparshëm mund të tërhiqet, lidhur me territorin e caktuar në deklaratë, me notifikim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Kjo tërheqje do të fillojë efektet gjashtë muaj pas datës së marrjes të notifikimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 13

1. Çdo Shtet mundet, në çastin e depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose të aderimit, të deklarojë përjashtimin e zbatimit tërësisht ose pjesërisht të dispozitave të nenit 6, paragrafi 1.b. Asnjë rezervë tjetër nuk pranohet për këtë Marrëveshje.

2. Çdo palë kontraktuese mund të tërheqë tërësisht ose pjesërisht rezervën që ajo ka bërë, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Efektet e rezervës do të pushojnë në datën e marrjes së deklaratës.

3. Kur një Palë kontraktuese bën një rezervë, çdo Palë tjetër mund të zbatojë të njëjtën rezervë ndaj kësaj Pale.

Neni 14

1. Çdo Palë kontraktuese që ka disa gjuhë zyrtare mundet, për efekt të zbatimit të nenit 6, paragrafi 1.a, të bëjë të ditur, me anë të një deklarate, gjuhën në të cilën kërkesa dhe dokumentet që e shoqërojnë do të duhet të hartohen ose të përkthehen me qëllim të transmetimit te palët e territorit që ajo ka përcaktuar.

2. Deklarata e parashikuar në paragrafin e mësipërm do t'i drejtohet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës në çastin e nënshkrimit të Marrëveshjes nga Shteti i interesuar ose në çastin e depozitimit të instrumenteve të saj të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose të aderimit. Deklarata mund të tërhiqet ose të modifikohet kurdoherë më pas sipas së njëjtës procedurë.

Neni 15

1. Çdo Palë kontraktuese mundet, përsa i takon, të denoncojë këtë Marrëveshje duke i drejtuar një notifikim Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Denoncimi do të fillojë efektet gjashtë muaj pas datës së marrjes së notifikimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 16

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'u notifikojë Shteteve anëtarë të Këshillit të Europës dhe çdo Shteti që ka aderuar në këtë Marrëveshje:

a. çdo nënshkrim pa rezervë të ratifikimit, të pranimit ose të miratimit;

b. çdo nënshkrim me rezervë të ratifikimit, të pranimit ose të miratimit;

c. depozitimin e çdo instrumenti ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi;

d. çdo deklaratë të marrë në zbatim të dispozitave të nenit 8;

e. çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, konform nenit 10 të saj;

f. çdo deklaratë të marrë në zbatim të paragrafeve 2 e 3 të nenit 12;

g. çdo deklaratë të marrë në zbatim të paragrafit 1 të nenit 13;

h. tërheqjen e çdo rezerve të bërë në zbatim të dispozitave të paragrafit 2 të nenit 13;

i. çdo deklaratë të marrë në zbatim të dispozitave të nenit 14;

j. çdo notifikim të marrë në zbatim të dispozitave të nenit 15 dhe datën në të cilën denoncimi do të fillojë efektet.

Me këtë mirëbesim, nënshkruesit, të autorizuar rregullisht për këtë qëllim, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në Strasburg, më 27 janar 1977, në frëngjisht dhe anglisht, të dy tekstet janë njëlloj të besueshëm, në një ekzemplar të vetëm që do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'u komunikojë nga një kopje të vërtetuar konform secilit nga Shtetet anëtare nënshkrues dhe aderues.

LIGJ
Nr.8722, datë 26.12.2000

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË "KONVENTËN E KOMBEVE TË BASHKUARA KUNDËR TRAFIKUT TË PALIGJSHËM TË DROGAVE NARKOTIKE DHE TË LËNDËVE PSIKOTROPE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në "Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe të lëndëve psikotrope".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2857, datë 5.1.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.50, faqe 2156

KONVENTA
E KOMBEVE TË BASHKUARA KUNDËR TRAFIKUT TË PALIGJSHËM TË DROGAVE NARKOTIKE DHE LËNDËVE PSIKOTROPE 1988

Akti Final dhe Rezolutat, siç është rënë dakord nga Konferenca e Kombeve të Bashkuara për miratimin e një Konvente kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe Lëndëve Psikotrope, dhe si edhe tabelat që i bashkëngjiten kësaj Konvente.

AKTI FINAL I KONFERENCËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA
PËR MIRATIMIN E NJË KONVENTE KUNDËR TRAFIKUT TË PALIGJSHËM TË DROGAVE NARKOTIKE DHE LËNDËVE PSIKOTROPE

1. Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, me anë të rezolutës së saj 39/141 të 14 Dhjetorit 1984, kërkonte që Këshilli Social-Ekonomik i Kombeve të Bashkuara, "duke marrë në konsideratë nenin 62 paragrafi 3, dhe nenin 66 paragrafi 1, të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe rezolutën 9 (1) të Këshillit të 16 Shkurtit 1946, t'i kërkonte Komisionit për Drogat Narkotike të fillonte në sesionin e tij të tridhjetë e një, që do të mbahej në shkurt 1985, me përparësi, përgatitjen e një Projektkonvente kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike që trajton aspekte të ndryshme të problemit në tërësi, dhe në mënyrë të veçantë, ato që parashikohen në dokumentet ekzistuese ndërkombëtare..." .

2. Në përpjekje për të avancuar kërkesën e mësipërme dhe veprimin për ndjekjen e kësaj çështjeje nga Komisioni për Drogat Narkotike dhe Këshilli Social - Ekonomik, Sekretari i

Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara përgatiti tekstin fillestar të një Projekt-konvente kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe Lëndëve Psikotrope. Në bazë të komenteve të bëra për këtë nga Qeveritë dhe të diskutimeve për këtë projekt nga Komisioni për Drogat Narkotike në sesionin e tij të tridhjetë e dy më 1987, Sekretari i Përgjithshëm përgatiti një dokument të konsoliduar pune që iu shpërnda të gjitha Qeverive në prill 1987, i cili u shqyrtua në dy sesionet e grupit të hapur ndërqeveritar të ekspertëve. Më 7 dhjetor 1987 Asambleja e Përgjithshme miratoi Rezolutën 42/111 që jepte udhëzime të mëtejshme për avancimin e përgatitjes së Projektkonventës. Meqënëse koha që kishte në dispozicion grupi i ekspertëve nuk lejonte shqyrtim të plotë të të gjitha neneve, Asambleja e Përgjithshme i kërkoi Sekretarit të Përgjithshëm të shqyrtonte thirrjen edhe të një grupi tjetër ndërqeveritar me ekspertë, që të mblidhej gjatë dy javëve që do të paraprinin fillimin e sesionit të dhjetë të veçantë të Komisionit për Drogat Narkotike në shkurt 1988, për të vazhduar rishikimin e dokumentit të punës për Projektkonventën kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe Lëndëve Psikotrope dhe, po të ishte e mundur, të arrinte në një marrëveshje për Konventën. Në sesionin e dhjetë të veçantë të tij, mbajtur në Vjenë nga 8 deri më 19 shkurt 1988, Komisioni për Drogat Narkotike rishikoi tekstin e Projekt konventës dhe vendosi që disa nene të tij t'i referoheshin Konferencës që do të mblidhej për të miratuar Konventën. Komisioni gjithashtu i rekomandoi Këshillit Social-Ekonomik disa veprime për të çuar më tej përgatitjen e Projektkonventës.

3. Këshilli Social - Ekonomik, me anë të Rezolutës së tij 1988/8 të 25 Majit 1988 pasi u njoh me punën përgatitore të ndërmarrë në pajtim me Rezolutën 39/141 të Asamblesë së Përgjithshme nga organet kompetente të Kombeve të Bashkuara, vendosi "që të thërrasë, në përputhje me nenin 62 paragrafi 4, të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe brenda dispozitave të Rezolutës 366 (IV) të 3 Dhjetorit 1949 të Asamblesë së Përgjithshme, një konferencë të të plotfuqishmeve për miratimin e një Konvente kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe Lëndëve Psikotrope. "Në bazë të vendimit të tij 1988/120, i marrë gjithashtu më 25 maj 1988, Këshilli vendosi që Konferenca të mbahej në Vjenë në datat 25 nëntor - 20 dhjetor 1988 dhe që Sekretari i Përgjithshëm t'u dërgonte ftesë për të marrë pjesë në Konferencë atyre të cilët kishin qenë të ftuar për të marrë pjesë në Konferencën Ndërkombëtare mbi përdorimin e drogës dhe trafikun e paligjshëm, mbajtur në Vjenë nga 17 deri më 29 qershor 1987.

4. Në bazë të Rezolutës së tij 1988/8, Këshilli Social - Ekonomik gjithashtu vendosi të thërrasë në Konferencë një grup rishikimi që të rishikonte projekt tekstet e disa neneve dhe Projektkonventën në tërësi me qëllim që të arrihej një konsistencë e përgjithshme e tekstit që do t'i paraqitej Konferencës. Grupi i Rishikimit të Projektkonventës u mblodh në Zyrën e Kombeve të Bashkuara në Vjenë nga datat 27 qershor deri më 8 korrik 1988 dhe miratoi një raport për Konferencën (E/CONF.82/3).

5. Konferenca e Kombeve të Bashkuara për miratimin e një Konvente kundër drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope u mblodh në Neue Hofburg të Vjenës nga datat 25 nëntor deri më 29 dhjetor 1988.

6. Në përputhje me rezolutën 1988/8 të 25 Majit 1988 të Këshillit Social-Ekonomik dhe vendimit të tij 1988/120 të së njëjtës datë, Sekretari i Përgjithshëm ftoi në Konferencë:

(a) të gjithë shtetet;

(b) Namibinë, e përfaqësuar nga Këshilli i Kombeve të Bashkuara për Namibinë;

(c) përfaqësuesit e organizatave, që kanë ftesë të përhershme nga Asambleja e Përgjithshme për të marrë pjesë në sesionet dhe punimet e të gjitha konferencave ndërkombëtare të mbajtura nën kujdesin e saj në rolin e vëzhguesve, që të marrin pjesë në Konferencë në këtë rol, në përputhje me Rezolutat 3237 (XXIX) të 22 nëntorit 1974 dhe 31/152 të 20 dhjetorit 1976 të Asamblesë;

(d) përfaqësuesit e lëvizjeve nacionalçlirimtare të njohura në rajonin e saj nga Organizata e Unitetit Afrikan që të merrnin pjesë në Konferencë në rolin e vëzhguesve, në përputhje me Rezolutën 3280 (XXIX) të 10 Dhjetorit 1974 të Asamblesë së Përgjithshme;

(e) agjencitë e specializuara dhe Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike, si dhe organet e interesuara të Kombeve të Bashkuara, që të përfaqësoheshin në Konferencë;

(f) të gjitha organizatat e interesuara ndërqeveritare që të përfaqësoheshin me vëzhgues në Konferencë;

(g) organizatat e interesuara joqeveritare me votë konsultative në Këshillin Social-Ekonomik dhe organizatat e tjera të interesuara joqeveritare, që mund të jepnin një kontribut të veçantë në punimet e Konferencës, që të përfaqësoheshin me vëzhgues në Konferencë.

7. Në Konferencë morën pjesë delegacionet e 106 Shteteve të mëposhtme:

Afganistani, Shqipëria, Algjeria, Argjentina, Australia, Austria, Bahamas, Bahrain, Bangladeshi, Barbados, Belgjika, Bolivia, Botsvana, Brazili, Bullgaria, Burma, Republika Socialiste Sovjetike e Bjellorusisë, Kameruni, Kanadaja, Kepi i Gjelbër, Kili, Kina, Kolumbia, Kosta Rika, Kepi i Fildishtë, Kuba, Qipro, Çekosllavakia, Danimarka, Republika Domenikane, Ekuadori, Egjipti, Etiopia, Finlanda, Franca, Republika Demokratike Gjermane, Republika Federale e Gjermanisë, Gana, Greqia, Guatemala, Guinea, Selia e Shenjtë, Hondurasi, Hungaria, India, Indonezia, Irani (Republika Islamike), Iraku, Irlanda, Izraeli, Italia, Xhamajka, Japonia, Jordania, Kenia, Kuvajti, Xhamahirija Arabe e Libisë, Luksemburgu, Madagaskari, Malajzia, Malta, Mauritania, Mauriciusi, Meksiko, Monako, Maroku, Nepali, Hollanda, Zelanda e Re, Nikaragua, Nigeria, Norvegjia, Omani, Pakistani, Panamaja, Guinea e Re Papua, Paraguaj, Peruja, Filipinet, Polonia, Portugalia, Katari, Republika e Koresë, Arabia Saudite, Senegali, Spanja, Sri Lanka, Sudani, Surinami, Suedia, Zvicra, Tailanda, Tunizia, Turqia, Republika Socialiste Sovjetike e Ukrainës, Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike, Emiratet e Bashkuara Arabe, Mbreteria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, Republika e Bashkuar e Tanzanisë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Uruguaji, Venezuela, Vietnami, Jemeni, Jugosllavia dhe Zaireja.

8. Përfaqësuesit e lëvizjeve nacionalçlirimtare të mëposhtme, të ftuara në Konferencë nga Sekretari i Përgjithshëm, ishin të pranishme dhe morën pjesë siç parashikohet në rregullat e procedurës së Konferencës (E/ CONF. 82/7): Kongresi Pan- afrikan i Azanisë dhe Organizata Popullore e Afrikës Jugperëndimore.

9. Përfaqësuesit e agjencive të mëposhtme, të specializuara, të ftuara në Konferencë nga Sekretari i Përgjithshëm, ishin të pranishëm dhe morën pjesë siç parashikohet në rregullat e procedurës së Konferencës: Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil, Organizata Ndërkombëtare e Punës, Organizata Arsimore, Shkencore dhe Kulturore e Kombeve të Bashkuara, Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin Industrial dhe Organizata Botërore e Shëndetit.

10. Përfaqësuesit e organizatave të tjera ndërqeveritare të poshtëshënuara, të ftuara në Konferencë nga Sekretari i Përgjithshëm, ishin të pranishme dhe morën pjesë siç parashikohet në rregullat e procedurës së Konferencës: Qendra e Studimeve dhe e Trajnimit për Sigurimin Arab, Byroja e Planit të Kolombos, Këshilli i Evropës, Këshilli për Bashkëpunimin e Doganave, Komuniteti Ekonomik Evropian, Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale, Liga e Shteteve Arabe dhe Marrëveshja Jugamerikane për Drogat Narkotike dhe Lëndët Psikotrope.

11. Përfaqësuesit e këtyre organeve të interesuara të Kombeve të Bashkuara dhe organizmave përkatëse, të ftuara në Konferencë nga Sekretari i Përgjithshëm, ishin të pranishëm dhe morën pjesë siç parashikohet në rregullat e procedurës së Konferencës: Qendra për Zhvillim Social dhe Çështje Humanitare, Bordi Ndërkombëtar për Kontrollin e Narkotikëve, Instituti i Kombeve të Bashkuara për Azinë dhe Lindjen e Largme për Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e Autorëve të Veprimtarive të Kundërligjshme dhe Fondi i Kombeve të Bashkuara për Kontrollin e Përdorimit të Drogës.

12. Vëzhguesit nga organizatat e mëposhme joqeveritare, të ftuara në Konferencë nga Sekretari i Përgjithshëm, ishin të pranishëm dhe morën pjesë siç parashikohet në rregullat e procedurës së Konferencës: Komuniteti Ndërkombëtar i Bahajve, Karitasi Ndërkombëtar, Qendra Italiane e Solidaritetit, Komunitetet Terapeutike të Kolumbisë, Bordi Koordinues i Organizatave Çifute, Kruz Blanka Panama, Programi për Parandalimin e Përdorimit të Drogës, Bashkimi Evropian i Grave, Integrative Drogenhilfe a.d. Fachhochschule Ffm.e.v., Federata Ndërkombëtare Abolicioniste, Shoqata Ndërkombëtare e Reklamave, Shoqata Ndërkombëtare e Transportit Ajror, Shoqata Ndërkombëtare e Juristëve Demokratë, Shoqata Ndërkombëtare e Klubeve të Luaneve, Byroja Ndërkombëtare Katolike e Fëmijës, Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë, Konfederata

Ndërkombëtare e Sindikatave të Lira, Këshilli Ndërkombëtar për Gratë, Këshilli Ndërkombëtar për Alkoolin dhe Toksikimin, Federata Ndërkombëtare e Biznesit dhe Grave Profesioniste, Federata Ndërkombëtare e Punëtorëve Sociale, Federata Farmaceutike Ndërkombëtare, Shoqata Ndërkombëtare e Shkollave, Agjencia Afrikane e Shpëtimit Islamik, Trusti për Trajtimin, Trajnimet dhe Kërkimet për Detoksifikimin nga Opiumi, Pace International Affairs e Mbretërisë së Bashkuar, Pax Romana, Soroptimist International, Shoqata Botërore e Shoqërueseve Vajza dhe Skauteve Vajza, Bashkimi Botëror i Organizatave Katolike të Grave dhe Komiteti Ndërkombëtar Zonta.

13. Konferenca zgjodhi si President Z.Guillermo Bedregat Gutierrez (Bolivi).

14. Konferenca zgjodhi si zëvendëspresidentë përfaqësuesit e këtyre shteteve: Algjeri, Argjentinë, Bahamas, Kinë, Kepi i Fildishtë, Francë, Republika Islamike e Iranit, Japoni, Kenia, Malajzi, Meksiko, Marok, Nigeri, Pakistan, Filipine, Senegal, Sudan, Suedi, Turqi, Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike, Mbreteria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe e Irlandës së Veriut, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Venezuelë dhe Jugosllavi.

15. Konferenca zgjodhi si Raporter të Përgjithshëm znj.Mervat Tallawy (Egjipt).

16. Konferenca krijoi Komitetet e mëposhtme:

Komiteti i Përgjithshëm

Kryetar: Presidenti i Konferencës

Anëtarë: Presidenti dhe zëvendëspresidentët e Konferencës, Raporteri i Përgjithshëm i Konferencës, Kryetarët e Komiteteve të Përgjithshme dhe Kryetari i Komitetit Hartues.

Komitetet Gjithpërfshirëse

Komiteti I

Kryetar: Z.Gioacchino Polimeri (Itali)

Zëvendës Kryetar: Z.M.A.Hena (Bangladesh)

Raporter: Z.Oskar Hugler (Republika Demokratike Gjermane)

Komiteti II

Kryetar: Z.Istvan Bayer (Hungari)

Zëvendëskryetar: Z.L.H.J.B. van Gorkom (Hollandë)

Raporter: Znj.Yolanda Fernandez Ochoa (Kosta Rika)

Komteti Hartues

Kryetar: Z.M.V.N.Rao (Indi)

Zëvendës Kryetar: Z.Hashem M.Kuraa (Egjipt)

Anëtarë: Kryetari i Komitetit Hartues dhe përfaqësuesit e këtyre Shteteve: Austri, Botsvana, Kanada, Kinë, Kolumbi, Çekosllavaki, Egjipt, Francë, Ganë, Irak, Peru, Senegal, Spanjë dhe Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike.

Raporterët e Komiteteve Gjithpërfshirëse morën pjesë ex officio në punën e Komitetit Hartues në përputhje me rregullin 49 të rregullave të procedurës së Konferencës.

Komiteti i Kredencialeve

Kryetar: Z.Edouard Molitor (Luksemburg)

Anëtarë: Përfaqësuesit e këtyre Shteteve: Bolivi, Botsvana, Kinë, Kepi i Fildishtë, Xhamajkë, Luksemburg, Tailandë, Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

17. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara u përfaqësua nga zonjusha Margaret J.Ansti, Nënsekretare e Përgjithshme, Drejtore e Përgjithshme e Zyrës së Kombeve të Bashkuara në Vjenë. Sekretari i Përgjithshëm emëroi si Sekretar Ekzekutiv Z.Francisko Ramos - Galino, Drejtor i Seksionit të Drogave Narkotike.

18. Konferenca kishte përpara raportin e Grupit të Rishikimit i mbledhur në pajtim me Rezolutën 1988/8 të 25 Majit 1988 të Këshillit Social - Ekonomik (E.CONF.82/3). Përveç një bilanci të punës së Grupit të Rishikimit, raporti përmbante propozime, që i ishin parashtruar Grupit të Rishikimit në lidhje me Projektkonventën që do të shqyrtonte Konferenca, dhe tekstin e Projektkonventës kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe Lëndëve Psikotrope (Shtojca II). Kjo Projektkonventë përbënte propozimin bazë që do të shqyrtonte Konferenca.

19. Gjatë punimeve të saj, Konferenca ndau nenet që përmbante Projektkonventa dy Komiteteve Gjithpërfshirëse (Komitetit I dhe Komitetit II). Nenet 1 deri 5 bashkë me parathënien iu dhanë Komitetit I dhe pjesa tjetër e neneve Komitetit II. Pasi ranë dakord për tekstin e një neni të caktuar, Komitetet Gjithpërfshirëse ia referuan atë Komitetit Hartues. Komitetet Gjithpërfshirëse i raportuan Konferencës për rezultatin e punës së tyre, ndërsa Komiteti Hartues i paraqiti Konferencës një tekst të plotë të Projektkonventës kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe Lëndëve Psikotrope (E.CONF/82/13).

20. Në bazë të diskutimeve të depozituara në dokumentacionin e Konferencës(E.CONF.82/SR.1 deri 8) dhe të Komiteteve Gjithpërfshirëse (E/CONF.82/C.1 SR.1 deri 33) dhe E/CONF.82/C.2SR.1 deri 34) dhe të raporteve të Komiteteve Gjithpërfshirëse (E.CONF/82/11 dhe E/CONF.82/12) dhe të Komitetit Hartues (E/CONF.82/13), Konferenca përpiloi Konventën e mëposhtme:

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe Lëndëve Psikotrope.

21. Konventa e mësipërme, që është subjekt i ratifikimit, pranimit, miratimit ose aktit të konfirmimit formal, dhe që duhet të mbetet e hapur për t'u pranuar nga të tjerët, u miratua nga Konferenca më 19 dhjetor 1988 dhe u la e hapur për t'u nënshkruar më 20 dhjetor 1988, në përputhje me dispozitat e saj, deri më 28 shkurt 1989, në Zyrën e Kombeve të Bashkuara në Vjenë dhe, më pas, deri me 20 dhjetor 1989, në Selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork, nën kujdesin e Sekretarit të Përgjithshëm.

22. Konferenca, gjithashtu, miratoi rezolutat e mëposhtme të cilat i bashkëngjiten këtij Akti Final:

1. Shkëmbimi i informacionit

2. Zbatimi i përkohshëm i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe Lëndëve Psikotrope.

3. Sigurimi i burimeve të nevojshme për Seksionin e Drogave Narkotike dhe sekretariatit të Bordit Ndërkombëtar për Kontrollin e Narkotikëve për t'i mundësuar ata që të kryejnë detyrat që u janë besuar në bazë të Traktateve Ndërkombëtare të Kontrollit të Drogës.

DUKE DËSHMUAR SA MË SIPËR, përfaqësuesit e nënshkruan këtë Akt Final.

NËNSHKRUAR NË VJENË, sot më datë njëzet dhjetor një mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë, në një kopje të vetme, që do të depozitohet te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, në gjuhët arabe, kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle, dhe secila prej tyre është e njëjtë me origjinalin.

REZOLUTAT E MIRATUARA NGA KONFERENCA E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR MIRATIMIN E NJË KONVENTE KUNDËR TRAFIKUT TË PALIGJSHËM TË DROGAVE NARKOTIKE DHE LËNDËVE PSIKOTROPE

REZOLUTA I
SHKËMBIMI I INFORMACIONIT

Konferenca e Kombeve të Bashkuara për miratimin e një Konvente kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe Lëndëve Psikotrope,

Duke tërhequr vëmendjen tek Rezoluta III, e miratuar nga Konferenca e Kombeve të Bashkuara e vitit 1961 për Miratimin e një Konvente të vetme mbi drogat narkotike, në të cilën iu kushtua vëmendje rëndësisë që ka dokumentacioni teknik i Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale mbi trafikantët ndërkombëtare të drogës dhe përdorimit të këtij dokumentacioni nga ana e kësaj organizate për qarkullimin e përshkrimeve të këtyre trafikantëve;

Duke pasur parasysh mekanizmin e përcaktuar nga Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale, për shkëmbimin në kohë dhe të efektshëm të informacionit për hetimin e krimeve midis autoriteteve policore në shkallë botërore;

Rekomandon që autoritetet policore duhet të përdorin në një shkallë sa më të gjerë që të jetë e mundur dokumentacionin dhe sistemin e komunikimit të Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale, me qëllim që të arrihen synimet e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe Lëndëve Psikotrope.

REZOLUTA 2

ZBATIMI I PËRKOHSHËM I KONVENTËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA KUNDËR TRAFIKUT TË PALIGJSHËM TË DROGAVE NARKOTIKE DHE LËNDËVE PSIKOTROPE

Konferenca e Kombeve të Bashkuara për miratimin e një Konvente kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe Lëndëve Psikotrope.

1. Nxit shtetet, në masën që kanë mundësi, që të përshpejtojnë hapat për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe Lëndëve Psikotrope me qëllim që ajo të hyjë në fuqi sa më shpejt që të jetë e mundur.

2. Fton shtetet, në masën që kanë mundësi, të zbatojnë përkohësisht masat e parashikuara nga Konventa në pritje që secila prej tyre të hyjë në fuqi.

3. Kërkon nga Sekretar i Përgjithshëm që t'ia transmetojë këtë Rezolutë Këshillit Social - Ekonomik dhe Asamblesë së Përgjithshme.

REZOLUTA 3

SIGURIMI I BURIMEVE TË NEVOJSHME PËR SEKSIONIN E DROGAVE NARKOTIKE DHE PËR SEKRETARIATIN E BORDIT NDËRKOMBËTAR TË KONTROLLIT TË NARKOTIKËVE ME QËLLIM QË ATA TË MUNDËSOHEN TË KRYEJNË DETYRAT QË U JANË BESUAR NË BAZË TË TRAKTATEVE NDËRKOMBËTARE TË KONTROLLIT TË DROGËS

Konferenca e Kombeve të Bashkuara për miratimin e një Konvente kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe Lëndëve Psikotrope,

Duke pranuar që Konventa e Vetme mbi Drogat Narkotike, 1961, ajo Konventë siç është ndryshuar nga Protokolli i vitit 1972 për ndryshimin e Konventës së Vetme mbi Drogat Narkotike, 1961, dhe Konventa mbi Lëndët Psikotrope, 1971, të mbeten baza e përpjekjeve ndërkombëtare për kontrollin e drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope, dhe që zbatimi rigoroz si nga ana e qeverive ashtu edhe nga e organeve ndërkombëtare të kontrollit të Kombeve të Bashkuara i detyrimeve që rrjedhin nga Konventat është thelbësor për arritjen e qëllimeve të tyre;

Duke pasur parasysh se Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe Lëndëve Psikotrope do të krijojë detyrime të mëtejshme për Qeveritë, Komisionin e Drogave Narkotike, Bordin Ndërkombëtar të Kontrollit të Narkotikëve dhe sekretariatet e tyre, dhe do të kërkojë shpenzime të mëtejshme financiare nga ana e tyre;

Thellësisht e shqetësuar nga ndikimi që kanë sjellë reduktimet kohët e fundit të personelit dhe të buxhetit në aftësinë e Seksionit të Drogave Narkotike dhe të sekretariatit të Bordit Ndërkombëtar të Kontrollit të Narkotikëve për të kryer plotësisht programin e tyre të punës për të cilin ata kanë mandat,

1. Nxit të gjitha shtetet anëtare të marrin hapat e duhura në Asamblenë e Përgjithshme, si edhe në organet financiare të Asamblesë, për të përcaktuar përparësinë e duhur dhe për të miratuar shumat e nevojshme buxhetore, me qëllim që t'u sigurojnë Seksionit të Drogave Narkotike dhe Sekretariatit të Bordit Ndërkombëtar të Kontrollit të Narkotikëve, burimet e nevojshme për të kryer plotësisht detyrat që u janë besuar në bazë të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe Lëndëve Psikotrope, Konventës së Vetme mbi Drogat Narkotike, 1961, të asaj Konvente siç është ndryshuar nga protokolli i vitit 1972 për ndryshimin e Konventës së Vetme mbi Drogat Narkotike, 1961, dhe të Konventës mbi lëndët psikotrope, 1971;

2. Kërkon që Sekretari i Përgjithshëm të ndërmarrë hapat e nevojshme, brenda kompetencave të tij, që të bëjë efektive dispozitat e paragrafit 1 sa më sipër.

KONVENTA

E KOMBEVE TË BASHKUARA KUNDËR TRAFIKUT TË PALIGJSHËM TË DROGAVE NARKOTIKE DHE LËNDËVE PSIKOTROPE

Miratuar nga Konferenca në mbledhjen e saj të 6-të të plenare më 19 dhjetor 1988.

Palët në këtë Konventë,

Thellësisht të shqetësuara nga përmasat dhe tendenca në rritje e prodhimit të paligjshëm të drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope, të kërkesave për to dhe të trafikut të tyre, gjë që përbën një kërcënim serioz për shëndetin dhe mirëqenien e qenieve njerëzore dhe ka ndikim të pafavorshëm ndaj themeleve ekonomike, kulturore dhe politike të shoqërisë;

Thellësisht të shqetësuara, gjithashtu, nga depërtimet gjithnjë në rritje në grupe të ndryshme shoqërore të Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe Lëndëve Psikotrope, dhe veçanërisht nga fakti që në shumë pjesë të botës fëmijët përdoren si treg i paligjshëm përdoruesish drogash dhe për qëllime të prodhimit, shpërndarjes dhe tregtimit të paligjshëm të drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope që përbën një rrezik me pasoja të pallogaritshme;

Duke ditur lidhjet midis trafikut të paligjshëm dhe veprimtarive të tjera të krimit të organizuar që minojnë ekonomitë legjitime dhe kërcënojnë stabilitetin, sigurinë dhe sovranitetin e shteteve;

Duke e ditur, gjithashtu, se trafiku i paligjshëm është një veprimtari ndërkombëtare kriminale, ndalimi i së cilës kërkon vëmendje urgjente dhe përparësinë më të lartë;

Të vetëdijshëm se trafiku i paligjshëm sjell përfitime të mëdha financiare dhe pasuri që i mundësojnë organizatat kriminale midis shteteve të depertojnë, të ndotin dhe të korruptojnë struktura të qeverisë, biznesin e ligjshëm tregtar dhe financiar dhe shoqërinë në të gjitha nivelet e saj;

Të vendosur për t'i privuar personat që merren me trafik të paligjshëm nga fitimet që sjellin veprimtaritë të tyre kriminale dhe duke eleminuar kështu stimulin e tyre kryesor që i nxit në këto veprimtari;

Duke dëshiruar të eleminojnë shkaqet bazë të problemit të përdorimit të drogave narkotike dhe të lëndëve psikotrope, duke përfshirë kërkesën për këto droga dhe lëndë dhe përfitimet shumë të mëdha që rrjedhin nga trafiku i paligjshëm;

Duke menduar se është e nevojshme marrja e masave për monitorimin e disa lëndëve, duke përfshirë prekursoret, kimikatet dhe tretësit, që përdoren në prodhimin e drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope, gjendja e gatshme e të cilave ka çuar në rritjen e prodhimit klandestin të këtyre drogave dhe lëndëve;

Të vendosur për të përmirësuar bashkëpunimin ndërkombëtar për ndalimin e trafikut të paligjshëm me rrugë detare;

Duke pranuar se zhdukja e trafikut të paligjshëm është një përgjegjësi kolektive e të gjitha Shteteve dhe se, për këtë qëllim, nevojitet një veprim i bashkërenduar në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar;

Duke njohur aftësinë e Kombeve të Bashkuara në fushën e kontrollit të drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope dhe me dëshirën që organet ndërkombëtare që merren me këtë kontroll të jenë brenda kuadrit të asaj organizate;

Duke riafirmuar parimet dejtuese të traktateve ekzistuese në fushën e drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope dhe sistemin e kontrollit që ato mishërojnë;

Duke ditur nevojën për forcimin dhe plotësimin e masave të parashikuara nga Konventa e Vetme mbi Drogat Narkotike, 1961, nga ajo Konvente siç është ndryshuar nga Protokolli i vitit 1972 mbi Ndryshimin e Konventës së Vetme mbi Drogat Narkotike, 1961, dhe Konventës së vitit 1971 mbi lëndët psikotrope, për të kundërshtuar përmasat dhe shtirjen e trafikut të paligjshëm dhe rjedhojat e tij serioze;

Duke ditur gjithashtu rëndësinë e forcimit dhe të rritjes së mjeteve efektive ligjore për bashkëpunimin ndërkombëtar në çështje kriminale për të ndaluar veprimtaritë kriminale ndërkombëtare të trafikut të paligjshëm;

Duke dëshiruar nënshkrimin e një Konvente ndërkombëtare të gjithanshme, efektive dhe

operative, që të drejtohet, në mënyrë të veçantë, kundër trafikut të paligjshëm dhe që të trajtojë aspektet e ndryshme të problemit në tërësi, në mënyrë të veçantë ato aspekte që nuk parashikohen në traktatet ekzistuese në fushën e drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope,

vendosën si më poshtë:

Neni 1

Përkufizimet

Përjashtuar rastet kur është shënuar shprehimisht ndryshe ose kur konteksti e kërkon ndryshe, në gjithë tekstin e kësaj Konvente do të përdoren përkufizimet e mëposhtme:

(a) "Bordi" nënkupton Bordin Ndërkombëtar për Kontrollin e Narkotikëve, i themeluar nga Konventa e Vetme mbi Drogat Narkotike, 1961, dhe ajo Konvente siç është ndryshuar nga protokolli i vitit 1972 mbi ndryshimin e Konventës së Vetme mbi Drogat Narkotike, 1961;

(b) "Bima kanabis" nënkupton çdo lloj bime të llojit kanabis;

(c) "Shkurre kokaine" nënkupton bimë të çdo lloji të klasës eritroksilon;

(d) "Transportues tregtar" nënkupton çdo njeri ose çdo subjekt publik, privat ose subjekt tjetër që merret me transportimin e njerëzve, mallrave ose postave kundrejt pagesës, qirasë ose ndonjë fitimi tjetër;

(e) "Komisioni" nënkupton Komisionin mbi Drogat Narkotike të Këshillit Social - Ekonomik të Kombeve të Bashkuara;

(f) "Konfiskimi", që përfshin gjobën atje ku është e zbatueshme, nënkupton marrjen e përhershme të pasurisë me urdhër të gjykatës ose të një autoriteti tjetër kompetent;

(g) "Shpërndarje e kontrolluar" nënkupton teknikën e lejimit të ngarkesave të paligjshme ose të dyshuara të drogave narkotike, lëndëve psikotrope, lëndëve të parashikuara në tabelën I dhe tabelën II që i bashkëngjiten kësaj Konvente ose lëndëve zëvendësuese të tyre , që të dalin, të kalojnë ose të hyjnë në territorin e një ose më shumë vendeve, me dijeninë dhe nën mbikqyerjen e autoriteteve të tyre kompetente, me qëllim që të identifikohen personat e përfshirë në kryerjen e veprimtarive të kundërligjshme, të parashikuara në përputhje me nenin 3 paragrafi 1, të Konventës;

(j) "Konventa 1961" nënkupton Konventën e vetme mbi drogat narkotike, 1961;

(i) "Konventa 1961 e ndryshuar" nënkupton Konventën e vetme mbi drogat narkotike, 1961, të ndryshuar nga Protokolli i vitit 1972 mbi Ndryshimin e Konventës së Vetme mbi Drogat Narkotike, 1961;

(j) "Konventa 1971" nënkupton Konventën mbi lëndët psikotrope, 1971,

"Këshilli" nënkupton Këshillin Social - Ekonomik të Kombeve të Bashkuara ;

(l) "Ngrirje" ose "kapje" nënkupton ndalimin e përkohshëm të transferimit, shkëmbimit, sistemimit ose lëvizjes së pasurisë ose marrjen përkohësisht nën kujdestari ose nën kontroll të pasurisë në bazë të një urdhri të lëshuar nga gjykata ose një autoritet kompetent;

(m) "Trafik i paligjshëm" nënkupton veprimtaritë e kundërligjshme të parashikuara në nenin 3, paragrafi 1 dhe 2, të kësaj Konvente;

(n) "Drogë narkotike" nënkupton çdo lloj lënde, natyrore ose sintetike, e paparashikuar në listat I dhe II të Konventës së Vetme mbi Drogat Narkotike, 1961, dhe të asaj Konvente të ndryshuar nga Protokolli i vitit 1972 mbi ndryshimin e Konventës së Vetme mbi Drogat Narkotike, 1961;

(o) "Hashashi" nënkupton bimën e llojit Papaver somniferum L;

(p) "Fitime" nënkupton çdo lloj pasurie që rrjedh ose përftohet, drejpërsëdrejti ose tërthorazi, nga kryerja e një veprimtarie të kundërligjshme e parashikuar në përputhje me nenin 3, paragrafi 1;

(q) "Pasuri" nënkupton pasuri të çdo lloji, fizike ose jo, të tundshme ose të patundshme, të prekshme ose jo, dhe dokumentet ligjore ose dokumentet që vërtetojnë të drejtën ndaj këtyre pasurive ose interesin në to;

(r) "Lëndë psikotrope" nënkupton çdo lloj lënde, natyrore ose sintetike, ose çdo lloj materiali natyral që parashikohen në Listat I, II, III dhe IV të Konventës mbi lëndët psikotrope, 1971;

(s) “Sekretari i Përgjithshëm” nënkupton Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara;

(t) “Tabela I dhe tabela II” nënkuptojnë listat me numrat korrespondues të lëndëve, që i bashkëngjiten kësaj Konvente, të ndryshuara herëpashere në përputhje me nenin 12;

(u) “Shtet tranzit” nënkupton një shtet nëpër territorin e të cilit kalojnë droga narkotike, lëndë psikotrope dhe lëndë të paligjshme të parashikuara në tabelën I dhe tabelën II, territor i cili nuk është as vendi i origjinës as vendi i destinacionit të tyre të fundit.

Neni 2

Sfera e veprimtarisë së Konventës

1. Qëllimi i kësaj Konvente është që të nxisë bashkëpunimin midis Palëve në mënyrë që ato të mund t'i trajtojnë në mënyrë më të efektshme aspektet e ndryshme të Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe Lëndëve Psikotrope që ka marrë përmasa ndërkombëtare. Gjatë zbatimit të detyrimeve të tyre, që rrjedhin nga kjo Konventë, Palët duhet të marrin masat e nevojshme, duke përfshirë masa legjislative dhe administrative, në përputhje me dispozitat themelore të sistemeve ligjore respektive të vendeve të tyre.

2. Palët duhet të zbatojnë detyrimet e tyre, që rrjedhin nga kjo Konventë, në atë mënyrë që të jetë në përputhje me parimet e barazisë së pavarësisë dhe integritetit territorial të Shteteve dhe parimit të mosndërhyrjes në punët e brendshme të Shteteve të tjerë.

3. Pala nuk duhet të ndërmarrë në territorin e një Pale tjetër ushtrimin e juridiksionit dhe kryerjen e funksioneve që, në bazë të ligjit të vendit të vet, i rezervohen vetëm autoriteteve të asaj pale tjetër.

Neni 3

Veprimtaria e kundërligjshme dhe sanksionet

1. Secila Palë, sipas nevojës, duhet të adoptojë masat për të parashikuar si veprimtari kriminale në bazë të ligjit të vendit të vet, kur kryhet në mënyrë të qëllimshme:

(a) (i) prodhimin, fabrikimin, ekstraktin, përgatitjen, ofrimin, ofrimin për shitje, shpërndarjen, shitjen, përhapjen në çfarëdo kushtesh qofshin, shpërblimin e ndërmjetësit, dërgimin tranzit, transportin, importimin ose eksportimin e çfarëdolloj droge narkotike ose çfarëdolloj lënde psikotrope në kundërshtim me dispozitat e Konventës 1961, Konventës 1961 të ndryshuar ose Konventës 1971;

(ii) kultivimin e hashashit, të shkurres së kokainës ose bimës së kanabisit për prodhimin e drogave narkotike në kundërshtim me dispozitat e Konventës 1961 dhe Konventës 1961 të ndryshuar;

(iii) mbajtjen ose blerjen e çfarëdolloj droge narkotike ose lënde psikotrope me qëllimin e ushtrimit të ndonjërës prej veprimtarive të renditura më sipër (i);

(iv) prodhimin, transportin ose shpërndarjen e pajisjve, materialeve ose lëndëve të parashikuara në tabelën I dhe tabelën II, duke ditur se ato do të përdoren në ose për kultivimin, prodhimin ose fabrikimin e paligjshëm të drogave narkotike ose lëndëve psikotrope;

(v) organizimin, drejtimin ose financimin e ndonjërës prej veprimtarive të kundërligjshme, të parashikuara sa më sipër (i), (ii), (iii) ose (iv);

(b) (i) shkëmbimin ose transferimin e pasurive duke ditur se këto pasuri kanë rrjedhur nga një veprimtari të kundërligjshme ose veprimtari të kundërligjshme të parashikuara në përputhje me nënparagrafin (a) të këtij paragrafi ose nga akti i pjesëmarrjes në një veprimtari të kundërligjshme ose veprimtari të kundërligjshme të tilla, me qëllimin e fshehjes ose mbulimin e origjinës së paligjshme të pasurive ose me qëllimin e dhënies së ndihmës ndonjë personi që është përfshirë në kryerjen e një veprimtarie të kundërligjshme ose veprimtarive të kundërligjshme të tilla, për t'iu shmangur pasojave ligjore të veprimeve të tij;

(ii) fshehjen ose mbulimin e natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, sistemimit, lëvizjes, të të drejtave në lidhje me pasurinë ose pronësinë e pasurisë, duke ditur se një pasuri e tillë ka rrjedhur nga një veprimtari e kundërligjshme ose veprimtari të kundërligjshme të parashikuara në përputhje me nënparagrafin (a) të këtij paragrafi ose nga akti i pjesëmarrjes në një veprimtari të kundërligjshme ose veprimtari të kundërligjshme të tilla.

(a) Në varësi të parimeve të veta kushtetuese dhe të koncepteve bazë të sistemit të vet ligjor:

(i) përvetësimin, zotërimin ose përdorimin e pasurive, duke e ditur në kohën e marrjes, se këto pasuri kanë rrjedhur nga një veprimtari e kundërligjshme ose veprimtari të kundërligjshme të parashikuara në përputhje me nënparagrafin (a) të këtij paragrafi ose nga akti i pjesëmarrjes në një veprimtari të kundërligjshme ose veprimtari të kundërligjshme të tilla;

(ii) zotërimin e pajisjeve ose materialeve ose lëndëve të parashikuara në tabelën I dhe tabelën II, duke ditur se ato përdoren apo do të përdoren në ose për kultivimin, prodhimin ose fabrikimin e paligjshëm të drogave narkotike ose lëndëve psikotrope;

(iii) nxitjen ose shtypjen publikisht të të tjerëve, me çfarëdo mjeti, për të kryer ndonjërën prej veprimtarive të kundërligjshme të parashikuara në përputhje me këtë nen ose për të përdorur droga narkotike ose lëndë psikotrope në mënyrë të paligjshme;

(iv) pjesëmarrjen, shoqërimin ose komplotimin për të kryer, përpjekjet për të kryer dhe dhënien e ndihmës, të mbështetjes, lehtësimin dhe këshillimin për të kryer ndonjërën prej veprimtarive të kundërligjshme të parashikuara në përputhje me këtë nen.

2. Në varësi të parimeve të veta kushtetuese dhe koncepteve bazë të sistemit të vet ligjor, secila Palë duhet të adoptojë masa, sipas nevojës, për të parashikuar si veprimtari kriminale, në bazë të ligjit të vendit kur kryhet qëllimisht, zotërimin, blerjen ose kultivimin e drogave narkotike ose lëndëve psikotrope për përdorimin personal, në kundërshtim me dispozitat e Konventës 1961, Konventës 1961 të ndryshuar ose Konventës 1971.

3. Njohja, synimi ose qëllimi, që kërkohen si elemente të veprimtarisë së kundërligjshme të parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni, mund të konstatohen nga rrethana objektive faktike.

4. (a) Secila Palë duhet të bëjë që kryerja e veprimtarive të kundërligjshme të parashikuara në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, t'i nënshtrohet sanksioneve që llogarisin natyrën e rëndë të këtyre veprimtarive të kundërligjshme, siç janë burgimi ose forma e tjera të heqjes së lirisë, sanksione financiare dhe konfiskimi.

(b) Përveç dënimit ose ndëshkimit, për një veprimtari të kundërligjshme të parashikuar në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, Palët mund të parashikojnë që ndaj autorit të veprimtarisë së kundërligjshme të zbatohen masa të tilla si trajtimi, edukimi, kujdesi pas vuajtjes së dënimit, rehabilitimi ose integrimi përsëri në shoqëri .

(c) Pavarësisht nga nënparagrafet e mësipërm, në raste të përshtatshme të një natyre më të lehtë, Palët mund të parashikojnë, si alternativa ndaj dënimit ose ndëshkimit, masa të tilla si edukimi, rehabilitimi ose integrimi përsëri në shoqëri, si edhe trajtimi dhe kujdesi pas vuajtjes së dënimit kur autori i veprimtarisë së kundërligjshme është përdorues droge.

(d) Palët mund të parashikojnë,si alternativë ndaj dënimit ose ndëshkimit, ose përveç dënimit ose ndëshkimit të një veprimtarie të kundërligjshme të parashikuar në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, masa për trajtimin, edukimin, kujdesin pas vuajtjes së dënimit, rehabilitimin ose integrimin përsëri në shoqëri të autorit të veprimtarisë së kundërligjshme.

5. Palët duhet të sigurojnë që gjykatat dhe autoritetet e tjera kompetente, që kanë juridiksion të marrin parasysh rrethanat faktike që e bëjnë kryerjen e veprimtarive të kundërligjshme të parashikuara në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni veçanërisht të rënduar, si:

a) përfshirja në veprimtarinë e kundërligjshme të një grupi të organizuar kriminal ku bën pjesë autori i veprimtarisë së kundërligjshme;

b) përfshirja e autorit të veprimtarisë së kundërligjshme në veprimtari të tjera ndërkombëtare të krimit të organizuar;

c) përfshirja e autorit të veprimtarisë së kundaligjshme në veprimtari të tjera të paligjshme të ndihmuara nga kryerja e veprimtarisë së kundërligjshme.

d) përdorimi i dhunës ose armëve nga autori i veprimtarisë së kundërligjshme;

e) fakti që autori i veprimtarisë së kundërligjshme ka një detyrë publike dhe që veprimtaria e kundërligjshme lidhet me detyrën në fjalë;

f) viktimizimi ose përdorimi i të miturve;

g) fakti që veprimtaria e kundërligjshme kryhet në një institucion të vuajtjes së dënimit, në një institucion arsimor, në një qendër të shërbimeve sociale ose shumë pranë tyre apo në vende të tjera në të cilat nxënësit e shkollave dhe studentët shkojnë për veprimtari arsimore, sportive dhe sociale;

d) dënimi i mëparshëm, sidomos për veprimtari të kundërligjshme të ngjashme, qofshin të huaj apo vendas, në masën që lejohet nga ligji i vendit të Palës.

6. Palët duhet të përpiqen të sigurojnë që të gjitha fuqitë e nevojshme ligjore në bazë të ligjit të vendit të tyre, në lidhje me ndjekjen penale të personave për veprimtari të kundërligjshme të parashikuara në përputhje me këtë nen, të ushtrohen për të rritur në maksimum efektshmërinë e masave për zbatimin e ligjit përsa i përket atyre veprimtarive të kundërligjshme dhe në lidhje me nevojën për ndalimin e kryerjes së veprimtarive të tilla të kundërligjshme.

7. Palët duhet të sigurojnë që gjykatat dhe autoritetet e tjera kompetente të mbajnë parasysh natyrën e rëndë të veprimtarive të kundërligjshme të renditura në paragrafin 1 të këtij neni dhe rrethanat e renditura në paragrafin 5 të këtij neni, kur të shqyrtojnë mundësinë e lirimit më shpejt ose lirimit me kusht të personave të dënuar për veprimtari të tilla të kundërligjshme.

8. Secila Palë, kur ta shohë të përshtatshme, duhet të përcaktojë në legjislacionin e vendit të vet një ligj të plotë për kohën e caktuar kur duhet të fillojë procedura gjyqësore për çdo veprimtari të kundërligjshme të parashikuar në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni dhe një periudhë më të gjatë kohore për rastet kur personi i shpallur si autori i veprimtarisë së kundërligjshme i është shmangur administrimit të drejtësisë.

9. Secila Palë duhet të marrë masat e përshtatshme, në përputhje me sistemin e vet ligjor, për të siguruar që personi i akuzuar ose i dënuar për një veprimtari të kundërligjshme e parashikuar në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, i cili është gjetur brenda territorit të saj, të jetë i pranishëm gjatë procedurave të ndjekjes penale.

10. Për të siguruar bashkëpunim midis Palëve në kuadrin e kësaj Konvente, duke përfshirë në mënyrë të veçantë bashkëpunimin në bazë të neneve 5,6,7 dhe 9, veprimtaritë e kundërligjshme të parashikuara në përputhje me këtë nen nuk duhet të konsiderohen si veprimtari të kundërligjshme fiskale ose si veprimtari të kundërligjshme politike ose të shikohen politikisht të motivuara, pa marrë parasysh kufizimet kushtetuese dhe ligjin themelor të vendeve të Palëve.

11. Përmbajtja e këtij neni nuk duhet të cenojë parimin se përshkrimi i veprimtarive të kundërligjshme të cilave ai u referohet dhe ai i mbrojtjeve të tyre ligjore i rezervohet ligjit vendas të Palës dhe se veprimtari të tilla të kundërligjshme duhet të ndiqen penalisht të ndështkohen në përputhje me atë ligj.

Neni 4

Juridiksioni

1. Secila Palë:

a) Duhet të marrë, sipas nevojës, masa për të përcaktuar juridiksionin e vet për veprimtaritë e kundërligjshme që ajo ka parashikuar në përputhje me nenin 3 paragrafi 1, kur:

(i) Veprimtaria e kundërligjshme kryhet në territorin e saj.

(ii) Veprimtaria e kundërligjshme kryhet në bordin e një anijeje, që lundron me flamurin e saj ose në një aeroplan që është regjistruar në bazë të ligjeve të saj në kohën kur kryhet veprimtaria e kundërligjshme.

(b) Mund të marrë masa, kur ta shohë të nevojshme, për të përcaktuar juridiksionin e vet për veprimtaritë e kundërligjshme që ajo ka parashikuar në përputhje me nenin 3 paragrafi 1, kur:

(i) Veprimtaria e kundërligjshme kryhet nga një shtetas i saj ose nga një person me vendbanim të vazhdueshëm në territorin e saj;

(ii) Veprimtaria e kundërligjshme kryhet në bordin e një anijeje në lidhje me të cilën ajo

Palë ka qenë e autorizuar të ndërmarrë veprimin e duhur në përputhje me nenin 17, me kusht që ky juridiksion të ushtrohet vetëm në bazë të marrëveshjeve ose të rregullimeve që i bëhen marrëveshjeve, të cilave iu referohet në paragrafin 4 dhe 9 të këtij neni;

(iii) Veprimtaria e kundërligjshme është njëra nga veprimtaritë e parashikuara në përputhje me nenin 3 paragrafi 1, nënparagrafi (c) (iv) kryhet jashtë territorit të saj me qëllimin e kryerjes, brenda territorit të saj, të një veprimtarie të kundërligjshme të parashkuar në përputhje me nenin 3 paragrafi 1.

2. Secila Palë:

(a) Duhet, kur ta shohë të nevojshme, të marrë masa gjithashtu për të përcaktuar juridiksionin e vet për veprimtaritë e kundërligjshme që ajo ka parashikuar në përputhje me nenin 3 paragrafi 1, kur personi i shpallur si autor i veprimtarisë së kundërligjshme është i pranishëm në territorin e saj dhe ajo nuk ia dorëzon atë një Palë tjetër për arsye:

(i) se veprimtaria e kundërligjshme është kryer në territorin e saj ose në bordin e një anijeje që lundronte me flamurin e saj ose në një aeroplan që ishte regjistruar në bazë të ligjit të saj në kohën e kryerjes së veprimtarisë së kundërligjshme ose

(ii) se veprimtaria e kundërligjshme është kryer nga një shtetas i saj.

(b) Mund të marrë gjithashtu masa, kur ta shohë të nevojshme, për të përcaktuar jurdiksionin e vet për veprimtaritë e kundërligjshme që ajo ka parashikuar në përputhje me nenin 3 paragrafi 1, kur personi i shpallur si autor i veprimtarisë së kundërligjshme, është i pranishëm në territorin e saj dhe ajo nuk ia dorëzon atë një Pale tjetër.

3. Kjo Konventë nuk përjashton ushtrimin e çfarëdo juridiksionin penal të përcaktuar nga një Palë në përputhje me ligjin e vendit të vet.

Neni 5
Konfiskimi

1. Secila Palë duhet, kur ta shohë të nevojshme, të marrë masa për të mundësuar konfiskimin e:

a) fitimeve që rrjedhin nga veprimtari të kundërligjshme të parashikuara në përputhje me nenin 3 paragrafi 1, ose të pasurive, vlera e të cilave korrespondon me vlerën e këtyre fitimeve;

b) drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope, materialeve dhe pajisjeve ose mjeteve të tjera që janë përdorur ose që synojnë të përdoren në çfarëdo mënyre në veprimtaritë e kundërligjshme të parashikuara në përputhje me nenin 3 paragrafi 1.

2. Secila Palë duhet, kur ta shohë të nevojshme, të marrë masa për të mundësuar autoritetet e veta kompetente të identifikojnë, të gjurmojnë dhe të ngrijnë ose të shtien në dorë fitimet, pasurinë, mjetet ose çdo gjë tjetër të cilës i referohet në paragrafin 1 të këtij neni, me qëllimin e një konfiskimi të mundshëm.

3. Me qëllim që të zbatojë masat të cilave iu referohet në këtë nen, secila Palë duhet t'u japë fuqi të plotë gjykatave ose autoriteteve të tjera kompetente që të urdhërojnë që dokumentacioni bankar, financiar se tregtar të vihet në dispozicion ose të shtihet në dorë. Pala nuk duhet të refuzojë që të veprojë në bazë të dispozitave të këtij paragrafi për arsye të sekretit bankar.

4. (a) Në vijim të kërkesës së bërë në përputhje me këtë nen nga një Palë tjetër që ka juridiksion për veprimtarinë e kundërligjshme të parashikuar në përputhje me nenin 3 paragrafi 1, Pala në territorin e të cilës gjenden fitimet, pasuria, mjetet ose ndonjë gjë tjetër të cilës i referohet në paragrafin 1 të këtij neni, duhet:

(i) t'ia paraqesë kërkesën autoriteteve të veta kompetente, me qëllim që të lëshohet një urdhër për konfiskim dhe, në rast të lëshimit të një urdhëri të tillë, ta bëjë atë efektiv;

(ii) ose t'u paraqesë autoriteteve të veta kompetente, për ta bërë atë efektiv në masën që kërkohet ose një urdhër për konfiskim të lëshuar nga Pala që bën kërkesën në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, lidhur me fitimet, pasurinë, mjetet ose ndonjë gjë tjetër të cilës i referohet në paragrafin 1, që gjenden në territorin e Palës të cilës i bëhet kërkesa.

(b) Në vijim të kërkesës së bërë në përputhje me këtë nen nga një Palë tjetër që ka

juridiksion për një veprimtari të kundërligjshme, të parashikuar në përputhje me nenin 3, paragrafi 1, Pala të cilës i bëhet kërkesa duhet të marrë masat për identifikimin, gjurmimin dhe ngrirjen ose shtënien në dorë të fitimeve, pasurisë, mjeteve ose ndonjë gjëje tjetër të cilës i referohet në paragrafin 1 të këtij neni me qëllimin e konfiskimit të mundshëm për të cilin do të lëshohet urdhër ose nga Pala që bën kërkesën, ose, në përputhje me kërkesën e bërë në bazë të nënparagrafit (a) të këtij paragrafi nga pala të cilës i drejtohet kërkesa.

(c) Vendimet ose veprimet e parashikuara në nënparagrafin (a) dhe (b) të këtij paragrafi duhet të merre nga Pala të cilës i drejtohet kërkesa, në përputhje dhe në vartësi të dispozitave të ligjit të vendit të vet, të rregullave të saj proceduriale, traktatit, marrëveshjes, rregullimeve të marrëveshjes dypalëshe ose shumëpalëshe nga të cilat rrjedhin detyrime për të në lidhje me Palën që bën kërkesën.

(d) Dispozitat e nenit 7 paragrafet 6 dhe 19, janë të zbatueshme, mutatis mutandis. Përveç informacionit të specifikuar në nenin 7 paragrafi 10, kërkesat e bëra në përputhje me këtë nen duhet të përmbajnë si më poshtë:

(i) në rastin e kërkesës së bërë në bazë të nënparagrafit (a) (i) të këtij paragrafi, një përshkrim të pasurisë që do të konfiskohet dhe një deklaratë të fakteve mbi të cilat mbështetet Pala që bën kërkesën të mjaftueshme për të mundësuar Palën, të cilës i drejtohet kërkesa, të kërkojë që urdhri të lëshohet në bazë të ligjit të vendit të vet;

(ii) në rastin e kërkesës së bërë në bazë të nënparagrafit (a) (ii), një kopje e pranueshme nga pikëpamja ligjore e urdhrit për konfiskim të lëshuar nga Pala që bën kërkesën, në të cilin mbështetet kërkesa, një deklaratë të fakteve dhe informacion në lidhje me shkallën në të cilën kërkohet ekzekutimi i urdhrit;

(iii) në rastin e kërkesës së bërë në bazë të nënparagrafit (b) një deklarate të fakteve mbi të cilat është mbështetur Pala që bën kërkesën dhe një përshkrim të veprimeve, që kërkohen të ndërmerren.

(e) Secila Palë duhet t'i dërgojë Sekretarit të Përgjithshëm tekstin e ligjeve ose rregulloreve të veta që e bën efektiv këtë paragraf dhe tekstin e ndryshimeve të mëvonshme të këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

(f) Kur një Palë zgjedh ta kushtëzojë marrjen e masave, të cilave iu referohet në nënparagrafin a dhe b të këtij paragrafi me ekzistencën e traktatit përkatës, ajo Palë duhet ta konsiderojë këtë Konventë si bazën e nevojshme dhe të mjaftueshme traktati.

(g) Palët duhet të kërkojnë të lidhin traktate, marrëveshje ose rregullime të marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe për të rritur efektshmërinë e bashkëveprimit ndërkombëtar në përputhje me këtë nen.

5. (a) Fitimet ose pasuria e konfiskuar nga një Palë në përputhje me paragrafin 1 ose paragrfin 4 të këtij neni, duhet të vihen në përdorim të asaj Pale sipas ligjit dhe procedurave administrative të vendit të vet.

(b) Kur vepron me kërkesën e një Pale tjetër në përputhje me këtë nen, Pala mund t'i kushtojë vëmendje të veçantë lidhjes së marrëveshjeve për:

(i) dhënien e vlerës së këtyre fitimeve dhe pasurive, ose fondeve, që rrjedhin nga shitja e këtyre fitimeve ose pasurive, ose një pjese të rëndësishme të tyre, organeve ndërqeveritare që specializohen në luftën kundër trafikut dhe përdorimit të paligjshëm të drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope;

(ii) ndarjen me Palët e tjera, në baza të rregullta ose rast pas rasti, të këtyre fitimeve, pasurive ose fondeve që rrjedhin nga shitja e këtyre fitimeve ose pasurive, në përputhje me ligjin e saj vendas, procedurat administrative, marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe të lidhura për këtë qëllim.

6. (a) Kur fitimet janë transformuar ose shndërruar në pasuri të tjera, këto pasuri duhet t'u nënshtrohen masave të cilave iu referohet në këtë nen në vend të fitimeve.

(b) Kur fitimet janë përzier me pasuri të përftuara nga burime të ligjshme, këto pasuri duhet, pa marrë parasysh asnjë lloj vendimi tjetër në lidhje me kapjen ose ngrirjen, t'i nënshtrohen konfiskimit deri në vlerësimin e vlerës së fitimeve të përziera me to.

(a) Të ardhurat ose përfitimet e tjera që rrjedhin nga:

(i) fitimet,

(ii) pasuritë në të cilat janë transformuar ose shndërruar fitimet,

(iii) ose pasuritë me të cilat janë përzier, fitimet gjithashtu do t'u nënshtrohen masave të cilave iu referohet në këtë nen, në po atë mënyrë dhe në po atë shkallë si edhe fitimet.

7. Secila Palë duhet të ketë parasysh se mund të ndodhë një përmbysje e vlerësimit të provave në lidhje me origjinën e ligjshme të fitimeve ose pasurive të tjera të deklaruara që i nënshtrohen konfiskimit, në atë masë që ky veprim të jetë në përputhje me parimet e ligjit të vendit të vet dhe me natyrën e procedurave gjyqësore dhe procedurave të tjera.

8. Dispozitat e këtij neni nuk duhet të interpretohen sikur dëmtojnë të drejtat e Palëve të treta që janë në mirëbesim.

9. Përmbajtja e këtij neni nuk duhet të cenojë parimin se masat, për të cilat ai bën fjalë, duhet të përkufizohen dhe të zbatohen në përputhje dhe në bazë të dispozitave të ligjit vendas të Palës.

Neni 6

Ekstradimi

1. Ky nen duhet të zbatohet për veprimtari të kundërligjshme të parashikuara nga Palët në përputhje me nenin 3, paragrafi 1.

2. Çdo veprimtari e kundërligjshme e parashikuar nga ky nen duhet të gjykohet që në çdo traktat ekstradimi, që ekziston midis Palëve të përfshihet si veprimtari e kundërligjshme për të cilën mund të përdoret ekstradimi. Palët zotohen të përfshijnë veprimtari të tilla të kundërligjshme në çdo traktat ekstradimi, që do të lidhet midis tyre, si veprimtari të kundërligjshme për të cilat mund të përdoret ekstradimi.

3. Kur një Palë, e cila e kushtëzon ekstradimin me ekzistencën e traktatit, merr një kërkesë për ekstradim nga një Palë tjetër me të cilën ajo nuk ka traktat ekstradimi, ajo mund ta konsiderojë këtë Konventë si bazën ligjore për ekstradim në lidhje me të gjitha veprimtaritë e kundërligjshme për të cilat zbatohet ky nen. Palët, që kërkojnë legjislacion të hollësishëm, me qëllim që ta përdorin këtë Konventë si bazën ligjore për ekstradim, duhet ta marrin në konsideratë zbatimin e këtij legjislacioni kur ta shohin të nevojshme.

4. Palët, që nuk e kushtëzojnë ekstradimin me ekzistencën e traktatit, duhet t'i njohin veprimtaritë e kundërligjshme, për të cilat zbatohen ky nen, si veprimtari të kundërligjshme për të cilat mund të përdoret ekstradimi midis Palëve.

5. Ekstradimi duhet t'i nënshtrohet kushteve që parashtron ligji i Palës, të cilës i drejtohet kërkesa, ose që parashtrojnë traktatet e ekstradimit në fuqi, duke përfshirë arsyet në bazë të të cilave Pala, të cilës i drejtohet kërkesa, mund ta refuzojë ekstradimin.

6. Në shqyrtimin e kërkesave të marra në përputhje me këtë nen, shteti, të cilit i drejtohet kërkesa mund të refuzojë të veprojë në përputhje me të tilla kërkesa kur ka arsye të forta që i bëjnë autoritetet gjyqësore ose autoritetet e tjera kompetente të tij të besojnë se mosrefuzimi do ta lehtësonte ndjekjen penale ose ndëshkimin e cilitdo person, për shkak të racës, besimit, kombësisë ose mendimeve të tij politike, ose do të shkaktonte paragjykim për shkak të ndonjërës prej atyre arsyeve për personin i cili preket nga kjo kërkesë.

7. Palët duhet të përpiqen të shpejtojnë procedurat e ekstradimit dhe të thjeshtësojnë kërkesat për dëshmi, që lidhen me to, në lsidhje me çfarëdolloj veprimtarie të kundërligjshme për të cilën zbatohet ky nen.

8. Në bazë të dispozitave të ligjit vendas dhe traktateve të saj të ekstradimit, Pala të cilës i drejtohet kërkesa, pasi bindet se rrethanat e justifikojnë dhe janë urgjente, dhe me kërkesën e Palës që bën kërkesën, mund ta marrë në kujdestari personin për të cilin kërkohet ekstradimi dhe që është i pranishëm në territorin e saj ose mund të marrë masa të tjera të përshtatshme për të siguruar praninë e tij gjatë procedurave të ekstradimit.

9. Pa marrë parasysh ushtrimin e çfarëdolloj kompetence juridike për të vepruar në lidhje me krimet, kompetencë kjo e përcaktuar në përputhje me ligjin vendas, pala në territorin e të cilës

gjendet personi i shpallur si autor i veprimtarisë së kundërligjshme, duhet:

a) Kur nuk e ekstradon personin për shkak të një veprimtarie të kundërligjshme të përcaktuar në përputhje me nenin 3 paragrafi 1, për arsyet e parashikuara në nenin 4 paragrafi 2, nënparagrafi a, të paraqesë rastin para autoriteteve të veta kompetente për ndjekje penale, përjashtuar rastet kur është rënë dakord ndryshe me Palën që bën kërkesën.

b) Kur ajo nuk e ekstradon personin, për shkak të një veprimtarie të tillë të kundërligjshme dhe ka përcaktuar juridiksionin e vet për atë veprimtari të kundërligjshme në përputhje me nenin 4 paragrafi 2 nënparagrafi b, ta paraqesë rastin para autoriteteve të veta kompetente për ndjekje penale, përjashtuar rastet kur është kërkuar ndryshe nga Pala që bën kërkesën për arsye të ruajtjes së juridiksionit të vet legjitim.

10. Kur ekstradimi, që kërkohet me qëllimin e zbatimit të vendimit, refuzohet sepse personi i kërkuar është shtetas i Palës të cilës i drejtohet kërkesa, Pala të cilës i drejtohet kërkesa duhet, në qoftë se ia lejon ligji dhe në përputhje me kërkesat e këtij ligji, me kërkesën e Palës kërkuese, të marrë në konsideratë zbatimin e vendimit që është marrë në bazë të ligjit të Palës që drejton kërkesën ose pjesën e mbetur të tij.

11. Palët duhet të kërkojnë të lidhin marrëveshje dypalëshe dhe shumpalëshe me qëllim që të realizojnë ose të rrisin efektshmërinë e ekstradimit.

12. Palët mund të shqyrtojnë lidhjen e marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe, qoftë mbi një bazë ad hoc ose të përgjithshme për transferimin në vendin e tyre të personave të dënuar me burgim ose forma të tjera të heqjes së lirisë për veprimtari të kundërligjshme për të cilat zbatohet ky nen, me qëllim që ta përfundojnë vuajtjen e dënimit atje.

Neni 7

Ndihmë e ndërsjellë ligjore

1. Në përputhje me këtë nen, Palët duhet t'i japin njëra - tjetrës në shkallë sa më të gjerë ndihmë të ndërsjellë ligjore për hetimet, ndjekjet penale dhe procedurat gjyqësore në lidhje me veprimtaritë kriminale të parashikuara në përputhje me nenin 3 paragrafi 1.

2. Ndihma e ndërsjellë ligjore që do të jepet në përputhje me këtë nen, mund të kërkohet për secilin nga qëllimet e mëposhtme:

a) marrja e dëshmive ose deklaratave nga personat;

b) sigurimi i dokumenteve gjyqësore;

c) ekzekutimi i kërkimeve dhe kapjeve;

d) ekzaminimi i objekteve dhe vendngjarjeve;

e) sigurimi i informacionit dhe materialeve evidentuese;

f) sigurimi i origjinaleve ose të kopjeve të vërtetuara, të dokumentave dhe dokumentacionit përkatës, duke përfshirë dokumentacionin bankar, financiar, dokumentacionin e koorporatës ose të biznesit;

g) identifikimi ose gjurmimi i fitimeve, pasurive, mjeteve ose gjërave të tjera për arsye evidentuese.

3. Palët mund t'i japin njëra - tjetrës ndihmë të ndërsjellë ligjore të çdo lloj forme tjetër të lejuar nga ligji i vendit të Palës të cilës i drejtohet kërkesa.

4. Sipas kërkesës, Palët duhet të lehtësojnë ose inkurajojnë, në atë shkallë që është në përputhje me ligjin dhe praktikën e vendit të tyre, praninë ose qënien në dispozicion të personave, duke përfshirë personat nën kujdestari, të cilët japin pëlqimin e tyre për të ndihmuar në hetime ose për të marrë pjesë në procedurat gjyqësore.

5. Palët nuk duhet të kundërshtojnë të japin ndihmë të ndërsjellë ligjore në bazë të këtij neni për arsye të sekretit bankar.

6. Dispozitat e këtij neni nuk duhet të ndikojnë në detyrimet që rrjedhin nga çfarëdo traktati tjetër, dypalësh ose shumëpalësh, që rregullon ose do të rregullojë në tërësi ose pjesërisht, ndihmën e ndërsjellë ligjore për akte kriminale.

7. Paragrafet 8 deri 19 të këtij neni duhet të zbatohen, për kërkesat e bëra në përputhje me

këtë nen, kur Palët në fjalë nuk kanë detyrime që burojnë nga ndonjë traktat i ndihmës së ndërsjellë ligjore. Kur këto Palë kanë detyrime që rrjedhin nga një traktat i tillë, dispozitat korresponduese të atij traktati duhet të zbatohen në rast se Palët nuk bien dakort të zbatojnë paragrafet 8 deri 19 të këtij neni në vend të tyre.

8. Palët duhet të emërojnë autoritetin, ose kur është e nevojshme, autoritetet që duhet të kenë përgjegjësi dhe fuqi të ekzekutojnë kërkesat për ndihmë të ndërsjellë ligjore ose t'ua transmetojnë ato autoriteteve kompetente për ekzekutim. Sekretari i Përgjithshëm duhet të njoftohet për autoritetin ose autoritetet e emëruara për këtë qëllim. Transmetimi i kërkesave për ndihmë të ndërsjellë ligjore dhe çdo komunikim në lidhje me to duhet të kryhet në mes të autoriteteve të emëruara nga Palët; kjo kërkesë nuk do të marrë parasysh të drejtën e Palës e cila kërkon që kërkesa dhe komunikime të tilla t'i drejtohen asaj përmes kanaleve diplomatike dhe, në rethana urgjente, kur Palët bien dakord, përmes kanaleve të organizatës ndërkombëtare të policisë kriminale, nëse është e mundur.

9. Kërkesat duhet të bëhen me shkrim me një gjuhë të pranueshme për Palën të cilës i drejtohet kërkesa. Sekretari i Përgjithshëm duhet të njoftohet për gjuhën ose gjuhët e pranueshme për çdo Palë. Në rrethana urgjente dhe kur Palët bien dakord, kërkesat mund të bëhet gojarisht, por duhet të konfirmohen menjëherë me shkrim.

10. Kërkesa për ndihmë të ndërsjellë ligjore duhet të përmbajë:

(a) identitetin e autoritetit që bën kërkesën;

(b) temën dhe natyrën e hetimit, ndjekjes penale ose procedures gjyqësore me të cilat lidhet kërkesa, dhe emrin dhe funksionet e autoritetit që kryen hetimin, ndjekjen penale ose proceduren gjyqësore;

(c) një përmbledhje të fakteve që kanë lidhje me çështjen, përjashtuar kërkesat që bëhen për të siguruar dokumentet gjyqësore;

(d) një përshkrim të ndihmës që kërkohet dhe hollësi të një procedure të caktuar që pala, e cila drejton kërkesën, dëshiron që të ndiqet;

(e) kur është e mundur, identitetin, vendin dhe kombësinë e çdo personi të interesuar;

(f) qëllimin për të cilin kërkohet dëshmia, informaci ose veprimi.

11. Pala të cilës i drejtohet kërkesa, mund të kërkojë informacion shtesë kur del e nevojshme për ekzekutimin e kërkesës, në përputhje me ligjin e vendit të vet ose kur ai mund ta lehtësojë këtë ekzekutim.

12. Kërkesa duhet të ekzekutohet në përputhje me ligjin e vendit të Palës të cilës i drejtohet kërkesa dhe në atë shkallë që nuk është në kundërshtim me ligjin e vendit të Palës të cilës i drejtohet kërkesa dhe, atje ku është e mundur, në përputhje me procedurat e specifikuara në kërkesë.

13. Pala që drejton kërkesën, duhet të mos i transmetojë as të përdorë informacionin ose dëshmitë që ia siguron Pala të cilës i drejtohet kërkesa për hetime, ndjekje penale ose procedura gjyqësore përveç atyre rasteve që bëhen të ditura në kërkesën pa pëlqimin paraprak të Palës të cilës i drejtohet kërkesa.

14. Pala që bën kërkesën, mund të kërkojë që Palës së cilës i drejtohet kërkesa, ta mbajë të fshehtë faktin dhe lëndën e kërkesës, përveç shkallës së nevojshme për ekzekutimin e kërkesës. Kur Pala, të cilës i drejtohet kërkesa, nuk mund të veprojë në përputhje me kërkesën e konfidencialitetit, ajo duhet ta njoftojë menjëherë Palën që drejton kërkesën.

15. Ndihma e ndërsjellë ligjore mund të refuzohet:

(a) kur kërkesa nuk është bërë në përputhje me dispozitat e këtij neni;

(b) kur Pala, të cilës i drejtohet kërkesa, mendon se ekzekutimi i kërkesës ka të ngjarë të dëmtojë sovranitetin, sigurinë, rendin publik ose interesa të tjera thelbësore të saj;

(c) kur autoritetet e Palës, të cilës i drejtohet kërkesa, do t'i ndalonte ligji i vendit të saj të kryenin veprimin e kërkuar në lidhje me një veprimtari tjetër të ngjashme të kundërligjshme, nëse kjo veprimtari do t'i nënshtrohej hetimit, ndjekjes penale ose procedurës gjyqësore në bazë të juridiksionit të tyre;

(d) kur pranimi i kërkesës do të ishte në kundërshtim me sistemin ligjor të Palës, të cilës i drejtohet kërkesa, për ndihmën e ndërsjellë ligjore.

16. Për çdo refuzim të ndihmës së ndërsjellë ligjore duhet të jepen arsye.

17. Ndihma e ndërsjellë ligjore mund të shtyhet nga Pala, të cilës i bëhet kërkesa, për shkak se ajo pengon hetimin, ndjekjen penale ose procedurën gjyqësore në proces. Në këtë rast Pala, të cilës i drejtohet kërkesa, duhet të konsultohet me Palën, që bën kërkesën, për të përcaktuar nëse ndihma, megjithatë, mund të jepet në bazë të atyre termave dhe kushteve që Pala, të cilës i drejtohet kërkesa, i gjykon të nevojshme.

18. Dëshmitari, eksperti ose personi tjetër, të cilët japin pëlqimin e tyre për të dhënë dëshmi në një procedurë gjyqësore ose të japin ndihmësen e tyre gjatë një hetimi, ndjekje penale ose procedurë gjyqësore në territorin e Palës që bën kërkesën, nuk duhet të ndiqet penalisht, të ndalohet, të ndëshkohet ose t'i nënshtrohet ndonjë kufizimi tjetër të lirisë së tij personale në atë territor, në lidhje me aktet, neglizhimet (omissions) ose dënimet përpara largimit të tij nga territori i Palës, të cilës i drejtohet kërkesa. Kjo leje qëndrimi duhet të pushojë së ekzistuari kur dëshmitari, eksperti ose personi tjetër i cili ka pasur, për një periudhë prej 15 ditësh të njëpasnjëshme, ose për çfarëdo periudhe për të cilën është rënë dakord midis Palëve, nga data në të cilën ai është njoftuar zyrtarisht se prania e tij nuk kërkohet më nga autoritetet gjyqësore, mundësinë për t'u larguar, megjithatë ka qëndruar vullnetarisht në atë territor ose, pasi është larguar prej tij, është kthyer me vullnetin e tij të lirë.

19. Shpenzimet e zakonshme të ekzekutimit të kërkesës duhet të përballohen nga Pala të cilës i drejtohet kërkesa, përjashtuar rastet kur është rënë dakord ndryshe nga Palët e interesuara. Në rast se, për plotësimin e kërkesës, kërkohen ose do të kërkohen shpenzime shumë të mëdha ose të jashtëzakonshme, Palët duhet të konsultohen për të përcaktuar termat dhe kushtet në bazë të cilave do të ekzekutohet kërkesa, si edhe mënyrën në të cilën do të përballohen shpenzimet.

20. Palët duhet të marrin në shqyrtim, kur ta shohin të nevojshme, mundësinë e lidhjes së marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe ose rregullimeve të marrëveshjeve që do t'u shërbenin qëllimeve të dispozitave të këtij neni, do t'i bënin ato praktikisht efektive ose do t'i përmirësonin ato.

Neni 8

Transferimi i procedurave gjyqësore

Palët duhet të shqyrtojnë mundësinë e transferimit tek njëra - tjetra të procedurave gjyqësore për ndjekjen penale të veprimtarive të kundërligjshme të parashikuara në përputhje me nenin 3 paragrafi 1, në rastet kur ky transferim mendohet të jetë në interes të administrimit të saktë të drejtësisë.

Neni 9

Forma të tjera bashkëpunimi dhe trajnimi

1. Palët duhet të bashkëpunojnë ngushtë me njëra - tjetrën, në përputhje me sistemet respektive ligjore dhe administrative të vendeve të tyre, me qëllim që të rrisin efektshmërinë e veprimit për zbatimin e ligjit për të ndaluar kryerjen e veprimtarive të kundërligjshme të parashikuara në përputhje me nenin 3 paragrafi 1. Në mënyrë të veçantë, në bazë të marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe ose të rregullimeve të marrëveshjeve, ato duhet:

(a) të përcaktojnë dhe të mbajnë kanale komunikimi midis agjencive dhe shërbimeve të tyre kompetente për të lehtësuar shkëmbimin e sigurt dhe të shpejtë të informacionit që prek të gjitha aspektet e veprimtarive të kundërligjshme, të parashikuara në përputhje me nenin 3 paragrafi 1, duke përfshirë, nëse Palët e interesuara e gjykojnë këtë të përshtatshme, lidhjet me veprimtari të tjera kriminale;

(b) të bashkëpunojnë me njëra - tjetrën për zhvillimin e hetimeve, për veprimtaritë e kundërligjshme të parashikuara në përputhje me nenin 3 paragrafi 1, që kanë karakter ndërkombëtar, në lidhje me:

(i) identitetin, vendndodhjen dhe veprimtaritë e personave që dyshohet se janë përfshirë në veprimtari të kundërligjshme të parashikuara në përputhje me nenin 3 paragrafi 1;

(ii) lëvizjen e fitimeve ose pasurive që burojnë nga kryerja e këtyre veprimtarive të kundërligjshme ;

(iii) lëvizjen e drogave narkotike, lëndëve psikotrope, lëndëve të parashikuara në tabelën I dhe tabelën II të kësaj Konvente dhe mjetet e përdorura ose ato që synohet të përdoren për kryerjen e këtyre veprimtarive të kundërligjshme;

a) në raste të përshtatshme dhe kur nuk është në kundërshtim me ligjin e vendit të krijojnë ekipe të përbashkëta, të marrin parasysh nevojën e mbrojtjes së sigurisë së personave dhe operacioneve, të zbatojnë dispozitat e këtij paragrafi. Zyrtarët e cilësdo Palë, që marrin pjesë në ekipe të tilla, duhet të veprojnë të autorizuar nga autoritetet e duhura të Palës në territorin e të cilës do të kryhet operacioni; në të gjitha këto raste, Palët pjesëmarrëse duhet të sigurojnë që sovraniteti i Palës në territorin e të cilës do të kryhet operacioni do të respektohet plotësisht ;

b) të sigurojnë, kur e shohin të përshtatshme, sasi të nevojshme lëndësh për qëllime analizash ose hetimesh;

c) të lehtësojnë bashkëveprimin efektiv midis agjencive dhe shërbimeve të tyre kompetente dhe të nxisin shkëmbimin e personelit dhe ekspertëve të tjerë, duke përfshirë emërimin e oficerëve ndërlidhës.

2.Secila Palë duhet, në atë masë që është e nevojshme, të nisë, të hartojë ose të përmirësojë programe të veçanta trajnimi për personelin e saj që merret me zbatimin e ligjit dhe personelin tjetër, duke përfshirë doganat, të cilit i është ngarkuar detyra e ndalimit të veprimtarive të kundërligjshme të parashikuara në përputhje me nenin 3 paragrafi 1. Në mënyrë të veçantë këto programe duhet të trajtojnë si më poshtë:

(a) metodat që përdoren për zbulimin dhe ndalimin e veprimtarive të kundërligjshme, të parashikuara në përputhje me nenin 3 paragrafi 1;

(b) rrugët e teknikat që përdoren nga personat, që dyshohet se janë përfshirë në veprimtari të kundërligjshme të parashikuara në përputhje me nenin 3 paragrafi 1, veçanërisht në shtetet tranzite, dhe kundërmasat e duhura;

(c) monitorimin e importit dhe eksportit të drogave narkotike, lëndëve psikotrope dhe lëndëve të parashikuara në tabelën I dhe tabelën II;

(d) zbulimin dhe monitorimin e lëvizjes së fitimeve dhe pasurive që burojnë nga drogat narkotike, lëndët psikotrope dhe lëndët e parashikuara në tabelën I dhe tabelën II, dhe të drogave narkotike, lëndëve psikotrope dhe lëndëve të parashikuara në tabelën I dhe tabelën II si edhe të mjeteve që përdoren ose synohet të përdoren në kryerjen e veprimtarive të kundërligjshme të parashikuara në përputhje me nenin 3 paragrafi 1;

(e) metodat që përdoren për transferimin, fshehjen ose mbulimin e këtyre fitimeve, pasurive dhe mjeteve;

(f) grumbullimin e dëshmive;

(g) teknikat e kontrollit në zonat e lira tregtare dhe në portet e lira;

(h) teknikat moderne të zbatimit të ligjit.

3. Palët duhet të ndihmojnë njëra - tjetrën për planifikimin dhe zbatimin e programeve kërkimore dhe të trajnimit në bazë të të cilave synohej që ato të ndajnë me njëra - tjetrën ekspertizën në fushat që iu referohet në paragrafin 2 të këtij neni dhe, për këtë qëllim, duhet gjithashtu, kur ta gjykojnë të përshtatshme të përdorin konferencat dhe seminaret rajonale dhe ndërkombëtare për të nxitur bashkëpunimin dhe për të stimuluar diskutimin e problemeve që përbëjnë shqetësim për të gjithë, duke përfshirë problemet dhe nevojat e veçanta të shteteve tranzite.

Neni 10

Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ndihma për shtetet tranzite

1. Palët duhet të bashkëpunojnë, në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose nëpërmjet organizatave kompetente ndërkombëtare ose rajonale, për të ndihmuar dhe mbështetur shtetet tranzite dhe, veçanërisht, vendet në zhvillim që kanë nevojë për këtë ndihmë dhe mbështetje, në atë masë që është e mundur, nëpërmjet programeve të bashkëpunimit teknik për ndalimin e veprimit dhe veprimtaritë e tjera të lidhura me të.

2. Palët mund të zotohen, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet organizatave kompetente ndërkombëtare ose rajonale, t'u japin ndihmë financiare këtyre shteteve tranzite për të rritur dhe forcuar infrastrukturën që nevojitet për kontrollin dhe parandalimin efektiv të trafikut të paligjshëm.

3. Palët mund të nënshkruajnë marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe ose rregullime të marrëveshjeve për të rritur efektshmërinë e bashkëpunimit ndërkombëtar në përputhje me këtë nen dhe mund të marrin në konsideratë rregullimet financiare në këtë aspekt.

Neni 11

Shpërndarja e kontrolluar

1. Kur parimet bazë të sistemeve respektive ligjore të vendeve të tyre e lejojnë, Palët duhet të marrin masat e nevojshme, brenda mundësive të tyre, për të lejuar përdorimin e përshtatshëm të shpërndarjes së kontrolluar në nivel ndërkombëtar, në bazë të marrëveshjeve ose rregullimeve të marrëveshjeve për të cilat të gjitha Palët kanë dhënë pëlqimin e tyre, me qëllim që të identifikohen personat e përfshirë në veprimtari të kundërligjshme në përputhje me nenin 3 paragrafi 1, dhe të ndërmerret veprim ligjor kundër tyre.

2. Vendimet për përdorimin e shpërndarjes së kontrolluar duhet të merren sipas rastit dhe, kur është e nevojshme, mund të merren në konsideratë rregullimet dhe mirëkuptimet financiare në lidhje me ushtrimin e juridiksionit nga Palët e interesuara.

3. Dërgesat e paligjshme për shpërndarjen e kontrolluar të të cilave është rënë dakord, me pëlqimin e Palëve të interesuara, mund të kapen dhe të lejohen të vazhdojnë duke i lënë drogat narkotike ose lëndët psikotrope të paprekura, të palëvizura ose të pazëvendësuara plotësisht ose pjesërisht.

Neni 12

Lëndët që përdoren shpesh për fabrikimin e paligjshëm të drogave narkotike ose lëndëve psikotrope

1. Palët duhet të marrin masat, që gjykojnë të përshtatshme, për të parandaluar ndryshimin e drejtimit të lëndëve të parashikuara në tabelën I dhe tabelën II, që përdoren për fabrikimin e paligjshëm të drogave narkotike ose lëndëve psikotrope dhe duhet të bashkëpunojnë me njëra - tjetrën për këtë qëllim.

2. Kur Pala ose Bordi ka informacion që, sipas mendimit të vet, mund të kërkojë përfshirjen e një lënde të parashikuar në tabelën I ose tabelën II, ajo/ai duhet të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm dhe t'i japë atij informacionin në mbështetje të atij njoftimi. Procedura, që përshkruhet në paragrafet 2 deri 7 të këtij neni, duhet të zbatohet edhe kur Pala ose Bordi ka informacion që justifikon heqjen e një lënde nga Tabela I ose Tabela II ose transferimin e një lënde nga njëra tabelë tek tjetra.

3. Sekretari i Përgjithshëm duhet t'ia transmetojë këtë njoftim dhe çfarëdo informacioni që ai mendon se ka lidhje, Palëve, Komisionit dhe, kur njoftimi është bërë nga njëra nga Palë, Bordit. Palët duhet t'ia komunikojnë Sekretarit të Përgjithshëm komentet e tyre në lidhje me njoftimin, bashkë me të gjithë informacionin plotësues që mund ta ndihmojë Bordin në kryerjen e vlerësimit dhe Komisionin në marrjen e një vendimi.

4. Kur Bordi, duke marrë në konsideratë shkallën, rëndësinë dhe shumëllojshmërinë e përdorimit të ligjshëm të lëndës dhe mundësinë dhe lehtësinë e përdorimit të lëndëve alternative, si për qëllime të ligjshme, ashtu edhe për fabrikimin e paligjshëm të drogave narkotike ose lëndëve psikotrope, konstaton:

(a) se lënda është përdorur shpeshherë për fabrikimin e paligjshëm të drogave narkotike ose lëndës psikotrope;

(b) se volumi dhe shkalla e fabrikimit të paligjshëm të drogës narkotike ose lëndës psikotrope shkakon probleme serioze për shëndetin publik ose probleme të rënda sociale, kështu që e

justifikon veprimin ndërkombëtar ai duhet t'ia komunikojë Komisionit vlerësimin e lëndës, duke përfshirë ndikimin e mundshëm të përfshirjes së kësaj lënde, në tabelën I ose ne tabelën II, si në fabrikimin e ligjshëm, ashtu edhe në atë të paligjshëm, së bashku me rekomandimet për masa monitoruese, nëse ka, që do të ishin të përshtatshme në dritën e vlerësimit të tij.

5. Komisioni, duke marrë parasysh komentet e paraqitura nga Palët dhe komentet dhe rekomandimet e Bordit, vlerësimi i të cilave duhet të jetë përcaktues përsa i përket çështjeve shkencore, dhe duke marrë gjithashtu në konsideratë ndonjë faktor tjetër që ka lidhje, mund të vendosë me shumicën e dy të tretave të anëtarëve të tij që të përfshijë një lëndë në tabelën I ose tabelën II.

6. Sekretari i Përgjithshëm duhet t'ia komunikojë çdo vendim të Komisionit, të marrë në përputhje me këtë nen, të gjitha shteteve dhe organizmave të tjera që janë ose kanë të drejtë të bëhen Palë në këtë Konventë dhe Bordit. Një vendim i tillë duhet të hyjë plotësisht në fuqi për çdo Palë njëqind e tetëdhjetë ditë pas ditës kur bëhet ky komunikim.

7. (a) Vendimet e Komisionit të marra në bazë të këtij neni duhet të rishikohen nga Këshilli me kërkesë të ndonjërës Palë, kërkesë kjo që duhet depozituar brenda njëqind e tetëdhjetë ditëve pas datës kur bëhet njoftimi i vendimit. Kërkesa për rishikim duhet t'i dërgohet Sekretarit të Përgjithshëm, së bashku me gjithë informacionin përkatës ku mbështetet kërkesa për rishikim.

(c) Sekretari i Përgjithshëm duhet t'u transmetojë kopje të kërkesës për rishikim dhe informacionin përkatës Komisionit, Bordit dhe të gjitha Palëve, duke i ftuar ato të paraqesin komentet e tyre brenda nëntëdhjetë ditëve. Të gjitha komentet e bëra duhet t'i paraqiten Këshillit për shqyrtim.

(d) Këshilli mund ta konfirmojë ose ta kthejë vendimin e Komisionit. Njoftimi për vendimin e Këshillit duhet t'u transmetohet të gjitha shteteve dhe organizmave të tjerë që janë ose që kanë të drejtë të bëhen Palë në këtë Konventë, Komisionit dhe Bordit.

8. (a) Pa marrë parasysh karakterin e përgjithshëm të dispozitave në paragrafin 1 të këtij neni dhe të dispozitave të Konventës 1961, Konventës 1961 të ndryshuar dhe të Konventës 1971, Palët duhet të marrin masat që gjykojnë të përshtatshme për monitorimin e fabrikimit dhe shpërndarjen e lëndëve të parashikuara në tabelën I dhe tabelën II që kryhen brenda territorit të tyre.

(a) Për këtë qëllim, Palët mund:

(i) të kontrollojnë të gjithë personat dhe ndërmarrjet që merren me fabrikimin dhe shpërndarjen e këtyre lëndëve;

(ii) të kontrollojnë në bazë të licensës, ndërmarrjen dhe lokalet ku kryhet fabrikimi ose shpërndarja;

(iii) të kërkojnë që të licencuarit të marrin leje për kryerjen e operacioneve të mësipërme;

(iv) të parandalojnë grumbullimin e këtyre lëndëve në zotërim të fabrikuesve dhe shpërndarësve mbi sasitë e kërkuara për zhvillimin normal të biznesit dhe kushtet mbizotëruese të tregut.

9. Secila Palë duhet të marrë masat e mëposhtme në lidhje me lëndët e parashikuara në tabelën I dhe tabelën II:

(a) Të krijojë dhe të mbajë një sistem për monitorimin e tregtisë ndërkombëtare të lëndëve të parashikuara në tabelën I dhe tabelën II, me qëllim që të ndihmojë në identifikimin e transaksioneve të dyshimta. Sisteme të tilla monitorimi duhet të zbatohen në bashkëveprim të ngushtë me fabrikuesit, importuesit, eksportuesit, tregtarët e shitjeve me shumicë dhe tregtarët e shitjeve me pakicë, të cilët duhet të informojnë autoritetet kompetente për porosi dhe transaksione të dyshimta.

(b) Të përgatisin bazën ligjore për të shtënë në dorë çdonjërën nga lëndët e parashikuara në tabelën I ose tabelën II, kur ka të dhëna të mjaftueshme se ajo shkon për përdorim në fabrikimin e paligjshëm të drogës narkotike ose lëndës psikotrope.

(c) Të njoftojë sa më shpejt të jetë e mundur autoritetet kompetente dhe shërbimet e Palëve të interesuara kur ka arsye për të besuar se importi, eksporti ose tranzitimi i ndonjërës nga lëndët e parashikuara në tabelën I ose tabelën II është i destinuar për fabrikimin e paligjshëm të drogave narkotike ose lëndëve psikotrope, duke përfshirë në mënyrë të veçantë informacionin mbi mjetet e pagesës dhe çfarëdo elementi tjetër thelbësor që çoi te kjo arsye.

(d) Të kërkojë që importet dhe eksportet të etiketohen dhe të dokumentohen ashtu siç duhet. Dokumentet tregtare si faturat, manifestet e ngarkesës, dokumentet e doganës, të transportit dhe dokumentet e tjera të transportit me anije duhet të përfshijnë emrat, siç përcaktohet në tabelën I dhe tabelën II të lëndëve që importohen ose eksportohen, sasinë që importohet ose eksportohet, si edhe emrin dhe adresën e eksportuesit, importuesit dhe atë të marrësit të ngarkesës, kur ka të tillë.

(e) Të sigurojë që dokumentet, të cilat iu referohet në nënparagrafin (d) të këtij paragrafi, të ruhen për një periudhë kohore jo më pak se dy vjet dhe të mund të vihen në dispozicion të autoriteteve kompetente për shqyrtim.

10. (a) Përveç dispozitave të paragrafit 9 dhe me kërkesë të Palës së interesuar drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm, secila Palë, nga territori i të cilës do të eksportohet ndonjëra nga lëndët e parashikuara në tabelën I, duhet të sigurojë, që para se të bëhet ky eksport, autoritetet e veta kompetente t'u dërgojnë informacionin e mëposhtëm autoriteteve kompetente të vendit importues:

i. emrin dhe adresën e eksportuesit dhe të importuesit dhe të marrësit të ngarkesës, kur ka të tillë;

ii. emrin e lëndës së parashikuar në tabelën I;

iii. sasinë e lëndës që do të eksportohet;

iv. pikën ku pritet të hyjë dhe datën që pritet të niset;

v. çdo informacion tjetër për të cilin është rënë dakord reciprokisht nga Palët.

(b) Pala mund të marrë masa kontrolli më rigoroze ose më të rrepta sesa ato që përcaktohen nga ky paragraf nëse, sipas mendmit të saj, masa të tilla janë të dëshirueshme ose të nevojshme.

11. Kur një Palë i jep infomacion një Pale tjetër, në përputhje me paragrafin 9 dhe 10 të këtij neni, Pala që e jep informacionin mund të kërkojë nga Pala e cila e merr informacion të mbajë të fshehtë çdo tregti, biznes, sekret tregtar ose profesional ose proces tregtar.

12. Secila Palë çdo vit duhet t'i dërgojë Bordit në formën dhe mënyrën që përcakton ajo dhe për format që ajo vë në dispozicion, informacion mbi :

(a) sasitë e kapura të lëndëve të parashikuara në tabelën I dhe tabelën II dhe, kur dihet, edhe origjinën e tyre;

(b) çdo lëndë që nuk është përfshirë në tabelën I dhe tabelën II që është identifikuar se është përdorur në fabrikimin e paligjishëm të drogave narkotike ose lëndëve psikotrope dhe që Pala gjykon se është mjaft e rëndësishme që të vihet në vëmendje të Bordit;

(c) metodat e ndryshimit të drejtimit dhe të fabrikimit të paligjshëm.

13. Bordi çdo vit duhet t'i raportojë Komisionit mbi zbatimin e këtij neni dhe Komisioni duhet ta rishikojë periodikisht përshtatshmërinë dhe korrektësinë e tabelës I dhe tabelës II.

14. Dispozitat e këtij neni nuk duhet të zbatohen për preparatet farmaceutike, as për preparatet e tjera, që përmbajnë lëndë të të parashikuara në tabelën I ose tabelën II, të cilat janë përzier në mënyrë të tillë sa që këto lëndë nuk mund të përdoren lehtësisht ose nuk mund të përftohen me mjete lehtësisht të manovrueshme.

Neni 13
Materialet dhe pajisjet

Palët duhet të marrin masat që gjykojnë të përshtatshme për parandalimin e tregtisë së drogave narkotike, lëndëve psikotrope, të ndërrimit, të drejtimit të materialeve dhe pajisjeve për prodhimin ose fabrikimin e paligjshëm të tyre, si dhe duhet të bashkëpunojnë për këtë qëllim.

Neni 14
Masat për shmangien e kultivimit të paligjshëm të bimëve narkotike dhe eleminimin e kërkesës së paligjshme për droga narkotike dhe lëndë psikotrope

1. Masat e marra në përputhje me këtë Konvente nga Palët nuk duhet të jenë më pak të rrepta sesa dispozitat në fuqi për shmangien e kultivimit të paligjshëm të bimëve, që përmbajne lëndë narkotike dhe psikotrope, dhe për eleminimin e kërkesës së paligjshme për droga narkotike

dhe lëndë psikotrope në bazë të dispozitave të Konventës 1961, Konventës 1961 të ndryshuar dhe Konventës 1971.

2. Secila Palë duhet të marrë masa të përshtatshme për parandalimin e kultivimit të paligjshëm dhe çrrënjosjen e bimëve që përmbajnë lëndë narkotike ose psikotrope, si hashashi, shkurrja e kokainës dhe bimët kanabis, që kultivohen në mënyrë të paligjshme në territorin e saj. Masat e marra duhet të respektojnë të drejtat themelore të njeriut dhe duhet të mbajnë parasysh përdorimin tradicional të ligjshëm, kur ka të dhëna që e vërtetojnë këtë përdorim historikisht, si edhe mbrojtjen e mjedisit.

3. (a) Palët mund të bashkëveprojnë për të rritur efektshmërinë e përpjekjeve për çrrënjosjen e tyre. Një bashkëpunim i tillë mund, inter alia, të përfshijë mbështetjen, kur shihet e përshtatshme, për zhvillimin e integruar të fshatit që çon në alternativa ekonomikisht të qëndrueshme ndaj kultivimit të paligjshëm. Faktorë të tillë si hyrja në tregje, vënia në dispozicion e burimeve dhe kushtet mbizotëruese socialekonomike duhet të merren parasysh përpara se të zbatohen programe të tilla për zhvillimin e fshatit. Palët mund të bien dakort edhe për masa të tjera të përshtatshme bashkëpunimi.

(b) Palët gjithashtu duhet të ndihmojnë në shkëmbimin e informacionit shkencor dhe teknik dhe në kryerjen e kërkimeve në lidhje me çrrënjosjen e tyre.

(c) Kudo ku kanë kufij të përbashkët, Palët duhet të kërkojnë të bashkëpunojnë, në kuadrin e programeve për çrrënjosjen e tyre në zonat e tyre përkatëse përgjatë atyre kufijve.

4. Palët duhet të marrin masa të përshtatshme, që synojnë eleminimin ose uljen e kërkesës së paligjshme për droga narkotike dhe lëndë psikotrope, me qëllim që të pakësohet vuajtja njerëzore dhe të eleminohen stimujt financiare të trafikut të paligjshëm. Këto masa mund të bazohen, inter alia, në rekomandimet e Kombeve të Bashkuara, agjencive të specializuara të Kombeve të Bashkuara si Organizata Botërore e Shëndetit, dhe organizatave të tjera kompetente ndërkombëtare dhe në vështrimin e përgjithshëm shumëdisiplinor të miratuar nga Konferenca Ndërkombëtare mbi përdorimin e Drogës dhe trafikun e paligjshëm, mbajtur me 1987, meqënëse ai lidhet me agjencitë qeveritare dhe joqeveritare dhe përpjekjet private në fushat e parandalimit, trajtimit dhe rehabilitimit. Palët mund të lidhin marrëveshje dypalëshe dhe shumëpalëshe ose rregullime që iu bëhen marrëveshjeve që synojnë të eleminojnë ose të ulin kërkesën e paligjshme për droga narkotike dhe lëndë psikotrope.

5. Palët, gjithashtu, mund të marrin masat e nevojshme për shkatërrimin e hershëm ose asgjësimin e ligjshëm të drogave narkotike, lëndëve psikotrope dhe lëndëve të parashikuara në tabelën I dhe tabelën II, që janë kapur ose konfiskuar, dhe për pranimin si prova të sasive të nevojshme të vërtetuara siç duhet të këtyre lëndëve.

Neni 15
Transportuesit tregtare

1. Palët duhet të marrin masat e përshtatshme për të siguruar që mjetet e transportit të drejtuara nga transportuesit tregtare, të mos përdoren për kryerjen e veprimtarive të kundërligjshme të parashikuara në përputhje me nenin 3 paragrafi 1; masa të tilla mund të përfshijnë marrëveshje të veçanta me transportuesit tregtarë.

2. Secila Palë duhet të kërkojë që tranportuesit tregtare të marrin masa të arsyeshme paraprake për të parandaluar që mjetet e tyre të transportit të përdoren për kryerjen e veprimtarive të kundërligjshme të parashikuara në përputhje me nenin 3 paragrafi 1. Masa të tilla paraprake mund të përfshijnë:

(a) rastin kur vendi kryesor i biznesit të transportuesit tregtar është brenda territorit të Palës:

(i) trajnimin e personelit për identifikimin e ngarkesës ose personave të dyshimtë;

(ii) rritjen e ndershmërisë së personelit;

(b) rastin kur transportuesi tregtar vepron brenda territorit të Palës:

(i) paraqitjen paraprakisht të manifestove të ngarkesës, kurdoherë që të jetë e mundur;

(ii) përdorimin mbi kontenierë të vulave të pafalsifikueshme, individualisht të vërtetueshme;

(iii) raportimin tek autoritetet e duhura në rastin më të parë të të gjitha rrethanave të dyshimta që mund të lidhen me kryerjen e veprimtarive të kundërligjshme të parashikuara në përputhje me nenin 3, paragrafi 1.

3. Secila Palë duhet të kërkojë të sigurojë që transportuesit tregtarë dhe autoritetet e duhura në pikat e hyrjes dhe të daljes dhe në zona të tjera të kontrollit doganor të bashkëveprojnë, me qëllim që të parandalojnë hyrjen e paautorizuar të mjeteve të transportit dhe ngarkesës së anijes dhe të zbatojnë masat e duhura të sigurisë.

Neni 16

Dokumentet tregtare dhe etiketimi i eksperteve

1. Secila Palë duhet të kërkojë që eksportet e ligjshme të drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope të shoqërohen me dokumentet e duhura. Përveç kërkesave për dokumentacion në bazë të nenit 31 të Konventës 1961 të nenit 31 të Konventës 1961 të ndryshuar dhe të nenit 21 të Konventës 1971, dokumentet tregtare si faturat, manifestot e ngarkesës, dokumentet e doganave, të transportit dhe dokumentet e tjera të transportimit me anije duhet të përfshijnë emrat e drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope që eksportohen siç parashikohet në listat e Konventës 1961, të Konventës 1961 të ndryshuar dhe të Konventës 1971, sasinë që eksportohet dhe emrin dhe adresën e eksportuesit, importuesit dhe marrësit të ngarkesës, kur ka të tillë.

2. Secila Palë duhet të kërkojë që ngarkesave të drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope që eksportohen të mos u vihen etiketa tjetër për tjetër.

Neni 17

Trafiku i paligjshëm me rrugë detare

1. Palët duhet të bashkëpunojnë në mënyrë sa më të plotë që të jetë e mundur, me qëllim që të ndalojnë trafikun e paligjshëm në rrugë detare, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare të detrave.

2. Pala, që ka arsye të logjikshme për të dyshuar se një anije që lundron me flamurin e saj ose që nuk ka flamur ose tregues regjistrimi, merret me trafik të paligjshëm, mund të kërkojë ndihmën e Palëve të tjera për të ndaluar që ajo të përdoret për atë qëllim. Palët, të cilave iu bëhet kjo kërkesë, duhet ta japin këtë ndihmë brenda mjeteve që ato kanë në dispozicion.

3. Pala, që ka arsye të logjikshme për të dyshuar, se një anije që ushtron lirinë e lundrimit në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe lundron me flamurin e një pale tjetër ose ka tregues regjistrimi të kësaj Pale, merret me trafik të paligjshëm, mund ta njoftojë shtetin të cilit i përket flamuri, t'i kërkojë konfirmim të regjistrimit dhe, nëse kjo vërtetohet, të kërkojë autorizim nga shteti të cilit i përket flamuri që të marrë masat e duhura në lidhje me atë anije.

4. Në përputhje me paragrafin 3, me traktatet në fuqi midis tyre ose në përputhje me çfarëdolloj marrëveshje ose rregullime të marrëveshjeve, e arritur në një formë tjetër midis atyre Palëve, shteti të cilit i përket flamuri mund të autorizojë shtetin që bën kërkesë që, inter alia,:

(a) të hipë në bord të anijes;

(b) të kontrollojë anijen;

(c) kur ka dëshmi të përfshirjes në trafik të paligjshëm, të ndërmarrë veprimin e duhur në lidhje me anijen, personat dhe ngarkesën e anijes.

5. Kur ndërmerret veprim në pajtim me këtë nen, Palët e interesuara duhet të marrin parasysh nevojën për të mos rrezikuar sigurinë e jetës në det, sigurinë e anijes dhe ngarkesën ose për të mos dëmtuar interesat tregtare dhe ligjore të shtetit të cilit i përket flamuri apo të ndonjë shtetit tjetër të interesuar.

6. Shteti të cilit i përket flamuri, në përputhje me detyrimet e tij të parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, mund ta kushtëzojë lëshimin e autorizimit të tij me kushte për të cilat ai dhe pala që bën kërkesën duhet të bien që të dy dakort, duke përfshirë që lidhen me përgjegjësinë.

7. Për qëllimet e paragrafit 3 dhe 4 të këtij neni, Pala duhet t'i përgjigjet menjëherë kërkesës së bërë nga një Palë tjetër për të përcaktuar nëse një anije, që lundron me flamurin e saj, ka të drejtë ta bëjë këtë gjë, si edhe kërkesave për autorizim të bëra në përputhje me paragrafin 3. Në kohën që bëhet Palë e kësaj Konvente, secila Palë duhet të emërojë një autoritet ose, kur ta shohë të nevojshme, autoritete që të pranojnë dhe t'u kthejnë përgjigje këtyre kërkesave. Të gjitha Palët e tjera duhet të marrin njoftim për këtë emërim, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm, brenda një muaji nga data e emërimit.

8. Pala, që ka ndërmarrë çfarëdo veprimi në përputhje me këtë nen, duhet të informojë menjëherë shtetin e interesuar të cilit i përket flamuri, për rezultatet e këtij veprimi.

9. Palët duhet të marrin në konsideratë lidhjen e marrëveshjeve dypalëshe ose rajonale ose rregullimeve për marrëveshje me qëllim që të zbatojnë ose të rrisin efektshmërinë e dispozitave të këtij neni.

10. Veprimi, në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni, duhet të ndërmerret vetëm nga luftanijet aviacioni ushtarak, nga anije ose aeroplanë të tjera, që kanë shenja të qarta dhe janë të identifikueshëm si mjete në shërbimin qeveritar dhe kanë autorizim për këtë qëllim.

11. Çdo veprim i ndërmarrë në përputhje me këtë nen duhet të marrë parasysh nevojën për të mos ndërhyrë në shtetet bregdetare apo për të mos prekur të drejtat dhe detyrimet dhe ushtrimin e juridiksionit të shteteve bregdetare në përputhje me të drejtën ndërkombëtare të detrave.

Neni 18

Zonat e lira tregtare dhe portet e lira

1. Palët duhet të zbatojnë masat për të ndaluar trafikun e paligjshëm të drogave narkotike, lëndëve psikotrope dhe lëndëve të parashikuara në tabelën I dhe tabelën II në zonat e lira tregtare dhe portet e lira, që janë jo më pak të rrepta se ato që zbatohen në pjesë të tjera të territoreve të tyre.

2. Palët duhet të përpiqen:

(a) të monitorojnë lëvizjen e mallrave dhe personave në zonat e lira tregtare dhe portet e lira dhe, për këtë qëllim, duhet t'u japin fuqi të plotë autoriteteve kompetente të kontrollojnë ngarkesat dhe anijet që hyjnë dhe dalin, duke përfshijë anijet që përdoren për argëtim dhe anijet e peshkimit, si edhe aeroplanet dhe mjetet e transportit dhe, kur të shihet e përshtatshme, të kontrollojnë anëtarët e ekuipazhit, pasagjerët dhe bagazhin;

(b) të krijojnë dhe të ruajnë një sistem për zbulimin e ngarkesave të dyshuara për droga narkotike, lëndë psikotrope dhe lëndë të parashikuara në tabelën I dhe tabelën II, që kalojnë ose dalin nga zonat e lira tregtare ose portet e lira;

(c) të krijojnë dhe të ruajnë sisteme mbikqyrjeje në zonat e portit dhe të dokut dhe në aeroporte e pika kontrolli kufitare në zonat e lira tregtare dhe portet e lira.

Neni 19

Përdorimi i postave

1. Në përputhje me detyrimet e tyre në bazë të konventave të bashkimit universal postar, dhe në përputhje me parimet bazë të sistemeve ligjore të vendeve të tyre, Palët duhet të marrin masa për të ndaluar që postat të përdoren për trafik të paligjshëm dhe duhet të bashkëveprojnë me njëra - tjetrën për këtë qëllim.

2. Masat, të cilave iu referohet në pragrafin 1 të këtij neni, duhet të përfshijnë në mënyrë të veçantë:

a) veprim të koordinuar për të parandaluar dhe për të mos lejuar që postat të përdoren për trafik të paligjshëm;

b) zbatimin dhe mirëmbajtjen, nga personeli i autorizuar që merret me zbatimin e ligjit, të teknikave hetimore dhe kontrolluese që përdoren për zbulimin e ngarkesave të paligjshme të drogave narkotike, lëndëve psikotrope dhe lëndëve të parashikuara në tabelën I dhe tabelën II në posta;

c) masat legjislative për të mundësuar përdorimin e mjeteve të përshtatshme për të siguruar të dhënat që kërkohen për procedurat gjyqësore.

Neni 20
Informacioni që duhet të japin Palët

1. Palët, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm, duhet t'i japin informacion Komisionit mbi funksionimin e kësaj Konvente në territoret e tyre dhe në mënyrë të veçantë:

(a) tekstin e ligjeve dhe rregulloreve që janë nxjerrë për ta bërë efektive këtë Konventë;

(b) hollësi të rasteve të trafikut të paligjshëm brenda juridiksionit të tyre që ata i konsiderojnë të rëndësishme për shkak të tendencave të reja që janë zbuluar, të sasive për të cilat bëhet fjalë, të burimeve nga ku janë përftuar lëndët ose metodat e përdorura nga personat e përfshirë në të.

2. Palët duhet ta japin këtë informacion në mënyrë të tillë dhe deri në ato data që Komisioni mund ta kërkojë.

Neni 21
Funksionet e Komisionit

Komisioni është i autorizuar të marrë në shqyrtimin të gjitha çështjet që lidhen me synimet e kësaj Konvente dhe, në mënyrë të veçantë:

(a) Komisioni duhet, në bazë të informacionit të dhënë nga Palët në përputhje me nenin 20, të rishikojë funksionimin e kësaj Konvente;

(b) Komisioni mund të bëjë sugjerime dhe rekomandime të përgjithshme në bazë të shqyrtimit të informacionit të marrë nga Palët;

(c) Komisioni mund të tërheqë vëmendjen e Bordit te çdo çështje që mund të ketë lidhje me funksionet e Bordit;

(d) Komisioni duhet, në lidhje me çdo çështje që i referohet atij nga Bordi në bazë të nenit 22, paragrafi 1 (b), të ndërmarrë veprimin që e gjykon të përshtatshëm;

(e) Komisioni, në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenin 12, mund të ndryshojë tabelën I dhe tabelën II;

(f) Komisioni mund të tërheqë vëmendjen e atyre që nuk janë Palë e vendimet që merr dhe rekomandimet që bën në bazë të kësaj Konvente, me qëllim që ato të marrin në konsideratë ndërmarrjen e veprimeve në përputhje me to.

Neni 22
Funksionet e Bordit

1. Pa marrë parasysh funksionet e Komisionit, të parashikuara në nenin 21, dhe pa marrë parasysh funksionet e Bordit dhe Komisionit të parashikuara në Konventën 1961, në Konventën 1961 të ndryshuar dhe në Konventën 1971;

(a) kur, në bazë të shqyrtimit të informacionit që është vënë në dispozicion të tij, të Sekretarit të Përgjithshëm ose të Komisionit, ose të informacionit të dhënë nga organet e Kombeve të Bashkuara, Bordi ka arsyet të besojë se synimet e kësaj Konvente për çështje që janë të lidhura me kompetencën e tij nuk janë përmbushur, Bordi mund ta ftojë Palën ose Palët të japin informacionin përkatës;

(b) në lidhje me nenet 12, 13 dhe 16:

(i) Pasi ndërmerr veprim në bazë të nënparagrafit të këtij neni Bordi, kur është i bindur se është e nevojshme që të veprohet kështu, mund ta nxisë Palën e interesuar të marrë masa përmirësuese që në këto rrethana duhet të duken të nevojshme për zbatimin e dispozitave të neneve 12, 13 dhe 16;

(ii) Përpara se të ndërmarrë veprimin si më poshtë (iii), Bordi duhet t'i trajtojë si konfidenciale komunikimet me Palën e interesuar në bazë të nënparagrafeve të mëparshëm,

(iii) Kur Bordi konstaton se Pala e interesuar nuk i ka marrë masat përmirësuese që i është thënë të marrë në bazë të këtij nënparagrafi, ai mund të tërheqë vëmendjen e Palëve, të Këshillit dhe të Komisionit te kjo çështje. Çdo raport i botuar nga Bordi, në bazë të këtij nënparagrafi, duhet të përmbajë gjithashtu pikëpamjet e Palës së interesuar, kur kjo e fundit e kërkon këtë.

2. Cilado Palë duhet të jetë ftuar të përfaqësohet në mbledhjen e Bordit, në të cilën, në bazë të këtij neni, do të shqyrtohet një çështje që i intereson asaj drejtpërsëdrejti.

3. Kur në ndonjë rast vendimi i Bordit, që merret në bazë të këtij neni, nuk është unanim, duhet të bëhen të ditura pikëpamjet e pakicës.

4. Vendimet e Bordit, në bazë të këtij neni, duhet të merren me një shumicë prej dy të tretash të gjithë numrit të anëtarëve të Bordit.

5. Në kryerjen e funksioneve të tij, në përputhje me nënparagrafin 1 (a) të këtij neni, Bordi duhet të sigurojë fshehtësinë e të gjithë informacionit, që ai mund të zotërojë.

6. Përgjegjësia e Bordit, në bazë të këtij neni, nuk duhet të ketë fuqi në lidhje me zbatimin e traktateve ose marrëveshjeve të lidhura midis Palëve, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente.

7. Dispozitat e këtij neni nuk duhet të jenë të zbatueshme për debatet midis Palëve që klasifikohen në dispozitat e nenit 32.

Neni 23

Raportet e Bordit

1. Bordi duhet të përgatisë një raport vjetor, për punën e saj që të përmbajë një analizë të informacionit në dispozicion të tij dhe, në raste të përshtatshme, një bilanc të shpjegimeve, nëse ka, të dhëna nga Palët ose të kërkuara prej tyre, si edhe çfarëdo vëzhgimi dhe rekomandimi që Bordi dëshiron të bëjë. Bordi mund të bëjë raporte të tilla plotësuese si ta gjykojë të nevojshme. Raportet duhet t'i paraqiten Këshillit nëpërmjet Komisionit që mund të bëjë ato komente që gjykon të përshtatshme.

2. Raportet e Bordit duhet t'i komunikohen Palëve dhe, në vijim, të botohen nga Sekretari i Përgjithshëm. Palët duhet të lejojnë shpërndarjen e tyre të pakufizuar.

Neni 24

Zbatimi i masave më të rrepta sesa ato që kërkon kjo Konventë

Pala mund të marrë masa më të rrepta ose më të ashpra se sa ato që parashikohen nga kjo Konventë, kur, sipas mendimit të saj, këto masa janë të dëshirueshme ose të nevojshme për parandalimin ose ndalimin e trafikut të paligjshëm.

Neni 25

Fuqia në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e traktateve të mëparshme

Dispozitat e kësaj Konvente duhet të kenë fuqinë e të gjitha të drejtave që kanë pasur ose detyrimeve që janë ndërmarrë nga Palët e kësaj Konvente në bazë të Konventës 1961, të Konventës 1961 të ndryshuar dhe të Konventës 1971.

Neni 26

Nënshkrimi

Kjo Konventë duhet të jetë e hapur për t'u nënshkruar në zyrën e Kombeve të Bashkuara në Vjenë, nga 20 dhjetori 1988 deri më 28 shkurt 1989, dhe më pas në Selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork, deri me 20 dhjetor 1989, nga:

(a) të gjitha shtetet;

(b) Namibia, e përfaqësuar nga Këshilli i Kombeve të Bashkuara për Namibinë;

(c) Organizatat rajonale të integrimit ekonomik, që kanë kompetencë për negociimin, lidhjen dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare për çështje që mbulohen nga kjo Konventë dhe rekomandimet në bazë të Konventës për Palët, Shtetet ose shërbimet kombëtare zbatohen për këto organizata brenda kufijve të kompetencës së tyre.

Neni 27

Ratifikimi, pranimi, miratimi ose akti i konfirmimit formal

1. Kjo Konventë paraqitet për ratifikim, pranim ose miratim nga Shtetet ose Namibia, e përfaqësuar nga Këshilli i Kombeve të Bashkuara për Namibinë dhe i nënshtrohet akteve të konfirmimit formal nga organizatat rajonale për integrim ekonomik të cilave iu referohet në nenin 26 nënparagrafi (c). Dokumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit dhe ato që lidhen me aktet e konfirmimit formal duhet të depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm.

2. Në dokumentet e tyre të konfirmimit formal, organizatat rajonale për integrim ekonomik duhet të deklarojnë shkallën e kompetencës së tyre në lidhje me çështje të parashikuara nga kjo Konventë. Këto organizata, gjithashtu, duhet të informojnë Sekretarin e Përgjithshëm për çdo modifikim të shkallës së kompetencës së tyre në lidhje me çështjet e përcaktuara nga kjo Konventë.

Neni 28

Pranim nga të tjerët

1. Kjo Konventë duhet të mbetet e hapur për t'u pranuar nga cilido Shtet, nga Namibia e përfaqësuar nga Këshilli i Kombeve të Bashkuara për Namibinë dhe nga organizatat rajonale për integrim ekonomik të cilave iu referohet në nenin 26, nënparagrafi (c). Pranimi duhet të bëhet efektiv me depozitimin e një dokumenti të pranimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

2. Në dokumentet e tyre të pranimit, organizatat rajonale për integrim ekonomik duhet të deklarojnë shkallën e kompetencës së tyre në lidhje me çështje të përcaktuara nga kjo Konventë. Këto organizata gjithashtu duhet të informojnë Sekretarin e Përgjithshëm për çdo modifikim të shkallës së kompetencës së tyre në lidhje me çështjet që përcaktohen nga Konventa.

Neni 29

Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë duhet të hyjë në fuqi në ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të dokumentit të njëzetë të ratifikimit, pranimit, miratimit ose pranimit nga Shtetet ose Namibia, e përfaqësuar nga Këshilli për Namibinë.

2. Për cilindo Shtet ose për Namibinë, të përfaqësuar nga Këshilli për Namibinë që ratifikon pranon, miraton ose pranon këtë Konventë pas depozitimit të dokumentit të njëzetë të ratifikimit, pranimit, miratimit ose pranimit nga të tjerët, Konventa duhet të hyjë në fuqi në ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitimit të dokumentit të ratifikimit, pranimit, miratimit ose të pranimit nga të tjerët.

3. Për secilën organizatë rajonale për integrim ekonomik, të cilës i referohet në nenin 26 nënparagrafi (c), që depoziton një dokument që lidhet me aktin e konfirmimit formal ose me dokumentin e pranimit nga të tjerët, kjo Konventë duhet të hyjë në fuqi në ditën e nëntëdhjetë pas këtij depozitimi, ose në datën kur Konventa hyn në fuqi në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, cilado qoftë data më e vonshme.

Neni 30

Denoncimi

1. Një Palë mund ta denoncojë këtë Konventë në çfarëdo kohe, duke njoftuar me shkrim Sekretarin e Përgjithshëm.

2. Ky denoncim duhet të ketë fuqi për Palën e interesuar një vit pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 31
Amendamentet

1. Çdo Palë mund të propozojë një amendament për këtë Konventë. Teksti i një amendamenti të tillë dhe arsyet për këtë duhet t'i komunikohen nga ajo Palë Sekretrait të Përgjithshëm, i cili duhet t'ia komunikojë atë Palëve të tjera dhe t'i pyesë nëse ato e pranojnë amenamentin e propozuar. Kur amendamenti i propozuar, pasi ka qarkulluar, nuk është hedhur poshtë nga ndonjë Palë brenda njëzet e katër muajve pasi ai ka filluar të qarkullojë, ai duhet të konsiderohet se është pranuar dhe duhet të hyjë në fuqi në lidhje me Palën nëntëdhjetë ditë pasi ajo Palë ka depozituar pranë Sekretarit të Përgjithshëm një dokument që shpreh pëlqimin e saj për të pranuar detyrimet që rrjedhin nga ai amendament.

2. Kur amenamenti i propozuar është hedhur poshtë nga ndonjë Palë, Sekretari i Përgjithshëm duhet të konsultohet me Palët dhe, nëse kërkohet nga shumica, ai duhet t'ia parashtrojë çështjen, së bashku me të gjitha komentet e bëra nga Palët, Këshillit që mund të vendosë të thërrasë një konferencë në përputhje me nenin 62 paragrafi 4, të Kartës së Kombeve të Bashkuara. Çdo amendament, që rezulton nga kjo Konferencë, duhet të mishërohet në protokollin e amendamentit. Pëlqimi për të pranuar detyrimet që rrjedhin nga ky protokoll, duhet të kërkohet t'i shprehet në mënyrë të veçantë Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 32
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Kur midis dy ose më shumë Palëve dalin mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, Palët duhet të konsultohet se bashku me qëllim që të zgjidhin mosmarrëveshjen, nëpërmjet bisedimeve, sqarimeve, ndërmjetësimit, pajtimit, arbitrazhit, duke iu drejtuar organizmave rajonale, procesit gjyqësor ose mjeteve të tjera paqësore që mund t'i zgjedhin vetë.

2. Çdo mosmarrëveshje që nuk mund të zgjidhet në mënyrën e parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni, duhet t'i referohet, me kërkesën e çdonjerit prej Shteteve Palë në këtë mosmarrëveshje, Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për të marrë vendim.

3. Kur Organizata Rajonale për Integrim Ekonomik të cilës i referohet në nenin 26, nënparagrafi (c) , është Palë në mosmarrëveshjen që nuk mund të zgjidhet në mënyrën e parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni, ajo, nëpërmjet një Shteti anëtar të Kombeve të Bashkuara, mund t'i kërkojë Këshillit të kërkojë këshillën e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në përputhje me nenin 65 të statutit të Gjykatës, këshilla e së cilës duhet të konsiderohet si vendimtare.

4. Cilido shtet, në kohën e nënshkrimit, të ratifikimit të pranimit, miratimit të kësaj Konvente ose pranimit të saj nga të tjerët, apo cilado organizatë rajonale për integrim ekonomik, në kohën e nënshkrimit ose të depozitimit të aktit të konfirmimit formal ose të pranimit nga të tjerët, mund të deklarojë se ai/ajo nuk i pranon detyrimet që rrjedhin nga paragrafi 2 dhe 3 në lidhje me Palën që e ka bërë këtë deklaratë.

5. Cilado Palë, që ka bërë një deklaratë në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni në çdo kohë mund ta tërheqë deklaratën duke njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm.

Neni 33
Tekstet e mirëfillta

Tekstet në gjuhën arabe, kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle të kësaj Konvente janë të njëjta me origjinalin.

Neni 34
Depozituesi

Depozituesi i kësaj Konvente duhet të jetë Sekretari i Përgjithshëm.

DUKE DËSHMUAR SA MË SIPËR, i autorizuar për këtë, nënshkrova këtë Konventë.

NËNSHKRUAR NË VJENË, në një kopje origjinale, më njëzet të dhjetorit një mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë.

SHTOJCË

Tabelat e rishikuara që përfshijnë amendamentet e bëra nga Komisioni mbi drogat narkotike, që kanë hyrë në fuqi që prej 23 nëntorit 1992:

Tabela I	Tabela II
Acid N-acetilantranilik	Anhidrit acetik
Efedrinë	Aceton
Ergometrinë	Acid antranilik
Ergotaminë	Eter etil
Izosofrole	Acid hidroklorik
Acid lisergjik	Metil etil ketone
3,4 - metilenedioksifenil	Acid fenilacetik
1 - fenil - 2-propanone	Piperidinë
Piperonal	Permagant potasi
Pseudoefedrinë	Acid sulfurik
Safrole	Toluene
Kriprat e lëndëve të renditura në këtë tabelë kudo që ekzistenca e këtyre kripërave është e mundur	Kripërat e lëndëve të renditura në këtë tabelë kudo që ekzistenca e këtyre kripërave është e mundur (kriprat e acidit hidroklorik dhe të acidit sulfurik janë përjashtuar në mënyrë të veçantë.

LIGJ
Nr.8723, datë 26.12.2000

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË "KONVENTËN E VETME MBI DROGAT NARKOTIKE, E NDRYSHUAR NGA PROTOKOLLI I VITIT 1972 PËR NDRYSHIMIN E KONVENTËS SË VETME MBI DROGAT NARKOTIKE, 1961"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në "Konventën e vetme mbi drogat narkotike, e ndryshuar nga Protokolli i vitit 1972 për ndryshimin e Konventës së Vetme mbi Drogat Narkotike, 1961".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2858, datë 5.1.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.50, faqe 2190

KONVENTA E VETME MBI DROGAT NARKOTIKE, 1961

E ndryshuar nga
Protokolli i vitit 1972 për Ndryshimin e Konventës së Vetme
mbi Drogat Narkotike, 1961
që përfshin Listat, Aktet Finale dhe Rezolutat siç është rënë dakord respektivisht nga Konferenca e Kombeve të Bashkuara e vitit 1961 për miratimin e një Konvente të Vetme mbi Drogat Narkotike dhe nga Konferenca e Kombeve të Bashkuara e vitit 1972 për shqyrtimin e Amendamenteve të Konventës së Vetme mbi Drogat Narkotike, 1961.

AKTI FINAL I KONFERENCËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR MIRATIMIN E NJË KONVENTE TË VETME MBI DROGAT NARKOTIKE

1. Këshilli Social-Ekonomik i Kombeve të Bashkuara, me Rezolutën 689 J (XXVI) të datës 28 korrik 1958, vendosi të thërrasë, në përputhje me nenin 62 paragrafi 4, të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe me dispozitat e Rezolutës 366 (IV) të datës 3 dhjetor 1949 të Asamblesë së Përgjithshme, një konferencë të plofuqishme për miratimin e një konvente të vetme mbi drogat narkotike për të zëvendësuar me një dokument të vetëm traktatet ekzistuese shumëpalëshe në këtë fushë, për të zvogëluar numrin e organeve të traktateve që merren vetëm me kontrollin e drogave narkotike dhe për të trajtuar kontrollin e prodhimit të lëndëve të para të drogave narkotike.

2. Konferenca e Kombeve të Bashkuara për miratimin e një Konvente të vetme mbi drogat narkotike u mblodh në Selinë e Kombeve të Bashkuara nga 24 janari deri më 25 mars 1961.

3. Shtatëdhjetë e tre shtetet e mëposhtme u përfaqësuan me përfaqësues në këtë konferencë:

AfganistaniEl SalvatoriLiberia
ShqipëriaFinlandaMadagaskari
ArgjentinaFrancaMeksiko
AustraliaGjermaniaMonako
BoliviaRepublika FederaleMaroku
BraziliGanaHollanda
BullgariaGreqiaZelanda e Re
BurmaGuatemalaNikaragua
Republika Socialiste HaitiNigeria
Sovjetike e BjellorusisëSelia e ShenjtëNorvegjia
KamboxhiaHungariaPakistani
KanadajaIndiaPanamaja
ÇadiIndonezia Paraguaj
KiliIraniPeruja
KinaIrakuFilipinet
Kongo (Leopoldvil)IzraeliPolonia
Kosta RikaItaliaPortugalia
ÇekosllovakiaJaponiaRumania

DahomejJordaniaSenegali
DanimarkaKoreaSpanja
Republika DomenikaneLibaniSuedia
ZvicraBashkimi i RepublikaveShtetet e Bashkuara
TailandaSocialiste Sovjetiketë Amerikës
TuniziaRepublika e Bashkuar ArabeUruguaj
TurqiaMbretëria e Bashkuar e BritanisëVenezuela
Republika Socialiste së Madhe dhe Irlandës së VeriutJugosllavia
Sovjetike e Ukrainës

4. Shteti i mëposhtëm u përfaqësua me një vëzhgues në Konferencë :

Cejloni.

5. Në konferencë u përfaqësuan agjencitë e mëposhtme të specializuara :

Organizata e Bujqësisë dhe Ushqimit të Kombeve të Bashkuara;
Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil;
Organizata Ndërkombëtare e Punës;
Organizata Botërore e Shëndetit.

6. Në konferencë u përfaqësuan organizmat e mëposhtme ndërkombëtare :

Bordi i Përhershëm Qendror i Opiumit;
Organi Mbikëqyrës i Drogave.

7. Në konferencë u përfaqësuan gjithashtu organizatat e më poshtme joqeveritare :

Konferenca Ndërkombëtare e Bamirësive Katolike;
Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale;
Federata Ndërkombëtare e Juristeve Gra.

8. Gjeneral Salwat, Drejtori i Byrosë së Përhershme të Antinarkotikëve të Ligës së Shteteve Arabe, me ftesë të konferencës, mori gjithashtu pjesë në këtë cilësi.

9. Në përputhje me Rezolutën e Këshillit Social-Ekonomik, të cilit i referohet në paragrafin 1 dhe me rregullat e procedurës të miratuara nga Konferenca, vëzhguesit dhe përfaqësuesit e organizatave dhe oranizmave të sipërpërmendura morën pjesë në punimet e konferencës pa të drejtë vote.

10.Konferenca zgjodhi President z.Carl Schumann (Hollandë) dhe zëvendëspresidentë përfaqësuesit e këtyre shteteve :

AfganistaniPeruja
BraziliZvicra
DahomejTajlanda
FrancaTurqia
HungariaRepublika e Bashkuar Arabe
IndiaMbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe
Iranidhe Irlandës së Veriut
JaponiaBashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike
MeksikoShtetet e Bashkuara të Amerikës
Pakistani

11. Sekretari Ekzekutiv i Konferencës ishte z. G.E.Yates dhe zëvendëssekretar ekzekutiv ishte z.Adolf Lande.

12. Konferenca kishte përpara mbi tavolinë, në përputhje me Rezolutën e Këshillit Social-Ekonomik, projektin e tretë të një konvente të vetme mbi drogat narkotike të përgatitur nga Komisioni mbi Drogat Narkotike i Këshillit dhe një përpilim të komenteve për këtë projekt; Konferenca kishte përpara mbi tavolinë edhe dokumente të tjera të përgatitura nga Sekretariati.

13. Konferenca krijoi komitetet e mëposhtme :

Komitetin e Përgjithshëm

Kryetar : Presidenti i Konferencës

Komitetin Ad Hoc për nenet 2 dhe 3 të projektit të tretë (sfera e veprimtarisë së Konventës dhe metoda e kontrollit të lëndëve plotësuese)

Kryetar : z.A.Tabiti (Afganistan)

Komitetin Ad Hoc për nenet 25, 30 dhe 40-43 (kontrolli kombëtar në përgjithësi)

Kryetar : z.B.Banerji (Indi)

Komitetin Ad Hoc për nenet 31-34 (Kontrolli Kombëtar i hashashit dhe i substancës së opiumit)

Kryetar : z. L.Ignacio-Pinto (Dahomej)

Zëvendëskryetar : z. J.Koch (Danimarkë)

Komitetin Ad Hoc për nenet 35-38 (Kontrolli Kombëtar i gjethes së kokainës)

Kryetar : z. K.Chikaraishi (Japoni)

Komitetin Ad Hoc për nenin 39 (Kontrolli Kombëtar i kanabis)

Kryetar : z. B.Grinberg (Bullgari)

Komitetin Ad Hoc për nenet 26, 27-29, 20-21, 4 (informacioni do të sigurohet nga qeveritë, sistemi i preventivave dhe statistikave; detyrimet e qeverive në përgjithësi)

Kryetar: z.E.Rodriguez Fabregat (Uruguaj)

Zëvendëskryetar : z.J.Bertschinger (Zvicër)

Komitetin Ad Hoc për nenin 22 (masat e zbatueshme nga Bordi në rast mospranimi)

Kryetar : z.A.Gurinovich (RSS e Bjellorusisë)

Komitetin Ad Hoc për nenet 5-11, 13-19, 23 (kushtetuta, funksionet dhe sekretariati i organeve ndërkombëtare)

Kryetar : z. H.Blomstedt (Finlandë)

Komitetin Ad Hoc për nenet 44-46 (masat e drejtpërdrejta kundër trafikut të paligjshëm)

Kryetar : z. A.Bittencourt (Brazil)

Komitetin Teknik

Kryetar : z. A.Johnson (Australi)

Zëvendëskryetar : z.A.Ismael (Republika e Bashkuar Arabe)

Komitetin Hartues

Kryetar : z. R.Curran (Kanada)

Zëvendëskryetar : z. D.Nikolic (Jugosllavi)

Komitetin e Kredencialeve

Kryetar : z.G.Ortiz (Kosta Rika)

14. Si rezultat i diskutimeve, siç është shënuar në dokumentet përmbledhëse të sesionit plenar dhe në dokumentat përmbledhëse dhe raportet e komiteteve, konferenca miratoi11 dhe la hapur nënshkrim Konventën e Vetme mbi Drogat Narkotike, 1961. Përveç kësaj, konferenca miratoi pesë rezoluta që i bashkëngjiten këtij Akti Final.

Duke dëshmuar sa më sipër përfaqësuesit e nënshkruan këtë Akt Final.

Nënshkruar në Nju Jork, sot më 30 mars një mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e një, në një kopje të vetme në gjuhët kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle dhe çdo tekst është i njëjtë me origjinalin. Tekstet origjinale duhet të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

[11]. Konferenca mbajti shënim se Konventa u miratua pa marrë parasysh vendimet apo deklaratat e marra ose të bëra në çfarëdo rezolute përkatëse të Asamblesë së Përgjithshme.

REZOLUTAT
E MIRATUARA NGA KONFERENCA E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR MIRATIMIN E NJË KONVENTE TË VETME MBI DROGAT NARKOTIKE

REZOLUTA 1
NDIHMË TEKNIKE MBI DROGAT NARKOTIKE

Konferenca,

Duke përshëndetur caktimin me anë të Rezolutës 1395 (XIV) të Asamblesë së Përgjithshme të parapërgatitjeve të veçanta për ndihmë teknike në fushën e kontrollit të narkotikëve,

Duke vënë re se Kombet e Bashkuara dhe agjencitë e specializuara të interesuara kanë dhënë tashmë një sasi të kufizuar ndihme në kuadrin e Programit të Zgjeruar të Ndihmës Teknike dhe në kuadrin e programeve të tyre të rregullta,

Duke mirëpritur bashkëpunimin e Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale në zbatimin e projekteve të ndihmës teknike,

Shpreson se do të gjenden burime të mjaftueshme për të siguruar ndihmë në fushën kundër trafikut të paligjshëm për ato vende që dëshirojnë dhe e kërkojnë këtë, veçanërisht në formën e këshilltarëve ekspertë dhe trajnimit, duke përfshirë kurse trajnimi për nëpunësit vendas.

REZOLUTA 2
TRAJTIMI I PËRDORUESVE TË DROGËS

Konferenca,

Duke përmendur dispozitat e nenit 38 të Konventës në lidhje me trajtimin dhe rehabilitimin e përdorueve të drogës:

1.Deklaron se një nga metodat më të efektshme të trajtimit të përdorimit të drogës është trajtimi në një institucion spitalor, ku ekziston një atmosferë e çliruar nga droga;

2.Nxit Palët që kanë probleme serioze të përdorimit të drogës dhe mjetet ekonomike në dispozicion që të krijojnë lehtësira të tilla.

REZOLUTA 3
TRAFIKANTËT E PALIGJSHËM

Konferenca ,

1.Tërheq vëmendjen tek rëndësia e dokumentimit teknik të trafikantëve ndërkombëtarë që aktualisht mbahet nga Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale;

2.Rekomandon që ky dokumentim të plotësohet sa më shumë që të jetë e mundur nga të gjitha Palët dhe të përdoret gjerësisht për qarkullimin e përshkrimit të trafikantëve nga ajo organizatë.

REZOLUTA 4
ANËTARËSIA NË KOMISIONIN MBI DROGAT NARKOTIKE

Konferenca,

Fton Këshillin Social-Ekonomik të shqyrtojë në sesionin e tij të tridhjetë e dy çështjen e zgjerimit të anëtarësisë së Komisionit mbi drogat narkotike, në dritën e kushteve të kësaj Konvente dhe të pikëpamjeve të shprehura për këtë çështje në këtë konferencë.

REZOLUTA 5
MAKINERIA NDËRKOMBËTARE E KONTROLLIT

Konferenca,

Duke mbajtur parasysh rëndësinë e mundësimit të parapërgatitjeve të përkohshme, baza ligjore e të cilave parashikohet në nenin 45 të Konventës së Vetme mbi Drogat Narkotike, 1961,

Fton Këshillin Social-Ekonomik që të studiojë mundësinë e marrjes së masave që do të siguronin kryerjen e shpejtë dhe pa probleme të thjeshtësimit të makinerisë ndërkombëtare të kontrollit.

AKTI FINAL
I KONFERENCËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR SHQYRTIMIN E AMENDAMENTEVE TË KONVENTËS SË VETME MBI DROGAT NARKOTIKE, 1961

1.Këshilli Social-Ekonomik i Kombeve të Bashkuara, duke vërejtur se janë propozuar amendamente për Konventën e Vetme mbi Drogat Narkotike, 1961, dhe duke mbajtur parasysh nenin 47 të asaj Konvente, vendosi me Rezolutën e tij 1577 (L) të datës 21 maj 1971 që të thërrasë, në përputhje me nenin 62, paragrafi 4 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, një konferencë të të plotfuqishmëve për të shqyrtuar të gjitha amendamentet e propozuara për Konventën e Vetme mbi Drogat Narkotike, 1961.

2.Konferenca e Kombeve të Bashkuara për shqyrtimin e amendamenteve të Konventës së Vetme mbi Drogat Narkotike, 1961, u mbajt në Zyrën e Kombeve të Bashkuara në Gjenevë nga datat 6-24 mars 1972.

3.Në Konferencë 97 shtetet e mëposhtme u përfaqësuan me përfaqësues :

AfganistaniEkuadori
AlgjeriaEgjipti
ArgjentinaEl Salvadori
AustraliaRepublika Federale e Gjermanisë
AustriaFinlanda
BelgjikaFranca
BoliviaGaboni
BraziliGambia
BullgariaGana
BurmaGreqia
BurundiGuatemala
Republika Socialiste SovjetikeHaiti
e BjellorusisëSelia e Shenjtë
KanadajaHungaria
CejloniIndia
KiliIndonezia
KolumbiaIrani
Kosta RikaIraku
KubaIrlanda
QiproIzraeli
ÇekosllovakiaItalia
DahomejBregu i Fildishtë
DanimarkaXhamajka
JaponiaPortugalia
JordaniaRepublika e Koresë
KeniaRepublika e Vietnamit
Republika KmereArabia Saudite

KuvajtiSenegali
LaosiSierra Leone
LibaniSingapori
LiberiaAfrika e Jugut
Republika Arabe e LibisëSpanja
LihtenshtajniSudani
LuksemburguSuedia
MadagaskariZvicra
MalaviTajlanda
MeksikoTogo
MonakoTunizia
Republika Popullore e MongolisëTurqia
MarokuRepublika Socialiste Sovjetike
Hollandae Ukrainës
Zelanda e ReBashkimi i Republikave Socialiste
NikaraguaSovjetike
NigeriMbretëria e Bashkuar e Britanisë
Nigeriasë Madhe dhe Irlandës së Veriut
NorvegjiaShtetet e Bashkuara të Amerikës
PakistaniUruguaj
PanamajaVenezuela
PerujaJugosllavia
FilipinetZaireja
Polonia

4. Shtetet e mëposhtme u përfaqësuan me vëzhgues në Konferencë :

KameruniMalta
Republika DomenikaneRumania
Malajzia

5.Këshilli Social-Ekonomik, me Rezolutën e tij 1577 (L), i kërkoi Sekretarit të Përgjithshëm të ftonte në Konferencë Organizatën Botërore të Shëndetit dhe agjenci të tjera të specializuara të interesuara, Bordin Ndërkombëtar për Kontrollin e Narkotikëve dhe Organizatën Ndërkombëtare të Policisë Kriminale. Në konferencë u përfaqësuan Organizata Botërore e Shëndetit, Bordi Ndërkombëtar për Kontrollin e Narkotikëve dhe Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale.

6.Konferenca zgjodhi President të konferencës zotin K.B.Asante (Ganë), zëvendëspresident të parë zotin D.Nikolic (Jugosllavi) dhe zëvendëspresidentë të tjerë përfaqësuesit e këtyre shteteve :

ArgjentinëFrancë
EgjiptIndi
LibanMbretëria e Bashkuar e Britanisë së
MeksikoMadhe dhe Irlandës së Veriut
TurqiShtetet e Bashkuara të Amerikës
Bashkimi i Republikave
Socialiste Sovjetike

7.Zoti V.Winspeare-Guicciardi, Drejtor i Përgjithshëm i Zyrës së Kombeve të Bashkuara në Gjenevë, ishte përfaqësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Sekretari Ekzekutiv i konferencës ishte Dr.V.Kusevic, Këshilltari Ligjor i konferencës ishte zoti G.Wattles dhe zëvendëssekretar ekzekutiv dhe zëvendëskëshilltar ligjor ishte zoti P.Raton.

8.Konferenca kishte përpara mbi tavolinë amendamentet e Konventës së Vetme mbi Drogat narkotike, 1961, të propozuara nga shtetet pjesëmarrëse në konferencë.

9.Konferenca krijoi komitetet e mëposhtme :

Komitetin e Përgjithshëm

Kryetar : Presidenti i konferencës

Komitetin I
Kryetar : Dr.R.A.Chapman (Kanada)
Komitetin II
Kryetar : Dr.Bela Bolcs (Hungari)
Komitetin hartues
Kryetar : Zotin J-P, Bertschinger (Zvicër)
Komiteti e Kredencialeve
Kryetar : zoti J.W.Lennon (Irlandë)

10.Komiteti I ngriti një grup pune për nenin 14, kryetar i të cilit ishte zoti A.C.Kirca (Turqi).

11.Si rezultat i diskutimeve të saj, siç është shënuar në dokumentet përmbledhëse të sesionit plenar dhe të Komiteteve I dhe II, konferenca miratoi dhe e la të hapur për nënshkrim protokollin që ndryshon Konventën e Vetme mbi Drogat Narkotike, 1961. Përpos kësaj, Konferenca miratoi tri rezoluta që i bashkëngjiten Aktit Final.

Bërë në Gjenevë, sot më njëzet e pesë mars njëmijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy, në një kopje të vetme në gjuhët angleze, frënge, ruse dhe spanjolle, çdo tekst është i njëjtë me origjinalin. Teksti origjinal duhet të depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Duke dëshmuar sa më sipër, përfaqësuesit e nënshkruan këtë Akt Final.

REZOLUTAT
E MIRATUARA NGA KONFERENCA E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR SHQYRTIMIN E AMENDAMENTEVE TË KONVENTËS SË VETME MBI DROGAT NARKOTIKE, 1961

REZOLUTA 1
SEKRETARIATI I BORDIT NDËRKOMBËTAR PËR KONTROLLIN E NARKOTIKËVE

Konferenca,

Duke e konsideruar se masat e miratuara nga Këshilli Social-Ekonomik në Rezolutën e saj 1196 (XLII) të datës 16 maj 1967 (mbledhja plenare e 1464-të) i plotësuan dëshirat e shteteve Palë në Konventën e vetme mbi drogat narkotike, 1961 dhe në konventat e mëparshme ende në fuqi,

Rekomandon vazhdimësinë e sistemit që u krijua nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara dhe dispozitat kryesore të të cilit vijojnë si më poshtë :

1.Bordi Ndërkombëtar për Kontrollin e Narkotikëve (që më poshtë do të quhet Bordi) ka një sekretariat të veçantë nga Seksioni i Drogave Narkotike;

2.Ai sekretariat është pjesë përbërëse e Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara; ndërsa është nën kontrollin e plotë administrativ të Sekretarit të Përgjithshëm, ai është i detyruar të zbatojë vendimet e Bordit;

3.Anëtarët e sekretariatit emërohen ose caktohen nga Sekretari i Përgjithshëm; kreu i sekretariatit emërohet ose caktohet në konsultim me Bordin.

REZOLUTA 2
NDIHMA PËR KONTROLLIN E NARKOTIKËVE

Konferenca,

Duke pasur parasysh se ndihma për vendet në zhvillim është një shprehje konkrete e vullnetit të komunitetit ndërkombëtar për të nderuar angazhimin që përmban Karta e Kombeve të Bashkuara për të nxitur progresin shoqëror dhe ekonomik të të gjithë popujve,

Duke pasur parasysh parapërgatitjet e veçanta të bëra nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në kuadrin e rezolutës së saj 1395 (XIV) për dhënien e ndihmës teknike për kontrollin e përdorimit të drogës;

Duke përshëndetur krijimin, në pajtim me Rezolutën 2719 (XXV) të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara të një Fondi të Kombeve të Bashkuara për kontrollin e përdorimit të drogës;

Duke vërejtur se konferenca ka miratuar një nen të ri 14 bis në lidhje me ndihmën teknike dhe financiare për të nxitur zbatimin më efektiv të dispozitave të Konventës së Vetme mbi Drogat Narkotike, 1961.

1.Deklaron se, për të qënë më të efektshme, masat e marra kundër përdorimit të drogës duhet të bashkërendohen dhe të jenë universale;

2.Deklaron më tej se përmbushja nga ana e vendeve në zhvillim të detyrimeve të tyre në kuadrin e kësaj Konvente do të lehtësohet nga ndihma e mjaftueshme teknike dhe financiare nga ana e komunitetit ndërkombëtar.

REZOLUTA 3
KUSHTET SHOQËRORE DHE MBROJTJA KUNDËR PËRDORIMIT TË DROGËS

Konferenca,

Duke kujtuar se parathënia e Konventës së Vetme mbi Drogat Narkotike, 1961, thotë se Palët në Konventë "interesohen për shëndetin dhe mirëqënien e njerëzimit" dhe janë të "vetëdijshme për detyrën e tyre për të parandaluar dhe për të luftuar" të keqen e përdorimit të drogës,

Duke mbajtur parasysh se diskutimet në konferencë kanë dhënë dëshmi të dëshirës për të ndërmarrë hapa të efektshëm për parandalimin e përdorimit të drogës,

Duke pasur parasysh se, teksa përdorimi i drogës çon në degradimin vetjak dhe në përçarjen shoqërore, ndodh shpeshherë që kushtet e mjerueshme shoqërore dhe ekonomike në të cilat jetojnë individë të caktuar dhe grupe të caktuara bëjnë që ata të priren ndaj përdorimit të drogës,

Duke marrë parasysh se faktorët shoqërorë kanë njëfarë ndikimi mbizotërues dhe nganjëherë ndikim mbizotërues në sjelljen e individëve dhe grupeve,

Rekomandon që Palët :

1.Të mbajnë parasysh se përdorimi i drogës është shpeshherë rezultat i një atmosfere shoqërore të papëlqyer ku jetojnë ata që janë më shumë të ekspozuar ndaj rrezikut të përdorimit të drogës;

2.Të bëjnë gjithçka që kanë në dorë për të luftuar përhapjen e përdorimit të paligjshëm të drogave,

3.Të zhvillojnë veprimtari shlodhëse dhe veprimtari të tjera që çojnë në krijimin e një mjedisi të shëndetshëm fizik dhe psikologjik për të rinjtë.

KONVENTA
E VETME MBI DROGAT NARKOTIKE,1961, E NDRYSHUAR NGA PROTOKOLI I VITIT 1972 QË NDRYSHON KONVENTËN E VETME MBI DROGAT NARKOTIKE, 1961

PARATHËNIE

Palët,

Të interesuara për shëndetin dhe mirëqënien e njerëzimit;

Duke e pranuar se përdorimi mjekësor i drogave narkotike vazhdon të jetë i domosdoshëm për qetësimin e dhimbjeve dhe vuajtjeve dhe se duhet të formulohen dispozita të përshtatshme për të siguruar ekzistencën e drogave narkotike për këto qëllime;

Duke e pranuar se përdorimi i drogave narkotike përbën një të keqe serioze për individin dhe mbart rrezik shoqëror dhe ekonomik për njerëzimin;

Të vetëdijshëm për detyrën e tyre për ta parandaluar dhe për ta luftuar këtë të keqe,

Duke pasur parasysh se masat e efektshme kundër përdorimit të drogave narkotike kërkojnë veprim të bashkërenduar dhe të përgjithshëm;

Duke e kuptuar se një veprim i tillë i përgjithshëm kërkon bashkëveprim në nivel ndërkombëtar që të udhëhiqet nga të njëjtat parime dhe që synon të arrijë objektiva të përbashkëta;

Duke njohur kompetencën e Kombeve të Bashkuara në fushën e kontrollit të narkotikëve dhe me dëshirën që organet ndërkombëtare të interesuara të inkuadrohen në atë organizatë,

Duke dashur që të përfundojnë një Konventë ndërkombëtare përgjithësisht të pranueshme që të zëvendësojë traktatet ekzistuese mbi drogat narkotike, duke i kufizuar këto droga në përdorimin e tyre mjekësor dhe shkencor dhe të sigurojë bazën ligjore për bashkëveprim të vazhdueshëm në nivel ndërkombëtar dhe për kontrollin e arritjes së këtyre synimeve dhe objektivave,

Bien dakord si më poshtë[12] :

Neni 1

Përkufizimet

1.Përjashtuar kur shënohet në mënyrë të qartë ndryshe ose kur konteksti e kërkon ndryshe, përkufizimet e mëposhtme do të përdoren gjatë gjithë Konventës:

(a)"Bordi" nënkupton Bordin Ndërkombëtar për Kontrollin e Narkotikëve,

(b)"Kanabis" nënkupton majat e luleve ose fruteve të bimës kanabis (duke përfshirë farat dhe gjethet kur nuk shoqërohen me majat), nga të cilat nuk është hequr rrëshira, pavarësisht nga emri me të cilin mund të emërtohen.

(c)"Bima kanabis" nënkupton çdo bimë të llojit kanabis.

(d)"Rrëshirë kanabis" nënkupton rrëshirën e ndarë, të papërpunuar ose të pastruar, që përftohet nga bima kanabis.

(e)"Shkurrja e kokainës" nënkupton bimën e çfarëdo gjinie të llojit eritroksilon,

(f)"Gjethja e kokainës" nënkupton gjethen e shkurres së kokainës përveç gjethes nga e cila janë hequr të gjitha alkaloidet ecgonine, kokainë dhe çdo lloj alkaloidi tjetër ecgonine.

(g)"Komisioni" nënkupton Komisionin mbi Drogat Narkotike të Këshillit.

(h)"Këshilli" nënkupton Këshillin Social-Ekonomik të Kombeve të Bashkuara.

(i)"Kultivimi" nënkupton kultivimin e hashashit, shkurres së kokainës ose bimës kanabis.

(j)"Droga" nënkupton çdo lloj lënde të parashikuar në listat I dhe II, qofshin natyrale ose sintetike.

(k)"Asambleja e Përgjithshme" nënkupton Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

(l)"Trafiku i paligjshëm" nënkupton kultivimin ose trafikun e drogave në kundërshtim me dispozitat e kësaj Konvente.

(m)"Importi" dhe "eksporti" nënkuptojnë në konotacionet e tyre respektive transferimin fizik të drogave nga një shtet në një shtet tjetër ose nga një territor në një territor tjetër të të njëjtit shtet.

(n)"Fabrikimi" nënkupton të gjitha proceset, përveç prodhimit, me anë të të cilave mund të përftohen drogat dhe përfshin rafinimin, si edhe transformimin e drogave në droga të tjera.

(o)"Opiumi mjekësor" nënkupton opiumin që i është nënshtruar proceseve të nevojshme për ta përshtatur për përdorim mjekësor.

---

[12]. Shënim i Sekretariatit : Hyrje në Protokollin që ndryshon Konventën e Vetme mbi Drogat Narkotike, 1961, lexo si më poshtë :

"Palët në këtë protokoll,

"Duke shqyrtuar dispozitat e Konventës së Vetme mbi Drogat Narkotike.

1961, bërë në Nju Jork më 30 mars 1961 (që më poshtë do të quhet Konventa e Vetme)".

"Me dëshirën për të ndryshuar Konventën e Vetme".

"Kanë rënë dakord si më poshtë".

(p)"Opiumi" nënkupton lëngun e koaguluar të hashashit.

(q)"Hashashi" nënkupton bimën e llojit papaver somniferum L.

(r)"Kashta e lulëkuqes" nënkupton të gjitha pjesët (përveç farave) e lulekuqes pasi është kositur.

(s)"Preparati" nënkupton një përzierje, të ngurtë ose të lëngët, që përmban drogë.

(t)"Prodhimi" nënkupton ndarjen e opiumit, të gjetheve të kokainës, të kanabis dhe të rrëshirës kanabis nga bimët nga të cilat ato janë përftuar.

(u)"Lista I", "Lista II", "Lista III" dhe "Lista IV" nënkuptojnë listat korresponduese me numra rendorë të drogave ose preparateve që i bashkëngjiten kësaj Konvente, të ndryshuar herëpashere në përputhje me nenin 3.

(v)"Sekretari i Përgjithshëm" nënkupton Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

(w)"Stoqet e veçanta" nënkuptojnë sasitë e drogave që mbahen në një vend apo në një territor nga qeveria e këtij vendi ose territori për qëllime të veçanta qeveritare dhe për përballimin e rrethanave të jashtëzakonshme dhe në pajtim me këtë do të përdoret shprehja "qëllime të veçanta".

(x)"Stoqet" nënkuptojnë sasitë e drogave që mbahen në një vend ose territor dhe që janë për:

(i) konsum në këtë vend ose territor për qëllime mjekësore dhe shkencore;

(ii) përdorim në këtë vend ose territor për fabrikimin e drogave dhe lëndëve të tjera, ose

(iii) eksport, por nuk përfshijnë sasitë e drogave që mbahen në këtë vend ose territor,

(iv) farmacistët që shesin me pakicë ose nga shpërndarës të tjerë që kanë autorizim të shesin me pakicë dhe nga institucione ose persona të kualifikuar në ushtrimin përkatës të autorizuar të funksioneve terapeutike ose shkencore,

(v) ose si "stoqe të veçanta".

(y)"Territori" nënkupton çdo pjesë të një shteti që trajtohet si njësi e veçantë për zbatimin e sistemit të çertifikatave të importit dhe autorizimeve të eksportit të parashikuara në nenin 31. Ky përkufizim nuk duhet të vlejë për termin "territor" siç përdoret në nenet 42 dhe 46.

2.Për qëllimet e kësaj Konvente një drogë duhet të konsiderohet "e konsumuar" kur ajo është dhënë nga një person ose ndërmarrje për shpërndarje me pakicë, për përdorim mjekësor ose kërkime shkencore; dhe në pajtim me këtë do të përdoret termi "konsum".

Neni 2

Lëndët nën kontroll

1.Përjashtuar masat e kontrollit që kufizohen për droga të specifikuara, drogat në Listën I u nënshtrohen të gjitha masave të kontrollit të zbatueshme për drogat, në kuadrin e kësaj Konvente dhe në mënyrë të veçantë për ato të paracaktuara në nenin 4 (c), 19, 20, 21, 29, 30, 31, 32, 33, 34 dhe 37.

2.Drogat në listën II u nënshtrohen të njëjtave masa të kontrollit si drogat në listën I, me përjashtim të masave të paracaktuara në nenin 30, paragrafi 2 dhe 5, në lidhje me tregtinë me pakicë.

3.Preparatet përveç atyre në Listën III u nënshtrohen të njëjtave masa të kontrollit, si edhe drogat që ato përmbajnë, por preventiva (neni 19) dhe statistika (neni 20) të veçanta nga ato që trajtojnë këto droga nuk duhet të kërkohen në rastin e këtyre preparateve dhe neni 29 paragafi (c) dhe neni 30 paragrafi 1 (b) (ii) nuk është nevoja të zbatohen.

4.Preparatet në Listën III u nënshtrohen të njëjtave masa të kontrollit si edhe preparatet që përmbajnë drogat në Listën II përveç atij neni 31, paragrafet 1 (b) dhe 3 deri 15, kurse, përsa i përket përvetësimit dhe shpërndarjes me pakicë, neni 34 paragrafi (b) nuk është nevoja të zbatohet dhe se për qëllime të preventivave (neni 19) dhe statistikave (neni 20) informacioni i kërkuar duhet të kufizohet në sasitë e drogave të përdorura në fabrikimin e këtyre preparateve.

5.Drogat në Listën IV gjithashtu duhet të përfshihen në Listën 1 dhe duhet t'u nënshtrohen të gjitha masave të kontrollit të zbatueshme për drogat në këtë listë të fundit dhe përveç kësaj :

(a) Një Palë duhet të marrë masa të veçanta kontrolli që sipas mendimit të saj janë të nevojshme, duke pasur parasysh vetitë veçanërisht të rrezikshme të një droge këtu të përfshirë; dhe

(b) Një Palë duhet, nëse për mendimin e saj kushtet mbizotëruese në vend e bëjnë atë mjetin më të përshtatshëm për mbrojtjen e shëndetit dhe mirëqenies publike, të ndalojë prodhimin, fabrikimin, eksportin dhe importin, tregtinë, zotërimin ose përdorimin e një droge të tillë, përjashtuar sasitë që mund të nevojiten vetëm për kërkime mjekësore dhe shkencore, duke përfshirë testet klinike që do të bëhen me ato nën mbikqyrjen dhe kontrollin e drejtpërdrejtë të Palës ose duke iu nënshtruar kësaj mbikqyrjeje dhe kontrolli të drejtpërdrejtë.

6.Përveç masave të kontrollit, të zbatueshme për të gjitha drogat në Listën I, opiumi trajtohet në dispozitat e nenit 19 paragrafi 1, nënparagrafi (f) dhe nenet 21 bis, 23 dhe 24, gjethja e kokainës në ato të neneve 26 dhe 27 dhe kanabis në ato të nenit 28.

7.Hashashi, shkurrja e kokainës, bima kanabis, kashta e lulekuqes dhe gjethet e kanabis u nënshtrohen masave të kontrollit të parashikuara në nenin 19 paragrafi 1, nënparagrafi (e), neni 20 paragrafi 1 nënparagrafi (g), neni 21 bis dhe përkatësisht nenet 22 deri 24; 22, 26 dhe 27; 22 dhe 28; 25 dhe 28.

8.Palët duhet të sigurojnë që përpjekjet e tyre më të mira të zbatohen për lëndët që nuk përfshihen në këtë Konventë, por që mund të përdoren në fabrikimin e paligjshëm të drogave, masa të tilla mbikqyrjeje që mund të jenë të praktikueshme.

9.Palët nuk kërkohet që të zbatojnë dispozitat e kësaj Konvente për droga që përdoren zakonisht në industri për qëllime të tjera, përveç atyre mjekësore ose shkencore me kusht që :

(a) Ato të sigurojnë me metoda të përshtatshme të denaturimit ose mjete të tjera që drogat e përdorura për këtë qëllim të mos ketë të ngjarë të përdoren ose të kenë efekte të këqija (neni 3 paragrafi 3) dhe që lëndët e dëmshme të mos kenë mundësi të përftohen sërisht në praktikë;

(b) Ato të përfshijnë në informacionin statistikor (neni 20), që u dërgohet atyre, sasinë e çdo droge të përdorur për këtë qëllim.

Neni 3

Ndryshimet në fushën e veprimtarisë së kontrollit

1.Kur një Palë ose Organizata Botërore e Shëndetit ka informacion që për mendimin e saj mund të kërkojë ndryshim të ndonjërës prej listave, ajo duhet të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm dhe t'i dërgojë atij informacionin në mbështetje të këtij njoftimi.

2.Sekretari i Përgjithshëm duhet t'ia transmetojë këtë njoftim dhe çdo informacion që ai e quan se ka lidhje, Palëve, Komisionit dhe, kur njoftimi është bërë nga një Palë, Organizatës Botërore të Shëndetit.

3.Kur njoftimi lidhet me një lëndë që nuk është përfshirë në Listën I ose Listën II,

(i) Palët duhet të shqyrtojnë në dritën e informacionit të dhënë mundësinë e zbatimit të përkohshëm për këtë lëndë të të gjitha masave të kontrollit të zbatueshme për drogat e parashikuara në Listën I;

(ii) Në pritje të vendimit të tij siç parashikohet në nënparagrafin (iii) të këtij paragrafi, Komisioni mund të vendosë që Palët të zbatojnë përkohësisht për këtë lëndë të gjitha masat e kontrollit të zbatueshme për drogat e parashikuara në Listën I. Palët duhet t'i zbatojnë përkohësisht këto masa për lëndën në fjalë;

(iii) Në qoftë se Organizata Botërore e Shëndetit konstaton se kjo lëndë ka të ngjarë të përdoret në mënyrë të ngjashme dhe të sjellë të njëjtat efekte të këqija si edhe drogat e parashikuara në Listën I ose Listën II ose është e shndërrueshme në drogë, ajo duhet t'ia komunikojë këtë konstatim Komisionit që, në përputhje me rekomandimin e Organizatës Botërore të Shëndetit, mund të vendosë që kjo lëndë t'i shtohet Listës 1 ose Listës II.

4.Në qoftë se Organizata Botërore e Shëndetit konstaton se një preparat, për shkak të lëndëve që përmban, nuk ka të ngjarë të përdoret dhe të sjellë efekte të këqija (paragrafi 3) dhe se kjo drogë nuk është menjëherë e shndërrueshme, komisioni, në përputhje me rekomandimin e Organizatës Botërore të Shëndetit, mund ta shtojë këtë preparat në Listën III.

5.Në qoftë se Organizata Botërore e Shëndetit konstaton se një drogë e parashikuar në Listën 1 është veçanërisht e prirur të përdoret dhe të sjellë efekte të këqija (paragrafi 3) dhe se kjo prirje nuk kompensohet me dobitë thelbësore terapeutike që nuk i kanë lëndët përveç drogave në Listën IV, komisioni, në përputhje me rekomandimin e Organizatës Botërore të Shëndetit, mund ta përfshijë këtë drogë në Listën IV.

6.Kur njoftimi lidhet me një drogë të parashikuar në Listën I ose Listën II ose me një preparat të parashikuar në Listën III, komisioni, përveç masës që parashikohet në paragrafin 5, mund, në përputhje me rekomandimin e Organizatës Botërore të Shëndetit, të ndryshojë çdonjërën nga listat duke :

(a) transferuar një drogë nga lisa I në Listën II ose nga lista II në Listën I;

(b) ose duke hequr një drogë ose preparat, sipas rastit, nga një listë.

7.Çdo vendim i Komisionit i marrë në pajtim me këtë nen duhet t'u komunikohet nga Sekretari i Përgjithshëm të gjitha shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara, shteteve joanëtare Palë në këtë Konventë, Organizatës Botërore të Shëndetit dhe Bordit. Një vendim i tillë duhet të hyjë në fuqi në lidhje me çdo Palë në datën e marrjes së këtij komunikimi dhe pastaj Palët duhet të ndërmarrin veprimin siç mund të kërkohet në kuadrin e kësaj Konvente.

8.(a) Vendimet e Komisionit që ndryshojnë ndonjërën prej listave duhet t'i nënshtrohen rishikimit nga Këshilli me kërkesë të secilës Palë, kërkesë kjo që depozitohet brenda nëntëdhjetë ditësh nga marrja e njoftimit të vendimit. Kërkesa për rishikim duhet t'i dërgohet Sekretarit të Përgjithshëm bashkë me të gjithë informacionin përkatës ku mbështetet kërkesa për rishikim;

(b) Sekretari i Përgjithshëm duhet t'u kalojë kopje të kërkesës për rishikim dhe informacionin përkatës Komisionit, Organizatës Botërore të Shëndetit dhe të gjitha Palëve duke i ftuar ato që të paraqesin komente brenda nëntëdhjetë ditësh. Të gjitha komentet e marra duhet t'i paraqiten për shqyrtim Këshillit;

(c) Këshilli mund të konfirmojë, të ndryshojë ose të kthejë vendimin e Komisionit dhe vendimi i Këshillit duhet të jetë përfundimtar. Njoftimi i vendimit të Këshillit duhet t'u transmetohet të gjitha shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara, shteteve joanëtare Palë në këtë Konventë, Komisionit, Organizatës Botërore të Shëndetit dhe Bordit;

(d) Gjatë kohës që pritet të bëhet rishikimi, duhet të mbetet në fuqi vendimi fillestar i Komisionit.

9.Vendimet e Komisionit, të marra në përputhje me këtë nen nuk duhet t'i nënshtrohen procedurës së rishikimit të parashikuar në nenin 7.

Neni 4
Detyrime të përgjithshme

Palët duhet të marrin masa të tilla legjislative dhe administrative, që mund të jenë të nevojshme :

(a) për t'i dhënë fuqi dhe për zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente brenda territoreve të veta;

(b) për të bashkëpunuar me Shtete të tjera për zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente; dhe

(c) në varësi të dispozitave të kësaj Konvente, të kufizojnë vetëm për qëllime mjekësore dhe shkencore prodhimin, fabrikimin, eksportin, importin, shpërndarjen, tregtimin dhe zotërimin e drogave.

Neni 5
Organet ndërkombëtare të kontrollit

Palët, duke pranuar kompetencën e Kombeve të Bashkuara në lidhje me kontrollin ndërkombëtar të drogave, bien dakord t'i besojnë Komisionit mbi Drogat Narkotike të Këshillit Social-Ekonomik dhe Bordit Ndërkombëtar për Kontrollin e Narkotikëve, funksionet që iu janë besuar përkatësisht atyre në kuadrin e kësaj Konvente.

Neni 6
Shpenzimet e organeve ndërkombëtare të kontrollit

Shpenzimet e Komisionit dhe Bordit do të përballohen nga Kombet e Bashkuara në atë mënyrë që do të vendoset nga Asambleja e Përgjithshme. Palët që nuk janë anëtarë të Kombeve të Bashkuara duhet të derdhin për këto shpenzime sasi të tilla siç do të quhet e drejtë dhe do të vlerësohet herëpashere nga Asambleja e Përgjithshme në konsultim me qeveritë e këtyre Palëve.

Neni 7
Rishikimi i vendimeve dhe rekomandimeve të Komisionit

Me përjashtim të vendimeve që merren në bazë të nenit 3, çdo vendim ose rekomandim që komisioni merr ose bën në pajtim me dispozitat e kësaj Konvente duhet t'i nënshtrohet miratimit ose modifikimit nga Këshilli ose Asambleja e Përgjithshme në të njëjtën mënyrë si edhe vendimet ose rekomandimet e tjera të Komisionit.

Neni 8
Funksionet e Komisionit

Komisioni është i autorizuar të shqyrtojë të gjitha çështjet që lidhen me synimet e kësaj Konvente dhe në mënyrë të veçantë :

(a) të ndryshojë listat, në përputhje me nenin 3;

(b) të tërheqë vëmendjen e Bordit në çdo çështje që mund të lidhet me funksionet e Bordit;

(c) të bëjë rekomandime për zbatimin e synimeve dhe dispozitave të kësaj Konvente, duke përfshirë programet e kërkimeve shkencore dhe shkëmbimit të informacionit të një natyre shkencore ose teknike; dhe

(d) të tërheqë vëmendjen e jopalëve në vendimet dhe rekomandimet që ai merr dhe bën në kuadrin e kësaj Konvente, me qëllim që ato të marrin parasysh ndërmarrjen e veprimit në përputhje me to.

Neni 9
Përbërja dhe funksionet e Bordit

1.Bordi duhet të përbëhet nga trembëdhjetë anëtarë që do të zgjidhen nga Këshilli si më poshtë :

(a) Tre anëtarë me përvojë mjekësore, farmakologjike ose farmaceutike nga lista e të paktën pesë personave të emëruar nga Organizata Botërore e Shëndetit; dhe

(b) Dhjetë anëtarë nga një listë personash të emëruar nga anëtarët e Kombeve të Bashkuara dhe nga Palët që nuk janë anëtarë të Kombeve të Bashkuara.

2. Anëtarët e Bordit duhet të jenë persona të cilët, në sajë të kompetencës, paanshmërisë dhe dizinteresimit të tyre, do të meritojnë besimin e përgjithshëm. Gjatë mandatit të detyrës së tyre ata duhet të mos mbajnë poste ose të mos angazhohen në ndonjë veprimtari që do të kishte prirje të dëmtonte paanshmërinë e tyre në ushtrimin e funksioneve të tyre. Këshilli, në konsultim me Bordin, duhet të bëjë të gjitha parapërgatitjet e nevojshme për të siguruar pavarësi të plotë teknike të Bordit në kryerjen e funksioneve të tij.

3. Këshilli, duke respektuar si duhet parimin e përfaqësimit të barabartë gjeografik, duhet t'i kushtojë vëmendje rëndësisë së përfshirjes në Bord, në përmasa të barabarta, të personave që kanë njohuri për gjendjen e drogës në vendet që prodhojnë, fabrikojnë dhe konsumojnë drogë dhe gjendjen e drogës në lidhje me këto vende.

4. Bordi, në bashkëpunim me qeveritë dhe në vartësi të kushteve të kësaj Konvente, duhet të përpiqet të kufizojë kultivimin, prodhimin, fabrikimin dhe përdorimin e drogave në një masë të mjaftueshme që kërkohet për qëllime mjekësore dhe shkencore, për të siguruar ekzistencën e tyre

për këto qëllime dhe për të parandaluar kultivimin, prodhimin dhe fabrikimin e paligjshëm dhe trafikun dhe përdorimin e paligjshëm të drogave.

5. Të gjitha masat e marra nga Bordi në kuadrin e kësaj Konvente duhet të jenë ato që janë më shumë në përputhje me synimin për një bashkëpunim të mëtejshëm të qeverive me Bordin dhe për sigurimin e mekanizmit për një dialog të vazhdueshëm midis qeverive dhe Bordit që do të japë ndihmë dhe do të lehtësojë veprimin e efektshëm në nivel kombëtar për arritjen e synimeve të kësaj Konvente.

Neni 10

Mandatet e detyrës dhe shpërblimi i anëtarëve të Bordit

1. Anëtarët e Bordit duhet të shërbejnë për një periudhë pesëvjeçare dhe mund të rizgjidhen.

2. Mandati i detyrës për çdo anëtar të Bordit duhet të përfundojë në prag të mbledhjes së parë të Bordit, ku ka të drejtë të marrë pjesë pasardhësi i tij.

3. Një anëtar i Bordit, i cili nuk merr pjesë në tre seksione të njëpasnjëshme, duhet të gjykohet se ka hequr dorë.

4. Këshilli, me rekomandimin e Bordit, mund të pushojë një anëtar të Bordit i cili nuk përmbush më kushtet që parashikohen për anëtarësim në paragrafin 2 të nenit 9. Një rekomandim i tillë duhet të bëhet me votë afirmative nga nëntë anëtarë të Bordit.

5. Kur gjatë mandatit të detyrës së një anëtari krijohet një vend bosh në Bord, Këshilli duhet ta plotësojë këtë vend bosh sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në përputhje me dispozitat e zbatueshme të nenit 9, duke zgjedhur një anëtar tjetër për pjesën e mbetur të mandatit.

6.Anëtarët e Bordit duhet të marrin shpërblim të mjaftueshëm siç përcaktohet nga Asambleja e Përgjithshme.

Neni 11

Rregullat e procedurës së Bordit

1. Bordi duhet të zgjedhë Presidentin e tij dhe zyrtarët e tjerë, si ta gjykojë të nevojshme dhe duhet të miratojë rregullat e veta të procedurës.

2. Bordi duhet të mblidhet sa më shpesh që, sipas mendimit të tij, mund të jetë e nevojshme për kryerjen e duhur të funksioneve të tij, por duhet të mbajë të paktën dy sesione në një vit kalendarik.

3. Numri minimal i nevojshëm në mbledhjet e Bordit duhet të jetë prej tetë anëtarësh.

Neni 12

Administrimi i sistemit të preventivit

1.Bordi duhet të caktojë datën ose datat deri në të cilën/cilat duhet të dorëzohen preventivat e parashikuara në nenin 19, si edhe mënyrën në të cilën ato do të jepen dhe duhet të parashikojë edhe formën e tyre.

2.Bordi, në lidhje me vendet dhe territoret për të cilat nuk zbatohet kjo Konventë, duhet t'u kërkojë qeverive të interesuara të dorëzojnë preventivin në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente.

3.Në qoftë se një shtet nuk arrin të dorëzojë preventivin në lidhje me ndonjërin nga territoret e tij deri në datën e caktuar, Bordi duhet, aq sa mundet, të përcaktojë preventivin. Në përcaktimin e këtij preventivi Bordi, në masën e praktikueshme, duhet ta bëjë këtë në bashkëpunim me qeverinë e interesuar.

4.Bordi duhet të shqyrtojë preventivin, duke përfshirë preventivin suplementar dhe përjashtuar kur është fjala për kërkesa për qëllime specifike, mund ta kërkojë këtë informacion si ta gjykojë të nevojshëm në lidhje me çdo vend apo territor në emër të të cilit është dorëzuar një preventiv, me qëllim që të plotësojë preventivin ose të shpjegojë ndonjë deklaratë të përfshirë aty.

5.Bordi, me qëllim që të kufizojë përdorimin dhe shpërndarjen e drogave në një masë të mjaftueshme të kërkuar për qëllime mjekësore dhe shkencore dhe për të siguruar ekzistencën e tyre për këto qëllime, duhet sa më shpejt që të jetë e mundur të konfirmojë preventivin, duke përfshirë preventivin suplementar ose me pëlqimin e qeverisë së interesuar, mund ta ndryshojë këtë preventiv. Në rast mosmarrëveshjeje midis qeverisë dhe Bordit, ky i fundit duhet të ketë të drejtën të përcaktojë, të komunikojë dhe të publikojë preventivin e vet, duke përfshirë preventivin suplementar.

6.Përveç raporteve të përmendura në nenin 15, Bordi duhet, në kohë të tilla si do t'i përcaktojë ai por të paktën çdo vit, ta botojë këtë informacion për preventivin, meqenëse sipas mendimit të tij, kjo do të ndihmojë në zbatimin e kësaj Konvente.

Neni 13

Administrimi i sistemit të raporteve të statistikave

1.Bordi duhet të përcaktojë mënyrën dhe formën në të cilën do të bëhen raportet statistikore siç parashikohet në nenin 20 dhe duhet të përcaktojë format e tyre.

2.Bordi duhet të shqyrtojë raportet, me qëllim që të përcaktojë nëse një Palë ose ndonjë shtet tjetër i ka zbatuar dispozitat e kësaj Konvente.

3.Bordi mund të kërkojë një informacion të tillë të mëtejshëm si ta gjykojë të nevojshme për të plotësuar ose shpjeguar informacionin që përmbajnë këto raporte statistikore.

4.Nuk duhet të jetë brenda kompetencës së tij që Bordi të bëjë pyetje ose të shprehë mendim mbi informacionin statistikor në lidhje me drogat që kërkohen për qëllime të veçanta.

Neni 14

Masat e Bordit për të siguruar zbatimin e dispozitave të Konventës

1.(a) Në qoftë se, në bazë të shqyrtimit që i bën Bordi informacionit që i paraqitet atij nga qeveritë në kuadrin e dispozitave të kësaj Konvente, ose të informacionit të komunikuar nga organet e Kombeve të Bashkuara ose nga agjenci të specializuara ose, me kusht që ato të miratohen nga komisioni me rekomandimin e Bordit, ose nga organizata të tjera ndërqeveritare ose organizata ndërkombëtare joqeveritare që merren drejtpërsëdrejti me këtë çështje dhe që kanë status Këshillimor në Këshillin Social-Ekonomik në bazë të nenit 71 të Kartës së Kombeve të Bashkuara ose që gëzojnë status të ngjashëm në bazë të një marrëveshjeje të veçantë me Këshillin, Bordi ka arsye objektive për të besuar se synimet e kësaj Konvente po rrezikohen seriozisht për shkak se ndonjë Palë vend apo territor nuk zbaton dispozitat e kësaj Konvente, Bordi duhet të ketë të drejtë t'i propozojë qeverisë së interesuar fillimin e konsultimeve ose t'i kërkojë asaj të japë shpjegime. Në qoftë se, edhe kur nuk është fjala për mungesë të zbatimit të dispozitave të Konventës, një Palë ose në vend apo territor është bërë rrezik serioz ose nëse ka të dhëna se mund të bëhet rrezik serioz, qendër e rëndësishme e kultivimit, prodhimit ose fabrikimit të paligjshëm ose trafikut apo konsumimit të drogave, Bordi ka të drejtë t'i propozojë qeverisë së interesuar fillimin e konsultimeve. Në vartësi të së drejtës së Bordit për të tërhequr vëmendjen e Palëve, Këshillit dhe Komisionit për çështjen të cilës i referohet në nënparagrafin (d) më poshtë, Bordi duhet ta trajtojë si konfidenciale kërkesën për informacion dhe shpjegimin e dhënë nga qeveria ose propozimin për konsultime dhe konsultimet e bëra me qeverinë në bazë të këtij nënparagrafi.

(b) Pasi të ndërmarrë veprim në bazë të nënparagrafit (a) si më sipër, Bordi, nëse mbetet i kënaqur se është e nevojshme të veprojë kështu, mund ta nxisë qeverinë e interesuar të marrë masa të tilla përmirësuese siç mund të duken që në ato kushte të jenë të nevojshme për zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente.

(c) Bordi mund, nëse e mendon një veprim të tillë të nevojshëm me qëllimin e vlerësimit të çështjes, të cilës i referohet në nënparagrafin (a) të këtij paragrafi, t'i propozojë qeverisë së interesuar që të kryhet një studim i kësaj çështjeje në territorin e saj me mjete të tilla që qeveria i gjykon të përshtatshme. Në qoftë se qeveria e interesuar vendos ta ndërmarrë këtë studim, ajo mund t'i kërkojë Bordit të vërë në dispozicion të saj ekspertizën dhe shërbimin e një ose më shumë

personave me kompetencën e duhur që të ndihmojnë zyrtarët e qeverisë në kryerjen e studimit të propozuar. Personi ose personat që Bordi synon t'i vërë në dispozicion duhet të kenë miratimin e qeverisë. Modalitetet e këtij studimi dhe kufiri kohor brenda të cilës duhet përfunduar ky studim duhet të përcaktohen në konsultim midis qeverisë dhe Bordit. Qeveria duhet t'i komunikojë Bordit rezultatet e studimit dhe duhet të përcaktojë masat përmirësuese që ajo mendon se janë të nevojshme të merren.

(d) Në qoftë se Bordi konstaton se qeveria e interesuar nuk ka mundur të japë shpjegime të kënaqshme kur i kërkohet ta bëjë këtë në bazë të nënparagrafit (a) si më sipër, ose nuk ka mundur të marrë ndonjë masë përmirësuese për të cilën ajo ka pasur nxitje për ta marrë në bazë të nënparagrafit (b) si më sipër, ose se ekziston një situatë serioze që kërkon veprim të bashkërenduar në nivel ndërkombëtar me qëllim që ajo të ndreqet, ai mund të tërheqë vëmendjen e Palëve, Këshillit dhe Komisionit për këtë çështje. Bordi duhet të veprojë kështu nëse synimet e kësaj Konvente vihen seriozisht në rrezik dhe nuk ka qënë e mundur që çështja të zgjidhej në mënyrë të kënaqshme në rrugë tjetër. Ai duhet të veprojë kështu nëse konstaton se ekziston një situatë serioze që kërkon veprim bashkërendues në nivel ndërkombëtar, me qëllim që ajo të ndreqet dhe se tërheqja e vëmendjes së Palëve, Këshillit dhe Komisionit për këtë situatë është mënyra më e përshtatshme për të ndihmuar një veprim të tillë bashkërendues; pasi të shqyrtojë raportet e Bordit dhe të Komisionit nëse ka të tilla për këtë çështje, Këshilli mund të tërheqë vëmendjen e Asamblesë së Përgjithshme për këtë çështje.

2.Bordi, kur tërheq vëmendjen e Palëve, Këshillit dhe Komisionit për një çështje në përputhje me paragrafin 1 (d) si më sipër, mund nëse mbetet i kënaqur se një rrugë e tillë është e nevojshme, u rekomandon Palëve që të ndërpresin importin e drogave, eksportin e drogave, ose të dyja, nga vendi ose territori i interesuar ose për në vendin ose territorin e interesuar, qoftë për një periudhë të caktuar kohe ose derisa Bordi të mbetet i kënaqur për gjendjen në atë vend ose territor. Shteti i interesuar mund t'ia parashtrojë këtë çështje Këshillit.

3.Bordi duhet të ketë të drejtë të publikojë një raport për çdo çështje që trajtohet në bazë të dispozitave të këtij neni dhe t'ia komunikojë atë Këshillit që duhet t'ia përcjellë atë të gjitha Palëve. Në qoftë se Bordi boton në këtë raport një vendim të marrë në bazë të këtij neni ose ndonjë informacion që lidhet me të, ai duhet gjithashtu të publikojë atje pikëpamjet e qeverisë së interesuar nëse kjo e fundit e kërkon këtë.

4.Në qoftë se në ndonjë rast një vendim i Bordit që është botuar në bazë të këtij neni nuk është unanim, duhet të paraqiten pikëpamjet e pakicës.

5.Cilido shtet duhet të ftohet të përfaqësohet në një mbledhje të Bordit, në të cilën, në bazë të këtij neni, do të shqyrtohet një çështje që i intereson drejtpërsëdrejti atij.

6.Vendimet e Bordit në bazë të këtij neni duhet të merren me dy të tretat e shumicës së numrit të përgjithshëm të Bordit.

Neni 14 bis

Ndihma teknike dhe financiare

Në rastet kur e konsideron të përshtatshme dhe ose përveç masave të parashikuara në nenin 14, paragrafi 1 dhe 2 ose si alternativë e tyre, Bordi, me miratimin e qeverisë së interesuar, mund t'u rekomandojë organeve kompetente të Kombeve të Bashkuara dhe agjencive të specializuara që qeverisë t'i jepet ndihmë teknike ose financiare, ose të dyja, në mbështetje të përpjekjeve të saj për zbatimin e detyrimeve të saj në kuadrin e kësaj Konvente, duke përfshirë ato që parashikohen ose të cilave iu referohet në nenet 2, 35, 38 dhe 38 bis.

Neni 15

Raportet e Bordit

1.Bordi duhet të përgatisë një raport vjetor për punën e vet dhe raporte të tilla shtesë, si t'i konsiderojë të nevojshme, që të përmbajnë gjithashtu një analizë të preventivave dhe informacionin

statistikor në dispozicion të tij dhe, në rastet e duhura, një përshkrim të shpjegimeve, nëse ka, të dhëna nga qeveritë ose të kërkuara prej tyre, së bashku me çfarëdo vëzhgimi dhe rekomandimi që Bordi dëshiron të bëjë. Këto raporte duhet t'i paraqiten Këshillit nëpërmjet Komisionit, që mund të bëjë komente të tilla si ta shohë të përshtatshme.

2.Raportet duhet t'u komunikohen Palëve dhe më vonë të botohen nga Sekretari i Përgjithshëm. Palët duhet të lejojnë shpërndarjen e tyre të pakufizuar.

Neni 16
Sekretariati

Shërbimet e sekretariatit të Komisionit dhe të Bordit duhet të sigurohen nga Sekretari i Përgjithshëm. Në mënyrë të veçantë, sekretari i Bordit duhet të emërohet nga Sekretari i Përgjithshëm në konsultim me Bordin.

Neni 17
Administratë e veçantë

Palët duhet të mbajnë një administratë të veçantë me qëllimin e zbatimit të dispozitave të kësaj Konvente.

Neni 18
Informacioni që do t'i jepet Sekretarit të Përgjithshëm nga Palët

1.Palët duhet t'i japin Sekrretarit të Përgjithshëm atë informacion që komisioni mund ta kërkojë si të nevojshëm për kryerjen e funksioneve të tij, dhe në mënyrë të veçantë :

(a) Një raport vjetor mbi funksionimin e Konventës brenda secilit nga territoret e tyre;

(b) Tekstin e të gjitha ligjeve dhe rregulloreve që nxirren herëpashere me qëllim që të bëhet e efektshme kjo Konventë;

(c) Hollësi të tilla, siç do t'i përcaktojë Komisioni, në lidhje me rastet e trafikut të paligjshëm, duke përfshirë hollësi të çdo rasti të trafikut të paligjshëm të zbuluar, që mund të jenë të rëndësishme, për shkak të dritës që hidhet mbi burimin, nga i cili përftohen drogat për trafik të paligjshëm, ose për shkak të sasive të përfshira ose metodës së përdorur nga trafikantët e paligjshëm; dhe

(d) Emrat dhe adresat e autoriteteve qeveritare që kanë fuqinë për lëshimin e autorizimeve ose çertifikatave të eksportit dhe importit.

2.Palët duhet ta japin informacionin të cilit i referohet në paragrafin paraprijës në atë mënyrë dhe në ato data dhe të përdorin formularë të tillë siç mund të kërkohet nga komisioni.

Neni 19
Preventivat e kërkesave për drogë

1.Palët duhet t'i japin çdo vit Bordit për secilin nga territoret e tyre, në mënyrën dhe formën e paracaktuar nga Bordi, preventiva në formularët që ai shpërndan në lidhje me çështjet e mëposhtme :

(a) sasitë e drogave që konsumohen për qëllime mjekësore dhe shkencore;

(b) sasitë e drogave që përdoren për fabrikimin e drogave të tjera, të preparateve të parashikuara në Listën III dhe të lëndëve që nuk përmenden në këtë Konventë;

(c) stoqet e drogave që do të mbahen deri më 31 dhjetor të çdo viti me të cilat lidhen preventivat;

(d) sasitë e drogave të nevojshme për t'iu shtuar stoqeve të veçanta;

(e) zonën (në hektarë) dhe vendndodhjen gjeografike të tokës që do të përdoret për kultivimin e hashashit;

(f) sasinë e përafërt të opiumit që do të prodhohet;

(g) numrin e lokaleve industriale që do të fabrikojnë droga sintetike;

(h) sasitë e drogave sintetike që do të fabrikohen nga secili prej këtyre lokaleve të cilave iu referohet në nënparagrafin e mësipërm.

2.(a) Në vartësi të përfundimeve të cilave iu referohet në paragrafin 3 të nenit 21, shuma totale e preventivave të çdo territori dhe çdo drogë përveç opiumit dhe drogave sintetike duhet të përbëjë shumën e sasive të specifikuara në nënparagrafet (a), (b) dhe (d) të paragrafit 1 të këtij neni, duke shtuar çdo sasi që kërkohet për t'i sjellë stoqet aktuale ekzistuese më 30 dhjetor të vitit pararendës në nivelet e preventivit siç parashikohet në nënparagrafin (c) të paragrafit 1.

(b) Në varësi të përfundimeve, të cilave iu referohet në paragrafin 3 të nenit 21, në lidhje me importet dhe në paragrafin 2 të nenit 21 bis, shuma totale e preventivave të opiumit për çdo territor duhet të përbëhet ose nga shuma e sasive të specifikuara në nënparagrafet (a), (b) dhe (d) të paragrafit 1 të këtij neni, duke shtuar çdo sasi që kërkohet për t'i sjellë stoqet aktuale ekzistuese më 31 dhjetor të vitit paraardhës në nivelet e preventivit siç parashikohet në nënparagrafin (c) të paragrafit 1, ose nga sasia e specifikuar në nënparagrafin (f) të paragrafit 1 të këtij neni, kushdo që të jetë më e lartë.

(c) Në varësi të përfundimeve, të cilave iu referohet në paragrafin 3 të nenit 21, shuma totale e preventivave të çdo territori për çdo drogë sintetike duhet të përbëhet ose nga shuma e sasive të specifikuara në nënparagrafet (a),(b) dhe (d) të paragrafit 1 të këtij neni, duke shtuar çdo sasi që kërkohet për t'i sjellë stoqet aktuale ekzistuese më 31 dhjetor të vitit pararendës në nivelin e preventivit siç parashikohet në nënparagrafin (c) të paragrafit 1, ose nga shuma e sasive të specifikuara në nënparagrafin (h) të paragrafit 1 të këtij neni, cilado që të jetë më e lartë.

(d) Preventivat e dhëna në bazë të nënparagrafeve të mësipërm të këtij paragrafi duhet të modifikohen ashtu siç duhet për të marrë parasysh çdo sasi të kapur dhe më pas të hedhur për përdorim të ligjshëm, si edhe çdo sasi të marrë nga stoqet e veçanta për kërkesat e popullsisë civile.

3.Çdo shtet gjatë vitit mund të japë preventiva suplementare duke shpjeguar rrethanat që i bënë të nevojshme këto preventiva.

4.Palët duhet të informojnë Bordin mbi metodën e përdorur për përcaktimin e sasive që jepen në preventiva dhe për çdo ndryshim të metodës në fjalë.

5.Në varësi të përfundimeve, të cilave iu referohet në paragrafin 3 të nenit 21 dhe sasisë që merret kur është e përshtatshme për dispozitat e nenit 21 bis, preventivat nuk duhet të kalohen.

Neni 20

Raportet statistikore që duhet t'i jepen Bordit

1.Palët duhet t'i japin Bordit, për secilin nga territoret e tyre, në mënyrën dhe formën e paracaktuar nga Bordi, raporte statistikore për formularët që ai ka shpërndarë në lidhje me çështjet e mëposhtme:

(a) prodhimin ose fabrikimin e drogave;

(b) përdorimin e drogave për fabrikimin e drogave të tjera, të preparateve në Listën III dhe të lëndëve që nuk përmenden nga kjo Konventë dhe përdorimin e kashtës së lulekuqes për fabrikimin e drogave;

(c) konsumimin e drogave;

(d) importet dhe eksportet e drogave dhe kashtës së lulekuqes;

(e) kapjet e drogave dhe asgjësimin e tyre;

(f) stoqet e drogës qysh prej 31 dhjetorit të vitit për të cilin bëjnë fjalë raportet ;

(g) zonën e verifikueshme të kultivimit të hashashit.

2.(a) Raportet statistikore, në lidhje me çështjet të cilave iu referohet në paragrafin 1, përveç nënparagrafit (d), duhet të përgatiten çdo vit dhe duhet t'i dërgohen Bordit jo më vonë se 30 qershori i vitit pasardhës për të cilin ato bëjnë fjalë.

(b) Raporte statistikore, në lidhje me çështjet të cilave iu referohet në nënparagrafin (d) të paragrafit 1, duhet të përgatiten çdo tre muaj dhe duhet t'i dërgohen Bordit brenda muajit pas

përfundimit të tre muajve për të cilat bëhet fjalë.

3. Nga Palët nuk kërkohet që të japin raporte statistikore, në lidhje me stoqet e veçanta, por ato duhet të japin veçmas raporte në lidhje me drogat e importuara ose të siguruara brenda vendit ose territorit për qëllime të veçanta, si edhe sasitë e drogave të tërhequra nga stoqet e veçanta për të plotësuar kërkesat e popullsisë civile.

Neni 21

Kufizimi i fabrikimit dhe importit

1. Shuma e përgjithshme e sasive të çdo droge, të fabrikuar dhe importuar nga një vend apo territor në një vit, nuk duhet ta kalojë shumën si më poshtë:

a) sasinë e konsumuar, brenda kufirit të preventivit përkatës, për qëllime mjekësore dhe shkencore;

b) sasinë e përdorur, brenda kufirit të preventivit përkatës, për fabrikimin e drogave të tjera, të preparateve të Listës III dhe të lëndëve që nuk përmenden nga kjo Konventë;

c) sasinë e eksportuar;

d) sasinë që i shtohet stokut për ta sjellë atë stok në nivelin e specifikuar në preventivin përkatës;

e) sasinë e siguruar brenda kufirit të preventivit përkatës për qëllime të veçanta.

2. Nga shuma e sasive të specifikuara në paragrafin 1 duhet të zbritet çfarëdo sasie që është kapur dhe është dhënë në përdorim të ligjshëm, si edhe çfarëdo sasie e marrë nga stoqet e veçanta për kërkesat e popullsisë civile.

3. Në qoftë se Bordi konstaton se sasia e fabrikuar dhe e importuar në cilindo vit e kalon shumën e sasive të specifikuara në paragrafin 1, duke bërë çfarëdo zbritje që kërkohet në bazë të paragrafit 2 të këtij neni, çdo tepri e përcaktuar si e tillë dhe që mbetet në fund të vitit duhet, në vitin pasardhës, të zbritet nga sasia që do të fabrikohet ose importohet dhe nga shuma e përgjithshme e preventivit, siç parashikohet në paragrafin 2 të nenit 19.

4. a) Në qoftë se, nga raportet statistikore mbi importet ose eksportet (neni 20), del se sasia e eksportuar në një vend apo territor e kalon shumën e përgjithshme të preventivit për atë vend apo territor, siç parashikohet në paragrafin 2 të nenit 19, duke shtuar shumat që tregohet se janë eksportuar dhe pasi është bërë zbritja e çdo teprie siç parashikohet në paragrafin 3 të këtij neni, Bordi mund t'ua njoftojë këtë fakt Shteteve që, sipas mendimit të Bordit, duhet të informohen;

b) Me marrjen e këtij njoftimi, Palët nuk duhet që gjatë vitit në fjalë, të autorizojnë eksporte të mëtejshme të drogës në lidhje me atë vend apo territor, përveç se:

i) në rastin kur jepet preventiv suplementar për atë vend apo territor në lidhje me çdo sasi mbi importin dhe me sasinë shtojcë që kërkohet, ose

ii) në raste të jashtëzakonshme kur eksporti, sipas mendimit të Qeverisë së vendit eksportues, është thelbësor për trajtimin e të sëmurëve.

Neni 21 bis

Kufizimi i prodhimit të opiumit

1. Prodhimi i opiumit nga një vend apo territor duhet të organizohet dhe të kontrollohet në mënyrë të tillë, që të sigurojë që, aq sa është e mundur, sasia e prodhuar në një vit të mos e kalojë preventivin e opiumit, që do të prodhohet siç parashikohet në paragrafin 1 (f) të nenit 19.

2. Në qoftë se Bordi konstaton, në bazë të informacionit që ka në dispozicion në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente së një Pale që ka paraqitur preventivin në bazë të paragrafit 1 (f) të nenit 19 nuk e ka kufizuar opiumin e prodhuar brenda kufijve të tij për qëllime të ligjshme në përputhje me preventivat përkatës dhe se një sasi e rëndësishme e opiumit të prodhuar, qoftë në mënyrë të ligjshme apo të paligjshme, brenda kufijve të kësaj Pale, është përdorur në trafikun e paligjshëm, ai mund, pasi të studiojë shpjegimet e Palës së interesuar, që do t'i paraqiten atij brenda një muaji pas njoftimit për konstatimin në fjalë, të vendosë ta zbresë të gjithë këtë sasi ose një pjesë

e saj nga sasia që do të përdoret dhe nga shuma e përgjithshme e preventivave siç parashikohet në paragrafin 2 (b) të nenit 19 për vitin e ardhshëm në të cilin kjo zbritje teknikisht mund të bëhet, duke marrë parasysh stinën e vitit dhe angazhimet kontraktuale për eksportimin e opiumit. Ky vendim do të hyjë në fuqi nëntëdhjetë ditë pasi Pala e interesuar ka marrë njofitm për këtë.

3. Pasi ka njoftuar Palën e interesuar për vendimin që ka marrë, në bazë të paragrafit 2 si më sipër në lidhje me një zbritje, Bordi duhet të konsultohet me atë Palë, me qëllim që ta zgjidhë situatën në mënyrë të kënaqshme.

4. Në qoftë se situata nuk zgjidhet në mënyrë të kënaqshme, Bordi mund të përdorë dispozitat e nenit 14, atje ku e sheh të përshtatshme.

5. Në marrjen e vendimit të vet, në lidhje me një zbritje në bazë të paragrafit 2 si më sipër, Bordi do të marrë parasysh jo vetëm të gjitha rrethanat përkatëse, duke përfshirë ato që çuan në ngritjen e problemit të trafikut të paligjshëm të cilit i referohet në paragrafin 2 si më sipër, por edhe çdo masë të re përkatëse kontrolli që mund të jetë marrë nga Pala.

Neni 22

Dispozitë e veçantë e zbatueshme për kultivimin

1. Kurdoherë që kushtet mbizëtoruese në vendin apo territorin e një Pale e bëjnë ndalimin e kultivimit të hashashit, shkurrës së kokainës apo bimës kanabis masën më të përshtatshme, sipas mendimit të saj, për mbrojtjen e shëndetit dhe mirëqënies publike dhe për parandalimin e ndërrimit të drejtimit të drogave dhe kalimit të tyre në trafik të paligjshëm, Pala e interesuar duhet ta ndalojë kultivimin.

2. Një Palë që ndalon kultivimin e hashashit apo bimës kanabis duhet të marrë masat e përshtatshme për të kapur të gjitha bimët që kultivohen në mënyrë të paligjshme dhe t'i asgjësojë ato, përveç se kur kemi të bëjmë me sasi të vogla që kërkohen nga Pala për qëllime shkencore apo kërkimore.

Neni 23

Agjencitë kombëtare të opiumit

1. Një Palë që lejon kultivimin e hashashit për prodhimin e opiumit duhet të krijojë, nëse nuk e ka bërë akoma këtë gjë, dhe të mbajë një ose më shumë agjenci qeveritare (që më poshtë në këtë nen do të quhet Agjencia) me qëllim që të kryejë funksionet e kërkuara në bazë të këtij neni.

2. Çdo Palë e tillë duhet të zbatojë dispozitat e mëposhtme në lidhje me kultivimin e hashashit për prodhimin e opiumit dhe në lidhje me opiumin:

a) Agjencia do të përcaktojë zonat dhe parcelat e tokës në të cilat duhet të lejohet kultivimi i hashashit për qëllimin e prodhimit të opiumit.

b) Vetëm kultivatorët e licencuar nga Agjencia duhet të autorizohen të merren me këtë kultivim.

c) Çdo licencë duhet të specifikojë sasinë e tokës në të cilën lejohet kultivimi.

d) Duhet të kërkohet që të gjithë kultivatorët e hashashit ta dorëzojnë të gjithë prodhimin e opiumit në Agjenci. Agjencia duhet ta blejë dhe ta marrë në zotërim fizik këtë prodhim sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se katër muaj pas përfundimit të të korrave.

e) Agjencia duhet, në lidhje me opiumin, të ketë të drejtë ekskluzive për importimin, eksportimin, shitjen me shumicë dhe mbajtjen e stoqeve përveç atyre që mbahen nga fabrikuesit e alkaloideve të opiumit, të opiumit medicinal apo të preparateve të opiumit.

3. Funksionet qeveritare të cilave iu referohet në paragrafin 2 duhet të kryhen nga një agjenci e vetme qeveritare nëse kushtetuta e Palës së interesuar e lejon këtë.

Neni 24

Kufizimi i prodhimit të opiumit për tregti ndërkombëtare

1.(a) Në qoftë se një Palë synon të nisë prodhimin e opiumit ose të rrisë prodhimin ekzistues, ajo duhet të mbajë parasysh nevojën që mbizotëron në botë për opiumin në përputhje me preventivat për këtë të botuara nga Bordi me qëllim që prodhimi i opiumit nga kjo Palë të mos rezultojë në mbiprodhimin e opiumit në botë.

(b) Një Palë nuk duhet të lejojë prodhimin e opiumit ose rritjen e prodhimit ekzistues të tij nëse, sipas mendimit të saj ky prodhim ose rritje e prodhimit në territorin e saj mund të çonte në trafik të paligjshëm të opiumit.

2. (a) Në bazë të paragrafit 1, ku një Palë, e cila duke filluar nga 1 janari 1961 nuk ka prodhuar opium për eksport, dëshiron të eksportojë opiumin që prodhon, në sasira që nuk i kalojnë të pesë tonet në vit, ajo duhet të njoftojë Bordin, duke e shoqëruar njoftimin me këtë informacion në lidhje me:

i) kontrollet në fuqi siç e kërkon kjo Konventë në lidhje me opiumin që do të prodhohet dhe eksportohet;

ii) emrin e vendit apo të vendeve ku ajo mendon ta eksportojë këtë opium; Bordi mund ose do ta miratojë këtë njoftim ose mund t'i rekomandojë Palës që të mos angazhohet në prodhimin e opiumit për eksport.

b) Kur një Palë përveç Palës, së cilës i referohet në paragrafin 3, dëshiron të prodhojë opium për eksport në sasira, që i kalojnë të pesë tonet në vit, ajo duhet të njoftojë Këshillin, duke dhënë bashkë me këtë njoftim informaiconin përkatës në lidhje me:

i) preventivin e sasive që do të prodhohen për eksport;

ii) kontrollet që ekzistojnë ose propozohen në lidhje me opiumin që do të prodhohet;

iii) emrin e vendit apo vendeve ku ajo mendon ta eksportojë këtë opium; dhe Këshilli ose do ta miratojë njoftimin ose mund t'i rekomandojë Palës që të mos angazhohet në prodhimin e opiumit për eksport.

3. Pavarësisht nga dispozitat e nënparagrafeve (a) dhe (b) të paragrafit 2, një Palë që gjatë dhjetë viteve para 1 janarit 1961 ka eksportuar opium që ky vend prodhonte, mund të vazhdojë ta eksportojë opiumin që ajo prodhon.

4.a) Një Palë nuk duhet të importojë opium nga ndonjë vend apo territor, përveç opiumit të prodhuar në territorin e:

i) një Pale të cilës i referohet në paragrafin 3;

ii) një Pale që ka njoftuar Bordin siç parashikohet në nënparagrafin (a) të paragrafit 2;

iii) një Pale që ka marrë miratimin e Këshillit siç parashikohet në nënparagrafin (b) të paragrafit 2.

b) Pavarësisht nga nënparagrafi (a) i këtij paragrafi, një Palë mund të importojë opiumin e prodhuar nga një vend ,që ka prodhuar dhe eksportuar opium gjatë dhjetë viteve përpara 1 Janarit 1961 në qoftë se ky vend ka krijuar dhe mban një organ ose agjenci kombëtare të kontrollit për qëllimet e parashtruara në nenin 23 dhe ka në fuqi mjete efektive për të siguruar që opiumi që ai prodhon të mos devijojë në trafik të paligjshëm.

5. Dispozitat e këtij nenin nuk e ndalojnë një Palë:

që të prodhojë opium të mjaftueshëm për kërkesat e veta;

që t'ia eksportojë opiumin e kapur nga trafiku i paligjshëm një Pale tjetër në përputhje me kërkesat e kësaj Konvente.

Neni 25

Kontrolli i kashtës së lulëkuqes

1. Një Palë që lejon kultivimin e hashashit për qëllime të tjera, që nuk janë prodhimi i opiumit duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar:

a) që opiumi të mos prodhohet nga një hashash i tillë;

b) që në fabrikimin e drogave nga kashta e lulëkuqes të ketë kontroll të mjaftueshëm.

2. Palët duhet të zbatojnë për kashtën e lulëkuqes sistemin e çertifikatave të importit dhe autorizimet e eksportit siç parashikohet në nenin 31, paragrafet 4 deri 15.

3. Palët duhet të japin informacion statistikor për importin dhe eksportin e kashtës së lulëkuqes siç kërkohet për drogat në bazë të nenit 20, paragrafi 1 (d) dhe 2 (b).

Neni 26

Shkurrja e kokainës dhe gjethet e kokainës

1. Në qoftë se një Palë lejon kultivimin e shkurres së kokainës, ajo duhet të zbatojë për këtë dhe gjethet e kokainës sistemin e kontrolleve siç parashikohet në nenin 23, në lidhje me kontrollin e hashashit; por përsa i përket paragrafit 2 (d) të atij neni, kërkesat e vëna nga Agjencia të cilave iu referohet aty duhet të jenë vetëm për të marrë në zotërim fizik prodhimin sa më shpejt që të jetë e mundur pas përfundimit të të korrave.

2. Palët duhet, sa më shumë që të jetë e mundur, të bëjnë të detyrueshme zhdukjen e të gjitha shkurreve të kokainës që rriten të egra.

Neni 27

Dispozita shtojcë në lidhje me gjethet e kokainës

1. Palët mund të lejojnë përdorimin e gjetheve të kokainës për përgatitjen e një agjenti aromatik, që nuk duhet të përmbajë alkaloide, dhe, në masën e nevojshme për një përdorim të tillë, mund të lejojnë prodhimin, importin, eksportin, tregtimin dhe zotërimin e këtyre gjetheve.

2. Palët duhet të japin veçmas preventiva (neni 19) dhe informacionin statistikor (neni 20) në lidhje me gjethet e kokainës për përgatitjen e agjentit aromatik, përveç se në atë masë kur po të njëjtat gjethe kokaine përdoren për përfitimin e alkaloideve dhe agjentit aromatik, dhe që është shpjeguar kështu në preventivat dhe informacionin statistikor.

Neni 28

Kontrolli i kanabis

1. Në qoftë se një Palë lejon kultivimin e bimës kanabis për prodhimin e kanabis ose rrëshirës kanabis, ajo duhet të zbatojë për sistemin e kontrolleve siç parashikohet në nenin 23 në lidhje me kontrollin e hashashit.

2. Kjo Konventë nuk duhet të zbatohet për kultivimin e bimës kanabis vetëm për qëllime industriale (fibër dhe farë) apo qëllime kopshtarie.

3. Palët duhet të marrin masa të tilla, siç mund t'i shohin të nevojshme për të parandaluar keqpërdorimin dhe trafikun e paligjshëm të gjetheve të bimës kanabis.

Neni 29

Fabrikimi

1. Palët duhet të kërkojnë që fabrikimi i drogave të bëhet me licencë përveç se kur një fabrikim i tillë bëhet nga një ndërmarrje ose ndërmarrje shtetërore.

2. Palët duhet:

a) të kontrollojnë të gjithë personat dhe ndërmarrjet që vazhdojnë ose merren me fabrikimin e drogave;

b) të kontrollojnë në bazë të licencës lokalet dhe selitë ku bëhet ky fabrikim;

c) të kërkojnë që fabrikantët e licencuar të drogave të marrin leje periodike, ku të specifikohen llojet dhe sasitë e drogave që ata kanë të drejtë të fabrikojnë. Sidoqoftë nuk është nevoja të kërkohet leje periodike për preparatet.

3. Palët duhet të parandalojnë grumbullimin, në zotërim të fabrikantëve të drogave, të sasive

të drogave dhe të kashtës së lulëkuqes mbi sasitë e kërkuara për kryerjen normale të biznesit, duke mbajtur parasysh kushtet mbizotëruese të tregut.

Neni 30

Tregtia dhe shpërndarja

1. a) Palët duhet të kërkojnë që tregtia dhe shpërndarja e drogave të jetë e licencuar përveç se kur kjo tregti ose shpërndarje bëhet nga një ndërmarrje ose ndërmarrje Shtetërore.

b) Palët duhet:

i) të kontrollojnë të gjithë personat dhe ndërmarrjet që vazhdojnë ose merren me tregti ose shpërndarje të drogave;

ii) Të kontrollojnë në bazë të licencës lokalet dhe selitë ku bëhet kjo tregti ose shpërndarje. Kërkesa për liçensë nuk është nevoja të zbatohet për preparatet.

c) Dispozitat e nënparagrafit (a) dhe (b) në lidhje me licencimin nuk është nevoja të zbatohen për persona që janë autorizuar posaçërisht për kryerjen dhe gjatë kryerjes së funksioneve terapeutike ose shkencore.

2. Palët duhet gjithashtu:

a) të parandalojnë grumbullimin në zotërim të tregtarëve, shpërndarësve, ndërmarrjeve shtetërore ose personave posaçërisht të autorizuar, të cilëve iu referohet më sipër, të sasive të drogave dhe kashtës së lulëkuqes mbi sasitë e kërkuara për kryerjen normale të biznesit, duke mbajtur parasysh kushtet mbizotëruese të tregut; dhe

b) (i) Të kërkojnë receta mjekësore për furnizimin ose shpërndarjen e drogave për individë. Kjo kërkesë nuk është nevoja të zbatohet për ato droga që individët mund t'i marrin, t'i përdorin, t'i shpërndajnë ose t'i administrojnë në mënyrë të ligjshme, në lidhje me funksionet terapeutike për të cilat ata janë posaçërisht të autorizuar;

(ii) Në qoftë se Palët i gjykojnë këto masa të nevojshme apo të dëshirueshme, të kërkojnë që recetat për drogat e Listës I të shkruhen në formularë zyrtarë që autoritetet kompetente qeveritare ose shoqatat e autorizuara profesionale do t'i nxjerrin në formë blloqesh me kupona.

3. Është e parapëlqyeshme që Palët të kërkojnë, që ofertat me shkrim ose të shtypura për droga, njoftimet e çdo lloji apo literatura përshkruese që lidhen me drogat dhe përdoren për qëllime komerciale, mbështjelljet brenda pakove që përmbajnë droga dhe etikat me të cilat ofrohen droga për shitje, të shënojnë emrin ndërkombëtar jo të pronarit të komunikuar nga Organizata Botërore e Shëndetit.

4. Në qoftë se një Palë e konsideron një masë të tillë të nevojshme ose të parapëlqyeshme, ajo duhet të kërkojë që pakoja e brendshme, që përmban drogë ose mbështjellsja e saj të mbajë një shirit të kuq dysh të dukshëm qartë. Mbështjellsja e jashtme e pakos në të cilën mbahet kjo drogë, nuk duhet të ketë shirit të kuq dyfish.

5. Një Palë duhet të kërkojë që etiketa me të cilën ofrohet një drogë për shitje, të tregojë përmbajtjen e saktë të drogës me peshë ose përqindje. Kjo kërkesë për informacionin e etiktës nuk është nevoja të zbatohet për një drogë që shpërndahet në bazë të një recetë individuale ose mjekësore.

6. Dispozitat e paragrafit 2 dhe 5 nuk është nevoja të zbatohen për tregti me pakicë ose shpërndarje me pakicë të drogave të Listës II.

Neni 31

Dispozita të veçanta në lidhje me tregtinë ndërkombëtare

1. Palët nuk duhet të lejojnë me vetëdije eksportin e drogave në ndonjë vend apo territor përveç se:

a) në përputhje me ligjet e rregulloret e atij vendi apo territori;

b) Brenda kufijve të shumës së përgjithshme të preventivave për atë vend apo territor, siç parashikohet në paragrafin 2 të nenit 19, duke shtuar sasitë që synohen të eksportohen sërish.

2. Palët duhet të ushtrojnë në portet dhe zonat e lira të njëjtën mbikqyrje dhe kontroll si edhe në pjesë të tjera të territoreve të tyre, me kusht, sidoqoftë që ato të mund të zbatojnë masa më drastike.

3. Palët duhet:

a) të kontrollojnë në bazë të liçensës importin dhe eksportin e drogave përveç se kur ky import ose eksport kryhet nga një ndërmarrje ose ndërmarrje shtetërore;

b) të kontrollojnë të gjithë personat dhe ndërmarrjet që vazhdojnë ose merren me këtë import ose eksport.

4. a) Cilado Palë që lejon importin ose eksportin e drogave duhet të kërkojë një autorizim të veçantë për importin ose eksportin që duhet siguruar për çdo import ose eksport të tillë pavarësisht nëse ato përbëhen nga një ose më shumë droga.

b) Një autorizim i tillë duhet të thotë emrin e drogës, emrin ndërkombëtar jo të pronarit nëse ka, sasinë që do të importohet ose eksportohet dhe emrin dhe adresën e importuesit dhe eksportuesit dhe duhet të specifikojë periudhën brenda të cilës duhet të kryhet importimi ose eksportimi.

c) Autorizimi i eksportit duhet gjithashtu të thotë numrin dhe datën e çertifikatës së importit (paragrafi 5) dhe autoritetin që e ka lëshuar atë.

d) Autorizimi i importit mund të lejojë importimin në më shumë se një ngarkesë.

5. Përpara lëshimit të autorizimit të eksportit, Palët duhet të kërkojnë një çertifikatë importi të lëshuar nga autoritetet kompetente të vendit apo të territorit importues dhe të vërtetojë se importimi i drogës ose drogave, të cilave iu referohet atje është miratuar dhe një çertifikatë e tillë duhet të lëshohet nga personi apo institucioni, që e kërkon autorizimin e eksportit. Palët duhet ta ndjekin sa më besnikërisht sa ç'mund të jetë e praktikueshme formularin e çertifikatës së importit të miratuar nga Komisioni.

6. Një kopje e autorizimit të eksportit duhet të shoqërojë çdo ngarkesë dhe Qeveria që lëshon autorizimin e eksportit duhet t'i dërgojë një kopje Qeverisë së vendit apo territorit importues.

7. a) Qeveria e vendit apo territorit importues, kur importimi është kryer ose kur afati i caktuar për importimin ka kaluar, duhet t'ia kthejë autorizimin e eksportit, bashkë me vërtetimin për këtë qëllim, Qeverisë së vendit apo territorit eksportues.

b) Vërtetimi duhet të specifikojë sasinë aktualisht të importuar.

c) Në qoftë se aktualisht është eksportuar një sasi më e vogël se sa ajo që specifikohet në autorizimin e eksportit, në autorizimin e eksportit dhe në çdo kopje zyrtare të tij autoritetet kompetente duhet të shënojnë sasinë aktualisht të eksportuar.

8. Eksportet e ngarkesave në kutinë postare ose në bankë në llogarinë e një Pale që nuk është Pala e shënuar në autorizimin e eksportit, duhet të jenë të ndaluara.

9. Eksportet e ngarkesave në një magazinë doganore janë të ndaluara në qoftë se Qeveria e vendit importues nuk e vërteton në çertifikatën e importit të lëshuar nga personi ose institucioni që kërkon autorizimin e eksportit se ajo e ka miratuar importimin me qëllim që të vendoset në një magazinë doganore. Në një rast të tillë autorizimi i eksportit duhet të specifikojë se ngarkesa është eksportuar për një qëllim të tillë. Çdo tërheqje nga magazina doganore duhet të kërkojë një leje nga autoritetet që kanë juridiksionin mbi këtë magazinë dhe, në rast se është fjala për një destinacion të huaj, duhet të trajtohet sikur të ishte një eksport i ri brenda kuptimit të kësaj Konvente.

10. Ngarkesat e drogave që hyjnë ose dalin nga territori i një Pale të pashoqëruara me autorizim eksporti duhet të pengohen nga autoritetet kompetente.

11. Një Palë nuk duhet të lejojë që ndonjë drogë që i dërgohet një vendi tjetër të kalojë nëpër territorin e saj, pavarsisht nëse ngarkesa është lëvizur apo jo nga mjeti i transportit me të cilin ajo transportohet, në qoftë se autoritetet kompetente të kësaj Pale nuk lëshojnë një kopje të autorizimit të eksportit për këtë ngarkesë.

12. Autoritetet kompetente të një vendi apo territori nëpër të cilin një ngarkesë drogash është lejuar të kalojë duhet të marrë të gjitha masat e duhura për të parandaluar ndërrimin e drejtimit të ngarkesës drejt destinacionit që nuk është ai që shënohet në kopjen shoqëruese të autorizimit të eksportit në qoftë se Qeveria e atij vendi apo territori nëpër të cilin ngarkesa kalon nuk e autorizon këtë ndërrim të drejtimit. Qeveria e vendit apo territorit të tranzitit duhet të trajtojë çdo ndërrim të

kërkuar të drejtimit sikur kjo shmangie të ishte një eksport nga vendi apo territori i tranzitit për në vendin apo territorin e destinacionit të ri. Në qoftë se ndërrimi i drejtimit autorizohet, dispozitat e paragrafit 7 (a) dhe (b) duhet të zbatohen gjithashtu midis vendit apo territorit të tranzitit dhe vendit apo territorit që ka eksportuar fillimisht ngarkesën.

13. Asnjë ngarkesë droge ndërsa është në tranzit apo ndërsa është magazinuar në magazinën doganore nuk mund t'i nënshtrohet ndonjë procesi që do të ndërronte natyrën e drogave në fjalë. Paketimi mund të mos ndryshohet pa lejen e autoriteteve kompetente.

14. Dispozitat e paragrafeve 11 deri 13 në lidhje me kalimin e drogave nëpër territorin e një Pale nuk zbatohen kur ngarkesa në fjalë transportohet me avion që nuk ulet në vendin apo territorin e tranzitit. Në qoftë se avioni ulet në ndonjë vend apo territor të tillë, ato dispozita duhet të zbatohen për sa e kërkojnë rrethanat.

15. Dispozitat e këtij neni nuk marrin parasysh dispozitat e ndonjë marrëveshjeje ndërkombëtare që kufizojnë kontrollin që mund të ushtrohet nga ndonjëra prej Palëve mbi drogat në tranzit.

16. Asgjë tjetër në këtë nen përveç paragrafeve 1 (a) dhe 2 nuk është nevoja të zbatohet në rastin e preparateve të Listës III.

Neni 32

Dispozita të veçanta në lidhje me transportin e drogave në kutitë e ndihmës së shpejtë të anijeve ose avioneve të angazhuar në trafikun ndërkombëtar

1.Transporti ndërkombëtar me anije ose avion i sasive të tilla të kufizuara të drogave siç mund të nevojiten gjatë udhëtimit ose lundrimit të tyre për qëllime të ndihmës së parë ose raste urgjente nuk duhet të konsiderohet që të jetë import, eksport ose kalim nëpër një vend brenda kuptimit të kësaj Konvente.

2. Masa të përshtatshme sigurimi duhet të merren nga vendi i regjistrimit për të parandaluar përdorimin e papërshtatshëm të drogave, të cilave iu referohet në paragrafin 1 ose shmangien e tyre për qëllime të paligjshme Komisioni, në konsultim me organizatat e duhura ndërkombëtare, duhet t'i rekomandojë këto masa sigurimi.

3. Drogat e transportuara me anije ose avion në përputhje me paragrafin 1 duhet t'i nënshtrohen ligjeve, rregullave, lejeve dhe liçensave të vendit të regjistrimit, pa marrë parasysh të drejtat e autoriteteve kompetente lokale për të kryer kontrolle, inspektime dhe për të marrë masa të tjera kontrolli në bordin e anijeve ose të avionit. Administrimi i këtyre drogave në rast urgjence nuk duhet të konsiderohet shkelje e kërkesave të nenit 30, paragrafi 2 (b).

Neni 33

Zotërimi i drogave

Palët nuk duhet të lejojnë zotërimin e drogave, përveç se në bazë të autoritetit ligjor.

Neni 34

Masat e mbikqyrjes dhe të inspektimit

Palët duhet të kërkojnë:

a) që të gjithë personat të marrin licencë siç parashikohet në përputhje me këtë Konventë ose ata që kanë pozita drejtuese ose mbikëqyrëse në një ndërmarrje shtetërore, të përcaktuar në përputhje me këtë Konventë duhet të kenë kualifikimet e mjaftueshme për zbatimin e efektshëm dhe besnik të dispozitave të këtyre ligjeve dhe rregulloreve siç janë dekretuar në zbatim të tyre;

b) që autoritetet qeveritare, fabrikuesit, tregtarët, shkencëtarët, institucionet shkencore dhe spitalet të mbajnë dokumentacionin që të tregojë sasitë e çdo droge të fabrikuar dhe çdo marrje dhe shpërndarje individuale të drogave. Ky dokumentacion duhet të ruhet, respektivisht për një peirudhë kohore jo më të vogël se dy vjet. Atje ku përdoren blloqe me kupona (neni 30, paragrafi 2 (b) të

recetave zyrtare, këto blloqe bashkë me kuponat duhet gjithashtu të ruhen për një periudhë kohore jo më të vogël se dy vjet.

Neni 35
Veprimi kundër trafikut të paligjshëm

Duke pasur konsideratën e duhur për sistemet e tyre kushtetuese, ligjore dhe administrative, Palët duhet:

a) Të bëjnë parapërgatitje në nivel kombëtar për bashkërendimin e veprimit parandalues dhe shtypës kundër trafikut të paligjshëm; për këtë qëllim ato mund sipas nevojës të caktojnë një agjenci të përshtatshme përgjegjëse për këtë bashkëveprim;

b) Të ndihmojnë njëra-tjetrën në fushatën kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike;

c) Të bashkëpunojnë ngushtësisht me njëra-tjetrën dhe me organizatat kompetente ndërkombëtare ku ato janë anëtare me qëllim që të zhvillojnë një fushatë të koordinuar kundër trafikut të paligjshëm;

d) Të sigurojnë që bashkëveprimi ndërkombëtar midis agjencive përkatëse të kryhet në mënyrë të menjëhershme;

e) Të sigurojnë që atje ku dokumentet ligjore transmetohen në nivel ndërkombëtar me qëllimin e ndjekjes penale, transmetimi të bëhet në mënyrë të menjëhershme për tek organizat e caktuara nga Palët, kjo kërkesë nuk duhet të marrë parasysh të drejtën e një Pale për të kërkuar që dokumentet ligjore t'i dërgohen asaj përmes kanaleve diplomatike;

f) T'u dërgojnë, nëse e gjykojnë të përshtatshme, Bordit dhe Komisionit përmes Sekretarit të Përgjithshëm, përveç informacionit që kërkohen nga neni 18, informacion që lidhet me veprimtarinë e paligjshme me drogat brenda kufijve të tye, duke përfshirë informacionin mbi kultivimin, prodhimin, fabrikimin dhe përdorimin e paligjshëm të drogave dhe trafikun e paligjshëm me drogat; dhe

g) Të japin informacionin, të cilit i referohet në paragrafin pararendës në mënyrë sa më të gjerë që të jetë e mundur në atë mënyrë dhe deri në ato data që Bordi mund ta kërkojë; nëse kërkohet nga një Palë, Bordi mund t'i ofrojë asaj këshilla për dhënien e informacionit dhe për përpjekjet për zvogëlimin e veprimtarisë së paligjshme me drogat brenda kufijve të asaj Pale.

Neni 36
Dispozita penale

1.a) Në varësi të kufizimeve të veta kushtetuese, çdo Palë duhet të marrë masa të tilla që të sigurojë që kultivimi, prodhimi, fabrikimi, nxjerrja, përgatitja, zotërimi, ofrimi, ofrimi për shitje, shpërndarja, blerja, shitja, përhapja me çfarëdo kushtesh, komisioni dërgimit, dërgimi në tranzit, transporti, importimi dhe eksportimi i drogave në kundërshtim me dispozitat e kësaj Konvente dhe çdo veprim tjetër që për mendimin e kësaj Pale mund të jetë në kundërshtim me dispozitat e kësaj Konvente, duhet të përbëjnë veprimtari të kundërligjshme të ndëshkueshme kur kryhen me qëllim dhe se veprimtaritë serioze të kundërligjshme duhen ndëshkuar siç duhet sidomos me burgim ose ndëshkime të tjera të heqjes së lirisë.

b) Pavarësisht nga nënparagrafi i mësipërm, kur përdoruesit e drogave i kanë kryer këto veprimtari të kundërligjshme, Palët mund të sigurojnë, ose si alternativë për dënimin ose ndëshkimin ose përveç dënimit ose ndëshkimit, se këta përdorues duhet t'u nënshtrohen masave të trajtimit, edukimit, kujdesit pas kryerjes së dënimit, rehabilitimit dhe integrimit sërisht në shoqëri në përputhje me paragrafin 1 të nenit 38.

2. Në varësi të kufizimeve kushtetuese të një Pale, sistemit të saj ligjor dhe legjislacionit vendas,

a) (i) Çdonjëra nga veprimtaritë e kundërligjshme të renditura në paragrafin 1, nëse kryhen në vende të ndryshme, duhet të konsiderohen si veprimtari të kundërligjshme të veçanta.

(ii) Pjesëmarrja e qëllimshme në veprimtari të tilla të kundërligjshme, fshetësia dhe

përpjekjet për kryerjen e tyre dhe veprimet përgatitore dhe operacionet financiare në lidhje me veprimtaritë e paligjshme dhe operacionet financiare në lidhje me veprimtaritë e paligjshme, të cilave iu referohet në këtë nen, duhet të jenë veprimtari të kundërligjshme të ndëshkueshme siç parashikohet në paragrafin 1.

(iii) Dënimi i huaj për të tilla veprimtari të paligjshme duhet të merret parasysh me qëllimin e përcaktimit të recidivizmit.

(iv) Veprimtaritë serioze të kundërligjshme, të cilave iu referohet më lart e kryera nga vendasit ose të huajt duhet të ndiqen penalisht nga Pala në territorin e së cilës është kryer veprimtaria e kundërligjshme, ose nga Pala në territorin e të cilës është gjendur autori i veprimtarisë së kundërligjshme në qoftë se ekstradimi nuk është i pranueshëm në përputhje me ligjin e Palës, të cilës i është bërë kërkesa, dhe në qoftë se ky autor i veprimtarisë së kundërligjshme nuk është ndjekur penalisht dhe vendimi i gjyqit nuk është dhënë akoma.

b) (i) Çdonjëra nga veprimtaritë e kundërligjshme të renditura në paragrafin 1 dhe 2 (a) (ii) të këtij neni duhet të gjykohet, që të përfshihet si veprimtari e kundërligjshme e ekstradueshme në çfarëdo traktati ekstradimi që ekziston midis Palëve. Palët zotohen t'i përfshijnë të tilla veprimtari të kundërligjshme si veprimtari të kundërligjshme të ekstradueshme në çdo traktat ekstradimi që do të lidhet midis tyre.

(ii) Në qoftë se një Palë, që e kushtëzon ekstradimin me ekzistencën e një traktati, merr një kërkesë për ekstradim nga një Palë tjetër me të cilën ajo nuk ka traktat ekstradimi, ajo mund, sipas zgjedhjes së saj ta konsiderojë këtë Konventë si bazën ligjore për ekstradim në lidhje me veprimtaritë e kundërligjshme të renditura në paragrafin 1 dhe 2 (a) (ii) të këtij neni. Ekstradimi duhet t'u nënshtrohet kushteve të tjera të parashikuara nga ligji i Palës të cilës i drejtohet kërkesa.

(iii) Palët që e kushtëzojnë ekstradimin me ekzistencën e një traktati duhet t'i njohin veprimtaritë e kundërligjshme të renditura në paragrafin 1 dhe 2 (a) (ii) të këtij neni si veprimtari të kundërligjshme të ekstradueshme midis tyre, në varësi të kushteve të parashikuara nga ligji i Palës të cilës i bëhet kërkesa.

(iv) Ekstradimi duhet të pranohet në përputhje me ligjin e Palës të cilës i bëhet kërkesa dhe, pavarësisht nga nënparagrafet (b) (i), (ii) dhe (iii) të këtij paragrafi, Pala duhet të ketë të drejtë të refuzojë të pranojë ekstradimin në rastet kur autoritetet kompetente nuk e konsiderojnë veprimtarinë e kundërligjshme mjaftueshmërisht serioze.

3. Dispozitat e këtij neni duhet t'u nënshtrohen dispozitave të ligjit penal të Palës së interesuar për çështje të juridiksionit.

4. Asgjë që përmban ky nen nuk duhet të dëmtojë parimin se veprimtaritë e kundërligjshme, të cilave ai iu referohet duhet të përcaktohen, ndiqen penalisht dhe ndëshkohen në përputhje me legjislacionin vendas të një Pale.

Neni 37

Kapja e konfiskimi

Çdo drogë, lëndë dhe pajisje e përdorur ose që synon të përdoret për kryerjen e një veprimtarie të kundërligjshme, të cilës i referohet në nenin 36, duhet t'i nënshtrohet kapjes dhe konfiskimit.

Neni 38

Masa kundër përdorimit të drogave

1. Palët duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë dhe të marrin të gjitha masat e praktikueshme për parandalimin e përdorimit të drogave dhe për identifikimin e tyre të hershëm, për trajtimin, edukimin, kujdesin pas kryerjes së dënimit, rehabilitimit dhe integrimit sërisht në shoqëri të personave të përfshirë dhe duhet të bashkërendojnë përpjekjet e tyre për këto qëllime.

2. Palët duhet sa më shumë që të jetë e mundur, të nxisin trajnimin e personalit në trajtimin, kujdesin pas kryerjes së dënimit, rehabilitimit dhe integrimit sërisht në shoqëri të përdoruesve të drogave.

3. Palët duhet të marrin të gjitha masat e praktikueshme për të ndihmuar personat, puna e të cilëve kështu e kërkon që të arrijnë të kuptojnë problemet e përdorimit të drogave dhe parandalimin e tij dhe gjithashtu duhet ta nxisin këtë kuptim të problemeve midis publikut të gjërë në qoftë se ka rrezik që përdorimi i drogave të përhapet.

Neni 38 bis

Marrëveshjet mbi qendrat rajonale

Në qoftë se një Palë e konsideron të parapëlqyeshme si pjesë të veprimit të saj kundër trafikut të paligjshëm të drogave, duke pasur konsideratën e duhur për sistemet e veta kushtetuese, ligjore dhe administrative, dhe, nëse ajo kështu dëshiron, duke pasur kështillën teknike të Bordit ose të agjencive të specializuara, ajo duhet të nxisë lidhjet, në konsultim me Palë të tjera të interesuara të rajonit, të marrëveshjeve që konsiderojnë mundësinë e ngritjes së qendrave rajonale për kërkime shkencore dhe edukim për të luftuar problemet që rrjedhin nga përdorimi i paligjshëm dhe trafiku i drogave.

Neni 39

Zbatimi i masave më të rrepta të kontrollit në vend se sa ato që kërkon kjo Konventë

Pavarësisht nga çdo gjë që përmban kjo Konventë, një Palë nuk duhet të, ose nuk duhet të gjykohet të pengohet që të marrë masa kontrolli më të rrepta ose më të ashpra se ato që parashikohen nga kjo Konventë dhe në mënyrë të veçantë që të kërkojë që preparatet e Listës III ose drogat e Listës II, t'u nënshtrohen të gjitha ose atyre masave të kontrollit të zbatueshme për drogat e Listës I si të jetë, për mendimin e saj, e nevojshme ose e parapëlqyeshme për mbrojtjen e shëndetit ose mirëqënies publike.

Neni 4013

Gjuhët e Konventës dhe procedura për nënshkrimin, ratifikimin dhe pranimin

1. Kjo Konventë, tekstet në gjuhën kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle të së cilës janë të njëjta me origjinalin, duhet të jenë të hapura për t'u nënshkruar deri më 1 Gusht 1961 në emër të çdo Anëtari të Kombeve të Bashkuara, të çdo Shteti joanëtar që është Palë në Statutin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë ose anëtar i një agjencie të specializuar të Kombeve të Bashkuara dhe gjithashtu të çdo Shteti tjetër që Këshilli mund ta ftojë të bëhet Palë.

2. Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit. Dokumentet e ratifikimit duhet të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

3. Kjo Konventë duhet të jetë e hapur deri më 1 Gusht 1961 për pranim nga Shtetet, të cilave iu referohet në paragrafin 1. Dokumentet e pranimit duhet të depozitohen pranë Sekratrit të Përgjithshëm.

---

1. Shënim i Sekretariatit: Dy paragrafet e mëposhtme janë nxjerrë nga Shënimi i Hyrjes i tekstit të Konventës së Vetme mbi Drogat Narkotike, 1961, siç është ndryshuar nga Protokolli që Ndryshon Konventën e Vetme mbi Drogat Narkotike, 1961, siç është përcaktuar nga Sekretari i Përgjithshëm më 8 Gusht 1975, në përputhje me nenin 22 të Protokollit të datës 25 Mars 1972:

"Protokolli që ndryshon Konventën e Vetme mbi Drogat Narkotike, 1961 (që më poshtë do të quhet Protokolli i vitit 1972) që ka hyrë në fuqi më 8 Gusht 1975, në përputhje me paragrafin 1 të nenit të tij të 18-të. Në lidhje me cilindo Shtet që është tashmë Palë në Konventën e Vetme dhe depozitimet tek Sekretari i përgjithshëm, pas datës së depozitimit të dokumentit të dyzetë të ratifikimit apo pranimit të Protokollit të vitit 1972, ky i fundit do të hyjë në fuqi ditën e tridhjetë pas depozitimit nga ai Shtet i dokumentit të tij (shih nenet 17 dhe 18 të Protokollit të vitit 1972)".

"Cilido Shtet që bëhet Palë në Konventën e Vetme pas hyrjes në fuqi të Protokollit të vitit 1972 duhet, në rast se nuk shprehet një synim i ndryshëm nga ai Shtet: a) të konsiderohet si Palë në Konventën e Vetme të ndryshuar dhe (b) të konsiderohet Palë në Konventën e Vetme të pandryshuar në lidhje me cilëndo Palë të asaj Konvente që nuk ka detyrime nga Protokolli i vitit 1972 (shih nenin 19 të Protokollit të vitit 1972)".

Neni 41[14]

Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë duhet të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës në të cilën dokumenti i dyzetë i ratifikimit ose pranimit depozitohet në përputhje me nenin 40.

2. Në lidhje me çdo Shtet tjetër që depoziton një dokument ratifikimi ose pranimi pas datës së depozitimit të dokumentit të dyzetë në fjalë, kjo Konventë duhet të hyjë në fuqi ditën e tridhjetë pas depozitimit nga ai Shtet i dokumentit të tij të ratifikimit ose pranimit.

Neni 42

Territoret ku zbatohet

Kjo Konventë duhet të zbatohet për të gjitha territoret jokryeqytetase për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilave çdo Palë është përgjegjëse, përveç se kur miratimi i mëparshëm i këtij territori kërkohet nga Kushtetuta e Palës ose nga territori i interesuar, ose nga praktika. Në këtë rast Pala duhet të përpiqet të sigurojë miratimin e nevojshëm të territorit brenda një kohe sa më të shkurtër dhe kur ai miratim merret Pala duhet të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm. Kjo Konventë duhet të zbatohet për territorin ose territoret e shënuar (a) në këtë njoftim nga data e marrjes së tij nga Sekretari i Përgjithshëm. Në ato raste kur nuk kërkohet miratimi i mëparshëm i territorit jokryeqytetas, Pala e interesuar duhet, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit ose pranimit, të deklarojë territorin ose territoret jo-kryeqytetase për të cilin/cilat zbatohet kjo Konventë.

Neni 43

Territoret për qëllimet e neneve 19, 20, 21 dhe 31

1. Secila Palë mund ta njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm se, për qëllime të neneve 19, 20, 21 dhe 31, një nga territoret e saj ndahet në dy ose më shumë territore ose se dy ose më shumë nga territoret e saj janë bashkuar në një territor të vetëm.

2. Dy ose më shumë Palë mund ta njoftojnë Sekretarin e Përgjithshëm se, si rezultat i krijimit të bashkimit të doganave midis tyre, ato Palë përbëjnë një territor të vetëm për qëllimet e neneve 19, 20, 21 dhe 31.

3. Çdo njoftim në bazë të paragrafit 1 ose 2 më sipër duhet të hyjë në fuqi më 1 Janar të vitit që vijon pas vitit në të cilin është bërë njoftimi.

Neni 44

Shfuqizimi i traktateve të mëparshme ndërkombëtare

1.Dispozitat e kësaj Konvente, me hyrjen e saj në fuqi, duhet, siç ka ndodhur midis Palëve të saj, shfuqizojnë dhe zëvendësojnë dispozitat e traktateve të mëposthme:

a) Konventën Ndërkombëtare të Opiumit, nënshkruar në Hagë më 23 janar 1912;

b) Marrëveshjen në lidhje me fabrikimin, tregtinë e brendshme dhe përdorimin e Opiumit të Përgatitur, nënshkruar në Gjenevë më 11 shkurt 1925;

c) Konventën Ndërkombëtare të Opiumit, nënshkruar në Gjenevë më 19 shkurt 1925;

d) Konventën për Kufizimin e Fabrikimit dhe Rregullimit e Shpërndarjes së Drogave Narkotike, nënshkruar në Gjenevë në 13 korrik 1931;

e) Marrëveshjen për Kontrollin e Pirjes së Opiumit në Lindjen e Largme, nënshkruar në Bangkok më 27 nëntor 1931;

f) Protokollin e nënshkruar në Lake Success më 11 dhjetor 1946, që ndryshon Marrëveshjet, Konventat dhe Protokollet mbi Drogat Narkotike të përfunduara në Hagë më 23 janar 1912, në Gjenevë më 11 shkurt 1925 dhe 19 shkurt 1925 dhe 13 korrik 1931, në Bangkok më 27 nëntor 1931

[14]. Shih shënimin (1) më sipër.

dhe në Gjenevë më 26 qershor 1936; me përjashtim kur dëmton Konventën e fundit;

g) Konventat dhe Marrëveshjet, të cilave iu referohet në nënparagrafet (a) deri tek (e) ndryshuar nga Protokolli i vitit 1946 të cilit i referohet në nënparagrafin (f);

h) Protokollin e nënshkruar në Paris më 19 nëntor 1948 Vënien nën Kontrollin Ndërkombëtar Drogat jashtë Sferës së Veprimtarisë së Konventës së 13 korrikut 1931 për Kufizimin e Fabrikimit dhe Rregullimit e Shpërndarjes së Drogave Narkotike, të ndryshuar nga Protokolli i nënshkruar në Lake Success më 11 dhjetor 1946;

i) Protokollin për Kufizimin dhe Rregullimin e Kultivimit të Bimës së Lulëkuqes, Prodhimit, Tregtisë Ndërkombëtare dhe me Shumicë dhe Përdorimin e Opiumit, nënshkruar në Nju Jork më 23 qershor 1953, nëse ai Protokoll ka hyrë në fuqi.

2. Me hyrjen në fuqi të kësaj Konvente, neni 9 i Konventës për Ndalimin e Trafikut të Paligjshëm të Drogave të Rrezikshme, nënshkruar në Gjenevë më 26 qershor 1936, duhet, midis Palëve të asaj që janë gjithashtu Palët të kësaj Konvente, të shfuqizohen dhe duhet të zëvendësohet me paragrafin 2 (b) të nenit 36 të kësaj Konvente; me kusht që kjo Palë me anë të një njoftimi për Sekretarin e Përgjithshëm mund të vazhdojë të mbajë në fuqi nenin në fjalë 9.

Neni 45[15]

Dispozita të përkohshme

1. Funksionet e Bordit të parashikuara në nenin 9 duhet, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente (neni 41, paragrafi 1), të zbatohen përkohësisht nga Bordi Qëndror i Përhershëm i caktuar në bazë të kapitullit VI të Konventës, të cilës i referohet në nenin 44 (c) të ndryshuar dhe nga Organi Mbikëqyrës i caktuar në bazë të kapitullit II të Konventës, të cilës i referohet në nenin 44 (d) të ndryshuar, siç mund të kërkojnë respektivisht këto funksione.

2. Këshilli duhet të caktojë, datën në të cilën Bordi, të cilit i referohet në nenin 9 duhet të fillojë detyrat e tij. Duke filluar nga data që Bordi, në lidhje me Shtetet Palë në traktatet e renditura në nenin 44 që nuk janë Palë në këtë Konventë, do të marrë përsipër funksionet e Bordit Qendror të Përhershëm dhe të Organizmit Mbikëqyrës, të cilave iu referohet në paragrafin 1.

Neni 46

Denoncimi

1. Pas kalimit të dy viteve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, (neni 41, paragrafi 1) çdo Palë mund, në emrin e vet ose në emrin e një territori për të cilin ajo ka përgjegjësi ndërkombëtare dhe miratimin e të cilit e ka tërhequr në përputhje me nenin

"Neni 20

Dispozita të Përkohshme"

"1. Funksionet e Bordit Ndërkombëtar për Kontrollin e Narkotikëve të parashikuara në amendamentet që përmban ky Protokoll duhet, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij Protokoklli në pajtim me paragrafin 1 të nenit 18 më sipër, të kryhen nga Bordi siç është caktuar nga Konventa e Vetme e pandryshuar.

"2. Këshilli Social-Ekonomik duhet të caktojë datën në të cilën Bordi sç caktohet nga amendamentet që përmban ky Protokoll, duhet të fillojë detyrat e tij. Duke filluar nga data që Bordi siç caktohet duhet, në lidhje me ato Palë në Konventën e Vetme të pandryshuar dhe me ato Palë të traktateve të renditura në nein 44 të saj, që nuk janë Palë në këtë Protokoll, të marrë përsipër funksionet e Bordit siç përcaktohet nga Konventa e Vetme e pandryshuar.

"3. Nga anëtarët e zgjedhur në zgjedhjet e para pas rritjes së numrit të anëtarëve të Bordit nga njëmbëdhjetë në trembëdhjetë anëtarë, mandati i gjashtë anëtarëve duhet të skadojë në fund të

[15]. Më poshtë është teksti i nenit 20 të Protokollit të vitit 1972.

tre viteve dhe mandati i shtatë anëtarëve të tjerë duhet të skadojë në fund të pesë viteve.

"4. Anëtarët e Bordit mandati i të cilëve do të skadojë në fund të periudhës së sipërpërmendur fillestare prej tre vitesh duhet të zgjidhet me short të tërhiqen nga Sekretari i Përgjithshëm menjëherë pasi të ketë përfunduar zgjedhjet e para."

42. Ta denoncojë këtë Konventë me anë të një dokumenti me shkrim të depozituar pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

2. Denoncimi, nëse merret nga Sekretari i Përgjithshëm në ditën e parë të Korrikut të cilitdo vit, apo përpara kësaj date, duhet të marrë fuqi ditën e parë të Janarit në vitin pasardhës dhe, nëse merret pas ditës së parë të Korrikut, duhet të marrë fuqi sikur të ishte marrë në ditën e parë të Korrikut të vitit pasardhës ose përpara saj.

3. Kjo Konventë duhet të shfuqizohet në qoftë se, si rezultat i denoncimit të bërë në përputhje me paragrafin 1, kushtet për hyrjen e saj në fuqi siç parashikohet në nenin 41, paragrafi 1, pushojnë së ekzistuari.

Neni 47

Amendamentet

1.Secila Palë mund të propozojë një amendament për këtë Konventë. Teksti i çfarëdo amendamenti të tillë dhe arsyet për këtë duhet t'i komunikohen Sekretarit të Përgjithshëm, i cili duhet t'ua komunikojë ato Palëve dhe Këshillit. Këshilli mund të vendosë:

a) të thirret një konferencë në përputhje me nenin 62, paragrafi 4, të Kartës së Kombeve të Bashkuara për të shqyrtuar amendamentin e propozuar, ose

b) që Palët të pyeten nëse ato e pranojnë amendamentin e propozuar dhe atyre gjithashtu duhet t'u kërkohet që t'i paraqesin Këshillit çdo koment për këtë propozim.

2. Në qoftë se një amendament i propozuar i qarkulluar në bazë të paragrafit 1 (b) të këtij neni nuk është hedhur poshtë nga asnjëra Palë brenda tetëmbëdhjetë muajve, pasi ajo është vënë në qarkullim, ai kështu duhet të hyjë në fuqi. Por nëse një amendament i propozuar hidhet poshtë nga ndonjë Palë, Këshilli mund të vendosë, në dritën e komenteve të marra nga Palët, nëse duhet të thirret një konferencë për shqyrtimin e këtij amendamenti.

Neni 48

Mosmarrëveshjet

1. Në qoftë se midis dy ose më shumë Palëve del ndonjë mosmarrëveshje, në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, Palët në fjalë duhet të konsultohen së bashku me qëllim që ta zgjidhin mosmarrëveshjen me anën bisedimesh, hetimesh, ndërmjetësimi, pajtimi, arbitrimi, duke iu drejtuar për ndihmë organizmave rajonale, procesit gjyqësor ose me anë mjetesh të tjera paqësore që do t'i zgjedhin vetë.

2. Çdo mosmarrëveshje e tillë, që nuk mund të zgjidhet në mënyrën e parashkruar duhet t'i referohet Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për të marrë vendim.

Neni 49

Rezervime të përkohshme

1. Një Palë në kohën e nënshkrimit, ratifikimit ose pranimit mund të rezervojë të drejtën për të lejuar përkohësisht në njerën prej territoreve të saj:

a) përdorimin pothuajse-mjekësor të opiumit;

b) thithjen e opiumit;

c) përtypjen e gjethes së kokainës;

d) përdorimin e kanabis, rrëshirës së kanabis, ekstrakteve dhe substancave të tretura të kanabis për qëllime jomjekësore; dhe

e) prodhimin dhe fabrikimin dhe tregtimin e drogave, të cilave iu referohet në pikat (a) deri tek (d) për qëllimet e përmendura aty.

2. Rezervat në bazë të paragrafit 1 duhet t'i nënshtrohen kufizimeve të mëposhtme:

a) Veprimtaritë e përmendura në paragrafin 1 mund të autorizohen vetëm deri në atë masë që ato janë tradicionale në territoret në lidhje me të cilat bëhet rezervimi, dhe u lejuan me 1 Janar 1961

b) Asnjë lloj eksporti i drogave, të cilave iu referohet në paragrafin 1 për qëllimet e përmendura atje nuk mund t'i lejohet një jo-pale ose një territori për të cilat kjo Konventë në bazë të nenit 42 nuk zbatohet.

c) Lejohet të thithin opium vetëm ata persona që u regjistruan nga autoritetet kompetente për këtë qëllim me 1 janar 1964.

d) Përdorimi pothuajse-mjekësor i opiumit duhet hequr brenda 15 vitesh duke filluar nga hyrja në fuqi e kësaj Konvente siç parashikohet në paragrafin 1 të nenit 41.

e) Përtypja e gjethes së kokainës duhet hequr brenda njëzetepesë vitesh duke filluar nga hyrja në fuqi e kësaj Konvente siç parashikohet në paragrafin 1 të nenit 41.

f) Përdorimi i kanabis për qëllime të tjera përveç atyre mjekësore dhe shkencore, duhet të ndërpritet sa më shpejt që të jetë e mundur, por në çdo rast brenda njëzetepesë viteve nga hyrja në fuqi e kësaj Konvente siç parashikohet në paragrafin 1 të nenit 41.

g) Prodhimi dhe fabrikimi dhe tregtia e drogave të cilave iu referohet në paragrafin 1 për çfarëdo lloj përdorimi i përmendur atje duhet të pakësohet dhe përfundimisht të zhduket njëkohësisht me pakësimin dhe zhdukjen e këtyre përdorimeve.

3. Një Palë që ka rezervë në bazë të paragrafit 1 duhet:

a) Të përfshijë në raportin vjetor që i dërgon Sekretarit të Përgjithshëm, në përputhje me nenin 18, paragrafi 1 (a), një përmbledhje të përparimit që është bërë gjatë vitit paraardhës drejt zhdukjes së përdorimit, prodhimit, fabrikimit ose tregtisë të cilave iu referohet në paragrafin 1; dhe

b) T'i dërgojë Bordit preventiva të veçanta (neni 19) dhe raporte statistikore (neni 20) në lidhje me veprimtaritë për të cilat ka rezerva në mënyrën dhe formën e parashikuar nga Bordi.

4. a) Në qoftë se një Palë që ka një rezervë në bazë të paragrafit 1 nuk arrin të dërgojë:

i) një raport të cilit i referohet në paragrafin 3 (a) brenda gjashtë muajve pas përfundimit të vitit, të cilit i përket ky informacion;

ii) preventivat, të cilave iu referohet në paragrafin 3 (b) brenda tre muajve pas datës së caktuar për atë qëllim nga Bordi në përputhje me nenin 12, paragrafi 1;

iii) statistikat, të cilave iu referohet në paragrafin 3 (b) brenda tre muajve pas datës në të cilën ato duheshin dorëzuar në përputhje me nenin 20, paragrafi 2, Bordi ose Sekretari i Përgjithshëm, sipas rastit, duhet t'i dërgojnë Palës së interesuar një njoftim për vonesën, dhe duhet ta kërkojnë këtë informacion brenda një periudhe tremujore pas marrjes së atij njoftimi.

b) Në qoftë se Pala nuk arrin brenda kësaj periudhe t'i përmbahet kërkesës së Bordit ose të Sekretarit të Përgjithshëm, rezerva në fjalë e bërë në bazë të paragrafit 1 duhet të pushojë së qeni e efektshme.

5. Një Shtet që ka pasur rezerva mundet në çdo kohë me anë të një njoftimi me shkrim të tërheqë të gjitha ose një pjesë të rezervave të veta.

Neni 507

Rezerva të tjera

1. Asnjë rezervë përveç atyre të bëra në përputhje me nenin 49 ose me paragrafet e mëposhtëm nuk do të lejohet.

2. Çdo Shtet mundet në kohën e nënshkrimit, ratifikimit ose pranimit të thotë rezervat e veta në lidhje me dispozitat e mëposhtme të kësaj Konvente:

Neni 12, paragrafi 2 dhe 3, neni 13, paragrafi 2; neni 14, paragrafi 1 dhe 2; neni 31, paragrafi 1 (b) dhe neni 48.

“Neni 21

3. Një Shtet që dëshiron të bëhet Palë por dëshiron të autorizohet të shprehë rezerva përveç atyre të shprehura në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni ose me nenin 49 mund ta informojë Sekretarin e Përgjithshëm për këtë synim. Në qoftë se deri në fund të dymbëdhjetë muajve pas datës së komunikimit të rezervave në fjalë nga Sekretari i Përgjithshëm, kjo rezervë nuk është kundërshtuar nga një e treta e Shteteve, që kanë ratifikuar ose pranuar këtë Konventë përpara përfundimit të asaj periudhe, ajo duhet të gjykohet e lejuar, por duke e kuptuar se Shtetet që kanë kundërshtuar rezervën nuk është nevoja të marrin kundrejt Shtetit që shpreh rezervën ndonjë detyrim ligjor në bazë të kësaj Konvente që të ndikohet nga rezerva.

4. Një Shtet që ka shprehur rezerva mundet në çfarëdo kohë me anë të një njoftimi me shkrim të tërheqë të gjitha ose një pjesë të rezervave të veta.

“Rezervat

“1. Çdo Shtet mundet, në kohën e nënshkrimit ose ratifikimit ose pranimit të këtij Protokollli, të shprehë rezervat e veta në lidhje me çfarëdo amendamenti që përmbahet aty përveç amendamenteve të nenit 2 paragrafi 6 dhe 7 (neni 1 i këtij Protokolli), neni 9 paragrafi 1, 4 dhe 5 (neni 2 i këtij Protokolli), nenit 10, paragrafi 1 dhe 4 (neni 3 i këtij Protokolli), nenit 11 (neni 4 i këtij Protokolli), nenit 14 bis (neni 7 i këtij Protokolli), nenit 16 (neni 8 i këtij Protokolli), nenit 22 (neni 12 i këtij Protokolli), neni 35 (neni 13 i këtij Protokolli), nenit 36 paragrafi 1 (b) (neni 14 i këtij Protokolli), nenit 38 (neni 15 i këtij Protokolli) dhe nenit 38 bis (neni 16 i këtij Protokolli”.16

“2. Një Shtet që ka shprehur rezerva mundet në çfarëdo kohë me anë të një njoftimi me shkrim të tërheqë të gjitha ose një pjesë të rezervave të veta”

Neni 51
Njoftimet

Sekretari i Përgjithshëm duhet t’i njoftojë të gjitha Shtetet të cilave iu referohet në paragrafin 1 të nenit 40:

Për nënshkrimet, ratifikimet dhe pranimet në përputhje me nenin 40;

Për datën në të cilën kjo Konventë hyn në fuqi në përputhje me nenin 41;

Për denoncimet në përputhje me nenin 46, dhe

Për deklaratat dhe njoftimet në bazë të neneve 42, 43, 47, 49 dhe 50.

* Shënim i Sekretariatit: Shënimi i mëposhtëm shpjegues është riprodhues nga kopja e vetme e vërtetuar,e verifikuar nga Sekretari i Përgjithshëm më 8 Gusht 1975, të Konventës së Vetme mbi Drogat Narkotike, 1961, të ndryshuar nga Protokolli i vitit 1872 që Ndryshon Konventën e Vetme mbi Drogat Narkotike, 1961:
“Do të vërehet se Shtetet që dëshirojnë të shprehin një rezervë për një ose më shumë amendamente në përputhje me nenin 21 të mësipërm të Protokollit të vitit 1972 duhet fillimisht të bëhen Palë në Konventën e Vetme në formën e saj të pandryshuar (në qoftë se e kanë bërë këtë akoma) dhe pastaj duhet ta ratifikojnë ose ta pranojnë Protokollin e vitit 1972 në vartësi të rezervave të dëshirueshme”.

LISTAT E RISHIKUARA QË PËRFSHIJNË TË GJITHA AMENDAMENTET E BËRA NGA KOMISIONI MBI DROGAT NARKOTIKE NË FUQI MË 1 KORRIK 1993

LISTAT

Listë e Drogave të përfshira në Listën I

ACETORPHINE (3 - 0 - acetyltetrahydro - 7 a - (1 - hydroxy - methylbutyl) - 6, 14 - endoetheno - oripavine)

ACETYL - ALPHA - METHYLFENTANYL (N - [1 - (a - methylphenethyl) - 4 - piperidyl]] acetanilide)

ACETYLMETHADOL (3 - acetoxy - 6 - dimethylamino - 4, 4 -diphenylheptane)

ALFENTANIL (N - [1 - [2 - (4 - ethyl - 4, 5 - dihydro - 5 - oxo - 1 H-tetrazol - 1 - yl) ethyl] - 4 - (methoxymethyl) - 4 - piperidinyl] - N - phenylpropanamide)

ALLYLPRODINE (3 - allyl - 1 - methyl - 4 - phenyl - 4 - propionoxypiperidine)

ALPHACETYLMETHADOL (alpha - 3 - acetoxy - 6 - dimethylamino - 4, 4 - diphenylheptane)

ALPHAMEPRODINE (alpha - 3 - ethyl - 1 - methyl - 4 - phenyl - 4 - propionoxypiperidine)

ALPHAMETHADOL (alpha - 6 - dimethylamino - 4, 4 - diphenyl - 3 - heptanol)

ALPHA - METHYLFENTANYL (N - [1 - (a - methylphenethyl - 4 - piperidyl] propionanilide)

ALPHA - METHYLTHIOFENTANYL (N - [1 - [1 - methyl - 2 - (2 - thienyl) ethyl] - 4 - piperidyl] propionanilide)

ALPHAPRODINE (alpha - 1, 3 - dimethyl - e- phenyl - 4 - propionoxypiperidine)

ANILERIDINE (1 - para - aminophenethyl - 4 - phenylpiperidine - 4 - carboxylic acid ethyl ester)

BENZETHIDINE (1 - (2 - benzyloxyethyl) - 4 - phenylpiperidine - 4 - carboxylic acid ethyl ester)

BENZYLMORPHINE (3 - benzylmorphine)

BETACETYLMETHADOL (beta - 3 - 3acetoxy - 6 - dimethylamino - 4, 4 - diphenylheptane)

BETA - HYDROXYFENTANYL (N - [1 - (B - hydroxyphenethyl) - 4 - piperidyl] propionanilide)

BETA - HYDROXY - 3 - METHYLFENTANYL (N - [1 - (B - hydroxyphenethyl) - 3 - methyl - 4 - piperidyl] propionanilide)

BETAMEPRODINE (beta - 3 - ethyl - 1 - methyl - 4 - phenyl - 4 - propionoxypiperidine)

BETAMETHADOL (beta - 6 - dimethylamino - 4, 4 - diphenyl - 3 - heptanol)

BETAPRODINE (beta - 1, 3 - dimethyl - 4 - phenyl - 4 propionoxypiperidine)

BEZITRAMIDE (1 - (3 - cyano - 3, 3 - diphenylpropyl) - 4 - (2 - oxo - 3 - propionyl - 1 - benzimidazolinyl) - piperidine)

CANNABIS dhe RRËSHIRË KANBIS dhe EKSTRAKTE KANABIS dhe SUBSTANCA TË KANABIS

CLONITAZENE (2 - para - chlorbenzyl - 1 - diethylaminoethyl - 5 - nitrobenzimidazole)

GJETHE KOKAINE

Shënim i Sekretariatit: Për listat origjinale shih E/CONF.34/24/ADD.1

COCAINE (methyl ester e benzolecgonine)

CODOXIME (dihydrocodeinone - 6 - carboxymethyloxime)

CONCENTRAT I SUBSTANCES SE OPIUMIT (materiali që përftohet kur kashta e lulëkuqes hyn në proces për përqendrimin e alkaloideve kur një material i tillë bëhet i pranishëm në tregti)

DESOMORPHINE (dihydrodeoxymorphine)

DEXTROMORAMIDE ((+) - 4 - [2 - methyl - 4 - oxo - 3, 3 - diphenyl - 4 - (1 pyrrolidinyl) butyl] morphine)

LISTATE RISHIKUARA QË PËRFSHIJNË TË GJITHA AMENDAMENTET E BËRA NGA KOMISIONI MBI DROGAT NARKOTIKE NË FUQI MË 1 KORRIK 1993

LISTAT

Listë e drogave të përfshirë në listën 1

ACETORPHINE (3 - 0 - acetyltetrahydro - 7 a - (1 - hydroxy - methylbutyl) - 6, 14 - endoetheno - oripavine)

ACETYL - ALPHA - METHYLFENTANYL (N - [1 - (a - methylphenethyl) - 4 - piperidyl]] acetanilide)

ACETYLMETHADOL (3 - acetoxy - 6 - dimethylamino - 4, 4 -diphenylheptane)

ALFENTANIL (N - [1 - [2 - (4 - ethyl - 4, 5 - dihydro - 5 - oxo - 1 H-tetrazol - 1 - yl) ethyl] - 4 - (methoxymethyl) - 4 - piperidinyl] - N - phenylpropanamide)

ALLYLPRODINE (3 - allyl - 1 - methyl - 4 - phenyl - 4 - propionoxypiperidine)

ALPHACETYLMETHADOL (alpha - 3 - acetoxy - 6 - dimethylamino - 4, 4 - diphenylheptane)

ALPHAMEPRODINE (alpha - 3 - ethyl - 1 - methyl - 4 - phenyl - 4 - propionoxypiperidine)

ALPHAMETHADOL (alpha - 6 - dimethylamino - 4, 4 - diphenyl - 3 - heptanol)

ALPHA - METHYLFENTANYL (N - [1 - (a - methylphenethyl - 4 - piperidyl] propionanilide)

ALPHA - METHYLTHIOFENTANYL (N - [1 - [1 - methyl - 2 - (2 - thienyl) ethyl] - 4 - piperidyl] propionanilide)

ALPHAPRODINE (alpha - 1, 3 - dimethyl - e- phenyl - 4 - propionoxypiperidine)

ANILERIDINE (1 - para - aminophenethyl - 4 - phenylpiperidine - 4 - carboxylic acid ethyl ester)

BENZETHIDINE (1 - (2 - benzyloxyethyl) - 4 - phenylpiperidine - 4 - carboxylic acid ethyl ester)

BENZYLMORPHINE (3 - benzylmorphine)

BETACETYLMETHADOL (beta - 3 - 3acetoxy - 6 - dimethylamino - 4, 4 - diphenylheptane)

BETA - HYDROXYFENTANYL (N - [1 - (B - hydroxyphenethyl) - 4 - piperidyl] propionanilide)

BETA - HYDROXY - 3 - METHYLFENTANYL (N - [1 - (B - hydroxyphenethyl) - 3 - methyl - 4 - piperidyl] propionanilide)

BETAMEPRODINE (beta - 3 - ethyl - 1 - methyl - 4 - phenyl - 4 - propionoxypiperidine)

BETAMETHADOL (beta - 6 - dimethylamino - 4, 4 - diphenyl - 3 - heptanol)

BETAPRODINE (beta - 1, 3 - dimethyl - 4 - phenyl - 4 propionoxypiperidine)

BEZITRAMIDE (1 - (3 - cyano - 3, 3 - diphenylpropyl) - 4 - (2 - oxo - 3 - propionyl - 1 - benzimidazolinyl) - piperidine)

CANNABIS dhe RRËSHIRË KANBIS dhe EKSTRAKTE KANABIS dhe SUBSTANCA TË KANABIS

CLONITAZENE (2 - para - chlorbenzyl - 1 - diethylaminoethyl - 5 - nitrobenzimidazole)

GJETHE KOKAINE

Shënim i Sekretariatit: Për listat origjinale shih E/CONF.34/24/ADD.1

COCAINE (methyl ester e benzolecgonine)

CODOXIME (dihydrocodeinone - 6 - carboxymethyloxime)

CONCENTRAT I SUBSTANCES SE OPIUMIT (materiali që përftohet kur kashta e lulëkuqes hyn në proces për përqendrimin e alkaloideve kur një material i tillë bëhet i pranishëm në tregti)

DESOMORPHINE (dihydrodeoxymorphine)

DEXTROMORAMIDE ((+) - 4 - [2 - methyl - 4 - oxo - 3, 3 - diphenyl - 4 - (1 pyrrolidinyl) butyl] morphine

DIAMPROMIDE (N - [2 - (methylphenethylamino) propyl] propionanilide)

DIETHYLTHIAMBUTENE (3 - diethylamino - 1, 1 - di - (2 - thienyl) - 1 - butene)

DIFENOXIN (1 - (3 - cyano - 3, 3 - diphenylpropyl) - 4 - phenylisonipecotic acid)

DIHYDROMORPHINE

DIMENOXADOL (2 - dimethylaminoethyl - 1 - ethoxy - 1, 1 - diphenylacetate)

DIMEPHEPTANOL (6 - dimethylamino - 4, 4 - diphenyl - 3- heptanol)

DIMETHYLTHIAMBUTENE (3 - dimethylamino - 1, 1 - di - (2 - thienyl) - 1 - butene)

DIOXAPHETYL BYTYRATE (ethyl - e - morpholino - 2, 2 - diphenylbutyrate)

DIPHENOXYLATE (1 - (3 - cyano - 3, 3 - diphenylpropyl) - 4 - phenylpiperidine - 4 - carboxylic acid ethyl ester)

DIPIPANONE (4, 4 - diphenyl - 6 - piperidine - 3 - heptanone)

DROTEBANOL (3, 4 - dimethoxy - 17 - methylmorphinan - 6 B, 14 - diol)

ECGONINE, esters and derivatet e tij që janë të konvertueshme në ecgonine dhe kokaine

ETHYLMETHYLTHIAMBUTENE (3 - ethylmethylamino - 1, 1 - di - (2 - thienyl) - 1 - butene)

ETONITAZENE (1 - diethylaminoethyl - 2 - para - ethoxybenzyl - 5 - nitrobenzimidazole)

ETORPHINE (tetrahydro - 7 a - (1 - hydroxy - 1 - methylbutyl) - 6, 14 - endoetheno - cripavine)

ETOXERIDINE (1 - [2 - (2 - hydroxyethoxy) - ethyl] - 4 - phenylpiperidine - 4 - carboxylic acid ethyl ester)

FENTANYL (1 - phenethyl - 4 - N - propionylanilinopiperidine)

FURETHIDINE (1 - (2 - tetrahydrofurfuryloxyethyl) - 4 - phenylpiperidine - 4 - carboxylic adic ethyl ester)

HEROIN (diacetylmorphine)

HYDROCODONE (dihydrocodeinone)

HYDROMORPHINOL (14 - hydroxydihydromorphine)

HYDROMORPHONE (dihydromorphinone)

HYDROXYPETHIDINE (4 - meta - hydroxyphenyl - 1 - methylpiperidine - 4 - carboxylic acid ethyl ester)

ISOMETHADONE (6 - dimethylamino - 5 - methyl - 4, 4 - diphenyl - 3 - hexanone)

KETOBEMIDONE (4 - meta - hydroxyphenyl - 1 - methyl - 4 - propionylpiperidine)

LEVOMETHORPHAN * ((-) - 3 - methoxy - N - methylmorphinan)

** Dextromerthorphan ((+) - 3 - methoxy - N - methylmorphinan) dhe dextrorphan ((+) - 3 - hydroxy - N - methyl - morphinan) janë përjashtuar në mënyrë të veçantë nga kjo listë.*

LEVOMORAMIDE ((-) - 4 - [2 - methyl - 4 - oxo - 3, 3 - diphenyl - 4 - (1 - pyrrolidinyl) butyl] morpholine)

LEVOPHENACYLMORPHAN ((-) - 3 - hydroxy - N - phenacylmorphinan)

LEVORPHANOL * ((-) - 3 - hydroxy - N - methylmorphinan)

METAZOCINE (2 - hydroxy - 2, 5, 9, - trimethyl - 6, 7 - benzomorphan)

METHADONE (6 - dimethylamino - 4, 4 - diphenyl - 3 - heptanone)

METHADONE INTERMEDIATE (4 - cyano - 2 - dimethylamino - 4, 4 - diphenylbutane)

METHYLDESORPHINE (6 - methyl - delta - 6 - deoxymorphine)

METHYLDIHYDROMORPHINE (6 - methyldihydromorphine)

3 - METHYLFENTANYL (N - (3 - methyl - 1 - phenethyl - 4 - piperidyl) propionanilide); cis - N - [3 - methyl - 1 - (2 - phenylethyl) - 4 - piperidyl] propionanilide); (trans - N - [3 - methyl - 1 - (2 - phenylethyl) - 4 - piperidyl] propionanilide)

3 - METHYLTHIOFENTANYL (N - [3 - methyl - 1 - [2 - (2 - thienyl) ethyl] - 4 - piperidyl] propionanilide)

METOPON (5 - methyldihydromorphinone)

MORAMIDE INTERMEDIATE (2 - methyl - 3 - morpholino - 1, 1 - diphenylpropane carboxylic acid)

MORPHERIDINE (1 - (2 - morpholinoethyl) - 4 - phenylpiperidine - 4 - carboxylic acid ethyl ester)

MORPHINE
MORPHINE METHOBROMIDE dhe derivate të tjera pesëvalentësh të nitrogen morphine
MORPHINE - N - OXIDE
MPPP (1 - methyl - 4 - phenyl - 4 - piperidinol propionate (este))
MYROPHINE (myristylbenzylmorphine)
NICOMORPHINE (3, 6 - dinicotinylmorphine)
NORACYMETHADOL ((±) - alpha - 3 - acetoxy - 6 - methylamino - 4, 4 - diphenylheptane)
NORLEVORPHANOL ((-) - 3 - hydroxymorphinan)
NORMETHADONE (6 - dimethylamino - 4, 4 - diphenyl - 3 - hexanone)
NORMORPHINE (demethylmorphine)
NORPIPANONE (4, 4 - diphenyl - 6 - piperidino - 3 - hexanone)
OPIUM
OXYCODONE (14 - hydroxydihydrocodeinone)
OXYMORPHONE (14 - hydroxydihydromorphinone)
PARA - FLUOROFENTANYL (4 - fluoro - N - (1 - phenethyl - 4 - piperidyl) propionanilide)
PEPAP (1 - phenethyl - 4 - phenyl - 4 - piperidionol acetate (ester))
PETHIDINE (1 - methyl - 4 - phenylpiperidine - 4 - carboxylic acid ethyl ester)
PETHIDINE INTERMEDIATE A (4 - cyano - 1 - methyl - 4 - phenylpiperidine)
PETHIDINE INTERMEDIATE B (4 - phenylpiperidine - 4 - carboxylic acid ethyl ester)
PETHIDINE INTERMEDIATE C (1 - methyl - 4 - phenylpiperidine - 4 - carboxylic acid)
PHENADOXONE (6 - morpholino - 4, 4 - diphenyl - 3 - heptanone)

* Dextromerthorphan ((+) - 3 - methoxy - N - methylmorphinan) dhe destrorphan ((+) - 3 - hydroxy - N - methyl - morphinan) janë përjashtuar në mënyrë të veçantë nga kjo listë.

PHENAMPROMIDE (N - (1 - methyl - 2 - piperidinoethyl) propionanilide)
PHENAZOCINE (2 - hydroxy - 5, 9 - dimethyl - 2 - phenethyl - 6, 7 - benzomorphan)
PHENOMORPHAN (3 - hydroxy - N - phenethylmorphinan)
PHENOPERIDINE (1 - (3 - hydroxy - 3 - phenylpropyl) - 4 - phenylpiperidine - 4 - carboxylic acid ethyl ester)
PIMINODINE (4 - phenyl - 1 - (3 - phenylaminopropyl) piperidine - 4 - carboxylic acid ethyl ester)
PIRITRAMIDE (1 - (3 - cyano - 3, 3 - diphenylpropyl) - 4 - (1 - piperidino) piperidine - 4 - carboxylic acid amide)
PROHEPTAZINE (1, 3 - dimethyl - 4 - phenyl - 4 - propionoxyazacydoheptane)
PROPERIDINE (1 - methyl - 4 - phenylpiperidine - 4 - carboxylic acid isopropyl ester)
RACEMETHORPHAN ((±) - 3 - methoxy - N - methylmorphinan)
RACEMORAMIDE ((±) - 4 - [2 - methyl - 4 - oxo - 3, 3 - diphenyl - 4 - (1 - pyrrolidinyl) butyl] morpholine)
RACEMORPHAN ((±) - 3 - hydroxy - N - methylmorphinan)
SUFENTANIL (N - [4 - (methoxymethyl) - 1 - [2 - (2 - thienyl) ethyl] - 4 - piperidyl] propionanilide)
THEBACON (acetyldihydrocodeinone)
THEBAINE
THIOFENTANYL (N - [1 - [2 - (2 - thienyl) ethyl] - 4 - piperidyl] propionanilide)
TILIDINE ((±) - ethyl trans - 2 (dimethylamino) - 1 - phenyl - 3 - cydohexene - 1 - carboxylate)
TRIMEPERIDINE (1, 2, 5 - trimethyl - 4 - phenyl - 4 - propionoxypiperidine); dhe

Izomeret, në qoftë se nuk janë përjashtuar në mënyrë të veçantë, e drogave në këtë Listë kurdoherë që ekzistenca e këtyre izomereve është e mundur brenda emërimit specifik kimik;

Esteret dhe eteret, në qoftë se nuk përfshihen në një Listë tjetër, të drogave në këtë Listë kurdoherë që ekzistenca e këtyre estereve është e mundur;

Kriprat e drogave të renditura në këtë Listë, duke përfshirë kriprat e estereve, etereve dhe izomereve siç parashikohet më sipër kurdoherë që ekzistenca e këtyre kriprave është e mundur.

LISTA E DROGAVE TË PËRFSHIRA NË LISTËN II

ACETYLDIHYDROCODEINE
CODEINE (3 - methylmorphine)
DEXTROPROPOXYPHENE (a - (+) - 4 - dimethylamino - 1, 2 - diphenyl - 3 - methyl - 2 - butanol propionate)
DIHYDROCODEINE
ETHYLMORPHINE (3 - ethylmorphine)
NICOCODINE (6 - nicotinylcodeine)
NICODICODINE (6 - nicotinyldihydrocodeine)
NORCODEINE (N - demethylcodeine)
PHOLCODINE (morpholinylethylmorphine)
PROPIRAM (N - (1 - methyl - 2 - piperidinoethyl) - N - 2 - pyridylpropionamide); dhe

Izomeret, në qoftë se nuk përjashtohen në mënyrë të veçantë, të drogave në këtë Listë kurdoherë që ekzistenca e këtyre izomereve është e mundur brenda emërimit specifik kimik;

Kriprat e drogave të renditura në këtë Listë, duke përfshirë kriprat e izomereve siç parashikohet më sipër, kurdoherë që ekzistenca e këtyre kriprave është e mundur.

LISTA E PREPARATEVE TË PËRFSHIRA NË LISTËN III

1. Preparatet e:
   Acetyldihydrocodeine,
   Codeine,
   Dihydrocodeine,
   Ethylmorphine,
   Nicocodine,
   Nicodicodine,
   Norcodeine, dhe
   Pholcodine

kur bashkohen me një ose më shumë përbërës të tjerë dhe përmbajnë jo më shumë se 100 miligram droge për njësi dozimi dhe me një përqendrim jo më shumë se 2.5 % në preparate të pandara.

2. Preparatet e propiam-it që përmbajnë jo më shumë se 100 miligram propiram për njësi dozimi dhe përziehen me të paktën të njëjtën sasi methylcellulose.

3. Preparatet e dextropropoxyphene për përdorim gojor që përmbajnë jo më shumë se 135 miligram bazë dextropropoxyphene për njësi dozimi ose me një përqendrim jo më të madh se 2.5 % në preparate të pandara, me kusht që këto preparate të mos përmbajnë ndonjë lëndë që i nënshtrohet kontrollit në bazë të Konventës së vitit 1971 të Lëndëve Psikotrope.

4. Preparatet e kokainës që përmbajnë jo më shumë se 0.1% kokainë, e llogaritur si bazë kokaine dhe preparatet e opiumit ose morfinës që përmbajnë jo më shumë se 0.2% morfinë të llogaritur si bazë morfine anhidrike dhe të përziera me një ose më shumë përbërës të tjerë dhe në mënyrë të tillë që droga të mos përftohet me mjete që zbatohen lehtësisht ose në një prodhim që do të përbënte rrezik për shëndetin publik.

5. Preparatet e difenoxi-ës që përmbajnë, për njësi dozimi, jo më shumë se 0.5 miligram difenoxin dhe një sasi sulfati atropin ekuivalent me të paktën 5% të tedozës së difenoxin-ës.

6. Preparatet e diphenoxylate që përmbajnë, për njësi dozimi, jo më shumë se 2.5 miligram diphenoxylate i llogaritur si bazë dhe një sasi sulfati atropin ekuivalent me të paktën 1% të dozës së diphenoxylate.

7. Pulvis ipecacuanhae et opil compositus

10 % opium pluhur,

10 % rrënjë Ipecacuanham, pluhur i përzier mirë me

80 % të çfarëdo përbërësi tjetër pluhur që nuk përmban drogë.

8. Preparatet që janë konform me një nga formulat e renditura në këtë Listë dhe përzierjet e këtyre preparateve me çfarëdo materiali që nuk përmban drogë.

LISTA E DROGAVE TË PËRFSHIRA NË LISTËN IV

ACETORPHINE (3 - 0 - acetyltetrahydro - 7 a - (1 - hydroxy - 1 - methylbutyl) - 6, 14 - endeoetheno - oripavine)

ACETYL - ALPHA - METHYLFENTANYL (N - [1 - (a - methylphenethyl) - 4 - piperidyl] acetanilide)

ALPHA - METHYLFENTANYL (N - [1 - (a - methylphenthyl) - 4 - piperidyl] propionanilide)

ALPHA - METHYLTHIOFENTANYL (N - (1 - [1 - methyl - 2 - (2 - thienyl) ethyl] - 4 - piperidyl] propionanilide)

BETA - HYDROXYFENTANYL (N - [1 - (B - hydroxyphenethyl) - 4 - piperidyl] propionanilide)

BETA - HYDROXY - 3 - METHYLFENTANYL (N - [1 - (B - hydroxyphenethyl) - 3 - methyl - 4 - piperidyl] propionanilide)

CANNABIS dhe RRËSHIRË KANABIS

DESOMORPHINE (dihydrodeoxymorphine)

ETORPHINE (tetrahydro - 7 a - (1 - hydroxy - 1 - methylbutyl) - 6, 14 - endeoetheno - oripavine)

HEROIN (diacetylmorphine)

KETOBEMIDONE (4 - meta - hydroxyphenyl - 1 - methyl - 4 - propionylpiperidine)

3 - METHYLFENTANYL (N - (3 - methyl - 1 - phenethyl - 4 - piperidyl) propionanilide); (cis - N - [3 - methyl - 1 - (2 - phenylethyl) - 4 - piperidyl] propionanilide); (trans - N - [3 - methyl - 1 - (2 - phenylethyl) - 4 - piperidyl] propionanilide)

3 - METHYLTHIOFENTANYL (N - [3 - methyl - 1 - [2 - (2 - thienylethyl] - 4 - piperidyl] propionanilide)

MPPP (1 - methyl - 4 - phenyl - 4 - piperidinol propionate (ester))

PARA - FLUOROFENTANYL (4 - fluoro - N - (1 - phenethyl - 4 - piperidyl) propionanilide)

PEPAP (1 - phenethyl - 4 - phenyl - 4 - piperidinol acetate (ester))

THIOFENTANYL (N - [1 - [2 - (2 - thienyl) ethyl] - 4 - piperidyl] propionanilide); dhe

Kriprat e drogave të renditura në këtë Listë kurdoherë që formimi i këtyre kriprave është i mundur.

LIGJ
Nr.8724, datë 26.12.2000

PËR RATIFIKIMIN E "KONVENTËS EUROPIANE PËR MBIKËQYRJEN E PERSONAVE TË DËNUAR OSE TË LIRUAR ME KUSHT"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Konventa Europiane për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2859, datë 5.1.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.50, faqe 2234

KONVENTA
EUROPIANE PËR MBIKËQYRJEN E PERSONAVE TË DËNUAR OSE TË LIRUAR ME KUSHT
Strasburg, më 30.11.1964

Seria e traktateve europiane nr.51

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës nënshkrues të kësaj Konvente,

Duke konsideruar se qëllimi i Këshillit të Europës është realizimi i një bashkimi më të ngushtë midis anëtarëve të tij;

Duke afirmuar vullnetin e tij për të bashkëpunuar në luftën kundër kriminalitetit;

Duke konsideruar se për këtë qëllim atyre u përket, që për çdo vendim që është marrë në njërin prej tyre, të përmbushin në territorin e të tjerëve, nga njëra anë rehabilitimin shoqëror të keqbërësve të dënuar ose të liruar me kusht dhe, nga ana tjetër, vënien në ekzekutim të sanksionit në rastin kur kushtet e parashikuara nuk janë përmbushur,

Kanë rënë dakord përsa vijon:

TITULLI I
PARIME THEMELORE

Neni 1

1. Palët kontraktuese angazhohen të japin, konform dispozitave të mëposhtme, ndihmën e ndërsjellë për rehabilitimin shoqëror të keqbërësve të parashikuar nga neni 2. Kjo ndihmë përbëhet

nga mbikëqyrja e keqbërsve që realizohet, nga njëra anë, me masat e përshtatshme për të lehtësuar përmirësimin dhe ripërshtatjen e tyre në jetën shoqërore dhe, nga ana tjetër, me kontrollin e sjelljes së tyre për të dhënë mundësi, kur është e nevojshme, që ose të shpallet sanksioni ose të vihet ai në ekzekutim.

2. Palët kontraktuese do të vënë në ekzekutim, konform dispozitave të mëposhtme, dënimin ose masën e sigurimit me heqje të lirisë, të dhënë ndaj keqbërësit dhe për të cilin zbatimi është pezulluar.

Neni 2

1. Në vështrim të kësaj Konvente, shprehja "keqbërës" do të thotë çdo person që, në territorin e Palëve kontraktuese, është bërë objekt:

a) i një vendimi gjyqësor fajësie, i shoqëruar me pezullimin me kusht të vendimit të dënimit;

b) i një dënimi që ka sjellë heqjen e lirisë, dhënë me kusht ose ekzekutimi i të cilit është pezulluar me kusht, pjesërisht ose tërësisht, ose në çastin e dënimit ose më pas.

2. Në nenet e mëposhtme, termi "dënim" ka të bëjë me vendimet e marra, si në bazë të pikës a ashtu edhe të pikës b të paragrafit 1 të mësipërm.

Neni 3

Vendimet e parashikuara nga neni 2 duhet të jenë përfundimtare dhe të ekzekutueshme.

Neni 4

Vepra penale që motivon kërkesën e parashikuar nga neni 5 duhet të jetë e dënueshme nga ligji i Shtetit kërkues dhe ai i Shtetit të kërkuar.

Neni 5

Shteti që ka dhënë dënimin mund t'i kërkojë Shtetit, në territorin e të cilit keqbërësi ka caktuar vendbanimin e zakonshëm të tij:

të realizojë vetëm mbikëqyrjen konform titullit II;

b) të realizojë mbikëqyrjen dhe, kur është e nevojshme, të bëjë ekzekutimin konform titujve II e III;

c) të realizojë zbatimin e plotë të dënimit konform dispozitave të titullit IV.

2. Shteti i kërkuar është i detyruar, në kushtet e parashikuara nga kjo Konventë, t'i japë rrugë një kërkese të tillë.

3. Kur Shteti kërkues ka formuluar një kërkesë të parashikuar nga paragrafi 1 i mësipërm dhe kur Shteti i kërkuar çmon, në çdo rast të veçantë, të parapëlqyeshme të përdorë njërën nga mundësitë e parashikuara në këtë paragraf, Shteti i kërkuar mund të refuzojë t'i japë rrugë kësaj kërkese, por gjithnjë duke u deklaruar e gatshme për t'i dhënë rrugë një kërkese tjetër që ai do të caktojë.

Neni 6

Me kërkesë të Shtetit që ka dhënë dënimin, mbikëqyrja, ekzekutimi ose zbatimi i plotë, të përcaktuara nga neni i mëparshëm, përmbushen nga Shteti në territorin e të cilit keqbërësi ka caktuar vendbanimin e zakonshëm të tij.

Neni 7

Mbikëqyrja, ekzekutimi ose zbatimi i plotë refuzohen:

a) kur ata konsiderohen nga Shteti i kërkuar se janë me natyrë të tillë që prekin sovranitetin e tij, sigurinë, parimet themelore të rendit të tij juridik ose interesa të tjerë thelbësorë;

b) kur dënimi që motivon kërkesën e parashikuar nga neni 5 bazohet në fakte që janë gjykuar përfundimisht në Shtetin e kërkuar;

c) kur Shteti i kërkuar i konsideron faktet që motivojnë dënimin ose si vepër penale politike ose si vepër penale e lidhur me një vepër të tillë politike, ose si vepër penale thjesht ushtarake;

d) kur parashkrimi i sanksionit është përmbushur sipas ligjit të Shtetit kërkues ose sipas atij të Shtetit të kërkuar;

e) kur autori i veprës penale përfiton nga një amnisti ose masë e faljes në Shtetin kërkues ose në Shtetin e kërkuar.

2. Mbikëqyrja, ekzekutimi ose zbatimit i plotë mund të refuzohen:

a) kur autoritetet kompetente të Shtetit të kërkuar kanë vendosur të mos fillojnë ndjekjen penale ose të pushojnë ndjekjen penale që ata kanë ushtruar për të njëjtat fakte;

b) kur faktet, që motivojnë dënimin, përbëjnë objekt për ndjekje penale në Shtetin e kërkuar;

c) kur dënimi, që motivon kërkesën, është dhënë në mungesë;

d) kur Shteti i kërkuar çmon se dënimi për të cilin ai është vënë në lëvizje është i papajtueshëm me parimet udhëheqëse të zbatimit të së drejtës penale të saj, veçanërisht kur, për shkak të moshës së tij, autori i veprës penale nuk do të ishte dënuar në Shtetin e kërkuar.

3. Në fushën e veprave penale fiskale, mbikëqyrja ose ekzekutimi bëhen në kushtet e parashikuara nga kjo Konventë vetëm nëse kështu është vendosur midis Palëve kontraktuese për çdo vepër penale ose kategori veprash penale.

Neni 8

Shteti kërkues dhe Shteti i kërkuar informojnë, kur është e nevojshme, reciprokisht njëri-tjetrin për çdo rrethanë që ka të bëjë me përmbushjen e masave të mbikëqyrjes në territorin e Shtetit të kërkuar ose vënien në ekzekutim të dënimit në këtë Shtet.

Neni 9

Shteti i kërkuar njofton pa vonesë Shtetin kërkues për dhënien rrugë të kërkesës.

TITULLI II
MBIKËQYRJA

Neni 10

Shteti kërkues i bën të njohur Shtetit të kërkuar kushtet që i janë caktuar keqbërësit dhe, kur është rasti, masat e mbikëqyrjes, të cilave ky është i detyruar t'u nënshtrohet gjatë periudhës së provës.

Neni 11

1. Shteti i kërkuar përmbush kërkesën e Shtetit kërkues dhe, kur është e nevojshme, ai përshtat sipas legjislacionit të vet masat e parashkruara të mbikëqyrjes.

2. Masat e mbikëqyrjes që zbatohen nga Shteti i kërkuar nuk mund, në asnjë rast, të rëndohen nga natyra ose kohëzgjatja e tyre nga ç'ka parashikuar Shteti kërkues.

Neni 12

Kur Shteti i kërkuar pranon të realizojë mbikëqyrjen, ai përmbush detyrat e mëposhtme:

1. njofton pa vonesë Shtetin kërkues për pritjen që ai i bën kërkesës së tij;

2. realizon bashkëpunimin e autoriteteve ose organizmave që janë ngarkuar, në territorin e tij, të mbikëqyrin dhe t'i qëndrojnë pranë keqbërësit;

3. informon Shtetin kërkues për të gjitha masat e marra dhe për zbatimin e tyre.

Neni 13

Në rastin kur i interesuari është vënë para revokimit të vendimit të pezullimit me kusht të parashikuar nga neni 2, ose për shkak të një ndjekjeje penale ose dënimi për një vepër tjetër penale, ose për shkak të shmangies nga detyrimet që i janë vënë, Shteti i kërkuar i dërgon kryesisht të dhënat e nevojshme Shtetit kërkues.

Neni 14

Me përfundimin e periudhës së mbikëqyrjes, me kërkesë të Shtetit kërkues, Shteti i kërkuar i jep këtij të fundit të gjitha të dhënat e nevojshme.

Neni 15

Vetëm Shteti kërkues ka kompetencë të çmojë, mbi bazën e të dhënave dhe mendimit të dhënë nga Shteti i kërkuar, nëse keqbërësi i ka përmbushur ose jo kushtet që i ishin vënë dhe, mbi bazën e këtyre konstatimeve, të kryejë çdo hap tjetër të mëtejshëm në bazë të legjislacionit të saj.

Ai informon Shtetin e kërkuar për vendimin që merr.

Titulli III – Mbi ekzekutimin e dënimeve

Neni 16

Pas revokimit të vendimit të pezullimit me kusht nga Shteti kërkues dhe me kërkesë të këtij Shteti, Shteti i kërkuar ka kompetencë të ekzekutojë dënimin.

Neni 17

Ekzekutimi bëhet në përputhje me ligjin e Shtetin të kërkuar, pas verifikimit të autencitetit të kërkesës për ekzekutim dhe konformitetit të saj me kushtet e fiksuara nga kjo Konventë.

Neni 18

Shteti i kërkuar i dërgon në kohën e duhur Shtetit kërkues një dokument që vërteton ekzekutimin e dënimit.

Neni 19

Shteti i kërkuar e zëvendëson, kur kjo është me vend, sanksionin e dhënë në Shtetin kërkues, me dënimin ose masën e parashikuar nga ligji i vet për një vepër penale analoge. Ky dënim ose masë i korrespondon, me aq sa është e mundur dhe në natyrën e tij, atij të dhënë nga vendimi i ekzekutimit. Ai nuk mund as të kapërcejë maksimumin e parashikuar nga ligji i Shtetit të kërkuar dhe as të rëndojë nga natyra ose kohëzgjatja sanksionin e dhënë në Shtetin kërkues.

Neni 20

Shteti kërkues nuk mundet më të marrë asnjë masë për ekzekutimin e kërkuar, veç kur Shteti i kërkuar e ka njoftuar atë për refuzim ose pamundësi ekzekutimi.

Neni 21

Shteti i kërkuar është kompetent në çështje të lirimit me kusht. E drejta e faljes mund të ushtrohet nga Shteti kërkues dhe nga Shteti i kërkuar.

Titulli IV – Heqja dorë në favor të Shtetit të kërkuar

Neni 22

Shteti kërkues do t'i bëjë të njohur Shtetit të kërkuar dënimin për të cilin ai kërkon zbatimin e plotë.

Neni 23

1. Shteti i kërkuar përshtat dënimin ose masën e dhënë me legjislacionin e vet penal ashtu sikur ai të ishte dhënë për të njëjtën vepër penale të kryer në territorin e vet.

2. Sanksioni i dhënë në Shtetin e kërkuar nuk mund të rëndojë sanksionin e dhënë në Shtetin kërkues.

Neni 24

Shteti i kërkuar siguron zbatimin e plotë të dënimit të përshtatur ashtu si do të veprohej për një dënim të dhënë nga juridiksionet e tij.

Neni 25

Pranimi nga Shteti i kërkuar i një kërkese të formuluar konform këtij titulli pushon të drejtën për ekzekutimin e dënimit në Shtetin kërkues.

Titulli V. Dispozita të përbashkëta

Neni 26

1. Çdo kërkesë e parashikuar nga neni 5 formulohet me shkrim.

Ajo përmban:

a) autoritetin që e ka nxjerrë;

objektin e saj;

c) identitetin e keqbërësit dhe vendbanimin e tij në Shtetin e kërkuar.

2. Kërkesa për mbikëqyrje shoqërohet me origjinalin ose me kopjen autentike të vendimit që përmban arsyet që kanë motivuar mbikëqyrjen dhe që specifikon masat që i vihen keqbërësit. Ajo saktëson, me aq sa është e mundur, rrethanat e veprës penale që ka motivuar vendimin e mbikëqyrjes, kohën dhe vendin e kryerjes, cilësimin ligjor të saj, dhe kur kjo është e nevojshme, kohëzgjatjen e sanksionit për ekzekutimin. Ajo jep të gjitha të dhënat për natyrën dhe kohëzgjatjen e masave të mbikëqyrjes që kërkohen për t'u ekzekutuar. Ajo përmban referenca në dispozitat ligjore të zbatueshme dhe të dhënat e nevojshme mbi personalitetn e keqbërësit dhe mbi sjelljen e tij në Shtetin kërkues para dhe pas dhënies së vendimit për mbikëqyrje.

Kërkesa për ekzekutim shoqërohet me origjinalin ose me një kopje autentike të vendimit që ka konstatuar revokimin e kushtit pezullues të dënimit ose të ekzekutimit të tij, si dhe vendimin e dënimit. Karakteri i ekzekutueshëm i këtyre dy vendimeve vërtetohet në format e parashikuara nga ligji i Shtetit që i ka dhënë.

Kur vendimi për t'u ekzekutuar zëvendëson një tjetër të mëparshëm pa bërë një paraqitje të fakteve, do t'i bashkëngjitet një kopje autentike e vendimit që përmban këtë paraqitje.

4. Kërkesa që ka për objekt zbatimin e plotë të dënimit shoqërohet me dokumentet e parashikuara në paragrafin 2 të mësipërm.

Neni 27

1. Kërkesa dërgohet nga Ministria e Drejtësisë e Shtetit kërkues drejtuar Ministrisë së Drejtësisë të Shtetit të kërkuar. Përgjigjja transmetohet sipas të njëjtës rrugë.

2. Komunikimet e nevojshme për zbatimin e kësaj Konvente shkëmbehen ose sipas rrugëve të treguara në paragrafin 1 të këtij neni ose drejtpërdrejt midis autoriteteve të Palëve kontraktuese.

3. Në raste urgjente, komunikimet e parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni mund të transmetohen nëpërmjet Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (Interpol).

4. Çdo Palë kontraktuese mundet, me deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të bëjë të njohur se ajo dëshiron t'u përmbahet rregullave të reja të ndryshme nga ato të formuluara në paragrafët 1 e 2 të këtij neni.

Neni 28

Kur Shteti i kërkuar çmon se të dhënat e paraqitura nga Shteti kërkues janë të pamjaftueshme për t'i dhënë atij mundësi të zbatojë këto Konventë, ai kërkon plotësimin e të dhënave. Ai mund të caktojë një afat për marrjen e këtyre informacioneve.

Neni 29

1. Me rezervën e dispozitave të paragrafit 2 të këtij neni, nuk do të kërkohet përkthimi i kërkesave dhe shkresave që i bashkëngjiten, si dhe i të gjitha dokumenteve të tjera lidhur me zbatimin e kësaj Konvente.

2. Çdo Palë kontraktuese mundet, në çastin e nënshkrimit ose depozitimit të instrumenteve të rafitikimit, të pranimit ose aderimit, me deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të rezervojë të drejtën të kërkojë që kërkesat dhe shkresat që u bashkëngjiten të shoqërohen me përkthim, ose në gjuhën e vet ose në njërën nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Europës ose në njërën nga këto gjuhë që ajo do të caktojë. Palët e tjera kontraktuese mund të kërkojnë të zbatojnë reciprocitetin.

3. Ky nen nuk prek dispozitat lidhur me përkthimin e kërkesave dhe shkresave që u bashkëngjiten, që përmbahen në marrëveshjet ose traktatet që janë në fuqi që mund të përfundohen midis dy ose disa Palësh kontraktuese.

Neni 30

Për shkresat dhe dokumentet e transmetuara në zbatim të kësaj Konvente nuk do të kërkohet asnjë formalitet legalizimi.

Neni 31

Shteti i kërkuar ka kompetencë, me kërkesë të Shtetit kërkues, të marrë shpenzimet për ndjekjen penale dhe gjykimin, të kryera në këtë Shtet. Kur ai vepron për marrjen e këtyre shpenzimeve, ai është i detyruar t'i rikthejë Shtetit kërkues vetëm honoraret për ekspertët që ai ka marrë.

Neni 32

Shpenzimet për mbikëqyrje dhe ekzekutim të bëra në Shtetin e kërkuar nuk kthehen.

TITULLI VI
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 33

Kjo Konventë nuk cenon dispozitat që rregullojnë policinë e të huajve.

Neni 34

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim nga Shtetet anëtare të Këshillit të Europës. Ajo do të ratifikohet ose do të pranohet. Instrumentet e ratifikimit ose të pranimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së të tretit depozitim të instrumenteve të ratifikimit ose të pranimit.

3. Për çdo Shtet nënshkrues që do të shprehë më pas pëlqimin e vet për ta ratifikuar ose pranuar, kjo do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të instrumenteve të ratifikimit ose të pranimit.

Neni 35

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës mund të ftojë çdo Shtet joanëtar i Këshillit të Europës për të aderuar në këtë Konventë.

2. Aderimi bëhet me anë të depozitimit të instrumenteve të aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës që do të fillojë efektet tre muaj pas datës së depozitimit.

Neni 36

1. Çdo Shtet kontraktues mundet, në çastin e nënshkrimit ose në çastin e depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, pranimit ose aderimit të caktojë territorin ose territoret ku do të zbatohet kjo Konventë.

2. Çdo Shtet kontraktues mundet, në çastin e depozitimit të ratifikimit, të pranimit ose të aderimit ose në çdo çast tjetër më pas, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës të shtrijë zbatimin e kësaj Konvente në çdo territor tjetër të caktuar në deklaratë, ku ai është i ngarkuar të mbulojë marrëdhëniet ndërkombëtare.

3. Çdo deklaratë e bërë në bazë të dy paragrafëve të mëparshëm mund të tërhiqet, përsa i takon çdo territori të caktuar në deklaratë sipas kushteve të parashikuara nga neni 39 i kësaj Konvente.

Neni 37

1. Kjo Konventë nuk prek detyrimet që përmbahen në dispozitat e çdo Konvente tjetër ndërkombëtare me karakter dypalësh ose shumëpalësh, që rregullon ose do të rregullojë, midis dy ose disa Palëve kontraktuese, ekstradimin ose forma të ndihmës gjyqësore në fushën penale.

2. Palët në Konventë mund të përfundojnë midis tyre marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe, lidhur me çështjet e rregulluara nga kjo Konventë, vetëm me qëllim të plotësimit të dispozitave të kësaj Konvente ose për të lehtësuar zbatimin e parimeve që ajo mishëron.

3. Megjithatë, kur dy ose disa Palë kanë vendosur ose sapo kanë vendosur marrëdhënie mbi bazën e një legjislacioni uniform ose të një regjimi të posaçëm, ato do të kenë të drejtë të rregullojnë marrëdhëniet e ndërsjella në këtë fushë duke u mbështetur plotësisht në këto sisteme që nuk bien ndesh me këtë Konventë.

Palët kontraktuese që do të përjashtojnë nga marrëdhëniet e tyre të ndërsjella zbatimin e kësaj Konvente, konform dispozitave të këtij paragrafi, do t'i drejtojnë për këtë qëllim një njoftim Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 38

1. Çdo Palë kontraktuese mundet, në çastin e nënshkrimit ose në çastin e depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, pranimit ose aderimit, të deklarojë se do të bëjë një ose disa rezerva që figurojnë në aneksin e kësaj Konvente.

2. Çdo Palë kontraktuese që ka formuluar një rezervë në bazë të paragrafit të mëparshëm mund ta tërheqë atë tërësisht ose pjesërisht, duke i drejtuar një deklaratë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës dhe që do të fillojë efektet në datën e marrjes së saj.

3. Pala kontraktuese që ka formuluar një rezervë lidhur me një dispozitë të kësaj Konvente nuk mund të pretendojë për zbatimin e kësaj dispozite nga një Palë tjetër; megjithatë, ajo mundet, nëse rezerva është e pjesshme ose me kusht, të pretendojë për zbatimin e kësaj dispozite në atë masë që ajo vetë e ka pranuar atë.

4. Çdo Palë kontraktuese mundet, në çastin e nënshkrimit të kësaj Konvente ose të depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, të pranimit ose të aderimit, me njoftim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të bëjë të ditur se ajo konsideron ratifikimin, pranimin ose aderimin të tillë që pas sjell detyrimin, konform të drejtës ndërkombëtare, të përfshijë në rendin e brendshëm dispozitat e nevojshme për zbatimin e kësaj Konvente.

Neni 39

Kjo Konventë do të mbetet në fuqi pa kufizim në kohë.

2. Çdo Palë kontraktuese mundet, përsa i takon, të denoncojë këtë Konventë duke i drejtuar një njoftim Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

3. Denoncimi do të fillojë efektet gjashtë muajsh pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 40

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të njoftojë Shtetet anëtare të Këshillit dhe çdo Shtet që ka aderuar në këtë Konventë për:

a) çdo nënshkrim;

b) depozitimin e instrumenteve të ratifikimit, pranimit ose aderimit;

c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente konform nenit 34 të saj;

d) çdo njoftim ose deklaratë të marrë në zbatim të paragrafit 4 të nenit 27 të paragrafit 2 të nenit 29, të paragrafit 3 të nenit 37 dhe të paragrafit 4 të të nenit 38;

e) çdo deklaratë të marrë në zbatim të dispozitave të paragrafëve 2 e 3 të nenit 36;

f) çdo rezervë të formuluar në zbatim të paragrafit 1 të nenit 38;

g) tërheqja e çdo rezerve të bërë në zbatim të paragrafit 2 të nenit 38;

h) çdo njoftim të marrë në zbatim të dispozitave të nenit 39 dhe datën e hyrjes kur denoncimi do të fillojë efektet.

Me këtë mirëbesim, nënshkruesit, të autorizuar rregullisht për këtë qëllim, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Strasburg, më 30 nëntor 1964, në frëngjisht dhe anglisht, të dy tekstet janë njëlloj të besueshëm, në një ekzemplar të vetëm që do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'u komunikojë nga një kopje të vërtetuar konform secilit nga Shtetet nënshkruese dhe aderuese.

ANEKS

Secila nga Palët kontraktuese mund të deklarojë se ajo rezervon të drejtën të bëjë të njohur:

1. se ajo nuk pranon dispozitat e Konventës që trajton ekzekutimin e dënimeve ose zbatimin e plotë të tyre;

2. se ajo pranon vetëm disa nga këto dispozita;
3. se ajo nuk pranon dispozitat e paragrafit 2 të nenit 37.

LIGJ
Nr.8778, datë 26.4.2001

PËR RATIFIKIMIN E "KONVENTËS PENALE PËR KORRUPSIONIN"

(Ndryshuar me ligjin nr.9369, datë 14.4.2005)

I përditësuar

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Ratifikohet "Konventa penale për korrupsionin", bërë në Strasburg më 27.1.1999, me rezervat e parashikuara në këtë ligj.

Neni 2

(Ndryshuar me ligjin nr.9369, datë 14.4.2005)

Në mbështetje të nenit 37 të Konventës, Shteti Shqiptar shpreh këto rezerva:

1. Të rezervojë të drejtën e vet për të mos vendosur si vepra penale, sipas ligjit të tij kombëtar, pjesërisht ose tërësisht, sjellje të referuara në nenet 4, 6 deri në 8, 10 deri në 12 ose të veprave të korrupsionit pasiv, të përcaktuara në nenin 5 të Konventës (neni 37/1).

2. Të deklarojë përdorimin prej Shtetit Shqiptar të rezervës së parashikuar në nenin 17/2 të Konventës (37/2).

3. Të deklarojë se mund të refuzojë asistencën e ndërsjellë ligjore, sipas nenit 26/1 të Konventës, nëse kërkesa lidhet me një vepër penale që nga Shteti Shqiptar vlerësohet si vepër politike (neni 37/3).

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2999, datë 4.5.2001 të Presidentit të Republikës
Rexhep Meidani

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.24, faqe 742

KONVENTA PENALE PËR KORRUPSION

Strasburg, më 21.1.1999

Seria e traktateve europiane / 173

HYRJE

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe shtetet e tjera nënshkruese si vijon:

Duke marrë në konsideratë se qëllimi i Këshillit të Europës është të mbështesë një unitet të madh midis anëtarëve të tij;

Duke njohur vlerën e përkrahjes së bashkëpunimit me shtete të tjera nënshkruese të kësaj Konvente;

Të bindur në nevojën e ndjekjes, si një çështje e prioritetit të një politike penale të përbashkët, duke u mbështetur në mbrojtjen e shoqërisë nga korrupsioni, përfshirë përshtatjen e legjislacionit të përshtashëm dhe masave parandaluese;

Duke theksuar se korrupsioni dëmton shtetin ligjor, demokracinë dhe të drejtat e njeriut, ul nivelin e qeverisjes së mirë, transparencës dhe drejtësisë shoqërore, pengon konkurrencën, zhvillimin ekonomik dhe rrezikon qëndrueshmërinë e institucioneve demokratike dhe themeleve morale të shoqërisë;

Duke besuar se një luftë efektive ndaj korrupsionit kërkon bashkëpunim ndërkombëtar të gjerë, të shpejtë dhe mirëfunksionues në çështjet penale;

Duke mirëpritur zhvillimet më të fundit, të cilat avancojnë marrëveshjet dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit, përfshirë veprime të kombeve të Bashkuara, Bankës Botërore, Fondit Monetar Ndërkombëtar, Organizatën Botërore të Tregtisë, Organizatën e Shteteve Amerikane, Organizatën për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim dhe Bashkimin Europian;

Duke patur parasysh Programin e Veprimit kundër Korrupsionit, të miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës në nëntor 1996, sipas rekomandimeve të Konferencës së 19-të të Ministrave Europianë të Drejtësisë (Valeta, 1994);

Duke treguar rëndësinë e pjesëmarrjes së shteteve joanëtare në veprimtaritë e Këshillit të Europës kundër korrupsionit dhe duke mirëpritur kontributin e tyre të çmuar në zbatimin e Programit të Veprimit kundër Korrupsionit;

Duke treguar se Rezoluta nr.1, e miratuar nga Ministrat europianë të drejtësisë në konferencën e tyre të 21-të (Pragë, 1997), rekomandonte zbatimin e shpejtë të Programit të Veprimit kundër Korrupsionit dhe bënte thirrje, veçanërisht, për miratimin e shpejtë të konventës penale, duke parashikuar ndërshkimin e koordinuar të veprave të korrupsionit, përkrahur bashkëpunimin për procedimin e këtyre veprave, sikurse dhe një mekanizëm pasues efektiv, të hapur për shtetet anëtare dhe joanëtare mbi baza barazie;

Duke patur parasysh se krerët e shteteve dhe Qeverive të Këshillit të Europës vendosën, me rastin e samitit të tyre të dytë të mbajtur në Strasburg me 10 dhe 11 tetor 1997, të japin përgjigje të përbashkëta për ndryshimet e ndodhura nga rritja e korrupsionit dhe miratuan një plan veprimi, i cili me qëllim përkrahjen e bashkëpunimit në luftën kundër korrupsionit, përfshirë lidhjet e tij me krimin e organizuar dhe pastrimin e parave, instruktuan Komitetin e Ministrave, inter alia, të sigurojë plotësimin e shpejtë të instrumenteve ligjorë ndërkombëtarë, mbi bazën e Programit të Veprimit kundër Korrupsionit;

Duke konsideruar se rezoluta (97) 24 në 20 Parimet Drejtuese për luftën kundër korrupsionit, miratuar në 6 nëntor 1997 nga Komiteti i Ministrave në sesionin e tij të 101-të, nënvizoi nevojën e plotësimit të shpejtë të përpunimit të instrumenteve ligjore ndërkombëtarë, mbi bazën e Programit të Veprimit kundër Korrupsionit;

Në vështrimin e miratimit nga Komiteti i Ministrave në sesionin e tij të 102-të të datës 4 maj 1998, të rezolutës (98) 7 e cila autorizon marrëveshjen e pjesshme dhe të gjerë krijuese të "Grupit të shteteve kundër korrupsionit –CRECO", e cila ka për qëllim përmirësimin e kapacitetit të anëtarëve të saj, për të luftuar korrupsionin nëpërmjet kryerjes së përputhshmërisë me angazhimet e tyre në këtë fushë;

Kanë pranuar si vijon:

KREU I
PËRDORIMI I TERMAVE

Neni 1
Përdorimi i termave

Për qëllimet e kësaj Konvente:

a) "Zyrtar publik" do të kuptohet në referencë me përkufizimin e "zyrtar" "oficer publik", "kryebashkiak", "ministër", ose "gjyqtar", në ligjin kombëtar të shtetit në të cilin personi në fjalë ushtron funksion dhe sikurse zbatohet në ligjin e tij penal;

b) termi "gjyqtar" i referohet paragrafit të mësipërm "a" dhe përfshin prokurorët dhe mbajtësit e shërbimeve gjyqësore;

c) në rastin e procedimeve që përfshijnë një zyrtar publik të një shteti tjetër, shteti procedues mund të zbatojë përkufizimin e zyrtarit publik, vetëm në rast se ky përkufizim përputhet me ligjin e tij kombëtar";

d) "Person juridik" do të kuptohet çdo entitet që ka këtë status, sipas ligjit kombëtar të zbatueshëm, përveçse për shtete ose trupa të tjerë publikë në ushtrim të autoritetit shtetëror dhe për organizata ndërkombëtare publike.

KREU II
MASA QË DUHET TË MERREN NË NIVELIN KOMBËTAR

Neni 2
Korrupsioni aktiv i zyrtarëve publikë kombëtarë

Secila Palë do të miratojë masa të tilla legjislative dhe të tjera, që janë të nevojshme, për përcaktimin si vepra penale, sipas legjislacionit të saj kombëtar, kur kryhen me qëllim premtimin, ofrimin ose dhënien direkt ose indirekt të çfarëdolloj avantazhi, që nuk i takon cilitdo zyrtari publik të asaj Pale, për vete ose për dikë tjetër, ndaj tij/saj, për të vepruar ose mosvepruar në ushtrim të funksioneve të tij/saj.

Neni 3
Korrupsioni pasiv i zyrtarëve publikë kombëtarë

Secila Palë do të miratojë masa të tilla legjislative dhe të tjera, që janë të nevojshme, për përcaktimin si vepra penale, sipas legjislacionit të saj kombëtar, kur kryhen me qëllim kërkimin ose marrjen nga cilido prej zyrtarëve publikë të asaj Pale, direkt ose indirekt, të çfarëdolloj avantazhi që nuk i takon, për vete ose për të tjerë, ose pranimi i një oferte ose premtimi apo avantazhi të tillë, për të vepruar ose mosvepruar në ushtrim të funksioneve të tij/saj.

Neni 4
Korrupsioni i anëtarëve të asambleve publike kombëtare

Secila Palë do të miratojë masa të tilla legjislative dhe të tjera, që janë të nevojshme, për përcaktimin si vepra penale sipas legjislacionit të saj kombëtar, sjelljen e referuar në nenet 2 dhe 3 , kur përfshihet cilido person që është anëtar i çfarëdo asambleje kombëtare publike, që ushtron pushtete legjislative ose administrative.

Neni 5
Korrupsioni i zyrtarëve publikë të huaj

Secila Palë do të miratojë masa të tilla legjislative dhe të tjera, që janë të nevojshme, për

përcaktimin si vepra penale sipas legjislacionit të saj kombëtar, sjelljen e referuar në nenet 2 dhe 3, kur përfshihet ndonjë zyrtar publik i një shteti tjetër.

Neni 6
Korrupsioni i anëtarëve të asambleve publike të huaja

Secila Palë do të miratojë masa të tilla legjislative dhe të tjera, që janë të nevojshme për përcaktimin si vepra penale sipas legjislacionit të saj kombëtar, sjelljen e referuar në nenet 2 dhe 3, kur përfshihet cilido person që është anëtar i çfardo asambleje publike, që ushtron pushtete legjislative ose administrative në një shtet tjetër.

Neni 7
Korrupsioni aktiv në sektorin privat

Secila Palë do të miratojë masa të tilla legjislative dhe të tjera që janë të nevojshme për përcaktimin si vepra penale sipas legjislacionit të saj kombëtar, kur kryhen me qëllim gjatë veprimtarisë ekonomike (biznesit) premtimin, ofrimin ose dhënien direkt ose indirekt, të çfarëdolloj avantazhi që nuk i takon, cilitdo personi që drejton ose punon, në çfarëdo cilësie, në entitete të sektorit privat, për vete apo për të tjerë që ata të veprojnë ose të mosveprojnë, në kundërshtim me detyrat e tyre.

Neni 8
Korrupsioni pasiv në sektorin privat

Secila Palë do të miratojë masa të tilla legjislative dhe të tjera, që janë të nevojshme, për përcaktimin si vepra penale, sipas legjislacionit të saj kombëtar, kur kryhen me qëllim gjatë veprimtarisë ekonomike (biznesit), kërkimin ose marrjen, direkt ose indirekt, nga cilido person që drejton ose punon, në çfarëdolloj cilësie, në entitete të sektorit privat, të çfardolloj avantazhi që nuk i takon ose premtimi për vete apo për të tjerë, ose pranimi i një oferte apo premtimi i një avantazhi të tillë, për të vepruar ose mosvepruar në kundërshtim me detyrat e tyre.

Neni 9
Korrupsioni i zyrtarëve të organizatave ndërkombëtare

Secila Palë do të miratojë masa të tilla legjislative dhe të tjera, që janë të nevojshme, për përcaktimin si vepra penale sipas legjislacionit të saj kombëtar, sjelljen e referuar në nenet 2 dhe 3, kur përfshihet cilido zyrtar apo i punësuar me kontratë, në përputhje me kuptimin e rregullave të personelit, të çdo organizate publike ndërkombëtare ose mbikombëtare ose trupe ku Pala është anëtare, si edhe çdo person tjetër, që ushtron funksione që i korrespondojnë atyre të ushtruara nga zyrtarë apo agjentë të tillë.

Neni 10
Korrupsioni i anëtarëve të asambleve parlamentare ndërkombëtare

Secila Palë do të miratojë masa të tilla legjislative dhe të tjera që janë të nevojshme, për përcaktimin si vepra penale sipas legjislacionit të saj kombëtar, sjelljen e referuar në nenin 4 kur përfshihet cilido anëtar i asambleve parlamentare të organizatave ndërkombëtare apo mbikombëtare ku Pala është anëtare.

Neni 11
Korrupsioni i gjyqtarëve dhe zyrtarëve të gjykatave ndërkombëtare

Secila Palë do të miratojë masa të tilla legjislative dhe të tjera që janë të nevojshme për përcaktimin si vepra penale sipas legislacionit të saj kombëtar, sjelljen e referuar në nenet 2 dhe 3, kur përfshihet cilido mbajtës i zyrave gjyqësore ose zyrtare të gjykatave ndërkombëtare, juridiksioni i të cilave është pranuar nga Pala.

Neni 12
Ushtrimi i ndikimit

Secila Palë do të miratojë masa të tilla legjislative dhe të tjera, që janë të nevojshme, për përcaktimin si vepra penale sipas legjislacionit të saj kombëtar, kur kryhen me qëllim premtimin, dhënien ose ofrimin, direkt ose indirekt, të çfarëdolloj avantazhi që nuk i takon cilitdo që siguron ose konfirmon se është i aftë të ushtrojë ndikim në vendimmarrjen e cilitdo personi të referuar në nenet 2, 4, 5, 6, 9, 10, 11, në përputhje me këtë dispozitë, kur avantazhi që nuk i takon është për atë vetë apo për të tjerë, sikurse dhe kërkimi, marrja ose pranimi i ofertës ose premtimi i një avantazhi të tilë, në përputhje me këtë ndikim, pavarësisht nëse ndikimi është ushtruar ose jo ose pavarësisht nëse ndikimi i supozuar çon ose jo në rezultatin e synuar.

Neni 13
Pastrimi i parave të produkteve nga veprat e korrupsionit

Secila Palë do të miratojë masa të tilla legjislative, dhe të tjera, që janë të nevojshme, për përcaktimin si vepra penale sipas legjislacionit të saj kombëtar, sjelljen e referuar në Konventën e Këshillit të Europës për pastrimin, kërkimin, marrjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit (Seria e trakteteve europiane nr.141) neni 6 paragrafet 1 dhe 2, sipas kushteve të referuara aty, kur vepra e treguar konsiston në një nga veprat penale të vendosura, në përputhje me nenet 2 deri 12 të kësaj konvente, në rastin kur Pala nuk ka bërë rezervime apo deklarime, lidhur me këto vepra ose nuk i konsideron këto vepra si serioze për qëllimin e legjislacionit të saj për pastrimin e parave.

Neni 14
Veprat e llogarive

Secila Palë do të miratojë masa të tilla legjislastive dhe të tjera, që janë të nevojshme, për përcaktimin si vepra që dënohen me sanksione penale apo të tjera, sipas legjislaciont të saj kombëtar veprimet ose mungesat vijuese, të kryera me qëllim për të kryer, fshehur ose maskuar veprat e referuara në nenet 2 deri 12, në rastin kur Pala nuk ka bërë rezervime ose deklarime:

a) duke krijuar ose shfrytëzuar një faturë ose dokument tjetër llogarie ose regjistrim që përmban informacion fals ose jo të plotë;
b) boshllëqe të paligjshme për bërjen e një regjistrimi të një pagese.

Neni 15
Akte pjesëmarrëse

Secila Palë do të miratojë masa të tilla legjislative dhe të tjera, që janë të nevojshme, për përcaktimin si vepra penale sipas legjislacionit të saj kombëtar, dhënien e ndihmës ose përkrahjen e kryerjes së këtyre veprave penale, të vendosura në përputhje me këtë konventë.

Neni 16
Imuniteti

Parashikimet e kësaj konvente nuk paragjykojnë parashikimet e asnjëlloj traktati, protokolli ose statuti, sikurse dhe tekstet e tyre zbatuese, përsa i përket heqjes së imunitetit.

Neni 17
Juridiksioni

1. Secila Palë do të miratojë masa të tilla legjislative dhe të tjera, që janë të nevojshme, për vendosjen e juridiksionit mbi vepra penale, të vendosur në përputhje me nenet 2 deri 14 të kësaj konvente kur:

a) vepra është kryer tërësisht ose pjesërisht në territorin e saj;

b) autori i veprës është shtetas i saj, zyrtar publik i saj ose anëtar i asambleve publike kombëtare të saj;

c) vepra përfshin një nga zyrtarët e saj publikë, ose anëtarët e asambleve publike kombëtare të saj, ose çdo person, referuar neneve 9 deri 11, i cili është në të njëjtën kohë shtetas i saj.

2. Çdo shtet mundet që, në momentin e nënshkrimit ose depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, të deklarojë me anë të një deklarate të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës se ai rezervon të drejtën për të mos zbatuar ose për të zbatuar vetëm, në raste ose kushte specifike, rregullat juridiksionale, të parashikuara në paragrafin 1 “b” dhe “c” të këtij neni ose një pjesë të tyre.

3. Nëse një Palë e ka përdorur rezervimin e parashikuar mundësisht në paragrafin 2 të këtij neni, ajo duhet të miratojë masa të tilla, që janë të nevojshme për vendosjen e juridiksionit mbi një vepër penale të vendosur në përputhje me këtë konventë, në rastet kur autori përkatës ndodhet në territorin e saj dhe nuk mund të ekstradohet te një Palë tjetër, vetëm në bazë të shtetësisë së tij, pas kërkesës për ekstradim.

4. Kjo konventë nuk përjashton asnjë juridiksion penal të ushtruar nga ndonjë Palë, në përputhje me ligjin kombëtar.

Neni 18
Përgjegjësia e personave juridike

1. Secila Palë do të miratojë masa të tilla legjislative dhe të tjera që janë të nevojshme, për të siguruar që personat juridikë mund të përgjigjen për veprat penale të korrupsionit aktiv, ushtrimit të ndikimit dhe pastrimit të parave të vendosura në përputhje me këtë konventë, të kryera për përfitimin e tyre nga persona fizikë, që veprojnë ose individualisht, ose si pjesë e një organi të personit juridik, e që kanë pozicione drejtuese brenda personit juridik, bazuar në:

- pushtet paraqitjeje të personit juridik; ose
- një autoritet që merr vendime për personin juridik; ose
- një autoritet që ushtron kontroll brenda personit juridik;

sikurse dhe për përfshirjen e një personi fizik të tillë si aksesor ose shtesë në veprat e sipërpërmendura.

2. Përveç rasteve të parashikuara në paragrafin 1, secila Palë do të marrë masat e nevojshme për të siguruar që një person juridik mund të përgjigjet kur mungesa e supervizimit ose kontrollit nga një person fizik, referuar në paragrafin 1, ka bërë të mundur kryerjen e veprave penale të përmendura në paragrafin 1 për përfitimin e atij personi juridik nga një person fizik nën autoritetin e tij.

3. Përgjegjësia e një personi juridik sipas paragrafeve 1 dhe 2, nuk përjashton procedimet penale në ngarkim të personave fizikë që janë kryerës, shtytës ose aksesorë në veprat penale të përmendura në paragrafin 1.

Neni 19
Sanksione dhe masa

1. Duke pasur parasysh natyrën serioze të veprave penale të vendsura në përputhje me këtë konventë, secila Palë do të sigurojë, në kuptim të këtyre veprave penale, të vendosura në përputhje me nenet 2 deri 14, sanksione dhe masa efektive, proporcionale dhe shtrënguese, përfshirë kur janë kryer nga persona fizikë edhe dënime që përfshijnë heqjen e lirisë, e cila mund të japë shkas për ekstradim.

2. Secila Palë do të sigurojë që personat juridikë që kanë përgjegjësi, në përputhje me nenin 18 paragrafet 1 dhe 2, do të jenë subjekte të sanksioneve penale ose jopenale efektive, proporcionale dhe shtrënguese, përfshirë edhe sanksione monetare.

3. Secila Palë do të miratojë masa të tilla legjislative dhe të tjera, që janë të nevojshme, për ta bërë atë të aftë të konfiskojë apo marrë mjetet dhe produktet e veprave penale, të vendosura në përputhje me këtë konventë, ose prona, vlera e të cilave i korrespondon këtyre produkteve.

Neni 20
Autoritete të specializuara

Secila Palë do të miratojë masa të tilla legjislative dhe të tjera që janë të nevojshme, për të siguruar që personat ose entitetet janë të specializuar në luftën kundër korrupsionit. Ata do të kenë pavarësinë e nevojshme, në përputhje me parimet themelore të sistemit ligjor të Palës, me qëllim që ata të jenë të aftë të ushtrojnë funksionet e tyre me efektivitet dhe të lirë nga çdo presion i palejuar. Pala do të sigurojë që personeli i këtyre entiteteve ka trajnim dhe burime financiare të përshtatshme për detyrat e tyre.

Neni 21
Bashkëpunimi me dhe midis autoriteteve kombëtare

Secila Palë do të miratojë masa të tilla, që janë të nevojshme, për të siguruar që autoritetet publike, sikurse dhe çdo zyrtar publik bashkëpunon, në përputhje me ligjin kombëtar, me ata të autoriteteve përgjegjëse për hartimin dhe procedimin e veprave penale:

a) nëpërmjet informimit të këtyre të fundit, me iniciativën e tyre kur ka dyshime të arsyeshme për të besuar se ndonjëra nga veprat penale, të vendosura në përputhje me nenet 2 deri 14 është kryer; ose

b) duke i siguruar, sipas kërkesës, autoriteteve të fundit gjithë informacionin e nevojshëm.

Neni 22
Mbrojtja e bashkëpunëtorëve të drejtësisë dhe dëshmitarëve

Secila Palë do të miratojë masa të tilla, që janë të nevojshme, për të siguruar mbrojtje efektive dhe të përshtatshme për:

a) ata që raportojnë veprat penale të vendosura, në përputhje me nenet 2 deri 14 ose që bashkëpunojnë me autoritetet hetimore ose proceduese;

b) dëshmitarë që dëshmojnë lidhur me këto vepra.

Neni 23
Masa për lehtësimin e marrjes së evidencave dhe konfiskimin e produkteve

1. Secila Palë do të miratojë masa legjislative dhe të tjera, të tilla që janë të nevojshme, përfshirë dhe ato që mundësojnë përdorimin e teknikave speciale hetimore, në përputhje me ligjin kombëtar, për mundësimin e lehtësimit të marrjes së evidencave, lidhur me veprat penale të vendosura, në përputhje me nenet 2 deri 14 të kësaj konvente dhe të identifikimit, gjurmimit,

ndalimit dhe marrjes së mjeteve dhe produkteve të korrupsionit ose pasurive, vlera e të cilave i korrespondon këtyre produkteve, të lidhura këto me masat e vendosura, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 19 të kësaj konvente.

2. Secila Palë do të miratojë masa të tilla legjislative dhe të tjera, që janë të nevojshme, për të autorizuar gjykatat e saj ose autoritete të tjera kompetente që të urdhërojnë vënien në dispozicion ose marrjen e regjistrimeve bankare, financiare ose tregtare, me qëllim përmbushjen e veprimeve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni.

3. Sekreti bankar nuk mund të jetë pengesë për masat e parashikuara në paragrafet 1 dhe 2 të këtij neni.

KREU III
MONITORIMI I ZBATIMIT

Neni 24
Monitorimi

Grupi i shteteve kundër korrupsiopnit (GRECO) monitoron zbatimin e kësaj konvente nga Palët.

KREU IV
BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Neni 25

Parime të përgjithshme dhe masa për bashkëpunimin ndërkombëtar

1. Palët bashkëpunojnë me njera-tjetrën, në përputhje me parashikimet e instrumenteve ndërkombëtare përkatës të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën penale, ose marrëveshjeve të arritura mbi bazë legjislacioni uniform ose reciprok, dhe në përputhje me ligjin e tyre kombëtar, në kuptimin më të gjerë të mundshëm, për qëllimet e hetimit dhe procedimit që i përkasin veprave penale të vendosura në përputhje me këtë konventë.

2. Kur nuk ka instrumente ndërkombëtare ose marrëveshje në fuqi midis Palëve, të referuara në paragrafin 1, zbatohen nenet 26 deri 31 të këtij kreu.

3. Nenet 26 deri 31 të këtij kreu zbatohen edhe kur ato janë me favorizuese sesa dispozitat e instrumenteve ndërkombëtare ose marrëveshjeve të referuara në paragrafin 1.

Neni 26
Asistenca e ndërsjellë

1. Palët i ofrojnë njera-tjetrës masat më të gjera të asistencës së ndërsjellë, nëpërmjet procedimit të shpejtë të kërkesave nga autoritetet që, në përputhje me ligjet e tyre kombëtare, kanë të drejtën e hetimit ose procedimit të veprave penale të vendosura në përputhje me këtë konventë.

2. Asistenca e ndërsjellë ligjore, sipas paragrafit 1 të këtij neni, mund të refuzohet nëse Pala e kërkuar beson se kërkesa e bërë dëmton interesat e saj themelore, sovranitetin kombëtar, sigurinë kombëtare ose rendin publik.

3. Palët nuk do të përdorin sekretin bankar si arsye për refuzimin e çfarëdo bashkëpunimi, sipas këtij kreu. Në rast se ligji kombëtar e kërkon, Pala mund të kërkojë që kërkesa për bashkëpunim, e cila përfshin zbulimin e sekretit bankar, të autorizohet ose nga një gjyqtar, ose nga një autoritet tjetër gjyqësor, përfshirë prokurorët publikë, ndonjë nga këto autoritete që veprojnë lidhur me veprat penale.

Neni 27
Ekstradimi

1.Veprat penale të vendosura në përputhje me këtë konventë konsiderohen se përfshihen si vepra të ekstradueshme në çdo traktat ekstradimi, që ekziston midis ose ndërmjet Palëve. Palët marrin përsipër të përfshijnë këto vepra si vepra të ekstradueshme në çdo traktat ekstradimi që do të lidhet midis ose ndërmjet tyre.

2. Nëse një Palë, që kryen ekstradim të kushtëzuar mbi bazën e eksiztencës së një traktari, merr një kërkesë për ekstradim nga një Palë tjetër me të cilën nuk ka ndonjë traktat ekstradimi, mund ta konsiderojë këtë konventë si një bazë ligjore për ekstradim, në kuptim të çdo vepre penale, të vendosur në përputhje me këtë konventë.

3. Palët, që nuk kryejnë ekstradim të kushtëzuar nga ekzistenca e një traktati, njohin veprat penale të vendosura në përputhje me këtë konventë si vepra të ekstradueshme midis tyre.

4. Ekstradimi i nënshtrohet kushteve të parashikuara në ligjet e Palës së kërkuar ose në traktatet e zbatueshme të ekstradimit, përfshirë arsyet për të cilat Pala e kërkuar mund të refuzojë ekstradimin.

5. Nëse ekstradimi për një veprën penale të vendosur në përputhje me këtë konventë refuzohet vetëm mbi bazën e shtetësisë së personit të kërkuar, ose për shkak se pala e kërkuar konsideron se ka juridiksion mbi vepër, Pala e kërkuar ia paraqet çështjen autoriteteve të saj kompetente për qëllimet e procedimit, përderisa nuk është rënë dakord ndryshe me Palën kërkuese, dhe do t'i raportojë rezultatin përfundimtar Palës kërkuese në të njëjtën rrugë.

Neni 28
Informacioni i rastësishëm

Pa paragjykuar hetimet ose procedimet e veta, një Palë mundet t'i japë një Pale tjetër pa patur kërkesë nga kjo, informacion për fakte kur ajo konsideron se dhënia e këtij informacioni mund të asistojë Palën marrëse në fillimin ose ushtrimin e hetimeve ose procedimeve që i përkasin veprave penale të vendosura në përputhje me këtë konventë ose mund të çojnë në një kërkesë nga ajo Palë, sipas këtij kreu.

Neni 29
Autoriteti qendror

1. Palët caktojnë një autoritet qendror ose, nëse është e përshtatshme, autoritete qendrore të ndryshme, të cilat janë përgjegjëse për dërgimin dhe përgjigjen e kërkesave të bëra sipas këtij kreu, ekzekutimin e këtyre kërkesave ose transmetimin e tyre tek autoritetet kompetente për ekzekutimin e tyre.

2. Secila Palë i komunikon Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit , pranimit, miratimit ose aderimit, emrat dhe adresat e autoriteteve të treguara, në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 30
Komunikimi i drejtpërdrejtë

1. Autoritetet qendrore komunikojnë drejtpërdrejt midis tyre.

2. Në rast urgjence, kërkesat për asistencë të ndërsjellë ose komunikimet që lidhen me to mund të dërgohen direkt nga autoritetet gjyqësore, përfshirë prokurorët publikë të Palës kërkuese tek autoritete të tilla të Palës së kërkuar. Në raste të tilla, i dërgohet në të njëjtën kohë një kopje autoritetit qendror të Palës së kërkuar nëpërmjet autoritetit qendror të Palës kërkuese.

3. Çdo kërkesë ose komunikim, sipas paragrafeve 1 dhe 2 të këtij neni, mund të bëhet nëpërmjet Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (INTERPOL).

4. Kur, në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni është bërë një kërkesë dhe autoriteti nuk është kompetent të trajtojë kërkesën, ai i referon kërkesën autoritetit kompetent kombëtar dhe informon direkt Palën kërkuese përsa ka vepruar.

5. Kërkesat ose komunikimet, sipas paragrafit 2 të këtij neni që nuk përfshijnë veprime detyruese, mund t'u transmetohen direkt nga autoritetet kompetente të Palës kërkuese autoriteteve kompetente të Palës së kërkuar.

6. Secili shtet mund të informojë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, se për arsye të efektivitetit, kërkesat e bëra sipas këtij kreu duhet t'i adresohen autoritetit të tij qendror.

Neni 31
Informacioni

Pala e kërkuar informon menjëherë Palën kërkuese për veprimin e ndërmarrë për një kërkesë sipas këtij kreu dhe rezultatin përfundimtar të këtij veprimi. Pala e kërkuar informon, gjithashtu, menjëherë Palën kërkuese për çdo rrethanë që e bën të pamundur përmbushjen e veprimit në fjalë ose që e vonojnë atë ndjeshëm.

KREU V
PARASHIKIME PËRFUNDIMTARE

Neni 32
Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo konventë do të jetë e hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe nga shtete joanëtare që kanë marrë pjesë në hartimin e saj.

Këto shtete mund ta shprehin pëlqimin e tyre për t'u bërë Palë nëpërmjet:

a) nënshkrimit pa rezerva dhe ratifikimit, pranimit ose miratimi; ose

b) nënshkrimit me qëllim ratifikimi, pranimi ose miratimi të pasuar nga ratifikimi, pranimi ose miratimi.

2. Instrumentet e ratifikimit ose të pranimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

3. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason tre muaj pas datës, në të cilën katërmbëdhjetë shtete kanë shprehur pëlqimin e tyre për të qenë Palë në konventë në përputhje me parashikimet e paragrafit 1. Çdo shtet që nuk është anëtar i Grupit të shteteve kundër korrupsionit (GRECO) në momentin e ratifikimit, bëhet automatikisht anëtar në datën kur Konventa hyn në fuqi.

4. Për shtetet nënshkruese, që bëhen Palë në këtë konventë më vonë, ajo do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason tre muaj pas datës në të cilën ata kanë shprehur pëlqimin e tyre për të qenë Palë në konventë, në përputhje me parashikimet e paragrafit 1ssss. Çdo shtet nënshkrues, që nuk është anëtar i Grupit të shteteve kundër korrupsionit (GRECO) në momentin e ratifikimit, bëhet automatikisht anëtar në datën kur Konventa hyn në fuqi për të.

Neni 33
Aderimi në konventë

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj konvente, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës, pas konsultimit të shteteve Palë të konventës mund të ftojë Komunitetin Europian, sikurse dhe çdo shtet joanëtar të Këshillit dhe që nuk ka marrë pjesë në hartimin e saj, të aderojë në këtë konventë nëpërmjet një vendimi të marrë me shumicën e parashikuar në nenin 20 "d" të Statutit të Këshillit të Europës dhe duhet të marrë miratimin unanim të përfaqësuesve të shteteve Palë që kanë të drejtë pjesëmarrjeje në Komitetin e Ministrave.

2. Lidhur me Komunitetin Europian, sikurse dhe çdo shtet që aderon në të, sipas paragrafit 1 të mësipërm, Konventa hyn në fuqi ditën e parë të muajit që pason tre muaj pas datës në të cilën është depozituar instrumenti i aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Komuniteti Europian dhe çdo shtet që aderon në konventë bëhet automatikisht anëtar i GRECO-s, nëse nuk është trashmë anëtar në momentin e aderimit, në datën kur Konventa hyn në fuqi për të.

Neni 34
Zbatimi territorial

1. Çdo shtet kontraktues mundet, në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit ose aderimit, të specifikojë territorin ose territoret në të cilat do të zbatohet kjo konventë.

2. Çdo Palë mundet, në një datë të mëvonshme, nëpërmjet një deklarate të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të shtrijë zbatimin e kësaj konvente në cilindo territor ose territore të specifikuara në deklaratë. Lidhur me këtë territor, konventa hyn në fuqi ditën e parë të muajit që pason tre muaj pas datës në të cilën është marrë kjo deklaratë nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë, e bërë në përputhje me dy paragrafet e mësipërm, mundet, lidhur me ato territore të treguara në atë deklaratë, të tërhiqet nëpërmjet një njoftimi të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Tërheqja bëhet efektive ditën e parë të muajit që pason tre muaj pas datës në të cilën është marrë njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 35
Raporti me konventat dhe marrëveshjet e tjera

1. Kjo Konventë nuk cenon të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga konventa ndërkombëtare shumëpalëshe, që përmbajnë fusha speciale.

2. Shtetet Palë në konventë mund të lidhin marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe mes tyre lidhur me çështjet e rregulluara nga kjo konventë për të plotësuar ose forcuar parashikimet e saj ose për të lehtësuar zbatimin e parimeve që përmbahen aty.

3. Nëse dy ose më shumë Palë kanë përfunduar tashmë një marrëveshje ose traktat, lidhur me një subjekt që trajtohet nga kjo konventë ose kanë vendosur në një mënyrë tjetër raportet e tyre lidhur me atë subjekt, ata do të kenë të drejtë të zbatojnë atë marrëveshje apo traktat, ose t'i rregullojnë ato marrëdhënie, në frymën e kësaj Konvente, nëse lehtësojnë bashkëpunimin ndërkombëtar.

Neni 36
Deklarime

Çdo shtet mundet, në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit ose aderimit, të deklarojë përdorimin prej tij si vepra penale korrupsionin aktiv dhe pasiv të zyrtarëve publikë të huaj sipas nenit 5, të zyrtarëve të organizatave ndërkombëtare sipas nenit 9 ose të gjyqtarëve dhe zyrtarëve të gjykatave ndërkombëtare sipas nenin 11, vetëm në rastin kur gjyqtari apo zyrtari publik vepron ose nuk vepron në kundërshtim me detyrat e tij.

Neni 37
Rezerva

1. Çdo shtet mundet, në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit ose aderimit, të rezervojë të drejtën e tij për të mos vendosur si vepra penale sipas ligjit të tij kombëtar, pjesërisht ose tërësisht, sjelljet e referuara në nenet 4, 6 deri 8, 10 deri 12 ose të veprave të korrupsionit pasiv të përcaktuara në nenin 5.

2. Çdo shtet mundet, në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit ose aderimit, të deklarojë përdorimin prej tij të rezervës së parashikuar në nenin 17 paragrafi 2.

3. Çdo shtet mundet, në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit ose aderimit, të deklarojë se mund të refuzojë asistencën e ndërsjellë ligjore sipas nenit 26 paragrafi 1, nëse kërkesa lidhet me një vepër që konsiderohet nga Pala e kërkuar si vepër politike .

4. Asnjë shtet nuk mund të bëjë, sipas zbatimit të paragrafeve 1, 2 dhe 3 të këtij neni, rezerva për më shumë se sa pesë nga parashikimet e përmendura këtu. Asnjë rezervë tjetër nuk mund të bëhet. Rezervat e të njëjtës natyrë sipas neneve 4, 6 dhe 10 do të konsiderohen si një rezervë.

Neni 38

Vlefshmëria dhe rishikimi i deklarimeve dhe rezervave

1. Deklarimet e referuara në nenin 36 dhe rezervat e referuara në nenin 37 janë të vlefshme për një periudhë prej tre vjetësh nga dita e hyrjes në fuqi të konventës për shtetin përkatës. Sidoqoftë, këto deklarime dhe rezerva mund të rinovohen për periudha së të njëjtës gjatësi.

2. Dy muaj para datës së skadimit të deklarimit ose rezervës, Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit të Europës njofton për skadimin shtetin përkatës. Jo më vonë se tre muaj para skadimit, shteti njofton Sekretarin e Përgjithshëm se ai do ta mbajë, ndryshojë ose tërheqë deklarimin ose rezervën e tij. Në mungesë të njoftimit nga shteti përkatës, Sekretari i Përgjithshëm informon atë shtet se deklarimi ose rezerva e tij konsiderohet se është shtrirë automatikisht për një periudhë prej gjashtë muajsh. Nëse shteti përkatës nuk njofton qëllimin e tij, për të mbajtur ose ndryshuar deklarimin ose rezervën e tij para skadimit të kësaj periudhe, kjo sjell humbjen e deklarimit ose të rezervës.

3. Nëse një Palë bën një deklarim ose rezervë në përputhje me nenet 36 dhe 37, ajo duhet të bëjë para rinovimit të saj ose bërjes së kërkesës, një shpjegim ndaj GRECO-s për arsyet që justifikojnë vazhdimin e tij/saj.

Neni 39

Ndryshimet

1. Ndryshime të kësaj konvente mund të propozohen nga çdo Palë dhe do t'i komunikohen nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës shteteve anëtare të Këshillit të Europës dhe çdo shteti joanëtar që ka aderuar në konventë ose është ftuar të aderojë në përputhje me parashikimet e nenit 33.

2. Çdo ndryshim i propozuar nga një Palë do t'i komunikohet Komitetit Europian për Problemet Penale (CDPC) që do t'i paraqesë Komitetit të Ministrave mendimin e tij për ndryshimin e propozuar.

3. Komiteti i Ministrave e konsideron ndryshimin e propozuar dhe mendimin e dhënë nga CDPC-ja dhe pas konsultimit me shtetet joanëtare Palë në këtë konventë, mund të miratojë ndryshimin.

4. Teksti i çdo ndryshimi të miratuar nga Komiteti i Ministrave, në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni, u jepet Palëve për pranim.

5. Çdo ndryshim i miratuar në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni hyn në fuqi në ditën e tridhjetë pas njoftimit, nga të gjitha Palët, të Sekretarit të Përgjithshëm për pranimin nga ana e tyre të ndryshimit.

Neni 40
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Komiteti Europian për Problemet Penale i Këshillit të Europës mbahet i informuar lidhur me intepretimin dhe zbatimin e kësaj konvente.

2. Në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet Palëve për interpretimin ose zbatimin e kësaj konvente, ato duhet të gjejnë zgjidhje të mosmarrëveshjes nëpërmjet bisedimit ose mjeteve të tjera paqësore të zgjedhjes së tyre, përfshirë paraqitjen e mosmarrëveshjes para Komitetit Europian për problemet penale, një gjykate arbitrazhi, vendimi i së cilës do të jetë i detyrueshëm për Palët ose para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, sikurse pranohet nga Palët përkatëse.

Neni 41
Denoncimi

1. Çdo Palë mundet, në çdo kohë, të denoncojë këtë konventë nëpërmjet një njoftimi të dërguar të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Denoncimi do të ketë efekt ditën e parë të muajit pasues të skadencës së periudhës prej tre muajsh nga data e marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 42
Njoftimi

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të njoftojë shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe çdo shtet tjetër, i cili ka aderuar në këtë konventë për:

a) çdo nënshkrim;

b) çdo depozitim të një instrumenti ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi;

c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj konvente në përputhje me nenet 32 dhe 33 të saj;

d) çdo deklaratë ose rezervë të bërë në përputhje me nenet 36 ose 37;

e) çdo veprim tjetër, njoftim ose komunikim lidhur me këtë konventë.

Si dëshmi të kësaj, nënshkruesit të autorizuar si duhet për këtë gjë, kanë nënshkruar këtë konventë.

Bërë në Strasburg, më 27 janar 1999, në anglisht dhe frëngjisht të dyja tekstet njëlloj të vlefshëm, në një kopje të vetme, e cila do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'i transmetojë kopje të vërtetuara secilit shtet anëtar të Këshillit të Europës, shteteve joanëtare që kanë marrë pjesë në hartimin e kësaj konvente dhe çdo shteti tjetër të ftuar për aderim në të.

LIGJ
Nr.9245, datë 24.6.2004

PËR RATIFIKIMIN E "PROTOKOLLIT SHTESË TË KONVENTËS PENALE PËR KORRUPSIONIN"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Protokolli Shtesë i Konventës Penale për Korrupsionin".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4273, datë 14.7.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.49, faqe 3386

PROTOKOLL SHTESË
I KONVENTËS PENALE MBI KORRUPSIONIN

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe shtetet e tjera nënshkruese,

duke menduar se është e dëshirueshme të plotësohet Konventa Penale mbi Korrupsionin (ETS Nr.173, tani e tutje "Konventa") për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin;

duke menduar gjithashtu se ky protokoll lejon një zbatim më të gjerë të programit të veprimit kundër korrupsionit,

kanë rënë dakord si më poshtë:

KAPITULLI I
PËRDORIMI I TERMAVE

Neni 1
Përdorimi i termave

Për qëllimet e këtij protokolli :

1. Termi "arbitër" kuptohet duke iu referuar ligjit kombëtar të shteteve palë të këtij protokolli, por në çdo rast përfshin një person të cilit me anë të një marrëveshjeje arbitrazhi i kërkohet të japë një vendim ligjërisht të detyrueshëm në lidhje me një mosmarrëveshje që i paraqitet atij/asaj nga palët e marrëveshjes.

2. Termi "marrëveshje arbitrazhi" do të thotë një marrëveshje të njohur nga ligji kombëtar, nëpërmjet së cilës palët bien dakord të paraqesin një mosmarrëveshje për vendim nga një arbitër.

3. Termi "anëtar jurie" kuptohet duke iu referuar ligjit kombëtar të shteteve palë të këtij

protokolli, por në çdo rast përfshin një person joprofesionist që vepron si anëtar i një organi kolegjial, i cili ka përgjegjësinë e marrjes së vendimit në lidhje me fajin e personit të akuzuar në kuadrin e një gjyqi.

4. Në rastin e një gjykimi ku është përfshirë një arbitër ose anëtar jurie i huaj, shteti që kryen ndjekjen penale mund të zbatojë përkufizimin e arbitrit ose anëtarit të jurisë vetëm deri në atë masë që ai përkufizim është në përputhje me ligjin kombëtar.

KAPITULLI II
MASAT QË MERREN NË NIVEL KOMBËTAR

Neni 2
Rryshfeti aktiv i arbitrave vendas

Secila Palë merr ato masa legjislative dhe të tjera që mund të jenë të nevojshme për të përcaktuar si vepra penale sipas ligjit kombëtar, kur kryhet me qëllim, premtimi, ofrimi ose dhënia nga çdo person, drejtpërdrejt ose jo, i çdo avantazhi të padrejtë një arbitri që ushtron funksionet e tij/saj sipas ligjit kombëtar mbi arbitrazhin e Palës, për veten e tij ose të saj apo për çdo njeri tjetër, që ai ose ajo të veprojë ose të mos veprojë në ushtrim të funksioneve të tij ose të saj.

Neni 3
Rryshfeti pasiv i arbitrave vendas

Secila Palë merr ato masa legjislative dhe të tjera që mund të jenë të nevojshme për të përcaktuar si vepra penale sipas ligjit kombëtar, kur kryhet me qëllim, kërkesa ose marrja nga një arbitër që ushtron funksionet e tij/saj sipas ligjit kombëtar mbi arbitrazhin e Palës, drejtpërdrejt ose jo, i një avantazhi të padrejtë për veten e tij ose të saj apo për çdo njeri tjetër, ose pranimi i një oferte apo premtimi i një avantazhi të tillë, për të vepruar ose mos vepruar në ushtrim të funksioneve të tij ose të saj.

Neni 4
Rryshfeti i arbitrave të huaj

Secila Palë merr ato masa legjislative dhe të tjera që mund të jenë të nevojshme për të përcaktuar si vepra penale sipas ligjit vendas sjelljen e përmendur në nenet 2 dhe 3, ku përfshihet një arbitër që ushtron profesionin e tij/saj sipas ligjit kombëtar mbi arbitrazhin e ndonjë shteti tjetër.

Neni 5
Rryshfeti i anëtarëve vendas të jurisë

Secila Palë merr ato masa legjislative dhe të tjera që mund të jenë të nevojshme për të përcaktuar si vepra penale sipas ligjit vendas sjelljen e përmendur në nenet 2 dhe 3, ku përfshihet një person që vepron si anëtar jurie brenda sistemit të tij gjyqësor.

Neni 6
Rryshfeti i anëtarëve të huaj të jurisë

Secila Palë merr ato masa legjislative dhe të tjera që mund të jenë të nevojshme për të përcaktuar si vepra penale sipas ligjit vendas sjelljen e përmendur në nenet 2 dhe 3, ku përfshihet një person që vepron si anëtar jurie brenda sistemit gjyqësor të çdo shteti tjetër.

KAPITULLI III
VËZHGIMI I ZBATIMIT DHE DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 7
Vëzhgimi i zbatimit

Grupi i shteteve kundër korrupsionit (GSC) vëzhgon zbatimin e këtij protokolli nga Palët.

Neni 8
Raporti me Konventën

1. Ndërmjet Shteteve Palë dispozitat e neneve 2 deri 6 të këtij protokolli konsiderohen si nene shtesë të Konventës.

2. Dispozitat e Konventës zbatohen deri në atë masë që të jenë në përputhje me këtë protokoll.

Neni 9
Deklaratat dhe rezervat

1. Kur një Palë bën një deklaratë në pajtim me nenin 36 të Konventës, ajo mund të bëjë një deklaratë të ngjashme në lidhje me nenet 4 dhe 6 të këtij protokolli në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit.

2. Kur një Palë bën në rezervë në pajtim me nenin 37, paragrafi 1 i Konventës që kufizon zbatimin e veprave penale të rryshfetit pasiv të përkufizuar në nenin 5 të Konventës, ajo mund të bëjë një rezervë të ngjashme në lidhje me nenet 4 dhe 6 të këtij protokolli në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit. Çdo rezervë tjetër e bërë nga një Palë, në pajtim me nenin 37 të Konventës zbatohet edhe për këtë protokoll, përveç kur Pala deklaron ndryshe në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit.

3. Nuk mund të bëhet asnjë rezervë tjetër.

Neni 10
Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Ky protokoll është i hapur për nënshkrim nga shtetet që kanë nënshkruar Konventën. Këta shtete mund të shprehin pëlqimin e tyre për detyrimin nëpërmjet:

a) nënshkrimit pa rezervë në lidhje me ratifikimin, pranimin ose aprovimin;

b) nënshkrimit që i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose aprovimit, e pasuar nga ratifikimi, pranimi ose aprovimi.

2. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose aprovimit depozitohen tek Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

3. Protokolli hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një periudhe tre mujore pas datës në të cilën pesë shtete kanë shprehur pëlqimin e tyre që t'i nënshtrohen protokollit në pajtim me dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, dhe vetëm pasi të ketë hyrë në fuqi vetë Konventa.

4. Në lidhje me çdo shtet nënshkrues që e shpreh pëlqimin e tij më vonë për t'iu nënshtruar protokollit, ky hyn në fyqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një periudhe tremujore pas datës së shprehjes së pëlqimit për t'iu nënshtruar protokollit në pajtim me dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2.

5. Një shtet nënshkrues nuk mund të ratifikojë, pranojë ose aprovojë këtë protokoll pa shprehur, në të njëjtën kohë ose më parë, pëlqimin për t'iu nënshtruar Konventës.

Neni 11
Aderimi në protokoll

1. Çdo shtet ose Komuniteti Europian që ka aderuar në Konventë mund të aderojë në këtë protokoll, pasi ai të ketë hyrë në fuqi.

2. Në lidhje me çdo shtet ose Komunitetin Europian që aderon në protokoll, ky hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një periudhe tremujore pas datës së depozitimit të një instrumenti aderimi tek Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 12
Zbatimi territorial

1. Çdo shtet ose Komuniteti Europian, në momentin e nënshkrimit ose depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit, mund të përcaktojë territorin ose pjesët e territorit ku zbatohet ky protokoll.

2. Çdo Palë, në çdo datë të mëvonshme, nëpërmjet një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund të zgjerojë zbatimin e këtij protokolli në një ose disa pjesë territori të përcaktuara në deklaratë dhe për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilave është përgjegjëse ose në emër të të cilave është autorizuar të marrë përsipër detyrime. Në lidhje me këtë territor protokolli hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një periudhe tremujore, pas datës së marrjes së një deklarate të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë sipas dy paragrafëve të mësipërm, në lidhje me çdo territor të përmendur në këtë deklaratë, mund të tërhiqet nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Një tërheqje e tillë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një periudhe tremujore, pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 13
Denoncimi

1. Çdo Palë, në çdo kohë, mund ta denoncojë këtë protokoll nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Një denoncim i tillë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një periudhe tremujore, pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Denoncimi i Konventës shkakton automatikisht denoncimin e protokollit.

Neni 14
Njoftimi

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës njofton shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe çdo shtet ose Komunitetin Europian që ka aderuar në këtë protokoll për:

a) çdo nënshkrim të këtij protokolli;

b) depozitimin e çdo instrumenti ratifikimi, pranimi, aprovimi ose aderimi;

c) çdo datë të hyrjes në fuqi të këtij protokolli në pajtim me nenet 10, 11 dhe 12;

d) çdo deklaratë ose rezervë të bërë sipas neneve 9 dhe 12;

e) çdo akt, njoftim ose komunikim tjetër që lidhet me protokollin.

Si dëshmi e kësaj, të poshtëshënuarit, duke qenë të autorizuar rregullisht, nënshkruajnë këtë protokoll.

Bërë në Strasburg, më 15 maj 2003, në anglisht dhe frëngjisht, të dy tekstet janë njëlloj autentike, në një kopje të vetme, që depozitohen në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës u transmeton kopje të vërtetuara të gjitha Palëve nënshkruese dhe aderuese.

LIGJ
Nr. 8865, datë 14.3.2002

PËR RATIFIKIMIN E "KONVENTËS NDËRKOMBËTARE PËR LUFTËN KUNDËR FINANCIMIT TË TERRORIZMIT"

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Konventa ndërkombëtare për luftën kundër financimit të terrorizmit" e datës 9.12.1999.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3272, datë 19.3.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.7, faqe 170

KONVENTA
NDËRKOMBËTARE PËR LUFTËN KUNDËR FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

Kombet e Bashkuara
1999
Preambula
Shtetet Anëtare të kësaj Konvente,

Duke pasur parasysh qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara për ruajtjen e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare dhe nxitjen e marrëdhënieve të mira të fqinjësisë, të miqësisë dhe bashkëpunimin midis Shteteve,

Të shqetësuar thellësisht për zhvillimin mbarëbotëror të akteve të terrorizmit në të gjitha format dhe manifestimet e tij,

Duke kujtuar Deklaratën me rastin e përvjetorit të pesëdhjetë të Kombeve të Bashkuara, të përfshirë në Rezolutën 50/6 të Asamblesë së Përgjithshme të 24 tetorit 1995,

Duke kujtuar, gjithashtu, të gjitha rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme që kanë lidhje me çështjen, përfshirë këtu Rezolutën 49/60 të 9 dhjetorit 1994 dhe shtojcën e saj në Deklaratën mbi Masat për Eliminimin e Terrorizmit Ndërkombëtar, në të cilën Shtetet Anëtare të Kombeve të Bashkuara riafirmojnë solemnisht dënimin e tyre pa ekuivok të të gjitha akteve, metodave dhe praktikave të terrorizmit si kriminale dhe të pajustifikueshme, të kryera kudo dhe nga kushdoqoftë, përfshirë ato që rrezikojnë marrëdhëniet miqësore mes Shteteve dhe popujve dhe kërcënojnë integritetin territorial dhe sigurisë e Shteteve,

Duke vënë në dukje se Deklarata mbi Masat për Eleminimin e Terrorizmit Ndërkombëtar i nxiti Shtetet për të riparë urgjentisht gamën e akteve ekzistuese ligjore ndërkombëtare mbi

parandalimin, shtypjen dhe eleminimin e terrorizmit në të gjitha format dhe manifestimet e tij, me qëllimin e sigurimit të ekzistencës së një kuadri tërësor ligjor që mbulon të gjitha aspektet e çështjes,

Duke kujtuar Rezolutën 51/210 të 17 dhjetorit 1996 të Asamblesë së Përgjithshme, paragrafin 3 të saj, nënparagrafin (f), në të cilën Asambleja u bëri thirrje të gjitha Shteteve të marrin masat për të parandaluar dhe kundërvepruar, përmes masave përkatëse nga secili Shtet, financimin e terroristëve dhe organizatave terroriste, pavarësisht nga fakti nëse financimi bëhet drejtpërdrejt ose jodrejtpërdrejt përmes organizatave që kanë ose pretendojnë se kanë qëllime bamirësie, sociale ose kulturore, ose të cilat janë gjithashtu të përfshira në aktivitete joligjore, të tilla si trafikimi i paligjshëm i armëve, drogës dhe i parave nga burime të papastra, përfshirë këtu shfrytëzimin e personave për qëllime të financimit të aktiviteteve terroriste, dhe, në veçanti, për të marrë në konsideratë, kur shihet e përshtatshme, përshtatjen e masave rregullatore për të mos lejuar dhe kundërvepruar ndaj lëvizjes së fondeve të dyshuara që mund të përdoren për qëllime terroriste pa penguar në asnjë mënyrë lirinë e lëvizjeve legjitime të kapitalit dhe për të intensifikuar shkëmbimin e informacionit lidhur me lëvizjet ndërkombëtare të këtyre fondeve,

Duke kujtuar gjithashtu Rezolutën 52/165 të 15 dhjetorit 1997, të Asamblesë së Përgjithshme, në të cilën Asambleja u bëri thirrje Shteteve të merrnin parasysh posaçërisht zbatimin e masave të përshkruara në paragrafet 3 (a) deri në (f) të Rezolutës së saj 51/210 të 17 dhjetorit 1996,

Duke kujtuar më tej Rezolutën 53/108 të 8 dhjetorit 1998, në të cilën Asambleja vendosi që Komiteti Ad Hoc i themeluar mbi bazën e Rezolutën 52/210 të 17 dhjetorit 1996 të Asamblesë së Përgjithshme, duhej të përpunonte draftin e një konvente ndërkombëtare për luftën kundër financimit të terrorizmit, i cili t'i shtohej instrumenteve ndërkombëtare përkatëse ekzistuese,

Duke kujtuar gjithashtu Rezolutën 52/165 të 15 dhjetorit 1997, të Asamblesë së Përgjithshme, në të cilën Asambleja u bëri thirrje Shteteve të merrnin parasysh posaçërisht zbatimin e masave të përshkruara në paragrafët 3 (a) deri në (f) të Rezolutës së saj 51/210 të 17 dhjetorit 1996,

Duke kujtuar më tej Rezolutën 53/108 të 8 dhjetorit 1998, në të cilën Asambleja vendosi që Komiteti Ad Hoc i themeluar mbi bazën e Rezolutës 51/210 të 17 dhjetorit 1996 të Asamblesë së Përgjithshme, duhej të përpunonte draftin e një konvente ndërkombëtare për luftën kundër financimit të terrorizmit, i cili t'i shtohej instrumenteve ndërkombëtare përkatëse ekzistuese,

Duke pasur parasysh se financimi i terrorizmit përbën një shqetësim të rëndë për komunitetin ndërkombëtar në tërësi,

Duke vënë në dukje se numri dhe serioziteti i akteve të terrorizmit ndërkombëtar varet nga financimi që terroristët munden të sigurojnë,

Duke vënë në dukje se instrumentet legale ekzistuese multilaterale nuk e përmendin shprehimisht një financim të tillë,

Duke qenë të bindur për nevojën urgjente të intensifikimit të bashkëpunimit ndërkombëtar midis Shteteve në sajimin dhe përshtatjen e masave efektive për parandalimin e financimit të terrorizmit, si edhe të luftës kundër tij përmes ndjekjes dhe ndëshkimit të fajtorëve,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Për qëllimet e kësaj Konvente:

1. "Fonde" ka kuptimin e aseteve të çdo lloji, të prekshme apo të paprekshme, të luajtshme ose të paluajtshme, pavarësisht se si janë vënë, dhe dokumente ligjore ose instrumente të çdo forme, përfshirë këtu mjete elektronike ose dixhitale, që dëshmojnë të drejtat ose interesin në asete të tilla, si kredi bankare, çeqe udhëtarësh, çeqe bankare, mandatpagesa, aksione, siguracione, bono, urdhërpagesa, letra krediti.

2. "Mjet shtetëror ose qeveritar" ka kuptimin e një mjeti të përhershëm ose të përkohshëm ose të një autorizimi që përdoret ose shtihet në dorë nga përfaqësues të Shtetit, anëtarë të qeverisë, zyrtarë të legjislativit ose të gjyqësorit ose punonjës të shtetit ose të ndonjë autoriteti tjetër publik

ose të ndonjë institucioni, ose nga punonjës apo zyrtarë të një organizate ndërqeveritare dhe që ka lidhje me përgjegjësitë e tyre zyrtare.

3. "Të ardhura" konsiderohen të gjitha ato fonde që rrjedhin nga ose janë siguruar drejtpërdrejt ose tërthorazi përmes kryerjes së një shkeljeje të përmendur në nenin 2.

Neni 2

1. Sipas kësaj Konvente, çdo person konsiderohet se kryen një shkelje nëse ai direkt ose indirekt, në mënyrë të paligjshme dhe me dëshirë, siguron ose grumbullon fonde me synimin që ato të përdoren ose ka dijeni se ato do të përdoren plotësisht ose pjesërisht për të kryer:

(a) një veprim që përbën një shkelje brenda kuadrit të shkeljeve të përcaktuara në një prej traktateve të listuara tek aneksi; ose

(b) çdo akt tjetër që ka për qëllim të shkaktojë vdekjen ose plagosje të rëndë trupore të një civili ose të çdo personi tjetër që nuk merr pjesë aktive në armiqësitë e situatave të një konflikti të armatosur, kur qëllimi i një veprimi të tillë nga natyra ose konteksti është ta frikësojë popullatën ose ta detyrojë qeverinë ose një organizatë ndërkombëtare të kryejë ose të mos e kryejë një veprim.

2. (a) Me depozitimin e instrumentit të ratifikimit, pranimit, miratimit ose të hyrjes në fuqi, një Shtet Anëtar, i cili nuk është anëtar i atij traktati të përmendur në aneks, mund të deklarojë mospërfshirjen e tij në aneksin të cilit i referohet paragrafi 1 nënparagrafi a. Kjo deklaratë do të shfuqizohet sapo traktati të hyjë në fuqi për Shtetin Anëtar, i cili njofton depozitimin e këtij instrumenti.

(b) Kur një Shtet Anëtar heq dorë nga anëtarësia në traktatin e përmendur në aneks, ai mund të bëjë një deklaratë në lidhje me këtë traktat, siç thuhet në këtë nen.

3. Që një akt të përbëjë një krim, të parashtruar në paragrafin 1, nuk është patjetër e nevojshme që fondet të jenë përdorur për të kryer një shkelje të përmendur në paragrafin 1 nënparagrafi (a) ose (b).

4. Çdo person konsiderohet se ka kryer krim, nëse ai përpiqet të kryejë njërën prej veprave të parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni.

5. Çdo person kryen një krim nëse ai:

(a) merr pjesë si bashkëpunëtor në njërën prej veprave të parashikuara në paragrafin 1 ose 4 të këtij neni;

(b) organizon ose udhëheq të tjerët për të kryer njërin prej veprave të parashikuara në paragrafin 1 ose 4 të këtij neni;

(c) kontribuon në kryerjen e një ose të më shumë veprave të parashikuara në paragrafin 1 ose 4 të këtij neni, kur këto vepra kryhen nga një grup personash, që kanë një qëllim të përbashkët. Një kontribut i tillë do të jetë i qëllimshëm dhe do të kryhet:

(i) ose për të çuar më tej aktivitetin ose qëllimin kriminal të grupit ku një qëllim ose veprim i tillë përfshin kryerjen e një krimi të parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni;

(ii) ose duke patur dijeni për qëllimin e grupit, i cili kryen njërin nga krimet e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 3

Kjo Konventë nuk zbatohet kur krimi kryhet brenda një Shteti të vetëm kur shkelësi është nënshtetas i atij vendi dhe është prezent në territorin e atij dhe asnjë Shtet tjetër sipas nenit 7 paragrafit 1 ose nenit 7 paragrafit 2 nuk kanë të drejtë të ushtrojnë juridiksionin e vet, me përjashtim të rasteve të parashikuara në dispozitat e neneve 12-18.

Neni 4

Çdo Shtet Anëtar duhet të adaptojë masa të tilla të domosdoshme:

(a) t'i konsiderojë si akte kriminale sipas ligjeve të vendit veprat e parashikuara në nenin 2.

(b) t'i shpallë këto vepra të dënueshme nëpërmjet dënimeve të përshtatshme, dënime të cilat duhen të marrin parasysh natyrën e rëndë të këtyre veprave.

Neni 5

1. Çdo Shtet Anëtar, në përputhje me ligjet e veta në fuqi, duhet të ndërmarrë masat e nevojshme për të bërë të mundur që një person juridik brenda territorit të këtij Shteti ose i organizuar sipas ligjeve të tij, të mbajë përgjegjësi kur një person përgjegjës për menaxhimin ose kontrollin e atij personi juridik ka kryer një prej veprave të parashikuara në nenin 2. Përgjegjësia e mbajtur do të jetë penale, civile ose administrative.

2. Një përgjegjësi e tillë duhet të mos cenojë përgjegjësinë kriminale të individit që ka kryer krimet.

3. Çdo Shtet Anëtar duhet të garantojë që këta persona juridikë, sipas paragafit 1 më sipër, t'i nënshtrohen sanksioneve efektive, proporcionale penale, civile ose administrative. Këtu mund të përfshihen edhe sanksionet monetare.

Neni 6

Çdo Shtet Anëtar duhet të adaptojë masa të tilla të nevojshme, përfshirë këtu legjislacionin vendas, për të siguruar që aktet kriminale të përmendura në këtë Konventë nuk mund të justifikohen në asnjë rrethanë me arsye politike, filozofike, ideologjike, raciale, etnike, fetare ose të natyrave të ngjashme me to.

Neni 7

1. Çdo Shtet Anëtar duhet të marrë masat e nevojshme për të ushtruar juridiksionin e vet ndaj krimeve të parashikuara në nenin 2 kur:

(a) krimi është kryer në territorin e atij Shteti;

(b) krimi është kryer në bordin e një anijeje që mban flamurin e atij Shteti ose në bordin e një aeroplani të regjistruar sipas ligjeve të atij Shteti në kohën kur është kryer krimi;

(c) krimi kryhet nga një nënshtetas i atij Shteti.

2. Një Shtet Anëtar mund të ushtrojë juridiksionin e vet ndaj një krimi edhe kur:

(a) krimi, i parashikuar në nenin 2 paragrafi 1, nënparagrafi a ose b drejtohet ndaj një shtetasi të atij Shteti ose kur rezulton i kryer në territorin e atij Shteti;

(b) krimi, i parashikuar në nenin 2 paragrafi 1, nënparagrafi a ose b, është drejtuar kundër Shtetit ose kundër një ndërtese qeveritare të atij Shteti jashtë, duke përfshirë këtu përfaqësitë diplomatike ose konsullore të atij Shteti;

(c) krimi, i parashikuar në nenin 2 paragrafi 1, nënparagrafi a ose b, ka ardhur si rezultat i një përpjekjeje për ta detyruar atë shtet të kryejë ose jo një veprim;

(d) krimi kryhet nga një person pa shtetësinë e atij Shteti, ndërkohë që jeton në atë Shtet;

(e) krimi kryhet në bordin e një aeroplani, i cili është në funksion të atij Shteti.

3. Me ratifikimin, pranimin, miratimin, ose me anëtarësimin në këtë Konventë, çdo Shtet Anëtar duhet të njoftojë sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për juridiksionin që ai ka vendosur në përputhje me paragrafin 2. Nëse do të ndodhë ndonjë ndryshim, Shteti Anëtar përkatës duhet të njoftojë menjëherë Sekretarin e Përgjithshëm.

4. Po ashtu çdo Shtet Anëtar duhet të marrë masat e nevojshme për të ushtruar juridiksionin e vet ndaj krimeve të parashikuara në nenin 2 edhe në rastet kur i dyshuari për krim është prezent në territorin e atij Shteti dhe ai Shtet nuk e ekstradon atë person në ndonjë prej Shteteve Anëtare, që e kanë vendosur juridiksionin e tyre në përputhje me paragrafët 1 ose 2.

5. Kur më shumë sesa një Shtet Anëtar pretendon të ketë juridiksionin ndaj krimeve të parashikuara në nenin 2, atëherë këto Shtete Anëtare duhet të përpiqen t'i koordinojnë si duhet veprimet e tyre, veçanërisht të sigurojnë kushtet për hetim dhe modalitetet për asistencë reciproke ligjore.

6. Pa cenuar normat e ligjit të përgjithshëm ndërkombëtar, kjo Konventë nuk përjashton ushtrimin e një juridiksioni kriminal të një Shteti Anëtar në lidhje me ligjet e veta të brendshme.

Neni 8

1. Secili Shtet Anëtar do të marrë masat e nevojshme në përputhje me parimet ligjore të vendit të vet, për identifikimin, zbulimin, dhe ngrirjen ose kapjen e çdo fondi të përdorur ose të caktuar për të kryer krimet e përshkruara në nenin 2, si edhe të ardhurat prej krimesh të tilla me qëllim të mbajtjes së mundshme të shumave.

2. Secili Shtet Anëtar do të marrë masat e nevojshme, në përputhje me parimet ligjore të vendit të vet për mbajtjen e fondeve të përdorura ose të caktuara për të kryer krimet e përshkruara në nenin 2, si edhe të ardhurat e rrjedhura prej krimesh të tilla.

3. Secili Shtet Anëtar, i interesuar, mund të marrë në konsideratë hartimin e marrëveshjeve me Shtete të tjera Anëtare për të përdorur bashkërisht e rast pas rasti fondet e krijuara prej mbajtjeve nga llogaritë e bllokuara që përmenden në këtë nen.

4. Secili Shtet Anëtar duhet të marrë në konsideratë ndërtimin e mekanizmave me anë të të cilave fondet e krijuar nga mbajtjet e llogarive të bllokuara të përmendura në këtë nen, të përdoren për të zhdëmtuar viktimat e krimeve të përmendura në nenin 2 paragrafi 1, nënparagrafi a ose b, ose familjet e tyre.

5. Dispozitat e këtij neni duhet të zbatohen pa cenuar të drejtat e Palëve të treta që veprojnë në mirëbesim.

Neni 9

1. Me të marrë informacionin se një person që e ka kryer një krim ose që supozohet ta ketë kryer atë krim, të përmendur në nenin 2, mund të jetë prezent në territorin e vet, Shteti Anëtar përkatës duhet të marrë masat e nevojshme sipas ligjeve të vendit të vet për të hetuar faktet që përmbahen në informacionin e dhënë.

2. Me t'u kënaqur me informacionin dhe me faktin se rrethanat e lejojnë, Shteti Anëtar, në territorin e të cilit ndodhet krimineli ose i akuzuari për krim, duhet të marrë masat përkatëse sipas ligjeve të vendit të vet në mënyrë që të garantojë prezencën e personit për qëllimet e ndjekjes dhe të ekstradimit.

3. Çdo person, ndaj të cilit janë marrë masat e përmendura në paragrafin 2, duhet të ketë të drejtë të:

(a) komunikojë pa vonesë me përfaqësuesin përkatës më të afërt të Shtetit, shtetësinë e të cilit ai mban, ose i cili ka të drejtën t'i mbrojë të drejtat e atij personi, ose nëse ai person është banor i atij shteti pa qenë shtetas i tij;

(b) kontaktohet nga një përfaqësues i atij Shteti;

(c) informohet për të drejtat që gëzon sipas nënparagrafëve a dhe b.

4. Të drejtat e përmendura në paragrafin 3 duhet të ushtrohen në përputhje me ligjet dhe rregullat e Shtetit, në territorin e të cilit krimineli ose i akuzuari për krim është prezent. Kjo duhet të bëhet në përputhje me dispozitën, sipas së cilës ligjet dhe rregullat e mësipërme duhet të sigurojnë arritjen e qëllimeve, të cilave iu shërbejnë të drejtat e akorduara në paragrafin 3.

5. Dispozitat e paragrafëve 3 dhe 4 duhet të mos cenojnë të drejtën e çdo Shteti Anëtar të kërkojë juridiksionin e vet në përputhje me nenin 7 paragrafin 1, nënparagrafin b ose paragrafin 2, nënparagrafin b, për të ftuar Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq për të komunikuar me dhe për të vizituar të akuzuarin për krim.

6. Sipas këtij neni, kur një Shtet Anëtar ka marrë një person nën mbikëqyrje, ai duhet të njoftojë menjëherë direkt ose nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara Shtetet Anëtare, të cilat kanë vendosur juridiksionin siç përshkruhet në nenin 7 paragrafi 1 ose 2 dhe nëse ai e konsideron të arsyeshme mund të njoftojë edhe Shtete të tjera Anëtare të interesuara që personi në fjalë është nën mbikqyrje dhe për rrethanat në të cilat ai mbahet i ndaluar. Shteti që heton faktet e

përmendura me hollësi në paragrafin 1 duhet të informojë menjëherë Shtetet Anëtare, si më sipër, për rezultatet e hetimit dhe duhet të tregojë nëse ai synon të ushtrojë juridiksionin e vet.

Neni 10

1. Shteti Anëtar, në territorin e të cilit ndodhet i akuzuari për krim, në rastet që parashikohen në nenin 7, duhet që, nëse nuk e ekstradon atë person, të jetë i detyruar pa përjashtim ta kalojë rastin për hetim pa asnjë vonesë tek autoritetet kompetente sipas procedurave të ligjeve të atij Shteti. Kjo duhet të ndodhë pavarësisht nga fakti nëse krimi është kryer ose jo në atë Shtet. Autoritetet e Shtetit duhet t'i marrin vendimet në të njëjtën mënyrë, si edhe në rastin e një krimi shumë të rëndë, në përputhje me ligjet e atij Shteti.

2. Sa herë që Shteti Anëtar lejohet nga ligji i vendit të vet të ekstradojë ose të dorëzojë njërin prej shtetasve të vet vetëm me kushtin që personi t'i kthehet sërisht Shtetit për të vuajtur dënimin e dhënë si rezultat i një gjyqi ose procedure për të cilën ishte kërkuar ekstradimi ose dorëzimi i personit; sa herë që ky Shtet dhe Shteti që kërkon ekstradimin e personit merren vesh për këtë variant dhe për kushtet e tjera që ata i gjykojnë të përshtatshme, atëherë një ekstradim ose dorëzim i tillë me kushte, duhet të jetë i mjaftueshëm për t'u çliruar nga detyrimi i përmendur në paragrafin 1.

Neni 11

1. Krimet e përmendura në nenin 2 duhet të gjykohen për t'u përfshirë si krime të ekstradueshme në çdo traktat ekstradimi që ekziston midis çdonjërit prej Shteteve Anëtare para se kjo Konventë të hyjë në fuqi. Shtetet Anëtare marrin përsipër t'i përfshijnë krime të tilla si krime të ekstradueshme në çdo marrëveshje ekstradimi që arrihet midis tyre.

2. Kur një Shtet Anëtar që bën një ekstradim mbi bazën e një traktati ekzistues merr një kërkesë për ekstradim nga një Shtet tjetër Anëtar, me të cilin ai nuk ka marrëveshje ekstradimi, Shtetit Anëtar të cilit i bëhet kërkesa, po të dojë e konsideron këtë Konventë si një bazë ligjore për ekstradimin e rasteve të krimeve të parashikuara në nenin 2. Ekstradimi duhet t'i nënshtrohet edhe kërkesave të tjera të ligjit të Shtetit të cilit i është kërkuar ekstradimi.

3. Shtetet Anëtare që nuk kanë marrëveshje për të bërë ekstradim me kushte duhet të njohin krimet e parashikuara në nenin 2 si krime të ekstradueshme midis këtyre Shteteve dhe kjo bëhet në përputhje me kërkesat e ligjit të Shteit të cilit i është kërkuar ekstradimi.

4. Krimet e parashikuaraa në nenin 2 duhet të trajtohen, nëse është e nevojshme për qëllime ekstradimi midis Shteteve Anëtare, jo vetëm si krime të kryera në vendin ku janë kryer, por gjithashtu edhe si krime të kryera në territorin e Shteteve që kanë ndërtuar juridiksione në përputhje me nenin 7 paragrafët 1 dhe 2.

5. Dispozitat e të gjitha traktateve dhe marrëveshjeve midis Shteteve Anëtare mbi ekstradimin e personave për krimet e përshkruara në nenin 2 duhet të gjykohen për t'u modifikuar si traktate dhe marrëveshje midis Shteteve Anëtare deri në atë shkallë sa të harmonizohen me këtë Konventë.

Neni 12

1. Shtetet Anëtare duhet t'i ofrojnë njëra-tjetrës masën më të madhe të ndihmës në lidhje me hetimet kriminale ose procedurat kriminale ose procedurat e ekstradimit për krimet e përshkruara në nenin 2, përfshirë këtu ndihmën për sigurimin e të dhënave që i posedon Pala tjetër dhe që janë të nevojshme për procedimin e mëtejshëm.

2. Shtetet Anëtare nuk kanë të drejtë ta refuzojnë kërkesën për ndihmë ligjore reciproke, duke nxjerrë si pretekst ruajtjen e sekretit.

3. Pala që kërkon ndihmë nuk duhet ta transmetojë ose ta përdorë informacionin ose faktet me të cilat është furnizuar nga Pala tjetër për hetime, ndjekje ose procedura të ndryshme nga ato që

janë formuluar në kërkesë, pa miratimin paraprak të Palës ndihmuese.

4. Çdonjëri prej Shteteve Anëtare kanë të drejtë të marrë në konsideratë ndërtimin e mekanizmave për të shkëmbyer me Shtetet e tjera Anëtare informacionin ose faktet e nevojshme për të kërkuar mbajtjen e përgjegjësisë kriminale, civile e administrative siç përshkruhen në nenin 5.

5. Shtetet Anëtare duhet të realizojnë detyrimet që rrjedhin nga paragrafët 1 dhe 2, konform çdo traktati dhe marrëveshjeje tjetër ekzistuese midis tyre për ndihmën ligjore reciproke dhe për shkëmbimin e informacionit. Në mungesë të traktateve dhe të marrëveshjeve të tilla, Shtetet Anëtare duhet t'i japin ndihmë njëri-tjetrit në përputhje me ligjet e vendeve të veta.

Neni 13

Asnjëri nga krimet e përshkruara në nenin 2 nuk duhet të shihet si një krim financiar kur është fjala për ekstradimin ose ndihmën ligjore reciproke. Po ashtu, Shtetet Anëtare nuk kanë të drejtë të refuzojnë një kërkesë për ekstradim ose për ndihmë ligjore reciproke vetëm sepse krimi ka natyrë financare.

Neni 14

Asnjëri nga krimet e përshkruara në nenin 2 nuk duhet të shihet si një krim politik ose si një krim i lidhur me një krim politik ose si një krim i frymëzuar nga motive politike. Po ashtu një kërkesë për ekstradim ose për ndihmë ligjore reciproke, e bazuar në një krim të tillë, nuk është mirë të refuzohet vetëm sepse krimi është politik ose sepse krimi është i lidhur me një krim politik ose sepse krimi është frymëzuar nga motive politike.

Neni 15

Asgjë në këtë Konventë nuk duhet të intepretohet si imponim i detyrimit për të ekstraduar ose për të ofruar ndihmë ligjore reciproke, në qoftë se Shteti Anëtar të cilit i është kërkuar kjo gjë, ka arsye thelbësore të besojë se kërkesa për ekstradim për krimet e përshkruara në nenin 2 ose kërkesa për ndihmë ligjore reciproke që lidhet me krime të tilla ka qenë paraqitur me synim persekutimin ose ndëshkimin e një personi për shkak të racës, fesë, kombësisë, origjinës etnike ose opinionit politik. Kjo vlen edhe për rastin kur pranimi i kërkesës mund të shkaktojë dëmtimin e pozitës së personit për çdonjërin prej këtyre shkaqeve.

Neni 16

1. Ku një person që është ndaluar ose që vuan një dënim në territorin e një Shteti Anëtar, kërkohet prej një Shteti tjetër Anëtar të jetë prezent në këtë të fundit për qëllime identifikimi, dëshime ose për të ofruar ndihmë në sigurimin e të dhënave për hetim ose ndjekje të krimeve siç përshkruhen në nenin 2, atëherë ai mund të transferohet nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

(a) Personi e pranon lirisht e me vetëdije këtë gjë.

(b) Autoritetet kompetente të të dy Shteteve bien dakord për kushtet të cilat i gjykojnë të përshtatshme vetë Shtetet.

2. Në funksion të qëllimeve të këtij neni:

(a) Shteti në të cilin personi transferohet duhet të ketë autoritetin dhe detyrimin ta mbajë personin e transferuar nën mbikqyrje, nëse nuk kërkohet dhe nuk autorizohet gjë tjetër nga Shteti prej të cilit personi u transferua;

(b) Shteti në të cilin personi transferohet duhet që, pa vonesë, të zbatojë detyrimin e vet për ta kthyer personin nën mbikqyrjen e Shtetit e nga i cili personi u transferua në bazë të marrëveshjes paraprake ose ashtu siç ishte ranë dakord nga autoritetet kompetente të të dyja Shteteve;

(c) Shteti në të cilin personi transferohet nuk duhet t'i kërkojë Shtetit nga i cili personi u transferua të fillojë procedurat ekstraduese për kthimin e personit;

(d) personit të transferuar duhet t'i njihet dënimi i vuajtur në Shtetin nga i cili ai/ajo u transferua si kohë e shpenzuar nën mbikqyrjen e Shtetit në të cilin ai/ajo transferohet.

3. Nëse Shteti Anëtar, nga i cili një person është për t'u transferuar në përputhje me këtë nen, nuk bie dakord, atëherë ai person pavarësisht nga kombësia e tij nuk duhet të ndiqet penalisht ose nuk duhet të ndalohet ose nuk duhet t'i nënshtrohet ndonjë kufizimi të lirisë së tij personale në territorin e Shtetit në të cilin ai person transferohet për akte ose vepra që ai i ka kryer përpara largimit të tij nga territori i Shtetit, nga i cili ky person u transferua.

Neni 17

Çdo personi të vendosur nën mbikqyrje ose ndaj të cilit janë ndërmarrë masa të tjera ose janë kryer procedura në përputhje me këtë Konventë duhet t'i sigurohet trajtim i drejtë, përfshirë këtu të gjitha të drejtat dhe garancitë në përputhje me ligjin e Shtetit, në territorin e të cilit ky person është prezent, si edhe dispozitat e aplikueshme të ligjit ndërkombëtar, përfshirë këtu ligjin ndërkokmbëtar për të drejtat e njeriut.

Neni 18

1. Shtetet Anëtare duhet të bashkëpunojnë për parandalimin e krimeve të parashikuara në nenin 2, duke marrë të gjitha masat e aplikueshme, ndër të tjera duke përshtatur legjislacionin e vendeve të veta, nëse kjo është e nevojshme, të parandalojnë dhe të kundërveprojnë në territoret përkatëse ndaj krimeve të kryera brenda ose jashtë territoreve të tyre, duke përfshirë:

(a) masat për të penguar në territoret e tyre aktivitetet e paligjshme të personave dhe organizatave që nxisin, provokojnë, organiziojnë ose përfshihen qëllimisht në kryerjen e krimeve të parashikuara në nenin 2;

(b) procedurat që u kërkojnë institucioneve financiare dhe profesioneve të tjera të përfshira në transaksione financiare të përdorin rrugët më efikase për identifikimin e klientëve të tyre të zakonshëm ose të rastit, si edhe klientë në interes të të cilëve janë hapur llogari bankare dhe t'i kushtojnë gjithashtu vëmendje të veçantë transaksioneve të pazakonshme ose të dyshimta dhe të raportojnë transaksionet, për të cilat ka dyshime se rrjedhin nga një aktivitet kriminal. Për këtë qëllim Shtetet Anëtare duhet të kenë parasysh:

(i) adaptimin e rregulave që pengojnë çeljen e atyre llogarive, zotëruesit ose përfituesit e të cilave janë të paidentifikuar ose të paidentifikueshëm dhe marrjen e masave që garantojnë që këto institucione të verifikojnë identitetin e pronarëve realë të transaksioneve të tilla;

(ii) që lidhur me identifikimin e entiteteve legale, që kërkojnë institucione financiare, të marrin masa kur është e nevojshme për verifikimin e ekzistencës ligjore dhe të strukturës së klientit, duke marrë ose nga ndonjë regjistër publik ose nga klienti apo nga të dy së bashku vërtetimet e hyrjeve, përfshirë këtu informacionin për emrin e klientit, gjendjen civile, adresën, drejtorët dhe dispozitat që rregullojnë institucionin;

(iii) kryerjen e rregullimeve që u imponojnë institucioneve financiare detyrimin për t'u raportuar menjëherë autoriteteve kompetente të gjitha transaksionet e mëdha, komplekse dhe të jashtëzakonshme, si edhe modelet e pazakonshme të transaksioneve që nuk kanë qëllim të dukshëm ekonomik e që duket se nuk janë ligjore, pa frikën se ngarkohen me përgjegjësi kriminale ose civile për thyerjen e kufizimeve për daljen e informacionit, nëse ata i raportojnë dyshimet e tyre në mirëbesim;

(iv) t'u kërkojnë institucioneve financiare të ruajnë të paktën për pesë vjet të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për transaksionet brenda vendit dhe për ato ndërkombëtare.

2. Shtetet Anëtare duhet të bashkëpunojnë në vijim për parandalimin e krimeve të përshkruara në nenin 2 duke patur parasysh:

(a) masat për mbikqyrjen, përfshirë p.sh. licencimin e të gjitha agjencive që bëjnë transferta parash;

(b) masa të përshtatshme për zbulimin ose monitorimin e transportit fizik ndërkufituar të

parasë kesh dhe të transportuesve të instrumenteve, të cilat u nënshtrohen rregullave shumë strikte për të siguruar përdorimin e duhur të informacionit, pa penguar lëvizjen e lirë të kapitaleve.

3. Shtetet Anëtare duhet të bashkëpunojnë në vijim për parandalimin e krimeve të përshkruara në nenin 2, duke shkëmbyer informacion të saktë dhe të verifikuar në përputhje me ligjin e vendit dhe duke koordinuar masat administrative dhe masat e tjera të marra ashtu siç duhet për të parandaluar kryerjen e krimeve të përshkruara në nenin 2, veçanërisht përmes:

(a) hapjes dhe mbajtjes së kanaleve të komunikimit midis agjencive dhe shërbimeve të tyre kompetente për të lehtësuar sigurimin e shkëmbimit të shpejtë të informacionit në lidhje me të gjitha aspektet e krimeve të përshkruara në nenin 2;

(b) bashkëpunimit me njëri-tjetrin dhe kryrjen e hetimeve për krime të përshkruara në nenin 2 lidhur me:

(i) identitetin, vendndodhjen dhe aktivitetet e personave për të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm për përfshirjen e tyre në krime të tilla;

(ii) Lëvizjen e fondeve lidhur me kryrjen e krimeve të tilla.

4. Shtetet Anëtare mund të shkëmbejnë informacion përmes Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (Interpol).

Neni 19

Shteti Anëtar ku i akuzuari për krim ndiqet duhet që, në përputhje me ligjin e vendit të vet ose me procedurat që aplikohen, të komunikojë rezultatin përfundimtar të procedimit te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, i cili duhet t'ua transmetojë informacionin Shteteve të tjera Anëtare.

Neni 20

Shtetet Anëtare duhet t'i përmbushin detyrimet e tyre që rrjedhin nga kjo Konventë në mënyrën që përputhet me parimet e sovranitetit, të barazisë dhe të integritetit territorial të Shteteve, si dhe të mosndërhyrjes në punët e brendshme të Shteteve të tjera.

Neni 21

Asgjë në këtë Konventë nuk duhet të prekë të drejtat e tjera, detyrimet dhe përgjegjësitë e Shteteve dhe të individëve që rrjedhin nga ligji ndërkombëtar, në veçanti nga qëllimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara, nga ligji humanitar ndërkombëtar dhe nga konventa të tjera.

Neni 22

Asgjë në këtë Konventë nuk i jep të drejtë një Shteti Anëtar për të ndërmarrë në territorin e një Shteti tjetër Anëtar ushtrimin e juridiksionit ose kryerjen e funksioneve që u lejohen vetëm autoriteteve të Shtetit tjetër Anëtar nga ligji i vendit të vet.

Neni 23

1. Aneksi mund të amendohet duke shtuar në të traktate të lidhura me të që:

(a) janë të hapura për pjesëmarrjen e të gjitha Shteteve;

(b) kanë hyrë në fuqi;

(c) janë ratifikuar, pranuar ose miratuar nga të paktën njëzet e dy Shtete Anëtare të Konventës aktuale.

2. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente çdo njëri prej Shteteve Anëtare mund të propozojë një amendament. Çdo propozim për një amendament duhet të depozitohet me shkrim. Arkivisti duhet t'ua njoftojë propozimet që i plotësojnë kërkesat e paragrafit 1 të gjitha Shteteve Anëtare dhe

të kërkojë pikëpamjet e tyre, nëse amendamenti i propozuar duhet të adaptohet apo jo.

3. Amendamenti i propozuar duhet të gjykohet i adaptuar, nëse një e treta e Shteteve Anëtare nuk e kundërshtojnë atë me shkrim brenda 180 ditëve nga qarkullimi i saj.

4. Amendamenti i adaptuar në aneks duhet të hyjë në fuqi 30 ditë pas depozitimit të instrumentit të njëzet e dytë të ratifikimit, të pranimit dhe të miratimit të amendamentit për të gjitha Shtetet Anëtare që e kanë depozituar një instrument të tillë. Për secilin nga Shtetet Anëtare që ratifikon, pranon ose miraton amendamentin pas depozitimit të instrumentit të njëzetedytë, amendamenti duhet të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas depozitimit nga Shteti Anëtar i instrumenteve të tij të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

Neni 24

1. Çdo diskutim midis dy ose më shumë Shteteve Anëtare lidhur me interpretimin ose aplikimin e kësaj Konvente që nuk zgjidhet përmes negociimeve brenda një kohe të arsyeshme duhet që me kërkesën e njërës prej Palëve të dërgohet për arbitrazh. Nëse brenda gjashtë muajsh nga data e kërkesës për arbitrazh Palët nuk janë të afta të bien dakord për organizimin e arbitrazhit, çdonjëra prej këtyre Palëve ka të drejtë ta referojë diskutimin në Gjyqin Ndërkombëtar, duke aplikuar në përputhje me Statusin e Gjyqit.

2. Secili Shtet ka të drejtë që në kohën e nënshkrimit, të ratifikimit, të pranimit ose të miratimit të kësaj Konvente ose të hyrjes së saj në fuqi, të deklarojë se ai nuk e konsideron veten të detyruar të zbatojë paragrafin 1. Shtetet e tjera Anëtare nuk mund të detyrojnë asnjë Shtet tjetër Anëtar që ka shprehur një rezervë të tillë të ndjejë detyrimin e paragrafit 1.

3. Çdo Shtet që ka shprehur një rezervë në lidhje me paragrafin 2 ka të drejtë që në çdo kohë ta tërheqë atë rezervë me shkrim te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Neni 25

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim nga të gjitha Shtetet që prej 10 janarit 2000 deri në 31 dhjetor 2001 në Selinë e Kombeve në Nju Jork.

2. Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit. Instrumentet e ratifikimit, të pranimit të miratimit duhet të depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

3. Kjo Konventë do të jetë e hapur për t'i miratuar nga çdo Shtet. Instrumentet e miratimit duhet të depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Neni 26

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit të instrumentit të njëzetedytë të ratifikimit, pranimit, ose miratimit te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

2. Çdo Shtet që ratifikon, pranon, ose miraton Konventën pas depozitimit të instrumentit të njëzet e dytë të ratifikimit, pranimit, miratimit, Konventa do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas depozitimit nga Shteti përkatës i instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit.

Neni 27

1. Çdo Shtet Anëtar ka të drejtë ta denoncojë këtë Konventë me shkrim te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

2. Denoncimi duhet të hyjë në fuqi një vit pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Neni 28

Origjinali i kësaj Konvente, tekstet arabe, kineze, angleze, franceze, ruse dhe spanjolle të së cilës janë po aq identike, duhet të depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, i cili duhet t'ua dërgojë kopjet e certifikuara të gjitha Shteteve.

Të poshtëshënuarit, duke qenë të autorizuar si duhet nga Qeveritë e tyre përkatëse, e kanë nënshkruar këtë Konventë, të hapur për nënshkrim në Selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork më 10 janar 2000.

Aneks

Konventa për Luftën ndaj Rrëmbimit të Paligjshëm të Aeroplanëve, e Hagës më 16 dhjetor 1970.

Konventa për Luftën ndaj Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Aviacionit Civil, e Montrealit më 23 shtator 1971.

Konventa për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimeve kundër Personave të Mbrojtur Ndërkombëtarisht, përfshirë diplomatët, adaptuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në 14 dhjetor 1973.

Konventa Ndërkombëtare kundër Marrjes së Pengjeve, adaptuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkauar në 17 dhjetor 1979.

Konventa mbi Mbrojtjen Fizike të Materialit Bërthamor, adaptuar në Vjenë në 3 mars 1980.

Protokolli për Luftën kundër Akteve të Paligjshme të Dhunës në Aeroportet që i Shërbejnë Aviacionit Civil Ndërkombëtar, suplement i Konventës për Luftën kundër Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Aviacionit Civil, në Montreal në 24 shkurt 1988.

Konventa për Luftën ndaj Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Lundrimit Oqeanik, në Romë në 10 mars 1988.

Protokolli për Luftën kundër Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Platformave Fikse të vendosura në Raftet Kontinentale, në Romë në 10 mars 1988.

Konventa Ndërkombëtare për Luftën kundër Bombardimeve Terroriste, adaptuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në 15 dhjetor 1997.

LIGJ
Nr.8920, datë 11.7.2002

PËR RATIFIKIMIN E "KONVENTËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR NDËRKOMBËTAR" DHE DY PROTOKOLLEVE SHTESË TË SAJ

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar" dhe dy protokolleve shtesë të saj, "Protokolli kundër trafikut të migrantëve me rrugë tokësore, ajrore dhe detare" dhe "Protokolli për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3411, datë 22.7.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.41, faqe 1195

KONVENTA
E KOMBEVE TË BASHKUARA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR NDËRKOMBËTAR

Neni 1
Deklarimi i qëllimit

Qëllimi i kësaj Konvente është të nxisë bashkëpunimin për të parandaluar dhe luftuar efektivisht krimin e organizuar ndërkombëtar.

Neni 2
Përdorimi i termave

Për qëllimet e kësaj Konvente:

(a) “Grup kriminal i organizuar” nënkupton një grup të strukturuar, i cili ka ekzistuar për një periudhë kohe të caktuar, i përbërë nga tre ose më shumë persona, të cilët veprojnë në harmoni me njëri-tjetrin, me qëllim që të kryejnë një ose më shumë krime ose vepra penale serioze, të përcaktuara si të tilla në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, me qëllim që të sigurojnë, në mënyrë direkte ose indirekte, përfitime financiare ose materiale.

(b) "Krim serioz" nënkupton atë akt që përbën një vepër penale të ndëshkueshme me një dënim maksimal të heqjes së lirisë prej të paktën katër vjetësh ose me një dënim më të rëndë.

(c) "Grup i strukturuar" nënkupton një grup që nuk është formuar në mëyrë të rastësishme për kryerjen e menjëhershme të një vepre penale dhe që nuk nevojitet të ketë të përcaktuar rolet e anëtarëve të tij, vazhdimësinë e anëtarësimit në të ose të ketë një strukturë të zhvilluar.

(d) "Pasuri" nënkupton pasuritë e çdo lloji, fizike ose jofizike, të luajtshme ose të paluajtshme, reale ose joreale, dhe dokumentet ose instrumentet ligjore, të cilat vërtetojnë një titull ose interes tek këto pasuri.

(e) "Të ardhura nga krimi" nënkupton çdo pasuri që rrjedh ose që është fituar, direkt ose indirekt, nëpërmjet kyerjes së një vepre penale.

(f) "Bllokim" ose "konfiskim" nënkupton ndalimin e përkohshëm të transferimit, shkëmbimit, rregullimit ose zhvendosjes së pasurisë, ose marrjen përkohësisht në ruajtje ose kontrollimin e pasurisë në bazë të një urdhri të lëshuar nga gjykata ose ndonjë autoritet tjetër kompetent.

(g) "Konfiskim", i cili përfshin në raste të veçanta gjobën, nënkupton privimin e përhershëm nga pronësia me anë të një urdhri gjykate ose të ndonjë autoriteti tjetër kompetent.

(h) "Vepër penale bazë" nënkupton çdo vepër penale, si rezultat i së cilës të ardhurat janë nxjerrë me qëllim që të bëhen subjekt i një vepre penale në mënyrën e përshkruar në nenin 6 të kësaj Konvente.

(i) "Shpërndarje e kontrolluar" nënkupton teknikën që lejon kalimin e ngarkesave të paligjshme ose të dyshimta, përmes ose në territorin e një ose më shumë Shteteve, me dijeninë dhe nën mbikëqyrjen e autoriteteve të tyre kompetente, me qëllim që të hetohet një vepër penale dhe të identifikohen personat e përfshirë në kryerjen e veprës penale.

(j) "Organizatë rajonale e integrimit ekonomik" nënkupton një organizatë të krijuar nga

shtete sovrane të një rajoni të caktuar, tek e cila Shtetet Anëtare kanë transferuar kompetenca në lidhje me çështjet që rregullohen nga kjo Konventë dhe që është është e autorizuar në mënyrën e duhur në përputhje me procedurat e saj të brendshme që të nënshkruajë, ratifikojë, pranojë, miratojë, ose aderojë në të; referimet tek "Shtetet Palë", në bazë të kësaj Konvente, do të aplikohen ndaj këtyre organizatave brenda kufijve të kompetencës së tyre.

Neni 3
Fusha e aplikimit

1. Përveç rasteve që parashikohen ndryshe në tekst, kjo Konventë do të aplikohet në lidhje me parandalimin, hetimin dhe ndjekjen penale të:

(a) veprave penale të parashikuara në nenet 5, 6, 8 dhe 23 të kësaj Konvente; dhe

(b) krimet serioze të përcaktuara në nenin 2 të kësaj Konvente.

2. Për qëllimet e paragrafit 1 të këtij neni, një vepër penale ka një natyrë ndërkombëtare në qoftë se:

(a) kryhet në më shumë se një Shtet;

(b) kryhet në një Shtet, por pjesa thelbësore e përgatitjes, planit, drejtimit ose kontrollit kryhet në një Shtet tjetër;

(c) kryhet në një Shtet, por në të është përfshirë një grup kriminal i organizuar, i cili angazhohet në aktivitete kriminale në më shumë se një Shtet; ose

(d) kryhet në një Shtet, por efektet thelbësore i ka në një Shtet tjetër.

Neni 4

Mbrojtja e sovranitetit

1. Shtetet Palë do të zbatojnë detyrimet e tyre që rrjedhin nga kjo Konventë në pajtim me parimet e barazisë së sovranitetit dhe integritetit territorial të Shteteve dhe të mosndërhyrjes në punët e brendshme të Shteteve të tjera.

2. Asgjë në këtë Konventë nuk i jep të drejtën një Shteti Palë që të ushtrojë juridiksionin e tij në territorin e një Shteti tjetër dhe të kryejë funksione që janë e drejtë ekskluzive e autoriteteve të Shtetit tjetër sipas ligjit të tij të brendshëm.

Neni 5
Penalizimi i pjesëmarrjes në një grup kriminal të organizuar

1. Çdo Shtet Palë duhet të adaptojë masa të tilla ligjore dhe masa të tjera që mund të konsiderohen të nevojshme për të cilësuar si vepra penale, në rastet kur kryhen qëllimisht:

a) secilin ose të dy prej rasteve të mëposhtme si vepra penale të dallueshme nga ato që përfshijnë tentativën ose kryerjen e aktivitetit kriminal:

(i) marrëveshjen me një ose disa persona të tjerë për të kryer një krim serioz për një qëllim që lidhet direkt ose jodirekt me marrjen e përfitimeve financiare ose materiale dhe, nëse kërkohet nga legjislacioni i brendshëm, që përfshin një veprim të ndërmarrë nga një prej pjesëmarrësve në zbatim të marrëveshjes, ose që përfshin një grup të organizuar kriminal;

(ii) veprimin e një personi, i cili, duke njohur qëllimin dhe aktivitetin e përgjithshëm kriminal të një grupi të organizuar kriminal ose synimin e tij për të kryer krimet në fjalë, merr pjesë aktivisht në:

(a) veprimtaritë kriminale të grupit të organizuar kriminal;

(b) Veprimtaritë e tjera kriminale të grupit të organizuar kriminal, duke ditur se pjesëmarrja e tij/saj do të kontribuojë në arritjen e qëllimit kriminal të përshkruar më lart;

b) organizimin, drejtimin, dhënien e ndihmës, përkrahjen, lehtësimin ose dhënien e këshillave për kryerjen e një krimi serioz që përfshin një grup kriminal të organizuar.

2. Dijenia, synimi, qëllimi, plani ose marrëveshja, të cilat përmenden në paragrafin 1 të këtij neni mund të nxirren nga rrethanat faktike objektive.

3. Shtetet Palë, ligji i brendshëm i të cilëve kërkon përfshirjen e një grupi kriminal të organizuar për qëllimet e veprave penale të cilësuara si të tilla, në përputhje me paragrafin 1 (a) (i) të këtj neni, do të sigurojë që legjislacioni i tyre i brendshëm të mbulojë të gjitha krimet serioze që përfshijnë grupet e organizuara kriminale. Këto Shtete Palë dhe Shtetet Palë, legjislacioni i brendshëm i të cilëve kërkon që një veprim në zbatim të një marrëveshjeje për qëllimet e veprës penale të përcaktuar në përputhje me paragrafin 1 (a) (i) të këtij neni, do të informojnë për këtë Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara në kohën e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tyre të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në këtë Konventë.

Neni 6

Penalizimi i pastrimit të të ardhurave nga krimi

1. Secili Shtet Palë, në përputhje me parimet bazë të legjislacionit të tij të brendshëm, duhet të adaptojë masa të tilla legjislative që mund të jenë të nevojshme për të cilësuar si vepra penale, kur kryhen në mënyrë të qëllimshme:

(a) (i) shkëmbimin ose transferimin e pasurisë, duke ditur që një pasuri e tillë është e ardhur nga krimi, me qëllim që të fshihet ose mbulohet origjina e paligjshme e saj ose dhënien e ndihmës ndaj një personi, i cili është përfshirë në kryerjen e veprës penale bazë për t'iu shmangur pasojave ligjore të veprimit tij/saj;

(ii) fshehjen ose mbulimin e natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave në lidhje me pronësinë, duke ditur që një pasuri e tillë është e ardhur nga krimi;

(b) duke iu nënshtruar koncepteve bazë të sistemit të tij ligjor:

(i) fitimin, posedimin ose përdorimin i pasurisë, duke ditur në kohën e marrjes në dorëzim që një pasuri e tillë është e ardhur nga krimi;

(ii) pjesëmarrjen, shoqërimin ose komplotimin për të kryer, tentativat për të kryer dhe dhënien e ndihmës, përkrahjen, lehtësimin dhe dhënien e këshillave për kryerjen e çdonjërës prej veprave penale të cilësuara si të tilla në përputhje me këtë nen.

2. Për qëllimet e zbatimit ose aplikimit të paragrafit 1 të këtij neni:

(a) secili Shtet Palë duhet të përpiqet të aplikojë paragrafin 1 të këtij neni në shtrirjen më të gjerë të veprave penale bazë;

(b) secili Shtet Palë duhet të përfshijë si vepra penale bazë të gjitha krimet serioze të cilësuara si të tilla në përputhje me nenet 5, 8 dhe 23 të kësaj Konvente; Në rastet kur Shtetet Palë, legjislacioni i të cilëve përcakton një listë të veprave penale specifike predicate, ato duhet të përfshijnë minimalisht në këtë listë një numër të plotë të veprave penale që lidhen me grupet e organizuara kriminale.

(c) për qëllimet e nënparagrafit (b), veprat penale bazë përfshijnë veprat penale të kryera si brenda dhe jashtë juridiksionit të Shtetit Palë në fjalë; Megjithatë, veprat penale të kryera jashtë juridiksionit të një Shteti Palë do të përbëjnë vepra penale bazë vetëm në rastet kur veprimi përkatës është një vepër penale në bazë të ligjit të brendshëm të Shtetit ku është kryer dhe do të ishte një vepër penale në bazë të legjislacionit të brendshëm të Shtetit Palë që zbaton ose aplikon këtë nen, në qoftë se vepra penale do të ishte kryer në këtë Shtet.

(d) secili Shtet Palë do t'i dorëzojë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara kopjet e ligjeve të tij të brendshme, që lidhen me zbatimin e këtij neni, ndryshimet vijuese të këtyre ligjeve ose një përmbledhje e tyre;

(e) në qoftë se e kërkojnë parimet themelore të legjislacionit të brendshëm të Shtetit Palë, mund të parashikohet që veprat penale të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni të mos aplikohen ndaj personave që kanë kryer veprën penale bazë;

(f) dijenia, qëllimi ose synimi të kërkuara si elemente të një vepre penale, të parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, mund të nxirren nga rrethanat objektive faktike.

Neni 7

Masat për të luftuar pastrimin e parave

1. Secili Shtet Palë:

(a) duhet të krijojë një regjim të brendshëm të gjithanshëm, rregullator dhe mbikëqyrës për bankat dhe institucionet financiare jobankare, brenda kompetencës së tij, me qëllim që të pengojnë dhe zbulojë të gjitha format e pastrimit të parave, regjim i cili duhet t'i vërë theksin kërkesave për identifikimin e klientit, ruajtjen e dokumenteve dhe raportimin e transaksioneve të dyshimta;

(b) pa cenuar dispozitat e neneve 18 dhe 27 të kësaj Konvente, duhet të sigurojë që autoritetet administrative, rregullatore, të zbatimit të ligjit dhe autoritetet e tjera që i janë kushtuar luftës kundër pastrimit të parave (përfshirë autoritetet gjyqësore, kur kjo parashikohet nga legjislacioni i brendshëm), të kenë aftësinë për të bashkëpunuar dhe shkëmbyer informacion në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, brenda kushteve të parashikuara nga legjislacioni i tij i brendshëm. Për këtë qëllim, Shtetet Palë duhet të marrin parasysh krijimin e një njësie zbulimi në fushën e financave që do të shërbejë si një qendër kombëtare për mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen e informacionit që lidhet me pastrimin e mundshëm të parave.

2. Shtetet Palë duhet të marrin parasysh zbatimin e masave të përshtatshme për zbulimin dhe mbikëqyrjen e lëvizjes së parave dhe të instrumenteve të shkëmbyeshme përkatëse nëpër kufijtë e tyre, që janë subjekt i ruajtjes për të siguruar përdorimin e duhur të informacionit dhe pa penguar në asnjë mënyrë lëvizjen e kapitalit të ligjshëm. Këto masa mund të përfshijnë kërkesën që individët dhe aktivitetet e biznesit të raportojnë transferimet ndërkufitare të sasive të mëdha të parave dhe të instrumenteve të shkëmbyeshme përkatëse.

3. Shteteve Palë u bëhet thirrje, gjatë krijimit të një regjimi rregullator dhe mbikëqyrës në bazë të kushteve të këtij neni, dhe pa cenuar nenet e tjera të kësaj Konvente, që të orientohen tek iniciativat përkatëse rajonale, ndërrajonale dhe organizatat shumëpalëshe që luftojnë kundër pastrimit të parave.

4. Shtetet Palë duhet të përpiqen që të zhvillojnë e nxisin bashkëpunimin global, rajonal, nënrajonal dhe dypalësh ndërmjet autoriteteve rregullatore financiare, gjyqësore dhe të zbatimit të ligjeve, me qëllim që të luftohet pastrimi i parave.

Neni 8

Penalizimi i korrupsionit

1. Secili Shtet Palë duhet të adaptojë masa të tilla legjislative dhe masa të tjera që mund të jenë të nevojshme për të cilësuar si vepër penale, në rastet kur kryhet në mënyrë të qëllimshme:

(a) premtimin, propozimin ose dhënien ndaj një zyrtari publik, direkt ose jodirekt, të një përfitimi të padrejtë, për vetë zyrtarin/zyrtaren, një person ose dikë tjetër, me qëllim që zyrtari të veprojë ose të mos veprojë gjatë ushtrimit të detyrave të tij/saj zyrtare.

(b) kërkesën ose pranimin nga një zyrtar publik, direkt ose jodirekt, të një përfitimi të padrejtë, për atë vetë ose për një person apo dikë tjetër, me qëllim që zyrtari të veprojë ose të mos veprojë gjatë ushtrimit të detyrave të tij/saj zyrtare.

2. Secili Shtet Palë duhet të marrë parasysh adaptimin e masave të tilla legjislative dhe të masave të tjera që mund të jenë të nevojshme për të cilësuar si vepër penale veprimet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni që përfshin një zyrtar të huaj ose nëpunës civil ndërkombëtar. Gjithashtu, secili Shtet Palë duhet të marrë parasysh cilësimin si vepër kriminale të formave të tjera të korrupsionit.

3. Gjithashtu, secili Shtet Palë duhet të adaptojë masa të tilla që mund të jenë të nevojshme për të cilësuar si vepër penale, pjesëmarrjen si bashkëpunëtor në një vepër penale të cilësuar në përputhje me këtë nen.

4. Për qëllimet e paragrafit 1 të këtij neni dhe të nenit 9, "zyrtar publik" nënkupton një zyrtar publik ose një person i cili kryen një shërbim publik në mënyrën e parashikuar nga legjislacioni i brendshëm dhe në mënyrën që aplikohet nga legjislacioni penal i Shtetit Palë, në të cilin personi në fjalë kryen atë funksion.

Neni 9
Masat kundër korrupsionit

1. Përveç masave të parashikuara në nenin 8 të kësaj Konvente, secili Shtet Palë duhet të adaptojë, në masën e duhur dhe në pajtim me sistemin e tij ligjor, masa legjislative, administrative ose masa të tjera efektive për të forcuar integritetin dhe për të parandaluar, zbuluar dhe ndëshkuar korrupsionin e zyrtarëve publikë.

2. Secili Shtet Palë duhet të marrë masa për të siguruar veprimtarinë efektive të autoriteteve të tij në parandalimin, zbulimin dhe ndëshkimin e korrupsionit të zyrtarëve publikë, përfshirë dhënien e pavarësisë së duhur këtyre autoriteteve, me qëllim ndalimin e përpjekjeve për të influencuar në mënyrë të padrejtë në aktivitetin e tyre.

Neni 10
Përgjegjësia e personave juridikë

1. Secili Shtet Palë duhet të adaptojë masat e nevojshme, që janë në pajtim me parimet e tij ligjore, për të përcaktuar përgjegjësinë e personave juridikë që marrin pjesë në krime serioze që përfshijnë një grup të organizuar kriminal dhe për veprat penale të cilësuara si të tilla, në përputhje me nenet 5, 6, 8 dhe 23 të kësaj Konvente.

2. Duke iu nënshtruar parimeve ligjore të Shtetit Palë, përgjegjësia e personave juridikë mund të jetë penale, civile ose administrative.

3. Një përgjegjësi e tillë nuk duhet të cenojë përgjegjësinë penale të personave fizikë që kanë kryer veprat penale.

4. Secili Shtet Palë duhet të sigurojë, veçanërisht, që personat juridikë që konsiderohen përgjegjës në përputhje me këtë nen t'i nënshtrohen sanksioneve efektive, proporcionale, bindëse penale ose jopenale, përfshirë sanksionet financiare.

Neni 11
Gjykimi dhe sanksionet

1. Secili Shtet Palë duhet t'ia nënshtrojë sanksioneve veprën penale të cilësuar në përputhje me nenet 5, 6, 8 dhe 23 të kësaj Konvente, duke marrë parasysh shkallën e veprës penale.

2. Secili Shtet Palë duhet të përpiqet të sigurojë që çdo pushtet ligjor që ai ka në bazë të legjislacionit të brendshëm, që lidhet me ndjekjen penale të personave që kryejnë veprat penale që mbulohen nga kjo Konventë, të ushtrohet për të rritur në maksimum efektivitetin e masave për zbatimin e ligjit në lidhje me këto vepra penale dhe duke pasur parasysh nevojën për të penguar kryerjen e veprave të tilla penale.

3. Në rastin e veprave penale të cilësuara si të tilla në përputhje me nenet 5, 6, 8 dhe 23 të kësaj Konvente, secili Shtet Palë duhet të ndërmarrë masat e nevojshme, në përputhje me legjislacionin e tij të brendshëm dhe duke pasur parasysh të drejtën e mbrojtjes, për të siguruar që kushtet e vendosura në lidhje me vendimet mbi lirimin e personit në pritje të gjykimit ose apelit të marrin parasysh nevojën për të garantuar praninë e të pandehurit në procedurat penale vijuese.

4. Secili Shtet Palë duhet të sigurojë që gjykatat ose autoritetet e tjera kompetente të mbajnë parasysh seriozitetin e veprave penale, që mbulohen nga kjo Konventë, në rastin kur shqyrtojnë mundësinë e lirimit para kohe ose me kusht të personave të dënuar për këto vepra penale.

5. Nëse është e nevojshme, secili Shtet Palë duhet të përcaktojë, në bazë të legjislacionit të tij të brendshëm, një rregullore të gjatë mbi periudhën e kufizimeve në të cilën të fillojë ndjekjen për një vepër penale që mbulohet nga kjo Konventë dhe një periudhë më të gjatë nëse personi, që pretendohet se ka kryer veprën penale, i është shmangur organeve të drejtësisë.

6. Asgjë që përfshihet në këtë Konventë nuk do të prekë parimin se përshkrimi i veprave penale të cilësuara në këtë Konventë dhe i mbrojtjeve ligjore të aplikueshme ose parimeve të tjera

ligjore që kontrollojnë ligjshmërinë e aktit, i takon se legjislacionit të brendshëm të një Shteti Palë dhe se këto vepra penale duhet të ndiqen penalisht dhe të ndëshkohen në përputhje me atë ligj.

Neni 12

Konfiskimi dhe marrja e sendeve

1. Shtetet Palë duhet të adaptojnë, në shkallën më të madhe të mundshme dhe brenda sistemeve të tyre ligjore, masa të tilla që mund të jenë të nevojshme për të mundësuar konfiskimin e:

(a) të ardhurave nga krimi, që rrjedhin nga veprat penale që mbulohen nga kjo Konventë ose pasurisë, vlera e së cilës i korrespondon asaj të të ardhurave nga krimi;

(b) pasurisë, pajisjeve ose mjeteve të përdorura ose të destinuara për t'u përdorur në veprat penale që mbulohen nga kjo Konventë.

2. Shtetet Palë duhet të adaptojnë masa të tilla që mund të jenë të nevojshme për të mundësuar identifikimin, zbulimin, bllokimin ose marrjen e çdo sendi që përmendet në paragrafin 1, me qëllim konfiskimin e mundshëm.

3. Në qoftë se të ardhurat nga krimi janë transformuar ose konvertuar pjesërisht ose plotësisht në pasuri tjetër, kjo pasuri duhet t'i nënshtrohet masave të përmendura në këtë nen në vend të të ardhurave nga krimi.

4. Në qoftë se të ardhurat nga krimi janë përzier me pasuri të fituara nga burime të ligjshme, një pasuri e tillë duhet t'i nënshtrohet konfiskimit deri në masën e vlerës së të ardhurave nga krimi që janë përzier.

5. Mjetet monetare ose përfitimet e tjera, që rrjedhin nga të ardhurat nga krimi, nga pasuria në të cilën janë transformuar të ardhurat nga krimi ose konvertuar ose nga pasuria me të cilën janë bashkuar këto të ardhura, duhet t'i nënshtrohet, gjithashtu, masave të përmendura në këtë nen, në të njëjtën mënyrë dhe në të njëjtën masë si të ardhurat nga krimi.

6. Për qëllimet e këtij neni dhe të nenit 13, secili Shtet Palë duhet t'u japë pushtetin gjykatave të tij ose autoriteteve të tjera kompetente, që të urdhërojnë bankat që t'u vërë në dispozicion ose t'u marrin dokumentet financiare ose tregtare. Shtetet Palë nuk duhet të refuzojnë për të vepruar, në bazë të dispozitave të këtij paragrafi me arsyetimin e ruajtjes së sekretit bankar.

7. Shtetet Palë duhet të vlerësojnë mundësinë që të kërkojnë që autori i veprës penale të demonstrojë origjinën e ligjshme të të ardhurave nga krimi në fjalë ose të pasurisë tjetër që i nënshtrohet konfiskimit, në atë shkallë që kërkesa është në përputhje me parimet e legjislacionit të tyre të brendshëm dhe me natyrën e procedurave gjyqësore dhe procedurave të tjera.

8. Dispozitat e këtij neni nuk do të interpretohen në mënyrë të tillë që të cenojnë të drejtat e palëve të treta në mirëbesim.

9. Asgjë që përfshihet në këtë nen nuk do të prekë parimin që masat, të cilave ai u referohet, do të përcaktohen dhe zbatohen në përputhje me dispozitat e legjislacionit të brendshëm të një Shteti Palë dhe t'i nënshtrohen këtyre dispozitave.

Neni 13

Bashkëpunimi ndërkombëtar në lidhje me konfiskimin

1. Një Shtet Palë që ka marrë një kërkesë nga një Shtet tjetër Palë, i cili ka juridiksion mbi një vepër penale të parashikuar nga kjo Konventë për konfiskimin e të ardhurave nga krimi, pasurisë, pajisjeve ose mjeteve të tjera të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 12 të kësaj Konvente, të kryera në territorin e tij, duhet që, në shkallën më të madhe të mundshme:

(a) t'ua parashtrojë kërkesën autoriteteve kompetente, me qëllim marrjen e një urdhri për konfiskim dhe, në qoftë se jepet një urdhër i tillë, ta zbatojë atë; ose

(b) t'u dorëzojë autoriteteve të tij kompetente një urdhër konfiskimi të lëshuar nga një gjykatë në territorin e Shtetit Palë kërkues, në përputhje me nenin 12 paragrafi 1 të kësaj Konvente, me qëllim që ta zbatojnë atë në masën e kërkuar, për aq sa ka të bëjë me të ardhurat nga krimi, pasuritë, pajisjet ose mjetet e tjera që përmenden në nenin 12 paragrafi 1, që ndodhen në territorin e Shtetit Palë të kërkuar.

2. Në zbatim të një kërkese të bërë nga një Shtet tjetër Palë, i cili ka juridiksion mbi një vepër penale që mbulohet nga kjo Konventë, Shteti Palë i kërkuar duhet të marrë masat për të identifikuar, zbuluar dhe bllokuar ose konfiskuar të ardhurat nga krimi, pasuritë, pajisjet ose mjetet e tjera të përmendura në nenin 12 paragrafi 1 të kësaj Konvente për qëllimet e një konfiskimi të mundshëm, që do të urdhërohet nga Shteti Palë kërkues ose, në zbatim të një kërkese në bazë të paragrafit 1 të këtij neni nga Shteti Palë i kërkuar.

3. Dispozitat e nenit 18 të kësaj Konvente janë të aplikueshme mutatis mutandis ndaj këtij neni. Përveç informacionit të specifikuar në nenin 18 paragrafi 15, kërkesat e bëra në zbatim të këtij neni duhet të përmbajnë:

(a) në rastin e një kërkese që lidhet me paragrafin 1 (b) të këtij neni, një përshkrim të pasurisë që do të konfiskohet dhe një deklarim të fakteve në të cilat mbështetet Shteti Palë kërkues, që janë të mjaftueshme për t'i mundësuar Shtetit Palë të kërkuar që të zbatojë urdhrin në bazë të legjislacionit të tij të brendshëm;

(b) në rastin e një kërkese që lidhet me paragrafin 1 (b) të këtij neni, një kopje ligjërisht të pranueshme të një urdhri konfiskimi, në bazë të të cilit është bazuar kërkesa e lëshuar nga Shteti Palë kërkues, një deklarim të fakteve dhe një informacion mbi masën në të cilën kërkohet ekzekutimi i urdhrit;

(c) në rastin e një kërkese që lidhet me paragrafin 2 të këtij neni, një deklarim të fakteve në të cilat mbështetet Shteti Palë kërkues dhe një përshkrim të veprimeve të kërkuara.

4. Vendimet ose veprimet e parashikuara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni duhet të merren nga Shteti Palë i kërkuar në përputhje me, dhe duke iu nënshtruar dispozitave të legjislacionit të tij të brendshëm, rregullave të tij procedurale ose ndonjë traktati, marrëveshjeje ose ujdie, dypalëshe ose shumëpalëshe, ndaj të cilave ai ka detyrime në lidhje me Shtetin Palë kërkues.

5. Secili Shtet Palë duhet t'i dorëzojë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara kopje të ligjeve dhe akteve nënligjore, që lidhen me zbatimin e këtij neni, si dhe të çdo ndryshimi të mëvonshëm të këtyre ligjeve e akteve nënligjore ose një përshkrim të tyre.

6. Në qoftë se një Shtet Palë vendos që të kushtëzojë marrjen e masave që përmenden në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni me ekzistencën e një traktati përkatës, ai Shtet Palë duhet ta konsiderojë këtë Konventë si traktatin bazë të nevojshëm dhe të mjaftueshëm.

7. Bashkëpunimi në bazë të këtij neni mund të refuzohet nga një Shtet Palë, në qoftë se vepra penale me të cilën lidhet kërkesa nuk është një vepër penale që mbulohet nga kjo Konventë.

8. Dispozitat e këtij neni nuk do të interpretohen për të cenuar të drejtat e palëve të treta në mirëbesim.

9. Shtetet Palë duhet të marrin në konsideratë përfundimin e traktateve, marrëveshjeve ose ujdive, dypalëshe ose shumëpalëshe, për të rritur efektivitetin e bashkëpunimit ndërkombëtar të ndërmarrë në zbatim të këtij neni.

Neni 14
Disponimi i të ardhurave nga krimi ose i pasurisë së konfiskuar

1. Të ardhurat e krimit ose pasuria e konfiskuar nga një Shtet Palë, në zbatim të nenit 12 ose të nenit 13, paragrafi 1 i kësaj Konvente, do të disponohen nga ai Shtet Palë, në përputhje me legjislacionin dhe procedurat e tij të brendshme administrative.

2. Shtetet Palë, kur veprojnë në bazë të kërkesës së bërë nga një Shtet tjetër Palë, në përputhje me nenin 13 të kësaj Konvente, duhet t'i japin prioritet në atë shkallë që lejohet nga legjislacioni i brendshëm dhe nëse kërkohet një gjë e tillë, mundësisë së kthimit tek Shteti Palë kërkues të të ardhurave nga krimi ose pasurisë së konfiskuar, në mënyrë që ai të kompensojë viktimat e krimit ose t'ua kthejë këto të ardhura nga krimi, ose pasuri, pronarëve të ligjshëm.

3. Një Shtet Palë, kur vepron në bazë të kërkesës së bërë nga një Shtetit tjetër Palë, në përputhje me nenet 12, 13 të kësaj Konvente, mund të marrë parasysh veçanërisht lidhjen e marrëveshjeve ose të ujdive në lidhje me:

(a) dhënien e kontributit të vlerës së të ardhurave nga krimi, pasurive ose fondeve që

rrjedhin nga shitja e këtyre të ardhurave nga krimi, pasurive ose një pjesë prej tyre në llogarinë që është caktuar në përputhje me nenin 30 paragrafi 2 (c) të kësaj Konvente dhe ndaj strukturave ndërqeveritare të specializuara në luftën kundër krimit të organizuar;

(b) ndarjen me Shtetet e tjera Palë, mbi baza të rregullta ose rast pas rasti, të të ardhurave nga krimi, pasurive ose fondeve që rrjedhin nga shitja e këtyre të ardhurave nga krimi ose pasurive në përputhje me legjislacionin ose procedurat e tij administrative të brendshme.

Neni 15
Juridiksioni

1. Secili Shtet Palë duhet të adaptojë masa të tilla që mund të jenë të nevojshme për të vendosur juridiksionin e tij mbi veprat penale, të përcaktuara në përputhje me nenet 5, 6, 8 dhe 23 të kësaj Konvente kur:

(a) vepra penale është kryer në territorin e atij Shteti Palë; ose

(b) vepra penale është kryer në bordin e një anije që mban flamurin këtij Shteti Palë ose në një avion që është regjistruar në bazë të ligjeve të këtij Shteti Palë në kohën e kryerjes së veprës penale.

2. Duke qenë subjekt i nenit 4 të kësaj Konvente, një Shtet Palë mund të vendosë juridiksionin e tij mbi secilën prej veprave të mësipërme kur:

(a) vepra penale është kryer kundër një shtetasi të atij Shteti Palë;

(b) vepra penale është kryer nga një shtetas i atij Shteti Palë ose një person pa shtetësi, i cili e ka rezidencën në territorin e tij; ose

(c) vepra penale është:

(i) një nga veprat penale, të përcaktuara në përputhje me nenin 5 paragrafi 1 të kësaj Konvente dhe është kryer jashtë territorit të tij, me qëllim që të kryhet një krim serioz brenda territorit të tij;

3. (iii) Një prej veprave penale të cilësuara në përputhje me nenin 6 paragrafi 1 (b) (ii) të kësaj Konvente dhe është kryer jashtë territorit të tij, me qëllim që të kryhet një vepër penale brenda territorit të tij, e cilësuar në përputhje me nenin 6 paragrafi 1(a) (i) ose (ii) ose (b) (i) të kësaj Konvente.

4. Për qëllimet e nenit 16 paragrafi 10 të kësaj Konvente, secili Shtet Palë duhet të adaptojë masa të tilla që mund të jenë të nevojshme për të vendosur juridiksionin e tij mbi veprat penale që mbulohen nga kjo Konventë, kur autori i dyshuar i veprës penale ndodhet në territorin e tij dhe nuk e ekstradon atë vetëm për shkak se ai/ajo është shtetas i tij.

5. Secili Shtet Palë mund të adaptojë, gjithashtu, masat që mund të jenë të nevojshme për të vendosur juridiksionin e tij mbi veprat penale që mbulohen nga kjo Konventë kur autori i dyshuar i veprës penale ndodhet në territorin e tij dhe nuk e ekstradon atë.

6. Në qoftë se Shteti Palë, gjatë ushtrimit të juridiksionit të tij në bazë të paragrafit 1 ose 2 të këtij neni, është njoftuar ose ka marrë dijeni se një ose më shumë Shtete Palë janë duke kryer një hetim ndjekje penale ose procedura gjyqësore që lidhen me të njëjtën vepër, autoritetet kompetente të këtyre Shteteve Palë duhet të konsultohen me njëri-tjetrin, me qëllim që të koordinojnë veprimet e tyre.

7. Pa cenuar normat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, kjo Konventë nuk përjashton ushtrimin e çfarëdo juridiksioni penal të vendosur nga një Shtet Palë në pajtim me legjislacionin e tij të brendshëm.

Neni 16
Ekstradimi

1. Ky nen do të aplikohet ndaj veprave penale që mbulohen nga kjo Konventë ose në rastet kur një vepër penale që përmendet në nenin 3 paragrafi 1 (a) ose (b) përfshin një grup kriminal të organizuar dhe personi, i cili është subjekt i kërkesës për ekstradim, ndodhet në Shtetin Palë të

kërkuar, me kusht që vepra penale për të cilën kërkohet ekstradimi të jetë e ndëshkueshme në bazë të legjislacionit të brendshëm të Shtetit Palë kërkues dhe të Shtetit Palë të kërkuar.

2. Në qoftë se kërkesa për ekstradim përfshin një numër kërkesash të veçanta për krime serioze, disa prej të cilave nuk mbulohen nga ky nen, Shteti Palë i kërkuar mund të aplikojë këtë nen në lidhje me këto të fundit.

3. Secila prej veprave penale ndaj të cilave aplikohet ky nen do të konsiderohet për t'u përfshirë në çdo traktat mbi ekstradimin që ekziston ndërmjet Shteteve Palë, si një vepër penale e ekstradueshme. Shtetet Palë marrin përsipër që të përfshijnë këto vepra penale si dhe vepra të ekstradueshme në çdo traktat mbi ekstradimin që lidhin ndërmjet tyre.

4. Në qoftë se një Shtet Palë që e kushtëzon ekstradimin me ekzistencën e një traktati, merr një kërkesë për ekstradim nga një Shtet tjetër Palë me të cilin nuk ka lidhur ndonjë traktat mbi ekstradimin, ai mund ta konsiderojë këtë Konventë si bazën ligjore për ekstradimin në lidhje me çdo vepër penale ndaj të cilës aplikohet ky nen.

5. Shtetet Palë që e kushtëzojnë ekstradimin me ekzistencën e një traktati duhet që:

(a) të informojnë Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara në kohën e depozitimit të instrumentit të tyre të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në këtë Konventë, nëse ata do ta konsiderojnë këtë Konventë si bazën ligjore të bashkëpunimit në lidhje me ekstradimin me Shtetet e tjera Palë në të; dhe

(b) në qoftë se nuk e konsiderojnë këtë Konventë si bazën ligjore për bashkëpunim në fushën e ekstradimit, duhet të përpiqen, aty ku është e mundur, që të lidhin traktate mbi ekstradimin me Shtetet e tjera Palë të kësaj Konvente, me qëllim që të zbatohet ky nen.

6. Shtetet Palë, që nuk e kushtëzojnë ekstradimin me ekzistencën e një traktati, duhet të njohin veprat penale ndaj të cilave aplikohet ky nen si vepra penale të ekstradueshme ndërmjet tyre.

7. Ekstradimi duhet t'i nënshtrohet kushteve të parashikuara nga legjislacioni i brendshëm i Shtetit Palë të kërkuar ose traktateve që aplikohen ndaj ekstradimit, përfshirë, ndër të tjera, kushtet në lidhje me dënimin minimal të kërkuar për ekstradim dhe arsyet në bazë të të cilave Shteti Palë i kërkuar mund të refuzojë ekstradimin.

8. Shtetet Palë, mbështetur në legjislacionin e tyre të brendshëm, duhet të përpiqen që të lehtësojnë procedurat e ekstradimit dhe të thjeshtojnë kërkesat për marrjen e provave që lidhen me veprat penale ndaj të cilave aplikohet ky nen.

9. Shteti Palë i kërkuar, mbështetur në dispozitat e legjislacionit të tij të brendshëm dhe të traktateve që ka lidhur, nëse e gjykon se rrethanat e justifikojnë dhe janë urgjente dhe me kërkesën e Shtetit Palë të kërkuar, mund ta marrë në arrest një person që ndodhet në territorin e tij, për të cilin kërkohet ekstradimi, ose të marrë masa të tjera për të siguruar praninë e këtij personi në procedurat e ekstradimit.

10. Një Shtet Palë, në territorin e të cilit është gjetur personi i akuzuar, nëse nuk e ekstradon këtë person në lidhje me një vepër penale ndaj të cilës aplikohet ky nen, në një Shtet Palë që kërkon ekstradimin, vetëm sepse ai/ajo është shtetas i tij, është i detyruar t'ia paraqesë çështjen pa vonesë të arsyeshme autoriteteve të tij kompetente, me qëllim fillimin e ndjekjes penale. Këto autoritete do të marrin vendimet e tyre dhe do të kryejnë procedurat përkatëse në të njëjtën mënyrë si në rastin e çdo vepre tjetër penale të rëndë në bazë të legjislacionit të brendshëm të atij Shteti Palë. Shtetet Palë të interesuara duhet të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, veçanërisht në aspektin procedural dhe të marrjes së provave, për të siguruar efektivitetin e kësaj ndjekjeje penale.

11. Në çdo rast që Shteti Palë lejohet, në bazë të legjislacionit të tij të brendshëm, që të ekstradojë ose dorëzojë në ndonjë mënyrë tjetër një shtetas të tij, duke e kushtëzuar këtë me kthimin e personit në atë Shtet Palë për të vuajtur dënimin që është vendosur ndaj tij, si rezultat i një gjyqi ose procedurave gjyqësore për të cilat është kërkuar ekstradimi ose dorëzimi i personit dhe që ky Shtet dhe Shteti Palë që kërkon ektradimin e personit bien dakord me këtë mundësi dhe kushtet e tjera që mund të konsiderohen të përshtatshme, ky ekstradim ose dorëzim i tillë i kushtëzuar duhet të jetë i mjaftueshëm për të shkarkuar detyrimin e parashikuar në paragrafin 10 të këtij neni.

12. Në qoftë se ekstradimi, i kërkuar për qëllimet e zbatimit të një vendimi gjyqësor, refuzohet për shkak se personi i kërkuar është shtetas i Shtetit Palë të kërkuar, Pala e kërkuar, në

bazë të kërkesës së Palës kërkuese, duhet të marrë parasysh zbatimin e vendimit gjyqësor që është vendosur në bazë të legjislacionit të brendshëm të kësaj të fundit ose të pjesës së pazbatuar të tij, në qoftë se një gjë e tillë lejohet nga legjislacioni i saj i brendshëm dhe nëse veprohet në pajtim me kërkesat e këtij legjislacioni.

13. Çdo personi, ndaj të cilit kanë filluar procedurat gjyqësore në lidhje me një prej veprave penale për të cilat aplikohet ky nen, do t'i garantohet një trajtim i drejtë në të gjitha shkallët e procedurave gjyqësore, përfshirë gëzimin e të gjitha të drejtave dhe garancive të parashikuara nga legjislacioni i brendshëm i Shtetit Palë, në territorin e të cilit ndodhet ai person.

14. Asgjë në këtë Konventë nuk do të interpretohet se vendos një detyrim për të ekstraduar, në qoftë se Shteti Palë i kërkuar ka arsye thelbësore për të besuar se kërkesa është bërë me qëllim ndjekjen penale ose ndëshkimin e një personi për shkak të seksit, racës, besimit fetar, kombësisë, origjinës etnike ose opinioneve politike të tij ose prej këtyre shkaqeve.

15. Shtetet Palë nuk mund të refuzojnë, një kërkesë për ekstradim për shkakun e vetëm se vepra penale vlerësohet se do të përfshijë çështje të karakterit fiskal.

16. Përpara se të refuzojë ekstradimin, Shteti Palë i kërkuar do të konsultohet, nëse është e nevojshme, me Shtetin Palë kërkues për t'i siguruar atij mundësinë për të paraqitur opinionet e tij dhe t'i japë informacionin përkatës që lidhet me kërkesat e tij.

17. Shtetet Palë duhet të përpiqen që të lidhin marrëveshje ose ujdi, dypalëshe e shumëpalëshe, për të zbatuar ekstradimin ose për të rritur efektivitetin e tij.

Neni 17
Transferimi i personave të dënuar

Shtetet Palë mund të marrin parasysh hyrjen në marrëveshje ose ujdi, dypalëshe e shumëpalëshe, mbi transferimin për në territorin e tyre të personave të dënuar me burgim ose forma të tjera të heqjes së lirisë për veprat penale që mbulohen nga kjo Konventë, me qëllim që ata të përfundojnë dënimin e tyre në këtë Shtet.

Neni 18
Ndihma ligjore reciproke

1. Shtetet Palë duhet t'i japin njëri-tjetrit ndihmë maksimale ligjore në hetimet, ndjekjet penale dhe procedurat gjyqësore në lidhje me veprat penale që mbulohen nga kjo Konventë, ashtu siç është parashikuar në nenin 3. Ata do t'i ofrojnë në mënyrë reciproke njëri-tjetrit ndihmë të ngjashme kur Shteti Palë kërkues ka baza të arsyeshme për të dyshuar se vepra penale, të cilës i referohet neni 3 paragrafi 1(a) ose (b), ka një natyrë ndërkombëtare, përfshirë faktin që viktimat, dëshmitarët, të ardhurat nga krimi, mjetet ose provat e këtyre veprave penale ndodhen në Shtetin Palë kërkues dhe që në veprën në fjalë është përfshirë një grup kriminal i organizuar.

2. Ndihma ligjore reciproke duhet të ofrohet në shkallën më të gjerë të mundshme, mbështetur në ligjet, traktatet, marrëveshjet dhe ujditë përkatëse të Shtetit Palë të kërkuar, që kanë të bëjnë me hetimet, ndjekjen penale dhe procedurat gjyqësore për veprat penale për të cilat një person juridik mund të mbahet përgjegjës në Shtetin Palë kërkues, në përputhje me nenin 10 të kësaj Konvente.

3. Ndihma ligjore reciproke që do të jepet në përputhje me këtë nen mund të kërkohet për secilin nga qëllimet e mëposhtme:

(a) Marrjen e provave ose deklaratave nga personat;

(b) kryerjen e shërbimeve që lidhen me dokumentet gjyqësore;

(c) ushtrimin e kontrolleve, konfiskimeve dhe bllokimeve të sendeve;

(ç) ekzaminimin e objekteve dhe vendeve;

(d) dhënien e informacionit, sendeve të provës dhe vlerësmeve të ekspertëve;

(e) dhënien e origjinaleve ose të kopjeve të vërtetuara të dokumenteve dhe të dhënave përkatëse, përfshirë dokumentet qeveritare bankare financiare të korporatave dhe të bisnesit;

(f) identifikimin ose gjurmimin e të ardhurave nga krimi, pasurisë, mjeteve ose sendeve të tjera, me qëllim marrjen e provave;

(g) lehtësimin e paraqitjes vullnetare të personave në Shtetin Palë kërkues;

(h) çdo lloj tjetër ndihme, që nuk është në kundërshtim me legjislacionin e brendshëm të Shtetit Palë të kërkuar.

4. Autoritetet kompetente të një Shteti Palë, pa cenuar legjislacionin e brendshëm, mund t'i japin informacion në lidhje me çështjet penale një autoriteti kompetent të një Shteti tjetër Palë, pa pasur një kërkesë paraprake, nëse ata besojnë se një informacion i tillë mund të ndihmojë këtë autoritet që të ndërmarrë ose përfundojë me sukses hetimet dhe procedurat penale ose që mund të rezultojë në një kërkesë të formuluar nga Shteti i fundit në zbatim të kësaj Konvente.

5. Dhënia e informacionit në zbatim të paragrafit 4 të këtij neni nuk duhet të cenojë hetimet dhe procedurat penale në Shtetin në të cilin janë autoritetet që japin informacionin. Autoritetet kompetente që marrin informacionin duhet të plotësojnë kërkesën që informacionin në fjalë ta mbajnë konfidencial, qoftë dhe përkohësisht, ose ta përdorin në mënyrë të kufizuar. Megjithatë, kjo nuk ndalon Shtetin Palë marrës që të zbulojë në procedurat e tij gjyqësore atë informacion që shfajëson një person të akuzuar. Në një rast të tillë, Shteti Palë marrës duhet të njoftojë Shtetin Palë dhënës përpara që të zbulojë informacionin dhe të konsultohet me Shtetin Palë dhënës, nëse kërkohet një gjë e tillë. Si një rast përjashtimor, nëse njoftimi paraprak nuk është i mundur të bëhet, Shteti Palë marrës duhet të njoftojë pa vonesë Shtetin Palë dhënës në lidhje me zbulimin e informacionit.

6. Dispozitat e këtij neni nuk duhet të prekin detyrimet në bazë të ndonjë traktati tjetër, dypalësh ose shumëpalësh, që rregullon ose do të rregullojë, plotësisht ose pjesërisht, ndihmën ligjore reciproke.

7. Paragrafët 9 deri 29 të këtij neni do të aplikohen ndaj kërkesave të bëra në zbatim të tij, në qoftë se Shtetet Palë në fjalë nuk kanë detyrime që rrjedhin nga ndonjë traktat mbi ndihmën ligjore reciproke. Në qoftë se këto Shtete Palë kanë detyrime nga një traktat i tillë, do të aplikohen dispozitat korresponduese të këtij traktati, me përjashtim të rasteve kur Shtetet Palë bien dakord të aplikojnë në vend të tyre paragrafët 9 deri 29 të këtij neni. Shtetet Palë inkurajohen fuqimisht që të aplikojnë këto paragrafë në qoftë se këto të fundit lehtësojnë bashkëpunimin.

8. Shtetet Palë nuk duhet të refuzojnë që të japin ndihmë ligjore reciproke në zbatim të këtij neni, duke e bazuar këtë refuzim në ruajtjen e sekretit bankar.

9. Shtetet Palë mund të refuzojnë të japin ndihmë ligjore reciproke në zbatim të këtij neni, duke e bazuar këtë në mungesën e kriminalitetit të dyfishtë. Megjithatë, Shteti Palë i kërkuar, nëse e gjykon të nevojshme, mund të ofrojë ndihmë në masën që ai dëshiron, pavarësisht nëse veprimi do të përbënte një vepër penale në bazë të legjislacionit të brendshëm të Shtetit Palë të kërkuar.

10. Një person, i cili është arrestuar ose është duke vuajtur një dënim në territorin e një Shteti Palë, prania e të cilit kërkohet në një Shtet tjetër Palë për qëllime identifikimi, të dhënies së dëshmive ose për dhënien e ndonjë ndihme tjetër në marrjen e provave për hetimet, ndjekjet penale ose procedurat gjyqësore lidhur me veprat penale që mbulohen nga kjo Konventë, mund të ekstradohen në qoftë se ekzistojnë kushtet$e mëposhtme:

(a) Personi shpreh lirisht miratimin e tij/saj të njoftuar;

(b) autoritetet kompetente të të dy Shteteve Palë bien dakord, sipas kushteve që këto Shtete Palë mund t'i gjykojnë të përshtatshme.

11. Për qëllimet e paragrafit 10 të këtij neni:

(a) Shteti Palë, në të cilin është ekstraduar personi, do të ketë autoritetin dhe detyrimin të mbajë personin e ekstraduar nën arrest, përjashtuar rastet kur një gjë e tillë nuk autorizohet nga Shteti Palë nga i cili është ekstraduar personi;

(b) Shteti Palë, tek i cili është ekstraduar personi, duhet të përmbushë pa vonesë detyrimin që ka për ta kaluar personin nën mbikëqyrjen e Shtetit Palë nga i cili është ekstraduar personi, nëse bien dakord që më parë për këtë ose nëse kanë rënë dakord ndryshe autoritetet kompetente të të dy Shteteve Palë;

(c) Shteti Palë, në të cilin është ekstraduar personi, nuk duhet t'i kërkojë Shtetit Palë nga i cili ai është ekstraduar që të nisë procedurat e ekstradimit për të kthyer personin;

(d) Personit të ekstraduar do t'i merret parasysh koha e vuajtjes së dënimit në Shtetin nga i cili është ekstraduar për kohën që duhet të kalojë nën arrest në Shtetin Palë në të cilin është ekstraduar.

12. Përjashtuar rastin kur Shteti Palë, nga i cili një person duhet të ekstradohet në përputhje me paragrafët 10 dhe 11 të këtij neni, nuk bie dakord, personi i ekstraduar, çfarëdo qoftë kombësia e tij/saj, nuk duhet të ndiqet penalisht, mbahet nën arrest, të dënohet ose t'i nënshtrohet ndonjë kufizimi tjetër të lirisë personale në lidhje me veprimet, mosveprimet ose dënimet përpara nisjes së tij nga territori i Shtetit nga i cili ai/ajo është transferuar.

13. Secili Shtet Palë duhet të caktojë një autoritet qendror që do të ketë përgjegjësinë dhe pushtetin që të presë kërkesat për ndihmë ligjore reciproke dhe t'i zbatojë ato ose t'ia transmetojë autoriteteve kompetente për ekzekutim. Nëse një Shtet Palë ka një rajon ose territor të veçantë me një sistem tjetër të ndihmës ligjore reciproke, ai mund të caktojë një autoritet qendror të posaçëm, që do të ketë të njëjtin funksion për atë rajon ose territor. Autoritetet qendrore duhet të sigurojnë zbatimin ose transferimin e shpejtë dhe në mënyrën e duhur të kërkesës së marrë. Në momentin që autoriteti qendror i transmeton kërkesën një autoriteti kompetent për zbatim, ai duhet të inkurajojë zbatimin e shpejtë dhe në mënyrën e duhur të kërkesës nga autoriteti kompetent. Shtetet Palë duhet të njoftojnë Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara në lidhje me autoritetin kompetent të caktuar për këtë qëllim në momentin e depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në këtë Konventë. Kërkesat për ndihmë ligjore reciproke dhe çdo komunikim që lidhet me këtë qëllim duhet t'i transmetohet autoriteteve qendrore të caktuara nga Shtetet Palë. Kjo kërkesë nuk duhet të cenojë të drejtën e një Shteti Palë për të kërkuar që këto kërkesa dhe komunikime t'i adresohen atij përmes kanaleve diplomatike dhe, në rrethana urgjente, nëse bien dakord Shtetet Palë dhe nëse është e mundur, përmes Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale.

14. Kërkesat duhen bërë në formë shkresore ose, aty ku është e mundur, nëpërmjet çdo mënyre që mund të përpilohet një dokument shkresor, në një gjuhë të kuptueshme për Shtetin Palë të kërkuar, në bazë të kushteve që e lejojnë atë Shtet Palë të vendosë autencitetin. Sekretari i Përgithshëm i Kombeve të Bashkuara duhet të njoftohet në lidhje me gjuhën ose gjuhët e pranueshme për secilin Shtet Palë në kohën e depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në këtë Konventë. Në rrethana urgjente dhe nëse është rënë dakord midis Shteteve Palë, kërkesat mund të bëhen gojarisht, por duhet të konfirmohen menjëherë me shkrim.

15. Kërkesa për ndihmë ligjore reciproke duhet të përmbajë:

(a) identitetin e autoritetit që bën kërkesën;

(b) përmbajtjen dhe natyrën e hetimit, të ndjekjes penale ose të procedurave gjyqësore me të cilat lidhet kërkesa dhe emrin e funksionet e autoritetit që kryen hetimin, ndjekjen penale ose procedurat gjyqësore;

(c) një përmbledhje të fakteve përkatëse, me përjashtim të rasteve kur ato kanë të bëjnë me përdorimin e dokumenteve gjyqësore;

(d) një përshkrim të ndihmës së kërkuar dhe detaje të çfarëdo procedure që Shteti Palë kërkues, dëshiron të ndiqet;

(e) nëse është e mundur, identitetin, vendndodhjen dhe kombësinë e çdo personi të interesuar; dhe

(f) qëllimin për të cilin kërkohet prova, informacioni ose veprimi.

16. Shteti Palë i kërkuar mund të kërkojë informacione të tjera kur ato i nevojiten për përmbushjen e kërkesës ose për shpejtimin e saj, në përputhje me legjislacionin e tij të brendshëm.

17. Një kërkesë duhet të zbatohet në përputhje dhe jo në kundërshtim me legjislacionin e brendshëm të Shtetit Palë të kërkuar dhe, në rast se është e mundur, në përputhje dhe me procedurat e përcaktuara në kërkesë.

18. Në çdo rast të mundur dhe në përputhje me parimet themelore të legjislacionit të brendshëm, kur një person ndodhet në territorin e një Shteti Palë dhe duhet të dëgjohet si dëshmitar ose ekspert nga autoritetet gjyqësore të një Shteti tjetër Palë, Pala e parë, me kërkesë të Palës tjetër, mund të lejojë që seanca të zhvillohet me video-konferencë, nëse nuk është e mundur ose e

dëshirueshme që personi në fjalë të jetë i pranishëm në territorin e Shtetit Palë kërkues. Shtetet Palë mund të bien dakord që seanca të drejtohet nga një autoritet gjyqësor i Shtetit Palë kërkues, ku duhet të marrë pjesë dhe një autoritet gjyqësor i Shtetit Palë të kërkuar.

19. Shteti Palë kërkues nuk duhet të transmetojë ose shfrytëzojë informacione ose prova të marra nga Shteti Palë i kërkuar, për hetime, ndjekje penale ose procedura gjyqësore të tjera, përveç atyre të deklaruara në kërkesë, pa marrë më parë pëlqimin e Shtetit Palë të kërkuar. Asgjë në këtë paragraf nuk duhet të ndalojë Shtetin Palë kërkues të paraqesë procedurat e tij gjyqësore informacionin ose provat që fajësojnë një person të akuzuar. Në rastin e fundit Shteti Palë kërkues duhet të njoftojë Shtetin Palë të kërkuar para paraqitjes së këtyre të dhënave dhe, nëse është e domosdoshme, të konsultohet me Shtetin Palë të kërkuar. Nëse, në një rast përjashtimor, njoftimi paraprak nuk është i mundur. Shteti Palë kërkues duhet të njoftojë Shtetin Palë të kërkuar për këtë paraqitje, sa më shpejt të jetë e mundur.

20. Shteti Palë kërkues mund të kërkojë që Shteti Palë i kërkuar të ruajë fshehtësinë e faktit dhe objektit të kërkesës, me përjashtim të rastit kur kjo është e domosdoshme për plotësimin e kërkesës. Nëse Shteti Palë i kërkuar nuk mund të përmbushë kërkesën e konfidencialitetit, ai duhet të njoftojë menjëherë Shtetin Palë kërkues.

21. Ndihma reciproke ligjore mund të refuzohet:

(a) në rast se kërkesa nuk është bërë në përputhje me dispozitat e këtij neni;

(b) në rast se Shteti Palë i kërkuar vlerëson se plotësimi i kërkesës ka të ngjarë të cenojë sovranitetin e tij, sigurinë, rendin publik dhe interesa të tjera themelore;

(c) në rast se legjislacioni i brendshëm nuk i lejon autoritetet e Shtetit Palë të kërkuar të kryejnë veprimin e kërkuar lidhur me çdo vepër të ngjashme penale, e cila mund të ketë qenë subjekt hetimi, ndjekjeje penale ose procedimi gjyqësor të kryer nën juridiksionin e tyre;

(d) në rast se plotësimi i kërkesës do të ishte në kundërshtim me kuadrin ligjor mbi asistencën reciporoke ligjore të Shtetit Palë të kërkuar.

22. Shtetet Palë nuk duhet të refuzojnë një kërkesë për ndihmë reciproke ligjore me arsyen e vetme se vepra penale përfshin, gjithashtu, dhe çështje fiskale.

23. Duhet të jepen arsye për çdo refuzim të ndihmës reciproke ligjore.

24. Shteti Palë i kërkuar duhet të plotësojë kërkesën për ndihmë reciproke ligjore sa më shpejt të jetë e mundur dhe duhet të marrë në konsideratë të plotë çdo afat kohor të propozuar nga Shteti Palë kërkues, për të cilin preferohen të jepen arsyet në kërkesë. Shteti Palë i kërkuar duhet t'i përgjigjet kërkesave të arsyeshme të Shtetit Palë kërkues mbi mbarëvajtjen e plotësimit të kërkesës. Shteti Palë kërkues duhet të njoftojë menjëherë Shtetin Palë të kërkuar nëse ndihma e kërkuar nuk është më e nevojshme.

25. Ndihma reciproke ligjore mund të shtyhet nga Shteti Palë i kërkuar kur ajo ndërhyn në një hetim, ndjekje penale ose procedurë gjyqësore në vazhdim.

26. Para se të refuzojë një kërkesë në përputhje me paragrafin 21 të këtij neni ose të shtyjë afatin e zbatimit të saj në përputhje me paragrafin 25 të këtij neni, Shteti Palë i kërkuar duhet të këshillohet me Shtetin Palë kërkues për të marrë në konsideratë nëse asistenca mund të jepet në bazë të kushteve dhe nomenklaturave që do të gjykohen të domosdoshme. Në rast se Shteti Palë kërkues pranon ndihmën e shoqëruar me të tilla kushte, atëherë ai duhet t'i përmbahet këtyre kushteve.

27. Pa cenuar zbatimin e paragrafit 12 të këtij neni, një dëshmitar, ekspert ose person tjetër, i cili, me kërkesë të Shtetit Palë kërkues, pranon të paraqesë prova gjatë një procedure gjyqësore ose të ofrojë ndihmën e tij në një hetim, ndjekje penale ose procedim gjyqësor në territorin e Shtetit Palë kërkues, nuk duhet të paditet, arrestohet, ndëshkohet ose t'i nënshtrohet ndonjë kufizimi të lirisë së saj/tij personale në atë territor për veprime, fyerje ose shkelje të kryera para largimit të saj/tij nga territori i Shtetit Palë të kërkuar. Një veprim i tillë i sigurt duhet të pushojë në rast se dëshmitari, eksperti ose një person tjetër nuk largohet me dëshirën e tij nga territori i Shtetit Palë kërkues brenda një periudhe kohe prej pesëmbëdhjetë ditësh rresht ose brenda një periudhe për të cilën Shtetet Palë kanë rënë dakord që nga koha kur ai është njoftuar zyrtarisht se prania e tij nuk është më e nevojshme për autoritetet gjyqësore, ose në rast se ai kthehet me dëshirën e tij pasi është larguar më parë.

28. Shpenzimet e zakonshme të zbatimit të një kërkese duhet të mbulohen nga Shteti Palë i kërkuar, në rast se nuk është rënë dakord ndryshe nga Shtetet Palë të interesuar. Në rast se shpenzimet e një natyre thelbësore ose të jashtëzakonshme janë të domosdoshme për plotësimin e kërkesës, Shtetet Palë duhet të konsultohen për të vendosur kushtet, sipas të cilave kërkesa do të zbatohet, si edhe për mënyrën sipas së cilës shpenzimet do të ndahen.

29. Shteti Palë i kërkuar:

(a) duhet t'i sigurojë Shtetit Palë kërkues kopje të akteve, dokumenteve ose informacioneve qeveritare që ai zotëron, të cilat sipas legjislacionit të tij të brendshëm janë të hapura për publikun në përgjithësi;

(b) sipas dëshirës së tij, mund t'i sigurojë Shtetit Palë kërkues, të plota, të pjesshme ose sipas kushteve të gjykuara të domosdoshme, kopje të akteve, dokumenteve ose informacioneve qeveritare që ai zotëron, të cilat sipas legjislacionit të tij të brendshëm janë të hapura për publikun në përgjithësi.

30. Shtetet Palë duhet të marrin parasysh, në rast se është e domosdoshme, mundësinë e nënshkrimit të marrëveshjeve, dypalëshe ose shumëpalëshe, të cilat do t'i shërbenin qëllimit, përmirësimit ose do t'i jepnin efekt praktik dispozitave të këtij neni.

Neni 19
Hetimi i përbashkët

Shtetet Palë duhet të marrin në konsideratë nënshkrimin e marrëveshjeve, dypalëshe ose shumëpalëshe, lidhur me çështjet që përbëjnë subjekt hetimesh, ndjekjesh penale ose procedurash gjyqësore në një ose me shumë shtete, sipas të cilave autoritetet përkatëse të interesuara mund të krijojnë organe hetimore të përbashkëta. Në mungesë të marrëveshjeve të tilla, mund të ndërmerren hetime të përbashkëta me marrëveshje, rast pas rasti, Shtetet Palë të interesuara duhet të sigurojnë respektimin e sovranitetit të Shtetit Palë, në territorin e të cilit do të zhvillohet një hetim i tillë.

Neni 20
Teknika të veçanta hetimore

1. Në rast se lejohet nga parimet themelore të sistemit ligjor të brendshëm, çdo Shtet Palë duhet të marrë masat përkatëse për të lejuar përdorimin e duhur të dërgesave të kontrolluara dhe në rast se është e domosdoshme të teknikave të tjera të veçanta hetimore, siç është mbikëqyrja elektronike ose forma të tjera të saj dhe operacionet e mbuluara, brenda mundësive të tij dhe sipas kushteve të përcaktuara nga legjislacioni i tij i brendshëm.

2. Për të hetuar veprat penale të përfshira në këtë Konventë, Shtetet Palë, nëse është e nevojshme, nxiten të nënshkruajnë marrëveshje të duhura, dypalëshe ose shumëpalëshe, për të përdorur këto teknika të veçanta hetimore në kuadrin e bashkëpunimit në nivel ndërkombëtar. Marrëveshje të tilla duhet të nënshkruhen dhe zbatohen në përputhje të plotë me parimet e barazisë së sovranitetit ndërmjet Shteteve dhe të kushteve që ato përmbajnë.

3. Në mungesë të një marrëveshjeje të ngjashme me atë që përmendet në paragrafin 2 të këtij neni, vendimet për përdorim të teknikave të tilla të veçanta hetimore në nivel ndërkombëtar duhet të merren rast pas rasti dhe, në raste të nevojshme, mund të merren parasysh marrëveshje dhe mirëkuptime financiare që kanë të bëjnë me ushtrimin e juridiksionit nga Shtetet Palë të interesuara.

4. Vendimet për ushtrimin e kontrollit të dërgesave të kontrolluara në nivel ndërkombëtar mund të përfshijnë metoda të tilla, si interceptimin ose lejimin e mallrave të kalojnë të paprekura ose të hiqen apo zëvendësohen tërësisht ose pjesërisht me pëlqimin e Shteteve Palë të interesuara.

Neni 21
Transferimi i procedurave penale

Shtetet Palë duhet të marrin parasysh mundësinë e transferimit tek njëri-tjetri të procedurave për ndjekjen e një vepre penale të përfshirë në këtë Konventë, në rastet kur një transferim i tillë

është në interes të administrimit të duhur të drejtësisë, në veçanti në rastet kur përfshihen disa juridiksione, me qëllim që të përqendrohet ndjekja penale.

Neni 22
Krijimi i dokumenteve regjistruese penale

Çdo Shtet Palë duhet të adaptojë masa legjislative dhe masa të tjera të nevojshme për të marrë në konsideratë, në përputhje me kushte të tilla dhe për qëllimin e duhur, çdo dënim të mëparshëm në një Shtet tjetër të një autori të veprës penale, për ta shfrytëzuar një informacion të tillë në procedurat penale që kanë të bëjnë me një vepër penale të përfshirë në këtë Konventë.

Neni 23
Penalizimi i pengimit të drejtësisë

Çdo Shtet Palë duhet të adaptojë masa legjislative dhe masa të tjera të nevojshme, për të konsideruar si vepra penale, kur ato kryhen qëllimisht:

(a) përdorimin e forcës fizike, kërcënimeve dhe terrorizimeve ose premtimin, ofrimin ose dhënien e një avantazhi të pameritуar për të siguruar një dëshmi të rreme ose për të ndërhyrë në dhënien e dëshmisë ose në krijimin e provave në një procedurë që ka të bëjë me kryerjen e veprave penale të përfshira në këtë Konventë;

(b) përdorimin e forcës fizike, kërcënimeve dhe terrorizimeve për të ndërhyrë në ushtrimin e detyrave zyrtare të një zyrtari të drejtësisë ose që merret me zbatimin e ligjit, që kanë të bëjnë me kryerjen e veprave penale të përfshira në këtë Konventë. Asgjë në këtë nënparagraf nuk duhet të cenojë të drejtën e Shteteve Palë të kenë një legjislacion që mbron kategori të tjera të zyrtarëve publikë.

Neni 24
Mbrojtja e dëshmitarëve

1. Çdo Shtet Palë duhet të marrë masat e duhura, brenda mundësive të tij, për të siguruar një mbrojtje efektive të dëshmitarëve, të cilët dëshmojnë në procedurat penale lidhur me veprat penale të përfshira në këtë Konventë dhe, sipas rastit, për familjarët e tyre ose te njerëz të tjerë të afërt, kundër raprezaljeve dhe kërcënimeve të mundshme.

2. Masat e përmendura në paragrafin 1 mund të përfshijnë, ndër të tjera, pa cenuar të drejtat e të pandehurit, duke përfshirë të drejtën për një proces të drejtë:

(a) krijimin e procedurave për mbrojtjen fizike të personave të tillë, si për shembull, kur është e domosdoshme dhe e mundshme, zhvendosjen e tyre dhe lejimin, në rastet e duhura, mosdhënia ose dhënia e kufizuar e informacionit që ka të bëjë me identitetin dhe vendosjen e personave të tillë;

(b) të sigurojë rregulla për marrjen e provave që lejojnë dhënien e dëshmisë nga dëshmitarët në një mënyrë që të sigurojë mbrojtjen e tyre, siç është lejimi i dhënies së dëshmisë përmes përdorimit të teknologjisë së komunikimit, siç janë lidhjet me anë të videove dhe të tjera mjete të sakta.

3. Shtetet Palë duhet të marrin në konsideratë hyrjen në marrëveshje me Shtetet e tjera për zhvendosjen e personave të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni.

4. Dispozitat e këtij neni duhet të zbatohen edhe për viktima në rast se ato janë dëshmitarë.

Neni 25
Ndihma dhe mbrojtja e viktimave

1. Çdo Shtet Palë duhet të marrë masat e duhura, brenda mundësive të tij, për të siguruar ndihmën dhe mbrojtjen e viktimave të veprave penale të përfshira në këtë Konventë, veçanërisht në rastet e kërcënimit për raprezalje dhe terrorizmit.

2. Çdo Shtet Palë duhet të vendosë procedurat e duhura, të cilat do të sigurojnë mundësi kompensimi dhe zhdëmtimi për viktimat e veprave penale të përfshira në këtë Konventë.

3. Çdo Shtet Palë, në varësi të legjislacionit të tij të brendshëm, duhet të bëjë të mundur që pikëpamjet dhe shqetësimet e viktimave të paraqiten dhe merren në konsideratë në fazat e duhura të procedurave penale kundër të pandehurve, në mënyrë të tillë që të mos cenojë të drejtat e mbrojtjes.

Neni 26

Masat për rritjen e bashkëpunimit me autoritetet e zbatimit të ligjit

1. Çdo Shtet Palë duhet të marrë masat e duhura për të nxitur personat që marrin pjesë ose që kanë marrë pjesë në grupe të organizuara kriminale:

(a) të ofrojnë për autoritetet kompetente informacion të dobishëm për qëllime hetimore ose dëshmuese mbi çështje të tilla si:

(i) identitetin, natyrën, përbërjen, strukturën, vendosjen ose aktivitetet e grupeve të organizuara kriminale;

(ii) lidhjet, përfshirë lidhjet ndërkombëtare, me grupe të tjera të organizuara kriminale;

(iii) vepër penale që kanë kryer ose mund të kryejnë grupet e organizuara kriminale;

(b) të ofrojnë për autoritetet kompetente ndihmë faktike konkrete, e cila mund të kontribuojë në privimin e grupeve të organizuara kriminale ndaj burimeve të tyre ose të të ardhurave të krimit.

2. Çdo Shtet Palë duhet të marrë në konsideratë krijimin, në rastet e duhura, të mundësisë për lehtësimin e ndështkimit të një personi të akuzuar, i cili ofron një bashkëpunim të mirëfilltë në hetimin ose ndjekjen e një vepre penale të përfshirë në këtë Konventë.

3. Çdo Shtet Palë, në përputhje me parimet themelore të legjislacionit të tij të brendshëm, duhet të marrë në konsideratë krijimin e mundësisë së dhënies së imunitetit nga ndjekja penale, një personi që ofron bashkëpunim të mirëfilltë në hetimin ose ndjekjen e një vepre penale të përfshirë në këtë Konventë.

4. Mbrojtja e personave të tillë duhet të sigurohet sipas nenit 24 të kësaj Konvente.

5. Kur një person i vendosur në një nga Shtetet Palë i ofron bashkëpunim të mirëfilltë autoriteteve kompetente të një Shteti tjetër Palë sipas paragrafit 1 të këtij neni, Shtetet Palë të interesuara mund të hyjnë në marrëveshje në përputhje me legjislacionet e tyre të brendshme, lidhur me dispozitën e mundshme të trajtimit nga Shteti tjetër Palë sipas paragrafëve 2 dhe 3 të këtij neni.

Neni 27

Bashkëpunimi në zbatimin e ligjit

1. Shtetet Palë duhet të bashkëpunojnë ngushtë me njëri-tjetrin, në përputhje me sistemet e tyre përkatëse ligjore dhe administrative, për të rritur efektivitetin e zbatimit të ligjit në luftë kundër veprave penale të përfshira në këtë Konventë. Çdo Shtet Palë, duhet të adaptojë në veçanti, masa efektive për:

(a) zgjerimin dhe, kur është e nevojshme, krijimin e kanaleve komunikuese ndërmjet autoriteteve kompetente, agjencive dhe shërbimeve për të lehtësuar shkëmbimin e sigurt dhe të shpejtë të informacionit që ka të bëjë me të gjitha aspektet e veprave penale të përfshira në këtë Konventë, duke përfshirë lidhjet me aktivitete të tjera kriminale, në rast se Shtetet Palë e konsiderojnë të domosdoshme;

(b) bashkëpunimin me Shtete të tjera Palë në kryerjen e hetimeve mbi veprat penale të përfshira në këtë Konventë që kanë të bëjnë me:

(i) identitetin, vendnodhjen dhe veprimtaritë e personave të dyshuar për përfshirje në vepra të tilla penale ose vendndodhjen e personave të tjerë të implikuar;

(ii) qarkullimin e të ardhurave të krimit ose të pasurisë së krijuar nga kryerja e veprave të tilla penale;

(iii) qarkullimin e pasurisë, pajisjeve dhe mjeteve të tjera të përdorura ose që synohen të përdoren për kryerjen e veprave të tilla penale;

(c) sigurimin, kur është e nevojshme, të artikujve ose sasive të sustancave të domosdoshme për qëllime analizuese dhe hetimore;

(d) lehtësimin dhe koordinimin efektiv ndërmjet autoriteteve të tyre kompetente, agjencive dhe shërbimeve dhe nxitjen e shkëmbimit të personelit dhe të ekspertëve të tjerë, duke përfshirë dhe emërimin e punonjësve ndërlidhës, në varësi të marrëveshjeve dypalëshe ndërmjet Shteteve Palë të interesuara;

(e) shkëmbim informacionesh me Shtete të tjera Palë mbi mjetet dhe metodat specifike të përdorura nga grupet e organizuara kriminale, për identifikimin e menjëhershëm të veprave penale të përfshira në këtë Konventë.

2. Me qëllim vënien në zbatim të kësaj Konvente, Shtetet Palë duhet të marrin në konsideratë të hyjnë në marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe për bashkëpunim të drejtëpërdrejtë të agjencive të tyre të zbatimit të ligjit dhe t'i përmirësojnë këto marrëveshje, kur ato ekzistojnë. Në mungesë të marrëveshjeve të tilla ndërmjet Shteteve Palë të interesuara, Palët mund të konsiderojnë këtë Konventë si bazë për bashkëpunimin reciprok në zbatimin e ligjit kur kemi të bëjmë me vepra penale të përfshira në këtë Konventë. Sa herë që të jetë e domosdoshme, Shtetet Palë duhet të venë në përdorim të plotë marrëveshjet, duke përfshirë dhe organizatat ndërkombëtare ose rajonale, për të rritur bashkëpunimin ndërmjet agjencive të tyre të zbatimit të ligjit.

3. Shtetet Palë duhet të përpiqen që të bashkëpunojnë, brenda mundësive të tyre, për të kundërvepruar ndaj krimit të organizuar ndërkombëtar të kryer nëpërmjet shfrytëzimit të teknologjisë moderne.

Neni 28

Mbledhja, shkëmbimi dhe analiza e informacionit mbi natyrën e krimit të organizuar

1. Çdo Shtet Palë, duke u konsultuar me komunitetet shkencore dhe akademike, duhet të marrë në konsideratë analizimin e tendencave të krimit të organizuar në territorin e tij, rrethanat në të cilat krimi i organizuar vepron, si edhe grupet profesioniste dhe teknologjitë e përdorura.

2. Shtetet Palë duhet të marrin në konsideratë zhvillimin dhe shkëmbimin me njëri-tjetrin dhe përmes organizatave ndërkombëtare dhe rajonale të ekspertizës analitike lidhur me veprimtaritë e organizuara kriminale. Për këtë qëllim, duhet të zhvillohen përkufizime të përbashkëta, standarde dhe metodologji dhe të zbatohen në mënyrën e duhur.

3. Çdo Shtet Palë duhet të marrë në konsideratë monitorimin e politikave dhe të masave të tij aktuale në luftën kundër krimit të organizuar dhe të bëjë vlerësimet për efektshmërinë dhe rendimentin e tyre.

Neni 29

Trajnimi dhe ndihma teknike

1. Çdo Shtet Palë duhet, domosdoshmërisht, të fillojë, zhvillojë ose përmirësojë programe të veçanta trajnimi për personelin e tij të zbatimit të ligjit, duke përfshirë prokurorë, hetues dhe personel doganor, si edhe personel tjetër të ngarkuar me parandalimin, zbulimin dhe kontrollin e veprave penale të përfshira në këtë Konventë. Programe të tilla mund të përfshijnë dërgime misionesh dhe shkëmbime të stafit. Këto programe, në veçanti dhe në përputhje me legjislacionin e brendshëm, duhet të përfshijnë:

(a) metodat e përdorura në parandalimin, zbulimin dhe kontrollin e veprave penale të përfshira në këtë Konventë;

(b) rrugët dhe teknikat e përdorura nga personat e dyshuar për pjesëmarrje në veprat penale të përfshira në këtë Konventë, duke marrë në konsideratë Shtetet tranzite, si edhe masat e duhura kundërvepruese;

(c) monitorimin e lëvizjes së kontrabandës;

(d) zbulimin dhe monitorimin e qarkullimit të të ardhurave të krimit, pasurisë, pajisjeve ose mjeteve të tjera, metoda të përdorura për transferimin, fshehjen ose maskimin e këtyre të ardhurave,

pajisjeve ose mjeteve, si edhe metodat e përdorura në luftën kundër pastrimit të parave dhe krimeve të tjera financiare;

(e) mbledhjen e provave;

(f) kontrollin e teknikave në zona të lira tregtare dhe portet e lira;

(g) pajisjet dhe teknikat moderne të zbatimit të ligjit, duke përfshirë dhe survejimin elektronik, dërgesat e kontrolluara dhe operacionet e mbuluara;

(h) metodat e përdorura në luftën kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, të kryer nëpërmjet përdorimit të kompjuterave, rrjeteve të telekomunikimit dhe formave të tjera të teknologjisë moderne; dhe

(i) metodat e përdorura në mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve.

2. Shtetet Palë duhet të ndihmojnë njëri-tjetrin në planifikimin dhe zbatimin e programeve kërkimore dhe trajnuese të hartuara për të krijuar një ekspertizë të përbashkët në zonat e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni dhe për këtë qëllim, në raste të duhura, ato duhet gjithashtu të shfrytëzojnë konferencat dhe seminaret rajonale dhe ndërkombëtare për të nxitur bashkëpunimin dhe stimuluar diskutimin për probleme të interesit të përbashkët, duke përfshirë dhe problemet dhe nevojat e veçanta të Shteteve tranzite.

3. Shtetet Palë duhet të nxisin trajnimin dhe ndihmën teknike, të cilat do të lehtësojnë ekstradimin dhe asistencën reciproke ligjore. Një trajnim dhe ndihmë e tillë teknike mund të përfshijë trajnimin gjuhësor, dërgim misionesh dhe shkëmbime të personelit ndërmjet autoriteteve ose agjencive qendrore me përgjegjësitë përkatëse.

4. Në rastet kur ekzistojnë marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe, Shtetet Palë duhet të forcojnë përpjekjet për të rritur veprimtaritë vepruese dhe trajnuese brenda organizatave ndërkombëtare dhe rajonale dhe brenda marrëveshjeve të tjera përkatëse, dypalëshe dhe shumëpalëshe.

Neni 30
Masa të tjera: Zbatimi i Konventës nëpërmjet zhvillimit ekonomik dhe ndihmës teknike

1. Shetet Palë duhet të marrin masat e favorshme për zbatimin sa më optimal të mundshëm të kësaj Konvente, nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar, duke marrë në konsideratë efektet negative të krimit të organizuar tek shoqëria në përgjithësi dhe zhvillimin e qëndrueshëm në veçanti.

2. Shtetet Palë duhet të përpiqen dhe të koordinojnë me njëri-tjetrin dhe me organizata ndërkombëtare dhe rajonale për:

(a) të rritur bashkëpunimin e tyre në nivele të ndryshme me vendet në zhvillim, me qëllim që të forcohet pozita e këtyre vendeve në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar ndërkombëtar.

(b) të rritur ndihmën financiare dhe materiale në mbështetje të përpjekjeve të vendeve në zhvillim për të luftuar me efikasitet krimin e organizuar ndërkombëtar dhe për të ndihmuar ato në zbatimin me sukses të kësaj Konvente;

(c) t'i ofruar ndihmë teknike vendeve në zhvillim dhe vendeve me ekonomi në tranzicion për t'i ndihmuar ato për plotësimin e nevojave të tyre në zbatimin e kësaj Konvente; Për këtë qëllim, Shtetet Palë duhet të përpiqen të japin kontributin e duhur dhe të vazhdueshëm vullnetar në një llogari të përcaktuar për këtë qëllim në mekanizmin financiar të Kombeve të Bashkuara. Shtetet Palë, në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm dhe dispozitat e kësaj Konvente, duhet, gjithashtu, të marrin në konsideratë të veçantë, që të kontribuojnë në llogarinë e lartpërmendur me një përqindje të parave ose të vlerës korresponduese të të ardhurave të krimit ose pasurisë së konfiskuar, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente.

(d) të nxitur dhe bindur, Shtetet e tjera dhe institucionet financiare të bashkohen me to në përpjekjet sipas këtij neni, në veçanti, duke i ofruar më shumë programe trajnimi dhe pajisje moderne vendeve në zhvillim për t'i ndihmuar ato në realizimin e objektivave të kësaj Konvente.

3. Këto masa nuk duhet të cenojnë angazhimet ekzistuese të ndihmës së huaj ose

marrëveshjet e tjera të bashkëpunimit financiar në nivel dypalësh, shumëpalësh ose ndërkombëtar.

4. Shtetet Palë mund të nënshkruajnë marrëveshje, dypalëshe ose shumëpalëshe, për ndihmë materiale dhe logjistike, duke marrë në konsideratë masat financiare të domosdoshme që mënyrat e bashkëveprimit ndërkombëtar të përcaktuara në këtë Konventë të jenë sa më efektive dhe për të parandaluar, zbuluar dhe kontrolluar krimin e organizuar ndërkombëtar.

Neni 31
Parandalimi

1. Shtetet Palë duhet të përpiqen të zhvillojnë dhe vlerësojnë projekte kombëtare për krijimin dhe promovimin e praktikave dhe politikave më të mira në parandalimin e krimit të organizuar ndërkombëtar.

2. Shtetet Palë, në përputhje me parimet themelore të legjislacionit të tyre të brendshëm, duhet të përpiqen nëpërmjet masave të duhura legjislative, administrative dhe të tjera, të reduktojnë mundësitë ekzistuese ose të ardhshme që grupet e organizuara kriminale të marrin pjesë në tregje të ligjshme me të ardhurat e tyre nga krimi. Këto masa duhet të përqëndrohen në:

(a) forcimin e bashkëveprimit ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit ose prokurorëve dhe enteve përkatëse private, duke përfshirë dhe industrinë;

(b) nxitjen e zhvillimit të standardeve dhe procedurave të hartuara për ruajtjen e integritetit të institucioneve publike dhe enteve përkatëse private, si edhe kodet e sjelljes për profesionet përkatëse, në veçanti avokatët, noterët, këshilltarët e taksave dhe llogaritarët;

(c) parandalimin e keqpërdorimit nga grupet e organizuara kriminale të procedurave të tenderit të drejtuara nga autoritetet publike dhe të subvencioneve dhe licencave të lëshuara nga autoritetet publike për veprimtari tregtare;

(d) parandalimin e keqpërdorimit nga grupet e organizuara kriminale të personave ligjore këto masa duhet të përfshijnë:

(i) krijimin e regjistrit publik të personave ligjorë dhe fizikë të përfshirë në krijimin, menaxhimin dhe financimin e personave juridikë;

(ii) paraqitjen e mundësisë së përjashtimit, me urdhër gjyqi ose ndonjë mjet tjetër të përshtatshëm, nga e drejta për të vepruar si drejtues të personave juridikë që janë nën juridiksionin e tyre, për një periudhë të konsiderueshme kohe, të personave të dënuar për vepra penale të përfshira në këtë Konventë.

(iii) krijimin e regjistrave kombëtarë të personave të përjashtuar nga e drejta për të vepruar si drejtues të personave ligjore; dhe

(iv) shkëmbimin e informacionit të ruajtur në regjistrat e përmendur në nënparagrafët (d), (i) dhe (iii) të këtij paragrafi me autoritetet kompetente të Shteteve të tjera Palë.

3. Shtetet Palë duhet të përpiqen të nxisin riintegrimin në shoqëri të personave të dënuar për veprat penale të përfshira në këtë Konventë.

4. Shtetet Palë duhet të përpiqen të vlerësojnë periodikisht instrumentet ekzistuese përkatëse ligjore dhe praktikat administrative, me qëllim që të zbulojnë ndjeshmërinë e tyre për t'u keqpërdorur nga grupet e organizuara kriminale.

5. Shtetet Palë duhet të përpiqen të nxisin ndërgjegjen publike lidhur me ekzistencën, shkaqet, seriozitetin, si dhe kërcënimin që sjell krimi i organizuar ndërkombëtar. Informacioni mund të shpërndahet nëpërmjet mas-medias dhe duhet të përfshijë masa për nxitjen e pjesëmarrjes së publikut në parandalimin dhe luftën e këtyre krimeve.

6. Çdo Shtet Palë duhet të informojë Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara mbi emrin dhe adresën e autoritetit ose autoriteteve që mund të ndihmojnë Shtetet e tjera Palë për zhvillimin e masave për parandalimin e krimit të organizuar ndërkombëtar.

7. Shtetet Palë duhet të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe organizatat përkatëse ndërkombëtare dhe rajonale në nxitjen dhe zhvillimin e masave të përmendura në këtë nen. Këtu përfshihet dhe pjesëmarrja në projekte ndërkombëtare që synon në parandalimin e krimit të

organizuar ndërkombëtar, për shembull duke lehtësuar rrethanat që bëjnë që grupet e skajshme shoqërore të preken nga veprimi i krimit të organizuar ndërkombëtar.

Neni 32
Konferenca e Palëve të Konventës

1. Nëpërmjet kësaj Konvente është vendosur të zhvillohet një Konferencë e Palëve të Konventës për të përmirësuar pozitën e Shteteve Palë në luftë kundër krimit të organizuar ndërkombëtar dhe për të nxitur dhe shyrtuar zbatimin e kësaj Konvente.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara duhet të mbledhë Konferencën e Palëve, jo më vonë se një vit pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente. Konferenca e Palëve duhet të aprovojë rregullat e procedurës dhe rregullat që drejtojnë veprimtaritë e përshkruara në paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni (duke përfshirë dhe rregullat që kanë të bëjnë me pagesën e shpenzimeve të bëra për kryerjen e këtyre veprimtarive).

3. Konferneca e Palëve duhet të bjerë dakord për mekanizmat e realizimit të objektivave të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, duke përfshirë:

(a) lehtësimin e veprimtarive të Shteteve Palë, sipas neneve 29, 30 dhe 31 të kësaj Konvente, si edhe nxitjen e mobilizimit të kontributeve vullnetare;

(b) lehtësimin e shkëmbimit të informacionit ndërmjet Shteteve Palë mbi llojet dhe rrymat e krimit të organizuar ndërkombëtar dhe mbi praktikat e suksesshme të luftimit të tij;

(c) bashkëpunimin me organizatat përkatëse ndërkombëtare dhe rajonale dhe organizatat joqeveritare;

(d) vëzhgimin periodik të zbatimit të kësaj Konvente;

(e) rekomandimet për përmirësimin e kësaj Konvente dhe zbatimit të saj.

4. Për qëllim të paragrafit 3 (d) dhe (e) të këtij neni, Konferenca e Palëve duhet të ketë njohuritë e duhura për masat e marra nga Shtetet Palë për zbatimin e kësaj Konvente dhe vështirësitë e hasura nga ato gjatë këtij zbatimi nëpërmjet informacionit të ofruar nga ato dhe mekanizmave të tilla shtesë vëzhguese që mund të vendosen nga Konferenca e Palëve.

5. Çdo Shtet Palë duhet t'i paraqesë Konferencës së Palëve informacion mbi programet, planet dhe praktikat e tij, si edhe mbi masat legjislative dhe administrative për zbatimin e kësaj Konvente, sipas kërkesës së Konferencës së Palëve.

Neni 33
Sekretariati

1. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara duhet t'i sigurojë Konferencës së Palëve të Konventës shërbimet e duhura të Sekretariatit.

2. Sekretariati duhet:

(a) të ndihmojë Konferencën e Palëve në kryerjen e veprimtarive të përshkruara në nenin 32 të kësaj Konvente dhe të bëjë përgatitjet dhe të sigurojë shërbimet e duhura për sesionet e Konferencës së Palëve;

(b) sipas kërkesës, të ndihmojë Shtetet Palë për paraqitjen e informacionit në Konferencën e Palëve, siç është parashikuar në nenin 32 paragrafi 5 i kësaj Konvente; dhe

(c) të sigurojë koordinimin e nevojshëm me sekretariatet e organizatave përkatëse ndërkombëtare dhe rajonale.

Neni 34
Zbatimi i Konventës

1. Çdo Shtet Palë duhet të marrë masat e duhura, duke përfshirë dhe masa legjislative ose administrative, në përputhje me parimet themelore të legjislacionit të tij të brendshëm për të siguruar zbatimin e detyrimeve të tij në lidhje me këtë Konventë.

2. Veprat penale të përcaktuara në përputhje me nenet 5, 6, 8 dhe 23 të kësaj Konvente duhet të vendosen në legjislacionin e brendshëm të çdo Shteti Palë pavarësisht nga natyra ndërkombëtare ose përfshirja në një grup të organizuar kriminal, siç është përshkruar në nenin 3, paragrafi 1, të kësaj Konvente, me përjashtim të rasteve kur neni 5 i kësaj Konvente kërkon përfshirjen e një grupi të organizuar kriminal.

3. Çdo Shtet Palë mund të adaptojë masa më të rrepta se ato të përcaktuara në këtë Konventë për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar ndërkombëtar.

Neni 35
Zgjidhja e konflikteve

1. Shtetet Palë duhet të përpiqen të zgjidhin konfliktet që kanë të bëjnë me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente nëpërmjet negociatave.

2. Çdo konflikt ndërmjet dy ose më shumë Shteteve Palë, që ka të bëjë me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, i cili nuk mund të zgjidhet nëpërmjet negociatave brenda një kohe të konsiderueshme, me kërkesë të njërit nga Shtetet Palë, duhet të kalohet për gjykim. Në rast se, gjashtë muaj pas datës së kërkesës për gjykim, këto Shtete Palë nuk janë në gjendje të bien dakord mbi organizimin e gjykimit, secila nga Palët mund t'i drejtohet Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë me një kërkesë të hartuar në përputhje me Statutin e Gjykatës.

3. Çdo Shtet Palë, në momentin e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit ose aprovimit të apo aderimit në këtë Konventë, mund të deklarojë se ai nuk mendon t'i përmbahet paragrafit 2 të këtij neni. Shtetet e tjera Palë nuk duhet t'i përmbahen paragrafit 2 të këij neni lidhur me secilin Shtet Palë që ka shprehur një kusht të tillë.

4. Secili nga Shtetet Palë që ka bërë një rezervë në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni, në çdo kohë, mund të tërheqë atë kusht duke njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 36
Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi dhe aderimi

1. Kjo Konventë duhet, gjithashtu, të jetë e hapur për nënshkrim nga të gjitha Shtetet nga 12 deri më 15 dhjetor 2000 në Palermo, Itali, dhe më pas në Selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork deri më 12 dhjetor 2002.

2. Kjo Konventë, duhet gjithashtu, të jetë e hapur për t'u nënshkruar nga organizata të integrimit ekonomik rajonal, me kusht që të paktën një Shtet Anëtar i një organizate të tillë ta ketë nënshkruar këtë Konventë, në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni.

3. Kjo Konventë është subjekt ratifikimi, pranimi ose aprovimi. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose aprovimit duhet të depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara. Një organizatë e integrimit ekonomik rajonal mund të depozitojë instrumentin e saj të ratifikimit, pranimit ose aprovimit në rast se të paktën një nga Shtetet e saj Anëtare e ka bërë këtë. Në atë instrument ratifikimi, pranimi ose aprovimi, një organizatë e tillë duhet të deklarojë shtrirjen e kompetencës së tij, duke respektuar çështjet e trajtuara nga kjo Konventë. Një organizatë e tillë duhet, gjithashtu, të informojë depozituesit për çdo modifikim dhe shtrirje të kompetencave të saj.

4. Kjo Konventë është e hapur për aderim nga çdo Shtet apo organizatë rajonale integrimi ekonomik, në të cilën të paktën një nga Shtetet Anëtare të organizatës është Palë e kësaj Konvente. Instrumentet për aderim duhet të depozitohen me Sekretarin e Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Në momentin e aderimit, një organizatë rajonale integrimi ekonomik duhet të deklarojë shtrirjen e kompetencave të saj, duke respektuar çështjet e trajtuara nga kjo Konventë. Një organizatë e tillë duhet, gjithashtu, të informojë depozituesit për çdo modifikim dhe shtrirje të kompetencave të saj.

Neni 37
Marrëdhëniet me protokollet

1. Kjo Konventë mund të plotësohet nga një ose më shumë protokolle.

2. Me qëllim që të bëhesh Palë në një Protokoll, një Shtet ose një organizatë rajonale integrimi ekonomik duhet të jetë Palë e kësaj Konventë.

3. Një Shtet Palë i kësaj Konvente nuk është i detyruar nga një protokoll derisa nuk është bërë Palë e protokollit, në përputhje me parashikimet e çështjeve të protokollit.

4. Çdo protokoll i kësaj Konvente duhet intepretuar së bashku me këtë Konventë, duke pasur parasysh qëllimin e protokollit.

Neni 38
Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë duhet të hyjë në fuqi ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitimit të instrumentit të dyzetë të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit. Përsa i përket këtij paragrafi, çdo instrument i depozituar nga një organizatë rajonale integrimi ekonomik nuk do të llogaritet si shtesë e atyre të cilat janë depozituar nga Shtetet Anëtare të kësaj organizate.

2. Për çdo shtet ose organizatë rajonale, integrimi ekonomik për ratifikimin, pranimin ose hyrjen në Palë të kësaj Konvente pas depozitës së instrumentit të dyzetë të çdo veprimi, kjo Konventë do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit nga çdo Shtet ose organizatë për instrumentin e aplikueshëm.

Neni 39
Amendamentet

1. Pas përfundimit të pesë vjetëve nga hyrja në fuqi e kësaj Konvente, një Shtet Palë mund të propozojë një amendament dhe ta dorëzojë në Sekretariatin e Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, i cili duhet që, menjëherë pas kësaj, të komunikojë amendamentin e propozuar Shteteve Palë dhe Konferencës së Palëve të Konventës për propozimin, marrjen në konsideratë dhe vendimin mbi këtë propozim. Konferenca e Palëve duhet të bëjë çdo përpjekje për të arritur konsensus për secilin nga amendamentet. Në qoftë se të gjitha përpjekjet për konsensus janë shfrytëzuar dhe nuk është arritur ndonjë marrëveshje, amendamenti duhet që si mundësi të fundit të kërkojë adaptimin e tij me maxhoritetin e dy të tretave të Shteteve Palë, të cilët janë të pranishëm dhe votojnë në Konferencën e Palëve.

2. Organizatat rajonale të integrimit ekonomik, në raport me kompetencat e tyre, do të ushtrojnë të drejtën e tyre të votës bazuar në këtë nen me një numër votash të barabartë me numrin e Shteteve të cilat janë Palë e kësaj Konvente. Kjo organizatë nuk mund ta ushtrojë të drejtën e saj për të votuar në qoftë se Shtetet votojnë në mënyrë të veçuar nga organizata ose anasjelltas.

3. Një Amendament i aprovuar në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni është subjekt ratifikimi, pranimi ose aprovimi nga Shtetet Palë.

4. Një amendament i apovuar në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni duhet të hyjë në fuqi duke respektuar nëntëdhjetëditëshin e Shtetit Palë pas datës së depozitimit në Sekretariatin e Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara të një instrumenti për ratifikim, pranim ose aprovim për çdo amendament.

5. Kur një amendament hyn në fuqi, ai duhet të bëhet obligim për ato Shtete Palë, të cilat kanë shprehur konsensusin e tyre për ta pranuar si të tillë. Shtetet e tjera Palë duhet të vazhdojnë të jenë të detyruara nga dispozitat që parashikon ky Protokoll dhe çdo amandament i mëparshëm që ata kanë ratifikuar, pranuar apo aprovuar.

Neni 40
Denoncimi

1. Një Shtet Palë mund të denoncojë këtë Konventë me një njoftim të shkruar, në Sekretariatin e Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Një denoncim i tillë duhet të bëhet efektiv një vit pas datës së marrjes nga Sekretariati i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

2. Një organizatë rajonale e integrimit ekonomik mund të pushojë së qeni Palë e kësaj Konvente vetëm atëherë kur të gjithë shtetet pjesëmarrëse në këtë organizatë të kenë denoncuar Konventën.

3. Denoncimi i kësaj Konvente, në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, do të përfshijë dhe protokollet e lidhura me këtë Konventë.

Neni 41
Depozitimi dhe gjuhët

1. Sekretariati i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara është vendi i depozitimit të kësaj Konvente.

2. Origjinali i kësaj Konvente do të jetë në arabisht, kinezçe, anglisht, frëngjisht, rusisht dhe spanjisht me tekste autentikisht të njëjta, i depozituar në Sekretariatin e Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Në dëshmi të kësaj, përfaqësuesit e plotfuqishëm të autorizuar nga qeveritë respektive nënshkruan këtë Konventë.

PROTOKOLL
KUNDËR TRAFIKUT TË MIGRANTËVE ME RRUGË TOKËSORE, AJRORE DHE DETARE, E CILA PLOTËSON KONVENTËN E KOMBEVE TË BASHKUARA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR NDËRKOMBËTAR

Parashtesë

Shtetet Palë të këtij Protokolli,

Duke deklaruar se masat efektive për parandalimin dhe luftimin e trafikut të migrantëve me rrugë tokësore, detare dhe ajrore kërkojnë një qëndrim të përgjithshëm ndërkombëtar, duke përfshirë bashkëpunimin, shkëmbimin e informacionit dhe masa të tjera të nevojshme, si dhe masa social-ekonomike në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëar,

Duke kujtuar rezolutën 54/212 të Asamblesë së Përgjithshme, të datës 12 dhjetor 1999, në të cilën Asambleja kërkoi që Shtetet Anëtare dhe Kombet e Bsashkuara të forcojnë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e migrimit ndërkombëtar dhe zhvillimit, në mënyrë që të trajtojnë shkaqet kryesore të migrimit, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me varfërinë, dhe të maksimizojnë përfitimet e të interesuarve nga migrimi ndërkombtëar, si dhe të nxisin, në vendet përkatëse, mekanizmat ndërrajonalë, rajonalë dhe nënrajonalë për të vazhduar trajtimin e çështjes së migrimit dhe zhvillimit,

Të bindur për nevojën e sigurimit të një trajtimi human të migrantëve dhe mbrojtje të plotë të të drejtave të tyre,

Duke marrë në konsideratë faktin që, pavarësisht nga puna e ndërmarrë në forume të tjera ndërkombëtare, nuk ka asnjë dokument universal që trajton të gjitha aspektet e trafikut të migrantëve dhe çështjeve të tjera që kanë të bëjnë me të,

Të shqetësuar për rritjen e konsiderueshme të veprimtarive të grupeve të organizuara kriminale në trafikun e migrantëve dhe veprimtarive të tjera të ngjashme kriminale të parashtruara në këtë Protokoll, e cila i shkakton dëme të mëdha Shteteve të interesuara,

Të shqetësuar gjithashtu, që kontrabanda e migrantëve mund të rrezikojë jetën ose sigurinë e migrantëve të përfshirë,

Duke krijuar rezolutën 53/111 të Asamblesë së Përgjithshme të datës 9 dhjetor 1998, sipas së cilës Asambleja vendosi të krijojë një komitet të posaçëm të hapur ndërqeveritar për përpunimin e një konvente të përgjithshme ndërkombëtare kundër krimit të organizuar ndërkombëtar dhe diskutimin, ndër të tjera, të përpunimit të një dokumenti ligjor ndërkombëtar që trajton trafikun ilegal dhe transportin e migrantëve, edhe me rrugë detare,

Të bindur që plotësimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar me një dokument ligjor ndërkombëtar kundër trafikun e migrantëve me rrugë tokësore, detare dhe ajrore do të jetë i dobishëm për parandalimin dhe luftimin e krimit.

Ranë dakord si më poshtë:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Lidhja me Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar

1. Ky Protokoll plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar. Ai duhet të interpretohet së bashku me këtë Konventë.

2. Dispozitat e Konventës duhet të përdoren, me ndryshimet e nevojshme, në këtë Protokoll, në rast se nuk paraqiten të tjera në këtë dokument.

3. Veprat penale të përcaktuara si të tilla në përputhje me nenin 6 të këtij Protokolli duhet të konsiderohen si vepra penale në përputhje me Konventën.

Neni 2
Deklarimi i qëllimit

Qëllimi i këtij Protokolli është të parandalojë dhe luftojë trafikun e migrantëve, si edhe të nxisë bashkëpunimin ndërmjet Shteteve Palë për këtë qëllim, duke mbrojtur, në të njëjtën kohë të drejtat e migrantëve.

Neni 3
Përdorimi i termave

Për qëllime të këtij Protokolli:

(a)"Trafik i migrantëve" do të thotë prokurimi për qëllim përfitimi financiar ose material, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nga kalimi i paligjshëm në një Shtet Palë të një personi, në të cilin ai/ajo nuk është shtetas ose rezident i përhershëm.

(b) "Kalim i paligjshëm" do të thotë kalim i kufirit pa iu përmbajtur kërkesave të domosdoshme për kalimin e ligjshëm në Shtetin pritës.

(c)"Dokument i falsifikuar udhëtimi ose identifikimi" do të thotë çdo dokument udhëtimi ose identifikimi, i cili:

(i) është bërë ose ndryshuar në mënyrë të falsfikuar në rrugë noteriale nga çdokush, me përjashtim të një personi ose agjencie të autorizuar me ligj për të bërë ose lëshuar dokumente udhëtimi ose identifikimi në emër të një Shteti; ose

(ii) është lëshuar ose marrë në mënyrë të parregullt, nëpërmjet paraqitjes së të dhënave të falsifikuara, korrupsionit, kërcënimit ose të ndonjë mënyrë tjetër të paligjshme; ose

(iii) përdoret nga një person tjetër dhe jo nga mbajtësi i ligjshëm.

(d) "Anije" do të thotë çdo lloj mjeti lundrues, duke përfshirë dhe mjetet jotransportuese dhe hidroplanet, që përdoren ose të afta për t'u përorur si mjet transporti ujor, me përjashtim të anijeve luftarake, anije ndihmëse marine ose anije të tjera të zotëruara ose që veprojnë për qeverinë dhe të përdorura, tani për tani, vetëm për shërbime qeveritare jotregtare.

Neni 4
Qëllimi i zbatimit

Ky Protokoll, me përjashtim të rasteve kur e kundërta deklarohet në këtë dokument, duhet t'i referohet parandalimit, hetimit dhe ndjekjes të veprave penale, të përcaktuara sipas nenit 6 të këtij Protokolli, kur ato kanë natyrë ndërkombëtare dhe që përfshijnë grup të organizuar kriminal, si edhe mbrojtjes së të drejtave të personave që kanë qenë objekt i veprave të tilla penale.

Neni 5
Përgjegjësia penale e migrantëve

Migrantët nuk duhet të bëhen subjekt i ndjekjes penale në bazë të këtij Protokolli, për faktin se kanë qenë objekt i veprimit të përmendur në nenin 6 të këtij Protokolli.

Neni 6
Penalizimi

1. Secili Shtet duhet të adaptojë masa të tilla legjislative dhe masa të tjera që mund të jenë të nevojshme për të cilësuar si vepra penale, nëse kryhen qëllimisht dhe për të marrë, direkt ose indirekt, një përfitim financiar ose material:

(a) trafikun e migrantëve;

(b) në rast se kryhen me qëllim mundësimin e trafikut të migrantëve:

(i) paraqitja e dokumenteve të falsifikuara të udhëtimit dhe identifikimit;

(ii) gjetja, sigurimi ose posedimi i një dokumenti të tillë.

(c) krijimin e mundësisë për një person, i cili nuk është shtetas ose nuk ka qëndrim të përhershëm në Shtetin e interesuar, pa plotësuar kërkesat e domosdoshme për të qëndruar ligjërisht në këtë Shtet nëpërmjet mënyrave të përmendura në nënparagrafin (b) të këtij paragrafi ose nëpërmjet mjeteve të tjera ligjore.

2. Secili Shtet Palë duhet të adaptojë, gjithashtu, masa të tilla legjislative dhe masa të tjera të nevojshme për të cilësuar si vepra penale:

(a) duke iu nënshtruar koncepteve bazë të sistemit të tij ligjor, tentativën për të kryer një vepër penale, të cilësuar në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni;

(b) pjesëmarrjen si bashkëpunëtor në një vepër penale, të cilësuar në përputhje me paragrafin 1(a), (b) (i) ose (c) të këtij neni dhe, duke iu nënshtruar koncepteve bazë të sistemit të tij ligjor, pjesëmarrjen si bashkëpunëtor në një vepër penale të cilësuar, në përputhje me paragrafin 1(b) (ii) të këtij neni;

(c) organizimin ose drejtimin e personave të tjerë për të kryer një vepër penale të cilësuar, në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni.

3. Secili Shtet Palë duhet të adaptojë masa të tilla legjislative dhe masa të tjera të nevojshme për të cilësuar si rrethana rënduese për veprat e cilësuara, në përputhje me paragrafin 1 (a), (b) (i) dhe (c) të këtij neni dhe duke iu nënshtruar koncepteve bazë të sistemit të tij ligjor, për veprat penale të cilësuara, në përputhje me paragrafin 2 (b) dhe (c) të këtij neni, rrethanat:

(a) që rrezikojnë ose kanë të ngjarë se do të rrezikojnë jetën ose sigurinë e migrantëve në fjalë; ose

(b) që mundësojnë trajtimin jonjerëzor ose degradues, duke përfshirë dhe shfrytëzimin, e këtyre migrantëve.

4. Asgjë në këtë Protokoll nuk duhet të ndalojë një Shtet Palë që të marrë masa kundër një personi, sjelllja e të cilit përbën një vepër penale në bazë të ligjit të tij vendas.

II. TRAFIKU I MIGRANTËVE ME RRUGË DETARE

Neni 7
Bashkëpunimi

Shtetet Palë duhet të bashkëpunojnë sa më shumë të jetë e mundur për parandalimin dhe pengimin e trafikut të migrantëve me rrugë detare, në përputhje me ligjin ndërkombëtar të detit.

Neni 8
Masat kundër trafikut të migrantëve në rrugë detare

1. Një Shtet Palë që ka arsye të drejta për të dyshuar se një anije që valëvit flamurin e tij ose pretendon të jetë e regjistruar tek ai, e cila nuk ka shtetësi ose që, pavarësisht se valëvit një flamur të huaj ose refuzon të tregojë një flamur, ka në të vërtetë shtetësinë e Shtetit Palë të interesuar dhe është përfshirë në trafikun e migrantëve nëpërmjet detit, mund të kërkojë ndihmën e Shteteve të tjera Palë për të penguar përdorimin e anijes për këtë qëllim. Shtetet Palë që u kërkohet një gjë e tillë duhet të ofrojnë ndihmën e tyre në atë masë që e kanë të mundur.

2. Një Shtet Palë që ka arsye të drejta për të dyshuar se një anije që ushtron lirinë e lundrimit në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe valëvit flamurin ose mban shenjat e regjistrimit të një Shteti tjetër Palë, merret me trafikun e migrantëve nëpërmjet detit, mund të njoftojë për këtë gjë Shtetin, flamurin e të cilit mban anija, të kërkojë konfirmimin e regjistrimit dhe, në qoftë se konfirmohet, të kërkojë autorizimin nga ky Shtet për të marrë masat e duhura në lidhje me atë anije. Shteti i fundit mund të autorizojë Shtetin kërkues, ndër të tjera:

(a) të hyjë në anije;

(b) të kontrollojë në anije; dhe

(c) në rast se zbulohen prova se anija merret me trafikun e migrantëve nëpërmjet detit, të marrë masat e përshtatshme në lidhje me anijen, personat dhe ngarkesën që ndodhet në bord, në mënyrën e autorizuar nga Shteti, flamurin e të cilit mban anija.

3. Një Shtet Palë që kanë marrë masat, në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, duhet të njoftojë menjëherë Shtetin, flamurin e të cilit mban anija, për rezultatet e këtyre masave.

4. Një Shtet Palë duhet t'i përgjigjet menjëherë kërkesës nga një Shtet tjetër Palë për të përcaktuar nëse një anije, që pretendon të jetë e regjistruar tek ai ose valëvit flamurin e tij, është e autorizuar të veprojë kështu dhe të parashtrojë një kërkesë në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni.

5. Në përputhje me nenin 7 të këtij Protokolli, një Shtet, flamurin e të cilit mban anija, mund t'ia nënshtrojë autorizimin e tij kushteve, të cilat do të pranohen prej tij dhe Shtetit kërkues, përfshirë kushtet që lidhen me përgjegjësinë dhe shtrirjen e masave efektive që do të merren. Një Shtet Palë nuk do të marrë masa plotësuese pa autorizimin e shprehur të Shtetit, flamurin e të cilit mban anija, përveç masave të nevojshme për të reduktuar rrezikun e lartë për jetën e personave ose të atyre masave që rrjedhin nga marrëveshjet përkatëse, dypalëshe ose shumëpalëshe.

6. Secili Shtet Palë duhet të caktojë një autoritet ose, në rastet e domosdoshme, autoritetet për të marrë dhe për t'iu përgjigjur kërkesave për ndihmë, për konfirmimin e regjistrimit ose të së drejtës së një anijeje për të valëvitur flamurin e tij dhe për autorizimin e marrjes së masave të duhura. Ky caktim duhet t'i njoftohet përmes Sekretarit të Përgjithshëm, të gjitha Shteteve të tjera Palë, benda një muaji nga data caktimit.

7. Një Shtet Palë që ka arsye të drejta për të dyshuar se një anije është përfshirë në trafikun e migrantëve nëpërmjet detit dhe është pa shtetësi ose mund të konsiderohet si e tillë, mund të hyjë dhe të kontrollojë në anije, në rast se zbulohen prova që vërtetojnë dyshimin, ai Shtet Palë duhet të marrë masat e duhura, në përputhje me legjislacionin përkatës vendas dhe ndërkombëtar.

Neni 9
Klauzolat mbrojtëse

1. Nëse një Shtet Palë merr masa kundër një anije, në përputhje me nenin 8 të këtij Protokolli, ai duhet:

(a) të garantojë sigurinë e trajtimit njerëzor të personave që ndodhen në bord;

(b) të marrë parasysh nevojën për të mos rrezikuar sigurinë e anijes ose të ngarkesës së saj;

(c) të marrë parasysh nevojën për të mos cenuar interesat tregtare ose ligjore të Shtetit, flamurin e të cilit mban anija, ose të ndonjë Shteti tjetër të interesuar;

(d) të garantojë, me mundësitë që ka, që çdo masë e marrë në lidhje me anijen nuk dëmton mjedisin.

2. Në rast se arsyet për marrjen e masave në zbatim të nenit 8 të këtij Protokolli janë të pabazuara, anija duhet të kompensohet për çdo humbje ose dëmtim që ka pësuar, me kusht që anija të mos ketë kryer ndonjë veprim që të justifikojë masat e marra.

3. Duhet të merret në konsideratë që çdo masë e marrë, e adaptuar ose e zbatuar në përputhje me këtë kapitull, të mos ndërhyjë ose ndikojë në:

(a) të drejtat dhe detyrimet dhe në ushtrimin e juridiksionit të Shteteve bregdetare, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare të detit; ose

(b) autoritetin e Shtetit, flamurin e të cilit mban anija, për të ushtruar juridiksionin dhe kontrollin në çështjet administrative, teknike dhe sociale që kanë të bëjnë me anijen.

4. Çdo masë e marrë në det, në zbatim të këtij kapitulli, do të kryhet vetëm në luftanijet ose avionët luftarakë, ose nga anije apo avionë të tjerë që kanë shenja të qarta dhe janë të identifikueshëm se kryejnë shërbime qeveritare dhe të autorizuara për këtë qëllim.

III. PARANDALIMI, BASHKËPUNIMI DHE MASAT E TJERA

Neni 10
Informacioni

1. Pa cenuar nenet 27 dhe 28 të Konventës dhe në përputhje me sistemet e tyre të brendshme ligjore dhe administrative, Shtetet Palë, në veçanti ato që kanë kufij të përbashkët ose ndodhen në rrugët e trafikimit të migrantëve, për qëllimet e arritjes së objektivave të këtij Protokolli, duhet të shkëmbejnë ndërmjet tyre informacione përkatëse në lidhje me çështje të tilla si:

(a) pikat e imbarkimit dhe destinacionit, si dhe rrugët, transportuesit dhe mjetet e transportit, që dihet ose dyshohet se janë përdorur nga një grup i organizuar kriminal që kryejnë aktet e parashikuara në nenin 6 të këtij Protokolli;

(b) identiteti dhe metodat e organizatave ose të grupeve të organizuara kriminale, që njihen ose dyshohen që kryejnë aktet e parashikuara në nenin 6 të këtij Protokolli;

(c) autenticiteti dhe forma e duhur e dokumenteve të udhëtimit, të lëshuara nga një Shtet Palë dhe vjedhja ose keqpërdorimi përkatës i dokumenteve të paplotësuara të udhëtimit ose identitetit;

(d) mjetet dhe metodat e fshehjes dhe transportimit të personave, ndryshimi i paligjshëm, riprodhimi, marrja ose keqpërdorimi në një formë tjetër i dokumenteve të udhëtimit ose identitetit, të përdorura në aktet e parashikuara në nenin 6 të këtij Protokolli dhe mënyra të zbulimit të tyre;

(e) eksperiencat dhe praktikat ligjore, si dhe masat për parandalimin dhe luftën kundër akteve të parashikuara në nenin 6 të këtij Protokolli; dhe

(f) informacionin shkencor dhe teknologji, i dobishëm për zbatimin e ligjit, me qëllim që të rrisin aftësinë e njëri-tjetrit për të parandaluar, zbuluar dhe hetuar aktet e parashikuara në nenin 6 të këtij Protokolli dhe për të ndjekur penalisht personat e përfshirë në to.

2. Një Shtet Palë që merr informacionin duhet të përmbushë të gjitha kërkesat e Shtetit Palë që e ka transmetuar atë, i cili vendos kufizime për përdorimin e tij.

Neni 11
Masat kufitare

1. Pa cenuar angazhimet ndërkombëtare në lidhje me lëvizjen e lirë të njerëzve, Shtetet Palë duhet të forcojnë sa më shumë të jetë e mundur kontrollet kufitare, të cilat mund të jenë të nevojshme për parandalimin dhe zbulimin e trafikut të emigrantëve.

2. Secili Shtet Palë duhet të adaptojë masa legjislative ose masa të tjera të nevojshme për të parandaluar, sa më shumë që të jetë e mundur, përdorimin e mjeteve të transportit nga transportues tregtarë për kryerjen e veprave penale të parashikuara në nenin 6 paragrafi 1(a) të këtij Protokolli.

3. Në rastet e duhura dhe pa cenuar konventat ndërkombtëare të zbatueshme, masa të tilla duhet të përfshijnë vendosjen e detyrimit të transportuesve tregtarë, duke përfshirë çdo kompani transporti, pronarin ose drejtuesin e çdo mjeti transporti për t'u siguruar që të gjithë pasagjerët posedojnë dokumentet e udhëtimit të kërkuara për të hyrë në Shtetin pritës.

4. Çdo Shtet Palë duhet të marrë masat e duhura në përputhje me legjislacionin e tij të brendshëm për sigurimin e sanksioneve në rastet e dhunimit të detyrimit të parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni.

5. Në përputhje me legjislacionin e tij të brendshëm çdo Shtet Palë duhet të marrë parasysh marrjen e masave që lejojnë mohimin e hyrjes në Shtetin tjetër ose revokimin e vizave të personave të implikuar në kryerjen e veprave penale të përcaktuara, në përputhje me këtë Protokoll.

6. Pa cenuar nenin 27 të Konventës, Shtetet Palë duhet të marrin në konsideratë forcimin e bashkëpunimit ndërmjet agjencive të kontrollit kufitar, duke krijuar dhe ruajtur, ndër të tjera kanale të drejtpërdrejta komunikimi.

Neni 12
Sigurimi dhe kontrolli i dokumenteve

Çdo Shtet Palë duhet të marrë masa të tilla të nevojshme brenda mundësive që ka:

(a) për t'u siguruar që dokumentet e udhëtimit ose të udhëtimit të lëshuara nga ai janë të tilla që nuk mund të keqpërdoren me lehtësi dhe nuk mund të falsifikohen, të ndryshohen në mënyrë të paligjshme, të riprodhohen ose lëshohen; dhe

(b) për të garantuar integritetin dhe sigurinë e dokumenteve të udhëtimit ose identifikimit të lëshuara nga Shteti Palë ose në emër të tij dhe për të parandaluar krijimin, lëshimin dhe përdorimin e tyre të paligjshëm.

Neni 13
Legjitimiteti dhe vlefshmëria e dokumenteve

Me kërkesë të një Shteti tjetër Palë, një Shtet Palë, në përputhje me legjislacionin e tij të brendshëm, duhet të verifikojë brenda një kohe të arsyeshme legjitimitetin dhe vlefshmërinë e dokumenteve të udhëtimit ose identifikimit të lëshuar në emër të tij dhe dyshohet që po përdoren për qëllimet e akteve të parashikuara në nenin 6 të këtij Protokolli.

Neni 14
Trajnimi dhe bashkëpunimi teknik

1. Shtetet Palë të sigurojnë ose forcojnë trajnimin e specializuar për zyrtarët e imigracionit dhe zyrtarët e tjerë për parandalimin e akteve të parashikuara në nenin 6 të këtij Protokolli dhe për trajtimin human të migrantëve që kanë qenë objekt i akteve të tilla, duke respektuar në të njëjtën kohë të drejtat e tyre të parashikuara në këtë Protokoll.

2. Shtetet Palë duhet të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, me organizata ndërkombëtare kompetente, organizata joqeveritare, organizata të tjera përkatëse dhe elementë të tjerë të shoqërisë civile për të siguruar trajnimin e duhur të personelit në territoret e tyre për parandalimin, luftimin

dhe eliminimin e akteve të parashikuara në nenin 6 të këtij Protokolli dhe mbrojtjen e të drejtave të migrantëve që janë objekt i akteve të tilla. Një trajnim i tillë duhet të përfshijë:

(a) përmirësimin e sigurisë dhe cilësisë së dokumenteve të udhëtimit;

(b) njohjen dhe zbulimin e dokumenteve të falsifikuara të udhëtimit ose identifikimit;

(c) grumbullimin e të dhënave të krimit, që kanë të bëjnë, veçanërisht, me identifikimin e grupeve të organizaura kriminale që njihen ose dyshohen të jenë përfshirë në aktet e parashikuar në nenin 6 të këtij Protokolli, metodat e përdorura për transportin e migrantëve të trafikuar, keqpërdorimin e dokumenteve të udhëtimit ose identifikimit për qëllimet e akteve të parashikuar në nenin 6 dhe mjetet e fshehjes të përdorura në trafikun e migrantëve;

(d) përmirësimin e procedurave të zbulimit të personave të trafikuar në pikat konvencionale dhe jokonvencionale të hyrjes dhe daljes; dhe

(e) trajtimin human të migrantëve dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre, siç parashikohet në këtë Protokoll.

3. Shtetet Palë, me ekspertizën përkatëse, duhet t'u sigurojnë ndihmë teknike Shteteve që janë shpesh vende të origjinës dhe tranzitit të personave që janë objekt i akteve të parashikuara në nenin 6 të këtij Protokolli. Shtetet Palë duhet të bëjnë çdo përpjekje për të siguruar burimet e nevojshme siç janë mjetet, sistemet kompjuterike dhe lexuesit e dokumenteve për të luftuar aktet e parashikuara në nenin 6.

Neni 15
Masa të tjera parandalimi

1. Çdo Shtet Palë duhet të marrë masa për të siguruar dhe forcuar programet e informacionit për ndërgjegjësimin e publikut për faktin se aktet e parashikuara në nenin 6 të këtij Protokolli përbëjnë veprimtari kriminale të kryera nga grupe të organizuara krimiale për përfitime dhe që ato paraqesin rreziqe serioze për migrantët e implikuar.

2. Në përputhje me nenin 31 të Konventës, Shtetet Palë duhet të bashkëpunojnë në fushën e informimit publik për parandalimin e rënies së migrantëve potencialë viktimë e grupeve të organizuara kriminale.

3. Çdo Shtet duhet të nxisë dhe forcojë programe zhvillimi dhe bashkëpunimi në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, duke marrë parasysh realitetet social-ekonomike të migrimit dhe duke i kushtuar vëmendje të veçantë zonave me probleme ekonomike dhe sociale, për të luftuar shkaqet kryesore social-ekonomike të trafikut të migrantëve, si varfërinë dhe mungesën e zhvillimit.

Neni 16
Mbrojtja dhe masat ndihmëse

1. Në zbatim të këtij Protokolli, çdo Shtet Palë, në përputhje me detyrimet e tij sipas të drejtës ndërkombëtare, duhet të marrë të gjitha masat e duhura, duke përfshirë, në rast se është e nevojshme, legjislacioni për të ruajtur dhe mbrojtur të drejtat e personave që janë bërë objekt i akteve të parashikuara në nenin 6 të këtij Protokolli, siç është pranuar në bazë të së drejtës ndërkombëtare të aplikueshme, veçanërisht të drejtën për të jetuar dhe të drejtën për të mos iu nënshtruar torturës, trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe degraduese.

2. Çdo Shtet Palë duhet të marrë masat e duhura për t'i siguruar migrantëve mbrojtjen e duhur kundër dhunës që mund të ushtrohet ndaj tyre nga individë ose grupe, për arsye se ato janë objekt i akteve të parashikuara në nenin 6 të këtij Protokolli.

3. Çdo Shtet Palë duhet t'i sigurojë ndihmën e duhur migrantëve, jeta ose siguria e të cilëve rrezikohet për arsye se janë objekt i akteve të parashikuara në nenin 6 të këtij Protokolli.

4. Në zbatimin e dispozitave të këtij neni, Shtetet Palë duhet të marrin parasysh nevojat e veçanta të grave dhe fëmijëve.

5. Në rastin e zbulimit të një personi i cili është objekt i akteve të parashikuara në nenin 6 të këtij Protokolli, çdo Shtet Palë duhet të përmbushë detyrimet e tij sipas Konventës së Vjenës për

Marrëdhëniet Konsullore, duke përfshirë dhe informimin pa vonesë të personit të interesuar për dispozitat që kanë të bëjnë me njoftimin dhe komunikimin me zyrtarët konsullorë.

Neni 17
Marrëveshjet

Shtetet Palë duhet të marrin parasysh lidhjen e marrëveshjeve ose mirëkuptimeve dypalëshe ose rajonale që synojnë:

(a) vendosjen e masave të duhura dhe efektive për parandalimin dhe luftimin e akteve të parashikuara në nenin 6 të këtij Protokolli; ose

(b) forcimin e dispozitave të këtij Protokolli.

Neni 18
Kthimi i migrantëve të trafikuar

1. Çdo Shtet Palë pranon të lehtësojë dhe pranojë, pa vonesa të paarsyeshme, kthimin e një personi që është objekt i akteve të parashikuara në nenin 6 të këtij Protokolli dhe që është shtetas ose ka të drejtën e qëndrimit të përhershëm në territorin e tij në kohën e kthimit.

2. Çdo Shtet Palë duhet të marrë në konsideratë mundësinë e lehtësimit dhe pranimit të kthimit të një personi që është objekt i akteve të parashikuara në nenin 6 të këtij Protokolli dhe që ka të drejtën e qëndrimit të përhershëm në territorin e tij në kohën e hyrjes në Shtetin pritës, në përputhje me legjislacionin e tij të brendshëm.

3. Me kërkesë të Shtetit Palë pritës, një Shtet Palë i kërkuar duhet të verifikojë, pa vonesa të paarsyeshme, nëse një person që ka qenë objekt i akteve të parashikuara në nenin 6 të këtij Protokolli është shtetas i tij ose ka të drejtën e qëndrimit të përhershëm në territorin e tij.

4. Me qëllim që të lehtësohet kthimi i një personi që ka qenë objekt i akteve të parashikuara në nenin 6 të këtij Protokolli dhe që nuk ka dokumentet e duhura, Shteti Palë, shtetas i të cilit është personi ose në të cilin ky i fundit ka të drejtën e qëndrimit të përhershëm, duhet të pranojë të lëshojë, me kërkesën e Shtetit Palë pritës, dokumentet e udhëtimit ose ndonjë autorizim tjetër që mund të jetë i nevojshëm për të mundësuar personin të udhëtojë dhe të rihyjë në territorin e tij.

5. Çdo Shtet Palë, që përfshihet në kthimin e një personi, që ka qenë objekt i akteve të parashikuara në nenin 6 të këtij Protokolli, duhet të marrë të gjitha masat përkatëse për të zbuluar kthimin në mënyrë të rregullt dhe duke pasur parasysh sigurinë dhe dinjitetin e personit.

6. Shtetet Palë mund të bashkëpunojnë me organizatat ndërkombëtare përkatëse për zbatimin e këtij neni.

7. Ky nen nuk duhet të cenojë të drejtat që i janë dhënë personave që kanë qenë objekt i akteve të parashikuara në nenin 6 të këtij Protokolli nga ndonjë ligj i brendshëm i Shtetit Palë pritës.

8. Ky nen nuk duhet të cenojë detyrimet në bazë të ndonjë traktati tjetër të aplikueshëm, dypalësh ose shumëpalësh, ose të ndonjë marrëveshjeje tjetër vepruese që rregullon, plotësisht ose pjesërisht, kthimin e personave që kanë qenë objekt i akteve të parashikuara në nenin 6 të këtij Protokolli.

III. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 19
Klauzola mbrojtëse

1. Asgjë në këtë Protokoll nuk duhet të cenojë të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e tjera të Shteteve dhe individëve në bazë të së drejtës ndërkombëtare, përfshirë të drejtën ndërkombëtare monetare, dhe së drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe, në veçanti, Konventën e vitit 1951 dhe Protokollin e vitit 1967, që lidhet me statusin e refugjatëve dhe parimin e moskthimit të refugjatëve (non-refoulement) të përfshirë në këtë dokument.

2. Masat e parashikuara në këtë Protokoll duhet të interpretohen dhe zbatohen në mënyrë jodiskriminuese ndaj personave që kanë qenë objekt i akteve të parashikuara në nenin 6 të këtij Protokolli. Interpretimi dhe vënia në zbatim i këtyre masave duhet të bëhet në përputhje me parimet e njohura ndërkombëtare të mosdiskriminimit.

Neni 20
Zgjidhja e konflikteve

1. Shtetet Palë duhet të përpiqen të zgjidhin konfliktet lidhur me interpretimin dhe vënien në zbatim të këtij Protokolli nëpërmjet negociatave.

2. Çdo konflikt ndërmjet dy ose më shumë Shteteve Palë, që ka të bëjë me interpretimin ose zbatimin e këtij Protokolli, i cili nuk mund të zgjidhet nëpërmjet negociatave brenda një kohe të konsiderueshme, me kërkesë të njërit nga Shtetet Palë, duhet të kalohet për gjykim. Në rast se gjashtë muaj pas datës së kërkesës për gjykim, këto Shtete Palë nuk janë në gjendje të bien dakord mbi organizimin e gjykimit, secila nga Palët mund t'i drejtohet Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, me një kërkesë të hartuar në përputhje me Statutin e Gjykatës.

3. Çdo Shtet Palë në momentin e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit ose aprovimit apo të aderimit në këtë Protokoll, mund të deklarojë se ai nuk mendon t'i përmbahet paragrafit 2 të këtij neni. Shtetet e tjera Palë nuk duhet t'i përmbahen paragrafit 2 të këtij neni lidhur me secilin Shtet Palë që ka shprehur një kusht të tillë.

4. Secili nga Shtetet Palë, që ka shprehur një rezervim në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni, në çdo kohë, mund ta tërheqë atë, duke njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 21
Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi dhe aderimi

1. Ky Protokoll duhet të jetë i hapur për nënshkrim nga të gjitha Shtetet nga 12 deri më 15 dhjetor 2000 në Palermo, Itali, dhe më pas në Selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork deri më 12 dhjetor 2002.

2. Ky Protokoll duhet, gjithashtu, të jetë i hapur për t'u nënshkruar nga organizata të integrimit ekonomik rajonal, me kusht që të paktën një Shtet Anëtar i një organizate të tillë ta ketë nënshkruar këtë Protokoll, në përputhje me paragrafi 1 të këtij neni.

3. Ky Protokoll është subjekt ratifikimi, pranimi ose aprovimi. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose aprovimit duhet të depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara. Një organizatë e integrimit ekonomik rajonal mund të depozitojë instrumentin e saj të ratifikimit, pranimit ose aprovimit, në rast se të paktën një nga Shtetet e Anëtare e ka bërë këtë. Në atë instrument ratifikimi, pranimi ose aprovimi, një organizatë e tillë duhet të deklarojë shtrirjen e kompetencës së tij, duke respektuar çështjet e trajtuara nga ky Protokoll. Një organizatë e tillë duhet, gjithashtu, të informojë depozituesit për çdo modifikim përkatës dhe shtrirje të kompetencave të saj.

4. Ky Protokoll është i hapur për aderim nga çdo Shtet apo organizatë rajonale integrimi ekonomik, në të cilën të paktën një nga Shtetet Anëtare të organizatës është Palë e kësaj Konvente. Instrumentet për aderim duhet të depozitohen në Sekretariatin e Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Në momentin e aderimit, një organizatë rajonale integrimi ekonomik duhet të deklarojë shtrirjen e kompetencave të saj, duke respektuar çështjet e trajtuara nga ky Protokoll. Një organizatë e tillë duhet, gjithashtu, të informojë depozituesit për çdo modifikim dhe shtrirje të kompetencave të saj.

Neni 22
Hyrja në fuqi

1. Ky Protokoll duhet të hyjë në fuqi ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitimit të instrumentit të dyzetë të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit. Përsa i përket këtij paragrafi, çdo instrument i depozituar nga një organizatë rajonale integrimi ekonomik nuk do të llogaritet si shtesë e atyre të cilat janë depozituar nga Shtetet Anëtare të kësaj organizate.

2. Për çdo Shtet ose organizatë rajonale integrimi ekonomik për ratifikimin, pranimin oe hyrjen në Palë të këtij Protokolli, pas depozitës së instrumentit të dyzetë të çdo akti, ky Protokoll do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit nga çdo Shtet ose organizatë për instrumentin e aplikueshëm ose në datën kur ky Protokoll hyn në fuqi, në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, cilido qoftë ky i fundit.

Neni 23
Amendamentet

1. Pas përfundimit të pesë vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij Protokolli, një Shtet Palë mund të propozojë një amendament dhe ta dorëzojë në Sekretariatin e Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, i cili duhet që menjëherë pas kësaj të komunikojë amendamentin e propozuar Shteteve Palë dhe Konferencës së Palëve të Konventës për propozimin, marrjen në konsideratë dhe vendimin mbi këtë propozim. Shtetet Palë të këtij Protokolli në takimin e Konferencës së Palëve duhet të bëjnë çdo përpjekje për të arritur konsensus për secilin amendament. Në rast se të gjitha përpjekjet për konsensus janë shfrytëzuar dhe nuk është arritur ndonjë agrement, amendamenti duhet që si mundësi të fundit të kërkojë adaptimin e tij me shumicën e dy të tretave të Shteteve Palë, të cilët janë të pranishëm dhe votojnë në Konferencën e Palëve.

2. Organizatat rajonale të integrimit ekonomik, në raport me kompetencat e tyre do të ushtrojnë të drejtën e tyre të votës bazuar në këtë nen me një numër votash të barabartë me numrin e Shteteve të cilat janë Palë e këtij Protokolli. Një organizatë e tillë nuk mund ta ushtrojë të drejtën e saj për të votuar, në qoftë se Shtetet votojnë në mënyrë të veçuar nga organizata ose anasjelltas.

3. Një amendament i aprovuar në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni është subjekt ratifikimi, pranimi ose aprovimi nga Shtetet Palë.

4. Një amendament i aprovuar në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni duhet të hyjë në fuqi duke respektuar nëntëdhjetëditëshin e Shtetit Palë pas datës së depozitimit në Sekretariatin e Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara të një instrumenti për ratifikim, pranim ose aprovim të çdo amendamenti.

5. Kur një amendament hyn në fuqi, ai duhet të bëhet obligim për ato Shtete Palë, të cilat kanë shprehur konsensusin e tyre për ta pranuar si të tillë. Shtetet e tjera Palë duhet të vazhdojnë t'i nënshtrohen dispozitave që parashikon ky Protokoll dhe çdo amendament i mëparshëm që ata kanë ratifikuar, pranuar apo aprovuar.

Neni 24
Denoncimi

1. Një Shtet Palë mund të denoncojë këtë Protokoll me një njoftim të shkruar në Sekretariatin e Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Një njoftim i tillë do të ketë efekt një vit pas marrjes së njoftimit nga Sekretariati.

2. Një organizatë rajonale e integrimit ekonomik do të përpiqet të jetë një Palë për këtë Protokoll atëherë kur të gjitha Shtetet e tij Anëtare ta kenë denoncuar atë.

Neni 25

Depozitimi dhe gjuhët

1. Sekretariati i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara është përcaktuar si depozituesi i këtij Protokolli.

2. Origjinali i këtij Protokolli, tekstet e tij arabe, kineze, anglisht, frëngjisht, rusisht dhe spanjisht janë autentikisht të barabarta, do të depozitohen në Sekretariatin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Në dëshmi të, personat e poshtëshënuar, të autorizuar nga Qeveritë e tyre respektive kanë firmosur këtë Protokoll.

PROTOKOLLI
MBI PARANDALIMIN, PENGIMIN DHE NDËSHKIMIN E TRAFIKUT TË PERSONAVE, VEÇANËRISHT TË GRAVE DHE FËMIJËVE, NË PLOTËSIM TË KONVENTËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR NDËRKOMBËTAR

Shtetet Palë në këtë Protokoll,

Duke deklaruar se aksionet efektive për të luftuar trafikun ndërkombëtar të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve, kërkon një trajtim të gjithanshëm dhe ndërkombëtar në vendet e origjinës, tranzitit dhe destinacionit, që përfshin masat për të parandaluar këtë trafik, për të ndëshkuar trafikantët dhe për të mbrojtur viktimat e një trafiku të tillë, përfshirë mbrojtjen e të drejtave të tyre të njohura ndërkombëtarisht,

Duke marrë parasysh faktin që, pavarësisht ekzistencës së një shumëllojshmërie instrumentesh ndërkombëtare, që përfshijnë rregullat edhe masat praktike për të luftuar shfrytëzimin seksual të grave dhe fëmijëve, nuk ka një instrument universal që i adresohet të gjitha aspekteve të trafikimit të personave,

Të shqetësuar që, në mungesë të një instrumenti të tillë, personat të cilët janë të prekur nga trafikimi nuk do të kenë një mbrojtje të mjaftueshme,

Duke rikujtuar rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme 53/111 të dhjetorit 1998, në të cilën Asambleja vendosi të krijojë një komitet ad-hoc ndërqeveritar afatgjatë (openended) hapur me qëllim përpunimin e një konvente të plotë ndërkombëtare në lidhje me luftën kundër krimit të organizuar ndërkombëtar dhe për të diskutuar përpunimin, ndër të tjera, të një instrumenti ndërkombëtar që do t'i adresohet trafikut të grave dhe fëmijëve,

Të bindur se plotësimi i Konventës me një instrument ndërkombëtar për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve, do të jetë i dobishëm në luftën kundër këtij krimi,

Ranë dakord për sa më poshtë:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Marrëdhëniet me Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar

1. Ky Protokoll plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar. Ai do të interpretohet së bashku me Konventën.

2. Dispozitat e Konventës do të aplikohen, mutatid mutandis, ndaj këtij Protokolli me përjashtim të rasteve ku parashikohet ndryshe në tekst.

3. Veprat penale të cilësuara në përputhje me nenin 5 të këtij Protokolli do të konsiderohen si vepra penale të cilësuara në përputhje me Konventën.

Neni 2
Deklarimi i qëllimit

Qëllimet e këtij Protokolli janë:

(a) të parandalojë dhe të luftojë trafikun ndërkombëtar të personave, duke i kushtuar vëmendje të veçantë grave dhe fëmijëve;

(b) të mbrojë dhe të ndihmojë viktimat e këtij trafiku, duke respektuar të drejtat e tyre njerëzore; dhe

(c) të nxisë dhe të lehtësojë bashkëpunimin ndërmjet Shteteve Palë, me qëllim që të realizohen këto objektiva.

Neni 3
Përkufizime

Për qëllimet e këtij Protokolli:

(a)"Trafik personash" nënkupton rekrutimin, transportimin, transferimin, fshehjen ose pritjen e personave nëpërmjet kërcënimit, përdorimit të forcës e formave të tjera të shtrëngimit, mashtrimit, marrjes me forcë, dredhisë ose abuzimit të pushtetit ose të pozitës vulnerabël ose dhënien apo marrjen e pagesave ose përfitimeve për të arritur pëlqimin e një personi që kontrollon një person tjetër, për qëllime shfrytëzimi. Shfrytëzimi përfshin, së paku, shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose format e tjera të shfrytëzimit seksual, punën ose shërbimet e detyruara, skllavërinë ose praktikat e ngjashme me skllavërinë, heqjen e organeve ose servitudet.

(b) Pëlqimi i viktimës së trafikut për shfrytëzimin e qëllimshëm të përmendur në nënparagrafin (a) të këtij neni do të jetë i pavend nëse janë përdorur mjetet e parashikuara në nënparagrafin (a).

(c) Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e një fëmije për qëllime shfrytëzimi, do të konsiderohet "trafik personash" edhe nëse në të nuk do të përfshihen mjetet e parashikuara në nënparagrafin (a) të këtij neni.

(d) "Fëmijë" nënkupton çdo person nën 18 vjeç.

Neni 4
Fusha e aplikimit

Ky Protokoll, përveç rasteve të parashikuara ndryshe këtu, do të aplikohet për parandalimin, hetimin dhe ndjekjen penale të veprave të parashikuara në nenin 5 të këtij Protokolli, në rastet kur këto vepra penale kanë një natyrë ndërkombëtare dhe përfshijnë një grup të organizuar kriminal, si dhe për mbrojtjen e viktimave të këtyre krimeve.

Neni 5
Penalizimi

1. Shtetet Palë duhet të adaptojnë masa të tilla, që mund të jenë të nevojshme për të përcaktuar si vepra kriminale, në bazë të legjislacionit të brendshëm, veprimet e përcaktuara në nenin 3 të këtij Protokolli, nëse kryhen qëllimisht.

2. Shtetet Palë duhet të adaptojnë masa të tilla, që mund të jenë të nevojshme për të përcaktuar si vepra kriminale:

(a) duke iu nënshtruar koncepteve bazë të sistemit të tij ligjor, tentativën për të kryer një vepër penale të parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni;

(b) pjesëmarrjen si bashkëpunëtor në një vepër penale të parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni; dhe

(c) organizimin ose drejtimin e personave të tjerë për të kryer një vepër penale të parashikuar nën paragrafin 1 të këtij neni.

II. MBROJTJA E PERSONAVE TË TRAFIKUAR

Neni 6
Asistenca për mbrojtjen e viktimave të trafikut të personave

1. Në rastet përkatëse dhe në masën që parashikohet nga legjislacioni i brendshëm, Shtetet Palë duhet të mbrojnë jetën private dhe identitetin e viktimave të trafikut të personave, përfshirë, ndër të tjera, bërjen konfidenciale të procedurave ligjore, që lidhen me trafikun e personave.

2. Shtetet Palë duhet të sigurojnë që sistemi i tyre legjislativ ose administrativ të përmbajë masa të tilla që u sigurojnë viktimave të trafikut në rastet e duhura:

(a) informacion në lidhje me procedurat gjyqësore dhe administrative;

(b) asistencë, në mënyrë që të paraqesin shqetësimet dhe problemet që kanë dhe t'u merren parasysh në shkallët përkatëse të procedurave penale kundër autorëve të veprave penale, pa cënuar të drejtën e mbrojtjes.

3. Në raste të veçanta dhe masën e mundshme, Shtetet Palë duhet të marrin parasysh masat për të siguruar trajtimin fizik, psikologjik ose social të viktimave të trafikut, përfshirë bashkëpunimin me organizatat joqeveritare, organizatat e tjera dhe elementët e shoqërisë civile dhe, në veçanti sigurimin e:

(a) banimit të përshtatshëm;

(b) këshillimin dhe informimin që ka të bëjë sidomos me të drejtat e tyre, në një gjuhë që personat e trafikuar mund ta kuptojnë;

(c) asistencën mjekësore, psikologjike dhe materiale; dhe

(d) mundësinë e punësimit, edukimit dhe trajnimit.

4. Shtetet Palë duhet të marrin parasysh, gjatë aplikimit të dispozitave të këtij neni, moshën, seksin dhe nevojat e veçanta të viktimave të trafikut dhe, në veçanti, nevojat e veçanta të fëmijëve, përfshirë banesën, arsimimin dhe kujdesin e përshtatshëm.

5. Shtetet Palë duhet të përpiqen që të garantojnë sigurinë fizike të viktimave të trafikut nëse ato janë brenda territoreve të tyre.

6. Shtetet Palë duhet të sigurojnë që sistemi i tyre ligjor të përfshijë masa që iu ofrojnë viktimave të trafikut të personave mundësinë e kompensimit për dëmin që u është shkaktuar.

Neni 7
Statusi i viktimave të trafikut në Shtetin Pritës

1. Përveç masave që parashikohen në nenin 6 të këtij Protokolli, Shtetet Palë duhet të marrin parasysh adaptimin e masave legjislative ose masave të tjera që u lejojnë viktimave të trafikut të personave që të qëndrojnë në territoret e tyre, përkohësisht ose përgjithmonë, në rastet përkatëse.

2. Gjatë zbatimit të dispozitës që përfshihet në paragrafin 1 të këtij neni, Shtetet Palë duhet të mbajnë mirë parasysh faktorët humanitarë dhe mëshirues.

Neni 8
Riatdhesimi i viktimave të trafikut të personave

1. Shteti Palë, shtetas i të cilit është viktima e trafikut të personave ose në të cilin personi ka të drejtën e qëndrimit të përhershëm në kohën e hyrjes në Shtetin Palë pritës, duhet të lehtësojë dhe pranojë kthimin e atij personi pa vonesa të paarsyeshme, si dhe duke iu kushtuar kujdes sigurisë së tij.

2. Nëse një Shtet Palë kthen një viktimë të trafikut të personave në një Shtet Palë, shtetas i të cilit është personi ose në të cilin ai ka pasur të drejtën e qëndrimit të përhershëm në momentin e hyrjes në Shtetin Palë pritës, rikthimi duhet të bëhet duke i kushtuar kujdes sigurisë së personit, si dhe për statusin të procedurave ligjore që lidhen me faktin se personi është viktimë e trafikimit dhe, mundësisht, kthimi të jetë vullnetar.

3. Në kërkesën e një Shteti Palë pritës, një Shtet Palë duhet të verifikojë, pa vonesa të paarsyeshme, nëse një person i cili është viktimë e këtij trafiku është shtetas i tij ose ka të drejtën e qëndrimit të përhershëm në kohën e hyrjes në Shtetin Palë pritës.

4. Me qëllim që të lehtësohet kthimi i viktimës së këtij trafiku, i cili është pa dokumente të përshtatshme, Shteti Palë, shtetas i të cilit është viktima ose në të cilin ai/ajo ka të drejtën e qëndrimit të përhershëm në momentin e hyrjes në Shtetin Palë pritës duhet të pranojë që të lëshojë, me kërkesën e Shtetit Palë pritës, dokumente udhëtimi ose ndonjë autorizim tjetër që mund të jetë i nevojshëm për të lejuar hyrjen e personit në territorin e tij.

5. Dispozitat e këtij neni nuk duhet të cenojë të drejtat që i njihen viktimës nga legjislacioni i brendshëm i Shtetit Palë pritës.

6. Ky nen nuk do të cenojë ndonjë Marrëveshje, dypalëshe ose shumëpalëshe, që rregullon, plotësisht ose pjesërisht, kthimin e personave të trafikuar.

III. PARANDALIMI, BASHKËPUNIMI DHE MASAT E TJERA

Neni 9
Parandalimi i trafikut të personave

1. Shtetet Palë duhet të vendosin politika, programe dhe masa të tjera:

(a) për të parandaluar dhe luftuar trafikun e personave; dhe

(b) për të mbrojtur personat e trafikuar, veçanërisht gratë dhe fëmijët, nga riviktimizimi.

2. Shtetet Palë duhet të përpiqen që të ndërmarrin masa të tilla si kërkimi, informimi dhe fushata në masmedia dhe iniciativa sociale dhe ekonomike, për të parandaluar dhe luftuar trafikun e personave.

3. Politikat, programet dhe masat e tjera të ndërmarra, në përputhje me këtë nen, duhet të përfshijnë bashkëpunimin me organizatat joqeveritare, organizatat të tjera përkatëse ose elementë të shoqërisë civile;

4. Shtetet Palë duhet të ndërmarrin ose të forcojnë masat, përfshirë ato nëpërmjet bashkëpunimit, dypalësh ose shumëpalësh, për të reduktuar faktorët që i bëjnë personat, veçanërisht gratë dhe fëmijët, të bëhen viktima të trafikut, siç janë varfëria, zhvillimi i pakët dhe mungesa e mundësive të barabarta.

5. Shtetet Palë duhet të adaptojnë ose forcojnë masat legjislative ose masat e tjera, siç janë edukimi, masat sociale e kulturore, përfshirë ato që rrjedhin nga bashkëpunimi, dypalësh e shumëpalësh, për të mos inkurajuar kërkesën që nxit të gjitha format e shfrytëzimit të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve, që i çon ato drejt trafikut.

Neni 10
Shkëmbimi i informacionit dhe trajnimi

1. Autoritetet e zbatimit të ligjit, të emigracionit ose autoritetet e tjera përkatëse të Shteteve Palë duhet të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për të shkëmbyer informacion, në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm, për t'i mundësuar atyre të përcaktojnë:

(a) nëse personat që kalojnë ose tentojnë të kalojnë një kufi ndërkombëtar me dokumente udhëtimi, që i përkasin personave të tjerë ose pa dokumente udhëtimi, kryejnë ose janë viktima të trafikut të personave;

(b) tipet e dokumenteve që kanë përdorur personat ose që janë përpjekur të përdorin për të kaluar një kufi ndërkombëtar me qëllim që të trafikojnë persona; dhe

(c) metodat dhe mjete e përdorura nga grupet e organizuara kriminale për trafikimin e personave, përfshirë rekrutimin dhe transportimin e viktimave, rrugët dhe lidhjet ndërmjet personave dhe grupeve që merren me këtë trafik dhe masat e mundshme për t'i zbuluar ato.

2. Shtetet Palë duhet të sigurojnë ose forcojnë trajnimin e zyrtarëve të zbatimit të ligjit, imigracionit dhe të zyrtarëve të tjerë përkatës, mbi parandalimin e trafikut të personave. Trajnimi

duhet të përqëndrohet në metodat e përdorura për parandalimin e këtij trafiku, ndjekjen penale të trafikantëve dhe mbrojtjen e të drejtave të viktimave, përfshirë mbrojtjen e viktimave nga trafikantët. Trajnimi duhet të ketë parasysh gjithashtu nevojën për të marrë në konsideratë të drejtat e njeriut dhe çështjet e mprehta që lidhen me fëmijët dhe ato të karakterit gjinor, si dhe duhet të inkurajojnë bashkëpunimin me organizatat joqeveritare, organizatat e tjera përkatëse dhe elementët e shoqërisë civile.

3. Një Shtet Palë që merr informacion duhet të përmbushë një kërkesë të bërë nga një Shtet Palë, që ka transmetuar informacionin që vendos kufizime në përdorimin e tij.

Neni 11
Masat e kufirit

1. Pa cenuar angazhimet ndërkombëtare për lëvizjen e lirë të njerëzve, Shtetet Palë duhet të forcojnë, në masën më të madhe të mundshme, kontrollin kufitar për të zbuluar dhe parandaluar trafikun e personave.

2. Shtetet Palë duhet të marrin masa legjislative ose masa të tjera të përshtatshme për të parandaluar mjetet e transportit, që drejtohen nga transportues tregtarë për t'u përdorur në kryerjen e veprave penale që mbulohen nga neni 5 i këtij Protokolli.

3. Këto masa duhet të përfshijnë, aty ku është e mundur dhe pa cenuar konventat ndërkombëtare të aplikueshme, përfshirë çdo kompani transportuese, pronar ose drejtues të ndonjë anije apo mjeti transporti, të verifikojë që të gjithë pasagjerët kanë dokumentet e udhëtimit të kërkuara për hyrjen në mënyrë të ligjshme në Shtetin Pritës.

4. Shtetet Palë duhet të ndërmarrin masat e nevojshme, në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm, për të siguruar vendosjen e sanksioneve në rastet e dhunimit të detyrimit të parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni.

5. Shtetet Palë duhet të marrin në konsideratë adaptimin e masave që lejojnë mohimin, në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm, të hyrjes ose revokimit të vizave të personave të implikuar në krimet që mbulohen nga ky Protokoll.

6. Pa cenuar nenin 27 të Konventës, Shtetet Palë duhet të marrin parasysh forcimin e bashkëpunimit të agjencive të kontrollit kufitar, ndër të tjera, nëpërmjet vendosjes dhe mbajtjes së kanaleve direkte të komunikimit.

Neni 12
Siguria dhe kontrolli i dokumenteve

1. Shtetet Palë duhet të adaptojnë masa të tilla, që mund të jenë të nevojshme, dhe në përputhje me mjetet në dispozicion:

(a) për të garantuar që dokumentet e udhëtimit ose të identitetit të lëshuara prej tyre të jenë të një cilësie të tillë që të mos keqpërdoren lehtësisht dhe të mos falsifikohen, ndryshohen, kopjohen ose lëshohen në mënyrë të paligjshme;

(b) për të siguruar integritetin dhe sigurinë e dokumenteve të udhëtimit dhe identifikimit të lëshuara nga Shtetet Palë ose në emër të tyre dhe për të parandaluar krijimin, lëshimin dhe përdorimin e paligjshëm të tyre.

Neni 13
Legjitimiteti dhe vlefshmëria e dokumenteve

Një Shtet Palë, mbështetur në kërkesën e një Shteti tjetër Palë dhe në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm, duhet të verifikojë brenda një kohe të arsyeshme legjitimitetin dhe vlefshmërinë e dokumenteve të udhëtimit ose identitetit, të lëshuara ose që nënkuptohen se janë lëshuar në emër të tij dhe që dyshohen të përdoren për trafikimin e personave.

IV. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 14
Dispozita mbrojtëse

1. Asgjë në këtë Protokoll nuk duhet të prekë të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e Shteteve dhe personave që rrjedhin nga e drejta ndërkombëtare, përfshirë të drejtën ndërkombëtare humanitare dhe legjislacionin ndërkombëtar të të drejtave të njeriut dhe, në veçanti, nëse është e mundur, Konventën e vitit 1951 dhe Protokollin e vitit 1967 që lidhen me Statusin e Refugjatëve dhe parimin e moskthimit të refugjatëve në det (non-refoulment) që përmendet këtu.

2. Masat e parashikuara në këtë Protokoll do të interpretohen dhe aplikohen në mënyrë josdiskriminuese ndaj personave për shkak se ata janë viktima të trafikut të personave. Aplikimi dhe interpretimi i këtyre masave duhet të jetë në pajtim me parimet e njohura ndërkombëtarisht të mosdiskriminimit.

Neni 15
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Shtetet Palë duhet të përpiqen që të zgjidhin mosmarrëveshjet që lidhen me interpretimin ose aplikimin e këtij Protokolli përmes negociatave.

2. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet dy ose më shumë Shteteve Palë, që lidhet me interpretimin ose aplikimin e këtij Protokolli, që nuk mund të zgjidhet përmes negociatave brenda një kohe të arsyshme, duhet t'i paraqitet arbitrazhit. Në qoftë se gjashtë muaj pas datës së kërkesës për arbitrazh këto Shtete Palë nuk kanë mundësi për të rënë dakord në lidhje me organizimin e arbitrazhit, secili prej këtyre Shteteve Palë mund t'ia paraqesë mosmarrëveshjen Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë nëpërmjet një kërkese në përputhje me Statutin e Gjykatës.

3. Secili Shtet Palë, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në këtë Protokoll, mund të deklarojë se ai nuk e konsideron si të detyrueshëm për të paragrafin 2 të këtij neni. Shtetet e tjera Palë nuk do të kenë detyrime që rrjedhin nga paragrafi 2 i këtij neni në lidhje me çdo Shtet Palë që ka paraqitur një rezervë të tillë.

4. Shtetet Palë, që kanë paraqitur një rezervë në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni, mund ta tërheqin atë në çdo kohë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 16
Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, miratimi dhe adermi

1. Ky Protokoll do të jetë i hapur për nënshkrim për të gjitha Shtetet nga data 12 deri 15 nëntor 2000 në Palermo, Itali dhe më pas në Selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork deri në datë 12 dhjetor 2002.

2. Ky Protokoll do të jetë i hapur, gjithashtu, për organizatat rajonale të integrimit ekonomik, me kusht që së paku një Shtet Anëtar i kësaj organizate të ketë nënshkruar këtë Protokoll, në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni.

3. Ky Protokoll do t'i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit do të depozitohen tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara. Organizata rajonale e integrimit ekonomik mund ta depozitojë instrumentin e saj të ratifikimit, pranimit ose miratimit në qoftë se të paktën njëri prej Shteteve të saj anëtare e ka bërë një gjë të tillë. Në instrumentin e saj të ratifikimit, pranimit ose miratimit, kjo organizatë duhet të deklarojë shtrirjen e kompetencës së saj në lidhje me çështjet që rregullohen nga ky Protokoll. Kjo organizatë duhet të njoftojë, gjithashtu, depozituesin në lidhje me ndryshimet përkatëse të shtrirjes së kompetencës së saj.

4. Ky Protokoll është i hapur, për aderim për çdo Shtet ose organizatë rajonale të integrimit ekonomik, të paktën njëri Shtet Anëtar i të cilës është Palë në këtë Protokoll. Instrumentet e aderimit do të depozitohen tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara. Në kohën e aderimit të saj, organizata rajonale e integrimit ekonomik duhet të deklarojë shtrirjen e kompetencës së saj në lidhje me çështjet që rregullohen nga ky Protokoll. Kjo organizatë duhet të njoftojë depozituesin në lidhje me ndryshimet përkatëse në shtrirjen e kompetencës së saj.

Neni 17
Hyrja në fuqi

1. Ky Protokoll do të hyjë në fuqi ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitimit të instrumentit të dyzetë të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit. Për qëllimet e këtij paragrafi, çdo instrument i depozituar nga një organizatë rajonale e integrimit ekonomik nuk do të numërohet si plotësuese e atyre instrumenteve të depozituara nga Shtetet Anëtare të kësaj organizate.

2. Për çdo Shtet ose organizatë rajonale të integrimit ekonomik që ratifikon, pranon, miraton ose aderon në këtë Protokoll pas depozitimit të instrumentit të dyzetë të këtij akti, ky Protokoll do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit të instrumentit përkatës të këtij Shteti ose organizate ose në datën që Protokolli hyn në fuqi në zbatim të paragrafit 1 të këtij neni, cilindo që të jetë i fundit.

Neni 18
Amendamentet

1. Pas kalimit të pesë vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij Protokolli, një Shtet Palë mund të propozojë një amendament dhe ta regjistrojë atë tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, i cili duhet t'ua komunikojë këtë amendament Shteteve Palë, si dhe Konferencës së Shteteve Palë të Konventës me qëllim shqyrtimin e tij dhe marrjen e vendimit në lidhje me të. Shtetet Palë të këtij Protokolli që mblidhen në Konferencën e Palëve duhet të bëjnë çdo përpjekje për të arritur konsensusin për çdo amendament. Në qoftë se të gjitha përpjekjet për të arritur konsensusin janë shfrytëzuar dhe nuk është arritur një marrëveshje si zgjidhje e fundit, amendamenti duhet të adaptohet me një shumicë prej 2/3 e votave të Shteteve Palë që janë të pranishëm dhe votojnë në takimin e Konferencës së Palëve.

2. Organzatat rajonale të integrimit ekonomik, për çështjet që hyjnë brenda kompetencës së tyre, duhet të ushtrojnë të drejtën e votës në bazë të këtij neni me një numër votash të barabartë me numrin e Shteteve Anëtare që janë Palë në këtë Protokoll. Këto organizata nuk duhet të ushtrojnë të drejtën e votës nëse Shtetet e tyre Anëtare ushtrojnë të drejtën e tyre të votës dhe anasjelltas.

3. Çdo amendament i miratuar në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit prej Shteteve Palë.

4. Një amendament i adaptuar në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni do të hyjë në fuqi për një Shtet Palë nëntëdhjetë ditë pas datës së depozitimit tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara të instrumentit të ratifikimit, pranimit ose miratimit të këtij amendamenti.

5. Në momentin që amendamenti hyn në fuqi, ai do të ketë fuqi detyruese për ato Shtete, Palë që kanë shprehur pëlqimin që të marrin përsipër detyrimet që rrjedhin prej tij. Shtetet e tjera Palë do të kenë përsëri detyrimet e këtij Protokolli dhe të çdo amendamenti që ata kanë ratifikuar, pranuar ose miratuar.

Neni 19
Denoncimi

1. Një Shtet Palë mund të denoncojë këtë Protokoll me anë të një njoftimi të shkruar, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Ky denoncim do të ketë efekt një vit pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

2. Një organizatë rajonale e integrimit ekonomik do të pushojë së qëni Palë në këtë Protokoll kur të gjithë Shtetet Anëtare të saj të kenë denoncuar atë.

Neni 20
Depozituesit dhe gjuhët

1. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të jetë depozituesi i këtij Protokolli.

2. Origjinali i këtij Protokolli, i përpiluar në kopje autentike në gjuhën arabe, kineze, angleze, ruse dhe spanjolle do të depozitohet tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit e plotfuqishëm, të autorizuar në mënyrën e duhur nga qeveritë respektive, nënshkruan këtë Protokoll.

LIGJ
Nr. 8945, datë 3.10.2002

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË RUMANISË PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E LUFTËS KUNDËR TERRORIZMIT, TË LUFTËS KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR, TË TRAFIKUT TË PALIGJSHËM TË SUBSTANCAVE NARKOTIKE E PSIKOTROPE DHE TË VEPRIMTARIVE TË TJERA TË JASHTËLIGJSHME"

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Rumanisë për bashkëpunimin në fushën e luftës kundër terrorizmit, të luftës kundër krimit të organizuar, të trafikut të paligjshëm të stubstancave narkotike e psikotrope dhe të veprimtarive të tjera të jashtëligjshme", nënshkruar në Bukuresht më 7.6.2002.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3509, datë 21.10.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.67, faqe 1888

MARRËVESHJE

MIDIS QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË TË RUMANISË MBI BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E LUFTËS KUNDËR TERRORIZMIT, TË LUFTËS KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR, TË TRAFIKUT TË PALIGJSHËM TË SUBSTANCAVE NARKOTIKE E PSIKOTROPE, SI EDHE AKTIVITETE TË TJERA ILEGALE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Rumanisë, këtu të ashtuquajtura si "Palë Kontraktuese",

Me qëllim që të zhvillojnë kontaktet bilaterale midis të dyja Palëve Kontraktuese;

Të interesuara që të bashkëpunojnë në luftën kundër krimit dhe në veçanti kundër krimit të organizuar;

Duke dëshiruar të shtojnë më tej përpjekjet e përbashkëta në luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar;

Duke qenë të bindura për nevojën për të harmonizuar aksionet kundër krimit të organizuar, terrorizmit, trafikut të paligjshëm të substancave narkotike e psikotrope dhe aktiviteteve të tjera ilegale me ndikim ndërkombëtar;

Duke pasur parasysh klauzolat e instrumenteve juridike ndërkombëtare, tek të cilat Shtetet e tyre janë Palë,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Palët Kontraktuese do të bashkëpunojnë dhe sigurojnë asistencë të përbashkët në fushat e mëposhtme:

1. Luftën kundër terrorizmit.

2. Luftën kundër krimit të organizuar, zbulimit dhe hetimit të personave dhe të organizatave të përfshira në:

a) trafikimin, prodhimin dhe përdorimin e paligjshëm të drogave narkotike dhe të substancave psikotrope;

b) trafikimin e qenieve njerëzore dhe shfrytëzimit të fëmijëve;

c) trafikimin e paligjshëm të lëndëve akoma në gjendje natyrore, teknologjive dhe materialeve bërthamore, teknologjive dhe produkteve strategjike, armëve të zjarrit, municionit dhe eksplozivëve dhe substancave toksike, si edhe komponentet e tyre;

d) krimet në fushën e shfrytëzimit seksual të personave;

e) kontrabanda e gurëve dhe metaleve të çmuar ose kontrabanda e aseteve historike dhe kulturore, të cilat i përkasin pronës kombëtare ose janë pronë ndërkombëtare kulturore;

f) falsifikimi i dokumenteve, monedhave dhe mjeteve të tjera të pagesës, si edhe të letrave me vlerë;

g) lojërat e fatit të paligjshme dhe aktet e mashtrimit të përdorura në lojërat e ligjshme;

h) parandalimi, identifikimi dhe hetimi i vjedhjeve dhe i trafikimit të automjeteve të vjedhura dhe të rasteve të shkeljeve të qarkullimit rrugor.

3. Lufta kundër aktiviteteve ekonomike ndërkombëtare të paligjshme, kontrabandës, evazionit fiskal dhe operacioneve për riqarkullimin e parave ose të përfitimeve nga aktivitete ilegale.

4. Garantimi, mbajtja dhe rivendosja e rendit publik, si dhe garantimi i sigurisë së pjesëmarrësve në mitingjet publike.

5. Organizimi dhe administrimi i sistemit të evidentimit të dokumenteve të identifikimit dhe gjendjes civile, duke respektuar detyrimet e marra nga Palët Kontraktuese nëpërmjet instrumenteve juridikë ndërkombëtarë.

6. Lufta kundër migracionit të paligjshëm:

a) lufta kundër migracionit të paligjshëm dhe rrjeteve të implikuara në trafikimin e personave;

b) identifikimi i transportuesve të implikuar në aktivitete që lidhen me trafikun e personave;

c) zbulimi i dokumenteve të udhëtimit dhe vizave false ose të falsifikuara.

7. Zhvillimi i metodave dhe sistemeve të seleksionimit, përgatitjes dhe formimit profesional, respektiv, promovimi i specialistëve të dy Palëve Kontraktuese në fushat e përmendura në pikat 1-6.

Neni 2

Bashkëpunimi midis Palëve Kontraktuese do të realizohet nëpërmjet:

a) shkëmbimit të informacionit në fushat e përshkruara në nenin 1, në lidhje me personat dhe grupet e implikuara ose që mendohet që janë të implikuara në aktivitetet kriminale të specifikuara, aksionet e tyre, metodat e përdorura dhe objektivat e ndjekura me paramendim nga ana e tyre, si edhe çdo element tjetër me interes operativ të nevojshëm për parashikimin dhe mbarëvajtjen e tyre;

b) marrjes së masave ose kryerjes së aksioneve të përbashkëta, për të cilat bashkërisht bihet dakord nga të dy autoritetet kompetente të të dy shteteve;

c) shkëmbimit të specialistëve në fushat e interesit të përbashkët;

d) shkëmbimit të dokumentacionit, botimeve dhe studimeve shkencore në fushat me interes të përbashkët;

e) shkëmbimet eksperiencës, që kanë të bëjnë me mjetet dhe metodat e përdorura për parandalimin, zbulimin, si dhe hetimin e aktiviteteve dhe akteve të terrorizmit, të krimit të organizuar ndërkombëtar dhe të krimeve të tjera.

Neni 3

1. Palët Kontraktuese përcaktojnë si autoritete kompetente për të zbatuar klauzolat e kësaj Marrëveshjeje:

Për Palën Kontraktuese Shqiptare:

- Ministria e Rendit Publik,
- Shërbimi Informativ Kombëtar.

Për Palën Kontraktuese Rumune, respektivisht:

- Ministria e Brendshme, për fushat e përmendura në nenin 1 pika 2-7;
- Shërbimi Sekret Rumun për fushat e përmendura, në nenin 1 pika 1 dhe7;
- Ministria e Financave Publike - Garda Financiare, për luftën e akteve të evazionit fiskal të parashikuara në nenin 1 pika 3 dhe lojërave ilegale të fatit, të parashikuara në nenin 1 pika 2 germa g;
- Ministria e Financave Publike - Drejtoria e Përgjithshme e Doganave - për luftën kundër kontrabandës e parashikuar në nenin 1 pika 3.

2. Për sigurimin e lidhjeve operacionale, secili autoritet kompetent do të caktojë një person pikë kontakti, të dhënat e të cilit, emri, mbiemri, funksioni, numrat e telefonit dhe faksit do të komunikohen midis Palëve Kontraktuese, nëpërmjet kanaleve diplomatike, brenda 10 ditësh nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.

3. Me qëllim që të vihet në praktikë bashkëpunimi i parashikuar në nenin 1 dhe nenin 2 më sipër, autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese, brenda juridiksionit të tyre ligjor, mund të nënshkruajnë protokolle bashkëpunimi, në përputhje me legjislacionet kombëtare.

Neni 4

Palët Kontraktuese do të japin në mënyrë reciproke asistencë në përpunimin dhe analizimin e informacioneve, në fushat e parashikuara në nenin 1 dhe mund të furnizojnë autoritetet kompetente të Palës tjetër Kontraktuese me mjete dhe teknologji specifike, duke respektuar detyrimet ndërkombëtare të ndërmarra në këtë fushë.

Neni 5

Me qëllim që të sigurohet mbrojtja e të dhënave, të cilat i referohen personave (të dhënat personale), të cilat shkëmbehen nga Palët Kontraktuese, në përputhje me legjislacionin kombëtar të shteteve të Palëve Kontraktuese do të zbatohen kushtet e mëposhtme:

1. Pala Kontraktuese e cila merr të dhëna të tilla mund t'i përdorë ato vetëm për qëllim dhe në bazë të kushteve të vendosura nga Pala Kontraktuese dërguese.

2. Pala Kontraktuese e cila merr të dhënat, me anë të kërkesës së Palës Kontraktuese dërguese, do të informojë këtë të fundit mbi mënyrën në të cilën janë përdorur të dhënat dhe mbi rezultatet e përdorimit të tyre.

3. Të dhënat e transmetuara do të bëhen të vlefshme për autoritetet kompetente vetëm kur qëllimi i përdorimit të tyre është lufta kundër krimit në të gjitha format e tij. Të dhëna të tilla do të vendosen në dispozicion të një autoriteti tjetër vetëm me pëlqimin paraprak dhe me shkrim të Palës dërguese përkatëse.

4. Pala Kontraktuese e cila dërgon të dhënat e kërkuara do të sigurojë vlefshmërinë e të dhënave dhe të sigurohet që është absolutisht e domosdoshme t'i bëjë të vlefshme këto të dhëna dhe përmbajtjen e tyre, në përputhje me qëllimin për të cilin ato janë vënë në dispozicion. Nëse konstatohet se janë furnizuar me të dhëna të pasakta ose të dhëna të tjera, të cilat nuk duhet të ishin transmetuar, Pala Kontraktuese e cila i merr ato, menjëherë do të bëjë ndryshimet e duhura mbi të dhënat e gabuara dhe, respektivisht, do të shkatërrojë menjëherë, çdo të dhënë të gabuar ose që është dhënë në mënyrë të palejueshme.

5. Me anë të kërkesës së një personi që është objekt i të dhënave personale, këto të dhëna dhe mënyra në të cilën këto të dhëna janë përdorur ose do të përdoren, do t'i bëhen të njohura ose do t'i paraqiten personit përkatës. Këto të dhëna do të bëhen të vlefshme për ankuesin deri në atë masë që e lejon legjislacioni kombëtar i Palës, e cila i ka transmetuar këto të dhëna.

6. Pala Kontraktuese e cila dërgon të dhënat do të specifikojë afatin ligjor për eliminimin e tyre, në bazë të legjislacionit të tij kombëtar. Brenda kësaj periudhe, ndonjë e dhënë e cila ka lidhje me personin në fjalë do të eliminohet në rastet kur përdorimi i tyre nuk është më i nevojshëm. Pala Kontraktuese dërguese e të dhënave do të njoftohet mbi eliminimin e tyre, si edhe për motivin e eliminimit të tyre. Të gjitha të dhënat e marra do të eliminohen me shfuqizimin e Marrëveshjes në fjalë.

7. Palët Kontraktuese mbajnë evidencë mbi dhënien, marrjen dhe eliminimin e të dhënave personale.

8. Palët Kontraktuese do të sigurojnë një mbrojtje më efikase të të dhënave, me qëllim që të mos lejojë akses për personat e paautorizuar për këto të dhëna, dhe nuk do të lejojnë të modifikohen ose të bëhen publike këto të dhëna.

Neni 6

1. Palët Kontraktuese garantojnë konfidencialitetin e këtyre të dhënave, informacioneve, materialet dhe mjetet e shkëmbyera reciprokisht në bazë të kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë edhe kërkesat e marra për këtë qëllim, nëse këto kualifikohen si të tilla në bazë të legjislacionit të Palës Kontraktuese dërguese. Niveli i sigurisë i përcaktuar nga Pala Kontraktuese që i furnizon nuk mund të modifikohet.

2. Transmetimi i materialeve, informacioneve dhe mjeteve teknike të furnizuara në bazë të kësaj Marrëveshje, për një palë të tretë, bëhet e mundshme vetëm me anë të një miratimi me shkrim paraprak të autoritetit kompetent të Palës Kontraktuese dërguese.

Neni 7

1. Secila prej Palëve Kontraktuese mund të refuzojë, pjesërisht ose plotësisht, ose mund të vendosë kushte për zgjidhjen e një kërkese të bashkëpunimit ose të shpërndarjes së informacionit,

nëse e konsideron që një kërkesë e tillë mbi dhënien e këtij informacioni mund të japë efekt në sovranitetin, sigurinë kombëtare të Palës Kontraktuese së kërkuar, kur cenon interesa madhore ose marrëdhëniet e saj ndërkombëtare, ose kur dhunon legjislacionin e saj të brendshëm, ose detyrime të tjera të përmbajtura në marrëveshjet ndërkombëtare.

2. Në një rast të tillë, motivi i refuzimit apo kushtëzimi do të njoftohet tek Pala tjetër Kontraktuese brenda periudhës më të shkurtër kohore me anë të një njoftimi.

Neni 8

1. Palët Kontraktuese do të themelojnë një komision të përbashkët për promovimin dhe vlerësimin, duke shtuar dhe evoluar më tej bashkëpunimin në bazë të kësaj Marrëveshjeje, ku do të jenë prezent 5 anëtarë nga secila Palë. Palët Kontraktuese do të informojnë njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike në lidhje me përbërjen e komisionit të përbashkët.

2. Komisioni i përbashkët do të mblidhet të paktën një herë në vit, në mënyrë alternative Shqipëri dhe në Rumani. Ndonjëra prej Palëve Kontraktuese mund të propozojë, nëse është e nevojshme, organizimin e takimeve të tjera shtesë të komisionit të përbashkët.

Neni 9

Shpenzimet për zbatimin e klauzolave të kësaj Marrëveshjeje do të mbulohen nga Palët Kontraktuese mbi baza reciprociteti. Për shkëmbimin e delegacioneve, shpenzimet e transportit ndërkombëtar vajtje-ardhje do të mbulohen nga Pala Kontraktuese dërguese, ndërsa akomodimi, transporti i brendshëm dhe asistenca mjeksore në raste emergjente do të mbulohet nga Pala Kontraktuese, e cila pret delegacionin e Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 10

Klauzolat e kësaj Marrëveshjeje do të paragjykojnë të drejtën dhe detyrimet e ndërmarra nga shtetet e të dyja Palëve Kontraktuese, të cilat rrjedhin nga marrëveshjet e tjera dypalëshe ose shumëpalëshe.

Neni 11

1. Marrëveshja nënshkruhet për një periudhë kohe të papërcaktuar.

2. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të fundit të bërë nëpërmjet kanaleve diplomatike, me anë të të cilit Palët Kontraktuese njoftojnë reciprokisht njëra-tjetrën mbi përmbushjen e procedurave kombëtare ligjore të nevojshme për hyrjen në fuqi.

3. Marrëveshja në fjalë mund të modifikohet në çdo kohë me pëlqimin e Palëve Kontraktuese, modifikimi do të hyjë në fuqi sipas përcaktimeve të paragrafit 2 të këtij neni.

4. Secila prej Palëve Kontraktuese mund të denoncojë Marrëveshjen nëpërmjet rrugëve diplomatike. Marrëveshja përfundon vlefshmërinë pas gjashtë muajsh nga data në të cilën Pala tjetër Kontraktuese ka bërë njoftimin e denoncimit.

5. Çdo mosmarrëveshje ose divergjencë përsa i përket interpretimit ose aplikimit të kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet nëpërmjet konsultimeve ndërmjet Palëve Kontraktuese, në kuadër të komisionit miks, ndërsa në rastin kur kjo gjë nuk është e mundur, zgjidhja të bëhet nëpërmjet rrugëve diplomatike.

Firmosur në Bukuresht, më 7.6.2002 në dy kopje origjinale, në gjuhët shqipe, rumune dhe anglisht, të gjitha tekstet autentikisht të barabarta. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje në përkthim, do të merret për bazë teksti anglisht.

LIGJ
Nr. 8984, datë 23.12.2002

PËR RATIFIKIMIN E STATUTIT TË ROMËS PËR GJYKATËN NDËRKOMBËTARE PENALE

Në mbështetje të neneve 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 123 pikat 1 dhe 2 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Statuti i Romës për Gjykatën Ndërkombëtare Penale", bërë në Romë më 17 korrik 1998.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3666, datë 17.1.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu.

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.91, faqe 2653

STATUTI I ROMËS

PJESA 1
THEMELIMI I GJYKATËS

Neni 1
Gjykata

Themelohet Gjykata Ndërkombëtare Penale ("Gjykata"). Ajo është një institucion i përhershëm dhe ka kompetencë të ushtrojë juridiksionin e saj mbi personat në lidhje me krimet më serioze që janë shqetësim për bashkësinë ndërkombëtare, sipas parashikimit në këtë Statut, dhe është plotësim i juridiksioneve penale kombëtare. Juridiksioni dhe funksionimi i Gjykatës rregullohet nga dispozitat e këtij Statuti.

Neni 2
Marrëdhëniet e Gjykatës me Kombet e Bashkuara

Gjykata hyn në marrëdhënie me Kombet e Bashkuara përmes një marrëveshjeje që aprovohet nga Asambleja e Shteteve Palë të këtij Statuti dhe përfundohet pastaj nga ana e Kryetarit të Gjykatës në emër të saj.

Neni 3
Selia e Gjykatës

1. Selia e Gjykatës themelohet në Hagë të Holandës ("Shteti pritës").

2. Gjykata lidh një marrëveshje për selinë e saj me Shtetin pritës, që aprovohet nga Asambleja e Shteteve Palë të këtij Statuti dhe pastaj përfundohet nga ana e Kryetarit të Gjykatës në emër të saj.

3. Gjykata mund të vendoset edhe në ndonjë vend tjetër kur e konsideron të nevojshme sipas parashikimit të këtij Statuti.

Neni 4
Statusi ligjor dhe kompetenca e Gjykatës

1. Gjykata ka personalitet ligjor ndërkombëtar. Ajo, po ashtu, ka atë zotësi ligjore që i duhet per ushtrimin e funksioneve dhe përmbushjen e qëllimeve të saj.

2. Gjykata mund të ushtrojë funksionet dhe kompetencat e saj, ashtu siç parashikohet në këtë Statut, në territorin e çdo Shteti Palë dhe, me anë të një marrëveshjeje të veçantë, në territorin e çdo Shteti tjetër.

PJESA 2
JURIDIKSIONI, PRANUESHMËRIA DHE LIGJI 1 ZBATUESHËM

Neni 5
Krimet në juridiksionin e Gjykatës

1. Juridiksioni i Gjykatës kufizohet në krimet më serioze, që janë shqetësim për bashkësinë ndërkombëtare në tërësi. Gjykata, në pajtim me këtë Statut, ka juridiksion për krimet në vijim:

(a) krimin e gjenocidit;

(b) krimet kundër njerëzimit;

(c) krimet e luftës;

(d) krimin e agresionit.

2. Gjykata e ushtron juridiksionin mbi krimin e agresionit, menjëherë sepse të miratohet një dispozitë në pajtim me nenet 121 dhe 123, që përkufizojnë krimin dhe vendosin kushtet në të cilat Gjykata e ushtron juridiksionin në lidhje me atë krim. Një dispozitë e tillë është në pajtim me dispozitat përkatëse të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Neni 6
Gjenocidi

Për qëllimet e këtij Statuti, "gjenocidi" nënkupton cilindo nga aktet vijuese, të kryera me qëllimin e shkatërrimit, në tërësi ose pjesërisht të grupit nacional, etnik, racor ose fetar, si të tillë:

(a) vrasja e anëtarëve të grupit;

(b) shkaktimi i dëmtimeve serioze trupore ose mendore, anëtarëve të grupit;

(c) imponimi i qëllimshëm i kushteve të jetës një grupi, të menduara që të sjellin shkatërrimin e tij fizik të plotë ose të pjesshëm;

(d) imponimi i masave me qëllim të parandalohen lindjet brenda grupit;

(e) transferimi i dhunshëm i fëmijëve të grupit në grupin tjetër.

Neni 7
Krimet kundër njerëzimit

1. Për qëllimet e këtij Statuti, "krimi kundër njerëzimit" nënkupton cilindo nga aktet në

vijim, kur kryhen si pjesë e një sulmi të gjerë ose sistematik, drejtuar kundër cilësdo popullsie civile, me dije për sulmin:

(a) vrasje;

(b) shfarosje;

(c) skllavërim;

(d) deportim ose transferim i dhunshëm i popullsisë;

(e) burgosje ose privim i rëndë i lirisë fizike, duke shkelur rregullat themelore të së drejtës ndërkombëtare;

(f) torturë;

(g) përdhunim, skllavërim seksual, prostitucion i detyruar, shtatzëni e detyruar, sterilizim i detyruar, çdo formë tjetër e dhunës seksuale e krahasueshme me këto;

(h) persekutim i çdo grupi të identifikueshëm se bashkësie, në bazë të përkatësisë politike, racore, nacionale, etnike, kulturore, fetare ose gjinore, ashtu siç është parashikuar në paragrafin 3, ose për shkaqe tjera që janë pranuar përgjithësisht si të palejueshme në bazë të së drejtës ndërkombëtare, në lidhje me çdo akt të përmendur në këtë paragraf ose çdo krim brenda juridiksionit të Gjykatës;

(i) zhdukje e detyruar e personave;

(j) krimi i aparteidit;

(k) akte të tjera johumane të karakterit të ngjashëm që shkaktojnë qëllimisht vuajtje të mëdha, ose dëmtime serioze trupore ose të shëndetit fizik a mendor.

2. Për qëllimet e paragrafit 1:

(a) "Sulmi i drejtuar kundër çdo popullsie civile" nënkupton mënyrën e sjelljes që përfshin kryerjen e shumëfishtë të akteve të parashikuara në paragrafin 1 kundër çdo popullsie civile, në pajtim me ose në ndihmë të politikës shtetërore ose organizative për të kryer një sulm të tillë;

(b) "Shfarosja" përfshin imponimin e qëllimshëm të kushteve të jetës një grupi, inter alia, heqjen e mundësisë për ushqim dhe barna, të parashikuara që të shkaktojnë shkatërrimin e një pjese të popullsisë;

(c) "Skllavërimi" nënkupton ushtrimin e një ose të gjitha kompetencave të lidhura me të drejtën e pronësisë mbi një person dhe përfshin ushtrimin e një kompetence të tillë nëpërmjet trafikimit të personave, sidomos grave dhe fëmijëve;

(d) "Deportimi ose transferimi i dhunshëm i popullsisë" nënkupton zhvendosjen e dhunshme të personave, përmes dëbimit ose akteve të tjera detyruese, nga rajoni në të cilin ata qëndrojnë në mënyrë të ligjshme, dhe që nuk bazohet në të drejtën ndërkombëtare;

(e) "Tortura" nënkupton shkaktimin e qëllimshëm të dhimbjeve ose vuajtjeve të rënda, fizike ose mendore, personit të ndaluar ose nën kontrollin e të akuzuarit; përveç kësaj, tortura nuk përfshin dhimbjen ose vuajtjen e rrjedh vetëm nga, përmbahet ose shoqëron sanksionet e ligjshme;

(f) "Shtatzënia e dhunshme" nënkupton izolimin e paligjshëm të një gruaje të lënë shtatzënë me dhunë, me qëllimin e ndikimit në përbërjen etnike të çdo popullsie, ose kryerjen e shkeljeve të tjera të rënda të së drejtës ndërkombëtare. Ky përkufizim në asnjë mënyrë nuk duhet të nënkuptojë se ndikon në ligjet kombëtare që rregullojnë shtatzëninë;

(g) "Persekutimi" nënkupton privimin e qëllimshëm dhe të rëndë nga të drejtat themelore, që është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, bazuar mbi identitetin e grupit ose bashkësisë;

(h) "Krimi i aparteidit" nënkupton aktet çnjerëzore të karakterit të ngjashëm me ato të parashikuara në paragrafin 1, të kryera në kontekstin e regjimit të institucionalizuar të shtypjes sistematike dhe dominimit të një grupi racor mbi grupin ose grupet tjera racore dhe të kryera me qëllimin e mbajtjes së atij regjimi;

(i) "Zhdukja e detyruar e personave" nënkupton arrestimin, ndalimin ose rrëmbimin e personave nga ose të autorizuar, përkrahur ose pranuar nga shteti ose organizata politike, e pasuar nga refuzimi për të njohur një privim të tillë lirie ose për të dhënë informacion rreth fatit ose vendndodhjes së këtyre personave, me qëllim largimin e tyre nga mbrojtja ligjore për një periudhë të gjatë kohe.

3. Për qëllim të këtij Statuti, shprehja "gjini" kuptohet se ka të bëjë me të dy gjinitë, mashkullore e femërore, brenda kontekstit të shoqërisë. Shprehja "gjini" nuk nënkupton ndonjë koncept të ndryshëm nga ai i përmendur më sipër.

Neni 8
Krimet e luftës

1. Gjykata ka juridiksion mbi krimet e luftës, sidomos kur janë kryer si pjesë e një plani ose politike, ose si pjesë e kryerjes së krimeve të tilla në shkallë të lartë.

2. Për qëllimin e këtij Statuti, "krimet e luftës" nënkuptojnë:

(a) Shkeljet e rënda të Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949, pikërisht, secili nga aktet e mëposhtme kundër personave ose pasurisë që mbrohen sipas dispozitave të Konventës përkatëse të Gjenevës:

(i) Vrasja e qëllimshme.

(ii) Tortura ose trajtimi çnjerëzor, përfshirë këtu edhe eksperimentet biologjike.

(iii) Shkaktimi i qëllimshëm i vuajtjeve të mëdha, ose dëmtimeve serioze të trupit ose shëndetit;

(iv) Shkatërrimi masiv dhe përvetësimi i pasurisë, që nuk justifikohet me nevojat ushtarake dhe e kryer në mënyrë të paligjshme e të pamëshirshme.

(v) Detyrimi i të burgosurit të luftës ose personave tjerë të mbrojtur për të shërbyer në forcat e një Pale armike.

(vi) Privimi i qëllimshëm i të burgosurit të luftës ose personit tjetër të mbrojtur, nga e drejta për një gjykim të drejtë e të rregullt.

(vii) Deportimi, transferimi ose dënimi i paligjshëm.

(viii) Marrja e pengjeve.

(b) Shkeljet e tjera serioze të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në një konflikt të armatosur ndërkombëtar, brenda kornizës së themeluar nga e drejta ndërkombëtare, pikërisht, secili nga aktet e mëposhtëme:

(i) Kryerja e qëllimshme e sulmeve kundër popullsisë civile ose individëve civilë të cilët nuk marrin pjesë drejtpërdrejt në konflikt.

(ii) Kryerja e qëllimshme e sulmeve kundër objekteve civile, pra objekteve që nuk janë objektiva ushtarake.

(iii) Kryerja e qëllimshme e sulmeve kundër personelit, instalimeve, materialit, njësive ose automjeteve të përfshira në ndihmën humanitare ose misionin paqeruajtës, në pajtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara, kur ata kanë të drejtë të mbrojnë civilët ose objektet civile sipas së drejtës ndërkombëtare, gjatë konflikteve të armatosura;

(iv) Fillimi i qëllimshëm i sulmit, duke ditur se një sulm i tillë do të shkaktonte humbjen e rastësishme të jetës ose plagosjen e civilëve, ose dëmet në objekte civile, ose dëmtimin në masë, afatgjatë dhe serioz të mjedisit natyror, që do të ishin haptazi ne disproporcion me avantazhet ushtarake konkrete të pritura;

(v) Sulmi ose bombardimi, pa marrë parasysh me çfarë mjetesh, i qyteteve, fshatrave, banesave ose ndërtesave të pambrojtura e që nuk janë objektiva ushtarake.

(vi) Vrasja ose plagosja e një luftëtari që ka hedhur poshtë armët e tij, ose që nuk ka më mjete për mbrojtje e që është dorëzuar në besim;

(vii) Përdorimi i padrejtë i flamurit të paqes, flamurit ose simboleve ushtarake dhe uniformës së armikut, ose të Kombeve të Bashkuara e po ashtu edhe të shenjave dalluese të Konventave të Gjenevës, që shkaktojnë vdekjen a dëmtimin e rëndë trupor.

(viii) Transferimi, i drejtpërdrejtë ose i tërthortë, nga Forca Pushtuese e pjesëve të popullsisë së saj në territorin që ka pushtuar, ose deportimi a transferimi i të gjithëve ose një pjese të popullsisë së territorit të okupuar brenda ose jashtë këtij territori.

(ix) Kryerja e qëllimshme e sulmeve kundër ndërtesave fetare, arsimore, të artit, shkencës ose për qëllime humanitare, monumenteve historike, spitaleve dhe vendeve ku janë të mbledhur të

sëmurët e të plagosurit e që nuk janë objektiva ushtarake;

(x) Nënshtrimi i personave që janë në pushtetin e palës kundërshtare, kryerjes së gjymtimeve fizike, ose eksperimenteve mjekësore a shkencore të çfarëdo lloji, të cilat nuk janë të justifikuara nga trajtimi mjekësor, dental ose spitalor të personit në fjalë e as që janë kryer në interesin e tij ose saj personal dhe të cilat shkaktojnë vdekjen ose rrezikojnë seriozisht shëndetin e personit ose personave të tillë.

(xi) Vrasja ose plagosja me pabesi e individëve që janë pjesëtarë të kombit a ushtrisë armike.

(xii) Deklarimi se nuk ofrohet strehë.

(xiii) Shkatërrimi ose marrja e pasurisë së armikut, vetëm nëse një shkatërrim ose marrje e tillë e pasurisë, kërkohet për shkak të domosdoshmërisë së luftës.

(xiv) Deklarimi në gjykatë i të drejtave dhe veprimeve të pjesëtarëve të palës armiqësore si të hequra, të pezulluara ose të palejueshme.

(xv) Detyrimi i pjesëtarëve të palës armiqësore për të marrë pjesë në operacionet e luftës të drejtuara kundër vetë shtetit të tyre, edhe nëse ata kanë qenë në shërbim luftarak para fillimit të luftës.

(xvi) Plaçkitja e qytetit ose vendit edhe atëherë kur është marrë me sulm,

(xvii) Përdorimi i helmeve ose armëve helmuese.

(xviii) Përdorimi i gazrave asfiksues, helmues ose të tjerë dhe lëngje, materiale ose pajisje të ngjashme me to.

(xix) Përdorimi i plumbave që zgjerohen ose shpërndahen lehtë në trupin e njeriut, siç janë plumbat me mbështjellje të fortë, të cilët nuk e mbulojnë në tërësi pjesën e brendshme ose që janë me prerje;

(xx) Përdorimi i armëve, predhave dhe materialit e metodave të luftës, të cilat janë të asaj natyre që shkaktojnë lëndime të tepërta ose vuajtje të panevojshme, që janë vetiu të pakujdesshme, duke shkelur të drejtën ndërkombëtare për konfliktin e armatosur, me kusht që këto armë, predha, materiale, si dhe metoda luftimi te jenë plotësisht të ndaluara dhe të jenë të përfshira në një shtesë të këtij Statuti, nëpërmjet një amendamenti, në pajtim me dispozitat përkatëse të paraqitura në nenet 121 dhe 123;

(xxi) Ushtrimi i dhunës mbi dinjitetin personal, sidomos trajtimi poshtërues dhe degradues.

(xxii) Kryerja e përdhunimit, skllavërimit seksual, prostitucionit të detyruar, shtatzënisë së detyruar, siç është përkufizuar në nenin 7, paragrafi 2 (f), sterilizimi i detyruar, ose cilado formë tjetër e dhunës seksuale, gjithashtu paraqet shkelje të rëndë të Konventave të Gjenevës.

(xxiii) Shfrytëzimi i pranisë së personit civil ose personit tjetër të mbrojtur për të dorëzuar pikat, rajonet ose forcat ushtarake, të pacënueshme nga operacionet ushtarake.

(xxiv) Kryerja e sulmeve të drejtpërdrejta ndaj ndërtesave, materialeve, njësive mjekësore dhe transportuese, dhe personelit që përdor shenjat dalluese të Konventave të Gjenevës në pajtim me të drejtën ndërkombëtare.

(xxv) Përdorimi i qëllimshëm i vuajtjes së civilëve nga uria, si metodë e luftës, përmes privimit të tyre nga objektet e domosdoshme për ekzistencën e tyre, përfshirë këtu pengimin me dëshirë të furnizimeve me ndihma, ashtu siç është paraqitur në Konventat e Gjenevës.

(xxvi) Rekrutimi dhe regjistrimi i fëmijëve nën moshën 15-vjeçare në forcat e armatosura kombëtare ose shfrytëzimi i tyre për të marrë pjesë aktivisht në konflikte.

(c) Në rast të konfliktit të armatosur që nuk ka karakter ndërkombëtar, shkeljet e rënda të nenit 3, i përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1949, cilado nga aktet në vijim të kryera ndaj personave që nuk marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë në konflikt, përfshirë këtu edhe anëtarët e forcave të armatosura, të cilët kanë hedhur poshtë armët e tyre dhe ata që janë vendosur jashtë fushëbetejës për shkak të sëmundjes, plagëve, ndalimit, ose çfarëdo shkak tjetër:

(i) Dhuna kundër jetës dhe personit, sidomos vrasja e të gjitha llojeve, gjymtimi, trajtimi i vrazhdë dhe tortura.

(ii) Kryerja e keqtrajtimeve mbi dinjitetin personal, sidomos trajtimi poshtërues dhe degradues.

(iii) Marrja e pengjeve.

(iv) Dhënia e dënimeve dhe kryerja e ekzekutimeve pa një vendim gjyqësor të shpallur nga gjykata e themeluar në mënyrë të rregullt, që ofron të gjitha garancitë gjyqësore, përgjithësisht të pranuara si të domosdoshme.

(d) Paragrafi 2 (c) zbatohet në konfliktet e armatosura që nuk kanë karakter ndërkombëtar, prandaj nuk zbatohet në situatat e trazirave të brendshme dhe tensioneve, siç janë kryengritjet, aktet e izoluara dhe sporadike të dhunës, ose akteve tjera të një natyre të ngjashme.

(e) Shkeljet e tjera serioze të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktet e armatosura, që nuk kanë karakter ndërkombëtar, brenda kuadrit të caktuar të së drejtës ndërkombëtare, pikërisht secili nga aktet në vijim:

(i) Kryerja e qëllimshme e sulmeve kundër popullsisë civile ose individëve civilë që nuk marrin pjesë aktive në konflikt.

(ii) Kryerja e qëllimshme e sulmeve kundër ndërtesave, materialit, njësive mjekësore dhe transportuese, dhe personelit që përdorin shenjat dalluese të Konventave të Gjenevës në pajtim me të drejtën ndërkombëtare;

(iii) Kryerja e qëllimshme e sulmeve kundër personelit, instalimeve, materialit, njësive ose automjeteve të përfshira në një ndihmë humanitare ose mision paqeruajtës, në pajtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara, për aq kohë sa janë në mbrojtje të personave civilë ose objekteve civile, sipas së drejtës ndërkombëtare të konfliktit të armatosur.

(iv) Kryerja e qëllimshme e sulmeve kundër ndërtesave kushtuar fesë, arsimit, artit, shkencës ose nevojave humanitare, monumenteve historike, spitaleve dhe vendeve ku mbahen të sëmurët dhe të plagosurit, që nuk janë objektiva ushtarake.

(v) Plaçkitja e qytetit ose vendit, edhe kur është marrë me sulm.

(vi) Kryerja e përdhunimeve, skllavërimi seksual, prostitucioni i detyruar, shtatzënia e detyruar, siç është definuar në nenin 7, paragrafi 2 (f), sterilizimi i detyruar, ose cilado formë tjetër e dhunës seksuale, që gjithashtu paraqet shkelje të rënda të nenit 3 të përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës.

(vii) Rekrutimi dhe regjistrimi i fëmijëve nën moshën 15-vjeçare në forcat ose grupet e armatosura, ose shfrytëzimi i tyre për të marrë pjesë në mënyrë aktive në konflikt.

(viii) Urdhërimi i zhvendosjes së popullsisë civile për arsye të lidhjes me konfliktin, përveç kur kjo kërkohet nga siguria e civilëve të interesuar ose nga arsye shumë të rëndësishme ushtarake.

(ix) Vrasja ose plagosja e luftëtarit kundërshtar me pabesi.

(x) Deklarimi se nuk ofrohet strehim.

(xi) Nënshtrimi i personave që janë nën kontrollin e palës kundërshtare gjymtimeve fizike ose eksperimenteve mjekësore ose shkencore të çfarëdo lloji e që nuk janë të justifikuara me trajtimin mjekësor, dentar ose spitalor të këtyre personave, e as që janë kryer në interesin e tij ose saj personal, dhe të cilat shkaktojnë vdekjen ose rrezikojnë seriozisht shëndetin e këtij ose këtyre personave.

(xii) Shkatërrimi ose konfiskimi i pasurisë së armikut, përveç nëse një shkatërrim ose konfiskim i tillë i pasurisë kërkohet patjetër për shkak të nevojave të luftës.

(f) Paragrafi 2 (e) zbatohet në konfliktet e armatosura që nuk kanë karakter ndërkombëtar, prandaj nuk zbatohet në situatat e trazirave të brendshme dhe tensioneve, siç janë kryengritjet, aktet e izoluara dhe sporadike të dhunës, ose akte të tjera të kësaj natyre. Ai zbatohet në konfliktet e armatosura që zhvillohen në territorin e Shtetit, kur është fjala për konfliktin e zgjatur të armatosur në mes organeve qeveritare dhe grupeve të organizuara të armatosura, ose edhe në mes vetë këtyre grupeve.

3. Asgjë në paragrafin 2 (c) dhe (d) nuk ndikon mbi përgjegjësinë e Qeverisë për të mbajtur ose rivendosur rendin publik në Shtet, ose për të mbrojtur unitetin dhe integritetin territorial të Shtetit, sipas të gjitha mjeteve të ligjshme.

Neni 9
Elementet e Krimeve

1. Elementet e Krimeve ndihmojnë Gjykatën në interpretimin dhe zbatimin e neneve 6, 7 dhe 8. Ato miratohen nga shumica e dy të tretave të të gjithë anëtarëve të Asamblesë së Shteteve Palë.

2. Amendamentet për Elementet e Krimeve mund të propozohen nga:

(a) çdo Shtet Palë;

(b) gjyqtarët që veprojnë me shumicën e votave;

(c) prokurori.

Amendamentet e tilla miratohen nga shumica prej dy të tretat e të gjithë anëtarëve të Asamblesë së Shteteve Palë.

3. Elementet e Krimeve dhe amendamentet përkatëse, duhet të jenë në pajtim të plotë me këtë Statut.

Neni 10

Asgjë në këtë Pjesë nuk mund të interpretohet sikur kufizon ose paragjykon në ndonjë mënyrë si kufizim a cenim i rregullave ekzistuese ose atyre në zhvillim të së drejtës ndërkombëtare për qëllime të ndryshme nga ky Statut.

Neni 11
Juridiksioni ratione temporis

1. Gjykata ka juridiksion vetëm për krimet e kryera pas hyrjes në fuqi të këtij Satuti.

2. Nëse një Shtet bëhet Palë në këtë Statut pas hyrjes së tij në fuqi, Gjykata mund të ushtrojë juridiksion vetëm për krimet që janë kryer pas hyrjes në fuqi të këtij Statuti për atë Shtet, përveçse, kur ky Shtet ka bërë një deklaratë sipas nenit 12, paragrafi 3.

Neni 12
Parakushtet për ushtrimin e juridiksionit

1. Një Shtet që bëhet Palë në këtë Statut pranon njëkohësisht juridiksionin e Gjykatës lidhur me krimet e përmendura në nenin 5.

2. Në rastin e nenit 13, paragrafi (a) ose (c), Gjykata mund të ushtrojë juridiksionin, nëse një ose më tepër nga Shtetet në vijim e kanë miratuar Statutin ose e kanë pranuar juridiksionin e Gjykatës në pajtim me paragrafin 3:

(a) Shteti, në territorin e të cilit ka ndodhur rasti në fjalë ose, kur krimi ka ndodhur në anije ose aeroplan, Shteti ku është e regjistruar anija ose aeroplani;

(b) Shteti, shtetas i të cilit është personi i akuzuar për krim.

3. Nëse kërkohet pranimi sipas paragrafit 2 nga një Shtet i cili nuk është Palë në Statut, ky Shtet, me anë të një deklarate paraqitur te Sekretari, pranon ushtrimin e juridiksionit nga Gjykata në lidhje me krimin në fjalë. Shteti që e pranon Statutin bashkëpunon pa vonesë dhe pa përjashtime në pajtim me pjesën 9.

Neni 13
Ushtrimi i juridiksionit

Gjykata ushtron juridiksionin e vet në lidhje me krimet e përmendura në nenin 5, në pajtim me dispozitat e këtij Statuti, kur:

(a) Paraqitet rasti ku një ose më tepër nga krimet e kryera të kësaj natyre i paraqiten Prokurorit nga Shteti që e ka miratuar në pajtim me nenin 14.

(b) Paraqitet rasti ku një ose më tepër nga krimet e kryera të kësaj natyre i paraqiten Prokurorit nga Këshilli i Sigurimit që vepron sipas Kaptinës VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara; ose

(c) Prokurori ka iniciuar hetimet lidhur me krimin e tillë në pajtim me nenin 15.

Neni 14
Paraqitja e rastit nga Shteti Palë

1. Shteti Palë mund t'ia paraqesë një rast ku kanë ndodhur një ose më tepër krime brenda juridiksionit të Gjykatës Prokurorit, duke kërkuar nga Prokurori që të hetojë rastin, me qëllim që të vendoset nëse një ose më shumë persona të veçantë mund të akuzohen për kryerjen e këtyre krimeve.

2. Paraqitja e rastit duhet të specifikojë sa të jetë e mundur rrethanat përkatëse të rastit dhe të shoqërohet me dokumentacion tjetër shtesë, i cili disponohet nga shteti që e ka paraqitur rastin.

Neni 15
Prokurori

1. Prokurori mund të nisë hetimin proprio motu, në bazë të informacioneve mbi krimet nën juridiksionin e Gjykatës.

2. Prokurori analizon rëndësinë e informacioneve të pranuara. Për këtë qëllim, ai ose ajo mund të kërkojë informacion shtesë nga Shtetet, Organet e Kombeve të Bashkuara, organizatat ndërqeveritare ose jo qeveritare ose burime të tjera mbështetëse, të cilat ai ose ajo i konsideron të përshtatshme dhe mund të pranojë dëshmi të shkruara ose gojore në selinë e Gjykatës.

3. Nëse Prokurori konstaton se ka baza të arsyeshme për të vazhduar hetimin, ai ose ajo duhet paraqesë kërkesë në Dhomën e Procedurës Paraprake ku shqyrtohen vërejtjet para fillimit të seancës gjyqësore, për të marrë autorizimin për të kryer një hetim, së bashku me të gjitha materialet tjera ndihmëse të mbledhura. Viktimat mund të paraqesin parashtresat e tyre në Dhomën e Procedurës Paraprake, në pajtim me Rregullat e Procedurës dhe Provave.

4. Nëse Dhoma e Procedurës Paraprake, me rastin e shqyrtimit të kërkesave dhe materialeve të tjera shtesë, konstaton se ekzistojnë baza të arsyeshme për të vazhduar me procedurën e hetimit dhe rasti duhet të trajtohet nën juridiksionin e Gjykatës, autorizon fillimin e procedurës hetimore, pa marrë parasysh vendimet e mëvonshme të Gjykatës, në lidhje me juridiksionin dhe pranueshmërinë e rastit.

5. Refuzimi i Dhomës së Procedurës Paraprake për të dhënë autorizimin e procedurës hetimore, nuk pengon parashtrimin e ndonjë kërkese të mëvonshme nga ana e Prokurorit, bazuar në fakte dhe dëshmi të reja që kanë të bëjnë me rastin e njëjtë.

6. Nëse, pas hetimit paraprak të parashikuar në paragrafin 1 dhe 2, Prokurori nxjerr përfundimin se informacioni i siguruar nuk siguron bazë të arsyeshme për procedurën hetimore, ai/ajo informon ata të cilët kanë dhënë informacionin mbi këtë. Kjo nuk e ndalon Prokurorin që të shqyrtojë informacione të tjera që i dorëzohen atij ose asaj në lidhje me rastin e njëjtë nën dritën e fakteve dhe provave te reja.

Neni 16
Shtyrja e hetimit ose ndjekjes penale

Asnjë hetim ose procedurë gjyqësore nuk mund të fillojë ose të zhvillohet sipas këtij Statuti për një periudhë kohore prej 12 muajsh, pasi Këshilli i Sigurimit i ka kërkuar Gjykatës një gjë të tillë në rezolutën e miratuar sipas Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara; kjo kërkesë mund të bëhet përsëri nga Këshilli në kushte të njëjta.

Neni 17

Çështjet e pranueshmërisë

1. Sipas paragrafit 10 të Preambulës dhe nenit 1, Gjykata vendos se rasti është i papranueshëm, nëse:

(a) Çështja është duke u hetuar ose ndjekur nga Shteti, i cili ka juridiksion mbi të, përveç kur Shteti nuk dëshiron ose nuk është realisht në gjendje të kryejë hetimin a ndjekjen.

(b) Çështja është hetuar ose është ndjekur nga Shteti, i cili ka juridiksion mbi të dhe Shteti ka vendosur të mos bëjë ndjekjen e personit në fjalë, përveç kur vendimi ka rezultuar nga mosdëshira ose pamundësia e Shtetit për të kryer ndjekjen.

(c) Personi në fjalë, tanimë është gjykuar për sjelljen që është objekt i ankesës, dhe gjykimi nga ana e Gjykatës nuk lejohet sipas nenit 20, paragrafi 3.

(d) Çështja nuk ka rëndësi të tillë që të mund të justifikojë veprimet e mëtejshme të Gjykatës.

2. Në mënyrë që të konstatojë mungesën e vullnetit në një rast konkret, Gjykata shqyrton, duke marrë parasysh parimet e procesit të rregullt, të njohur nga e drejta ndërkombëtare, nëse një ose më shumë nga këto në vijim ekzistojnë si të zbatueshme:

(a) Gjykimi u zhvillua ose po zhvillohet, ose vendimi kombëtar është marrë me qëllim të mbrojtjes së personit në fjalë prej përgjegjësisë penale për krimet brenda juridiksionit të Gjykatës të përmendura në nenin 5.

(b) Ka patur një zvarritje të paarsyeshme në gjykim, gjë që në këto rrethana është në mospajtim me qëllimin e vendosjes së personit para drejtësisë.

(c) Gjykimi nuk ishte ose nuk është duke u zhvilluar në mënyrë të pavarur a të paanshme, dhe ishte ose është duke u zhvilluar në mënyrën që, në këto rrethana, është në mospajtim me qëllimin e vendosjes së personit para drejtësisë.

3. Në mënyrë që të përcaktohet paaftësia në një rast konkret, Gjykata shqyrton nëse Shteti, për shkak të kolapsit të përgjithshëm ose të konsiderueshëm ose pamundësisë së sistemit të tij gjyqësor, nuk është në gjendje të gjejë të akuzuarin ose provat dhe dëshmitë e domosdoshme, ose në ndonjë mënyrë tjetër nuk është e mundur të zhvillojë gjykimin e tij.

Neni 18

Vendimet paraprake në lidhje me pranueshmërinë

1. Kur një situatë i është paraqitur Gjykatës në pajtim me nenin 13 (a) dhe Prokurori ka vendosur që ka baza të arsyeshme për të filluar hetimin ose Prokurori fillon hetimin në pajtim me nenet l3 (c) dhe 15, Prokurori njofton të gjitha Shtetet Palë dhe ato Shtete që, duke marrë parasysh informacionin në dispozicion, do të ushtronin normalisht juridiksion mbi ato krime. Prokurori mund t'i njoftojë këto Shtete në mënyrë konfidenciale dhe, atëherë kur Prokurori beson se është e domosdoshme për të mbrojtur personat, parandaluar shkatërrimin e dëshmive ose parandaluar fshehjen e personave, mund të kufizojë gamën e informacionit që u jepet Shteteve.

2. Brenda një muaji nga marrja e një njoftimi të tillë, Shteti mund të informojë Gjykatën se është duke kryer ose ka kryer hetimet ndaj qytetarëve të tij, ose ndaj të tjerëve brenda juridiksionit të tij, sa i përket veprave penale që mund të përbëjnë krime të përmendura në nenin 5 dhe që kanë të bëjnë me informacionin e dhënë në njoftimin që u është bërë Shteteve. Me kërkesën e atij Shteti, Prokurori pezullon hetimin Shtetëror të atyre personave, përveç kur Dhoma e Procedurës Paraprake, me kërkesë të Prokurorit, vendos të autorizojë hetimin.

3. Pezullimi i hetimeve nga ana e Prokurorit është i hapur për rishqyrtim nga Prokurori gjashtë muaj pas datës së pezullimit ose në çdo kohë kur ka ndodhur një ndryshim i rëndësishëm i rrethanave, për shkak të mosdëshirës së Shtetit ose pamundësinë e tij që të kryejë hetimin.

4. Shteti ose Prokurori mund të ankohet në Dhomën e Apelit kundër vendimit të Dhomës së Procedurës Paraprake, në pajtim me nenin 82, paragrafi 2. Ankesa mund të dëgjohet në mënyrë të shpejtuar.

5. Kur Prokurori e ka pezulluar hetimin në pajtim me paragrafin 2, Prokurori mund t'i kërkojë Shtetit përkatës të informojë Prokurorin në mënyrë periodike rreth përparimeve në hetimet e tij dhe rreth ndjekjeve të mëvonshme. Shtetet Palë u përgjigjen këtyre kërkesave pa vonesa të panevojshme.

6. Në pritje të vendimit nga Dhoma e Procedurës Paraprake, ose në çdo kohë kur Prokurori ka pezulluar hetimin sipas këtij neni, Prokurori, përjashtimisht, mund të kërkojë autorizimin nga Dhoma e Procedurës Paraprake që të ndjekë hapat e domosdoshëm hetimorë, me qëllim të ruajtjes së dëshmive, në rast se ekziston mundësia unike për të siguruar dëshmi të rëndësishme ose nëse ekziston rreziku i madh që dëshmi të tilla nuk do të mund të sigurohen më vonë.

7. Shteti që ka kundërshtuar vendimin e Dhomës së Procedurës Paraprake, sipas këtij neni, mund të kundërshtojë edhe lejueshmërinë e rastit sipas nenit 19, bazuar në fakte të rëndësishme plotësuese ose në ndërrimin thelbësor të rrethanave.

Neni 19

Kundërshtimet e juridiksionit të Gjykatës ose pranueshmëria e rastit

1. Gjykata krijon bindje se ka juridiksion mbi çdo çështje të sjellë para saj. Gjykata mund të përcaktojë kryesisht pranueshmërinë e çështjes në pajtim me nenin 17.

2. Kundërshtimet e lejueshmërisë së çështjes për shkaqet e përmendura në nenin 17, ose kundërshtimet e juridiksionit të Gjykatës mund të bëhen nga:

(a) I akuzuari ose personi për të cilin është lëshuar urdhër-arresti ose thirrja për t'u paraqitur sipas nenit 58.

(b) Shteti i cili ka juridiksion mbi çështjen, bazuar mbi faktin se ka filluar hetimin ose ndjekjen penale të çështjes ose ka hetuar ose ndjekur çështjen më parë; ose

(c) Shteti, nga i cili pranimi i juridiksionit kërkohet sipas nenit 12.

3. Prokurori mund të kërkojë vendimin nga Gjykata në lidhje me çështjen e juridiksionit ose pranueshmërisë. Në procedurat në lidhje me juridiksionin ose pranueshmërinë, ata që kanë paraqitur situatën sipas nenit 13, gjithashtu edhe viktimat, mund të paraqesin vërejtjet e tyre para Gjykatës.

4. Pranueshmëria e çështjes ose juridiksionit të Gjykatës mund të kundërshtohet vetëm një herë nga cilido person ose Shtet i përmendur në paragrafin 2. Kjo duhet të bëhet para fillimit të gjykimit. Në raste të jashtëzakonshme, Gjykata mund të lejojë që kundërshtimet të sillen para saj më shumë se një herë, ose edhe pas fillimit të gjykimit. Kundërshtimet e pranueshmërisë së çështjes me lejen e Gjykatës, me rastin e fillimit të gjykimit ose më vonë, mund të bazohen vetëm në nenin 17, paragrafi 1 (c).

5. Shteti i përmendur në paragrafin 2 (b) dhe (c) duhet të bëjë kundërshtimin sa më herët që është e mundur.

6. Para konfirmimit të padive, kundërshtimet e pranueshmërisë së çështjes ose juridiksionit të Gjykatës duhet t'i drejtohen Dhomës së Procedurës Paraprake. Pas konfirmimit të padive, ato duhet t'i drejtohen Dhomës së Gjykimit. Kundër vendimeve në lidhje me juridiksionin ose lejueshmërinë mund të bëhet ankim në Dhomën e Apelit, në pajtim me nenin 82.

7. Nëse kundërshtimi është bërë nga Shteti, i parashikuar në paragrafin 2 (b) ose (c), Prokurori pezullon hetimin, derisa Gjykata të vendosë në pajtim me nenin 17.

8. Në pritje të një vendimi nga Gjykata, Prokurori mund të kërkojë autoritetin e gjykatës:

(a) të ndërmarrë masat e nevojshme hetimore të llojit të parashikuar në nenin 18, paragrafi 6;

b) të marrë një deklaratë ose deponim nga një dëshmitar, ose të përfundojë mbledhjen dhe ekzaminimin e provave që ka filluar para se të bëhej kundërshtimi; dhe

c) në bashkëpunim me Shtetet përkatës, të parandalojë zhdukjen e personave për të cilët Prokurori ka kërkuar një urdhër-arresti sipas nenit 58.

9. Bërja e një kundërshtimi nuk cënon vlefshmërinë e asnjë veprimi të kryer nga Prokurori ose vendimi ose urdhri të nxjerrë nga Gjykata para se të bëhej kundërshtimi.

10. Nëse Gjykata ka vendosur se një çështje është e papranueshme sipas nenit 17, Prokurori

mund të bëjë kërkesë për rishikimin e vendimit kur ai ose ajo është plotësisht e bindur që kanë dalë fakte të reja të cilat mohojnë bazën mbi të cilën çështja është konsideruar e papranueshme sipas nenit 17.

11. Nëse Prokurori pezullon një hetim në lidhje me pikat e parashikuara në nenin 17, Prokurori mund të kërkojë që Shteti përkatës t'i paraqesë Prokurorit informacion mbi çështjen në gjykim. Me kërkesë të Shtetit përkatës, ky informacion mbetet konfidencial. Nëse Prokurori pas kësaj vendos vazhdimin e hetimit, ai ose ajo njofton Shtetin për të cilin ishte bërë pezullimi i gjykimit.

Neni 20
Ne bis in idem

1. Nëse nuk është parashikuar ndryshe në këtë Statut, asnjë person nuk gjykohet nga kjo Gjykatë në lidhje me një sjellje që ka qenë baza e krimeve për të cilën ai ka marrë fajësi ose pafajësi nga gjykata.

2. Asnjë person nuk gjykohet nga ndonjë gjykatë tjetër për një krim të përmendur në nenin 5 për të cilin ai person ka marrë fajësi ose pafajësi nga Gjykata.

3. Asnjë person i gjykuar nga një gjykatë tjetër për sjelljen e parashikuar në nenet 6, 7 ose 8 nuk gjykohet nga kjo Gjykatë në lidhje me të njëjtën sjellje, përveç kur gjykimi në gjykatën tjetër:

(a) ishte për qëllimin e mbrojtjes së personit përkatës nga përgjegjësia penale për krimet në juridiksionin e Gjykatës; ose

(b) nuk është kryer në mënyrë të pavarur ose të paanshme në pajtim me normat proceduriale të njohura nga e drejta ndërkombëtare dhe është kryer në mënyrë të tillë që, në bazë të rrethanave, nuk i shërbente qëllimit të çuarjes së personit përkatës para drejtësisë.

Neni 21
Ligji i zbatuar

1. Gjykata zbaton:

(a) në radhë të parë, këtë Statut, Elementet e Krimeve dhe Rregullat e Procedurës dhe provave;

(b) në radhë të dytë, kur është e nevojshme, traktatet e zbatueshme dhe principet e rregullat e së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë principet e pranuara të së drejtës ndërkombëtare për konfliktet e armatosura;

(c) kur kjo është e pamundur, principet e përgjithshme të së drejtës që nxirren nga Gjykata nga ligjet vendëse të sistemeve ligjore të botës duke përfshirë si duhet, ligjet vendëse të Shteteve që normalisht do të ushtronin juridiksionin mbi krimin, me kusht që këto principe të mos jenë të papajtueshme me këtë Statut dhe me të drejtën ndërkombëtare e normat dhe standardet e njohura ndërkombëtarisht.

2. Gjykata mund të zbatojë parimet dhe rregullat ligjore, ashtu siç janë interpretuar në vendimet e saj të mëparshme.

3. Zbatimi dhe interpretimi i ligjit, në pajtim me këtë nen, duhet të jetë në pajtim me të drejtat e njeriut të pranuara ndërkombëtarisht dhe pa asnjë dallim të bazuar mbi shkaqe të tilla, siç është gjinia, sipas përcaktimit të nenit 7, paragrafi 3, mosha, raca, ngjyra, gjuha, feja ose besimi, mendimi politik ose tjetër, origjina kombëtare, etnike ose sociale, pasuria, lindja ose ndonjë status tjetër.

PJESA 3
PARIMET E PËRGJITHSHME TË LIGJIT PENAL

Neni 22
Nullum crimen sine lege

1. Një person nuk përgjigjet penalisht sipas këtij Statuti, përveçse kur sjellja në fjalë paraqet, në kohën kur ndodh, krim brenda juridiksionit të Gjykatës.

2. Përkufizimi i krimit duhet të sqarohet qartë dhe nuk duhet të jetë i zgjeruar me analogji. Në rast të dykuptimësisë, përkufizimi duhet të interpretohet në dobi të personit që merret në pyetje, ndiqet ose dënohet.

3. Ky nen nuk duhet të ndikojë në karakterizimin e cilësdo sjellje si kriminale, sipas së drejtës ndërkombëtare, pavarësisht nga ky Statut.

Neni 23
Nulla poena sine lege

Personi i fajësuar nga Gjykata mund të ndëshkohet vetëm në pajtim me këtë Statut.

Neni 24
Mosprapaveprimi për personat

1. Asnjë person nuk është përgjegjës sipas këtij Statuti për sjelljen para hyrjes në fuqi të këtij Statuti.

2. Në rast të ndryshimeve në ligjin e zbatueshëm për një çështje të caktuar para vendimit përfundimtar, zbatohet ligji më i favorshëm për personin që merret në pyetje, ndiqet penalisht ose dënohet.

Neni 25
Përgjegjësia penale individuale

1. Gjykata ka juridiksion mbi personat fizikë, në pajtim me këtë Statut.

2. Personi që kryen një krim brenda juridiksionit të Gjykatës është përgjegjës personalisht dhe i nënshtrohet dënimit, në pajtim me këtë Statut.

3. Në pajtim me këtë Statut, personi është përgjegjës penalisht dhe i nënshtrohet dënimit për krimin brenda juridiksionit të Gjykatës, nëse ai person:

(a) kryen një krim të tillë, si individ, bashkë me një tjetër ose përmes një personi tjetër, pavarësisht nëse personi tjetër përgjigjet penalisht ose jo;

(b) urdhëron, kërkon ose shtyn në kryerjen e një krimi të tillë, i cili në fakt ndodh ose mbetet në tentativë;

(c) me qëllim të mundësimit të kryerjes së krimit, ndihmon, përkrah ose përndryshe asiston në kryerjen e tij ose në tentim, përfshirë këtu edhe ofrimin e mjeteve për kryerjen e tij;

(d) në çfarëdo mënyre tjetër kontribuon në kryerjen ose tentimin e kryerjes së një krimi të tillë, nga grupi i personave që veprojnë me të njëjtin qëllim. Një kontribut i tillë duhet të jetë i qëllimshëm dhe duhet të:

(i) bëhet me qëllim të zhvillimit të aktivitetit ose qëllimit kriminal të grupit, kur një aktivitet ose qëllim i tillë përfshin kryerjen e krimit brenda juridiksionit të Gjykatës; ose

(ii) bëhet edhe pse është ditur për qëllimin e grupit për kryerjen e krimit;

(e) përsa i përket krimit të genocidit, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose publikisht, shtyn të tjerët që të kryejnë gjenocid;

(f) tenton të kryejë një krim të tillë, përmes ndërmarrjes së veprimit që inicion kryerjen e tij, me anë të një hapi thelbësor, por krimi nuk ndodh për shkak të rrethanave që nuk varen nga qëllimet

e personit. Megjithatë, personi që tërhiqet nga përpjekja për të kryer krimin, ose në një mënyrë tjetër parandalon përfundimin e krimit, nuk i nënshtrohet dënimit sipas këtij Statuti për tentimin për të kryer atë krim, nëse ai person ka hequr dorë plotësisht dhe në mënyrë vullnetare nga qëllimi kriminal.

4. Asnjë dispozitë në këtë Statut, që ka të bëjë me përgjegjësinë penale individuale, nuk ndikon në përgjegjësinë e Shteteve sipas së drejtës ndërkombëtare.

Neni 26

Përjashtimi i juridiksionit mbi personat nën moshën tetëmbëdhjetëvjeçare

Gjykata nuk ka juridiksion mbi cilindo person që ishte nën moshën tetëmbëdhjetëvjeçare në kohën e kryerjes së prezumuar të krimit.

Neni 27

Mosmarrja parasysh e pozitës zyrtare

1. Ky Statut zbatohet në të njëjtën mënyrë ndaj të gjithë personave, pa asnjë dallim të bazuar në pozitën zyrtare. Veçanërisht, pozita zyrtare si Kryetar Shteti ose Qeverie, anëtar i Qeverisë ose i Parlamentit, përfaqësues i zgjedhur i Qeverisë ose zyrtar i Qeverisë, në asnjë rast nuk përjashtojnë asnjë person nga përgjegjësia penale sipas këtij Statuti dhe ajo, në dhe për vete, nuk përbëjnë shkak për zvogëlimin e dënimit.

2. Imunitetet ose rregullat e veçanta procedurale që lidhen me pozitën zyrtare të personit, sipas së drejtës kombëtare ose asaj ndërkombëtare, nuk duhet të pengojnë Gjykatën në ushtrimin e juridiksionit të saj mbi një person të tillë.

Neni 28

Përgjegjësia e komandantëve dhe drejtuesve të tjerë

Përveç shkaqeve të tjera të përgjegjësisë penale sipas këtij Statuti, për krimet brenda juridiksionit të Gjykatës:

(a) komandanti ushtarak ose personi që në mënyrë efektive vepron si i tillë, është penalisht përgjegjës për krimet brenda juridiksionit të Gjykatës, të kryera nga forcat nën komandën a kontrollin efektiv të tij ose saj, ose autoritetin efektiv që mund të jenë si rezultat i dështimit të tij ose saj për të ushtruar kontrollin e duhur mbi ato forca, kur:

(i) ai komandant ushtarak ose personi, ose ka ditur, ose duke marrë parasysh rrethanat e rastit, duhej të dinte se forcat ishin duke kryer ose do të kryenin krime të tilla; dhe

(ii) ai komandant ushtarak ose personi ka dështuar të ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme dhe të arsyeshme brenda fuqive të tij ose saj, për të parandaluar ose shtypur kryerjen e tyre, ose për të dorëzuar çështjen në organin kompetent për hetim dhe ndjekje penale.

(b) Në lidhje me raportin drejtues vartës që nuk është përshkruar në paragrafin (1), drejtuesi duhet të jetë përgjegjës penalisht për krimet brenda juridiksionit të Gjykatës, të kryera nga personat vartës, nën autorizimin dhe kontrollin efektiv të tij ose saj, si rezultat i dështimit të tij ose saj për të ushtruar kontrollin e duhur mbi personat e tillë, kur:

(i) drejtuesi ka ditur ose në mënyrë të vetëdijshme nuk ka përfillur informacionin që në mënyrë të qartë ka treguar se personat vartës ishin duke kryer ose mendonin të kryenin krime të tilla;

(ii) krimet kanë të bëjnë me vepra që janë brenda përgjegjësisë dhe kontrollit efektiv të drejtuesit; dhe

(iii) drejtuesi ka dështuar në marrjen e të gjitha masave të domosdoshme dhe të arsyeshme brenda fuqive të tij ose saj për të parandaluar ose ndaluar kryerjen e tyre, ose për të dorëzuar çështjen në organin kompetent për hetim dhe ndjekje penale.

Neni 29
Moszbatueshmëria e statutit të kufizimeve

Krimet brenda juridiksionit të Gjykatës nuk kushtëzohen nga asnjë statut kufizues.

Neni 30
Elementi mendor

1. Përveçse kur është parashikuar ndryshe, personi është penalisht përgjegjës dhe i nënshtrohet ndëshkimit për krimin brenda juridiksionit të Gjykatës, vetëm nëse elementet materiale janë kryer me qëllim dhe njohje.

2. Për qëllimet e këtij neni, personi ka qëllim, kur:

(a) në lidhje me sjelljen, ai person mendon të angazhohet në atë sjellje;

(b) në lidhje me pasojën, ai person mendon të shkaktojë atë pasojë, ose është i vetëdijshëm se ajo do të ndodhë sipas rrjedhës së rregullt të ngjarjeve.

3. Për qëllimet e këtij neni, "njohje" nënkupton dijeninë se një rrethanë ekziston, ose se një pasojë do të ndodhë sipas rrjedhës së rregullt të ngjarjeve. "Dije" dhe "me dijeni" përkufizohen qartë.

Neni 31
Shkaqet për përjashtimin nga përgjegjësia penale

1. Si shtesë e shkaqeve të tjera për përjashtimin nga përgjegjësitë penale, të parashikuara në këtë Statut, personi nuk është penalisht përgjegjës, nëse në kohën e veprimit të atij personi:

(a) personi vuan nga një sëmundje mendore ose një mangësi, që shkatërron aftësinë e këtij personi për të vlerësuar paligjshmërinë ose natyrën e sjelljes se tij ose të saj për të kontrolluar sjelljen e tij ose saj për të qenë në pajtim me kërkesat e ligjit;

(b) personi është në gjendje helmimi që shkatërron aftësinë e atij personi për të vlerësuar paligjshmërinë ose natyrën e sjelljes së tij ose të saj, ose aftësinë për të kontrolluar sjelljen e tij ose saj për të qenë në pajtim me kërkesat e ligjit, përveç nëse personi është helmuar në mënyrë vullnetare, në rrethana të cilat personi i ka ditur, ose ka nënçmuar rrezikun, që si rezultat i helmimit, ai ose ajo do të angazhohet në sjelljen që paraqet vepër penale brenda juridiksionit të Gjykatës;

(c) personi vepron me arsye për të mbrojtur veten ose personin tjetër, ose, në rastin e krimeve të luftës, pronën që është thelbësore për ekzistencën e personit ose ndonjë personi tjetër, ose pronën që është thelbësore për plotësimin e misionit ushtarak, kundër përdorimit të pashmangshëm dhe të paligjshëm të forcës, në mënyrën që është proporcionale me shkallën e rrezikut për personin, ose ndonjë person tjetër, ose pronën që mbrohet. Fakti që personi ka qenë i përfshirë në operacion mbrojtës, të zhvilluar nga forcat, nuk përbën vetiu shkak për përjashtimin e përgjegjësisë penale, sipas këtij nënparagrafi;

(d) sjellja që pohohet se paraqet krim brenda juridiksionit të Gjykatës, është shkaktuar me detyrim, që ka rrjedhur nga kërcënimi me vdekje të paevitueshme, ose nga dëmtimi i vazhdueshëm ose i menjëhershëm dhe serioz trupor kundër personit ose ndonjë personi tjetër dhe personi ka vepruar domosdoshmërisht dhe në mënyrë të arsyeshme për të shmangur këtë kërcënim, kështu që personi nuk ka pasur për qëllim të shkaktojë dëm më të madh se atë që ka dashur ta shmangë. Një kërcënim i tillë mund të jetë:

(i) bërë nga persona të tjerë; ose

(ii) krijuar nga rrethanat të tjera që janë jashtë kontrollit të atij personi.

2. Gjykata duhet të përcaktojë zbatueshmërinë e shkaqeve për përjashtimin e përgjegjësisë penale të parashikuara në këtë Statut për rastin në shqyrtim.

3. Gjatë gjykimit, Gjykata mund të marrë parasysh shkaqe të tjera për përjashtimin e përgjegjësisë penale nga ato që janë përmendur në paragrafin 1, ku një shkak i tillë rrjedh nga ligji i

zbatueshëm, siç është parashikuar në nenin 21. Procedurat në lidhje me shqyrtimin e një shkaku të tillë, rregullohen në Rregullat e Procedurës dhe Provave.

Neni 32
Gabimi në fakt ose gabimi në ligj

1. Gabimi në fakt është shkak për përjashtimin e përgjegjësisë penale, vetëm nëse ai mohon elementin mendor të kërkuar nga krimi.

2. Gabimi në ligj, në lidhje me nëse një lloj i veçantë i sjelljes është krim brenda juridiksionit të Gjykatës, nuk është shkak për përjashtimin e përgjegjësisë penale. Gabimi në ligj, megjithatë, mund të jetë shkak për përjashtimin e përgjegjësisë penale, nëse mohon elementin mendor të kërkuar nga një krim i tillë ose ashtu siç është parashikuar në nenin 33.

Neni 33
Urdhrat e drejtuesve dhe parashkrimi ligjor

1. Fakti që krimi brenda juridiksionit të Gjykatës është kryer nga një person sipas urdhrave të Qeverisë ose drejtuesit, qoftë ai ushtarak ose civil, nuk e liron atë person nga përgjegjësia penale, përveç kur:

(a) personi ka qenë nën detyrimin ligjor që të respektojë urdhrat e Qeverisë ose drejtuesit në fjalë;

(b) personi nuk ka ditur se urdhri është i paligjshëm; dhe

(c) urdhri nuk ka qenë haptazi i paligjshëm.

2. Për qëllimet e këtij neni, urdhrat për të kryer gjenocid ose krime kundër njerëzimit janë haptazi të paligjshme.

PJESA 4
PËRBËRJA DHE ADMINISTRATA E GJYKATËS

Neni 34
Organet e Gjykatës

Gjykata përbëhet nga këto organe:

(a) Kryesia.

(b) Divizioni për Ankesa, Divizioni për Gjykime dhe Divizioni për Procedurën Paraprake.

(c) Zyra e Prokurorit.

(d) Sekretaria.

Neni 35
Shërbimi i gjyqtarëve

1. Të gjithë gjyqtarët zgjidhen si anëtarë me orar të plotë të Gjykatës dhe janë të disponueshëm të kryejnë detyrën në atë bazë që nga fillimi i afatit të shërbimit të tyre.

2. Gjyqtarët që përbëjnë Kryesinë punojnë me orar të plotë pune menjëherë sapo zgjidhen.

3. Kryesia mundet, në bazë të normës së punës në Gjykatë dhe sipas konsultimeve me anëtarët e saj, të vendosë kohë pas kohe se në çfarë mase gjyqtarët e mbetur do të kërkohet të punojnë me orar të plotë. Çfarëdo marrëveshje e tillë nuk cënon dispozitat e nenit 40.

4. Në pajtim me nenin 49, marrëveshjet financiare bëhen për gjyqtarët që nuk kërkohet të punojnë në orar të plotë.

Neni 36

Kualifikimet, emërimi dhe zgjedhja e gjyqtarëve

1. Kushtëzuar nga dispozitat e paragrafit 2, Gjykata ka 18 gjyqtarë.

2. (a) Kryesia, duke vepruar në emër të Gjykatës, mund të propozojë që të rritet numri i gjyqtarëve të përmendur në paragrafin 1, duke përmendur arsyet se pse kjo konsiderohet si e domosdoshme dhe e nevojshme. Referenti përcjell menjëherë çdo propozim të tillë te të gjitha Shtetet Palë.

(b) Çdo propozim i tillë merret në shqyrtim në takimin e Asamblesë së Shteteve Palë, që thirret në pajtim me nenin 112. Propozimi konsiderohet si i miratuar, nëse aprovohet në takim me votën e dy të tretave të anëtarëve të Asamblesë së Shteteve Palë dhe hyn në fuqi në kohën për të cilën vendos Asambleja e Shteteve Palë.

(c) (i) Kur propozimi për shtimin e numrit të gjyqtarëve është miratuar sipas nënparagrafit (b), zgjedhja e gjyqtarëve shtesë bëhet në sesionin e ardhshëm të Asamblesë së Shteteve Palë në pajtim me paragrafët 3 deri 8 dhe nenin 37, paragrafi 2.

(ii) Kur propozimi për shtimin e numrit të gjyqtarëve është miratuar dhe është bërë efektiv sipas nënparagrafëve (b) dhe (c) (i), ai pastaj mbetet i hapur për Kryesinë në çdo kohë, nëse norma e punës së Gjykatës e justifikon atë, për të propozuar pakësimin e numrit të gjyqtarëve, por që numri i gjyqtarëve nuk zvogëlohet nën atë të specifikuar në paragrafin 1. Propozimi shqyrtohet në pajtim me procedurën e parashikuar në nënparagrafët (a) dhe (b). Në rast se propozimi miratohet, numri i gjyqtarëve zvogëlohet në mënyrë progresive me mbarimin e afatit të shërbimit të gjyqtarëve që janë duke shërbyer, derisa të arrihet numri i domosdoshëm.

3. (a) Gjyqtarët zgjidhen nga radhët e personave me karakter të lartë moral, me paanësi dhe integritet e që posedojnë kualifikimet e nevojshme në Shtetet e tyre për t'u emëruar në postet më të larta gjyqësore.

(b) Secili kandidat për zgjedhje në Gjykatë duhet të ketë:

(i) dëshmuar kompetencë në të drejtën dhe procedurën penale dhe me gjithë përvojën përkatëse, qoftë si gjyqtar, prokuror, avokat ose në një cilësi tjetër të ngjashme në procedurën penale; ose

(ii) dëshmuar kompetencë në fushat përkatëse të së drejtës ndërkombëtare, siç është e drejta ndërkombëtare humanitare dhe ligjet mbi të drejtat e njeriut dhe përvojë të gjerë në cilësi profesionale ligjore, që është me rëndësi për aktivitetin gjyqësor të Gjykatës.

(c) Secili kandidat për zgjedhje në Gjykatë duhet të njohë shkëlqyeshëm dhe të jetë i rrjedhshëm në të paktën njërën prej gjuhëve të punës së Gjykatës.

4. (a) Emërimet e kandidatëve për zgjedhje në Gjykatë mund të bëhen nga cilado prej Shteteve Palë në këtë Statut dhe duhet të bëhen:

(i) nëpërmjet procedurës së emërimit të kandidatëve për emërim në pozitat më të larta gjyqësore në Shtetin në fjalë; ose

(ii) nëpërmjet procedurës së caktuar për emërimin e kandidatëve në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë sipas Statutit të asaj Gjykate.

Emërimet paraqiten në një deklaratë me të gjitha detajet e domosdoshme, ku tregohet se si kandidati i plotëson kërkesat e paragrafit 3.

(b) Secili Shtet Palë mund të paraqesë një kandidat për cilëndo pozitë dhe nuk është e domosdoshme që ai të jetë shtetas i atij Shteti Palë, por në çdo rast duhet të jetë shtetas i ndonjërit prej Shteteve Palë.

(c) Asambleja e Shteteve Palë mund të vendosë që të themelojë, nëse është e duhur, një Komitet Këshillues për emërimet. Në atë rast, përbërja e Komitetit dhe mandati i tij duhet të përcaktohet nga ana e Asamblesë së Shteteve Palë.

5. Për qëllimin e zgjedhjes, janë dy lista me kandidatë:

lista A që përmban emrat e kandidatëve me kualifikimet e parashikuara në paragrafin 3 (b) (i); dhe

lista B që përmban emrat e kandidatëve me kualifikimet e parashikuara në paragrafin 3 (b) (ii).

Kandidati me kualifikimet e mjaftueshme për të dyja listat, mund të zgjedhë se në cilën listë do të paraqitet. Me rastin e zgjedhjes së parë në Gjykatë, të paktën nëntë gjyqtarë zgjidhen nga lista A dhe të paktën pesë të tjerë nga lista B. Zgjedhjet plotësuese organizohen ashtu që të mbajnë një raport të barabartë në Gjykatë të gjyqtarëve të kualifikuar nga të dyja listat.

6. (a) Gjyqtarët zgjidhen me zgjedhje të fshehta në takimin e Asamblesë së Shteteve Palë, të thirrur për këtë qëllim në bazë të nenit 112. Sipas paragrafit 7, personat e zgjedhur në Gjykatë duhet të jenë ata 18 kandidatë që fitojnë numrin më të madh të votave dhe shumicën nga dy të tretat e votave të Shteteve Palë që janë të pranishme dhe që votojnë.

(b) Në rast se një numër i madh gjyqtarësh nuk janë zgjedhur në votimin e parë, votimet pasuese organizohen në pajtim me procedurat e përshkruara në nënparagrafin (a), përderisa të plotësohen vendet e mbetura.

7. Dy gjyqtarë nuk mund të jenë shtetas të të njëjtit Shtet. Personi që, me qëllim të anëtarësimit në Gjykatë, mund të konsiderohet si shtetas i më shumë se një Shteti, vlerësohet se është shtetas i Shtetit në të cilin ai person ushtron në mënyrë të rregullt të drejtat e tij civile dhe politike.

8. (a) Shtetet Palë duhet që, gjatë zgjedhjes së gjyqtarëve, të marrin parasysh nevojën brenda anëtarësisë në Gjykatë, për:

(i) përfaqësimin e sistemeve kryesore ligjore të botës;

(ii) përfaqësimin e drejtë gjeografik; dhe

(iii) përfaqësimin e drejtë të gjyqtarëve të gjinisë femërore dhe mashkullore.

(b) Shtetet Palë duhet po ashtu të marrin parasysh nevojën e përfshirjes së gjyqtarëve me përvojë ligjore në çështjet specifike, duke përfshirë, por jo të kufizuar në dhunën e drejtuar ndaj grave ose fëmijëve.

9. (a) Sipas nënparagrafit (b), gjyqtarët mbajnë pozitën e tyre për periudhën prej nëntë vjetësh dhe sipas nënparagrafit (c) dhe neni 37, paragrafi 2, nuk kanë të drejtë të rizgjidhen.

(b) Në zgjedhjen e parë, një e treta e gjyqtarëve të emëruar zgjidhen me short për të punuar për një periudhë kohe prej tre vjetësh; një e treta e gjyqtarëve të emëruar zgjidhen me short për të shërbyer për një periudhë kohe prej gjashtë vjetësh dhe të tjerët shërbejnë për një periudhë kohe prej nëntë vjetësh.

(c) Gjyqtari që është zgjedhur për të shërbyer për periudhën kohore prej tre vjetësh sipas nënparagrafit (b) ka të drejtë të rizgjidhet për afat të plotë.

10. Në ndryshim nga paragrafi 9, gjyqtari i caktuar në Dhomën e Gjykimit ose Ankesave, në pajtim me nenin 39, vazhdon punën e tij rreth përfundimit të gjykimit ose ankesës, shqyrtimi i së cilës ka filluar para asaj Dhome.

Neni 37

Vendet e lira për gjyqtarë

1. Në rast të vendit të lirë, bëhet zgjedhja në pajtim me nenin 36, për të plotësuar atë vend të lirë pune.

2. Gjyqtari i zgjedhur për të plotësuar atë vend të lirë, shërben për kohën e mbetur nga mandati i paraardhësit të tij dhe, nëse kjo kohë është për tre ose më pak vjet, ai ka të drejtë të rizgjidhet për një afat të plotë, sipas nenit 36.

Neni 38

Kryesia

1. Kryetari dhe Nënkryetari i Parë dhe i dytë zgjidhen me votat e shumicës absolute të gjyqtarëve. Secili prej tyre shërben për një afat kohor prej tre vjetësh ose deri në përfundimin e mandatit të tyre si gjyqtarë, cilido afat që përfundon më parë. Ata kanë të drejtë të rizgjidhen vetëm një herë.

2. Nënkryetari i Parë vepron në vend të Kryetarit, në rast se Kryetari nuk është në dispozicion ose është i skualifikuar. Nënkryetari i Dytë vepron në vend të Kryetarit, në rast se si Kryetari, ashtu edhe Nënkryetari i Parë nuk janë në dispozicion ose janë të skualifikuar.

3. Kryetari, bashkë me Nënkryetarin e Parë dhe të Dytë, përbëjnë Kryesinë, që eshtë përgjegjëse për:

(a) administrimin e duhur të Gjykatës, me përjashtim të Zyrës së Prokurorit; dhe

(b) funksionet e tjera që i ngarkohen asaj në pajtim me këtë Statut.

4. Në shkarkimin e tij nga përgjegjësia sipas paragrafit 3 (a), Kryesia koordinon punën dhe kërkon bashkëpunimin me Prokurorin në të gjitha çështjet me interes të përbashkët.

Neni 39
Dhomat

1. Sa më parë që të jetë e mundur pas zgjedhjes së gjyqtarëve, Gjykata organizohet në divizione, të parashikuara në nenin 34, paragrafi (b). Divizioni i Ankesave përbëhet nga Kryetari dhe katër gjyqtarë të tjerë, Divizioni i Gjykimeve nga jo më pak se gjashtë gjyqtarë dhe Divizioni i Procedurës Paraprake më pak se gjashtë gjyqtarë. Caktimi i gjyqtarëve në divizione bazohet në natyrën e funksioneve që kryhen nga secili divizion dhe në kualifikimet dhe përvojën e gjyqtarëve të zgjedhur në Gjykatë, në atë mënyrë që secili divizion të përmbajë një kombinim të përshtatshëm të përvojës në të drejtën dhe procedurën penale dhe në të drejtën ndërkombëtare. Divizionet e Gjykimit dhe të Procedurës Paraprake përbëhen kryesisht nga gjyqtarët me përvojë në gjykimet penale.

2. (a) Funksionet gjyqësore të Gjykatës ushtrohen në secilin divizion nga ana e Dhomave.

(b) (i) Dhoma e Ankesave përbëhet nga të gjithë gjyqtarët e Divizionit të Ankesave.

(ii) Funksionet e Dhomës së Gjykimit ushtrohen nga ana e tre gjyqtarëve të Divizionit të Gjykimit.

(iii) Funksionet e Dhomës së Procedurës Paraprake ushtrohen nga ana e tre gjyqtarëve të Divizionit të Procedurës Paraprake ose nga gjyqtari i vetëm i atij divizioni, në pajtim me këtë Statut dhe Rregullat e Procedurës dhe Provave.

(c) Asgjë në këtë paragraf nuk pengon themelimin e njëkohshëm të më shumë se një Dhome Gjykimi ose Dhome të Procedurës Paraprake, kur një gjë të tillë e kërkon manaxhimi i efektshëm i ngarkesës së punës në Gjykatë.

3. (a) Gjyqtarët e caktuar në Divizionet e Gjykimit dhe atë të Procedurës Paraprake shërbejnë në ato divizione për një periudhë kohore prej tre vjetësh, dhe pas kësaj deri në përfundimin e çdo çështjeje, shqyrtimi i së cilës ka filluar para divizionit në fjalë.

(b) Gjyqtarët e caktuar në Divizionin e Ankesave shërbejnë në atë divizion deri në përfundimin e mandatit të tyre.

4. Gjyqtarët e caktuar në Divizionin e Ankesave shërbejnë vetëm në atë divizion. Megjithatë, asgjë në këtë nen nuk pengon kalimin e përkohshëm të gjyqtarëve nga Divizioni i Gjykimit në atë të Divizionit të Procedurës Paraprake ose e kundërta, nëse Kryesia mendon se një gjë të tillë e kërkon menaxhimi i efektshëm i ngarkesës së punës në Gjykatë, me kusht që, gjyqtari që ka marrë pjesë në fazën paraprake, nuk do të ketë të drejtë në asnjë rast të ulet në Dhomën e Gjykimit dhe të marrë pjesë në shqyrtimin e asaj çështjeje.

Neni 40
Pavarësia e gjyqtarëve

1. Gjyqtarët janë të pavarur në ushtrimin e funksioneve të tyre.

2. Gjyqtarët nuk angazhohen në asnjë aktivitet që është në kundërshtim me funksionet e tyre gjyqësore ose që ka ndikim në besueshmërinë e pavarësisë së tyre.

3. Gjyqtarët që punojnë me orar të plotë në selinë e Gjykatës, nuk angazhohen në ndonjë punë tjetër të karakterit profesional.

4. Çdo çështje që rrjedh nga zbatimi i paragrafëve 2 dhe 3, vendoset nga një shumicë

absolute e gjyqtarëve. Kur një çështje e tillë ka të bëjë me një gjyqtar individual, ai gjyqtar nuk merr pjesë në marrjen e vendimit.

Neni 41
Lirimi dhe përjashtimi i gjyqtarëve

1. Kryesia, sipas kërkesës së gjyqtarit, mund ta lirojë atë gjyqtar nga ushtrimi i një funksioni sipas këtij Statuti, në pajtim me Rregullat e Procedurës dhe Provave.

2. (a) Gjyqtari nuk merr pjesë në asnjë çështje në të cilën paanshmëria e tij ose saj mund të vihet në dyshim në mënyrë të arsyeshme për çdo shkak. Gjyqtari përjashtohet nga çështja në pajtim me këtë paragraf, nëse, inter alia, ai gjyqtar ka qenë në çfarëdo cilësie i angazhuar më herët në këtë çështje para Gjykatës ose në një çështje penale në shkallë kombëtare që lidhet me të e që përfshin personin që tani është nën hetim ose në ndjekje penale. Gjyqtari, po ashtu, përjashtohet për shkaqet e parashikuara në Rregullat e Procedurës dhe Provave.

(b) Prokurori ose personi që është në hetim a ndjekje penale, mund të kërkojë përjashtimin e gjyqtarit sipas këtij paragrafi.

(c) Çdo çështje në lidhje me përjashtimin e gjyqtarit vendoset nga shumica absolute e gjyqtarëve. Gjyqtari i përjashtuar ka të drejtë të paraqesë komentet e tij ose saj në lidhje me çështjen, por nuk ka të drejtë të marrë pjesë në marrjen e vendimit.

Neni 42
Zyra e Prokurorit

1. Zyra e Prokurorit vepron në mënyrë të pavarur, si organ i ndarë i Gjykatës. Ajo nuk është përgjegjëse për pranimin e rekomandimeve dhe çfarëdo informacioni të vërtetuar mbi krimet brenda juridiksionit të Gjykatës, për shqyrtimin e tyre dhe kryerjen e hetimeve e ndjekjeve para Gjykatës. Anëtari i Zyrës nuk kërkon ose vepron sipas instruksioneve nga cilido burim i jashtëm.

2. Zyra udhëhiqet nga Prokurori. Prokurori ka autoritet të plotë për drejtimin dhe administrimin e Zyrës, përfshirë këtu edhe personelin, mjetet dhe burimet e tjera. Prokurori ndihmohet nga një ose më shumë Zëvendësprokurorë, të cilët janë të autorizuar të kryejnë cilindo nga veprimet e Prokurorit sipas këtij Statuti. Prokurori dhe Zëvendësprokurorët janë të kombësive të ndryshme. Ata punojnë me orar të plotë.

3. Prokurori dhe Zëvendësprokurorët janë persona me karakter të lartë moral, kompetentë dhe kanë përvojë të gjerë praktike në ndjekjen ose gjykimin e rasteve penale. Ata kanë njohuri të shkëlqyeshme dhe flasin rrjedhshëm njërën prej gjuhëve të punës në Gjykatë.

4. Prokurori zgjidhet nëpërmjet votimit të fshehtë nga ana e shumicës absolute të anëtarëve të Asamblesë së Shteteve Palë. Zëvendësprokurorët zgjidhen në mënyrë të njëjtë nga lista e kandidatëve të ofruar nga Prokurori. Prokurori emëron tre kandidatë për secilën post të Zëvendës-prokurorit. Përveçse kur është caktuar afat më i shkurtër në kohën e zgjedhjes së tyre, Prokurori dhe Zëvendësprokurorët punojnë për një periudhë kohore nëntëvjeçare dhe nuk kanë të drejtë për rizgjedhje.

5. Prokurori dhe Zëvendësprokurori nuk angazhohen në asnjë aktivitet që do të ndërhynte në funksionet e tij ose saj të ndjekjes penale, ose që do të kishte ndikim në besueshmërinë rreth pavarësisë së tij ose saj. Ata nuk angazhohen në asnjë punë tjetër të natyrës profesionale.

6. Kryesia mund të lirojë një Prokuror ose Zëvendësprokuror, me kërkesën e tij ose saj, nga veprimi në një çështje të caktuar.

7. Prokurori dhe Zëvendësprokurori nuk marrin pjesë në asnjë çështje në të cilën paanshmëria e tyre mund të vihet për çdo shkak në dyshim të arsyeshëm. Ata përjashtohen nga rasti, në pajtim me këtë paragraf, nëse, inter alia, kanë qenë të angazhuar më parë në çfarëdo cilësie në atë çështje para Gjykatës, ose në një çështje tjetër penale në shkallë kombëtare që lidhet me personin që tani është në hetime ose ndjekje penale.

8. Çdo çështje lidhur me përjashtimin e Prokurorit ose të Zëvendësprokurorit vendoset nga Dhoma e Ankesave.

(a) Personi që është në hetim ose ndjekje penale në çdo kohë mund të kërkojë përjashtimin e Prokurorit ose Zëvendësprokurorit për shkaqet e parashikuara në këtë nen.

(b) Prokurori ose Zëvendësprokurori, përkatësisht, ka të drejtë të paraqesë komentet e tij ose saj në lidhje me çështjen.

9. Prokurori duhet të caktojë këshilltarë me përvojë ligjore në çështjet specifike, përfshirë këtu, por jo të kufizuara në, dhunën seksuale dhe gjinore, si dhe dhunën ndaj fëmijëve.

Neni 43
Sekretaria

1. Sekretaria është përgjegjëse për aspektet jogjyqësore të administrimit dhe shërbimit në Gjykatë, duke mos paragjykuar funksionet dhe kompetencat e Prokurorit në pajtim me nenin 42.

2. Sekretaria drejtohet nga Referenti, i cili është zyrtari kryesor administrativ i Gjykatës. Referenti i ushtron funksionet e tij ose saj, nën autoritetin e Kryetarit të Gjykatës.

3. Referenti dhe Zëvendësreferenti janë persona me karakter të lartë moral, shumë të kualifikuar dhe duhet të kenë njohuri të shkëlqyeshme dhe të flasin rrjedhshëm të paktën njërën nga gjuhët e punës në Gjykatë.

4. Gjyqtarët e zgjedhin Referentin me shumicë absolute, përmes votimit të fshehtë, duke marrë parasysh çdo rekomandim të bërë nga Asambleja e Shteteve Palë. Nëse paraqitet nevoja, me rekomandim të Referentit, gjyqtarët zgjedhin, në të njëjtën mënyrë, një Zëvendësreferent.

5. Referenti punon në periudhën kohore prej pesë vjetësh, ka një herë të drejtën e rizgjedhjes dhe punon me orar të plotë. Zëvendësreferenti punon për një periudhë kohore prej pesë vjetësh, ose për ndonjë afat më të shkurtër, sic vendoset nga ana e shumicës absolute të gjyqtarëve, dhe mund të zgjidhet duke u bazuar në atë që Zëvendësreferenti thirret në shërbim sipas nevojës.

6. Referenti ngre pranë Sekretarisë Njësinë e Viktimave dhe Dëshmitarëve. Kjo Njësi cakton, në këshillim me Zyrën e Prokurorit, masa mbrojtëse dhe marrëveshje sigurie, këshillime dhe ndihmë tjetër të përshtatshme për dëshmitarët, viktimat që paraqiten para Gjykatës, si dhe të tjerët që janë në rrezik për shkak të dëshmive të dhëna nga dëshmitarët e tillë. Njësia ka personel me përvojë në trauma, përfshirë këtu traumat në lidhje me krimet e dhunës seksuale.

Neni 44
Personeli

1. Prokurori dhe Referenti emërojnë personel me kualifikimin që duhet për nevojat e zyrave të tyre. Në rastin e Prokurorit, kjo do të përfshijë edhe caktimin e hetuesve.

2. Në punësimin e personelit, Prokurori dhe Referenti sigurojnë standardet më të larta të efikasitetit, kompetencës e integritetit dhe respektojnë, mutatis mutandis, kriteret e dhëna në nenin 36, paragrafi 8.

3. Referenti, mbi bazën e marrëveshjes së Kryesisë dhe të Prokurorit, propozon Rregulloren e Personelit, që përfshin afatet dhe kushtet në të cilat personeli i Gjykatës emërohet, shpërblehet dhe shkarkohet nga puna. Rregulloret e Personelit aprovohen nga ana e Asamblesë së Shteteve Palë.

4. Gjykata, në raste të veçanta, mund të shfrytëzojë përvojën e personelit pa pagesë të ofruar nga Shtetet Palë, organizatat ndërqeveritare ose ato jo qeveritare, që do ndihmonin në punën e cilitdo nga organet e Gjykatës. Prokurori mund të pranojë çdo ofertë të tillë në emër të Zyrës së Prokurorit. Personeli i tillë pa pagesë punësohet në pajtim me udhëzimet që përpilohen nga ana e Asamblesë së Shteteve Palë.

Neni 45
Betimi solemn

Para marrjes së detyrave të tyre sipas këtij Statuti,Gjyqtarët,Prokurori, Zëvendësprokurorët, Referenti dhe Zëvendësreferenti bëjnë betimin solemn në sallë me dyer të hapura se do të ushtrojë funksionin e tij ose saj me paanshmëri dhe ndërgjegje të plotë.

Neni 46
Largimi nga detyra

1. Gjyqtari, Prokurori, Zëvendësprokurori, Referenti ose Zëvendësreferenti largohen nga zyra nëse merret vendimi në pajtim me paragrafin 2, në rastet kur ai person:

(a) vërtetohet se ka bërë sjellje seriozisht të keqe ose ka thyer seriozisht detyrat e tij ose saj sipas këtij Statuti, ashtu si është caktuar në Rregullat e Procedurës dhe Provave; ose

(b) nuk është i aftë të ushtrojë funksionet ashtu si kërkohet nga ky Statut.

2. Vendimi lidhur me largimin nga zyra e Gjyqtarit, Prokurorit ose Zëvendësprokurorit sipas paragrafit 1, merret nga Asambleja e Shteteve Palë, nëpërmjet votimit të fshehtë:

(a) Në rast se kemi të bëjmë me gjyqtar, me shumicën e dy të tretave të Shteteve Palë me rekomandimin e miratuar nga shumica prej dy të tretave e gjyqtarëve të tjerë.

(b) Në rast se kemi të bëjmë me Prokuror, nga shumica absolute e Shteteve Palë.

(c) Në rast se kemi të bëjmë me Zëvendësprokuror, nga shumica absolute e Shteteve Palë, me rekomandimin e Prokurorit.

3. Vendimi në lidhje me largimin nga detyra të Referentit ose Zëvendësreferentit merret nga shumica absolute e gjyqtarëve.

4. Gjyqtari, Prokurori, Zëvendësprokurori, Referenti ose Zëvendësreferenti, sjellja ose aftësia e të cilëve për të ushtruar funksionet e zyrës ashtu si kërkohet nga ky Statut kundërshtohet sipas këtij neni, kanë mundësinë e plotë për të paraqitur dhe pranuar prova, si dhe për të bërë parashtrime në pajtim me Rregullat e Procedurës e Provave. Personi në fjalë nuk merr pjesë në ndonjë mënyrë tjetër në shqyrtimin e çështjes.

Neni 47
Masat disiplinore

Gjyqtari, Prokurori, Zëvendësprokurori, Referenti ose Zëvendësreferenti që ka bërë sjellje të keqe të natyrës më pak serioze se ajo e përmendur në nenin 46, paragrafi 1, i nënshtrohet masave disiplinore, në pajtim me Rregullat e Procedurës dhe Provave.

Neni 48
Privilegjet dhe imunitetet

1. Gjykata gëzon në territorin e çdo Shteti Palë privilegjet dhe imunitetet e domosdoshme për arritjen e qëllimeve të saj.

2. Gjyqtarët, Prokurori, Zëvendësprokurorët dhe Referenti, kur angazhohen me punët e Gjykatës, gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e njëjta me ato që u janë dhënë drejtuesve të misioneve diplomatike dhe, pas përfundimit të mandatit të tyre, vazhdojnë të kenë imunitet nga proceset gjyqësore të çfarëdo lloji, në lidhje me fjalët e thëna ose të shkruara dhe veprimet e kryera nga ata në cilësinë e tyre zyrtare.

3. Zëvëndësreferenti, personeli i Zyrës së Prokurorit dhe personeli i Sekretarisë gëzojnë privilegjet dhe imunitetet, si dhe mjetet e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të tyre, në pajtim me marrëveshjen mbi privilegjet dhe imunitetet e Gjykatës.

4. Këshilltarit, ekspertëve, dëshmitarëve ose cilitdo personi tjetër nga të cilët kërkohet të jenë të pranishëm në Gjykatë, u ofrohet trajtim i tillë që është i domosdoshëm për funksionimin e

duhur të Gjykatës, në pajtim me marrëveshjen mbi privilegjet dhe imunitetet e Gjykatës.

5. Privilegjet dhe imunitetet e:

(a) Gjyqtarit ose Prokurorit mund të hiqen me anë të shumicës absolute të gjyqtarëve;

(b) Referentit mund të hiqen nga ana e Kryesisë;

(c) Zëvendësprokurorëve dhe personelit të Zyrës së Prokurorit mund të hiqen nga Prokurori;

(d) Zëvendësreferentit dhe personelit të Sekretarisë mund të hiqen nga Referenti.

Neni 49

Pagat, ndihmat financiare dhe shpenzimet

Gjyqtarët, Prokurori, Zëvendësprokurorët, Referenti dhe Zëvendësreferenti marrin paga të tilla, ndihma financiare dhe mjete për shpenzime në bazë të vendimit të marrë nga ana e Asamblesë së Shteteve Palë. Këto paga dhe kompensime nuk reduktohen gjatë kohës sa ata punojnë.

Neni 50

Gjuhët zyrtare në punë

1. Gjuhët zyrtare të Gjykatës janë: arabishtja, kinesçja, anglishtja, frëngjishtja, rusishtja dhe spanjishtja. Vendimet përfundimtare të Gjykatës, si dhe të gjitha vendimet e tjera me të cilat zgjidhen çështje me rëndësi themelore në Gjykatë, botohen në gjuhët zyrtare. Kryesia, në pajtim me kriteret e themeluara në Rregullat e Procedurës dhe Provave, përcakton se cilat vendime mund të konsiderohen se zgjidhin çështje themelore për qëllimet e këtij paragrafi.

2. Gjuhët e punës të Gjykatës janë anglishtja dhe frëngjishtja. Rregullat e Procedurës dhe Provave përcaktojnë rastet në të cilat gjuhët e tjera zyrtare mund të përdoren si gjuhë pune.

3. Me kërkesën e një pale në gjykim ose të Shtetit të cilit i është lejuar të ndërhyjë në gjykim, Gjykata autorizon përdorimin e një gjuhe tjetër përveç asaj angleze e frënge e që shfrytëzohet nga Pala ose Shteti i tillë, me kusht që Gjykata mendon se ky autorizim është i justifikuar në masën e duhur.

Neni 5l

Rregullat e Procedurës dhe Provave

1. Rregullat e Procedurës dhe Dëshmive hyjnë në fuqi pas miratimit nga ana e shumicës së dy të tretave të anëtarëve të Asamblesë së Shteteve Palë.

2. Amendamentet për Rregullat e Procedurës dhe Provave mund të propozohen nga:

(a) çdo Shtet Palë;

(b) gjyqtarët nëpërmjet një shumice absolute; ose

(c) Prokurori.

Këto amendamente hyjnë në fuqi pas miratimit nga një shumicë prej dy të tretat e anëtarëve të Asamblesë së Shteteve Palë.

3. Pas miratimit të Rregullave të Procedurës dhe Provave, në rastet urgjente kur Rregullat nuk ofrojnë zgjidhje për një situatë specifike para Gjykatës, gjyqtarët, me shumicën e dy të tretave, mund të përpilojnë Rregullat e përkohshme, të cilat zbatohen deri në miratimin, ndryshimin ose refuzimin e tyre në sesionin e ardhshëm të zakonshëm ose të jashtëzakonshëm të Asamblesë së Shteteve Palë.

4. Rregullat e Procedurës dhe Provave, amendamentet e tyre dhe çdo Rregull i përkohshëm është në pajtim me këtë Statut. Amendamentet në Rregullat e Procedurës dhe Provave, gjithashtu edhe Rregullat e përkohshme, nuk kanë fuqi prapavepruese në dëm të personit i cili është në hetim, në ndjekje penale, ose që është dënuar.

5. Në rast konflikti ndërmjet Statutit dhe Rregullave të Procedurës dhe Provave, Statuti ka prioritet.

Neni 52
Rregulloret e Gjykatës

1. Gjyqtarët, në pajtim me këtë Statut dhe Rregullat e Procedurës dhe Provave, miratojnë, me shumicë absolute, Rregulloret e Gjykatës, të domosdoshme për funksionimin e saj të përditshëm.

2. Prokurori dhe Regjistruesi këshillohen rreth përpilimit të Rregulloreve dhe çdo amendamenti të tyre.

3. Rregulloret dhe çdo amendament i tyre hyjnë në fuqi menjëherë pas aprovimit, përveçse kur vendoset ndryshe nga ana e gjyqtarëve. Menjëherë pas aprovimit, ato u shpërndahen Shteteve Palë për komente. Nëse brenda gjashtë muajsh nuk ka ndonjë vërejtje nga ana e shumicës së Shteteve Palë, ato do të mbeten në fuqi.

PJESA 5
HETIMI DHE NDJEKJA PENALE

Neni 53
Fillimi i hetimeve

1. Prokurori, pasi vlerëson informacionin e ofruar për të, fillon hetimin, përveçse kur ai ose ajo përcakton se nuk ka baza të arsyeshme për veprim të mëtejshëm sipas këtij Statuti. Në marrjen e vendimit për fillimin e hetimit, Prokurori merr parasysh nëse:

(a) informacioni i ofruar Prokurorit ofron shkaqe të arsyeshme për të besuar se krimi brenda juridiksionit të gjykatës është kryer ose është duke u kryer;

(b) rasti është ose do të jetë i pranueshëm sipas nenit 17; dhe

(c) duke marrë parasysh peshën e krimit dhe interesat e viktimave, ekzistojnë arsye thelbësore për të besuar se hetimi nuk do t'u shërbente interesave të drejtësisë.

Nëse Prokurori përcakton se nuk ka baza të arsyeshme për të vepruar dhe vendimi i tij ose saj është i mbështetur vetëm në nënparagrafin (c) të mësipërm, ai ose ajo informon Dhomën e Procedurës Paraprake.

2. Nëse pas hetimit Prokurori nxjerr përfundimin se nuk ka baza të mjaftueshme për ndjekje penale, për arsye se:

(a) nuk ekziston bazë e mjaftueshme ligjore ose faktike për të kërkuar urdhër-arrestin ose fletëthirrje sipas nenit 58;

(b) rasti nuk është i pranueshëm sipas nenit 17; ose

(c) ndjekja penale nuk është në interes të drejtësisë, duke patur parasysh të gjitha rrethanat, përfshirë këtu edhe peshën e krimit, interesat e viktimave dhe moshën ose dobësinë e personit të prezumuar dhe rolin e tij ose saj në krimin e menduar.

Prokurori informon Dhomën e Procedurës Paraprake dhe Shtetin që bën rekomandimin sipas nenit 14 ose Këshillin e Sigurimit për një çështje sipas nenit 13, paragrafi (b), në lidhje me përfundimet e tij ose saj dhe arsyet për këtë përfundim.

3. (a) Me kërkesë të Shtetit që bën rekomandimin sipas nenit 14 ose të Këshillit të Sigurimit sipas nenit 13, paragrafi (b), Dhoma e Procedurës Paraprake mund të rishqyrtojë vendimin e Prokurorit sipas paragrafit 1 ose 2 për të mos vepruar dhe mund të kërkojë nga Prokurori që të shqyrtojë edhe një herë atë vendim.

(b) Po kështu, Dhoma e Procedurës Paraprake, me iniciativë të saj, mund të rishqyrtojë vendimin e Prokurorit për të mos vepruar nëse ai është mbështetur vetëm në paragrafin 1 (c) ose 2 (c). Në një rast të tillë, vendimi i Prokurorit mbetet në fuqi vetëm nëse konfirmohet nga ana e Dhomës së Procedurës Paraprake.

4. Prokurori, në çdo kohë, mund ta rishqyrtojë vendimin në lidhje me fillimin e hetimit ose ndjekjes penale, bazuar në faktet ose informacione të reja.

Neni 54

Përgjegjësitë dhe fuqitë e Prokurorit në lidhje me hetimet

1. Prokurori:

(a) në mënyrë që të zbulojë të vërtetën, i zgjeron hetimet për të mbuluar të gjitha faktet dhe provat përkatëse për të vlerësuar se a ekziston përgjegjësia penale sipas këtij Statuti dhe, duke bërë këtë, heton rrethanat inkriminuese dhe ato shfajësuese në mënyrë të barabartë;

(b) merr masat e duhura për të siguruar hetimin efektiv dhe ndjekjen e krimeve brenda juridiksionit të Gjykatës dhe, duke bërë këtë, respekton interesat dhe rrethanat personale të viktimave dhe dëshmitarëve, përfshirë moshën, gjininë, ashtu siç është përkufizuar në nenin 7, paragrafi 3, dhe shëndetin, dhe të marrë parasysh natyrën e krimit, sidomos kur përfshin dhunën seksuale, dhunën gjinore ose dhunën e drejtuar ndaj fëmijëve; dhe

(c) respekton plotësisht të drejtat e personave që rrjedhin nga ky Statut.

2. Prokurori mund të zhvillojë hetime në territorin e një Shteti:

(a) në pajtim me dispozitat e Pjesës 9; ose

(b) sipas autorizimit nga Dhoma e Procedurës Paraprake sipas nenit 57, paragrafi 3 (d).

3. Prokurori mund:

(a) të mbledhë dhe të ekzaminojë provat;

(b) të kërkojë praninë dhe marrjen në pyetje të personave që janë në hetim, viktimave dhe dëshmitarëve;

(c) të kërkojë bashkëpunimin e çdo Shteti ose organizate ndërqeveritare, ose marrëveshjen në pajtim me kompetencën dhe/ose mandatin e tij;

(d) të bëjë rregullime dhe të hyjë në marrëveshje që të mos jenë në kundërshtim me këtë Statut, siç mund të jetë e nevojshme për të mundësuar bashkëpunimin e një Shteti, organizate ndërqeveritare ose personi;

(e) të bjerë dakord që të mos zbulojë, në cilëndo fazë të procedurës, dokumentet ose informacionin të cilin Prokurori e siguron me kushtin e besueshmërisë dhe me qëllimin e vetëm që të gjejë prova të reja, kur ofruesi i informatës nuk e jep pëlqimin; dhe

(f) të ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme ose të kërkojë që të ndërmerren të gjitha masat e domosdoshme, për të siguruar besueshmërinë e informacionit, mbrojtjen e çdo personi ose ruajtjen e provave.

Neni 55

Të drejtat e personave gjatë hetimeve

1. Në lidhje me hetimet sipas këtij Statuti, personi:

(a) nuk do të detyrohet të inkriminojë veten e tij ose saj ose të pranojë fajin;

(b) nuk i nënshtrohet asnjë forme detyrimi, shtrëngimi, kërcënimi, torture apo çfarëdo forme të trajtimit ose dënimit të vrazhdë, çnjerëzor ose degradues;

(c) kur merret në pyetje në një gjuhë tjetër nga gjuha të cilën personi e kupton dhe flet plotësisht, ai ka, pa pagesë, ndihmën e përkthyesit kompetent dhe përkthime të tilla që janë të domosdoshme për të plotësuar kërkesat e drejtësisë;

(d) nuk i nënshtrohet arrestimit ose ndalimit arbitrar, dhe nuk do të privohet nga liria e tij ose saj, përveçse për ato shkaqe dhe sipas atyre procedurave që janë parashikuar në këtë Statut.

2. Kur ekzistojnë shkaqe për të besuar se personi ka kryer një krim brenda juridiksionit të Gjykatës dhe kur ai person merret në pyetje nga Prokurori, ose nga autoritetet kombëtare, sipas kërkesës së bërë në Pjesën 9, ai person po ashtu ka të drejtat që pasojnë dhe për të cilat ai/ajo ose është i informuar para se të merret në pyetje:

(a) të jetë i informuar, para se të merret në pyetje, se ekzistojnë shkaqe për të besuar se ai ose ajo ka kryer një krim brenda juridiksionit të Gjykatës;

(b) të heshtë, dhe kjo heshtje të mos merret në konsideratë për përcaktimin e fajit ose pafajësisë;

(c) të ketë ndihmë juridike sipas zgjedhjes së vetë personit ose, nëse personi nuk ka ndihmë juridike, t'i caktohet ndihmë juridike, në çdo rast kur interesat e drejtësisë e kërkojnë një gjë të tillë, dhe pa pagesë nga personi, në çdo rast të tillë kur ai person nuk ka mjete të mjaftueshme për të paguar atë; dhe

(d) të merret në pyetje në praninë e avokatit, përveçse kur personi ka hequr dorë vullnetarisht nga e drejta e tij ose saj për avokat.

Neni 56

Roli i Dhomës së Procedurës Paraprake në lidhje me mundësinë e vetme hetimore

1. (a) Kur Prokurori mendon që hetimi paraqet mundësinë e vetme për të marrë dëshminë ose deklaratën nga dëshmitari ose për të ekzaminuar, mbledhur a testuar provat, të cilat më vonë mund të mos jenë në dispozicion për qëllimet e gjykimit, Prokurori informon Dhomën e Procedurës Paraprake.

(b) Në atë rast, Dhoma e Procedurës Paraprake, sipas kërkesës së Prokurorit, mund të ndërmarrë masa të tilla që mund të jenë të domosdoshme për të siguruar efikasitetin dhe integritetin e procedurës dhe, në veçanti, për të mbrojtur të drejtat e mbrojtjes.

(c) Nëse Dhoma e Procedurës Paraprake nuk urdhëron ndryshe, Prokurori duhet t'i ofrojë informacionin përkatës personit të arrestuar ose që i është përgjigjur thirrjes në lidhje me hetimin e përmendur në nënparagrafin (a), në mënyrë që ai ose ajo të dëgjohet në lidhje me çështjen.

2. Masat e përmendura në paragrafin 1 (b) mund të përfshijnë:

(a) dhënien e rekomandimeve ose urdhrave në lidhje me procedurat që do të ndiqen;

(b) udhëzimin që të mbahet procesverbali i gjykimit;

(c) emërimin e një eksperti për të asistuar;

(d) autorizimin e avokatit për personin e arrestuar, ose që është paraqitur para Gjykatës si përgjigje në thirrjen e bërë, që të marrë pjesë, ose kur ende nuk është bërë arrestimi ose paraqitja, ose avokati ende nuk është caktuar, emërimin e një avokati tjetër për të marrë pjesë dhe përfaqësuar interesat e mbrojtjes;

(e) emërimin e njërit prej anëtarëve të saj, ose, nëse është e domosdoshme, një gjyqtari tjetër të lirë të Dhomës së Procedurës Paraprake ose të Divizionit të Gjykimit për të mbikëqyrur dhe dhënë rekomandime ose urdhra në lidhje me mbledhjen dhe ruajtjen e provave dhe marrjen në pyetje të personave;

(f) ndërmarrjen e çfarëdo veprimi tjetër që mund të jetë i domosdoshëm për mbledhjen dhe ruajtjen e provave.

3. (a) Kur Prokurori nuk ka ndërmarrë masat në pajtim me këtë nen, por Dhoma e Procedurës Paraprake konsideron që masat e tilla kërkohen për të ruajtur provat të cilat beson se do të ishin thelbësore për mbrojtjen gjatë gjykimit, ajo do të këshillohet me Prokurorin nëse ka arsye të mjaftueshme për Prokurorin që nuk ka kërkuar ndërmarrjen e këtyre masave. Nëse pas këshillimit Dhoma e Procedurës Paraprake nxjerr përfundimin se moskërkimi nga Prokurori i ndërmarrjes së masave të tilla është i paarsyetueshëm, Dhoma e Procedurës Paraprake mund të ndërmarrë masat e tilla me iniciativë të saj.

(b) Prokurori mund të bëjë ankesë ndaj vendimit të Dhomës së Procedurës Paraprake për të vepruar me iniciativë të saj, sipas këtij paragrafi. Ankesa dëgjohet në mënyrë të përshpejtuar.

4. Pranueshmëria e provave të ruajtura ose të mbledhura për gjykim në pajtim me këtë nen, si dhe procesverbali, rregullohet gjatë gjykimit nga neni 69 dhe ka atë peshë që përcaktohet nga Dhoma e Gjykimit.

Neni 57

Funksionet dhe fuqitë e Dhomës së Procedurës Paraprake

1. Përveç kur është përcaktuar ndryshe në këtë Statut, Dhoma e Procedurës Paraprake i ushtron funksionet e saj në pajtim me dispozitat e këtij neni.

2. (a) Urdhrat ose vendimet e Dhomës së Procedurës Paraprake të lëshuara sipas neneve 15. 18, 19, 54, paragrafët 2, 61, paragrafi 7 dhe 72 duhet të përpilohen njëkohësisht nga shumica e gjyqtarëve të saj.

(b) Në të gjitha rastet e tjera, gjyqtari i vetëm i Dhomës së Procedurës Paraprake mund të ushtrojë funksionet e ofruara në këtë Statut, përveçse nëse është caktuar ndryshe në Rregullat e Procedurës dhe Provave ose nga shumica e Dhomës së Procedurës Paraprake.

3. Përveç funksioneve të tjera sipas këtij Statuti, Dhoma e Procedurës Paraprake mund:

(a) me kërkesë të Prokurorit, të lëshojë urdhra dhe urdhër-arreste që mund të kërkohen për qëllimet e hetimeve;

(b) sipas kërkesës së personit të arrestuar ose që është paraqitur në pajtim me thirrjen sipas nenit 58, të lëshojë urdhra të tilla, përfshirë këtu edhe masat e përshkruara në nenin 56, ose të kërkojë një bashkëpunim të tillë në pajtim me Pjesën 9, nëse do të jetë e domosdoshme për të ndihmuar personin në përgatitjen e mbrojtjes së tij ose saj;

(c) kur është e domosdoshme, të mundësojë mbrojtjen dhe fshehtësinë e viktimave e dëshmitarëve, ruajtjen e provave, mbrojtjen e personave të arrestuar ose atyre që i janë përgjigjur thirrjes së bërë, si dhe ruajtjen e informacioneve të sigurisë kombëtare;

(d) të autorizojë Prokurorin në marrjen e hapave specifikë hetues brenda territorit të Shtetit Palë pa siguruar bashkëpunimin e atij Shteti sipas Pjesës 9, nëse, mundësisht, duke patur parasysh qëndrimet e Shtetit në fjalë, Dhoma e Procedurës Paraprake përcakton në atë rast se Shteti në mënyrë të qartë nuk ka mundësi të ekzekutojë kërkesën për bashkëpunim për shkak të pamundësisë së cilitdo autoriteti ose ndonjë komponenti të sistemit të tij gjyqësor për të përmbushur kërkesën për bashkëpunim sipas Pjesës 9.

(e) kur urdhër-arresti ose fletëthirrja është lëshuar sipas nenit 58, dhe duke pasur gjithnjë kujdes për fuqinë e provave dhe për të drejtat e palëve, ashtu siç është parashikuar në këtë Statut dhe në Rregullat e Procedurës dhe Provave, të kërkojë bashkëpunimin e Shteteve në pajtim me nenin 93, paragrafi 1 (j), të marrë masat mbrojtëse në lidhje me humbjet, sidomos për interesin e lartë të viktimave.

Neni 58

Lëshimi nga Dhoma e Procedurës Paraprake i urdhër-arrestit ose fletëthirrjes

1. Në çdo kohë pas fillimit të hetimeve, Dhoma e Procedurës Paraprake, me kërkesë të Prokurorit, lëshon urdhër-arrestin për personin, nëse, pas shqyrtimit të kërkesës dhe provave ose ndonjë informacioni tjetër të dorëzuar nga Prokurori, plotësohen këto kushte:

(a) ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për të besuar se ai person ka kryer krimin brenda juridiksionit të Gjykatës; dhe

(b) arrestimi i personit paraqitet si i nevojshëm:

(i) për të siguruar paraqitjen e personit në gjykim;

(ii) për të siguruar se personi nuk do të pengojë ose rrezikojë hetimet ose procedurën gjyqësore, ose

(iii) kur është e zbatueshme, për të ndaluar personin nga vazhdimi i kryerjes së atij krimi ose krimit të ngjashëm që është brenda juridiksionit të Gjykatës dhe që del nga rrethanat e njëjta.

2. Kërkesa e Prokurorit përmban:

(a) emrin e personit dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm për identifikim;

(b) një referim specifik për krimet brenda juridiksionit të Gjykatës e të cilat mendohet se i ka kryer personi në fjalë;

(c) një deklaratë të shkurtër mbi faktet të cilat mendohet se paraqesin krimin;

(d) një përmbledhje të provave dhe çdo informacion tjetër që përbën shkak të arsyeshëm për të besuar se ai person ka kryer ato krime; dhe

(e) arsyen pse Prokurori beson që arrestimi i personit është i nevojshëm.

3. Urdhër-arresti përmban:

(a) emrin e personit dhe çdo informacion tjetër të rëndësishëm për identifikimin e tij;

(b) një referencë të veçantë për krimet brenda juridiksionit të Gjykatës për të cilat kërkohet arrestimi i personit; dhe

(c) një deklaratë të shkurtër mbi faktet për të cilat prezumohet se i paraqesin ato krime.

4. Fletë-arresti mbetet në fuqi derisa të urdhërohet ndryshe nga Gjykata.

5. Në bazë të urdhrit për arrest, Gjykata mund të kërkojë arrestimin e përkohshëm ose arrestimin dhe dorëzimin e personit sipas Pjesës 9.

6. Prokurori mund të kërkojë nga Dhoma e Procedurës Paraprake të ndryshojë urdhrin për arrest, duke ndryshuar ose shtuar krimet e përcaktuara në të. Dhoma e Procedurës Paraprake ndryshon urdhër-arrestin nëse ka bindjen se ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për të besuar se personi ka kryer krimet e ndryshuara ose ato shtesë.

7. Si alternativë për kërkimin e urdhër-arrestit, Prokurori mund të dorëzojë një kërkesë ku të kërkojë që Dhoma e Procedurës Paraprake të lëshojë fletëthirrjen që personi të paraqitet. Nëse Dhoma e Procedurës Paraprake ka bindjen se ekzistojnë baza të arsyeshme për të besuar se personi ka kryer krimin e pohuar dhe se thirrja është e mjaftueshme për të siguruar paraqitjen e personit, ajo lëshon fletëthirrjen, me ose pa kushtet të cilat e kufizojnë lirinë (në dallim nga ndalimi), nëse kjo parashikohet nga ligji kombëtar, që personi të paraqitet në gjyq. Fletëthirrja përmban:

(a) emrin e personit dhe çdo informacion tjetër të rëndësishëm për identifikimin e tij;

(b) datën kur duhet të paraqitet personi;

(c) një referim të veçantë rreth krimeve brenda juridiksionit të Gjykatës, e për të cilat pohohet se i ka kryer personi në fjalë; dhe

(d) një deklaratë të shkurtër mbi faktet për të cilat prezumohet se paraqesin krimin.

Thirrja i dorëzohet vetë personit.

Neni 59

Procedura e arrestimit në Shtetin që ka të drejtën e ndalimit

1. Shteti Palë që ka marrë kërkesën për arrest të përkohshëm ose për arrest dhe dorëzim, duhet që menjëherë të ndërmarrë masa për të arrestuar personin në fjalë në pajtim me ligjet e tij dhe dispozitat e Pjesës 9.

2. Personi i arrestuar sillet pa vonesë para organit gjyqësor kompetent në Shtetin që bën ndalimin, i cili përcakton, në pajtim me ligjet e atij Shteti, se:

(a) urdhri për arrest është i zbatueshëm ndaj atij personi;

(b) personi është arrestuar në përputhje me procedurat e rregullta; dhe

(c) të drejtat e personit janë respektuar.

3. Personi i arrestuar ka të drejtë të kërkojë nga organi kompetent në Shtetin që ka të drejtën e ndalimit lirimin e përkohshëm në pritje të dorëzimit.

4. Në marrjen e çfarëdo vendimi në lidhje me një kërkesë të tillë, organi kompetent në Shtetin që ka të drejtën e ndalimit merr në shqyrtim nëse, duke marrë parasysh peshën e krimeve të pohuara, ekzistojnë rrethanat urgjente dhe të veçanta që arsyetojnë lirimin e përkohshëm dhe nëse ekzistojnë masat e sigurisë të domosdoshme për të siguruar që Shteti që ka të drejtën e ndalimit mund të plotësojë detyrimin e tij për të dorëzuar personin në Gjykatë. Nuk është e hapur për organin kompetent të Shtetit që ka të drejtën e ndalimit të shqyrtojë, nëse urdhri i arrestit është lëshuar në mënyrë të drejtë në pajtim me nenin 58, paragrafi 1 (a) dhe (b).

5. Dhoma e Procedurës Paraprake lajmërohet rreth çdo kërkese për lirim të përkohshëm dhe kjo jep rekomandime për organin kompetent të Shtetit që ka të drejtën e ndalimit. Organi kompetent në këtë Shtet merr plotësisht parasysh rekomandimet e tilla, përfshirë këtu rekomandimet mbi masat për parandalimin e ikjes së personit, para marrjes së vendimit.

6. Nëse personi lirohet përkohësisht, Dhoma e Procedurës Paraprake mund të kërkojë raporte periodike rreth statusit të lirimit të përkohshëm.

7. Sapo të jetë urdhëruar dorëzimi nga Shteti që ka të drejtën e ndalimit, personi dorëzohet në Gjykatë sa më parë që të jetë e mundur.

Neni 60
Procedura fillestare para Gjykatës

1. Me rastin e dorëzimit të personit në Gjykatë, ose paraqitjes së personit para Gjykatës në mënyrë vullnetare ose sipas fletëthirrjes, Dhoma e Procedurës Paraprake krijon bindje nëse personi është informuar për krimet të cilat ai ose ajo pohohet se i ka kryer, dhe për të drejtat e tij ose saj sipas këtij Statuti, përfshirë edhe të drejtën për të kërkuar lirimin e përkohshëm në pritje të mbajtjes së gjykimit.

2. Personi për të cilin lëshohet urdhri për arrest mund të kërkojë lirimin e përkohshëm derisa të vendoset për gjykimin. Nëse Dhoma e Procedurës Paraprake është e mendimit se plotësohen kushtet e parashikuara në nenin 58, paragrafi I, personi vazhdon të mbahet i ndaluar. Nëse nuk e ka këtë mendim, Dhoma e Procedurës Paraprake liron personin, me ose pa kushte.

3. Dhoma e Procedurës Paraprake rishqyrton në mënyrë periodike vendimin e saj për lirimin ose ndalimin e personit, dhe mund ta bëjë këtë në çdo kohë me kërkesë të Prokurorit ose personit. Me rastin e një rishqyrtimi të tillë, ajo mund të ndryshojë vendimin e saj në lidhje me ndalimin, lirimin ose kushtet e lirimit, nëse është e bindur se rrethanat e ndryshuara e kërkojnë një gjë të tillë.

4. Dhoma e Procedurës Paraprake siguron që personi nuk paraburgoset për një periudhë të paarsyeshme para gjykimit për shkak të shtyrjes së pajustifikueshme të Prokurorit. Nëse ndodh një shtyrje e tillë, Gjykata shqyrton lirimin e personit, me ose pa kushte.

5. Nëse është e domosdoshme, Dhoma e Procedurës Paraprake mund të lëshojë urdhër-arrestin për të siguruar praninë e personit të liruar.

Neni 61
Vërtetimi i akuzave para gjykimit

1. Në bazë të dispozitave të paragrafit 2, brenda një afati kohor të arsyeshëm pas dorëzimit të personit ose paraqitjes së tij vullnetare para Gjykatës, Dhoma e Procedurës Paraprake mban një seancë për të vërtetuar akuzat, në bazë të të cilave Prokurori mendon të kërkojë gjykimin. Dëgjimi mbahet në praninë e Prokurorit dhe personit të akuzuar, gjithashtu edhe në praninë e avokatit të tij ose të saj.

2. Dhoma e Procedurës Paraprake, sipas kërkesës së Prokurorit ose kryesisht, mund ta mbajë seancën në mungesë të personit të akuzuar, për të vërtetuar akuzat në të cilat Prokurori mendon të kërkojë gjykimin, kur personi:

(a) ka hequr dorë nga e drejta e tij ose saj për të marrë pjesë në seancë; ose

(b) është larguar ose nuk mund të gjendet dhe janë ndërmarrë të gjithë hapat e arsyeshëm për të siguruar paraqitjen e tij ose saj para Gjykatës dhe për të informuar personin rreth akuzave, si dhe për atë se do të mbahet seanca për vërtetimin e atyre akuzave.

Në këtë rast, personi përfaqësohet nga avokati, kur Dhoma e Procedurës Paraprake përcakton se kjo është në interes të drejtësisë.

3. Brenda një kohe të arsyeshme para seancës, personi:

(a) merr një kopje të dokumentit që përmban akuzat në të cilat Prokurori mendon të sjellë personin në gjykim; dhe

(b) informohet në lidhje me provat në të cilat Prokurori mendon të mbështetet gjatë seancës.

Dhoma e Procedurës Paraprake mund të lëshojë urdhra që kanë të bëjnë me zbulimin e informacioneve për qëllimet e seancës.

4. Para seancës, Prokurori mund të vazhdojë hetimin dhe mund të ndryshojë ose tërheqë cilëndo akuzë. Personi lajmërohet para seancës në lidhje me çdo ndryshim ose tërheqje të akuzave. Në rast të tërheqjes së akuzave, Prokurori njofton Dhomën e Procedurës Paraprake për arsyet e tërheqjes.

5. Gjatë seancës, Prokurori mbështet secilën akuzë me prova të mjaftueshme, në mënyrë që të krijojë shkaqe thelbësore për të besuar se personi ka kryer krimin për të cilin akuzohet. Prokurori mund të mbështetet në provat me shkrim ose ato përmbledhëse dhe nuk ka nevojë të thërrasë

dëshmitarët të cilët priten të dëshmojnë gjatë gjykimit.

6. Gjatë seancës, personi mund:

(a) të bëjë vërejtje në lidhje me akuzat;

(b) të kundërshtojë provat e ofruara nga Prokurori; dhe

(c) të paraqesë prova.

7. Dhoma e Procedurës Paraprake, në bazë të seancës, vendos nëse ka prova të mjaftueshme për të besuar se personi ka kryer secilin nga krimet për të cilat akuzohet. Në bazë të vendimit të saj, Dhoma e Procedurës Paraprake:

(a) vërteton ato akuza për të cilat ajo ka vendosur se ka prova të mjaftueshme dhe dorëzon personin para Dhomës së Gjykimit për gjykim në lidhje me akuzat e vërtetuara;

(b) nuk bën vërtetimin e atyre akuzave për të cilat ka vendosur se nuk ka prova të mjaftueshme;

(c) shtyn seancën dhe kërkon nga Prokurori të marrë parasysh:

(i) sigurimin e provave të mëtejme ose zhvillimin e hetimeve të tjera në lidhje me akuzën e caktuar; ose

(ii) ndryshimin e akuzës për shkak se prova e ofruar duket se paraqet një krim tjetër brenda juridiksionit të Gjykatës.

8. Kur Dhoma e Procedurës Paraprake nuk bën vërtetimin e akuzës, Prokurori nuk përjashtohet nga e drejta për të kërkuar më vonë vërtetimin e saj, nëse kjo kërkesë e tij mbështetet nga provat plotësuese.

9. Pas vërtetimit të akuzave dhe para se gjykimi të ketë filluar, Prokurori, me lejen e Dhomës së Procedurës Paraprake dhe pas njoftimit të të akuzuarit, mund të ndryshojë akuzat. Nëse Prokurori kërkon të shtojë akuza plotësuese ose t'i zëvendësojë ato me akuza më të rënda, duhet të mbahet seanca sipas këtij neni për të vërtetuar ato akuza. Pas fillimit të gjykimit, Prokurori mundet që, me lejen e Dhomës së Gjykimit, të tërheqë akuzat.

10. Çdo urdhër-arrest i lëshuar më parë nuk ka më efekt përsa i përket secilës akuzë që nuk është vërtetuar nga ana e Dhomës së Procedurës Paraprake ose që është tërhequr nga ana e Prokurorit.

11. Pasi të jenë vërtetuar akuzat në pajtim me këtë nen, Kryesia themelon Dhomën e Gjykimit, e cila, në përputhje me paragrafin 8 dhe nenin 64, paragrafi 4, është përgjegjëse për zhvillimin e procedurave të mëvonshme dhe mund të ushtrojë cilindo funksion të Dhomës së Procedurës Paraprake që është e nevojshme dhe e mundshme për zbatim në ato procedura.

PJESA 6
GJYKIMI

Neni 62
Vendi i gjykimit

Përveçse kur vendoset ndryshe, vendi i gjykimit është në selinë e Gjykatës.

Neni 63
Gjykimi në praninë e të akuzuarit

1. I akuzuari është i pranishëm gjatë gjykimit.

2. Nëse i akuzuari, duke qenë i pranishëm para Gjykatës, vazhdon të pengojë gjykimin, Dhoma e Gjykimit mund ta largojë të akuzuarin dhe i krijon kushte që të ndjekë gjykimin dhe të këshillojë avokatin jashtë gjykatës, përmes përdorimit të teknologjisë së komunikimit, nëse kjo kërkohet. Masa të tilla ndërmerren vetëm në rrethana të posaçme, pasi të gjitha mundësitë e tjera të arsyeshme të jenë provuar si të papërshtatshme dhe vetëm për kohën e përcaktuar rreptësisht.

Neni 64

Funksionet dhe kompetencat e Dhomës së Gjykimit

1. Funksionet dhe kompetencat e Dhomës së Gjykimit, të parashikuara në këtë nen, ushtrohen në pajtim me këtë Statut dhe Rregullat e Procedurës dhe Provave.

2. Dhoma e Gjykimit siguron që gjykimi të jetë i drejtë e i shpejtë, dhe të zhvillohet me respekt të plotë për të drejtat e të akuzuarit dhe me kujdes të vazhdueshëm për mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve.

3. Me rastin e caktimit të çështjes për gjykim në pajtim me këtë Statut, Dhoma e Gjykimit, e caktuar për të shqyrtuar këtë çështje:

(a) këshillohet me palët dhe miraton procedurat që do të mund të paraqiten si të domosdoshme për të mundësuar zhvillimin e drejtë e të shpejtë të procedurës;

(b) përcakton gjuhën ose gjuhët që do të përdoren në gjykim; dhe

(c) kushtëzuar nga dispozitat e tjera përkatëse të këtij Statuti, mundëson zbulimin e dokumenteve ose informacionit të pazbuluar më herët, në kohë të mjaftueshme para fillimit të gjykimit, për të mundësuar përgatitjet e duhura për gjykim.

4. Dhoma e Gjykimit, nëse është e domosdoshme për funksionimin e saj efektiv e të drejtë, mund t'i kalojë çështjet paraprake te Dhoma e Procedurës Paraprake ose, nëse është e nevojshme, te ndonjë gjyqtar nga Divizioni i Procedurës Paraprake.

5. Pas lajmërimit të Palëve, Dhoma e Gjykimit mund të udhëzojë që të bashkojë ose ndajë akuzat ndaj më shumë se një të akuzuari.

6. Në kryerjen e funksioneve të saj para gjykimit ose gjatë kohës që zhvillohet gjykimi, Dhoma e Gjykimit, nëse është e domosdoshme, mund:

(a) të ushtrojë çdo funksion të Dhomës së Procedurës Paraprake të parashikuar në nenin 61, paragrafi 11;

(b) të kërkojë pjesëmarrjen dhe dhënien e dëshmive nga dëshmitarët dhe paraqitjen e dokumenteve dhe provave të tjera, nëse është e domosdoshme, nëpërmjet ndihmës së Shteteve, ashtu siç është përcaktuar në këtë Statut;

(c) të mundësojë ruajtjen e informacioneve konfidenciale;

(d) të urdhërojë prodhimin e provave të tjera si shtesë për ato që janë mbledhur para gjykimit ose që janë paraqitur të gjatë gjykimit nga ana e Palëve;

(e) të mundësojë mbrojtjen e të akuzuarit, dëshmitarëve dhe viktimave; dhe

(f) të vendosë për çdo çështje tjetër të mundur.

7. Gjykimi mbahet me dyer të hapura. Dhoma e Gjykimit, megjithatë, mund të vendosë që rrethana të caktuara të shqyrtohen në procedurat me sesione të mbyllura për qëllimet e përcaktuara në nenin 68, ose të mbrojë informacionet konfidenciale ose delikate që ofrohen si prova.

8. (a) Në fillim të gjykimit, Dhoma e Gjykimit i lexon të akuzuarit akuzat e vërtetuara më parë nga ana e Dhomës së Procedurës Paraprake. Dhoma e Gjykimit krijon bindje se i akuzuari e kupton natyrën e akuzave. Ajo i ofron atij ose asaj mundësinë për të bërë pranimin e fajit në pajtim me nenin 65, ose për t'u deklaruar si i pafajshëm.

(b) Në gjykim, gjyqtari kryesues mund të japë udhëzime për zhvillimin e gjykimit, për t'u siguruar që ai të zhvillohet në mënyrë të drejtë dhe të paanshme. Bazuar mbi udhëzimet e gjyqtarit kryesues, palët mund të ofrojnë prova në pajtim me dispozitat e këtij Statuti.

9. Dhoma e Gjykimit ka kompetencë, inter alia, sipas kërkesës së një pale ose sipas propozimit të saj:

(a) të vendosë në lidhje me pranueshmërinë ose rëndësinë e provave; dhe

(b) të ndërmarrë të gjithë hapat e domosdoshëm për të mbajtur qetësi gjatë seancës.

10. Dhoma e Gjykimit siguron që procesverbali i plotë i gjykimit, që paraqet në mënyrë të saktë gjykimin e zhvilluar, është bërë dhe mbahet e ruhet nga Referenti.

Neni 65
Procedurat në lidhje me pranimin e fajit

1. Kur i akuzuari pranon fajin në përputhje me nenin 64, paragrafi 8 (a), Dhoma e Gjykimit vendos nëse:

(a) i akuzuari e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit;

(b) pranimi është bërë në mënyrë vullnetare nga i akuzuari, pas këshillimit të mjaftueshëm me avokatin; dhe

(c) pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes e që gjenden në:

(i) akuzat e sjella nga Prokurori dhe të pranuara nga i akuzuari;

(ii) ndonjë material të paraqitur nga Prokurori e që plotëson akuzat dhe të cilat i akuzuari i pranon; dhe

(iii) çfarëdo prove tjetër, siç është dëshmia e dëshmitarëve, paraqitur nga Prokurori ose i akuzuari.

2. Kur Dhoma e Gjykimit krijon bindje që janë vërtetuar çështjet e përmendura në paragrafin 1, ajo merr parasysh pranimin e fajit, bashkë me çfarëdo prove tjetër shtesë të paraqitur e që vërteton të gjitha faktet thelbësore të cilat kërkohen për të vërtetuar krimin me të cilin lidhet pranimi i fajit, dhe mund të dënojë të akuzuarin për atë krim.

3. Kur Dhoma e Gjykimit nuk krijon bindje se janë vërtetuar çështjet e përmendura në paragrafin 1, ajo merr parasysh që pranimi i fajit nuk është bërë dhe, në këtë rast, ajo urdhëron vazhdimin e gjykimit sipas procedurave të rregullta gjyqësore të parashikuara nga ky Statut dhe mund të dorëzojë rastin në një Dhomë tjetër Gjykimi.

4. Kur Dhoma e Gjykimit mendon që për interesat e drejtësisë e sidomos për interesat e viktimave kërkohet një paraqitje e plotë e fakteve të çështjes, ajo mund:

(a) të kërkojë nga Prokurori të paraqesë prova plotësuese, përfshirë këtu edhe dëshmitë e dëshmitarëve; ose

(b) të urdhërojë që gjykimi të vazhdojë sipas procedurave të rregullta të gjykimit të parashikuara nga ky Statut dhe, në një rast si ky, ajo urdhëron vazhdimin e gjykimit sipas procedurave të rregullta gjyqësore të parashikuara nga ky Statut dhe mund ta dorëzojë rastin në një Dhomë tjetër Gjykimi.

5. Çdo diskutim ndërmjet Prokurorit dhe mbrojtjes në lidhje me ndryshimin e akuzave, pranimin e fajit ose dënimin që do të jepet, nuk është detyrues për Gjykatën.

Neni 66
Prezumimi i pafajësisë

1. Çdo person konsiderohet i pafajshëm derisa të deklarohet fajtor para Gjykatës dhe në pajtim me ligjin e zbatueshëm.

2. Barra për vërtetimin e fajit të të akuzuarit i bie Prokurorit.

3. Për të dënuar të akuzuarin, Gjykata duhet të jetë e bindur në fajin e të akuzuarit dhe pa asnjë dyshim të arsyeshëm.

Neni 67
Të drejtat e të akuzuarit

1. Në përcaktimin e çfarëdo akuze, i akuzuari ka të drejtën e gjykimit me dyer të hapura, duke iu referuar dispozitave të këtij Statuti, për një dëgjim të drejtë të zhvilluar në mënyrë të paanshme, dhe për garancionet minimale të mëposhtme, në barazi të plotë:

(a) të njoftohet menjëherë dhe në hollësi rreth natyrës, shkakut dhe përmbajtjes së akuzës, në gjuhën të cilën i akuzuari e kupton dhe flet lirisht;

(b) të ketë kohën dhe mjetet e duhura për përgatitjen e mbrojtjes dhe për të komunikuar lirisht dhe në besim me avokatin të cilin i akuzuari e ka zgjedhur vetë;

(c) të gjykohet pa shtyrje të paarsyeshme;

(d) kushtëzuar nga neni 63, paragrafi 2, të jetë i pranishëm në gjykim, të bëjë mbrojtjen personalisht ose përmes ndihmës juridike sipas zgjedhjes së të akuzuarit, nëse i akuzuari nuk ka ndihmë juridike, të jetë i informuar për këtë të drejtë dhe të ketë ndihmën juridike të caktuar për të nga Gjykata në çdo rast kur interesat e drejtësisë e kërkojnë një gjë të tillë, dhe pa pagesë, në rast se të akuzuarit i mungojnë mjetet e mjaftueshme për të paguar atë;

(e) të ekzaminojë ose të ketë ekzaminuar dëshmitarët kundër tij ose saj dhe të sigurojë praninë dhe ekzaminimin e dëshmitarëve në dobi të tij ose saj nën kushtet e njëjta, si edhe për dëshmitarët kundër tij ose saj. I akuzuari, po ashtu, ka të drejtë të paraqesë mbrojtjen dhe prova të tjera të lejueshme sipas këtij Statuti;

(f) të ketë ndihmën e përkthyesit kompetent falas dhe përkthime të tilla që janë të domosdoshme për të plotësuar kërkesat e drejtësisë, nëse cilado nga procedurat ose dokumentet e paraqitura para Gjykatës nuk janë në gjuhën të cilën i akuzuari e kupton dhe flet lirisht;

(g) të mos detyrohet të dëshmojë ose të pranojë fajin dhe të heshtë, dhe një heshtje e tillë të mos merret në konsideratë gjatë përcaktimit të fajit ose pafajësisë;

(h) të japë deklaratë gojore ose me shkrim në mbrojtje të tij ose saj pa bërë betimin; dhe

(i) të mos i nënshtrohet detyrimit për të vërtetuar pafajësinë e rastit ose barrës për të kundërshtuar provat.

2. Përveç njoftimeve të tjera të parashikuara në këtë Statut, Prokurori i njofton mbrojtjes, sa më parë që të jetë e mundur, provat që i posedon Prokurori ose ka nën kontrollin e tij dhe për të cilat ai ose ajo beson që tregojnë ose kanë tendencën të tregojnë pafajësinë e të akuzuarit, ose të zbusin fajin e të akuzuarit, ose mund të ndikojnë në besueshmërinë e provave të ndjekjes penale. Gjykata vendos në çdo rast dyshimi në lidhje me zbatimin e këtij paragrafi.

Neni 68

Mbrojtja e viktimave dhe dëshmitarëve dhe pjesëmarrja e tyre në gjykim

1. Gjykata ndërmerr të gjitha masat e duhura për të mbrojtur sigurinë, mirëqenien fizike e psikologjike, dinjitetin dhe fshehtësinë e viktimave dhe dëshmitarëve. Gjatë kësaj, Gjykata merr parasysh të gjithë faktorët përkatës, përfshirë këtu moshën, gjininë, ashtu si është parashikuar në nenin 2, paragrafi 3, dhe shëndetin, si dhe natyrën e krimit në veçanti, por jo të kufizuar, në rastin kur krimi përfshin dhunën seksuale ose gjinore ose dhunën ndaj fëmijëve. Prokurori i merr këto masa sidomos gjatë hetimit dhe ndjekjes së krimeve të tilla. Këto masa nuk dëmtojnë dhe janë në pajtim me të drejtat e të akuzuarit dhe me gjykimin e drejtë dhe të paanshëm.

2. Si përjashtim nga rregulli për dëgjimet publike të parashikuara në nenin 67, Dhoma e Gjykimit mund të mbrojë viktimat dhe dëshmitarët ose të akuzuarin, të zhvillojë cilëndo pjesë të procedurës përmes xhirimit me kamerë ose të lejojë paraqitjen e provave nëpërmjet mjeteve elektronike ose mjeteve të tjera speciale. Në veçanti, masa të tilla zbatohen në rastin e viktimës së dhunës seksuale ose fëmijës që është viktimë ose dëshmitar, nëse nuk urdhërohet ndryshe nga Gjykata, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat, në veçanti qëndrimet e viktimës ose dëshmitarit.

3. Kur preken interesat personale të viktimave, Gjykata duhet t'i lejojë ata të paraqesin qëndrimet dhe çështjet e tyre dhe ato të merren në konsideratë në fazat e procedurës që vendosen nga Gjykata dhe në atë mënyrë që nuk dëmtojnë dhe nuk janë në mospajtim me të drejtat e të akuzuarit dhe me gjykimin e drejtë dhe të paaanshëm. Qëndrimet dhe çështjet e tilla mund të paraqiten nga përfaqësuesit ligjorë të viktimave, kur Gjykata i konsideron si të përshtatshme, në pajtim me Rregullat e Procedurës dhe Provave.

4. Njësia e Viktimave dhe Dëshmitarëve mund të këshillojë Prokurorin dhe Gjykatën rreth masave të duhura mbrojtëse, marrëveshjeve të sigurisë, këshillimit dhe ndihmës, ashtu siç parashikohen në nenin 43, paragrafi 6.

5. Kur zbulimi i provave ose informacioneve në përputhje me këtë Statut mund të shkaktojë rrezikimin serioz të sigurisë së dëshmitarit ose familjes së tij ose saj, Prokurori, për qëllimet e çdo gjykimi të zhvilluar para fillimit të gjykimit, mund të mbajë provat ose informatat e tilla dhe në vend

të kësaj të dorëzojë një përmbledhje. Masat e tilla ushtrohen në mënyrën që nuk dëmtojnë dhe nuk janë në kundërshtim me të drejtat e të akuzuarit dhe me gjykimin e drejtë dhe të paanshëm.

6. Shteti mund të bëjë kërkesë që të ndërmerren masat e domosdoshme në lidhje me mbrojtjen e nëpunësve ose agjentëve të tij, si dhe ruajtjen e informacioneve konfidenciale ose delikate.

Neni 69
Provat

1. Para dhënies së dëshmisë, secili dëshmitar, në pajtim me Rregullat e Procedurës dhe Provave, betohet në lidhje me vërtetësinë e dëshmisë së dhënë prej tij.

2. Dëshmia e dëshmitarit në gjykim jepet personalisht, përveçse në masën e parashikuar në nenin 68 ose në Rregullat e Procedurës dhe Provave. Gjykata, po ashtu, mund të lejojë dhënien viva voce (gojore) ose dëshminë e dëshmitarit të regjistruar nëpërmjet mjeteve të videos ose audio teknologjisë, e po ashtu edhe paraqitjen e dokumenteve ose transkripteve me shkrim, në bazë të këtij Statuti dhe në pajtim me Rregullat e Procedurës dhe Provave. Këto masa nuk dëmtojnë dhe nuk janë në mospajtim me të drejtat e të akuzuarit.

3. Palët mund të dorëzojnë prova që lidhen me çështjen, në pajtim me nenin 64. Gjykata është e autorizuar të kërkojë dorëzimin e të gjitha provave të cilat i konsideron të domosdoshme për përcaktimin e së vërtetës.

4. Gjykata mund të vendosë për rëndësinë ose pranueshmërinë e çdo prove, duke marrë parasysh, inter alia, vlerën dëshmuese të provave dhe çdo paragjykim që provat e tilla mund t'i shkaktojnë gjykimit të drejtë ose vlerësimit të drejtë të dëshmisë së dëshmitarit, në pajtim me Rregullat e Procedurës dhe Provave.

5. Gjykata respekton dhe mbikëqyr privilegjet mbi konfidencialitetin dhe në mënyrën që janë parashikuar në Rregullat e Procedurës dhe Dëshmive.

6. Gjykata nuk duhet të kërkojë prova për faktet e njohura botërisht, por mund të marrë shënime gjyqësore për to.

7. Dëshmitë e marra përmes mjeteve që shkelin këtë Statut ose të drejtat e njeriut të pranuara ndërkombëtarisht, nuk janë të pranueshme nëse:

(a) shkelja paraqet dyshim të konsiderueshëm në besueshmërinë e provave; ose

(b) pranimi i provave do të ishte kundër etikës dhe do të dëmtonte seriozisht integritetin e gjykimit.

8. Kur merret vendim për rëndësinë ose pranueshmërinë e provave të mbledhura nga Shteti, Gjykata nuk merr vendim për zbatimin e ligjit kombëtar të atij Shteti.

Neni 70
Veprat kundër administrimit së drejtësisë

1. Gjykata ka juridiksion mbi veprat e mëposhtme që janë kundër administrimit të drejtësisë dhe kur janë kryer me qëllim:

(a) dhënia e dëshmive false kur është detyrimi për të thënë të vërtetën në përputhje me nenin 69, paragrafi 1;

(b) paraqitja e provës për të cilën pala e di se është false;

(c) ndikimi në dëshmitarin duke e korruptuar atë, pengimi ose ndërhyrja në pjesëmarrjen ose dëshminë e dëshmitarit, hakmarrja ndaj dëshmitarit për shkak të dhënies së dëshmisë ose shkatërrimi, ndikimi ose ndërhyrja në mbledhjen e provave;

(d) pengimi, shqetësimi ose korruptimi i nëpunësit të Gjykatës me qëllim të detyrimit ose bindjes së tij për të mos kryer, ose për të kryer në mënyrë të gabuar, detyrat e tij ose saj;

(e) hakmarrja ndaj nëpunësit të Gjykatës në lidhje me detyrat e ushtruara nga ai ose ndonjë zyrtar tjetër;

(f) kërkimi ose pranimi i mitës si nëpunës i Gjykatës e në lidhje me detyrat zyrtare të tij ose saj.

2. Parimet dhe procedurat që rregullojnë ushtrimin e juridiksionit të Gjykatës mbi veprat sipas këtij neni janë ato që parashikohen në Rregullat e Procedurës dhe Provave. Kushtet për sigurimin e bashkëpunimit ndërkombëtar për Gjykatën në lidhje me procedurat e saj sipas këtij neni, rregullohen nga ligjet kombëtare të Shtetit nga i cili kërkohet bashkëpunimi.

3. Në rast të dënimit, Gjykata mund të caktojë një afat burgimi që nuk i kalon pesë vjet, ose një gjobë, në pajtim me Rregullat e Procedurës dhe Provave, ose të ato.

4. (a) Secili Shtet Palë i zgjeron ligjet e tij penale përmes penalizimit të veprave kundër integritetit të procesit të tij hetues ose gjyqësor me veprat kundër administrimit të drejtësisë të përmendur në këtë nen, të kryera në territorin e tij, ose nga ana e njërit prej shtetasve të tij.

(b) Me kërkesë të Gjykatës, sa herë që e konsideron të nevojshme, Shteti Palë ua dorëzon çështjen organeve të tij kompetente me qëllim të ndjekjes penale. Këto organe i trajtojnë këto çështje me kujdes dhe u përkushtojnë burime të mjaftueshme për të mundësuar shqyrtimin e tyre efektiv.

Neni 71
Sanksionet për sjelljet e pahijshme para Gjykatës

1. Gjykata mund të ndëshkojë personat e pranishëm para saj të cilët kryejnë sjellje të pahijshme, përfshirë këtu pengimin e gjykimeve të saj ose refuzimin e qëllimshëm për të vepruar sipas udhëzimeve të saj, me masa administrative përveç burgosjes, siç është largimi i përkohshëm ose i përhershëm nga gjykata, gjoba ose masa të ngjashme të rregulluara në Rregullat e Procedurës dhe Provave.

2. Procedurat që rregullojne dhënien e masave të përmendura në paragrafin 1 janë ato që parashikohen në Rregullat e Procedurës dhe Dëshmive.

Neni 72
Ruajtja e informacionit mbi sigurinë kombëtare

1. Ky nen zbatohet në çdo çështje kur zbulimi i informacionit ose dokumenteve të Shtetit, sipas mendimit të atij Shteti, dëmton interesat e tij kombëtare. Çështje të tilla përfshijnë ato që hyjnë brenda sferës së nenit 56, paragrafët 2 dhe 3, neni 61 paragrafi 3, neni 64 paragrafi 3, neni 67 paragrafi 2, neni 68 paragrafi 6, neni 87 paragrafi 6 dhe neni 93, e po ashtu edhe çështjet që dalin në cilëndo fazë të gjykimit ku zbulimi i tyre është i mundur.

2. Ky nen zbatohet edhe kur personit i është kërkuar që të japë informacion ose dëshmi dhe ai ia ka refuzuar ta bëjë atë ose ia ka referuar çështjen Shteti duke u bazuar në faktin që zbulimi do të dëmtonte interesat e sigurisë kombëtare të Shtetit dhe se Shteti në fjalë vërteton se është i mendimit që zbulimi do të dëmtonte interesat e sigurisë kombëtare të tij.

3. Asgjë në këtë nen nuk dëmton kërkesat për konfidencialitet të zbatueshme sipas nenit 54, paragrafi 3 (e) dhe (f), ose zbatimin e nenit 73.

4. Nëse Shteti mëson se informacioni ose dokumentet e Shtetit janë, ose pritet të zbulohen në cilëndo fazë të gjykimit, dhe është i mendimit që zbulimi do të dëmtonte interesat e sigurisë kombëtare të tij, ai Shtet ka të drejtë të ndërhyjë në mënyrë që të sigurojë zgjidhjen e çështjes në pajtim me këtë nen.

5. Nëse, sipas mendimit të Shtetit, zbulimi i informacionit do të dëmtonte interesat e sigurisë kombëtare të tij, merren të gjitha masat e arsyeshme nga Shteti, duke vepruar në bashkëpunim me Prokurorin, mbrojtjen, Dhomën e Procedurës Paraprake ose Dhomën e Gjykimit, kur është rasti për të kërkuar zgjidhjen e çështjes me masa bashkëpunimi. Masat e tilla mund të përfshijnë:

(a) modifikimin ose sqarimin e kërkesës;

(b) përcaktimin nga ana e Gjykatës në lidhje me rëndësinë e informacionit ose dëshmive që kërkohen, ose përcaktimin nëse dëshmia, edhe pse e rëndësishme, ka mundësi të sigurohet ose është siguruar nga ndonjë burim tjetër dhe jo nga Shteti të cilit i është drejtuar kërkesa;

(c) sigurimin e informacionit ose dëshmive nga një burim tjetër ose në formë tjetër; ose

(d) marrëveshjen rreth kushteve nën të cilat do të mund të ofrohej ndihma, përfshirë këtu përveç të tjerash, sigurimin e përmbledhjeve ose redaktimeve, kufizimeve në zbulim, zhvillimin e gjykimit in camera ose ex parte, ose masat e tjera mbrojtëse të lejueshme sipas këtij Statuti dhe Rregullave.

6. Pasi të jenë ndërmarrë të gjithë hapat e arsyeshëm për zgjidhjen e çështjes përmes mjeteve të bashkëpunimit, dhe nëse Shteti mendon se nuk ka mënyra ose kushte në të cilat informacioni ose dokumentet mundet të sigurohen ose zbulohen pa rrezikuar interesat e sigurisë së tij kombëtare, ai njofton Prokurorin ose Gjykatën për shkaqet specifike që e kanë shtyrë në marrjen e një vendimi të tillë, përveçse kur vetë përshkrimi specifik i shkaqeve do të rezultonte në rrezikimin e interesave të sigurisë kombëtare të Shtetit.

7. Kështu, nëse Gjykata përcakton se dëshmia është e rëndësishme dhe e domosdoshme për përcaktimin e fajit ose pafajësisë së të akuzuarit, Gjykata mund të ndërmarrë veprimet që vijojnë:

(a) kur zbulimi i informacionit ose dokumentit kërkohet për zbatim në përputhje me lutjen për bashkëpunim sipas Pjesës 9 ose me rrethanat e përshkruara në paragrafin 2, dhe Shteti ka kërkuar shkaqet për refuzim të përmendur në nenin 93, paragrafi 4:

(i) Gjykata, para marrjes së çdo përfundimi të përmendur në nënparagrafin 7 (a) (ii), mund të kërkojë konsultime të mëtejshme me qëllimin e shqyrtimit të përfaqësimeve të Shtetit, që mund të përfshijnë, sipas rastit, dëgjimin me kamerë dhe atë ex parte;

(ii) nëse Gjykata nxjerr përfundimin që, përmes referimit të shkaqeve për refuzim sipas nenit 93, paragrafi 4, në rrethanat e rastit, Shteti të cilit i është bërë kërkesa nuk është duke vepruar në pajtim me detyrimet e tij sipas këtij Statuti, Gjykata mund të shqyrtojë çështjen në pajtim me nenin 87, paragrafi 7, duke specifikuar arsyet për këtë përfundim të sajin; dhe

(iii) Gjykata mund të nxjerrë një përfundim të tillë në gjykimin e të akuzuarit në lidhje me ekzistimin ose mosekzistimin e fakteve, ashtu siç është e nevojshme për ato rrethana; ose

(b) në të gjitha rastet e tjera:

(i) urdhëron zbulimin; ose

(ii) deri në masën që nuk urdhëron zbulimin, nxjerr atë përfundim në gjykimin e të akuzuarit në lidhje me ekzistimin ose mosekzistimin e një fakti, siç është e nevojshme për ato rrethana.

Neni 73

Informacioni ose dokumentet e palës së tretë

Nëse Gjykata kërkon nga Shteti Palë që të sigurojë një dokument ose informacion që ai e ka në ruajtje, posedim ose kontroll, e që i është treguar atij në mirëbesim nga një Shtet, organizatë ndërqeveritare ose organizatë ndërkombëtare, ajo kërkon pëlqimin e këtij të fundit për të zbuluar atë dokument ose informatë. Nëse ky është një Shtet Palë, ai duhet të japë pëlqimin për zbulimin e informatës ose dokumentit, ose do të ndërmarrë zgjidhjen e problemit të zbulimit me Gjykatën, kushtëzuar nga dispozitat e nenit 72. Nëse ky nuk është një Shtet Palë dhe refuzon të pajtohet me zbulimin, Shteti të cilit i është bërë kërkesa, informon Gjykatën se nuk ka mundësi të ofrojë dokumentin ose informatën për shkak të detyrimit të mëparshëm për konfidencialitet ndaj shtetit të parë.

Neni 74

Kërkesat për marrjen e vendimit

1. Të gjithë gjyqtarët e Dhomës së Gjykimit janë të pranishëm në secilën fazë të gjykimit dhe gjatë shqyrtimit të tyre. Kryesia, mbi bazë rast-pas-rasti, mund të caktojë, nëse janë në dispozicion, një ose më shumë gjyqtarë shtesë, të cilët janë të pranishëm në secilën fazë të gjykimit për të zëvendësuar ndonjë anëtar të Dhomës së Gjykimit, nëse ai anëtar nuk është në gjendje të vazhdojë pjesëmarrjen e tij.

2. Vendimi i Dhomës së Gjykimit bazohet në vlerësimin e saj mbi provat dhe gjykimin në

tërësi. Vendimi nuk tejkalon faktet dhe rrethanat e përshkruara në akuza dhe çdo ndryshim në akuzë. Gjykata mund të mbështesë vendimin e saj vetëm në provat e dorëzuara dhe të diskutuara para saj në gjykim.

3. Gjyqtarët përpiqen të arrijnë unanimitet në vendimin e tyre, dhe nëse kjo nuk mund të arrihet, vendimi merret nga shumica e gjyqtarëve.

4. Këshillimet e Dhomës së Gjykimit mbeten të fshehta.

5. Vendimi është me shkrim dhe përmban deklaratën e plotë dhe të arsyetuar të vendimeve të Dhomës së Gjykimit në lidhje me provat dhe përfundimet. Dhoma e Gjykimit lëshon një vendim. Kur nuk ka unanimitet, vendimi i Dhomës së Gjykimit përmban qëndrimet e shumicës dhe pakicës. Vendimi apo një përmbledhje shpallet me dyer të hapura.

Neni 75
Dëmshpërblimet për viktima

1. Gjykata përcakton parimet në lidhje me dëmshpërblimet për, ose në lidhje me viktimat, përfshirë këtu restitucionin, kompensimin dhe rehabilitimin. Sipas kësaj baze, në vendimin e saj Gjykata mund të kërkojë, në bazë të kërkesës ose në bazë të propozimit të saj, në rrethana të veçanta, përcaktimin e shkallës dhe gjerësisë së çfarëdo dëmi, humbjeje ose lëndimi për ose në lidhje me viktimat dhe deklaron parimet mbi të cilat ajo vepron.

2. Gjykata mund të japë urdhër drejtpërdrejt kundër personit të dënuar duke përmendur dëmshpërblimet e duhura për, ose në lidhje me viktimat, përfshirë këtu restitucionin, kompensimin dhe rehabilitimin. Kur është e nevojshme, Gjykata mund të urdhërojë që dëmshpërblimi të bëhet përmes Fondit "Fondi Besimit" të parashikuar në nenin 79.

3. Para dhënies së urdhrit sipas këtij neni, Gjykata mund të ftojë dhe marrë parasysh përfaqësimet nga ose në emër të personit të dënuar, viktimat, personat e tjerë të interesuar ose Shtetet e interesuara.

4. Në ushtrimin e kompetencave të saj sipas këtij neni, Gjykata, pasi të jetë dënuar personi për një krim brenda juridiksionit të Gjykatës, mund të përcaktojë nëse, për të realizuar urdhrin të cilin mund ta japë sipas këtij neni, është e domosdoshme të kërkohen masat sipas nenit 93, paragrafi 1.

5. Një Shtet Palë i jep fuqi vendimit sipas këtij neni, sikur dispozitat e nenit 109 të ishin të zbatueshme për këtë nen.

6. Asgjë në këtë nen nuk interpretohet si dëmtim i të drejtave të viktimave sipas ligjit kombëtar ose atij ndërkombëtar.

Neni 76
Dënimi

1. Në rastin e fajësimit, Dhoma e Gjykimit shqyrton dënimin e duhur që duhet të jepet dhe do të ketë parasysh provat e paraqitura dhe depozitimet e bëra gjatë gjykimit e të cilat janë të rëndësishme për dënimin.

2. Përveçse kur zbatohet neni 65 dhe para përfundimit të gjykimit, Dhoma e Gjykimit, sipas propozimit të saj dhe me kërkesë të Prokurorit ose të të akuzuarit, mund të mbajë një seancë tjetër për të dëgjuar çfarëdo prove plotësuese ose parashkresat që kanë të bëjnë me dënimin, në pajtim me Rregullat e Procedurës dhe Dëshmive.

3. Kur zbatohet paragrafi 2, çdo përfaqësim sipas nenit 75 dëgjohet gjatë seancës tjetër të përmendur në paragrafin 2 dhe, nëse është e nevojshme, gjatë çfarëdo seance shtesë.

4. Dënimi shpallet publikisht dhe, kur është e mundur, në praninë e të akuzuarit.

PJESA 7
NDËSHKIMET

Neni 77
Ndëshkimet e zbatueshme

1. Në bazë të nenit 110, Gjykata mund të japë ndaj personit të dënuar për krimin e përmendur në nenin 5 të këtij Statuti, njërin nga ndëshkimet e mëposhtme:

(a) burgimin për një numër të caktuar vjetësh, që nuk mund të kalojë maksimumin prej 30 vjetësh, ose

(b) dënimin me burg të përjetshëm kur është i arsyetuar me peshën e rëndë të krimit dhe me rrethanat individuale të personit të dënuar.

2. Si plotësim për burgimin, Gjykata mund të urdhërojë:

(a) një gjobë sipas kritereve të parashikuara në Rregullat e Procedurës dhe Provave;

(b) konfiskimin e të ardhurave, pronës dhe mjeteve që rrjedhin në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga ai krim, pa rrezikuar të drejtat e palëve të treta që veprojnë bona fide.

Neni 78
Përcaktimi i dënimit

1. Në përcaktimin e dënimit, Gjykata, në pajtim me Rregullat e Procedurës dhe Dëshmive, merr parasysh faktorë të tillë, si peshën e krimit dhe rrethanat individuale të personit të dënuar.

2. Në dhënien e dënimit me burgim, Gjykata zbret, nëse ekziston, periudhën e kaluar më parë në paraburgim, në pajtim me urdhrin e Gjykatës. Gjykata mund të zbresë cilëndo periudhë tjetër të kaluar në paraburgim në lidhje me sjelljen që përbën atë krim.

3. Kur personi është dënuar për më shumë se një krim, Gjykata jep dënimin për secilin krim, si dhe dënimin e përbashkët, duke specifikuar periudhën e përgjithshme të burgosjes. Kjo periudhë nuk është më pak se dënimi më i lartë individual i dhënë dhe nuk kalon dënimin prej 30 vjetësh burgim ose dënimin me burg të përjetshëm në përputhje me nenin 77, paragrafi 1 (b).

Neni 79
Fondi "Fondi Besimi"

1. Fondi i njohur si "Fond Besimi" themelohet me vendim të Asamblesë së Shteteve Palë në dobi të viktimave të krimeve brenda juridiksionit të Gjykatës dhe të familjeve të viktimave të tilla.

2. Gjykata mund të urdhërojë që të hollat dhe pronësitë e tjera të mbledhura përmes gjobave ose konfiskimit të transferohen, me urdhër të Gjykatës, në fondin "Fond Besimi".

3. Fondi "Fond Besimi" menaxhohet sipas kritereve që përcaktohen nga Asambleja e Shteteve Palë.

Neni 80
Pacenueshmëria në zbatimin kombëtar të ndëshkimeve dhe ligjeve kombëtare

Asgjë në këtë Pjesë nuk ndikon në zbatimin nga ana e Shteteve të ndëshkimeve të përshkruara në ligjet e tyre kombëtare, e as në ligjin e Shteteve që nuk mundëson ndëshkimet e përshkruara në këtë Pjesë.

PJESA 8
ANKESA DHE RISHIKIMI

Neni 81
Ankesa kundër vendimit për shfajësim ose fajësim ose kundër dënimit

1. Kundër një vendimi sipas nenit 74 mund të bëhet ankesë në pajtim me Rregullat e Procedurës dhe Provave, si më poshtë:

(a) Prokurori mund të ushtrojë ankesën duke u bazuar në:

(i) gabimin procedural;

(ii) gabimin në fakt; ose

(iii) gabimin në ligj;

(b) personi i dënuar, ose Prokurori në emër të atij personi, mund të ushtrojë ankesën duke u bazuar në:

(i) gabimin procedural;

(ii) gabimin në fakt;

(iii) gabimin në ligj; ose

(iv) Çdo shkak tjetër që ka ndikim në paanshmërinë dhe sigurinë e gjykimit ose vendimit.

2. (a) Ndaj dënimit mund të bëhet ankesë, në pajtim me Rregullat e Procedurës dhe Provave, nga ana e Prokurorit ose personit të dënuar, duke u bazuar në shpërpjesëtimin në mes të krimit dhe dënimit.

(b) Nëse në ankesën ndaj dënimit, Gjykata konsideron se ekzistojnë shkaqe për të cilat mund të mënjanohet dënimi, tërësisht ose pjesërisht, ajo mund të ftojë Prokurorin dhe personin e dënuar për të dorëzuar shkaqet sipas nenit 81, paragrafi 1 (a) ose (b), dhe mund të japë vendimin për dënimin në pajtim me nenin 83.

(c) E njëjta procedurë zbatohet kur Gjykata, vetëm sipas ankesës kundër dënimit, konsideron se shkaqet për uljen e dënimit ekzistojnë sipas paragrafit 2 (a).

3. (a) Përveçse kur Dhoma e Gjykimit urdhëron ndryshe, personi i dënuar mbahet në ndalim derisa të zgjidhet ankesa.

(b) Kur koha që personi kalon në ndalim tejkalon dënimin me burgim të dhënë, ai person lirohet, ndërsa, kur edhe Prokurori është duke bërë ankesë, lirimi mund të kushtëzohet nga kushtet e nënparagrafit (c) të mëposhtëm.

(c) Në rast të dhënies së pafajësisë, i akuzuari lirohet menjëherë, kushtëzuar nga sa vijon:

(i) në rrethana të veçanta, dhe duke konsideruar, inter alia, rrezikun konkret të zhdukjes, seriozitetin e shkeljes së caktuar dhe mundësinë e suksesit të ankesës, Dhoma e Gjykimit, me kërkesën e Prokurorit, mund ta mbajë personin në ndalim derisa të zgjidhet ankesa.

(ii) ndaj vendimit të marrë nga Dhoma e Gjykimit sipas nënparagrafit (c) (i) mund të ushtrohet ankesë në pajtim me Rregullat e Procedurës dhe Provave.

4. Në bazë të dispozitave të paragrafit 3 (a) dhe (b), ekzekutimi i vendimit ose dënimit pezullohet gjatë periudhës së lejuar për ankesë dhe gjatë kohëzgjatjes së procedurës së ankesës.

Neni 82
Ankesa ndaj vendimeve tjera

1. Secila Palë mund të ushtrojë ankesë ndaj çdo vendimi të mëposhtëm, në pajtim me Rregullat e Procedurës dhe Provave:

(a) vendimit në lidhje me juridiksionin ose pranueshmërinë;

(b) vendimit për lirimin ose mohimin e lirimit të personit që është marrë në pyetje ose ndiqet penalisht;

(c) vendimit të Dhomës së Procedurës Paraprake për të vepruar kryesisht sipas nenit 56, paragrafi 3;

(d) vendimit që përfshin një çështje që do të mund të kishte ndikim të rëndësishëm në

zhvillimin e drejtë dhe të shpejtë të gjykimit ose në përfundimin e gjykimit, dhe për të cilën, sipas mendimit të Dhomës së Procedurës Paraprake ose asaj të Gjykimit, zgjidhja e menjëhershme nga Dhoma e Ankesës mund të shpejtojë materialisht gjykimin.

2. Ndaj vendimit të Dhomës së Procedurës Paraprake sipas nenit 57, paragrafi 3 (d), mund të bëhet ankesë nga Shteti i interesuar ose nga Prokurori, me leje të Dhomës së Procedurës Paraprake. Ankesa dëgjohet në mënyrë të përshpejtuar.

3. Ankesa, si e tillë, nuk ka efekt pezullues, përveçse kur vendos Dhoma e Ankesave me kërkesë, në pajtim me Rregullat e Procedurës dhe Provave.

4. Përfaqësuesi ligjor i viktimave, personi i dënuar ose pronari bona fide i pronësisë së prekur në mënyrë të pafavorshme me urdhërin sipas nenit 75 mund të bëjë ankesë kundër urdhrit për dëmshpërblime, ashtu siç është rregulluar në Rregullat e Procedurës dhe Provave.

Neni 83
Gjykimi i ankimit

1. Për qëllimet e gjykimit sipas nenit 81 dhe sipas këtij neni, Dhoma e Ankimit ka të gjitha kompetencat e Dhomës së Gjykimit.

2. Nëse Dhoma e Ankimit konstaton se gjykimi, kundër të cilit është bërë ankim, ka qenë i padrejtë në atë mënyrë që ka ndikuar në besueshmërinë e vendimit ose dënimit, ose se vendimi ose dënimi ndaj të cilit është bërë ankim ka qenë thelbësisht nën ndikim të gabimit në fakt, në ligj ose të gabimit procedural, ajo mund të:

(a) anulojë ose ndryshojë vendimin ose dënimin; ose

(b) urdhërojë një gjykim të ri para një Dhome tjetër Gjykimi.

Për këto qëllime, Dhoma e Ankimit mund ta ridërgojë çështjen te Dhoma e parë e Gjykimit, në mënyrë që ajo të vendosë mbi çështjen dhe të respektojë përsëri në pajtim me rrethanat ose edhe vetë të kërkojë prova për të vendosur mbi çështjen. Kur ndaj vendimit ose dënimit është ushtruar ankim vetëm nga ana e personit të dënuar, ose nga Prokurori në emër të atij personi, ai nuk mund të ndryshohet në dëm të tij ose saj.

3. Nëse në një ankim kundër dënimit Dhoma e Ankesave konstaton se dënimi nuk është proporcional me krimin, ajo mund të ndryshojë dënimin në pajtim me Pjesën 7.

4. Vendimi i Dhomës së Ankesave merret nga shumica e gjyqtarëve dhe shpallet me dyer të hapura. Në vendim paraqiten arsyet në të cilat ai është bazuar. Kur nuk ka unanimitet, vendimi i Dhomës së Ankesave përmban qëndrimet e shumicës dhe pakicës, por gjyqtari mund të japë një mendim të ndryshëm ose të kundërt për një çështje ligjore.

5. Dhoma e Ankesave mund ta paraqesë vendimin e saj në mungesë të personit që merr fajësi ose pafajësi.

Neni 84
Rishikimi i fajësimit ose dënimit

1. Personi i dënuar ose, pas vdekjes së tij, bashkëshorti/ja, fëmijët, prindërit ose një person i gjallë në kohën e vdekjes së të akuzuarit, të cilit i janë dhënë udhëzime të qarta me shkrim nga i akuzuari për të bërë një kërkesë të tillë, ose Prokurori, në emër të personit, mund të kërkojë nga Dhoma e Ankesave që të rishikojë fajësimin ose dënimin duke u bazuar mbi këto shkaqe:

(a) është zbuluar prova e re që:

(i) nuk ka qenë në dispozicion në kohën e gjykimit, dhe një mungesë e tillë nuk mund t'i ngarkohet tërësisht ose pjesërisht palës që bën kërkesën; dhe

(ii) është mjaft e rëndësishme dhe, po të ishte vërtetuar gjatë gjykimit, do të kishte pasur gjasa që të ndikonte në marrjen e një vendimi krejtësisht tjetër;

(b) është zbuluar së fundi që prova vendimtare, e marrë gjatë gjykimit dhe nga e cila varet dënimi, ka qenë e pavërtetë, ose e falsifikuar;

(c) një ose më shumë gjyqtarë që kanë marrë pjesë në dënim ose vërtetim të akuzave, kanë

manifestuar, në atë rast, një akt të rëndë të sjelljes së keqe dhe shkelje serioze të detyrave me peshë të tillë që mjafton për të justifikuar largimin e atij ose atyre gjyqtarëve nga detyra sipas nenit 46.

2. Dhoma e Ankesave refuzon kërkesën nëse mendon se ajo është e pabazuar. Nëse ajo vendos që kërkesa është e arsyetuar, ajo mundet, sipas rastit:

(a) të thërrasë përsëri Dhomën e mëparshme të Gjykimit;

(b) të themelojë një Dhomë të re Gjykimi; ose

(c) të ruajë juridiksionin mbi çështjen, me qëllim që, pas dëgjimit të palëve në mënyrën e paraqitur në Rregullat e Procedurës dhe Provave, të nxjerrë përfundimin nëse do të rishikohet vendimi përfundimtar.

Neni 85

Kompensimi për personin e arrestuar ose të dënuar

1. Kushdo që ka qenë viktimë e një arresti ose ndalimi të paligjshëm ka të drejtën ekzekutive për kompensim.

2. Kur personi është dënuar me vendim përfundimtar për një vepër penale, dhe kur mëpastaj dënimi i tij ose saj është rishikuar në bazë të asaj se fakti i ri ose i sapozbuluar tregon në mënyrë bindëse se drejtësia ka gabuar, personi që ka vuajtur dënimin si rezultat i një dënimi të tillë kompensohet në bazë të ligjit, përveçse kur vërtetohet se moszbulimi i faktit të panjohur më parë, mund t'i ngarkohet plotësisht ose pjesërisht atij ose asaj.

3. Në rrethana të veçanta, kur Gjykata gjen fakte vendimtare që tregojnë se është bërë gabim i rëndë dhe i dukshëm i drejtësisë, ajo mundet sipas zgjedhjes së saj të ofrojë kompensimin, në pajtim me kriteret e përcaktuara në Rregullat e Procedurës dhe Provave, për personin që është liruar nga ndalimi me vendim përfundimtar për dhënie pafajësie ose mbarim të gjykimit për atë shkak.

PJESA 9

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR DHE NDIHMA GJYQËSORE

Neni 86

Detyrimi i përgjithshëm për bashkëpunim

Shtetet Palë, në pajtim me dispozitat e këtij Statuti, bashkëpunojnë plotësisht me Gjykatën për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve brenda juridiksionit të Gjykatës.

Neni 87

Kërkesat për bashkëpunim: dispozitat e përgjithshme

1. (a) Gjykata ka kompetencë të kërkojë bashkëpunim nga Shtetet Palë. Kërkesat përcillen nëpërmjet kanaleve diplomatike ose ndonjë kanal tjetër të përshtatshëm, siç mund të përcaktohet nga secili Shtet Palë me rastin e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

Ndryshimet plotësuese në këtë përcaktim bëhen nga secili Shtet Palë në pajtim me Rregullat e Procedurës dhe Provave.

(b) Kur është e përshtatshme, por pa cënuar dispozitat e nënparagrafit (a), kërkesat, po ashtu, mund të përcillen përmes Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale ose cilësdo organizate të përshtatshme regjionale.

2. Kërkesat për bashkëpunim dhe të gjitha dokumentet mbështetëse të kërkesës përkthehen ose përcillen me përkthimin në gjuhën zyrtare të Shtetit të cilit i bëhet kërkesa ose në njërën nga gjuhët e punës në Gjykatë, në pajtim me zgjedhjen e bërë nga ai Shtet me rastin e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

Ndryshimet e mëvonshme të kësaj zgjedhjeje bëhen në pajtim me Rregullat e Procedurës dhe Provave.

3. Shteti të cilit i bëhet kërkesa, mban në fshehtësi kërkesën për bashkëpunim dhe çdo dokument në mbështetje të kërkesës, përveçse kur zbulimi është i domosdoshëm për ekzekutimin e kërkesës.

4. Në lidhje me çdo kërkesë për ndihmë të paraqitur në Pjesën 9, Gjykata mund të marrë ato masa, përfshirë këtu masat në lidhje me ruajtjen e informacionit, që janë të domosdoshme për të garantuar sigurinë ose mirëqenien fizike a psikologjike të viktimave, dëshmitarëve potencialë dhe familjeve të tyre. Gjykata mund të kërkojë që çdo informacion që është vënë në dispozicion sipas Pjesës 9, sigurohet dhe trajtohet në mënyrën që mbron sigurinë dhe mirëqenien fizike a psikologjike të të gjithë viktimave, dëshmitarëve potencialë dhe familjeve të tyre.

5. Gjykata mund të ftojë cilindo Shtet joanëtar në këtë Statut që të ofrojë ndihmë sipas kësaj Pjese në bazë të një rregullimi ad-hoc, marrëveshjeje me Shtetin ose çfarëdo baze tjetër të përshtatshme.

Kur Shteti joanëtar në këtë Statut, që ka hyrë në një rregullim ad-hoc ose në marrëveshje me Gjykatën, nuk bashkëpunon me kërkesat në përputhje me rregullimin ose marrëveshjen, Gjykata mund të informojë për këtë Asamblenë e Shteteve Palë ose, kur Këshilli i Sigurimit e ka përcjellë çështjen në Gjykatë, Këshillin e Sigurimit.

6. Gjykata mund të kërkojë nga çdo organizatë ndërqeveritare dhënien e informacionit ose dokumenteve. Gjykata, po ashtu, mund të kërkojë forma të tjera të bashkëpunimit dhe asistencës për të cilat mund të merret vesh me një organizatë të tillë dhe të cilat janë në pajtim me kompetencat dhe mandatin e saj.

7. Kur Shteti Palë nuk përmbush kërkesën për bashkëpunim nga ana e Gjykatës në kundërshtim me dispozitat e këtij Statuti, duke penguar kështu Gjykatën në ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të saj sipas këtij Statuti, Gjykata për këtë mund të bëjë një konstatim dhe ta përcjellë çështjen në Asamblenë e Shteteve Palë ose, kur Këshilli i Sigurimit e ka përcjellë çështjen në Gjykatë, në Këshillin e Sigurimit.

Neni 88

Disponibiliteti i Procedurave sipas ligjit kombëtar

Shtetet Palë sigurojnë që të ketë procedurat në dispozicion sipas ligjit të tyre kombëtar për të gjitha format e bashkëpunimit që janë caktuar në këtë Pjesë.

Neni 89

Dorëzimi i personave në Gjykatë

1. Gjykata mund t'i transmetojë kërkesën për arrest dhe dorëzim të personit, bashkë me materialet në mbështetje të kërkesës së parashikuar në nenin 91, çdo Shteti në territorin e të cilit mund të gjendet ai person dhe kërkon bashkëpunimin e atij Shteti në arrestimin dhe dorëzimin e një personi të tillë. Shtetet Palë, në pajtim me dispozitat e kësaj Pjese dhe procedurën sipas ligjeve të tyre kombëtare, përmbushin kërkesën për arrestim dhe dorëzim.

2. Kur personi i kërkuar për dorëzim sjell kundërshtimin e tij para gjykatës kombëtare në bazë të parimit ne bis in ide, ashtu si është parashikuar në nenin 20, Shteti të cilit i është drejtuar kërkesa menjëherë këshillohet me Gjykatën për të përcaktuar nëse ka pasur vendim në lidhje me pranueshmërinë. Nëse rasti është i pranueshëm, Shteti të cilit i është drejtuar kërkesa vazhdon me ekzekutimin e kërkesës. Nëse vendimi në lidhje me pranueshmërinë pritet të merret, Shteti të cilit i drejtohet kërkesa mund të shtyjë ekzekutimin e kërkesës për dorëzimin e personit përderisa Gjykata të bëjë përcaktimin në lidhje me pranueshmërinë.

3. (a) Shteti Palë, në pajtim me ligjin e tij kombëtar procedural, autorizon transportimin e personit që do t'i dorëzohet Gjykatës nga një Shtet tjetër nëpër territorin e tij, përveçse kur kalimi tranzit nëpër atë Shtet pengon ose shtyn dorëzimin.

(b) Kërkesa e gjykatës për kalim transmetohet në pajtim me nenin 87. Kërkesa për kalim përmban:

(i) përshkrimin e personit që do të transportohet;

(ii) një deklaratë të shkurtër mbi faktet e rastit dhe karakterizimin e tyre ligjor; dhe

(iii) urdhrin për arrestim dhe dorëzim.

(c) Personi që do të transportohet mbahet në ndalim gjatë periudhës së kalimit tranzit.

(d) Nuk kërkohet autorizim kur personi transportohet në vijë ajrore dhe nuk është planifikuar asnjë zbritje në territorin e këtij Shteti.

(e) Nëse ndodh zbritja e paplanifikuar në territorin e Shtetit tranzit, ai Shtet mund të kërkojë nga Gjykata kërkesën për tranzit ashtu siç është parashikuar në nënparagrafin (b). Shteti tranzit ndalon transportin e personit derisa të pranohet kërkesa për tranzit dhe tranziti të jetë kryer, me kusht që ndalimi për qëllimet e këtij nënparagrafi nuk duhet të zgjatë më shumë se 96 orë nga zbritja e paplanifikuar, përveçse kur kërkesa është marrë brenda asaj kohe.

4. Nëse personi i kërkuar po ndiqet penalisht ose është duke vuajtur dënimin në Shtetin pritës për një krim tjetër nga ai për të cilin është kërkuar dorëzimi në Gjykatë, Shteti pritës, pas marrjes së vendimit për përmbushjen e kërkesës, këshillohet me Gjykatën.

Neni 90

Kërkesat konkurruese

1. Shteti Palë që merr një kërkesë nga Gjykata për dorëzimin e personit sipas nenit 89, merr një kërkesë tjetër nga cilido Shtet tjetër për ekstradimin e të njëjtit person dhe për të njëjtën sjellje që formon bazën e krimit për të cilin Gjykata kërkon dorëzimin e personit, njofton për këtë fakt Gjykatën dhe Shtetin dërgues.

2. Kur Shteti dërgues është Shtet Palë, Shteti pritës i jep përparësi kërkesës së bërë nga Gjykata, nëse:

(a) Gjykata, në përputhje me nenin 18 ose 19, ka përcaktuar se çështja në lidhje me të cilin kërkohet dorëzimi është i pranueshëm dhe se vendimi merr parasysh hetimin ose ndjekjen penale të zhvilluar nga Shteti dërgues, në lidhje me kërkesën e tij për ekstradim; ose

(b) Gjykata bën përcaktimin e parashikuar në nënparagrafin (a), në përputhje me njoftimin e Shtetit të cilit i drejtohet kërkesa sipas paragrafit 1.

3. Kur nuk është bërë përcaktimi sipas paragrafit 2 (a), Shteti pritës, sipas zgjedhjes së tij, duke pritur përcaktimin nga Gjykata sipas paragrafit 2 (b), mund të vazhdojë të merret me kërkesën për ekstradim nga Shteti dërgues, por nuk e ekstradon personin derisa Gjykata të përcaktojë se rasti është i papranueshëm. Përcaktimi i Gjykatës do të bëhet me procedurë të shpejtuar.

4. Nëse Shteti dërgues nuk është Shtet Palë në këtë Statut, Shteti pritës, nëse nuk është nën detyrimin ndërkombëtar për të ekstraduar personin në Shtetin dërgues, i jep përparësi kërkesës për dorëzim të bërë nga Gjykata, nëse Gjykata ka përcaktuar se rasti është i pranueshëm.

5. Kur një çështje sipas paragrafit 4 nuk është përcaktuar si e pranueshme nga ana e Gjykatës, Shteti pritës, sipas zgjedhjes së tij, mund të vazhdojë të merret me kërkesën për ekstradim nga Shteti dërgues.

6. Në rastet kur zbatohet paragrafi 4, përveçse kur Shteti pritës është nën detyrimin ekzistues ndërkombëtar për të ekstraduar personin në Shtetin dërgues e që nuk është palë në këtë Statut, Shteti pritës vendos nëse do ta dorëzojë personin në Gjykatë ose do ta ekstradojë atë në Shtetin dërgues. Në marrjen e vendimit të tij, Shteti pritës merr parasysh të gjithë faktorët përkatës, përfshirë këtu por jo të kufizuara në:

(a) datat përkatëse të kërkesave;

(b) interesat e Shtetit dërgues, përfshirë këtu, kur është me rëndësi, nëse krimi është kryer në territorin e tij, si dhe kombësinë e viktimave dhe të personit të kërkuar; dhe

(c) mundësinë e dorëzimit pasues ndërmjet Gjykatës dhe Shtetit dërgues.

7. Kur Shteti Palë që merr kërkesën nga Gjykata për dorëzimin e personit, pranon gjithashtu një kërkesë nga cilido Shtet për ekstradimin e personit të njëjtë për një vepër tjetër nga ajo që paraqet krim për të cilin Gjykata kërkon dorëzimin e personit:

(a) shteti pritës, nëse nuk është nën detyrimin ekzistues ndërkombëar për të ekstraduar

personin në Shtetin dërgues, i jep përparësi kërkesës së bërë nga Gjykata;

(b) shteti pritës, nëse është nën detyrimin ekzistues ndërkombëtar për të ekstraduar personin në Shtetin dërgues, vendos nëse do ta dorëzojë personin në Gjykatë ose do ta ekstradojë atë në Shtetin pritës. Në marrjen e vendimit të tij, Shteti pritës merr në konsidatë të gjithë faktorët përkatës, duke përfshirë por jo kufizuar në ato të paraqitura në paragrafin 6, por jep konsideratat e veçanta për natyrën relative dhe peshën e sjelljes në fjalë.

8. Kur në përputhje me njoftimin sipas këtij neni, Gjykata ka përcaktuar që çështja është e papranueshme, dhe si pasojë ekstradimi në Shtetin dërgues refuzohet, Shteti pritës njofton Gjykatën në lidhje me këtë vendim.

Neni 91

Përmbajtja e kërkesës për arrestim dhe dorëzim

1. Kërkesa për arrest dhe dorëzim përpilohet me shkrim. Në rastet urgjente, kërkesa mund të bëhet me çdo mjet të aftë për dhënien e vendimit me shkrim, kështu që kërkesa konfirmohet nëpërmjet kanalit të parashikuar në nenin 87, paragrafi 1 (a).

2. Në rast të kërkesës për arrestin ose dorëzimin e personit për të cilin është lëshuar urdhër-arresti nga Dhoma e Procedurës Paraprake sipas nenit 58, kërkesa përmban ose të mbështetet nga:

(a) informacioni në të cilën përshkruhet personi që kërkohet, i mjaftueshëm për të identifikuar personin, dhe informacion në lidhje me vendndodhjen e mundshme të personit;

(b) kopja e urdhër-arrestit; dhe

(c) dokumente, deklarata ose informacione të tilla që janë të domosdoshme për të plotësuar kërkesat për procesin e dorëzimit në Shtetin pritës, por këto kërkesa nuk do të duhej të ishin më të rënda se ato që janë të zbatueshme për kërkesat për ekstradim në përputhje me traktatet ose marrëveshjet ndërmjet Shtetit pritës dhe Shteteve të tjera dhe do të duhej, nëse është e mundur, të jenë më pak të rënda, duke marrë parasysh natyrën e veçantë të Gjykatës.

3. Në rast të kërkesës për arrestim dhe dorëzim të personit tanimë të dënuar, kërkesa përmban dhe mbështetet nga:

(a) kopja e çdo urdhër-arresti për atë person;

(b) kopja e vendimit për dënim;

(c) informacioni për të demonstruar që personi i kërkuar është ai i përmendur në vendimin për dënim; dhe

(d) nëse personi i kërkuar është dënuar, kopja e dënimit të dhënë dhe, në rast të dënimit me burgim, deklarata për çdo afat të vuajtur dhe për kohën e mbetur të vuajtjes së dënimit.

4. Sipas kërkesës së Gjykatës, Shteti Palë këshillohet me Gjykatën, në mënyrë të përgjithshme ose në lidhje me një çështje specifike, në lidhje me cilëndo kërkesë sipas ligjit të tij kombëtar që mund të zbatohet sipas paragrafit 2 (c). Gjatë këshillimeve, Shteti Palë këshillon Gjykatën për kërkesat specifike të ligjit të tij kombëtar.

Neni 92

Arresti i përkohshëm

1. Në rastet urgjente, Gjykata mund të kërkojë arrestin e përkohshëm të personit të kërkuar, duke pritur paraqitjen e kërkesës për dorëzim dhe dokumentet në mbështetje të kërkesës ashtu siç është parashikuar në nenin 91.

2. Kërkesa për arrestin e përkohshëm bëhet me çdo mjet të aftë për dhënien e vendimit me shkrim dhe përmban:

(a) informacionin që përshkruan personin e kërkuar, të mjaftueshëm për të identifikuar personin, dhe informacionin në lidhje me vendndodhjen e mundshme të personit;

(b) një deklaratë të shkurtër për krimet për të cilat kërkohet arresti i personit dhe për faktet në të cilat prezumohet se përbëjnë ato krime, përfshirë këtu, kur është e mundur, datën dhe vendin e krimit;

(c) deklaratën mbi ekzistencën e urdhrit për arrestim ose vendimin për dënim ndaj personit të kërkuar; dhe

(d) deklaratën se do të pasojë kërkesa për dorëzimin e personit të kërkuar.

3. Personi i arrestuar përkohësisht mund të lirohet nga ndalimi nëse Shteti pritës nuk ka marrë kërkesën për dorëzim dhe dokumentet në mbështetje të kërkesës ashtu siç është parashikuar në nenin 91 brenda afateve kohore të specifikuara në Rregullat e Procedurës dhe Provave. Megjithatë, personi mund të pajtohet të dorëzohet para skadimit të këtij afati nëse është e lejuar sipas ligjit të Shtetit pritës. Në një rast të tillë, Shteti pritës vazhdon me dorëzimin e personit në Gjykatë sa më parë të jetë e mundur.

4. Fakti që personi i kërkuar është liruar nga ndalimi në përputhje me paragrafin 3 nuk ndikon mbi arrestin pasues dhe dorëzimin e atij personi nëse kërkesa për dorëzim dhe dokumentet në mbështetje të kësaj kërkese janë dorëzuar në një datë të mëvonshme.

Neni 93

Format e tjera të bashkëpunimit

1. Shtetet Palë, në pajtim me dispozitat e kësaj Pjese dhe sipas procedurave të ligjeve kombëtare, përmbushin kërkesat e Gjykatës për dhënien e ndihmës së mëposhtme, në lidhje me hetimet ose ndjekjet penale:

(a) identifikimin e vendndodhjes së personave ose vendin ku gjenden sendet;

(b) marrjen e provave, përfshirë këtu dëshminë e dhënë nën betim, dhe paraqitjen e provave, përfshirë mendimet e ekspertit dhe raportet e domosdoshme për Gjykatën;

(c) marrjen në pyetje të çdo personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet ose është në ndjekje penale;

(d) shërbimin e dokumenteve, përfshirë këtu dokumentet gjyqësore;

(e) mundësimin e paraqitjes vullnetare të personave si dëshmitarë ose ekspertë para Gjykatës;

(f) transferimin e përkohshëm të personave sipas parashikimit të paragrafit 7;

(g) ekzaminimin e vendeve ose vendndodhjeve, përfshirë këtu zhvarrosjen dhe ekzaminimin e varrezave;

(h) ekzekutimin e kontrolleve dhe konfiskimeve;

(i) paraqitjen e shënimeve dhe dokumenteve, përfshirë këtu shënimet dhe dokumentet zyrtare;

(j) mbrojtjen e viktimave e dëshmitarëve dhe ruajtjen e provave;

(k) identifikimin, gjetjen dhe ngrirjen ose konfiskimin e fitimeve, pronës dhe mjeteve e instrumenteve të krimeve për qëllimet e konfiskimit eventual, pa dëmtuar të drejtat e palëve të treta që veprojnë bona fide; dhe

(l) çfarëdo lloji tjetër të asistencës që nuk është e ndaluar me ligjin e Shtetit pritës, me qëllim të lehtësimit të hetimeve dhe ndjekjes së krimeve brenda juridiksionit të Gjykatës.

2. Gjykata ka autoritetin të sigurojë dëshmitarin ose ekspertin që paraqitet para Gjykatës se ai ose ajo nuk do të ndiqet, paraburgoset ose t'i nënshtrohet çfarëdo kufizimi të lirisë personale nga Gjykata në lidhje me çdo akt ose mangësi që i ka paraprirë largimit të atij personi nga Shteti pritës.

3. Kur ekzekutimi i masës së posaçme të asistencës së detajuar në kërkesë e të paraqitur në paragrafin 1 është e ndaluar në Shtetin pritës në bazë të një parimi themelor ligjor me zbatim të përgjithshëm, Shteti pritës këshillohet menjëherë me Gjykatën në përpjekje për zgjidhjen e çështjes. Në këshillime, do të duhej të merret në konsiderim nëse asistenca mund të jepet në ndonjë mënyrë tjetër ose t'i nënshtrohet kushteve. Nëse pas këshillimeve çështja nuk mund të zgjedhet, Gjykata ndryshon kërkesën sipas nevojës.

4. Në pajtim me nenin 72, Shteti Palë mund ta refuzojë kërkesën për bashkëpunim, tërësisht ose pjesërisht, vetëm nëse kërkesa ka të bëjë me paraqitjen e dokumenteve ose zbulimin e provave që kanë të bëjnë me sigurinë e tij kombëtare.

5. Para refuzimit të kërkesës për asistencë sipas paragrafit 1 (1), Shteti pritës shqyrton nëse asistenca mund të ofrohet duke ia nënshtruar atë kushteve specifike, ose asistenca mund të ofrohet më vonë ose në ndonjë mënyrë tjetër, kështu që nëse Gjykata ose Prokurori pranon asistencën sipas kushteve të dhëna, Gjykata ose Prokurori do t'i respektojnë ato.

6. Nëse kërkesa për asistencë refuzohet, Shteti Palëpritës informon menjëherë Gjykatën ose Prokurorin për arsyet e një refuzimi të tillë.

7. (a) Gjykata mund të kërkojë transferimin e përkohshëm të personit të ndaluar për qëllimet e identifikimit ose për të siguruar dëshmi ose asistencë tjetër. Personi mund të transferohet nëse plotësohen këto kushte:

(i) personi me vullnetin e tij të lirë jep pëlqimin e tij ose saj për transferim; dhe

(ii) Shteti pritës pajtohet me transferimin, duke iu nënshtruar kushteve të tilla me të cilat mund të pajtohen Shteti dhe Gjykata.

(b) Personi i transferuar do të mbetet në arrest. Pasi të plotësohen qëllimet e transferimit, Gjykata e kthen personin pa vonesë në Shtetin pritës.

8. (a) Gjykata siguron fshehtësinë e dokumenteve dhe informacionit, përveçse kur kërkohen për hetimin dhe gjykimin e përshkruar në kërkesë.

(b) Shteti pritës, kur është e domosdoshme, mund të përcjellë dokumentet dhe informacione te Prokurori mbi baza konfidencialiteti. Prokurori mund t'i përdorë ato vetëm me qëllim të nxjerrjes së provave të reja.

(c) Shteti pritës, sipas zgjedhjes së tij ose me kërkesë të Prokurorit, mund të japë pëlqimin e mëvonshëm për zbulimin e dokumenteve ose informatave të tilla. Ato pastaj mund të përdoren si provë në përputhje me dispozitat e Pjesëve 5 dhe 6, dhe në pajtim me Rregullat e Procedurës dhe Provave.

9. (a) (i) Në rast se Shteti Palë merr kërkesa që janë konkurruese, përveç atyre për dorëzim ose ekstradim, nga Gjykata dhe nga ndonjë Shtet tjetër në përputhje me detyrimin ndërkombëtar, Shteti Palë përpiqet, në kështillim me Gjykatën dhe Shtetin tjetër, të plotësojë të dyja kërkesat, nëse është e domosdoshme përmes shtyrjes ose shtimit të kushteve në njërën ose tjetrën kërkesë.

(ii) Nëse dështohet në këtë, kërkesat që janë konkurruese zgjidhen në pajtim me parimet e parashikuara në nenin 90.

(b) Kur, megjithatë, kërkesa nga Gjykata ka të bëjë me informacionin, pronën ose personat që i nënshtrohen kontrollit të një Shteti të tretë ose një organizate ndërkombëtare në respektim të një marrëveshjeje ndërkombëtare, Shtetet pritëse informojnë për këtë Gjykatën dhe Gjykata e drejton kërkesën e saj te Shteti i tretë ose tek organizata ndërkombëtare.

10. (a) Gjykata, sipas kërkesës, mund të bashkëpunojë dhe t'i ofrojë asistencë Shtetit Palë që është duke zhvilluar hetimet ose gjykimin në lidhje me veprën që paraqet krim brenda juridiksionit të Gjykatës ose që paraqet krim të rëndë sipas ligjit kombëtar të Shtetit dërgues.

(b) (i) Asistenca e ofruar sipas nënparagrafit (a) përfshin, inter alia:

a. transmetimin e deklaratave, dokumenteve ose llojeve të tjera të provave të siguruara gjatë procesit të hetimeve ose gjykimit të zhvilluar nga Gjykata; dhe

b. marrjen në pyetje të cilitdo person të ndaluar me urdhër të Gjykatës.

(ii) Në rast të asistencës sipas nënparagrafit (b) (i) (1):

a. nëse dokumentet ose llojet e tjera të provave janë siguruar me ndihmën e një Shteti, një transmetim i tillë kërkon pëlqimin e atij Shteti;

b. nëse deklaratat, dokumentet ose llojet e tjera të provave janë ofruar nga dëshmitari ose eksperti, një transmetim i tillë do t'i nënshtrohet dispozitave të nenit 68.

(c) Gjykata, në kushtet e paraqitura në këtë paragraf, mund të lëshojë kërkesën për asistencë sipas këtij paragrafi nga Shteti që nuk është Palë në këtë Statut.

Neni 94

Shtyrja e ekzekutimit të kërkesës për shkak të hetimit ose ndjekjes penale në zhvillim e sipër

1. Nëse ekzekutimi i menjëhershëm i kërkesës do të pengonte hetimin ose ndjekjen penale

në zhvillim e sipër për një çështje të ndryshme nga ajo me të cilën ka të bëjë kërkesa, Shteti pritës mund të shtyjë ekzekutimin e kërkesës për një periudhë kohore për të cilën do të merret vesh me Gjykatën. Megjithatë, shtyrja nuk do të jetë më e gjatë sesa është e nevojshme për të përfunduar hetimin ose ndjekjen penale në Shtetin pritës. Para marrjes së vendimit për shtyrje, Shteti pritës duhet të shqyrtojë nëse asistenca mund të ofrohet menjëherë nën disa kushte të caktuara.

2. Nëse vendimi për shtyrje është marrë në përputhje me paragrafin 1, Prokurori, megjithatë, mund të kërkojë masa për ruajtjen e provave, në përputhje me nenin 93, paragrafi 1 (j).

Neni 95

Shtyrja e ekzekutimit të kërkesës për kundërshtimin e pranueshmërisë

Kur kundërshtimi për pranueshmërinë është nën shqyrtimin e Gjykatës në përputhje me nenin 18 ose 19, Shteti pritës mund ta shtyjë ekzekutimin e kërkesës sipas kësaj Pjese në pritje të një vendimi nga Gjykata, nëse Gjykata nuk ka urdhëruar në mënyrë specifike që Prokurori mund të vazhdojë me mbledhjen e provave të tilla në përputhje me nenin 18 apo 19.

Neni 96

Përmbajtja e kërkesës për format e tjera të asistencës sipas nenit 93

1. Kërkesa për format e tjera të asistencës e përmendur në nenin 93, bëhet me shkrim. Në rastet urgjente, kërkesa mund të bëhet nga çdo mjet i aftë për dhënien e shënimit me shkrim, me kusht që kërkesa të konfirmohet përmes kanalit të parashikuar në nenin 87, paragrafi 1 (a).

2. Kërkesa, si e zbatueshme, përmban dhe mbështetet nga dokumentet e mëposhtme:

(a) deklaratë e shkurtër mbi qëllimin e kërkesës dhe asistencën e kërkuar, përfshirë këtu bazën ligjore dhe shkaqet e kërkesës;

(b) informacion sa më të detajuar që të jetë e mundur për vendndodhjen ose identifikimin e çdo personi ose vendi që mund të gjendet ose identifikohet në mënyrë që të sigurohet asistenca e kërkuar;

(c) deklarata e shkurtër mbi faktet thelbësore që gjenden në kërkesë;

(d) arsyet dhe detajet për çdo procedurë ose kërkesë pasuese;

(e) informata të tilla që mund të kërkohen nga ligjet e Shtetit pritës, në mënyrë që të bëhet ekzekutimi i kërkesës; dhe

(f) çdo informatë tjetër e rëndësishme në mënyrë që asistenca e kërkuar të sigurohet.

3. Me kërkesë të Gjykatës, Shteti Palë këshillohet me Gjykatën, në përgjithësi ose edhe në lidhje me një çështje specifike e që ka të bëjë me kërkesat e ligjeve të tij kombëtare që mund të zbatohen sipas paragrafit 2 (e). Gjatë këshillimeve, Shteti Palë këshillon Gjykatën për kërkesat specifike të ligjit të tij kombëtar.

4. Dispozitat e këtij neni, kur janë të zbatueshme, zbatohen po ashtu në lidhje me kërkesën për asistencë bërë Gjykatës.

Neni 97

Këshillimet

Kur Shteti Palë merr një kërkesë sipas kësaj Pjese e në lidhje me të cilën identifikon problemet të cilat mund të pengojnë ose ndalojnë ekzekutimin e kërkesës, ai Shtet këshillohet me Gjykatën pa vonesë, në mënyrë që të zgjidhet çështja. Problemet e tilla mund të përfshijnë, inter alia:

(a) informacionin e pamjaftueshëm për të ekzekutuar kërkesën;

(b) në rast të kërkesës për dorëzim, faktin që, pavarësisht nga përpjekjet më të mira, personi i kërkuar nuk mund të gjendet ose që hetimi i zhvilluar ka përcaktuar që personi në Shtetin pritës, qartazi nuk është personi i përcaktuar në urdhrin për arrest; ose

(c) fakti që ekzekutimi i kërkesës në formën e saj të tanishme do të kërkonte që Shteti të cilit i drejtohet kërkesa të shkelë detyrimin nga një traktat i mëparshëm i lidhur me një Shtet tjetër.

Neni 98

Bashkëpunimi për heqjen dorë nga imuniteti dhe pëlqimi për dorëzim

1. Gjykata mund të mos veprojë në lidhje me kërkesën për dorëzim ose asistencë, e cila do të kërkonte nga Shteti pritës që të vepronte në mënyrë të papajtueshme me detyrimet e tij sipas së drejtës ndërkombëtare në lidhje me Shtetin ose imunitetin diplomatik të personit ose pronës së Shtetit të tretë, përveçse kur Gjykata mund të sigurojë më parë bashkëpunimin e atij Shteti të tretë për heqjen nga imuniteti.

2. Gjykata mund të mos veprojë në lidhje me kërkesën për dorëzim, që do të kërkonte nga Shteti pritës që të vepronte në kundërshtim me detyrimin e tij sipas marrëveshjeve ndërkombëtare në lidhje me pëlqimin që kërkohet nga Shteti dërgues për të dorëzuar personin e atij Shteti në Gjykatë, përveçse kur Gjykata mund të sigurojë më parë bashkëpunimin e Shtetit dërgues për dhënien e pëlqimit për dorëzim.

Neni 99

Ekzekutimi i kërkesave sipas neneve 93 dhe 96

1. Kërkesat për asistencë ekzekutohen në pajtim me procedurat përkatëse sipas ligjit të Shtetit pritës dhe, përveç nëse është e ndaluar me një ligj të tillë, në mënyrën e specifikuar në kërkesë, përfshirë këtu zhvillimin e çdo procedure të përcaktuar këtu ose lejimin e personave të caktuar në kërkesë që të jenë të pranishëm dhe të ndihmojnë në procesin e ekzekutimit.

2. Në rast të një kërkese urgjente, dokumentet ose provat e dhëna në përgjigje të saj dërgohen urgjentisht me kërkesë të Gjykatës.

3. Përgjigjet nga Shteti pritës transmetohen në gjuhën dhe formën e tyre origjinale.

4. Pa cenuar nenet e tjera në këtë Pjesë, kur është e domosdoshme për ekzekutimin suksesshëm të kërkesës pa përdorimin e masave shtrënguese, përfshirë këtu në mënyrë specifike intervistën ose marrjen e dëshmive nga personi në baza vullnetare, përfshirë bërjen e kësaj pa praninë e autoriteteve të Shtetit Palë pritës nëse është esenciale për ekzekutimin e kërkesës dhe shqyrtimin pa ndryshimin e pozitës ose vendit tjetër publik, Prokurori mund të ekzekutojë kërkesën e tillë drejtpërdrejt në territorin e Shtetit si vijon:

(a) Kur Shteti Palë pritës është Shteti në territorin e të cilit pohohet se është kryer krimi, dhe se përcaktimi për pranueshmërinë e çështjes është bërë në përputhje me nenin 18 ose 19, Prokurori mund ta ekzekutojë një kërkesë të tillë në mënyrë direkte pas të gjitha këshillimeve të mundshme me Shtetin Palë pritës.

(b) Në raste të tjera, Prokurori mund të ekzekutojë kërkesën e tillë pas këshillimeve me Shtetin Palë pritës dhe kushtëzuar nga kushtet e arsyeshme ose çështjet e paraqitura nga ai Shtet Palë. Kur Shteti Palë pritës identifikon probleme në lidhje me ekzekutimin e kërkesës në përputhje me këtë nënparagraf, ai këshillohet pa vonesë me Gjykatën për zgjidhjen e çështjes.

5. Dispozitat që lejojnë një person të dëgjuar ose të kontrolluar nga Gjykata sipas nenit 72 t'u referohet kufizimeve të caktuara për të parandaluar zbulimin e informacionit konfidencial që kanë lidhje me sigurinë kombëtare zbatohen po ashtu për ekzekutimin e kërkesave për asistencë sipas këtij neni.

Neni 100

Shpenzimet

1. Shpenzimet e zakonshme për ekzekutimin e kërkesave në territorin e Shtetit pritës mbulohen nga ai Shtet, përveç shpenzimeve të mëposhtme, të cilat mbulohen nga Gjykata:

(a) shpenzimet për udhëtimin dhe sigurinë e dëshmitarëve dhe ekspertëve ose për transferimin sipas nenit 93 të personave në ndalim;

(b) shpenzimet e përkthimit, interpretimit dhe transkriptimit;

(c) shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit për gjyqtarët, Prokurorin, Zëvendësprokurorët, Referentin, Zëvendësreferentin dhe të punësuarit e çdo organi të Gjykatës;

(d) shpenzimet për çdo ekspertizë ose raporti të kërkuar nga Gjykata;

(e) shpenzimet në lidhje me transportimin e personit të dorëzuar në Gjykatë nga Shteti që ka të drejtën e ndalimit; dhe

(t) këshillimet pasuese, çdo shpenzim të veçantë që mund të rezultojë nga ekzekutimi i kërkesës.

2. Dispozitat e paragrafit 1, ku është e duhur, zbatohen për kërkesat nga Shtetet Palë në Gjykatë. Në atë rast, Gykata mbulon shpenzimet e zakonshme të ekzekutimit.

Neni 101
Rregulli i veçantë

1. Personi i dorëzuar në Gjykatë sipas këtij Statuti nuk ndiqet penalisht, nuk dënohet ose ndalohet për asnjë vepër të kryer para dorëzimit, përveç sjelljes ose serisë së sjelljeve që formon bazën e krimeve për të cilat ai person është dorëzuar.

2. Gjykata mund të kërkojë heqjen dorë nga kërkesat e paragrafit 1 nga Shteti që ka dorëzuar personin në Gjykatë dhe, nëse është e domosdoshme, Gjykata siguron informacion shtesë në pajtim me nenin 91. Shtetet Palë kanë autorizimin t'i ofrojnë dokumentin e heqjes dorë Gjykatës dhe duhet të përpiqen ta bëjnë këtë.

Neni 102
Përdorimi i shprehjeve

Për qëllimet e këtij Statuti:

(a) "dorëzim" do të thotë dërgimi i një personi në Gjykatë nga ana e Shtetit, në përputhje me këtë Statut;

(b) "ekstradim" do të thotë dorëzimi i një personi nga ana e një Shteti në Shtetin tjetër, ashtu siç përcaktohet në traktat, konventë ose legjislacion kombëtar.

PJESA 10
ZBATIMI I LIGJIT

Neni 103
Roli i Shteteve në zbatimin e dënimeve me burgim

1.(a) Dënimi me burgim vuhet në Shtetin e caktuar nga Gjykata nga lista e Shteteve që i kanë shfaqur Gjykatës dëshirën e tyre për të pranuar personat e dënuar.

(b) Në kohën e shfaqjes së dëshirës së tij për të pranuar personat e dënuar, Shteti mund të bashkëngjisë kushtet në pranimin e saj, ashtu siç është rënë dakord me Gjykatën dhe në pajtim me këtë Pjesë.

(c) Shteti i emëruar në rastin e veçantë duhet të informojë menjëherë Gjykatën nëse e pranon përcaktimin e bërë nga Gjykata.

2. (a) Shteti zbatues njofton Gjykatën për të gjitha rrethanat, përfshirë këtu edhe ushtrimin e cilado kushteve të parashikuara sipas paragrafit 1, të cilat do të mund të ndikonin materialisht në kushtet ose zgjatjen e burgimit. Gjykatës i jepet njoftim të paktën 45 ditë më parë në lidhje me çfarëdo rrethana të ditura ose të parashikueshme. Gjatë kësaj periudhe, Shteti zbatues nuk ndërmerr asnjë veprim që do të të cenonte obligimet e tij sipas nenit 110.

(b) Kur Gjykata nuk mund të bjerë dakord me rrethanat e përmendura në nënparagrafin (a), ajo njofton Shtetin zbatues dhe vepron në pajtim me nenin 104, paragrafi 1.

3. Në ushtrimin e bindjes së saj për të bërë përcaktimin sipas paragrafit 1, Gjykata merr parasysh:

(a) parimin që Shtetet Palë duhet të ndajnë përgjegjësinë e zbatimit të dënimeve me burgim, në pajtim me parimet e ndarjes së barabartë, ashtu siç është mundësuar në Rregullat e Procedurës dhe Provave;

(b) zbatimin e standardeve ndërkombëtare të traktateve të pranuara gjerësisht mbi trajtimin e të burgosurve;

(c) pikëpamjet e personit të dënuar;

(d) nacionalitetin e personit të dënuar;

(e) faktorë të tjerë që kanë të bëjnë me rrethanat e krimit, me personin e dënuar, ose me zbatimin efektiv të dënimit, ashtu siç është e nevojshme për caktimin e Shtetit zbatues.

4. Nëse asnjë Shtet nuk është caktuar sipas paragrafit 1, dënimi me burgim vuhet në ndërtesën e burgut të ofruar nga Shteti që ka të drejtën e ndalimit, në pajtim me kushtet e paraqitura në marrëveshjen e selisë të përmendur në nenin 3, paragrafi 2. Në këtë rast, shpenzimet që dalin nga zbatimi i dënimit me burgim mbulohen nga Gjykata.

Neni 104
Ndryshimi në caktimin e Shtetit zbatues

1. Gjykata, në çdo kohë, mund të marrë vendim që të transferojë personin e dënuar në burgun e një Shteti tjetër.

2. Personi i dënuar, në çdo kohë, mund të kërkojë nga Gjykata të transferohet nga Shteti i zbatimit.

Neni 105
Zbatimi i dënimit

1. Në bazë të kushteve të cilat Shteti ka mundur t'i përcaktojë në pajtim me nenin 103, paragrafi 1 (b), dënimi me burgim është detyrues për Shtetet Palë, të cilat në asnjë rast nuk e ndryshojne atë.

2. Vetë Gjykata ka të drejtë të vendosë për çdo kërkesë për ankesë dhe rishikim. Shteti zbatues nuk pengon bërjen e asnjë kërkese të tillë nga personi i dënuar.

Neni 106
Mbikëqyrja e zbatimit të dënimeve dhe kushteve të burgimit

1. Zbatimi i dënimit me burgim i nënshtrohet mbikëqyrjes së Gjykatës dhe është në përputhje me standardet ndërkombëtare të traktateve të pranuara gjerësisht mbi trajtimin e të burgosurve.

2. Kushtet e burgimit rregullohen nga ligji i Shtetit zbatues dhe janë në pajtim me standardet ndërkombëtare të traktateve të pranuara gjerësisht mbi trajtimin e të burgosurve; në asnjë rast kushtet e tilla nuk janë më shumë ose më pak të favorshme se sa ato të ofruara për të burgosurit e dënuar për veprat e njëjta në Shtetin zbatues.

3. Komunikimet ndërmjet personit të dënuar dhe Gjykatës janë të papenguara dhe konfidenciale.

Neni 107
Transferimi i personit pas përfundimit të dënimit

1. Pas përfundimit të dënimit, personi që është shtetas i Shtetit zbatues, në pajtim me ligjin e

Shtetit të zbatimit, mund të transferohet në Shtetin që është i detyruar ta pranojë atë ose në Shtetin tjetër që bie dakord ta pranojë atë, duke marrë parasysh çfarëdo dëshire të personit që do të transferohet në atë Shtet, përveçse kur Shteti i zbatimit e autorizon personin të mbetet në territorin e tij.

2. Nëse asnjë Shtet nuk i siguron shpenzimet që rrjedhin nga transferimi i personit në Shtetin tjetër në përputhje me paragrafin 1, këto shpenzime i mbulon Gjykata.

3. Bazuar në dispozitat e nenit 108, Shteti zbatues mundet po ashtu, në pajtim me ligjin e tij kombëtar, të ekstradojë ose të dorëzojë në ndonjë mënyrë tjetër personin në Shtetin që ka kërkuar ekstradimin ose dorëzimin e personit me qëllim të gjykimit ose zbatimit të dënimit.

Neni 108

Kufizimi në ndjekje penale ose ndëshkimi i shkeljeve të tjera

1. Personi i dënuar në mbikëqyrje të Shtetit zbatues nuk i nënshtrohet ndjekjes penale, ndëshkimit ose ekstradimit në Shtetin e tretë për çfarëdo vepër në të cilën ka qenë i angazhuar para dorëzimit të atij personi në Shtetin zbatues, përveç nëse një ndekje, ndëshkim ose ekstradim i tillë është aprovuar nga Gjykata me kërkesë të Shtetit zbatues.

2. Gjykata vendos për çështjen pasi të ketë dëgjuar pikëpamjet e personit të dënuar.

3. Paragrafi 1 pushon së zbatuari nëse personi i dënuar mbetet vullnetarisht për më shumë se 30 ditë në territorin e Shtetit zbatues pasi të ketë vuajtur dënimin e plotë të dhënë nga Gjykata ose kthehet në territorin e atij Shteti pasi është larguar një herë.

Neni 109

Zbatimi i gjobave dhe masave të konfiskimit

1. Shtetet Palë zbatojnë gjobat ose konfiskimet e urdhëruara nga Gjykata sipas Pjesës 7, pa dëmtuar të drejtat e palëve të treta që veprojnë bona fide, në pajtim me procedurën e ligjeve të tyre kombëtare.

2. Nëse Shteti Palë nuk ka mundësi të zbatojë një urdhër për konfiskim, ai merr masa për të kthyer vlerën e fitimeve, pronës ose mjeteve për të cilat Gjykata ka urdhëruar konfiskimin, pa dëmtuar të drejtat e palëve të treta që veprojnë bona fide.

3. Prona, ose fitimet nga shitja e pasurisë së patundshme ose, kur është e volitshme, shitja e ndonjë pasurie tjetër, që është siguruar nga Shteti Palë si rezultat i zbatimit të vendimit të Gjykatës transferohet në Gjykatë.

Neni 110

Rishqyrtimi i zvogëlimit të dënimit nga Gjykata

1. Shteti zbatues nuk liron personin para skadimit të dënimit të dhënë nga Gjykata.

2. Vetë Gjykata ka të drejtë të vendosë për çdo zvogëlim të dënimit dhe vendos për çështjen pasi të ketë dëgjuar personin.

3. Kur personi ka vuajtur dy të tretat e dënimit ose 25 vjet në rast të burgimit të përjetshëm, Gjykata rishqyrton dënimin për të përcaktuar nëse ai do të zvogëlohet. Një rishqyrtim i tillë nuk zhvillohet para asaj kohe.

4. Në rishqyrtimin e saj sipas paragrafit 3, Gjykata mund të zvogëlojë dënimin nëse shikon se një ose më shumë nga faktorët janë të pranishëm në vijim:

(a) gatishmëria e hershme dhe e vazhdueshme e personit për të bashkëpunuar me Gjykatën në hetimet dhe ndjekjet penale të saj;

(b) asistenca vullnetare e personit në mundësimin e zbatimit të vendimeve dhe urdhërave të Gjykatës në raste të tjera, dhe sidomos ofrimi i ndihmës në gjetjen e mjeteve që janë lëndë e urdhrave për gjobë, konfiskim ose rikthim e që mund të përdoren në dobi të viktimave; ose

(c) faktorë të tjerë që krijojnë një ndryshim të qartë dhe të rëndësishëm të rrethanave, të

mjaftueshëm për të arsyetuar zvogëlimin e dënimit, ashtu siç është parashikuar në Rregullat e Procedurës dhe Provave.

5. Nëse Gjykata vendos në rishqyrtimin e saj fillestar sipas paragrafit 3 se nuk është e nevojshme të zvogëlohet dënimi, ajo rishqyrton pas kësaj çështjen e zvogëlimit të dënimit në intervale të tilla dhe me zbatimin e kritereve që janë rregulluar në Rregullat e Procedurës dhe Provave.

Neni 111
Ikja

Nëse personi i dënuar arratiset nga ndalimi dhe ikën nga Shteti zbatues, ai Shtet, pas këshillimit me Gjykatën, mund të kërkojë dorëzimin e personit nga Shteti në të cilin gjendet personi në përputhje me marrëveshjet ekzistuese dypalëshe e shumëpalëshe ose mund të kërkojë që Gjykata të bëjë përpjekje për dorëzimin e personit. Ajo mund të urdhërojë që personi të dorëzohet në Shtetin në të cilin ai ose ajo ka qenë duke vuajtur dënimin ose në një Shtet tjetër të caktuar nga Gjykata.

PJESA 11
ASAMBLEJA E SHTETEVE PALË

Neni 112
Asambleja e Shteteve Palë

1. Themelohet Asambleja e Shteteve Palë në këtë Statut. Secili Shtet Palë ka një përfaqësues në Asamble, që mund të shoqërohet nga zëvendësit dhe këshilltarët. Shtetet e tjera që kanë nënshkruar këtë Statut ose Aktin Final mund të jenë vëzhgues në Asamble.

2. Asambleja do të:

(a) shqyrtojë dhe miratojë, si të përgatitura mirë, rekomandimet e Komisionit Përgatitor;

(b) sigurojë mbikëqyrjen e menaxhimit për Kryesinë, Prokurorin dhe Referentin në lidhje me administrimin e Gjykatës;

(c) shqyrtojë raportet dhe aktivitetet e Byrosë së themeluar sipas paragrafit 3 dhe merr masat e duhura në lidhje me të;

(d) shqyrtojë dhe vendosë për buxhetin e Gjykatës;

(e) vendosë nëse do të ndryshojë numrin e gjyqtarëve, në pajtim me nenin 36:

(f) shqyrtojë në përputhje me nenin 87, paragrafët 5 dhe 7, çdo çështje në lidhje me mosbashkëpunimin;

(g) kryejë çfarëdo funksioni tjetër në pajtim me këtë Statut ose me Rregullat e Procedurës dhe Provave.

3. (a) Asambleja ka Byronë të përbërë nga Kryetari, dy Nënkryetarët dhe 18 anëtarë të zgjedhur nga Asambleja për një periudhë trevjeçare.

(b) Byroja ka karakter përfaqësues, duke marrë parasysh, në veçanti, shpërndarjen e barabartë gjeografike dhe përfaqësimin e duhur të sistemeve kryesore ligjore të botës.

(c) Byroja takohet sa herë është e nevojshme, por të paktën një herë në vit. Ajo ndihmon Asamblenë në ushtrimin e përgjegjësive të saj.

4. Asambleja mund të themelojë organe plotësuese që janë të nevojshme, përfshirë këtu edhe një mekanizëm të pavarur mbikëqyrës për inspektimin, vlerësimin dhe hetimin e Gjykatës, në mënyrë që të rrisë efikasitetin dhe ekonomizimin e saj.

5. Kryetari i Gjykatës, Prokurori dhe Referenti ose përfaqësuesit e tyre, mund të marrin pjesë, nëse është e nevojshme, në takimet e Asamblesë dhe Byrosë.

6. Asambleja takohet në selinë e Gjykatës ose në selinë e Kombeve të Bashkuara një herë në vit dhe, kur rrethanat e kërkojnë një gjë të tillë, mbajnë seanca të veçanta. Nëse nuk është specifikuar ndryshe në këtë Statut, seancat e veçanta thirren nga Byroja sipas iniciativës së saj ose me kërkesë të një të tretës së Shteteve Palë.

7. Secili Shtet Palë ka një votë. Duhet bërë çdo përpjekje që vendimet të merren me konsensus në Asamble dhe Byro. Nëse konsensusi nuk mund të arrihet, përveçse kur parashikohet ndryshe në Statut:

(a) vendimet në çështjet me rëndësi duhet të aprovohen nga shumica e dy të tretave të Shteteve të pranishme e votuese, kështu që shumica absolute e Shteteve Palë përbën numrin e nevojshëm vendimmarrës;

(b) vendimet në çështjet procedurale merren nga shumica e thjeshtë e Shteteve Palë, të pranishme dhe votuese.

8. Shteti Palë që është në vonesë rreth pagimit të kontributeve të tij financiare ndaj shpenzimeve të Gjykatës, nuk ka të drejtë të votojë në Asamble dhe Byro nëse shuma e borxheve të tij është e barabartë ose kalon shumën e kontributeve të caktuara nga ajo për dy vite të plota të mëparshme. Asambleja, megjithatë, mund të lejojë një Shtet të tillë Palë të votojë në Asamble dhe Byro nëse krijon bindje se mospagesa është shkaktuar nga kushtet që janë jashtë kontrollit të Shtetit Palë.

9. Asambleja miraton rregullat e veta të procedurës.

10. Gjuhët zyrtare dhe të punës të Asamblesë janë ato të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

PJESA 12
FINANCIMI

Neni 113
Rregulloret financiare

Përveçse kur është rregulluar ndryshe në mënyrë specifike, të gjitha çështjet financiare në lidhje me Gjykatën dhe takimet e Asamblesë së Shteteve Palë, përfshirë edhe Byronë dhe organet plotësuese, rregullohen nga ky Statut dhe Rregulloret Financiare e Rregullat e miratuara nga Asambleja e Shteteve Palë.

Neni 114
Pagesa e shpenzimeve

Shpenzimet e Gjykatës dhe Asamblesë së Shteteve Palë, përfshirë Byronë e saj dhe trupat plotësues, paguhen nga fondet e Gjykatës.

Neni 115
Fondet e Gjykatës dhe të Asamblesë së Shteteve Palë

Shpenzimet e Gjykatës dhe të Asamblesë së Shteteve Palë, përfshirë Byronë e saj dhe trupat plotësues, ashtu si është rregulluar në buxhetin e caktuar nga Asambleja e Shteteve Palë, sigurohen nga këto burime:

(a) kontributet e caktuara nga Shtetet Palë;

(b) fondet e siguruara nga Kombet e Bashkuara, që duhen aprovuar nga Asambleja e Përgjithshme, sidomos në lidhje me shpenzimet e paraqitura për shkak të rekomandimeve nga Këshilli i Sigurimit.

Neni 116
Kontributet vullnetare

Brenda kushteve të nenit 115, Gjykata mund të pranojë dhe shfrytëzojë fondet plotësuese, kontributet vullnetare nga Qeveritë, organizatat ndërkombëtare, individët, korporatat dhe personat e tjerë juridikë, në pajtim me kriteret relevante të miratuara nga Asambleja e Shteteve Palë.

Neni 117
Vlerësimi i kontributeve

Kontributet e Shteteve Palë vlerësohen në pajtim me shkallën e vlerësimit bazuar në shkallën e miratuar nga Kombet e Bashkuara për buxhetin e saj të rregullt dhe të përshtatur në pajtim me parimet në të cilat ajo shkallë është bazuar.

Neni 118
Kontrolli financiar vjetor

Shënimet, librat dhe llogaritë e Gjykatës, përfshirë këtu deklaratat e saj financiare vjetore, kontrollohen nga një kontrollor i pavarur.

PJESA 13
KLAUZOLAT PËRFUNDIMTARE

Neni 119
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje që ka të bëjë me funksionet gjyqësore të Gjykatës zgjidhet me vendim të Gjykatës.

2. Çdo mosmarrëveshje tjetër në mes dy ose më shumë Shteteve Palë në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtij Statuti që nuk është rregulluar përmes negociatave brenda afatit prej tre muajve nga paraqitja e tyre paraqitet në Asamblenë e Shteteve Palë. Asambleja mundet edhe vetë të kërkojë mënyra për të zgjidhur mosmarrëveshjen ose të bëjë rekomandime mbi mënyrat e mëtejme të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, përfshirë këtu edhe sjelljen e rastit në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë në përputhje me Statutin e asaj Gjykate.

Neni 120
Rezervimet

Këtij Statuti nuk mund t'i bëhet asnjë rezervë.

Neni 121
Amendamentet

1. Pas skadimit të afatit shtatëvjeçar nga hyrja në fuqi e këtij Statuti, cilido Shtet Palë mund të propozojë amendamente.Teksti i cilitdo amendament të propozuar i dorëzohet Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili e shpërndan atë menjëherë në të gjitha Shtetet Palë.

2. Jo më shpejt se tre muaj nga data e njoftimit, Asambleja e Shteteve Palë, në takimin e saj të ardhshëm, me shumicë votash të atyre që janë të pranishëm dhe që votojnë, vendos nëse do ta pranojë propozimin. Asambleja mund të merret me propozimin e drejtpërdrejtë ose të thërrasë Konferencën për Rishqyrtim nëse çështja në fjalë e kërkon një gjë të tillë.

3. Miratimi i një amendamenti në takimin e Shteteve Palë ose në Konferencën për Rishqyrtim në të cilën nuk mund të arrihet konsensusi, kërkon shumicën e dy të tretave të Shteteve Palë.

4. Nëse nuk është parashikuar ndryshe në paragrafin 5, amendamenti hyn në fuqi për të gjitha Shtetet Palë një vit pasi instrumentet e ratifikimit ose pranimit të jenë dorëzuar nga shtatë të tetat prej tyre te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

5. Çdo amendament i nenit 5 të këtij Statuti hyn në fuqi për ato Shtete Palë që kanë pranuar amendamentin një vit pas depozitimit të instrumenteve të tyre të ratifikimit ose pranimit. Përsa i përket Shtetit Palë që nuk ka pranuar amendamentin, Gjykata nuk e ushtron juridiksionin e saj kur

ka të bëjë me krimin që mbulohet nga amendamenti dhe kur është kryer nga shtetasit e atij Shteti Palë ose në territorin e tij.

6. Nëse amendamenti është pranuar nga shtatë të tetat e Shteteve Palë në pajtim me paragrafin 4, cilido Shtet Palë që nuk ka pranuar amendamentin, mund të tërhiqet nga ky Statut me efekt të menjëhershëm, pavarësisht nga neni 127, paragrafi 1, por kushtëzuar nga neni 127, paragrafi 2, përmes dhënies së njoftimit jo më vonë se një vit pas hyrjes në fuqi të një amendamenti të tillë.

7. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara shpërndan te të gjitha Shtetet Palë çdo amendament të miratuar në takimin e Asamblesë së Shteteve Palë ose në Konferencën për Rishqyrtim.

Neni 122

Amendamentet në dispozitat e natyrës institucionale

1. Amendamentet në dispozitat e këtij Statuti, që janë të natyrës ekskluzivisht institucionale, që janë: neni 35, neni 36, paragrafët 8 dhe 9, neni 37, neni 38, neni 39 paragrafët 1 (dy fjalitë e para), 2 dhe 4, neni 42 paragrafët 4 deri 9, neni 43 paragrafët 2 dhe 3, dhe nenet 44, 46, 47 e 49, mund të propozohen në çdo kohë, pavarësisht nga neni 121, paragrafi 1, nga cilido Shtet Palë. Teksti i çdo amendamenti të propozuar i dorëzohet Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara ose një personi tjetër të caktuar nga Asambleja e Shteteve Palë dhe i cili e shpërndan atë menjëherë te të gjitha Shtetet Palë dhe te të tjerët që marrin pjesë në Asamble.

2. Amendamentet sipas këtij neni për të cilat nuk mund të arrihet konsensusi, miratohen nga Asambleja e Shteteve Palë ose Konferenca për Rishqyrtim, nga shumica e dy të tretave të Shteteve Palë. Amendamentet e tilla hyjnë në fuqi në çfarëdo kohe të mëvonshme, me kërkesë të Shtetit Palë dhe për qëllimet e parashtruara në paragrafin 1. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, pas aprovimit nga shumica e Shteteve Palë, thërret Konferencën për Rishqyrtim.

3. Dispozitat e nenit 121 paragrafët 3 deri 7, zbatohen për miratimin dhe hyrjen në fuqi të cilitdo amendament në Statut, të shqyrtuara në Konferencën për Rishqyrtim.

Neni 123

Dispozita kalimtare

Pavarësisht nga neni 12 paragrafi 1, Shteti, me rastin e anëtarësimit në këtë Statut, mund të deklarojë se, për një periudhë shtatëvjeçare pas hyrjes në fuqi të këtij Statuti për atë Shtet, ai nuk e pranon juridiksionin e Gjykatës në lidhje me kategorinë e krimeve të përmendura në nenin 8 kur pohohet se krimi është kryer nga shtetasit e tij ose në territorin e tij. Deklarata sipas këtij neni mund të tërhiqet në çdo kohë. Dispozitat e këtij neni rishqyrtohen në Konferencën për Rishqyrtim të thirrur në pajtim me nenin 123 paragrafi 1.

Neni 124

Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, aprovimi ose aderimi

1. Ky Statut është hapur për nënshkrim nga të gjitha Shtetet në Romë, në selinë e Organizatës për Ushqim e Bujqësi të Kombeve të Bashkuara, më 17 korrik 1998. Prandaj, ai do të mbetet i hapur për nënshkrim në Romë në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Italisë deri më 17 tetor 1998. Pas kësaj date, Statuti do të mbetet i hapur për nënshkrim në Njujork, në selinë e Kombeve të Bashkuara, deri më 31 dhjetor 2000.

2. Ky Statut i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose aprovimit nga Shtetet nënshkruese. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose aprovimit depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

3. Ky Statut mbetet i hapur për aderim nga të gjitha Shtetet. Instrumentet e marrëveshjes depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Neni 125
Hyrja në fuqi

1. Ky Statut hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas ditës së 60 nga dita e depozitimit të instrumentit të 60 të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

2. Për secilin Shtet që ratifikon, pranon, aprovon ose aderon në këtë Statut pas depozitimit të instrumentit të 60 të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit, Statuti hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të afatit prej 60 ditëve prej depozitimit nga ana e atij Shteti të instrumenteve të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

Neni 126
Tërheqja

1. Shteti Palë, përmes njoftimit me shkrim të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, mund të tërhiqet nga ky Statut. Tërheqja bëhet e efektshme një vit prej datës së pranimit të njoftimit, përveçse kur njoftimi specifikon një datë të mëvonshme.

2. Shteti nuk shkarkohet, për shkak të tërheqjes, nga detyrimet që rrjedhin prej këtij Statuti për kohën që ishte Palë në Statut, përfshirë këtu çdo detyrim financiar që mund të jetë paraqitur. Tërheqja e tij nuk ndikon në asnjë lloj bashkëpunimi me Gjykatën në lidhje me hetimet penale dhe procedurat për të cilat Shteti që tërhiqet ka qenë i detyruar të bashkëpunojë dhe të cilat kanë filluar para datës në të cilën tërheqja është bërë e efektshme, dhe nuk e cënon aspak vazhdimin e shqyrtimit të çdo çështjeje që është marrë në shqyrtim nga Gjykata para datës në të cilën tërheqja është bërë e efektshme.

Neni 127
Tekstet autentike

Origjinali i këtij Statuti, tekstet e të cilit në gjuhën arabe, kineze, angleze, frënge, ruse e spanjolle janë njëlloj autentike, depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, i cili u dërgon kopje të vërtetuara të gjitha Shteteve.

Në dëshmi të kësaj, të poshtëshënuarit, duke qenë rregullisht të autorizuar nga Qeveritë e tyre, kanë nënshkruar këtë Statut.

Bërë në Romë, më 17 korrik 1998.

LIGJ
Nr. 8985, datë 23.12.2002

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES EVROPIANE PËR PERSONAT PJESËMARRËS NË PROCEDURAT PARA GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 e 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja evropiane për personat pjesëmarrës në procedurat para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut", bërë në Strasburg, më 5.3.1996.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3667, datë 17.1.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu.

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.91, faqe 2706

MARRËVESHJA
EVROPIANE PËR PERSONAT PJESËMARRËS NË PROCEDURAT PARA GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Strasburg, 5.3.1996
Seria e Marrëveshjeve Evropiane nr. 161.
Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, nënshkrues të kësaj Marrëveshjeje,
Duke patur parasysh Konventën Europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, nënshkruar në Romë, më 4 nëntor 1950 (në vazhdim e quajtur "Konventa");
Duke patur parasysh Marrëveshjen Evropiane për personat pjesëmarrës në procedurat e Komisionit dhe Gjykatës Europiane për të drejtat e njeriut, nënshkruar në Londër, më 6 maj 1969;
Duke patur parasysh Protokollin nr. 11 të Konventës mbi ristrukturimin e mekanizmit kontrollues të dhënë nga Konventa, nënshkruar në Strasburg, më 11 maj 1994 (në vazhdim të quajtur "Protokolli nr. 11 i Konventës"), i cili vendos krijimin e një Gjykate Evropiane për të drejtat e njeriut;
Duke marrë në konsideratë, nën dritën e këtij zhvillimi, se është e përshtatshme për përmbushjen më mirë të objektivave të Konventës që personave pjesëmarrës në procedurat para Gjykatës t'u jepen disa imunitete dhe lehtësira nëpërmjet një Marrëveshjeje të re, Marrëveshja Evropiane për Personat Pjesëmarrës në Procedurat para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vazhdim të quajtur "Marrëveshja").
Kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1

1. Personat ndaj të cilëve zbatohet Marrëveshja janë:

a) çdo person që merr pjesë në procedurat para Gjykatës si palë ose si përfaqësues ose këshilltar i një pale;

b) dëshmitarë dhe ekspertë të thirrur nga Gjykata si edhe persona të tjerë të ftuar nga Presidenti i Gjykatës për të marrë pjesë në procedura.

2. Për qëllimet e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, termi "Gjykatë" përfshin komitetet, dhomat, Kolegjin e Dhomës së Madhe, Dhomën e Madhe dhe gjyqtarët. Shprehja "pjesëmarrje në procedura" përfshin dhe bërjen e komunikimeve me qëllim parashtrimin e një ankese kundër një shteti palë në Konventë.

3. Në rast se gjatë ushtrimit nga Komiteti i Ministrave të funksioneve të dhëna sipas nenit 46 paragrafi 2 të Konventës, çdo person i përmendur në paragrafin 1 më sipër thirret të paraqitet para tij ose t'i paraqesë deklarata me shkrim Komitetit të Ministrave, për këtë person zbatohen parashikimet e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

1. Personat e treguar në paragrafin 1 të nenit 1 të kësaj Marrëveshjeje gëzojnë imunitet juridiksioni për deklarimet e tyre me shkrim ose me gojë të bëra para Gjykatës, si edhe për dokumentet dhe provat e tjera të paraqitura prej tyre Gjykatës.

2. Ky imunitet nuk zbatohet për komunikime jashtë Gjykatës të deklaratave të bëra ose dokumenteve dhe provave të paraqitura Gjykatës.

Neni 3

1. Palët Kontraktuese respektojnë të drejtën e personave të treguar në paragrafin 1 të nenit 1 të kësaj Marrëveshjeje për të komunikuar lirisht me Gjykatën.

2. Për personat e burgosur, ushtrimi i kësaj të drejte kërkon veçanërisht që:

a) letërkëmbimi i tyre duhet të transmetohet dhe t'u vihet në dispozicion pa vonesa të paarsyeshme dhe pa ndryshime;

b) këta persona nuk do të jenë objekt i asnjë lloj mase disiplinore lidhur me çfarëdo komunikim të dërguar Gjykatës nëpërmjet rrugëve të përshtatshme;

c) këta persona do të kenë të drejtën të komunikojnë dhe këshillohen pa praninë e personave të tjerë me një jurist të kualifikuar për t'u paraqitur para gjykatave të vendit ku janë burgosur, lidhur me një kërkesë drejtuar Gjykatës, ose çdo procedim që rrjedh nga ajo.

3. Në zbatim të paragrafit të mësipërm, nuk do të ketë asnjë interferencë nga asnjë autoritet publik, me përjashtim të atyre që janë në përputhje me ligjin dhe janë të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë kombëtare, për zbulimin dhe procedimin e një vepre penale ose për mbrojtjen e shëndetit.

Neni 4

1. a) Palët Kontraktuese marrin përsipër të mos pengojnë lëvizjen e lirë dhe udhëtimin për qëllimin e pjesëmarrjes në procedurat para Gjykatës dhe kthimin e personave të treguar në paragrafin 1 të nenit 1 të kësaj Marrëveshjeje.

b) Asnjë kufizim tjetër nuk mund të vihet për lëvizjen dhe udhëtimin e tyre, me përjashtim të atyre që janë në përputhje me ligjin dhe janë të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë kombëtare dhe publike, për ruajtjen e rendit publik, për parandalimin e veprave penale, për mbrojtjen e shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

2. a) Në vendet e ndërmjetëm dhe në vendet ku zhvillohet procedura këta persona nuk mund të përndiqen, as të burgosen dhe as t'i nënshtrohen ndonjë kufizimi tjetër të lirisë së tyre vetjake

lidhur me veprime ose dënime të kohës para nisjes së udhëtimit të tyre.

b) Çdo Palë Kontraktuese mundet, në momentin e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit ose miratimit të kësaj Marrëveshjeje, të deklarojë, se parashikimet e këtij paragafi nuk zbatohen ndaj shtetasve të saj. Kjo deklaratë mund të tërhiqet në çdo kohë nëpërmjet një njoftimi të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

3. Palët Kontraktuese marrin përsipër të lënë të kthehen në territorin e tyre personat që e kanë filluar udhëtimin e tyre nga ky territor.

4. Parashikimet e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni pushojnë së zbatuari kur personi i interesuar ka patur mundësinë, gjatë pesëmbëdhjetë ditëve të njëpasnjëshme nga data kur paraqitja e tij nuk është kërkuar më nga Gjykata, për t'u kthyer në vendin nga i cili ka nisur udhëtimi i tij.

5. Në rast se konflikti ndërmjet detyrimeve të një Pale Kontraktuese që rrjedhin nga paragrafi 2 i këtij neni dhe atyre që rrjedhin nga një Konventë e Këshillit të Evropës ose nga një marrëveshje ekstradimi ose marrëveshje tjetër lidhur me ndihmën e ndërsjellë në çështjet penale me Palë të tjera Kontraktuese, parashikimet e paragrafit 2 të këtij neni zbatohen me përparësi.

Neni 5

1. Imunitetet dhe lehtësitë i jepen personave të treguar në paragrafin 1 të nenit 1 të kësaj Marrëveshjeje vetëm për t'u siguruar atyre lirinë e fjalës dhe pavarësinë e nevojshme për përmbushjen e funksioneve, detyrave dhe detyrimeve të tyre, ose për ushtrimim e të drejtave të tyre para Gjykatës.

2. a) Vetëm Gjykata është kompetente për heqjen pjesore ose tërësore të imunitetit të parashikuar në paragrafin 1 të nenit 2 të kësaj Marrëveshjeje; ajo ka jo vetëm e drejtën, por edhe detyrimin e heqjes së imunitetit në çdo rast kur, sipas saj, imuniteti do të pengonte rrjedhën e drejtësisë dhe heqja pjesore ose tërësore nuk do të paragjykonte qëllimin e parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni.

b) Imuniteti mund të hiqet nga Gjykata kryesisht ose me kërkesë të çdo Pale Kontraktuese ose çdo personi të interesuar.

c) Vendimet me të cilat hiqet imuniteti ose refuzojnë heqjen arsyetohen.

3. Nëse një Palë Kontraktuese vërteton se heqja e imunitetit të parashikuar në paragrafin 1 të nenit 2 të kësaj Marrëveshjeje është e nevojshme për qëllimet e procedimeve lidhur me një vepër kundër sigurisë kombëtare, Gjykata duhet të heqë imunitetin në masën e parashikuar në vërtetim.

4. Në rast zbulimi të një fakti që për nga natyra e tij mund të ketë influencë vendimtare dhe që në çastin e marrjes së vendimit për refuzimin e heqjes së imunitetit ishte i panjohur për autorin e kërkesës, ky i fundit mund t'i bëjë kërkesë të re Gjykatës.

Neni 6

Asnjë parashikim në këtë marrëveshje nuk do të interpretohet sikur kufizon ose shmang nga ndonjë nga detyrimet e marra përsipër nga Palët Kontraktuese në përputhje me Konventën ose protokollet e saj.

Neni 7

1. Kjo Marrëveshje do të jetë e hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, të cilët mund të shprehin pëlqimin e tyre për të qenë palë nëpërmjet:

a) nënshkrimit pa rezerva dhe ratifikimit, pranimit ose miratimit; ose

b) nënshkrimit me pasojë ratifikimin, pranimin ose miratimin, të pasuar nga ratifikimi, pranimi ose miratimi.

2. Instrumentet e ratifikimit, miratimit ose të pranimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

Neni 8

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e periudhës prej një muaji pas datës në të cilën dhjetë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë shprehur pëlqimin e tyre për të qenë palë në Marrëveshje në përputhje me parashikimet e nenit 7, në rast se në këtë datë Protokolli nr. 11 i Konventës ka hyrë në fuqi, ose në rast të kundërt, në datën e hyrjes në fuqi të Protokollit nr.11 të Konventës.

2. Për shtetet anëtare që shprehin pëlqimin e tyre më vonë për të qenë palë në Marrëveshje, ajo do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e periudhës prej një muaji pas datës së nënshkrimit ose depozitimit së instrumentit të tyre të ratifikimit, miratimit ose pranimit.

Neni 9

1. Çdo shtet kontraktues mundet, në momentin e depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit ose miratimit, ose në një datë të mëvonshme, nëpërmjet një deklarate të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, të shtrijë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje në cilindo territor ose territore të specifikuar në deklaratë, territore për të cilat ajo është përgjegjëse për marrëdhëniet ndërkombëtare, ose për të cilat ajo është e autorizuar të lidhë marrëveshje.

2. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi për çdo territor ose territoret e treguara në një deklaratë të bërë në përputhje me paragrafin 1 në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e periudhës prej një muaji pas datës së marrjes së deklaratës nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë në përputhje me paragrafin 1, lidhur me çdo territor të përmendur në atë deklaratë, mund të tërhiqet në përputhje me procedurën e parashikuar për denoncimin në nenin 10 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 10

1. Kjo Konventë do të mbetet në fuqi për një afat kohor të pacaktuar.

2. Çdo Palë Kontraktuese mundet, përsa i përket asaj, të denoncojë këtë Marrëveshje nëpërmjet një njoftimi të dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

3. Denoncimi do të ketë pasoja gjashtë muaj pas datës së marrjes së këtij njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm. Denoncimi nuk do të ketë për pasojë çlirimin e palëve kontraktuese të interesuara nga detyrimet që mund të kenë lindur sipas kësaj Marrëveshjeje lidhur me çdo person të treguar në paragrafin 1 të nenit 1.

Neni 11

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do të njoftojë shtetet anëtare të Këshillit, për:

a) çdo nënshkrim;

b) çdo depozitim të një instrumenti ratifikimi, pranimi ose aderimi;

c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me nenet 8 dhe 9 të saj;

d) çdo akt tjetër, njoftim ose komunikim lidhur me këtë Marrëveshje.

Si dëshmi të kësaj, nënshkruesit të autorizuar si duhet për këtë gjë, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në Strasburg, më 5 mars 1996, në anglisht dhe frëngjisht, të dyja tekstet njëlloj të vlefshëm, në një kopje të vetme, e cila do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Evropës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do t'i transmetojë kopje të vërtetuara secilit shtet anëtar të Këshillit të Evropës.

LIGJ
Nr.9019, datë 6.3.2003

PËR RATIFIKIMIN E "PROTOKOLLIT TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË ITALISË PËR ZHVILLIMIN E PROGRAMEVE TË MBËSHTETJES SË FORCAVE TË POLICISË SHQIPTARE DHE TË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET TË DYJA VENDEVE NË LUFTË KUNDËR KRIMINALITETIT, NËPËRMJET ZYRËS NDËRLIDHËSE ITALIANE NË SHQIPËRI DHE OFICERIT OSE OFICERËVE SHQIPTARË TË KONTAKTIT NË ITALI"

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Protokolli i mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë për zhvillimin e programeve të mbështetjes së Forcave të Policisë Shqiptare dhe të bashkëpunimit ndërmjet të dyja vendeve në luftë kundër kriminalitetit, nëpërmjet zyrës ndërlidhëse italiane në Shqipëri dhe oficerit ose oficerëve shqiptarë të kontaktit në Itali", nënshkruar në Leçe (Itali) më 11 nëntor 2002.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.3757, datë 26.3.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu.

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.21, faqe 645

PROTOKOLLI I MIRËKUPTIMIT
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS ITALIANE

Lidhur me zhvillimin e programeve të mbështetjes së forcave të policisë shqiptare dhe bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve në luftë kundër kriminalitetit nëpërmjet zyrës ndërlidhëse italiane në Shqipëri dhe oficerit (oficerëve) shqiptar(Ë) i (të) kontaktit në Itali

Duke u bazuar në Marrëveshjen në fuqi midis Ministrisë së Rendit Publik të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës Italiane në fushën e luftës kundër trafikut të paligjshëm të lëndëve narkotike dhe të kriminalitetit të organizuar, firmosur në Tiranë, më 24 gusht 1991;

- duke u mbështetur në protokollin shtesë firmosur në Tiranë, më 24 gusht 1991 nga Ministrat e Rendit Publik të Republikës së Shqipërisë dhe të Brendshëm të Republikës Italiane dhe në integrim të marrëveshjes së mëparshme;

- duke marrë parasysh procesverbalin e mbledhjes së parë të komitetit bilateral shqiptaro-italian, sipas Marrëveshjes së 24 gushtit 1991, që u zhvillua në Tiranë, më 9 dhjetor 1996;

- duke konsideruar protokollet dypalëshe të mirëkuptimit të viteve 1997, 1998, 2000, 2001;

- duke vlerësuar rezultatet e arritura nga misioni italian interforcë në veprimtarinë e këshillimit, trajnimit dhe asistencës në favor të forcave të policisë shqiptare, si dhe nga zyra ndërlidhëse italiane interforcë, në bashkëpunim me policinë shqiptare, në luftën kundër kriminalitetit, si dhe të nismave të ndërmarra nga Ministria Shqiptare e Rendit Publik për përmirësimin e profileve organizuese dhe operative të Policisë së Shtetit Shqiptar;

- duke konfirmuar interesin e përbashkët në forcimin e mirëkuptimit për ta bërë më efikase dhe sistematike luftën kundër krimit të organizuar dhe parandalimin e flukseve emigruese klandestine, si dhe të trafiqeve të tjera midis Shqipërisë dhe Italisë;

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Italiane, që prej këtu do të quhen Palë,

kanë rënë dakord për sa më poshtë:

Neni 1

Pala italiane, në lidhje me nevojat e realizimit të programeve të parashikuara në protokollet e mëparshme të mirëkuptimit, ofron, ku të jetë e nevojshme dhe me kërkesë të Palës shqiptare, mbështetje të mëtejshme forcave të policisë shqiptare, në përfshirje të veprimtarisë së këshillimit dhe trajnimit të kryer deri tani.

Neni 2

Për të siguruar një luftë më efikase kundër fluksit emigrues klandestin dhe të trafiqeve të tjera të paligjshme, nëpërmjet mjeteve detare të përmirësuara për kontrollin e brigjeve shqiptare, Policia Kufitare Shqiptare, duke përdorur edhe mjetet lundruese të dhuruara nga pala italiane për të rritur kapacitetin operativ, garanton patrullimin e të gjithë brezit bregdetar, me asistencën e mjeteve lundruese të forcave të policisë italiane, deri më 31.12.2003.

Do të përsosen marrëveshje të nivelit tekniko-operativ, për përfshirjet e nevojshme në veprimtaritë e luftës kundër fenomeneve të lartpërmendura përgjatë brigjeve me ato që kryhen nga Policia Kufitare Shqiptare në territorin e saj.

Pala shqiptare do t'i përmbahet nismave që kanë për qëllim lehtësimin e koordinimit të veprimtarive të specifikuara në pikat e mësipërme, si dhe ato që parashikohen nga marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe në lidhje me kontrollin e kufijve të saj tokësorë dhe detarë.

Mbetet i konfirmuar angazhimi, sipas mënyrave të parashikuara në nivel teknik, të mjeteve ajrore të forcave të policisë italiane në mbështetje të veprimtarisë së policisë shqiptare në operacionet e parandalimit të përgjithshëm dhe të luftës kundër kriminalitetit.

Neni 3

Bashkëpunimi dypalësh në luftën kundër kriminalitetit, në veçanti atij të organizuar dhe të trafiqeve të paligjshme në interes të dy vendeve, do të zhvillohet në mënyrë sistematike nga zyra ndërlidhëse italiane interforcë e krijuar në Shqipëri dhe nga oficeri (ose oficerët) shqiptar (ë) i (të) kontaktit i (të) vendosur në Itali.

Neni 4

Zyra ndërlidhëse italiane interforcë në Shqipëri dhe oficeri (ose oficerët) shqiptar (ë) i (të) kontaktit në Itali do të sigurojnë deri më 31 dhjetor 2003, duke rezervuar të drejtën për ripërtëritje të mundshme, rakordimin e nevojshëm informativ dhe hetues me strukturat e policisë së vendit pritës, rakordim që është i destinuar të rrisë më tej bashkëpunimin midis dy vendeve në luftën kundër kriminalitetit.

Veprimi i tyre përshtatet me linjat programatike të përcaktuara në Marrëveshjen bilaterale, si dhe në protokollin shtesë të 24 gushtit 1991 dhe mban parasysh rezultatet e bashkëpunimit në bazë të protokolleve të mirëkuptimit të nënshkruara nga Palët në vitet e mëparshme.

Zyra ndërlidhëse italiane interforcë në Shqipëri zhvillon gjithashtu rakordimin me Qendrën Ndërkombëtare Antitrafik të Vlorës nëpërmjet pjesëmarrjes së përfaqësuesve të saj në veprimtarinë e këtij organizmi.

Për problemet që lidhen me statusin, privilegjet dhe imunitetet e personelit të zyrës ndërlidhëse italiane interforcë, si dhe të mirave materiale e pronave të tij, kohëzgjatjen e përdorimit dhe konditat e shërbimit, lehtësirat valutore dhe të komunikimeve, reklamimet, procedimeve ligjore, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe të çdo problemi tjetër që lidhet me praninë dhe veprimtarinë e zyrës në Shqipëri, do të zbatohet mutatis mutandis, siç parashikohet në "Memorandum of Understanding on the status of the EC Police Assisstance (ECPA) project in Albania" ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, nënshkruar në Tiranë, më datë 6 mars 2002.

I njëjti trajtim do të zbatohet edhe ndaj njësive detare dhe ajrore të forcave të policisë italiane dhe personelit përkatës, si dhe specialistëve të tyre, që do të angazhohen herë pas here, në veprimtarinë e mbështetjes, këshillimit, trajnimit dhe asistencës për policinë shqiptare.

I njëjti regjim parashikohet për oficerin (ët) shqiptar (ë) të kontaktit (i) të pranishëm në territorin italian.

Për aspektet e tjera të garancive në favor të përfaqësuesve të forcave të policisë italiane mbeten në fuqi, gjithashtu, dispozitat e parashikuara në protokollet e mëparshme të mirëkuptimit.

Zyra ndërlidhëse italiane interforcë vazhdon të kryejë koordinimin e veprimtarisë bazuar në nenet 1 dhe 2 të këtij protokolli me qëllim luftën kundër kriminalitetit dhe trafiqeve të paligjshme.

Neni 5

Zyra ndërlidhëse italiane interforcë në Shqipëri dhe oficeri (ose oficerët) shqiptar(ë) i (të) kontaktit në Itali bashkëpunojnë, përkatësisht, me Drejtorinë Qendrore të Policisë Kriminale pranë Ministrisë Shqiptare të Rendit Publik dhe me Drejtorinë Qendrore homologe të Ministrisë së Brendshme Italiane-Departamenti i Sigurisë Publike.

Atyre u janë ngarkuar detyrat që vijojnë:

- mbledhja dhe analiza e informacioneve mbi ecurinë e kriminalitetit, mbi organizatat dhe subjektet kriminale, si dhe mbi trafiqet e paligjshme, në interes të përbashkët, të dy vendeve;
- thellimin e informacioneve në fushën e hetimeve specifike;
- zbulimin e personave në kërkim;
- asistencë policore në planin teknik dhe shkencor;
- lehtësimin e veprimtarisë së autoriteteve gjyqësore kombëtare pranë autoriteteve kompetente të vendit pritës;
- studimin e linjave të politikës kriminale që synojnë shmangien e vështirësive operative që rrjedhin nga ndryshimet e sistemeve ligjore të të dy vendeve.

Neni 6

Palët, duke garantuar shkëmbimin reciprok të informacioneve në fushën e kriminalitetit dhe të trafiqeve të paligjshme nëpërmjet strukturave ndërlidhëse të parashikuara nga ky protokoll, angazhohen, të mos i komunikojnë vendeve të treta, informacionet e marra nga zyra ose oficerët ndërlidhës, pa pëlqimin e vendit që i ka dhënë ato.

Neni 7

Secila Palë Kontraktuese merr përsipër financimin e zyrave të saj dhe administrimin e personelit.

Neni 8

Ky protokoll do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të dytë nga dy njoftimet me shkrim, me anë të të cilave Palët Kontraktuese do t'i komunikojnë njëra-tjetrës përmbushjen e plotë të procedurave përkatëse të brendshme.

Me besimin që të nënshkruarit, posaçërisht të autorizuar, nënshkruajnë këtë protokoll.

Bërë në Lece, më 13.11.2002 në dy tekste origjinale, që të dy të barasvlefshëm, në gjuhët shqipe dhe italiane.

LIGJ
Nr.9068, datë 15.5.2003

PËR RATIFIKIMIN E "KONVENTËS EUROPIANE PËR VLEFSHMËRINË NDËRKOMBËTARE TË GJYKIMEVE PENALE"

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Konventa europiane për vlefshmërinë ndërkombëtare të gjykimeve penale", me rezervat e parashikuara në këtë ligj.

Neni 2

Në përputhje me paragrafin e dytë të nenit 19 të Konventës, Republika e Shqipërisë rezervon të drejtën të kërkojë që kërkesat dhe dokumentet mbështetëse të tyre të shoqërohen me përkthimin e tyre në gjuhën shqipe.

Neni 3

Në përputhje me paragrafin e parë të nenit 61 të Konventës, Republika e Shqipërisë rezervon të drejtën për të refuzuar:

a) ekzekutimin, nëse vlerëson se vendimi ka lidhje me një vepër penale, fiskale ose fetare (Lidhja I, shkronja "a");

b) ekzekutimin e një dënimi për një akt që, sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, është vetëm përgjegjësi e një autoriteti administrativ (Lidhja I, shkronja "b");

c) ekzekutimin e një gjykimi penal europian, të cilin autoritetet e shtetit kërkues e kanë dhënë në një datë kur, sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, procedimi penal i veprës penale të dënuar nga gjykimi duhet të ishte parashkruar (Lidhja I shkronja "c");

ç) zbatimin e parashikimeve të nenit 8 të Konventës, kur shteti shqiptar ka përgjegjësi origjinale dhe të njohë, në raste të tilla, vetëm njëvlefshmërinë e akteve që ndërpresin ose pezullojnë parashkrimin, të cilat janë kryer në shtetin kërkues (Lidhja I, shkronja "e").

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.3840, datë 17.6.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.51, faqe 2017

KONVENTA
EUROPIANE MBI VLEFSHMËRINË NDËRKOMBËTARE TË GJYKIMEVE PENALE
HAGË, MË 28.5.1970

HYRJE

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës, nënshkruese të kësaj Konvente:

duke marrë në konsideratë që lufta kundër kriminalitetit, e cila po kapërcen gjithmonë e më tepër kufijtë administrativë të një shteti të vetëm, kërkon në planin ndërkombëtar përdorimin e mënyrave moderne dhe efikase;

të bindur për nevojën e ndjekjes së një politike penale të përbashkët me qëllim mbrojtjen e shoqërisë;

të ndërgjegjshëm për nevojën e respektimit të dinjitetit njerëzor dhe nxitjen e rehabilitimit të autorëve të veprave panale;

duke pasur parasysh se qëllimi i Këshillit të Europës është realizimi i një bashkimi sa më të ngushtë mes anëtarëve të tij,

kanë rënë dakord si vijon:

KAPITULLI I
PËRKUFIZIME

Neni 1

Në kuptim të kësaj Konvente:

a) "Vendim penal europian" do të thotë çdo vendim përfundimtar i dhënë nga një gjykatë penale e një shteti palë si rezultat i procedimit penal.

b) "Vepra penale" përshin, përveç veprave të dënueshme nga legjislacioni penal dhe ato të parashikuara në dispozitat ligjore të listuara në lidhjen II të kësaj Konvente, me kusht që në rastin kur këto dispozita i japin kompetencë një autoriteti administrativ, duhet të ekzistojë mundësia për personin e interesuar ta paraqesë çështjen para një gjykate.

c) "Dënim" do të thotë vendosje e një sanksioni.

d) "Sanksion" do të thotë çdo lloj dënimi ose masë tjetër e vendosur shprehimisht ndaj një personi për shkak të kryerjes së një vepre penale dhënë nga një gjykim penal europian ose një ordonnance penale.

e) "Humbje" do të thotë çdo humbje ose pezullim i një të drejte ose çdo ndalim ose humbje e zotësisë.

f) "Gjykim i bërë në mungesë" do të thotë çdo vendim i konsideruar i tillë sipas nenit 21 paragrafi i dytë.

g) "Ordonnance penale" do të thotë çdo vendim i dhënë në një shtet tjetër palë dhe i listuar në lidhjen II të kësaj Konvente.

KAPITULLI II
EKZEKUTIMI I GJYKIMEVE PENALE EUROPIANE

SEKSIONI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

A) Kushte të përgjithshme të ekzekutimit

Neni 2

Kjo pjesë zbatohet ndaj:
a) sanksioneve që përfshijnë heqjen e lirisë;
b) gjobave ose konfiskimeve;
c) heqjes ose kufizimit të një ose disa të drejtave.

Neni 3

1. Një shtet palë do të jetë kompetent në rastet dhe sipas kushteve të parashikuara në këtë Konventë për ekzekutimin e sanksioneve të vendosura në një shtet tjetër palë, të cilat janë të ekzekutueshme në këtë të fundit.

2. Kjo kompetencë mund të ushtrohet vetëm pas paraqitjes së një kërkese nga një shtet tjetër palë.

Neni 4

1. Sanksioni nuk do të ekzekutohet nga një shtet tjetër palë, përveçse kur sipas legjislacionit të tij veprimi, për të cilin është vendosur sanksioni do të përbënte vepër penale, nëse do të ishte kryer në territorin e tij dhe personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni do të ishte i dënueshëm atje.

2. Nëse vendimi trajton dy ose më shumë vepra penale dhe jo të gjitha përmbushin kërkesat e paragrafit të parë, shteti dënues do të specifikojë cilat pjesë të sanksionit zbatohen për veprat penale që përmbushin ato kërkesa.

Neni 5

Shteti dënues mund t'i kërkojë një shteti tjetër palë të ekzekutojë sanksionin vetëm nëse një ose më shumë nga kushtet vijuese janë përmbushur:

a) nëse personi i dënuar ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm në shtetin tjetër;

b) nëse ekzekutimi i sanksionit në shtetin tjetër duket se do të sjellë shtimin e mundësive për rehabilitimin social të personit të dënuar;

c) nëse, në rastin e një sanksioni me heqje të lirisë, sanksioni mund të ekzekutohet duke ndjekur ekzekutimin e një sanksioni tjetër me heqje të lirisë që i dënuari vuan ose duhet të vuajë në këtë shtet;

d) nëse shteti tjetër është shteti i origjinës së personit të dënuar dhe është deklaruar i gatshëm të marrë përsipër ekzekutimin e këtij sanksioni;

e) nëse konsideron se nuk është në gjendje ta ekzekutojë vetë sanksionin, edhe pse ka bërë kërkesë për ekstradim dhe shteti tjetër ka mundësi.

Neni 6

Ekzekutimi i kërkuar në përputhje me dispozitat e mësipërme nuk mund të refuzohet tërësisht ose pjesërisht, përveç rasteve kur:

a) ekzekutimi do të ishte në kundërshtim me parimet themelore të rendit juridik të shtetit të kërkuar;

b) shteti i kërkuar e konsideron veprën penale për të cilin është dhënë dënimi të karakterit politik ose tërësisht ushtarak;

c) shteti i kërkuar konsideron se ka arsye serioze për të besuar se dënimi është provokuar ose rënduar për arsye race, besimi fetar, kombësie ose bindjeje politike;

d) ekzekutimi është në kundërshtim me angazhimet ndërkombëtare të shtetit të kërkuar;

e) vepra është objekt procedimi në shtetin e kërkuar ose kur ky i fundit vendos të fillojë procedimin lidhur me këtë vepër;

f) autoritetet kompetente të shtetit të kërkuar vendosin të mos procedojnë ose të mbyllin procedimin për këtë vepër;

g) vepra është kryer jashtë territorit të shtetit të kërkuar;

h) shteti i kërkuar nuk është në gjendje të ekzekutojë sanksionin;

i) kërkesa bazohet në nenin 5 shkronja "a" dhe asnjë nga kushtet e tjera të parashikuara në atë dispozitë nuk është përmbushur;

j) shteti i kërkuar konsideron se shteti kërkues është vetë në gjendje ta ekzekutojë sanksionin;

k) mosha e personit të dënuar në kohën e kryerjes së veprës penale ishte e tillë që ai nuk mund të procedohej në shtetin e kërkuar;

l) sanksioni është parashikuar tashmë sipas legjislacionit të shtetit të kërkuar;

m) vendimi përcakton heqjen ose kufizimin e një ose më shumë të drejtave.

Neni 7

Kërkesa për ekzekutim nuk do të zbatohet nëse ekzekutimi bie ndesh me parimet e njohura nga dispozitat e seksionit të parë të kapitullit III të kësaj Konvente.

B) Pasojat e transferimit të ekzekutimit

Neni 8

Në funksion të nenit 6 paragrafi i parë dhe rezervën e përmendur në shkronjën "c" të lidhjes I të kësaj Konvente, çdo vepër që ndërpret ose pezullon parashkrimin e përmbushur vlefshmërisht nga autoritetet e shtetit dënues, do të konsiderohet në shtetin e kërkuar sikur të ketë prodhuar të njëjtin efekt për zbatimin e parashkrimit sipas legjislacionit të këtij shteti.

Neni 9

1. Një person i dënuar, i burgosur në shtetin kërkues, që i është dorëzuar shtetit të kërkuar për qëllim të ekzekutimit, nuk do të procedohet, gjykohet, dënohet për shkak të ekzekutimit të një dënimi ose mase sigurimi dhe as do t'i nënshtrohet ndonjë kufizimi tjetër të lirisë vetjake për një veprim të ndryshëm nga ai për të cilin është dhënë vendimi për t'u ekzekutuar, përveçse në rastet kur:

a) Shteti që e ka dorëzuar bie dakord. Për këtë gjë atij do t'i paraqitet një kërkesë, e shoqëruar me të gjitha dokumentet e nevojshme dhe një procesverbal gjyqësor që përmban të gjitha deklarimet e bëra nga i dënuari. Pëlqimi do të jepet kur vepra penale për të cilën ai është kërkuar është gjithashtu subjekt ekstradimi sipas legjislacionit të shtetit kërkues të ekzekutimit ose kur ekstradimi mund të përjashtohet vetëm për arsye të masës së dënimit.

b) Personi i dënuar ka pasur mundësinë e largimit nga territori i shtetit ku është dorëzuar, por nuk e ka bërë këtë brenda 45 ditëve nga dorëzimi i tij përfundimtar ose nëse është kthyer në këtë territor, pasi është larguar prej tij.

2. Shteti i kërkuar për të ekzekutuar dënimin mundet sidoqoftë të marrë çdo masë të

nevojshme për zhvendosjen e personit nga territori i tij ose çdo masë të nevojshme sipas legjislacionit të tij, përfshirë këtu procedimin në mungesë, me qëllim parandalimin e pasojave ligjore të parashkrimit.

Neni 10

1. Ekzekutimi do të rregullohet nga legjislacioni i shtetit të kërkuar dhe vetëm ky shtet do të jetë kompetent për marrjen e vendimeve të duhura që përfshijnë lirimin me kusht.

2. Vetëm shteti kërkues ka të drejtë të vendosë për çdo kërkesë për rishikim të dënimit.

3. Secili nga të dy shtetet mund të ushtrojë të drejtën e amnistisë ose të faljes.

Neni 11

1. Kur shteti dënues kërkon ekzekutimin, ai nuk mund të fillojë ekzekutimin e një sanksioni subjekt i kësaj kërkese. Shteti dënues mundet sidoqoftë të fillojë ekzekutimin e një sanksioni me heqje të lirisë, kur personi i dënuar është tashmë i burgosur në territorin e atij shteti në momentin e paraqitjes së kërkesës.

2. Shteti kërkues rifiton të drejtën për ekzekutim kur:

a) Tërheq kërkesën e tij, para se shteti i kërkuar ta ketë informuar atë për ndonjë qëllim të tijin për të ndërmarrë veprime për trajtimin e kërkesës.

b) Shteti i kërkuar e informon për refuzimin e tij për të ndërmarrë veprime për trajtimin e kërkesës.

c) Shteti i kërkuar heq dorë në mënyrë të shprehur nga e drejta e tij për ekzekutim. Heqja dorë mund të jetë e vlefshme vetëm nëse të dy shtetet përkatëse bien dakord për këtë ose nëse ekzekutimi nuk është më i mundur në shtetin e kërkuar. Në rastin e fundit heqja dorë është e detyrueshme, nëse shteti kërkues ka bërë kërkesë për këtë.

Neni 12

1. Autoritetet kompetente të shtetit të kërkuar duhet t'i japin fund ekzekutimit menjëherë sapo marrin dijeni për çfarëdo falje, amnisti ose rekurs për rishikim ose çdo vendim tjetër që ka për pasojë pushimin e karakterit ekzekutiv të sanksionit. E njëjta gjë do të zbatohet për ekzekutimet e gjobave sa kohë që personi i dënuar i ka paguar gjobën autoriteteve kompetente të shtetit kërkues.

2. Shteti kërkues do të informojë pa vonesë shtetin e kërkuar për çdo vendim ose veprim procedural të ndërmarrë në territorin e tij që ka për pasojë parashkrimin e të drejtës për ekzekutim në përputhje me paragrafin e mësipërm.

C. Dispozita të ndryshme

Neni 13

1.Transitimi nëpërmjet territorit të një shteti palë të një personi të burgosur, i cili duhet të transferohet tek një shtet i tretë palë në zbatim të kësaj Konvente, do të akordohet me kërkesën e shtetit në të cilin personi ndodhet i burgosur. Shteti i transitit mund të kërkojë të marrë çdo dokument të nevojshëm para se të marrë vendim lidhur me kërkesën. Personi që transferohet do të qëndrojë në burg në territorin e shtetit të transitit, përveçse kur shteti nga i cili ai transferohet kërkon lirimin e tij.

2. Përveç rasteve kur transferimi kërkohet në përputhje me nenin 34, çdo shtet palë mund të refuzojë transitin:

a) për një nga motivet e përmendura në nenin 6, shkronja "b" dhe "c";

b) nëse personi në fjalë është shtetas i tij.

3. Nëse përdoret transporti ajror, zbatohen dispozitat vijuese:

a) kur nuk parashikohet ulje e avionit, shteti nga i cili transferohet personi mund të njoftojë shtetin mbi territorin e të cilit do të fluturohet që personi në fjalë po transferohet në zbatim të kësaj Konvente. Në rastin e një uljeje të paparashikuar ky njoftim do të ketë vlerën e kërkesës për arrest të përkohshëm sikurse parashikohet në nenin 32 paragrafi i dytë dhe do të bëhet një kërkesë formale për transitim;

b) kur parashikohet ulje e avionit, do të bëhet një kërkesë formale për transitim.

Neni 14

Shtetet palë nuk kërkojnë nga njëri-tjetri shlyerjen e shpenzimeve që kryhen në zbatim të kësaj Konvente.

SEKSIONI 2
KËRKESA PËR EKZEKUTIM

Neni 15

1. Kërkesat e parashikuara në këtë Konventë do të bëhen me shkrim. Ato dhe të gjitha komunikimet e nevojshme për zbatimin e kësaj Konvente do t'i dërgohen Ministrisë së Drejtësisë së shtetit të kërkuar nga Ministria e Drejtësisë e shtetit kërkues ose, nëse shtetet palë bien dakord, direkt nga autoritetet e shtetit kërkues atyre të shtetit të kërkuar; përgjigjet ndjekin të njëjtën rrugë.

2. Në raste urgjente, kërkesat dhe komunikimet mund të dërgohen përmes Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (Interpol).

3. Çdo shtet palë, me anë të një deklarate të dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund të njoftojë qëllimin e tij për t'iu shmangur rregullave të komunikimit të përcaktuara në paragrafin e parë të këtij neni.

Neni 16

Kërkesa për ekzekutim do të shoqërohet nga origjinali ose një kopje e vërtetuar e vendimit, ekzekutimi i të cilit kërkohet dhe të gjitha dokumentet e tjera të nevojshme. Origjinali ose një kopje e vërtetuar e të gjithë ose e një pjese të dosjes penale i komunikohet shtetit të kërkuar me kërkesë të këtij të fundit. Autoriteti kompetent i shtetit kërkues vërteton ekzekutimin e sanksionit.

Neni 17

Nëse shteti i kërkuar konsideron që informacioni i dhënë nga shteti kërkues nuk është i mjaftueshëm për t'i dhënë mundësinë atij të zbatojë këtë Konventë, ai kërkon informacion shtesë, duke fiksuar një afat për marrjen e këtij informacioni.

Neni 18

1. Autoritetet e shtetit të kërkuar informojnë pa vonesë ato të shtetit kërkues për veprimet e ndërmarra për trajtimin e kërkesës për ekzekutim.

2. Autoritetet e shtetit të kërkuar i transmetojnë atyre të shtetit kërkues, kur është rasti, një dokument që vërteton ekzekutimin e sanksionit.

Neni 19

1. Nën rezervën e paragrafit të dytë të këtij neni, nuk do të kërkohet asnjë përkthim i kërkesave ose i dokumenteve shtesë.

2. Çdo shtet palë mundet të rezervojë, në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit ose aderimit, me anë të një deklarate me shkrim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të drejtën e tij për të kërkuar që kërkesat dhe dokumentet mbështetëse të shoqërohen me përkthimin e tyre në gjuhën e tij, në një nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Europës ose në një nga gjuhët që kërkon ai. Shtetet e tjera palë mund të kërkojnë reciprocitet.

3. Kjo dispozitë nuk cenon dispozitat që lidhen me përcaktimin e kërkesave dhe dokumenteve mbështetëse që mund të parashikohen në marrëveshje të tjera tashmë në fuqi ose që mund të lidhen në të ardhmen midis dy ose më shumë shteteve palë.

Neni 20

Materialet shkresore dhe dokumentet e transmetuara në zbatim të kësaj Konvente nuk është e nevojshme të legalizohen.

SEKSIONI 3
GJYKIMET NË MUNGESË DHE ORDONNANCE PENALE

Neni 21

1. Nën rezervën e parashikimeve të ndryshme të bëra në këtë Konventë, ekzekutimi i vendimeve të gjykimeve në mungesë dhe i ordonnance penale u nënshtrohen të njëjtave rregulla sikurse ekzekutimi i vendimeve të tjera gjyqësore.

2. Nën rezervën e parashikimeve të paragrafit të tretë, një vendim në mungesë sipas kësaj Konvente nënkupton çdo vendim të dhënë nga një gjykatë e një shteti palë pas procedimit penal, gjatë shqyrtimit të të cilit personi i dënuar nuk ka qenë personalisht i pranishëm.

3. Pa paragjykuar përmbajtjen e neneve 25 paragrafi i dytë, 26 paragrafi i dytë dhe 29, do të konsiderohet si vendim i marrë në prani të të akuzuarit:

a) çdo vendim i dhënë në mungesë dhe çdo ordonnance penale, që është konfirmuar ose dhënë në shtetin dënues pas kundërshtimit nga personi i dënuar;

b) çdo vendim i marrë në mungesë në apel, nëse apelimi për vendimin e gjykatës së shkallës së parë është kërkuar nga personi i dënuar.

Neni 22

Çdo vendim në mungesë dhe çdo ordonnance penale, që nuk është kundërshtuar ose apeluar mund t'i transmetohet menjëherë shtetit të kërkuar me qëllim njoftimin dhe ekzekutimin e mundshëm të tyre.

Neni 23

1. Nëse shteti i kërkuar e konsideron të përshtatshme të ndërmarrë veprime mbi kërkesën për ekzekutimin e një vendimi në mungesë ose të një ordonnance penale, ai do t'ia njoftojë të dënuarit personalisht vendimin e marrë në shtetin kërkues.

2. Në aktin e njoftimit dërguar të dënuarit do të jepet edhe informacioni se:

a) në përputhje me këtë Konventë është paraqitur një kërkesë për ekzekutim;

b) e vetmja rrugë ankimimi e vlefshme është kundërshtimi i parashikuar në nenin 24;

c) kundërshtimi bëhet pranë autoritetit të përcaktuar, pranimi i kundërshtimit është objekt i kushteve të parashikuara në nenin 24 të kësaj Konvente, dhe se personi i dënuar mund të kërkojë të dëgjohet nga autoritetet e shtetit dënues;

d) nëse nuk bëhet asnjë kundërshtim brenda afatit të përshkruar, vendimi do të konsiderohet i marrë në prani të të akuzuarit në përputhje me këtë Konventë.

3. Një kopje e njoftimit do t'i dërgohet menjëherë autoritetit që ka kërkuar ekzekutimin.

Neni 24

1. Pasi vendimi është njoftuar në përputhje me nenin 23, rruga e vetme e ankimit për të dënuarit është kundërshtimi. Ky kundërshtim do të shqyrtohet sipas zgjedhjes së të dënuarit ose nga gjykata kompetente në shtetin kërkues, ose nga ajo e shtetit të kërkuar. Nëse personi i dënuar nuk shpreh asnjë zgjedhje, kundërshtimi do të shqyrtohet nga gjykata kompetente në shtetin e kërkuar.

2. Në rastet e parashikuara në paragrafin e mësipërm, kundërshtimi do të pranohet nëse ai i është drejtuar autoritetit kompetent të shtetit të kërkuar brenda afatit 30 ditor duke filluar nga data në të cilën është bërë njoftimi. Ky afat do të llogaritet në përputhje me rregullat përkatëse të legjislacionit të shtetit të kërkuar. Autoriteti kompetent i këtij shteti do të njoftojë menjëherë autoritetin që ka bërë kërkesën për ekzekutim.

Neni 25

1. Nëse kundërshtimi shqyrtohet në shtetin kërkues, personi i dënuar duhet të paraqitet në këtë shtet në seancën e fiksuar për shqyrtimin e ri të çështjes. Paraqitja do t'i njoftohet atij personalisht të paktën 21 ditë para seancës. Kjo periudhë mund të shkurtohet me pëlqimin e të dënuarit. Shqyrtimi i ri do të mbahet para gjykatës që është kompetente në shtetin kërkues dhe sipas procedurës së këtij shteti.

2. Nëse personi i dënuar nuk paraqitet personalisht ose nuk përfaqësohet në përputhje me legjislacionin e shtetit kërkues, gjykata e deklaron kundërshtimin të pakryer dhe vendimi i saj i komunikohet autoritetit kompetent të shtetit të kërkuar. E njëjta procedurë do të ndiqet dhe nëse gjykata e deklaron kundërshtimin të papranueshëm. Në të dyja rastet vendimi në mungesë ose masa penale do të konsiderohet, në përputhje me këtë Konventë, sikur të jetë marrë në praninë e të akuzuarit.

3. Nëse personi i dënuar paraqitet personalisht ose përfaqësohet në përputhje me legjislacionin e shtetit kërkues dhe nëse kundërshtimi deklarohet i pranueshëm, kërkesa për ekzekutim do të konsiderohet sikur të mos jetë bërë.

Neni 26

1. Nëse kundërshtimi shqyrtohet në shtetin e kërkuar, personi i dënuar duhet të paraqitet në atë shtet në seancën e fiksuar për shqyrtimin e ri të çështjes. Njoftimi për paraqitje do t'i bëhet atij personalisht jo më vonë se 21 ditë para seancës së re. Kjo periudhë mund të shkurtohet me pëlqimin e personit të dënuar. Shqyrtimi i ri do të mbahet para gjykatës që është kompetente në shtetin e kërkuar dhe sipas procedurës së këtij shteti.

2. Nëse personi i dënuar nuk paraqitet personalisht ose nuk përfaqësohet në përputhje me legjislacionin e shtetit të kërkuar, gjykata e deklaron kundërshtimin të pakryer dhe vendimi i saj i komunikohet autoritetit kompetent të shtetit të kërkuar. E njëjta procedurë do të ndiqet dhe nëse gjykata e deklaron kundërshtimin të papranueshëm. Në të dyja rastet vendimi në mungesë ose masa penale do të konsiderohet, në përputhje me këtë konventë, sikur të jetë marrë në praninë e të akuzuarit.

3. Nëse personi i dënuar paraqitet personalisht ose përfaqësohet në përputhje me legjislacionin e shtetit kërkues dhe nëse kundërshtimi deklarohet i pranueshëm, çështja do të gjykohet sikur të jetë kryer në këtë shtet. Sidoqoftë, çështja nuk mund të shqyrtohet nëse procedimi penal është parashkruar. Vendimi i marrë në shtetin kërkues do të konsiderohet sikur të mos jetë marrë.

4. Të gjitha veprimet lidhur me procedimet ose hetimet paraprake të ndërmarra në shtetin dënues, në përputhje me legjislacionin e tij që është në fuqi kanë të njëjtën vlerë në shtetin e kërkuar, sikur të jenë ndërmarrë nga autoritetet e atij shteti, por ky asimilim nuk i jep atyre fuqi provuese më të madhe, sesa ato kanë në shtetin kërkues.

Neni 27

Për ngritjen e kundërshtimit dhe procedurës që e shoqëron, i dënuari në mungesë ose për një masë penale ka të drejtë t'i vendoset kryesisht një mbrojtës në rastet dhe kushtet e parashikuara nga ligji i shtetit të kërkuar dhe, kur është e nevojshme, të shtetit kërkues.

Neni 28

Çdo vendim gjyqësor i dhënë në përputhje me nenin 26 paragrafi i tretë, si dhe ekzekutimi i tij rregullohet nga legjislacioni i shtetit të kërkuar.

Neni 29

Nëse një person i dënuar në mungesë ose për një masë penale nuk ngre kundërshtim, vendimi do të konsiderohet, në përputhje me këtë Konventë, sikur të jetë marrë në prani të të akuzuarit.

Neni 30

Legjislacionet kombëtare janë të zbatueshme në fushën e rikthimit tërësor, nëse personi i dënuar, për arsye të pavarura nga vullneti i tij, nuk respekton afatet e përcaktuara në nenet 24, 25 dhe 26 ose nuk paraqitet personalisht në seancën e fiksuar për shqyrtimin e ri të çështjes.

SEKSIONI 4
MASA TË PËRKOHSHME

Neni 31

Nëse personi i dënuar është i pranishëm në shtetin kërkues pas marrjes së njoftimit të pranimit të kërkesës së tij për ekzekutimin e një vendimi me heqje të lirisë, ky shtet mundet, nëse e sheh të nevojshme për të siguruar ekzekutimin, ta arrestojë atë me qëllim transferimin e tij sipas parashikimeve të nenit 43.

Neni 32

1. Kur shteti kërkues ka kërkuar ekzekutimin, shteti i kërkuar mund ta arrestojë personin e dënuar kur:

a) ligji i shtetit të kërkuar autorizon paraburgimin për këtë vepër penale;

b) ekziston rreziku i largimit ose, në rastin e një dënimi në mungesë, rreziku i dëmtimit të provave.

2. Kur shteti kërkues njofton qëllimin e tij për të kërkuar ekzekutimin, shteti i kërkuar mundet, në zbatim të kërkesës së shtetit kërkues, ta arrestojë personin e dënuar, me kusht që të plotësohen kushtet e përcaktuara në paragrafin e mësipërm, shkronjat (a) dhe (b). Kërkesa duhet të përmendë veprën penale që solli dënimin, kohën dhe vendin e kryerjes së saj, si edhe përshkrimin sa më të saktë të personit të dënuar. Ajo duhet të përmbajë gjithashtu një përshkrim të shkurtër të akteve në të cilat bazohet dënimi.

Neni 33

1. Personi i dënuar do të mbahet në burg në përputhje me legjislacionin e shtetit të kërkuar; ky legjislacion përcakton gjithashtu kushtet në të cilat ai mund të lirohet.

2. Personi i burgosur do të lirohet në të gjitha ato raste kur:

a) kohëzgjatja e burgimit arrin atë të sanksionit të dhënë me heqje lirie;

b) ai është arrestuar në zbatim të nenit 32 paragrafi i dytë dhe shteti i kërkuar nuk arriti të merrte brenda 18 ditëve nga data e arrestimit, kërkesën së bashku me dokumentet e specifikuara në nenin 16.

Neni 34

1. Një person i mbajtur në burg në shtetin e kërkuar, në përputhje me nenin 32, dhe që duhet të paraqitet para gjykatës kompetente të shtetit kërkues në përputhje me nenin 25, si pasojë e kundërshtimit që ai ka ngritur, do të transferohet për këtë qëllim në territorin e shtetit kërkues.

2. Pas transferimit, ky person nuk do të mbahet në burg nga shteti kërkues, nëse janë kushtet e përcaktuara në nenin 33 paragrafi i dytë ose nëse shteti kërkues nuk kërkon ekzekutimin e dënimit të ri. Personi do të kthehet menjëherë në shtetin e kërkuar, përsa kohë që ai nuk është liruar.

Neni 35

1. Një person i thirrur në një gjykatë kompetente të shtetit kërkues si rezultat i kundërshtimit që ai ka ngritur nuk do të procedohet, gjykohet dhe as do të dënohet, përsa i përket ekzekutimit të një dënimi ose mase sigurie dhe as do t'i nënshtrohet ndonjë kufizimi tjetër të lirisë vetjake për një arsye çfarëdo që ka lindur para largimit të tij nga territori i shtetit të kërkuar dhe nuk është specifikuar në ftesën për paraqitje, përveçse kur ky person jep pëlqimin shprehimisht me shkrim. Në rastin e parashikuar në paragrafin e parë të nenit 34, një kopje e deklaratës së pëlqimit do t'i transmetohet shtetit prej nga është transferuar personi.

2. Pasojat e parashikuara në paragrafin e mësipërm pushojnë kur personi i ftuar, pasi ka pasur mundësinë që të veprojë, nuk është larguar nga territori e shtetit kërkues brenda 15 ditëve pas datës së dhënies së vendimit që pason seancën në të cilën ai është paraqitur ose, nëse ai është kthyer në atë territor, pasi është larguar prej tij, pa qenë i detyruar për t'u paraqitur sërish.

Neni 36

1. Nëse shteti kërkues ka kërkuar ekzekutimin e një konfiskimi pasurie, shteti i kërkuar mund të procedojë me marrjen e përkohshme të pasurisë në fjalë, me kusht që legjislacioni i tij e parashikon marrjen për raste të ngjashme.

2. Marrja e pasurisë rregullohet nga legjislacioni i shtetit të kërkuar, i cili do të përcaktojë kushtet në të cilat mund të hiqet masa e marrjes së pasurisë.

SEKSIONI 5
EKZEKUTIMI I SANKSIONEVE

A. Përcaktime të përgjithshme

Neni 37

Një sanksion i vendosur në shtetin kërkues nuk do të ekzekutohet në shtetin e kërkuar, përveçse me anë të një vendimi të një gjykate në shtetin e kërkuar. Çdo shtet palë mundet sidoqoftë të ngarkojë autoritete të tjera të marrin vendime të tilla, nëse sanksioni që do të ekzekutohet është vetëm një gjobë ose konfiskim dhe nëse këto vendime janë të apelueshme në një gjykatë.

Neni 38

Çështja shqyrtohet nga gjykata ose nga autoriteti i ngarkuar sipas nenit 37, nëse shteti i kërkuar vëren se ka vend për të ndërmarrë veprime lidhur me kërkesën për ekzekutim.

Neni 39

1. Para se të marrë një vendim mbi kërkesën, gjykata i jep mundësinë personit të dënuar të shfaqë mendimin e tij, kur ky i fundit e kërkon këtë, përmes paraqitjes së tij personalisht përpara gjykatës ose përmes paraqitjes së një letre rogatore. Dëgjimi personalisht ndodh pas kërkesës së shprehur posaçërisht të vetë personit të dënuar.

2. Gjykata mundet sidoqoftë të vendosë për pranimin e kërkesës për ekzekutim në mungesë të personit që kërkon të paraqitet para gjykatës, nëse ai është i burgosur në shtetin kërkues. Në këto rrethana çdo vendim për zëvendësimin e sanksionit sipas nenit 44 do të shtyhet për sa kohë që personit të dënuar, pas transferimit të tij në shtetin e kërkuar, i është dhënë mundësia për t'u paraqitur para gjykatës.

Neni 40

1. Gjykata ose, në rastet e parashikuara në nenin 37, autoriteti i ngarkuar sipas të njëjtës dispozitë, sigurohet që:

a) sanksioni, ekzekutimi i të cilit kërkohet është vendosur në një gjykim penal europian;

b) kërkesat e nenit 4 janë përmbushur;

c) kushti i parashikuar nga shkronja "a" e nenit 6 nuk është përmbushur ose nuk bie ndesh me ekzekutimin;

d) ekzekutimi nuk bie ndesh me nenin 7;

e) në rastin e një dënimi në mungesë ose të një ordonnance penale, kërkesat e seksionit 3 të këtij kapitulli janë përmbushur.

2. Secili shtet palë mund ta ngarkojë gjykatën ose autoritetin e përcaktuar sipas nenit 37 me verifikimin e kushteve të tjera të ekzekutimit të parashikuara në këtë Konventë.

Neni 41

Vendimet gjyqësore të marra në përputhje me këtë seksion sipas kërkesave për ekzekutim dhe ato të marra mbi apelimet ndaj vendimeve të autoriteteve administrative sipas nenit 37, duhet të jenë të apelueshme.

Neni 42

Konstatimet e fakteve janë për shtetin e kërkuar të detyrueshme për sa kohë që ato janë paraqitur në vendim ose për sa kohë ky vendim bazohet heshtazi në to.

B) Dispozita të veçanta për ekzekutimin e sanksioneve me heqje lirie.

Neni 43

Kur personi i dënuar është burgosur në shtetin kërkues, me përjashtim të rastit kur legjislacioni i atij shteti parashikon ndryshe, ai duhet të transferohet në shtetin e kërkuar menjëherë pasi shteti kërkues të jetë njoftuar për pranimin e kërkesës për ekzekutim.

Neni 44

1. Nëse kërkesa për ekzekutim pranohet, gjykata duhet të zëvendësojë sanksionin me heqje lirie të vendosur në shtetin kërkues me një sanksion të parashikuar nga legjislacioni i tij për të njëjtën vepër penale. Ky sanksion mundet, në kufijtë e treguar në paragrafin e dytë, të jetë i një natyre ose kohëzgjatjeje tjetër nga ai i vendosur në shtetin kërkues. Nëse ky sanksion i fundit është më i vogël në minimum, sesa ai që mund të vendoset sipas legjislacionit të shtetit të kërkuar, gjykata nuk është e detyruar të respektojë këtë minimum dhe zbaton një sanksion që i korrespondon sanksionit të vendosur në shtetin kërkues.

2. Në vendosjen e sanksionit, gjykata nuk duhet të rëndojë pozitën penale të personit të dënuar që rezulton nga vendimi i dhënë në shtetin kërkues.

3. Çdo pjesë e sanksionit të vendosur në shtetin kërkues dhe e gjithë periudha e burgimit paraprak të vuajtur nga personi i dënuar pas dënimit do të llogaritet e plotë. E njëjta gjë do të zbatohet përsa i përket burgimit paraprak të vuajtur nga personi i dënuar në shtetin kërkues para dënimit të tij, për aq sa legjislacioni i atij shteti e rregullon këtë llogaritje.

4. Çdo shtet palë mundet në çdo kohë të depozitojë pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës një deklaratë, e cila i jep atij të drejtën, në përputhje me këtë Konventë, të ekzekutojë një sanksion me heqje lirie të të njëjtës natyrë me atë të vendosur në shtetin kërkues, edhe pse kohëzgjatja e këtij sanksioni kapërcen maksimumin e parashikuar nga legjislacioni i tij kombëtar për një sanksion të së njëjtës natyrë. Sidoqoftë, ky rregull do të zbatohet vetëm për rastet kur legjislacioni kombëtar i këtij shteti e lejon, për të njëjtën vepër penale, vendosjen e një sanksioni që ka të paktën të njëjtën kohëzgjatje sa ai i vendosur në shtetin kërkues, por që është i një natyre më të rëndë. Sanksioni i vendosur sipas këtij paragrafi mund të ekzekutohet, nëse kohëzgjatja dhe qëllimi i tij e kërkojnë kështu, në një institucion penal të caktuar për ekzekutimin e sanksioneve të një natyre tjetër.

C. Dispozita të veçanta për ekzekutimin e gjobave dhe konfiskimeve

Neni 45

1. Nëse kërkesa për ekzekutimin e një gjobe ose konfiskimi të një shume parash pranohet, gjykata ose, autoriteti i ngarkuar sipas nenit 37 konverton shumën në monedhën e shtetit të kërkuar sipas kursit të shkëmbimit në fuqi në momentin e marrjes së vendimit. Ajo përcakton edhe masën e gjobës ose shumën që duhet të konfiskohet, e cila nuk duhet të tejkalojë maksimumin e shumës së fiksuar në legjislacionin e saj për të njëjtën vepër penale ose, në mungesë të maksimumit ligjor, maksimumin e shumës së dhënë zakonisht në shtetin e kërkuar për një vepër të tillë penale.

2. Sidoqoftë, gjykata ose autoriteti i ngarkuar sipas nenit 37 mund t'i përmbahet për shumën e vendosur në shtetin kërkues, dënimit me gjobë ose konfiskimit, kur një sanksion i tillë nuk parashikohet nga legjislacioni i shtetit të kërkuar për të njëjtën vepër penale, por ky legjislacion lejon vendosjen e sanksioneve më të rënda. I njëjti rregullim zbatohet edhe nëse sanksioni i vendosur në shtetin kërkues tejkalon maksimumin e parashikuar në legjislacionin e shtetit të kërkuar për të njëjtën vepër penale, por ky legjislacion lejon vendosjen e sanksioneve më të rënda.

3. Të gjitha lehtësirat e pagimit të dhëna në shtetin kërkues, si përsa i përket afatit, edhe pagimit me këste, do të respektohen në shtetin e kërkuar.

Neni 46

1. Kur kërkesa për ekzekutim përmban konfiskimin e një objekti të veçantë, gjykata ose autoriteti i ngarkuar sipas nenit 37 mund të urdhërojë konfiskimin e atij objekti vetëm nëse ky konfiskim autorizohet nga legjislacioni i shtetit të kërkuar për të njëjtën vepër penale.

2. Sidoqoftë, gjykata ose autoriteti i ngarkuar sipas nenit 37 mund t'i përmbahen konfiskimit të urdhëruar në shtetin kërkues, kur ky sanksion nuk parashikohet në legjislacionin e shtetit të kërkuar për të njëjtën vepër penale, por ky legjislacion lejon vendosjen e sanksioneve më të rënda.

Neni 47

1. Gjobat e paguara dhe konfiskimet hyjnë në thesarin e shtetit të kërkuar, pa paragjykuar të drejtat e personave të tretë.

2. Objektet e konfiskuara që paraqesin një interes të veçantë, mund t'i kthehen shtetit kërkues me kërkesën e tij.

Neni 48

Nëse ekzekutimi i një gjobe bëhet i pamundur, mund të zbatohet nga një gjykatë e shtetit të kërkuar një sanksion zëvendësues me heqje lirie, nëse legjislacioni i të dy shteteve e parashikon një rast të tillë, përveçse kur shteti kërkues e kufizon kërkesën e tij shprehimisht në ekzekutimin vetëm të gjobës. Nëse gjykata vendos një sanksion zëvendësues me heqje lirie, zbatohen rregullat vijuese:

a) Nëse konvertimi i një gjobe në një sanksion me heqje lirie është parashkruar tashmë në vendimin e dhënë në shtetin kërkues ose direkt në ligjin e atij shteti, gjykata e shtetit të kërkuar përcakton natyrën dhe kohëzgjatjen e këtij sanksioni në përputhje me rregullat e vendosura në legjislacionin e saj. Nëse sanksioni me heqje lirie të parashkruar tashmë në shtetin kërkues është më i vogël sesa minimumi, i cili mund të vendoset sipas legjislacionit të shtetit të kërkuar, gjykata nuk është e detyruar të respektojë këtë minimum dhe vendos një sanksion tjetër korrespondues të sanksionit të parashkruar në shtetin kërkues. Kur gjykata vendos një sanksion, ajo nuk mund të rëndojë pozitën penale të personit të dënuar që rezulton nga vendimi i marrë në shtetin kërkues.

b) Në rastet e tjera, gjykata e shtetit të kërkuar procedon me konvertimin e gjobës sipas legjislacionit të saj, duke respektuar kufijtë e parashikuar nga legjislacioni i shtetit kërkues.

D. Dispozita të veçanta për ekzekutimin e heqjes ose kufizimit të një ose më shumë të drejtave

Neni 49

1. Kur paraqitet një kërkesë për ekzekutimin e heqjes ose kufizimit të një të drejte të vendosur në shtetin kërkues, ajo sjell pasoja vetëm nëse legjislacioni i shtetit të kërkuar lejon vendosjen e heqjes së saj për një vepër të tillë penale.

2. Gjykata që shqyrton çështjen vlerëson dobinë e ekzekutimit të heqjes të së drejtës në territorin e shtetit të saj.

Neni 50

1. Nëse gjykata urdhëron ekzekutimin e heqjes të së drejtës, ajo duhet të përcaktojë kohëzgjatjen brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni i saj, pa kapërcyer ato të vendosura nga vendimi dhënë në shtetin kërkues.

2. Gjykata mund të kufizojë heqjen e së drejtës vetëm për një pjesë të të drejtave për të cilat është vendosur heqja ose pezullimi.

Neni 51

Neni 11 nuk zbatohet për heqjen ose kufizimin e të drejtave.

Neni 52

Shteti i kërkuar ka të drejtë t'i rikthejë personit të dënuar të drejtat nga të cilat ai është privuar, në përputhje me vendimin e marrë në zbatim të këtij seksioni.

KAPITULLI III
PASOJAT NDËRKOMBËTARE TË GJYKIMEVE PENALE EUROPIANE

SEKSIONI 1
NE BIS IN IDEM

Neni 53

1. Një person, ndaj të cilit është zhvilluar një gjykim penal europian, nuk mund të procedohet, gjykohet apo të bëhet objekt ekzekutimi i një sanksioni në një shtet tjetër palë për të njëjtin fakt kur:

a) ai është shpallur i pafajshëm;

b) sanksioni i vendosur:

i) është ekzekutuar plotësisht ose është duke u ekzekutuar;

ii) është objekt i një faljeje ose amnistie në tërësinë e tij ose për pjesën e paekzekutuar;

iii) nuk mund të ekzekutohet më, pasi është parashkruar;

c) gjykata konstaton fajësinë e autorit, por nuk vendos ndonjë sanksion.

2. Sidoqoftë, një shtet palë nuk është i detyruar, përveçse, kur ai vetë ka kërkuar procedimin, të njohë pasojat e "ne bis in idem", nëse veprimi që i dha shkas gjykimit është drejtuar kundër ndonjë personi, institucioni ose sendi që ka karakter publik në këtë shtet ose nëse personi objekt i gjykimit kishte një karakter publik në këtë shtet.

3. Gjithashtu, çdo shtet palë në të cilin është kryer veprimi ose është konsideruar i tillë në përputhje me legjislacionin e atij shteti, nuk është i detyruar të njohë pasojat e "ne bis in idem" përveçse, kur ky shtet ka kërkuar procedimin.

Neni 54

Nëse fillohen procedime të reja kundër një personi të gjykuar për të njëjtin fakt në një shtet tjetër palë, çdo periudhë heqje lirie e vuajtur për ekzekutimin e një vendimi do të llogaritet në sanksionin që mund të vendoset.

Neni 55

Ky seksion nuk pengon zbatimin e rregullave kombëtare më të gjera lidhur me pasojat e "ne bis in idem" për gjykimet penale të huaja.

SEKSIONI 2
MARRJA NË KONSIDERATË

Neni 56

Çdo shtet palë merr masat legjislative, që i vlerëson të përshtatshme për t'u dhënë mundësi gjykatave, kur ato japin vendime, për të marrë në konsideratë të gjitha vendimet e mëparshme penale europiane të dhëna për një vepër tjetër penale pas paraqitjes së të akuzuarit, me qëllim që t'i bashkëlidhë atij vendimi të gjitha pasojat ose një pjesë të tyre, të cilat legjislacioni i tij ia bashkëlidh vendimeve të dhëna në territorin e tij. Ai përcakton kushtet në të cilat është dhënë ky vendim.

Neni 57

Çdo shtet palë merr masat legjislative që i vlerëson të përshtatshme për të dhënë mundësinë e marrjes në konsideratë të të gjitha vendimeve penale europiane të dhëna pas paraqitjes së të akuzuarit, me qëllim bërjen të zbatueshme të të gjitha ose të një pjese të heqjeve të zotësive të

bashkëlidhura sipas legjislacionit të tij vendimeve të dhëna në territorin e tij. Ai përcakton kushtet në të cilat është dhënë ky vendim.

KAPITULI IV
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 58

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të përfaqësuara në Komitetin e Ministrave të Këshillit të Europës. Ajo mund të ratifikohet ose pranohet. Instrumentet e ratifikimit ose të pranimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit ose të pranimit.

3. Për shtetet nënshkruese që e ratifikojnë ose e pranojnë këtë Konventë më vonë, ajo do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të tyre të ratifikimit ose të pranimit.

Neni 59

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Europës mund të ftojë çdo shtet joanëtar të aderojë në këtë Konventë. Rezoluta që përmban këtë ftesë duhet të marrë miratimin unanim të anëtarëve të Këshillit që kanë ratifikuar këtë Konventë.

2. Aderimi do të kryhet nëpërmjet depozitimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës të një instrumenti aderimi, i cili do të ketë efekt tre muaj pas datës së depozitimit.

Neni 60

1. Çdo shtet palë në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, të pranimit ose të aderimit, mund të specifikojë territoret në të cilat do të zbatohet kjo Konventë.

2. Çdo shtet palë, gjatë depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, të pranimit ose të aderimit, ose në një datë të mëvonshme, nëpërmjet një deklarate të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund të shtrijë zbatimin e kësaj Konvente në cilindo territor ose territore të specifikuara në deklaratë, territore për të cilat ai është përgjegjës për marrëdhëniet ndërkombëtare ose për të cilat ai është i autorizuar të lidhë marrëveshje.

3. Çdo deklaratë e bërë në përputhje me paragrafin e mësipërm mund të tërhiqet përsa i përket territoreve të përmendura në atë deklaratë, në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 66 të kësaj Konvente.

Neni 61

1. Çdo shtet palë, në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, të pranimit ose të aderimit, mund të deklarojë përdorimin prej tij të një ose më shumë rezervave të parashikuara në lidhjen I të kësaj Konvente.

2. Çdo shtet palë mund të tërheqë tërësisht ose pjesërisht një rezervë të formuluar nga ai në përputhje me paragrafin e mësipërm, me anë të një deklarate të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, e cila sjell pasoja që nga data e marrjes së saj.

3. Shteti palë që ka bërë një rezervë për një parashikim të kësaj Konvente nuk mund të pretendojë zbatimin e atij parashikimi nga një shtet tjetër; sidoqoftë ai mund të pretendojë, nëse rezerva është e pjesshme ose e kushtëzuara, zbatimin e kësaj dispozite në masën që ai vetë e ka pranuar.

Neni 62

1. Çdo shtet palë mundet në çdo kohë të tregojë, me anë të një deklarate të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, dispozitat ligjore për t'u përfshirë në lidhjen II dhe III të kësaj Konvente.

2. Çdo ndryshim i dispozitave kombëtare të përmendura në lidhjen II ose III duhet t'i njoftohet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, nëse ky ndryshim e bën të pasaktë informacionin e dhënë në ato lidhje.

3. Çdo ndryshim i bërë në lidhjen II ose III në zbatim të paragrafit të mësipërm sjell pasoja për çdo shtet palë një muaj pas datës së njoftimit të tyre nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 63

1. Çdo shtet palë duhet t'i japë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, në momentin e depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, të pranimit ose të aderimit, të gjitha informacionet e nevojshme lidhur me sanksionet e zbatueshme në atë shtet dhe ekzekutimin e tyre lidhur me zbatimin e kësaj Konvente.

2. Çdo ndryshim i mëvonshëm që e bën të pasaktë informacionin e dhënë sipas paragrafit të mësipërm duhet t'i njoftohet në të njëjtën mënyrë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 64

1. Kjo Konventë nuk cenon as të drejtat dhe as detyrimet që rrjedhin prej marrëveshjeve të ekstradimit dhe konventave ndërkombëtare shumëpalëshe që përmbajnë fusha specifike, as dispozitat që përmbajnë fushat që janë objekt i kësaj Konvente të përcaktuara në konventa të tjera ekzistuese ndërmjet shteteve palë.

2. Shtetet palë mund të lidhin marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe mes tyre, lidhur me çështjet e rregulluara nga kjo Konventë vetëm për të plotësuar dispozitat e saj ose për të lehtësuar zbatimin e parimeve që përmbahen aty.

3. Sidoqoftë, nëse dy ose më shumë shtete palë kanë vendosur ose janë duke vendosur marrëdhënie ndërmjet tyre mbi bazën e një legjislacioni uniform ose të një regjimi të veçantë, ata do të kenë të drejtë të rregullojnë marrëdhëniet e tyre të ndërsjella të kësaj fushe duke u bazuar ekskluzivisht në këto sisteme, pavarësisht nga dispozitat e kësaj Konvente.

4. Shtetet palë që pushojnë së zbatuari dispozitat e kësaj Konvente lidhur me marrëdhëniet e tyre të ndërsjella në këtë fushë, duhet të njoftojnë për këtë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 65

Komiteti Europian për çështjet penale i Këshillit të Europës do të ndjekë zbatimin e kësaj Konvente dhe do të bëjë gjithçka të nevojshme për arritjen e zgjidhjeve miqësore të vështirësive që mund të lindin gjatë zbatimit të saj.

Neni 66

1. Kjo Konventë do të mbetet në fuqi për një afat kohor të pacaktuar.

2. Çdo shtet palë, përsa i përket asaj, mund ta denoncojë këtë Konventë nëpërmjet një njoftimi të dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

3. Denoncimi do të ketë efekt gjashtë muaj pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 67

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të njoftojë shtetet anëtare të përfaqësuara në Komitetin e Ministrave të Këshillit dhe çdo shtet tjetër, i cili ka aderuar në këtë Konventë për:

a) çdo nënshkrim;

b) çdo depozitim të një instrumenti ratifikimi, pranimi ose aderimi;

c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në përputhje me nenin 58 të saj;

d) çdo deklaratë të marrë në përputhje me dispozitat e nenit 19 paragrafit të dytë;

e) çdo deklaratë të marrë në përputhje me dispozitat e nenit 44 paragrafit të katërt;

f) çdo deklaratë të marrë në përputhje me dispozitat e nenit 60;

g) çdo rezervë të bërë në përputhje me dispozitat e nenit 61 paragrafi i parë dhe tërheqjen e një rezerve të tillë;

h) çdo deklaratë të marrë në përputhje me dispozitat e nenit 62 paragrafit të parë dhe çdo njoftim të mëtejshëm të marrë në përputhje me atë dispozitë, paragrafi i dytë;

i) çdo njoftim të marrë në përputhje me dispozitat e nenit 63 paragrafi i parë dhe çdo njoftim të mëtejshëm të marrë në përputhje me atë dispozitë, paragrafi i dytë;

j) çdo njoftim përsa i përket marrëveshjeve të dyanshme ose të shumanshme të lidhura në përputhje me nenin 64 paragrafi i dytë ose përsa i përket legjislacionit uniform të futur sipas nenit 64 paragrafi i tretë;

k) çdo njoftim të marrë në përputhje me nenin 66 dhe datën në të cilën bëhet i efektshëm denoncimi.

Neni 68

Kjo Konventë, deklaratat dhe njoftimet e autorizuara prej saj zbatohen vetëm për ekzekutimet e vendimeve të dhëna pas hyrjes në fuqi të Konventës ndërmjet shteteve palë të interesuara.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit të autorizuar rregullisht, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Hagë, më 28 maj 1970, në frëngjisht dhe anglisht, të dyja tekstet njëlloj të vlefshme, në një kopje të vetme, e cila do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'u transmetojë kopje të vërtetuara secilit shtet nënshkrues dhe aderues.

Lidhja I

Çdo shtet palë mund të deklarojë se rezervon të drejtën:

a) të refuzojë ekzekutimin, nëse konsideron se dënimi përbën një shkelje fiskale ose fetare;

b) të refuzojë ekzekutimin e një sanksioni për një veprim, i cili sipas legjislacionit të shtetit të kërkuar i përkiste kompetencës ekskluzive të një autoriteti administrativ;

c) të refuzojë ekzekutimin e një gjykimi penal europian, të cilin autoritetet e shtetit kërkues e kryen në një datë kur, sipas legjislacionit të tij, procedimi penal i veprës penale të dënuar nga gjykimi duhet të ishte parashkruar;

d) të refuzojë ekzekutimin e sanksioneve të vendosura në mungesë dhe masave penale, ose vetëm të njërës nga kategoritë e vendimeve;

e) të refuzojë zbatimin e parashikimeve të nenit 8, kur ky shtet ka një kompetencë origjinale dhe të njohë në raste të tilla vetëm ekuivalencën e akteve që ndërpresin ose pezullojnë parashkrimin, akte që janë kryer në shtetin kërkues;

f) të pranojë zbatimin e pjesës III përsa i përket njërit nga dy seksionet e saj.

Lidhja II

Lista e shkeljeve të tjera, përveç atyre të klasifikuara si vepra penale nga legjislacioni penal.

Shkeljet (veprat) e mëposhtme konsiderohen si vepra penale:

- Në Francë: Çdo sjellje e paligjshme e sanksionuar si e tillë nga një "contravention de grande voirie".

- Në RFGJ: Çdo sjellje e paligjshme e sanksionuar si e tillë përmes procedurave të përcaktuara nga Akti mbi Thyerjen e Rregullave (gesetz uber ordnungswidrigkeiten) i 24 majit 1968 (BGBL 1968, I 481).

- Në Itali: Çdo sjellje e paligjshme e sanksionuar si e tillë përmes Aktit nr.317 të 3 marsit 1967.

Lidhja III

Austri – Nenet 460-462 të Kodit të Procedurës Penale.

Danimarkë - Neni 931 i Aktit mbi Administrimin e Drejtësisë.

Francë - 1. Nenet 524-528 të Kodit të Procedurës Penale shtuar me nenet R42-R50; 2.Ordonnance Penale të zbatueshme vetëm në departamentet e Bas-Rhin, Haut-Rhim dhe Mossele.

Gjermani – 1. Nenet 407-412 dhe 413 të Kodit të Procedurës Penale; 2. Nenet 65-66 të Aktit të 24 majit 1968 (BGBL 1968 I, 481).

Itali – 1.Nenet 506-510 të Kodit të Procedurës Penale. 2. Akti i 7 janarit 1929, nr.4 për çështjet fiskale. 3. Nenet 1242-1243 të Kodit të Lundrimit. 4. Vendimi në zbatim të Aktit nr.317 të 3 marsit 1967.

Luksemburg – 1. Akti i 31 korrikut 1924 për organizimin e ordonnances penaleso. 2. Neni 16 i aktit të 14 shkurtit 1955 për trafikun në autostradat publike.

Norvegji – 1. Nenet 287-290 të Aktit për Procedurat gjyqësore në çështjet penale. 2. Neni 31B i Kodit Rrugor të 18 qershorit 1965.

Suedi – Kapitulli 48 i Kodit të Procedurave.

Turqi – Nenet 386 –391 të Kodit të Procedurës Penale dhe të gjitha vendimet sipas të cilave autoritetet administrative vendosin sanksione.

LIGJ
Nr.9081, datë 19.6.2003

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS PËR DORËZIMIN E PERSONAVE NË GJYKATËN NDËRKOMBËTARE PENALE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për dorëzimin e personave në Gjykatën Ndërkombëtare Penale", nënshkruar në Tiranë më 2.5.2003.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr. 3869, datë 30.6.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.53, faqe 2153

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS NË LIDHJE ME DORËZIMIN E PERSONAVE NË GJYKATËN NDËRKOMBËTARE PENALE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në vazhdim "Palët":

duke afirmuar rëndësinë e sjelljes përpara drejtësisë të personave që kryejnë genocid, krime kundër njerëzimit, si dhe krime lufte;

duke rikujtuar që Statuti i Romës i Gjykatës Ndërkombëtare Penale i përpiluar në Romë, më 17 korrik 1998, nga konferenca diplomatike e të plotfuqishmëve të Kombeve të Bashkuara për krijimin e një Gjykate Ndërkombëtare Penale, ka për qëllim të plotësojë dhe jo të zëvendësojë juridiksionin penal kombëtar;

duke pasur parasysh që secila prej palëve ka shprehur synimin e saj për të hetuar dhe për të ndjekur penalisht, kur e shohin me vend, veprimet brenda juridiksionit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale për të cilat pretendohet se janë kryer nga zyrtarët, nëpunësit, personeli ushtarak apo nënshtetasit e tjerë të tyre;

duke pasur paraysh nenin 98 të Statutit të Romës, bien dakord si më poshtë:

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, "persona" janë zyrtarë të tanishëm apo të mëparshëm të Qeverisë, të punësuar (përfshirë edhe kontraktuesit) ose personel ushtarak apo nënshtetas të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

2. Personat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, në mungesë të miratimit të shprehur prej Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës:

a) nuk do të dorëzohen apo nuk do të transferohen në asnjë mënyrë në Gjykatën Ndërkombëtare Penale për çfarëdo qëllimi ose

b) nuk do të dorëzohen apo nuk do të transferohen në asnjë mënyrë në një entitet tjetër ose vend të tretë apo të dëbohen në një vend të tretë, me qëllim dorëzimin apo transferimin në Gjykatën Ndërkombëtare Penale.

3. Kur Qeveria e Republikës së Shqipërisë ekstradon, dorëzon ose ndryshe transferon një person të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në një vend të tretë, Qeveria e Republikës së Shqipërisë nuk do të pranojë dorëzimin apo transferimin e këtij personi në Gjykatën Ndërkombëtare Penale nga një vend i tretë, pa miratimin e shprehur të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

4. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi me një shkëmbim notash, të cilat do të konfirmojnë që secila Palë ka përmbushur kërkesat e domosdoshme të legjislacionit të brendshëm për ta sjellë Marrëveshjen në fuqi. Do të vazhdojë të jetë në fuqi deri një vit pas datës, kur njëra Palë njofton tjetrën për synimin e saj për t'i dhënë fund kësaj Marrëveshjeje. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të vazhdojnë të jenë të vlefshme për çdo akt që do të kryhet apo çdo akuzë që do të ngrihet, përpara datës efektive të mbarimit të Marrëveshjes.

Përfunduar në Tiranë, në dublikatë, më datë 2 maj 2003 në gjuhët shqipe dhe angleze. Në rast mosmarrëveshjeje në interpretim, do të merret parasysh teksti në gjuhën angleze.

LIGJ
Nr.9092, datë 3.7.2003

PËR ZBATIMIN E "KONVENTËS PËR NDALIMIN E ZHVILLIMIT, TË PRODHIMIT, MAGAZINIMIT DHE PËRDORIMIT TË ARMËVE KIMIKE DHE PËR SHKATËRRIMIN E TYRE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 122 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1
Objekti

Ky ligj përcakton autoritetin, përgjegjësitë, krijimin dhe funksionimin e organeve të nevojshme për zbatimin e detyrimeve, që rrjedhin nga Konventa për Ndalimin e Armëve Kimike (KNAK) në Republikën e Shqipërisë, si shtet palë e saj.

Neni 2
Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Armët kimike" janë veçmas ose së bashku:

a) kimikatet helmuese dhe paraardhësët e tyre, përveç rastit kur përdoren për qëllime, të cilat nuk ndalohen nga Konventa, me kusht që lloji dhe sasia të jenë brenda normave të përcaktuara në të;

b) municionet dhe pajisjet e përgatitura për të shkaktuar vdekje ose dëmtime të tjera, përmes vetive helmuese të kimikateve të përmendura në shkronjën "a " të pikës 1 të këtij neni;

c) çdo pajisje e projektuar për përdorim të drejtpërdrejtë të municioneve dhe mjeteve të përcaktuara në shkronjën "b" të pikës 1 të këtij neni.

2. "ONAK-u" është Organizata për Ndalimin e Armëve Kimike, me seli në Hagë, Holandë.

3. "Numrat kimikë CAS" janë numrat e regjistrimit të produktit kimik, sipas Sistemit Kimik Abstrakt.

4. "Konventa" është "Konventa për ndalimin e zhvillimit, magazinimit dhe përdorimit të amëve kimike dhe për shkatërrimin e tyre" e 13 janarit 1993, së bashku me anekset (Aneksi I "Për kimikatet", Aneksi II "Për zbatimin dhe verifikimin" dhe Aneksi III "Për mbrojtjen e të dhënave").

Neni 3
Autoriteti shtetëror për zbatimin e Konventës

1. Ministri i Mbrojtjes është autoriteti shtetëror i Republikës së Shqipërisë për zbatimin e Konventës.

2. Autoriteti shtetëror kryen funksionet e parashikuara në pikën 4 të nenit 7 të Konventës dhe në dispozitat e këtij ligji.

3. Autoriteti shtetëror bashkërendon veprimtarinë e të gjithë organizmave dhe sipërmarrjeve industriale, të vendit dhe atyre ndërkombëtarë, për zbatimin e plotë të Konventës. Gjithashtu ai, në bashkëpunim me Ministrin e Punëve të Jashtme, Ministrin e Industrisë dhe të Energjetikës, Ministrin e Financave, Ministrin e Ekonomisë, Ministrin e Rendit Publik, Ministrin e Mjedisit, përgatit dhe nxjerr udhëzimet e nevojshme.

Neni 4

Funksionimi i strukturës për zbatimin e Konventës, përgjegjësitë dhe krijimi i bordit të këshilltarëve

1. Në Ministrinë e Mbrojtjes, në mbështetje të autoritetit shtetëror, krijohet dhe funksionon struktura për zbatimin e Konventës, e cila:

a) ndjek ecurinë e marrëdhënieve me ONAK-un dhe me autoritetet shtetërore të vendeve të tjera;

b) përgatit kushtet për nënshkrimin e marrëveshjeve ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe ONAK-ut;

c) përgatit raportin vjetor, të cilin ia paraqet Ministrit të Mbrojtjes, ku përshkruhen, me hollësi, të dhëna për zbatimin e Konventës në Republikën e Shqipërisë;

ç) njofton institucionet e përmendura në pikën 3 të nenit 3 të këtij ligji për gjendjen në vend;

d) shkëmben të dhëna për prodhimin, zotërimin, përdorimin, transferimin, eksportimin, importimin dhe shkatërrimin e produkteve që përdoren në industrinë kimike, të përmendura në nenin 5 të këtij ligji.

2. Struktura e lartpërmendur, përveç përgjegjësive dhe detyrave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, zbaton edhe detyra të tjera, të caktuara me akte ligjore e nënligjore.

3. Pranë Ministrit të Mbrojtjes krijohet bordi i këshilltarëve, si organ këshillimor, për çështjet e Konventës.

4. Përbërja, detyrat, përgjegjësitë dhe shpërblimi i anëtarëve të bordit të këshilltarëve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes.

Neni 5

Detyrimi për deklarimin e veprimtarisë dhe verifikimi nga autoriteti shtetëror

1. Çdo person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, që prodhon, zotëron, përdor ose transferon lëndë kimike, importon dhe/ose eksporton lëndë me përbërje kimike, të përcaktuara në tabelat 1, 2 dhe 3, që i bashkëlidhen këtij ligji, si dhe zotëruesit e impianteve të prodhimit të këtyre lëndëve janë subjekt deklarimi dhe verifikimi nga autoriteti shtetëror, për të siguruar përputhshmërinë e veprimtarive të tyre me Konventën dhe me këtë ligj.

2. Personi fizik ose juridik, vendas ose i huaj, është i detyruar të japë, sa herë i kërkohet nga autoriteti shtetëror, çdo të dhënë për veprimtarinë që ushtron, kur kjo veprimtari përmban elemente të fushës, që mbulon Konventa, për të verifikuar nëse këto veprimtari ushtrohen në përputhje me kërkesat e saj dhe të këtij ligji.

3. Informacioni paraqitet përmes një deklarate vjetore, sipas formularit që lëshohet nga autoriteti shtetëror.

Neni 6

Bashkëpunimi me specialistët

Autoriteti shtetëror bashkëpunon me institucionet shkencore, si me Universitetin Politeknik, Laboratorin Qendror të Forcave të Armatosura, shoqatat e industrisë kimike, si dhe me organizma e specialistë të tjerë, të specializuar në fushën e kimisë, për asistencë teknike.

Neni 7

Përfaqësuesi i përhershëm në ONAK

Përfaqësuesi i përhershëm i Republikës së Shqipërisë në ONAK emërohet nga Ministri i Punëve të Jashtme nga personeli i shërbimit të jashtëm.

Neni 8

Çështjet e sigurisë kombëtare

Autoriteti shtetëror, për çështje që ndikojnë në sigurinë kombëtare, vë në dijeni Kuvendin, Presidentin e Republikës dhe Kryeministrin.

Neni 9

Rregullat për deklarim dhe për marrjen e licencës

Në zbatim të Konventës dhe të këtij ligji, Këshilli i Ministrave miraton:

1. Rregullat e detyrueshme për deklarim dhe marrjen e licencës për:

a) prodhimin, depozitimin, transferimin dhe përdorimin e produkteve me përdorim të dyfishtë, të produkteve ushtarake të veçanta dhe të të gjitha produkteve kimike, të cilat përfshihen në nenet dhe anekset e Konventës;

b) importimin, eksportimin, kalimin tranzit dhe ndërmjetësimin për produktet me përdorim të dyfishtë, për produktet ushtarake të veçanta, si dhe për të gjitha produktet kimike, mbi të cilat veprojnë nenet e Konventës.

2. Udhëzimet për zbatimin e pikës 1 të këtij neni.

Neni 10

Detyrimi për informacion për organet e kontrollit

1. Çdo person fizik ose juridik, që kërkon të pajiset me licencë ose ka licencë, detyrohet t'u japë organeve të kontrollit, të përcakuara në këtë ligj, të gjitha të dhënat dhe dokumentet e nevojshme për vlerësimin tërësor të veprimtarisë ose për kryerjen e kontrolleve përkatëse.

2. Detyrimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni i nënshtrohen edhe shtetasit e tjerë, që kanë detyrime në zbatim të këtij ligji.

Neni 11

Dhënia e licencave

1. Asnjë person fizik ose juridik nuk mund të importojë ose eksportojë lëndë me përbërje kimike, të përcaktuara në tabelat 1, 2 dhe 3, si dhe nuk mund të prodhojë produkte kimike me përmbajtje fosfori, sulfuresh dhe fluoresh, pa licencën përkatëse, të lëshuar nga Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës.

2. Kërkesa për marrjen e licencës, sëbashku me dokumentacionin e nevojshëm, për ushtrimin e veprimtarive, që u nënshtrohen kontrollit të përcaktuar në Konventë dhe në këtë ligj, dërgohet në Ministrinë e Industrisë dhe të Energjetikës.

Kjo Ministri, për çdo rast, përpara dhënies së licencës merr miratimin e autoritetit shtetëror.

3. Dhënia e licencës mund të shoqërohet me kushte dhe detyrime, të cilat, në asnjë rast, nuk përbëjnë konflikt interesash.

4. Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës përcaktojnë, me udhëzim të përbashkët, dokumentacionin që shoqëron kërkesën për marrje licence.

Neni 12

Mospranimi i kërkesës për licencë

1. Kërkesa për marrjen e licencës nuk pranohet kur veprimtaria është në kundërshtim me:

a) Konventën për Ndalimin e Armëve Kimike (KNAK) dhe me marrëveshjet ndërkombëtare të kësaj fushe;

b) kërkesat dhe kushtet e parashikuara nga ky ligj dhe nga aktet e tjera ligjore e nënligjore.

2. Dhënia e licencës për prodhimin, përpunimin, përdorimin dhe magazinimin e lëndëve me

përbërje kimike, të përcaktuara në tabelën 1, refuzohet nëse:

a) veprimtaria nuk ka qëllime shkencore, mjekësore ose farmaceutike;

b) lloji dhe sasia e përbërjeve kimike nuk janë brenda limiteve të lejuara për veprimtaritë shkencore, mjekësore ose farmaceutike;

c) sasia e përgjithshme e këtyre përbërjeve kimike, për përdorim në Republikën e Shqipërisë, për veprimtaritë shkencore, mjekësore ose farmaceutike është më e madhe se 1 ton;

ç) sasia e përgjithshme e këtyre përbërjeve kimike, e prodhuar ose e eksportuar në Republikën e Shqipërisë, është më e madhe se 1 ton.

3. Dhënia e licencës për importim refuzohet në rastet kur sasia e përbërjeve kimike, e përcaktuar në tabelën 1, së bashku me sasinë e përgjithshme të përbërjeve kimike të lejueshme, gjendje në territorin e Republikës së Shqipërisë, është më e madhe se 1 ton.

4. Dhënia e licencës për eksportim refuzohet nëse:

a) përbërjet kimike në tabelën 1 do të eksportohen në një shtet, që nuk është palë në Konventë, ose do të rieksportohen ne një shtet të tretë;

b) përbërjet kimike nuk do të përdoren për qëllime shkencore, mjekësore, farmaceutike ose për qëllim të mbrojtjes nga armët kimike;

c) përbërjet kimike të tabelave 2 dhe 3 kanë si destinacion një shtet, që nuk është palë në Konventë ose nuk shoqërohen me dokumentacionin e nevojshëm, që të garantojë përdorimin vetëm për qëllime të lejuara nga Konventa.

Neni 13

Transferimi dhe kohëzgjatja e licencës

1. Licenca e dhënë, sipas kritereve të këtij ligji dhe të akteve të tjera ligjore e nënligjore, është e patransferueshme te persona të tjerë fzikë ose juridikë.

2. Licenca është e vlefshme për 12 muaj, nga data e dhënies. Afati i përdorimit të saj mund të shtyhet vetëm një herë, por deri në 6 muaj. Procedurat për miratimin e kërkesës për shtyrjen e afatit janë të njëjta me ato të përcaktuara në nenin 11 të këtij ligji.

Neni 14

Revokimi i licencës

Licenca revokohet kur:

a) pas lëshimit të saj krijohen rrethana, që plotësojnë kushtet për refuzim, siç parashikohet në nenin 12 të këtij ligji;

b) kushtet dhe detyrimet për të cilat është dhënë nuk janë respektuar.

Neni 15

Masat ndaj shteteve që janë përdoruesit e fundit të një produkti

1. Këshilli i Ministrave, në përputhje dhe në zbatim të marrëveshjeve ndërkombëtare, ka të drejtë t'ia refuzojë kërkesën për dhënie leje çdo shteti, i cili është përdoruesi i fundit i produktit, kur vëren se janë shkelur kërkesat e Konventës dhe dispozitat e këtij ligji.

2. Këshilli i Ministrave parashikon lehtësira ose bën përjashtime nga masat e kontrollit ndaj një shteti:

a) i cili është palë në Konventë;

b) është nënshkrues i masave të kontrollit ndërkombëtar, jo të detyrueshme nga e drejta ndërkombëtare, të pranuara këto me marrëveshje dypalëshe.

Neni 16
Inspektimet

1. Deklaratat dhe vërtetësia e dokumentacionit verifikohen nëpërmjet inspektimeve të drejtpërdrejta në vend.

2. Deklaratat për prodhimin e përbërjeve kimike të tabelës 1 verifikohen jo vetëm nëpërmjet inspektimeve të drejtpërdrejta, por edhe nëpërmjet instrumenteve ose pajisjeve që vendosen në mjedisin ku ndodhet impianti që verifikohet.

Neni 17
Inspektimi shtetëror

Në Ministrinë e Industrisë dhe të Energjetikës krijohet dhe funksionon, si organ kontrolli, struktura e inspektimit shtetëror.

Neni 18
Inspektimi ndërkombëtar

Inspektimi ndërkombëtar kryhet nga përfaqësues të organizatës së ONAK-ut dhe zhvillohet në prani të një grupi shoqërues vendas, i cili kryesohet nga përfaqësuesi i autoritetit shtetëror dhe në përbërje ka përfaqësues nga Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Mjedisit, Ministria e Shëndetësisë dhe specialistë nga Universiteti Politeknik dhe Laboratori Qendror i Forcave të Armatosura.

Neni 19
Lidhja e marrëveshjeve për inspektim

1. Inspektimet periodike të personave fizikë dhe juridikë, që ushtrojnë veprimtari në fushën e industrisë kimike ose në fusha të tjera, që përmbajnë elemente të parashikuara në Konventë, për të cilat Republika e Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshje inspektimi me ONAK-un, zhvillohen në përputhje me këtë ligj dhe me marrëveshjen.

2. Palët, për çdo inspektim, lidhin marrëveshje për rregullat e kryerjes së inspektimit.

3. Marrëveshja nënshkruhet nga kryetari i ekipit të inspektimit, për ONAK-un, dhe nga kryetari i grupit të shoqërimit, për palën shqiptare.

Neni 20
Bashkëpunimi me inspektorët

1. Subjektet e licencuara, për të zotëruar ose drejtuar impiantet për fabrikimin e lëndëve kimike, të çdo lloji, janë të detyruara të lejojnë inspektimet dhe të bashkëpunojnë me inspektorët.

Subjektet e licencuara vënë në dispozicion të ekipit të inspektimit ose personit të autorizuar:

a) të gjitha të dhënat që u kërkohen, për kryerjen e inspektimit;

b) pajisjet e telekomunikacionit, mjediset e punës, mjetet e transportit, të nevojshme për lëvizjet brenda këtyre mjediseve, për realizimin e inspektimit;

c) mostra, me kërkesë të ekipit, si dhe lejojnë fotografimin e objekteve dhe të ndërtesave të impiantit që inspektohet;

ç) analiza, me kërkesë dhe në prani të ekipit të inspektimit, kur ky veprim nuk bie në kundërshtim me masat e sigurimit teknik;

d) të gjithë dokumentacionin përkatës për pjesët dhe objektet e impiantit që po inspektohet, ku nuk lejohet hyrja e inspektorëve.

Gjithashtu, subjektet duhet:

- të marrin masa sigurimi gjatë kryerjes së inspektimit (për mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të inspektorëve), si dhe të japin të dhëna për administratën dhe logjistikën;

- të kontribuojnë në vlerësimin e rezultateve paraprake të inspektimit dhe në sqarimin e çështjeve të dyshimta;

- t'u japin organeve përkatëse informacionet e nevojshme për negociimet dhe përfundimin e marrëveshjeve të inspektimit, në rastet kur inspektimi është kërkuar nga ONAK-u.

2. Shpenzimet e inspektorëve, në rastet e kontrolleve të kërkuara nga ONAK-u, për akomodimin, komunikimin (përfshi përkthyesit), lëvizjen, ndihmën mjekësore, në raste urgjente, përballohen nga pronari ose drejtuesi i impiantit dhe rimbursohen nga ONAK-u.

Kërkesa për rimbursim i paraqitet autoritetit shtetëror, i cili ia paraqet ONAK-ut.

Neni 21

Kryerja e inspektimeve

Ekipet e inspektimeve ndërkombëtare të ONAK-ut në territorin e Republikës së Shqipërisë lejohen:

a) të hyjnë e të dalin lirisht gjatë orarit normal të punës në mjediset ku ndodhet impianti që po inspektohet;

b) të përdorin materialin e miratuar nga ONAK-u, duke zbatuar kushtet dhe masat e sigurimit teknik brenda reparteve të ndryshme që po inspektohen;

c) të kryejnë të gjitha hetimet e nevojshme për inspektimin dhe të mbledhin të gjitha të dhënat e nevojshme për këtë qëllim, duke marrë në pyetje, kur është e domosdoshme, edhe personelin e impiantit që inspektohet;

ç) të kontrollojnë dokumentet, materialet, ambalazhimet dhe regjistrat e produkteve që ndodhen në impiant;

d) të marrin mostra kimike, por vetëm me lejen e pronarit ose të drejtuesit të impiantit që po inspektohet;

dh) të analizojnë mostrat e marra, brenda impiantit që inspektohet ose në laboratorë jashtë tij, të njohura dhe të përcaktuara nga ONAK-u;

e) të vendosin instrumente matëse dhe pajisje për monitorimin e vazhdueshëm të impianteve të licencuara për prodhimin e përbërësve kimikë të tabelës 1, në mënyrë të tillë dhe në atë masë që këto instrumente të mos pengojnë funksionimin e tyre;

ë) të kërkojnë të dhëna për hyrje-daljet e të gjitha mjeteve të transportit, që qarkullojnë në impiantin që po inspektohet;

f) të vëzhgojnë dhe inspektojnë mjetet e transportit që hyjnë dhe dalin nga impianti, përveç rastit kur bëhet fjalë për mjete private (automjete private të tonazhit të ulët).

Neni 22

Përgjegjësitë e grupit të shoqërimit

Grupi i shoqërimit merr të gjitha masat e nevojshme për kryerjen e një inspektimi efikas dhe të befasishëm, pa cenuar interesat e pronarit ose të drejtuesit të impiantit që inspektohet.

Grupi ka këto përgjegjësi:

a) krijon kushtet e nevojshme për inspektim, pa cenuar veprimtarinë e impiantit gjatë zhvillimit të inspektimit;

b) mbron të dhënat, të klasifikuara "Sekret shtetëror", dhe pajisjet private, si dhe ruan konfidencialitetin;

c) bën klasifikimin e qartë të të gjitha të dhënave që i vihen në dispozicion ekipit të inspektimit;

ç) merr, në bashkëpunim me pronarin ose drejtuesin e impiantit që inspektohet, vendime për vënien në dispozicion të ekipit të inspektorëve të të dhënave konfidenciale;

d) kujdeset, me kërkesë të pronarit ose të drejtuesit të impiantit që inspektohet, që informacioni dhe të dhënat të mos dalin jashtë impiantit, duke parandaluar spiunazhin industrial;

dh) zhvillon bisedime me ekipin e inspektimit për ndjekjen e procedurave të veçanta, për të mbrojtur palët dhe objektet e impiantit që inspektohet;

e) merr në dorëzim raportin e ekipit të inspektimit, bashkë me vërejtjet e ekipit të inspektorëve dhe një kopje të këtij raporti ia dorëzon pronarit ose drejtuesit të impiantit, ku u zhvillua inspektimi.

Neni 23

Detyrimi për bashkëpunim ndërmjet organeve shtetërore dhe drejtuesve të impianteve që inspektohen

1. Pronari ose drejtuesi i impiantit, ku do të kryhet inspektimi, duhet të njoftohet nga organet përkatëse shtetërore për inspektimin e paralajmëruar nga ONAK-u, për datën e saktë të fillimit të inspektimit, për vendin ku do të kryhet, përbërjen e ekipit të inspektimit dhe të grupit të shoqërimit.

2. Kur pronari ose drejtuesi i impiantit pëson dëm gjatë inspektimit, për shkak të veprimeve të të tretëve, shteti shqiptar mbështet kërkesën për dëmshpërblim, në përputhje me kompetencat e tij ligjore.

Neni 24

Veprimtaritë e ndaluara

Personave fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, në të gjitha rastet u ndalohet:

a) të zhvillojnë, prodhojnë, blejnë, magazinojnë, zotërojnë armë kimike ose t'i transferojnë ato, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, te persona të tjerë;

b) të përdorin armë kimike;

c) të marrin pjesë në trajnime ushtarake për përdorimin e armëve kimike;

ç) të ndihmojnë, nxisin ose detyrojnë, në çdo mënyrë, persona të tjerë që të marrin pjesë në çdo veprimtari të ndaluar për një shtet nënshkrues të Konventës;

d) të transferojnë ose të marrin nga shtetet që nuk janë palë në Konventë, lëndët kimike të tabelave 1 dhe 2 të Konventës.

Ky nen është i detyrueshëm edhe për shtetasit shqiptarë që kryejnë veprimtari jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 25

Mbrojtja e të dhënave

Personeli i organizmave ndërkombëtarë dhe specialistët janë të detyruar të ruajnë informacionin e klasifikuar "Sekret shtetëror", në përputhje me ligjin nr.8457, datë 11.2.1999 "Për informacionin e klasifikuar "Sekret shtetëror" në Republikën e Shqipërisë" dhe me dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 26

Kundërvajtjet administrative

1. Shmangia nga detyrimet e Konventës dhe nga nenet 5, 6, 10, 13, 20, 23, 24, 25 të këtij ligji përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 300 000 lekë.

2. Shmangia nga detyrimet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, kur ndodh më shumë se 1 herë, përbën vepër penale dhe dënohet në përputhje me dispozitat e Kodit Penal.

3. Vënia e gjobave të parashikuara në pikën 1 dhe kallëzimi për shmangie nga detyrimet e pikës 2 bëhen nga organi i kontrollit.

4. Subjektet, të cilat gjobiten sipas këtij neni për kundërvajtje administrative, kanë të drejtën e ankimit pranë autoritetit shtetëror, i cili, për shqyrtimin e tyre, krijon një komision të posaçëm.

Neni 27
Ekzekutimi i gjobës

Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, ankimi ndaj vendimeve të autoritetit shtetëror dhe ekzekutimi i gjobës bëhen në përputhje me dispozitat e ligjit nr.7687, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative", i ndryshuar, dhe me Kodin e Procedurës Civile.

Neni 28
Shpenzimet

Fondet për përballimin e shpenzimeve të veprimtarive, në zbatim të Konventës dhe të këtij ligji, planifikohen dhe përballohen nga Buxheti i Shtetit.

Neni 29
Nxjerrja e akteve

Këshilli i Ministrave ngarkohet të nxjerrë aktet nënligjore të nevojshme në zbatim të neneve 4 pika 4, 9 e 15 të këtij ligji.

Neni 30
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3906, datë 30.7.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.63, faqe 2809

LIGJ
Nr.9094, datë 3.7.2003

PËR RATIFIKIMIN E "PROTOKOLLIT OPSIONAL TË KONVENTËS KUNDËR TORTURËS DHE TRAJTIMIT OSE DËNIMIT TË EGËR, ÇNJERËZOR OSE POSHTËRUES"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Protokolli opsional i Konventës kundër torturës dhe trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3908, datë 30.7.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.63, faqe 2828

Sesioni i pesëdhjetë e shtatë
Komiteti i tretë
Pika e rendit të ditës 109 (a)
Çështjet e të drejtave të njeriut: zbatimi i instrumenteve mbi të drejtat e njeriut

Shqipëria, Andorra, Argjentina, Armenia, Austria, Belgjika, Benin, Bolivia, Bosnja dhe Hercegovina, Brazili, Bullgaria, Burkina Faso, Burundi, Cape Verde, Kili, Komoros, Kongo, Kosta Rika, Kote Divore, Kroacia, Qipro, Republika Çeke, Danimarka, Republika Domenikane, El Salvador, Finlanda, Franca, Gabia, Gerjania, Gana, Greqia, Grenada, Guatemale, Guinea-Bisau, Honduras, Hungaria, Islanda, Irlanda, Italia, Kiribari, Kirgistani, Latvia, Lesoto, Lihtenshtein, Lituania, Luksenburgu, Madagaskar, Malawi, Ishujt Marshall, Meksiko, Monako, Namibia, Hollanda, Zelanda e Re, Nikaragua, Norvegjia, Panama, Papua Nju Guinea, Paraguai, Polonia, Portugalia, Rumania, Saint Kits de Nevis, Senegal, Sierra Leone, Sllovakia, Sllovenia, Afrika e Jugut, Spanja, Suriname, Suedia, Svicra, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, Uruguai dhe Jugosllavia: hartojnë rezolutën protokoll opsional për Konventën kundër torturës dhe trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor dhe poshtërues.

Asambleja e Përgjithshme,

duke iu referuar nenit 5 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut1, nenit 7 të Konventës Ndërkombëtare të të Drejtave Civile dhe Politike2, Deklaratës mbi mbrojtjen e të gjithë personave nga nënshtrimi në torturë dhe trajtim ose dënim17 të egër, çnjerëzor ose poshtërues dhe rezolutës së saj 39/46 të 10 dhjetorit 1984, nëpërmjet së cilës ajo miratoi dhe hapi për nënshkrim, ratifikim dhe aderim Konventën kundër torturës dhe trajtimit ose dënimit të egër çnjerëzor dhe poshtërues dhe të gjitha rezolutat përkatëse pasardhëse;

duke riafirmuar se liria nga tortura është një e drejtë që duhet të mbrohet në të gjitha rrethanat;

duke konsideruar se Konferenca Botërore mbi të Drejtat e Njeriut, mbajtur në Vjenë nga 14 deri në 25 qershor 1993, deklaroi fuqimisht se përpjekjet për heqjen e torturës, para së gjithash, duhet të përqëndrohen në parandalimin dhe bëri thirrje për aprovim të shpejtë të një protokolli opsional të Konventës kundër torturës dhe trajtimit ose dënimit të egër çnjerëzor ose poshtërues, i cili ka si synim të vendosë një sistem parandalues të vizitave të rregullta në vendet e ndalimit;

duke mirëpritur miratimin e projektprotokollit opsional të Konventës kundër torturës dhe trajtimit të egër, çnjerëzor dhe poshtërues nga Komisioni i të Drejtave të Njeriut në rezolutën e tij 2002/33 i 22 prillit 200218 dhe nga Këshilli Ekonomik dhe Social në rezolutën e tij E/2002/27 të 24 qershor 2002, në të cilën Këshilli i rekomandon Asamblesë së Përgjithshme aprovimin e projektprotokollit opsional:

[1] Rezoluta 217 A (III)
[2] Shiko rezolutën 2200 A (XXI), aneks
[3] Rezoluta 3452 (XXX), aneks
[18] shiko Regjistrat Zyrtarë të Këshillit Ekonomik dhe Social, 2002, numër suplementar 3.

1. Miraton protokollin opsional të Konventës kundër torturës dhe trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, që është në shtojcën e kësaj rezolute dhe i kërkon Sekretarit të Përgjithshëm ta hapë atë për nënshkrim, ratifikim ose aderim në Qendrën e Kombeve të Bashkuara në Nju York nga 1 janari 2003.

2. U bën thirrje shteteve që kanë nënshkruar, ratifikuar ose aderuar në Konventën kundër torturës dhe trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues të nënshkruajnë, ratifikojnë ose aderojnë në protokollin opsional.

Shtojcë

PROTOKOLL
OPSIONAL I KONVENTËS KUNDËR TORTURËS DHE TRAJTIMIT OSE DËNIMIT TË EGËR, ÇNJERËZOR OSE POSHTËRUES

PREAMBUL

Shtetet Palë të këtij protokolli:

duke rikonfirmuar se tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues ndalohen dhe përbëjnë një shkelje serioze të të drejtave të njeriut;

të bindur se për arritjen e qëllimeve të Konventës kundër torturës dhe trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues (tani e tutje quhet Konventa) dhe për forcimin e mbrojtjes së personave, që u është hequr liria nga tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues, janë të nevojshme masa të mëtejshme;

duke rikujtuar se nenet 2 dhe 16 të Konventës e detyrojnë çdo Shtet Palë të marrë masa të efektshme për të parandaluar aktet e torturës ose trajtimit apo dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues në të gjithë territorin nën juridiksionin e tij;

duke njohur që shtetet kanë përgjegjësinë primare për zbatimin e këtyre neneve, që forcimi i mbrojtjes së njerëzve, që u është hequr liria dhe respektimi i plotë i të drejtave të njeriut për ta është një përgjegjësi e përbashkët dhe organet ndërkombëtare zbatuese plotësojnë dhe forcojnë masat kombëtare;

duke rikujtuar se parandalimi i efektshën i torturës dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues kërkon edukim dhe një kombinim të masave legjislative, administrative, gjyqësore dhe të tjera;

duke rikujtuar gjithashtu se Konferenca Botërore mbi të Drejtat e Njeriut deklaroi fuqimisht se përpjekjet për heqjen e torturës duhet para së gjithash të përqëndrohen në parandalimin dhe bëri thirrje për miratimin e një protokolli opsional të Konventës, e cili ka si qëllim të vendosë një sistem parandalues vizitash të rregullta në vendet e ndalimit;

të bindur se mbrojtja e personave, që u është hequr liria nga tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues mund të forcohet nëpërmjet masave jogjyqësore të një natyre parandaluese, bazuar mbi vizita të rregullta në vendet e ndalimit,

kanë rënë dakord si më poshtë:

PJESA I
PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i këtij protokolli është vendosja e një sistemi vizitash të rregullta të ndërmarra nga organe të pavarura ndërkombëtare dhe kombëtare në vendet ku njerëzve u është hequr liria, me qëllim që të parandalohet tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor dhe poshtërues.

Neni 2

1. Krijohet një Nënkomitet për Parandalimin e torturës dhe trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues i Komitetit kundër Torturës (tani e tutje quhet Nënkomitet për Parandalimin) që ushtron funksionet e parashikuara në këtë protokoll.

2. Nënkomiteti për Parandalimin e kryen punën e tij brenda kuadrit të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe udhëhiqet nga qëllimet dhe principet e saj, si dhe normat e Kombeve të Bashkuara në lidhje me trajtimin e njerëzve që u është hequr liria.

3. Po ashtu, Nënkomiteti për Parandalimin udhëhiqet nga principet e besueshmërisë, paanësisë, mosdallimit, universalitetit dhe objektivitetit.

4. Nënkomiteti për Parandalimin dhe Shtetet Palë bashkëpunojnë për zbatimin e këtij protokolli.

Neni 3

Çdo Shtet Palë krijon, projekton ose mban në nivel kombëtar një ose disa organe vizitore për parandalimin e torturës dhe trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues (tani e tutje quhet mekanizmi parandalues kombëtar).

Neni 4

1. Çdo Shtet Palë lejon vizita, në pajtim me këtë protokoll nga mekanizmat e përmendur në nenet 2 dhe 3 në çdo vend nën juridiksionin dhe kontrollin e tij ku njerëzve u është hequr ose mund t'u hiqet liria, me anë të një vendimi të dhënë nga një organ publik ose me kërkesën, pëlqimin ose lejimin e tij (tani e tutje quhen vendet e ndalimit). Këto vizita ndërmerren me qëllimin e forcimit, nëse është e nevojshme, të mbrojtjes së këtyre personave nga tortura ose nga trajtimi apo dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues.

2. Për qëllimet e kësaj Konvente, heqje lirie është çdo lloj ndalimi ose burgosjeje, ose vendosja e personit në një kompleks të veçuar publik ose privat, nga i cili ai person nuk lejohet të largohet vetë me vendim të një organi gjyqësor, administrativ ose i një natyre tjetër.

PJESA II
NËNKOMITETI I PARANDALIMIT

Neni 5

1. Nënkomiteti i Parandalimit përbëhet nga 10 anëtarë. Pas ratifikimit ose aderimit të pesëdhjetë të këtij protokolli, numri i anëtarëve të Nënkomitetit të Parandalimit rritet në 25.

2. Anëtarët e Nënkomitetit zgjidhen nga personat me karakter të lartë moral, që kanë treguar eksperiencë profesionale në administrimin e drejtësisë, sidomos në të drejtën penale, burgje ose administratën policore apo në fusha të ndryshme që kanë të bëjnë me trajtimin e personave që u është hequr liria.

3. Në përbërjen e Nënkomitetit i kushtohet vëmendje shpërndarjes gjeografike të drejtë dhe përfaqësimit të formave të ndryshme të civilizimit dhe sistemeve ligjore të Shteteve Palë.

4. Për përbërjen i kushtohet rëndësi edhe përfaqësimit të balancuar të gjinisë mbi bazën e principit të barazisë dhe mosdiskriminimit.

5. Dy anëtarë të Nënkomitetit nuk mund të jenë qytetarë të të njëjtit shtet.

6. Anëtarët e Nënkomitetit, që shërbejnë në zotësinë e tyre individuale, janë të pavarur dhe të paanshëm dhe janë të gatshëm t'i shërbejnë Nënkomitetit me efektivitet.

Neni 6

1. Çdo Shtet Palë mund të emërojë, në pajtim me paragrafin 2 të mëposhtëm, deri në dy kandidatë që kanë cilësitë dhe plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 5, dhe kur bëjnë këtë, japin informacion të detajuar në lidhje me kualifikimet e personit të emëruar.

2. a) Personat e emëruar kanë shtetësinë e një Shteti Palë në këtë protokoll.

b) Të paktën njëri prej dy kandidatëve ka shtetësinë e Shtetit Palë që bën emërimin.

c) Nuk emërohen më shumë se dy shtetas të një Shteti Palë.

d) Para se një Shtet Palë të emërojë një shtetas të një Shteti tjetër Palë, ai kërkon dhe merr pëlqimin e atij Shteti Palë.

3. Të paktën pesë muaj para datës së takimit të Shteteve Palë në të cilin bëhen zgjedhjet, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara u dërgon një letër Shteteve Palë duke i ftuar ato të paraqesin emërimet e tyre brenda tre muajve. Sekretari i Përgjithshëm paraqet një listë, me renditje alfabetike të të gjithë personave të emëruar, duke vënë në dukje Shtetet Palë që kanë bërë emërimin e tyre.

Neni 7

1. Anëtarët e Nënkomitetit të Parandalimit zgjidhen në mënyrën e mëposhtme:

a) rëndësi e veçantë i kushtohet përmbushjes së kërkesave dhe kritereve të nenit 5 të këtij protokolli;

b) zgjedhja e parë bëhet jo më vonë se gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të këtij protokolli;

c) Shtetet Palë i zgjedhin anëtarët e Nënkomitetit me votë të fshehtë;

d) zgjedhja e anëtarëve të Nënkomitetit bëhet në mbledhjet në çdo dy vjet të Shteteve Palë të thirrura nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara. Në këto mbledhje, tek të cilat kuorumi përbëhet nga dy të tretat e Shteteve Palë, personat e zgjedhur në Nënkomitet janë ata që marrin numrin më të madh të votave dhe shumicën absolute të votave dhe të përfaqësuesve të Shteteve Palë të pranishme dhe votuese.

2. Kur gjatë procesit zgjedhor, dy shtetas të një Shteti Palë janë bërë të përshtatshëm për të shërbyer si anëtarë të Nënkomitetit të Parandalimit, kandidati që merr numrin më të madh të votave shërben si anëtar i Nënkomitetit. Kur shtetasit kanë marrë numër të njëjtë votash, zbatohet procedura e mëposhtme:

a) kur është emëruar vetëm njëri nga Shteti Palë, shtetas i të cilit ai ose ajo është, ky shtetas shërben si anëtar i Nënkomitetit të Parandalimit;

b) kur janë emëruar të dy nga Shteti Palë, shtetas të të cilit ata janë, mbahet një votim i veçantë i fshehtë për të përcaktuar se cili shtetas bëhet anëtar;

c) kur nuk është emëruar asnjë kandidat nga Shteti Palë, shtetas i të cilit ai ose ajo është, mbahet një votim i veçantë i fshehtë për të përcaktuar se cili kandidat bëhet anëtar.

Neni 8

Kur një anëtar i Nënkomitetit të Parandalimit vdes, jep dorëheqjen ose për një arsye tjetër nuk mund t'i ushtrojë më detyrat e tij ose të saj, Shteti Palë që ka emëruar këtë anëtar emëron një person tjetër të përshtatshëm, që ka kualifikimet dhe plotëson kërkesat e parashikuara në nenin 5, duke marrë parasysh nevojën për ekuilibrin e duhur ndërmjet fushave të ndryshme të kompetencës, për të shërbyer deri në mbledhjen tjetër të Shteteve Palë, duke iu nënshtruar aprovimit të shumicës së Shteteve Palë. Aprovimi konsiderohet si i dhënë, përveç kur gjysma ose pjesa më e madhe e Shteteve Palë përgjigjen negativisht brenda gjashtë muajve pas njoftimit të marrë nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara në lidhje me emërimin e propozuar.

Neni 9

Anëtarët e Nënkomisionit të Parandalimit zgjidhen për një periudhë katërvjeçare. Ata janë të përshtatshëm për t'u rizgjedhur një herë kur riemërohen. Afati i gjysmës së anëtarëve të zgjedhur në zgjedhjen e parë përfundon me kalimin e dy viteve; menjëherë pas zgjedhjes së parë emrat e këtyre anëtarëve zgjidhen me short nga kryetari i mbledhjes së përmendur në nenin 7 paragrafi 1(d).

Neni 10

1. Nënkomiteti i Parandalimit i zgjedh nëpunësit e tij për një afat dyvjeçar. Ata mund të rizgjidhen.

2. Nënkomiteti i Parandalimit cakton rregullat e veta procedurale. Këto rregulla, ndërmjet të tjerash, përcaktojnë:

a) gjysma plus një e anëtarëve përbën kuorumin;

b) vendimet e Nënkomitetit të Parandalimit merren me anë të votës së shumicës së anëtarëve të pranishëm;

c) Nënkomiteti i Parandalimit zhvillon mbledhje me dyer të mbyllura.

3. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara thërret mbledhjen e parë të Nënkomitetit të Parandalimit. Pas mbledhjes së parë Nënkomiteti i zhvillon mbledhjet në ato afate që parashikohet në rregullat e veta procedurale. Nënkomiteti i Parandalimit dhe Komiteti kundër Torturës i mbajnë sesionet e tyre në të njëjtën kohë, të paktën një herë në vit.

PJESA III
MANDATI I NËNKOMITETIT TË PARANDALIMIT

Neni 11

Nënkomiteti i Parandalimit:

a) viziton vendet e përmendura në nenin 4 dhe u bën rekomandime Shteteve Palë në lidhje me mbrojtjen e personave, që u është hequr liria nga tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues;

b) në lidhje me mekanizmat kombëtarë parandalues:

i) këshillon dhe ndihmon Shtetet Palë, kur është e nevojshme, në punën e tyre;

ii) mban kontakt të drejtpërdrejtë me mekanizmat kombëtarë parandalues dhe, kur është e nevojshme, në mënyrë konfidenciale u ofron atyre trajnim dhe ndihmë teknike, me qëllim që të forcojnë mundësitë e tyre;

iii) i këshillon dhe i ndihmon ata në vlerësimin e nevojave dhe mjeteve të nevojshme për forcimin e mbrojtjes së personave, që u është hequr liria nga tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues;

iv) u bën rekomandime dhe vërejtje Shteteve Palë, me qëllim që të forcojë mundësinë dhe mandatin e mekanizmave kombëtarë parandalues për parandalimin e torturës dhe trajtimin ose dënimin e egër, çnjerëzor ose poshtërues;

c) bashkëpunon për parandalimin e torturës në përgjithësi, me organet dhe mekanizmat përkatës të Kombeve të Bashkuara, si dhe me institucionet dhe organizatat ndërkombëtare, regjionale dhe kombëtare, që punojnë për forcimin e mbrojtjes së personave nga tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor dhe poshtërues.

Neni 12

Me qëllim që t'i mundësohet Nënkomitetit të Parandalimit të përmbushë mandatin e tij, siç është parashikuar në nenin 11, Shtetet Palë marrin përsipër:

a) ta pranojnë Nënkomitetin e Parandalimit në territorin e tyre dhe t'i lejojë hyrjen në vendet e ndalimit të përmendura në nenin 4 të këtij protokolli;

b) t'i japin Nënkomitetit të Parandalimit të gjithë informacionin përkatës që ky mund të kërkojë për të vlerësuar nevojat dhe masat që duhet të merren, me qëllim që të forcohet mbrojtja e personave që u është hequr liria nga tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues;

c) të inkurajojnë dhe të lehtësojnë kontaktet ndërmjet Nënkomitetit të Parandalimit dhe mekanizmave kombëtarë parandalues;

d) të shqyrtojnë rekomandimet e Nënkomitetit të Parandalimit dhe të hyjnë në bisedime me të në lidhje me masat e mundshme për zbatimin.

Neni 13

1. Nënkomiteti i Parandalimit, në fillim me short, cakton një program me vizita të rregullta në Shtetet Palë, me qëllim që të përmbushë mandatin e tij të parashikuar në nenin 11.

2. Pas konsultimeve, Nënkomiteti i Parandalimit njofton Shtetet Palë në lidhje me programin, me qëllim që ata të mund të marrin pa vonesë masat e nevojshme praktike për vizitat që do të kryhen.

3. Vizitat kryhen nga të paktën dy anëtarë të Nënkomitetit të Parandalimit. Këta anëtarë mund të shoqërohen, kur është e nevojshme, nga ekspertë me eksperiencë dhe njohuri profesionale të provuara në fushat e mbuluara nga ky protokoll, të cilët zgjidhen nga një listë ekspertësh të përgatitur mbi bazën e propozimeve nga Shtetet Palë, Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut dhe Qendra e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Krimit në nivel ndërkombëtar. Në përgatitjen e listës, Shtetet Palë të interesuara propozojnë jo më shumë se pesë ekspertë kombëtarë. Shteti Palë i interesuar mund të kundërshtojë përfshirjen e një eksperti të caktuar në vizitë dhe në një rast të tillë Nënkomiteti i Parandalimit propozon një ekspert tjetër.

4. Kur Nënkomiteti i Parandalimit e konsideron të nevojshme, ai mund të propozojë një vizitë të shkurtër verifikuese pas vizitës së rregullt.

Neni 14

1. Me qëllim që Nënkomitetit të Parandalimit t'i mundësohet përmbushja e mandatit, Shtetet Palë në këtë protokoll marrin përsipër t'i sigurojnë:

a) mundësi të pakufizuara për të marrë të gjithë informacionin në lidhje me numrin e personave, që u është hequr liria në vendet e ndalimit të përmendura në nenin 4, si dhe numrin e vendeve dhe vendndodhjen e tyre;

b) mundësi të pakufizuara për të marrë të gjithë informacionin në lidhje me trajtimin e këtyre personave, si dhe kushtet e tyre të ndalimit;

c) në pajtim me paragrafin 2 të mëposhtëm, mundësi të pakufizuara për të parë vendet e ndalimit dhe ambientet e tyre të brendshme;

d) mundësinë për të bërë intervista private pa dëshmitarë me personat që u është hequr liria, personalisht ose me përkthyes nëse është e nevojshme, si dhe me çdo person tjetër që Nënkomiteti i Parandalimit mendon se mund të japë informacion të nevojshëm;

e) lirinë për të zgjedhur vendet që ai do të vizitojë dhe personat që do të intervistojë.

2. Kundërshtimi i një vizite në një vend të caktuar ndalimi mund të bëhet vetëm atëherë kur ka arsye urgjente detyruese për mbrojtjen kombëtare, sigurinë publike, katastrofa natyrore ose rrëmujë serioze në vendin që do të vizitohet, që përkohësisht e pengojnë kryerjen e një vizite të tillë. Qenia e një deklarate të gjendjes së jashtëzakonshme si të tillë nuk përdoret nga Shteti Palë si arsye për kundërshtimin e vizës.

Neni 15

Asnjë organ ose nëpunës nuk urdhëron, zbaton, lejon ose toleron ndonjë sanksion kundër ndonjë personi ose organizate, për shkak se i ka dërguar Nënkomitetit të Parandalimit ose

përfaqësuesve të tij çdo lloj informacioni, të vërtetë ose të falsifikuar dhe asnjë person ose organizatë e tillë nuk paragjykohet në ndonjë mënyrë.

Neni 16

1. Nënkomiteti i Parandalimit ia dërgon rekomandimet dhe vërejtjet Shtetit Palë në mënyrë konfidenciale dhe kur është e nevojshme, edhe mekanizmit kombëtar.

2. Nënkomiteti i Parandalimit e boton raportin e tij së bashku me ndonjë koment të bërë nga Shteti Palë i interesuar, kurdoherë që kjo kërkohet nga ky Shtet Palë. Kur Shteti Palë publikon një pjesë të raportit, Nënkomiteti i Parandalimit mund ta botojë raportin pjesërisht ose tërësisht. Megjithatë, nuk botohet asnjë e dhënë personale pa pëlqimin e dhënë shprehimisht nga personi i interesuar.

3. Nënkomiteti i Parandalimit paraqet një raport vjetor publik mbi aktivitetet e tij tek Komiteti kundër Torturës.

4. Kur Shteti Palë nuk pranon të bashkëpunojë me Nënkomitetin e Parandalimit sipas neneve 12 dhe 14 ose të ndërmarrë hapa për të përmirësuar situatën nën dritën e rekomandimeve të Nënkomitetit, Komiteti kundër Torturës, me kërkesë të Nënkomitetit të Parandalimit, mund të vendosë me shumicën e anëtarëve të tij, pasi Shteti Palë të ketë pasur mundësinë të bëjë të ditura mendimet e tij, të bëjë një deklaratë publike mbi çështjen ose të botojë raportin e Nënkomitetit.

PJESA IV
MEKANIZMAT PARANDALUES KOMBËTARË

Neni 17

Çdo Shtet Palë mban, emëron ose krijon, jo më vonë se një vit pas hyrjes në fuqi të këtij protokolli ose të ratifikimit apo të aderimit, një ose disa mekanizma të pavarur, kombëtarë parandalues për parandalimin e torturës në nivel kombëtar. Mekanizmat e krijuar si njësi të decentralizuara mund të emërohen si mekanizma kombëtarë parandalues për qëllimet e këtij protokolli, nëse ato janë në pajtim me dispozitat e tij.

Neni 18

1. Shtetet Palë garantojnë pavarësinë funksionale të mekanizmave parandalues kombëtarë, si dhe pavarësinë e personelit të tyre.

2. Shtetet Palë marrin masat e nevojshme, me qëllim që ekspertët e mekanizmave kombëtarë të kenë cilësitë e kërkuara dhe njohuritë profesionale. Ata përpiqen për një ekuilibër gjinish dhe përfaqësim të plotë të grupeve minoritare dhe etnike në vend.

3. Shtetet Palë ndërmarrin të vënë në dispozicion burimet e nevojshme për funksionimin e mekanizmave parandalues kombëtarë.

4. Kur themelojnë mekanizmat parandalues kombëtarë, Shtetet Palë u kushtojnë vëmendjen e duhur principeve në lidhje me statusin dhe funksionimin e institucioneve kombëtare për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Neni 19

Mekanizmave parandalues kombëtarë u jepen minimalisht kompetencat:

a) të vëzhgojnë rregullisht trajtimin e personave, që u është hequr liria në vendet e ndalimit që përmenden në nenin 4, me qëllim që të forcohet, kur është e nevojshme, mbrojtja e tyre nga tortura, trajtimi ose dënimi i egër çnjerëzor ose poshtërues;

b) t'u bëjë rekomandime organeve përkatëse, me qëllim që të përmirësohet trajtimi dhe kushtet e personave, që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër

çnjerëzor dhe poshtërues, duke marrë parasysh normat përkatëse të Kombeve të Bashkuara;

c) të bëjë propozime dhe vërejtje në lidhje me legjislacionin ekzistues dhe në hartim e sipër.

Neni 20

Me qëllim që t'u mundësohet mekanizmave parandalues kombëtarë të përmbushin mandatin e tyre, Shtetet Palë në këtë protokoll ndërmarrin t'u garantojnë atyre:

a) mundësinë e çdo informacioni në lidhje me numrin e personave që u është hequr liria në vendet e ndalimit, siç përmendet në nenin 4, si dhe numrin e vendeve dhe vendndodhjen e tyre;

b) mundësinë e të gjithë informacionit në lidhje me trajtimin e këtyre personave, si dhe kushtet e tyre të ndalimit;

c) mundësinë për tek të gjitha vendet e ndalimit dhe ambientet e tyre të brendshme;

d) mundësinë për të bërë intervista private pa dëshmitarë me personat që u është hequr liria, personalisht ose me një përkthyes kur është e nevojshme, si dhe me çdo person tjetër që mekanizmi parandalues kombëtar beson se mund të japë informacion të nevojshëm;

e) lirinë për të zgjedhur vendet që ata duan të vizitojnë dhe personat që ata duan të intervistojnë;

f) të drejtën për të pasur kontakte me Nënkomitetin e Parandalimit, për t'i dërguar informacion dhe për t'u takuar me të.

Neni 21

1. Asnjë organ ose nëpunës nuk urdhëron, zbaton, lejon ose toleron ndonjë sanksion kundër një personi ose organizate, për shkak se i ka dërguar mekanizmit parandalues kombëtar informacion të vërtetë ose të falsifikuar dhe asnjë person ose organizatë e tillë nuk paragjykohet në asnjë mënyrë.

2. Informacioni konfidencial i mbledhur nga mekanizmi parandalues kombëtar mbetet i tillë. Nuk botohet asnjë e dhënë personale pa u dhënë pëlqimi shprehimisht nga personi i interesuar.

Neni 22

Organet kompetente të Shtetit Palë të interesuar shqyrtojnë rekomandimet e mekanizmit parandalues kombëtar dhe hyjnë me të në bisedime mbi masat e mundshme për zbatimin.

Neni 23

Shtetet Palë në këtë protokoll marrin përsipër të botojnë dhe të shpërndajnë raportet vjetore të mekanizmave parandalues kombëtarë.

PJESA V
DEKLARATA

Neni 24

1. Në momentin e ratifikimit, Shtetet Palë mund të bëjnë një deklaratë për të shtyrë plotësimin e detyrimeve të tyre të parashikuara në pjesën III ose në pjesën IV të këtij protokolli.

2. Kjo shtyrje është e efektshme jo më shumë se tre vjet. Pas shpjegimeve përkatëse të bëra nga Shteti Palë dhe pas konsultimeve me Nënkomitetin e Parandalimit, Komiteti kundër Torturës mund ta zgjasë atë periudhë me dy vjet të tjerë.

PJESA VI
DISPOZITA FINANCIARE

Neni 25

1. Shpenzimet e shkaktuara nga Nënkomiteti i Parandalimit në zbatimin e këtij protokolli mbulohen nga Kombet e Bashkuara.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara siguron stafin dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e efektshme të funksioneve të Nënkomitetit sipas këtij protokolli.

Neni 26

1. Krijohet një fond i veçantë në përputhje me rregulloret përkatëse të Asamblesë së Përgjithshme, që administrohet në pajtim me rregulloret dhe rregullat financiare të Kombeve të Bashkuara, për të ndihmuar në financimin e zbatimit të rekomandimeve të bëra nga Nënkomiteti i Parandalimit pas vizitës në një Shtet Palë, si dhe për programet edukative të mekanizmave parandalues kombëtarë.

2. Fondi i veçantë mund të financohet me anë të kontributeve vullnetare të bëra nga qeveritë, organizatat ndërqeveritare dhe joqeveritare, si dhe subjekte private ose publike.

PJESA VII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 27

1. Ky protokoll është i hapur për t'u nënshkruar nga çdo shtet që ka nënshkruar Konventën.

2. Ky protokoll i nënshtrohet ratifikimit nga çdo shtet që ka ratifikuar ose aderuar në Konventë. Instrumentet e ratifikimit depozitohen tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

3. Ky protokoll është i hapur për të aderuar çdo shtet që ka ratifikuar ose aderuar në Konventë.

4. Aderimi hyn në fuqi nëpërmjet depozitimit të një instrumenti aderimi tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

5. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara informon të gjitha shtetet që kanë nënshkruar këtë protokoll ose aderuar në të për depozitimin e çdo instrumenti ratifikimi ose aderimi.

Neni 28

1. Ky protokoll hyn në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara të instrumentit të njëzetë të ratifikimit ose të aderimit.

2. Për çdo shtet që ratifikon këtë protokoll ose aderon në të, pas depozitimit tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara të instrumentit të njëzetë të ratifikimit ose të aderimit, ky protokoll hyn në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit të instrumentit të vet të ratifikimit ose të aderimit.

Neni 29

Dispozitat e këtij protokolli shtrihen në të gjitha pjesët e shteteve federale pa ndonjë kufizim ose përjashtim.

Neni 30

Këtij protokolli nuk mund t'i bëhet asnjë rezervë.

Neni 31

Dispozitat e këtij protokolli nuk cenojnë detyrimet e Shteteve Palë në bazë të konventave regjionale që caktojnë një sistem vizitash në vendet e ndalimit. Nënkomiteti i Parandalimit dhe organet e parandalimit, të caktuara në bazë të konventave regjionale, inkurajohen të konsultohen dhe të bashkëpunojnë, me qëllim që të mënjanohet puna e dyfishtë dhe të promovohen në mënyrë aktive objektivat e këtij protokolli.

Neni 32

Dispozitat e këtij protokolli nuk cenojnë detyrimet e Shteteve Palë në katër Konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1949 dhe protokollet shtesë të tyre të 8 qershorit 1977, as edhe mundësinë që ka çdo Shtet Palë të autorizojë Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq për të vizituar vendet e ndalimit në situatë që nuk mbulohen nga e drejta ndërkombëtare humanitare.

Neni 33

1. Çdo Shtet Palë mund ta denoncojë këtë protokoll në çdo kohë me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili pas kësaj njofton të gjitha Shtetet e tjera Palë të këtij protokolli dhe Konventës. Denoncimi hyn në fuqi një vit pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

2. Ky denoncim nuk ka efektin e lirimit të Shtetit Palë nga detyrimet e tij sipas këtij protokolli në lidhje me çdo akt ose situatë që mund të ndodhë para datës në të cilën bëhet i efektshëm denoncimi ose në lidhje me veprimet, që Nënkomiteti i Parandalimit ka vendosur ose mund të vendosë të aprovojë në lidhje me këtë Shtet Palë, as edhe nuk paragjykon në ndonjë mënyrë shqyrtimin e vazhdueshëm të çdo çështjeje që ka nisur të shqyrtohet nga Nënkomiteti i Parandalimit para datës në të cilën denoncimi hyn në fuqi.

3. Pas datës në të cilën denoncimi i Shtetit Palë hyn në fuqi, Nënkomiteti i Parandalimit nuk fillon shqyrtimin e ndonjë çështjeje të re në lidhje me atë shtet.

Neni 34

1. Çdo Shtet Palë në këtë protokoll mund të propozojë një ndryshim dhe ta depozitojë atë tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara. Sekretari i Përgjithshëm ua dërgon pastaj ndryshimin e propozuar Shteteve Palë të këtij protokolli me kërkesën ta njoftojnë atë nëse ata janë për organizimin e një konference të Shteteve Palë, me qëllimin e shqyrtimit dhe votimit të propozimit. Kur brenda katër muajve nga data e një njoftimi të tillë, të paktën një e treta e Shteteve Palë janë për një konferencë të tillë, Sekretari i Përgjithshëm thërret konferencën nën kujdesin e Kombeve të Bashkuara. Çdo ndryshim i aprovuar nga një shumicë prej dy të tretave të Shteteve Palë të pranishme dhe votuese në konferencë u paraqitet nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuar të gjitha Shteteve Palë për pranim.

2. Një ndryshim i miratuar në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni hyn në fuqi kur të jetë pranuar nga një shumicë prej dy të tretave të Shteteve Palë në këtë protokoll në pajtim me procesin e tyre kushtetues përkatës.

3. Kur ndryshimet hyjnë në fuqi, ato janë të detyrueshme për ato Shtete Palë që i kanë pranuar ato, Shtetet e tjera Palë që janë nën detyrimin e dispozitave të këtij protokolli dhe të ndryshimeve të mëparshme që ato kanë pranuar.

Neni 35

Anëtarëve të Nënkomitetit të Parandalimit dhe të mekanizmave parandalues kombëtarë u sigurohen ato privilegje dhe imunitete që janë të nevojshme për ushtrimin e pavarur të funksioneve të tyre. Anëtarëve të Nënkomitetit të Parandalimit u garantohen privilegjet dhe imunitetet e parashikuara në seksionin 22 të Konventës mbi privilegjet dhe imunitetet e Kombeve të Bashkuara të 13 shkurtit 1946, në pajtim me dispozitat e seksionit 23 të Konventës.

Neni 36

Gjatë vizitës në një Shtet Palë, anëtarët e Nënkomitetit të Parandalimit, pa cenuar dispozitat dhe qëllimet e këtij protokolli, privilegjet dhe imunitetet që ata mund të gëzojnë:

a) respektojnë ligjet dhe rregulloret e shtetit të vizituar;

b) nuk kryejnë asnjë veprim ose aktivitet që është në kundërshtim me natyrën e paanshme dhe ndërkombëtare të detyrave të tyre.

Neni 37

1. Ky protokoll, tekstet e të cilit në gjuhën arabe, kineze, angleze, franceze, ruse dhe spanjolle janë njëlloj autentike, depozitohen tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

LIGJ
Nr.9169, datë 22.1.2004

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SHTESË TË KONVENTËS EUROPIANE TË 21 MARSIT 1983 "PËR TRANSFERIMIN E PERSONAVE TË DËNUAR" NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË ITALISË

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet Marrëveshja shtesë e Konventës Europiane të 21 marsit 1983 "Për transferimin e personave të dënuar" ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4123, datë 9.2.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.5, faqe 135

MARRËVESHJE
SHTESË E KONVENTËS MBI TRANSFERIMIN E PERSONAVE TË DËNUAR
TË 21 MARSIT 1983

Republika e Shqipërisë dhe Republika Italiane:

duke dashur të intensifikojnë dhe të lehtësojnë bashkëpunimin në marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve në zbatimin e Konventës Europiane mbi transferimin e personave të dënuar të 21 marsit 1983 (e përmendur më poshtë si "Konventa");

duke konsideruar të përshtatshëm plotësimin e Konventës në disa pika, me qëllim shtrirjen e zbatimit edhe me forma të tjera të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore penale,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

1. Termat dhe shprehjet e përdorura në këtë Marrëveshje duhen interpretuar sipas Konventës.

2. Dispozitat e Konventës janë të zbatueshme në masën që janë të pajtueshme me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

1. Kur në njërin prej shteteve është shpallur një vendim dënimi i formës së prerë ndaj një shtetasi të shtetit tjetër, ky i fundit, me kërkesën e shtetit dënues, mund të procedojë me ekzekutimin përkatës, në rast se personi i dënuar ndodhet në territorin e tij, në përputhje me normativat e brendshme lidhur me njohjen e vendimit gjyqësor.

2. Me kërkesën e shtetit dënues, shteti ekzekutues, përpara marrjes së dokumentacionit mbështetës të kërkesës ose në pritje të vendimit përkatës për këtë kërkesë, mund të procedojë me arrestimin e personit të dënuar ose me marrjen e çdo lloj mase për të garantuar që ai të mbetet në territorin e tij në pritje të një vendimi lidhur me kërkesën. Në këtë kuptim kërkesat shoqërohen me informacionet e parashikuara në paragrafin 3 të nenit 4 të Konventës. Ky arrestim i personit të dënuar nuk mund të çojë në një rëndim të situatës penale të tij.

3. Për ekzekutimin e vendimit të dënimit sipas këtij neni, nuk është e nevojshme marrja e pëlqimit të personit të dënuar.

Neni 3

Me kërkesën e shtetit dënues, shteti ekzekutues, duke përfshirë zbatimin e dispozitave të këtij neni, mund të lejojë transferimin e një personi të dënuar pa pëlqimin e këtij të fundit kur vendimi i shpallur ndaj tij ose një masë administrative e formës së prerë, sipas rregullit të brendshëm të shtetit dënues, shpie në një masë dëbimi ose shoqërimi deri në kufi, në zbatim të së cilës personi i dënuar, pas daljes së tij nga burgu, nuk mund të qëndrojë më në territorin e shtetit dënues.

Shteti ekzekutues e jep pëlqimin e tij në bazë të paragrafit 1 vetëm pasi të ketë dëgjuar mendimin e personit të dënuar.

Me qëllim zbatimin e këtij neni, shteti dënues i përcjell shtetit ekzekutues:

a) Një deklaratë që përmban mendimin e personit të dënuar lidhur me transferimin e mundshëm të tij.

b) Një kopje të vendimit të dënimit ose të masës administrative të formës së prerë, që sjell si pasojë një masë, sipas së cilës personi i dënuar, pas daljes së tij nga burgu, nuk mund të qëndrojë më në territorin e shtetit dënues.

Çdo person i transferuar, në zbatim të këtij neni, nuk do të ndiqet, gjykohet, t'i hiqet liria, me qëllim ekzekutimin e një vendimi ose mase sigurie, ose t'i nënshtrohet ndonjë kufizimi tjetër lirie

personale për çfarëdolloj vepre të kryer më parë, që nuk ka të bëjë me transferimin, të ndryshme nga ai që ka motivuar dënimin e zbatueshëm, me përjashtim të rasteve:

a) Kur shteti i dënimit e autorizon: për këtë qëllim paraqitet një kërkesë e pajisur me dokumentacionin përkatës dhe me procesverbalin gjyqësor, që përmban deklaratat e personit të dënuar; ky autorizim jepet kur vepra penale për të cilën kërkohet parashikon ekstradimin, në përputhje me legjislacionin e shtetit dënues ose kur ekstradimi do të përjashtohej vetëm nga arsyeja e shkallës së dënimit.

b) Kur, duke pasur mundësinë për ta bërë, personi i dënuar nuk e lë, edhe në dyzet e pesë ditët e adhshme nga lirimi i tij përfundimtar nga burgu, territorin e shtetit ekzekutues ose nëse kthehet pasi e ka lënë atë.

Pavarësisht nga rregullat e paragrafit 4 të këtij neni, shteti ekzekutues mund të marrë masat e domosdoshme, në përputhje me legjislacionin e tij, duke përfshirë këtu rekursin në një proces në mungesë, me qëllim ndërprerjen e parashikimit.

Neni 4

Për ekzekutimin e vendimeve, zbatohet neni 9 paragrafi 1 shkronja (a) e Konventës.

Neni 5

Kjo Marrëveshje është e zbatueshme për ekzekutimin e dënimeve të dhëna si përpara, ashtu dhe pas hyrjes së saj në fuqi.

Neni 6

Kërkesa e transferimit dhe dokumentet e bashkëngjitura duhet të përcillen në gjuhën e shtetit ekzekutues, të cilit i janë drejtuar.

Neni 7

Shpenzimet e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje janë në ngarkim të shtetit dënues, me përjashtim të shpenzimeve të bëra vetëm në territorin e shtetit ekzekutues.

Neni 8

Kjo Marrëveshje i nënshtrohet procedurës së ratifikimit dhe hyn në fuqi datën e marrjes së njoftimit të dytë, përmes të cilit shteteve do t'u komunikohet zyrtarisht që procedurat e brendshme përkatëse të ratifikimit janë përmbushur.

Me besim për sa më sipër, palët nënshkruese kanë firmosur këtë Marrëveshje.

Bërë në Romë, më 24.4.2002 në dy origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe atë italiane, të konsideruara të dy tekstet njësoj të barasvlershme.

LIGJ
Nr.9265, datë 29.7.2004

PËR RATIFIKIMIN E "KONVENTËS EUROPIANE "PËR KOMPENSIMIN E VIKTIMAVE TË KRIMEVE TË DHUNSHME""

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Konventa europiane "Për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme", Strasburg, më 24.11.1983".

Neni 2

Republika e Shqipërisë rezervon të drejtën të deklarojë se Ministria e Drejtësisë, në kuptim të nenit 12 të kësaj Konvente, është "Autoritet qendror".

Neni 3

Në kuptim të paragrafit të parë të nenit 18 të kësaj Konvente, Republika e Shqipërisë rezervon të drejtën të deklarojë se "Autoriteti qendror", i përcaktuar në përputhje me nenin 12 të Konventës, mund të refuzojë kërkesën për asistencë nga një shtet tjetër kontraktues, nëse kjo kërkesë nuk është bërë në gjuhën shqipe, në gjuhën angleze a në gjuhën frënge ose nëse ajo nuk është e shoqëruar me një përkthim në njërën nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Europës.

Neni 4

Në kuptim të paragrafit të parë të nenit 18 të Konventës, Republika e Shqipërisë deklaron se rezervon të drejtën të përcaktojë, në përputhje me legjislacionin shqiptar, se termi "person i varur" nënkupton "fëmijët e mitur, bashkëshorten dhe prindërit e paaftë për punë, që kanë qenë plotësisht ose pjesërisht në ngarkim të të vdekurit, si dhe të personave që banonin në familjen e të vdekurit dhe që gëzonin prej tij të drejtën e ushqimit".

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4294, datë 2.8.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.56, faqe 3711

KONVENTA EUROPIANE
MBI KOMPENSIMIN E VIKTIMAVE TË KRIMEVE TË DHUNSHME

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës, nënshkruese,

duke pasur parasysh se qëllimi i Këshillit të Europës është arritja e një uniteti më të madh ndërmjet anëtarëve të tij,

duke pasur parasysh se për arsye të korrektesës dhe solidaritetit social është e nevojshme të trajtohet gjendja e viktimave të krimeve të qëllimshme të dhunës që kanë pësuar dëmtim trupor ose dëmtim të shëndetit dhe të personave të varur të tyre, të cilët kanë vdekur si rezultat i këtyre krimeve,

duke pasur parasysh se është e nevojshme të prezantohen ose të zhvillohen skema për kompensimin e këtyre viktimave nga shteti, në territorin e të cilit janë kryer këto viktima, sidomos kur personi që ka kryer krimin nuk është identifikuar ose nuk ka mjete,

duke pasur parasysh se është e nevojshme të caktohen kushte minimale në këtë fushë,

duke mbajtur parasysh Rezolutën (77) 27 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës mbi kompensimin e viktimave të krimeve,

kanë rënë dakord si më poshtë:

PJESA I
PARIME THEMELORE

Neni 1

Palët marrin përsipër të ndëmarrin të gjitha hapat për të bërë të efektshëm parimet e parashikuara në pjesën 1 të kësaj Konvente.

Neni 2

1. Nëse kompensimi nuk mund të jepet nga burime të tjera, shteti ndihmon në kompensimin:

a) e atyre që kanë pësuar një dëmtim të rëndë trupor ose dëmtim të shëndetit që ka rrjedhur direkt nga një krim i dhunshëm;

b) e personave të varur prej personave që kanë vdekur si rezultat i një krimi të tillë.

2. Kompensimi në rastet e mësipërme jepet edhe nëse personi që ka kryer krimin nuk mund të ndiqet penalisht ose dënohet.

Neni 3

Kompensimi u paguhet nga shteti, në territorin e të cilit është bërë krimi:

a) shtetasve të shteteve palë në këtë Konventë;

b) shtetasve të të gjitha shteteve anëtare të Këshillit të Europës, që janë me banim të përhershëm në shtetin, në territorin e të cilit është kryer krimi.

Neni 4

Në varësi të rastit në fjalë, kompensimi mbulon të paktën kategoritë e mëposhtme: të ardhurat e humbura, shpenzimet mjekësore, të shtrimit në spital dhe shpenzimet e varrimit, si dhe pensionin ushqimor për personat e varur prej personave që kanë vdekur si rezultat i një krimi të tillë.

Neni 5

Skema e kompensimit, nëse është e nevojshme, mund të parashikojë për çdo element ose të gjitha elementet e kompensimit nivelin maksimal, dhe atë minimal tej të cilit kompensimi nuk jepet.

Neni 6

Skema e kompensimit mund të caktojë periudhën për të cilën mund të bëhet çdo kërkesë për kompensim.

Neni 7

Kompensimi mund të zvogëlohet ose të refuzohet në varësi të gjendjes financiare të kërkuesit.

Neni 8

1. Kompensimi mund të zvogëlohet ose të refuzohet në varësi të sjelljes së viktimës ose të kërkuesit para, gjatë ose pas krimit, ose në lidhje me dëmtimin ose vdekjen.

2. Kompensimi mund të zvogëlohet ose të refuzohet edhe në varësi të përfshirjes së viktimës ose kërkuesit në krimin e organizuar, apo anëtarësisë të tij në një organizatë që përfshihet në krime të dhunshme.

3. Kompensimi mund të zvogëlohet ose të refuzohet edhe nëse dhënia ose dhënia e pjesshme do të ishte në kundërshtim me kuptimin e drejtësisë ose të rendit publik.

Neni 9

Me qëllim që të mënjanohet kompensimi i dyfishtë, shteti ose organi kompetent mund të zbresë nga kompensimi i dhënë ose t'i kërkojë personit të kompensuar çdo shumë parash, të marrë si pasojë e dëmtimit ose vdekjes, nga personi që ka kryer krimin, sigurimet shoqërore ose sigurime të tjera, ose të ardhura nga ndonjë burim tjetër.

Neni 10

Shteti ose organi kompetent mund të përfitojë të drejtat e personit të kompensuar për shumën e paguar të kompensimit.

Neni 11

Secila palë ndërmerr hapa të përshtatshme për të siguruar që informacioni mbi skemën t'u jepet kërkuesve të mundshëm.

PJESA II
BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Neni 12

Në zbatim të marrëveshjeve dy ose shumëpalëshe mbi ndihmën e ndërsjellë, lidhur ndërmjet Shteteve Kontraktuese, organet kompetente të secilës palë, me kërkesë të organeve përkatëse të çdo pale tjetër, japin ndihmën maksimale të mundshme në lidhje me çështjet e mbuluara nga kjo Konventë. Për këtë qëllim, çdo Shtet Kontraktues cakton një organ qendror të pranojë dhe të veprojë në lidhje me kërkesat për këtë ndihmë dhe vë në dijeni në lidhje me këtë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës kur bën depozitimin e instrumenteve të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit.

Neni 13

1. Komiteti Europian për Problemet e Krimit (KEPK) të Këshillit të Europës mbahet i informuar në lidhje me zbatimin e Konventës.

2. Për këtë qëllim, secila palë i transmeton Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës çdo informacion të rëndësishëm mbi dispozitat legjislative dhe rregullatore në lidhje me çështjet e mbuluara nga kjo Konventë.

PJESA III
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 14

Kjo Konventë është e hapur për t'u nënshkruar nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës. Ajo i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose aprovimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose aprovimit depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 15

1. Kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati tremujor pas datës në të cilën tre shtete anëtare të Këshillit të Europës kanë shprehur pëlqimin e tyre për të respektuar Konventën në pajtim me dispozitat e nenit 14.

2. Në lidhje me çdo shtet që e shpreh më vonë pëlqimin e tij për të respektuar Konventën, kjo hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati tremujor pas datës së depozitimit të instrumenteve të tij të ratifikimit, pranimit ose aprovimit.

Neni 16

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Europës mund të ftojë çdo shtet joanëtar të Këshillit të Europës të aderojë në këtë Konventë nëpërmjet një vendimi të marrë nga shumica e parashikuar në nenin 20d të Statutit të Këshillit të Europës dhe me votën anonime të përfaqësuesve të shteteve kontraktuese që kanë të drejtën e një vendi në Komitetin e Ministrave.

2. Në lidhje me çdo shtet aderues, Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati tremujor pas datës së depozitimit të instrumentit të aderimit te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 17

1. Çdo shtet, në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit, mund të përcaktojë territorin ose pjesët e territorit ku zbatohet kjo Konventë.

2. Çdo palë, në një datë të mëvonshme dhe nëpërmjet një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës mund ta zgjerojë zbatimin e kësaj Konvente për në çdo pjesë tjetër territori të përcaktuar në deklaratë. Në lidhje me këtë pjesë territori, Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati tremujor pas datës së marrjes së një deklarate të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë sipas dy paragrafëve të mësipërm, në lidhje me çdo pjesë territori të përcaktuar në deklaratë, mund të tërhiqet nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Tëheqja hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati tremujor pas datës së marrjes së një deklarate të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 18

1. Çdo shtet, në momentin e nënshkrimit ose depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit, mund të deklarojë se bën një ose disa rezerva.

2. Çdo shtet kontraktues që ka bërë një rezervë sipas paragrafit të mësipërm, mund ta tërheqë atë plotësisht ose pjesërisht nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Tërheqja hyn në fuqi në datën e marrjes së këtij njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Një palë që ka bërë një rezervë në lidhje me një dispozitë të kësaj Konvente nuk mund të pretendojë zbatimin e asaj dispozite nga ndonjë palë tjetër, megjithatë, nëse rezerva e saj është e pjesshme ose me kusht, ajo mund të pretendojë zbatimin e asaj dispozite për aq sa ajo e ka pranuar vetë atë.

Neni 19

1. Çdo palë mund ta denoncojë këtë Konventë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Ky denoncim hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati gjashtëmujor pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 20

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës njofton shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe çdo shtet që ka aderuar në këtë Konventë për:

a) çdo nënshkrim;

b) depozitimin e çdo instrumenti të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit;

c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente sipas neneve 15, 16 dhe 17;

d) çdo akt, njoftim ose komunikim tjerët në lidhje me këtë Konventë.

Si dëshmi të kësaj, të poshtëshënuarit, duke qenë të autorizuar rregullisht, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Strasburg, më 24 nëntor 1983, në anglisht dhe frëngjisht, të dyja tekstet njëlloj të vlefshme, në një kopje të vetme, e cila depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës u transmeton kopje të vërtetuara të gjitha shteteve anëtare të Këshillit të Europës dhe çdo shteti që është ftuar të aderojë në këtë Konvetë.

LIGJ
Nr.9307, datë 4.11.2004

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË MAQEDONISË PËR BASHKËPUNIMIN NË LUFTËN KUNDËR TERRORIZMIT, KRIMIT TË ORGANIZUAR, TRAFIKUT TË PALIGJSHËM TË DROGAVE NARKOTIKE, SUBSTANCAVE PSIKOTROPE E PREKURSORËVE, MIGRACIONIT TË PALIGJSHËM DHE VEPRIMTARIVE TË TJERA TË PALIGJSHME"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Maqedonisë për bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, krimit të

organizuar, trafikut të paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotrope e prekursorëve, migracionit të paligjshëm dhe veprimtarive të tjera të paligjshme".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4406, datë 25.11.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.90, faqe 6418

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLËKËS TË MAQEDONISË MBI BASHKËPUNIMIN NË LUFTËN KUNDËR TERRORIZMIT, KRIMIT TË ORGANIZUAR, TRAFIKUT TË PALIGJSHËM TË DROGAVE NARKOTIKE, SUBSTANCAVE PSIKOTROPE E PREKURSORËVE, MIGRACIONIT TË PALIGJSHËM DHE VEPRIMTARIVE TË TJERA TË PALIGJSHME

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë më poshtë të quajtura Palë Kontraktuese:

në frymën e miqësisë dhe të bashkëpunimit ekzistues ndërmjet të dy vendeve,

të ndërgjegjshme për nevojën për të mbrojtur jetën, pronën, të drejtat themelore dhe liri të tjera të shtetasve të tyre,

duke pranuar avantazhet e bashkëpunimit ndërkombëtar si një faktor i një rëndësie shumë të madhe për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, terrorizmit, trafikut të paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotrope e prekursorëve, emigracionit të paligjshëm dhe veprimtarive të tjera të paligjshme,

duke marrë në konsideratë dispozitat e konventave dhe traktateve ndërkombëtare në këtë fushë, në të cilat shtetet e Palëve Kontraktuese janë palë,

kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

1. Palët Kontraktuese, në përputhje me legjislacionin e tyre, bashkëpunojnë dhe asistojnë në mënyrë reciproke njëra-tjetrën në parandalimin dhe identifikimin e krimeve në fushat e mëposhtme:

a) terrorizmi;

b) krimi i organizuar;

c) prodhimi i paligjshëm dhe hedhja në shitje e drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve;

d) trafiku i personave e i organeve njerëzore dhe shfrytëzimi i fëmijëve;

e) grabitja;

f) prodhimi, tregtimi dhe zotërimi i paligjshëm i armëve të zjarrit, municionit dhe eksplozivëve, materialeve kimike, biologjike, bërthamore dhe radioaktive, mallra dhe teknologji me përdorim të dyfishtë, teknologji ushtarake, materiale, pajisje dhe përbërës që mund të përdoren për prodhim armësh të shkatërrimit në masë dhe materiale të tjera të rrezikshme;

g) favorizimi i prostitucionit;

h) vjedhja dhe tregtia e paligjshme e pasurive kulturore e historike, pasurive artistike, objekteve me vlerë kulturore e historike, metaleve e minerale te çmuara dhe objekteve të tjera me vlera të mëdha;

i) falsifikimi i parave, letrave me vlerë, mjeteve të tjera të pagesës që nuk janë as para as letra me vlerë sikurse dhe nxjerrja e tyre në qarkullim apo përdorim;

j) organizimi i lojërave të paligjshme të fatit dhe skemat e mashtrimit në lojërat e ligjshme të fatit;

k) kontrabanda e mallrave të akcizës dhe krime të tjera të lidhura me tregtinë ndërkombëtare dhe shkëmbimin ekonomik, evazionin fiskal, pastrimin e parave dhe fitime të tjera të paligjshme;

1) vjedhja dhe tregtia e paligjshme e automjeteve, falsifikimi dhe përdorimi i dokumenteve të falsifikuara për ato automjete;

m) migracioni i paligjshëm-kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror, falsifikimi i pasaportave dhe vizave false dhe përdorimi i tyre;

n) krimet kundër jetës dhe shëndetit njerëzor;

o) krimet kundër mjedisit.

2. Duke rënë dakord në mënyrë reciproke Palët Kontraktuese zhvillojnë asistencë të ndërsjellë edhe në luftën ndaj krimeve të tjera. Palët Kontraktuese zhvillojnë asistencë të ndërsjellë vetëm për ato veprimtari që konsiderohen krime sipas legjislacioneve kombëtare.

3. Palët Kontraktuese bashkëpunojnë dhe zhvillojnë asistencë të ndërsjellë në fushat e mëposhtme:

a) metodat dhe mënyrat e përdorura për të siguruar, ruajtur e rivendosur rendin publik, për të ruajtur e mbrojtur objektiva të interesit publik e kombëtar, vlera dhe mallra, sikurse dhe për të garantuar sigurinë e personave të cilët marrin pjesë në demonstrimet publike;

b) parandalimi i dhunës;

c) organizimi, kryerja dhe menaxhimi i ruajtjes dhe mbikëqyrjes së kufirit shtetëror në sektorët tokësore, detare apo liqenore për ruajtjen dhe mbikëqyrjen e kufirit.

4. Palët Kontraktuese bashkëpunojnë për trajnime profesionale bazë e të posaçme dhe në promovimin e ekspertëve të të dyja Palëve Kontraktuese në fushat e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 2

1. Të dyja Palët Kontraktuese, në përputhje me legjislacionin e tyre bashkëpunojnë nëpërmjet:

a) shkëmbimit të informacionit dhe në fushat e përcaktuara në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje;

b) marrjes së masave ose veprimeve për të cilat eshtë rënë dakord në mënyrë të ndërsjellë nga ministritë dhe/ose organe të tjera kompetente të të dy shteteve;

c) shkëmbimit të ekspertëve të specializuar në fusha të interesit reciprok;

d) shkëmbimit të dokumentacionit, publikimeve dhe rezultateve të kërkimeve shkencore të kryera në fusha të interesit reciprok;

e) shkëmbimit të informacioneve operacionale për të ndihmuar në parandalimin, identifilkimin dhe hetimin e veprimtarisë së krimit të organizuar dhe krimeve të tjera.

2. Palët Kontraktuese bien dakord, pas përmbushjes së procedurave ligjore në fuqi në shtetet e tyre, në marrëveshje të ndërsjellë, për të dërguar oficerë ndërlidhës të caktuar nga autoritetet kompetente të përmendura në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3

1. Për të përmbushur dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, Palët Kontraktuese caktojnë si autoritete kompetente:

Për palën shqiptare:

a) Ministria e Rendit Publik;

Për palën maqedonase:

a) Ministria e Punëve të Brendshme

2. Në mënyrë që të sigurohen lidhje operacionale, autoritetet kompetente caktojnë një person kontakti dhe Palët Kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike për të dhënat e këtij personi, d.m.th. emri, mbiemri, pozicioni, numri i telefonit, faksit brenda 30 ditësh nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.

3. Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese në përputhje me klauzolat e kësaj Marrëveshejeje kryhet në gjuhën angleze ose në ndonjë gjuhë tjetër për të cilën bihet dakord në mënyrë të ndersjellë nga Palët Kontraktuese.

4. Në mënyrë që të realizohet bashkëpunimi, në përputhje me parashikimet e nenit 1, dhe 2 të kësaj Marrëveshjeje, autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese, me kompetencat e tyre të përcaktuara ligjërisht, mund të përfundojnë protokolle bashkëpunimi, duke respektuar legjislacionin kombëtar të të dy shteteve.

Neni 4

Palët Kontraktuese zhvillojnë asistencë të ndërsjellë në përpunimin dhe ana1izimin e informacioneve që i përkasin fushave të përmenduara në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje dhe mund t'u japin pajisje dhe teknologji specifike autoriteteve kompetente të Palës tjetër Kontraktuese, në përputhje me angazhimet ndërkombëtare të ndërmarra në këtë fushë.

Neni 5

Për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Palët Kontraktuese:

a) Organizojnë takime ekspertësh brenda ministrive të tyre të brendshme dhe/ose institucioneve të tjera për fushat e tyre përkatëse të kompetencës, kur është e nevojshme të zgjidhen probleme urgjente e të veçanta si trafikimi i drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve, armëve të zjarrit dhe municionit, trafikimi i personave, rrjete të emigracionit të paligjshëm dhe forma të tjera të krimit të organizuar.

b) Zhvillojnë asistencë të ndërsjellë, bazuar në konsultime paraprake, brenda forumeve, organizmave e organeve të ndryshme ndërkombëtare përkatëse.

Neni 6

1. Secila Palë Kontrakuese mund ta refuzojë një kërkesë për bashkëpunim ose informacion nëse ajo konsideron se një kërkesë e tillë mund të rrezikojë sovranitetin ose sigurinë e Palës Kontraktuese të kërkuar, ose nëse një përmbushje e një kërkese të tillë mund të bjerë në kundërshtim me legjislacionin kombëtar ose me angazhimet që dalin nga marrëveshje ndërkombëtare. Ne raste të tilla, refuzimi i kërkesës i njoftohet pa vonesë Palës tjetër Kontraktuese.

2. Informacioni i siguruar në bazë të kësaj Marrëveshjeje konsiderohet konfidencial dhe mund të përdoret nga autoritetet kompetente të përcaktuara në këtë Marreveshje dhe vetëm për qëllim shkëmbimi dhe nuk i komunikohen apo jepen një shteti të tretë, përveçse në ato raste kur Pala Kontraktuese dërguese ka dhënë një miratim paraprak me shkrim.

3. Secila Palë Kontraktuese garanton mbrojtjen e të dhënave sekrete të marra në përputhje me parashikimet e kësaj Marrëveshjeje, si kërkesa për informacion në përputhje të plotë me legjislacionin e saj kombëtar.

4. Secila Palë Kontraktuese ka si detyre të fshijë apo eliminojë të dhëna në përputhje me kushtet e përcaktuara nga Pala Kontraktuese dërguese, ose nëse kushte të tilla nuk janë caktuar, sapo këto të dhëna të mos jenë më të nevojshme për qëllimin për të cilin u kërkuan apo dërguan. Në rast përfundimi të kësaj Marrëveshjeje, të gjitha të dhënat e marra në bazë të saj duhet të fshihen apo eliminohen jo me vonë se data e përfundimit.

Neni 7

1. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk ndikojnë të drejtat e angazhimet që dalin për Palët Kontraktuese nga konventa ose marrëveshje të tjera ndërkombëtare dypalëshe apo shumëpalëshe.

2. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin apo zbatimin e kësaj Marrëveshjeje zgjidhet nepërmjet konsultimeve ndërmjet Pa1ëve Kontraktuese.

Neni 8

Shpenzimet e lidhura me zbatimin e klauzolave të kësaj Marrëveshjeje sikurse edhe ato që lidhen me shkëmbimin e delegacioneve mbulohen në një bazë të ndërsjellë e rregullohen me përfundimin e protokolleve sipas nenit 3 paragrafi 4 i kësaj Marrëveshjeje.

Neni 9

Kjo Marrëveshje përfundohet për një periudhë të pacaktuar kohe dhe mund të denoncohet apo pezullohet në çdo kohë nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar Palës tjetër Kontraktuese përmes kanaleve diplomatike. Denoncimi hyn në fuqi brenda 6 muajsh ndërsa pezullimi brenda 30 ditësh nga data e njoftimit.

Neni 10

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi datën e njoftimit të fundit të shkëmbyer përmes kanaleve diplomatike në lidhje me përmbushjen e procedurave të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi.

Bërë në shkurt, më 17.6.2004 në dy origjinale secili në gjuhët shqipe, maqedonase e angleze ku të gjitha tekstet jane të barasvlefshëm. Në rast mospërputhjesh në interpretim, për bazë merret teksti në gjuhën angleze.

LIGJ
Nr. 9348, datë 24.2.2005

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË BULLGARISË PËR NDIHMË TË NDËRSJELLË JURIDIKE NË ÇËSHTJET CIVILE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Bullgarisë për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet civile".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4503, datë 10.3.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.19, faqe 706

MARRËVESHJE
PËR NDIHMË TË NDËRSJELLË JURIDIKE NË ÇËSHTJET CIVILE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË BULLGARISË

Republika e Shqipërisë dhe Republika e Bullgarisë, të cilat këtu quhen "Palët Kontraktuese",

me dëshirën për të vendosur një bashkëpunim më të ngushtë në fushën e marrëdhënieve juridike dhe duke pasur respekt reciprok për sovranitetin e tyre, kanë vendosur t'i ofrojnë njëra-tjetrës ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet civile dhe kanë rënë dakord si më poshtë:

KAPITULLI 1
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Mbrojtja ligjore

1. Shtetasit e çdo Pale Kontraktuese gëzojnë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese të njëjtën mbrojtje ligjore të të drejtave të tyre personale dhe pasurore, si edhe shtetasit e Palës tjetër Kontraktuese. Ata kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës, autoriteteve të tjera, prokurorisë dhe çdo institucioni tjetër kompetent për çështjet civile dhe mund të ngrenë pretendime ose padi, si dhe të kryejnë akte të tjera procedurale në të njëjtat kushte, si edhe shtetasit e Palës tjetër Kontraktuese.

2. Dispozita e paragrafit 1 zbatohet për personat juridikë të krijuar në territorin e njërës prej Palëve Kontraktuese në pajtim me legjislacionin e saj.

3. Termi "çështje civile" ka kuptimin e të gjitha çështjeve që nuk përfshihen në fushën penale dhe në fushën administrative.

Neni 2
Ndihma e ndërsjellë

Autoritetet dhe institucionet e Palëve Kontraktuese, në pajtim me paragrafin 1 të nenit 1 të kësaj Marrëveshjeje, japin ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet civile brenda kompetencës së tyre, sipas përcaktimit të legjislacionit të brendshëm të secilës prej Palëve.

Neni 3
Ndihma ligjore falas dhe përjashtimi nga shpenzimet

1. Shtetasit e çdo Pale Kontraktuese kanë të drejtën të marrin ndihmë ligjore falas në territorin e Palës tjetër Kontraktuese në të njëjtën mënyrë si edhe shtetasit e vet, në pajtim me legjislacionin përkatës të Palës Kontraktuese, kur kërkohet ndihmë juridike falas.

2. Shtetasit e çdo Pale Kontraktuese, në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, përjashtohen nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore në të njëjtat kushte dhe sasira si edhe shtetasit e vet.

Neni 4

Procedura e përjashtimit nga shpenzimet

1. Përjashtimi nga shpenzimet sipas nenit 3 të Konventës realizohet nëpërmjet një vendimi gjykate në vendin e kërkuar me kërkesë të personit të interesuar. Ky përjashtim rregullohet në pajtim me legjislacionin e vendit të kërkuar.

2. Nëse personi sipas paragafit 1 është me vendbanim të zakonshëm te një palë e tretë, dokumentet e nevojshme për përjashtimin nga shpenzimet mund të lëshohet nga agjencia diplomatike ose konsullore e Palës Kontraktuese, shtetas i së cilës është personi.

3. Gjykata e Palës së Kërkuar që është kompetente për dhënien e vendimit mbi përjashtimin nga shpenzimet mund të kërkojë informacion shtesë.

Neni 5

Heqja e shpenzimeve gjyqësore

1. Heqja e shpenzimeve gjyqësore nuk mund të kërkohet nga një shtetas i një vendi kontraktues që shfaqet në gjykatën e një vendi tjetër kontraktues si paditës ose i paditur, thjesht për faktin e qenies së tij si shtetas i huaj ose të mungesës së qëndrimit të përhershëm në këtë vend.

2. Dispozita e paragrafit 1 të këtij neni zbatohet edhe për personat juridikë.

Neni 6

Llojet e ndihmës ligjore

Me kërkesë, Palët Kontraktuese i japin njëra-tjetrës dokumente gjyqësore dhe jogjyqësore, marrin masa për sigurimin e pretendimeve, marrin prova nga pjesëmarrësit në gjykim, dëshmitarët dhe ekspertët, ndërmarrin ekzaminime dhe inspektime, njohin dhe ekzekutojnë vendime, duke përfshirë zbatimin e masave për gjetjen e debitorit dhe masa të tjera procedurale.

Neni 7

Mjetet e komunikimit

1. Organet kompetente të Palëve Kontraktuese komunikojnë nëpërmjet organeve qendrore të përcaktuara në këtë Marrëveshje për dhënien e ndihmës së ndërsjellë.

2. Organet qendrore të përmendura në paragrafin 1 janë për Republikën e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë dhe për Republikën e Bullgarisë, Ministria e Drejtësisë.

Neni 8

Gjuha

Organet qendrore të Palëve Kontraktuese përdorin gjuhën e tyre ose gjuhën angleze në lidhje me të gjitha çështjet e kësaj Konvente.

Neni 9

Forma e dokumenteve

Dokumentet dërguar organeve kompetente të Palëve Kontraktuese për qëllimin e dhënies së ndihmës së ndërsjellë të përpiluar në gjuhën zyrtare të palës dërguese, shoqërohen me një përkthim të vërtetuar në gjuhën e palës kontraktuese pritëse ose në anglisht.

Neni 10
Shpenzimet e ndihmës së ndërsjellë

Palët Kontraktuese i ofrojnë njëra-tjetrës ndihmë juridike falas, përveç kur është parashikuar ndryshe në këtë Marrëveshje.

Neni 11
Refuzimi i ndihmës së ndërsjellë

Kur pala pritëse mendon se ndihma e ndërsjellë, nëse jepet, mund të cenojë sovranitetin, sigurinë dhe rendin e saj shoqëror ose që mund të jetë në kundërshtim me legjislacionin e brendshëm, ajo mund të refuzojë dhënien e ndihmës së ndërsjellë dhe informon palën kërkuese për arsyet e refuzimit.

KAPITULLI 2
NJOFTIMI DHE DËRGIMI I DOKUMENTEVE

Neni 12
Kërkesa për njoftimin ose dërgimin e dokumenteve

1. Nëse dokumentet gjyqësore ose jogjyqësore u referohen personave që kanë vendqëndrimin ose vendbanimin në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, organet kompetente të palës kërkuese i drejtohen organit qendror të palës pritëse me një kërkesë për njoftimin ose dërgimin e dokumenteve.

2. Dokumentet në gjuhën e palës kërkuese, e shoqërurar nga një përkthim në gjuhën e palës pritëse ose në anglisht, i bashkëngjiten kërkesës.

Neni 13
Dërgimi i dokumenteve

1. Organi qendror i palës pritëse i dërgon dokumentet ose merr masa për dërgimin e tyre në një mënyrë që e konsideron më të përshtatshme.

2. Dërgimi ose përpjekja për dërgimin vërtetohet nëpërmjet përpilimit të një fature ose regjistri, i cili i kthehet organit qendror të palës kërkuese së bashku me një kopje të dokumenteve. Dokumenti që vërteton zbatimin e kërkesës për të dërguar dokumentet përmban datën e dërgimit, nënshkrimin e marrësit dhe nënshkrimin e personit që kryen kërkesën. Nëse marrësi refuzon të marrë dokumentet, përfshihen dhe arsyet e refuzimit të tij.

3. Këto shërbime që i bëhen palës pritëse nuk janë shkak për pagesën e ndonjë tarife apo për shpenzime.

Neni 14
Dërgimi i dokumenteve nëpërmjet agjentëve diplomatikë ose konsullorë

Me kërkesn e organeve kompetente agjentët diplomatikë ose konsullorë të njërës prej Palëve Kontraktuese të akredituar te Pala tjetër Kontraktuese mund t'u dërgojnë dokumente gjyqësore ose jogjyqësore shtetasve të tyre. Këto veprime nuk mund të përmbledhin masat e detyrimit dhe nuk mund të jenë në kundërshtim me legjislacionin e brendshëm të shtetit të vendbanimit.

Neni 15
Ligji i zbatuar për ndihmën e ndërsjellë

1. Kur ofrohet ndihma e ndërsjellë, organi pritës zbaton legjislacionin e brendshëm.

2. Kur jepet ndihmë e ndërsjellë, organi pritës, me kërkesë të palës dërguese, mund të zbatojë procedurën e Palës tjetër Kontraktuese, përveç kur ajo është në kundërshtim me legjislacionin e brendshëm të Palës Kontraktuese pritëse.

KAPITULLI 3
LETËR POROSITË

Neni 16
Forma e kërkesës/letërporositë për ndihmë të ndërsjellë

1. Kërkesa/letërporosia për ndihmë të ndërsjellë bëhet me shkrim dhe përmban, në lidhje me tipin e kërkesës, të dhënat e mëposhtme:

a) emrin e organit kërkues;

b) emrin e organit pritës, nëse është e mundur;

c) natyrën dhe përmbajtjen e çështjes për të cilën kërkohet ndihma ligjore, të dhënat e veçanta të kërkesës;

d) emrat, mbiemrat, emri i nënës, emri i babait të personave që kanë të bëjnë me çështjen, shtetësinë, seksin, profesionin, vendqëndrimin ose vendbanimin, datën dhe vendbanimin, emrin dhe vendin e krijimit të personit juridik;

e) emrat dhe adresat e përfaqësuesve të personave të përmendur në nënparagrafin “d”;

f) titullin e dokumentit i cili duhet të dërgohet.

2. Kërkesa për ndihmë të ndërsjellë duhet të nënshkruhet dhe të vuloset nga organi kompetent i vendit pritës.

Neni 17
Kryerja e kërkesës

1. Dokumenti që tregon kryerjen e kërkesës për dërgimin e dokumenteve përmban datën e dorëzimit, nënshkrimin e marrësit dhe nënshkrimin e personit që kryen kërkesën. Nëse pritësi refuzon marrjen e dokumentit, tregohen edhe shkaqet për refuzimin e bërë.

2. Kur në pajtim me legjislacionin e Palës Kontraktuese pritëse kryerja e kërkesës nuk është në kompetencën e gjykatës ose të organeve të tjera të asaj pale, kërkesa mund të kthehet duke treguar shkaqet e refuzimit.

3. Kur organi pritës i Palës Kontraktuese nuk është kompetent për përmbushjen e kërkesës, ai ua kalon atë organeve kompetente të kësaj Pale Kontraktuese për ta përmbushur dhe informon organin dërgues të Palës tjetër Kontraktuese. Pala tjetër mbahet e informuar për sa më sipër.

4. Organi gjyqësor dërgues mund të kërkojë që palët e interesuara dhe, kur është e mundur, përfaqësuesit e tyre të informohen për datën dhe vendin e zbatimit të masave të kërkuara me qëllim që të ndihmohet ekzekutimi i vendimit.

Neni 18
Metodat e veçanta për përmbushjen e kërkesës

1. Organet kompetente të Palëve Kontraktuese që përmbushin kërkesën për ndihmë të ndërsjellë zbatojnë ligjin e tyre të brendshëm për të përcaktuar metodën që duhet të zbatohet.

2. Ata mund të përmbushin kërkesën e organit kërkues në lidhje me zbatimin e një metode të caktuar, me kusht që ajo të mos jetë në mospërputhje me ligjin e palës pritëse.

3. Pala pritëse ka të drejtë të kërkojë nga pala kërkuese të rimbursojë pagesën që u është bërë ekspertëve dhe shpenzimet e shkaktuara nga metoda e veçantë e kërkuar nga pala kërkuese.

4. Secila Palë Kontraktuese është e lirë të zbatojë, nëpërmjet agjencive të tyre diplomatike ose konsullore, kërkesat gjyqësore në lidhje me shtetasit e saj, pa zbatuar masat e detyrueshme.

KAPITULLI 4
NJOHJA DHE ZBATIMI I VENDIMEVE GJYQËSORE

Neni 19
Vendimet që njihen dhe ekzekutohen

1. Në pajtim me këtë Marrëveshje, Palët Kontraktuese njohin dhe zbatojnë në territorin e tyre vendimet gjyqësore që janë dhënë dhe kanë hyrë në fuqi në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

2. Termi "vendim gjyqësor" për të dyja Palët ka kuptimin e një vendimi gjyqësor përfundimtar ose të ndërmjetëm dhe të një vendimi penal që ka të bëjë me një pretendim civil.

Neni 20
Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore

1. Kërkesa për njohje dhe ekzekutim të një vendimi gjyqësor depozitohet që e ka dhënë vendimin dhe që ia transmeton kërkesën gjykatës së Palës tjetër Kontraktuese në mënyrën e parashikuar në nenin 7 të kësaj Marrëveshjeje.

2. Kërkesa për njohjen dhe ekzekutimin e një vendimi gjyqësor shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:

a) një kopje e vendimit e vërtetuar nga gjykata. Kur vendimi nuk tregon qartë që ai është i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, atëherë lëshohet një dokument tjetër nga gjykata që tregon se vendimi ka hyrë në fuqi;

b) një dokument i lëshuar nga gjykata për ekzekutim të pjesshëm të vendimit në territorin e palës kërkuese, nëse është e nevojshme;

c) një dokument që tregon se Pala që nuk ka marrë pjesë në gjykim, ose kur është i pazot përfaqësuesi i saj, është thirrur në gjykatë rregullisht.

3. Dokumentet e përmendura më sipër shoqërohen nga një përkthim i vërtetuar në gjuhën e Palës Kontraktuese pritëse ose në anglisht, i bërë nga agjencitë diplomatike ose konsullore, apo nga në person tjetër i autorizuar nga njëra prej Palëve.

Neni 21
Procedura e njohjes dhe e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore

1. Vendimet gjyqësore njihen dhe ekzekutohen nga gjykata kompetente e Palës Kontraktuese pritëse në pajtim me procedurën e parashikuar nga ligji i brendshëm i asaj Pale Kontraktuese.

2. Gjykata që merr kërkesën, nuk e rishikon vendimin në themel, por vetëm në lidhje me përputhjen e tij me kërkesat e kësaj Marrëveshjeje.

3. Gjykata që merr kërkesën për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit të gjykatës së huaj mund të kërkojë dokumente shtesë nga gjykata që ka dhënë vendimin.

Neni 22
Refuzimi i njohjes dhe i ekzekutimit të vendimit

Njohja dhe ekzekutimi i vendimit mund të refuzohet në rastet e mëposhtme:

a) vendimi nuk ka hyrë në fuqi ose nuk është i ekzekutueshëm sipas legjislacionit të Palës Kontraktuese ku ai është dhënë;

b) legjislacioni i brendshëm i Palës që i drejtohet kërkesa për njohjen dhe ekzekutimin u jep gjykatave të veta juridiksionin ekskluziv;

c) Pala që ka munguar në gjykim ose, në rastin e pazotësisë së plotë ose të pjesshme të saj, përfaqësuesi, nuk është thirrur në gjykatë rregullisht në pajtim me legjislacionin e brendshëm të Palës Kontraktuese prej nga ka ardhur vendimi;

d) gjykata e Palës pritëse ka dhënë për të njëjtat palë dhe për të njëjtën çështje një vendim, i cili ka hyrë në fuqi apo gjykimi është duke u zhvilluar në gjykatë, apo kur është njohur një vendim gjyqësor i dhënë nga një juridiksion i tretë për të njëjtat palë dhe për të njëjtën çështje;

e) vendimi i dhënë nga gjykatat e Palës kërkuese përmban dispozita që janë në mospërputhje me politikën publike të Palës pritëse.

KAPITULLI 5
PËRJASHTIMI NGA LEGALIZIMI, STATUSI CIVIL DHE SHKËMBIMI I INFORMACIONIT

Neni 23
Dokumentet zyrtare

1. Dokumentet zyrtare të lëshuara në territorin e njërës prej Palëve Kontraktuese përjashtohen nga legalizimi ose çdo formalitet tjetër të ngjashëm kur paraqiten në territorin e Palës tjetër.

2. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje “dokumente zyrtare” janë:

- dokumentet e lëshuara nga gjykatat, prokuroritë ose përmbaruesit;
- dokumentet e lëshuara nga organet administrative;
- dokumentet noteriale;
- certifikata zyrtare, të dhënat nga regjistrat, vërtetimi i datave dhe vërtetimi i nënshkrimeve dhe dokumenteve personale.

Neni 24
Transformimi i dokumenteve në lidhje me statusin civil

1. Secila prej Palëve Kontraktuese i transmeton Palës tjetër, me kërkesë dhe falas, certifikata dhe kopje të vendimeve gjyqësore në lidhje me statusin civil të shtetasve të Palës kërkuese, në pajtim me legjislacionin e tyre të brendshëm.

2. Kërkesat dërgohen nëpërmjet organeve qendrore. Secila nga Palët Kontraktuese do të jetë e lirë të transferojë nëpërmjet agjencive konsullore kërkesa dhe certifikatat që lidhen me statusin civil.

Neni 25
Shkëmbimi i informacionit

Organet qendrore, me kërkesë, i japin njëra-tjetrës informacion në lidhje me legjislacionin dhe jurisprudencën në territorin e tyre, si dhe kopjet e vendimeve të gjykatave.

KAPITULLI 6
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 26
Vlefshmëria e dokumenteve

Dokumentet e lëshuara ose të vërtetuara nga gjykatat ose çdo organ tjetër kompetent i njërës prej Palëve Kontraktuese konsiderohen të vlefshme, kur organi kompetent i ka pajisur me vulë rregullisht. Dokumentet që përputhen me këto kërkesa njihen nga gjykatat dhe nga organet e tjera kompetente të Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 27
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Të gjitha mosmarrëveshjet që rrjedhin nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje zgjidhen nga Palët Kontraktuese nëpërmjet konsultimeve ndërmjet organeve të përmendura në nenin 7 të kësaj Marrëveshjeje ose nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 28
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje i nënshtrohet ratifikimit dhe hyn në fuqi në ditën e tridhjetë pas këmbimit të instrumenteve të ratifikimit.

Neni 29
Marrëdhëniet me marrëveshjet ekzistuese

Kjo Marrëveshje nuk do të prekë të drejtat dhe detyrimet të garantuara nëpërmjet marrëveshjeve ekzistuese të lidhura me shtetet e tjera kontraktuese.

Neni 30
Ndryshimi i Marrëveshjes

1. Palët Kontraktuese konsultohen me njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike në lidhje me ndryshimin e kësaj Marrëveshjeje.
2. Ndryshimet e Marrëveshjes hyjnë në fuqi sipas parashikimit të nenit 28.

Neni 31
Denoncimi

Kjo Marrëveshje përfundohet për një periudhë kohore të pacaktuar dhe e humb fuqinë pas skadimit të një afati 6-mujor nga marrja prej një Pale të një njoftimi me shkrim për denoncimin nëpërmjet kanalit diplomatik.

Bërë në Sofje, më 17 nëntor 2003 në dy kopje, në shqip, bullgarisht dhe anglisht, të gjitha tekstet janë njëlloj të vlefshme. Në rast mospërputhjeje ndërmjet teksteve, merret për bazë teksti anglisht.

LIGJ
Nr. 9359, datë 24.3.2005

PËR RATIFIKIMIN E "KONVENTËS EUROPIANE "PËR MARRËDHËNIET ME FËMIJËT""

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Konventa Europiane "Për marrëdhëniet me fëmijët"".

Neni 2

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 11 të Konventës, Republika e Shqipërisë cakton Ministrinë e Drejtësisë si organ qendror për të kryer funksionet e parashikuara nga kjo Konventë.

Neni 3

Në përputhje me pikën 3 të nenit 18 të Konventës, Republika e Shqipërisë deklaron se mund të kundërshtojë përdorimin e gjuhës angleze ose franceze, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2 të këtij neni, në çdo kërkesë, korrespondencë ose dokument tjetër dërguar organeve qendrore.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4533, datë 13.4.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.28, faqe 1063

KONVENTË
MBI MARRËDHËNIET ME FËMIJËT

Preambul

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe nënshkruesit e tjerë,

duke marrë parasysh Konventën europiane për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në lidhje me kujdestarinë e fëmijëve dhe rivendosjen e kujdestarisë mbi fëmijët, të 20 majit 1980 (ETS N0 105);

duke marrë parasysh Konventën e Hagës të 25 tetorit 1980 mbi aspektet civile të rrëmbimit të fëmijëve në nivel ndërkombëtar dhe Konventën e Hagës të 19 tetorit 1996 mbi juridiksionin, ligjin e zbatuar, njohjen, ekzekutimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve;

duke marrë parasysh rregulloren e këshillit (EC) nr.1347/2000 të 29 majit 2000 mbi juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në çështjet martesore dhe në çështjet e përgjegjësisë prindërore për fëmijët e të dy bashkëshortëve;

duke ditur se, sipas parashikimit të bërë në instrumente të ndryshme ligjore ndërkombëtare të Këshillit të Europës, si dhe në nenin 3 të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijve të 20 nëntorit 1989, interesat e fëmijëve janë të një rëndësie prioritare;

të ndërgjegjshëm për nevojën e dispozitave të mëtejshme për të garantuar marrëdhëniet ndërmjet fëmijëve, dhe prindërve të tyre dhe personave të tjerë që kanë lidhje familjare me fëmijët, sipas mbrojtjes së bërë nga neni 8 i Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të 4 nëntorit 1950 (ETS nr.5);

duke pasur parasysh nenin 9 të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijëve, i cili parashikon të drejtën e fëmijëve që është i ndarë nga një ose nga të dy prindërit të mbajë marrëdhënie personale dhe kontakt të drejtpërdrejtë dhe të rregullt me të dy prindërit, përveç kur një gjë e tillë është në dëm të interesave të fëmijës;

duke marrë parasysh paragrafin 2 të nenit 10 të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijëve, i cili parashikon të drejtën e fëmijëve, prindërit e të cilit banojnë në shtete të ndryshme, duke përjashtuar situatat e jashtëzakonshme, të mbajë rregullisht marrëdhënie personale dhe kontakt të drejtpërdrejtë me të dy prindërit;

të ndërgjegjshëm për dobinë e njohjes si mbajtës të të drejtave jo vetëm prindërit, por edhe fëmijët;

duke rënë dakord për zëvendësimin e konceptit "e drejta e vizitës tek fëmijët" me nocionin "marrëdhëniet me fëmijët";

duke marrë parasysh Konventën europiane për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve (ETS nr.160) dhe dobinë e nxitjen në marrjen e masave për të ndihmuar fëmijët në çështjet në lidhje me marrëdhëniet me prindërit dhe personat e tjerë që kanë lidhje familjare me fëmijët;

duke rënë dakord për nevojën që fëmijët të kenë marrëdhënie jo vetëm me të dy prindërit, por edhe me persona të tjerë të caktuar që kanë lidhje familjare me fëmijët dhe rëndësinë për prindërit dhe personat e tjerë për të mbajtur marrëdhënie me fëmijët në përshtatje me interesat e fëmijëve;

duke vënë re nevojën për të nxitur adoptimin nga shtetet të parimeve të përbashkëta në lidhje me marrëdhëniet mbi fëmijët, sidomos për të lehtësuar zbatimin e instrumenteve ndërkombëtare në këtë fushë;

duke qenë të ndërgjegjshëm se mekanizmi për t'u dhënë fuqi vendimeve të huaja mbi marrëdhëniet me fëmijët ka më shumë mundësi të japë rezultate të kënaqshme kur parimet mbi të cilat mbështeten këto vendime janë të ngjashme me parimet e shtetit që u jep fuqi këtyre vendimeve të huaja;

duke njohur nevojën, kur fëmijët, prindërit dhe persona të tjerë që kanë lidhje familjare me fëmijët banojnë në shtete të ndryshme, për të inkurajuar autoritetet gjyqësore për të përdorur më shpesh marrëdhëniet ndërkufitare dhe për të rritur besimin e të gjithë personave të interesuar se fëmijët do të kthehen në përfundim të kësaj marrëdhënieje;

duke vënë re se parashikimi i një sigurimi të efektshëm dhe i garancive shtesë është i mundur të sigurojë kthimin e fëmijëve, sidomos, në përfundim të marrëdhënies ndërkufitare;

duke vënë re se për parashikimin e zgjidhjeve që sidomos kanë të bëjnë me marrëdhënien ndërkufitare për fëmijët është i nevojshëm një instrument ndërkombëtar shtesë;

me dëshirën për të vendosur bashkëpunim ndërmjet të gjitha organeve qendrore ose organeve të tjera për të nxitur dhe përmirësuar marrëdhëniet ndërmjet fëmijëve, prindërve të tyre dhe personave të tjerë që kanë lidhje familjare me këta fëmijë, dhe sidomos për të nxitur bashkëpunim gjyqësor në çështjet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndërkufitare,

kanë rënë dakord si më poshtë:

KAPITULLI I
OBJEKTET E KONVENTËS DHE PËRKUFIZIME

Neni 1
Objektet e Konventës

Objektet e kësaj Konvente janë:

a) përcaktimi i parimeve të përgjithshme për t'u zbatuar me lidhje në vendimet mbi marrëdhëniet;

b) rregullimi i garancive të përshtatshme për të siguruar ushtrimin e rregullt të marrëdhënieve dhe kthimin e menjëhershëm të fëmijëve në fund të afatit të marrëdhënies;

c) vendosja e bashkëpunimit ndërmjet organeve qendrore, organeve gjyqësore dhe organeve të tjera për të nxitur dhe përmirësuar marrëdhëniet ndërmjet fëmijëve, prindërve të tyre dhe personave të tjerë që kanë lidhje familjare me fëmijët.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Konvente:

a) "marrëdhënie" do të thotë:

i) qëndrimi i fëmijës për një periudhës të caktuar kohe me ose në takim me një person të përmendur në nenet 4 ose 5 me të cilin ai ose ajo nuk banon zakonisht;

ii) çdo formë komunikimi ndërmjet fëmijës dhe një personi të tillë;

iii) dhënia e informacionit një personi të tillë për fëmijën ose fëmijët mbi këtë person;

b) "vendim mbi marrëdhëniet" do të thotë një vendim i një organi gjyqësor në lidhje me marrëdhëniet duke përfshirë një marrëveshje mbi marrëdhëniet, e cila është konfirmuar nga një organ kompetent gjyqësor ose që është përpiluar formalisht ose regjistruar si një instrument autentik dhe është i ekzekutueshëm;

c) "fëmijë" është një person nën 18 vjet në lidhje me të cilin mund të jepet ose të ekzekutohet një vendim mbi marrëdhëniet në një shtet palë;

d) "lidhje familjare" do të thotë një lidhje e ngushtë si ndërmjet një fëmije dhe gjyshit/gjyshes, ose vëllezërve dhe motrave të tij ose të saj, në bazë të ligjit ose në bazë të një lidhjeje familjare de fakto;

e) "organ gjyqësor" do të thotë një gjykatë ose organ administrativ i cili ka kompetenca ekuivalente.

KAPITULLI II
PARIME TË PËRGJITHSHME PËR TË ZBATUAR VENDIMET NË LIDHJE ME MARRËDHËNIET

Neni 3
Zbatimi i parimeve

Shtetet palë marrin ato masa legjislative dhe të tjera që mund të jenë të nevojshme për të siguruar zbatimin e parimeve të këtij kapitulli nga organet gjyqësore kur ata marrin, ndryshojnë, pezullojnë ose anulojnë vendime në lidhje me marrëdhëniet.

Neni 4
Marrëdhënia ndërmjet një fëmije dhe prindërve të tij ose të saj

1. Një fëmijë dhe prindërit e tij ose të saj kanë të drejtë të marrin dhe të mbajnë marrëdhënie të rregullta me njëri-tjetrin.

2. Këto marrëdhënie mund të kufizohen ose përjashtohen kur kjo kërkohet nga interesat e larta të fëmijës.

3. Kur nuk është në favor të interesave të larta të një fëmije që ky të mbajë marrëdhënie të pambikëqyrura me një nga prindërit e tij ose të saj, konsiderohet mundësia e marrëdhënieve personale të mbikëqyrura ose forma të tjera të marrëdhënieve me këtë prind.

Neni 5

Marrëdhëniet ndërmjet një fëmije dhe personave të tjerë, përveç prindërve të tij ose të saj

1. Në varësi të interesave të larta të fëmijës, mund të vendosen marrëdhënie ndërmjet atij ose asaj dhe personave të ndryshëm nga prindërit e tij ose të saj që kanë lidhje familjare me fëmijën.

2. Shtetet palë janë të lira ta shtrijnë këtë dispozitë për tek persona të tjerë nga ata të përmendur në paragrafin 1, dhe kur bëhet një shtrirje e tillë. Shtetet mund të vendosin lirisht se cilat aspkte të marrëdhënieve zbatohen sipas përkufizimit të nenit 2 germa a.

Neni 6

E drejta e fëmijës për t'u informuar, konsultuar dhe shprehur mendimet e tij ose të saj

1. Fëmija që në bazë të së drejtës ndërkombëtare konsiderohet me zhvillim të plotë mendor ka të drejtën, përveç kur një gjë e tillë do të ishte haptazi në dëm të interesave të larta të tij ose të saj:

- të marrë të gjithë informacionin përkatës;
- të konsultohet;
- të shprehë mendimet e tij ose të saj.

2. Këtyre mendimeve, dëshirave dhe ndjenjave të konstatueshme të fëmijës u kushtohet vëmendja e duhur.

Neni 7

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve në lidhje me marrëdhëniet

Gjatë zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në lidhje me marrëdhëniet, organet gjyqësore marrin të gjitha masat:

a) për të siguruar që të dy prindërit të jenë informuar për rëndësinë e vendosjes dhe të mbajtjes së marrëdhënieve të rregullta me fëmijën e tyre, për fëmijën dhe për ata vetë;

b) për të nxitur prindërit dhe persona të tjerë që kanë lidhje familjare me fëmijën për të lidhur marrëveshje miqësore në lidhje me marrëdhëniet, sidomos duke përdorur ndërmjetësimin familjar ose ndonjë formë tjetër për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;

c) para marrjes së një vendimi, të sigurohen që disponojnë informacion të mjaftueshëm, sidomos nga ata që mbajnë përgjegjësinë familjare, me qëllim që të marrin një vendim në favor të interesave të larta të fëmijës, dhe, kur është e nevojshme, të marrin informacion shtesë nga organe ose personat e tjerë përkatës.

Neni 8

Marrëveshjet për marrëdhëniet

1. Shtetet palë nxisin, me anë të mjeteve që ata i konsiderojnë të përshtatshme, prindërit dhe personat e tjerë që kanë lidhje familjare me fëmijën të repsektojnë parimet e parashikuara në nenet 4 deri 7 kur përpilojnë ose ndryshojnë marrëveshjet mbi marrëdhëniet në lidhje me një fëmijë. Këto marrëveshje duhet që mundësisht të bëhen me shkrim.

2. Me kërkesë, organet gjyqësore, përveç kur parashikohet ndryshe në ligjin e brendshëm, e konfirmojnë një marrëveshje mbi marrëdhëniet në lidhje me një fëmijë, përveç kur kjo është kundër interesave të larta të fëmijës.

Neni 9

Zbatimi i vendimeve në lidhje me marrëdhëniet

Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar që vendimet në lidhje me marrëdhëniet të zbatohen.

Neni 10

Mbrojtja dhe garancitë që jepen në lidhje me marrëveshjet

1. Secili shtet palë parashikon dhe nxit zbatimin e mbrojtjes dhe garancive. Ai i komunikon, nëpërmjet organeve të tij qendrore, Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, brenda tre muajsh pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për atë shtet palë, të paktën tre kategori mbrojtjesh dhe garancish të parashikuara nga ligji i brendshëm përveç mbrojtjes dhe garancive të përmendura në paragrafin 3 të nenit 4 dhe në germën b të paragrafit 1 të nenit 14 të kësaj Konvente. Ndryshimi i mbrojtjes dhe garancive të dhëna komunikohet sa më parë që të jetë e mundur.

2. Kur e kërkojnë rrethanat e çështjes, organet gjyqësore në çdo kohë mund të marrin një vendim mbi marrëdhëniet që t'i nënshtrohet mbrojtjes dhe garancive për sigurimin e zbatimit të këtij vendimi, që fëmija të kthehet në fund të afatit të marrëdhënies në vendin ku ai ose ajo banon zakonisht, ose që ai ose ajo të mos lëvizet në mënyrë të parregullt.

a) Mbrojtja dhe garancitë për të siguruar që vendimi të zbatohet, mund të përfshijnë sidomos:

- mbikëqyrjen e marrëdhënies;
- detyrimin për një person të sigurojë shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit të fëmijës dhe, nëse është e nevojshme, të çdo personi tjetër që e shoqëron fëmijën;
- një garanci, që depozitohet nga personi me të cilën fëmija banon rregullisht, për të siguruar që personi i cili kërkon marrëdhënie me fëmijën të mos pengohet për të hyrë në marrëdhënie;
- një gjobë që i vihet personit me të cilën fëmija banon zakonisht, nëse ky refuzon të përmbushë vendimin mbi marrëdhëniet.

b) Mbrojtja dhe garancitë për të siguruar kthimin e fëmijës ose parandalimin e kthimit të parregullt mund të përfshijë sidomos:

- dorëzimin e pasaportave ose dokumenteve të identitetit dhe, kur është e nevojshme, një dokument që të tregojë se personi që kërkon të ketë marrëdhënie ka njoftuar organin kompetent konsullor për këtë dorëzim gjatë periudhës së marrëdhënies;
- garancitë financiare;
- barrët mbi pasurinë;
- detyrimet ose marrëveshjet para gjykatës;
- detyrimin e personit që ka marrëdhënie me fëmijën për t'u paraqitur së bashku me fëmijën rregullisht para një organi kompetent, si zyra për mirëqenien e rinisë ose një rajon policie, në vendin ku duhet të ushtrohet marrëdhënia;
- detyrimin e personit që kërkon të hyjë në marrëdhënie që të paraqesë një dokument të lëshuar nga shteti ku duhet të zhvillohet marrëdhënia, që të vërtetojë njohjen dhe deklarimin e ekzekutueshmërisë së kujdestarisë ose të një vendimi mbi marrëdhëniet, ose të dyja, para se të merret vendimi për marrëdhëniet ose para se të fillojë marrëdhënia;
- caktimin e kushteve në lidhje me vendin ku duhet të zhvillohet marrëdhënia dhe, nëse është e nevojshme, regjistrimin në ndonjë sistem kombëtar ose ndërkufitar, të ndalimit që pengon fëmijën për t'u larguar nga shteti ku duhet të zhvillohet marrëdhënia.

3. Kjo mbrojtje dhe këto garanci janë të përcaktuara me shkrim ose të provuara me shkrim dhe janë pjesë e vendimit për marrëdhëniet ose marrëveshjes së konfirmuar.

4. Nëse mbrojtja dhe garancitë duhet të zbatohen në një shtet tjetër palë, organi gjyqësor mundësisht vendos mbrojtje dhe garanci të tilla të përshtatshme për t'u zbatuar në atë shtet palë.

KAPITULLI III
MASAT PËR TË NXITUR DHE PËRMIRËSUAR MARRËDHËNIET NDËRKUFITARE

Neni 11
Organet qendrore

1. Çdo shtet palë emëron një organ qendror për të kryer funksionet e parashikuara nga kjo Konventë në rastet e marrëdhënieve ndërkufitare.

2. Shtetet federale, shtetet me më shumë se një sistem ligjor ose shtetet që kanë pjesë territoriale autonome janë, të lira të emërojnë më shumë se një organ qendror dhe të përcaktojnë hapësirën territoriale dhe personale të funksioneve të tyre. Kur një shtet ka emëruar më shumë se një organ qendror, ai emëron një organ qendror të cilit i dërgohet çdo korrespondencë për ta transmetuar tek organi përkatës qendror brenda atij shteti.

3. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës njoftohet për çdo emërim sipas këtij neni.

Neni 12
Detyrat e organeve qendrore

Organet qendrore të shteteve palë:

a) bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për të nxitur bashkëpunimin ndërmjet organeve kompetente, duke përfshirë organet gjyqësore në vendet e tyre përkatëse për të arritur qëllimet e Konventës. Ata veprojnë me të gjithë shpejtësinë dhe efektivitetin e duhur;

b) me qëllim që të lehtësohet zbatimi i kësaj Konvente, pajisin, pas kërkesës përkatëse, njëri-tjetrin me informacion në lidhje me ligjet e brendshme që rregullojnë përgjegjësitë prindërore, duke përfshirë marrëdhëniet dhe me çdo informacion të detajuar në lidhje me mbrojtjen dhe garancitë përveç atyre të parashikuara sipas paragrafit 1 të nenit 10, dhe shërbimet e ofruara prej tyre (duke përfshirë shërbimet ligjore, të financuara me fonde publike ose të tjera), si dhe me informacione mbi çdo ndryshim në këto ligje dhe shërbime;

c) bëjnë të gjitha përpjekjet për të zbuluar vendndodhjen e fëmijës;

d) sigurojnë transmetimin e kërkesave për informacion që vijnë nga organet kompetente në lidhje me çështjet ligjore ose faktike mbi një gjykim të papërfunduar;

e) e mbajnë njëri-tjetrin të informuar për çdo vështirësi që mund të lindë gjatë zbatimit të Konventës dhe, nëse është e mundur, mënjanojnë pengesat për zbatimin e saj.

Neni 13
Bashkëpunimi ndërkombëtar

1. Organet gjyqësore, organet qendrore dhe organet sociale dhe të tjera të shteteve palë përkatëse, duke vepruar brenda kompetencës së tyre, bashkëpunojnë në lidhje me gjykimet mbi marrëdhëniet ndërkufitare.

2. Organet qendrore ndihmojnë veçanërisht organet gjyqësore të shteteve palë për të komunikuar me njëri-tjetrin dhe në marrjen e informacionit dhe të ndihmës që është e nevojshme për të arritur objektivat e kësaj Konvente.

3. Në çështjet ndërkufitare, organet qendrore ndihmojnë fëmijët, prindërit dhe personat e tjerë që kanë lidhje familjare me fëmijën sidomos për të filluar gjykimin në lidhje me marrëdhënien ndërkufitare.

Neni 14
Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve për marrëdhëniet ndërkombëtare

1. Shtetet palë parashikojnë, duke përfshirë ato që kur është e mundur janë në përputhje me instrumentet ndërkombëtare:

a) një sistem për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të dhëna në shtetet e tjera palë në lidhje me marrëdhëniet dhe të drejtën e kujdestarisë;

b) një procedurë ku vendimet në lidhje me marrëdhëniet dhe të drejtën e kujdestarisë të dhënë në shtete të tjera palë të mund të njihen dhe të deklarohen të ekzekutueshme para se të ushtrohet marrëdhënia në shtetin pritës.

2. Nëse një shtet palë e kushtëzon një njohje apo ekzekutim ose të dyja bashkë për një vendim të huaj me ekzistencën e një marrëveshjeje ose të reciprocitetit, ai mund ta konsiderojë këtë Konventë si bazë ligjore për njohjen ose ekzekutimin, apo të dyjave bashkë, të një vendimi të huaj për marrëdhëniet.

Neni 15

Kushtet për zbatimin e vendimeve për marrëdhëniet ndërkufitare

Organi gjyqësor i shtetit palë ku duhet të zbatohet një vendim mbi një marrëdhënie ndërkufitare të dhënë në një shtet tjetër palë, në momentin e njohjes ose të deklarimit të ekzekutueshmërisë së këtij vendimi për marrëdhëniet ose në një moment të mëvonshëm, mund të përcaktojë ose adoptojë kushtet për zbatimin e tij, si dhe çdo mbrojtje ose garanci të lidhura me të, nëse kjo është e nevojshme për të lehtësuar ushtrimin e kësaj marrëdhënieje, me kusht që elementet thelbësore të vendimit të respektohen dhe të merren parasysh, sidomos ndryshimi i rrethanave dhe i marrëveshjeve të kryera nga personat e interesuar. Në asnjë rrethanë, vendimi i huaj nuk mund të rishikohet në themel.

Neni 16

Rikthimi i një fëmije

1. Kur një fëmijë nuk rikthehet në përfundim të një marrëdhënieje ndërkufitare në bazë të një vendimi mbi këtë marrëdhënie, organet kompetente, me kërkesë, sigurojnë rikthimin e menjëhershëm të fëmijës, dhe kur është e mundur duke zbatuar dispozitat përkatëse të instrumenteve ndërkombëtare, të ligjit të brendshëm dhe, kur është e mundur, duke zbatuar mbrojtjen dhe garancitë sipas parashikimit të bërë në vendimin për marrëdhënien.

2. Një vendim për rikthimin e fëmijës merret, kur është e mundur, brenda gjashtë javëve nga data e bërjes së kërkesës për rikthimin.

Neni 17

Shpenzimet

Përveç shpenzimeve të riatdhesimit, çdo shtet palë merr përsipër për të mos pretenduar ndonjë pagesë nga kërkesa në lidhje me çdo masë të marrë sipas kësaj Konvente nga vetë organet qendrore të atij shteti në emër të kërkuesit.

Neni 18

Kërkesat për gjuhën

1. Në varësi të çdo marrëveshjeje të veçantë të bërë ndërmjet organeve qendrore përkatëse:

a) korrespondenca e dërguar organit qendror të shtetit pritës përpilohet në gjuhën zyrtare ose në një nga gjuhët zyrtare të atij shteti, ose shoqërohet me një përkthim në këtë gjuhë.

b) organi qendror i shtetit pritës megjithatë pranon dhe korrespondencën në anglisht ose frëngjisht, ose të shoqëruar me një përkthim në një nga këto gjuhë.

2. Korrespondenca që del nga organi qendror i shtetit pritës, duke përfshirë edhe rezultatet e hetimeve të kryera, mund të bëhen në gjuhën zyrtare ose në një nga gjuhët zyrtare të atij shteti, ose në anglisht apo frëngjisht.

3. Megjithatë, një shtet palë, nëpërmjet një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund të kundërshtojë përdorimin e anglishtes ose të frëngjishtes sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni në çdo kërkesë, korrespondencë ose dokumente të tjera dërguar organeve qendrore.

KAPITULLI IV
RAPORTI ME INSTRUMENTET E TJERA

Neni 19
Raporti me Konventën europiane mbi njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në lidhje me kujdestarinë e fëmijëve dhe rivendosjen e kujdestarisë mbi fëmijët

Paragrafët 2 dhe 3 të nenit 11 të Konventës europiane të 20 majit 1980 (ETS nr.105) mbi njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në lidhje me kujdestarinë e fëmijëve dhe rivendosjen e kujdestarisë mbi fëmijët nuk zbatohet në marrëdhëniet ndërmjet shteteve palë, të cilat janë gjithashtu shtete palë në këtë Konventë.

Neni 20
Raporti me instrumente të tjera

1. Kjo Konventë nuk cenon asnjë instrument tjetër ndërkombëtar në të cilën shtetet palë në këtë Konventë janë palë ose do të bëhen palë i cili përmban dispozita mbi çështje që janë rregulluar në këtë Konventë. Kjo Konventë nuk cenon sidomos zbatimin e instrumenteve të mëposhtme ligjore:

a) Konventën e Hagës të 5 tetorit 1961 mbi kompetencën e organeve dhe ligjin e zbatuar për mbrotjen e të miturve.

b) Konventën europiane mbi njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në lidhje me kujdestarinë e fëmijëve dhe rivendosjen e kujdestarisë mbi fëmijët të 20 majit 1980 sipas nenit 19 të mësipërm.

c) Konventën e Hagës të 25 tetorit 1980 mbi aspektet civile të rrëmbimit të fëmijëve në nivel ndërkombëtar.

d) Konventën e Hagës të 19 tetorit 1996 mbi juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, ekzekutimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve.

2. Asgjë në këtë Konventë nuk i pengon palët të lidhin marrëveshje ndërkombëtare që plotësojnë ose zhvillojnë më tej dispozitat e kësaj Konvente apo që zgjerojnë sferën e zbatimit të tyre.

3. Në marrëdhëniet e tyre reciproke, shtetet palë që janë anëtare të Komunitetit Europian zbatojnë rregullat e Komunitetit dhe kështu nuk zbatojnë rregullat që rrjedhin nga kjo Konventë, përveç kur nuk ka rregull komunitar që të rregullojë lëndën në fjalë.

KAPITULLI V
NDRYSHIMET E KONVENTËS

Neni 21
Ndryshimet

1. Çdo propozim për ndryshimin e kësaj Konvente të paraqitur nga një palë i komunikohet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës dhe ky i fundit ia paraqet këtë shteteve anëtare të Këshillit të Europës, çdo nënshkuresi, çdo shteti palë, Komunitetit Europian, çdo shteti të ftuar për ta nënshkurar këtë Konventë sipas dispozitave të nenit 22 dhe çdo shteti të ftuar për të aderuar në këtë Konventë sipas dispozitave të nenit 23.

2. Çdo ndryshim i propozuar nga një palë i komunikohet Komitetit Europian për Bashkëpunimin Ligjor (KEBL), i cili i paraqet Komitetit të Ministrave mendimin e tij mbi ndryshimin e propozuar.

3. Komiteti i Ministrave e merr në shqyrtim ndryshimin e propozuar dhe mendimin e paraqitur nga KEBL dhe, pas konsultimeve me palët e Konventës, të cilët nuk janë anëtarë të Këshillit të Europës, mund të miratojë ndryshimin.

4. Teksti i çdo ndryshimi të miratuar nga Komiteti i Ministrave në pajtim me paragrafin 3 të këtij neni u paraqitet për pranim palëve.

5. Çdo ndryshim i aprovuar në pajtim me paragrafin 3 të këtij neni hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati njëmujor pas datës në të cilën të gjitha palët kanë informuar Sekretarin e Përgjithshëm se e kanë pranuar atë.

KAPITULLI VI
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 22
Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë është e hapur për t'u nënshkruar nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës, shtetet joanëtare që kanë marrë pjesë në përpilimin e saj dhe nga Komuniteti Europian.

2. Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose aprovimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose aprovimit depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

3. Kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati tremujor pas datës në të cilën tre shtete, duke përfshirë të paktën dy shtete anëtare të Këshillit të Europës, kanë shprehur pëlqimin e tyre për të respektuar Konventën në pajtim me dispozitat e paragrafit të mësipërm.

4. Në lidhje me çdo shtet të përmendur në paragrafin 1 ose me Komunitetin Europian i cili e shpreh më vonë pëlqimin e tij për të respektuar Konventën, kjo hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati tremujor pas datës së depozitimit të instrumenteve të tij të ratifikimit, pranimit ose aprovimit.

Neni 23
Aderimi në Konventë

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës, pas konsultimeve me palët, mund të ftojë çdo shtet joanëtar të Këshillit të Europës, i cili nuk ka marrë pjesë në përpilimin e Konventës, të aderojë në këtë Konventë nëpërmjet një vendimi të marrë nga shumica e parashikuar në nenin 20d të statutit të Këshillit të Europës dhe me votën unanime të përfaqësuesve të shteteve kontraktuese që kanë të drejtën e një vendi në Komitetin e Ministrave.

2. Në lidhje me çdo shtet aderues, Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati tremujor pas datës së depozitimit të instrumentit të aderimit te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 24
Zbatimi territorial

1. Çdo shtet ose Komunitet Europian, në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit, mund të përcaktojë territorin ose pjesët e territorit ku zbatohet kjo Konventë.

2. Çdo palë në një datë të mëvonshme dhe nëpërmjet një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës mund ta zgjerojë zbatimin e kësaj Konvente për në çdo pjesë tjetër territori të përcaktuar në deklaratë dhe për ato marrëdhënie ndërkombëtare që ajo është e përgjegjshme dhe në emër të të cilit ajo është e autorizuar të marrë përsipër detyrime. Në lidhje me këtë pjesë territori, Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati tremujor pas datës së marrjes së një deklarate të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë sipas dy paragrafëve të mësipërm, në lidhje me çdo pjesë territori të përcaktuar në deklaratë, mund të tërhiqet nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Tërheqja hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati tremujor pas datës së marrjes së një njoftimi të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 25
Rezervat

Nuk mund të bëhet asnjë rezervë për dispozitat e kësaj Konvente.

Neni 26
Denoncimi

1. Çdo Palë mund ta denoncojë këtë Konventë në çdo kohë nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Një denoncim i tillë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati tremujor pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 27
Njoftimet

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës njofton shtetet anëtare të Këshillit të Europës, çdo shtet nënshkrues, çdo shtet palë, Komunitetin Europian, çdo shtet të ftuar për të nënshkruar këtë Konventë sipas dispozitave të nenit 22 dhe çdo shtet të ftuar të aderojë në këtë Konventë në pajtim me dispozitat e nenit 23 për:

a) çdo nënshkrim;

b) depozitimin e çdo instrumenti të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit;

c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente sipas neneve 22 dhe 23;

d) çdo ndryshim të miratuar sipas nenit 21 dhe datën në të cilën hyn në fuqi një ndryshim i tillë;

e) çdo deklaratë të bërë sipas dispozitave të nenit 18;

f) çdo denoncim të bërë sipas dispozitave të nenit 26;

g) çdo akt, njoftim ose komunikim tjetër, sidomos ata që janë parashikuar në nenet 10 dhe 11 të kësaj Konvente.

Si dëshmi të kësaj, të poshtëshënuarit, duke qenë të autorizuar rregullisht, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në 15 maj 2003, në anglisht dhe frëngjisht të dyja tekstet njëlloj të vlefshme në një kopje të vetme e cila depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës, Sekretari i Përgjithshm i Këshillit të Europës u transmeton kopje të vërtetuara të gjitha shteteve anëtare të Këshillit të Europës, shteteve joanëtare të cilat kanë marrë pjesë në hartimin e Konventës, Komunitetit Europian dhe çdo shteti që është ftuar të aderojë në këtë Konventë.

LIGJ
Nr. 9427, datë 13.10.2005

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË SË BELGJIKËS PËR BASHKËPUNIMIN POLICOR"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Belgjikës për bashkëpunimin policor".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4678, datë 1.11.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.84, faqe 2735

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË TË BELGJIKËS PËR BASHKËPUNIMIN POLICOR

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Mbretërisë së Belgjikës, të quajtura më poshtë "Palë Kontraktuese";

duke u bazuar në angazhimin për të zhvilluar marrëdhënie miqësie dhe bashkëpunimi ndërmjet dy shteteve dhe në veçanti duke u bazuar në vullnetin e përbashkët për të forcuar bashkëpunimin policor midis tyre;

duke u bazuar në dëshirën për ta forcuar këtë bashkëpunim policor në kuadrin e angazhimeve ndërkombëtare të marra nga të dy shtetet në fushën e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore, konkretisht në kuadrin e Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore, si dhe në kuadrin e Konventës nr.108 të Këshillit të Europës të 28 janarit 1981 për mbrojtjen e personave ndaj trajtimit të automatizuar të të dhënave me karakter personal;

duke marrë parasysh se kriminaliteti i organizuar ndërkombëtar përfaqëson një kërcënim të rëndë për zhvillimin social-ekonomik të shteteve kontraktuese dhe se zhvillimet më të fundit të krimit të organizuar ndërkombëtar vënë në rrezik funksionimin e tyre institucional;

duke marrë parasysh se lufta kundër trafikut të qenieve njerëzore dhe goditja e hyrje-daljeve të paligjshme në territorin përkatës të shteteve dhe ajo e lëvizjeve migratore të paligjshme, si dhe shkatërrimi i rrjeteve të organizuara që marrin pjesë në këto akte të paligjshme, janë një shqetësim për qeveritë dhe parlamentet e dy shteteve tona;

duke marrë parasysh se prodhimi dhe tregtia e paligjshme e drogave dhe e substancave psikotrope përbëjnë një rrezik për shëndetin dhe sigurinë e shtetasve;

duke marrë parasysh se nuk mjafton vetëm harmonizimi i legjislacioneve të përshtatshme për të luftuar me efikasitet të mjaftueshëm dukurinë e lëvizjeve migratore klandestine;

duke marrë parasysh se nevoja e bashkëpunimit policor ndërkombëtar efikas në fushën e krimit të organizuar dhe lëvizjeve migratore të paligjshme konkretisht nëpërmjet shkëmbimit dhe trajtimit të informacioneve, është e domosdoshme për të luftuar dhe për të parandaluar këtë veprimtari kriminale dhe të kundërligjshme;

duke marrë parasysh se përmbushja e kësaj nevoje kërkon një seri masash të duhura dhe një bashkëpunim të ngushtë ndërmjet Palëve Kontraktuese,

kanë vendosur ta përfundojnë këtë Marrëveshje.

Përkufizime

Neni 1

Në këtë Marrëveshje kuptohet me:

- Trafik ndërkombëtar të qenieve njerëzore, çdo akt i qëllimshëm që ka të bëjë me:

a) lehtësimin e hyrjes në territorin e secilës nga Palët Kontraktuese, atë të transitimit, qëndrimit ose daljes nga ky territor, nëse për këtë qëllim është përdorur detyrimi, më konkretisht dhuna ose kërcënimet, ose nëse është përdorur mashtrimi, shpërdorimi i detyrës ose forma të tjera presioni në atë masë që personi nuk ka rrugëdalje tjetër reale dhe të pranueshme, përveçse t'u nënshtrohet këtyre presioneve;

b) shfrytëzimin me çfarëdolloj mënyre qoftë të një personi, duke e ditur se ky person ka hyrë, transiton ose qëndron në territorin e secilit shtet të Palëve Kontraktuese të kësaj Marrëveshjeje, në kushtet e parashikuara në pikën "a".

- Shfrytëzimi seksual i fëmijëve: shkeljet e parashikuara nga neni 34 i Konventës së Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijëve e 20 nëntorit 1989, duke përfshirë këtu edhe prodhimin, shitjen, shpërndarjen si dhe forma të tjera trafiku të materialeve me karakter pornografik ku implikohen fëmijë, si dhe mbajtjen, qoftë edhe për përdorim personal, të këtyre lloj materialesh.

- Asistencë teknike: ndihma e dhënë, në fushën logjistike, shërbimeve të policisë dhe të migrimit.

- Kriminalitet që ka të bëjë me lëndët bërthamore dhe radioaktive: shkeljet që parashikohen në paragrafin 7 të nenit 1 të Konventës së 3 marsit 1980 për mbrojtjen fizike të lëndëve bërthamore, të nënshkruar në Vjenë dhe Nju Jork më 3 mars 1980.

- Pastrim parash: shkeljet që parashikohen nga paragrafi 1 deri në paragrafin 3 të nenit 6 të Konventës së Këshillit të Europës për pastrimin, zbulimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve që rrjedhin nga krimi, nënshkruar në Strasburg më 8 nëntor 1990.

- Kriminaliteti i organizuar: çdo shkelje e parashikuar në nenin 2 të Konventës së 12 dhjetorit të vitit 2000 të Kombeve të Bashkuara që ka të bëjë me kriminalitetin e organizuar transnacional.

- Trajtimi i të dhënave me karakter personal: me të dhëna me karakter personal duhet kuptuar çdo informacion për një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm (personi në fjalë); konsiderohet si i identifikueshëm një person i cili mund të identifikohet drejtpërsëdrejti ose tërthorazi, pikërisht duke iu referuar një numri identifikimi ose një ose disa elementeve specifike, karakteristikë e identitetit të tij fizik, fiziologjik, psikik, ekonomik, kulturor dhe shoqëror.

Me trajtim të të dhënave me karakter personal duhet kuptuar çdo operacion ose bashkësi operacionesh të kryera me apo pa ndihmën e proceseve të automatizuara dhe që aplikohen për të dhëna me karakter personal, si mbledhja, regjistrimi, organizimi, ruajtja, përshtatja ose modifikimi, nxjerrja, analiza, përdorimi, komunikimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarja ose çdo lloj forme vënie në dispozicion, krahasimi ose lidhja në rrjet, si dhe arkivimi, fshirja dhe asgjësimi i këtyre të dhënave.

- Drogë: çdo substancë, pavarësisht nga origjina e saj natyrore apo sintetike, që figuron në tabelën I ose në tabelën II të Konventës unike për drogat, bërë në Nju Jork më 30 mars 1961.

- Substancë psikotrope: çdo substancë, pavarësisht nga origjina e saj natyrore ose sintetike, ose çdo produkt natyror të tabelave I, II, III ose IV të Konventës për substancat psikotrope të 21 shkurtit 1971.

- Trafik të paligjshëm të drogave dhe të substancave psikotrope: kultivimi, prodhimi ose trafiku i drogave ose i substancave psikotrope që u kundërvihen qëllimeve të Konventës së 31 marsit 1961 për drogat, Konventës së 21 shkurtit 1971 për substancat psikotrope ose Konventës së Kombeve të Bashkuara të 20 dhjetorit 1988 për trafikun e paligjshëm të drogave dhe të substancave psikotrope.

- Kërkesë urgjente: një kërkesë cilësohet urgjente në rastet kur paraqitja e saj nëpërmjet procedurës administrative formale pranë organeve qendrore rrezikon të pengojë ose të kompromentojë aktin e parandalimit ose të kërkimit.

Fushat e bashkëpunimit

Neni 2

1. Secila Palë angazhohet për t'i ofruar Palës tjetër, në bazë të rregullave dhe kritereve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, bashkëpunimin më të gjerë që ka të bëjë me lëmin policor.

2. Palët Kontraktuese do të bashkëpunojnë për parandalimin, goditjen dhe ndjekjen e akteve të rënda që lidhen me krimin e organizuar dhe në veçanti për:

- aktet kundër jetës, shëndetit dhe paprekshmërisë fizike të personit;

- aktet që lidhen me prodhimin dhe trafikun e paligjshëm të drogave, substancave psikotrope dhe prekursorëve;

- imigracionin e paligjshëm dhe trafikun e qenieve njerëzore;

- organizimin dhe shfrytëzimin e prostitucionit, trafikun e qenieve njerëzore dhe shfrytëzimin seksual të fëmijëve;

- kërkimin dhe marrjen e parave nëpërmjet dhunës dhe kërcënimit;

- vjedhjen, trafikun dhe tregtimin e paligjshëm të armëve, municioneve, eksplozivave, lëndëve radioaktive, lëndëve bërthamore dhe lëndëve të tjera të rrezikshme;

- falsifikimet (prodhimin, falsifikimin, transformimin ose shpërndarjen) e dokumenteve të identitetit të mjeteve të pagesës, çeqeve dhe letrave të tjera me vlerë;

- kriminalitetin në fushën e shkëmbimeve tregtare e financiare;

- aktet kundër pasurisë, midis të tjerash,vjedhja dhe trafiku i veprave të artit dhe atyre me vlerë historike (vjedhje me dhunë dhe vjedhje me thyerje);

- vjedhjet me ose pa dhunë, tregtimin e paligjshëm dhe trafikun e mjeteve motorike, si dhe falsifikimin dhe përdorimin e dokumenteve të falsifikuara të automjeteve;

- pastrimin e parave.

3. Aktet e rënda që kanë të bëjnë me krimin e organizuar dhe që nuk janë përmendur në nenin 1 mbeten për t'u vlerësuar nga autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese në përputhje me legjislacionin e brendshëm të shteteve të tyre.

Neni 3

Bashkëpunimi ndërmjet Palëve Kontraktuese do të përfshijë edhe:

- kërkimin e personave të zhdukur, si dhe ndihmën për identifikimin e kufomave të paidentifikuara;

- kërkimin në territorin e secilës Palë Kontraktuese të sendeve të vjedhura, të zhdukura, si dhe të marra në mënyrë të paligjshme ose të humbura në territorin e shtetit tjetër.

Neni 4

Palët Kontraktuese do të bashkëpunojnë në fushat e specifikuara në nenet 2 dhe 3 të sipërpërmendura nëpërmjet:

- shkëmbimit të informacioneve që u përkasin fushave në kompetencë të autoriteteve të policisë dhe të migrimit;
- shkëmbimit të pajisjeve;
- asistencës teknike dhe shkencore, ekspertimeve dhe dhënies së materialit teknik të specializuar;
- shkëmbimit të përvojave;
- bashkëpunimit në fushën e formimit profesional;
- ndihmës në përgatitjen e ekzekutimit të kërkesave për ndihmë të ndërsjellë gjyqësore;

sipas dispozitave që vijojnë më poshtë.

Shkëmbimi i informacioneve

Neni 5

Palët Kontraktuese do t'i japin njëra-tjetrës asistencë dhe do të sigurojnë një bashkëpunim të ngushtë dhe të përhershëm. Ato do të kryejnë gjithashtu edhe shkëmbim të të gjitha informacioneve të nevojshme dhe të rëndësishme.

Ky bashkëpunim mund të marrë formën e një kontakti të përhershëm nëpërmjet oficerëve ndërlidhës që do të caktohen.

Neni 6

1. Palët Kontraktuese angazhohen se shërbimet e tyre policore do t'i japin njëra-tjetrës, në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm dhe në kuadrin e kompetencave të tyre, asistencë për parandalimin dhe ndjekjen e akteve të dënueshme me ligj për aq sa e drejta e brendshme e Palës Kontraktuese të kërkuar nuk ua nënshtron kërkesën ose ekzekutimin e saj autoriteteve gjyqësore.

2. Në raste të veçanta, secila Palë Kontraktuese, në përputhje me legjislacionin e saj të brendshëm dhe pa ia kërkuar këtë Pala tjetër, mund t'i komunikojë Palës tjetër Kontraktuese informacione që mund të jenë të rëndësishme për këtë të fundit, me qëllim që ta ndihmojë për parandalimin dhe goditjen e akteve që parashikohen në nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje ose për të parandaluar kërcënime për rendin dhe sigurinë publike të saj.

Neni 7

Çdo informacion i dhënë nga Pala Kontraktuese e kërkuar mund të përdoret nga Pala Kontraktuese kërkuese për të paraqitur prova të akteve të inkriminuara vetëm pas një kërkese për ndihmë të ndërsjellë gjyqësore në përputhje me dispozitat e së drejtës ndërkombëtare në fuqi.

Neni 8

1. Kërkesat për asistencë dhe përgjigjet ndaj tyre duhet të shkëmbehen ndërmjet organeve qendrore që janë të ngarkuara, nga secila Palë Kontraktuese, për bashkëpunimin policor ndërkombëtar dhe imigrimin.

Në rast se kërkesa nuk mund të paraqitet për arsye kohe nëpërmjet kësaj rruge, për raste të veçanta dhe vetëm në raste urgjente, ajo mund t'i paraqitet drejtpërsëdrejti nga autoritetet kompetente të Palës Kontraktuese kërkuese autoriteteve kompetente të Palës Kontraktuese të kërkuar dhe këto të fundit mund t'u përgjigjen atyre drejtpërsëdrejti. Në këto raste të veçanta, autoriteti kërkues duhet të njoftojë në afatet më të mira për këtë kërkesë të drejtpërdrejtë dhe duke shpjeguar motivet e urgjencës së saj organit qendror të ngarkuar për bashkëpunim policor ndërkombëtar të Palës Kontraktuese të kërkuar.

2. Përcaktimi i organeve qendrore të ngarkuara për bashkëpunimin policor ndërkombëtar, si dhe mënyrat e asistencës së ndërsjellë rregullohen sipas vendimeve që do të merren ndërmjet ministrave kompetentë të Palëve Kontraktuese.

Neni 9

Autoriteti kompetent kërkues duhet të garantojë shkallën e sekretit që autoriteti kompetent i Palës tjetër Kontraktuese ka përcaktuar për informacionin. Nivelet e sigurisë janë ato që përdoren nga Interpoli.

Neni 10

1. Palët Kontraktuese mund të vendosin për një kohëzgjatje të caktuar ose të pacaktuar oficerë ndërlidhës të tyre pranë Palës tjetër Kontraktuese.

2. Vendosja e oficerëve ndërlidhës për një kohëzgjatje të caktuar ose të pacaktuar ka si qëllim zhvillimin dhe përshpejtimin e bashkëpunimit ndërmjet Palëve Kontraktuese, konkretisht duke rënë dakord për asistencën:

a) në formën e shkëmbimit të informacioneve me qëllim për të luftuar krimin si në planin parandalues, ashtu dhe në atë goditës;

b) në ekzekutimin e kërkesave për ndihmë gjyqësore të ndërsjellë në fushën penale;

c) për nevoja të ushtrimit të misioneve të autoriteteve të ngarkuara për mbikëqyrjen e kufijve të jashtëm dhe atyre të imigracionit;

d) për nevoja të ushtrimit të misioneve të autoriteteve të ngarkuara me parandalimin e kërcënimeve për rendin publik.

3. Oficerët ndërlidhës kanë si mision dhënien e mendimeve dhe të asistencës. Ata nuk janë kompetentë për ekzekutimin autonom të masave policore. Ata japin informacione dhe zbatojnë misionet e tyre sipas udhëzimeve të Palës Kontraktuese të origjinës së tyre, si dhe atyre të Palës Kontraktuese pranë së cilës janë vendosur. Ata i raportojnë rregullisht organit qendror të ngarkuar me bashkëpunimin policor ndërkombëtar të Palës Kontraktuese pranë së cilës janë vendosur.

4. Ministrat kompetentë të Palëve Kontraktuese mund të bien dakord që zyrtarët ndërlidhës të njërës Palë Kontraktuese të vendosur pranë shteteve të treta të përfaqësojnë dhe interesat e Palës tjetër Kontraktuese.

5. Oficeri ndërlidhës mund të atashohet ose të akreditohet pranë një misioni të tretë diplomatik të një shteti të Bashkimit Europian.

Mbrojtja e të dhënave me karakter personal

Neni 11

1. Në zbatim të kësaj Marrëveshjeje, trajtimi i të dhënave me karakter personal i nënshtrohet legjislacionit të brendshëm respektiv të secilës Palë Kontraktuese.

2. Përsa i përket trajtimit të të dhënave me karakter personal në bazë të kësaj Marrëveshjeje, Palët Kontraktuese angazhohen të realizojnë një nivel mbrojtje të të dhënave me karakter personal që respekton dispozitat e Konventës së Këshillit të Europës të 28 janarit 1981 për mbrojtjen e personave ndaj trajtimit automatik të të dhënave me karakter personal dhe të Rekomandimit R(87) 15 të 17 shtatorit 1987 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, i cili ka për objekt rregullimin e përdorimit të të dhënave me karakter personal në sektorin e policisë.

3. Përsa i përket trajtimit të të dhënave me karakter personal, të transmetuara në bazë të kësaj Marrëveshjeje, zbatohen dispozitat e mëposhtme:

a) Të dhënat mund të përdoren nga Pala Kontraktuese që i merr vetëm sipas qëllimeve për të cilat kjo Marrëveshje parashikon transmetimin e tyre. Përdorimi i të dhënave për qëllime të tjera është i mundur vetëm pas autorizimit paraprak të Palës Kontraktuese që i jep ato dhe duke respektuar legjislacionin e Palës Kontraktuese që i merr ato.

b) Të dhënat mund të përdoren vetëm nga autoritetet gjyqësore dhe shërbimet e instancat që kanë detyra ose përmbushin funksione në kuadrin e qëllimeve që synon kjo Marrëveshje, konkretisht ato të parashikuara në nenet 2 dhe 3. Palët do t'i komunikojnë njëra-tjetrës listën e përdoruesve të këtyre të dhënave.

c) Pala kontraktuese që transmeton të dhënat është e detyruar të garantojë se ato janë të sakta dhe të plota. Ajo është e detyruar gjithashtu që të interesohet që këto të dhëna të mos ruhen më shumë sesa është e nevojshme. Nëse ajo konstaton me iniciativën e saj ose pas kërkesës së personit të interesuar se ka transmetuar të dhëna të pasakta ose që nuk duheshin transmetuar, Pala ose Palët Kontraktuese marrëse duhet të informohen sa më shpejt; kjo ose këto të fundit janë të detyruara që të bëjnë korrigjimin ose asgjësimin e të dhënave, ose të njoftojnë se këto të dhëna janë të pasakta ose nuk duhej të ishin transmetuar.

d) Asnjëra nga Palët Kontraktuese nuk mund të përdorë si pretekst faktin që një Palë tjetër Kontraktuese të ketë transmetuar të dhëna të pasakta, me synim që të shkarkohet nga përgjegjësia që i takon në bazë të së drejtës së saj të brendshme, ndaj personit të dëmtuar.

e) Dhënia dhe marrja e të dhënave me karakter personal duhet të regjistrohen. Palët Kontraktuese do t'i komunikojnë njëra-tjetrës listën e autoriteteve apo shërbimeve të autorizuara për të kërkuar informacion mbi regjistrimin.

f) Njohja me të dhënat bëhet në përputhje me legjislacionin e brendshëm të Palës Kontraktuese të cilës personi i interesuar i paraqet kërkesën. Komunikimi i të dhënave personit të interesuar është i mundur vetëm pasi është kërkuar autorizimi i Palës Kontraktuese që i ka transmetuar këto të dhëna.

g) Të dhënat mund të përdoren nga Pala Kontraktuese marrëse vetëm për qëllimet e përcaktuara nga Pala Kontraktuese transmetuese dhe duke respektuar kriteret e përcaktuara nga kjo Palë Kontraktuese;

4. Përveç kësaj, përsa i përket transmetimit, zbatohen dispozitat e mëposhtme:

a) Të dhënat mund t'u transmetohen vetëm autoriteteve dhe shërbimeve policore dhe të imigrimit; komunikimi i të dhënave instancave të tjera që ndjekin të njëjtat objektiva si këto shërbime e autoritete dhe që veprojnë në të njëjtin kuadër, mund të bëhet vetëm pas autorizimit paraprak të Palës Kontraktuese që i jep ato.

b) Në bazë të një kërkese, Pala Kontraktuese marrëse e informon Palën Kontraktuese dhënëse për përdorimin që u ka bërë këtyre të dhënave dhe rezultateve që ka arritur në bazë të tyre.

5. Secila Palë Kontraktuese përcakton një autoritet kontrolli të ngarkuar, duke respektuar të drejtën e saj të brendshme, për të ushtruar në territorin e saj një kontroll të pavarur të trajtimeve të të dhënave me karakter personal të kryera në bazë të kësaj Marrëveshjeje dhe për të verifikuar nëse këto trajtime nuk kanë cenuar të drejtat e personit të interesuar. Këto autoritete kontrolli janë kompetente, gjithashtu për të analizuar vështirësitë e zbatimit dhe të interpretimit të kësaj Marrëveshjeje lidhur me trajtimin e të dhënave me karakter personal. Këto autoritete kontrolli mund të bien dakord midis tyre për të bashkëpunuar në kuadër të misioneve që u njihen nga kjo Marrëveshje.

Neni 12

Në rastet kur të dhënat me karakter personal transmetohen nëpërmjet oficerit ndërlidhës të parashikuar në nenin 10, zbatohen dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, vetëm kur ky zyrtar ndërlidhës ia transmeton këto të dhëna Palës Kontraktuese pranë së cilës është vendosur.

Përjashtimi

Neni 13

Secila Palë Kontraktuese refuzon asistencën kur bëhet fjalë për krime politike ose ushtarake, si dhe kur kjo asistencë rezulton në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi në territorin e saj. Secila palë mund ta refuzojë asistencën ose ta kushtëzojë atë kur bëhet fjalë për akte antiligjore politike ose ushtarake.

Secila Palë Kontraktuese mund ta refuzojë asistencën ose t'ua nënshtrojë disa kushteve kur bëhet fjalë për krime të lidhura me krimet politike ose ushtarake ose kur realizimi i saj mund të kërcënojë sovranitetin, sigurinë, rendin publik dhe interesa të tjerë thelbësorë të shtetit.

Forma të tjera të bashkëpunimit

Neni 14

1. Palët Kontraktuese bien dakord për t'i dhënë njëra-tjetrës asistencë në fushën e formimit profesional dhe asistencë teknike për problemet që lidhen me funksionimin e policisë.

2. Palët Kontraktuese bien dakord për të shkëmbyer përvojat e tyre praktike në të gjitha fushat që përfshihen në këtë Marrëveshje.

3. Mënyrat e dhënies së asistencës së ndërsjellë rregullohen sipas vendimeve të përbashkëta të ministrave kompetentë të Palëve Kontraktuese.

Grupet e përbashkëta të punës

Neni 15

1. Palët Kontraktuese mund të ngrejnë grupe pune, të përhershme ose rast pas rasti, të ngarkuara me analizën e problemeve të përbashkëta, lidhur me goditjen dhe parandalimin e tipologjisë kriminale të parashikuar në nenin 2, si dhe për fushat e bashkëpunimit të parashikuara në nenin 3 dhe në rast nevoje hartojnë propozime që synojnë përmirësimin e aspekteve praktike dhe teknike të bashkëpunimit midis Palëve Kontraktuese.

2. Shpenzimet për realizimin e bashkëpunimit mbulohen nga secila Palë Kontraktuese, përveç rasteve kur përfaqësuesit kompetentë të Palëve Kontraktuese vendosin ndryshe.

3. Ministrat kompetentë të Palëve Kontraktuese krijojnë një grup vlerësimi, i cili çdo tre vjet u paraqet një raport ministrave.

Rregullimi i mosmarrëveshjeve

Neni 16

Çdo mosmarrëveshje e shkaktuar nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet nga një komision i përzier konsultativ.

Për të lehtësuar zgjidhjen e problemeve që do të dalin nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje, ngrihet një komision i përzier konsultativ i përbërë nga përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Jashtme, asaj të Brendshme, të Rendit Publik dhe të Drejtësisë, që do të mblidhet periodikisht dhe me kërkesën e njërit apo tjetrit shtet.

Dispozita të fundit

Neni 17

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje zbatohen vetëm kur nuk bien ndesh me të drejtën e brendshme.

Mbikëqyrja e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje do të realizohet në përputhje me të drejtën e brendshme të secilës nga Palët Kontraktuese.

Neni 18

Palët Kontraktuese do t'i bëjnë të ditur njëra-tjetrës me shkrim dhe në rrugë diplomatike përmbushjen e formaliteteve kushtetuese të parashikuara për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Marrëveshja do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit të dytë që pason datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim.

Kjo Marrëveshje është përfunduar për një kohëzgjatje të pakufizuar. Secila Palë Kontraktuese mund ta anulojë atë nëpërmjet një njoftimi me shkrim dërguar në rrugë diplomatike Palës tjetër Kontraktuese. Anulimi hyn në fuqi 6 muaj pas datës së dërgimit të këtij njoftimi.

Neni 19

Secila Palë Kontraktuese mund t'i dërgojë Palës tjetër Kontraktuese çdo propozim që synon të modifikojë këtë Marrëveshje. Palët Kontraktuese vendosin me miratim të përbashkët për modifikime në këtë Marrëveshje.

Duke u bazuar sa më sipër, të nënshkruarit, ligjërisht të autorizuar për këtë akt, kanë vendosur firmat e tyre në fund të kësaj Marrëveshjeje.

Bërë në Bruksel, më 22 mars 2005, në dy ekzemplarë origjinalë, secili prej tyre në gjuhët shqip, frëngjisht dhe holandisht, dhe të tre tekstet në secilën gjuhë janë të barasvlefshëm.

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë
Ministri i Rendit
Igli Toska

Për Qeverinë e Mbretërisë së Belgjikës
Ministre e Drejtësisë
Laurette Onkelinx

Ministri i Brendshëm
Patrik Dewael

LIGJ
Nr. 9443, datë 16.11.2005

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN "PËR JURIDIKSIONIN, LIGJIN E ZBATUESHËM, NJOHJEN, ZBATIMIN DHE BASHKËPUNIMIN, NË LIDHJE ME PËRGJEGJËSINË PRINDËRORE DHE MASAT PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën "Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin, në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve", bërë në Hagë më 19 tetor 1996, me rezervat dhe deklarimet e parashikuara në këtë ligj.

Neni 2

Në përputhje me paragrafin e parë të nenit 29 të Konventës, autoriteti qendror për përmbushjen e detyrave të kësaj Konvente është Ministria e Drejtësisë.

Neni 3

Në përputhje me paragrafin e dytë të nenit 34 të Konventës, Republika e Shqipërisë deklaron se kërkesat, sipas paragrafit të parë të këtij neni, do t'u komunikohen autoriteteve të tij vetëm nëpërmjet autoritetit qendror.

Neni 4

Në përputhje me paragrafin e parë të nenit 60 të Konventës, Republika e Shqipërisë rezervon të drejtën e juridiksionit të autoriteteve të veta për të marrë masa për mbrojtjen e pasurisë së fëmijës në territorin e vet, si dhe rezervon të drejtën e mosnjohjes së një përgjegjësie prindërore apo të një mase për sa kohë nuk është në përputhje me ndonjë masë të marrë nga autoritetet e veta, në lidhje me këtë pasuri, siç është parashikuar në paragrafin e parë të nenit 55 të Konventës.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4708, datë 30.11.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.96, faqe 3067

KONVENTA
MBI JURIDIKSIONIN, LIGJIN E ZBATUESHËM, NJOHJEN, ZBATIMIN DHE BASHKËPUNIMIN NË LIDHJE ME PËRGJEGJËSINË PRINDËRORE DHE MASAT PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE

(lidhur më 19 tetor 1996)

Shtetet nënshkruese të kësaj Konvente, duke marrë në konsideratë nevojën për të përmirësuar mbrojtjen e fëmijëve në situatat ndërkombëtare;

duke dëshiruar të shmangin konfliktet midis sistemeve të tyre ligjore në lidhje me juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen dhe zbatimin e masave për mbrojtjen e fëmijëve;

duke pasur parasysh rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar për mbrojtjen e fëmijëve;

duke konfirmuar se interesat e fëmijëve janë të një rëndësie parësore;

duke vërejtur se Konventa e 5 tetorit 1961, në lidhje me kompetencat e autoriteteve dhe ligjin e zbatueshëm për mbrojtjen e minorenëve, ka nevojë për rishikim;

duke dëshiruar të vendosin dispozita të përbashkëta për këtë qëllim, duke marrë në konsideratë Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve të 20 nëntorit 1989,

kanë rënë dakord për dispozitat e mëposhtme:

KAPITULLI I
FUSHA E VEPRIMIT TË KËSAJ KONVENTE

Neni 1

1. Objektivat e kësaj Konvente janë:

a) të përcaktojë shtetin, autoritetet e të cilit kanë juridiksion për të marrë masa në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve ose pasurisë së tyre;

b) të përcaktojë se cili ligj duhet të zbatohet nga këto autoritete në ushtrimin e juridiksionit të tyre;

c) të përcaktojë ligjin e zbatueshëm për përgjegjësinë prindërore;

d) të parashikojë njohjen dhe zbatimin e këtyre masave mbrojtëse në të gjitha Shtetet Kontraktuese;

e) të vendosë bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve të Shteteve Kontraktuese, sipas nevojës, në mënyrë që të përmbushen qëllimet e kësaj Konvente.

2. Për qëllimet e kësaj Konvente, termi "përgjegjësi prindërore" nënkupton autoritetin prindëror ose çdo marrëdhënie të ngjashme të autoritetit që përcakton të drejtat, kompetencat dhe përgjegjësitë e prindërve, kujdestarëve ose përfaqësuesve të tjerë ligjorë në lidhje me fëmijën ose pasurinë e tij.

Neni 2

Kjo Konventë zbatohet për fëmijët nga momenti i lindjes deri në moshën 18 vjeç.

Neni 3

Masat e referuara në nenin 1 do të kenë lidhje, në veçanti, me:

a) dhënien, ushtrimin, përfundimin ose kufizimin e përgjegjësisë prindërore, si dhe delegimin e saj;

b) të drejtat e kujdestarisë, duke përfshirë të drejtat në lidhje me kujdesin për fëmijën dhe, në veçanti, të drejtën për të përcaktuar vendbanimin e fëmijës, si dhe të drejtat e hyrjes, duke përfshirë të drejtën për ta marrë fëmijën për një periudhë të kufizuar kohe, në një vend tjetër nga ai i banesës së përhershme të fëmijës;

c) kujdestarinë dhe institucionet e ngjashme;

d) planifikimin dhe funksionet e çdo personi apo organi që përfaqëson apo ndihmon fëmijën, që është përgjegjës për fëmijën ose pasurinë e tij;

e) vendosjen e fëmijës në një familje kujdestare nën kujdesin institucional, sigurimin e kujdesit kafala apo të një institucioni të ngjashëm;

f) mbikëqyrjen nga një autoritet publik për kujdesin e treguar ndaj fëmijës nga çdo person që ka fëmijën nën përgjegjësinë e vet;

g) administrimin, ruajtjen ose eliminimin e pasurisë së fëmijës.

Neni 4

Kjo Konventë nuk është e zbatueshme për:

a) vendosjen ose kundërshtimin e marrëdhënies prind-fëmijë;

b) vendimet mbi adoptimin, masat përgatitore për adoptim ose anulimin, apo revokimin e adoptimit;

c) emrin dhe mbiemrin e fëmijës;

d) emancipimin;

e) detyrimet për mbajtjen;

f) trustet apo vazhdimin e trashëgimisë;

g) sigurimet shoqërore;

h) masat publike të karakterit të përgjithshëm në çështjet e arsimit ose ato shëndetësore;

i) masat e marra si rezultat i veprave penale të kryera nga fëmijët;

j) vendimet mbi të drejtat e strehimit politik dhe ato mbi emigracionin.

KAPITULLI II
JURIDIKSIONI

Neni 5

1. Autoritetet gjyqësore ose administrative të Shtetit Kontraktues, ku fëmija ka banesën e përhershme, kanë juridiksion për të marrë masa në lidhje me mbrojtjen e fëmijës ose të pronës së tij.

2. Në bazë të nenit 7, në rast ndryshimi të banesës së përhershme të fëmijës në një Shtet tjetër Kontraktues, autoritetet e shtetit të banesës së re kanë juridiksion.

Neni 6

1. Për fëmijët emigrantë dhe fëmijët të cilët, për shkak të problemeve të ndodhura në vendin e tyre, janë zhvendosur në një shtet tjetër, autoritetet e Shtetit Kontraktues në territorin e të cilit ndodhen këta fëmijë si rezultat i zhvendosjes së tyre, kanë juridiksionin e parashikuar në nenin 5 paragrafi 1.

2. Dispozitat e paragrafit të mësipërm zbatohen gjithashtu për fëmijët, banesa e përhershme e të cilëve nuk mund të përcaktohet.

Neni 7

1. Në rast të ndonjë largimi apo mbajtjeje pa të drejtë të fëmijës, autoritetet e Shtetit Kontraktues në të cilin fëmija ka qenë banor i përhershëm, menjëherë para largimit apo mbajtjes, ruajnë juridiksionin e tyre, derisa fëmija të ketë marrë një banesë të përhershme në çdo shtet tjetër:

a) çdo person, institut ose çdo organ tjetër që ka të drejtat e kujdestarisë, ka rënë dakord për largimin apo mbajtjen;

b) fëmija ka banuar në këtë shtet tjetër për një periudhë prej jo më pak se një vit pasi personi, instituti apo organi tjetër që ka të drejtat e kujdestarisë, ka ose duhet të ketë pasur dijeni për vendndodhjen e fëmijës, asnjë kërkesë për kthimin e bërë brenda kësaj periudhe nuk është pezull, dhe fëmija është vendosur në ambientin e ri të tij/të saj.

2. Largimi apo mbajtja e një fëmije konsiderohen të gabuara kur:

a) shkelin të drejtat e kujdestarisë që i jepen një personi, një institucioni apo ndonjë organi tjetër, kolektivisht ose individualisht, sipas ligjit të shtetit në të cilin fëmija ka qenë banor i përhershëm, menjëherë para largimit apo mbajtjes;

b) në kohën e largimit apo mbajtjes, kur këto të drejta ushtroheshin, kolektivisht ose individualisht, ose duhet të ishin ushtruar në këtë mënyrë, me përjashtim të largimit apo mbajtjes.

Të drejtat e kujdestarisë të referuara në nënparagrafin “a” më sipër, mund të lindin veçanërisht përmes funksionimit të ligjit ose për shkak të një vendimi gjyqësor ose administrativ, apo për shkak të një marrëvështjeje që ka efekt ligjor sipas ligjit të këtij shteti.

3. Për sa kohë që autoritetet e përmendura së pari në paragrafin 1 e ruajnë juridiksionin e tyre, autoritetet e Shtetit Kontraktues, tek i cili fëmija është larguar ose në të cilin ai ose ajo është mbajtur, mund të marrin vetëm ato masa urgjente që, sipas nenit 11, janë të nevojshme për mbrojtjen e fëmijës ose pronës së fëmijës.

Neni 8

1. Me anë të përjashtimit, autoriteti i Shtetit Kontraktues që ka juridiksion sipas nenit 5 ose 6, nëse gjykon se autoriteti i një Shteti tjetër Kontraktues do të vendosej më mirë në një rast të veçantë për të vlerësuar interesin më të mirë të fëmijës:

- mund të kërkojë që autoriteti tjetër, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose me ndihmën e autoritetit qendror të shtetit të tij, të marrë juridiksionin për të ndërmarrë këto masa mbrojtëse, si ta gjykojë të nevojshme;

- mund të pezullojë shqyrtimin e çështjes dhe të ftojë palët të paraqesin këtë kërkesë para autoritetit të këtij shteti tjetër.

2. Shtetet Kontraktuese, autoritetet e të cilëve mund të adresohen siç parashikohet në paragrafin e mësipërm, janë:

a) një shtet, shtetas i të cilit është ky fëmijë;

b) një shtet, në të cilin ndodhet pasuria e fëmijës;

c) një shtet, autoritetet e të cilit janë në shqyrtim e sipër të një kërkese për divorc ose ndarje ligjore të prindërve të fëmijës ose për anulimin e martesës së tyre;

d) një shtet, me të cilin fëmija ka lidhje të ngushta.

3. Autoritetet e interesuara mund të procedojnë për një shkëmbim mendimesh.

4. Autoriteti i adresuar, siç parashikohet në paragrafin 1, mund të marrë juridiksionin në vend të autoritetit që ka juridiksion sipas nenit 5 ose 6, nëse e gjykon se kjo është në të mirën e fëmijës.

Neni 9

1. Nëse autoritetet e një Shteti Kontraktues të referuara në nenin 8 paragrafi 2, në rastin e veçantë gjykojnë se janë në pozitë më të mirë për të vlerësuar interesin më të mirë të fëmijës:

- mund t'i kërkojnë autoritetit kompetent të Shtetit Kontraktues të banesës së përhershme të fëmijës, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose me ndihmën e autoritetit qendror të këtij shteti, që të autorizohen për të ushtruar juridiksionin për të marrë masa mbrojtëse, të cilat i gjykojnë të nevojshme;

- mund të ftojnë palët të paraqesin këtë kërkesë para autoritetit të Shtetit Kontraktues të banesës së përhershme të fëmijës.

2. Autoritetet e interesuara mund të procedojnë për një shkëmbim mendimesh.

3. Autoriteti që fillon bërjen e kërkesës mund të ushtrojë juridiksion në vend të Shtetit Kontraktues të banesës së perhershme të fëmijës vetëm nëse ky autoritet e pranon kërkesën.

Neni 10

1. Pa asnjë paragjykim në lidhje me dispozitat e neneve 5-9, autoritetet e një Shteti Kontraktues, që ushtrojnë juridiksionin për të vendosur në lidhje me një kërkesë për divorc ose ndarje ligjore të prindërve të një fëmije që është banor i përhershëm në një Shtet tjetër Kontraktues ose për anulimin e martesës së tyre, nëse e parashikon ligji i shtetit të tyre, mund të marrin masa për mbrojtjen e fëmijës apo të pasurisë së tij, nëse:

a) në kohën e fillimit të procedimit, njëri nga prindërit e tij ose të saj ka pasur banesë të përhershme në këtë shtet dhe njëri prej tyre ka përgjegjësi ligjore në lidhje me fëmijën;

b) juridiksioni i këtyre autoriteteve për të marrë këto masa është pranuar nga prindërit, si dhe nga ndonjë person tjetër i cili ka përgjegjësi prindërore në lidhje me fëmijën dhe kur është në interes të fëmijës.

2. Juridiksioni i parashikuar në paragrafin 1 për të marrë masa për mbrojtjen e fëmijës ndërpritet nëse vendimi për të lejuar ose refuzuar kërkesën për divorc, ndarjen ligjore ose prishjen e martesës ka marrë formë të prerë, ose procedimi ka përfunduar për ndonjë arsye tjetër.

Neni 11

1. Në të gjitha rastet emergjente, autoritetet e ndonjë Shteti Kontraktues, në territorin e të cilit ndodhet fëmija ose prona që i përket fëmijës, ka juridiksion për të marrë masat e nevojshme mbrojtëse.

2. Masat e marra sipas paragrafit të mësipërm, për sa i përket një fëmije që është banor i përhershëm në Shtetin Kontraktues, do të shfuqizohen nëse autoritetet, të cilat kanë juridiksion sipas neneve 5-10, kanë marrë masat që kërkohen sipas rrethanave.

3. Masat e marra sipas paragrafit 1 në lidhje me fëmijën që është banor i përhershëm në një shtet jokontraktues, do të shfuqizohen në secilin Shtet Kontraktues, nëse masat e kërkuara sipas rrethanave dhe ato të marra nga autoritetet e një shteti tjetër njihen në Shtetin Kontraktues në fjalë.

Neni 12

1. Në bazë të nenit 7, autoritetet e një Shteti Kontraktues, në territorin e të cilit ndodhet fëmija ose prona që i përket fëmijës, kanë juridiksion për të marrë masa të një karakteri të përkohshëm për mbrojtjen e fëmijës ose pronës së fëmijës, me efekt territorial të kufizuar në shtetin në fjalë, për sa kohë që këto masa nuk janë në mospërputhje me masat e marra tashmë nga autoritetet të cilat kanë juridiksion sipas neneve 5-10.

2. Masat e marra sipas paragrafit të mësipërm, në lidhje me një fëmijë që është banor i përhershëm në një Shtet Kontraktues, do të shfuqizohen nëse autoritetet të cilat kanë juridiksion sipas neneve 5-10 të kenë marrë një vendim në lidhje me masat mbrojtëse, të cilat mund të kërkohen sipas rrethanave.

3. Masat e marra sipas paragrafit 1, në lidhje me një fëmijë i cili është banor i përhershëm në një shtet jokontraktues, do të shfuqizohen në Shtetin Kontraktues ku janë marë masat, nëse masat e kërkuara nga rrethanat dhe të marra nga autoritetet e një shteti tjetër janë njohur në Shtetin Kontraktues në fjalë.

Neni 13

1. Autoritetet e një Shteti Kontraktues, të cilat kanë juridiksion sipas neneve 5 deri në 10 për të marrë masa për mbrojtjen e fëmijës ose pasurisë së fëmijës, duhet të frenohen nga ushtrimi i këtij juridiksioni, nëse, në kohën e fillimit të procedimit, masat korresponduese janë kërkuar nga autoritetet e një Shteti tjetër Kontraktues që ka juridiksion sipas neneve 5-10 në kohën e kërkesës dhe janë akoma në proces shqyrtimi.

2. Dispozitat e paragrafit të mësipërm nuk do të zbatohen nëse autoritetet, para të cilave është paraqitur fillimisht kërkesa për marrjen e masave, nuk kanë juridiksion.

Neni 14

Masat e marra në zbatim të neneve 5-10 qëndrojnë në fuqi sipas afateve të tyre, edhe nëse një ndryshim rrethanash ka eliminuar bazën mbi të cilat është ngritur juridiksioni, për sa kohë që autoritetet, të cilat kanë juridiksion sipas Konventës, nuk kanë ndryshuar, zëvëndësuar apo përfunduar këto masa.

KAPITULLI III
LIGJI I ZBATUESHËM

Neni 15

1. Në ushtrimin e juridiksionit të tyre, sipas dispozitave të kapitullit II, autoritetet e Shteteve Kontraktuese do të zbatojnë ligjin e tyre.

2. Megjithatë, për sa kohë që mbrojtja e fëmijës ose e pasurisë së fëmijës e kërkon këtë, ato mund të zbatojnë përjashtimisht ose ta marrin në konsideratë ligjin e shtetit tjetër, me të cilin situata ka një lidhje thelbësore.

3. Nëse banesa e përhershme e fëmijës ndryshon në një Shtet tjetër Kontraktues, nga koha e ndryshimit, ligji i këtij shteti tjetër ka epërsi mbi kushtet e zbatimit të masave të marra në shtetin e ish-banesës së përhershme.

Neni 16

1. Dhënia ose shuarja e përgjegjësisë prindërore me anë të funksionimit të ligjit, pa ndërhyrjen e një autoriteti gjyqësor ose administrativ, udhëhiqet nga ligji i shtetit të banesës së përhershme të fëmijës.

2. Dhënia ose shuarja e përgjegjësisë prindërore me anë të një marrëveshjeje ose akti të njëanshëm, pa ndërhyrjen e një autoriteti gjyqësor ose administrativ, udhëhiqet nga ligji i shtetit të banesës së përhershme të fëmijës në kohën kur marrëveshja ose akti i njëanshëm bëhet i vlefshëm.

3. Përgjegjësia prindërore, e cila ekziston sipas ligjit të shtetit të banesës së përhershme të fëmijës, vazhdon të ekzistojë pas një ndryshimi të banesës së përhershme në një shtet tjetër.

4. Nëse banesa e përhershme e fëmijës ndryshon, dhënia e përgjegjësisë prindërore me anë të funksionimit të ligjit të një personi i cili tashmë nuk ka një përgjegjësi të tillë, udhëhiqet nga ligji i shtetit të banesës së tij të re.

Neni 17

Ushtrimi i përgjegjësisë prindërore udhëhiqet nga ligji i shtetit të banesës së përhershme të fëmijës. Nëse banesa e përhershme e fëmijës ndryshon, udhëhiqet nga ligji i shtetit të banesës së re.

Neni 18

Përgjegjësia prindërore e përmendur në nenin 16 mund të përfundojë, ose kushtet e ushtrimit të saj mund të modifikohen, me anë të masave të marra sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni l9

1. Vlefshmëria e një transaksioni midis një pale të tretë dhe një personi tjetër, i cili do të kishte të drejtë të vepronte si përfaqësuesi ligjor i fëmijës sipas ligjit të shtetit ku transaksioni është përfunduar, nuk mund të kundërshtohet dhe pala e tretë nuk mund të jetë përgjegjëse, për arsyen e vetme se personi tjetër nuk ka pasur të drejtë të veprojë si përfaqësues ligjor i fëmijës, sipas ligjit të përcaktuar nga dispozitat e këtij kapitulli, për sa kohë që pala e tretë e di ose duhet ta ketë ditur se përgjegjësia prindërore është udhëhequr nga ky ligj.

2. Paragrafi i mësipërm zbatohet vetëm nëse transaksioni është lidhur midis personave të pranishëm në territorin e të njëjtit shtet.

Neni 20

Dispozitat e këtij kapitulli zbatohen edhe nëse ligji i përcaktuar nga to është ligji i një shteti jokontraktues.

Neni 2l

1. Në këtë kapitull, termi “ligj” nënkupton ligjin në fuqi në shtet, të ndryshëm nga zgjedhja e tij e dispozitave ligjore.

2. Megjithatë, nëse ligji i zbatueshëm sipas nenit 16 është ai i një shteti jokontraktues dhe nëse zgjedhja e dispozitave të ligjit të këtij shteti përcakton ligjin e një shteti tjetër jokontraktues, i cili do zbatonte ligjin e vet, zbatohet ligji i atij shteti. Nëse ky shtet tjetër jokontraktues nuk do të zbatonte ligjin e vet, ligji i zbatueshëm është ai i përcaktuar në nenin 16.

Neni 22

Zbatimi i ligjit të përcaktuar nga dispozitat e këtij kapitulli mund të refuzohet vetëm nëse ky

zbatim do të ishte hapur kundër politikës publike, duke marrë në konsideratë interesin më të mirë të fëmijës.

KAPITULLI IV
NJOHJA DHE ZBATIMI

Neni 23

1. Masat e marra nga autoritetet e një Shteti Kontraktues do të njihen nga funksionimi i ligjit në të gjitha Shtetet e tjera Kontraktuese.

2. Megjithatë, njohja mund të refuzohet:

a) nëse masa është marrë nga një autoritet, juridiksioni i të cilit nuk ishte bazuar në një nga kushtet e parashikuara në kapitullin II;

b) nëse është marrë masa, përveç ndonjë rasti urgjent, në kuptimin e një procedimi gjyqësor ose administrativ, pa iu dhënë mundësia fëmijës të dëgjohet, në shkelje të parimeve themelore të procedurës së shtetit të kërkuar;

c) me kërkesën e ndonjë personi që pretendon se masa e cenon përgjegjësinë prindërore të tij ose të saj, nëse kjo masë është marrë, përveç ndonjë rasti urgjent, pa iu dhënë mundësia personit të dëgjohet;

d) nëse kjo njohje është hapur kundër politikës publike të shtetit të kërkuar, duke marrë në konsideratë interesin më të mirë të fëmijës;

e) nëse masa nuk është në përputhje me një masë të mëvonshme të marrë në shtetin jokontraktues të banesës së përhershme të fëmijës, ku kjo masë e mëvonshme përmbush kërkesat për njohje në shtetin e kërkuar;

f) nëse procedura e parashikuar në nenin 33 nuk ka qenë në përputhje me to.

Neni 24

Pa paragjykuar nenin 23 paragrafi 1, ndonjë person i interesuar mund të kërkojë nga autoritetet kompetente të një Shteti Kontraktues që ato të vendosin në lidhje me njohjen apo mosnjohjen e një mase të marrë në një Shtet tjetër Kontraktues. Procedura udhëhiqet nga ligji i shtetit të kërkuar.

Neni 25

Autoriteti i shtetit të kërkuar është i detyruar t'i bindet vendimeve në themel, mbi të cilat ka bazuar juridiksionin e tij autoriteti i shtetit ku është marrë masa.

Neni 26

1. Nëse masat e marra në një Shtet Kontraktues dhe të zbatueshme kërkojnë zbatim në një Shtet tjetër Kontraktues, ato do të deklarohen të zbatueshme ose të regjistruara për qëllim zbatimi në këtë shtet tjetër, sipas procedurës së parashikuar në ligjin e këtij shteti, me anë të kërkesës së një pale të interesuar.

2. Çdo Shtet Kontraktues do të zbatojë deklaratën e zbatueshmërisë ose të regjistrimit në një procedurë të thjeshtë dhe të shpejtë.

3. Deklarata e zbatueshmërisë ose e regjistrimit mund të refuzohet vetëm për një nga arsyet e parashtruara në nenin 23 paragrafi 2.

Neni 27

Pa paragjykuar këtë rishikim, siç është i nevojshëm në zbatim të neneve të mësipërme, nuk do të ketë rishikim në themel të masave të marra.

Neni 28

Masat e marra në një Shtet Kontraktues dhe të deklaruara të zbatueshme ose të regjistruara për qëllim zbatimi në një Shtet tjetër Kontraktues, do të zbatohen në këtë shtet, sikur të ishin marrë nga autoritetet e këtij shteti. Zbatimi zhvillohet në përputhje me ligjin e shtetit të kërkuar në masën e parashikuar nga ky ligj, duke marrë në konsideratë interesin më të mirë të fëmijës.

KAPITULLI V
BASHKËPUNIMI

Neni 29

1. Një Shtet Kontraktues do të caktojë një autoritet qendror për të kryer detyrat, të cilat janë vënë nga kjo Konventë për këto autoritete.

2. Shtetet federale, shtetet me më shumë se një sistem ligjor ose shtetet që kanë njësi autonome territoriale do të jenë të lira të caktojnë më shumë se një autoritet qendror dhe të përcaktojë masën territoriale ose personale të funksioneve të tyre. Kur një shtet ka caktuar më shumë se një autoritet qendror, ai do të caktojë autoritetin qendror tek i cili mund të paraqitet ndonjë komunikim për transmetim tek autoriteti qendror përkatës brenda këtij shteti.

Neni 30

1. Autoritetet qendrore do të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe do të nxisin bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve kompetente në shtetet e tyre, për të përmbushur qëllimet e Konventës.

2. Ata, në lidhje me zbatimin e Konventës, do të marrin hapat e duhur për të siguruar informacion, sipas ligjeve dhe shërbimeve në dispozicion, në shtetet e tyre, në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve.

Neni 3l

Autoriteti Qendror i një Shteti Kontraktues ose në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose nëpërmjet autoriteteve publike apo organeve të tyre, duhet të marrin të gjithë hapat e nevojshëm:

a) për të lehtësuar komunikimin dhe ofruar ndihmën e parashikuar në nenet 8 dhe 9 dhe në këtë kapitull;

b) për të lehtësuar, me anë të ndërmjetësimit, pajtimit ose instrumenteve të tjera të ngjashme, zgjidhjet e miratuara për mbrojtjen e fëmijës ose pasurisë së fëmijës në situatat në të cilat zbatohet Konventa;

c) me kërkesën e një autoriteti kompetent të një Shteti tjetër Kontraktues, të sigurojë asistencë për zbulimin e vendndodhjes, ku ka të ngjarë të jetë fëmija dhe për nevojën e mbrojtjes brenda territorit të shtetit të kërkuar.

Neni 32

Përmes një kërkese të bërë me arsye të argumentuara përkatëse nga autoriteti qendror ose çdo autoritet tjetër kompetent i çdo Shteti Kontraktues, me të cilin fëmija ka lidhje të ngushtë, autoriteti qendror i Shtetit Kontraktues, në të cilin fëmija është banor i përhershëm dhe i pranishëm, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose me anë të autoriteteve publike apo organeve të tjera:

a) mund të bëjë një raport në lidhje me situatën e fëmijës;

b) mund t'i kërkojë autoritetit kompetent të shtetit të tij të marrë në konsideratë nevojën për të marrë masa për mbrojtjen e fëmijës ose pasurisë së fëmijës.

Neni 33

1. Nëse një autoritet që ka juridiksionin sipas neneve 5-10 e shqyrton me hollësi çështjen e vendosjes së fëmijës në një familje kujdestare ose nën kujdes institucional, apo në sigurimin e kujdesit *kafala* ose një institucioni të ngjashëm dhe nëse kjo vendosje ose sigurim kujdesi zhvillohet në një Shtet tjetër Kontraktues, së pari do të konsultohet me autoritetin qendror ose çdo autoritet tjetër kompetent të këtij shteti. Për këtë qëllim, ai do të dërgojë një raport për fëmijën, së bashku me arsyet për vendosjen e propozuar ose sigurimin e kujdesit.

2. Vendimi në lidhje me vendosjen ose sigurimin e kujdesit mund të merret në shtetin kërkues vetëm nëse autoriteti qendror ose autoriteti tjetër kompetent i shtetit të kërkuar ka miratuar vendosjen ose sigurimin e kujdesit, duke marrë në konsideratë interesat e fëmijës.

Neni 34

1. Kur reflektohet në lidhje me një masë mbrojtëse, nëse e kërkon situata e fëmijës, autoritetet kompetente sipas Konventës mund t'i kërkojnë çdo autoriteti ose ndonjë Shteti tjetër Kontrakutes, i cili ka informacion mbi mbrojtjen e fëmijës, komunikimin e këtij informacioni.

2. Një Shtet Kontraktues mund të deklarojë se kërkesat sipas paragrafit 1 do t'i komunikohen autoriteteve të tij vetëm nëpërmjet autoritetit qendror të tij.

Neni 35

1. Autoritetet kompetente të një Shteti Kontraktues mund t'i kërkojnë autoriteteve të një Shteti tjetër Kontraktues të ndihmojnë në zbatimin e masave të mbrojtjes marrë sipas kësaj Konvente, veçanërisht në sigurimin e ushtrimit efektiv të të drejtave të hyrjes, si dhe të drejtën për të marrë kontakte të drejtpërdrejta dhe të rregullta.

2. Autoritetet e një Shteti Kontraktues, në të cilin fëmija nuk ka banesën e përhershme, me kërkesën e prindit që banon në atë shtet, i cili kërkon të krijojë apo mbajë lidhje me fëmijën, mund të mbledhin informacion ose të dhëna dhe të nxjerrin një përfundim mbi përshtatshmërinë e këtij prindi për të ushtruar të drejtat dhe mbi kushtet sipas të cilave duhet të ushtrohen këto të drejta. Një autoritet që ushtron juridiksionin, sipas neneve 5 deri në 10, për të përcaktuar një kërkesë në lidhje me të drejtat mbi fëmijën, duhet të deklarojë dhe ta marrë në konsideratë këtë informacion, këto fakte dhe këtë përfundim para se të marrë vendimin e saj.

3. Një autoritet që ka juridiksion, sipas neneve 5 deri në 10 për të vendosur mbi të drejtat, mund të shtyjë një procedim duke pezulluar rezultatin e një kërkese të bërë sipas paragrafit 2, në veçanti, kur po merr në konsideratë një kërkesë për të kufizuar apo për t'i dhënë fund të drejtave të hyrjes të dhëna në shtetin e banesës së mëparshme të përhershme të fëmijës.

4. Asgjë në këtë nen nuk do ta ndalojë një autoritet që ka juridiksion, sipas neneve 5- 10, të marrë masa të përkohshme duke pezulluar rezultatin e kërkesës së bërë sipas paragrafit 2.

Neni 36

Në rast se fëmija është i ekspozuar ndaj një rreziku serioz, autoritetet kompetente të Shtetit Kontraktues, ku janë marrë masat për mbrojtjen e fëmijës ose janë në shqyrtim, nëse informohen se vendbanimi i fëmijës ka ndryshuar ose se fëmija ndodhet në një shtet tjetër, do të informojnë autoritetet e shtetit tjetër mbi rrezikun dhe masat e marra apo ato nën shqyrtim.

Neni 37

Një autoritet nuk do të kërkojë apo transmetojë ndonjë informacion sipas këtij kapitulli, nëse për këtë do t'i duhej, sipas gjykimit të saj, ta vinte fëmijën apo pasurinë e tij në rrezik apo të përbënte një kërcënim serioz të lirisë apo jetës së një anëtari të familjes së fëmijës.

Neni 38

1. Pa paragjykuar mundësinë e vënies së tarifave të arsyeshme për sigurimin e shërbimeve, autoritetet qendrore dhe autoritetet e tjera publike të Shteteve Kontraktuese do të përballojnë shpenzimet e tyre në zbatimin e dispozitave të këtij kapitulli.

2. Një Shtet Kontraktues mund të hyjë në marrëveshje me një ose me shumë Shtete të tjera Kontraktuese në lidhje me ndarjen e përgjegjësive.

Neni 39

Çdo Shtet Kontraktues mund të hyjë në marrëveshje me një ose më shumë Shtete Kontraktuese, më qëllim përmirësimin e zbatimit të këtij kapitulli në marrëdhëniet e tyre reciproke. Shtetet të cilat kanë lidhur këtë marrëveshje, do t'i japin një kopje depozitarit të Konventës.

KAPITULLI VI
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 40

1. Autoritetet e Shtetit Kontraktues të banesës së përhershme të fëmijës ose të Shtetit Kontraktues ku është marrë masa e mbrojtjes, mund t'i japin personit që ka përgjegjësi prindërore ose personit të cilit i është besuar mbrojtja e fëmijës dhe e pasurisë së tij, një certifikatë, me kërkesën e tij apo të saj, që tregon cilësinë në të cilën ky person është i autorizuar të veprojë dhe kompetencat që i jepen atij apo asaj.

2. Cilësia dhe kompetencat e specifikuara në certifikatë supozohen t'i jepen këtij personi në mungesë të provës për rastin e kundërt.

3. Çdo Shtet Kontraktues do të caktojë autoritetet kompetente të bëjnë certifikatën.

Neni 41

Të dhënat personale të mbledhura ose të transmetuara sipas Konventës, do të përdoren vetëm për qëllimet për të cilat ato janë mbledhur apo transmetuar.

Neni 42

Autoritetet te të cilat transmetohet informacioni do të sigurojnë konfidencialitet, në përputhje me ligjin e shtetit të tyre.

Neni 43

Të gjitha dokumentet e paraqitura apo të dorëzuara sipas kësaj Konvente do të përjashtohen nga legalizimi apo ndonjë formalitet i ngjashëm.

Neni 44

Çdo Shtet Kontraktues mund të caktojë autoritetet te të cilat paraqiten kërkesat sipas neneve 8, 9 dhe 33.

Neni 45

1. Përcaktimet e përmendura në nenet 29 dhe 44 do t'i komunikohen Zyrës së Përhershme të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private.

2. Deklaratat e përmendura në nenin 34 paragrafi 2 do t'i bëhen depozitarit të Konventës.

Neni 46

Një Shtet Kontraktues, në të cilin sisteme të ndryshme ligjore ose kuadri ligjor zbatojnë mbrojtjen e fëmijës dhe të pasurisë së tij/saj, nuk do të jenë të detyruara të zbatojnë dispozitat e Konventës vetëm për konflikte midis këtyre sistemeve të ndryshme ose kuadrit ligjor.

Neni 47

Për sa i përket një shteti, në të cilin dy ose më shumë sisteme ligjore apo kuadër ligjor në lidhje me ndonjë çështje të trajtuar në këtë Konventë, zbatohen në njësi të ndryshme territoriale:

1. çdo refererim për banesën e përhershme në këtë shtet do të interpretohet si referim për banesën e përhershme në një njësi territoriale;

2. çdo referim për praninë e fëmijës në këtë shtet do të interpretohet si referim për praninë në një njësi territoriale;

3. çdo referim për vendndodhjen e pasurisë së fëmijës në këtë shtet do të interpretohet si referim për vendndodhjen e pasurisë së fëmijës në një njësi territoriale;

4. çdo referim për shtetin nga i cili është fëmija do të interpretohet si referim ndaj njësisë territoriale të caktuar me ligjin e këtij shteti ose në mungesë të rregullave përkatëse, të njësive territoriale me të cilat fëmija ka pasur lidhje më të ngushtë;

5. çdo referim ndaj shtetit, autoritetet e të cilit janë në shqyrtim e sipër të një kërkese për divorc ose ndarje ligjore të prindërve të fëmijës ose për anulimin e martesës së tyre, do të interpretohet si referim ndaj njësisë territoriale, autoritetet e të cilit janë në shqyrtim e sipër të kësaj kërkese;

6. çdo referim ndaj shtetit me të cilin fëmija ka një lidhje thelbësore, do të interpretohet si referim ndaj njësisë territoriale me të cilën fëmija ka këtë lidhje;

7. çdo referim ndaj shtetit tek i cili fëmija është larguar apo në të cilin ai apo ajo është mbajtur, do të interpretohet si referim ndaj njësisë territoriale përkatëse tek e cila fëmija është larguar apo në të cilën ai apo ajo është mbajtur;

8. çdo referim ndaj organeve ose autoriteteve të këtij shteti, të tjera nga autoritetet qendrore, do të interpretohet si referim ndaj atyre të autorizuara për të vepruar në njësinë territoriale përkatëse;

9. çdo referim ndaj ligjit ose procedurës, ose autoritetit të shtetit në të cilin është marrë një masë, do të interpretohet si referim ndaj ligjit ose procedurës, ose autoritetit të njësisë territoriale në të cilën është marrë kjo masë;

10. çdo referim ndaj ligjit ose procedurës, apo autoritetit të shtetit të kërkuar, do të interpretohet si referim ndaj ligjit ose procedurës, apo autoritetit të njësisë territoriale në të cilën është kërkuar njohja apo zbatimi.

Neni 48

Për qëllime të identifikimit të ligjit të zbatueshëm sipas kapitullit III, në lidhje me një shtet i cili përfshin dy ose më shumë njësi territoriale, secila prej tyre ka sistemin e vet ligjor apo kuadrin ligjor, në lidhje me çështjet e mbuluara nga kjo Konventë, zbatohen rregullat e mëposhtme:

a) nëse ka rregulla në fuqi në këtë shtet, duke identifikuar se cili ligj i njësisë territoriale është i zbatueshëm, zbatohet ligji i kësaj njësie;

b) në mungesë të këtyre rregullave, zbatohet ligji i njësisë territoriale përkatëse, siç përcaktohet në nenin 47.

Neni 49

Për qëllim të identifikimit të ligjit të zbatueshëm sipas kapitullit III, në lidhje me një shtet i cili ka dy ose më shumë sisteme ligjore apo kuadër ligjor të ligjit të zbatueshëm për kategori të ndryshme personash në lidhje me çështjet e mbuluara nga kjo Konventë, do të zbatohen rregullat e mëposhtme:

a) nëse ka rregulla në fuqi në këtë shtet, duke identifikuar se cili nga këto ligje zbatohet, do të zbatohet ky ligj;

b) në mungesë të këtyre rregullave, zbatohet ligji i sistemit ose kuadri ligjor, me të cilat fëmija ka lidhje më të afërt.

Neni 50

Kjo Konventë nuk do të cenojë zbatimin e Konventës së 25 tetorit 1980 mbi aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës si midis palëve në të dyja konventat. Megjithatë, asgjë nuk përjashton dispozitat e kësaj Konvente nga nxitja për qëllime të sigurimit të kthimit të fëmijës, i cili është larguar apo mbajtur pa të drejtë ose nga organizimi i të drejtave të hyrjes.

Neni 51

Për sa i përket Shteteve Kontraktuese, kjo Konventë zëvendëson Konventën e 5 tetorit të vitit 1961 mbi pushtetet e autoriteteve dhe të ligjit të zbatueshëm në lidhje me mbrojtjen e të miturve dhe Konventën që mbulon kujdestarinë e të miturve, nënshkruar në Hagë në 12 qershor 1902, pa paragjykim, për njohjen e masave të marra sipas Konventës së 5 tetorit 196, të përmendur më sipër.

Neni 52

1. Kjo Konventë nuk do të cenojë ndonjë instrument ndërkombëtar me të cilin Shtetet Kontraktuese janë palë dhe që përmbajnë dispozita në lidhje me çështjet e trajtuara nga Konventa, për sa kohë që është bërë një deklaratë tjetër nga Shtetet Palë në këtë instrument.

2. Kjo Konventë nuk cenon mundësinë për një apo më shumë Shtete Kontraktuese për të lidhur marrëveshje që përmbajnë dispozita mbi çështjet e trajtuara nga kjo Konventë, në lidhje me fëmijët që kanë banesë të përhershme në një nga Shtetet Palë në këto marrëveshje.

3. Marrëveshjet për t'u lidhur nga një apo më shumë Shtete Kontraktuese mbi çështje brenda fushës së veprimit të kësaj Konvente, nuk cenojnë zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente, në marrëdhëniet e këtyre shteteve me Shtete të tjera Kontraktuese.

4. Paragrafi i mësipërm zbatohet midis shteteve të interesuara edhe për ligjet uniformë të bazuara në lidhje të veçanta të natyrës rajonale apo të një natyre tjetër.

Neni 53

1. Kjo Konventë do të zbatojë masa vetëm nëse ato merren në një shtet pasi Konventa ka hyrë në fuqi për atë shtet.

2. Konventa do të zbatohet për njohjen dhe zbatimin e masave të marra pas hyrjes së saj në fuqi midis shtetit ku janë marrë masat dhe shtetit të kërkuar.

Neni 54

1. Ndonjë komunikim i dërguar autoritetit qendror apo ndonjë autoriteti tjetër të një Shteti Kontraktues do të jetë në gjuhën origjinale dhe do të shoqërohet me një përkthim në gjuhën zyrtare ose në një nga gjuhët zyrtare të shtetit tjetër, ose, kur kjo nuk është e mundur, do të sigurohet një përkthim në gjuhën frenge ose angleze.

2. Megjithatë, një Shtet Kontraktues, duke bërë një rezervë në përputhje me nenin 60, mund të kundërshtojë përdorimin e gjuhës frënge ose angleze, por jo të të dyja gjuhëve.

Neni 55

1. Në përputhje me nenin 60, një Shtet Kontraktues:

a) mund të rezervojë juridiksionin e autoriteteve të saj për të marrë masa mbi mbrojtjen e pasurisë së fëmijës të ndodhur në territorin e saj;

b) mund të rezervojë të drejtën e mosnjohjes së një përgjegjësie prindërore apo mase për sa kohë që nuk është në pëputhje me ndonjë masë të marrë nga autoritetet e saj në lidhje me këtë pasuri.

2. Rezerva mund të kufizohet për kategori të caktuara të pasurisë.

Neni 56

Sekretari i Përgjithshëm i Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private do të mbledhë rregullisht një komision special, me qëllim rishikimin e funksionimit praktik të Konventës.

KAPITULLI VII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 57

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim për shtetet e përfaqësuara në sesionin e tetëmbëdhjetë të Konferencës së Hagës mbi të drejtën ndërkombëtare private.

2. Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit dhe instrumentet përkatëse të ratifikimit, pranimit ose miratimit depozitohen pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës, që ka funksionin e depozitarit të kësaj Konvente.

Neni 58

1. Çdo Shtet tjetër mund të aderojë në këtë Konventë pas hyrjes në fuqi të saj në përputhje me nenin 61 paragrafi i parë.

2. Instrumenti i aderimit depozitohet pranë depozitarit të kësaj Konvente.

3. Ky aderim do të ketë efekt vetëm në lidhje me marrëdhëniet midis shtetit aderues dhe shteteve palë, të cilët nuk kanë paraqitur kundërshtim për këtë aderim brenda gjashtë muajve nga marrja e njoftimit, parashikuar nga neni 63 pika b. Një kundërshtim i tillë mund të bëhet prej shteteve palë gjatë ratifikimit, pranimit ose miratimit të kësaj Konvente pas një aderimi. Për çdo kundërshtim do të njoftohet depozitari.

Neni 59

1. Nëse një shtet ka dy ose më shumë njësi territoriale në të cilat zbatohen sisteme të ndryshme ligjore në lidhje me çështjet e trajtuara në këtë Konventë, ai mund të deklarojë në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, miratimit ose aderimit, se Konventa do të shtrihet në të gjitha njësitë territoriale ose vetëm në një ose më shumë prej tyre. Ky shtet mund ta modifikojë këtë deklaratë duke dorëzuar një deklaratë tjetër në çdo kohë.

2. Çdo deklaratë e tillë do t'i njoftohet depozitarit duke deklaruar shprehimisht njësitë territoriale në të cilat zbatohet kjo Konventë.

3. Nëse një shtet nuk bën asnjë deklaratë të tillë në përputhje me këte nen, kjo Konventë do të shtrihet në të gjitha njësitë territoriale të këtij shteti.

Neni 60

1. Çdo shtet, në çastin e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në këtë Konventë, ose në kohën e paraqitjes se një deklarate në lidhje me nenin 59, mund të paraqesë një ose të dyja rezervat e parashikuara në nenin 54 paragrafi i dytë dhe nenin 55. Asnjë rezervë tjetër nuk mund të bëhet.

2. Çdo shtet palë në çdo kohë mund ta tërheqë këtë rezervë me një njoftim të drejtuar depozitarit.

3. Rezerva e humbet fuqinë dy muaj pas datës së dërgimit të njoftimit të referuar në paragrafin mësipërm.

Neni 61

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit, të pranimit ose të miratimit referuar në nenin 57.

2. Më pas ajo do të hyjë në fuqi:

a) për çdo shtet tjetër palë në proces ratifikimi, pranimi ose miratimi, tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, të pranimit, të miratimit, ose të aderimit;

b) për çdo shtet aderues, tre muaj pas përfundimit të periudhës gjashtëmujore parashikuar në paragrafin e tretë të nenit 58;

c) për një territor në të cilin Konventa është shtrirë në përputhje me nenin 59 tre muaj pas njoftimit të referuar në të njëjtin nen.

Neni 62

1. Çdo shtet palë në Konventë mund ta denoncojë atë përmes një njoftimi me shkrim të dërguar depozitarit. Ai mund të kufizohet për disa territore në të cilat zbatohet Konventa.

2. Denoncimi bëhet i efektshëm dymbëdhjetë muaj pas marrjes së njoftimit të denoncimit prej depozitarit. Në rast se hyrja në fuqi e denoncimit kërkon një periudhë më të gjatë kohe sipas specifikimit të bërë në njoftim, denoncimi bëhet i efektshëm pas përfundimit të kësaj periudhe.

Neni 63

Depozitari i njofton shtetet palë të Konferencës së Hagës mbi të drejtën ndërkombëtare private, si dhe shteteve që kanë aderuar në përputhje me nenin 58, sa më poshtë:

a) nënshkrimet, ratifikimet, pranimet dhe miratimet e parashikuara në nenin 57;

b) aderimet dhe kundërshtimet përkatëse të parashikuara në nenin 58;

c) datën në të cilën kjo Konventë hyn në fuqi në përputhje me nenin 61;

d) deklarimet e parashikuara në nenin 34 paragrafi i dytë dhe nenin 59;

e) marrëveshjet e parashikuara në nenin 39;

f) rezervat e parashikuara në nenin 54 paragrafi i dytë dhe nenin 55, si dhe tërheqjet e tyre të parashikuara në nenin 60 paragrafi i dytë;

g) denoncimet i referohen nenit 62.

Në dëshmi të kësaj, personat e autorizuar posaçërisht nënshkruajnë këtë Konventë.

Bërë në Hagë, më 19 tetor 1996, në frëngjisht dhe anglisht, të dyja tekstet njëlloj të vlefshme, në një kopje të vetme, e cila do të depozitohet në arkivat e Qeverisë holandeze, e cila, nëpërmjet kanaleve diplomatike, i dërgon një kopje të vërtetuar çdo shteti të përfaqësuar në sesionin e tetëmbëdhjetë të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën ndërkombëtare private.

LIGJ
Nr. 9446, datë 24.11.2005

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN, "PËR ASPEKTET CIVILE TË RRËMBIMIT NDËRKOMBËTAR TË FËMIJËS"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën "Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës", bërë në Hagë më 25 tetor 1980, me rezervën e parashikuar në këtë ligj.

Neni 2

Në përputhje me paragrafin e parë të nenit 6 të Konventës, autoriteti qendror për përmbushjen e detyrave të kësaj Konvente është Ministria e Drejtësisë.

Neni 3

Në përputhje me nenin 42 të Konventës, Republika e Shqipërisë rezervon të drejtën të mos jetë e detyruar të marrë përsipër ndonjë kosto, që parashikohet në paragrafin e tretë të nenit 26 të Konventës, si rezultat i pjesëmarrjes së konsulentit apo konsulentëve ligjorë ose nga procesi gjyqësor, vetëm deri në atë shkallë, që këto kosto mund të mbulohen nga sistemi i asistencës apo konsulencës ligjore.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4716, datë 8.12.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.97, faqe 3096

KONVENTA
PËR ASPEKTET CIVILE TË RRËMBIMIT NDËRKOMBËTAR TË FËMIJËS
(lidhur në 25 tetor 1980)

Vendet nënshkruese të kësaj Konvente,

tërësisht të bindura se interesat e fëmijëve janë të një rëndësie të veçantë në çështjet që lidhen me kujdestarinë e tyre,

duke dëshiruar mbrojtjen ndërkombëtare të fëmijëve nga pasojat e dëmshme të largimit ose mbajtjes së tyre të padrejtë dhe për të krijuar procedura që sigurojnë kthimin e tyre të menjëhershëm në shtetin e banesës së tyre të përhershme, si dhe për të siguruar mbrojtje për të drejtat e kontaktit,

kanë vendosur të lidhin një Konventë për këtë qëllim dhe kanë rënë dakord për dispozitat e mëposhtme.

KAPITULLI I
FUSHA E VEPRIMIT TË KONVENTËS

Neni 1

Qëllimet e kësaj Konvente janë:

a) të sigurojë kthimin e shpejtë të fëmijëve që largohen apo mbahen pa të drejtë në Shtetin Kontraktues;

b) të sigurojë që të drejtat e kujdestarisë dhe të kontaktit sipas ligjit të një Shteti Kontraktues të respektohen efektivisht në Shtetet e tjera Kontraktuese.

Neni 2

Shtetet Kontraktuese duhet të marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar brenda territoreve të tyre përmbushjen e qëllimeve të Konventës. Për këtë qëllim, ato duhet të përdorin procedurat më të shpejta të mundshme.

Neni 3

Largimi ose mbajtja e një fëmije konsiderohet i padrejtë në rastet kur:

a) konsiston në shkeljen e të drejtave të kujdestarisë dhënë një personi, një institucioni apo organi tjetër, qoftë kolektivisht apo individualisht, sipas ligjit të shtetit në të cilin fëmija ka qenë banor i përhershëm para largimit apo mbajtjes;

b) në kohën e largimit apo mbajtjes këto të drejta janë ushtruar, qoftë kolektivisht apo individualisht, ose që mund të kenë qenë ushtruar me përjashtim të largimit apo mbajtjes.

Të drejtat e kujdestarisë, të përmendura në nënparagrafin (a) më sipër, mund të lindin veçanërisht nga funksionimi i ligjit ose për shkak të një vendimi gjyqësor apo administrativ ose për shkak të një marrëveshjeje që ka efekt ligjor sipas ligjit të shtetit.

Neni 4

Konventa do të zbatohet për çdo fëmijë që ka qenë banor i përhershëm i Shtetit Kontraktues menjëherë para rastit të ndonjë shkeljeje kujdestarie apo të të drejtave të kontaktit. Konventa do të pushojë së zbatuari kur fëmija arrin moshën 16 vjeç.

Neni 5

Për qëllime të kësaj Konvente:

a) “të drejtat e kujdestarisë” do të përfshijnë të drejtat që lidhen me kujdesin e fëmijës dhe në veçanti, e drejta për të përcaktuar vendbanimin e fëmijës;

b) “të drejtat e hyrjes” do të përfshijnë të drejtën për ta marrë fëmijën për një periudhë të kufizuar në një vend tjetër nga vendbanimi i tij i përhershëm.

KAPITULLI II
AUTORITETET QENDRORE

Neni 6

Një Shtet Kontraktues do të autorizojë një autoritet qendror të përmbushë detyrat që Konventa u ka dhënë këtyre autoriteteve.

Shtetet federale, shtetet me më shumë se një sistem ligjor ose shtetet që kanë organizime territoriale autonome, do të jenë të lira të caktojnë më shumë se një autoritet qendror dhe të përcaktojnë shtrirjen territoriale të kompetencave të tyre.

Kur shteti ka caktuar më shumë se një autoritet qendror, do të autorizojë autoritetin qendror, tek i cili mund të dërgohen aplikimet për t'u përcjellë tek autoriteti i duhur qendror brenda këtij shteti.

Neni 7

Autoritetet qendrore do të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe do të nxisin bashkëpunimin midis autoriteteve kompetente në shtetin e tyre përkatës, për të siguruar kthimin e shpejtë të fëmijëve dhe për të arritur objektivat e tjera të kësaj marrëveshjeje.

Në veçanti, qoftë në mënyrë direkte apo me anë të një ndërmjetësi, do të marrin të gjitha masat e duhura:

a) për të zbuluar vendndodhjen e një fëmije, i cili është larguar apo mbajtur pa të drejtë;

b) për të parandaluar dëmtimin e mëtejshëm ndaj fëmijës ose paragjykimin te palët e interesuara duke marrë ose bërë që të merren masa të përkohshme;

c) për të siguruar kthimin e vullnetshëm të fëmijës ose për të arritur një zgjidhje paqësore të çështjeve;

d) për të shkëmbyer, aty ku duhet, informacion në lidhje me *bekgraundin* social të fëmijës;

e) për të siguruar informacion të karakterit të përgjithshëm sipas ligjit të shtetit të tyre, në lidhje me zbatimin e Konventës;

f) për të filluar apo lehtësuar procedimin gjyqësor ose administrativ, me qëllim kthimin e fëmijës dhe në rastin e duhur, të bëjnë përgatitje për organizimin ose sigurimin e ushtrimit efektiv të të drejtave të kontaktit;

g) siç e kërkojnë rrethanat, të sigurojnë ose lehtësojnë sigurimin e konsulencës dhe asistencës ligjore, duke përfshirë pjesëmarrjen e konsulentëve ligjorë;

h) të marrin masat e nevojshme administrative, për të siguruar kthimin e sigurt të fëmijës;

i) të informojnë njëri-tjetrin në lidhje me funksionimin e kësaj Konvente dhe sa të jetë e mundur, të eliminojnë pengesat ndaj zbatimit të saj.

KAPITULLI III
KTHIMI I FËMIJËVE

Neni 8

Çdo person, institucion apo organ tjetër që pretendon se një fëmijë është larguar apo mbajtur në shkelje të të drejtave të kujdestarisë, mund t'i drejtohet autoritetit qendror të vendbanimit të përhershëm të fëmijës ose autoritetit qendror të ndonjë Shteti tjetër Kontraktues për asistencë në sigurimin e kthimit të fëmijës.

Aplikimi do të përmbajë:

a) informacion në lidhje me identitetin e aplikantit, të fëmijës dhe të personit që pretendon se ka larguar apo mbajtur fëmijën;

b) kur kërkohet, data e lindjes së fëmijës;

c) shkaqet mbi të cilat bazohet pretendimi i aplikantit për kthimin e fëmijës;

d) një informacion të nevojshëm në lidhje me vendndodhjen e fëmijës dhe identitetin e personit me të cilin supozohet të jetë fëmija.

Aplikimi duhet të shoqërohet ose shtohet nga:

e) një kopje e vërtetuar e ndonjë vendimi apo marrëveshjeje përkatëse;

f) një certifikatë apo aktbetim që vjen nga autoriteti qendror ose ndonjë autoritet tjetër kompetent i shtetit të vendbanimit të përhershëm të fëmijës ose nga një person i kualifikuar, në lidhje me ligjin përkatës të këtij shteti;

g) çdo dokument tjetër në interes të çështjes.

Neni 9

Nëse autoriteti qendror, i cili merr aplikimin e parashikuar në nenin 8, ka arsye të besojë se fëmija është në një Shtet tjetër Kontraktues, do t'ia transmetojë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe pa vonesë aplikimin autoritetit qendror të këtij Shteti Kontraktues dhe do të informojë autoritetin qendror kërkues ose aplikantin, në vartësi të çështjes.

Neni 10

Autoriteti qendror i shtetit ku është fëmija do të marrë apo do të nxisë marrjen e masave të nevojshme, me qëllim sigurimin e kthimit të vullnetshëm të fëmijës.

Neni 11

Autoritetet gjyqësore apo administrative të Shteteve Kontraktuese do të shpejtojnë procedurat për kthimin e fëmijëve.

Nëse autoriteti përkatës administrativ apo gjyqësor nuk ka arritur një vendim brenda një periudhe gjashtë javore nga data e fillimit të procedimit, aplikanti ose autoriteti qendror i shtetit të kërkuar, me iniciativën e vet ose nëse i kërkohet nga autoriteti qendror i shtetit kërkues, do të ketë të drejtën të kërkojë një deklaratë për shkaqet e vonesës. Nëse merret një përgjigje nga autoriteti qendror i shtetit të kërkuar, ky autoritet do t'ia transmetojë, sipas rastit, përgjigjen autoritetit qendror të shtetit kërkues ose aplikantit.

Neni 12

Kur fëmija është larguar apo mbahet padrejtësisht, siç është parashikuar në nenin 3, dhe kur në datën e fillimit të procedimit para autoritetit gjyqësor apo administrativ të Shtetit Kontraktues ku është fëmija ka kaluar më pak se një vit nga data e largimit apo mbajtjes së padrejtë, autoriteti i interesuar do të urdhërojë kthimin e menjëhershëm të fëmijës.

Edhe kur procedimet kanë filluar pas mbarimit të periudhës së një viti, siç referohet në paragrafin e mësipërm, autoriteti gjyqësor apo administrativ do të urdhërojë kthimin e fëmijës, për sa kohë që nuk është provuar se fëmija tashmë është vendosur në një mjedis të ri të tij.

Nëse autoriteti gjyqësor apo administrativ në shtetin e kërkuar ka arsye të besojë se fëmija është çuar në një shtet tjetër, mund të shtyjë procedimet ose të pushojë aplikimin për kthimin e fëmijës.

Neni 13

Pavarësisht nga dispozitat e nenit të mësipërm, autoriteti gjyqësor apo administrativ i shtetit të kërkuar nuk është i detyruar të urdhërojë kthimin e fëmijës, nëse personi, institucioni apo organi tjetër që e kundërshton kthimin ose mbajtjen e tij, vendos që:

a) personi, institucioni apo organi tjetër që kujdeset për fëmijën nuk po ushtronin të drejtat e kujdestarisë në kohën e largimit apo mbajtjes ose kanë rënë dakord, ose si rrjedhojë të kenë pranuar në heshtje largimin apo mbajtjen;

b) ekziston rrezik serioz që kthimi i tij ose i saj ta ekspozojë fëmijën ndaj dëmit fizik ose psikologjik ose ta vërë fëmijën para një situate të patolerueshme.

Autoriteti gjyqësor ose administrativ mund të refuzojë të urdhërojë kthimin e fëmijës, nëse zbulon se fëmija kundërshton të kthehet dhe ka arritur një moshë dhe një shkallë pjekurie, sipas së cilës është në gjendje të vendosë vetë për jetën e vet.

Në marrjen parasysh të rrethanave që i referohen këtij neni, autoritetet gjyqësore dhe administrative do të marrin në konsideratë informacionin në lidhje me bekgraundin social të fëmijës, të siguruar nga autoriteti qendror ose ndonjë autoritet tjetër kompetent i vendbanimit të përhershëm të fëmijës.

Neni 14

Në përcaktimin nëse largimi apo mbajtja ka qenë e padrejtë brenda kuptimit të nenit 3, autoritetet gjyqësore ose administrative të shtetit të kërkuar, mund të marrin në konsideratë drejtpërsëdrejti ligjin dhe vendimet gjyqësore ose administrative, që njihen apo nuk njihen formalisht në shtetin e vendbanimit të përhershëm të fëmijës, pa rekurs ndaj procedurave specifike për provën e këtij ligji ose për njohjen e vendimeve të huaja, që do të zbatoheshin ndryshe.

Neni l5

Autoritetet gjyqësore ose administrative të një Shteti Kontraktues mund të kërkojnë para nxjerrjes së një urdhri për kthimin e fëmijës, që aplikanti të marrë nga autoritetet e shtetit të vendbanimit të përhershëm të fëmijës një vendim se largimi apo mbajtja ishte e padrejtë brenda kuptimit të nenit 3 të Konventës, kur një vendim i tillë mund të merret në këtë shtet. Autoritetet qendrore të Shteteve Kontraktuese do t'i ndihmojnë aplikantët të marrin praktikisht një vendim të tillë.

Neni 16

Pas marrjes së njoftimit për një largim apo mbajtje të padrejtë të fëmijës në kuptimin e nenit 3, autoritetet gjyqësore ose administrative të Shtetit Kontraktues, nga i cili fëmija është larguar apo mbajtur, nuk do të vendosin mbi thelbin e të drejtave të kujdestarisë, derisa të vendoset se fëmija nuk do të kthehet sipas kësaj Konvente ose nëse nuk bëhet një aplikim sipas kësaj Konvente, brenda një kohe të arsyeshme pas marrjes së njoftimit.

Neni l7

Fakti i vetëm që një vendim në lidhje me kujdestarinë është dhënë ose ka të drejtën e njohjes në shtetin e kërkuar, nuk do të përbëjë shkak për refuzimin e kthimit të fëmijës sipas kësaj Konvente, por autoritetet gjyqësore ose administrative të shtetit të kërkuar do të marrin parasysh shkaqet për këtë vendim në zbatimin e kësaj Konvente.

Neni 18

Dispozitat e këtij kapitulli nuk do t'i kufizojnë kompetencat e një autoriteti gjyqësor ose administrativ për të urdhëruar kthimin e fëmijës në çdo kohë.

Neni l9

Një vendim sipas kësaj Konvente në lidhje me kthimin e fëmijës, nuk do të merret si vendim për thelbin e një çështjeje kujdestarie.

Neni 20

Kthimi i fëmijës, sipas dispozitave të nenit 12, mund të refuzohet nëse nuk do lejohej nga parimet themelore të shtetit të kërkuar në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

KAPITULLI IV
TË DREJTAT E KONTAKTIT

Neni 21

Një aplikim për të marrë masa për organizimin ose sigurimin e ushtrimit efektiv të të drejtave të kontaktit, mund t'u paraqitet autoriteteve qendrore të Shteteve Kontraktuese, në të njëjtën mënyrë siç bëhet aplikimi për kthimin e fëmijës.

Autoritetet qendrore janë të detyruara nga detyrimet e bashkëpunimit, të cilat përcaktohen në nenin 7, të nxisin gëzimin paqësor të të drejtave të kontaktit dhe plotësimin e kushteve në të cilat mund të jetë objekt ushtrimi i këtyre të drejtave. Autoritetet qendrore do të ndërmarrin hapa për të shmangur, sa më shumë që të jetë e mundur, pengesat ndaj ushtrimit të këtyre të drejtave.

Autoritetet qendrore, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë, qoftë me anë të ndërmjetësve, mund të iniciojnë ose ndihmojnë në fillimin e procedimit, me qëllim organizimin ose mbrojtjen e këtyre të drejtave dhe sigurimin e respektimit të kushteve ndaj të cilave mund të jetë objekt ushtrimi i këtyre të drejtave.

KAPITULLI V
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 22

Asnjë siguracion, obligacion apo depozitë, sido që të përshkruhen, nuk do të kërkojë garanci pagese kostosh dhe shpenzimesh në procedimin gjyqësor ose administrativ që janë brenda kompetencave të kësaj Konvente.

Neni 23

Asnjë legalizim apo formalitet i ngjashëm nuk do të kërkohet në kuptimin e kësaj Konvente.

Neni 24

Aplikimi, komunikimi apo ndonjë dokument tjetër i dërguar autoritetit qendror të shtetit të kërkuar do të jetë në gjuhën origjinale dhe do të shoqërohet nga një përkthim në gjuhën zyrtare ose në një nga gjuhët zyrtare të shtetit të kërkuar ose, kur kjo nuk është e mundur, nga një përkthim në frëngjisht ose anglisht.

Megjithatë, një Shtet Kontraktues mundet, duke bërë një rezervë në përputhje me nenin 42, të kundërshtojë përdorimin e frëngjishtes apo të anglishtes, por jo të të dyjave, në ndonjë aplikim, komunikim apo dokument tjetër dërguar autoritetit të saj qendror.

Neni 25

Shtetasit e Shteteve Kontraktuese dhe personat që janë banorë të përhershëm të këtyre shteteve do t'u jepet e drejta për çështje që lidhen me zbatimin e kësaj Konvente për ndihmë dhe konsulencë ligjore në ndonjë Shtet tjetër Kontraktues në të njëjtat kushte sikur ata të ishin vetë shtetas dhe banorë të përhershëm të atij shteti.

Neni 26

Secili autoritet qendror do t'i përballojë vetë kostot për zbatimin e kësaj Konvente.

Autoritetet qendrore dhe shërbimet e tjera publike të Shteteve Kontraktuese nuk do të vënë tarifa në lidhje me aplikimet e dorëzuara sipas kësaj Konvente. Në veçanti, ato nuk mund të

kërkojnë ndonjë pagesë nga aplikanti përkundrejt kostove dhe shpenzimeve të procedimit ose, kur është e zbatueshme, ato që rrjedhin nga pjesëmarrja e konsulentit ligjor. Megjithatë, ato mund të kërkojnë pagesën e shpenzimeve të rrjedhura ose që rrjedhin nga mundësimi i kthimit të fëmijës.

Megjithatë, një Shtet Kontraktues mundet të deklarojë, duke bërë një rezervë në përputhje me nenin 42, se nuk do të jetë i detyruar të marrë përsipër ndonjë kosto që parashikohet në paragrafin e mësipënn, si rezultat i pjesëmarrjes së konsulentit apo konsulentëve ligjorë ose nga procesi gjyqësor, vetëm deri në atë shkallë që këto kosto të mund të mbulohen nga sistemi i tij i asistencës apo konsulencës ligjore.

Pas urdhërimit të kthimit të fëmijës ose daljes së urdhrit në lidhje me të drejtat e kontaktit sipas kësaj Konvente, autoritetet gjyqësore ose administrative munden, kur të jetë nevoja, të urdhërojnë personin që largoi apo mbajti fëmijën ose që pengoi ushtrimin e të drejtave të kontaktit, të paguajë shpenzimet e nevojshme që rrjedhin nga ose në emër të aplikantit, duke përfshirë shpenzimet e udhëtimit, ndonjë kosto rrjedhëse ose pagesa të bëra për vendosjen e fëmijës, kostot e përfaqësimit ligjor të aplikantit dhe ato të kthimit të fëmijës.

Neni 27

Kur provohet që kërkesat e kësaj Konvente nuk përmbushen ose që aplikimi nuk është i mirëbazuar, një autoritet qendror nuk është i detyruar të pranojë aplikimin. Në këtë rast, autoriteti qendror do ta informojë menjëherë, sipas rastit, aplikantin ose autoritetin qendror me anë të të cilit u dorëzua aplikimi, lidhur me shkaqet e tij.

Neni 28

Një autoritet qendror mund të kërkojë që aplikimi të shoqërohet nga një autorizim me shkrim duke e autorizuar atë të veprojë në emër të aplikantit ose duke caktuar një përfaqësues për të vepruar.

Neni 29

Kjo Konventë nuk do të pengojë asnjë person, institucion apo organ që pretendon se ka pasur shkelje të kujdestarisë apo të të drejtave të kontaktit brenda kuptimit të neneve 3 ose 21, të aplikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë tek autoritetet gjyqësore ose administrative të një Shteti Kontraktues, sipas apo në kundërshtim me dispozitat e kësaj Konvente.

Neni 30

Aplikimi i dorëzuar autoriteteve qendrore ose drejtpërdrejt autoriteteve gjyqësore ose administrative të një Shteti Kontraktues, në përputhje me kushtet e kësaj Konvente, së bashku me dokumentet dhe ndonjë informacion tjetër të bashkëngjitur ose të siguruar nga një autoritet qendror, do të ketë akses në gjykata ose tek autoritetet administrative të Shteteve Kontraktuese.

Neni 3l

Përsa i përket një shteti, i cili në çështjet e kujdestarisë së fëmijëve ka dy ose më shumë sisteme të ligjit të zbatueshëm në njësi të ndryshme territoriale:

a) ndonjë referim ndaj banesës së përhershme në këtë shtet do të interpretohet sikur t'i referohej banesës së përhershme në një njësi territoriale të këtij shteti;

b) ndonjë referim ndaj ligjit të shtetit të banesës së përhershme do të interpretohet sikur t'i referohej ligjit të njësisë territoriale në atë shtet ku fëmija banon.

Neni 32

Përsa i përket një shteti, i cili në çështjet e kujdestarisë së fëmijëve ka dy ose më shumë sisteme të ligjit të zbatueshëm në kategori të ndryshme personash, ndonjë referim ndaj ligjit të këtij shteti do të interpretohet sikur t'i referohej sistemit ligjor të përcaktuar nga ligji i atij shteti.

Neni 33

Një shtet, brenda të cilit, njësi të ndryshme territoriale kanë legjislacionin e tyre në lidhje me kujdestarinë e fëmijëve, nuk do të jetë i detyruar të zbatojë këtë Konventë, kur një shtet me sistem të unifikuar ligjor nuk do të ishte i detyruar ta bënte një gjë të tillë.

Neni 34

Kjo Konventë do t'u japë përparësi çështjeve brenda fushës së saj sipas konventës së 5 tetorit 1961, në lidhje me kompetencat e autoriteteve dhe ligjit të zbatueshëm mbi mbrojtjen e minorenëve, si ndërmjet palëve të të dyja konventave. Në rast të kundërt, kjo Konventë nuk do të kufizojë zbatimin e një instrumenti ndërkombëtar në fuqi midis shtetit të origjinës dhe shtetit të adresuar ose ligjit tjetër të shtetit të adresuar për qëllimet e sigurimit të kthimit të fëmijës që është larguar apo mbajtur pa të drejtë ose të organizimit të të drejtave të kontaktit.

Neni 35

Kjo Konventë do të zbatohet midis Shteteve Kontraktuese vetëm në rast largimesh apo mbajtjeve të padrejta që ndodhin pas hyrjes së saj në fuqi në ato shtete.

Kur një deklarim është bërë sipas neneve 39 ose 40, referimi ndaj një shteti kontraktues në paragrafin e mësipërm do t'i referohet njësisë ose njësive territoriale ndaj të cilave zbatohet kjo Konventë.

Neni 36

Asgjë në këtë Konventë nuk do të pengojë dy ose më shumë Shtete Kontraktuese, me qëllim ngushtimin e kufizimeve ndaj të cilave mund të jetë objekt kthimi i fëmijës, nga marrëveshja ndërmjet tyre për të hequr ndonjë dispozitë të kësaj Konvente, e cila mund të nënkuptojë një kufizim të tillë.

KAPITULLI VI
DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 37

Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim për shtetet e përfaqësuara në sesionin e katërmbëdhjetë të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private.

Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit dhe instrumentet përkatëse të ratifikimit, pranimit ose miratimit depozitohen pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës.

Neni 38

Çdo shtet tjetër mund të aderojë në këtë Konventë.

Instrumenti i aderimit depozitohet pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës.

Konventa do të hyjë në fuqi për një shtet që e ka miratuar ditën e parë të muajit të tretë kalendarik pas depozitimit të instrumentit të saj të hyrjes.

Ky aderim do të ketë efekt vetëm në lidhje me marrëdhëniet midis shtetit aderues dhe shteteve palë që do të kenë deklaruar pranimin e tyre në lidhje me këtë hyrje. Një deklaratë e tillë duhet të bëhet edhe nga çdo shtet anëtar që ratifikon, pranon apo miraton Konventën pas aderimit. Kjo deklaratë do të depozitohet në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Holandës.

Kjo ministri do t'i dorëzojë secilit prej Shteteve Kontraktuese një kopje të vërtetuar nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Konventa do të hyjë në fuqi midis shtetit aderues dhe shtetit që ka deklaruar pranimin e aderimit të saj ditën e parë të muajit të tretë kalendarik pas depozitimit të deklaratës së pranimit.

Neni 39

Çdo shtet deklaron shtrirjen e efekteve të kësaj Konvente, në të gjithë territorin që ai përfaqëson në nivel ndërkombëtar, apo në një ose disa prej tyre. Kjo deklaratë bëhet efektive në momentin e hyrjes në fuqi të Konventës në atë shtet.

Çdo deklaratë, si dhe çdo shtrirje tjetër e mëvonshme, i njoftohet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës.

Neni 40

Nëse një shtet ka dy ose më shumë njësi territoriale në të cilat zbatohen sisteme të ndryshme ligjore në lidhje me çështjet e trajtuara në këtë Konventë, ai mund të deklarojë në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, miratimit ose aderimit se Konventa do të shtrihet në të gjitha njësitë territoriale ose vetëm në një ose më shumë prej tyre. Ky shtet mund ta modifikojë këtë deklaratë duke dorëzuar një deklaratë tjetër në çdo kohë.

Çdo deklaratë e tillë do t'i njoftohet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës, duke deklaruar shprehimisht njësitë territoriale në të cilat zbatohet kjo Konventë.

Neni 41

Kur Shteti Kontraktues ka një sistem qeverisës, sipas të cilit, pushtetet ekzekutive, gjyqësore dhe legjislative shpërndahen midis autoriteteve qendrore dhe atyre të tjera brenda këtij shteti, nënshkrimi i tij, ratifikimi, pranimi, miratimi, hyrja në këtë Konventë ose bërja e ndonjë deklarate në lidhje me nenin 40, nuk do të sjellë ndërlikime në shpërndarjen e brendshme të pushteteve brenda këtij shteti.

Neni 42

Çdo shtet mundet, në çastin e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në këtë Konventë, ose në kohën e paraqitjes së një deklarate në lidhje me nenet 39 ose 40, të paraqesë një ose të dyja rezervat e parashikuara në nenin 24 dhe nenin 26, paragrafi i tretë. Asnjë rezervë tjetër nuk mund të bëhet.

Çdo shtet palë mundet në çdo kohë ta tërheqë këtë rezervë me një njoftim të drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës.

Rezerva nuk do të ketë më efekt ditën e parë të muajit të tretë kalendarik, pas njoftimit të referuar në paragrafin paraardhës.

Neni 43

Kjo Konventë do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit të tretë kalendarik, pas datës së depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose të aderimit, referuar në nenet 37 dhe 38.

Më pas ajo do të hyjë në fuqi:

1. Për çdo shtet tjetër palë në proces ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi ditën e parë të muajit të tretë kalendarik pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose të aderimit.

2. Për një territor në të cilin Konventa është shtrirë në përputhje me nenet 39 dhe 40, ditën e parë të muajit të tretë kalendarik, pas njoftimit të referuar në të njëjtin nen.

Neni 44

Kjo Konventë ka një kohëzgjatje 5-vjeçare nga dita e hyrjes në fuqi, në përputhje me paragrafin e parë të nenit 43, përfshi edhe shtetet që e kanë ratifikuar, pranuar, miratuar ose aderuar në të në një datë të mëvonshme.

Nëse nuk ka denoncime, Konventa rinovohet në mënyrë të heshtur çdo pesë vjet.

Çdo denoncim i njoftohet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës të paktën 6 muaj përpara përfundimit të periudhës prej 5 vjetësh. Ai mund të kufizohet për disa ose për të tëra territoret në të cilat zbatohet Konventa.

Denoncimi ka efekt vetëm për shtetin që e paraqet. Konventa mbetet në fuqi për shtetet e tjera palë.

Neni 45

Ministria e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Holandës u njofton shteteve palë të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private, si dhe shteteve që kanë aderuar në përputhje me nenin 38, sa më poshtë:

a) nënshkrimet, ratifikimet, pranimet dhe miratimet e parashikuara në nenin 37;

b) aderimet e parashikuara në nenin 38;

c) datën në të cilën kjo Konventë hyn në fuqi në përputhje me nenin 43;

d) shtrirjet e parashikuara në nenin 39;

e) deklarimet e parashikuara në nenin 38 dhe nenin 40;

f) rezervat e parashikuara në nenin 24 dhe nenin 26, paragrafi i tretë, si dhe tërheqjet e tyre të referuara në nenin 42;

g) denoncimet e referuara në nenin 44.

Në dëshmi të kësaj, personat e autorizuar posaçërisht nënshkruajnë këtë Konventë.

Bërë në Hagë, më 25.10.1980, në frëngjisht dhe anglisht, të dyja tekstet njëlloj të vlefshme, në një kopje të vetme, e cila do të depozitohet në arkivat e Qeverisë Holandeze, prej së cilës një kopje e vërtetuar i dërgohet nëpërmjet kanaleve diplomatike çdo shteti të përfaqësuar në Sesionin e Katërmbëdhjetë të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private.

LIGJ
Nr.9492, datë 13.3.2006

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA KUNDËR KORRUPSIONIT

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit, miratuar në Nju-Jork më 31 tetor 2003.

Neni 2

Në zbatim të pikës 3 të nenit 6 të Konventës, autoriteti që mund të asistojë shtetet e tjera palë në zhvillimin dhe zbatimin e masave të veçanta për parandalimin e korrupsionit është Departamenti i Kontrollit të Brendshëm dhe Antikorrupsionit në Këshillin e Ministrave.

Neni 3

Në zbatim të shkronjës "a'' të pikës 6 të nenit 44 të Konventës, Republika e Shqipërisë e pranon këtë Konventë si bazë ligjore në bashkëpunimin me shtetet e tjera palë të Konventës për ekstradimin.

Neni 4

1. Në zbatim të pikës 13 të nenit 46 të Konventës, autoriteti qendror përgjegjës dhe i autorizuar, për të marrë kërkesa për ndihmë të ndërsjellë ligjore, si dhe për t'i ekzekutuar ose transmetuar ato në organet përkatëse për ekzekutim është Prokuroria e Përgjithshme për kërkesat për hetimin dhe procedimin penal dhe Ministria e Drejtësisë për kërkesat gjatë gjykimit dhe ekzekutimit të dënimit, si dhe për kërkesat për ekstradimin dhe transferimin e personave të dënuar.
2. Në zbatim të pikës 14 të nenit 46 të Konventës, gjuha e pranueshme për Republikën e Shqipërisë është gjuha shqipe dhe, nëse nuk arrihet, përkthimi i certifikuar zyrtarisht në shqip.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4820, datë 28.3.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.27, faqe 885

KONVENTA E KOMBEVE TË BASHKUARA KUNDËR KORRUPSIONIT

Preambulë

Shtetet palë në këtë Konventë,

të shqetësuar për seriozitetin e problemeve dhe rreziqeve që dalin nga korrupsioni për stabilitetin dhe sigurinë e shoqërive, duke dëmtuar institucionet dhe vlerën e demokracisë, vlerat etike dhe drejtësinë dhe duke rrezikuar zhvillimin thelbësor dhe shtetin ligjor;

të shqetësuar nga lidhjet ndërmjet korrupsionit dhe formave të tjera të krimit, sidomos krimit të organizuar dhe krimit ekonomik, duke përfshirë pastrimin e parave;

të shqetësuar edhe për rastet e korrupsionit që kanë të bëjnë me sasi të mëdha pasurish, që mund të përbëjnë një pjesë thelbësore të burimeve për shtetet, dhe që kërcënojnë stabilitetin politik dhe zhvillimin e shëndetshëm të këtyre shteteve;

të bindur se korrupsioni nuk vazhdon të jetë një çështje e një vendi, por një fenomen transkombëtar që prek të gjitha shoqëritë dhe ekonomitë, duke e bërë bashkëpunimin ndërkombëtar për parandalimin dhe kontrollin e tij thelbësor;

të bindur gjithashtu se kërkohet një trajtim i plotë dhe i shumëllojshëm për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit me efektivitet;

të bindur edhe se marrja e asistencës teknike mund të luajë një rol të rëndësishëm në rritjen e aftësisë së shteteve, duke përfshirë forcimin e kapacitetit dhe ndërtimin e institucioneve, për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin me efektivitet;

të bindur se përfitimi i paligjshëm i pasurisë personale mund të jetë veçanërisht i dëmshëm për institucionet demokratike, ekonomitë kombëtare dhe shtetin ligjor;

të vendosur për të parandaluar, zbuluar dhe mënjanuar në një mënyrë më të efektshme transfertat ndërkombëtare të pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme dhe për të forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar për rimarrjen e pasurive;

duke njohur principet themelore të zbatimit të drejtë të ligjit në gjykimet penale dhe në gjykimet civile dhe administrative për njohjen e të drejtave pronësore;

duke pasur në mendje se parandalimi dhe çrrënjosja e korrupsionit është një përgjegjësi e të gjitha shteteve dhe se ata duhet të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, me mbështetjen dhe përfshirjen e individëve dhe grupeve jashtë sektorit publik, si shoqëria civile, organizatat joqeveritare dhe organizatat e bazuara në komunitet, nëse përpjekjet e tyre në këtë fushë janë me efektivitet;

duke pasur gjithashtu në mendje principet e administrimit të rregullt të çështjeve publike dhe pasurisë publike, drejtësisë, përgjegjësisë dhe barazisë para ligjit, dhe të nevojës për të garantuar integritetin dhe të nxitjes së kulturës për të hedhur poshtë korrupsionin;

duke vlerësuar punën e Komisionit për parandalimin e krimit dhe të drejtësisë penale dhe Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe krimin në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit;

duke rikujtuar punën e bërë nga organizata të tjera ndërkombëtare dhe regjionale në këtë fushë, duke përfshirë aktivitetet e Bashkimit Afrikan, Këshillit të Europës, Këshillit të Bashkëpunimit të Doganave (e njohur gjithashtu edhe si Organizata Botërore e Doganave) Bashkimit Europian, Lidhjen e Shteteve Arabe, Organizatën për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillim dhe Organizatën e Shteteve Amerikane;

duke vënë në dukje me vlerësim instrumentet shumëpalëshe për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, duke përfshirë, ndërmjet të tjerash, Konventën Ndëramerikane kundër Korrupsionit, të miratuar nga Organizata e Shteteve Amerikane më 29 mars 1966, Konventën për Luftën kundër Korrupsionit që ka të bëjë me zyrtarët e Komuniteteve Europiane ose zyrtarët e Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian, të miratuar nga Këshilli i Bashkimit Europian më 26 maj 1997, Konventën për Luftën kundër Ryshfetit ndaj Nëpunësve Publikë të Huaj në Transaksione Ndërkombëtare Biznesi, të miratuar nga Organizata për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillim më 21 dhjetor 1997, Konventën e së Drejtës Penale mbi Korrupsionin, të miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës më 27 janar 1999, Konventën e së Drejtës Civile mbi

Korrupsionin, të miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës më 4 nëntor 1999, dhe Konventën e Bashkimit Afrikan për Parandalimin dhe Luftën kundër Korrupsionit, të miratuar nga kryetarët e shteteve dhe qeverive të Bashkimit Afrikan më 12 korrik 2003;

duke mirëpritur hyrjen në fuqi më 29 shtator 2003 të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transkombëtar,

kanë rënë dakord si më poshtë.

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Deklarimi i qëllimit

Qëllimet e kësaj Konvente janë:

a) nxitja dhe forcimi i masave për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit më me efiçencë dhe efektivitet;

b) nxitja, lehtësimi dhe mbështetja e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe asistencës teknike në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, duke përfshirë rimarrjen e pasurisë;

c) nxitja e integritetit, përgjegjësisë dhe administrimi i rregullt i çështjeve publike dhe pasurisë publike.

Neni 2
Përdorimi i termave

Për qëllimet e kësaj Konvente:

a) "Nëpunës publik" është: (i) çdo person që mban në post legjislativ, ekzekutiv, administrativ ose gjyqësor në një shtet palë, i emëruar ose i zgjedhur, i përhershëm ose i përkohshëm, i paguar ose i papaguar, pavarësisht nga kohëzgjatja e shërbimit të personit; (ii) çdo person tjetër që ushtron një funksion publik, duke përfshirë në agjenci publike ose ndërmarrje publike, ose që kryen një shërbim publik, sipas përcaktimit të ligjit të brendshëm të shtetit palë dhe sipas zbatimit në sferën përkatëse të ligjit në shtetin palë; (iii) çdo person tjetër të përcaktuar si "nëpunës publik" në ligjin e brendshëm të shtetit palë, megjithatë, për qëllimet e disa masave specifike që parashikohen në kapitullin II të kësaj Konvente, "nëpunës publik" është çdo person që ushtron një funksion publik ose jep një shërbim publik sipas parashikimit të ligjit të brendshëm të shtetit palë dhe sipas zbatimit në fushën përkatëse të ligjit të shtetit palë.

b) "Nëpunës publik i huaj" është çdo person që ka një post legjislativ, ekzekutiv, administrativ ose gjyqësor të një shteti të huaj, i emëruar ose i zgjedhur, dhe çdo person që ushtron një funksion publik për një vend të huaj, duke përfshirë një agjenci publike ose një ndërmarrje publike.

c) "Nëpunës i një organizate publike ndërkombëtare" është një punonjës i shërbimit civil ndërkombëtar ose çdo person që është i autorizuar nga një organizatë e tillë për të vepruar në emër të asaj organizate.

d) "Pronë" është pasuri e çdo lloji, materiale ose jomateriale, e tundshme ose e patundshme dhe dokumentet ose instrumentet ligjore që vërtetojnë tituj ose interesa në pasuri të tilla.

e) "Të ardhura nga krimi" janë të gjitha pasuritë që rrjedhin ose janë përftuar, direkt ose indirekt, nëpërmjet kryerjes së një vepre penale.

f) "ngrirje" ose "kapje" është ndalim i përkohshëm i transferimit, konvertimit, disponimit, ose lëvizjes së pasurisë ose veçim i përkohshëm ose kontroll i pasurisë mbi bazën e një vendimi të dhënë nga një gjykatë ose organ tjetër kompetent;

g) "Konfiskim", i cili përfshin edhe humbjen e së drejtës kur është e zbatueshme, është ndarja e përhershme nga pasuria me anë të një urdhri gjykate ose organi tjetër kompetent.

h) “Vepër penale” është çdo vepër penale, si rezultat i së cilës janë marrë fitime, që mund të përfshihet në kualifikimin e veprës penale të përcaktuar në nenin 23 të kësaj Konvente.

i) “Dhënie e kontrolluar” është teknika e lejimit të dërgimeve të paligjshme ose të dyshimta për të dalë, kaluar ose hyrë në territorin e një ose më shumë shteteve, me njohurinë dhe nën mbikëqyrjen e organeve të tyre kompetente, me qëllimin e hetimit të një vepre penale dhe identifikimin e personave të përfshirë në kryerjen e veprës penale.

Neni 3
Objekti

1. Kjo Konventë zbatohet, në pajtim me kushtet e saj, për parandalimin, hetimin dhe ndjekjen penale të korrupsionit dhe për ngrirjen, kapjen, konfiskimin dhe kthimin e fitimeve nga veprat penale të parashikuara sipas kësaj Konvente.

2. Për qëllimet e zbatimit të kësaj Konvente, nuk është e nevojshme, përveç kur është e parashikuar ndryshe, që veprat penale të parashikuara në të, të dëmtojnë ose cenojnë pasurinë e shtetit.

Neni 4
Mbrojtja e sovranitetit

1. Shtetet palë përmbushin detyrimet e tyre sipas kësaj Konvente në një mënyrë që të jetë në përputhje me principet e barazisë së sovranitetit dhe integritetit të territorit të shtetit dhe të mosndërhyrjes në punët e brendshme të shteteve të tjera.

2. Asgjë në këtë Konventë nuk i jep të drejtën një shteti palë të ndërmarrë në territorin e një shteti tjetër ushtrimin e juridiksionit dhe ushtrimin e funksioneve që i rezervohen ekskluzivisht organeve të atij shteti në bazë të ligjit të brendshëm.

KAPITULLI II
MASAT PARANDALUESE

Neni 5
Politikat dhe praktikat parandaluese kundër korrupsionit

1. Secili shtet palë, në përputhje me principet themelore të sistemit ligjor të tij, zhvillon dhe zbaton ose ruan politika të efektshme dhe të koordinuara kundër korrupsionit që nxisin pjesëmarrjen e shoqërisë dhe reflektojnë principet e shtetit ligjor, administrimin e rregullt të punëve publike, pasurisë publike, integritetit, transparencës dhe përgjegjësisë.

2. Secili shtet palë përpiqet të vendosë dhe të nxitë praktika të efektshme që synojnë parandalimin e korrupsionit.

3. Secili shtet palë përpiqet të vlerësojë periodikisht instrumentet përkatëse ligjore dhe masat administrative me qëllim që të përcaktojë përshtatshmërinë e tyre për të parandaluar dhe luftuar kundër korrupsionit.

4. Shtetet palë, siç duhet dhe në përputhje me principet themelore të sistemit të tyre ligjor, bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe me organizatat ndërkombëtare dhe regjionale në nxitjen dhe zhvillimin e masave të përmendura në këtë nen. Ky bashkëpunim mund të përfshijë pjesëmarrjen në programe dhe projekte ndërkombëtare që synojnë parandalimin e korrupsionit.

Neni 6
Organi ose organet parandaluese të korrupsionit

1. Secili shtet palë, në pajtim me principet themelore të sistemit të tij ligjor, siguron ekzistencën e një ose disa organeve, si të jetë e përshtatshme, për të parandaluar korrupsionin me mjete të tilla si:

a) zbatimi i politikave të përmendura në nenin 5 të kësaj Konvente dhe, kur është e përshtatshme, mbikëqyrja dhe koordinimi i zbatimit të këtyre politikave;

b) rritja dhe shpërndarja e njohurive rreth parandalimit të korrupsionit.

2. Secili shtet palë i jep organit ose organeve të përmendura në paragrafin 21 të këtij neni pavarësinë e nevojshme, në përputhje me principet themelore të sistemit të tij të drejtësisë, për t'i dhënë mundësi organit ose organeve për të kryer funksionet e tyre me efektivitet dhe të lirë nga çdo influencë e parregullt. Jepen burimet e nevojshme materiale dhe personeli i specializuar, si dhe kualifikimi që ky personel mund të kërkojë për të kryer funksionet e tij.

3. Secili shtet palë informon Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara në lidhje me emrin dhe adresën e organit ose organeve që mund të asistojnë shtetet e tjera palë në zhvillimin dhe zbatimin e masave specifike për parandalimin e korrupsionit.

Neni 7
Sektori politik

1. Secili shtet palë, kur është e përshtatshme dhe në përputhje me principet themelore të sistemit të tij ligjor, përpiqet të miratojë, ruajë dhe forcojë sistemet për marrjen në punë, kontraktimin, mbajtjen në detyrë, ngritjen në përgjegjësi dhe nxjerrjen në pension të punonjësve të shërbimit publik dhe, kur është e përshtatshme, të punonjësve publikë të pazgjedhur:

a) që të bazohen mbi principet e efiçencës, transparencës dhe kritereve objektive, si meritat, barazia dhe aftësitë;

b) që përfshin procedura të përshtatshme për zgjedhjen dhe kualifikimin e individëve për pozicionet publike, që konsiderohen veçanërisht delikate kundrejt korrupsionit, dhe kur është e përshtatshme, qarkullimin e këtyre individëve në pozicione të tjera;

c) që nxit pagesa të përshtatshme dhe shkallë të drejta pagese, duke marrë parasysh nivelin e zhvillimit ekonomik të shtetit palë;

d) që nxit arsimimin dhe programet kualifikuese për t'i ndihmuar ata të plotësojnë kërkesat për kryerjen e saktë, të ndershme dhe të përshtatshme të funksioneve publike dhe që u japin atyre kualifikimin e specializuar dhe të përshtatshëm për të rritur vëmendjen e tyre në lidhje me rreziqet e korrupsionit që mbart ushtrimi i këtyre funksioneve. Këto programe mund t'u referohen kodeve dhe standardeve të sjelljes në fushat e zbatueshme.

2. Secili shtet palë mendon të miratojë masa të përshtatshme legjislative dhe administrative, në përputhje me objektivat e kësaj Konvente dhe në pajtim me principet themelore të ligjit të tij të brendshëm, të paracaktojë kritere në lidhje me kandidaturën dhe zgjedhjen në një post publik.

3. Secili shtet palë mendon gjithashtu të marrë masa të përshtatshme, legjislative dhe administrative, në përputhje me objektivat e kësaj Konvente dhe në pajtim me principet themelore të ligjit të tij të brendshëm, të rrisë transparencën në financimin e kandidaturave për postin e zgjedhur publik dhe, kur është e zbatueshme, financimin e partive politike.

4. Secili shtet palë, në përputhje me principet themelore të ligjit të vet të brendshëm, përpiqet të miratojë, ruajë dhe forcojë sistemet që nxisin transparencën dhe të parandalojnë konfliktet e interesave.

Neni 8
Kodet e sjelljes për nëpunësit publikë

1. Me qëllim që të luftohet korrupsioni, secili shtet palë nxit, ndërmjet të tjerash, integritetin, ndershmërinë dhe përgjegjësinë e nëpunësve të tij publikë, në përputhje me principet themelore të sistemit të tij ligjor.

2. Secili shtet palë përpiqet, në veçanti, të zbatojë, brenda sistemeve të tij institucionale dhe ligjore, kodet ose standardet e sjelljes për ushtrimin korrekt, të ndershëm dhe të përshtatshëm të funksioneve publike.

3. Për qëllimet e zbatimit të dispozitave të këtij neni, secili shtet palë, kur është e

përshtatshme dhe në përputhje me principet themelore të sistemit të tij ligjor, shënon iniciativat përkatëse të organizatave regjionale, ndërregjionale dhe multilaterale, si Kodi Ndërkombëtar i Sjelljes për Nëpunësit Publik, i cili gjendet në shtesën e Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme 51/59 të 12 dhjetorit 1996.

4. Secili shtet palë, në përputhje me principet themelore të së drejtës së tij të brendshme, shqyrton caktimin e masave dhe të sistemeve për të ndihmuar raportimin nga nëpunësit publikë të akteve të korrupsionit tek autoritetet e duhura, kur ata marrin dijeni për këto akte gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.

5. Secili shtet palë, kur është e përshtatshme dhe në pajtim me principet themelore të ligjit të brendshëm, përpiqet të caktojë masa dhe sisteme që u kërkojnë nëpunësve publikë të bëjnë deklarata tek autoritetet e duhura, ndërmjet të tjerash, në lidhje me aktivitetet e jashtme, punësimin, investimet, pasuritë dhe dhuratat ose privilegjet e mëdha nga të cilat mund të lindë një konflikt interesash për shkak të funksioneve të tyre si nëpunës publikë.

6. Secili shtet palë, në pajtim me principet themelore të ligjit të tij të brendshëm, shqyrton marrjen e masave disiplinore dhe të tjera kundër nëpunësve publikë që shkelin kodet ose standardet e caktuara në pajtim me këtë nen.

Neni 9

Prokurimi publik dhe administrimi i financave publike

1. Secili shtet palë, në pajtim me principet themelore të sistemit të tij ligjor, merr hapat e nevojshëm për të vendosur sisteme të përshtatshme prokurimi, bazuar mbi transparencën, konkurrencën dhe kriteret objektive në vendimmarrje, që, ndërmjet të tjerash, janë të efektshme në parandalimin e korrupsionit. Këto sisteme, që mund të marrin parasysh vlerat përkatëse minimale në zbatimin e tyre, ndërmjet të tjerash shqyrtojnë:

a) Shpërndarjen publike të informacionit në lidhje me procedurat e prokurimit dhe kontratat, duke përfshirë informacionin mbi ftesat për tender dhe informacionin përkatës ose të rëndësishëm mbi dhënien e kontratave, duke u dhënë kohë të mjaftueshme pjesëmarrësve në tendera të përgatisin dhe të dorëzojnë tenderat e tyre;

b) Caktimin paraprak të kushteve për pjesëmarrje, duke përfshirë kriteret e zgjedhjes dhe të fitimit, rregullat e tenderimit dhe botimin e tyre;

c) Përdorimin e kritereve objektive dhe të paracaktuara për vendimet e prokurimeve publike, me qëllim që të ndihmohet verifikimi i mëvonshëm i zbatimit të saktë të rregullave procedurale;

d) Një sistem të efektshëm të rishikimit të brendshëm, duke përfshirë një sistem të efektshëm ankimi, për të siguruar ndërhyrjen ligjore dhe ankimimin në rast se rregullat procedurale të parashikuara në këtë paragraf nuk respektohen;

e) Nëse është e përshtatshme, masat për rregullimin e çështjeve që kanë të bëjnë me personelin e përgjegjshëm për prokurimet, procedurat e kontrollit dhe kërkesat për kualifikim.

2. Secili shtet palë, në pajtim me principet themelore të sistemit të tij ligjor, merr masat e përshtatshme për nxitjen e transparencës dhe përgjegjësisë në administrimin e financave publike. Këto masa, ndërmjet të tjerash, përfshijnë:

a) Procedurat për miratimin e buxhetit kombëtar;

b) Raportimin në kohë për të ardhurat dhe shpenzimet;

c) Një sistem standardesh kontabiliteti dhe kontrolli dhe mbikëqyrjen përkatëse;

d) Sisteme efiçente dhe të efektshme të administrimit të rrezikut dhe kontrollit të brendshëm, dhe

e) Kur është e përshtatshme, veprimin korrigjues në rast mospërmbushjeje të kërkesave të caktuara në këtë paragraf.

3. Secili shtet palë merr ato masa civile dhe administrative që janë të nevojshme, në pajtim me principet themelore të ligjit të brendshëm, për të ruajtur integritetin e regjistrave të kontabilitetit, regjistrimeve, deklaratave financiare ose dokumenteve të tjera që kanë të bëjnë me shpenzimet dhe të ardhurat publike dhe për të parandaluar falsifikimin e këtyre dokumenteve.

Neni 10
Raportimi publik

Duke pasur parasysh nevojën për të luftuar korrupsionin, secili shtet palë, në pajtim me principet themelore të ligjit të brendshëm, merr ato masa që janë të nevojshme për të rritur transparencën në administratën publike, duke përfshirë, kur është e nevojshme, proceset e organizimit, funksionimit dhe vendimmarrjes. Këto masa, ndërmjet të tjerash, mund të përfshijnë:

a) Miratimin e procedurave dhe rregullave që lejojnë anëtarët e publikut të gjerë, kur është e përshtatshme, të marrin informacion mbi proceset e organizimit, funksionimit dhe vendimmarrjes në administratën publike dhe, duke i kushtuar kujdes ruajtjes së jetës private dhe të dhënave personale, mbi vendimet dhe aktet ligjore që prekin anëtarët e publikut;

b) Thjeshtëzimet e procedurave administrative, kur është e nevojshme, për të lehtësuar shkuarjen e publikut te organet e vendimmarrjes; dhe

c) Botimin e informacionit që mund të përfshijë raporte periodike mbi rreziqet e korrupsionit në administratën publike.

Neni 11
Masat në lidhje me shërbimet gjyqësore dhe të prokurorisë

1. Duke pasur parasysh pavarësinë e gjyqësorit dhe rolin e tij themelor në luftën kundër korrupsionit, secili shtet palë, në pajtim me principet themelore të sistemit të tij ligjor dhe pa cenuar pavarësinë e gjyqësorit, merr masa për të forcuar integritetin dhe parandaluar mundësitë për korrupsion tek anëtarët e gjyqësorit. Këto masa mund të përfshijnë rregulla në lidhje me sjelljen e anëtarëve të gjyqësorit.

2. Masa me të njëjtin efekt si ato të marra sipas paragrafit 1 të këtij neni mund të paraqiten dhe zbatohen në shërbimin e prokurorisë në ato shtete palë ku ai nuk është pjesë e gjyqësorit por ka pavarësi të ngjashme me pavarësinë e gjyqësorit.

Neni 12
Sektori privat

1. Secili shtet palë, në pajtim me principet themelore të ligjit të tij të brendshëm, merr masa për të parandaluar korrupsionin në sektorin privat, forcuar standardet e kontabilitetit dhe kontrollit në sektorin privat dhe, nëse është e përshtatshme, cakton dënime të efektshme, proporcionale dhe parandaluese, civile administrative dhe penale, nëse këto masa nuk merren.

2. Masat për arritjen e këtyre qëllimeve, ndërmjet të tjerash, mund të arrijnë:

a) nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet agjencive të përmbarimit dhe subjekteve përkatëse private;

b) nxitjen e zhvillimit të standardeve dhe procedurave të caktuara për ruajtjen e integritetit të subjekteve përkatëse private, duke përfshirë kodet e sjelljes për kryerjen e saktë, të ndershme dhe të përshtatshme të aktiviteteve të biznesit dhe të gjitha profesionet përkatëse, dhe parandalimin e konflikteve të interesit, dhe për nxitjen e përdorimit të praktikave të mira tregtare ndërmjet bizneseve dhe në marrëdhëniet kontraktuale ndërmjet bizneseve dhe shtetit;

c) nxitjen e transparencës te subjektet private, duke përfshirë, nëse është e përshtatshme, masat për identitetin e personave juridikë dhe fizikë të përfshirë në themelimin dhe menaxhimin e kompanive;

d) parandalimin e keqpërdorimit të procedurave që rregullojnë subjektet private, duke përfshirë procedurat për subvencionet dhe licencimet e dhëna nga organet publike për aktivitetet tregtare;

e) parandalimin e konflikteve të interesit duke vënë kufizime, nëse është e përshtatshme dhe për një periudhë të arsyeshme kohe, mbi aktivitetet profesionale të ish- nëpunësve publikë ose mbi punësimin e nëpunësve publikë nga sektori privat pas dorëheqjes ose me daljen në pension, nëse

këto aktivitete ose ky punësim lidhet direkt me funksionet e ushtruara ose mbikëqyrur nga ata nëpunës publikë gjatë kohës së shërbimit;

f) garantimin që ndërmarrjet private, duke marrë parasysh strukturën dhe madhësinë e tyre, të kenë kontrolle të mjaftueshme të brendshme për të ndihmuar në parandalimin dhe zbulimin e akteve të korrupsionit, dhe që llogaritë dhe deklarimet financiare të kërkuara të këtyre ndërmarrjeve private t'u nënshtrohen procedurave të përshtatshme të kontrollit të vërtetimit.

3. Me qëllim që të parandalohet korrupsioni, secili shtet palë merr ato masa që janë të nevojshme, në pajtim me ligjet dhe rregulloret e brendshme, për mbajtjen e librave dhe të regjistrave, dhënien e deklarimeve financiare dhe standardet e kontabilitetit dhe të kontrollit për të ndaluar kryerjen e akteve të mëposhtme me qëllim kryerjen e një prej veprave penale të mëposhtme të parashikuara sipas kësaj Konvente:

a) Mbajtja e llogarive jashtë regjistrave;

b) Kryerja e transaksioneve të paregjistruara ose të paidentifikuara në mënyrë të përshtatshme;

c) Regjistrimi i shpenzimeve të paqena;

d) Hyrja e detyrimeve me identifikim jo të saktë të objektit të tyre;

e) Përdorimi i dokumenteve false;

f) Prishja me qëllim e dokumenteve të kontabilitetit para afatit të parashikuar në ligj.

4. Secili shtet palë nuk lejon zbritjen e taksave për shpenzimet që përbëjnë ryshfet, duke qenë se kjo e fundit është një nga elementet përbërëse të veprave penale të parashikuara në pajtim me nenet 15 dhe 16 të kësaj Konvente dhe, nëse është e përshtatshme, edhe nga shpenzimet e tjera të shkaktuara si vijim i sjelljes korruptive.

Neni 13
Pjesëmarrja e shoqërisë

1. Secili shtet palë merr masa të përshtatshme, brenda mundësive të tij dhe në pajtim me principet themelore të ligjit të brendshëm, për të nxitur pjesëmarrjen aktive të individëve dhe grupeve jashtë sektorit publik, siç është shoqëria civile, organizatat joqeveritare dhe organizatat e bazuara mbi komunitet, në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, dhe për të rritur ndërgjegjësimin publik në lidhje me ekzistencën, shkaqet dhe rëndësinë dhe kërcënimin që përbën korrupsioni. Kjo pjesëmarrje duhet të forcohet me masa të tilla si:

a) Forcimi i transparencës dhe nxitja e kontributit të publikut në proceset e vendimmarrjes;

b) Garantimi që publiku ka të drejtën efektive për informacion;

c) Ndërmarrja e aktiviteteve për informimin publik që kontribuojnë në mostolerimin e korrupsionit, si dhe programet e edukimit publik, duke përfshirë programet shkollore dhe universitare;

d) Respektimi, nxitja dhe mbrojtja e lirisë për të kërkuar, marrë, botuar dhe shpërndarë informacion në lidhje me korrupsionin. Kjo liri mund t'u nënshtrohet kufizimeve të caktuara, por këto janë vetëm ato që janë parashikuar në ligj dhe ato që janë të nevojshme:

i) për respektimin e të drejtave dhe reputacionit të të tjerëve;

ii) për mbrojtjen e sigurisë kombëtare, rendit publik ose shëndetit ose moralit publik.

2. Secili shtet palë merr masa të përshtatshme për të siguruar që organet përkatëse kundër korrupsionit që përcaktohen në këtë Konventë të jenë të njohura për publikun dhe siguron të drejtën për t'iu drejtuar këtyre organeve, kur është e përshtatshme, për raportimin, edhe anonimisht, të çdo incidenti që mund të konsiderohet se përbën një vepër penale të parashikuar në pajtim me këtë Konventë.

Neni 14
Masat për parandalimin e pastrimit të parave

1. Secili shtet palë:

a) vendos një regjim të plotë rregullator dhe mbikëqyrës të brendshëm për bankat dhe institucionet financiare jobankare, duke përfshirë personat fizikë dhe juridikë që bëjnë shërbime formale dhe joformale për dërgimin e parave dhe vlerave dhe, nëse është e përshtatshme, për organe të tjera që janë tepër të prekshme nga pastrimi i parave, brenda kompetencës së tij, me qëllim që të parandalojë dhe zbulojë të gjitha format e pastrimit të parave, dhe ky regjim thekson kërkesat për identifikimin e klientit dhe, nëse është e përshtatshme, për identifikimin e përfituesit, mbajtjen e regjistrit dhe raportimin e transaksioneve të dyshimta.

b) pa cenuar nenin 46 të kësaj Konvente, garanton që organet administrative, rregullatore, të përmbarimit dhe të tjera që janë ngarkuar me luftën kundër pastrimit të parasë (duke përfshirë, nëse është e përshtatshme sipas ligjit të brendshëm, organet gjyqësore) të kenë aftësinë për të bashkëpunuar dhe shkëmbyer informacion në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar brenda kushteve të parashikuara nga ligji i brendshëm dhe, për këtë qëllim, konsideron formimin e një njësie të shërbimit të fshehtë financiar për të shërbyer si qendër për mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen e informacionit në lidhje me pastrimin e mundshëm të parave.

2. Shtetet palë konsiderojnë të zbatojnë masa të mundshme për të zbuluar dhe vëzhguar lëvizjen e parasë dhe letrave me vlerë të transferueshme jashtë kufijve të tyre, duke iu nënshtruar kushteve për të siguruar përdorim të përshtatshëm të informacionit dhe pa penguar në asnjë mënyrë lëvizjen e kapitalit të ligjshëm.

3. Shtetet palë konsiderojnë zbatimin e masave të përshtatshme dhe të mundshme për t'u kërkuar institucioneve financiare, duke përfshirë dërguesit e parave:

a) të përfshijnë në formularët e transfertave elektronike të parave dhe mesazheve përkatëse informacion të saktë dhe të përshtatshëm mbi dërguesin;

b) të mbajnë informacion të tillë gjatë gjithë zinxhirit të pagesës, dhe

c) të ushtrojnë vëzhgim intensiv mbi transfertat e fondeve që nuk kanë informacion të plotë për dërguesin.

4. Për vendosjen e një regjimi rregullator dhe mbikëqyrës të brendshëm sipas kushteve të këtij neni dhe pa cenuar ndonjë nen tjetër të kësaj Konvente, shteteve palë u kërkohet të përdorin iniciativat përkatëse të organizatave regjionale, ndërregjionale dhe shumëpalëshe kundër pastrimit të parave.

5. Shtetet palë përpiqen të zhvillojnë dhe nxisin bashkëpunimin global, regjional, nënregjional dhe dypalësh ndërmjet organeve gjyqësore, përmbaruese dhe rregullatore financiare, me qëllim që të luftohet pastrimi i parave.

KAPITULLI III
PENALIZIMI DHE PËRMBARIMI

Neni 15
Dhënia e ryshfetit nëpunësve publikë

Secili shtet palë miraton ato masa legjislative dhe të tjera që mund të jenë të nevojshme për parashikimin si vepra penale, kur kryhet me qëllim:

a) premtimi, ofrimi ose dhënia një nëpunësi publik, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, i një avantazhi të parregullt për vetë nëpunësin ose një person tjetër apo subjekt, me qëllim që nëpunësi të veprojë ose të mos veprojë në ushtrim të funksioneve të tij ose të saj zyrtare.

b) kërkimi ose pranimi nga nëpunësi publik, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, i një avantazhi të parregullt për vetë nëpunësin ose një person tjetër, apo një subjekt, me qëllim që nëpunësi të veprojë ose të mos veprojë në ushtrim të funksioneve të tij zyrtare.

Neni 16

Dhënia e ryshfetit nëpunësve publikë të huaj dhe nëpunësve të organizatave publike ndërkombëtare

1. Secili shtet palë miraton ato masa legjislative dhe të tjera që mund të jenë të nevojshme për të parashikuar si vepër penale, kur kryhet me qëllim premtimi, ofrimi ose dhënia e një nëpunësi të huaj publik ose një nëpunësi të një organizate publike ndërkombëtare, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, i një avantazhi të parregullt, me qëllim që nëpunësi vetë ose një person tjetër apo subjekt të veprojë ose jo në ushtrim të detyrave të tij zyrtare, me qëllim që të përfitohen ose mbahen avantazhe biznesi ose të tjera në lidhje me sjelljen e biznesit ndërkombëtar.

2. Secili shtet palë shqyrton miratimin e masave legjislative ose të tjera që mund të jenë të nevojshme për parashikimin si vepra penale, kur kryhen me qëllim kërkimi ose pranimi nga një nëpunës i huaj publik, ose nëpunës i një organizate publike ndërkombëtare, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, i një avantazhi të parregullt për nëpunësin vetë ose një person tjetër apo subjekt, me qëllim që nëpunësi të veprojë ose mos veprojë në ushtrim të funksioneve të tij ose të saj zyrtare.

Neni 17

Përfitimi, keqadministrimi i qëllimit ose abuzime të tjera me pasurinë nga një nëpunës publik

Secili shtet palë miraton ato masa legjislative ose të tjera që mund të jenë të nevojshme për të parashikuar si vepër penale, kur kryhet me qëllim përfitimi, keqadministrimi ose për abuzime të tjera nga një nëpunës publik për përfitimin e tij ose përfitimin e një personi tjetër ose subjekti, të çdo lloj pasurie, fondeve publike ose private, ose letrave me vlerë, apo çdo send tjetër me vlerë që i është besuar nëpunësit publik në sajë të pozicionit të tij ose të saj.

Neni 18

Trafikimi i influencave

Secili shtet palë shqyrton marrjen e masave legjislative dhe të tjera që mund të jenë të nevojshme për të parashikuar si vepra penale, kur kryhen me qëllim:

a) premtimi, ofrimi ose dhënia një nëpunësi publik ose çdo personi tjetër, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, e një avantazhi të parregullt, me qëllim që nëpunësi publik ose personi të keqpërdorë influencën e tij të vërtetë ose të prezumuar me qëllim që të merret nga një organ administrativ ose publik i shtetit palë i një avantazhi të parregullt për nxitësin e parë të këtij akti ose për çdo person tjetër.

b) kërkimi ose pranimi nga një nëpunës publik ose një person tjetër, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, të një avantazhi të parregullt për vetë ose një person tjetër, me qëllim që nëpunësi publik ose personi të keqpërdorë influencën e tij ose të saj të vërtetë ose të prezumuar me qëllim që të përftohet nga një organ administrativ ose publik i shtetit palë i në avantazhi të parregullt.

Neni 19

Abuzimi me funksionet

Secili shtet palë shqyrton marrjen e masave legjislative dhe të tjera që mund të jenë të nevojshme për parashikimin si vepër penale, kur kryhet me qëllim abuzimi me funksionet ose pozicionin, që është kryerja ose moskryerja e një akti, duke thyer ligjin, nga një nëpunës publik në ushtrim të funksioneve të tij ose të saj, për qëllimin e marrjes së një avantazhi të parregullt për vetë ose një person tjetër apo subjekt.

Neni 20
Pasurimi i paligjshëm

Në përputhje me Kushtetutën dhe principet themelore të sistemit të tij ligjor, secili shtet palë shqyrton marrjen e masave legjislative dhe të tjera që mund të jenë të nevojshme për të parashikuar si vepër penale, kur kryhet me qëllim pasurimin e paligjshëm, që është një rritje e madhe e pasurisë së një nëpunësi publik që ai ose ajo nuk mund ta justifikojë me të ardhurat e tij ose të saj të ligjshme.

Neni 21
Dhënia e ryshfetit në sektorin privat

Secili shtet palë shqyrton marrjen e masave legjislative dhe të tjera që mund të jenë të nevojshme për të parashikuar si vepra penale, kur kryhen me qëllim, në ushtrim të aktiviteteve ekonomike, financiare ose tregtare:

a) premtimin, ofrimin ose dhënien, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, të një avantazhi të parregullt çdo personi që drejton ose punon, në çfarëdolloj cilësie, në një subjekt në sektorin privat, për vetë personin ose për një person tjetër, me qëllim që ai ose ajo, duke shkelur detyrat e tij ose të saj, të veprojë ose mos veprojë;

b) kërkimin ose pranimin, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, të një avantazhi të parregullt nga një person që drejton ose punon, në çfarëdolloj aktiviteti, për një subjekt të sektorit privat, për vetë personin ose për një person tjetër, me qëllim që ai ose ajo, duke shkelur detyrat e tij ose të saj, të veprojë ose mos veprojë.

Neni 22
Përfitimi i paligjshëm i pasurisë në sektorin privat

Secili shtet palë shqyrton marrjet e masave legjislative ose të tjera që mund të jenë të nevojshme për të parashikuar si vepër penale, kur kryhet me qëllim, gjatë aktiviteteve ekonomike, financiare ose tregtare, përfitimin e paligjshëm nga një person që drejton ose punon, në çfarëdolloj cilësie, në një subjekt të sektorit privat, të çdo pasurie, fonde private ose letra me vlerë, apo çdo send tjetër me vlerë që i është besuar atij në sajë të pozicionit të tij ose të saj.

Neni 23
Pastrimi i fitimeve nga krimi

1. Secili shtet palë, në pajtim me principet themelore të ligjit të tij të brendshëm, miraton ato masa legjislative që mund të jenë të nevojshme për të parashikuar si vepra penale, kur kryhen me qëllim:

a) i) konvertimin ose transferimin e pasurisë, duke ditur se kjo pasuri rrjedh nga krimi, për qëllimin e fshehjes ose të tjetërsimit të origjinës së pasurisë ose për të ndihmuar çdo person që është i përfshirë në kryerjen e veprës penale prej nga rrjedh pasuria, për të mënjanuar pasojat ligjore për veprimin e tij ose të saj;

ii) fshehjen ose tjetërsimin e natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, lëvizjes ose pronësisë, ose të drejtave në lidhje me pasurinë, duke e ditur se kjo pasuri ka rrjedhur nga krimi;

b) brenda koncepteve bazë të sistemit të tij ligjor:

i) përftimi, zotërimi ose përdorimi të pasurisë, duke e ditur në kohën e marrjes që kjo pasuri ka rrjedhur nga krimi;

ii) pjesëmarrje, bashkimi ose planet e fshehta për kryerjen, përpjekjet për kryerjen dhe ndihmë, nxitjë, lehtësimi dhe këshillimi për kryerjen e një prej veprave të parashikuara sipas këtij neni.

2. Për qëllimet e zbatimit të paragrafit 1 të këtij neni:

a) secili shtet palë përpiqet të zbatojë paragrafin 1 të këtij neni në gamën më të gjerë të mundur për këto vepra penale;

b) secili shtet palë përfshin në kategorinë e këtyre veprave penale të paktën një gamë të plotë të veprave penale të parashikuara në pajtim me këtë Konventë,

c) për qëllimet e nënparagrafit (b) të mësipërm, kategoria e këtyre veprave penale përfshin veprat penale të kryera brenda dhe jashtë juridiksionit të shtetit palë në fjalë. Megjithatë, veprat penale të kryera jashtë juridiksionit të një shteti palë, përfshihen në kategorinë e këtyre veprave penale vetëm kur sjellja përkatëse është një vepër penale sipas ligjit të brendshëm të shtetit ku ajo është kryer dhe do të ishte një vepër penale sipas ligjit të brendshëm të shtetit palë që zbaton këtë nen nëse ajo do të ishte kryer atje;

d) secili shtet palë i paraqet kopje të ligjeve që i japin fuqi këtij neni dhe të çdo ndryshimi të mëvonshëm të këtyre ligjeve, ose një përshkrim të tyre te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara;

e) nëse kërkohet nga principet themelore të ligjit të brendshëm të një shteti palë, mund të parashikohet që veprat penale të parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni nuk zbatohen për personat që kanë kryer këtë vepër penale.

Neni 24
Fshehja

Pa cenuar dispozitat e nenit 23 të kësaj Konvente, secili shtet palë shqyrton marrjen e masave legjislative dhe të tjera që mund të jenë të nevojshme për parashikimin si vepër penale, kur kryhet me qëllim pas kryerjes së një prej veprave penale të parashikuara sipas kësaj Konvente pa marrë pjesë në vepra të tilla fshehjen ose zotërimin e vazhdueshëm të pasurisë kur personi përkatës është në dijeni që kjo pasuri është rezultat i ndonjë prej veprave penale të kryera në pajtim me këtë Konventë.

Neni 25
Pengimi i drejtësisë

Secili shtet palë merr ato masa legjislative dhe të tjera që mund të jenë të nevojshme për të parashikuar si vepra penale, kur kryhen me qëllim:

a) përdorimin e forcës fizike, kërcënimeve ose frikësimit, apo premtimin, ofrimin ose dhënien e një avantazhi të parregullt për të mundësuar një deklarim të rremë ose për të ndërhyrë në dhënien e një deklarimi apo paraqitjen e provave në një gjykim në lidhje me kryerjen e veprave penale të parashikuara në pajtim me këtë Konventë.

b) përdorimin e forcës fizike, kërcënimeve ose fiksimeve për të ndërhyrë në ushtrimin e detyrave zyrtare nga nëpunës i drejtësisë ose i përmbarimit në lidhje me kryerjen e veprave penale të parashikuara sipas kësaj Konvente. Asgjë në këtë paragraf nuk cenon të drejtën e shteteve palë për të pasur legjislacionin në mbrojtje të kategorive të tjera të nëpunësve publikë.

Neni 26
Përgjegjësia e personave juridikë

1. Secili shtet palë aprovon masat e nevojshme, në pajtim me principet e tij ligjore, për të parashikuar përgjegjësinë e personave juridikë për pjesëmarrjen në veprat penale të parashikuara në pajtim me këtë Konventë.

2. Në varësi të principeve ligjore të shtetit palë, përgjegjësia e personave juridikë mund të jetë penale, civile ose administrative.

3. Kjo përgjegjësi nuk cenon përgjegjësinë penale të personave fizike që kanë kryer këto vepra penale.

4. Secili shtet palë siguron veçanërisht që personat juridikë, të cilët janë të përgjegjshëm sipas këtij neni, t'u nënshtrohen sanksioneve të efektshme, proporcionale dhe penguese, penale ose jopenale, duke përfshirë sanksionet penale.

Neni 27
Pjesëmarrja dhe tentativa

1. Secili shtet palë miraton ato masa legjislative dhe të tjera që janë të nevojshme për të parashikuar si vepra penale, në pajtim me ligjin e brendshëm, pjesëmarrjen në çfarëdolloj cilësie si bashkëpunëtor, ndihmës ose nxitës në një vepër penale të parashikuar sipas kësaj Konvente.

2. Secili shtet palë mund të aprovojë ato masa legjislative dhe të tjera që mund të jenë të nevojshme për të parashikuar si vepër penale, në pajtim me ligjin e vet të brendshëm, çdo përpjekje për të kryer një vepër penale të parashikuar në pajtim me këtë Konventë.

3. Secili shtet palë mund të miratojë ato masa legjislative ose të tjera që mund të jenë të nevojshme për të parashikuar si vepër penale, në pajtim me ligjin e brendshëm, përgatitjen për një vepër penale të parashikuar sipas kësaj Konvente.

Neni 28
Dijenia dhe qëllimi si elemente të një vepre penale

Dijenia dhe qëllimi i kërkuar si element i një vepre penale, i parashikuar në pajtim me këtë Konventë, mund të nxirren nga rrethanat faktike objektive.

Neni 29
Dispozitat e parashkrimit

Secili shtet palë, nëse është e përshtatshme, parashikon në ligjin e tij të brendshëm një periudhë të gjatë parashkrimi në të cilën duhet të fillojë gjykimi për çdo vepër penale të parashikuar në pajtim me këtë Konventë dhe parashikon një periudhë më të gjatë parashkrimi ose parashikon pezullimin e parashkrimit kur kryesuesi i prezumuar i veprës penale i është larguar dhënies së drejtësisë.

Neni 30
Ndjekja penale, gjykimi dhe sanksionet

1. Secili shtet palë mund t'ia nënshtrojë kryerjen e një vepre penale të parashikuar sipas kësaj Konvente sanksioneve që marrin parasysh seriozitetin e veprës penale.

2. Secili shtet palë merr ato masa që janë të nevojshme për vendosjen ose ruajtjen, në pajtim me sistemin e tij ligjor dhe principet kushtetuese, të një drejtpeshimi të përshtatshëm ndërmjet çdo imuniteti dhe privilegji juridiksional që u është dhënë nëpunësve të tij publikë për kryerjen e funksioneve të tyre dhe mundësisë, nëse është e nevojshme, për të hetuar, ndjekur penalisht dhe gjykuar veprat penale të parashikuara në pajtim me këtë Konventë.

3. Secili shtet palë përpiqet të garantojë që të gjitha kompetencat ligjore diskrecionare sipas ligjit të brendshëm në lidhje me ndjekjen penale të personave për veprat penale të parashikuara sipas kësaj Konvente të ushtrohen për të maksimalizuar efektivitetin e masave të përmbarimit në lidhje me ato vepra penale dhe duke pasur parasysh nevojën për pengimin e kryerjes së veprave penale të tilla.

4. Në rastin e veprave penale të parashikuara sipas kësaj Konvente, secili shtet palë merr masat e duhura, në pajtim me ligjin e tij të brendshëm dhe duke marrë parasysh si duhet rregullat e mbrojtjes, për të garantuar që kushtet e vendosura në lidhje me vendimet për lirimin, gjykimi në vazhdim ose gjykimi në apel të marrë parasysh nevojën për garantimin e pranisë së të pandehurit në gjykimet penale të mëvonshme.

5. Secili shtet palë merr parasysh seriozitetin e veprave penale përkatëse kur shqyrtohet mundësia e lirimit të hershëm ose e lirimit me kusht të personave të fajësuar për këto vepra penale.

6. Secili shtet palë, në masën që është në pajtim me principet themelore të sistemit të tij ligjor, merr në shqyrtim procedurat nëpërmjet të cilave një nëpunës publik, i akuzuar për një vepër penale të parashikuar sipas kësaj Konvente, nëse është e përshtatshme, mund të largohet, pezullohet ose riemërohet nga organi përkatës, duke pasur parasysh respektimin e principit të prezumimit të pafajësisë.

7. Kur kërkohet nga serioziteti i veprës penale, secili shtet palë, në masën që është në përputhje me principet themelore të sistemit të tij ligjor, shqyrton caktimin e procedurave për largimin e personave të fajësuar, me anë të një vendimi gjykate ose ndonjë mënyre tjetër të përshtatshme, për një periudhë të përcaktuar nga ligji i brendshëm, në pajtim me këtë Konventë nga:

a) mbajtja e një posti publik;

b) mbajtja e një posti në një ndërmarrje në pronësi të shtetit, tërësisht ose pjesërisht.

8. Paragrafi 1 i këtij neni nuk cenon ushtrimin e kompetencave disiplinore të organeve kompetente kundër punonjësve të shërbimit publik.

9. Asgjë në këtë Konventë nuk cenon principin, sipas të cilit përshkrimi i veprave penale të parashikuara në pajtim me këtë Konventë dhe të mbrojtjes ligjore të zbatueshme ose principe të tjera ligjore që rregullojnë ligjshmërinë e sjelljes i rezervohet ligjit të brendshëm të shteteve palë dhe se këto vepra penale ndiqen penalisht dhe dënohen në pajtim me atë ligj.

10. Shtetet palë përpiqen të nxitin riintegrimin në shoqëri të personave të fajësuar për veprat penale të parashikuara në pajtim me këtë Konventë.

Neni 31

Ngrirja, kapja dhe konfiskimi

1. Secili shtet palë, në masën më të madhe të mundur brenda sistemit të brendshëm ligjor, merr ato masa që mund të jenë të nevojshme për mundësinë e konfiskimit të:

a) të ardhurave nga krimi që rrjedhin nga veprat penale të parashikuara në pajtim me këtë Konventë ose pasurisë, vlera e së cilës përputhet me atë të të ardhurave të tilla;

b) pasurisë, pajisje ose mjete të tjera që përdoren ose janë të destinuara të përdoren në veprat penale të parashikuara në pajtim me këtë Konventë.

2. Secili shtet palë merr ato masa që mund të jenë të nevojshme për identifikimin, ndjekjen, ngrirjen ose kapjen e çdo sendi të referuar në paragrafin 1 të këtij neni për qëllimin e konfiskimit të mundshëm.

3. Secili shtet palë, në pajtim me ligjin e tij të brendshëm, miraton ato masa legjislative ose të tjera që mund të jenë të nevojshme për rregullimin e administrimit nga organet kompetente të pasurive të ngrira, kapura ose konfiskuara të përmendura në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni.

4. Nëse këto fitime nga krimi janë transformuar ose konvertuar, pjesërisht ose plotësisht, në pasuri tjetër, kjo pasuri u nënshtrohet masave të përmendura në këtë nen në vend të fitimeve.

5. Nëse fitimet nga krimi janë ngatërruar me pasuri të fituar nga burime të ligjshme, kjo pasuri, pa cenuar kompetencën për ngrirjen ose kapjen, mund të konfiskohet deri në vlerën e vlerësuar të fitimit që është përzier.

6. Të ardhurat ose privilegjet e tjera që kanë rrjedhur nga fitime nga krimi, nga pasuri ku fitimet nga krimi janë transformuar ose konvertuar ose nga pasuri me të cilat janë ngatërruar edhe fitimet nga krimi u nënshtrohen po ashtu masave të përmendura në këtë nen, në të njëjtën mënyrë dhe në të njëjtën masë si edhe fitimet nga krimi.

7. Për qëllimet e këtij neni dhe të nenit 55 të kësaj Konvente, secili shtet palë u jep kompetencë gjykatave të veta ose organeve të tjera kompetente për të urdhëruar që regjistrat bankarë, financiarë ose tregtarë të tregohen ose merren. Një shtet palë lë pa zbatuar këtë dispozitë të këtij paragrafi me arsyen e fshehtësisë së bankës.

8. Shtetet palë mund të shqyrtojnë mundësinë e kërkimit që një kryerës i një vepre penale të tregojë origjinën e këtyre fitimeve të prezumuara nga krimi ose të çdo pasurie tjetër që i nënshtrohet

konfiskimit, në masën që një kërkesë e tillë të jetë në përputhje me principet themelore të ligjit të tyre të brendshëm dhe me natyrën e procedurave gjyqësore dhe të tjera.

9. Dispozitat e këtij neni nuk interpretohen në mënyrë të tillë që të dëmtojnë të drejtën e mirëbesimit të palëve të treta.

10. Asgjë në këtë nen nuk cenon principin se masat të cilat ai u referohet përcaktohen dhe zbatohen dhe rregullohen në pajtim me dispozitat e ligjit të shtetit palë.

Neni 32

Mbrojtja e dëshmitarëve, ekspertëve dhe viktimave

1. Secili shtet palë merr masat e duhura, në pajtim me sistemin e brendshëm, dhe burimet e tij për t'u siguruar një mbrojtje të efektshme nga hakmarrja ose frikësimi i mundshëm dëshmitarëve dhe ekspertëve që japin deklarata në lidhje me dispozitat e parashikuara në pajtim me këtë Konventë dhe, nëse është e përshtatshme, për të afërmit e tyre dhe persona të tjerë të afërt me ta.

2. Masat e parashikuara në nenin 1 të këtij neni mund të përfshijnë, ndërmjet të tjerash, pa cenuar të drejtat e të pandehurit, duke përfshirë të drejtën e një procesi të rregullt:

a) caktimin e procedurave për mbrojtjen fizike të këtyre personave, siç është, në masën që është e nevojshme dhe e mundshme, ndërrimi i vendbanimit dhe lejimi, nëse është e përshtatshme, i mosnxjerrjes ose i kufizimeve në nxjerrjen e informacionit në lidhje me identitetin dhe vendndodhjen e këtyre personave;

b) caktimin e rregullave në lidhje me provat për të lejuar dëshmitarët dhe ekspertët të bëjnë deklarime në një mënyrë që të garantojnë sigurinë e këtyre personave, siç është lejimi i marrjes së deklaratës nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së komunikimit, si video ose mjetet të tjera të përshtatshme.

3. Shtetet palë shqyrtojnë lidhjen e marrëveshjeve ose marrjen e masave me shtete të tjera për ndërrimin e vendbanimit të personave të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni.

4. Dispozitat e këtij neni zbatohen gjithashtu edhe për viktimat për aq sa ato janë dëshmitarë.

5. Secili shtet palë, në pajtim me ligjin e tij të brendshëm, bën të mundur që mendimet dhe shqetësimet e viktimave të paraqiten dhe shqyrtohen në fazat e përshtatshme gjatë gjykimeve penale kundër kryerësve të veprave penale në një mënyrë që nuk cenon të drejtat e mbrojtjes.

Neni 33

Mbrojtja e personave raportues

Secili shtet palë shqyrton përfshirjen në sistemin e tij të brendshëm ligjor të masave të përshtatshme për të garantuar mbrojtjen kundër çdo trajtimi të pajustifikuar për çdo person që raporton në mirëbesim dhe për shkaqe të arsyeshme te organet kompetente çdo fakt në lidhje në veprat penale që parashikohen në pajtim me këtë Konventë.

Neni 34

Pasojat e akteve të korrupsionit

Duke pasur parasysh të drejtat e palëve të treta që janë përfituar në mirëbesim, secili shtet palë merr masa, në pajtim me principet themelore të ligjit të tij të brendshëm, për të trajtuar pasojat e korrupsionit. Në këtë kontekst, shtetet palë mund ta konsiderojnë korrupsionin një faktor të rëndësishëm në proceset gjyqësore për të anuluar një kontratë, tërhequr një koncesion ose një instrument tjetër të ngjashëm apo për të ndërmarrë një veprim tjetër ankimor.

Neni 35
Kompensimi i dëmit

Secili shtet palë merr ato masa që janë të nevojshme, në pajtim me principet e ligjit të tij të brendshëm, për të siguruar që subjektet ose personat që kanë pësuar një dëm si rezultat i një veprimi korrupsioni kanë të drejtën të nisin procese gjyqësore kundër personave përgjegjës për dëmin me qëllim që të marrin kompensim.

Neni 36
Organet e specializuara

Secili shtet palë, në pajtim me principet themelore të sistemit të tij ligjor, siguron ekzistencën e organit ose organeve apo personave të specializuar për luftën kundër korrupsionit me anë të organeve ekzekutive ligjore. Këtij organi ose këtyre organeve, apo personave u jepet pavarësia e nevojshme, në pajtim me principet themelore të sistemit ligjor të shtetit palë, për të qenë në gjendje të ushtrojnë funksionet e tyre me efektivitet dhe pa u influencuar në mënyrë të parregullt. Këta persona ose ky personel i këtij ose këtyre organeve duhet të ketë kualifikimet dhe burimet e nevojshme për të kryer detyrat e tyre.

Neni 37
Bashkëpunimi me organet e përmbarimit

1. Secili shtet palë merr masat e nevojshme për të inkurajuar personat që marrin pjesë ose kanë marrë pjesë në kryerjen e një vepre penale, të parashikuar sipas kësaj Konvente, të japin informacionin e dobishëm tek organet kompetente për qëllimet hetimore ose të evidentimit dhe të japin ndihmesë faktike dhe specifike te organet kompetente që mund të kontribuojnë në marrjen e fitimeve nga krimi prej kryerësit të veprës penale dhe në rimarrjen e fitimeve nga krimi.

2. Secili shtet palë shqyrton parashikimin e mundësisë, në rastet e duhura, për uljen e dënimit të një personi të akuzuar, i cili siguron bashkëpunim thelbësor në hetimin ose ndjekjen penale të një vepre penale të parashikuar në pajtim me këtë Konventë.

3. Secili shtet palë shqyrton parashikimin e mundësisë, në pajtim me principet themelore të ligjit të tij të brendshëm, të dhënies së imunitetit nga ndjekja penale një personi, i cili siguron bashkëpunim thelbësor në hetimin dhe ndjekjen penale të një vepre penale të parashikuar sipas kësaj Konvente.

4. Mbrojtja e këtyre personave bëhet, *mutatis mutandis,* sipas parashikimit të nenit 32 të kësaj Konvente.

5. Nëse një person i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, që është në një shtet palë, mund të sigurojë bashkëpunim thelbësor me organet kompetente të një shteti palë tjetër, shtetet palë të interesuara mund të shqyrtojnë hyrjen në marrëveshje ose të marrin masa, në pajtim me ligjin e tyre të brendshëm, në lidhje me dhënien e mundshme nga shteti tjetër palë i trajtimit të parashikuar në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni.

Neni 38
Bashkëpunimi ndërmjet organeve kombëtare

Secili shtet palë merr ato masa që janë të nevojshme për inkurajimin, në pajtim me ligjin e tij të brendshëm, e bashkëpunimit ndërmjet organeve publike, si dhe nëpunësve të tij publikë, nga njëra anë, dhe organeve që janë përgjegjëse për hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale nga ana tjetër. Ky bashkëpunim mund të përfshijë:

a) informimin e këtyre të fundit, me iniciativën e tyre, kur ka shkaqe të arsyeshme për të besuar se është kryer ndonjë nga veprat penale të parashikuara sipas neneve 15, 21 dhe 23 të kësaj Konvente, ose

b) dhënien, me kërkesë, këtyre organeve të gjithë informacionin e nevojshëm.

Neni 39
Bashkëpunimi ndërmjet organeve kombëtare dhe sektorit privat

1. Secili shtet palë merr ato masa që mund të jenë të nevojshme për të inkurajuar, në pajtim me ligjin e tij të brendshëm, bashkëpunimin ndërmjet organeve kombëtare hetimore dhe të ndjekjes penale dhe subjekteve në sektorin privat, sidomos institucionet financiare, në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me kryerjen e veprave penale të parashikuara në pajtim me këtë Konventë.

2. Secili Shtet Palë shqyrton inkurajimin e shtetasve të tij dhe personat me banim të zakonshëm në territorin e tij për të raportuar te organet kombëtare të hetimit dhe të ndjekjes penale për kryerjen e veprave penale të parashikuara në pajtim me këtë Konventë.

Neni 40
Fshehtësia e bankës

Secili Shtet Palë siguron që në rastin e hetimit të brendshëm të veprave penale të parashikuar në pajtim me këtë Konventë, të ketë mekanizma të përshtatshme brenda sistemit të tij të brendshëm ligjor për të kaluar pengesat që mund të lindin nga zbatimi i ligjeve për fshehtësinë e bankës.

Neni 41
Regjistri penal

Secili shtet palë mund të miratojë masa legjislative dhe të tjera që mund të jenë të nevojshme për marrjen parasysh, në bazë të kushteve dhe për qëllimet që ai i mendon të përshtatshme, çdo dënim të mëparshëm në një shtet tjetër të një kryerësi të prezumuar të një vepre penale për qëllimet e përdorimit të një informacioni të tillë në gjykimet penale që kanë të bëjnë me një vepër penale të parashikuar në pajtim me këtë Konventë.

Neni 42
Juridiksioni

1. Secili shtet palë merr ato masa që mund të jenë të nevojshme, për të vendosur juridiksionin e vet mbi veprat penale të parashikuara në këtë Konventë, nëse:

a) vepra penale është kryer në territorin e atij Shteti Palë; ose

b) vepra penale është kryer në bordin e një anijeje që mban flamurin e atij shteti palë ose të një avioni që është i regjistruar sipas ligjit të atij shteti palë në kohën që është kryer vepra penale.

2. Në bazë të nenit 4 të kësaj Konvente, një shtet palë mund të vendosë juridiksionin e tij mbi çdo vepër të tillë penale kur:

a) vepra penale është kryer kundër një shtetasi të atij shteti palë; ose

b) vepra penale është kryer nga një shtetas i atij shteti palë ose një person pa shtetësi i cili ka vendqëndrimin e zakonshëm në territorin e tij; ose

c) vepra penale është një prej veprave të parashikuara në pajtim me nenin 23, paragrafi 1, b, ii, i kësaj Konvente dhe është kryer jashtë territorit të tij me qëllimin e kryerjes së një vepre penale të parashikuar sipas nenit 23, paragrafi 1, a, i, ii, ose b, i, i kësaj Konvente brenda territorit të tij; ose

d) vepra penale kryhet kundër shtetit palë.

3. Për qëllimet e nenit 44 të kësaj Konvente, secili shtet palë merr ato masa që mund të jenë të nevojshme për të vendosur juridiksionin mbi veprat penale të parashikuara në pajtim me këtë Konventë, kur kryerësi i prezumuar i veprës penale është i pranishëm në territorin e tij dhe ai nuk e ekstradon atë person vetëm për shkak se ai ose ajo është një prej shtetasve të tij.

4. Secili shtet palë mund të marrë edhe ato masa që mund të jenë të nevojshme për të vendosur juridiksionin mbi veprat penale të parashikuara në pajtim me këtë Konventë, kur kryerësi i prezumuar i veprës penale është i pranishëm në territorin e tij dhe ai nuk e ekstradon atë.

5. Nëse një shtet palë që e ushtron juridiksionin e tij sipas paragrafit 1 ose 2 të këtij neni është njoftuar ose ka marrë dijeni në ndonjë mënyrë tjetër që disa shtete të tjera palë po bëjnë një hetim, ndjekje penale ose gjykim në lidhje me të njëjtën sjellje, organet kompetente të atyre shteteve palë, si të jetë e përshtatshme, konsultojnë njëri-tjetrin me qëllim që të koordinojnë veprimet e tyre.

6. Pa cenuar normat e së drejtës së përgjithshme ndërkombëtare, kjo Konventë nuk përjashton ushtrimin e çdo juridiksioni penal të caktuar nga një shtet palë në pajtim me ligjin e tij të brendshëm.

KAPITULLI IV
BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Neni 43
Bashkëpunimi ndërkombëtar

1. Shtetet palë bashkëpunojnë në sferën penale në pajtim me nenet 44 deri 50 të kësaj Konvente. Nëse është e përshtatshme dhe në pajtim me sistemin ligjor të brendshëm, shtetet palë shqyrtojnë të ndihmojnë njëri-tjetrin në hetimin dhe gjykimet e çështjeve civile dhe administrative që kanë të bëjnë me korrupsionin.

2. Në çështjet e bashkëpunimit ndërkombëtar, kurdoherë që kriminaliteti i dyfishtë është një kërkesë, ai konsiderohet i përmbushur pavarësisht nëse ligjet e shtetit palë pritës e vendosin ose jo veprën penale në të njëjtën kategori të veprave panele apo e emërtojnë ose jo veprën penale me të njëjtën terminologji, si dhe shteti palë dërgues, kur sjellja që është në bazë të veprës penale, për të cilën kërkohet ndihma juridike, është një vepër penale sipas ligjit të të dyja shteteve palë.

Neni 44
Ekstradimi

1. Ky nen zbatohet edhe për veprat penale të parashikuara në pajtim me këtë Konventë kur personi që përbën subjektin e kërkesës, për ekstradim është i pranishëm në territorin e shtetit palë pritës, me kusht që vepra penale për të cilën kërkohet ekstradimi është e dënueshme sipas ligjit të brendshëm si të shtetit palë kërkues, ashtu edhe të shtetit palë pritës.

2. Pa cenuar dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, një shtet palë, nëse ligji i tij e lejon, mund të lejojë ekstradimin e një personi për një nga veprat penale të mbuluara nga kjo Konventë që nuk janë të dënueshme sipas ligjit të vet të brendshëm.

3. Nëse kërkesa për ekstradim përfshin disa vepra penale të veçanta, të paktën një prej të cilave është e ekstradueshme sipas këtij neni dhe disa prej të cilave nuk janë të ekstradueshme për shkak të periudhës së burgimit, por kanë të bëjnë me veprat penale të parashikuara në pajtim me këtë Konventë, shteti palë pritës mund të zbatojë këtë nen edhe në lidhje me këto vepra penale.

4. Secila nga veprat penale për të cilat mund të zbatohet ky nen konsiderohen të përfshihen në veprat penale të ekstradueshme për çdo marrëveshje ekstradimi që ekziston ndërmjet shteteve palë. Shtetet palë marrin përsipër t'i përfshijnë këto vepra penale në veprat penale të ekstradueshme në çdo marrëveshje ekstradimi që do të lidhet ndërmjet tyre. Një shtet palë, nëse këtë e lejon ligji i tij, në rastet e përdorimit të kësaj Konvente si bazë për ekstradimin, nuk e konsideron asnjë nga veprat penale të parashikuara në pajtim me këtë Konventë si vepër penale politike.

5. Nëse një shtet palë, që e kushtëzon ekstradimin me ekzistencën e një marrëveshjeje, merr një kërkesë për ekstradim nga një shtet tjetër palë me të cilin ai nuk ka marrëveshje ekstradimi, ai mund ta konsiderojë këtë Konventë si bazë ligjore për ekstradimin në lidhje me çdo vepër penale për të cilën zbatohet ky nen.

6. Një shtet palë që e kushtëzon ekstradimin me ekzistencën e një marrëveshjeje:

a) në momentin e depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit në këtë Konventë, informon Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara nëse ai e merr këtë Konventë si bazë ligjore për bashkëpunimin mbi ekstradimin me shtetet e tjera palë në këtë Konventë dhe

b) nëse ai nuk e merr këtë Konventë si bazë ligjore për bashkëpunimin mbi ekstradimin, kërkon, kur është e përshtatshme, të lidhë marrëveshje ekstradimi me shtetet e tjera palë në këtë Konventë, me qëllim që të zbatojë këtë nen.

7. Shtetet palë që nuk e kushtëzojnë ekstradimin me ekzistencën e marrëveshjeve, i njeh veprat penale për të cilat zbatohet ky nen si vepra penale të ekstradueshme ndërmjet tyre.

8. Ekstradimi u nënshtrohet kushteve të parashikuara nga ligji i brendshëm i shtetit palë pritës ose nga marrëveshjet e zbatueshme për ekstradimin, duke përfshirë ndërmjet të tjerash, kushtet në lidhje me kërkesat minimale të dënimit për ekstradim dhe shkaqet për të cilat shteti palë pritës mund të refuzojë ekstradimin.

9. Shtetet palë, duke respektuar ligjin e tyre të brendshëm, përpiqen të shpejtojnë procedurat e ekstradimit dhe të thjeshtëzojnë kërkesat për prova në lidhje me to për çdo vepër penale ku zbatohet ky ligj.

10. Duke respektuar dispozitat e ligjit të brendshëm dhe marrëveshjet e ekstradimit, shteti palë pritës, duke qenë i bindur se kërkohet nga rrethanat urgjente dhe me kërkesën e shtetit palë dërgues, mund ta ndalojë personin për të cilin kërkohet ekstradimi dhe që është i pranishëm në territorin e tij ose të marrë masa të tjera të përshtatshme për të siguruar praninë e tij në procesin e ekstradimit.

11. Një shtet palë, në territorin e të cilit është gjetur një kryerës i prezumuar i një vepre penale dhe nëse ai nuk e ekstradon dot këtë person vetëm për shkakun se ai është një prej shtetasve të tij, me kërkesën e shtetit palë që kërkon ekstradimin, është i detyruar t'ua paraqesë çështjen pa vonesë organeve të veta kompetente për qëllimin e ndjekjes penale. Këto organe e marrin vendimin dhe e zhvillojnë gjykimin në të njëjtën mënyrë si për çdo vepër tjetër penale të një natyre të rëndë sipas ligjit të brendshëm të atij shteti palë. Shtetet palë të interesuara bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, sidomos në aspektet procedurale dhe të provave, për të siguruar efiçencën e këtij procedimi,

12. Kurdo që një shtet palë, sipas ligjit të tij të brendshëm, i lejohet të ekstradojë ose dorëzojë një shtetas të tij me kushtin që ai person të kthehet në shtetin palë për të vuajtur dënimin e dhënë si rezultat i gjykimit për të cilin kërkohej ekstradimi ose dorëzimi i personit dhe ai shtet palë si dhe shteti palë që kërkon ekstradimin e personit bien dakord me këtë dhe kushtet e tjera që ata mund t'i shohin të përshtatshme, ky ekstradim ose dorëzim me kushte është i mjaftueshëm për të përmbushur detyrimin e parashikuar në paragrafin 11 të këtij neni.

13. Nëse ekstradimi i kërkuar për qëllimet e ekzekutimit të një vendimi refuzohet sepse personi i kërkuar është shtetas i shtetit palë pritës, ky i fundit, nëse një gjë të tillë e lejon ligji i brendshëm dhe është në përputhje me përmbushjen e detyrimeve të këtij ligji, me kërkesën e shtetit palë dërgues, shqyrtojnë ekzekutimin e vendimit të dhënë sipas ligjit të brendshëm të shtetit palë kërkues ose të pjesës së tij të mbetur.

14. Çdo personi, në lidhje me të cilin po zhvillohet gjykimi për një nga veprat penale për të cilat zbatohet ky nen, i garantohet trajtim i drejtë në të gjitha shkallët e gjykimit, duke përfshirë gëzimin e të drejtave dhe garancive të parashikuara nga ligji i brendshëm i shtetit palë në territorin e të cilit ai person është i pranishëm.

15. Asgjë në këtë Konventë nuk interpretohet si vënie e një detyrimi për ekstradim, nëse shteti palë pritës ka arsye thelbësore për të besuar se kërkesa është bërë për qëllimin e procedimit ose dënimit të një personi për shkak të seksit, racës, fesë, kombësisë, origjinës etnike ose bindjet politike të personit ose kur përmbushja e kësaj kërkese do të shkaktonte dëme në gjendjen e personit për ndonjë nga këto arsye.

16. Shtetet palë nuk refuzojnë asnjë kërkesë për ekstradim me shkakun se vepra penale është konsideruar se ka të bëjë me çështje financiare.

17. Para refuzimit të ekstradimit, shteti palë pritës, nëse është e përshtatshme, konsultohet me shtetin palë kërkues për t'i dhënë atij mundësi të mjaftueshme për të paraqitur mendimet e tij dhe për të dhënë informacionin përkatës në lidhje me dyshimet e tij.

18. Shtetet palë kërkojnë të lidhin marrëveshje dypalëshe dhe shumëpalëshe ose marrin masa për të kryer ose rritur efiçencën e ekstradimit.

Neni 45

Transferimi i personave të dënuar

Shtetet palë mund të shqyrtojnë lidhjen e marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe ose marrjen e masave për transferimin në territorin e tyre të personave të dënuar me burgim ose forma të tjera të heqjes së lirisë për veprat penale të parashikuara në pajtim me këtë Konventë me qëllim që ata të përfundojnë vuajtjen e dënimit atje.

Neni 46

Asistencë ligjore e përbashkët

1. Shtetet palë do të kryejnë masën më të gjerë të asistencës ligjore të përbashkët në investigime, hedhje në gjyq dhe procedime gjyqësore në lidhje me krimet e mbuluara nga kjo Konventë.

2. Asistencë ligjore e përbashkët do t'i jepet, në madhësinë më të plotë të mundshme, sipas ligjeve përkatëse, traktateve, marrëveshjeve dhe rregullimeve të shtetit palë të kërkuar përsa i përket investigimeve, hedhjeve në gjyq dhe procedimeve gjyqësore në lidhje me krimet për të cilat një person ligjor mund të jetë përgjegjës në pajtim me nenin 26 të kësaj Konvente në shtetin palë kërkues.

3. Asistencë ligjore e dyfishtë duhet dhënë në përputhje me këtë nen mund të kërkohet për secilin nga qëllimet e mëposhtme:

a) Të merren deklaratat nga personat ose evidenca;

b) Kryhet shërbimi i dokumenteve gjyqësore;

c) Kryhet kërkim dhe kapje, dhe ngrirje;

d) Ekzaminim i objekteve dhe vendeve;

e) Sigurim informacioni, pika faktuale dhe vlerësime eksperte;

f) Sigurohen origjinalet e kopjeve të certifikuara të dokumenteve përkatëse dhe rekordet, duke përfshirë rekorde qeveritare, bankare, financiare, korporative ose biznesi;

g) Identifikimi ose ndjekja e të ardhurave të krimit, pronës, instrumenteve ose gjërave të tjera për qëllime faktuale;

h) Lehtësimi i shfaqjes vullnetare të personave në shtetin palë kërkues;

i) Çdo lloj tjetër asistence që nuk është kundër së drejtës së brendshme të shtetit palë të kërkuar;

j) Identifikimi, ngrirja dhe ndjekja e të ardhurave të krimit në pajtim me dispozitat e kapitullit V të kësaj Konvente;

k) Rikuperimi i aseteve, në përputhje me dispozitat e kapitullit V të kësaj Konvente.

4. Pa paragjykim ndaj së drejtës së brendshme, organet kompetente të një shteti palë, pa kërkesë paraprake, mund të transmetojnë informacion në lidhje me çështje penale te një organ kompetent në një tjetër shtet palë ku ata besojnë që ky informacion mund të asistojë organin në sipërmarrjen ose përfundimin e suksesshëm të kërkimeve të formuluara nga shteti palë i fundit sipas kësaj Konvente.

5. Transmetimi i informacionit sipas paragrafit 4 të këtij neni do të jetë pa paragjykim ndaj kontrolleve dhe procedimeve penale në shtetin e organeve kompetente që sigurojnë informacionin. Organet kompetente, duke marrë informacion, do të pajtohen me një kërkesë që informacioni i thënë të mbetet konfidencial, edhe përkohësisht, ose me kufizime në përdorimin e tij. Megjithatë, kjo nuk do të ndalojë shtetin palë marrës nga hapja e informacionit procedues që është fajësues për një

person të akuzuar. Në një rast të tillë, shteti palë marrës do të njoftojë shtetin palë transmetues përpara kësaj hapjeje dhe, nëse do të kërkohet, të konsultohet me shtetin palë transmetues. Nëse, në një rast të veçantë, njoftimi paraprak nuk është i mundur, shteti palë marrës do të informojë shtetin palë transmetues për hapjen pa vonesë.

6. Dispozitat e këtij neni nuk do të ndikojnë detyrimet nën çdo traktat tjetër, bilaterale ose multilaterale, që drejtojnë ose do të drejtojnë, plotësisht ose pjesërisht, asistencën ligjore të përbashkët.

7. Paragrafët 9 deri në 29 të këtij neni do të zbatohen për kërkesat e bëra sipas këtij neni nëse shtetet palë në fjalë nuk janë të detyruara nga një traktat i asistencës ligjore të përbashkët. Nëse ato shtete palë janë të lidhura me një traktat të tillë, dispozitat korresponduese e atij traktati do të zbatohen përveçse kur shtetet palë janë dakord të zbatojnë paragrafët 9 deri në 20 të këtij neni në lidhje me të. Shtetet palë janë të inkurajuara për të zbatuar ato paragrafë nëse ato lehtësojnë bashkëpunimin.

8. Shtetet palë nuk do të bien dakord për të bërë asistencë ligjore të përbashkët sipas këtij neni me arsye të sekretit bankar.

9. a) Një shtet palë i kërkuar, në përgjigje të një kërkese për asistencë sipas këtij neni, në mungesë të kriminalitetit të dyfishtë do të marrë në llogari qëllimet e kësaj Konvente, siç janë të vendosura në nenin 1;

b) Shtetet palë mund të lënë të bëjnë asistencën sipas këtij neni mbi arsye të mungesës së penalitetit të dyfishtë. Megjithatë, një shtet palë i kërkuar, atje ku është e përshtatur me konceptet bazë të sistemit të vetë ligjor, do të japin asistencë që nuk përfshin veprim shtrëngues. Një asistencë e tillë mund të refuzohet kur kërkesat që nuk përfshijnë çështje të një natyre *de minimis* ose çështje për të cilat bashkëpunimi ose asistenca e kërkuar është e mundshme sipas dispozitave të tjera të kësaj Konvente;

c) Secili shtet palë mund të marrë parasysh të adaptojë masa të tilla siç mund të jetë e nevojshme për të bërë të mundur të sigurojë një hapësirë më të gjerë të asistencës sipas këtij neni në mungesë të kriminalitetit të dyfishtë.

10. Një person, i cili është duke u mbajtur ose është duke vuajtur një dënim në territorin e një shteti palë, dhe që prezenca e të cilit kërkohet në një shtet tjetër palë, është kërkuar për qëllime identifikimi, dëshmie ose përndryshe që siguron asistencë në marrjen e evidencës për investigime, hedhje në gjyq ose procedime gjyqësore në lidhje me krimet e mbuluara nga kjo Konventë mund të transferohet nëse kushtet e mëposhtme përmbushen:

a) personi jep lejen e tij ose të saj me informacion;

b) organet kompetente të të dyja shteteve palë kanë rënë dakord, subjekt i kushteve të tilla siç ato palë mund ta shikojnë të përshtatshme.

11. Për qëllime të paragrafit 10 të këtij neni:

a) shteti palë për të cilin personi transferohet do të ketë autoritetin dhe detyrimin për të mbajtur personin e transferuar nën vëzhgim, përveçse kur kërkohet ndryshe ose autorizohet nga shteti palë nga i cili personi u transferua;

b) shteti palë për të cilin personi transferohet do të zbatojë pa vonesë detyrimin e tij për të kthyer personin nën mbajtje të detyruar të shtetit palë nga i cili personi ishte transferuar siç është rënë dakord më përpara ose dakorduar nga organet kompetente të të dyja shteteve palë;

c) shteti palë për të cilin personi transferohet nuk do t'i kërkojë shtetit palë nga i cili personi u transferua të fillojë ekstradimin për kthimin e personit;

d) personi i transferuar do të marrë kredi për shërbim të dënimit që kryhet në shtetin nga i cili ai ose ajo u transferua për kohën e shpenzuar në mbajtje të detyruar në shtetin palë në të cilin ai ose ajo u transferua.

12. Përveç se kur shteti palë nga i cili një person duhet transferuar në pajtim me paragrafët 10 dhe 11 të këtij neni, ka rënë dakord që ai person, çfarëdo që të jetë nacionaliteti i tij, nuk do të hidhet në gjyq, mbahet, dënohet ose vihet nën çdo kufizim tjetër në lirinë e tij personale në territorin e shtetit për të cilin ai person është transferuar përsa i përket akteve, shuajtjeve ose bindjeve përpara largimit të tij ose saj nga territori i shtetit nga i cili ai ose ajo u transferua.

13. Secili shtet palë do të caktojë një organ qendror që do të ketë përgjegjësinë dhe fuqinë për të marrë kërkesa për asistencë të dyfishtë ligjore dhe nëse për t'i ekzekutuar ato ose për të transmetuar ato në organet kompetente për ekzekutim. Atje ku shteti palë ka një regjion specifik ose territor me një sistem të ndarë të asistencës së dyfishtë ligjore, ai mund të caktojë një organ të caktuar qendror që do të ketë të njëjtin funksion për atë regjion ose territor. Organet qendrore do të sigurojnë ekzekutimin e shpejtë dhe të duhur të transmetimit të kërkesave të marra. Atje ku organi qendror transmeton kërkesën për një organ kompetent për ekzekutim, do të inkurajojë ekzekutimin e shpejtë dhe të duhur të kërkesës nga organi kompetent. Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së do të njoftohet për organin qendror të caktuar për këtë qëllim në kohën që çdo shtet palë depoziton instrumentin e tij të ratifikimit, pranimin ose aprovimin e hyrjes në këtë Konventë. Kërkesa për asistencë ligjore të dyfishtë dhe çdo komunikim i lidhur me të do të transmetohet në organet qendrore të caktuara nga shtetet palë. Kjo kërkesë do të jetë pa paragjykim për të drejtën e një shteti palë të kërkojë që kërkesa të tilla dhe komunikime t'i adresohen atij nëpërmjet kanaleve diplomatike dhe, në rrethana urgjente, ku shtetet palë bien dakord, nëpërmjet Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Penale nëse është e mundur.

14. Kërkesat do t'i bëhen me shkrim ose, atje ku është e mundur, me çdo mënyrë të aftë për të prodhuar një rekord me shkrim, në një gjuhë të pranueshme për shtetin palë të kërkuar, nën kushtet që lejojnë që shteti palë të vendosë autenticitetin e tij. Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së do të njoftohet për gjuhën ose gjuhët e pranueshme për çdo shtet palë në kohën që ajo depoziton instrumentin e tij të ratifikimit, pranimit ose aprovimit për hyrjen në këtë Konventë. Në rrethana urgjente dhe ku është rënë dakord nga shtetet palë, kërkesat mund të bëhen me gojë por do të konfirmohen me shkrim më pas.

15. Një kërkesë për asistencë të dyfishtë ligjore do të përmbajë:

a) Identitetin e organit që bën kërkesën;

b) Çështjen dhe natyrën e investigimit, hedhjes në gjyq ose procedimit gjyqësor për të cilin kërkesa lidhet dhe emri dhe funksionet e autoritetit që merret me investigimin, hedhjen në gjyq ose procedimin gjyqësor;

c) Një përmbledhje të fakteve përkatëse, përveç në lidhje me kërkesat për qëllim të shërbimit të dokumenteve gjyqësore;

d) Një përshkrim të asistencës së marrë dhe detaje e çdo procedura të veçantë që shtetit Palë kërkues dëshiron të ndiqen:

e) Atje ku është e mundur, identitetin, vendndodhjen dhe nacionalitetin e çdo personi përkatës;

f) Qëllimin për të cilin evidenca, informacioni ose veprimi kërkohet.

16. Shteti palë i kërkuar mund të kërkojë informacion të mëtejshëm kur të duket e nevojshme për ekzekutimin e kërkesës në përputhje me të drejtën e brendshme ose kur mund të lehtësojë një ekzekutim të tillë.

17. Një kërkesë do të ekzekutohet në pajtim me të drejtën e brendshme të shtetit palë të kërkuar dhe, për madhësinë jo kundër së drejtës së brendshme të shtetit palë të kërkuar dhe ku është e mundur, në pajtim me procedurat e specifikuara në kërkesë.

18. Kurdo që është e mundur dhe në pajtim me parimet themelore të së drejtës së brendshme, kur një individ është në territorin e një shteti palë dhe duhet dëgjuar si një dëshmitar ose ekspert në organet gjyqësore të një tjetër shteti palë, shteti palë i parë mundet, me kërkesën e tjetrit, të lejojë një seancë të bëhet me anë të konferencës me video nëse nuk është e mundur ose e dëshirueshme për individin në fjalë të shfaqet në person në territorin e shtetit palë kërkues. Shtetet palë mund të bien dakord që seanca do të kryhet nga një organ gjyqësor i shtetit palë kërkues dhe e ndjekur nga një organ gjyqësor i shtetit palë të kërkuar.

19. Shteti palë kërkues nuk do të transmetojë ose përdorë informacion ose evidencë të siguruar nga shteti palë i kërkuar për investigime, hedhje në gjyq ose procedime gjyqësore përveç ato të thëna në kërkesën pa leje të mëparshme të shtetit palë të kërkuar. Asgjë në këtë paragraf nuk do ta ndalojë shtetin palë kërkues të hapë informacionin e procedimit ose evidencë që është fajësuese për një person të akuzuar. Në rastin e fundit, shteti palë kërkues do të njoftojë shtetin palë të

kërkuar përpara hapjes dhe, nëse kërkohet, do të konsultohet me shtetin palë të kërkuar. Nëse, në një rast të jashtëzakonshëm, njoftimi paraprak nuk është i mundur, shteti palë kërkues do të informojë shtetin palë të kërkuar për hapjen pa vonesë.

20. Shteti palë kërkues mund të kërkojë që shteti palë i kërkuar të mbajë konfidenciale faktin dhe substancën e kërkesës, përveç për madhësinë e nevojshme për të ekzekutuar kërkesën. Nëse shteti palë i kërkuar nuk mund të bjerë dakord me kërkesën e konfidencialitetit, ai do të informojë menjëherë shtetin palë kërkues.

21. Asistenca ligjore e dyfishtë mund të refuzohet:

a) nëse kërkesa nuk është bërë konform dispozitave të këtij neni;

b) nëse shteti palë i kërkuar konsideron që ekzekutimi i kërkesës është paragjykues ndaj sovranitetit të tij, sigurisë, rendit publik ose interesave të tjera;

c) nëse organet e shtetit palë të kërkuar do të ndaloheshin nga e drejta e brendshme për të kryer veprimin e kërkuar për sa i përket ndonjë krimi të njëjtë, do të ishte subjekt investigimi, hedhjeje në gjyq ose procedime gjyqësore nën juridiksionin e tyre;

d) nëse do të ishte kundër sistemit ligjor të shtetit palë të kërkuar që ka të bëjë me asistencë ligjore të dyfishtë për kërkesën që duhet dhënë.

22. Shtetet Palë nuk mund të refuzojnë një kërkesë për asistencë të dyfishtë ligjore vetëm me arsyen se krimi është i konsideruar të përfshijë çështje fiskale.

23. Arsyet do të jepen për çdo refuzim të asistencës ligjore të dyfishtë.

24. Shteti palë i kërkuar do të ekzekutojë kërkesën për asistencë ligjore të dyfishtë sa më shpejt të jetë e mundur dhe do të marrë konsideratë të plotë të çdo afati të sugjeruar nga shteti palë kërkues dhe për të cilin arsyet janë dhënë, preferohet në kërkesë. Shteti palë kërkues mund të bëjë kërkesa të arsyeshme për informacion mbi statusin dhe progresin e masave të marra nga shteti palë i kërkuar për të përmbushur kërkesën e tij. Shteti palë i kërkuar do t'i përgjigjet kërkesave të arsyeshme nga shteti palë i kërkues mbi statusin, dhe progresin në zgjidhjen e tij, të kërkesës. Shteti palë kërkues do të informojë menjëherë shtetin palë të kërkuar kur asistenca e kërkuar nuk kërkohet më.

25. Asistenca e dyfishtë ligjore mund të shtyhet nga shteti palë i kërkuar mbi arsye që ndërhyn me një investigim në vazhdim, hedhje në gjyq ose procedim gjyqësor.

26. Përpara se të refuzojë një kërkesë sipas paragrafit 21 të këtij neni ose duke shtyrë ekzekutimin e tij sipas paragrafit 25 të këtij neni, shteti palë i kërkuar do të konsultohet me shtetin palë kërkues për të konsideruar nëse asistenca mund të jepet sipas termave të tillë dhe kushteve siç e bën të nevojshme. Nëse shteti palë kërkues pranon asistencë sipas këtyre kushteve, do të pajtohet me kushtet.

27. Pa paragjykim për zbatimin e paragrafit 12 të këtij neni, një dëshmitar, ekspert ose person tjetër, i cili, me kërkesën e shtetit palë kërkues, lejon për të dhënë evidencë në një procedim ose të asistojë në një investigim, hedhjen në gjyq ose procedim gjyqësor në territorin e shtetit palë kërkues nuk do të dënohet, mbahet ose vihet nën ndonjë kufizim për lirinë e tij ose të saj në atë territor për sa i përket akteve, lejimeve ose dënimeve përpara largimit të tij ose saj nga territori i shtetit palë të kërkuar. Kjo sjellje e sigurt do të përfundojë kur dëshmitari, eksperti ose person tjetër që ka pasur, për një periudhë të 15 ditëve ose për çdo periudhë që është rënë dakord nga shtetet palë nga data në të cilën ai ose ajo ka qenë informuar zyrtarisht që prezenca e tij ose e saj nuk është më e kërkuar nga organet gjyqësore, një mundësi për të lënë, megjithatë ka mbetur vullnetarisht në territorin e shtetit palë kërkues ose që pasi është larguar, është kthyer me dëshirën e vetë të lirë.

28. Kostot e zakonshme të ekzekutimit të një kërkese do të lindin nga shteti palë i kërkuar përveçse kur është rënë dakord nga shtetet palë përkatëse. Nëse shpenzimet e një natyre substanciale ose të jashtëzakonshme janë ose do të kërkohen të përmbushin kërkesën, shtetet palë do të konsultohen për të vendosur termat dhe konditat nën të cilat kërkesa do të ekzekutohen sikurse dhe mënyra në të cilën kostot do të krijohen.

29. Shteti palë i kërkuar:

a) do të sigurojë për shtetin palë kërkues kopje të rekordeve qeveritare, dokumenteve ose informacionit në zotërim të tij që nën të drejtën e brendshme janë të ofruara për publikun e gjerë;

b) në gjykimin e tij, mundet të sigurojë shtetin palë kërkues në përgjithësi, pjesërisht ose subjekt i kushteve të tilla siç duket e përshtatshme, kopje të çdo rekordi qeveritar, dokumente ose informacion në zotërim të tij që nën të drejtën e brendshme nuk janë të ofruara për publikun e përgjithshëm.

30. Shtetet palë do të konsiderojnë, siç mund të jetë e nevojshme, mundësinë e lidhjes së marrëveshjeve bilaterale ose multilaterale ose rregullimeve që do t'i shërbenin qëllimit të dhënit efekt praktik për të rritur dispozitat e këtij neni.

Neni 47

Transferimi i procedimeve penale

Shtetet palë do të konsiderojnë mundësinë e transferimit për njëri-tjetrin të procedimeve për hedhjen në gjyq të një krimi të vendosur në përputhje me këtë Konventë në rastet kur një transferim i tillë është konsideruar të jetë në interes të administrimit të duhur të drejtësisë, veçanërisht në raste ku shumë juridiksione janë përfshirë, me një pikëpamje për t'u përqendruar në hedhjen në gjyq.

Neni 48

Bashkëpunimi në shtrëngimin e ligjit

1. Shtetet palë do të bashkëpunojnë afër njëri-tjetrit, në pajtim me sistemet e tyre të brendshme administrative dhe ligjore, për të rritur efektivitetin e veprimit të zbatimit të ligjit për të luftuar krimet e mbuluara nga kjo Konventë. Shtetet palë do të marrin masa të efektshme:

a) për të rritur dhe, atje ku është e nevojshme, të ngrihen kanale komunikimi midis organeve të tyre kompetente, agjencive dhe shërbimeve, në mënyrë që të sigurojë këmbimin e shpejtë dhe të sigurt të informacionit që ka të bëjë me të gjitha aspektet e krimeve të kryera nga kjo Konventë, duke përfshirë, nëse shtetet palë përkatëse e konsiderojnë të duhur, lidhje me aktivitete të tjera penale;

b) të bashkëpunojë me shtete palë të tjera në kryerjen e kontrolleve për sa i përket krimeve të kryera nga kjo Konventë që kanë të bëjnë me:

i) identitetin, vendndodhjen dhe aktivitetet e personave të dyshuar për përfshirje në krime të tilla ose vendndodhjen e personave të tjerë përkatës;

ii) lëvizjen e të ardhurave të krimit ose pronës së ardhur nga komisioni i krimeve të tilla;

iii) lëvizjen e pronës, pajisjeve ose instrumenteve të tjera të përdorura ose të destinuara për përdorim në komisionin e krimeve të tilla;

c) të sigurojë, atje ku është e nevojshme, objekte ose sasi substancash për qëllime analitike ose investiguese;

d) të këmbejë, atje ku është e përshtatshme, informacion me shtete palë të tjera që kanë të bëjnë me mënyra dhe metoda specifike të përdorura për të kryer krime të mbuluara nga kjo Konventë, duke përfshirë përdorimin e identiteteve false, të falsifikuara dhe mënyra të tjera të fshehjes së aktiviteteve;

e) të lehtësojë koordinimin efektiv midis organeve të tyre kompetente, agjencive dhe shërbimeve dhe të promovojë këmbimin e personelit dhe ekspertëve të tjerë, duke përfshirë, subjekt për marrëveshje bilaterale ose rregullime midis shteteve palë përkatëse, vendosjen e oficerëve përfaqësues;

f) të këmbehet informacion dhe të koordinohen masa administrative dhe të tjera masa të marra për qëllime të identifikimit të hershëm të krimeve të mbuluara nga kjo Konventë.

2. Duke pasur parasysh që të vihet në fuqi kjo Konventë, shtetet palë do të konsiderojnë hyrjen në marrëveshje bilaterale dhe multilaterale ose rregullime mbi bashkëpunim direkt midis agjencive të tyre të shtrëngimit të ligjit, dhe atje ku marrëveshje të tilla ose rregullime ekzistojnë, duke i ndryshuar ato. Në mungesë të marrëveshjeve të tilla ose rregullime midis shteteve palë përkatëse, shtetet palë mund të konsiderojnë këtë Konventë të jetë baza për bashkëpunim të përbashkët në zbatimin e ligjit për sa i përket krimeve të mbuluara nga kjo Konventë. Atje ku është

e përshtatshme, shtetet palë do të bënin përdorim të plotë të marrëveshjeve ose rregullimeve, duke përfshirë organizata ndërkombëtare ose rajonale, për të rritur bashkëpunimin midis agjencive të zbatimit të ligjit.

3. Shtetet palë do të bashkëpunojnë në mënyrë që t'u përgjigjen krimeve të mbuluara nga kjo Konventë të kryera nëpërmjet përdorimit të teknologjisë moderne.

Neni 49
Investigime të përbashkëta

Shtetet palë do të konsiderojnë përfundimin e marrëveshjeve ose rregullimeve multilaterale, në lidhje me çështje që janë subjekt i investigimeve, hedhjes në gjyq në një ose më shumë shtete, organet kompetente përkatëse mund të ngrenë organe investigative të përbashkëta. Në mungesë të marrëveshjeve të tilla ose rregullimeve, investigime të përbashkëta mund të ndërmerren me anë të marrëveshjeve në bazë çështje të veçantë. Shtetet palë të përfshira do të sigurojnë që sovraniteti i shtetit palë në territorin e të cilit një investigim i tillë të ndodhë është i respektuar plotësisht.

Neni 50
Teknika të veçanta investigative

1. Në mënyrë që të luftohet korrupsioni në mënyrë efektive, çdo shtet palë, në hapësirën e lejuar nga parimet bazë të sistemit të tij ligjor dhe në përputhje me kushtet e përshkruara nga e drejta e brendshme, marrin masa të tilla siç mund të jetë e nevojshme, brenda së drejtës së brendshme, për të lejuar përdorimin e duhur nga organet kompetente të dorëzimit të kontrolluar dhe, ku është e duhur, teknika të tjera investigative speciale, si forma elektronike të ruajtjes dhe operacione të fshehta brenda territorit të saj, dhe për të lejuar pranueshmërinë në gjykatë të evidencës së ardhur nga ato.

2. Për qëllime të investigimit të krimeve të mbuluara nga kjo Konventë, shtetet palë janë të inkurajuara të përfundojnë, kur është e nevojshme, marrëveshje bilaterale ose multilaterale, ose rregullime për përdorimin e teknikave të tilla investigative në kontekstin e bashkëpunimit në nivel ndërkombëtar. Marrëveshje të tilla do të kryhen dhe zbatohen në pajtim të plotë me principin e barazisë së shteteve dhe të kryhen në përputhje me termat e atyre marrëveshjeve ose rregullimeve.

3. Në mungesë të një marrëveshjeje ose rregullimi, siç është paraqitur në paragrafin 2 të këtij neni, vendimet për të përdorur teknika kaq të veçanta investigative në nivel ndërkombëtar do të bëhet mbi një bazë çështje dhe mundet që, kur të jetë e nevojshme, të merren parasysh rregullimet financiare dhe mirëkuptimet për sa i përket ushtrimit të juridiksionit të shteteve palë përkatëse.

4. Vendimet për të përdorur dorëzim të kontrolluar në nivel ndërkombëtar, mund të përfshijnë metoda si ndërhyrja dhe lejimi i mallrave ose fondeve të vazhdojnë të paprekura ose të hiqen, ose zëvendësohen, plotësisht ose pjesërisht, me lejen e shteteve palë përkatëse.

KAPITULLI V
RIKUPERIMI I ASETEVE

Neni 51
Dispozitë e përgjithshme

Kthimi i aseteve sipas këtij kapitulli është një princip themelor i kësaj Konvente dhe shtetet palë i lejojnë njëra-tjetrës masën më të gjerë të bashkëpunimit dhe asistencës në këtë fushë.

Neni 52
Ndalimi dhe dallimi i transferimeve të të ardhurave nga krimi

1. Pa paragjykim për nenin 14 të kësaj Konvente, secili shtet palë do të marrë masa, siç mund të jetë e nevojshme, në përputhje me të drejtën e brendshme, për t'i kërkuar institucioneve

financiare brenda juridiksionit të tij të verifikojnë identitetin e klientëve, për të ndërmarrë hapa të arsyeshëm për të vendosur identitetin e pronarëve përfitues të fondeve të depozituara në llogari me vlerë të lartë dhe për të kryer kontrolle të larta të llogarive të hapura ose të mbajtura nga individë që janë ose kanë qenë të besuar me funksione të rëndësishme publike, si dhe familjet dhe bashkëpunëtorët e tyre. Një kontroll kaq i imtësishëm do të ishte i projektuar për të dalluar transaksione të dyshimta për qëllime raportimi ndaj organeve kompetente, por nuk duhen shtrënguar në mënyrë të tillë që të diskurajojnë ose ndalojnë institucionet financiare nga kryerja e biznesit me çdo klient legjitim.

2. Për të lehtësuar zbatimin e masave të siguruara në paragrafin 1 të këtij neni, çdo shtet palë, në pajtim me të drejtën e brendshme dhe e inspiruar nga iniciativa përkatëse të organizatave regjionale, ndërregjionale dhe multilaterale kundër pastrimit të parave:

a) do të dorëzojnë këshilla për sa i përket llojeve të personave, fizikë ose juridikë, ndaj llogarive të të cilëve do të aplikojnë kontroll të lartë, llojeve të llogarive dhe transaksioneve për të cilat të paguajnë vëmendje të veçantë dhe hapje llogarie të duhur, mbajtje dhe masa regjistrimi ndaj llogarive të tilla; dhe

b) atje ku është e duhur, do të njoftojnë institucionet financiare brenda juridiksionit të tyre, me kërkesën e një tjetër shteti palë ose edhe me iniciativë të vetën, rreth identitetit të personave të veçantë, fizikë ose juridik, për llogaritë e të cilëve këto institucione pritet që të kryejnë kontroll të lartë, edhe për ata që mund të identifikohen nga institucionet financiare.

3. Në kontekstin e paragrafit 2 (a) të këtij neni, çdo shtet palë do të zbatojë masa për të siguruar që institucionet e tij financiare të mbajnë regjistër të rregullt, për një periudhë të duhur kohore, për llogaritë dhe transaksionet që përfshijnë persona të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, që duhet, minimalisht, të përmbajnë informacion lidhur me identitetin e klientit, sikurse edhe, për sa është e mundur, të pronarit përfitues.

4. Me qëllim ndalimin dhe zbulimin e transferimeve të të ardhurave nga krimet sipas kësaj Konvente, secili shtet palë do të zbatojë masa të duhura dhe efektive për të ndaluar, me ndihmën e organeve të tij rregulluese dhe mbikëqyrëse, ngritjen e bankave që nuk kanë prezencë fizike dhe që nuk janë të lidhura me një grup financiar të rregulluar. Për më tepër, shtetet palë mund të konsiderojnë t'i kërkojnë institucioneve të tyre financiare të refuzojnë të hyjnë në ose të vazhdojnë një marrëdhënie korresponduese bankare me institucione të tilla dhe të ruajnë nga ngritja e marrëdhënieve me institucione të huaja financiare që lejojnë llogaritë e tyre të përdoren nga banka që nuk kanë prezencë fizike dhe që nuk janë të lidhura me një grup financiar të rregulluar.

5. Secili shtet palë do të marrë parasysh të ngrejë, në përputhje me të drejtën e brendshme, sisteme të efektshme të hapjes financiare për zyrtarë të përshtatshëm publikë dhe do të sigurojë sanksione për moskryerje. Secili shtet palë do të konsiderojë gjithashtu të marrë masa të tilla siç mund të jetë e nevojshme për të lejuar organet e saj kompetente në shtete të tjera palë kur është e nevojshme për të investiguar, marrë përsipër dhe rikuperojë të ardhura nga krimet e ngritura në përputhje me këtë Konventë.

6. Secili shtet palë do të marrë parasysh të ngrejë, në përputhje me të drejtën e brendshme, për të kërkuar zyrtarë publikë që kanë një interes ose t'i kërkojnë zyrtarëve publikë të interesuar, kanë nënshkruar ose fuqi tjetër mbi një llogari financiare të një vendi të huaj të raportojë atë marrëdhënie në organet kompetente dhe të mbajë regjistër të rregullt për këto llogari. Masa të tilla do të sigurojnë gjithashtu për sanksione të duhura për mospërputhje.

Neni 53
Masat për rikuperim direkt të pronës

Secili shtet palë do të kryejë në përputhje me të drejtën e brendshme:

a) Merr masa siç mund të jetë e nevojshme për të lejuar një tjetër shtet palë të iniciojë veprim civil në gjykatat e tij për të fituar pronësi nëpërmjet komisionit për një krim të vendosur në përputhje me këtë Konventë;

b) Merr masa siç mund të jetë e nevojshme për të lejuar gjykatat e tij të urdhërojnë ata që kanë kryer krime, e vendosur në përputhje me këtë Konventë, për të paguar kompensim ose dëme ndaj një tjetër shteti palë që është dëmtuar nga krime të tilla; dhe

c) Merr masa siç mund të jetë e nevojshme për të lejuar gjykatat e tij ose organet kompetente kur duhet të vendosin mbi konfiskimin, për të njohur një deklaratë të një shteti palë tjetër si një pronar legjitim i pronës së fituar nëpërmjet komisionit të një krimi të ngritur në pajtim me Konventën.

Neni 54

Mekanizma për rikuperimin e pronës nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar në konfiskim

1. Secili shtet palë, në mënyrë që të sigurojë asistencë të dyfishtë ligjore sipas nenit 55 të kësaj Konvente për sa i përket pronës së fituar nëpërmjet ose të përfshirë në komision ndaj një krimi të vendosur në pajtim me këtë Konventë, në pajtim me të drejtën e brendshme:

a) do të marrë masa, siç mund të jetë e nevojshme, për të lejuar organet e tij kompetente të vënë në përdorim një urdhër konfiskimi të lëshuar nga një gjykatë për një tjetër shtet palë;

b) do të marrë masa, siç mund të jetë e nevojshme, për të lejuar organet e tij kompetente që, atje ku kanë juridiksionin e tyre, të urdhërojnë konfiskimin e një prone të tillë të një origjine të huaj me anë të një gjykimi të pastrimit të parave ose ndonjë krimi tjetër siç mund të jetë brenda juridiksionit të tij ose me anë të procedurave të autorizuara nën të drejtën e tij të brendshme; dhe

c) do të konsiderojë të marrë masa të tilla për të lejuar konfiskimin e një prone të tillë pa një dënim penal, në rastet në të cilat kryesi i krimit nuk mund të dënohet me anë të vdekjes, braktisjes ose mungesës ose në rastet të tjera të përshtatshme.

2. Secili shtet palë, në mënyrë që të sigurojë asistencë të dyfishtë ligjore me kërkesën e bërë sipas paragrafit 2 të nenit 55 të kësaj Konvente, sipas së drejtës së brendshme:

a) do të marrë masa, siç mund të jetë e nevojshme, për të lejuar organet e tij kompetente që të ngrijnë ose të kapin pronë me një urdhër kapjeje ose ngrirjeje të lëshuar nga një gjykatë ose organ kompetent i një shteti palë kërkues që siguron një bazë të arsyeshme për shtetin palë e kërkuar të besojë se ka arsye të mjaftueshme për të marrë një veprim të tillë dhe që prona do të ishte subjekt i një urdhri konfiskimi për qëllime të paragrafit 1 (a) të këtij neni;

b) do të marrë masa, siç mund të jetë e nevojshme, për të lejuar organet e tij kompetente që të ngrijnë ose të kapin pronë me një kërkesë që siguron një bazë të arsyeshme për shtetin palë, e kërkuar të besojë se ka arsye të mjaftueshme për të marrë një veprim të tillë dhe që prona do të ishte subjekt i një urdhri konfiskimi për qëllime të paragrafit 1 (a) të këtij neni; dhe

c) do të konsiderojë marrjen e masave të tjera për të lejuar organet e veta kompetente të ruajnë pronën për konfiskim, në mënyrë të tillë që në bazë të urdhrit të arrestit të lidhur me marrjen e një prone të tillë.

Neni 55

Bashkëpunimi ndërkombëtar për qëllime të konfiskimit

1. Një shtet palë që ka marrë një kërkesë nga një tjetër shtet palë që ka juridiksion mbi një krim, sipas kësaj Konvente, për konfiskimin e të ardhurave nga krimi, prona, pajisje ose instrumente të tjera të referuara në nenin 31 paragrafi 1 të kësaj Konvente të vendosur në territorin e saj, në madhësinë më të madhe të mundur brenda sistemit të brendshëm ligjor:

a) do të dorëzojë kërkesën për organet kompetente për qëllim të marrjes së një urdhri konfiskimi dhe, nëse një urdhër i tillë është dhënë, t'i japi fuqi atij; ose

b) do të dorëzojë tek organet kompetente, me një qëllim për t'i dhënë fuqi në madhësinë e kërkuar, një urdhri konfiskimi të lëshuar nga një gjykatë në territorin e shtetit palë kërkues në përputhje me nenet 31 paragrafi 1, dhe 54 paragrafi 1(a) të kësaj Konvente përsa lidhet me të ardhurat nga krimi, prona ose pajisje, ose instrumentalitete të tjera të referuara në nenin 31 paragrafi 1 të vendosur në territorin e shtetit palë.

2. Sipas një kërkese të bërë nga një tjetër shtet palë që ka juridiksion mbi një krim sipas kësaj Konvente, shteti palë i kërkuar do të marrë masa për të identifikuar, ndjekur dhe kapur të ardhura nga krimi, prona ose pajisje ose instrumentalitete të tjera të referuara në nenin 31 paragrafi 1 të kësaj Konvente përsa lidhet me konfiskimin që duhet urdhëruar ose nga shteti palë kërkues ose sipas një kërkese sipas paragrafit 1 nga shteti palë i kërkuar.

3. Dispozitat e nenit 46 të kësaj Konvente janë të aplikueshme, *mutatis mutandis*, për këtë nen. Përveç informacionit të specifikuar në nenin 46 paragrafi 154, kërkesat e bëra sipas këtij neni përmbajnë:

a) Në rast kur një kërkesë që ka të bëjë me paragrafin 1 (a) të këtij neni, një përshkrim i pronës që duhet konfiskuar, duke përfshirë, në madhësinë e mundur, vendin dhe, atje ku do ishte e përshtatshme, vlerën e çmuar të pronës dhe një deklaratë të fakteve të mbështetur mbi shtetin palë kërkues të mjaftueshëm për të bërë të mundur shtetin palë të kërkuar për të kërkuar urdhrin sipas së drejtës së vetë të brendshme.

b) Në rast kur një kërkesë që ka të bëjë me paragrafin 1 (a) të këtij neni, një kopje të ligjshme të një urdhri konfiskimi mbi të cilin kërkesa është bazuar duke lëshuar nga shteti palë kërkues një deklaratë të fakteve dhe informacion për madhësinë në të cilën kërkohet ekzekutimi i urdhrit, një deklaratë që specifikon masat e marra nga shteti palë kërkues për të siguruar njoftim të përshtatshëm për palë të treta *bona fide* dhe për të siguruar proces ligjor dhe një deklaratë që urdhri i konfiskimit është final.

c) Në rastin kur një kërkesë që ka të bëjë me paragrafin 2 të këtij neni, një deklaratë të fakteve të mbështetura mbi shtetin palë kërkues dhe një përshkrim të veprimeve të kërkuara dhe, ku është e mundur, një kopje ligjore të një urdhri mbi të cilin bazohet kjo kërkesë.

4. Vendimet ose veprimet e siguruara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni do të merren nga shteti palë kërkues në përputhje me subjektin për dispozitat e së drejtës së brendshme dhe rregullave procedurale ose çdo marrëveshjeje bilaterale ose multilaterale për të cilën mund të lidhet me shtetin palë kërkues.

5. Secili shtet palë do të furnizojë me kopje të ligjeve të tij dhe rregulloreve që i japin fuqi këtij neni dhe çdo ndryshim i mëpasshëm për ligje të tilla dhe rregullore ose një përshkrim i tij ndaj Sekretarit të Përgjithshëm të 0KB-së.

6. Nëse një shtet palë zgjedh për të bërë marrjen e masave të referuara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni kondicionale mbi ekzistencën e një traktati të përshtatshëm, ai shtet palë do të konsiderojë këtë Konventë të nevojshme dhe të mjaftueshme si bazë për këtë traktat.

7. Bashkëpunimi nën këtë nen mund të refuzohet ose masat e dispozitave të hiqen nëse shteti palë kërkues nuk merr evidencë të mjaftueshme ose në kohë, ose nëse prona është me një vlerë *de minimis*.

8. Përpara se të hiqet ndonjë masë e marrë sipas këtij neni, shteti palë i kërkuar, atje ku është e mundur, do t'i japë shtetit palë kërkues një mundësi për të prezantuar arsyet e tij në favor të vazhdimit të masës.

9. Dispozitat e këtij neni nuk do të konsiderohen si të tilla që paragjykojnë të drejtat e palëve të treta *bona fide*.

Neni 56
Bashkëpunimi i veçantë

Pa paragjykim mbi të drejtën e saj të brendshme, çdo shtet palë do të përpiqet të marrë masa për të lejuar atë të kalojë, pa paragjykim ndaj investigimeve të veta, hedhje në gjyq ose procedim gjyqësor, informacion mbi të ardhurat e krimeve të vendosura në përputhje me këtë Konvente ndaj një shteti palë tjetër pa kërkesë paraprake, kur ajo konsideron që hapja e informacionit të tillë mund të asistojë shtetin palë marrës në fillimin ose kryerjen e investigimeve, hedhjeve në gjyq ose mund të çojë në një kërkesë nga shteti palë sipas këtij kapitulli të Konventës.

KAPITULLI 57
KTHIMI DHE HEDHJA E ASETEVE

1. Prona e konfiskuar nga një shtet palë sipas nenit 1 ose 55 të kësaj Konvente do të hidhet, duke përfshirë me kthim të pronarëve të mëparshëm legjitimë, sipas paragrafit 3 të këtij neni, nga ai shtet palë në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente dhe së drejtës së brendshme.

2. Secili shtet palë do të adaptojë masa të tilla legjislative dhe të tjera në përputhje me parimet themelore të së drejtës së saj të brendshme, siç mund të jetë e nevojshme për të bërë të mundur organet e veta kompetente të kthejnë pronën e konfiskuar, kur veprojnë me kërkesën e bërë nga një tjetër shtet palë, në përputhje me këtë Konventë, duke marrë në konsideratë të drejtat e palëve të treta *bona fide*.

3. Në përputhje me nenet 46 dhe 55 të kësaj Konvente dhe paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, shteti palë kërkues do të:

a) Në rastin kur ka një shpërdorim të fondeve publike ose të pastrimit të fondeve publike të shpërdoruara, si është referuar në nenet 17 dhe 2 të kësaj Konvente, kur konfiskimi është ekzekutuar në përputhje me nenin 55 dhe mbi bazën e një gjykimi final në shtetin palë kërkues, një kërkesë që mund të kalohet pa marrë u parasysh nga shteti palë i kërkuar, kthen pronën e konfiskuar për shtetin palë kërkues.

b) Në rastin e të ardhurave të çdo krimi të mbuluar nga kjo Konventë, kur konfiskimi ishte ekzekutuar në përputhje me nenin 55 të kësaj Konvente dhe mbi bazën e një gjykimi final në shtetin palë kërkues, një kërkesë që mund të mos merret parasysh nga shteti palë i kërkuar, kthen pronën e konfiskuar te shteti palë kërkues, kur shteti palë kërkues arsyeton pronësinë e mëparshme të pronës së konfiskuar për shtetin palë të kërkuar ose kur shteti palë i kërkuar njeh dëmtime ndaj shtetit palë të kërkuar si një bazë për kthimin e pronës së konfiskuar.

c) Në të gjitha rastet e tjera, t'i jepet konsideratë prioritare kthimit të pronës së konfiskuar ndaj shtetit palë kërkues, duke kthyer pronën e tillë për pronarët e saj të ligjshëm të mëparshëm ose duke kompensuar viktimat e krimeve.

4. Atje ku është e përshtatshme, përveç kur shtetet palë vendosin ndryshe, shteti palë i kërkuar mund të ulë shpenzime të arsyeshme të ndodhura gjatë hetimit, hedhjes në gjyq duke iu afruar kthimit të pronës së konfiskuar sipas këtij neni.

5. Atje ku është e përshtatshme, shtetet palë mund t'i japin gjithashtu konsideratë të veçantë përfundimit të marrëveshjeve ose rregullimeve të pranueshme nga të gjithë, mbi një bazë çështje pas çështje, për kalimin final të pronës së konfiskuar.

Neni 58
Njësia e inteligjencës financiare

Shtetet palë do të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për qëllime të ndalimit dhe luftës kundër transferimit të të ardhurave nga krimet e vendosura në përputhje me këtë Konventë dhe duke promovuar mënyra të rikuperimit të të ardhurave të tilla dhe për këtë qëllim, do të konsiderojnë ngritjen e një njësie të inteligjencës financiare që është përgjegjëse për të marrë, analizuar dhe lëshuar ndaj organeve kompetente raporte të transaksioneve të dyshimta financiare.

Neni 59
Marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale

Shtetet palë mund të shqyrtojnë, të lidhin marrëveshje bilaterale ose multilaterale ose rregullime për të rritur efektivitetin e bashkëpunimit ndërkombëtar sipas këtij kapitulli të konventës.

KAPITULLI VI
ASISTENCA TEKNIKE DHE KËMBIMI I INFORMACIONIT

Neni 60
Trajnimi dhe asistenca teknike

1. Secili shtet palë, në masën e duhur, fillon, zhvillon ose përmirëson programe trajnimi të veçanta për personelin e tij të përgjegjshëm për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit. Ky program trajnimi, ndërmjet të tjerash, mund të trajtojë sferat e mëposhtme:

a) Masat e efektshme për parandalimin, zbulimin, hetimin, dënimin dhe kontrollin e korrupsionit duke përfshirë përdorimin e mbledhjes së provave dhe metodave hetimore;

b) Krijimin e kapaciteteve në zhvillimin dhe planifikimin e politikave strategjike kundër korrupsionit;

c) Trajnimin e organeve kompetente në përgatitjen e kërkesave për ndihmën e ndërsjellë ligjore që përmbush kërkesat e kësaj Konvente;

d) Vlerësimin dhe forcimin e institucioneve, menaxhimin e shërbimit publik dhe menaxhimin e financave publike, duke përfshirë prokurimin publik dhe sektorin privat.

e) Parandalimin dhe luftën kundër transferimit të fitimit nga veprat penale të parashikuara sipas kësaj Konvente dhe në rimarrjen e këtyre fitimeve;

f) Gjetjen dhe ngritjen e transferimit të fitimeve nga veprat penale të parashikuara në pajtim me këtë Konventë;

g) Mbikëqyrjen e lëvizjeve të fitimeve nga veprat penale të parashikuara sipas kësaj Konvente dhe metodat e përdorura për transferimin, fshehjen ose kamuflimin e këtyre fitimeve

h) Mekanizmat e përshtatshëm dhe të efektshëm dhe administrativë, dhe metodat për lehtësimin e kthimit të fitimeve nga veprat penale të parashikuara sipas kësaj Konvente;

i) Metodat e përdorura për mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve që bashkëpunojnë me organet gjyqësore;

j) Trajnimin për rregulloret kombëtare dhe ndërkombëtare dhe në gjuhë.

2. Shtetet palë, brenda kapaciteteve të tyre, shqyrtojnë dhënien e asistencës teknike njëri-tjetrit me masën më të gjerë, sidomos në interes të vendeve në zhvillim, në planet e tyre përkatëse për luftën kundër korrupsionit, duke përfshirë mbështetjen materiale dhe trajnimin në fushat e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, trajnimin dhe asistencën, dhe shkëmbimin reciprok të experiencës përkatëse dhe njohurive të specializuara të cilat ndihmojnë bashkëpunimin ndërkombëtar ndërmjet shteteve palë në fushat e ekstradimit dhe të ndihmës së ndërsjellë juridike.

3. Shtetet palë forcojnë në masën e duhur përpjekjet e tyre për të shtuar aktivitetet operacionale dhe trajnuese në organizatat ndërkombëtare dhe regjionale dhënë në kuadër të marrëveshjeve dhe masave përkatëse dypalëshe dhe shumëpalëshe.

4. Shtetet palë shqyrtojnë të ndihmojnë njëri-tjetrin, me kërkesë, në bërjen e vlerësimeve, studimeve dhe kërkimeve në lidhje me tipat, shkaqet efektet dhe shpenzimet e korrupsionit në vendet e tyre përkatëse, me qëllim që të zhvillojnë, me pjesëmarrjen e organeve kompetente dhe shoqërisë, strategji dhe plane veprimi për të luftuar korrupsionin.

5. Për të lehtësuar rimarrjen e fitimeve nga veprat penale të parashikuara sipas kësaj Konvente, shtetet palë mund të bashkëpunojnë për t'u dhënë njëri-tjetrit emra ekspertësh, të cilët mund të ndihmonin në arritjen e këtyre objektivave.

6. Shtetet palë shqyrtojnë të përdorin konferencat dhe seminaret nënregjionale, regjionale dhe ndërkombëtare për të nxitur bashkëpunimin dhe ndihmën teknike dhe nxitur diskutimin e problemeve të interesit të përbashkët, duke përfshirë problemet e veçanta dhe nevojat e vendeve në zhvillim dhe të vendeve me ekonomitë e tyre në tranzicion.

7. Shtetet palë shqyrtojnë vendosjen e mekanizmave vullnetarë, me qëllim që të kontribuojnë financiarisht në përpjekjet e vendeve në zhvillim dhe vendeve me ekonomitë e tyre në tranzicion për të zbatuar këtë Konventë me anë të programeve dhe projekteve të asistencës teknike.

8. Secili shtet palë shqyrton t'i japë kontribute vullnetare Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin për qëllimin e ndihmesës, nëpërmjet Zyrës së programeve dhe projekteve në vendet në zhvillim dhe me qëllimin e zbatimit të kësaj Konvente.

Neni 61

Mbledhja, shkëmbimi dhe analizimi i informacionit mbi korrupsionin

1. Secili shtet palë shqyrton analizimin, në konsultim me ekspertët, korrentet e korrupsionit në territorin e tij, si dhe rrethanat në të cilat kryhen veprat penale në lidhje me korrupsionin.

2. Shtetet palë shqyrtojnë zhvillimin dhe dhënien njëri-tjetrit dhe nëpërmjet organizatave ndërkombëtare dhe regjionale të statistikave, ekspertizës analitike në lidhje me korrupsionin dhe me informacionin, me qëllim që të zhvillohen, me aq sa është e mundur, përkufizime, standarde dhe metodologji të përbashkëta, si dhe informacionin mbi praktikat më të mira për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

3. Secili shtet palë shqyrton vëzhgimin e politikave të tij dhe masave faktike për luftën kundër korrupsionit dhe kryerjen e vlerësimeve për efektivitetin dhe efiçencën e tyre.

Neni 62

Masa të tjera: Zbatimi i Konventës nëpërmjet zhvillimit ekonomik dhe asistencës teknike

1. Shtetet palë marrin masat që bëjnë të mundur zbatimin optimal të kësaj Konvente, në masën e duhur, nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar, duke marrë parasysh efektet negative të korrupsionit në shoqëri në përgjithësi, sidomos në një zhvillim të shëndetshëm.

2. Shtetet palë bëjnë përpjekje konkrete në masën e mundur dhe në bashkëpunim me njëri-tjetrin, si dhe me organizatat ndërkombëtare dhe regjionale:

a) për rritjen e bashkëpunimit të tyre në nivele të ndryshme me vendet në zhvillim, me qëllimin e forcimit të kapacitetit të këtyre të fundit për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin;

b) për rritjen e asistencës financiare dhe materiale për mbështetjen e përpjekjeve të vendeve në zhvillim për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin me efektivitet dhe për t'i ndihmuar ata të zbatojnë këtë Konventë me sukses;

c) për dhënien e asistencës teknike vendeve në zhvillim dhe vendeve me ekonomitë e tyre në tranzicion për t'i ndihmuar ata të përmbushin nevojat për zbatimin e kësaj Konvente. Për këtë qëllim, shtetet palë përpiqen të japin vullnetarisht kontribute të përshtatshme dhe të rregullta në një llogari që hapet për këtë qëllim në mekanizmat e financimit të Kombeve të Bashkuara. Shtetet palë, në pajtim me ligjin e tyre të brendshëm dhe dispozitat e kësaj Konvente, mund t'i kushtojnë rëndësi të madhe dhënies në këtë llogari të një përqindje të parasë ose të vlerës korresponduese të fitimeve nga krimi ose pasuria e konfiskuar në pajtim me dispozitat e kësaj Konvente;

d) për inkurajimin dhe detyrimin e shteteve të tjera dhe institucionet financiare sipas rastit të bashkohen me ta në pajtim me këtë nen, sidomos duke dhënë më shumë programe trajnimi dhe pajisje moderne për vendet në zhvillim me qëllim që të ndihmohen ata në arritjen e objektivave të kësaj Konvente.

3. Në masën e mundur, të gjitha masat merren pa cenuar ndihmën e huaj ekzistuese ose masat e tjera të bashkëpunimit në nivelin dypalësh, regjional ose ndërkombëtar.

4. Shtetet palë mund të lidhin marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe apo masa të tjera për asistencën materiale dhe logjistike, duke marrë në konsideratë masat financiare të nevojshme për mjetet e bashkëpunimit ndërkombëtar të parashikuar në këtë Konventë për të qenë e efektshme në parandalimin, gjetjen dhe kontrollin e korrupsionit.

KAPITULLI VII
MEKANIZMAT E ZBATIMIT

Neni 63
Konferenca e shteteve palë në Konventë

1. Një konferencë e shteteve palë në Konventë parashikohet këtu për të përmirësuar kapacitetin dhe bashkëpunimin ndërmjet shteteve palë për arritjen e objektivave të përcaktuara në këtë Konventë dhe për të nxitur dhe rishikuar zbatimin e saj.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara thërret konferencën e shteteve palë jo më vonë se një vit nga hyrja në fuqi e kësaj Konvente. Pas kësaj, mbledhjet e rregullta të konferencës së shteteve palë mbahen në përputhje me rregullat e procedurës së miratuar nga Konferenca.

3. Konferenca e shteteve palë miraton rregulla procedurale dhe rregulla për rregullimin e funksionimit të aktiviteteve të parashikuara në këtë nen, duke përfshirë rregullat në lidhje me pranimin dhe pjesëmarrjen e vëzhguesve, dhe pagesën e shpenzimeve që rrjedhin nga zhvillimi i këtyre aktiviteteve.

4. Konferenca e shteteve palë bie dakord për aktivitetet, procedurat dhe metodat e punës për arritjen e objektivave të parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni duke përfshirë:

a) mbështetjen e aktiviteteve nga shtetet palë sipas nenit 60 dhe 62 të kapitujve II deri V të kësaj Konvente, duke përfshirë inkurajimin dhe mobilizimin e kontributeve vullnetare;

b) mbështetjen e shkëmbimit të informacionit ndërmjet shteteve palë mbi modelet dhe korrentet në korrupsion dhe mbi praktikat e suksesshme për parandalimin dhe luftimin e tij dhe për kthimin e fitimit nga krimi, ndërmjet të tjerash, me anë të botimit të informacionit përkatës siç përmendet në këtë nen;

c) bashkëpunimin me organizatat dhe mekanizmat ndërkombëtarë dhe regjionalë, dhe me organizatat joqeveritare;

d) përdorimin e rregullt të informacionit përkatës të dhënë nga mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë dhe regjionalë për të luftuar dhe parandaluar korrupsionin me qëllim që të mënjanohet dublikimi i panevojshëm i punës;

e) rishikimin periodik të zbatimit të kësaj Konvente nga shtetet palë;

f) bërjen e rekomandimeve për përmirësimin e kësaj Konvente dhe zbatimin e saj;

g) shënimin e kërkesave të asistencës teknike të shteteve palë në lidhje me zbatimin e kësaj Konvente dhe rekomandimin e çdo veprimi që mund të duket i dobishëm nga kjo pikëpamje.

5. Për qëllimin e paragrafit 4 të këtij neni, Konferenca e shteteve palë merr dijeninë e nevojshme në lidhje me masat e marra nga shtetet palë për zbatimin e kësaj Konvente dhe vështirësitë e hasura prej tyre për këtë nëpërmjet informacionit të dhënë atyre dhe nëpërmjet mekanizmave suplementarë të rishikimit, siç mund të caktohen nga konferenca e shteteve palë.

6. Secili shtet palë i paraqet Konferencës së shteteve palë informacion në lidhje me programet, planet dhe praktikat, si dhe masat legjislative dhe administrative për zbatimin e kësaj Konvente, siç kërkohet nga konferenca e shteteve palë. Konferenca e shteteve palë shikon rrugën më të efektshme për marrjen dhe reagimin mbi informacionin, duke përfshirë, ndërmjet të tjerash informacionin e marrë nga shtetet palë dhe nga organizatat kompetente ndërkombëtare. Mund të shqyrtohen gjithashtu edhe informacionet e marra nga organizatat përkatëse joqeveritare të akredituara sipas rregullit nga konferenca e shteteve palë.

7. Në pajtim me paragrafët 4 deri 6 të këtij neni, konferenca e shteteve palë parashikon, nëse e shikon të nevojshme, çdo mekanizëm të përshtatshëm ose organ për të ndihmuar në zbatimin e efektshëm të Konventës.

Neni 64
Sekretariati

1. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara parashikon shërbimet e nevojshme të sekretariatit për konferencën e shteteve palë në Konventë.

2. Sekretariati:

a) Ndihmon konferencën e shteteve palë në kryerjen e aktiviteteve të parashikuara në nenin 63 të kësaj Konvente, merr masat dhe jep shërbimet e nevojshme për sesionet e konferencës së shteteve palë;

b) Me kërkesë, ndihmon shtetet palë në dhënien e informacionit, konferencës së shteteve palë sipas parashikimit të bërë në nenin 63 paragrafët 5 dhe 6 të kësaj Konvente; dhe

c) Siguron bashkëpunimin e nevojshëm me sekretariatet e organizatave përkatëse ndërkombëtare dhe regjionale.

KAPITULLI VIII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 65
Zbatimi i Konventës

1. Secili shtet palë merr masat e nevojshme, duke përfshirë masat legjislative dhe administrative, në pajtim me principet themelore të ligjit të brendshëm, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kësaj Konvente.

2. Secili shtet palë mund të miratojë masa më të forta ose rigoroze se ato të parashikuara në këtë Konventë për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

Neni 66
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Shtetet palë përpiqen të zgjidhin mosmarrëveshjet në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente me anë të bisedimeve.

2. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet dy ose më shumë shteteve palë në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, që nuk mund të zgjidhet me anë të bisedimeve brenda një kohe të arsyeshme, me kërkesë të këtyre shteteve palë, i jepet arbitrazhit. Nëse gjashtë muaj pas depozitimit të kërkesës për arbitrazh këto shtete palë nuk janë në gjendje të bien dakord me organizimin e arbitrazhit, çdonjëra nga këto shtete palë mund ta çojë çështjen në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë me kërkesë në pajtim me Statutin e Gjykatës.

3. Secili shtet palë, në momentin e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit në këtë Konventë, mund të deklarojë se ai nuk konsiderohet i detyruar nga paragrafi 2 i këtij neni. Shtetet e tjera palë nuk detyrohen nga paragrafi 2 i këtij neni në lidhje me çdo shtet palë që ka bërë një rezervë të tillë.

4. Çdo shtet palë që ka bërë një rezervë në lidhje me paragrafin 3 të këtij neni, në çdo kohë mund ta tërheqë këtë rezervë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 67
Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, aprovimi ose aderimi

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim për të gjitha shtetet nga 9 deri më 11 dhjetor të vitit 2003 në Merida, Meksikë dhe pastaj në Qendrën e Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork, deri më 9 dhjetor të vitit 2005.

2. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim nga organizatat regjionale të integrimit ekonomik, me kushte që të paktën një shtet anëtar i një organizate të tillë të ketë nënshkruar këtë Konventë në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni.

3. Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose aprovimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose aprovimit depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara. Një organizatë regjionale e integrimit ekonomik mund ta depozitojë instrumentin e saj të ratifikimit, pranimit ose aprovimit nëse të paktën një nga shtetet anëtare të saj e ka bërë këtë në atë instrument ratifikimi, pranimi ose aprovimi, kjo organizatë deklaron masën e kompetencës së saj në lidhje me çështjet që rregullohen nga kjo Konventë. Kjo organizatë informon gjithashtu depozituesin për çdo modifikim të mundshëm brenda sferës së kompetencës së saj.

4. Kjo Konventë është e hapur për aderim nga çdo shtet e organizatë regjionale e integrimit ekonomik, kur të paktën një shtet anëtar i saj është palë në këtë Konventë. Instrumentet e aderimit depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara. Në momentin e aderimit, një organizatë regjionale e integrimit ekonomik deklaron masën e kompetencës së saj në lidhje me çështjet e rregulluara nga kjo Konventë. Kjo organizatë informon depozituesin edhe për modifikimet e mundshme brenda masës së kompetencës së saj.

Neni 68
Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitimit të instrumentit të tridhjetë të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit. Për qëllimin e këtij paragrafi, çdo instrument i depozituar nga një organizatë regjionale e integrimit ekonomik nuk llogaritet si shtesë mbi ato të depozituara nga shtetet anëtare të kësaj Organizate.

2. Për çdo shtet palë ose organizatë regjionale të integrimit ekonomik, që e ratifikon, pranon, aprovon ose aderon në Konventë pas depozitimit të tridhjetë të instrumentit për një veprim të tillë, kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit nga ky shtet ose organizatë i instrumentit përkatës ose në datën që kjo Konventë hyn në fuqi sipas paragrafin 1 të këtij neni, në datën më të mëvonshme.

Neni 69
Ndryshimet

Pas kalimit të pesë viteve nga hyrja në fuqi e kësaj Konvente, një shtet palë mund të propozojë një ndryshim dhe t'ia transmetojë atë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili pastaj ua komunikon ndryshimin e propozuar shteteve palë dhe konferencës së shteteve palë në Konventë, me qëllim shqyrtimin dhe marrjen e vendimin mbi propozimin. Konferenca e shteteve palë bën të gjitha përpjekjet për të arritur konsensus për çdo ndryshim. Nëse janë bërë të gjitha përpjekjet për të arritur konsensus dhe nuk është arritur marrëveshje, ndryshimi, si përpjekje e fundit, kërkon shumicën prej dy të tretash të shteteve anëtare të pranishme dhe që votojnë në mbledhjen e konferencës së shteteve palë.

2. Organizatat regjionale të integrimit ekonomik, për çështjet brenda kompetencës së tyre, ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar sipas këtij neni me një numër të barabartë votash me atë të numrit të anëtarëve të shteteve anëtare që janë palë në këtë Konventë. Këto organizata nuk e ushtrojnë të drejtën për të votuar nëse shtetet anëtare të tyre e ushtrojnë të tyren dhe e kundërta.

3. Një ndryshim i miratuar sipas paragrafit 1 të këtij neni i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose aprovimit nga shtetet palë.

4. Një ndryshim i miratuar sipas paragrafit 1 të këtij neni hyn në fuqi në lidhje me një shtet palë nëntëdhjetë ditë pas datës së depozitimit te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara i një instrumenti ratifikimi, pranimi ose aprovimi për këtë ndryshim.

5. Kur një ndryshim hyn në fuqi, ai është i detyrueshëm për ato shtete palë që kanë shprehur pëlqimin e tyre për të qenë të detyruar prej tij. Shtetet e tjera palë u nënshtrohen dispozitave të kësaj Konvente dhe çdo ndryshimi të mëparshëm që ato kanë ratifikuar, pranuar ose miratuar.

Neni 70
Denoncimi

1. Një shtet palë mund ta denoncojë këtë Konventë me njoftim me shkrim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Ky denoncim hyn në fuqi një vit pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

2. Një organizatë regjionale e integrimit ekonomik pushon se qeni palë në këtë Konventë kur të gjithë anëtarët e saj e kanë denoncuar atë.

Neni 71
Depozituesi dhe gjuhët

1. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara caktohet depozitues i kësaj Konvente.

2. Origjinali i kësaj Konvente, teksti i së cilës në gjuhën arabe, kineze, angleze, franceze, ruse dhe spanjolle janë njëlloj autentike, depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Si dëshmi e kësaj, të plotfuqishmit e poshtëshënuar, duke qenë rregullisht të autorizuar nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë Konventë.

LIGJ
Nr.9496, datë 20.3.2006

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MISIONIT TË PËRKOHSHËM TË KOMBEVE TË BASHKUARA NË KOSOVË (UNMIK) PËR TRANSFERIMIN E PERSONAVE TË DËNUAR"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 shkronja "b" të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Misionit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) për transferimin e personave të dënuar".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4824, datë 28.3.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.28, faqe 940

MARRËVESHJE
NDËRMJET MISIONIT TË PËRKOHSHËM TË ADMINISTRATËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA NË KOSOVË (UNMIK) DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR TRANSFERIMIN E PERSONAVE TË DËNUAR

Hyrje

Misioni i Përkohshëm i Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, nënshkruese të kësaj Marrëveshjeje,

duke dëshiruar zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën penale;

duke konsideruar se një bashkëpunim i tillë duhet të çojë më tej qëllimet e drejtësisë dhe rehabilitimin social të personave të dënuar;

duke konsideruar Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244 (1999) të 10 qershorit 1999, me të cilën UNMIK-u u themelua me një mandat për të siguruar një administrim të përkohshëm të Kosovës;

duke njohur rëndësinë e vendosjes së bazës ligjore për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe UNMIK-ut në çështjet që kanë të bëjnë me trasferimin e personave të dënuar,

janë marrë vesh për sa vijon:

Neni 1
Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

a) "Dënim" është çdo dënim ose masë me heqje lirie të dhënë nga një gjykatë për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohe për shkak të një vepre penale.

b) "Vendim" është çdo vendim ose urdhër i gjykatës që cakton dënimin.

c) "Palë" është Misioni i Përkohshëm i Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe Republika e Shqipërisë, që përfaqësohet nga Këshilli i Ministrave.

d) "Palë dënuese" është Pala që ka të dhënë dënimin për personin që mund ose është transferuar.

e) "Palë administruese" është Pala tek e cila personi i dënuar mund ose është transferuar për të vuajtur dënimin e tij.

Neni 2
Parime të përgjithshme

1. Palët marrin përsipër t'i ofrojnë njëra-tjetrës masën më të gjerë të bashkëpunimit në lidhje me transferimin e personave të dënuar në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

2. Një person i dënuar në territorin e një Pale mund të transferohet në territorin e Palës tjetër, në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, me qëllim që të vuajë dënimin e dhënë për të. Për këtë qëllim, ai mund t'i shprehë interesin e tij Palës dënuese ose Palës administruese për t'u transferuar sipas kësaj Marrëveshjeje.

3. Transferimi mund të kërkohet nga Pala dënuese ose Pala administruese.

Neni 3
Kushtet e transferimit

1. Një person i dënuar mund të transferohet sipas kësaj Marrëveshjeje vetëm në kushtet e mëposhtme:

a) i) nëse Pala administruese është Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, kur personi është shtetas i Republikës së Shqipërisë;

ii) nëse Pala administruese është Misioni i Përkohshëm i Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë, kur personi është me vendbanim të zakonshëm në Kosovë ose figuron i regjistruar si banor i Kosovës;

b) nëse vendimi ka marrë formë të prerë;

c) nëse në momentin e marrjes së kërkesës për transferim, personi i dënuar ka jo më pak se gjashtë muaj të dënimit për të vuajtur ose nëse dënimi është i papërcaktuar;

d) nëse për transferimin ka rënë dakord personi i dënuar ose, duke pasur parasysh moshën ose gjendjen fizike, ose mendore të tij, dhe njëra nga të dyja Palët e konsiderojnë këtë të nevojshme, përfaqësuesi ligjor i personit të dënuar;

e) nëse veprimet ose mosveprimet për të cilat është dhënë dënimi përbëjnë vepër penale në pajtim me ligjin e Palës administruese ose do të përbënin vepër penale nëse do të ishin kryer në territorin e saj;

f) nëse Palët dënuese dhe administruese bien dakord për transferimin.

2. Në raste të veçanta, Palët mund të bien dakord për transferimin edhe kur pjesa e mbetur për t'u vuajtur nga personi i dënuar është më e vogël se ajo e përcaktuar në paragrafin 1 c.

Neni 4

Detyrime për të dhënë informacion

1. Çdo person i dënuar për të cilin zbatohet kjo Marrëveshje, informohet nga Pala dënuese mbi përmbajtjen e kësaj Marrëveshjeje.

2. Nëse personi i dënuar i ka shprehur interesin Palës dënuese për t'u transferuar sipas kësaj Marrëveshjeje, kjo Palë informon Palën administruese menjëherë sapo të jetë e mundur pasi vendimi të ketë marrë formë të prerë.

3. Informacioni përfshin:

a) emrin, datën dhe vendin e lindjes së personit të dënuar;

b) shtetësinë e personit të dënuar, kur Pala dënuese është autoriteti kompetent gjyqësor i Republikës së Shqipërisë, dhe nëse personi i dënuar është banor i përhershëm i Kosovës;

c) adresën e tij, nëse ai ka, në territorin e Palës administruese;

d) një përmbledhje të fakteve mbi të cilat është bazuar dënimi;

e) natyrën, kohëzgjatjen dhe fillimin e dënimit.

4. Nëse personi i dënuar i ka shprehur interesin e tij Palës administruese, Pala dënuese, me kërkesë, i përcjell Palës administruese informacionin e përmendur në paragrafin 3 të mësipërm.

5. Personi i dënuar informohet me shkrim dhe në një gjuhë që ai e kupton për çdo veprim të ndërmarrë nga Pala dënuese ose nga Pala administruese në bazë të paragrafëve të mësipërm, si dhe për çdo vendim të marrë nga secila palë mbi kërkesën për transferim.

Neni 5

Kërkesat dhe përgjigjet

1. Kërkesat për transferim dhe përgjigjet bëhen me shkrim.

2. Kërkesat do të komunikohen ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë dhe Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut. Përgjigjet do të komunikohen nëpërmjet të njëjtave kanale.

3. Pala pritëse njofton menjëherë Palën kërkuese në lidhje me vendimin e saj nëse pranon ose jo transferimin e kërkuar.

Neni 6

Dokumentacioni shoqërues

1. Pala administruese, nëse i kërkohet nga Pala dënuese, paraqet:

a) i) nëse Pala administruese është Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, një dokument se personi i dënuar është shtetas i Republikës së Shqipërisë;

ii) nëse Pala administruese është UNMIK-u, një dokument që tregon se personi i dënuar është me vendbanim në Kosovë ose figuron i regjistruar si banor i Kosovës;

b) një kopje të ligjit përkatës të Palës administruese, i cili parashikon se veprimet ose mosveprimet, në bazë të të cilave është dhënë dënimi nga Pala dënuese, përbëjnë një vepër penale në bazë të ligjit të Palës administruese ose do të përbënte vepër penale, nëse do të kryhej në territorin e saj.

2. Nëse kërkohet transferimi, Pala dënuese i paraqet dokumentet e mëposhtme Palës administruese, përveç kur të dyja Palët kanë bërë të ditur se nuk do të pranojnë transferimin:

a) një kopje të vërtetuar të vendimit dhe të ligjit ku ai bazohet;

b) një deklaratë, që tregon se cila pjesë e dënimit është vuajtur, duke përfshirë informacionin mbi paraburgimin, zbritjet e dënimit dhe çdo faktor tjetër që është i rëndësishëm për ekzekutimin e dënimit, si vlerësimet nga puna e bërë ose sjellja e mirë;

c) një deklaratë që përmban pëlqimin për transferimin, sipas parashikimit të nenit 3.1.d;

d) sipas rastit, çdo raport mjekësor ose shoqëror për personin e dënuar, informacion për trajtimin e tij nga Pala dënuese dhe rekomandime për trajtimin e tij të mëtejshëm nga Pala administruese. Ky informacion përfshin raporte nga psikiatri, psikologu ose për vetëvrasje të mbetur në tentativë, informacion për gjendjen shëndetësore, duke përfshirë problemet e abuzimit me substancat, informacion për trajtimin e shkuar dhe të tanishëm ose raporte disiplinore, ose për incidentet gjatë kohës së kaluar në ndalim, duke vënë në dukje shqetësimet e veçanta për sigurinë.

3. Secila nga Palët mund të kërkojë t'i paraqitet çdo dokument, i përmendur në paragrafin 1 ose 2 të mësipërm, para se të bëjë kërkesën për transferim ose të marrë vendimin për të pranuar ose mos pranuar transferimin.

Neni 7

Pëlqimi i personit të dënuar

1. Pala dënuese sigurohet që personi të cilit i kërkohet të japë pëlqimin për trasferimin në pajtim me nenin 3.1.d e bën këtë vullnetarisht dhe duke pasur dijeni të plotë në lidhje me pasojat ligjore të kësaj nëpërmjet një konsultimi me një këshillues ligjor të pavarur.

2. Para se të japë pëlqimin, personit të cilit i kërkohet të japë pëlqimin për trasferimin, i jepet informacion në lidhje me kushtet në burgun përkatës, shërbimet që ofrohen dhe për programet për lirimin në Palën administruese.

3. Pala dënuese i ofron mundësinë Palës administruese të verifikojë, nëpërmjet një nëpunësi konsullor ose një nëpunësi tjetër, për të cilin është rënë dakord me Palën administruese, se pëlqimi është dhënë në pajtim me kushtet e caktuara në këtë nen.

Neni 8

Efekti i transferimit për Palën dënuese

1. Marrja në dorëzim e personit të dënuar nga organet e Palës administruese ka efektin e pezullimit të ekzekutimit të dënimit nga Pala dënuese.

2. Pala dënuese nuk mund të vazhdojë të ekzekutojë dënimin nëse Pala administruese e konsideron ekzekutimin e dënimit të përfunduar.

Neni 9

Efekti i transferimit për Palën administruese

1. Organet kompetente të Palës administruese e konvertojnë dënimin, nëpërmjet një procedure gjyqësore, në një vendim të asaj Pale, duke zëvendësuar masën e dënimit të caktuar nga Pala dënuese me një masë dënimi të parashikuar nga ligji i shtetit administrues për të njëjtën vepër penale, në bazë të kushteve të parashikuara në nenin 10.

2. Ekzekutimi i dënimit rregullohet nga ligji i Palës administruese dhe vetë Pala ka kompetencë për të marrë të gjitha vendimet përkatëse.

Neni 10
Konvertimi i dënimit

1. Kur bëhet konvertimi i dënimit, zbatohen procedurat e parashikuara në ligjin e Palës administruese dhe organi kompetent:

a) është i detyruar t'u përmbahet konstatimeve në lidhje me faktet e caktuara shprehimisht ose që nënkuptohen nga vendimi i dhënë nga Pala dënuese;

b) nuk mund të konvertojë një masë dënimi me heqje lirie në një masë dënimi me gjobë;

c) zbret periudhën e plotë të heqjes së lirisë së vuajtur nga personi i dënuar;

d) nuk rëndon pozitën penale të personit të dënuar dhe nuk është i detyruar t'i përmbahet një minimumi të caktuar nga ligji i Palës administruese për veprën ose veprat penale.

2. Nëse procedurat e konvertimit kryhen pas trasferimit të personit të dënuar, Pala administruese e mban atë person të ndaluar ose siguron prezencën e tij në Palën administruese deri në përfundim të procedurës.

Neni 11
Amnistia ose zbutja e dënimit

Secila nga Palët mund të bëjë amnisti ose zbutje të dënimit të pajtim me ligjet e veta, me kusht që këto akte të kenë zbatueshmëri të përgjithshme. Secila Palë, me pëlqimin e Palës dënuese, mund të bëjë falje në pajtim me ligjet e veta.

Neni 12
Rishikimi i vendimit

Pala dënuese është e vetmja që ka të drejtën për të vendosur për zbatimin e rishikimit të vendimit.

Neni 13
Përfundimi i ekzekutimit

Pala administruese përfundon ekzekutimin e dënimit menjëherë sapo të informohet nga Pala dënuese në lidhje me çdo vendim ose masë, si rezultat i të cilave dënimi pushon se qeni i ekzekutueshëm.

Neni 14
Informacioni për ekzekutimin

Pala administruese i paraqet informacion Palës dënuese në lidhje me ekzekutimin e dënimit:

a) kur ajo mendon se ekzekutimi i dënimit ka përfunduar;

b) nëse personi i dënuar është arratisur nga burgu para se të ishte përfunduar ekzekutimi i dënimit;

c) nëse Pala dënuese kërkon një raport të veçantë.

Neni 15
Gjuha dhe vërtetimi

1. Informacioni sipas neneve 4.3, 6.1 dhe 6.2 paraqitet në gjuhën angleze dhe në gjuhën e palës që i drejtohet, që do të thotë:

a) në rastin e UNMIK-ut, në gjuhën shqipe ose serbe; ose

b) në rastin e Republikës së Shqipërisë, në gjuhën shqipe.

2. Sipas parashikimit të nenit 6.2.a, dokumentet e përcjella në zbatim të kësaj Marrëveshjeje nuk nevojitet të vërtetohen.

3. Çdo shpenzim i shkaktuar nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje përballohet nga Pala administruese, përveç shpenzimeve që shkaktohen gjerësisht në territorin e Palës dënuese. Shpenzimet në lidhje me transportin e personit të dënuar mbulohen nga Pala dënuese, përveç kur parashikohet ndryshe nga palët rast pas rasti.

Neni 16
Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje do të jetë subjekt i nënshkrimit prej të dyja Palëve.

2. Pas nënshkrimit, Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë do të njoftojë UNMIK-un për ratifikimin e Marrëveshjes dhe UNMIK-u do të njoftojë Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë se i ka plotësuar të gjitha procedurat e nevojshme për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes.

3. Marrëveshja do të hyjë në fuqi në ditën e 30 (tridhjetë) pasi palët të kenë njoftuar njëra-tjetrën sipas paragrafit 2 të këtij neni.

Neni 17
Zbatimi i përkoshëm

1. Kjo Marrëveshje zbatohet për ekzekutimin e dënimeve të dhëna para ose pas hyrjes në fuqi të saj.

2. Secila Palë mund të shfuqizojë këtë Marrëveshje duke paraqitur një kërkesë me shkrim për shfuqizimin Palës tjetër. Shfuqizimi hyn në fuqi 30 ditë pas datës së marrjes nga Pala tjetër të kërkesës për shfuqizim, përveç kur është rënë dakord me shkrim ndryshe nga Palët. Në rastin e shfuqizimit, Marrëveshja megjithatë vazhdon të zbatohet për ekzekutimin e dënimeve të personave që janë transferuar në pajtim me dispozitat për shkëmbimin e dokumenteve para datës në të cilën hyn në fuqi shfuqizimi.

Bërë në …… më …… në dy kopje, në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe, tekstet njëlloj të vlefshme; në rast mosmarrëveshjeje taksti në gjuhën angleze ka përparësi.

LIGJ
Nr.9505, datë 3.4.2006

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT MINISTROR TË KONFEDERATËS ZVICERANE PËR BASHKËPUNIMIN POLICOR NË LUFTËN KUNDËR KRIMIT"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit Ministror të Konfederatës Zvicerane për bashkëpunimin policor në luftën kundër krimit".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4839, datë 25.4.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.40, faqe 1249

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE KËSHILLIT FEDERAL TË KONFEDERATËS ZVICERANE MBI BASHKËPUNIMIN POLICOR KUNDËR KRIMIT

Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit Federal të Konfederatës Zviceriane, të quajtur më poshtë Palë Kontraktuese,

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin e marrëdhënieve të ndërsjella;

të bindur për rëndësinë e madhe të bashkëpunimit policor për të luftuar krimin dhe për ta parandaluar me efektivitet atë, në mënyrë të veçantë krimin e organizuar, terrorizmin, trafikimin e paligjshëm të narkotikëve dhe substancave psikotrope dhe prekursorëve;

duke u përpjekur të përcaktojnë dhe përmbushin nivelin e bashkëpunimit policor ndërmjet autoriteteve shqiptare dhe autoriteteve zviceriane;

ndërsa duke respektuar nga ana tjetër të drejtat dhe detyrimet për shtetasit e të dyja Palëve Kontraktuese, dhe

duke pasur të bëjnë me detyrimet ndërkombëtare dhe legjislacionin kombëtar të shteteve të tyre respektive,

kanë rënë dakord për sa më poshtë:

TITULLI I
QËLLIMI I MARRËVESHJES

Neni 1

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është të forcojë bashkëpunimin dypalësh policor ndërmjet Palëve Kontraktuese, zbulimin dhe hetimin e krimeve në mënyrë të veçantë ndërmjet shkëmbimit të informacionit strategjik dhe operacional dhe kontakteve të rregullta ndërmjet autoriteteve përgjegjëse në të gjitha nivelet e duhura.

TITULLI II
FUSHA E ZBATIMIT

Neni 2
Fusha e veprimtarisë kriminale

1. Bashkëpunimi, sikurse është vendosur në këtë Marrëveshje, do të lidhet me të gjitha format e aktiviteteve kriminale, në mënyrë të veçantë:

a) krimi i organizuar;

b) terrorizmi dhe financimi i tij;

c) trafikimi i qenieve njerëzore dhe kontrabanda e njerëzve;

d) krimet seksuale ndaj të miturve;

e) krimi kompjuterik;

f) trafikim i paligjshëm i narkotikëve, substancave psikotrope dhe prekursorëve;

g) përvetësim i paligjshëm, zotërim i paligjshëm dhe trafikim i paligjshëm armësh, municioni dhe eksplozivash ose materialesh kimike, biologjike, radioaktive dhe materialesh bërthamore, ose mallrash dhe teknologjisë të rëndësisë strategjike, ose të teknologjisë ushtarake;

h) krime në lidhje me objektet me vlera kulturore dhe historike;

i) prodhimi dhe falsifikimi i parave, mjeteve të pagesës dhe dokumenteve zyrtare;

j) pastrim parash dhe krim ekonomik;

k) korrupsioni;

l) krime në mjete motorike.

2. Pavarësisht nga fushat e krimit, sikurse specifikohen në paragrafin 1, kjo Marrëveshje nuk lejon autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese të bashkëpunojnë për çështje të natyrës politike, ushtarake dhe fiskale.

Neni 3

E drejta e zbatueshme

Bashkëpunimi sipas kësaj Marrëveshjeje kryhet siç parashikohet nga legjislacioni kombëtar i Palëve Kontraktuese dhe sipas dispozitave të së Drejtës Ndërkombëtare.

TITULLI III

PROCEDURAT DHE FUSHAT E BASHKËPUNIMIT

Neni 4

Bashkëpunimi i përgjthshëm

Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve kompetente sipas kësaj Marrëveshjeje mbulon fushat e mëposhtme:

a) shkëmbimi i informacionit;

b) koordinimi operacional;

c) krijimi i grupeve të përbashkëta të punës;

d) trajnimi dhe formimi profesional.

Neni 5

Shkëmbimi i informacionit

Palët Kontraktuese do të ofrojnë mbështetje të ndërsjellë nëpërmjet shkëmbimit të të dhënave dhe materialeve personale dhe jopersonale, veçanërisht mbi:

a) aktet kriminale, në mënyrë të veçantë mbi autorët e veprave penale ose personat e tjerë të përfshirë në veprat penale ashtu si edhe mbi kushtet nën të cilat është kryer një vepër penale dhe masat që janë marrë;

b) përgatitjen e akteve kriminale, veçanërisht akteve të terrorizmit drejtuar kundër interesave të Palëve Kontraktuese;

c) objektet që janë të lidhura me një krim, duke përfshirë kampione të objekteve të tilla;

d) aksionet dhe operacionet e planifikuara që mund të jenë me interes për Palën tjetër Kontraktuese;

e) dokumentacionin konceptual dhe analitik si dhe literaturën profesionale;

f) dispozitat ligjore të brendshme mbi subjektin e kësaj Marrëveshjeje dhe ndryshimet në këto dispozita;

g) njohuritë që përfitohen nga veprimet e autoriteteve kompetente, veçanërisht mbi format e reja të krimit.

Neni 6
Koordinimi

1. Autoritetet përgjegjëse të Palëve Kontraktuese do të marrin masa, nëse është e nevojshme, për të siguruar në territorin e tyre respektiv koordinimin e operacioneve:

a) në kërkimin për persona dhe objekte, përfshirë zbatimin e masave që synojnë zbulimin dhe bllokimin e të ardhurave dhe sendeve që rrjedhin nga aktivitetet kriminale;

b) në zbatimin e teknikave të posaçme të hetimit të tilla, si dorëzimet e kontrolluara, vëzhgimi dhe hetimet e fshehta;

c) në mbrojtjen e dëshmitarëve, viktimave, bashkëpunëtorëve të drejtësisë dhe personave të tjerë me qëllim të evitimit të rreziqeve për jetën dhe shëndetin ose ndonjë rreziku tjetër serioz që ka të bëjë me procedurat penale;

d) në planifikimin dhe zbatimin e programeve të përbashkëta për parandalimin e krimit.

2. Autoritetet përgjegjëse do të vendosin bashkërisht mbi bazë rastesh të veçanta mbi kompensimin financiar si rezultat i kostove që lindin nga zbatimi i këtij neni.

Neni 7
Grupet e përbashkëta

1. Autoritetet përgjegjëse të Palëve Kontraktuese do të krijojnë sipas nevojave ekipe të përziera të analizës, grupe të përbashkëta pune për kontrollin dhe mbikëqyrjen në të cilët zyrtarët e autoriteteve kompetente të një Pale Kontraktuese, pa ushtruar përgjegjësi të pakufizuar, janë aktivë me kapacitet këshillues dhe mbështetës në operacionet mbi territorin sovran të Palës tjetër Kontraktuese. Zyrtarët respektojnë instruksionet e lëshuara nga Pala në Marrëveshje në territorin e së cilës kryhen operacionet.

2. Autoritetet përgjegjëse do të vendosin bashkërisht mbi bazë rastesh të veçanta mbi kompensimin financiar si rezultat i kostove që lindin nga zbatimi i këtij neni.

Neni 8
Asistenca dhe shërbimi

1. Palët Kontraktuese u japin zyrtarëve nga Pala tjetër në marrëveshje që operojnë në territoret e tyre sipas nenit 7, të njëjtën mbrojtje dhe asistencë sikurse zyrtarëve të vet.

2. Zyrtarët e Palëve Kontraktuese mbeten subjekt i legjislacionit të tyre kombëtar në lidhje me kushtet e punësimit dhe afatet e shërbimit dhe statusin e tyre juridiko-disiplinor.

Neni 9
Detyrimi civil lidhur me zyrtarët

1. Në rastet kur, në pajtim me nenin 7, zyrtarët e një Pale Kontraktuese janë duke operuar në territorin sovran të Palës tjetër, Pala e parë do të jetë përgjegjëse për ndonjë dëm të shkaktuar nga ana e tyre gjatë operimit, në përputhje me ligjin e Palës në territorin e së cilës ato janë duke operuar.

2. Pala, në territorin e së cilës u shkaktua dëmi i përmendur në paragrafin 1, do ta shlyejë këtë dëm sipas kushteve që zbatohen për dëmin e shkaktuar nga zyrtarët e vet.

3. Pala, zyrtarët e së cilës kanë shkaktuar dëm ndaj ndonjë personi në territorin e Palës tjetër do t'i rimbursojë kësaj të fundit plotësisht çdo shumë që kjo i ka paguar viktimave ose personave të njohur si përfaqësues të tyre.

4. Pa cenuar ushtrimin e të drejtave të saj karshi palëve të treta dhe me përjashtim të paragrafit 3, secila Palë nuk do të kërkojë në rastin e parashikuar në paragrafin 1 rimbursimin për dëmet që ajo ka pësuar nga Pala tjetër.

Neni 10
Detyrimi penal lidhur me zyrtarët

Gjatë operacioneve të cituara në neni 7 zyrtarët e një Pale, e cila nuk është Pala që operon, do të konsiderohen si zyrtarë të Palës që operon për sa i përket krimeve të kryera kundër tyre ose nga vetë ata.

Neni 11
Trajnimi dhe formimi profesional

1. Palët Kontraktuese mbështesin njëra-tjetrën përmes masave në sferën e trajnimit dhe formimit profesional, veçanërisht nëpërmjet:

a) pjesëmarrjes në kurse trajnimi në gjuhën/gjuhët zyrtare të Palës tjetër Kontraktuese ose në gjuhën angleze;

b) mbajtjes së seminareve të përbashkëta, stërvitjeve të përbashkëta dhe kurseve të trajnimit;

c) trajnimit të specialistëve;

d) shkëmbimit të ekspertëve dhe koncepteve të trajnimit;

e) pjesëmarrjes së vëzhguesve në stërvitje.

2. Gjithashtu, Palët Kontraktuese do të inkurajojnë ndarjen e eksperiencave dhe njohurive në të gjitha format e tjera.

Neni 12
Procedurat dhe kostot

1. Kërkesat për informacion, masa të koordinuara ose për mjete të tjera të asistencës do të bëhen më shkrim dhe duke deklaruar arsyet për kërkesën. Këto kërkesa mund të transmetohen, nëse është e nevojshme, nëpërmjet faksit ose e-mailit, duke parashikuar që është e pranueshme për të vepruar kështu bazuar në përmbajtjet e kërkesës. Palët Kontraktuese në raste emergjencash mund të bëjnë një kërkesë gojore të pasuar menjëherë nga konfirmimi me shkrim.

2. Autoritetet kompetente mund të informojnë njëra-tjetrën rreth rasteve specifike pa qenë e nevojshme të bëjnë një kërkesë për informim kur këto raste mund të ishin të rëndësishme në ndihmën për t'u mbrojtur kundër rreziqeve konkrete për rendin dhe sigurinë publike ose për të luftuar kundër krimit dhe për ta parandaluar atë.

3. Autoritetet kompetente i japin njëra-tjetrës asistencë të drejtpërdrejtë, me kusht që kërkesa për asistencë nuk do t'i përkasë juridiksionit të autoriteteve gjyqësore në pajtim me legjislacionin kombëtar. Nëse autoriteti policor i cili ka marrë një kërkesë për asistencë nuk është përgjegjës për t'u marrë me kërkesën, ai do t'ia përcjellë kërkesën autoritetit përgjegjës.

4. Autoritetet përgjegjëse të Palës Kontraktuese të Kërkuar do t'i përgjigjen kërkesës së specifikuar në paragrafin 1 sa më shpejt të jetë e mundur. Autoritetet kompetente të Palës Kontraktuese të Kërkuar mund të kërkojnë për më tepër informacion nëse është e nevojshme për të plotësuar kërkesën.

5. Çdo Palë Kontraktuese mund të refuzojë, plotësisht ose pjesërisht, një kërkesë për asistencë nëse ajo vlerëson se duke e plotësuar atë kërkesë mund të kërcënohet sovraniteti, siguria ose ndonjë interes tjetër jetik për shtetin e saj, ose nëse kërkesa nuk është në përputhje me legjislacionin e saj kombëtar, ose nëse kërkesa cenon detyrimet e saj që burojnë nga marrëveshjet ndërkombëtare. Me synim që të përmbushin kërkesën, Palët Kontraktuese mund të përcaktojnë kushtet në të cilat kushtëzohet përmbushja e saj.

6. Pala e Kërkuar do të informojë menjëherë me shkrim Palën Kërkuese duke deklaruar arsyet në rast të refuzimit të një kërkese ose plotësimit të pjesshëm të saj.

7. Kostot që rrjedhin, në zbatim të një kërkese, do të përballohen nga Pala Kontraktuese e Kërkuar, me përjashtim të nenit 6, paragrafi 2 dhe nenit 7, paragrafi 2, ku autoritetet kompetente vendosin bashkërisht mbi bazë rasti të veçantë për kompensimin financiar.

TITULLI IV
ATASHETË POLICORË

Neni 13

1. Autoritetet përgjegjëse të Palëve Kontraktuese mund të lidhin marrëveshje të posaçame në lidhje me caktimin e atasheve policorë për periudha kohe të përcaktuara ose të papërcaktuara për në shtetin e Palës tjetër Kontraktuese. Atasheve policorë do t'u jepet statusi i përfaqësuesve diplomatikë në pajtim me konventën e Vjenës të 18 prillit 1961 mbi Marrëdhëniet Diplomatike.

2. Qëllimi i caktimit të atasheve policorë për në shtetin e Palës tjetër Kontraktuese është që të përmirësohet dhe të përshpejtohet bashkëpunimi policor, në mënyrë të veçantë me anë të mbështetjes për procedurat e asistencës së ndërsjellë policore dhe gjyqësore në çështjet penale.

3. Atashetë policorë do të jenë aktivë me cilësi këshillimi dhe mbështetje, duke mos ushtruar përgjegjësi të pakufizuara. Ata japin informacion dhe kryejnë detyra në pajtim me instruksionet që ato marrin nga Pala në marrëveshje që i dërgon ato.

TITULLI V
MBROJTJA DHE TRANSMETIMI I TË DHËNAVE TEK TË TRETËT

Neni 14
Mbrojtja e të dhënave

Për qëllim të mbrojtjes së të dhënave me karakter personal që shkëmbehen nga Palët Kontraktuese brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje bashkëpunimi dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar të shteteve të Palëve Kontraktuese dhe me detyrimet e tyre respektive ndërkombëtare, do të respektohen kushtet e mëposhtme:

a) Të dhënat e klasifikuara mbi individët dhe përshkrimet e personalitetit, sikurse përcaktohet në nenin 6 të Konventës së Këshillit të Europës të datës 28 janar 1981 për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale, mund të shkëmbehen vetëm nëse është absolutisht e nevojshme dhe së bashku me të dhëna të tjera policore.

b) Pala në Marrëveshje e cila i merr ato, mund të përdorë të dhënat vetëm për qëllimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje dhe sipas kushteve të përcaktuara nga Pala në Marrëveshje që transmeton të dhënat; këto të dhëna mund të përdoren për qëllime të tjera vetëm me autorizim paraprak me shkrim të bëra nga Pala që transmeton të dhënat dhe në përputhje me legjislacionin e Palës Kontraktuese që merr të dhënat.

c) Mbi bazën e kërkesës të Palës Kontraktuese që transmeton të dhënat, Pala në Marrëveshje që merr të dhënat do të japë informacion mbi përdorimin e të dhënave të transmetuara dhe rezultatet e përfituara si rrjedhim.

d) Të dhënat mund të përdoren vetëm nga autoritetet gjyqësore ose policore ose nga ndonjë autoritet tjetër i caktuar nga Palët Kontraktuese për qëllim të luftës kundër krimit. Një listë e autoriteteve të duhura do t'i komunikohet Palës tjetër Kontraktuese. Të dhënat nuk mund të transferohen tek autoritete të tjera me përjashtim kur ka një aprovim me shkrim të Palës Kontraktuese që transmeton të dhënat.

e) Pala në Marrëveshje që transmeton të dhënat do të marrë përsipër të sigurojë që të dhënat e transmetuara janë të sakta, dhe do të verifikojë nëse transmetimi është i nevojshëm dhe proporcional me qëllimin e paracaktuar. Për këtë, është e nevojshme të respektohen legjislacionet kombëtare të të dyja Palëve, gjë që mund të kufizojë transmetimin e të dhënave. Nëse më vonë konstatohet që janë transmetuar të dhëna të pasakta ose të paautorizuara, Pala në Marrëveshje që mori të dhënat duhet të njoftohet menjëherë. Pala në Marrëveshje që mori të dhënat do t'i korrigjojë gabimet ose, në rastin kur të dhënat nuk duhej të ishin transmetuar, do t'i asgjësojë ato.

f) Personat, të dhënat personale të të cilëve u transmetuan, me kërkesën e tyre do të marrin informacion rreth të dhënave të transmetuara dhe përdorimit të tyre të paracaktuar. Publikimi i

informacionit duhet të bëhet në pajtim me legjislacionin kombëtar të Palës Kontraktuese ku është bërë kërkesa. Kërkesa do të plotësohet vetëm mbi bazën e pëlqimit paraprak me shkrim të Palës tjetër Kontraktuese.

g) Kur transmetohen të dhënat, Pala në Marrëveshje që i transmeton ato mund të njoftojë Palën tjetër Kontraktuese për afatin e fundit për asgjësimin e tyre në përputhje me legjislacionin kombëtar të shtetit të saj. Pavarësisht afatit, të dhënat duhet të fshihen menjëherë sapo të pushojnë së qeni të nevojshme. Pala në Marrëveshje që i transmeton të dhënat duhet të informohet rreth fshirjes së të dhënave të transmetuara dhe rreth arsyeve për fshirjen. Në rastin e pushimit së vepruari të kësaj Marrëveshjeje, të gjitha të dhënat që janë marrë mbi bazën e saj do të eliminohen.

h) Të dyja Palët Kontraktuese do të regjistrojnë transmetimin, marrjen dhe fshirjen e të dhënave. Regjistrimi do të tregojë në mënyrë të veçantë qëllimin e transmetimit, autoritetet e përfshira dhe arsyet për fshirjen.

i) Sipas legjislacionit të saj Pala në Marrëveshje nuk mund t'ia hedhë përgjegjësinë e saj paditësit me anë të deklarimit që dëmi u shkaktua nga transmetimi i të dhënave të pasakta ose të paautorizuara. Nëse Palës Kontraktuese i kërkohet të paguajë kompensim për arsye të dëmit të shkaktuar nga përdorimi i të dhënave të transmetuara në mënyrë të pasaktë ose të dhënave të paautorizuara, Pala në Marrëveshje që transmeton të dhënat do ta rimbursojë Palën Kontraktuese që merr të dhënat për vlerën totale të kompensimit.

j) Të dyja Palët Kontraktuese do të kenë detyrën për të mbrojtur me efektivitet të dhënat e transmetuara kundër së drejtës së paautorizuar për t'i njohur dhe përdorur ato, dhe tjetërsimit ose publikimit të paautorizuar.

Neni 15

Mbrojtja e informacionit të klasifikuar dhe transmetimi tek të tretët

1. Pala në Marrëveshje që transmeton të dhënat do të vendosë kushte për përdorimin e informacionit, nëse ai konsiderohet i klasifikuar në kuadrin e legjislacionit të saj kombëtar. Pala në Marrëveshje që merr të dhënat duhet të respektojë mbrojtjen e nevojshme për informacionin e klasifikuar. Këto kushte mund të ndryshohen ose klasifikimi mund të hiqet në çdo kohë nga Pala në Marrëveshje, që transmeton të dhënat.

2. Informacioni i klasifikuar mund të përdoret vetëm nga policia dhe autoritetet e tjera përgjegjëse për parandalimin dhe luftimin e krimit, të cilët janë të autorizuar të përdorin të dhëna të klasifikuara. Të dhënat e klasifikuara mund t'i transmetohen vetëm autoriteteve të tjera ose shteteve të treta me miratimin paraprak me shkrim të Palës Kontraktuese që transmeton të dhënat. Këto të dhëna mund të përdoren vetëm nga persona të cilët kërkojnë informacion me qëllim që të përmbushin detyrat e tyre të punës dhe të cilët janë të autorizuar të kenë të drejtë në shfrytëzimin e këtyre të dhënave sipas legjislacionit kombëtar.

3. Çdo keqpërdorim në lidhje me të dhënat e klasifikuara dotë njoftohet me shkrim menjëhetë.

TITULLI VI

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 16

Autoritetet përgjegjëse

1. Autoritetet kompetente për qëllim të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje janë:

- Për Republikën e Shqipërisë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në Ministrinë e Brendshme, dhe
- për Konfederatën Zvicerane, Zyra e Policisë Federale në Departamentin Federal të Drejtësisë dhe Policisë,
- të cilat do të bashkëpunojnë drejtpërdrejt dhe në mënyrë operative në kuadrin e kompetencave të tyre respektive.

2. Autoritetet përgjegjëse do të shkëmbejnë numrat e tyre përkatës të telefonit, faksit ose adresa të tjera kontakti dhe caktojnë personin e kontaktit, i cili mundësisht ka njohuri mbi gjuhën e Palës tjetër Kontraktuese, brenda 30 ditëve pasi Marrëveshja të ketë hyrë në fuqi.

3. Autoritetet kompetente do të njoftojnë njëra-tjetrën pa vonesë për ndryshime në të dhënat e komunikuara sipas paragrafëve 1 dhe 2.

Neni 17
Gjuha

Nëse nuk bihet dakord ndryshe nga autoritetet kompetente, kjo Marrëveshje do të zbatohet në gjuhën angleze.

Neni 18
Takimet e ekspertëve

Një grup i përbashkët nga zyrtarë të nivelit të lartë nga Palët Kontraktuese do të takohen sipas nevojave me qëllim për të bërë bilancin e arritjeve të bashkëpunimit të kryer në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje, për të vlerësuar cilësinë e saj, për të diskutuar strategji të reja dhe për të vendosur nëse nevojitet që bashkëpunimi të plotësohet ose zhvillohet më tej.

Neni 19
Marrëveshje plotësuese

Për qëllim të zbatimit dhe zhvillimit të bashkëpunimit në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje, autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese mund të lidhin marrëveshje të mëtejshme policore në bazë dhe brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 20
Raporti përkundrejt marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare

Kjo Marrëveshje nuk do të pengojë detyrimet e shteteve të Palëve Kontraktuese që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare, dypalëshe ose shumëpalëshe nëpërmjet të cilave secili nga shtetet e Palëve Kontraktuese mund të jetë i kushtëzuar.

Neni 21
Hyrja në fuqi, Pushimi së vepruari dhe Denoncimi

1. Kjo Marrëveshje u nënshtrohet formaliteteve të aprovimit të brendshëm në pajtim me legjislacionin kombëtar të secilës Palë Kontraktuese dhe do të fillojë së vepruari në ditën e marrjes së shkëmbimit të fundit të notave që konfirmojnë këto aprovime të brendshme.

2. Kjo Marrëveshje është e vlefshme për një periudhë kohe të pakufizuar. Ajo mund të denoncohet në çdo kohë nga secila prej Palëve Kontraktuese me anë të një njoftimi me shkrim. Kjo marrëveshje do të pushojë së qeni e vlefshme gjashtë muaj pas datës së dorëzimit të këtij njoftimi me shkrim Palës tjetër Kontraktuese.

Bërë në Tiranë, më 21.9.2005 në dy origjinale, secila në gjuhët shqip dhe gjermanisht, duke qenë të dyja njëlloj të barasvlefshme.

LIGJ
Nr.9554, datë 8.6.2006

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN "PËR NJOFTIMIN DHE DORËZIMIN JASHTË SHTETIT TË DOKUMENTEVE GJYQËSORE DHE JASHTËGJYQËSORE NË FUSHËN CIVILE DHE TREGTARE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën "Për njoftimin dhe dorëzimin jashtë shtetit të dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në fushën civile dhe tregtare" të Konferencës së Hagës, bërë më 15 nëntor 1965, me deklarimet e parashikuara në këtë ligj.

Neni 2

Në zbatim të nenit 21 të kësaj Konvente, Republika e Shqipërisë deklaron si më poshtë:

a) në përputhje me nenin 2, autoritet qendror caktohet drejtoria që mbulon bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar në Ministrinë e Drejtësisë;

b) në përputhje me nenet 6 e 18, autoritete janë gjykatat, të cilat kanë kërkuar dokumentet gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në zbatim të kësaj Konvente;

c) në përputhje me nenin 9, autoritet përgjegjës, për të marrë dokumentet e transmetuara me rrugë konsullore, caktohet drejtoria që mbulon çështjet konsullore në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4938, datë 27.6.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.69, faqe 1947

KONVENTA
PËR NJOFTIMIN DHE DORËZIMIN JASHTË SHTETIT TË DOKUMENTEVE GJYQËSORE DHE JASHTËGJYQËSORE NË FUSHËN CIVILE DHE TREGTARE

(Përfunduar më 15 nëntor 1965 dhe hyrë në fuqi më 15 shkurt 1969)

Shtetet palë në këtë Konventë,

duke dëshiruar të krijojnë mjetet e nevojshme për t'u siguruar që dokumentet gjyqësore dhe jashtëgjyqësore që dërgohen jashtë shtetit, do të trajtohen prej marrësit në një kohë të pranueshme,

duke dëshiruar përmirësimin e organizimit të ndihmës së ndërsjellë gjyqësore për atë qëllim, duke thjeshtuar dhe përshpejtuar procedurat përkatëse,

vendosën të përfundojnë këtë Konventë dhe të merren vesh përsa u përket dispozitave të mëposhtme.

Neni 1

Kjo Konventë do të zbatohet në të gjitha rastet për çështje civile ose tregtare, ku ka rast për të transmetuar një dokument gjyqësor ose jashtëgjyqësor për t'u dërguar jashtë shtetit.

Kjo Konventë nuk do të zbatohet kur nuk dihet adresa e personit të cilit do t'i dërgohet dokumenti.

KAPITULLI I
DOKUMENTET GJYQËSORE

Neni 2

Çdo Shtet Kontraktues do të caktojë një Autoritet Qendror, i cili do të marrë kërkesa për dërgim që vijnë nga Shtete të tjera Kontraktuese dhe të procedojë në përputhje me dispozitat e neneve 3 deri në 6.

Çdo Shtet do të organizojë Autoritetin Qendror në përputhje me ligjin e vet.

Neni 3

Autoriteti ose oficeri gjyqësor kompetent sipas ligjit të Shtetit në të cilin dokumentet e kanë origjinën do t'i parashtrojë Autoritetit Qendror të Shtetit të adresuar një kërkesë në përputhje me modelin bashkëlidhur kësaj Konvente, pa ndonjë kërkesë legalizimi apo formalitet tjetër ekuivalent.

Dokumenti që do dërgohet ose një kopje e tij do t'i bashkëlidhet kërkesës. Kërkesa dhe dokumenti do të bëhen në dy kopje.

Neni 4

Nëse Autoriteti Qendror çmon se kërkesa nuk është në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, do të informojë menjëherë aplikantin dhe do të specifikojë kundërshtimet e tij ndaj kërkesës.

Neni 5

Autoriteti Qendror i Shtetit dërgues do të dërgojë dokumentin ose do ta rregullojë që ta dërgojë atë me anë të një metode të përshtatshme ose:

a) me një metodë të parashikuar nga ligji i saj i brendshëm për dërgimin e dokumenteve në paditë e brendshme për persona të cilët janë brenda territorit të saj ose

b) me anë të një metode të veçantë të kërkuar nga aplikanti, vetëm nëse kjo metodë nuk është në mospërputhje me ligjin e Shtetit Dërgues.

Objekt i nënparagrafit (b) të paragrafit të parë të këtij neni, dokumenti mund t'i dërgohet gjithmonë një marrësi që e pranon atë vullnetarisht.

Nëse dokumenti duhet të dërgohet sipas paragrafit të parë sa më sipër, Autoriteti Qendror mund të kërkojë që dokumenti të shkruhet ose të përkthehet në gjuhën zyrtare ose në një nga gjuhët zyrtare të Shtetit Dërgues.

Ajo pjesë e kërkesës, në formën bashkëlidhur kësaj Konvente, e cila përmban një përmbledhje të dokumentit që duhet dërguar, do të dërgohet me këtë dokument.

Neni 6

Autoriteti Qendror i Shtetit Dërgues ose çdo autoritet që mund të ketë caktuar për atë qëllim, do të plotësojë një certifikatë në formën e modelit bashkëlidhur kësaj Konvente.

Në certifikatë do të deklarohet se dokumenti është dërguar dhe do të përfshijë metoden, vendin dhe datën e dërgimit dhe personin të cilit i është dërguar. Nëse dokumenti nuk është dërguar, në certifikatë do të paraqiten arsyet që kanë parandaluar dërgimin.

Aplikanti mund të kërkojë që një certifikatë e paplotësuar nga një Autoritet Qendror ose nga një autoritet gjyqësor do të kundërfirmoset nga një prej këtyre autoriteteve.

Certifikata do t'i paraqitet aplikantit në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Neni 7

Termat standarde në modelin bashkëlidhur kësaj Konvente, në të gjitha rastet, do të jenë me shkrim në gjuhën frënge ose në atë angleze. Ato gjithashtu mund të jenë me shkrim në gjuhën zyrtare ose në një prej gjuhëve zyrtare të Shtetit nga i cili e kanë origjinën dokumentet.

Vendet korresponduese bosh do të plotësohen ose në gjuhën e shtetit që i drejtohen ose në gjuhën frënge apo angleze.

Neni 8

Çdo Shtet Kontraktues do të jetë i lirë për të kryer dërgimin e dokumenteve gjyqësore në lidhje me personat jashtë shtetit, pa zbatimin e ndonjë detyrimi, në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet rrugëve të saj diplomatike ose konsullore.

Çdo shtet mund të deklarojë që është kundër këtij dërgimi brenda territorit të tij, përveç rasteve kur dokumenti i dërgohet një shtetasi të shtetit në të cilin dokumentet e kanë origjinën.

Neni 9

Për më tepër, çdo Shtet Kontraktues do të jetë i lirë për të përdorur rrugë konsullore për të paraqitur dokumente me qëllim dërgimin atyre autoriteteve të Shtetit tjetër Kontraktues, të cilët janë caktuar nga ky i fundit për këtë qëllim.

Në rrethana të jashtëzakonshme, çdo Shtet Kontraktues mund të kërkojë përdorimin e rrugëve konsullore për të njëjtin qëllim.

Neni 10

Nëse Shteti i destinacionit nuk ka kundërshtim, kjo Konventë nuk do të ndërhyjë në:

a) lirinë për të dërguar dokumente gjyqësore me postë në mënyrë të drejtpërdrejtë personave jashtë shtetit;

b) lirinë e oficerëve gjyqësorë, zyrtarëve ose personave të tjerë kompetentë të Shtetit të origjinës për të kryer dërgimin e dokumenteve gjyqësore në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet oficerëve gjyqësorë, zyrtarëve ose personave të tjerë kompetentë të Shtetit të destinacionit;

c) lirinë e çdo personi të interesuar në një procedim gjyqësor për të kryer dërgimin e dokumenteve gjyqësore në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet oficerëve gjyqësorë, zyrtarëve ose personave të tjerë kompetentë të Shtetit të destinacionit.

Neni 11

Kjo Konventë nuk do të ndalojë dy ose më shumë Shtete Kontraktuese nga rënia dakord për të lejuar, për qëllim të dërgimit të dokumenteve gjyqësore, rrugë transmetimi të ndryshme nga ato të parashikuara në nenet e mësipërme dhe, në veçanti, komunikimin e drejtpërdrejtë midis autoriteteve të tyre përkatëse.

Neni 12

Dërgimi i dokumenteve gjyqësore që vijnë nga një Shtet Kontraktues nuk do të mundësojnë ndonjë pagesë ose rimbursim të taksave ose kostove për dërgimet e dhëna nga Shteti Dërgues.

Aplikanti do të paguajë ose rimbursojë kostot e shkaktuara nga:

a) punësimi i oficerit gjyqësor ose i një personi kompetent sipas ligjit të Shtetit të destinacionit;

b) përdorimi i një metode specifike dërgimi.

Neni 13

Kur një kërkesë për dërgim është në përputhje me kushtet e kësaj Konvente, Shteti Dërgues mund të refuzojë të jetë dakord me këtë vetëm nëse çmon që përputhshmëria do të shkelte sovranitetin ose sigurinë e tij.

Ai mund të mos refuzojë të jetë në përputhje vetëm mbi bazën se, sipas ligjit të tij të brendshëm, pretendon juridiksion të posaçëm mbi lëndën e padisë ose se ligji i saj i brendshëm nuk do të lejonte padinë mbi të cilën është bazuar aplikimi.

Në rast refuzimi, Autoriteti Qendror do të informojë menjëherë aplikantin dhe do të deklarojë arsyet e refuzimit.

Neni 14

Vështirësitë që mund të lindin në lidhje me transmetimin e dokumenteve gjyqësore për dërgim do të zgjidhen me rrugë diplomatike.

Neni 15

Kur një thirrje gjyqësore ose një dokument ekuivalent duhet të transmetohej jashtë shtetit për qëllim dërgimi, sipas dispozitave të kësaj Konvente dhe kur i padituri nuk është paraqitur, vendimi nuk do të jepet derisa të vërtetohet se:

a) dokumenti është dërguar me anë të një metode të parashikuar nga ligji i brendshëm i shtetit dërgues për dërgimin e dokumenteve për paditë e brendshme mbi personat që janë brenda territorit të saj, ose

b) dokumenti në të vërtetë i është dërguar të padituri ose në banesën e tij me anë të një metode të ndryshme nga ajo e parashikuar nga kjo Konventë,

dhe se në secilin prej këtyre rasteve, dërgimi është kryer në kohën e nevojshme për t'i mundësuar të padituri të mbrohet.

Secili Shtet Kontraktues do të jetë i lirë të deklarojë se gjykatësi, pavarësisht nga dispozitat e paragrafit të parë të këtij neni, mund të japë vendime edhe nëse nuk është marrë asnjë certifikatë dërgimi, nëse janë përmbushur të gjitha kusht mëposhtme:

a) dokumenti është transmetuar me anë të njërës prej metodave të parashikuara në këtë Konventë;

b) ka kaluar një periudhë kohore prej jo më pak se gjashtë muajsh që prej datës së transmetimit të dokumentit, e konsideruar e mjaftueshme nga gjykatësi në rastin specifik;

c) nuk është marrë asnjë certifikatë e çfardolloji, edhe nëse është bërë çdo përpjekje e arsyeshme për ta përftuar atë nëpërmjet autoriteteve kompetente të Shtetit Dërgues.

Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve të mësipërm, gjykatësi mund të urdhërojë në rast urgjence, masa të përkohshme ose mbrojtëse.

Neni l6

Kur një thirrje gjyqësore ose një dokument ekuivalent duhet të transmetohej jashtë shtetit për qëllim dërgimi, sipas dispozitave të kësaj Konvente dhe është marrë një vendim kundër një të

padituri i cili nuk është paraqitur, gjykatësi do të ketë kompetencën ta lehtësojë të padituri nga efektet e skadimit të kohës për apel nga vendimi nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

a) i padituri, pa pasur faj nga ana e tij, nuk ka pasur dijeni për dokumentin në kohë të mjaftueshmë për t'u mbrojtur ose nuk ka pasur dijeni për vendimin në kohë të mjaftueshme për të apeluar, dhe

b) i padituri ka zbuluar fillimisht mbrojtje ndaj padisë në themel.

Një aplikim për ndihmë mund të paraqitet vetëm brenda një kohe të arsyeshme, pasi i padituri të ketë marrë dijeni për vendimin.

Secili Shtet Kontraktues mund të deklarojë se aplikimi nuk do të merret në konsideratë nëse është paraqitur pas skadimit të një kohe që duhej deklaruar në deklaratë, por që në asnjë rast nuk do të jetë më pak se një vit pas datës së vendimit.

Ky nen nuk do të zbatohet për vendime në lidhje me statusin ose kapacitetin e personave.

KAPITULLI II
DOKUMENTET JASHTËGJYQËSORE

Neni 17

Dokumentet jashtëgjyqësore që dalin nga autoritetet dhe oficerët gjyqësorë të një Shteti Kontraktues mund të transmetohen për qëllime dërgimi në një Shtet tjetër Kontraktues me anë të metodave dhe sipas dispozitave të kësaj Konvente.

KAPITULLI III
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 18

Secili Shtet Kontraktues mund të caktojë autoritete të tjera përveç Autoritetit Qendror dhe do të përcaktojë shkallën e kompetencës së tyre.

Megjithatë, aplikanti, në të gjitha rastet do të ketë të drejtën e adresimit të një kërkese në mënyrë të drejtpërdrejtë Autoritetit Qendror.

Shtetet Federale do të jenë të lira të caktojnë më shumë se një Autoritet Qendror.

Neni 19

Në shkallën që ligji i brendshëm i një Shteti Kontraktues lejon metodat e transmetimit, të ndryshme nga ato të parashikuara në nenet e mëparshme të dokumenteve që vijnë nga jashtë shtetit për dërgim brenda terriotrit të tij, kjo Konventë nuk do të cenojë këto dispozita.

Neni 20

Kjo Konventë nuk do të ndalojë një marrëveshje midis dy ose më shumë Shteteve Kontraktuese për të përjashtuar:

a) nevojën për dy kopje të dokumenteve të transmetuara siç kërkohet nga paragrafi i dytë i nenit 3;

b) kërkesat gjuhësore të paragrafit të tretë të neneve 5 dhe 7;

c) dispozitat e paragrafit të katërt të nenit 5;

d) dispozitat e paragrafit të dytë të nenit 12.

Neni 21

Secili Shtet Kontraktues, në kohën e depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit apo aderimit ose në një datë të mëvonshme, do të informojë Ministrinë e Jashtme të Hollandës në lidhje me sa më poshtë:

a) caktimin e autoriteteve, sipas neneve 2 dhe 18;

b) caktimin e një autoriteti kompetent për të plotësuar certifikatën sipas nenit 6;

c) caktimin e një autoriteti kompetent për të marrë dokumente të transmetuara me rrugë konsullore, sipas nenit 9.

Po ashtu, secili Shtet Kontraktues do të informojë Ministrinë, sipas rastit, në lidhje me:

a) kundërshtimin ndaj përdorimit të metodave të transmetimit sipas neneve 8 dhe 10;

b) deklaratat sipas paragrafit të dytë të nenit 15 dhe paragrafit të tretë të nenit 16;

c) të gjitha modifikimet e përcaktimeve, kundërshtimeve dhe deklaratave të mësipërme.

Neni 22

Kur edhe palët e kësaj Konvente janë palë në një ose në të dyja Konventat mbi Procedurën Civile të nënshkruara në Hagë më 17 korrik 1905 dhe më 1 mars 1954, kjo Konventë do të zëvendësojë si midis tyre nenet 1 deri në 7 të Konventave të mëparshme.

Neni 23

Kjo Konventë nuk do të cenojë zbatimin e nenit 23 të Konventës mbi Procedurën Civile të nënshkruar në Hagë më 17 korrik 1905 ose të nenit 24 të Konventës mbi Procedurën Civile të nënshkruar në Hagë më 1 mars 1954.

Megjithatë, këto nene zbatohen vetëm nëse përdoren metodat e komunikimit, të njëjta me ato të parashikuara në këto Konventa.

Neni 24

Marrëveshjet plotësuese midis Palëve në Konventat e vitit 1905 dhe 1954 do të konsiderohen si njësoj të zbatueshme në këtë Konventë, përveç rasteve kur palët kanë rënë dakord ndryshe.

Neni 25

Pa cenuar dispozitat e neneve 22 dhe 24, kjo Konventë nuk do të devijojë nga Konventat që përmbajnë dispozitat mbi çështjet e udhëhequra nga kjo Konventë në të cilat, Shtetet Kontraktuese janë ose do të bëhen Palë.

Neni 26

Kjo Konventë është e hapur për t'u firmosur nga shtetet anëtare të përfaqësuara gjatë sesionit të dhjetë të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private.

Kjo Konventë do të ratifikohet dhe instrumentet e ratifikimit do të depozitohen pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta.

Neni 27

Kjo Konventë do të hyjë në fuqi në ditën e gjashtëdhjetë pas depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit siç parashikohet në paragrafin e dytë të nenit 26.

Konventa do të hyjë në fuqi për çdo shtet palë që e ratifikon atë në një datë të mëvonshme në ditën e gjashtëdhjetë pas depozitimit të instrumentit përkatës të ratifikimit.

Neni 28

Çdo Shtet që nuk është përfaqësuar gjatë sesionit të shtatë të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private mund të aderojë në këtë Konventë pas hyrjes në fuqi të kësaj

Konvente në përputhje me nenin 27, paragrafi i parë. Instrumenti i aderimit do të depozitohet pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta.

Konventa do të hyjë në fuqi për këtë Shtet, nëse asnjë nga Shtetet të cilat e kanë ratifikuar atë përpara depozitimit të instrumentit të aderimit nuk paraqesin ndonjë kundërshtim pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta në lidhje me këtë aderim brenda gjashtë muajsh nga data e njoftimit të tyre prej kësaj Ministrie për këtë aderim.

Në mungesë të një kundërshtimi të tillë, Konventa do të hyjë në fuqi për këtë Shtet aderues në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e periudhës më të fundit të përmendur në paragrafin e mësipërm.

Neni 29

Në momentin e nënshkrimit, ratifikimit ose aderimit, çdo shtet mund të deklarojë shtrirjen e pasojave të kësaj Konvente, në të gjithë territorin që ai përfaqëson në nivel ndërkombëtar, apo në një ose disa prej tyre. Kjo deklaratë do të hyjë në fuqi në momentin e hyrjes në fuqi të Konventës në atë shtet.

Në vazhdimësi, për çdo shtrirje të kësaj natyre do të njoftohet Ministria e Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta.

Konventa do të hyjë në fuqi për territoret e përmendura në këtë zgjerim në ditën e gjashtëdhjetë pas njoftimit të përmendur në paragrafin e mësipërm.

Neni 30

Kjo Konventë do të mbetet në fuqi për një periudhë pesëvjeçare nga dita e hyrjes në fuqi të saj në përputhje me nenin 27 paragrafi i parë edhe përsa i përket shteteve që e kanë ratifikuar ose kanë aderuar në të në një datë të mëvonshme.

Në rast se nuk ka pasur asnjë denoncim, Konventa do të rinovohet në mënyrë të heshtur çdo pesë vjet.

Çdo denoncim do të njoftohet të paktën 6 muaj përpara skadimit të periudhës pesëvjeçare pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta.

Denoncimi mund të jetë i kufizuar në një territor ose territore të caktuara në të cilat zbatohet Konventa.

Denoncimi do të ketë efekt vetëm përsa i përket shtetit i cili e ka bërë atë. Konventa do të qëndrojë në fuqi për shtetet e tjera palë.

Neni 31

Ministria e Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta i njofton shteteve palë të përmenduara në nenin 26, si dhe shteteve që kanë aderuar në përputhje me nenin 28, sa më poshtë:

a) Çdo nënshkrim dhe ratifikim të përmendur në nenin 26;

b) Datën në të cilën kjo Konventë hyn në fuqi në përputhje me nenin 27 paragrafi i parë;

c) Çdo aderim të përmendur në nenin 28 dhe datën në të cilën hyn në fuqi;

d) Çdo zgjerim të parashikuar në nenin 29 dhe datën në të cilën hyn në fuqi;

e) Çdo caktim, kundërshtim dhe deklaratë të përmendur në nenin 21;

f) Çdo denoncim të parashikuar në nenin 30 paragrafi i tretë.

Në dëshmi të sa më sipër, nënshkruesit, të autorizuar posaçërisht, nënshkruajnë këtë Konventë.

Bërë në Hagë më 15 nëntor 1965 në dy gjuhë, anglisht dhe frëngjisht, të dy tekstet njësoj autentike, të lidhura në një kopje të vetme, e cila depozitohet në Arkivat e Qeverisë së Vendeve të Ulëta, prej të cilës një kopje e vërtetuar i dërgohet nëpërmjet kanaleve diplomatike çdo shteti të përfaqësuar në Sesionin e Dhjetë të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private.

[N.B. Më 25 tetor 1980 Sesioni i katërmbëdhjetë miratoi një rekomandim për informacionin që duhet të shoqërojë njoftimin dhe dorëzimin e dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në fushën civile dhe tregtare jashtë shtetit (Actes et documents de la Quatorzieme session (1980), Tome I, Matiéres diverses, p. 1-67; idem, Tome IV, Entraide judiciaire, p. 339; Udhëzues praktik mbi veprimin e Konventës së Hagës së 15 nëntorit 1965 për njoftimin dhe dorëzimin e dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore jashtë shtetit në fushën civile dhe tregtare)]

FORMULARËT (KËRKESA DHE CERTIFIKATA)
PËRMBLEDHJE E DOKUMENTIT QË DO TË DËRGOHET
(Shtojcat e parashikuara në nenet 3, 5, 6 dhe 7)
SHTOJCA NË KONVENTË
Forimularë
KËRKESA PËR DËRGIM JASHTË SHTETIT TË DOKUMENTEVE GJYQËSORE DHE JASHTËGJYQËSORE

Konventa për Njoftimin dhe Dorëzimin Jashtë Shtetit të Dokumenteve Gjyqësore dhe Jashtëgjyqësore në Fushën Civile dhe Tregtare, nënshkruar në Hagë më 15 nëntor 1965.

Identiteti dhe adresa e aplikantit	Adresa e autoritetit marrës

Aplikanti i nënshkruar ka nderin të transmetojë - në dy kopje- dokumentet e listuara më poshtë dhe, në përputhje me nenin 5 të Konventës së sipërpërmendur, kërkon dërgim të menjëhershëm të një kopjeje të kësaj te
marrësi, d.m.th.
(identiteti dhe adresa……

a) në përputhje me dispozitat e nënparagrafit (a) të paragrafit të parë të nenit 5 të Konventës*
b) në përputhje me metodën e mëposhtme specifike (nënparagrafi (b) i paragrafit të parë të nenit 5) *
c) më anë të dërgimit te marrësi, nëse ai e pranon atë vullnetarisht (paragrafi i dytë i nenit 5) *

Autoritetit i kërkohet të kthejë ose t'i ketë kthyer aplikantit një kopje të dokumenteve- dhe të shtojcave* - me një certifikatë siç parashikohet në anën e prapme.

Lista e dokumenteve
……
……
……
……
……
……

Bërë në……
Firma dhe/ ose vula

* Fshij nëse është e papërshtatshme
Ana e prapme e kërkesës

CERTIFIKATË
Autoriteti i nënshkruar ka nderin të vërtetojë, në përputhje me nenin 6 të Konventës.
1) që dokumenti është dërguar*
o data
……
o (vendi, rruga, numri)
……
……
- në një prej metodave të mëposhtme të autorizuara sipas nenit 5:
a) në përputhje me dispozitat e nënparagrafit (a) të paragrafit të parë të nenit 5 të Konventës*.
b) në përputhje me metodën specifike të mëposhtme*:
……
……
c) me anë të dërgimit ndaj marrësit, i cili e ka pranuar atë vullnetarisht*.
Dokumentet e referuara në kërkesë i janë dërguar:
o (identiteti dhe përshkrimi i personit)
……
……

o Marrëdhënia me marrësin (familja, biznesi ose të tjera):
o……
……
……
2) që dokumenti nuk është dërguar për arsyet e mëposhtme*:
……
……
……
Në përputhje me paragrafin e dytë të nenit 12 të Konventës, aplikantit i kërkohet të paguajë ose rimbursojë shpenzimet e detajuara në deklaratën bashkëlidhur*.

Shtojca
Dokumentet e kthyera:……
……
……
Në rastet e përshtatshme, dokumentet që vërtetojnë dërgimin:
……
……
Bërë në……
Firma dhe/ose vula

*Fshij nëse është e papërshtatshme

PËRMBLEDHJE E DOKUMENTIT QË DO TË DËRGOHET
Konventa mbi Dërgimin jashtë Shtetit të Dokumenteve Gjyqësore dhe Jashtëgjyqësore në Çështjet Civile ose Tregtare,
Nënshkruar në Hagë, më 15 nëntor 1965.
(neni 5 paragrafi i katërt)
Emri dhe adresa e autoritetit kërkues:
……
……

Informacion të detajuar për palët*:
……
……

DOKUMENTI GJYQËSOR**
Natyra dhe qëllimi i dokumentit:
……
……
Natyra dhe qëllimi i procedimeve dhe, kur duhet, sasinë në fjalë:
……
……
Data dhe vendi për paraqitjen**:
……
……
Gjykata që ka dhënë vendimin**:
……
……
Data e vendimit **:
……
……
Afatet e deklaruara në dokument **:
……
……
DOKUMENTI JASHTËGJYQËSOR**
Natyra dhe qellimi i dokumentit:
……
……
Afatet e deklaruara në dokument**:
……
……

LIGJ
Nr.9725, datë 7.5.2007

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROTOKOLLIN SHTESË TË PAKTIT NDËRKOMBËTAR PËR TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Protokollin shtesë të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5321, datë 21.5.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.61, faqe 1635

PROTOKOLL SHTESË I PAKTIT NDËRKOMBËTAR
PËR TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE

Miratuar dhe hapur për nënshkrim, ratifikim dhe aderim nga Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 2200A (XXI) e datës 16 dhjetor 1966

Hyrë në fuqi më 23 mars 1976, në përputhje me nenin 9

Shtetet Palë në këtë Protokoll:

duke marrë në konsideratë se për arritjen e mëtejshme të qëllimeve të Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike (këtu e tutje e referuar si "Pakti") dhe zbatimin e dispozitave të saj, do të ishte e përshtatshme t'i krijonte mundësinë Komitetit të të Drejtave të Njeriut të krijuar në pjesën IV të Paktit (këtu e tutje referuar si "Komiteti") të merrte dhe shqyrtonte, siç parashikohet në këtë Protokoll, komunikimin nga individët që pretendojnë të jenë viktima të shkeljeve të ndonjë prej të drejtave të parashtruara në Pakt,

kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

Neni l

Një Shtet Palë në Pakt, i cili bëhet Palë në këtë Protokoll njeh kompetencën e Komitetit për të marrë dhe shqyrtuar komunikimet nga individët, subjekt i juridiksionit të saj, të cilët pretendojnë të jenë viktima të një shkeljeje nga ai Shtet Palë të ndonjë prej të drejtave të parashtuara në Pakt. Asnjë komunikim nuk merret nga Komiteti nëse ka lidhje me një Shtet Palë të Paktit, i cili nuk është Palë në këtë Protokoll.

Neni 2

Subjekt i dispozitave të nenit 1, individët të cilët pretendojnë shkeljen e ndonjë prej të drejtave të tyre të përcaktuara në Pakt dhe që kanë konsumuar të gjitha zgjidhjet e brendshme në dispozicion, mund t'i paraqesin një komunikim me shkrim Komitetit për shqyrtim.

Neni 3

Komiteti çmon si të papranueshëm çdo komunikim sipas këtij Protokolli që është anonim ose të cilin ai e çmon të jetë abuzim i të drejtës së paraqitjes së këtyre komunikimeve ose në mospajtim me dispozitat e Paktit.

Neni 4

1. Subjekt i dispozitave të nenit 3, Komiteti sjell në vëmendjen e Shtetit Palë në këtë Protokoll çdo komunikim të dorëzuar atij sipas këtij Protokolli, që supozohet të shkelë ndonjë dispozitë të Paktit.

2. Brenda gjashtë muajsh, Shteti dërgues do t'i paraqesë Komitetit shpjegime ose deklarata me shkrim, duke shpjeguar çështjen dhe zgjidhjen, nëse ka, që mund të jetë përftuar nga ai Shtet.

Neni 5

1. Komiteti shqyrton komunikimet e marra sipas këtij Protokolli nën dritën e gjithë informacionit me shkrim që i është vënë në dispozicion nga individi dhe nga Shteti Palë i interesuar.

2. Komiteti nuk shqyrton ndonjë komunikim nga një individ, për sa kohë që nuk ka vërtetuar se:

a) e njëjta çështje nuk po shqyrtohet sipas një procedure tjetër të hetimit ose marrëveshjeje ndërkombëtare;

b) individi ka konsumuar të gjitha zgjidhjet e brendshme në dispozicion. Ky nuk është rregull kur zbatimi i zgjidhjeve zgjatet në mënyrë të paarsyeshme.

3. Komiteti zhvillon takime të mbyllura kur shqyrton komunikimet sipas këtij Protokolli.

4. Komiteti i paraqet pikëpamjet e tij Shtetit Palë të interesuar dhe individit.

Neni 6

Komiteti përfshin në raportin e tij vjetor sipas nenit 45 të Paktit një përmbledhje të aktiviteteve të tij sipas këtij Protokolli.

Neni 7

Në pritje të arritjes së objektivave të Rezolutës 1514 (XV), të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara e datës 14 dhjetor 1960 në lidhje me Deklaratën mbi Dhënien e Pavarësisë Vendeve dhe Popujve Kolonialë, dispozitat e këtij Protokolli nuk do të kufizojnë në asnjë mënyrë të drejtën e peticionit dhënë këtyre popujve nga Karta e Kombeve të Bashkuara dhe konventave e instrumenteve të tjera ndërkombëtare sipas Kombeve të Bashkuara dhe agjencive të saj të specializuara.

Neni 8

1. Ky Protokoll është i hapur për nënshkrim nga çdo shtet, i cili ka nënshkruar Paktin.

2. Ky Protokoll është objekt ratifikimi nga çdo shtet, i cili ka ratifikuar ose aderuar në Pakt. Instrumentet e ratifikimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

3. Ky Protokoll është i hapur për aderim nga çdo shtet, i cili ka ratifikuar ose aderuar në këtë Pakt.

4. Aderimi realizohet me anë të depozitimit të një instrumenti aderimi pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

5. Sekretari i Përgjithshem i Kombeve të Bashkuara informon të gjitha shtetet, të cilat kanë nënshkruar këtë Protokoll ose që kanë aderuar në të, në lidhje me depozitimin e çdo instrumenti ratifikimi aderimi.

Neni 9

1. Pas hyrjes në fuqi të Paktit, ky Protokoll hyn në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara të instrumentit të dhjetë të ratifikimit ose aderimit.

2. Për çdo shtet që ratifikon këtë Protokoll ose aderon në të pas depozitimit të instrumentit të dhjetë të ratifikimit ose aderimit, ky Protokoll hyn në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit ose aderimit.

Neni 10

Dispozitat e këtij Protokolli do të shtrihen në të gjitha pjesët e shteteve federale, pa kufizime ose përjashtime.

Neni 11

1. Çdo Shtet Palë në këtë Protokoll mund të propozojë një amendim dhe ta depozitojë atë pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Sekretari i Përgjithshëm i komunikon çdo amendim të propozuar Shteteve Palë në këtë Protokoll me një kërkesë që ata e njoftojnë atë nëse e favorizojnë një konferencë të Shteteve Palë, për qëllim të shqyrtimit dhe votimit në lidhje me propozimin. Në rast se të paktën një e treta e Shteteve Palë favorizon këtë konferencë, Sekretari i Përgjithshëm mban një konferencë nën kujdesin e Kombeve të Bashkuara. Çdo amendim i miratuar nga një shumicë e Shteteve Palë të pranishme dhe votuese në konferencë i paraqitet Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara për miratim.

2. Amendimet do të hyjnë në fuqi kur të jenë miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara dhe pranuar nga dy të tretat e Shteteve Palë në këtë Protokoll, në përputhje me proceset e tyre përkatëse kushtetuese.

3. Kur amendimet hyjnë në fuqi, do të jenë detyruese për ato Shtete Palë që i kanë pranuar, Shtete të tjera Palë që kanë ende detyrime ligjore për dispozitat e këtij Protokolli dhe çdo amendim të mëparshëm, të cilin kanë pranuar.

Neni 12

1. Çdo Shtet Palë mund ta denoncojë këtë Protokoll në çdo kohë me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Denoncimi hyn në fuqi tre muaj pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

2. Denoncimi nuk cenon zbatimin e vazhdueshëm të dispozitave të këtij Protokolli për çdo komunikim të paraqitur sipas nenit 2 para datës efektive të denoncimit.

Neni 13

Pavarësisht nga njoftimet e bëra sipas nenit 8 paragrafi 5 të këtij Protokolli, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të informojë të gjitha shtetet e referuara në nenin 48 paragrafi I të Paktit, në lidhje me detajet e mëposhtme:

a) nënshkrimet, ratifikimet dhe aderimet sipas nenit 8;

b) data e hyrjes në fuqi të këtij Protokolli sipas nenit 9 dhe data e hyrjes në fuqi të çdo amendimi sipas nenit 11;

c) denoncimet sipas nenit 12.

Neni 14

1. Ky Protokoll, tekstet e të cilit në gjuhën kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle janë njëlloj autentike, do të depozitohet në arkivat e Kombeve të Bashkuara.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të transmetojë kopjet e vërtetuara të këtij Protokolli të gjitha shteteve të referuara në nenin 48 të Paktit.

LIGJ
Nr.9726, datë 7.5.2007

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROTOKOLLIN E DYTË SHTESË TË PAKTIT NDËRKOMBËTAR PËR TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Protokollin e dytë shtesë të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5322, datë 21.5.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.61, faqe 1638

PROTOKOLLI I DYTË SHTESË
I PAKTIT NDËRKOMBËTAR MBI TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE, MBI HEQJEN E DËNIMIT ME VDEKJE

Miratuar dhe shpallur nga rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme nr.44/128 e datës 15 dhjetor 1989

Shtetet Palë në këtë Protokoll,

duke besuar se heqja e dënimit me vdekje kontribuon në zhvillimin e dinjitetit njerëzor dhe zhvillimit progresiv të të drejtave të njeriut;

duke risjellë në mend nenin 3 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, të miratuar më 10 dhjetor 1948 dhe nenin 6 të Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të miratuar më 16 dhjetor 1966;

duke vënë re se neni 6 i Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike i referohet heqjes së dënimit me vdekje që sugjeron fuqimisht se është i pëlqyeshëm;

të bindur se të gjitha masat e heqjes së dënimit me vdekje duhet të konsiderohen progresive në gëzimin e së drejtës për të jetuar;

me dëshirën për të ndërmarrë një angazhim ndërkombëtar për heqjen e dënimit me vdekje,

kane rënë dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

1. Askush brenda juridiksionit të një Shteti Palë në këtë Protokoll nuk ekzekutohet.

2. Çdo Shtet Palë merr të gjitha masat e nevojshme për heqjen e dënimit me vdekje brenda juridiksionit të tij.

Neni 2

1. Asnjë rezervë nuk lejohet në këtë Protokoll, përveç një rezerve të bërë në kohën e ratifikimit ose aderimit që parashikon zbatimin e dënimit me vdekje në kohën e luftës, sipas një dënimi për krimin më të rëndë të një natyre ushtarake të kryer gjatë periudhës së luftës.

2. Shteti Palë që bën këtë rezervë, në kohën e ratifikimit ose aderimit, i komunikon Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, dispozitat përkatëse të legjislacionit të saj kombëtar të zbatueshëm gjatë periudhës së luftës.

3. Shteti Palë që ka bërë këtë rezervë njofton Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara në lidhje me çdo fillim ose mbarim të gjendjes së luftës, të zbatueshëm në territorin e tij.

Neni 3

Shtetet Palë në këtë Protokoll përfshijnë në raportet që ata i paraqesin Komitetit të të Drejtave të Njeriut, në përputhje me nenin 40 të Paktit, informacion në lidhje me masat që ata kanë miratuar për t'i dhënë fuqi ligjore këtij Protokolli.

Neni 4

Përsa i përket Shteteve Pale të Paktit që kanë bërë një deklaratë sipas nenit 41, kompetenca e Komitetit të të Drejtave të Njeriut për të marrë dhe shqyrtuar komunikimet kur një Shtet Palë pretendon se Shteti tjetër Palë nuk po përmbush detyrimet e tij, shtrihet për dispozitat e këtij Protokolli nëse Shteti Palë i interesuar nuk ka bërë një deklaratë për të kundërtën në momentin e ratifikimit ose aderimit.

Neni 5

Përsa i përket Shteteve Palë në Protokollin e Parë Shtesë të Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të miratuar më 16 dhjetor 1966, kompetenca e Komitetit të të Drejtave të Njeriut për të marrë dhe shqyrtuar komunikimet nga individë, objekt i juridiksionit të saj, shtrihet për dispozitat e këtij Protokolli, nëse Shteti Palë i interesuar nuk ka bërë një deklaratë për të kundërtën në momentin e ratifikimit ose aderimit.

Neni 6

1. Dispozitat e këtij Protokolli zbatohen si dispozita shtesë të Paktit.

2. Pa cenuar mundësinë e një rezerve sipas nenit 2 të këtij Protokolli, e drejta e garantuar në nenin 1 paragrafi 1 të këtij Protokolli, nuk është objekt i ndonjë devijimi sipas nenit 4 të Paktit.

Neni 7

1. Ky Protokoll është i hapur për nënshkrim nga çdo shtet që ka nënshkruar Paktin.

2. Ky Protokoll është objekt ratifikimi nga çdo shtet që ka ratifikuar Paktin ose aderuar në të. Instrumentet e ratifikimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

3. Ky Protokoll është i hapur për aderim nga çdo shtet që ka ratifikuar Paktin ose ka aderuar në të.

4. Aderimi bëhet me anë të depozitimit të një instrumenti aderimi pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

5. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara informon të gjitha shtetet që kanë nënshkruar këtë Protokoll ose aderuar në të, në lidhje me depozitimin e çdo instrumenti ratifikimi ose aderimi.

Neni 8

1. Ky Protokoll hyn në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara të instrumentit të dhjetë të ratifikimit ose aderimit.

2. Për çdo shtet që ratifikon këtë Protokoll ose aderon në të pas depozitimit të instrumentit të dhjetë të ratifikimit ose aderimit, ky Protokoll hyn në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit ose aderimit.

Neni 9

Dispozitat e këtij Protokolli shtrihen për të gjitha pjesët e shteteve federale, pa kufizime ose përjashtime.

Neni 10

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara informon të gjitha shtetet e referuara në nenin 48 paragrafi 1 të Paktit, në lidhje me detajet e mëposhtme:

a) Rezervat, komunikimet dhe njoftimet sipas nenit 2 të këtij Protokolli;

b) Deklaratat e bëra sipas neneve 4 ose 5 të këtij Protokolli;

c) Nënshkrimet, ratifikimet dhe aderimet sipas nenit 7 të këtij Protokolli:

d) Data e hyrjes në fuqi të këtij Protokolli sipas nenit 8 të tij.

Neni 11

1. Ky Protokoll, tekstet e të cilit në gjuhët arabe, kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle janë njëlloj autentike, depozitohen në arkivat e Kombeve të Bashkuara.

2. Sekretari i Kombeve të Bashkuara i transmeton kopjet e vërtetuara të këtij Protokolli të gjitha shteteve të referuara në nenin 48 të Paktit.

LIGJ
Nr.9753, datë 14.6.2007

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN "PËR AKSES NDËRKOMBËTAR NË DREJTËSI"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën "Për akses ndërkombëtar në drejtësi" me deklarimet dhe rezervat e parashikuara në këtë ligj.

Neni 2

Në zbatim të nenit 28 të kësaj konvente, Republika e Shqipërisë paraqet rezervat si më poshtë:

a) Në përputhje me paragrafin e parë të nenit 28 të kësaj konvente, në mungesë të zbatimit të reciprocitetit me shtetin, shtetas i të cilit është kërkuesi i ndihmës juridike, Republika e Shqipërisë rezervon të drejtën të përjashtojë zbatimin e nenit 1 të konventës për personat, të cilët nuk janë shtetas të një shteti palë në këtë konventë, por që janë rezidentë të zakonshëm në një shtet palë, të ndryshëm nga shteti rezervues, ose që kanë qenë më parë rezidentë të zakonshëm në shtetin rezervues.

b) Në përputhje me nenet 7 dhe 28 paragrafi i dytë shkronja "a" të kësaj konvente, Republika e Shqipërisë merr parasysh vetëm ato kërkesa, të cilat hartohen në gjuhën shqipe, ose që shoqërohen nga një përkthim në gjuhën shqipe.

c) Paragrafi i dytë i nenit 13 të konventës nuk zbatohet për shtetasit e atyre shteteve, të cilat kanë paraqitur rezerva, në përputhje me shkronjën "b" të nenit 28 të konventës, si dhe për personat, të cilët kanë rezidencë të zakonshme në këto shtete.

ç) Parashikimet e kapitullit II të konventës nuk zbatohen për shtetasit e atyre shteteve, të cilat kanë paraqitur rezerva, në përputhje me shkronjën "c" të nenit 28 të konventës, si dhe për personat, të cilët kanë rezidencë të zakonshme në këto shtete.

Neni 3

Në zbatim të nenit 28 të kësaj konvente, Republika e Shqipërisë deklaron si më poshtë:

Sipas neneve 3, 4 e 16, drejtoria, që mbulon bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar në Ministrinë e Drejtësisë, caktohet autoritet qendror dhe autoritet transmetues.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5371, datë 25.6.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.80, faqe 2371

KONVENTA PËR AKSES NDËRKOMBËTAR NË DREJTËSI

(Lidhur në 25 tetor 1980)
(Ka hyrë në fuqi në 1 maj 1988)

Shtetet nënshkruese të kësaj Konvente,

të cilët dëshirojnë të lehtësojnë aksesin ndërkombëtar në drejtësi,

vendosën të lidhin një marrëveshje për këtë qëllim dhe ranë dakord për dispozitat e mëposhtme:

KAPITULLI I
NDIHMA LIGJORE

Neni 1

Shtetasit e çdo Shteti Kontraktues dhe personat që si rregull banojnë në ndonjë prej Shteteve Kontraktuese u jepet e drejta e ndihmës ligjore në seancat gjyqësore për çështjet civile dhe tregtare

në secilin Shtet Kontraktues me të njëjtat kushte sikur të ishin shtetas dhe rezidentë/banorë të zakonshëm të atij Shteti.

Personat të cilët nuk përfshihen në paragrafin 1, por që ishin banorë të rregullt më parë në Shtetin Kontraktues, ku do të fillojnë ose kanë filluar procedurat gjyqësore, prapë se prapë u jepet e drejta e ndihmës ligjore, siç është parashikuar në paragrafin 1, nëse shkaku i veprës ka të bëjë me banimin e mëparshëm të rregullt të tyre në atë shtet.

Në shtetet ku sigurohet ndihmë ligjore për çështjet administrative, sociale apo fiskale, do të zbatohen dispozitat e këtij neni, për çështjet e depozituara në gjykatat kompetente për çështje të tilla.

Neni 2

Neni 1 aplikohet për asistencën ligjore, me kusht që personi i cili kërkon këtë asistencë, të jetë i prezent në shtetin ku kërkohet konsulenca.

Neni 3

Çdo Shtet Kontraktues cakton një autoritet qendror për të pranuar dhe vendosur lidhur me aplikimet që dorëzohen për asistencë ligjore në bazë të kësaj Konvente.

Shtetet Federale dhe Shtetet të cilat kanë më shumë se një sistem ligjor, mund të caktojnë më shumë se një autoritet qendror. Nëse autoriteti qendror, të cilit i është dërguar aplikimi nuk është kompetent për ta shqyrtuar atë, ia kalon çdo autoriteti tjetër qendror të Shtetit Kontraktues që është kompetent për ta shqyrtuar atë.

Neni 4

Çdo Shtet Kontraktues cakton një ose me shumë autoritete transmetuese që t'ia kalojë aplikimet autoritetit të duhur qendror në shtetin e kërkuar.

Aplikimet për asistencë ligjore do të transmetohen/dërgohen pa ndërhyrjen e ndonjë autoriteti tjetër, në formën e modelit që i bashkëlidhet kësaj Konvente.

Asgjë e parashikuar nga ky nen, nuk e pengon që një aplikim të dërgohet nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 5

Në rast se aplikanti për asistencë ligjore nuk është i pranishëm në shtetin e kërkuar, ai mund t'ia dorëzojë aplikimin e tij autoritetit transmetues në Shtetin Kontraktues ku ai është banor i rregullt, pa paragjykuar mjete të tjera të mundshme për dorëzimin e aplikimit tek autoriteti kompetent në shtetin përkatës.

Aplikimi duhet të paraqitet në formën e modelit që i bashkëngjitet kësaj Konvente dhe do të shoqërohet me të gjitha dokumentet e nevojshme, pa paragjykime përsa i përket së drejtës që ka shteti në fjalë për të kërkuar më shumë të dhëna ose dokumente, në rastet kur është e nevojshme.

Çdo Shtet Kontraktues mund të deklarojë se autoriteti qendror marrës/pritës pranon aplikime që dorëzohen nga kanale apo metoda të tjera.

Neni 6

Autoriteti transmetues ndihmon aplikantët, duke i siguruar se aplikimi është i shoqëruar me të gjitha informacionet dhe dokumentet e nevojshme për t'u marrë në konsideratë aplikimi. Ai siguron që të përmbushen kërkesat.

Nëse autoriteti transmetues kupton që aplikimi është në mënyrë të qartë i pabazë, ai refuzojë ta dërgojë/transmetojë aplikimin.

Ai ndihmon aplikuesin/kërkuesin që të sigurojë përkthimin e dokumenteve pa pagesë, atëherë kur kjo ndihmë është e nevojshme.

Ai i përgjigjet kërkesës për informacion të mëtejshëm nga autoriteti qendror marrës/pritës në shtetin e kërkuar.

Neni 7

Aplikimi/kërkesa, dokumentet mbështetëse dhe çdo njoftim si përgjigje ndaj kërkesave për informacion të mëtejshëm të jenë në gjuhën zyrtare ose në një prej gjuhëve zyrtare të shtetit të kërkuar ose të jenë shoqëruar me një përkthim në një prej atyre gjuhëve.

Megjithatë, aty ku në shtetin e kërkuar nuk është e mundshme të sigurohet një përkthim në gjuhën e shtetit të kërkuar, i cili i pranon dokumentet në gjuhën angleze ose në gjuhën frënge, ose i pranon dokumentet të shoqëruara me një përkthim në një prej atyre dy gjuhëve.

Njoftimet që dalin nga autoriteti/organi qendror marrës mund të përpilohen në gjuhën zyrtare ose në një prej gjuhëve zyrtare të shtetit të kërkuar, ose në gjuhën angleze apo në gjuhën frënge. Megjithatë, nëse aplikimi i dërguar nga autoriteti transmetues është në gjuhën angleze ose në gjuhën frënge, ose shoqërohet me një përkthim në një prej atyre gjuhëve, njoftimet e nxjerra nga autoriteti qendror marrës të jenë gjithashtu në një prej atyre dy gjuhëve.

Shpenzimet e përkthimit lidhur me aplikimin e paragrafëve të mësipërm të mbulohen nga shteti i kërkuar, vetëm se çdo përkthim i bërë në shtetin e kërkuar të mos japë shkas për të pretenduar rimbursim nga ana e atij shteti.

Neni 8

Autoriteti/organi qendror marrës/pritës vendos për aplikimin ose merr masa të tilla të nevojshme për të marrë vendim me kompetencën e autoritetit respektiv në shtetin e kërkuar.

Autoriteti/organi qendror marrës ia kalon kërkesat për detaje të mëtejshme autoritetit transmetues dhe e njofton atë për çdo vështirësi lidhur me shqyrtimin e aplikimit dhe vendimin e marrë.

Neni 9

Atëherë kur kandidati për asistencë/ndihmë ligjore nuk banon në Shtetin Kontraktues, ai mund ta dorëzojë kërkesën nëpërmjet kanaleve konsullore, pa paragjykime ndaj çdo mjeti tjetër të paraqitjes së kërkesës së tij autoriteteve kompetente/përkatëse në shtetin e kërkuar.

Çdo Shtet Kontraktues mund të deklarojë se autoriteti qendror pritës pranon aplikime që dorëzohen nga kanale apo mënyra të tjera.

Neni 10

Të gjitha dokumentet e dërguara sipas këtij kapitulli janë të çliruara nga legalizimi ose çdo formalitet tjetër analog.

Neni 11

Nuk do të ketë pagesë për transmetimin, marrjen ose përcaktimin e aplikimit për asistencë ligjore sipas këtij kapitulli.

Neni 12

Aplikimet për asistencë ligjore do të shqyrtohen në afat kohor të shpejtë.

Neni 13

Në rastet kur asistenca ligjore garantohet në përputhje me nenin 1, shërbimi për dokumentet në çdo Shtet tjetër Kontraktues lidhur me procedurat e asistencës ligjore të personave, nuk do të bëhet me pagesë, pavarësisht nga mënyra sesi kryhet shërbimi. E njëjta gjë mund të thuhet për letërkërkesat dhe raportet e kërkimit social, përveç tarifës së pagesës për ekspertët dhe përkthyesit.

Në rastet kur një person ka marrë asistencë ligjore në përputhje me nenin 1 për procedurat që kryhen në një Shtet Kontraktues dhe vendimin që është marrë gjatë procedimeve, ai ka të drejtën e asistencës ligjore, pa shqyrtuar më tej rrethanat, në çdo Shtet Kontraktues ku ai përpiqet të sigurojë njohjen apo zbatimin e atij vendimi.

KAPITULLI II
GARANCIA PËR SHLYERJEN E DETYRIMEVE GJYQËSORE DHE ZBATIMI I URDHRAVE LIDHUR ME TO

Neni 14

Nuk kërkohet asnjë siguri, kontratë apo depozitë e ndonjë lloji të caktuar nga persona (duke përfshirë persona ligjorë) të cilët janë banorë të rregullt në një Shtet Kontraktues dhe janë paditës ose palë që ndërhyjnë në seanca gjyqësore ose në gjykata të një Shteti tjetër Kontraktues vetëm për shkak të kombësisë së huaj ose për shkak se nuk kanë jetuar apo nuk kanë qenë banorë në shtetin ku kanë filluar procedurat.

I njëjti rregull zbatohet për çdo pagesë që pretendohet nga paditësit apo palët pjesëmarrëse si siguri për tarifën gjyqësore.

Neni 15

Do të zbatohet pa taksë, në çdo Shtet Kontraktues, urdhri për pagesën e shpenzimeve gjyqësore të kryera në një nga Shtetet Kontraktuese ndaj çdo personi të çliruar nga kërkesat për garanci, detyrime, depozitë ose pagesë duke u mbështetur në nenit 14 të ligjit të shtetit ku kanë filluar procedurat për zbatimin e urdhrit që i jep të drejtë personave të përfitojnë prej tij.

Neni 16

Çdo Shtet Kontraktues përcakton një ose më shumë autoritete transmetuese, me qëllim që të dërgojnë aplikimet tek autoritet përkatëse qendrore në shtetin e kërkuar për të vënë në praktikë urdhrat në zbatim të nenit 15.

Çdo Shtet Kontraktues cakton autoritetet qendrore që të pranojnë aplikime të tilla dhe të marrin hapat e duhura për të qenë të sigurt që të merret një vendim përfundimtar/i formës së prerë për to.

Shtetet federale dhe shtetet të cilat kanë më shumë se një sistem ligjor caktojnë më shumë se një autoritet qendror. Në rast se autoriteti qendror, të cilit i është dërguar një aplikim, nuk i ka kompetencat ta marrë atë në shqyrtim, atëherë ai duhet t'ia dërgojë aplikimin cilitdo autoriteti tjetër qendror në shtetin e kërkuar që ka kompetencat e duhura.

Sipas këtij neni, aplikimit transmetohen pa ndërhyrjen e ndonjë autoriteti tjetër, pa paragjykuar ndonjë aplikim që transmetohet me rrugë diplomatike.

Asgjë në këtë nen nuk pengon që aplikimet të bëhen drejtpërsëdrejti nga persona që gëzojnë të drejtën e përfitimit nga ky urdhër për të bërë aplikimin vetëm nëse shteti përkatës deklaron se nuk do t'i pranojë aplikimit e bëra në këtë mënyrë.

Neni 17

Çdo aplikim sipas nenit 15 do të shoqërohet me:

a) një kopje origjinale të pjesës përkatëse të vendimit me emrat dhe aftësitë ligjore të palëve dhe të urdhrit të pagesës së detyrimeve;

b) çdo dokument të nevojshëm që provon se vendimi nuk është më subjekt i formave të zakonshme të rishikimit në shtetin e origjinës dhe që duhet të zbatohet në atë shtet;

c) përkthimin, të certifikuar si të vërtetë, të dokumenteve të sipërpërmendura në gjuhën e shtetit kërkues, nëse ato nuk janë në atë gjuhë.

Vendimet për aplikimet merren pa seancë gjyqësore dhe autoriteti kompetent në shtetin kërkues kufizohet në shqyrtimin e vënies në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar. Në bazë të kërkesave të aplikantit, autoriteti përcakton/duhet të caktojë shumën e shpenzimeve të legalizimeve, përkthimeve dhe certifikimet, të cilat duhet të trajtohen si shpenzime dhe kosto të procedurave.

Nuk kërkohet asnjë formalitet apo legalizim analog.

Nuk ka të drejtë apelimi ndaj vendimeve të autoriteteve kompetente, përveç rastit kur ka përputhje me ligjin e shtetit përkatës.

KAPITULLI III
KOPJE TË REGJISTRIMEVE DHE VENDIMEVE

Neni 18

Shtetasit e çdo Shteti Kontraktues dhe personat rezidentë/banorë të rregullt të çdo Shteti Kontraktues, marrin me të njëjtat terma dhe kushte si shtetasit e tij, kopje ose ekstrakte/pjesë nga regjistrimet në regjistrat publikë dhe vendimet lidhur me çështjet civile ose tregtare dhe i marrin ato dokumente të legalizuara, kur është e nevojshme.

KAPITULLI IV
NDALIMI FIZIK DHE SJELLJA E MIRË

Neni 19

Arrestimi dhe ndalimi si mjet për zbatimin e ligjit ose si masë parandaluese nuk duhet të përdoret si për çështjet civile, ashtu edhe për ato tregtare kundër shtetasve të një Shteti Kontraktues ose personave rezident në atë Shtet Kontraktues në rrethana ku nuk mund të zbatohet ndaj shtetasve të shtetit ku kryhet ndalimi ose arrestimi. Çdo fakt që mund të lidhet me kërkesat e një rezidenti banor i rregullt i atij shteti për të fituar lirinë nga arresti ose ndalimi mund të kërkohet me të njëjtën forcë/ndikim nga një shtetas i të njëjtit Shtet Kontraktues ose nga një person rezident në Shtetin Kontraktues, edhe pse një fakt i tillë mund të ketë ndodhur jashtë atij shteti.

Neni 20

Personi, i cili është shtetas ose banor i rregullt në një Shtet Kontraktues dhe që thërritet në emër nga një gjykatë ose trup gjykues në një tjetër Shtet Kontraktues, ose nga një palë, me leje të gjykatës ose trupit gjykues, në mënyrë që të paraqitet si dëshmitar ose ekspert gjatë procedurave që zhvillohen në atë shtet, nuk do të jetë përgjegjës para ndjekjes penale ose arrestimit, ose t'i nënshtrohet çdo lloj kufizimi tjetër të lirive të tij personale, në territorin e atij shteti, përsa i përket çdo akti apo dënimi që mund të ngjasë para mbërritjes së tij në atë shtet.

Imuniteti i siguruar në paragrafin pararendës hyn në fuqi shtatë ditë para datës së caktuar për seancën e dëgjimit të dëshmitarit ose ekspertit dhe mbaron kur dëshmitari ose eksperti, për një periudhë prej shtatë ditësh në vazhdim, që nga data kur ai është lajmëruar nga autoritetet juridike që

prezenca e tij nuk është më e nevojshme, i cili ka pasur mundësi të largohet, por që megjithatë ka qëndruar në atë territor, ose e ka lënë atë, është kthyer me dëshirë/në mënyrë të vullnetshme.

KAPITULLI V
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 21

Pa paragjykuar dispozitat e nenit 22, asgjë në këtë Konventë nuk do të interpretohet si kufizim i ndonjë të drejte përsa i përket çështjeve të trajtuara nga kjo Konventë, që mund t'i akordohen një personi sipas ligjit të çdo Shteti Kontraktues ose sipas çdo konvente tjetër me të cilën është ose mund të bëhet palë.

Neni 22

Midis palëve pjesëmarrësve të kësaj Konvente, të cilat janë gjithashtu pjesëmarrëse të një apo dy konventave mbi procedurat civile të nënshkruara në Hagë më 17 korrik 1905 dhe 1 mars 1954, kjo Konventë do të zëvendësojë nenet nga 17 deri tek 24 të Konventës së vitit 1905 ose nenet 17 deri tek 26 të Konventës së vitit 1954, edhe nëse është siguruar rezervimi sipas paragrafit 2 c) të nenit 28 të kësaj Konvente.

Neni 23

Marrëveshjet shtesë (suplementare) midis Palëve të kësaj Konvente së vitit 1905 dhe 1954, duhet të konsiderohen si të aplikueshme në mënyrë të barabartë në konventën ekzistuese, deri në masën kur janë në përputhje me të, me përjashtim të rastit kur palët bien dakord për të kundërtën.

Neni 24

Shteti Kontraktues mundet që me anë të një deklarate të specifikojë një gjuhë apo disa gjuhë përveç atyre që përmenden në nenet 7 dhe 17, në të cilën mund të përpilohen ose përkthehen dokumentet e dërguara tek autoriteti qendror.

Neni 25

Nëse një Shtet Kontraktues, i cili ka më shumë se një gjuhë zyrtare dhe nuk mundet, për arsye të ligjeve të brendshme, të pranojë për të gjithë territorin e tij dokumentet e përmendura në nenet 7 dhe 17 të përpiluara në një nga këto gjuhë, të specifikojë, me anë të një deklarate, gjuhën në të cilën dokumente ose përkthime të tilla duhet të përpilohen që të jenë të pranueshme në zona të caktuara të territorit të atij shteti.

Neni 26

Në rast se një Shtet Kontraktues ka dy ose më shumë njësi territoriale, në të cilat zbatohen sisteme të ndryshme ligjore lidhur me çështje që trajtohen në këtë Konventë, mundet që në momentin e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aksesi, të deklarojë që kjo Konventë të shtrihet në të gjitha njësitë territoriale ose vetëm te njëra apo më shumë se një prej tyre dhe mund ta ndryshojë atë deklaratë me anë të një deklarate tjetër në çdo kohë.

Çdo deklaratë e tillë i bëhet e ditur Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Holandës dhe duhet të cilësojë shprehimisht njësitë territoriale në të cilat aplikohet Konventa.

Neni 27

Në rastet kur Shteti Kontraktues ka një sistem qeverisjeje, sipas të cilit pushteti ekzekutiv, gjyqësor dhe legjislativ shpërndahet ndërmjet autoriteteve qendrore dhe të tjera brenda atij shteti, nënshkrimi ose ratifikimi i saj, pranimi ose aprovimi, ose aksesi te kjo Konventë, ose bërja e çdo deklarate sipas nenit 26, nuk sjell asnjë implikim/ndërlikim përsa i përket shpërndarjes së brendshme të pushteteve brenda atij shteti.

Neni 28

Çdo Shtet Kontraktues mund të ruajë/rezervojë të drejtën që në cilëndo kohë të nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, hyrjes apo aprovimit, ose aksesit, të përjashtojë aplikimin e nenit 1 për personat që nuk janë shtetas të Shtetit Kontraktues, por që janë banorë të rregullt të Shtetit Kontraktues, ndryshe nga shteti rezervë ose që ishin më parë banorë të rregullt të Shtetit rezervë, në rast se nuk ka trajtim të ndërsjellë ndërmjet shtetit rezervë dhe shtetit ku banojnë aplikantët që kërkojnë asistencë ligjore.

Çdo Shtet Kontraktues mund të ruajë/rezervojë të drejtën që në cilëndo kohë të nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, hyrjes apo aprovimit, ose aksesit, të përjashtojë:

a) përdorimin e gjuhës angleze apo frënge, ose të dyjave, sipas paragrafit 2 të nenit 7;

b) zbatimin e paragrafit 2 të nenit 13;

c) zbatimin e kapitullit II;

d) zbatimin e nenit 20.

Kur një shtet e ka bërë rezervimin

e) sipas paragrafit 2 a) të këtij neni, duke përjashtuar përdorimin e gjuhës angleze dhe frënge, çdo Shtet tjetër i përfshirë në lidhje me të mund të zbatojë të njëjtin rregull ndaj Shtetit rezervues.

f) sipas paragrafit 2 b) të këtij neni, çdo shtet tjetër mund të refuzojë të aplikojë paragrafin 2 të nenit 13 për persona të cilët janë shtetas të apo janë rezidentë të rregullt në shtetin rezervues;

g) sipas paragrafit 2 c) të këtij neni, çdo shtet tjetër mund të refuzojë që kapitulli II të zbatohet për ata persona të cilët janë shtetas apo rezidentë të rregullt në shtetin rezervues.

Asnjë rezervim tjetër nuk do të lejohet.

Çdo Shtet Kontraktues në çdo kohë mund të tërheqë rezervimin që ka bërë. Tërheqja duhet t'i njoftohet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Holandës. Rezervimi nuk do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit të tretë kalenderik pas njoftimit.

Neni 29

Çdo Shtet Kontraktues, në kohën e depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit ose pranimit, ose në një datë të mëvonshme, duhet të informojë Ministrinë e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Holandës për emërtimin e autoriteteve në bazë të neneve 3, 4 dhe 16.

Ajo duhet të informojë gjithashtu Ministrinë, kur është e nevojshme për sa vijon më poshtë:

a) deklaratën në bazë të neneve 5, 9, 16, 24, 25, 26 dhe 33;

b) çdo tërheqje ose modifikim të përcaktimeve dhe deklaratave të mësipërme;

c) tërheqja e çdo lloj rezervimi.

Neni 30

Formularët model të bashkëngjitur kësaj Konvente mund të amendohen/përmirësohen me një vendim të një komisioni të veçantë që thërritet nga Sekretari i Përgjithshëm i Konferencës së Hagës, ku do të ftohen të gjitha Shtetet Kontraktuese dhe Shtetet Anëtare. Njoftimi i propozimit për përmirësimin e formularëve duhet të përfshihet në rendin e ditës së takimit.

Amendamentet e miratuara nga shumica e Shteteve Kontraktuese të pranishme dhe që votojnë në komisionin special hyjnë në fuqi për të gjitha Shtetet Kontraktuese ditën e parë të muajit të shtatë kalendarik pas datës së komunikimit të tyre nga Sekretari i Përgjithshëm për të gjitha Shtetet Kontraktuese.

Gjatë periudhës siç është parashikuar në paragrafin 2, çdo Shtet Kontraktues, me anë të njoftimit me shkrim drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Holandës, mund të bëjë rezervime përsa i përket amendamenteve. Pala e cila bën një rezervim trajtohet si shtet e jo si palë derisa të tërhiqet rezervimi për Konventën në fjalë përsa i përket amendamenteve.

KAPITULLI VI
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 31

Konventa është e hapur të nënshkruhet nga Shtete që kanë qenë Anëtare në Konferencën e Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private gjatë seancës së katërmbëdhjetë dhe nga Shtetet jo Anëtare, të cilat ishin ftuar të merrnin pjesë për përgatitjen e saj.

Ajo duhet të ratifikohet, pranohet ose aprovohet dhe të depozitohen instrumentet e ratifikimit, pranimit ose aprovimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Holandës.

Neni 32

Çdo Shtet tjetër mund të miratojë Konventën.

Instrumenti i pranimit duhet të depozitohet në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Holandës.

Pranimi do të hyjë në fuqi vetëm përsa i përket marrëdhënieve ndërmjet shtetit miratues dhe Shteteve Kontraktuese të cilat nuk kanë dalë kundër pranimit e saj gjatë dymbëdhjetë muajve pas marrjes së njoftimit, të cilit i referohemi te nënparagrafi 2 i nenit 36. Mospranimi mund të bëhet nga Shtetet Anëtare gjatë kohës së ratifikimit, pranimit ose aprovimit të Konventës pas hyrjes në fuqi.

Neni 33

Çdo shtet mund të deklarojë gjatë kohës së nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aksesit që Konventa të shtrihet në të gjitha territoret për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilave ai mban përgjegjësi, ose në njërin apo më shumë prej tyre. Një deklarim i tillë ka efekt kur Konventa hyn në fuqi për atë shtet. Kjo deklaratë dhe çdo shtesë tjetër pasuese duhet t'i njoftohet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Holandës.

Neni 34

Konventa hyn në fuqi ditën e parë të muajit të tretë kalendarik pas depozitimit të dokumentit ligjor/instrumentit të tretë të ratifikimit, pranimit, aprovimit apo aksesit, në bazë të nenit 31 dhe 32.

Pas kësaj Konventa hyn në fuqi:

1. për çdo shtet që e ratifikon, pranon, aprovon ose miraton atë më pas, ditën e parë të muajit të tretë kalendarik pas depozitimit të dokumentit/instrumentit të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aksesit;

2. për çdo territor apo njësi territoriale që mbulon Konventa në përputhje me nenin 26 ose 33, ditën e parë të muajit të tretë kalendarik pas njoftimit që i referohet atij neni.

Neni 35

Konventa mbetet në fuqi për pesë vjet që nga data e hyrjes në fuqi, në përputhje me paragrafin e parë të nenit 34 edhe për shtete të cilat më pas e kanë ratifikuar, pranuar, aprovuar ose miratuar atë.

Nëse nuk ka pasur prishje të marrëveshjes, nënkuptohet që ajo duhet të rinovohet çdo pesë vjet.

Çdo anulim duhet t'i njoftohet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Holandës, të paktën gjashtë muaj para skadimit të periudhës pesëvjeçare. Ajo mund të kufizohet në disa territore apo njësi territoriale të caktuara, ku aplikohet Konventa.

Prishja e marrëveshjes ka efekt vetëm për shtetet të cilat e kanë bërë njoftimin. Konventa hyn në fuqi për Shtetet e tjera Kontraktuese.

Neni 36

Ministria e Punëve të Jashtme e Mbretërisë së Holandës duhet të njoftojë Shtetet Anëtare të Konferencës dhe shtetet të cilat kanë miratuar në përputhje me nenin 32 të saj si më poshtë:

1. nënshkrimet dhe ratifikimet, pranimet dhe aprovimet sipas nenit 31;
2. pranimi dhe kundërshtimi që bëhet sipas nenit 32;
3. data kur Konventa hyn në fuqi në përputhje me nenin 34;
4. deklarata si ato që u përmendën në nenet 26 dhe 33;
5. rezervimet dhe tërheqjet siç është referuar në nenet 28 dhe 30;
6. informacioni i përmendur sipas nenit 29;
7. prishje të marrëveshjes siç është referuar në nenin 35.

Si provë e asaj që u nënshkrua dhe të autorizuar zyrtarisht për të, kanë firmosur Konventën.

Në Hagë, më 25 tetor 1980, në gjuhët angleze dhe frënge, me të dyja tekstet njëlloj të autentike, në një kopje të vetme, që do të depozitohet në arkivën e Qeverisë së Mbretërisë së Holandës dhe prej ku do t'i dërgohet një kopje e certifikuar me rrugë diplomatike secilit nga Shteteve Anëtare që kanë marrë pjesë në përgatitjen e kësaj Konvente gjatë këtij sesioni.

SHTOJCË E KONVENTËS
FORMULAR PËR DËRGIMIN E APLIKIMIT PËR ASISTENCË LIGJORE

Konventa për Aksesin Ndërkombëtar në Drejtësi
Nënshkruar në Hagë, më 25 tetor 1980

Identiteti dhe adresa e autoritetit transmetues/delegues	Adresa e autoritetit qendror marrës/pritës

Autoriteti i nënshkruar transmetues ka nderin t'i dërgojë autoritetit qendror marrës aplikimin e bashkëngjitur për asistencë ligjore dhe shtojcën e tij (deklaratë lidhur me gjendjen financiare të aplikantit), në funksion të kapitullit 1 të Konventës të sipërpërmendur.

Vërejtjet lidhur me aplikimin dhe deklaratën, nëse ka ndonjë:
Vërejtje të tjera, nëse ka ndonjë:
Nënshkruar në....., më..... Firma dhe/ose vula
.....

FORMULAR BASHKËNGJITUR KONVENTËS

Aplikimi për asistencë ligjore
Konventa për Aksesin Ndërkombëtar në Drejtësi
Nënshkruar në Hagë, më 25 tetor 1980

1. Emri dhe adresa e aplikantit për asistencë ligjore

2. Trupit gjykues të gjykatës ku ka filluar ose do të fillojë procesi/seanca (nëse dihet)

3. a) Objekti i çështjes; përbërja e pretendimeve, nëse janë të zbatueshme

b) Nëse janë të zbatueshme, lista e dokumenteve plotësuese që kanë të bëjnë me seancën e filluar ose që pritet të fillojë*

c) Emri dhe adresa e palës kundërshtare*

4. Çdo datë ose kufi kohor lidhur me procesin me pasoja ligjore për aplikantin, që kërkon shqyrtim të përshpejtuar të aplikimit*

5. Çdo informacion tjetër i përshtatshëm*

6. I bërë në……, më…….

7. Firma e aplikantit

- Fshije nëse është e papërshtatshme.

……

SHTOJCË E APLIKIMIT PËR ASISTENCË LIGJORE
DEKLARATË PËR GJENDJEN FINANCIARE TË APLIKANTIT

I. Të dhëna personale

8. Emri (emri vajzërisë, nëse mundet)

9. Emri (emrat)

10. Data dhe vendi i lindjes

11. Kombësia

12. a) Banimi i rregullt (data e fillimit të lejeqëndrimit)

b) Banimi i mëparshëm (data e fillimit dhe mbarimit të lejeqëndrimit)

13. Statusi/gjendja civile (beqar/e, i/e martuar, i/e ve, i/e divorcuar, i/e ndarë)

14. Emri dhe mbiemri i bashkëshortit

15. Emrat, emrat dhe data e lindjes së fëmijëve të aplikantit

16. Persona të tjerë në ngarkim të aplikantit

17. Informacion plotësues në lidhje me gjendjen familjare

II. Gjendja financiare

18. Profesioni

19. Emri dhe adresa e punëdhënësit ose vendi i ushtrimit të profesionit

20.Të ardhurat e aplikantit të bashkëshortit të personave varësi aplikantit

a) Pagesa (duke përfshirë pagesat në natyrë)

b) Pensionet, pensioni për paaftësi në punë, alimonia/pensioni ushqimor për fëmijët, ndihma financiare, pensioni vjetor;

c) Asistencë financiare për papunësi;

d) Të ardhura nga profesione që nuk shpërblehen me rrogë (si në bujqësi);

e) Të ardhura nga letrat me vlerë dhe kapitalet rrjedhëse;

f) Të ardhura nga pasuri të patundshme;

g) Burime të tjera të ardhurash.

21.Pasuri të patundshme të aplikantit të bashkëshortit të personave nëvarësi të aplikantit
(Ju lutem shënoni vlerën (at) dhe detyrimet)

22. Vlera/pasuri të tjera të aplikantit të bashkëshortit të personavenë varësi të aplikantit (letra me vlerë, ndarje fitimesh, pretendime, llogari bankare, kapital biznesi etj.)

23. Borxhe dhe detyrime të tjera financiare të aplikantit të bashkëshortit të personave në varësi të aplikantit

a) Hua (deklaroni natyrën, shumën për t'u paguar dhe shlyerjet vjetore/mujore të borxhit)

b) Detyrime për mirëmbajtjen (deklaroni pagesat mujore)

c) Qira shtëpie (duke përfshirë shpenzimet për ngrohje, energji elektrike, gaz dhe ujë)

d) Detyrime të tjera periodike

24. Tatimi mbi të ardhurat dhe kontributet mbi sigurimet shoqërore për vitin e kaluar

25. Vërejtje të aplikantit

26. Nëse mundet lista e dokumenteve plotësuese

27. I nënshkruari, duke qenë plotësisht i vetëdijshëm për penalitetet/ndëshkimet e garantuara me ligj për dëshmi të rreme, deklaron se formulimi i mësipërm është i plotë dhe i saktë.

28. I kryer në .....(vendi)

29. Më.....(data)

30. .....(Firma e aplikantit)

LIGJ
Nr.9833, datë 22.11.2007

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROTOKOLLIN OPSIONAL TË KONVENTËS SË OKB-SË "PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE", PËR PËRFSHIRJEN E FËMIJËVE NË KONFLIKTE TË ARMATOSURA

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Protokollin Opsional të Konventës së OKB-së "Për të drejtat e fëmijëve", për përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura, bërë më 25.5.2000.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5529, datë 4.12.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.165, faqe 4929

PROTOKOLL OPSIONAL
I KONVENTËS PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE NË LIDHJE ME PËRFSHIRJEN E FËMIJËVE NË KONFLIKTE TË ARMATOSURA

Shtetet Palë në këtë protokoll:

të shtyra nga mbështetja e gjerë për Konventën mbi të Drejtat e Fëmijëve, që demonstron përkushtimin e gjerë që ekziston për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve;

duke ripohuar se të drejtat e fëmijëve kërkojnë mbrojtje të veçantë, dhe duke bërë apel për përmirësimin e vazhdueshëm të gjendjes së fëmijëve pa dallim, si dhe për zhvillimin dhe edukimin e tyre në kushte paqeje dhe sigurie;

të shqetësuara nga efekti i dëmshëm dhe i gjerë i konflikteve të armatosura mbi fëmijët dhe pasojat afatgjata që kjo ka për paqen, sigurinë dhe zhvillimin;

duke dënuar përfshirjen e fëmijëve në situata konfliktesh të armatosura dhe sulmet direkte mbi objektet e mbrojtura nga e drejta ndërkombëtare, duke përfshirë përgjithësisht vendet që kanë prezencë të konsiderueshme fëmijësh, siç janë shkollat dhe spitalet;

duke vënë re miratimin e Statutit të Gjykatës Penale Ndërkombëtare dhe, në veçanti, përfshirjen si krim lufte marrjen nën armë ose futjen në listë të fëmijëve nën moshën 15 vjeç ose përdorimin e tyre për pjesëmarrje aktive në operacione në konfliktet e armatosura, qofshin këto ndërkombëtare ose jondërkombëtare;

duke konsideruar, para së gjithash, se forcimi i mëtejshëm i zbatimit të të drejtave të njohura në Konventën për të Drejtat e Fëmijëve është i nevojshëm për të rritur mbrojtjen e fëmijëve nga përfshirja në konflikte të armatosura;

duke vënë re se neni 1 i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve përcakton se, për qëllimet e Konventës, fëmijë është çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, përveç kur, sipas ligjit që zbatohet mbi fëmijën, madhoria fitohet më herët;

të bindura se një protokoll opsional i Konventës që ngre moshën e rekrutimit të personave në forcat e armatosura dhe pjesëmarrjen e tyre në veprime do të kontribuojë efektivisht në zbatimin e parimit se interesat e lartë të fëmijës duhet të merren me përparësi në konsideratë në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët;

duke vënë re se Konferenca Ndërkombëtare e njëzetegjashtë e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe në dhjetor 1995 rekomandojnë, ndërmjet të tjerash, që palët në konflikt të marrin çdo hap të mundshëm për të siguruar që fëmijët nën moshën 18 vjeç të mos marrin pjesë në veprime luftarake;

duke mirëpritur miratimin unanim, në qershor 1999, të Konventës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës nr.182 mbi Ndalimin dhe Veprimin e Menjëhershëm për Eliminimin e Formave më të Këqija të Punës së Fëmijëve, e cila, ndërmjet të tjerash, ndalon rekrutimin nëpërmjet forcës ose detyrimit të fëmijëve për t'u përdorur në konflikte të armatosura;

duke dënuar me shqetësimin më të thellë rekrutimin, stërvitjen dhe përdorimin brenda ose përtej kufijve shtetërore të fëmijëve në veprime të grupeve të armatosura të ndara nga forcat e armatosura të një shteti, dhe duke njohur përgjegjësinë e atyre që rekrutojnë, stërvisin dhe përdorin fëmijët në këtë mënyrë;

duke kujtuar detyrimin e çdo Pale në një konflikt të armatosur për të respektuar dispozitat e ligjit humanitar ndërkombëtar;

duke theksuar se ky protokoll nuk cenon qëllimet dhe parimet që përmbahen në Kartën e Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë nenin 51 dhe normat përkatëse të ligjit humanitar;

duke mos harruar se kushtet e paqes dhe sigurisë bazuar në respektimin e plotë të qëllimeve dhe parimeve që parashikohen në Kartë dhe respektimi i instrumenteve të zbatueshme për të drejtat e njeriut janë të domosdoshme për mbrojtjen e plotë të fëmijëve, sidomos gjatë konflikteve të armatosura dhe pushtimeve të huaja;

d*uke njohur* nevojat e veçanta të atyre fëmijëve që janë veçanërisht të pambrojtur ndaj rekrutimit ose përdorimit në veprime luftarake në kundërshtim me këtë protokoll për shkak të gjendjes së tyre ekonomike, shoqërore apo gjinore;

duke ditur domosdoshmërinë e marrjes në konsideratë të shkaqeve fillestare ekonomike, shoqërore dhe politike të përfshirjes së fëmijëve në konflikte të armatosura;

të bindura për nevojën e forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar për zbatimin e këtij protokolli, si dhe rehabilitimin fizik dhe psikologjik dhe riintegrimin shoqëror të fëmijëve që janë viktima të konflikteve të armatosura;

duke nxitur pjesëmarrjen e komunitetit dhe, sidomos, të fëmijëve ose fëmijëve viktima në shpërndarjen e programeve edukative dhe informative në lidhje me zbatimin e protokollit,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Shtetet Palë do të marrin të gjitha masat e mundshme për të siguruar që të gjithë anëtarët e forcave të tyre të armatosura që nuk kanë mbushur 18 vjeç të mos marrin pjesë direkt në veprime luftarake.

Neni 2

Shtetet Palë do të sigurojnë që personat që nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç të mos jenë të detyruar të rekrutohen në forcat e tyre të armatosura.

Neni 3

1. Shtetet Palë do të ngrenë moshën minimale për rekrutimin vullnetar të personave në forcat e tyre të armatosura kombëtare nga ajo e parashikuar në nenin 38 paragrafi 3 i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, duke marrë parasysh parimet e parashikuara në atë nen dhe duke pranuar se në bazë të Konventës personat nën 18 vjeç kanë të drejtën e mbrojtjes së veçantë.

2. Secili Shtet Palë do të depozitojë një deklaratë detyruese në momentin e ratifikimit ose anëtarësimit në këtë protokoll, e cila përcakton moshën minimale në të cilën ai lejon rekrutimin vullnetar në forcat kombëtare të armatosura dhe një përshkrim të garancive që ai ka adaptuar për të siguruar që një rekrutim i tillë nuk do të bëhet me forcë ose në formë të detyruar.

3. Shtetet Palë që lejojnë rekrutimin vullnetar në forcat kombëtare të armatosura nën moshën 18 vjeç caktojnë garanci për të siguruar, minimalisht që:

a) një rekrutim i tillë është vërtet vullnetar;

b) një rekrutim i tillë bëhet me pëlqimin e dhënë nga prindërit e personit ose kujdestarët e tij ligjorë;

c) këta persona janë plotësisht të informuar në lidhje me detyrat në një shërbim të tillë ushtarak;

d) këta persona paraqesin prova të besueshme për moshën para pranimit në shërbimin ushtarak kombëtar.

4. Secili Shtet Palë mund të përforcojë deklaratën e tij, në çdo kohë, duke bërë për këtë një njoftim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili informon të gjitha Shtetet Palë. Një njoftim i tillë bëhet i efektshëm në datën në të cilën ai merret nga Sekretari i Përgjithshëm.

5. Kërkesa për ngritjen e moshës në paragrafin 1 të këtij neni nuk zbatohet në lidhje me shkollat, që veprojnë ose kontrollohen nga forcat e armatosura të Shteteve Palë, në pajtim me nenet 28 dhe 29 të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve.

Neni 4

1. Në asnjë rrethanë grupet e armatosura, të ndara nga forcat e armatosura të një shteti, nuk do të rekrutojnë ose përdorin në veprime luftarake persona nën moshën 18 vjeç.

2. Shtetet Palë do të marrin të gjitha masat e mundshme për të parandaluar një rekrutim dhe përdorim të tillë, duke përfshirë edhe masat ligjore të nevojshme për ndalimin dhe penalizimin e praktikave të tilla.

3. Zbatimi i këtij neni sipas këtij protokolli nuk prek asnjë status ligjor të ndonjë pale në konflikt të armatosur.

Neni 5

Asgjë në këtë protokoll nuk do të interpretohet si paragjykim i dispozitave të ligjeve të një Shteti Palë ose të instrumenteve ndërkombëtare, apo të së drejtës humanitare ndërkombëtare që janë më të favorshme për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Neni 6

1. Çdo Shtet Palë do të marrë të gjitha masat e duhura ligjore, administrative etj., për të siguruar zbatimin e efektshëm të dispozitave të këtij protokolli brenda juridiksionit të vet.

2. Çdo Shtet Palë do të marrë përsipër t'i bëjë parimet dhe dispozitat e këtij protokolli gjerësisht të njohura dhe t'i promovojë si duhet, si te të rriturit, ashtu edhe te fëmijët.

3. Çdo Shtet Palë do të marrë të gjitha masat e duhura për të siguruar që personat brenda juridiksionit të tyre, të rekrutuar ose përdorur në veprime luftarake në kundërshtim me këtë protokoll, të demobilizohen ose të lirohen nga shërbimi. Shtetet Palë, kur është e nevojshme, do t'u japin këtyre personave të gjithë asistencën e duhur për shërimin e tyre fizik, psikologjik dhe riintegrimin e tyre shoqëror.

Neni 7

1. Shtetet Palë do të bashkëpunojnë për zbatimin e këtij protokolli, duke përfshirë ndalimin e çdo aktiviteti në kundërshtim me protokollin dhe rehabilitimin, dhe riintegrimin shoqëror të personave që janë viktima të veprimeve në kundërshtim me këtë protokoll, duke përfshirë bashkëpunimin teknik dhe ndihmën financiare.

2. Shtetet Palë që janë në gjendje ta bëjnë këtë, do ta japin këtë asistencë nëpërmjet programeve ekzistuese shumëpalëshe, dypalëshe etj., ndërmjet të tjerash, ndërmjet një fondi vullnetar të krijuar në pajtim me rregullat e Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 8

1. Çdo Shtet Palë, brenda dy vjetësh nga hyrja në fuqi e protokollit për atë Shtet Palë, do t'i paraqesë Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve një raport me informacione të plota mbi masat që ai ka marrë për zbatimin e dispozitave të protokollit, duke përfshirë masat e marra për të zbatuar dispozitat mbi pjesëmarrjen dhe rekrutimin.

2. Pas paraqitjes së raportit të plotë, çdo Shtet Palë do të përfshijë në raportin që paraqet në Komitetin mbi të Drejtat e Fëmijëve, në pajtim me nenin 44 të Konventës, çdo informacion tjetër në lidhje me zbatimin e protokollit. Shtetet e tjera Palë në protokoll paraqesin një raport në çdo pesë vjet.

3. Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve mund të kërkojë nga Shtetet e tjera Palë informacion shtesë që ka të bëjë me zbatimin e këtij protokolli.

Neni 9

1. Ky protokoll është i hapur për t'u nënshkruar nga çdo shtet që është palë në Konventë ose e ka nënshkruar atë.

2. Ky protokoll duhet të ratifikohet dhe është i hapur për anëtarësimin për çdo shtet. Instrumentet e ratifikimit ose anëtarësimit depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

3. Sekretari i Përgjithshëm, në cilësinë e Depozitarit të Konventës dhe të protokollit, informon të gjitha Shtetet Palë në Konventë dhe të gjitha shtetet që kanë nënshkruar Konventën për çdo instrument deklarimi në pajtim me nenin 13.

Neni 10

1. Ky protokoll hyn në fuqi tre muaj pas depozitimit të instrumentit të dhjetë të ratifikimit ose anëtarësimit.

2. Për çdo shtet që ratifikon këtë protokoll ose anëtarësohet në të pas hyrjes në fuqi, ky protokoll hyn në fuqi një muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit ose anëtarësimit.

Neni 11

1. Çdo Shtet Palë mund ta denoncojë këtë protokoll në çdo kohë, me anë të një njoftimi me shkrim, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili njofton Shtetet e tjera Palë në Konventë dhe të gjitha shtetet që kanë nënshkruar Konventën. Denoncimi hyn në fuqi një vit pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm. Megjithatë, kur në momentin e kalimit të një viti Shteti Palë denoncues është i përfshirë në një konflikt të armatosur, denoncimi nuk bëhet i efektshëm para përfundimit të konfliktit të armatosur.

2. Një denoncim i tillë nuk ka efektin e lirimit të Shtetit Palë nga përgjegjësitë e tij, sipas këtij protokolli, në lidhje me ndonjë veprim që ndodh para datës në të cilën denoncimi bëhet i efektshëm. Një denoncim i tillë nuk cenon as edhe vazhdimin e shqyrtimit të një çështjeje që ka filluar të shqyrtohet nga Komiteti para datës në të cilën denoncimi bëhet i efektshëm.

Neni 12

1. Çdo Shtet Palë mund të propozojë një ndryshim dhe ta depozitojë atë te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara. Sekretari i Përgjithshëm me këtë rast u komunikon ndryshimin e propozuar Shteteve Palë, me kërkesën që ata të tregojnë, nëse ata janë në favor të një konference të Shteteve Palë për qëllimin e shqyrtimit dhe votimit të propozimeve. Në rast se, brenda katër muajve që nga data e një komunikimi të tillë, të paktën një treta e Shteteve Palë janë në favor të një konference të tillë, Sekretari i Përgjithshëm mbledh konferencën nën kujdesin e Kombeve të Bashkuara. Çdo ndryshim i miratuar nga shumica e Shteteve Palë të pranishme dhe votues në konferencë i paraqitet Asamblesë së Përgjithshme për miratim.

2. Ndryshimi i miratuar në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni hyn në fuqi, pasi të jetë miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara dhe pranuar nga një shumicë prej dy të tretash të Shteteve Palë.

3. Kur një ndryshim hyn në fuqi, ai është i detyrueshëm për ato Shtete Palë që e kanë pranuar atë, ose Shtetet e tjera Palë që janë të detyruara nga dispozitat e këtij protokolli apo nga ndryshime të pranuara më parë.

Neni 13

1. Ky protokoll, në gjuhët arabisht, kinezisht, anglisht, frëngjisht, rusisht dhe spanjisht, tekstet e të cilave janë njësoj të vlefshme, depozitohet në arkivin e Kombeve të Bashkuara.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara u transmeton kopje të vërtetuara të këtij protokolli Shteteve Palë në Konventë dhe të gjitha shteteve që kanë nënshkruar Konvent

LIGJ
Nr.9834, datë 22.11.2007

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROTOKOLLIN OPSIONAL TË KONVENTËS SË OKB-SË "PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE", PËR SHITJEN E FËMIJËVE, PROSTITUCIONIN DHE PORNOGRAFINË ME FËMIJË

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Protokollin Opsional të Konventës së OKB-së "Për të drejtat e fëmijëve", për shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë me fëmijë, bërë më 25.5.2000.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5530, datë 4.12.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.165, faqe 4933

PROTOKOLL OPSIONAL
I KONVENTËS PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE NË LIDHJE ME SHITJEN E FËMIJËVE, PROSTITUCIONIN ME FËMIJË DHE PORNOGRAFINË ME FËMIJË

Shtetet Palë në këtë Konventë,

duke qenë se, për të arritur më tej qëllimet e Konventës mbi të Drejtat e Fëmijëve dhe zbatimin e dispozitave të saj, sidomos të neneve 1, 11, 21, 32, 33, 34, 35 dhe 36 do të ishte i nevojshëm zgjerimi i masave që Shtetet Palë duhej të ndërmerrnin me qëllim që të garantonin mbrojtjen e fëmijëve nga shitja, prostitucioni dhe pornografia me ta;

gjithashtu, duke qenë se Konventa për të drejtat e fëmijëve e njeh të drejtën e fëmijëve për t'u mbrojtur nga shfrytëzimi fitimprurës ose kryerja e çdo pune që do të ishte e dëmshme, ose do të pengonte edukimin e fëmijëve, ose që do të ishte e dëmshme për shëndetin e fëmijëve, apo për zhvillimin fizik mendor, shpirtëror, moral ose shoqëror;

thellësisht të shqetësuara për trafikimin e konsiderueshëm ndërkombëtar dhe në rritje të fëmijëve me qëllim shitjen e fëmijëve, prostitucionin me fëmijë dhe pornografinë me fëmijë;

tepër të shqetësuara për praktikën tepër të përhapur dhe të vazhdueshme të turizmit seksual, i cili kërcënon veçanërisht fëmijët, pasi ai nxit shitjen e fëmijëve, prostitucionin me fëmijë dhe pornografinë me fëmijë;

duke pranuar se një numër kategorish, veçanërisht të kërcënuara, duke përfshirë fëmijët vajza janë nën një rrezik më të madh për shfrytëzim seksual dhe se fëmijët vajza janë të përfaqësuara në mënyrë disproporcionale te fëmijët e shfrytëzuar seksualisht;

të shqetësuara rreth daljes së pornografisë së fëmijëve në internet dhe teknologji të tjera që shfaqen dhe duke kujtuar Konferencën Ndërkombëtare për Luftën kundër Pornografisë së Fëmijëve në Internet (Vjenë 1999) dhe sidomos përfundimin e saj duke bërë apel për penalizimin mbarëbotëror të prodhimit të shpërndarjes, eksportimit, transmetimit, mbajtjes së qëllimshme dhe reklamës me pornografi fëmijësh, dhe duke theksuar rëndësinë e një partneriteti dhe bashkëpunimi më të ngushtë ndërmjet qeverive dhe industrisë së internetit;

duke besuar që shitja e fëmijëve, prostitucioni me fëmijë dhe pornografia me fëmijë nxitet, kur nuk zbatohet rreptësia e duhur, duke shqyrtuar faktorët kontribues, duke përfshirë prapambetjen, varfërinë, pabarazinë ekonomike, strukturën e papërshtatshme social-ekonomike, keqfunksionimin e familjeve, mungesën e arsimit, migrimin nga qyteti në fshat, diskriminimin për shkak të gjinisë, sjelljen e papërgjegjshme seksuale të të rriturve, praktikat e dëmshme tradicionale, konfliktet e armatosura dhe trafikimin e fëmijëve;

duke besuar që përpjekjet për forcimin e sensibilizimit publik janë të nevojshme për uljen e kërkesës së konsumatorit për shitjen e fëmijëve, prostitucionin me fëmijë dhe pornografinë me fëmijë dhe, gjithashtu duke besuar në rëndësinë e partneritetit global ndërmjet të gjithë aktorëve dhe të përmirësimit të zbatimit të ligjit në nivel kombëtar;

duke vënë re dispozitat e instrumenteve ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve, duke përfshirë Konventën e Hagës për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin në lidhje me miratimin ndërshtetëror, Konventën e Hagës mbi aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve, Konventën e Hagës mbi juridiksionin, ligjin e zbatuar, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve, dhe Konventën e Organizatës Ndërkombëtare të Punës nr.182 mbi ndalimin dhe veprimin e menjëhershëm për eliminimin e formave më të këqija të punës së fëmijëve;

të nxitura nga mbështetja e gjerë për Konventën për të drejtat e fëmijëve, duke treguar përkushtimin e gjerë që ekziston për zhvillimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve;

duke njohur rëndësinë e zbatimit të dispozitave e programit të veprimit për parandalimin e shitjes së fëmijëve, prostitucionit të fëmijëve dhe pornografisë së fëmijëve dhe deklarimin e axhendës për veprim të miratuar në Kongresin Botëror kundër shfrytëzimit seksual për qëllime fitimi të fëmijëve mbajtur në Stokholm, më 27-31 gusht 1996, dhe vendimet e tjera të rëndësishme dhe rekomandimet e organeve përkatëse ndërkombëtare;

duke marrë parasysh si duhet rëndësinë e traditave dhe vlerave kulturore të çdo populli për mbrojtjen dhe zhvillimin harmonik të fëmijëve,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Shtetet Palë do të ndalojnë shitjen e fëmijëve, prostitucionin me fëmijë dhe pornografinë me fëmijë, siç është parashikuar në këtë protokoll.

Neni 2

Për qëllimin e këtij protokolli:

a) Shitje e fëmijëve është çdo veprim ose transaksion me anë të të cilit një fëmijë transferohet prej një personi ose grupi personash te një tjetër me pagesë ose në çdo mënyrë tjetër.

b) Prostitucion me fëmijë është përdorimi i fëmijës në aktivitete seksuale me pagesë ose çdo mënyrë tjetër.

c) Pornografia me fëmijë është çdo formë përfaqësimi, me çfarëdo mjeti, i një fëmije të përfshirë në aktivitete të qarta seksuale, të vërteta ose të simuluara, ose çdo demonstrim i pjesëve seksuale të një fëmije për qëllime kryesisht seksuale.

Neni 3

1. Çdo Shtet Palë do të garantojë të paktën mbulimin plotësisht nga ligji i tij penal, të veprimeve dhe aktiviteteve të mëposhtme pavarësisht se këto vepra penale janë kryer brenda apo jashtë vendit nga një individ apo grup individësh të organizuar:

a) Në kontekstin e shitjes së fëmijëve sipas nenit 2:

i) Ofrimi, dorëzimi ose pranimi me çfarëdo mjeti i një fëmije për qëllimin e:

a) shfrytëzimit seksual të fëmijëve;

b) transferimit të organeve të një fëmije për qëllime fitimi;

c) përfshirjes së fëmijëve në punë të detyruara.

ii) Marrja e pëlqimit në mënyrë të papërshtatshme, si ndërmjetës për adoptimin e një fëmije duke shkelur instrumentet e zbatueshme ligjore ndërkombëtare për miratimin.

b) Ofrimi, marrja, gjetja ose dorëzimi i një fëmije për prostitucion me fëmijë, sipas përcaktimit të nenit 2.

c) prodhimi, shpërndarja, importimi, eksportimi, ofrimi, shitja ose mbajtja e pornografisë me fëmijë për qëllimet e sipërshënuara, sipas përcaktimit të nenit 2.

2. Në pajtim me dispozitat e ligjit vendas të çdo Shteti Palë, e njëjta gjë zbatohet në lidhje me përpjekjet për kryerjen e ndonjërit prej këtyre veprimeve, me bashkëveprimin ose pjesëmarrjen në ndonjë prej këtyre veprimeve.

3. Çdo Shtet Palë i bën këto vepra penale të dënueshme nëpërmjet dënimeve të përshtatshme në varësi të natyrës së rëndë të tyre.

4. Në pajtim me dispozitat e ligjit kombëtar, çdo Shtet Palë do të marrë masa, kurdo që është e nevojshme, për të përcaktuar përgjegjësinë e personave juridikë të parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni. Në pajtim me parimet ligjore të Shtetit Palë, kjo përgjegjësi e personave juridikë, mund të jetë penale, civile ose administrative.

5. Shtetet Palë do të marrin të gjitha masat e duhura ligjore dhe administrative për të siguruar që të gjithë personat e përfshirë në adoptimin e një fëmije të veprojnë në përputhje me instrumentet ligjore ndërkombëtare të zbatueshme.

Neni 4

1. Çdo Shtet Palë do të marrë të gjitha masat që janë të nevojshme për të caktuar juridiksionin e tij në lidhje me veprat penale të përmendura në nenin 3, paragrafi 1, kur këto vepra janë kryer në territorin e tij ose në bordin e një anijeje, ose avioni të regjistruar në këto shtete.

2. Çdo Shtet Palë mund të marrë të gjitha masat që mund të jenë të nevojshme për të përcaktuar juridiksionin e tij në lidhje me veprat penale të përmendura në nenin 3, paragrafi 1, për rastet e mëposhtme:

a) kur kryerësi i prezumuar i veprës penale është shtetas i atij shteti ose një person që ka vendqëndrimin e zakonshëm në territorin e tij;

b) kur viktima është shtetas i atij shteti.

3. Çdo Shtet Palë do të marrë, gjithashtu të gjitha masat e nevojshme për të përcaktuar juridiksionin e tij në lidhje me veprat penale të përmendura më sipër, kur kryerësi i prezumuar i veprës është i pranishëm në territorin e tij dhe ky nuk e ekstradon atë në një Shtet tjetër Palë me arsyen se vepra penale është kryer nga njëri prej shtetasve të tij.

4. Ky protokoll nuk përjashton asnjë juridiksion penal që ushtrohet në pajtim me të drejtën ndërkombëtare.

Neni 5

1. Veprat penale të përmendura në nenin 3, paragrafi 1, konsiderohen se përfshihen në veprat penale të ekstradueshme në të gjitha marrëveshjet e ekstradimit që ekzistojnë ndërmjet Shteteve Palë dhe përfshihen si vepra penale të ekstradueshme në çdo Marrëveshje ekstradimi që

lidhet më vonë ndërmjet tyre, në pajtim me dispozitat e parashikuara në këto Marrëveshje.

2. Kur një Shtet Palë që e kushtëzon ekstradimin me ekzistencën e një marrëveshjeje do të marrë një kërkesë për ekstradimin nga një Shtet tjetër Palë, me të cilin ai nuk ka marrëveshje ekstradimi, ai mund ta konsiderojë këtë protokoll si bazë ligjore për ekstradim në lidhje me këto vepra penale. Ekstradimi u nënshtrohet dispozitave të parashikuara në ligjin e shtetit pritës.

3. Shtetet Palë që nuk e kushtëzojnë ekstradimin me ekzistencën e një marrëveshjeje i njohin këto vepra penale si vepra të ekstradueshme ndërmjet tyre në pajtim me dispozitat e parashikuara në ligjin e shtetit pritës.

4. Këto vepra penale, për qëllimet e ekstradimit ndërmjet Shteteve Palë trajtohen sikur të ishin kryer jo vetëm në vendin ku ato kanë ndodhur, por gjithashtu edhe në territoret e shteteve që duhet të caktojnë juridikisionin e tyre në pajtim me nenin 4.

5. Kur një kërkesë për ekstradim bëhet në lidhje me një vepër penale të përmendur në nenin 3, paragrafi 1 dhe, kur Shteti i Palës pritës, nuk e ekstradon ose nuk do ta bëjë këtë mbi bazën e shtetësisë së personit që ka kryer veprën, ai shtet do të marrë masat e përshtatshme për t'ua dorëzuar këtë çështje organeve të veta kompetente për të bërë ndjekjen penale.

Neni 6

1. Shtetet Palë i ofrojnë njëra-tjetrës masën më të lartë të asistencës në lidhje me hetimet për proceset penale ose të ekstradimit, që janë në lidhje me veprat penale të parashikuara në nenin 3, paragrafi 1, duke përfshirë asistencën në marrjen e provave të nevojshme për gjykim.

2. Shtetet Palë përmbushin detyrimet e tyre sipas paragrafit 1 të këtij neni në përputhje me marrëveshjet ose masat e tjera për ndihmë të ndërsjellë ligjore që mund të ekzistojnë ndërmjet tyre. Në mungesë të këtyre marrëveshjeve ose masave, Shtetet Palë i ofrojnë njëra-tjetrës ndihmë në pajtim me ligjin e vendit të tyre.

Neni 7

Shtetet Palë, në pajtim me dispozitat e ligjit vendas:

a) do të marrin masa për të bërë bllokimin ose konfiskimin sipas rastit të:

i) mallrave siç janë materiale, sende me vlerë dhe mjete të tjera që përdoren për të kryer ose ndihmuar kryerjen e veprave penale të parashikuara në këtë protokoll;

ii) të ardhurave që rrjedhin nga këto vepra penale;

b) plotësojnë kërkesa nga një Shtet tjetër Palë për bllokimin ose konfiskimin e mallrave, ose të ardhurat e përmendura në nënparagrafin (a) (i);

c) do të marrin masat që kanë për qëllim mbylljen, përkohësisht ose përgjithmonë të ambienteve që përdoren për kryerjen e veprave të tilla.

Neni 8

1. Shtetet Palë do të marrin masa të përshtatshme për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e fëmijëve viktima të praktikave të ndaluara nga ky protokoll në të gjitha fazat e procedimit penal, sidomos duke:

a) njohur ekspozimin e fëmijëve viktima dhe duke miratuar procedura për njohjen e nevojave të tyre të veçanta, duke përfshirë nevojat e tyre të veçanta si dëshmitarë;

b) informuar fëmijët viktima për të drejtat e tyre, rolin e tyre dhe objektin, kohën dhe ecurinë e gjykimit, si dhe disponimin e çështjeve të tyre;

c) lejuar mendime, nevoja dhe shqetësime të fëmijëve viktima të parashtrohen dhe shqyrtohen në gjykimet që kanë të bëjnë me interesat e tyre personale, në një mënyrë që të jetë në pajtim me rregullat procedurale të ligjit kombëtar;

d) dhënë mbështetje të përshtatshme fëmijëve viktima gjatë gjithë procesit gjyqësor;

e) mbrojtur, si duhet, sferën private dhe identitetin e fëmijëve viktima, duke marrë masa në

përputhje me ligjin e tyre kombëtar për të mënjanuar shpërndarjen e papërshtatshme të informacionit që mund të çonte në identifikimin e fëmijëve viktima;

f) mënjanuar, në mënyrë të përshtatshme për sigurinë e fëmijëve, familjeve të tyre dhe dëshmitarëve nga ana e tyre, kërcënimet dhe hakmarrjet;

g) mënjanuar vonesa të panevojshme në disponimin e çështjeve dhe zbatimin e vendimeve ose dekreteve që japin kompensim për fëmijët viktima.

2. Shtetet Palë do të sigurojnë që pasiguria në lidhje me moshën e viktimës të mos pengojë fillimin e hetimit penal, duke përfshirë hetimet që kanë për qëllim përcaktimin e moshës së viktimës.

3. Shtetet Palë do të sigurojnë që në trajtimin që procedura penale u bën fëmijëve që janë viktima të veprave penale, të parashikuara në këtë protokoll, interesat e larta të fëmijës të kenë shqyrtim prioritar.

4. Shtetet Palë do të marrin të gjitha masat për të siguruar trajnimin e duhur, sidomos trajnimin ligjor dhe psikologjik, për personat që punojnë me viktimat e veprave penale të ndaluara nga ky protokoll.

5. Shtetet Palë, në rastet e duhura, do të marrin masa për të mbrojtur sigurinë dhe dinjitetin e atyre personave dhe/ose organizatave që janë të përfshira në parandalimin dhe/ose mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të këtyre veprave penale.

6. Asgjë në këtë nen nuk mund të interpretohet si e dëmshme ose e papërputhshme me të drejtat e personit të akuzuar në një gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Neni 9

1. Shtetet Palë miratojnë, përforcojnë, zbatojnë dhe publikojnë ligje, masa administrative, politika sociale dhe programe për parandalimin e veprave penale të parashikuara në këtë protokoll. Vëmendje e veçantë i kushtohet mbrojtjes së fëmijëve që janë tepër të ekspozuar ndaj këtyre praktikave.

2. Shtetet Palë nxisin sensibilizimin e publikut të gjerë, duke përfshirë fëmijët, nëpërmjet informimit me të gjitha mjetet e përshtatshme, edukimin dhe trajnimin, në lidhje me masat parandaluese dhe efektet e dëmshme të veprave penale të përmendura në këtë protokoll. Në përmbushjen e detyrimeve të tyre, sipas këtij neni, Shtetet Palë nxisin pjesëmarrjen e komunitetit dhe, veçanërisht, të fëmijëve dhe fëmijëve viktima, në programe të tilla informimi, edukimi dhe trajnimi, duke u bërë edhe në nivel ndërkombëtar.

3. Shtetet Palë do të marrin të gjitha masat e mundshme me qëllim që të sigurojnë të gjithë asistencën e nevojshme për viktimat e këtyre veprave, duke përfshirë riintegrimin e tyre të plotë shoqëror dhe shërimin e tyre të plotë fizik dhe psikologjik.

4. Shtetet Palë sigurojnë që të gjithë fëmijët viktima të veprave penale të përmendura në këtë protokoll të kenë mundësi t'u drejtohen procedurave të përshtatshme për të kërkuar, pa u diskriminuar, kompensim për dëmet e shkaktuara nga personat që kanë përgjegjësi ligjore.

5. Shtetet Palë do të marrin masa të përshtatshme, që kanë për qëllim të ndalojnë efektivisht prodhimin dhe shpërndarjen e materialeve që ekspozojnë veprat penale të parashikuara në këtë protokoll.

Neni 10

1. Shtetet Palë do të marrin të gjitha hapat e duhur për të forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar shumëpalësh, rajonal ose dypalësh për parandalimin, zbulimin, hetimin, ndjekjen penale dhe dënimin e personave përgjegjës për veprime që përfshijnë shitjen e fëmijëve, prostitucionin me fëmijë, pornografinë me fëmijë dhe turizmin seksual me fëmijë. Shtetet Palë nxisin, gjithashtu bashkëpunimin ndërkombëtar dhe koordinimin ndërmjet autoriteteve, organizatave joqeveritare vendase ose ndërkombëtare dhe organizatave ndërkombëtare.

2. Shtetet Palë nxisin bashkëpunimin ndërkombëtar për të ndihmuar fëmijët viktima në shërimin e tyre fizik dhe psikologjik, riintegrimin shoqëror, riatdhesimin.

3. Shtetet Palë nxisin forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar me qëllim që të trajtohen shkaqet bazë, siç është varfëria dhe prapambetja, të cilat ndikojnë në ekspozimin e fëmijëve kundrejt shitjes së fëmijëve, prostitucionit me fëmijë, pornografisë me fëmijë dhe turizmit me seks me fëmijë.

4. Shtetet Palë që janë në gjendje të bëjnë një gjë të tillë japin asistencë financiare, teknike etj., nëpërmjet programeve shumëpalëshe, rajonale, dypalëshe ose të tjera.

Neni 11

Asgjë në këtë protokoll nuk cenon ndonjë dispozitë tjetër që është më e favorshme për realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe që mund të ndodhet në:

a) ligjin e Shtetit Palë;

b) të drejtën ndërkombëtare që është në fuqi në shtetin përkatës.

Neni 12

1. Çdo Shtet Palë, brenda dy vjetëve që nga hyrja në fuqi e protokollit për atë Shtet Palë, i paraqet Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve një raport me informacione të plota mbi masat që ai ka marrë për zbatimin e protokollit.

2. Pas paraqitjes së raportit të plotë, çdo Shtet Palë përfshin në raportin që paraqet në Komitetin mbi të Drejtat e Fëmijëve, në pajtim me nenin 44 të Konventës, çdo informacion tjetër në lidhje me zbatimin e protokollit. Shtetet e tjera Palë në protokoll paraqesin një raport në çdo pesë vjet.

3. Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve, mund të kërkojë nga Shtetet e tjera Palë informacion shtesë që ka të bëjë me zbatimin e këtij protokolli.

Neni 13

1. Ky protokoll është i hapur për t'u nënshkruar nga çdo Shtet që është Palë në Konventë ose e ka nënshkruar atë.

2. Ky protokoll duhet të ratifikohet dhe është i hapur për anëtarësim për çdo Shtet që është Palë në Konventë ose e ka nënshkruar atë. Instrumentet e ratifikimit ose anëtarësimit depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Neni 14

1. Ky protokoll hyn në fuqi tre muaj pas depozitimit të instrumentit të dhjetë të ratifikimit ose anëtarësimit.

2. Për çdo Shtet që ratifikon këtë protokoll ose anëtarësohet në të pas hyrjes në fuqi, ky protokoll hyn në fuqi një muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit ose anëtarësimit.

Neni 15

1. Çdo Shtet Palë mund ta denoncojë këtë protokoll në çdo kohë me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili njofton shtetet e tjera Palë në Konventë dhe të gjitha shtetet që kanë nënshkruar Konventën. Denoncimi hyn në fuqi një vit pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

2. Një denoncim i tillë nuk ka efektin e lirimit të Shtetit Palë nga përgjegjësitë e tij, sipas këtij protokolli, në lidhje me ndonjë veprim që ndodh para datës në të cilën denoncimi bëhet i efektshëm. Një denoncim i tillë nuk cenon as edhe vazhdimin e shqyrtimit të një çështjeje që ka filluar të shqyrtohet nga Komiteti para datës në të cilën denoncimi bëhet i efektshëm.

Neni 16

1. Çdo Shtet Palë mund të propozojë në ndryshim dhe ta depozitojë atë te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara. Sekretari i Përgjithshëm me këtë rast u komunikon ndryshimin e propozuar Shteteve Palë, me kërkesën që ata të tregojnë, nëse ata janë në favor të një konference të Shteteve Palë për qëllimin e shqyrtimit dhe votimit të propozimeve. Në rast se brenda katër muajve që nga data e një komunikimi të tillë të paktën një e treta e Shteteve Palë janë në favor të një konference të tillë, Sekretari i Përgjithshëm mbledh konferencën nën kujdesin e Kombeve të Bashkuara. Çdo ndryshim i miratuar nga shumica e Shteteve Palë të pranishëm dhe votues në konferencë i paraqitet Asamblesë së Përgjithshme për miratim.

2. Ndryshimi i miratuar në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni hyn në fuqi, pasi të jetë miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara dhe pranuar nga një shumicë prej dy të tretash të Shteteve Palë.

3. Kur një ndryshim hyn në fuqi, ai është i detyrueshëm për ato Shtete Palë që e kanë pranuar atë ose Shtetet e tjera Palë, që janë të detyruara nga dispozitat e këtij protokolli apo nga ndryshimet të pranuara më parë.

Neni 17

1. Ky protokoll në gjuhët arabisht, kinezisht, anglisht, frëngjisht, rusisht dhe spanjisht tekstet e të cilave janë njësoj të vlefshme, depozitohet në arkivin e Kombeve të Bashkuara.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara u transmeton kopje të vërtetuara të këtij protokolli Shteteve Palë në Konventë dhe të gjitha shteteve që kanë nënshkruar Konventën.

LIGJ
Nr.9838, datë 10.12.2007

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROTOKOLLIN KUNDËR PRODHIMIT TË PALIGJSHËM DHE TRAFIKIMIT TË ARMËVE TË ZJARRIT, PJESËVE TË TYRE, KOMPONENTËVE DHE MUNICIONEVE, QË PLOTËSON KONVENTËN E KOMBEVE TË BASHKUARA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR NDËRKOMBËTAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Protokollin kundër prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municioneve, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5560, datë 27.12.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.177, faqe 5481

Kombet e Bashkuara A/RES/55/255
Stema Asambleja e Përgjithshme 8 qershor 2001
Sesioni i pesëdhjetë e pestë
Pika 105 e rendit të ditës

REZOLUTË E MIRATUAR NGA ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME
[PA REFERENCËN E NJË KOMITETI KRYESOR (A/55/383/SHTESA 2)]
55/255. PROTOKOLL KUNDËR PRODHIMIT TË PALIGJSHËM DHE TRAFIKIMIT TË ARMËVE TË ZJARRIT, PJESËVE TË TYRE, KOMPONENTËVE DHE MUNICIONEVE, QË PLOTËSON KONVENTËN E KOMBEVE TË BASHKUARA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR NDËRKOMBËTAR

Asambleja e Përgjithshme,

duke sjellë në kujtesë rezolutën e saj 53/111 të 9 dhjetorit 1998, në të cilën ajo vendosi të krijonte një komitet të posaçëm të hapur ndërqeveritar për këtë rast, me qëllim hartimin e një konvente ndërkombëtare gjithëpërfshirëse kundër krimit të organizuar ndërkombëtar dhe diskutimin e zhvillimit, në mënyrën e duhur, të instrumenteve ndërkombëtare për trajtimin e trafikimit të grave/femrave dhe fëmijëve, luftimin e prodhimit të paligjshëm dhe trafikimin e armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municioneve dhe trafikimit dhe transportimit ilegal të emigrantëve, përfshirë edhe nga deti;

duke sjellë në kujtesë, gjithashtu, rezolutën e saj 54/126 të 17 dhjetorit 1999, në të cilën ajo i kërkoi Komisionit të Posaçëm, për atë rast, mbi hartimin e një konvente kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, që të vazhdonte punën e nisur në përputhje me rezolutat 53/111 dhe 53/114 të 9 dhjetorit 1998 dhe të intensifikonte punën e nisur, në mënyrë që ta plotësonte atë në vitin 2000;

duke sjellë në kujtesë më tej rezolutën e saj 55/25 të 15 nëntorit 2000, me anë të së cilës ajo miratonte Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, protokollin për ta parandaluar, shtypur dhe ndëshkuar trafikimin e personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe protokollin kundër kontrabandimit të emigrantëve nga toka, deti dhe ajri, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar;

duke ripohuar të drejtën e brendshme të vetëmbrojtjes individuale ose kolektive të njohur nga neni 51 i Kartës së Kombeve të Bashkuara, i cili lë të kuptohet se shtetet gëzojnë, gjithashtu të drejtën të përfitojnë armë me të cilat të vetëmbrohen, si dhe të drejtën e vetëvendosjes të të gjithë popujve, në veçanti popujt nën sundimin kolonial ose forma të tjera dominimi të papajtueshme ose nën okupacionin e huaj dhe rëndësinë e kuptimit real të kësaj të drejte:

1. *analizon* raportin e Komisionit të Posaçëm, për këtë rast, mbi hartimin e një konvente kundër krimit të organizuar ndërkombëtar në sesionin e tij të dymbëdhjetë[19] dhe lavdëron Komisionin në fjalë për punën e kryer;

2. *miraton* protokollin kundër prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municioneve, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar të aneksuar rezolutës aktuale dhe e hap atë për nënshkrim në Selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju York;

3. *nxit* të gjitha shtetet dhe organizatat rajonale ekonomike të nënshkruajnë dhe ratifikojnë Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe protokollet përkatëse, sa më shpejt që të jetë e mundur, me qëllim sigurimin e një hyrjeje në fuqi të shpejtë të Konventës dhe protokolleve përkatëse.

Mbledhja plenare e 101-të
31 maj 2001

[19] A/55/383/Add. 2.

SHTOJCË PROTOKOLLI
KUNDËR PRODHIMIT TË PALIGJSHËM DHE TRAFIKIMIT TË ARMËVE TË ZJARRIT, PJESËVE TË TYRE, KOMPONENTËVE DHE MUNICIONEVE, QË PLOTËSON KONVENTËN E KOMBEVE TË BASHKUARA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR NDËRKOMBËTAR

HYRJE

Shtetet palë të këtij protokolli,

të vetëdijshme mbi nevojën urgjente për të parandaluar, luftuar dhe çrrënjosur prodhimin e paligjshëm dhe trafikimin e armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municioneve, për shkak të efekteve të dëmshme të aktiviteteve në fjalë ndaj sigurisë së çdo shteti, rajoni dhe shoqërisë në tërësi, duke rrezikuar mirëqenien e njerëzve, zhvillimin e tyre social dhe ekonomik dhe të drejtën e tyre për të jetuar në paqe;

të bindura, për pasojë, mbi domosdoshmërinë e të gjitha shteteve për të ndërmarrë të gjitha masat e duhura për arritjen e këtij qëllimi, përfshirë bashkëpunimin ndërkombëtar dhe masa të tjera në nivele rajonale dhe globale;

duke sjellë në kujtesë rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme 53/111 të 9 dhjetorit 1998, në të cilën Asambleja vendosi të krijonte një Komision të Posaçëm të hapur ndërqeveritar, për këtë rast, me qëllim hartimin e një konvente gjithëpërfshirëse ndërkombëtare kundër krimit të organizuar ndërkombëtar dhe diskutimin e zhvillimit, ndër të tjera, të një instrumenti ndërkombëtar për të luftuar prodhimin e paligjshëm dhe trafikimin e armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municioneve;

duke pasur parasysh parimin e të drejtave të barabarta dhe të vetëvendosjes, siç theksohet në Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe Deklaratën mbi Parimet e Ligjit Ndërkombëtar në lidhje me marrëdhëniet miqësore dhe bashkëpunimin ndërmjet shteteve në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara[20];

të bindura mbi plotësimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar me një instrument ndërkombëtar kundër prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municioneve,

kanë rënë dakord si më poshtë:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Raporti me Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar

1. Ky protokoll plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar. Ai interpretohet së bashku me Konventën.

2. Dispozitat e Konventës zbatohen *mutandis mutandis* në këtë protokoll, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë dokument.

3. Shkeljet e shkaktuara, sipas nenit 5 të këtij protokolli, konsiderohen shkelje të Konventës.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i këtij protokolli është të nxisë, lehtësojë dhe forcojë bashkëpunimin ndërmjet shteteve anëtare, me qëllim parandalimin, luftimin dhe çrrënjosjen e prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municioneve.

[20] Rezoluta 2625 (XXV), shtojca.

Neni 3
Përdorimi i termave

Për qëllim të këtij protokolli:

a) "Armë zjarri" nënkupton çdo armë të transportueshme me tytë që realizon, është e projektuar për të realizuar ose mund të modifikohet lehtësisht për të realizuar të shtëna, plumba ose predha me anë të një lënde plasëse, përjashtuar armët e zjarrit antike ose riprodhimet e tyre. Armët antike dhe replikat e tyre përcaktohen sipas ligjit të vendit. Megjithatë, në asnjë rast, armët e zjarrit nuk përfshijnë armë të prodhuara pas vitit 1899.

b) "Pjesë dhe komponentë" nënkupton çdo element ose element zëvendësues të projektuar specifikisht për një armë zjarri dhe vital për operimin e saj, përfshirë tytën, kuadër apo marrës, apo shënues, rrëshqitës apo cilindër, shul apo siguresë dhe çdo pajisje të projektuar ose modifikuar për të zvogëluar zhurmën e shkaktuar nga zbrazja e armës së zjarrit.

c) "Municione" nënkupton ciklin e plotë ose komponentët e tij përfshirë gëzhoja, kapsolla, barut shtytës, plumba ose predha që përdoren në një armë zjarri, me kusht që komponentët në fjalë t'i nënshtrohen autorizimit në shtetin përkatës palë.

d) "Prodhim i paligjshëm" nënkupton prodhimin ose montimin e armëve të zjarrit, pjesëve të tyre dhe komponentëve ose municioneve:

i) të pjesëve dhe komponentëve të trafikuara në mënyrë të paligjshme;

ii) pa licencë ose autorizim nga një autoritet kompetent i shtetit palë, ku realizohet prodhimi ose montimi; ose

iii) pa etiketuar armët e zjarrit në momentin e prodhimit, sipas nenit 8 të këtij protokolli;

Licencimi ose autorizimi i prodhimit të pjesëve dhe komponentëve realizohet sipas ligjit kombëtar.

e) "Trafikim i paligjshëm" nënkupton importin, eksportin, përvetësimin, shitjen, shpërndarjen, lëvizjen ose zhvendosjen e armëve të zjarrit, pjesëve të tyre dhe komponentëve dhe municioneve nga ose përmes territorit të një shteti palë drejt një shteti tjetër anëtar, nëse një nga shtetet anëtare në fjalë nuk e autorizon një veprim të tillë sipas kushteve të këtij protokolli ose, nëse armët e zjarrit nuk etiketohen sipas nenit 8 të këtij protokolli.

f) "Ndjekje" nënkupton gjurmimin sistematik të armëve të zjarrit dhe, kur është e mundur, të pjesëve, komponentëve dhe municioneve të tyre nga prodhuesi, blerësit, me qëllim asistimin e autoriteteve kompetente të shteteve palë/anëtare në zbulimin, investigimin dhe analizimin e prodhimit dhe trafikimit të paligjshëm.

Neni 4
Objekti i zbatimit

1. Ky protokoll zbatohet, me përjashtim të rasteve kur theksohet ndryshe në këtë dokument, për parandalimin e prodhimit dhe trafikimit të paligjshëm të armëve të zjarrit, pjesëve, komponentëve dhe municioneve të tyre, për investigimin dhe ndjekjen penale të shkeljeve të shkaktuara sipas nenit 5 të këtij protokolli, kur shkeljet në fjalë kanë natyrë ndërkombëtare dhe përfshijnë një grup kriminal të organizuar.

2. Ky protokoll nuk zbatohet për operacione shtet me shtet ose për transfertat shtetërore, në rastet kur zbatimi i protokollit do të cenonte të drejtën e shtetit palë/anëtar për të ndërmarrë veprime në interes të sigurisë kombëtare, në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara.

Neni 5
Ndjekja penale

1. Çdo shtet anëtar/palë, miraton ligje dhe masa të tjera sipas nevojës për të trajtuar si vepër penale veprimet e mëposhtme, kur realizohen me dashje:

a) prodhim i paligjshëm i armëve të zjarrit, pjesëve, komponentëve dhe municioneve të tyre;

b) trafikim i paligjshëm i armëve të zjarrit, pjesëve, komponentëve dhe municioneve të tyre;

c) falsifikim ose fshirje, zhvendosje ose ndryshim i paligjshëm i shenjave mbi armët e zjarrit, kërkesë kjo e nenit 8 të këtij protokolli.

2. Çdo shtet anëtar/palë, miraton gjithashtu ligje dhe masa të tjera sipas nevojës për të trajtuar si vepër penale veprimet e mëposhtme:

a) në varësi të koncepteve bazë të sistemit ligjor të tij, tentativa për të kryer ose marrë si bashkëpunëtor në një shkelje të shkaktuar sipas paragrafit 1 të këtij neni; dhe

b) organizimi, drejtimi, asistenca, mbështetja, lehtësimi ose këshillimi i realizimit të një shkeljeje sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 6

Konfiskimi, sekuestrimi dhe shkatërrimi

1. Pa cenuar nenin 12 të Konventës, shtetet anëtare/palë miratojnë, në shkallën më të lartë të mundshme, brenda sistemeve të brendshme ligjore, masa të tilla sipas nevojave për të bërë të mundur konfiskimin e armëve të zjarrit, pjesëve, komponentëve dhe municioneve të tyre, të cilat janë prodhuar dhe trafikuar në mënyrë të paligjshme.

2. Shtetet anëtare/palë miratojnë, brenda sistemeve të brendshme ligjore, masa të tilla sipas nevojave për të parandaluar armët e zjarrit, pjesët, komponentët dhe municionet e tyre, të prodhuara dhe trafikuara në mënyrë të paligjshme nga rënia në duart e personave të paautorizuar, duke i kapur dhe shkatërruar armë të tilla zjarri, pjesët, komponentët dhe municionet e tyre, me përjashtim të rasteve kur një zgjidhje tjetër është autorizuar zyrtarisht, me kusht që armët e zjarrit të etiketohen dhe metodat e shkatërrimit të armëve të zjarrit dhe municioneve të regjistrohen.

II. PARANDALIMI

Neni 7

Regjistrimi

Çdo Shtet anëtar/palë siguron mirëmbajtjen, për jo më pak se dhjetë vjet, të informacionit që ka të bëjë me armët e zjarrit dhe, kur të jetë e mundur, të informacionit mbi pjesët, komponentët dhe municionet e tyre, i cili është i nevojshëm për të zbuluar dhe identifikuar armët e zjarrit dhe, kur të jetë mundur, për të zbuluar pjesët, komponentët dhe municionet e tyre të cilat janë prodhuar dhe trafikuar në mënyrë të paligjshme dhe të parandalojë e zbulojë aktivitete të tilla. Një informacion i tillë përfshin:

a) shenjat e duhura, kërkesë e nenit 8 të këtij protokolli;

b) në rastet kur përfshihen operacione/transaksione ndërkombëtare të armëve të zjarrit, pjesëve, komponentëve dhe municioneve të tyre, datat e lëshimit dhe skadencës, vendi nga janë importuar, vendet transite dhe, kur të jetë e mundur, marrësi përfundimtar dhe përshkrimi e sasia e artikujve.

Neni 8

Etiketimi i armëve të zjarrit

1. Me qëllim identifikimin dhe zbulimin e çdo arme zjarri, shtetet anëtare/palë:

a) në periudhën e prodhimit të çdo armë zjarri ose kërkojnë etiketim unikal duke siguruar emrin e prodhuesit, shtetin dhe vendin e prodhimit dhe numrin e serisë, ose i përmbahen ndonjë etiketimi alternativ unikal, të lehtë në përdorim, me simbole të thjeshta gjeometrike kombinuar me një kod numerik dhe/ose alfanumerik, duke lejuar identifikim të lehtë nga ana e të gjitha shteteve të vendit të prodhimit;

b) kërkon etiketim të thjeshtë e të përshtatshëm për çdo armë zjarri të importuar, duke lejuar identifikimin e vendit të importit dhe, ku të jetë e mundur, vitin e importit duke i dhënë mundësi autoriteteve kompetente të vendit në fjalë të zbulojnë armën e zjarrit dhe një etiketim unikal në rast se arma e zjarrit nuk mbart një etiketim të tillë. Kërkesat e këtij nënparagrafi nuk nevojiten të

zbatohen për importe të përkohshme të armëve të zjarrit për qëllime të ligjshme të verifikueshme;

c) të sigurojë, në momentin e transferimit të një arme zjarri nga rezervat qeveritare drejt përdorimit të përhershëm civil, etiketimin e duhur unikal për të lejuar identifikimin nga të gjitha shtetet e vendit transferues.

2. Shtetet anëtare/palë inkurajojnë industrinë e prodhimit të armëve të zjarrit të ndërmarrin masa kundër heqjes ose ndryshimit të etiketimit.

Neni 9

Çaktivizimi i armëve të zjarrit

Një shtet anëtar/palë që nuk njeh një armë të çaktivizuar si armë zjarri, sipas ligjit të brendshëm, merr masat e nevojshme, përfshirë përcaktimin e shkeljeve specifike, nëse është e përshtatshme, për të parandaluar riaktivizimin e paligjshëm të armëve të zjarrit të çaktivizuara në pajtim me parimet e përgjithshme të çaktivizimit:

a) të gjitha pjesët e një arme zjarri të çaktivizuar shndërrohen në mënyrë të përhershme të paoperueshme dhe të paafta për t'u zhvendosur, lëvizur apo modifikuar, në mënyrë që të lejojë riaktivizimin e armës së zjarrit në çdo mënyrë të mundshme;

b) duhet të bëhen përgatitje që masat çaktivizuese të verifikohen, kur është e përshtatshme, nga një autoritet kompetent për të siguruar që modifikimet e realizuara kundrejt një arme zjarri e kanë shndërruar atë në mënyrë të përhershme të paoperueshme;

c) verifikimi nga një autoritet kompetent duhet të përfshijë një vërtetim ose regjistrim, ku provohet çaktivizimi i një arme zjarri ose të përfshijë një shenjë krejtësisht të dukshme, me qëllim të njëjtë, stampuar mbi armën.

Neni 10

Kërkesa të përgjithshme për eksportin, importin dhe licencimin transit ose sistemet e autorizimit

1. Secili Shtet Anëtar/Palë përcakton ose ruan një sistem efikas të licencimit ose autorizimit të eksportit dhe importit, si dhe ndërmerr masa për transitin ndërkombëtar për kalimin transit të armëve të zjarrit, pjesëve, komponentëve dhe municioneve të tyre.

2. Para lëshimit të licencave ose autorizimeve të eksportit për transportimin e armëve të zjarrit, pjesëve, komponentëve dhe municioneve të tyre, secili shtet/palë/anëtar verifikon:

a) që shtetet importuese kanë lëshuar licenca ose autorizime importi; dhe

b) që, pa cenuar marrëveshjet bilaterale ose multilaterale, ose marrëveshjet në favor të shteteve të mbyllura pa dalje në det, shtetet transit, minimalisht të kenë njoftuar me shkrim para dërgimit se nuk kanë kundërshtime ndaj transitit.

3. Licencimi ose autorizimi për eksport dhe import së bashku me dokumentacionin shoqërues përmban informacion, i cili të paktën përfshin vendin dhe datën e lëshimit, datën e skadencës, shtetin nga eksportohet, shtetin ku importohet, marrësin përfundimtar, një përshkrim dhe sasinë e armëve të zjarrit, pjesëve, komponentëve dhe municioneve të tyre dhe, kur bëhet fjalë për transit, vendet e transitit. Informacioni që përmban licenca e importit i transmetohet që më parë shteteve transite.

4. Shteti anëtar/palë, mbi bazën e kërkesës, informon shtetin marrës mbi ngarkesën e nisur të armëve të zjarrit, pjesëve, komponentëve dhe municioneve të tyre.

5. Secili shtet anëtar/palë, brenda mjeteve në dispozicion, ndërmerr masa të tilla sipas nevojës për të siguruar që procedurat e licencimit apo autorizimit janë të sigurta dhe që vlefshmëria e dokumentacionit të licencimit apo autorizimit mund të verifikohet ose provohet.

6. Shtetet anëtarë/palë miratojnë procedura të thjeshtuara për importin dhe eksportin transit dhe kalimin transit të armëve të zjarrit, pjesëve, komponentëve dhe municioneve të tyre, për qëllime të ligjshme të verifikueshme siç është gjuetia, sporti i qitjes, vlerësimi, ekspozimi ose riparimet.

Neni 11
Siguria dhe masat parandaluese

Në përpjekje për të zbuluar, parandaluar dhe eliminuar vjedhjen, humbjen ose modifikimin, si dhe prodhimin dhe trafikimin e armëve të zjarrit, pjesëve, komponentëve dhe municioneve të tyre, secili shtet anëtarë/palë ndërmerr masat e duhura:

a) për të kërkuar sigurinë e armëve të zjarrit, pjesëve, komponentëve dhe municioneve të tyre gjatë periudhës së prodhimit, importimit, eksportimit dhe kalimit transit përgjatë territorit të tij; dhe

b) për të rritur efikasitetin e kontrolleve të importit, eksportit dhe kalimit transit përfshirë, ku të jetë e përshtatshme, kontrollet e kufijve dhe efikasitetin e policisë dhe bashkëpunimit të doganave ndërkufitare.

Neni 12
Informimi

1. Pa cenuar nenet 27 dhe 28 të Konventës, shtetet anëtare/palë shkëmbejnë ndërmjet tyre, në pajtim me sistemet e tyre respektive ligjore dhe administrative të brendshme, informacion përkatës specifik mbi çështje të tilla si prodhuesit e autorizuar, tregtarët, importuesit, eksportuesit dhe, ku të jetë e mundur, transportuesit e armëve të zjarrit, pjesëve, komponentëve dhe municioneve të tyre.

2. Pa cenuar nenet 27 dhe 28 të Konventës, shtetet anëtare/palë shkëmbejnë ndërmjet tyre, konform sistemeve të tyre respektive ligjore dhe administrative të brendshme, informacionin përkatës për çështje, si:

a) grupet kriminale të organizuara që njihen si pjesëmarrëse ose dyshohen në prodhimin dhe trafikimin e paligjshëm të armëve të zjarrit, pjesëve, komponentëve dhe municioneve të tyre;

b) metodat e fshehjes që përdoren në prodhimin ose trafikimin e paligjshëm të armëve të zjarrit, pjesëve, komponentëve dhe municioneve të tyre dhe mënyrat e zbulimit të tyre;

c) metodat dhe mjetet, pikat e nisjes dhe destinacionin dhe rrugët që përdoren zakonisht nga grupet e organizuara kriminale, të përfshira në trafikimin e paligjshëm të armëve të zjarrit, pjesëve, komponentëve dhe municioneve të tyre; dhe

d) përvojat legjislative, praktikat dhe masat për të parandaluar, luftuar dhe çrrënjosur prodhimin ose trafikimin e paligjshëm të armëve të zjarrit, pjesëve, komponentëve dhe municioneve të tyre.

3. Shtetet anëtare/palë sigurojnë, për/ose ndajnë me njëra-tjetrën, si të jetë e arsyeshme, informacionin përkatës shkencor dhe teknologjik të nevojshëm për autoritetet e vendosjes së ligjit, me qëllim rritjen e aftësive të njëra-tjetrës për të parandaluar, zbuluar dhe investiguar prodhimin dhe trafikimin e paligjshëm të armëve të zjarrit, pjesëve, komponentëve dhe municioneve të tyre dhe ndjekjen penale të personave të përfshirë në aktivitetet e paligjshme.

4. Shtetet anëtare/palë bashkëpunojnë në zbulimin e armëve të zjarrit, pjesëve, komponentëve dhe municioneve të tyre, të cilat mund të jenë trafikuar ose prodhuar në mënyrë të paligjshme. Një bashkëpunim i tillë përfshin sigurimin e përgjigjeve të shpejta kundrejt kërkesave për ndihmë në zbulimin e armëve të zjarrit, pjesëve, komponentëve dhe municioneve të tyre.

5. Në varësi të koncepteve bazë të sistemit të tij ligjor ose të ndonjë marrëveshjeje ndërkombëtare, secili shtet anëtar/palë garanton konfidencialitetin dhe pajtohet me çdo kufizim mbi përdorimin e informacionit që ai merr nga një shtet anëtar/palë, sipas këtij neni, përfshirë informacionin mbi pronësinë e transaksioneve tregtare, në rast se i kërkohet ta bëjë një gjë të tillë, nga shteti anëtar/palë, i cili siguron informacionin. Në rast se një konfidencialitet i tillë nuk mund të ruhet, shteti anëtar/palë, i cili siguroi informacionin, njoftohet para nxjerrjes së informacionit.

Neni 13
Bashkëpunimi

1. Shtetet Anëtare/Palë bashkëpunojnë në nivele bilaterale, rajonale dhe ndërkombëtare për të parandaluar, luftuar dhe çrrënjosur prodhimin dhe trafikimin e paligjshëm të armëve të zjarrit, pjesëve, komponentëve dhe municioneve të tyre.

2. Pa cenuar nenin 18, paragrafin 13 të Konventës, secili shteti anëtar/palë identifikon një organizëm kombëtar ose një person të vetëm kontakti për të vepruar si koordinues ndërmjet atij/shteti dhe shteteve anëtare/palë për çështje që kanë të bëjnë me këtë protokoll.

3. Shtetet anëtare/palë kërkojnë mbështetjen dhe bashkëpunimin e prodhuesve, tregtarëve, importuesve, eksportuesve, agjentëve dhe transportuesve tregtarë të armëve të zjarrit, pjesëve, komponentëve dhe municioneve të tyre, për të parandaluar dhe zbuluar aktivitetet e paligjshme, të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 14
Asistenca teknike dhe kualifikimet

Shtetet Anëtare/Palë bashkëpunojnë me njëra-tjetrën dhe me organizatat përkatëse ndërkombëtare, sipas kushteve, në mënyrë që të marrin, në bazë të kërkesës, asistencën e nevojshme teknike dhe kualifikuese për të rritur aftësitë e tyre për të parandaluar, luftuar dhe çrrënjosur prodhimin dhe trafikimin e paligjshëm të armëve të zjarrit, pjesëve, komponentëve dhe municioneve të tyre, përfshirë asistencën teknike, financiare dhe materiale për çështjet e identifikuara në nenet 29 dhe 30 të Konventës.

Neni 15
Komisionerët dhe ndërmjetësia

1. Me qëllim parandalimin dhe luftimin e prodhimit dhe trafikimit të paligjshëm të armëve të zjarrit, pjesëve, komponentëve dhe municioneve të tyre, shtetet anëtare/palë të cilat nuk kanë vepruar ende, marrin në konsideratë krijimin e një sistemi për harmonizimin e aktiviteteve të personave që janë të përfshirë në ndërmjetësi. Një sistem i tillë mund të përfshijë një ose më shumë masa si:

a) kërkesa për regjistrimin e komisionerëve/agjentëve që operojnë brenda territorit të tyre;

b) kërkesa për licencim dhe autorizim të ndërmjetësisë; ose

c) kërkesa për nxjerrje nga ana e licencave dhe autorizimeve të importit dhe eksportit ose nga dokumentacioni i bashkëngjitur i emrave dhe vendndodhjeve të komisionerëve/agjentëve të përfshirë në transaksion.

2. Shtetet anëtare/palë të cilat kanë vendosur një sistem autorizimi lidhur me ndërmjetësinë, siç është parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni, nxiten të përfshijnë informacion mbi komisionerët/agjentët dhe ndërmjetësinë në shkëmbimet e tyre të informacionit sipas nenit 12 të këtij protokolli dhe të ruajnë regjistrimet lidhur me komisionerët/agjentët dhe ndërmjetësinë sipas nenit 7 të këtij protokolli.

III. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 16
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Shtetet anëtare/palë mundohen t'i zgjidhin mosmarrëveshjet lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij protokolli me bisedim/negociata.

2. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet dy ose më shumë shteteve anëtare/palë lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij protokolli, e cila nuk mund të zgjidhet me negociata brenda një

periudhe kohe të arsyeshme, me kërkesë të njërit prej shteteve anëtare/palë në fjalë, depozitohet në arbitrazh. Në rast se gjashtë muaj nga data e kërkesës për arbitrazh, shtetet anëtare/palë në fjalë nuk janë në gjendje të bien dakord mbi organizimin e arbitrazhit, atëherë secili nga shtetet anëtare/palë mund t'ia dërgojë mosmarrëveshjen Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë me anë të një kërkese sipas statutit të Gjykatës.

3. Secili shtet anëtar/palë, në momentin e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit ose miratimit apo hyrjes në këtë protokoll, mund të deklarojë se ai/shteti nuk e konsideron veten të lidhur/detyruar nga paragrafi 2 i këtij neni. Shtetet anëtare/palë të tjera nuk janë të lidhura/detyruara nga paragrafi 2 i këtij neni për sa i përket çdo shteti anëtar/palë që ka shprehur një rezervë të tillë.

4. Secili shtet anëtar/palë që ka shprehur një rezervë, sipas paragrafit 3 të këtij neni, në çdo kohë mund ta tërheqë rezervën në fjalë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 17

Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, miratimi dhe hyrja

1. Ky protokoll është i hapur për nënshkrim nga të gjitha shtetet në Selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju York pas ditës së tridhjetë, pasi të jetë miratuar nga Asambleja e Përgjithshme deri më 12 dhjetor 2002.

2. Ky protokoll është, gjithashtu i hapur për nënshkrim nga organizatat rajonale të integrimit ekonomik, me kusht që të paktën një shtet anëtar i organizatës në fjalë të ketë nënshkruar këtë protokoll sipas paragrafit 1 të këtij neni.

3. Ky protokoll i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Një organizatë rajonale e integrimit ekonomik, mund të depozitojë instrumentin e ratifikimit, pranimit ose miratimit, në rast se të paktën një nga shtetet anëtare të saj ka vepruar në mënyrë të tillë. Në instrumentin e ratifikimit, pranimit ose miratimit, organizata në fjalë deklaron shtrirjen e kompetencave të saj, përsa i përket çështjeve të rregulluara nga ky protokoll. Një organizatë e tillë, gjithashtu informon zyrën depozituese mbi çdo modifikim përkatës të shtrirjes së kompetencave të saj.

4. Ky protokoll, është gjithashtu i hapur për hyrje nga çdo shtet ose nga çdo organizatë rajonale e integrimit ekonomik nga e cila të paktën një shtet anëtar është palë e këtij protokolli. Instrumentet e hyrjes depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Në momentin e hyrjes, organizata në fjalë deklaron shtrirjen e kompetencave të saj, për sa i përket çështjeve të rregulluara nga ky protokoll. Një organizatë e tillë, gjithashtu informon zyrën depozituese mbi çdo modifikim përkatës të shtrirjes së kompetencave të saj.

Neni 18

Hyrja në fuqi

1. Ky protokoll hyn në fuqi ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitimit të instrumentit të dyzetë të ratifikimit, pranimit, miratimit ose hyrjes, nëse protokolli nuk hyn në fuqi para hyrjes në fuqi të Konventës. Për qëllim të këtij paragrafi, çdo instrument i depozituar nga një organizatë rajonale e integrimit ekonomik nuk llogaritet si plotësuese e instrumenteve të depozituara nga shtetet anëtare të organizatës në fjalë.

2. Për çdo shtet ose organizatë rajonale të integrimit ekonomik që ratifikon, pranon, aprovon ose miraton këtë protokoll pas depozitimit të instrumentit të dyzetë, ky protokoll hyn në fuqi ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit nga ana e shtetit apo organizatës në fjalë të instrumentit përkatës ose datën kur ky protokoll hyn në fuqi sipas paragrafit 1 të këtij neni, data që i takon të jetë më e vonshmja.

Neni 19
Amendimi

1. Pas përfundimit të afatit prej pesë vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij protokolli, një shtet anëtar/palë në këtë protokoll mund të propozojë një amendim dhe t'ia depozitojë atë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili pas kësaj ia komunikon amendimin e propozuar shteteve anëtare dhe Konferencës së Palëve në Konventë, me qëllim marrjen në konsideratë të propozimit dhe marrjen e një vendimi. Shtetet anëtare në këtë protokoll të mbledhura në Konferencën e Palëve duhet të bëjnë çdo përpjekje për të arritur një konsensus në çdo ndryshim. Në rast se të gjitha përpjekjet për konsensus janë bërë dhe nuk është arritur një marrëveshje, atëherë ndryshimi, si zgjidhje e fundit, kërkon për t'u miratuar një shumicë votash prej 2/3 të shteteve anëtare në këtë protokoll që janë të pranishme, të mbledhura në Konferencën e Palëve.

2. Organizatat rajonale të integrimit ekonomik, për çështje brenda kompetencave të tyre, ushtrojnë të drejtën për të votuar sipas këtij neni me një numër votash të barabartë me numrin e shteteve anëtare të tyre që janë palë e këtij protokolli. Organizata të tilla nuk ushtrojnë të drejtën e tyre për votim, në rast se shtetet anëtare ushtrojnë të drejtën e tyre për votim dhe anasjellas.

3. Një amendim i miratuar sipas paragrafit 1 të këtij neni i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit nga Shtetet Anëtare.

4. Një amendim i miratuar sipas paragrafit 1 të këtij neni hyn në fuqi, për sa i përket një shteti anëtar/palë, nëntëdhjetë ditë pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit ose miratimit të amendimit në fjalë, pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

5. Kur një amendim hyn në fuqi, ai ka efekt detyrues mbi ato shtete anëtare/palë të cilat kanë shprehur dëshirën të jenë të varura prej tij. Shtetet e tjera anëtare/palë janë ende të varura nga dispozitat e këtij protokolli dhe çdo amendimi të mëparshëm të cilin e kanë ratifikuar, pranuar ose miratuar.

Neni 20
Prishja e marrëveshjes

1. Një shtet anëtar/palë mund ta shpallë të pavlefshëm këtë protokoll me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Prishje të tilla hyjnë në fuqi një vit nga data e depozitimit të njoftimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

2. Një organizatë rajonale e integrimit ekonomik pushon së qenuri palë e këtij protokolli, kur shtetet anëtare të saj e kanë prishur marrëveshjen.

Neni 21
Kancelari/depozitari dhe gjuhët

1. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara është zgjedhur kancelari/depozitari i këtij protokolli.

2. Origjinali i këtij protokolli, versionet në gjuhët arabisht, kinezisht, anglisht, frëngjisht, rusisht dhe spanjisht, të cilat janë njëlloj autentike, depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Në dëshmi sa më sipër, të nënshkruarit e plotfuqishëm, duke qenë të autorizuar sipas rregullave nga qeveritë respektive, kanë nënshkruar këtë protokoll.

LIGJ
Nr.9871, datë 11.2.2008

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË ITALISË, SI SHTESË E KONVENTËS EUROPIANE PËR EKSTRADIMIN, TË 13 DHJETORIT 1957 DHE E KONVENTËS EUROPIANE PËR NDIHMË JURIDIKE PËR ÇËSHTJET PENALE, TË 20 PRILLIT 1959, QË KA SI QËLLIM TË LEHTËSOJË ZBATIMIN E TYRE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë, si shtesë e Konventës Europiane për Ekstradimin, të 13 dhjetorit 1957 dhe e Konventës Europiane për Ndihmë Juridike për Çështjet Penale, të 20 prillit 1959, që ka si qëllim të lehtësojë zbatimin e tyre".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5628, datë 22.2.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.26, faqe 1229

MARRËVESHJE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË ITALISË, SI SHTESË E KONVENTËS EUROPIANE MBI EKSTRADIMIN E 13 DHJETORIT 1957 DHE E KONVENTËS EUROPIANE PËR NDIHMËN JURIDIKE PËR ÇËSHTJET PENALE TË 20 PRILLIT 1959, QË KA SI QËLLIM TË LEHTËSOJË ZBATIMIN E TYRE

Republika e Shqipërisë dhe Republika e Italisë, më poshtë do të quhen Palët Kontraktuese,

dëshirojnë të plotësojnë Konventën Europiane të Ndihmës Juridike për Çështjet Penale të datës 20 prill 1959 në marrëdhëniet ndërmjet Palëve Kontraktuese, dhe të lehtësojnë zbatimin e parimeve që përmbahen në të, pa paragjykuar nenet që mbrojnë lirinë individuale;

duke nënvizuar që është interes i përbashkët i Palëve Kontraktuese që ndihma juridike ndërmjet tyre të kryhet në mënyrë të shpejtë dhe efikase, në përputhje me parimet themelore të së drejtës së tyre të brendshme, si dhe duke respektuar të drejtat individuale dhe parimet e Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore, e firmosur në Romë, më 4 nëntor 1950;

duke dëshiruar, gjithashtu të plotësojnë Konventën Europiane të Ekstradimit të 13 dhjetorit 1957 në marrëdhëniet ndërmjet Palëve Kontraktuese, duke iu referuar në mënyrë të veçantë ekstradimit të shtetasve respektivë;

duke pasur parasysh që, përsa i përket ekstradimit të shtetasve, Republika e Shqipërisë, në

depozitimin e instrumentit të ratifikimit të Konventës Europiane për Ekstradimin deklaronte, duke iu referuar parashikimit të bërë në nenin 6 paragrafi 1 të së njëjtës Konventë, që: "Shqipëria refuzon ekstradimin e shtetasve të vet, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Shqipëria është Palë Kontraktuese";

duke njohur që me këtë Marrëveshje, në përputhje me letrën dhe në kuadër të deklarimit të Republikës së Shqipërisë, Palët Kontraktuese kanë si qëllim që të heqin dorë nga e drejta për të refuzuar dorëzimin e shtetasve respektivë, siç parashikohet nga neni 6 paragrafi 1 i Konventës Europiane për Ekstradimin, dhe për këtë qëllim parashikimet e mundshme në kundërshtim me këtë qëllim të parashikuara nga rregullimet respektive juridike nuk mund të përbëjnë një motiv të vlefshëm për të refuzuar dorëzimin e shtetasve përkatës;

dëshirojnë të plotësojnë dhe të përfshijnë marrëdhëniet përkatëse në fushën e asistencës juridike për ekstradimin nën dritën dhe në përputhje me *acquis*-in e Bashkimit Europian në këtë çështje, duke iu referuar në mënyrë të veçantë parashikimeve që përmbahen në Konventën e Ndihmës Juridike në Fushën Penale ndërmjet shteteve anëtare të Bashkimit Europian, miratuar nga Këshilli i Bashkimt Europian në 29 maj 2000, si dhe protokollin e saj shtesë, të miratuar nga Këshilli i Bashkimit Europian, më 16 tetor 2001;

duke shprehur besimin e tyre në strukturën dhe në funksionimin e rregullimeve respektive juridike dhe në aftësinë e Palëve Kontraktuese për të garantuar procese të njëjta;

duke njohur se parashikimet e parashikuara nga Konventa Europiane e Ndihmës Juridike në Fushën Penale e 20 prillit 1959 dhe nga Konventa Europiane e Ekstradimit e 13 dhjetorit 1957 qëndrojnë në fuqi për të gjitha çështjet që nuk rregullohen nga kjo Marrëveshje,

kanë rënë dakord për parashikimet e mëposhtme:

TITULLI I
RAPORTET ME KONVENTAT E TJERA TË NDIHMËS JURIDIKE DHE EKSTRADIMIT

Neni 1
Raportet me konventat e tjera në fushën e ndihmës juridike dhe ekstradimit

Kjo Marrëveshje ka si qëllim që t'i plotësojë parashikimet dhe të lehtësojë zbatimin ndërmjet Palëve Kontraktuese:

a) të Konventës Europiane të Ndihmës Juridike në Fushën Penale të 20 prillit 1959, më poshtë e quajtur Konventa Europiane e Ndihmës Juridike;

b) të protokollit shtesë të Konventës Europiane të Ndihmës Juridike të 17 marsit 1978;

c) të Konventës Europiane për Ekstradimin e 13 dhjetorit 1957, më poshtë e quajtur Konventa Europiane e Ekstradimit.

TITULLI II
PARASHIKIME NË LIDHJE ME KONVENTËN EUROPIANE TË NDIHMËS JURIDIKE

KREU I
PARASHIKIME TË PËRGJITHSHME

Neni 2
Formalitetet dhe procedurat që kanë të bëjnë me kërkesat për ndihmë juridike

1. Në rastet në të cilat lejohet ndihma, pala së cilës i kërkohet ndihma shikon formalitetet dhe procedurat e treguara në mënyrë të shprehur nga pala kërkuese, me përjashtim të rasteve kur kjo Marrëveshje parashikon ndryshe dhe gjithmonë nëse formalitetet dhe procedurat e treguara nuk janë në konflikt me parimet themelore të së drejtës së palës që i kërkohet ndihma.

2. Pala që i kërkohet ndihma i jep zbatim sa më shpejt të jetë e mundur kërkesës së ndihmës juridike, duke pasur plotësisht parasysh, brenda kufijve të mundshëm, afatet procedurale, si dhe afatet e tjera të treguara nga pala kërkuese. Pala kërkuese shpjegon arsyet se përse ka kërkuar një afat të caktuar.

3. Në rast se kërkesës nuk mund t'i jepet zbatim, tërësisht ose pjesërisht, sipas kërkesave të përcaktuara nga pala kërkuese, autoritetet e palës që i kërkohet ndihma informojnë menjëherë autoritetet e palës kërkuese, duke treguar kushtet sipas të cilave mund t'i jepet zbatim kërkesës. Autoritetet e palës kërkuese dhe të palës që i kërkohet ndihma mund të bien dakord më pas mbi të ardhmen që i rezervohet kërkesës, mbi domosdoshmërinë duke e kushtëzuar këtë me plotësimin e këtyre kushteve.

4. Nëse parashikohet se afatet e përcaktuara nga pala kërkuese për t'i dhënë zbatim kërkesës nuk mund të respektohen dhe, nëse arsyet sipas paragrafit 2, fraza e dytë, tregojnë konkretisht që një vonesë e mundshme do të përbëjë një pengesë themelore për procedimin në vazhdim të palës kërkuese, autoritetet e palës që i kërkohet ndihma tregojnë menjëherë një përllogaritje të afateve të nevojshme për t'i dhënë zbatim kërkesës. Autoritetet e palës kërkuese komunikojnë menjëherë, nëse kërkesa gjithsesi duhet të merret parasysh. Autoritetet e palës kërkuese dhe të palës që i kërkohet ndihma mund të bien dakord më pas mbi të ardhmen që duhet t'i rezervohet kërkesës.

Neni 3

Dërgimi nëpërmjet postës dhe dorëzimi i akteve të procedimit

1. Secila Palë Kontraktuese i dërgon personave që ndodhen në territorin e tjetrës aktet e procedimit të destinuara për to drejtpërdrejt nëpërmjet postës.

2. Dërgimi i akteve të procedimit mund të bëhet nëpërmjet autoriteteve kompetente qendrore të palës që i kërkohet ndihma vetëm në rast se:

a) adresa e marrësit të aktit është e panjohur ose e paqartë; ose

b) normat përkatëse të procedurës së palës kërkuese kërkojnë një provë të dorëzimit të kryer të aktit te marrësi, e ndryshme nga ajo që mund të sigurohet nëpërmjet postës; ose

c) nuk ka qenë e mundur që të dërgohet akti nëpërmjet postës; ose

d) pala kërkuese ka motive të bazuara për të pretenduar se dërgimi nëpërmjet postës është joefikas dhe i papërshtatshëm.

3. Nëse ka motiv për të pretenduar që marrësi nuk kupton gjuhën në të cilën është hartuar akti i procedimit, ky i fundit, ose të paktën pjesët e rëndësishme të tij, duhet të përkthehen në gjuhën ose në një nga gjuhët e palës në territorin e të cilës gjendet marrësi. Nëse autoriteti që nxjerr aktin është në dijeni të faktit që marrësi njeh vetëm një gjuhë tjetër, akti ose të paktën pjesët e rëndësishme të tij duhet të përkthehen në këtë gjuhë tjetër.

4. Të gjitha aktet e procedimit janë të pajisura me një njoftim në të cilën është përcaktuar që marrësi mund të marrë informacione nga autoriteti që ka nxjerrë aktin ose nga autoritete të tjera të palës së interesuar në lidhje me të drejtat e tij dhe detyrimet e tij në lidhje me aktin. Paragrafi 3 zbatohet në mënyrë të njëjtë me këtë njoftim.

5. Ky nen nuk ndikon në zbatimin e neneve 8, 9 dhe 12 të Konventës Europiane të Ndihmës Juridike.

Neni 4

Transmetimi i kërkesave të ndihmës juridike

1. Kërkesat për ndihmë juridike bëhen në mënyrë të shkruar ose nëpërmjet çdo mjeti tjetër të aftë për të prodhuar një regjistrim të shkruar të kushteve që i bëjnë të mundur palës që i kërkohet ndihma të verifikojë vërtetësinë. Këto kërkesa kryhen drejtpërdrejt nëpërmjet autoriteteve gjyqësore që kanë kompetencë territoriale me qëllim të prezantimit të tyre dhe sipas përmbajtjes, përpara zbatimit të tyre, i transmetohen:

- përsa i përket Republikës Italiane, Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Drejtësisë Penale, zyra II;

- përsa i përket Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme për Çështjet e Drejtësisë.

Kërkesat për ndihmë juridike rikthehen nëpërmjet kanaleve të njëjta, nëse nuk parashikohet ndryshe në këtë nen. Çdo denoncim i një Pale të drejtpërdrejtë për të siguruar që të nxiten procedimet përpara gjyqtarëve të tjetrës në kuadër të nenit 21 të Konventës Europiane të Ndihmës Juridike mund të jetë objekt i komunikimeve të drejtpërdrejta ndërmjet autoriteteve juridike kompetente.

2. Paragrafi 1 nuk paragjykon mundësinë që të dërgohen ose të dorëzohen kërkesat në çështje specifike:

a) nëpërmjet një autoriteti qendror të njërës palë dhe të një autoriteti qendror të tjetrës; ose

b) midis një autoriteti gjyqësor të njërës palë dhe një autoriteti qendror të tjetrës.

3. Aty ku, përsa i përket kërkesave sipas neneve 9, 10 ose 11, autoriteti kompetent është një autoritet gjyqësor ose një autoritet qendror për njërën palë dhe një autoritet doganor ose policor për palën tjetër, kërkesat dhe përgjigjet mund të shkëmbehen drejtpërdrejt midis këtyre autoriteteve. Paragrafi 1 zbatohet për këto kontakte.

4. Kërkesat ose komunikimet më poshtë dërgohen nëpërmjet autoriteteve qendrore të palëve:

a) kërkesat për transferim të përkohshëm ose tranziti të personave të burgosur sipas nenit 11 të Konventes Europiane të Ndihmës Juridike;

b) njoftime të informacioneve në lidhje me dënimet sipas nenit 22 të Konventës Europiane të Asistences Juridike. Gjithsesi, kërkesat për kopje të vendimeve dhe të masave sipas nenit 4 të protokollit shtesë të Konventës Europiane të Ndihmës Juridike mund t'u dërgohen drejtpërdrejt autoriteteve kompetente.

Neni 5

Shkëmbimi spontan i informacioneve

1. Brenda kufijve që vendos e drejta e brendshme, autoritetet gjyqësore kompetente të Palëve Kontraktuese mund të procedojnë për një shkëmbim informacioni, pa qenë paraqitur një kërkesë për këtë qëllim, në lidhje me vepra penale që ndiqen nga ana e autoritetit marrës në momentin e transmetimit të informacioneve.

2. Informacionet shkëmbehen në mënyrë të shkruar, ose nëpërmjet çdo mjeti të aftë për të prodhuar një regjistrim të shkruar, me kushtet që i lejojnë Palëve Kontraktuese që të verifikojnë vërtetësinë.

3. Autoriteti që siguron informacionet mund, sipas së drejtës së brendshme, t'i imponojë autoritetit gjyqësor marrës kushte për përdorimin e këtij informacioni. Autoriteti gjyqësor marrës i respekton këto kushte.

4. Midis autoriteteve gjyqësore kompetente të parashikuara nga paragrafi 1, për palën italiane, Drejtoria Kombëtare Antimafia procedon me shkëmbimin e informacioneve dhe të aktiviteteve të tjera të dhëna asaj nga e drejta e brendshme e vendit.

KREU II

KËRKESA E FORMAVE TË VEÇANTA TË NDIHMËS JURIDIKE

Neni 6

Kthimi

1. Palës që i kërkohet ndihmë, sipas kërkesës së palës kërkuese dhe pas mbrojtjes së të drejtave të të tretëve në mirëbesim, mund të vërë në dispozicion të palës kërkuese, me qëllim të rikthimit te pronari i ligjshëm, të mirat e siguruara nëpërmjet veprave penale.

2. Në zbatim të neneve 3 dhe 6 të Konventës Europiane të Ndihmës Juridike, pala që i

kërkohet ndihmë mund të heqë dorë nga rikthimi i të mirave para ose pas dorëzimit të tyre te pala kërkuese, në rast se kjo mund të favorizojë rikthimin e këtyre të mirave te pronari i ligjshëm. Mbeten të paparagjykuara të drejtat e të tretëve në mirëbesim.

3. Në rast të heqjes dorë nga rikthimi i të mirave para dorëzimit të tyre te pala kërkuese, pala që i kërkohet ndihmë nuk kërkon asnjë të drejtë garancie ose asnjë të drejtë tjetër kundërshtimi në lidhje me parashikimet e ligjit për çështjet e taksave dhe të doganës në lidhje me këto të mira. Një heqje dorë që sipas paragrafit 2 nuk paragjykon të drejtën e palës që i kërkohet ndihmë të përfitojë detyrime ose të drejta nga pronari i ligjshëm.

Neni 7

Pyetja nëpërmjet lidhjes audiovizive

1. Nëse një person ndodhet në territorin e njërës prej Palëve Kontraktuese, dhe duhet të pyetet në cilësinë e dëshmitarit apo të ekspertit nga organet gjyqësore të palës tjetër, kjo e fundit mund të kërkojë që nëse për personin në fjalë nuk është e përshtatshme apo e mundur të shfaqet vetë në territorin e saj, që pyetja të zhvillohet nëpërmjet lidhjes audiovizive, sipas dispozitave të paragrafëve 2 dhe 8.

2. Pala të cilës i kërkohet ndihmë jep pëlqimin për një pyetje të tillë nëse metoda e lidhjes audiovizive nuk përbën shkelje të parimeve themelore të së drejtës së brendshme dhe me kusht që të disponojë instrumente teknike për kryerjen e një dëgjimi të tillë në distancë. Nëse pala të cilës i kërkohet ndihmë nuk disponon instrumentet teknike për kryerjen e lidhjes audiovizive, ato mund t'i vihen në dispozicion nga pala kërkuese në vijim të një marrëveshjeje të ndërsjellë.

3. Kërkesat e pyetjes me anë të lidhjes audiovizive, përveç informacioneve për të cilat flet neni 14 i Konventës Europiane të Ndihmës në Fushën Juridike përmbajnë tregues të arsyeve për të cilat nuk është e përshtatshme apo e mundur prania e dëshmitarit apo e ekspertit, emrin e organit gjyqësor dhe të personave që do të kryejnë pyetjen.

4. Organi gjyqësor i palës së pyetur urdhëron paraqitjen e personit në fjalë sipas formave të parashikuara nga legjislacioni i tij.

5. Në pyetjen e kryer nëpërmjet lidhjes audiovizive zbatohen dispozitat në vijim:

a) gjatë pyetjes është i pranishëm autoriteti gjyqësor i palës së pyetur, i asistuar dhe nga një përkthyes nëse është e nevojshme, që kujdeset dhe garanton identifikimin e personit që do të pyetet, si dhe respektimin e parimeve themelore të së drejtës së palës së pyetur. Nëse autoriteti gjyqësor i palës së cilës i kërkohet ndihmë konsideron se gjatë pyetjes dhunohen parimet themelore të së drejtës së kësaj pale, ajo ndërmerr pa vonesë masat e nevojshme për të siguruar që pyetja të vazhdojë të kryhet sipas këtyre parimeve;

b) organet kompetente të palës së pyetur bien dakord, nëse është rasti, për ndërmarrjen e masave mbrojtëse për personin që do të pyetet;

c) pyetja drejtohet drejtpërdrejt nga organi gjyqësor i palës kërkuese ose nën drejtimin e tij, në përputhje me parimet e tij të së drejtës;

d) pas kërkesës së palës kërkuese, ose të personit që do të pyetet, pala së cilës i kërkohet ndihmë sigurohet që personi që do të pyetet të asistohet, nëse është rasti, nga një përkthyes;

e) personi që do të pyetet mund të përdorë të drejtën e tij për të mos u përgjigjur, të parashikuar nga legjislacioni i brendshëm i palës së cilës i kërkohet ndihmë, apo i palës kërkuese.

6. Përveç masave të vendosura për mbrojtjen e personave, në përfundim të pyetjes autoriteti gjyqësor i palës së cilës i kërkohet ndihmë përgatit një procesverbal duke shënuar datën dhe vendin e pyetjes, identitetin e personit të pyetur, identitetet dhe cilësitë e të gjithë personave të tjerë që kanë marrë pjesë në marrjen në pyetje, paraqitjet e mundshme të betimeve të bëra dhe kushtet teknike në të cilat është zhvilluar pyetja.

Ky dokument u dërgohet nga autoritetet kompetente të palës së cilës i kërkohet ndihmë, autoriteteve kompetente të palës kërkuese.

7. Kostot për vendosjen e lidhjes me video, organizimin e lidhjes me video te pala së cilës i kërkohet ndihmë, pagesa e përkthyesve të ofruar prej kësaj pale, përputhjen e pagesave të dëshmitarëve dhe të ekspertëve, si dhe mbulimin e shpenzimeve të tyre të udhëtimit për të arritur në palën së cilës i kërkohet ndihmë, rimbursohen nga pala kërkuese drejt palës së cilës i kërkohet ndihmë, përveç rastit kur kjo e fundit heq dorë plotësisht apo pjesërisht nga rimbursimi.

8. Palët Kontraktuese adoptojnë masat e nevojshme për të siguruar që në pyetjen e dëshmitarëve ose të ekspertëve të kryera në territorin e tyre, në bazë të këtij neni, në rastin kur ata refuzojnë të dëshmojnë megjithëse e kanë detyrim apo japin dëshmi të rreme, të aplikohet e drejta e brendshme me të njëjtën vlerë si në marrjet në pyetje të kryera në një procedim brenda vendit.

9. Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe në marrjen në pyetje të të pandehurve, si dhe të subjekteve të tjera dhe palëve të procedimit. Në këtë rast, vendimi për të kryer lidhjen audiovizive, si dhe kushtet në të cilat ajo kryhet, përcaktohen nga Palët Kontraktuese, në përputhje me të drejtën e tyre kombëtare dhe instrumentet përkatëse ndërkombëtare ekzistuese, përfshirë Konventën Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore të 1950. Për sa janë të pajtueshme, zbatohen dispozitat e parashikuara nga paragrafët 2 dhe 8.

Neni 8

Pyetja e dëshmitarëve dhe e ekspertëve me anë të lidhjes tetefonike

1. Kur nuk është e mundur të procedohet me një lidhje audiovizive, nëse një person ndodhet në territorin e njërës prej Palëve Kontraktuese dhe duhet të pyetet nga organet gjyqësore të palës tjetër në cilësinë e dëshmtarit ose të ekspertit, pala e dytë mund të kërkojë ndihmën e palës së parë në mënyrë që pyetja të kryhet nëpërmjet telefonit, në zbatim të paragrafëve nga 2 deri në 6.

2. Kusht paraprak për kryerjen e pyetjes nëpërmjet telefonit është që dëshmitari ose eksperti të jenë dakord.

3. Pala së cilës i kërkohet ndihmë bie dakord me pyetjen nëpërmjet telefonit, nëse përdorimi i kësaj teknike nuk bie në kundërshtim me parimet themelore të së drejtës së brendshme.

4. Kërkesa për pyetjen nëpërmjet telefonit përmban përveç informacioneve që përmban neni 14 i Konventës Europiane të Ndihmës Juridike emrin e autoritetit gjyqësor dhe të personave që do të kryejnë pyetjen, si dhe të dhëna nga të cilat të rezultojë që dëshmitari ose eksperti janë dakord të marrin pjesë në një marrje në pyetje nëpërmjet telefonit.

5. Aspektet praktike të pyetjes përcaktohen nga Palët Kontraktuese. Gjatë rënies dakord mbi aspektet e lartpërmendura, pala së cilës i kërkohet ndihmë impenjohet që të:

a) njoftojë dëshmitarin ose ekspertin në fjalë për orën dhe vendin e pyetjes;

b) të kryejë identifikimin e dëshmitarit ose ekspertit;

c) të verifikojë që dëshmitari ose eksperti janë dakord për kryerjen e pyetjes nëpërmjet telefonit.

6. Zbatohen dispozitat e përshtatshme, siç janë neni 7, paragrafi 5 dhe paragrafi 8. Përveçse kur është vendosur ndryshe, zbatohen *mutatis mutandis* dispozitat e nenit 7, paragrafi 7.

Neni 9

Dorëzimet e kontrolluara

1. Palët Kontraktuese zotohen që të garantojnë se me marrjen e kërkesës nga pala tjetër mund të zhvillojnë dorëzime të kontrolluara në territorin ku zhvillohen hetimet lidhur me vepra penale objekt ekstradimi.

2. Vendimi për të kryer dorëzime të kontrolluara merret në secilin rast specifik, nga autoritetet kompetente të palës së cilës i kërkohet ndihmë, duke respektuar të drejtën e brendshme të kësaj pale.

3. Dorëzimet e kontrolluara kryhen në përputhje me procedurat në fuqi të palës së cilës i

kërkohet ndihmë. Autoritetet kompetente të kësaj pale mbajnë të drejtën e iniciativës, drejtimin dhe kontrollin e operacionit.

Neni 10
Skuadrat e përbashkëta hetimore

1. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese mund të krijojnë me marrëveshje të përbashkët, një skuadër të përbashkët hetimore, për një qëllim të caktuar dhe një afat të kufizuar, i cili mund të zgjatet me aprovimin e Palëve Kontaktuese, për të kryer hetime të një natyre penale, në territorin e palëve. Përbërja e skuadrës tregohet në marrëveshje.

Një skuadër e përbashkët hetimore mund të ngrihet në veçanti kur:

a) hetimet e kryera nga një prej Palëve Kontraktuese mbi vepra penale, janë të një natyre komplekse dhe të vështira që kanë lidhje me Palën tjetër Kontraktuese;

b) kur Palët Kontraktuese kryejnë hetime mbi vepra penale që për shkak të rrethanave të rastit kërkojnë ndërmarrjen e një veprimi të koordinuar dhe për të cilin është rënë dakord. Një kërkesë për ngritjen e një skuadre të përbashkët hetimore mund të paraqitet nga të dyja Palët Kontraktuese të interesuara. Skuadra ngrihet në Palën Kontraktuese ku do të presupozohet se do të zhvillohen hetimet.

2. Përveç informacioneve të parashikuara nga neni 14 i Konventës Europiane të Ndihmës Juridike, kërkesat për ngritjen e një skuadre të përbashkët hetimore përmbajnë propozime lidhur me përbërjen e skuadrës.

3. Skuadra e përbashkët hetimore vepron në territorin e Palëve Kontraktuese sipas kushteve të përgjithshme në vijim:

a) skuadra drejtohet nga një përfaqësues i organeve kompetente dhe merr pjesë në hetimet e natyrës penale të Palës Kontraktuese në territorin e së cilës vepron skuadra. Drejtuesi i skuadrës vepron brenda kufijve të kompetencave të tij në përputhje me të drejtën e brendshme të palës;

b) skuadra vepron në përputhje me të drejtën e Palës Kontraktuese në të cilën vepron. Gjatë kryerjes së funksioneve të tyre anëtarët e skuadrës i raportojnë personit të parashikuar në germën “a”, duke pasur parasysh kushtet e vendosura nga autoritetet përkatëse në marrëveshjen e krijimit të skuadrës;

c) Pala Kontraktuese në territorin e të cilës vepron skuadra, cakton kushtet e nevojshme organizative për t’i mundësuar funksionimin.

4. Në kuptim të këtij neni me shprehjen “të caktuar” pranë skuadrës hetimore nënkuptohen anëtarët e skuadrës së përbashkët hetimore, të ndryshëm nga ata të Palës Kontraktuese në territorin e të cilës ajo vepron.

5. Anëtarët e caktuar të skuadrës së përbashkët hetimore janë të autorizuar të jenë të pranishëm në territorin e Palës Kontraktuese ku do të veprohet nëse janë ndërmarrë masa hetimore. Gjithsesi, për arsye të veçanta, drejtuesi i skuadrës mund të urdhërojë ndryshe, në përputhje me të drejtën e Palës Kontraktuese në të cilën vepron skuadra.

6. Anëtarëve të caktuar të skuadrës së përbashkët hetimore, në përputhje me të drejtën e Palës Kontraktuese të veprimit, mund t’u ngarkohet ekzekutimi i këtyre masave hetimore nga ana e drejtuesit të skuadrës, atëherë kur kjo është aprovuar nga autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese të ndërhyrjes, dhe nga Pala Kontraktuese që i ka caktuar.

7. Nëse skuadra e përbashkët hetimore sheh nevojën që në njërën nga Palët Kontraktuese të merren masa hetimore, personat e caktuar nga kjo Palë Kontraktuese mund të bëjnë direkt një kërkesë drejtuar organeve kompetente të tyre. Masat në fjalë ekzaminohen nga kjo Palë Kontraktuese lidhur me kushtet në të cilat do të zbatoheshin, nëse do të ishin kërkuar në kuadër të një hetimi të kryer në nivel kombëtar.

8. Nëse skuadra e përbashkët hetimore ka nevojë për ndihmën e një shteti që nuk ka marrë pjesë në ngritjen e skuadrës, organet kompetente të Palës Kontraktuese të ndërhyrjes mund të drejtojnë një kërkesë tek organet kompetente të shtetit tjetër të interesuar në përputhje me instrumentet dhe dispozitat ekzistuese.

9. Për qëllimet e një hetimi penal të kryer nga skuadra e përbashkët hetimore, anëtarët e kësaj të fundit mund t'i ofrojnë kësaj skuadre informacionet që disponojnë të ardhura nga Pala Kontraktuese që i ka shkëputur, por duke respektuar të drejtën e tyre të brendshme dhe brenda kufijve të kompetencave përkatëse.

10. Informacionet e marra në mënyrë të ligjshme nga një anëtar apo nga një pjesëtar i shkëputur gjatë pjesëmarrjes në një skuadër të përbashkët hetimore, dhe të cilat ndryshe nuk janë në dispozicion të organeve kompetente të Palës Kontraktuese të interesuar, mund të përdoren:

a) për arritjen e qëllimeve të parashikuara në dokumentin e krijimit të skuadrës;

b) për të pasur konsensusin e Palës Kontraktuese ku vihen në dispozicion informacionet për identifikimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave të tjera penale. Ky konsensus mund të mohohet vetëm atëherë kur çështja në fjalë mund të verë në rrezik hetimet penale të Palës Kontraktuese të interesuar ose atëherë kur kjo e fundit mund të refuzojë asistencën juridike të përdorur për këtë qëllim;

c) për të eliminuar një kërcënim të menjëhershëm dhe të rëndë ndaj sigurisë publike, duke mos e dëmtuar germën "b" në rastin kur do të niset një hetim penal i mëtejshëm;

d) për qëllime të tjera brenda kufijve për të cilat është rënë dakord nga Palët Kontraktuese që janë pjesë përbërëse e skuadrës.

11. Neni në fjalë nuk prek asnjë nga dispozitat e tjera në fuqi apo marrëveshje lidhur me krijimin, apo veprimtarinë e skudrave të përbashkëta hetimore.

Neni 11
Infiltrimet

1. Palët Kontraktuese mund të bien dakord të bashkëpunojnë ndërmjet tyre për zhvillimin e hetimeve në fushën e kriminalitetit, me anë të personave të infiltruar ose nën identitete të rreme (infiltrimet).

2. Vendimi mbi kërkesën merret në secilin rast specifik nga autoritet kompetente të palës së pyetur në përputhje me të drejtën dhe procedurat në nivel kombëtar. Kohëzgjatja e operacionit të infiltrimit, kushtet e posaçme dhe statusi ligjor i agjentëve të përfshirë gjatë operacionit të infiltrimit caktohen nga palët në respektim të të drejtës së tyre dhe të procedurave të tyre të brendshme.

3. Operacionet e infiltrimit kryhen në përputhje me të drejtën dhe procedurat e brendshme të Palëve Kontraktuese në territorin e të cilës zhvillohet operacioni. Palët Kontraktuese bashkëpunojnë për të kryer përgatitjen dhe kontrollin e operacionit të infitrimit dhe për të ndërmarrë vendime me qëllim garantimin e sigurisë së agjentëve të infiltruar apo nën identitet falco.

Neni 12
Përgjegjësia penale në lidhje me funksionarët

Gjatë zhvillimit të operacioneve për të cilat flasin nenet 9, 10 e 11, funksionarët e palës së kundërt nga pala në të cilën zhvillohet operacioni njësohen me funksionarët e kësaj të fundit, përsa i përket veprave penale kundër tyre, apo të kryera nga ata.

Neni 13
Përgjegjësia civile në lidhje me funksionarët

1. Kur në përputhje me nenet 9, 10 e 11, funksionarët e njërës Palë Kontraktuese veprojnë te tjetra, e para është përgjegjëse për dëmet e shkaktuara nga ajo në përmbushjen e misionit, konform të drejtës së Palës Kontraktuese në territorin në të cilën ata veprojnë.

2. Pala në territorin e së cilës janë shkaktuar dëme të parashikuara nga paragrafi 1, kryen riparimin e dëmeve sipas kushteve që ekzistojnë për dëmet e shkaktuara nga funksionarët e saj.

3. Pala Kontraktuese, funksionarët e së cilës i kanë shkaktuar dëme të tretëve në terrritorin e palës tjetër, i kthen në mënyrë të plotë shumat e derdhura kësaj pale, viktimave apo familjarëve të tyre.

4. Përveç ushtrimit të të drejtave të tyre kundrejt të tretëve dhe përveç pararagrafit 3, secila Palë Kontraktuese, në rastin e paragrafit 1 heq dorë nga kërkesa drejtuar tjetrës palë mbi dëmshpërblimin e dëmit të pësuar nga ajo.

Neni 14

Kërkesa e informacioneve mbi llogaritë bankare dhe mbi operacionet bankare

1. Sipas kërkesave të këtij neni, secila Palë Kontraktuese adopton dispozitat e nevojshme për të përcaktuar në përgjigje të një kërkese të transmetuar nga pala tjetër, nëse një person fizik apo juridik, objekt i një hetimi penal, ka ose kontrollon një apo më shumë llogari bankare, të çfarëdolloj natyre, pranë një institucioni bankar që ndodhet në territorin e saj, dhe në rast se është kështu, të japë çdo lloj informacioni specifik mbi llogaritë e gjetura.

Informacionet përfshijnë edhe faktin nëse ka ardhur ndonjë kërkesë dhe nëse jepen brenda një periudhe të arsyeshme, edhe llogaritë e hapura nga personi, objekt i procedimit.

2. Detyrimi i parashikuar nga ky nen zbatohet vetëm në masën brenda së cilës detajet në fjalë njihen nga organizmi financiar pranë të cilit është depozituar llogaria.

3. Detyrimi i parashikuar nga ky nen zbatohet vetëm nëse hetimi ka të bëjë me një vepër penale që ndëshkohet me kufizim lirie, me një maksimum prej të paktën katër vjetësh në palën kërkuese, dhe me të paktën dy vjet në palën e pyetur.

4. Në kërkesë, autoriteti kërkues:

a) tregon arsyet përse konsideron se informacionet e kërkuara janë të një rëndësie themelore për arritjen e qëllimeve të hetimit të veprës penale;

b) tregon mbi ç'arsye prezumon se llogaritë bankare mbahen pranë bankave të ndodhura në palën e pyetur, dhe prej sa kohësh është në dijeni të këtij fakti, cilat banka mund të jenë të përfshira;

c) jep çfarëdolloj informacioni që disponon dhe që mund të lehtësojë zbatimin e kërkesës.

5. Pas marrjes së kërkesës nga pala kërkuese, pala e pyetur ofron detajet e llogarive bankare mbi të cilat kërkohet informacion, dhe mbi veprimet bankare që janë kryer brenda një periudhe të caktuar, mbi një apo më shumë llogari të përcaktuara në kërkesë, përfshirë këtu edhe detajet e lidhura me llogari të mundshme emetuese (dhënëse) apo përfituese.

6. Detyrimi i parashikuar në paragrafin e mëparshëm zbatohet vetëm në masën brenda së cilës detajet në fjalë janë të njohura nga organizmi financiar pranë të cilit është depozituar llogaria.

7. Pala kërkuese shpjegon në kërkesën e saj arsyet pse konsideron se informacionet e kërkuara janë të dobishme për qëllimet e hetimeve mbi veprën penale.

8. Për ekzekutimin e një kërkese të parashikuar nga ky nen, Palët Kontraktuese mund të zbatojnë të njëjtat kushte që zbatojnë edhe për kërkesat e kontrolleve dhe sekuestrimeve.

Neni 15

Kërkesat për verifikimin e veprimeve bankare

1. Secila Palë Kontraktuese merr përsipër që, pas marrjes së një kërkese, të jetë në gjendje të ushtrojë kontroll, gjatë një periudhe të caktuar mbi veprimet bankare që janë kryer në një apo më shumë llogari bankare të përcaktuara në kërkesë, dhe t'i japë rezultatet përkatëse palës kërkuese.

2. Pala kërkuese tregon në kërkesën e saj arsyet përse i konsideron se informacionet e kërkuara janë të domosdoshme për hetimin e veprës penale në fjalë.

3. Vendimi për të ushtruar kontroll merret në secilin rast specifik nga organet kompetente të palës së pyetur, duke mbajtur në konsideratë dispozitat e së drejtës së saj të brendshme.

4. Mënyrat praktike të kontrollit koordinohen me organet kompetente të Palëve Kontraktuese.

Neni 16
Konfidencialiteti

Palët Kontraktuese adoptojnë masat e nevojshme për të siguruar që bankat nuk do t'u zbulojnë klientëve të interesuar apo palëve të treta faktin që është kryer një transmetim informacionesh në përputhje me dispozitat e neneve 14 dhe 15, apo që është duke u zhvilluar një hetim.

Neni 17
Sekreti bankar

Palët Kontraktuese nuk e përdorin sekretin bankar si arsye për të refuzuar bashkëpunimin pas marrjes së një kërkese për ndihmë juridike në kuptimin e kësaj Marrëveshjeje.

TITULLI III
DISPOZITA LIDHUR ME EKSTRADIMIN E SHTETASVE

Neni 18
Ekstradimet e shtetasve

1. Palët Kontraktuese marrin përsipër, në mënyrë të ndërsjellë, të dorëzojnë shtetasit e tyre që ndodhen në ndjekje penale nga njëra prej tyre për kryerjen e veprave penale, ose që janë shpallur në kërkim për vuajtjen e dënimit apo të një mase shtrënguese, në përputhje me normat dhe kërkesat e Konventës Europiane mbi Ekstradimin.

2. Palët Kontraktuese nuk mund të ngrenë shtetësinë si arsye për refuzimin e dorëzimit.

3. Kërkesat për ekstradimin bëhen drejtpërdrejt midis autoriteteve qendrore: për Republikën e Italisë nga Drejtoria e Përgjithshme e Drejtësisë Penale, zyra II, pranë Ministrisë së Drejtësisë; për Republikën e Shqipërisë nga Ministria e Drejtësisë Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë.

TITULLI IV
DISPOZITA LIDHUR ME TRANSFERIMET E PROCEDIMEVE PENALE

Neni 19
Transferimet e procedimeve penale

Palët Kontraktuese marrin përsipër të rregullojnë transferimin e procedimeve penale mbi bazën e Konventës mbi Transferimet e Procedimeve Penale, hapur për firmë në Strasburg, më 15 maj 1972.

TITULLI V
MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 20
Parime të përgjithshme

1. Përsa i përket trajtimit të të dhënave personale që do të transmetohen nga Palët Kontraktuese në bazë të kësaj Marrëveshjeje, palët kontraktuese garantojnë se dispozitat përkatëse të së drejtës së brendshme ofrojnë një nivel mbrojtjeje të dhënash i cili është i barabartë të paktën me nivelin e kërkuar nga Konventa e Këshillit të Europës, e 28 janarit 1981, mbi mbrojtjen e personave në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave me karakter personal.

2. Në çdo rast kjo Marrëveshje nuk paragjykon detyrimet e caktuara në ngarkim të shteteve Palë Kontraktuese lidhur me marrëveshje të tjera shumëpalëshe ekzistuese apo të ardhshme, në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, përfshirë këtu edhe instrumentet e adoptuar nga Bashkimi Europian në fuqi, në nenin 34 paragrafi 2 i Traktatit Themelues të BE-së.

Neni 21

Trajtimi i të dhënave personale

1. Përveç sa është parashikuar nga neni 22, të dhënat personale të transmetuara mbi bazën e kësaj Marrëveshjeje mund të përdoren nga Pala Kontraktuese tek e cila janë transferuar:

a) për llogari të procedimeve mbi të cilat zbatohen dispozitat e kësaj Marrëveshjeje;

b) për procedime të tjera gjyqësore dhe administrative të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me procedimet e germës "a";

c) për parandalimin e një rreziku imediat dhe të rëndë për sigurinë publike;

ç) për çfarëdolloj qëllimi tjetër, vetëm pas marrjes së autorizimit nga Pala Kontraktuese që transmeton të dhënat, përveç rastit kur pala e interesuar ka marrë aprovimin e personit të interesuar.

2. Ky nen gjen zbatim edhe për të dhënat personale që nuk janë transmetuar, por që janë mbajtur me mënyra të ndryshme në zbatim nga kjo Marrëveshje.

3. Në varësi të rrethanave të rastit specifik, Pala Kontraktuese që transmeton të dhënat mund t'i kërkojë Palës Kontraktuese tek e cila të dhënat kanë qenë transferuar, të japë informacione mbi përdorimin e të dhënave.

4. Ky nen nuk gjen zbatim për të dhëna personale të përfituara nga njëra prej Palëve Kontraktuese në kuptim të kësaj Marrëveshjeje, dhe të ardhura nga kjo palë.

Neni 22

Mbrojtja e të dhënave në fushën e shkëmbimit të informacioneve

1. Në aktin e shkëmbimit të informacioneve, në çdo rast, organet kompetente gjyqësore marrin në konsideratë kërkesat për mbrojtjën e të dhënave me karakter personal. Këto respektojnë dispozitat në fuqi të Konventës së Këshillit të Europës, të datës 28 janar 1981, mbi mbrojtjen e personave lidhur me përpunimin automatik të të dhënave me karakter personal. Me qëllimin e mbrojtjes së të dhënave, organet gjyqësore kompetente, në zbatim të dispozitës së paragrafit 2, mund të vendosin kushte për trajtimin e të dhënave me karakter personal nga ana e Palës Kontraktuese tek e cila këto të dhëna janë transmetuar.

2. Kur në zbatim të kësaj Marrëveshjeje transmetohen të dhëna me karakter personal, aplikohen dispozitat në vijim:

a) Trajtimi i të dhënave personale nga ana e organit marrës, pranohet vetëm kur është për arsyet e paraqitura në nenin 5. Ky organ mund t'i transmetojë pa aprovimin paraprak të Palës Kontraktuese që ka furnizuar informacionet, tek organet përgjegjëse për veprimtarinë hetimore dhe tek organet gjyqësore me qëllim ndjekjen dhe shtypjen e veprave penale. Në të gjitha rastet e tjera të transmetimit është i nevojshëm aprovimi i Palës Kontraktuese që ka furnizuar informacionet.

b) Gjatë transmetimit të të dhënave, organi gjyqësor i Palës Kontraktuese kujdeset për korrektësinë dhe nivelin e përditësimit. Kurdoherë që mund të besohet se janë transmetuar të dhëna të pasakta, ose të dhëna të cilat nuk duhet të ishin komunikuar, apo të dhëna të transmetuara në mënyrë legjitime duhet që në një moment të caktuar të fshihen në përputhje me dispozitat e ligjit të Palës Kontraktuese që i ka komunikuar (dhënë), atëherë organi marrës informohet pa vonesë. Ky organ ka detyrimin të procedojë me korrigjimet e të dhënave në fjalë ose t'i fshijë ato. Nëse organi marrës ka arsye të besojë se të dhënat e komunikuara janë të pasakta ose duhen fshirë, bën me dije Palën Kontraktuese që i ka komunikuar.

c) Nëse të dhënat e komunikuara duhet të fshihen apo korrigjohen në përputhje me dispozitat e legjislacionit të Palës Kontraktuese që i ka komunikuar, personi i intersuar duhet të disponojë të drejtën efektive të korrigjimit.

d) Organet gjyqësore të interesuara procedojnë me regjistrimin e transmetimit, dhe me marrjen e të dhënave të shkëmbyera.

e) Nëse kërkohet, organet gjyqësore që transmetojnë dhe marrin të dhënat, duhet të vënë në dispozicion të të interesuarit informacione lidhur me të dhënat e tij personale të transmetuara, si dhe mbi përdorimin që parashikohet të bëhet. Detyrimi për të ofruar informacione nuk ekziston më kur konsiderohet se interesi publik për mosdhënien e informacioneve është mbi intereresin e personit të interesuar për t'i marrë. Për më tej, e drejta e të interesuarit për të marrë informacione lidhur me të dhënat personale të transmetuara rregullohet nga ligjet, nga rregulloret, dhe nga procedurat e brendshme të vendeve kontraktuese palë, në territorin e të cilave drejtohet kërkesa për informacion. Para se të merret vendimi lidhur me komunikimin e informacioneve, organi që transmeton të dhënat, duhet të ketë mundësinë të shprehë mendimin e tij.

f) Sipas dispozitave të ligjit, të rregulloreve dhe procedurave të brendshme, Palët Kontraktuese janë përgjegjëse për dëmet e shkaktuara kundrejt personave, për rrjedhojë të përpunimit të të dhënave në Palën Kontraktuese të interesuar. Ato konsiderohen përgjegjëse atëherë kur dëmi është shkaktuar nga transmetimi i të dhënave të pasakta, ose nga një transmetim nga ana e organeve gjyqësore që është kryer në dhunim të dispozitave të konventës.

g) Të dhënat e transmetuara ruhen vetëm për një periudhë të nevojshme për qëllim të komunikimit të tyre. Pala Kontraktuese e interesuar, vlerëson në kohën e duhur nevojën për ruajtjen e të dhënave.

h) Në çdo rast, mbi të dhënat ushtrohet mbrojtje të paktën në nive1in e mbrojtjes që pala marrëse i jep të dhënave analoge.

i) Palët Kontraktuese kërkojnë marrjen e masave të duhura për të garantuar dhe respektuar këtë dispozitë me anë të kontrolleve të efektshme. Palët Kontraktuese mund të transferojnë të tilla detyra kontrolli edhe tek organet e brendshme mbikëqyrëse.

TITULLI VI
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 23
Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e parë të muajit vijues pas marrjes së njoftimit të dytë nga të dy njoftimet me të cilat palët njoftojnë përfundimin e procedurave të brendshme përkatëse.

2. Kjo Marrëveshje mund të kundërshtohet me shkrim në çdo moment. Kundërshtimi merr efekt nga dita e parë e muajit të gjashtë pas ditës në të cilën Pala tjetër Kontraktuese do të marrë njoftimin përkatës.

3. Kjo Marrëveshje pushon së qëni në fuqi edhe pa kundërshtimin e përmendur në paragrafin e mësipërm, nga data në të cilën Konventa për Ndihmë Juridike në Fushën Penale dhe Konventa Europiane mbi Ekstradimet, nuk do të kenë më efekte ndërmjet Palëve Kontraktuese. Në prani të njëri-tjetrit, të nënshkruarit, duke qenë plotësisht të autorizuar për këtë nga qeveritë përkatëse të tyre, firmosën këtë Marrëveshje.

LIGJ
Nr.10 039, datë 22.12.2008

PËR NDIHMËN JURIDIKE

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj përcakton kushtet, llojin, mënyrën dhe procedurat për dhënien e ndihmës juridike nga shteti, për mbrojtjen e lirive e të të drejtave themelore të individit, si dhe të interesave të tjerë të ligjshëm të tij.

Neni 2
Parimet themelore për dhënien e ndihmës juridike

Dhënia e ndihmës juridike nga shteti për individët mbështetet në parimet:
a) e barazisë së të drejtave për të gjithë individët, që përfitojnë nga ndihma juridike;
b) e profesionalizmit të personave, që japin ndihmën juridike;
c) e cilësisë, efiçencës dhe efektivitetit të shërbimit të ndihmës juridike;
ç) e ruajtjes së konfidencialitetit;
d) e papranueshmërisë së konfliktit të interesit.

KREU II
ADMINISTRIMI I SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE

Neni 3
Administrimi

Shërbimi i ndihmës juridike për individët, të dhënë nga shteti, është përgjegjësi e Ministrisë së Drejtësisë, e Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe e Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike.

Neni 4
Detyrat e Ministrisë së Drejtësisë

Ministria e Drejtësisë, në fushën e shërbimit të ndihmës juridike për individët, kryen këto detyra:

a) zhvillon politikën shtetërore;

b) ndihmon në përgatitjen e akteve të nevojshme ligjore/nënligjore, në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Avokatisë dhe Komisionin Shtetëror për Ndihmën Juridike;

c) kujdeset për zbatimin e dispozitave ligjore e nënligjore dhe ndihmon në vlerësimin e cilësisë së ndihmës juridike të dhënë;

ç) përgatit projektbuxhetin, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 5
Detyrat e Dhomës Kombëtare të Avokatisë

Dhoma Kombëtare e Avokatisë, në fushën e shërbimit të ndihmës juridike për individët, kryen këto detyra:

a) merr pjesë në përcaktimin e kritereve për përzgjedhjen e avokatëve, që do të japin këtë ndihmë;

b) merr pjesë në përcaktimin e kritereve për vlerësimin e cilësisë së shërbimit të dhënë nga avokatët;

c) merr masa disiplinore ndaj avokatëve, që japin ndihmë juridike, në përputhje me ligjin nr.9109, datë 17.7.2003 "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Neni 6
Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike

1. Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike është organ shtetëror kolegjial dhe ka statusin e personit juridik publik.

2. Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilët njëri zgjidhet nga Ministri i Drejtësisë, njëri nga Ministri i Financave, njëri nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, i katërti nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe i pesti nga organizatat jofitimprurëse, që veprojnë në fushën e ndihmës ligjore. Anëtari nga organizatat jofitimprurëse zgjidhet prej 4 anëtarëve të zgjedhur më sipër, nga lista e kandidatëve të propozuar nga këto organizata.

3. Mandati i anëtarëve të komisionit është 4-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje të menjëhershme vetëm një herë.

4. Komisioni është organ kolegjial, me kohë të pjesshme, me përjashtim të kryetarit, i cili është funksionar me kohë të plotë.

5. Asistenca teknike, logjistike dhe financiare sigurohen nga sekretariati i komisionit.

6. Komisioni organizohet dhe funksionon sipas rregullores së brendshme, që propozohet prej tij dhe miratohet nga Ministri i Drejtësisë.

7. Paga e kryetarit të komisionit është e njëjtë me pagën e zëvendësministrit, ndërsa shpërblimi i anëtarëve, struktura e komisionit, organika dhe niveli i pagave të sekretariatit caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 7
Kushtet për t'u zgjedhur anëtar i komisionit dhe kryetar i tij

1. Anëtar i komisionit mund të zgjidhet personi që:

a) ka shtetësi shqiptare;

b) ka zotësi të plotë për të vepruar;

c) ka mbaruar arsimin e lartë juridik, ekonomik ose menaxhim publik;

ç) gëzon një figurë të pastër morale dhe përgatitje të lartë profesionale;

d) ka një përvojë jo më pak se 5 vjet në profesion.

2. Kryetari i komisionit emërohet në detyrë me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, pasi është marrë më parë mendimi i Këshillit Drejtues të Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

Kryetari i komisionit duhet të ketë arsim të lartë juridik.

3. Kryetari i komisionit lirohet nga detyra me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, me propozimin e Këshillit Drejtues të Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

4. Detyra e kryetarit është e papajtueshme me çdo detyrë tjetër shtetërore ose private.

Neni 8
Lirimi i anëtarëve të komisionit

Lirimi nga detyra i anëtarit të Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike bëhet nga organi që e ka emëruar kur:

a) jep dorëheqjen;

b) mbush moshën e pensionit;

c) dënohet me vendim gjyqësor penal të formës së prerë;

ç) ndërpret marrëdhëniet e punës me institucionin që e ka emëruar;

d) nuk merr pjesë, pa arsye, në më shumë se tri mbledhje rresht të komisionit;

dh) i mbaron mandati i qëndrimit në detyrë.

Neni 9
Fuqia detyruese e vendimeve

Vendimet e marra nga Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike janë detyruese për zbatim nga avokatët që japin ndihmën juridike, sipas këtij ligji. Në rast të moszbatimit të tyre, komisioni ka të drejtë të kërkojë marrjen e masave disiplinore ndaj avokatëve, sipas ligjit nr.9109, datë 17.7.2003 "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Neni 10
Detyrat e komisionit

Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike kryen këto detyra:

a) zbaton politikën shtetërore në dhënien e ndihmës juridike për individët;

b) menaxhon buxhetin e dhënë për ofrimin e ndihmës juridike nga shteti;

c) miraton rregullat e caktimit të avokatëve, zyrave të avokatisë dhe organizatave jofitimprurëse, që do të ofrojnë ndihmën juridike dhe kujdeset për zbatimin e tyre;

ç) vlerëson kostot dhe planifikon shpenzimet për ofrimin, nga ana e shtetit, të ndihmës juridike dhe ia paraqet Ministrit të Drejtësisë, për t'u përfshirë në Buxhetin e Shtetit;

d) lidh kontratat e shërbimit me avokatët, zyrat e avokatisë dhe organizatat jofitimprurëse, që do të ofrojnë shërbimin e ndihmës juridike;

dh) vendos masën e shpërblimit të avokatëve në ofrimin e ndihmës juridike ndaj individëve, pasi të ketë marrë më parë mendimin e Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Drejtësisë, por, në çdo rast, shpërblimet duhet të jenë jo më të vogla se tarifat e miratuara për shërbimin e avokatisë;

e) paraqet, në fund të çdo viti, raportin vjetor para Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të Financave dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë, si dhe raporton sa herë që i kërkohet;

ë) përcakton dhe rishikon standardet e ndihmës juridike, si dhe kujdeset për trajnimet profesionale për avokatët që japin këtë ndihmë;

f) bashkëpunon me organizatat ndërkombëtare dhe organizatat jofitimprurëse, vendase ose të huaja, që veprojnë në fushën e ndihmës juridike;

g) vendos kriteret, në bazë të të cilave do të vlerësohet cilësia e shërbimit të ndihmës juridike të dhënë;

gj) mban të dhëna për personat, që përfitojnë ndihmë juridike dhe boton, në fund të çdo viti, buletinin statistikor për to;

h) merr vendim dhe urdhëron kryerjen e pagesës së avokatëve për dhënien e ndihmës juridike, pas paraqitjes së dokumenteve, që përcaktohen me vendim të veçantë;

i) cakton përparësitë për çështjet, për të cilat ofrohet ndihmë juridike, me kufizimet e imponuara për shkak të burimeve dhe mjeteve financiare në dispozicion;

j) bashkërendon sistemin e ndihmës juridike, duke përfshirë ofrimin e saj në të gjitha format.

KREU III
SHËRBIMET E NDIHMËS JURIDIKE DHE PËRFITUESIT E SAJ

Neni 11
Ndihma juridike dhe përfituesit

1. Ndihma juridike nga shteti jepet nga avokatët e autorizuar, sipas këtij ligji, në kushtet e përcaktuara në këtë ligj dhe në formën e ndihmës juridike parësore e të ndihmës juridike dytësore.

Ndihma juridike parësore është dhënia e informacionit për sistemin ligjor në Republikën e Shqipërisë, për aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit, mënyrat e ushtrimit të të drejtave të individit, në proceset gjyqësore dhe ato jashtëgjyqësore, si dhe dhënia e asistencës në hartimin e dokumenteve juridike apo në forma të tjera.

Ndihma juridike dytësore është dhënia e shërbimeve të këshillimit, përfaqësimit apo mbrojtjes në proceset gjyqësore penale, proceset gjyqësore civile dhe administrative, si dhe të paraqitjes para organeve administrative shtetërore.

2. Ndihma juridike jepet edhe nëpërmjet edukimit ligjor të publikut, përmes ndihmës që i ofrohet komunitetit me klinika lëvizëse, publikime, fushata televizive dhe në medien e shkruar, si dhe masa të tjera të ngjashme, duke u kushtuar vëmendje të veçantë problemeve të grupeve më në nevojë.

Neni 12
Format e dhënies së ndihmës juridike

Ndihma juridike jepet nëpërmjet:

a) sigurimit të informacionit, dhënies së këshillimeve dhe shpjegimeve të çështjeve juridike, intervistave të drejtpërdrejta apo komunikimit në distancë;

b) plotësimit të akteve juridike;

c) këshillimit në vazhdimësi të personave që paraqiten vetë në gjykatë;

ç) përfaqësimit para organeve administrative;

d) mbrojtjes dhe përfaqësimit te interesave të të dyshuarit, të të akuzuarit dhe të të dëmtuarit në procesin penal;

dh) mbrojtjes dhe përfaqësimit të interesave të personave në çështjet civile ose administrative.

Neni 13
Personat që kanë të drejtë të përfitojnë ndihmë juridike

1. Të drejtën për të përfituar ndihmë juridike e kanë personat, të cilët:

a) kërkojnë të mbrohen me avokat në procesin penal në të gjitha fazat e tij dhe, për shkak të pamundësive financiare, nuk kanë mundur të zgjedhin një avokat apo kanë mbetur pa të;

b) kanë nevojë për ndihmë juridike në çështjet civile ose administrative, por nuk kanë mjete të mjaftueshme për ta paguar këtë ndihmë juridike apo çështjet janë tepër komplekse, nga ana e përmbajtjes dhe e procedurës. Në këtë rast, personi, që ta përfitojë ndihmën juridike, duhet të vërtetojë se përfshihet në programet e mbrojtjes sociale ose plotëson kushtet për t'u përfshirë në to.

2. Ndihmën juridike e përfitojnë edhe të miturit, për të cilët mbrojtja në procedimin penal dhe në gjykim është e detyrueshme me ligj.

3. Ndihma juridike mund të kërkohet para, gjatë dhe pas zhvillimit të procesit gjyqësor.

4. Personi, i cili përfiton ndihmë juridike, ka detyrimin të bashkëpunojë me avokatin, që siguron ndihmën juridike, të japë informacion të vërtetë, për të cilin është kërkuar ndihma juridike, si dhe të sigurojë në kohë çdo informacion për rrethanat dhe kushtet, që kanë ndryshuar shkakun e dhënies së ndihmës.

5. Moszbatimi i pikës 4 të këtij neni nga personi, që përfiton ndihmën juridike për çështjet civile ose administrative, përbën shkak për ndërprerjen e menjëhershme të përfitimit të kësaj ndihme juridike.

Neni 14
Kthimi i shpenzimeve për ndihmën juridike të dhënë

1. Në rast se përfituesi i ndihmës juridike, në përfundim të procesit gjyqësor, përfiton rimbursimin e shpenzimeve gjyqësore të parapaguara, ai detyrohet t'i kthejë Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike shpenzimet e kryera nga ky i fundit, për ofrimin e ndihmës juridike në çështjen përkatëse.

2. Personi që ka përfituar ndihmë juridike, duke paraqitur të dhëna të rreme ose të pavërteta, përfshirë edhe të dhënat për gjendjen e tij financiare, është i detyruar të kthejë të gjitha shpenzimet e kryera për ofrimin e kësaj ndihme.

3. Kthimi i shpenzimeve, sipas pikës 2 të këtij neni, bëhet sipas urdhrit të lëshuar nga Kryetari i Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike. Urdhri i kryetarit të komisionit përbën titull ekzekutiv dhe ngarkohet shërbimi i përmbarimit gjyqësor për ekzekutimin e tij.

Neni 15
Ofrimi i ndihmës juridike

1. Ndihma juridike në çështjet civile dhe administrative jepet duke pasur parasysh:

a) vlerën relative të ankesës apo pasurisë së përfshirë;

b) bazueshmërinë në ligj të argumenteve ligjore dhe pretendimeve, të cilat paraqiten në emër të kërkuesit apo përfituesit;

c) mundësinë e suksesit të ankesës apo të mbrojtjes;

ç) kompleksitetin e çështjes;

d) aftësinë e kërkuesit apo të përfituesit, që të vetëpërfaqësohet.

2. Dhënia e ndihmës juridike nuk refuzohet në çështjet penale, parashikuar nga pika 1 shkronja "a" dhe pika 2 e nenit 13 të këtij ligji.

KREU IV
PROCEDURA PËR DHËNIEN E NDIHMËS JURIDIKE

Neni 16
Paraqitja e kërkesës

1. Kërkesa për dhënien e ndihmës juridike, në formën e përfaqësimit në gjykatë, për një çështje civile ose administrative, duhet të paraqitet personalisht nga kërkuesi apo përfaqësuesi i tij, i autorizuar me prokurë. Formulari i kërkesës dhe dokumentet shoqëruese përcaktohen me vendim te Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike.

2. Kërkesa për dhënien e ndihmës juridike në format e tjera, të parashikuara në nenin 12 të këtij ligji, nuk i nënshtrohet asnjë forme. Ajo mund të paraqitet edhe gojarisht te personi i autorizuar për dhënien e ndihmës juridike apo për caktimin e ofruesit të kësaj ndihme.

3. Rregullat e hollësishme në zbatim të pikave 1 e 2 të këtij neni, për paraqitjen e kërkesave, përcaktohen nga Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike.

Neni 17
Refuzimi i dhënies së ndihmës juridike

1. Organi, që ka të drejtën e refuzimit të dhënies së ndihmës juridike, është Kryetari i Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike. Ndaj vendimit të kryetarit mund të bëhet ankim në

Komisionin Shtetëror për Ndihmën Juridike brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të tij.

2. Kundër vendimit të refuzimit të dhënies së ndihmës juridike mund të bëhet ankim në gjykatën që ka kompetencë gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Neni 18

Vendimi i refuzimit të dhënies së ndihmës juridike

1. Vendimi për refuzimin e dhënies së ndihmës juridike duhet të përmbajë:

a) datën dhe vendin e vendimit;

b) emrin dhe mbiemrin e kërkuesit;

c) formën e ndihmës juridike të kërkuar;

ç) arsyet e refuzimit të dhënies së ndihmës juridike;

d) procedurën e ankimit;

dh) të dhëna të tjera të nevojshme.

2. Avokati i caktuar për të dhënë ndihmën juridike mund të zëvendësohet nga komisioni:

a) nëse paraqitet kërkesa me shkrim nga vetë personi i interesuar për zëvendësimin e tij;

b) me kërkesë të avokatit të caktuar për dhënien e ndihmës juridike;

c) në rast të konfliktit të interesit.

Neni 19

Bashkëpunimi me organizatat jofitimprurëse

1. Organizatat jofitimprurëse, të specializuara në fushën e dhënies së ndihmës juridike, japin ndihmë juridike me avokatë, duke respektuar përcaktimet e bëra në këtë ligj.

2. Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike lidh kontratë bashkëpunimi me këto organizata, për të mundësuar dhënien e ndihmës juridike, në përputhje me format dhe kushtet e parashikuara nga ky ligj.

Neni 20

Avokatët që japin ndihmë juridike

1. Ndihma juridike parësore dhe ndihma juridike dytësore jepen vetëm nga personat që ushtrojnë profesionin e avokatit.

2. Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike përcaktojnë listën e avokatëve që autorizohen, në përputhje me këtë ligj, të japin ndihmë juridike, si dhe vendin e shtrirjes së veprimtarisë së tyre. Nëse është e nevojshme, komisioni dhe Dhoma Kombëtare e Avokatisë mund të organizojnë konkurs për përcaktimin e avokatëve që do të japin ndihmë juridike.

3. Lista e avokatëve, që autorizohen për dhënien e ndihmës juridike, bëhet publike.

Neni 21

Kontrolli i cilësisë së ndihmës juridike

1. Kontrolli i cilësisë së ndihmës juridike të ofruar realizohet nga Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike. Me kërkesë të të interesuarit, kryesisht apo me kërkesë të Ministrit të Drejtësisë, komisioni verifikon dhe kontrollon cilësinë e ndihmës juridike për një rast konkret dhe, në bazë të rezultateve, ka të drejtë të zgjidhë kontratën e shërbimit me avokatin e autorizuar për dhënien e ndihmës juridike.

2. Forma dhe standardet e kontrollit miratohen me vendim të Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike.

3. Rezultatet e kontrollit i dërgohen Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe mund të shërbejnë si bazë për marrjen e masave disiplinore ndaj avokatëve.

KREU V
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 22
Buxheti

1. Dhënia e ndihmës juridike parësore dhe e ndihmës juridike dytësore përballohen nga Buxheti i Shtetit ose edhe nga burime të tjera të ligjshme.
2. Fondet për dhënien e ndihmës juridike përbëjnë zë të veçantë në buxhetin e Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike.

Neni 23

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikës 7 të nenit 6 të këtij ligji.

Neni 24
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 3 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5997, datë 12.1.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.199, faqe 10821

LIGJ
Nr.10 071, datë 9.2.2009

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SË KËSHILLIT TË EUROPËS PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE NGA SHFRYTËZIMI DHE ABUZIMI SEKSUAL

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet konventa e Këshillit të Europës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6072, datë 27.2.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.21, faqe 1353

KËSHILLI I EUROPËS
SERIA E TRAKTATEVE TË KËSHILLIT TË EUROPËS – NR.201

KONVENTA E KËSHILLIT TË EUROPËS PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE NGA SHFRYTËZIMI SEKSUAL DHE ABUZIMI SEKSUAL

Lanzarote, 25.10.2007

Preambulë

Vendet anëtare të Këshillit të Europës dhe vende të tjera që e firmosin këtë Konventë,

duke pasur parasysh se qëllimi i Këshillit të Europës është që të arrijë një unitet më të madh midis anëtarëve të tij;

duke pasur parasysh se çdo fëmijë ka të drejtë për masa të tilla mbrojtëse siç i kërkon statusi i tij /e saj si i/e mitur, nga ana e familjes së tij ose të saj, nga shoqëria dhe shteti;

duke konstatuar se shfrytëzimi seksual i fëmijëve, në veçanti pornografia dhe prostitucioni i fëmijëve në të gjitha format e abuzimit seksual me fëmijët, duke përfshirë dhe aktet, që kryhen jashtë shtetit, janë shkatërruese për shëndetin e fëmijës dhe zhvillimin e tij psikosocial;

duke konstatuar se shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual i fëmijëve janë rritur në përmasa shqetësuese si në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, në veçanti në lidhje me përdorimin në rritje si nga fëmijët, dhe nga personat të cilët kanë kryer një nga veprat penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë, të teknologjive të informacionit dhe komunikimit (ICT) dhe që parandalimi kundër shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual të fëmijëve kërkon bashkëpunim ndërkombëtar;

duke pasur parasysh se mirëqenia dhe interesat më të mira të fëmijëve janë vlerat themelore, që ndajnë të gjitha vendet anëtare dhe që duhet të promovohen pa asnjë diskriminim;

duke rikujtuar planin e veprimit, të miratuar mbledhjen e tretë nivelit të lartë të krerëve të shteteve dhe qeverive të Këshillit të Europës (Varshavë, 16-17 maj 2005), që bëri thirrje për marrjen masave për të ndaluar shfrytëzimin seksual të fëmijëve;

duke rikujtuar në veçanti rekomandimin e Komitetit të Ministrave nr.R (91)11, në lidhje me shfrytëzimin seksual, pornografinë dhe prostitucionin, dhe trafikimin e fëmijëve dhe të adoleshentëve, rekomandimin Rec (2001)16 për mbrojtjen e fëmijëve kundër shfrytëzimit seksual, dhe Konventën për krimin kibernetik (ETS nr.185), veçanërisht nenin 9 të saj si dhe Konventën e Këshillit të Europës për veprimin kundër trafikimit të qenieve njerëzore (CETS nr.197);

duke pasur parasysh Konventën për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore (1950, ETS Nr.5), kartën europiane sociale të rishikuar (1996, ETS nr.163), dhe Konventën Europiane për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve (1996, ETS nr.160);

duke pasur parasysh gjithashtu Konventën e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijëve, veçanërisht nenin 34 të saj, protokollin me opsion për shitjen e fëmijëve, prostitucionin e fëmijëve dhe pornografinë e fëmijëve, protokollin për të parandaluar, për të shtypur trafikimin e personave, veçanërisht të grave dhe të fëmijëve, duke plotësuar Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional, si dhe Konventën e Organizatës Ndërkombëtare të Punës në lidhje me ndalimin dhe veprimin imediat për eliminimin e formave më të këqija të punës së fëmijëve;

duke pasur parasysh vendimin kuadër të Këshillit të Bashkimit Europian për luftën ndaj shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë së fëmijëve (2004/68/JHA), vendimin kuadër të Këshilli të Bashkimit Europian për objektivat aktuale në procedimet kriminale (2001/220/JHA) dhe vendimin kuadër të Këshillit të Bashkimit Europian për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore (2002/629/JHA);

duke marrë mirë parasysh instrumentet dhe programet e tjera përkatëse ndërkombëtare në këtë fushë, veçanërisht deklaratën e Stokholmit dhe agjendën për veprim e miratuar në Kongresin e Parë Botëror kundër Shfrytëzimit Seksual Komercial të Fëmijëve (27-31 gusht 1996), angazhimin

global te Jokohamas, miratuar në Kongresin e Dytë Botëror kundër Shfrytëzimit Seksual Komercial të Fëmijëve (17-20 dhjetor 2001), angazhimin e Budapestit dhe planin e veprimit, miratuar në konferencën përgatitore për Kongresin e Dytë Botëror Kundër Shfrytëzimit Komercial Seksual të Fëmijëve (20-21 nëntor 2001), rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara S-27/2 "Një botë e përshtatshme për fëmijët" dhe programin trevjeçar "Ndërtimi i një Europe për dhe me fëmijët", miratuar pas samitit të tretë dhe i shpallur në Konferencën e Monakos (4-5 prill 2006);

të vendosur për të kontribuar efektivisht për një qëllim të përbashkët për mbrojtjen e fëmijëve kundër shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual, kushdo qoftë personi i cili ka kryer një nga veprat penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë, dhe për t'u dhënë asistencë viktimave;

duke marrë parasysh nevojën për të përgatitur instrumentet ndërkombëtare që të përqëndrohet në aspekte ligjore parandaluese, mbrojtëse dhe të legjislacionit penal për luftën kundër të gjitha formave të shfrytëzimit seksual dhe të abuzimit seksual të fëmijëve duke ndërtuar një mekanizëm specifik monitorimi,

ranë dakord si më poshtë:

KAPITULLI I
QËLLIMET, PARIMET DHE PËRKUFIZIMET E MOSDISKRIMINIMIT

Neni 1
Qëllimet

1. Qëllimet e kësaj Konvente janë:

a) të parandalojë dhe të luftojë shfrytëzimin seksual dhe abuzimin seksual të fëmijëve;

b) të mbrojë të drejtat e fëmijëve viktima të shfrytëzimit seksual dhe të abuzimit seksual;

c) të promovojë bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar kundër shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual të fëmijëve.

2. Në mënyrë që të sigurohet zbatimi efektiv i dispozitave të saj nga palët, kjo Konventë krijon një mekanizëm specifik monitorimi.

Neni 2
Parimi i mosdiskriminimit

Zbatimi i dispozitave të kësaj Konvente nga palët, në veçanti marrja e masave për të mbrojtur të drejtat e viktimave, do të sigurohet pa diskriminim për çfarëdolloj arsyeje si: seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimi politik i një lloji tjetër, origjina kombëtare apo sociale, shoqërimi me një pakicë kombëtare, pasuria, lindja, orientimi seksual, gjendja shëndetësore, aftësia e kufizuar apo ndonjë status tjetër.

Neni 3
Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj Konvente:

a) "fëmijë" do të thotë çdo person nën moshën 18 vjeç";

b) "shfrytëzim seksual dhe abuzim seksual i fëmijëve" do të përfshijë sjelljen siç përmendet në nenet 18- 28 të kësaj Konvente;

c) "viktimë" do të thotë çdo fëmijë që i nënshtrohet shfrytëzimit seksual ose abuzimit seksual.

KAPITULLI II
MASAT PARANDALUESE

Neni 4
Parimet

Çdo palë do të marrë masat e domosdoshme ligjore apo të llojit tjetër për të parandaluar të gjitha format e shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual të fëmijëve dhe për të mbrojtur fëmijët.

Neni 5
Rekrutimi ose trajnimi dhe rritja e njohurive të personave në kontakt me fëmijët

1. Secila palë do të marrë masa të domosdoshme legjislative dhe masa të tjera për të inkurajuar rritjen e njohurive për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve midis personave që kanë kontakte të rregullta me fëmijët në arsim, shëndetësi, mbrojtjen sociale, në sektorët gjyqësorë të zbatimit të ligjit dhe në fusha që lidhen me sportin, kulturën dhe pikat e argëtimit.
2. Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legjislative dhe masat e tjera për të siguruar se personat, që përmenden në paragrafin 1, të kenë njohuri të përshtatshme për shfrytëzimin seksual dhe abuzimin seksual të fëmijëve, të mjeteve për të identifikuar ato dhe mundësinë përmendur në nenin 12, paragrafi 1.
3. Secila palë do të marrë masat e domosdoshme ligjore dhe masa të tjera, në përputhje më ligjin e saj të brendshëm, për të garantuar se kushtet për t'u futur në këto profesione, ushtrimi i të cilave nënkupton kontakte të shumta me fëmijët garantojnë që kandidatët për këto profesione të mos kenë qenë të dënuar për akte të shfrytëzimit seksual apo abuzimit seksual të fëmijëve.

Neni 6
Arsimi për fëmijët

Secila palë duhet të marrë masat e domosdoshme për të siguruar që fëmijët gjatë arsimit fillor dhe të mesëm të marrin informacion për rreziqet e shfrytëzimit seksual të abuzimit seksual, si dhe për mjetet për të mbrojtur vetveten, të përshtatura sipas kapaciteteve të tyre zhvillimore. Ky informacion do të jepet në bashkëpunim me prindërit, ku është e mundur, do të jepet brenda një konteksti më të përgjithshëm të informacionit për seksualitetin dhe do t'u kushtojë vëmendje të veçantë situatave të rrezikut, veçanërisht atyre që përfshijnë përdorimin e teknologjive të reja të informacionit dhe të komunikimit.

Neni 7
Programet ose masat e ndërhyrjes parandaluese

Secila palë do të garantojë që personat të cilët kanë frikë se mund të kryejnë ndonjë prej veprave penale të përcaktuara sipas kësaj Konvente të zhvillojnë, aty ku është e mundur, programe ose masa të ndërhyrjes efektive të planifikuara për të vlerësuar dhe parandaluar rrezikun e veprave penale, si dhe rrezikun që të mos kryhen vepra penale.

Neni 8
Masat për publikun në përgjithësi

1. Secila palë do të promovojë ose do të kryejë fushata për rritjen e sensibilitetit drejtuar publikut të gjerë duke dhënë informacion për fenomenin e shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual dhe për masat parandaluese që mund të ndërmerren.
2. Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të parandaluar ose ndaluar përhapjen e materialeve, që reklamojnë veprat penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë.

Neni 9

Pjesëmarrja e fëmijëve, sektori privat, media dhe shoqëria civile

1. Secila palë do të inkurajojë pjesëmarrjen e fëmijëve, në përputhje me kapacitetin e tyre zhvillimor, në zhvillimin dhe implementimin e politikave, programeve ose iniciativave të tjera shtetërore në lidhje me luftën kundër shfrytëzimit seksual ose abuzimit seksual të fëmijëve.

2. Secila palë do të inkurajojë sektorin privat, në veçanti sektorin e teknologjisë së informacionit të komunikimit, industrinë e turizmit dhe të udhëtimit, dhe sektorin bankar e financiar, si dhe shoqërinë civile, që të marrin pjesë në përpunimin dhe zbatimin e politikave për parandalimin e shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual të fëmijëve dhe për të implementuar normat e brendshme nëpërmjet vetërregullimit ose bashkërregulloreve.

3. Secila palë do të inkurajojë mediat që të japë informacionin e duhur në lidhje me të gjitha aspektet e abuzimit seksual të fëmijëve, duke respektuar plotësisht pavarësinë e medias dhe lirinë e shtypit.

4. Secila palë do të inkurajojë financimin, duke përfshirë, ku është e mundur, duke krijuar fonde, projekte dhe programe, që kryhen nga shoqëria civile, me synimin për të parandaluar dhe mbrojtur fëmijët nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual.

KAPITULLI III

AUTORITETET E SPECIALIZUARA DHE ORGANET BASHKËRENDUESE

Neni 10

Masa kombëtare të bashkërendimit dhe të bashkëpunimit

1. Secila palë do të marrë masat e domosdoshme për të siguruar bashkërendimin në nivel kombëtar ose vendor midis agjencive të ndryshme që përgjigjen për mbrojtjen nga; parandalimin dhe luftën kundër shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual të fëmijëve, përkatësisht sektori i arsimit, sektori i shëndetësisë, shërbimet sociale dhe autoritetet e zbatimit të ligjit dhe ato gjyqësore.

2. Secila palë duhet të marrë masat e domosdoshme legjislative apo masa të tjera për të ngritur ose planifikuar:

3. institucione kombëtare ose vendore të pavarura për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, duke siguruar që atyre t'u jepen burimet dhe përgjegjësitë specifike;

4. mekanizmat për mbledhjen e të dhënave ose pikave të fokusit në nivel kombëtar dhe ose vendor në bashkëpunim me shoqërinë civile, me qëllim që të vëzhgohet dhe vlerësohet fenomeni i shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual të fëmijëve, duke respektuar plotësisht kërkesat për mbrojtjen e të dhënave personale.

5. Secila palë do të inkurajojë bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve kompetente shtetërore, të shoqërisë civile, të sektorit privat, në mënyrë që të parandalohet e të luftohet më mirë shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual i fëmijëve.

KAPITULLI IV

MASAT MBROJTËSE DHE ASISTENCA E PROJEKTIMIT

Neni 11

Parimet

1. Secila palë do të krijojë programe efektive sociale dhe do të ngrejë struktura shumëdisplinore për të dhënë mbështetjen e domosdoshme për viktimat, të afërmit e tyre të afërt dhe për ndonjë person, që përgjigjet për kujdesin e tyre.

2. Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legjislative dhe masa të tjera për të garantuar që kur mosha e viktimës është jo e sigurt dhe ka arsye për të besuar se viktima është fëmijë, masat e mbrojtjes dhe të asistencës, dhënë fëmijëve, të jenë në përputhje me verifikimin në pritje të moshës së tij ose të saj.

Neni 12

Raportimi i dyshimit për shfrytëzim seksual ose abuzim seksual

1. Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar që konfidencialiteti i imponuar nga ligji i brendshëm për profesionistë të caktuar që thirren për të punuar në kontakt me fëmijët nuk do të përbëjnë ndonjë pengesë për mundësinë e këtyre profesionistëve, që t'u raportojnë shërbimeve përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës në çdo situatë kur ata kanë shkaqe të arsyeshme për të besuar se një fëmijë është viktimë e shfrytëzimit seksual ose e abuzimit seksual.

2. Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të inkurajuar çdo person që di ose dyshon, në mirëbesim, shfrytëzimin seksual ose abuzimin seksual të fëmijëve për t'ua raportuar këto fakte shërbimeve kompetente.

Neni 13

Linjat e ndihmës

Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera, për të inkurajuar dhe mbështetur ngritjen e shërbimeve të informacionit, të tilla si: linjat e ndihmës telefonike apo internetit për t'u dhënë këshilla telefonuesve, edhe në mënyrë konfidenciale ose duke respektuar plotësisht anonimitetitn e tyre.

Neni 14

Asistenca për viktimat

1. Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të asistuar viktimat për një afat të shkurtër dhe të gjatë, për shërimin e tyre fizik dhe psikosocial. Masat e marra sipas këtij paragrafi do të marrin parasysh plotësisht pikëpamjet, nevojat dhe shqetësimet e fëmijës.

2. Secila palë do të marrë masat, sipas kushteve që parashikon ligji i brendshëm, për të bashkëpunuar me organizata joqeveritare, organizata të tjera përkatëse ose elemente të tjera të shoqërisë civile të përfshira për asistencën e viktimave.

3. Kur prindërit ose personat, që kujdesen për fëmijët, janë përfshirë në shfrytëzimin ose abuzimin e tij ose të saj seksual, procedurat e ndërhyrjes që merren me zbatimin e nenit 11, paragrafi 1, do të përfshijnë:

a) mundësinë e largimit të personit i cili ka kryer një nga veprat penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë, të pretenduar;

b) mundësinë e largimit të viktimës nga mjedisi i familjes së tij ose të saj. Kushtet dhe kohëzgjatja e këtij largimi do të përcaktohet në përputhje me interesat më të mira të fëmijës.

4. Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar që personat, të cilët janë të afërm me viktimën, të mund të përfitojnë, kur mundet, nga asistenca terapeutike, përkatësisht kujdesi psikologjik i emergjencës.

KAPITULLI V

PROGRAMET DHE MASAT E NDËRHYRJES

Neni 15

Parime të përgjithshme

1. Secila palë do të sigurojë ose promovojë, në përputhje me ligjin e saj të brendshëm, programet ose masat efektive të ndërhyrjes për personat që përmenden në nenin 16, paragrafi 1 dhe 2, me synimin për të parandaluar dhe minimizuar rreziqet e veprave penale të përsëritura të një natyre seksuale kundër fëmijëve. Këto programe ose masa do të merren në çdo kohë gjatë

procedimeve, brenda dhe jashtë burgut, sipas kushteve të parashtruara në ligjin e brendshëm.

2. Secila palë do të sigurojë ose promovojë, në përputhje me ligjin e saj të brendshëm, zhvillimin e partneritetit ose formave të tjera të bashkëpunimit midis autoriteteve kompetente, në veçanti shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe shërbimeve sociale dhe autoriteteve gjyqësore dhe organeve të tjera përgjegjëse për ndjekjen e personave që përmenden në nenin 16, paragrafi 1 dhe 2.

3. Secila palë do të parashikojë, në përputhje me ligjin e saj të brendshëm, vlerësimin e rrezikshmërisë dhe rreziqeve të mundshme të përsëritjes së veprave penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë nga personat që përmenden në nenin 16, paragrafi 1 dhe 2, me synimin e identifikimit të programeve dhe masave të përshtatshme.

4. Secila palë do të parashikojë, në përputhje me ligjin e saj të brendshëm, vlerësimin e efektivitetit të programeve dhe masave të implementuara.

Neni 16

Përfituesit e programeve dhe masave të ndërhyrjes

1. Secila palë do të sigurojë, në përputhje me ligjin e saj të brendshëm, që personat, të cilët u nënshtrohen procedimeve kriminale për ndonjë nga shkeljet e përcaktuara, sipas kësaj Konvente, të mund të kenë akses për programet ose masat e përmendura në nenin 15, paragrafi 1, sipas kushteve të cilat të mos jenë as dëmtuese as në kundërshtim me të drejtat e mbrojtjes dhe me kërkesat e një gjyqi të paanshëm dhe objektiv e veçanërisht duke respektuar plotësisht rregullat që sundojnë parimin e prezumimit të pafajësisë.

2. Secila palë do të sigurojë, në përputhje me ligjin e saj të brendshëm, që personat e dënuar për një nga shkeljet e përcaktuara sipas kësaj Konvente, të mund të kenë akses për programet ose masat e përmendura në nenin 15, paragrafi 1.

3. Secila palë do të sigurojë, në përputhje me ligjin e saj të brendshëm, që të zhvillohen ose përshtaten programet ose masat e ndërhyrjes për të plotësuar nevojat zhvillimore të fëmijëve ndaj të cilëve është bërë shkelje seksuale, duke përfshirë ata që janë poshtë moshës së përgjegjësisë penale, me synimin për të adresuar problemet e sjelljes së tyre seksuale.

Neni 17

Informacioni dhe miratimi

1. Secila palë do të sigurojë, në përputhje me ligjin e saj të brendshëm, që personat, që përmenden në nenin 16, të cilëve u janë propozuar programet ose masat e ndërhyrjes, të informohen plotësisht për arsyet e propozimit dhe miratimin për programin ose masën duke i njohur plotësisht faktet.

2. Mund t'i refuzojnë ato dhe në rastin e personave të dënuar, ata të informohen për pasojat e mundshme, që mund të ketë refuzimi.

KAPITULLI VI

LIGJI SUBSTANTIV PENAL

Neni 18

Abuzimi seksual

1. Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar kriminalizimin e sjelljes së mëposhtme të qëllimshme:

a) Përfshirja në aktivitete seksuale me një fëmijë, i cili, sipas dispozitave përkatëse të ligjit kombëtar, nuk e ka arritur moshën ligjore për aktivitete seksuale;

b) Përfshirja në aktivitete seksuale me një fëmijë kur:

a. përdoret shtrëngimi, forca ose kërcënimet; ose

b. abuzimi bëhet nga një pozicion i njohur i besimit, autoritetit ose influencës mbi fëmijën, duke përfshirë dhe brenda familjes; ose

c. abuzimi bëhet nga një situatë veçanërisht e cenueshme e fëmijës, përkatësisht për shkak të aftësisë së kufizuar mendore ose fizike ose të një situate të varësisë.

2. Për qëllimin e paragrafit 1 më sipër, secila palë do të vendosë moshën, poshtë së cilës ndalohet angazhimi në aktivitete seksuale me një fëmijë. Dispozitat e paragrafit 1.a nuk synojnë të rregullojnë aktivitetet seksuale konsensuale midis të miturve.

Neni 19

Veprat penale që kanë të bëjnë më prostitucionin e fëmijës

1. Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar kriminalizimin e sjelljes së mëposhtme të qëllimshme:

a) rekrutimi i fëmijës në prostitucion ose bërja e një fëmije që të marrë pjesë në prostitucion;

b) shtrëngimi i një fëmije për të bërë prostitucion ose për të përfituar nga kjo ose në raste të tjera shfrytëzimi i fëmijës për qëllime të tilla;

c) përdorimi i prostitucionit të fëmijëve.

2. Për qëllimin këtij neni, termi "prostitucion fëmije" do të thotë fakti i përdorimit të fëmijës për aktivitete seksuale kur jepen para ose ndonjë formë shpërblimi ose konsiderate ose premtohet si pagesë, pavarësisht nëse kjo pagesë, ky premtim ose konsiderim bëhet për fëmijën apo për një person të tretë.

Neni 20

Krimet në lidhje me pornografinë e fëmijës

1. Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar kriminalizimin e sjelljes së mëposhtme të qëllimshme, kur kryhet pa të drejtë:

a) prodhimi i pornografisë së fëmijëve;

b) ofrimi ose vënia në dispozicion e pornografisë së fëmijëve;

c) shpërndarja ose transmetimi i pornografisë së fëmijëve;

d) përdorimi i pornografisë së fëmijëve për vete ose për ndonjë person tjetër;

e) posedimi i pornografisë së fëmijës;

f) krijimin e aksesit në mënyrë të vetëdijshme për pornografinë e fëmijës, nëpërmjet teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

2. Për qëllimin e këtij neni, termi "pornografi fëmije" do të thotë çdo material që vizualisht pasqyron një fëmijë të angazhuar në një sjellje eksplicite reale ose të simuluar seksuale ose ndonjë pasqyrim i organeve seksuale të fëmijës për qëllimet seksuale parësore.

3. Secila palë mund të rezervojë të drejtën të mos e aplikojë tërësisht ose pjesërisht paragrafin 1.a dhe e për prodhimin dhe posedimin e materialeve pornografike:

a) që përbëhet ekskluzivisht nga pasqyrime të simuluar ose imazhe realiste të një fëmije joekzistent;

b) që përfshijnë fëmijë, që kanë arritur moshën e përcaktuar në aplikimin e nenit 18, paragrafi 2, ku këto imazhe posedohen prej tyre, me pëlqimin e tyre dhe vetëm për përdorimin e tyre privat.

4. Secila palë mund të rezervojë të drejtën të mos aplikojë, tërësisht ose pjesërisht paragrafin 1.f.

Neni 21

Veprat penale që lidhen me pjesëmarrjen e një fëmije në performanca pornografike

1. Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar kriminalizimin e sjelljes së mëposhtme të qëllimshme:

a) rekrutimin e fëmijës për të marrë pjesë në performanca pornografike ose bërjen e një fëmije që të marrë pjesë në të tilla performanca;

b) shtrëngimi i një fëmije që të marrë pjesë në performaca pornografike ose përfitimi nga shfrytëzimi ose në raste të tjera prej shfrytëzimit të fëmijës për këto qëllime;

c) marrja pjesë me vetëdije në performancat pornografike, që përfshijnë pjesëmarrjen e fëmijëve.

2. Secila palë mund të rezervojë të drejtën që të kufizojë aplikimin e paragrafit 1.c për rastet kur fëmijët janë rekrutuar ose shtrënguar në përputhje më paragrafin 1.a ose b.

Neni 22

Korrupsioni i fëmijëve

Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar kriminalizimin e shkaktimit të qëllimshëm, për qëllime seksuale, të një fëmije që nuk ka arritur moshën e përcaktuar në zbatimin e nenit 18, paragrafi 2, që të jetë dëshmitar i abuzimit seksual ose aktiviteteve seksuale, edhe pa qenë pjesëmarrës.

Neni 23

Tundimi i fëmijëve për qëllime seksuale

Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar kriminalizimin e propozimit të qëllimshëm, nëpërmjet teknologjive të informacionit dhe të komunikimit, të një të rrituri për të takuar një fëmijë, që nuk e ka mbushur moshën e përcaktuar në zbatim të nenit 18, paragrafi 2, për qëllimin e kryerjes së ndonjërës prej veprave penale të përcaktuara, në përputhje me nenin 18, paragrafi 1.a, ose nenin 20, paragrafi 1.a, kundër tij ose saj, kur ky propozim pasohet nga akte materiale që çojnë në një takim të tillë.

Neni 24

Ndihma ose shtytja dhe tentativa

1. Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të parashikuar si vepra penale, kur kryhen me qëllim, ndihma ose shtytja për të kryer një nga veprat penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë.

2. Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të parashikuar si vepra penale, kur kryhen me qëllim, tentativat për të kryer një nga veprat penale, të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë.

3. Secila palë mund të rezervojë të drejtën të mos e aplikojë tërësisht ose pjesërisht paragrafin 2 për shkeljet në përputhje me nenin 20, paragrafi 1.b, d, e, dhe f, neni 21, paragrafi 1.c, neni 22 dhe neni 23.

Neni 25

Juridiksioni

1. Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të vendosur juridiksionin mbi veprat penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë, kur vepra penale kryhet:

a) në territorin e saj; ose

b) në bordin e një anijeje që mban flamurin e asaj pale; ose

c) në bordin e një avioni të regjistruar sipas ligjeve të asaj pale; ose

d) prej një nga shtetasit e saj; ose

e) prej një personi që banon rregullisht në territorin saj.

2. Secila palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera

për të vendosur juridiksionin mbi çdo vepër penale të përcaktuar në përputhje me këtë Konventë, kur vepra penale kryhet kundër njërit prej shtetasve të saj ose një personi, që banon rregullisht në territorin saj.

3. Secila palë mundet, në kohën e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose aderimit, me një deklaratë të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të deklarojë se ajo rezervon të drejtën për të mos i aplikuar ose për t'i aplikuar vetëm në raste ose kushte specifike rregullat e juridiksionit të parashtruara në paragrafin 1.e të këtij neni.

4. Për ndjekjen e veprave penale të përcaktuara në përputhje me nenet 18, 19, 20, paragrafi 1.a dhe 21, paragrafi 1.a dhe b të kësaj Konvente, secila palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar që juridiksioni në lidhje me paragrafin 1.d të mos varet nga kushti që aktet kriminalizohen në vendin ku kryhen.

5. Secila palë mundet, në kohën e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose aderimit, me një deklaratë të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të deklarojë se ajo rezervon të drejtën për ta kufizuar aplikimin e paragrafit 4 të këtij neni, ne lidhje me nenin 18, paragrafi 1.b, pika e dytë dhe e tretë, në rastet shtetasit e saj banojnë rregullisht në territorin saj.

6. Për ndjekjen e veprave penale të përcaktuara në përputhje me nenet 18, 19, 20, paragrafi 1.a dhe 21, paragrafi 1.a dhe b të kësaj Konvente, secila palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar që juridiksioni në lidhje me paragrafin 1.d të mos varet nga kushti që ndjekja mund të iniciohet pas një raporti për viktimën ose një denoncimi nga shteti në vendin e të cilit u krye vepra penale.

7. Secila palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të vendosur juridiksionin mbi çdo vepër penale të përcaktuar në përputhje me këtë Konventë, në rastet kur një person i cili ka kryer veprën penale të përcaktuar në përputhje me këtë Konventë, të pretenduar, është i pranishëm në territorin e saj dhe ajo nuk e ekstradon atë tek një palë tjetër, vetëm bazuar në kombësinë e tij ose të saj.

8. Kur juridiksionin mbi veprën penale të përcaktuar në përputhje me këtë Konventë e pretendojnë më tepër se një palë, palët e përfshira, kur është e mundur, do të konsultohen me synimin për të përcaktuar juridiksionin më të përshtatshëm për ndjekjen.

9. Pa paragjykuar rregullat e përgjithshme të ligjit ndërkombëtar, kjo Konventë nuk përjashton ndonjë juridiksion penal të ushtruar nga një palë në përputhje më ligjet e saj të brendshme.

Neni 26
Përgjegjësia shoqërore

1. Secila palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar që një person juridik të mund të përgjigjet për një vepër penale të kryer në përputhje me këtë Konventë, e kryer për përfitimin e një personi fizik, që vepron ose individualisht ose si pjesë e një organi të personit juridik, i cili ka një pozitë drejtuese brenda personit juridik, bazuar në:

a) të drejtën e përfaqësimit të personit juridik;

b) një autoritet për të marrë vendime në emër të personit juridik;

c) një autoritet për të ushtruar kontroll brenda personit juridik.

2. Përveç rasteve tashmë të parashikuara në paragrafin 1, secila Palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar që një person juridik të mund të përgjigjet kur mungesa e mbikëqyrjes ose kontrollit nga një person fizik, përmendur në paragrafin 1, ka bërë të mundur kryerjen e një vepre penale të përcaktuar në përputhje me këtë Konventë, në përftimi të personit juridik nga ana e personit fizik, që vepron me autoritetin e tij.

4. Duke iu nënshtruar parimeve ligjore të palës, përgjegjësia e personit ligjor mund të jetë penale, civile ose administrative.

5. Kjo përgjegjësi do të jetë pa paragjykim për përgjegjësinë penale të personave fizike që kaneë kryer veprën penale.

Neni 27
Sanksionet dhe mjetet

1. Secila palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar se veprat penale të përcaktuar në përputhje me këtë Konventë të ndëshkohen me sanksione efektive, proporcionale dhe penguese, duke marrë parasysh seriozitetin e tyre. Këto sanksione do të përfshijnë penalitetet që përfshijnë privimin e lirisë, e cilat mund të çojë në ekstradim.

2. Secila palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera që personat juridike, që përgjigjen sipas nenit 26, t'u nënshtrohen sanksioneve efektive, proporcionale dhe penguese, që do të përfshijnë gjoba monetare penale ose jo penale dhe mund të përfshijë në masat e tjera, në veçanti:

a) përjashtimin nga e drejta për përfitime ose ndihmë publike;

b) skualifikimi i përkohshëm ose i përhershëm nga praktikat e aktiviteteve komerciale;

c) vënia nën mbikëqyrje gjyqësore;

d) një urdhër gjyqësor përfundimtar.

3. Secila palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera:

a) për të siguruar kapjen dhe konfiskimin e:

- mallrave, dokumenteve dhe instrumenteve të tjera të përdoruar për kryerjen e veprës penale të përcaktuar në përputhje me këtë Konventë ose për të lehtësuar kryerjen e tyre.

- të ardhurat, që rrjedhin nga këto vepra penale ose pasuria vlera e së cilës korrespondon me këto të ardhura;

b) për të mundësuar mbylljen e përkohshme të ndonjë biznesi, që përdoret për të kryer ndonjë prej veprave penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë, pa paragjykuar të drejtën e palëve të treta për mirëbesim, ose për t'i mohuar personit i cili ka kryer një nga veprat penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë, përkohësisht ose përgjithmonë ushtrimin e aktivitetit vullnetar, që përfshin kontakte me fëmijët, gjatë të cilit është kryer vepra penale.

4. Secila palë do të përpiqet të marrë masa të tjera në lidhje me personin, i cili ka kryer një nga veprat penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë, si heqja e të drejtës prindërore ose monitorimi ose mbikëqyrja e personave të dënuar.

5. Secila Palë mund të përcaktojë që të ardhurat e krimit ose të pasurisë, të konfiskuara në përputhje me këtë nen, të mund të alokohen për një fond të veçantë në mënyrë që të financojë programet e parandalimit dhe të asistencës për viktimat e ndonjërës prej veprave penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë.

Neni 28
Rrethanat rënduese

Secila palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar që rrethana e mëposhtme, për aq kohë sa ato nuk formojnë pjesë të elementeve përbërëse të një vepre penale, në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit të brendshëm, mund të merren në konsideratë si rrethana rënduese për përcaktimin e sanksioneve në lidhje me shkeljet të përcaktuar në përputhje me këtë Konventë:

a) vepra penale ka dëmtuar seriozisht shëndetin fizik ose mendor të viktimës;

b) vepra penale është paraprirë ose shoqëruar me akte torture ose të dhunës serioze;

c) vepra penale është kryer kundër një viktime veçanërisht e cenueshme;

d) vepra penale është kryer nga një pjesëtar i familjes, një person që bashkëjeton me fëmijën ose një person që ka abuzuar me autoritetin e tij ose të saj;

e) vepra penale është kryer nga njerëz të ndryshëm që veprojnë së bashku;

f) vepra penale është kryer brenda kuadrit të një organizate kriminale;

g) personi, i cili ka kryer një nga veprat penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë, ka qenë i dënuar më parë për vepra penale të së njëjtës natyrë.

Neni 29
Dënimet e mëparshme

Secila palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar mundësinë për të marrë parasysh dënimet e formës së prerë të dhëna nga një palë tjetër në lidhje me veprat penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë kur vendosen sanksionet.

KAPITULLI VII
HETIMI, NDJEKJA DHE LIGJI PROCEDURAL

Neni 30
Parimet

1. Secila palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar hetimet dhe procedimet penale kryhen me interesat më të mira dhe respektimin e të drejtave të fëmijës.

2. Secila palë do të adoptojë një trajtim mbrojtës ndaj viktimave, duke siguruar që hetimet dhe procedimet penale të mos përkeqësojnë traumën e përjetuar nga fëmija dhe që përgjigja e drejtësisë penale të pasohet nga asistenca, kur është e mundur.

3. Secila palë do të sigurojë që hetimet dhe procedimet penale të trajtohen si përparësi dhe të kryhen pas asnjë vonesë të pajustifikuar.

4. Secila palë do të sigurojë masat e aplikueshme sipas këtij kapitulli nuk paragjykojnë të drejtat e mbrojtjes dhe kërkesat për një gjyq të paanshëm dhe objektiv, në përputhje me nenin 6 të Konventës për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

5. Secila palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar, në përputhje me parimet themelore të ligjit të saj të brendshëm:

a) për të siguruar një hetim dhe ndjekje efektive të veprave penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë duke lejuar, kur mundet, mundësinë e operacioneve të fshehta;

b) për t'u mundësuar shërbimeve investigative që të identifikojnë viktimat e shkeljeve, në veçanti duke analizuar materialet e pornografisë me fëmijët, të tilla si fotografitë, regjistrimet audio-vizuale të transmetuara ose të vëna në dispozicion përdorimit të teknologjive të informacionit dhe të komunikimit.

Neni 31
Masa të përgjithshme të mbrojtjes

1. Secila palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e viktimave, duke përfshirë nevojat e tyre të veçanta si dëshmitarë, në të gjitha fazat e hetimeve dhe procedimeve penale, në veçanti:

a) duke i informuar ata për të drejtat e tyre dhe shërbimet në dispozicion të tyre dhe, vetëm nëse ata nuk kanë dëshirë ta marrin një informacion të tillë, me ecurinë e ankesës së tyre, akuzat, progresin e përgjithshëm të hetimit ose procedimeve dhe rolin tyre në to si dhe rezultatin e çështjeve të tyre;

b) duke siguruar të paktën, në rastet kur viktimat dhe familjet e tyre mund të jenë në rrezik, që ata mund të informohen, nëse e është e domosdoshme, kur personi i proceduar ose i dënuar lirohet përkohësisht ose përfundimisht;

c) duke u mundësuar atyre në një mënyrë që të përputhet me rregullat procedurale të ligjit të brendshëm, që të dëgjohen, të paraqesin prova dhe të zgjedhin mjetet e paraqitjes së pikëpamjeve,

nevojave dhe shqetësimeve të tyre drejtpërdrejt ose nëpërmjet një ndërmjetësi dhe të konsiderohen;

d) duke u dhënë atyre shërbimet e përshtatshme të përkrahjes, në mënyrë që të drejtat dhe interesat e tyre të paraqiten siç duhet dhe të merren parasysh;

e) duke mbrojtur jetën e tyre private, identitetin e tyre dhe imazhin tyre dhe duke marrë masa në përputhje me ligjin e brendshëm për të parandaluar përhapjen publike të ndonjë informacioni që mund të çonte në identifikimin e tyre;

f) duke garantuar sigurinë e tyre, si dhe të familjeve dhe dëshmitarëve në emër të tyre, nga frikësimi, hakmarrja dhe viktimizimi i përsëritur;

g) duke siguruar që kontakti midis viktimave dhe personave, të cilët kanë kryer një nga veprat penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë, brenda gjykatës dhe mjediseve të agjencisë së zbatimit të ligjit, të shmanget, me përjashtim të rastit kur autoritete kompetente vendosin ndryshe për interesin më të mirë të fëmijës ose ku hetimet ose procedimet e kërkojnë këtë kontakt.

2. Secila palë do të sigurojë që viktimat të kenë të drejtë që në kontaktin e parë të tyre me autoritete kompetente për informacion, për procedimet përkatëse gjyqësore dhe administrative.

3. Secila palë do të sigurojë që viktimat të kenë të drejtë që do t'u garantohet falas, kur autorizohet, ndihmë ligjore, kur është e mundur për ta, që të kenë statusin palëve në procedimet penale.

4. Secila palë do të parashikojë mundësinë e autoriteteve gjyqësore për të emëruar një përfaqësuesit të veçantë për viktimën kur, me ligjin e brendshëm, ai ose ajo mund të ketë statusin e palës në procedimet penale dhe kur mbajtësit e përgjegjësisë prindërore përjashtohen nga përfaqësimi i fëmijës në këto procedime si rezultat i një konflikti të interesit midis tyre dhe viktimës.

5. Secila palë do të sigurojë me anë të masave të parashikuara në ligjin e brendshëm, mundësinë për grupet, fondacionet, shoqatat ose organizatat qeveritare ose joqeveritare dhe/ose të mbështetin viktimat me pëlqimin e tyre gjatë procedimeve penale në lidhje me veprat penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë.

6. Secila palë do të sigurojë që informacioni që u jepet viktimave, në përputhje me dispozitat e këtij neni, të jepet në një mënyrë të përshtatur për moshën dhe pjekurinë e tyre dhe në një gjuhë që ata ta kuptojnë.

Neni 32
Fillimi i procedimeve

Secila palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera, për të siguruar që hetimet ose procedimet e veprave penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë nuk do të varen nga raporti ose akuza e bërë nga viktima dhe që procedimet mund të vazhdojnë edhe në qoftë se viktima i ka tërhequr deklaratat e tij ose të saj.

Neni 33
Statuti i kufizimit

Për fillimin e procedimeve në lidhje me veprat penale të përcaktuara në përputhje me nenet 18, 19, paragrafi 1.a, dhe d, dhe 21, paragrafi 1.a dhe b, do të vazhdojnë për një periudhë kohe të mjaftueshme që të lejojë fillimin efiçent të procedimeve pasi viktima ka mbushur moshën madhore dhe e cila është proporcionale me gravitetin e krimit në fjalë.

Neni 34
Hetimet

Secila palë do të marrë të tilla masa që mund të jenë të domosdoshme për të siguruar që personat, njësitë ose shërbimet që përgjigjen për hetimet të jenë të specializuar në fushën e luftës kundër shfrytëzimit seksual ose abuzimit seksual të fëmijëve ose që personat të jenë të trajnuar për

këtë qëllim. Këto njësi ose shërbime do të kenë burime të përshtatshme financiare, pasiguria për moshën faktike të viktimës nuk do të pengojë fillimin e hetimeve penale.

Neni 35
Intervistat me fëmijët

1. Secila palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar që:

a) intervistat me fëmijën do të kryhen pa vonesë të pajustifikuar pasi të jenë raportuar faktet tek autoritetet kompetente;

b) intervistat me fëmijën do të kryhen, kur është e domosdoshme, në mjediset e përcaktuara ose të adaptuara për këtë qëllim;

c) intervistat me fëmijën do të kryhen nga profesionistë të trajnuar për këtë qëllim;

d) të njëjtët njerëz në qoftë se është e mundur dhe kur është e përshtatshme, kryejnë të gjitha intervistat me fëmijën;

e) numri i intervistave është i kufizuar sa të jetë e mundur dhe vetëm dhe në mënyrë të rreptë aq sa është e domosdoshme për qëllimin e procedimeve penale;

f) fëmija mund të shoqërohet nga përfaqësuesi i tij ose i saj ligjor, ose, ku është e përshtatshme, një i rritur që ai ose ajo e ka zgjedhur vetë, me përjashtim kur ka një vendim të arsyetuar që interesohet për të kundërtën duke respektuar atë person.

2. Secila palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar që të gjitha intervistat me viktimën ose, kur është e përshtatshme, ato me një fëmijë dëshmitar, mund të regjistrohen në video dhe këto intervista të regjistruara mund të pranohen si prova gjatë procedimeve në gjykatë, në përputhje me rregullat që parashikon ligji i brendshëm.

3. Kur mosha e viktimës nuk është e sigurt dhe ka arsye për të besuar që viktima është fëmijë, masat e përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2 do të aplikohen në pritje të verifikimit të moshës së tij ose të saj.

Neni 36
Procedimet penale të gjykatës

1. Secila palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera duke respektuar plotësisht rregullat që sundojnë autonominë e profesioneve ligjore të garantojë që trajnimi për të drejtat e fëmijëve dhe shfrytëzimi seksual e abuzimi seksual i fëmijëve të jetë i disponueshëm për të përfituar nga të gjithë personat e përfshirë në procedime, tek gjykatës të veçantë, prokurorë dhe avokatë.

2. Secila palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar, sipas rregullave të ligjit të brendshëm, që:

a) gjykatësi të mund të urdhërojë që seanca të kryhet pa praninë e publikut;

b) viktima të mund të dëgjohet në sallën e gjyqit pa qenë i pranishëm, përkatësisht nëpërmjet përdorimit të teknologjive të përshtatshme të komunikimit.

KAPITULLI XIII
REGJISTRIMI DHE RUAJTJA E TË DHËNAVE

Neni 37
Regjistrimi dhe ruajtja e të dhënave kombëtare për personat e dënuar për veprën penale seksuale

1. Për qëllimet e parandalimit e ndjekjes së veprave penale në përputhje me dispozitat përkatëse për mbrojtjen e të dhënave personale, për të mbledhur dhe ruajtur dhe rregullat e tjera të

përshtatshme dhe siç përshkruhen nga ligji i brendshëm, të dhënat që lidhen me identitetin dhe profilin gjenetik (ADN) të personave të dënuar për veprat penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë.

2. Secila palë në kohën e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit, i komunikon emrin dhe adresën e autoritetit të vetëm kombëtar që përgjigjet për qëllimet e paragrafit 1.

3. Secila palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera, për të siguruar që informacioni që përmendet në paragrafin 1 mund t'i transmetohet autoritetit kompetent të secilës palë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në ligjin e saj të brendshëm dhe në instrumentet përkatëse ndërkombëtare.

KAPITULLI IX
BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Neni 38
Parimet dhe masat e përgjithshme për bashkëpunimin ndërkombëtar

1. Palët duhet të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente dhe nëpërmjet aplikimit të instrumenteve përkatëse ndërkombëtare dhe rajonale të aplikueshme, rregullimet për të cilat është rënë dakord mbi bazën e një legjislacioni uniform ose reciprok dhe ligjeve të brendshme, deri në gamën më të gjerë të mundshme, për qëllimin e:

a) parandalimit dhe luftës kundër shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual të fëmijëve;

b) mbrojtjen dhe dhënien e asistencës për viktimat;

c) hetimin ose procedimin në lidhje me veprat penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë.

2. Secila palë do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar që viktimat e një vepre penale të përcaktuar në përputhje me këtë Konventë në territorin e një pale, që është i ndryshëm nga ai ku ata banojnë mund të bëjë një ankesë para autoriteteve kompetente për shtetin e tyre të banimit.

3. Nëse pala që e bën asistencën reciproke ligjore në çështjet penale apo ekstradimin të kushtëzuar nga ekzistenca e një traktati merr një kërkesë për asistencë ligjore ose ekstradim nga një palë me të cilën ajo nuk ka firmosur një traktat të tillë, ajo mund ta konsiderojë këtë Konventë si bazën ligjore për asistencën reciproke ligjore në çështje penale ose për ekstradimin në lidhje me veprat penale të përcaktuar në përputhje me këtë Konventë.

4. Secila palë do të përpiqet që ta integrojë, aty ku është përshtatshme, parandalimin e luftën kundër shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual të fëmijëve në programet e asistencës për zhvillimin të parashikuara për përfitimin e shteteve të treta.

KAPITULLI X
MEKANIZMI I MONITORIMIT

Neni 39
Komiteti i Palëve

1. Komiteti i Palëve do të përbëhet nga përfaqësues të palëve në Konventë.

2. Komiteti i Palëve do të mblidhet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës. Mbledhja e tij e parë do të mbahet brenda një periudhe njëvjeçare, pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, pasi ta ketë ratifikuar atë pala e dhjetë nënshkruese. Pas kësaj ai do të mblidhet sa herë që të paktën një e treta e palëve ose sekretari i përgjithshëm e kërkon atë.

3. Komiteti i Palëve do të miratojë rregullat e tij të procedurës.

Neni 40

Përfaqësues të tjerë

1. Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës, Komisionieri për të Drejtat e Njeriut, Komiteti Europian për Problemet e Krimit (CDPC), si dhe komitetet përkatëse të tjera ndërqeveritare të Këshillit të Europës, secili, do të emërojë një përfaqësues në Komitetin e Palëve.

2. Komiteti i Ministrave mund të ftojë organe të tjera të Këshillit të Europës për të emëruar një përfaqësues në Komitetin e Palëve pasi të jetë konsultuar me këtë të fundit.

3. Përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe në veçanti organizatat joqeveritare mund të pranohen si vëzhgues në Komitetin e Palëve sipas procedurës së përcaktuar nga rregullat përkatëse të Këshillit të Europës.

4. Përfaqësuesit e emëruar sipas paragrafëve 1-3 më sipër do të marrin pjesë në mbledhjet e Komitetit të Palëve pa të drejtë vote.

Neni 41

Funksionet e Komitetit të Palëve

1. Komiteti i Palëve do të monitorojë implementimin e kësaj Konvente; rregullat e procedurës së Komitetit të Palëve do të përcaktojnë procedurën për vlerësimin e implementimit të kësaj Konvente.

2. Komiteti i Palëve do të lehtësojë mbledhjen, analizimin dhe shkëmbimin e informacionit, përvojën dhe praktikën e mirë midis shteteve për të përmirësuar kapacitetet e tyre për të parandaluar e luftuar shfrytëzimin dhe abuzimin seksual të fëmijëve.

3. Komiteti i Palëve, ku të jetë e përshtatshme:

a) do të lehtësojë dhe përdorimin efektiv dhe implementimin e kësaj Konvente, duke përfshirë identifikimin e ndonjë problemi dhe efekteve të ndonjë deklarate apo rezerve të bërë sipas kësaj Konvente.

b) do të shprehë një mendim për ndonjë çështje në lidhje me aplikimin e kësaj Konvente dhe do të lehtësojë shkëmbimin e informacionit për zhvillimet e rëndësishme ligjor, të politikës ose të teknologjisë.

4. Komiteti i Palëve do të ndihmohet nga Sekretariati i Këshillit të Europës në kryerjen e funksioneve të tij sipas këtij neni.

5. Komiteti Europian për Problemet e Krimit (CDPC) do të informohet në mënyrë periodike në lidhje me aktivitetet e përmendura në paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni.

KAPITULLI XI

MARRËDHËNIET ME INSTRUMENTE TË TJERË NDËRKOMBËTARË

Neni 42

Marrëdhëniet me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijës dhe protokollin me zgjedhje për shitjen e fëmijës, prostitucionin e fëmijës dhe pornografinë e fëmijës

Konventa nuk do të ndikojë mbi të drejtat dhe detyrimet që lindin nga dispozitat e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijës dhe protokollin me zgjedhje për shitjen e fëmijës, prostitucionin e fëmijës dhe pornografinë e fëmijës dhe synon që të rritë mbrojtjen që i japin ato dhe të zhvilloje e plotësojë standardet që përmbajnë ato.

Neni 43

Marrëdhëniet me instrumente e tjera ndërkombëtare

1. Kjo Konventë nuk mund të ndikojë mbi të drejtat dhe detyrimet që dilnin nga dispozita e instrumenteve të tjera ndërkombëtare, ndër të cilat palët e kësaj Konvente janë palë

ose do të bëhen palë dhe të cilat përmbajnë dispozita për çështje që sundohen nga kjo Konventë dhe të cilat garantojnë një mbrojtje dhe asistencë më të madhe për fëmijën viktima te shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual.

2. Palët e kësaj Konvente mund të konkludojnë marrëveshje shumëpalëshe me njëra-tjetrën, për çështje që trajtohen në këtë Konventë, për qëllimet e plotësimit ose forcimit të dispozitave të saj, ose për lehtësimin e aplikimit të parimeve që ajo mishëron.

3. Palët që janë anëtare të Bashkimit Europian, në marrëdhëniet e tyre reciproke do të aplikojnë rregullat e Komunitetit dhe Bashkimit Europian kur ka rregulla të Komunitetit ose të Bashkimit Europian, që rregullojnë lëndën e veçantë në fjalë dhe janë të aplikueshme për çështjen specifike, pa paragjykuar objektin dhe qëllimin e kësaj Konvente dhe pa paragjykuar aplikimin e saj të plotë me palët e tjera.

KAPITULLI XII
AMENDAMENTET E KONVENTËS

Neni 44
Amendamentet

1. Çdo propozim për një amendament të kësaj Konventë i paraqitur nga një palë do t'i komunikohet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit dhe do të paraqitet prej tij ose prej saj para vendeve anëtare të Këshillit të Europës, çdo nënshkruesi, çdo shteti palë, Komunitetit Europian, çdo shteti të ftuar për të nënshkruar këtë Konventë në përputhje me dispozitat e nenit 45, paragrafi 1 dhe çdo shteti të ftuar për të aderuar në përputhje me dispozitat e nenit 46, paragrafi 1.

2. Çdo amendament i propozuar nga një palë do t'i komunikohet Komitetit Europian për Problemet e Krimit (CDPC), i cili do t'i paraqesë Komitetit të Ministrave opinionin e vet për amendamentin e propozuar.

3. Komiteti i Ministrave do të konsiderojë amendamentin e propozuar nga CDPC dhe pas konsultimeve me palët shtetet jo anëtare në këtë Konventë mund të miratojë amendamentin. Teksti i një amendamenti, të miratuar nga Komiteti i Ministrave në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni, do t'i paraqitet palëve për pranim.

4. Çdo amendament i miratuar në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit që pason skadimin e periudhës së një muaji pas datës në të cilën palë e kanë informuar Sekretarin e Përgjithshëm që ata e kanë pranuar atë.

KAPITULLI XIII
KLAUZOLA PËRFUNDIMTARE

Neni 45
Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Konventa do të jetë e hapur për t'u nënshkruar nga vendet anëtare të Këshillit të Europës dhe shtete jo anëtare, që kanë marrë pjesë në hartimin e saj si dhe Komuniteti Europian.

2. Konventa i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit do të depozitohen tek Sekretari Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

3. Konventa do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit që pason skadimi i periudhës prej tre muajsh nga data në të cilën 5 nënshkrues, duke përfshirë të paktën tre vende anëtare të Këshillit të Europës, kanë shprehur pëlqimin e tyre për të qenë të detyruar nga Konventa në përputhje me dispozitat paragrafit të mësipërm.

4. Në lidhje me ndonjë shtet, që përmendet në paragrafin 1, ose Komunitetin Europian, i cili më pas shpreh pëlqimin e vet për të qenë i ligjuar prej tij Konventa do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit, që pason skadimin e periudhës prej 3 muajsh pas datës së depozitimit të këtij instrumenti, ratifikimi, pranimi ose miratimi.

Neni 46
Aderimi në Konventë

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Europës, pas konsultimit me Palët e kësaj Konvente dhe marrjes së miratimit të tyre unianim, mund të ftojë çdo Shtet joanëtar të Këshillit të Europës që nuk ka marrë pjesë në rishikimin e Konventës, të aderojë në këtë Konventë me anë të një vendimi të marrë nga shumica e parashikuar në nenin 20.d të statutit të Këshillit të Europës dhe me votë unianime të përfaqësuesve të shteteve kontraktues të autorizuar për të qënë në Komitetin e Ministrave.

2. Në lidhje me çdo shtet aderues, Konventa do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas mbarimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së depozitimit të instrumentit të aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 47
Zbatimi territorial

1. Çdo shtet ose Komuniteti Europian, në kohën e nënshkrimit ose kur depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, mund të përcaktojë territorin ose territoret në të cilat do të zbatohet kjo Konventë.

2. Në çdo datë të mëvonshme, çdo palë, me anë të një deklarate të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund të zgjerojë zbatimin e kësaj Konvente në ndonjë territor tjetër të përcaktuar në deklaratë dhe për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit është përgjegjës ose në emër të të cilit është i autorizuar të bëjë marrëveshje. Në lidhje me një territor të tillë, Konventa do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas mbarimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së kësaj deklarate nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë sipas dy paragrafëve pararendës, në lidhje me çdo territor të përcaktuar në këtë deklaratë, mund të tërhiqet me anë të një njoftimi të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Tërheqja do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas mbarimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së këtij njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 48
Rezervat

Nuk mund të bëhet asnjë rezervë në lidhje me ndonjë dispozitë të kësaj Konvente, me përjashtim të rezervave të vendosura shprehimisht. Çdo rezervë mund të tërhiqet në çdo kohë.

Neni 49
Denoncimi

Çdo palë mundet në çdo kohë të denoncojë këtë Konventë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Ky denoncim do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas mbarimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 50
Njoftimi

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të njoftojë shtetet anëtare të Këshillit të Europës, çdo shtet nënshkrues, çdo shtet palë, Komunitetin Europian, çdo shtet të ftuar për të nënshkruar këtë Konventë në përputhje me dispozitat e nenit 45 dhe çdo shtet të ftuar për të aderuar në këtë Konventë në përputhje me dispozitat e nenit 46, në lidhje me:

a) çdo nënshkrim;

b) depozitimin e çdo instrumenti ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi;

c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, në përputhje me nenin 45 dhe 46;

d) çdo amendim të miratuar në përputhje me nenin 44 dhe datën në të cilën ky amendim hyn në fuqi;

e) çdo rezervë të bërë sipas nenit 48;

f) çdo denoncim të bërë në zbatim të dispozitave të nenit 49;

g) çdo akt, njoftim ose komunikim tjetër në lidhje me këtë Konventë.

Në dëshmi sa më sipër, të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar rregullisht, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Lanzarote, më 25 tetor 2007, në gjuhën angleze dhe frënge, të dyja tekstet njëlloj autentike, në një kopje të vetme e cila do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'i dërgojë kopje të vërtetuara secilit shtet anëtar të Këshillit të Europës, shteteve joanëtare të cilat kanë marrë pjesë në rishikimin e kësaj Konvente, Komunitetit Europian dhe çdo shteti të ftuar për të aderuar në këtë Konventë.

LIGJ
Nr.10 155, datë 15.10.2009

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË SPANJËS PËR BASHKËPUNIMIN NË LUFTËN KUNDËR KRIMIT"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës për bashkëpunimin në luftën kundër krimit", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6303, datë 28.10.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.150, faqe 6783

MARRËVESHJE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË SPANJËS MBI BASHKËPUNIMIN NË LUFTËN KUNDËR KRIMIT

Republika e Shqipërisë dhe Mbretëria e Spanjës, në vijim "palët",

duke pranuar rëndësinë e thellimit dhe zhvillimit të bashkëpunimit për të luftuar krimin në format e ndryshme të tij;

duke dëshiruar në bazë të traktatit për miqësinë dhe bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës dhe, bërë më datë 22 nëntor 2001, të kontribuojnë në zhvillimin e marrëdhënieve të tyre dypalëshe;

të udhëhequra nga parimet e barazisë, reciprocitetit dhe asistencës së ndërsjellë,

kanë rënë dakord sa më poshtë:

Neni 1

1. Palët, sipas legjislacionit të tyre kombëtar dhe sipas kësaj Marrëveshjeje mbi bashkëpunimin, do të bashkëpunojnë në luftën kundër krimit, veçanërisht për format e organizuara të tij.

2. Palët do të bashkëpunojnë në luftën kundër formave të aktiviteteve kriminale, veçanërisht kundër:

a) terrorizmit;

b) krimeve kundër jetës dhe integritetit të personave;

c) trafikut të paligjshëm, prodhimit dhe tregtimit të drogave dhe substancave psikotrope, si edhe lëndëve të para dhe perkursorëve për prodhimin e tyre;

d) imigrimit të paligjshëm dhe trafikut të qenieve njerëzore dhe shkeljes së regjimit të pasaportave dhe vizave;

e) ndalimit të paligjshëm të personave dhe rrëmbimit të fëmijëve;

f) falsifikimit (prodhim, tjetërsim), përdorimit të paligjshëm të dokumenteve të identitetit (pasaportave, vizave dhe dokumenteve lidhur me mjetet motorike) dhe shpërndarjes mashtruese të monedhës, mjeteve të pagesës, çeqeve dhe letrave me vlerë;

g) kontrabandës;

h) pastrimit të parave;

i) falsifikimit (prodhim, tjetërsim) dhe shpërndarjes mashtruese të monedhës, mjeteve të pagesës, çeqeve dhe letrave me vlerë;

j) vjedhjes së mjeteve motorike dhe tregtisë së paligjshme me to dhe aktiviteteve kriminale të lidhura me to;

k) trafikut të paligjshëm të armëve, municionit, lëndëve plasëse, lëndëve të para strategjike, (materialeve bërthamore dhe radioaktive), si edhe substancave të tjetra përgjithësisht të rrezikshme, dhe mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë;

l) trafikut të paligjshëm të objekteve kulturore me vlerë historike dhe veprave të artit;

m) akteve kriminale kundër financave publike, përfshirë evazionin fiskal;

n) formave të organizuara të krimit kundër lirisë seksuale, veçanërisht atyre që lidhen me minorenët, si edhe shtypjen, përhapjen dhe dhënien e materialeve pornografike me pjesëmarrjen e minorenëve;

o) akteve kriminale me futjen në sistemet kompjuterike;

p) veprave penale kundër burimeve natyrore dhe ambientit.

3. Palët do të bashkëpunojnë gjithashtu në luftën kundër llojeve të tjera të krimeve, parandalimi, zbulimi dhe hetimi i të cilave kërkojnë bashkëpunimin e autoriteteve kompetente të të dy shteteve. Palët do të bashkëpunojnë edhe në zbatimin e ndërsjellë të masave të posaçme të mbrojtjes, përfshirë ndryshimin e vendbanimit dhe qëndrimit të personave të mbrojtur në territoret përkatëse të palëve, si edhe në shkëmbimin e përvojave të ekspertëve në fushën e mbrojtjes së dëshmitarëve.

Neni 2

1. Bashkëpunimi ndërmjet palëve, brenda kuadrit të luftës kundër krimit cituar në nenin 1, do të përfshijë shkëmbimin e informacionit dhe dhënien e asistencës në aktivitetin operacional për:

a) kontrollin dhe verifikimin e identitetit të personave dhe kërkimin për persona të cilët janë zhdukur;

b) hetimin dhe kërkimin për persona të cilët kanë kryer ose dyshohet se kanë kryer akte kriminale në territorin e cilësdo prej palëve dhe të bashkëpunëtorëve të tyre;

c) identifikimin e kufomave dhe personave të kërkuar nga policia;

d) kërkimin në territorin e njërës prej palëve për objekte, efekte ose instrumente të përfshira në krim ose të përdorura në kryerjen e tyre me kërkesën e palës tjetër kontraktuese;

e) financimin e aktiviteteve kriminale.

2. Palët kontraktuese do të bashkëpunojnë gjithashtu në:

a) shkëmbimin e informacionit dhe ndihmës së nevojshme për shoqërimin e të dënuarve, personave në kuadrin e Konventës për transferimin e personave me vendim gjykate;

b) shkëmbimin e informacionit dhe ndihmës së nevojshme për zhvendosjen e lëndëve radioaktive, lëndëve plasëse dhe armëve;

c) shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin e ndërsjellë në kryerjen e dorëzimeve të kontrolluara të lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope;

d) shkëmbimin e informacionit dhe ndihmën e ndërsjellë për transferimin ose kalimin tranzit të personave të dëbuar ose personave që u është refuzuar hyrja.

Neni 3

Në mënyrë që të arrijnë synimet e bashkëpunimit, palët:

a) do të informojnë njëra-tjetrën reciprokisht mbi hetime në proces në forma të ndryshme të krimit të organizuar, përfshirë terrorizmin dhe lidhjet, strukturën, funksionimin dhe metodat e tyre;

b) kryerjen e veprimtarive të koordinuara dhe do të asistojnë njëra-tjetrën në kuadrin e marrëveshjeve plotësuese të nënshkruara nga organet kompetente;

c) do të ndajnë informacione mbi metodat dhe format e reja të krimit ndërkombëtar;

d) do të ndajnë informacionet mbi rezultatet e hetimeve kriminale dhe kronologjike të kryera, si dhe informacione reciproke mbi teknikat, hetimet dhe metodat për luftën kundër krimit ndërkombëtar;

e) do të mbajnë (mbledhin), kurdo është e nevojshme, takime pune për të përgatitur dhe asistuar në kryerjen e masave të koordinuara.

Neni 4

Palët do të bashkëpunojnë në fushat e specifikuara nga kjo Marrëveshje nëpërmjet:

a) shkëmbimit të informacionit mbi situatën e përgjithshme dhe tendencat e krimit në shtetet e tyre respektive;

b) shkëmbimit të eksperiencës në përdorimin e teknologjisë kriminale, si edhe të metodave dhe mjeteve të hetimit penal, shkëmbimit të fletëpalosjeve, publikimeve dhe rezultateve të kërkimeve shkencore në fushat e specifikuara nga kjo Marrëveshje;

c) shkëmbimit të informacionit në fushat që janë përgjegjësi e shërbimeve për mbrojtjen e ligjshmërisë penale dhe shërbimeve të tjera përgjegjëse për mbrojtjen e sigurisë kombëtare, rendit publik dhe luftën kundër krimit;

d) asistencës teknike dhe shkencore, inspektimeve nga ekspertët dhe dhënia hua për përdorim të pajisjeve të specializuara teknike;

e) diskutimit të eksperiencave dhe shkëmbimeve të ekspertëve dhe konsultimeve;

f) bashkëpunimit në fushën e trajnimit profesional.

Neni 5

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk do të prekin çështjet lidhur me ekstradimin ose lidhur me dhënien e asistencës gjatë gjykimeve.

Neni 6

Organet përgjegjëse për zbatimin praktik të Marrëveshjes janë:

Për palën e Republikës së Shqipërisë: Ministria e Brendshme.

Për Palën e Mbretërisë së Spanjës: Ministria e Brendshme, pa cenuar kompetencat e ndonjë ministrie tjetër.

Neni 7

1. Shkëmbimi i informacionit dhe kërkesat për kryerjen e aktiviteteve të parashikuara në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje do t'u jepen me shkrim drejtpërsëdrejti organeve kompetente ose nëpërmjet atasheve ose oficerëve ndërlidhës. Për këtë qëllim, palët do të informojnë njëra-tjetrën për emërimin e këtyre të fundit.

Në raste urgjente organet kompetente mund të japin informacion të hollësishëm me gojë, me qëllim zbatimin me përpikëri të kësaj Marrëveshjeje dhe konfirmon modaliteteve me shkrim menjëherë pas kësaj.

2. Kërkesat për shkëmbim informacioni ose për kryerjen e aktiviteteve të parashikuara në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje do të kryhen nga organet kompetente brenda afatit më të shpejtë të mundshëm.

3. Shpenzimi lidhur me plotësimin e një kërkese ose me kryerjen e një veprimtarie do të merret nga organi kompetent i palës kërkuese.

Neni 8

1. Çdonjëra nga palët mund të refuzojë, tërësisht ose pjesërisht, të plotësojë ose të vendosë kushte në lidhje me respektimin e një kërkese për ndihmë ose informacion nëse ajo vlerëson se plotësimi i kërkesës paraqet kërcënim për sovranitetin ose sigurinë e saj, ose që ajo është në kundërshtim me parimet bazë të sistemit ligjor të saj (palës), ose me interesat e tjerë themelorë të shtetit.

2. Organi kompetent i palës kërkuese do të informohet rreth arsyes së refuzimit.

Neni 9

1. Shkëmbimi i informacionit ndërmjet palëve sipas kësaj Marrëveshjeje do të kryhet mbi bazën e kushteve të mëposhtme:

a) Pala kërkuese mund ta përdorë informacionin vetëm për qëllimet dhe sipas kushteve të vendosura nga pala e kërkuar, duke marrë në konsideratë limitin kohor pas kalimit të të cilit informacioni duhet të asgjësohet, në pajtim me legjislacionin e saj kombëtar.

b) Me kërkesë të palës së kërkuar, pala kërkuese do të japë informacion rreth përdorimit të të dhënave që u janë dhënë atyre dhe rreth rezultateve të arritura.

c) Nëse do të ndodhte që asaj (palës) i janë dhënë të dhëna të pasakta ose të paplota, pala e kërkuar do të njoftojë pa vonesë palën kërkuese;

d) Secila nga palët do të mbajë një procesverbal për raportet mbi të dhënat e dërguara dhe shkatërrimin e tyre.

2. Palët do të sigurojnë mbrojtje të të dhënave të dërguara kundër së drejtës së paautorizuar për njohjen dhe përdorimin e tyre, tjetërsimit të paautorizuar, publikimit ose përhapjes së paautorizuar në pajtim me ligjin e tyre kombëtar.

Gjithashtu, palët angazhohen me këtë Marrëveshje të mos i japin të dhënat personale të cilave u referohet ky nen ndonjë pale të tretë cilado qoftë të ndryshme nga organi që bën kërkesën që i përket palës kërkuese ose në rastin kur kjo e fundit duhej të zbatonte kërkesën, të dhënat mund t'u transferohen vetëm disa prej organeve të parashikuara në nenin 6 dhe mbi bazën e autorizimit paraprak të palës së kërkuar.

3. Secila palë mund të vërë në dukje në çfarëdo kohë mospajtueshmërinë nga ana e palës kërkuese me dispozitat e këtij neni si një arsye për ta pezulluar në mënyrë të menjëhershme zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe sipas rastit ta shfuqizojë atë automatikisht.

Neni 10

1. Palët do të krijojnë një komitet të përbashkët për të kryer dhe mbikëqyrur bashkëpunimin e rregulluar në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje. Organet kompetente do të njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim rreth përfaqësuesve të cilët ata kanë emëruar si anëtarë të komitetit të përbashkët.

2. Komiteti i përbashkët do të mblidhet, në sesion të rregullt, një herë në vit dhe në sesion të jashtëzakonshëm, me kusht që secila palë të kërkojë këtë, sipas datës, vendit dhe agjendës për të cilën do të bihet dakord nëpërmjet kanaleve diplomatike.

3. Me përjashtim kur ka një marrëveshje të posaçme ndërmjet palëve, takimet do të mbahen të alternuara në Spanjë dhe në Shqipëri. Takimet do të kryesohen nga kryetari i delegacionit të palës ku mbahet ky takim.

Neni 11

Mosmarrëveshjet që lindin nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhen me anë të negociatave ndërmjet palëve.

Neni 12

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk do të prekin zbatimin e dispozitave të marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare dypalëshe ose shumëpalëshe, ose angazhimeve në të cilat bën pjesë Mbretëria e Spanjës dhe Republika e Shqipërisë.

Neni 13

Kjo Marrëveshje do të zbatohet përkohësisht tridhjetë ditë që nga data e firmosjes së saj dhe do të hyjë në fuqi ditën e fundit të muajit mbas datës së marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, nëpërmjet të cilit palët informojnë njëra-tjetrën që ata kanë plotësuar kërkesat e ligjit të tyre të brendshëm të nevojshëm për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes.

Neni 14

Këtu përcaktohet që kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi deri në denoncimin nga cilado prej palëve nëpërmjet kanaleve diplomatike. Marrëveshja do të pushojë se qeni e vlefshme gjashtë muaj pas marrjes nga secila prej palëve të njoftimit për denoncim.

Në cilësinë e dëshmisë dhe të provës, përfaqësuesit e të dy shteteve, të autorizuar në mënyrën e duhur për këto qëllime nga qeveritë e tyre respekive, nënshkruajnë këtë Marrëveshje.

Bërë në Tiranë, më 20 maj 2009, në dy kopje identike, në gjuhët shqip dhe spanjisht, duke qenë të dy tekstet njëlloj autentike.

LIGJ
Nr.10 182, datë 29.10.2009

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN E KONFERENCËS SË HAGËS "PËR PROCEDURËN CIVILE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika Shqipërisë aderon në konventën e Konferencës së Hagës "Për procedurën civile", hyrë në fuqi më 12 prill 1957.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6341, datë 17.11.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.166, faqe 7334

KONVENTA
PËR PROCEDURËN CIVILE
(përfunduar më 1 mars 1954
& hyrë në fuqi më 12 prill 1957)

Shtetet palë në këtë Konventë,
me dëshirën për të bërë përmirësimet e sugjeruara nga përvoja, në Konventën mbi Procedurën Civile të datës 17 korrik 1905,
vendosën të përfundojnë këtë Konventë dhe të merren vesh përsa u përket dispozitave të mëposhtme:

I. KOMUNIKIMI I DOKUMENTEVE GJYQËSORE DHE JASHTËGJYQËSORE

Neni 1

Në çështjet civile dhe tregtare, dërgimi i dokumenteve që u adresohen personave jashtë vendit do të kryhet në shtetet kontraktuese nëpërmjet kërkesës së një konsulli të shtetit që bën kërkesën, drejtuar autoritetit që do të caktohet nga shteti që i adresohet kjo kërkesë. Kërkesa, që specifikon autoritetin e origjinës së dokumentit të dërguar, emrat dhe kompetencat e palëve, adresën e marrësit dhe natyrën e dokumentit në fjalë duhet të jenë në gjuhën e autoritetit që i bëhet kërkesa. Ky autoritet duhet t'i dërgojë konsullit certifikatën që tregon dërgimin ose që tregon faktin që e ka penguar atë.

Të gjitha vështirësitë që mund të lindin në lidhje me kërkesën e konsullit, do të zgjidhen nëpërmjet rrugëve diplomatike.

Çdo shtet kontraktues mund të deklarojë, nëpërmjet një komunikate që i drejtohet shteteve të tjera kontraktuese, se ai shpreh dëshirën që kërkesat për dërgimin që kryhen në territorin e tij, duke iu përmbajtur specifikimeve të përmendura në paragrafin e parë, duhet t'i drejtohen atij nëpërmjet rrugëve diplomatike.

Dispozitat e mësipërme nuk i pengojnë dy shtete kontraktuese që të bien dakord për lejimin e komunikimit të drejtpërdrejtë midis autoriteteve të tyre respektive.

Neni 2

Dërgimi do të kryhet nga ana e autoritetit që është kompetent sipas ligjeve të shtetit që i drejtohet kërkesa. Ky autoritet, me përjashtim të rasteve të përmendura në nenin 3, mund të kufizojë veten duke ia dërguar dokumentin një marrësi që e pranon atë vullnetarisht.

Neni 3

Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentin që do të dërgohet në dy kopje.

Nëse dokumenti që do të dërgohet, është shkruar në gjuhën e autoritetit që i drejtohet kërkesa apo në gjuhën që është rënë dakord midis dy shteteve të interesuara, ose nëse ai është i shoqëruar me një përkthim në njërën prej këtyre gjuhëve, autoritetit që i drejtohet kërkesa, nëse kjo kërkesë shpreh dëshirën, duhet të dërgojë dokumentin me një metodë të përshkruar me anë të legjislacionit kombëtar për kryerjen e një dërgimi të tillë ose me anë të një metode specifike, përveçse në rastet kur këto bien në kundërshtim me atë ligj. Nëse një dëshirë e tillë nuk është shprehur, atëherë autoriteti që i drejtohet kërkesa duhet që fillimisht të kërkojë të kryejë dërgesën në përputhje me nenin 2.

Përveçse kur ka marrëveshje në kundërshtim me këtë, përkthimi i bërë sipas paragrafit të mëparshëm, do të certifikohet si i saktë nga zyrtari diplomatik ose agjenti konsullor i shtetit që bën kërkesën ose nga një përkthyes i licencuar i shtetit, të cilit i është drejtuar kërkesa.

Neni 4

Kur një kërkesë për dërgime është në përputhje me nenet 1, 2 dhe 3, shteti në territorin e të cilit do të kryhet kjo kërkesë mund të refuzojë të jetë dakord me të vetëm nëse ai gjykon se rënia dakord mund të cenojë sovranitetin dhe sigurinë e tij.

Neni 5

Dërgimi duhet të provohet nëpërmjet një vërtetimi të legalizuar dhe të datuar nga ana e marrësit ose të një certifikate nga ana e autoritetit të shtetit të cilit i drejtohet kërkesa, me anë të së cilës përcaktohet prova, metoda dhe data e dërgimit.

Vërtetimi i legalizuar ose certifikata duhet të vendoset në një prej të dy kopjeve të dokumentit të dërguar ose t'i bashkëlidhen atij.

Neni 6

Dispozitat e neneve të mësipërme nuk duhet të bien ndesh me:

1) lirinë për dërgimin e dokumenteve nëpërmjet rrugëve postare, drejtpërdrejt personave të interesuar jashtë shtetit;

2) lirinë e personave të interesuar për të përfituar dërgime të kryera drejtpërdrejt nëpërmjet oficerëve gjyqësorë ose zyrtarëve kompetentë të vendit të destinacionit;

3) lirinë e secilit shtet për të përfituar dërgime të kryera drejtpërdrejt nëpërmjet agjentëve të tij diplomatikë apo konsullorë për dokumentet që kanë si objekt personat jashtë shtetit.

Në secilin prej këtyre rasteve, liria e përmendur duhet të ekzistojë vetëm nëse lejohet nga konventat e lidhura midis shteteve të interesuara ose nëse nuk ekziston ndonjë konventë, shteti në territorin e të cilit do të kryhet dërgimi nuk ka kundërshtime. Ky shtet mund të mos ketë kundërshtime kur, në rastet e përmendura në nënparagrafin 3 të paragrafit të mësipërm, dokumenti duhet të dërgohet pa asnjë lloj detyrimi mbi një shtetas të shtetit që bën kërkesën.

Neni 7

Dërgimi i dokumenteve gjyqësore nuk duhet të shkaktojë rimbursimin e taksave apo të shpenzimeve të çdo lloj natyre.

Megjithatë, nëse nuk ka ndonjë marrëveshje kundërshtuese, shteti që merr kërkesën, do të ketë të drejtën të kërkojë nga shteti që bën kërkesën rimbursimin e shpenzimeve të rastit që lidhen me punësimin e një oficeri gjyqësor ose me përdorimin e një metode specifike dërgimi sipas rasteve të përmendura në nenin 3.

II. LETËRKËRKESAT

Neni 8

Në çështjet civile ose tregtare, një autoritet gjyqësor i një shteti kontraktues mund të aplikojë, në përputhje me dispozitat e ligjit të atij shteti, nëpërmjet një letërkërkese, ndaj autoritetit kompetent të një shteti tjetër kontraktues, duke i kërkuar atij autoriteti, brenda fushës së juridiksionit të tij, të sigurojë prova ose të kryejë ndonjë akt tjetër gjyqësor.

Neni 9

Letërkërkesat transmetohen nëpërmjet konsullit të shtetit që bën kërkesën për autoritetin që do të caktohet nga shteti që bën ekzekutimin e saj. Ky autoritet do t'i dërgojë konsullit dokumentin që vendos ekzekutimin e letërkërkesës ose tregon provën dhe shkaqet që kanë penguar ekzekutimin e saj.

Çdo vështirësi që mund të lindë në lidhje me transmetimin, duhet të zgjidhet nëpërmjet rrugëve diplomatike.

Çdo shtet kontraktues mund të deklarojë, nëpërmjet një komunikate të drejtuar shteteve të tjera kontraktuese, që ky shtet shpreh dëshirën që çdo letërkërkesë për t'u ekzekutuar në territorin e tij duhet t'i transmetohet atij nëpërmjet rrugëve diplomatike.

Dispozitat e mësipërme nuk i pengojnë dy shtete kontraktuese që të bien dakord për të lejuar transmetim të drejtpërdrejtë të letërkërkesave midis autoriteteve të tyre respektive.

Neni 10

Përveçse në rastet kur ka një marrëveshje kundërshtuese, letërkërkesat duhet të shkruhen ose në gjuhën e autoritetit që i drejtohet kërkesa, ose në gjuhën e rënë dakord midis dy shteteve të interesuara, ose ato duhet të shoqërohen me një përkthim në një prej këtyre gjuhëve dhe të certifikuar si të saktë nga një zyrtar diplomatik ose agjent konsullor i shtetit të origjinës së kërkesës, ose nga një përkthyes i licencuar i shtetit që do të bëjë ekzekutimin e saj.

Neni 11

Autoriteti gjyqësor, të cilit i është drejtuar letërkërkesa, është i detyruar ta respektojë atë duke përdorur të njëjtat masa detyruese, si dhe për ekzekutimin e urdhrave të lëshuara nga

autoritetet e shtetit që bën ekzekutimin ose të kërkesave të bëra nga palët në procedimet e brendshme. Këto masa detyruese nuk do të përdoren domosdoshmërisht në rastet kur përfshihet paraqitja e palëve në procedime të brendshme.

Autoriteti që bën kërkesën, nëse e kërkon një gjë të tillë, duhet të informohet mbi datën dhe vendin e ekzekutimit të masës së kërkuar, në mënyrë që palës së interesuar t'i krijohet mundësia të jetë e pranishme.

Ekzekutimi i letërkërkesës mund të refuzohet vetëm në rastet kur:

1) nuk është saktësuar vërtetësia e dokumentit;

2) në shtetin që bëhet ekzekutimi, ekzekutimi i letërkërkesës nuk është brenda fushës së përgjegjësisë së gjyqësorit;

3) shteti, në territorin e të cilit do të kryhet ekzekutimi, çmon se ky ekzekutim cenon sovranitetin dhe sigurinë e tij.

Neni 12

Nëse autoriteti të cilit i është transmetuar një letërkërkesë, nuk është kompetent për ta ekzekutuar atë, letra duhet t'i dërgohet automatikisht autoritetit përkatës në të njëjtin shtet, i cili është kompetent për ekzekutimin e tij në përputhje me dispozitat e ligjit të këtij vendi.

Neni 13

Në të gjitha rastet, kur letërkërkesa nuk është ekzekutuar nga ana e autoritetit që i drejtohet kjo letër, kjo e fundit duhet ta njoftojë menjëherë autoritetin që ka bërë kërkesën, duke treguar, në rastin e nenit 11, arsyet e refuzimit të ekzekutimit të letrës dhe, në rastin e nenit 12, autoritetin përkatës të cilit i është transmetuar kjo letër.

Neni 14

Autoriteti gjyqësor që ekzekuton një letërkërkesë zbaton ligjin e vendit të vet përsa i përket metodave dhe procedurave që do të ndiqen.

Megjithatë, ky autoritet mund të plotësojë një kërkesë të autoritetit që bën kërkesën në lidhje me ndjekjen e një metode apo procedure specifike, përveçse në rastet kur ato bien në kundërshtim me ligjin në fuqi të shtetit ku do të kryhet ekzekutimi.

Neni 15

Dispozitat e neneve të mësipërme nuk përjashtojnë të drejtën e secilit shtet për të ekzekutuar drejtpërdrejt letërkërkesat, nëpërmjet zyrtarëve diplomatikë ose agjentëve konsullorë të tij, nëse kjo lejohet nga konventat e lidhura midis shteteve të interesuara ose nëse shteti në territorin e të cilit do të ekzekutohet letra nuk ka kundërshtim për këtë.

Neni 16

Ekzekutimi i letërkërkesave nuk duhet të shkaktojë rimbursim të taksave apo të shpenzimeve të çdo lloj natyre.

Megjithatë, në rastet kur nuk ekziston ndonjë marrëveshje kundërshtuese, shteti që kryen ekzekutimin, ka të drejtën t'i kërkojë shtetit të origjinës rimbursimin e shpenzimeve të rastit që lidhen me tarifat e paguara për dëshmitarët ose ekspertët, të shpenzimeve për punësimin e ndonjë oficeri gjyqësor, të cilat bëhen të nevojshme kur dëshmitarët nuk paraqiten vullnetarisht, si dhe të shpenzimeve që rezultojnë nga zbatimi i paragrafit të dytë të nenit 14.

III. SIGURIA PËR SHPENZIMET

Neni 17

Asnjë siguri, obligacion ose depozitë e çdo lloji nuk mund të vendoset për arsye të kombësisë së tyre të huaj, ose për shkak të mungesës së vendbanimit apo rezidencës në vend, mbi shtetasit e një prej shteteve kontraktuese, që e kanë vendbanimin e tyre në njërin nga këto shtete, dhe që janë palë paditëse ose palë ndërmjetëse para gjykatave të një prej këtyre shteteve.

I njëjti rregull do të respektohet për çdo pagesë të kërkuar nga pala paditëse apo pala ndërmjetëse si siguri për shpenzimet e gjykatës.

Të gjitha konventat, për të cilat shtetet kontraktuese kanë rënë dakord që shtetasit e tyre të përjashtohen nga dhënia e sigurisë për kostot ose për pagesat për shpenzimet gjyqësore, pavarësisht nga vendbanimi i tyre, do të vazhdojnë të zbatohen.

Neni 18

Urdhrat për kostot dhe shpenzimet e seancave gjyqësore, të bëra në një nga shtetet kontraktuese kundër palës paditëse apo asaj ndërmjetëse të përjashtuara nga masa e sigurisë, depozitës apo pagesës sipas paragrafit të parë dhe të dytë të nenit 17, ose sipas ligjit të shtetit ku ka filluar gjykimi, përmes kërkesës së bërë nëpërmjet rrugëve diplomatike, do të bëhen të zbatueshme pa ndonjë detyrim financiar nga autoriteti kompetent, në secilin nga vendet e tjera të shteteve kontraktuese.

I njëjti rregull do të zbatohet edhe për vendimet gjyqësore për të cilat sasia e shpenzimeve të seancave gjyqësore është përcaktuar në vijim.

Asgjë sa shprehet në dispozitat e mësipërme nuk i pengon dy shtete kontraktuese të lidhin marrëveshje që aplikimet për zbatueshmërinë mund të bëhen gjithashtu edhe drejtpërdrejt midis palëve të interesuara.

Neni 19

Urdhri për kostot dhe shpenzimet do të bëhet i zbatueshëm pa asnjë seancë dëgjimore, por mund të jetë objekt i apelimit të mëtejshëm të palës humbëse në përputhje me legjislacionin e vendit ku është kërkuar zbatueshmëria.

Autoriteti kompetent për të vendosur mbi kërkesën për detyrimin e zbatueshmërisë, duhet të shqyrtojë nga ana e tij, nëse:

1) sipas ligjit të vendit ku është dhënë vendimi, kopja e vendimit përmbush kushtet e kërkuara për vërtetësinë e tij;

2) sipas të njëjtit ligj, vendimi ka forcën e *res judicata*;

3) ajo pjesë e gjykimit që përbën vendimin është përpiluar në gjuhën e autoritetit, të cilit i drejtohet kërkesa ose në gjuhën e rënë dakord midis dy shteteve të interesuara, ose nëse është shoqëruar me një përkthim në njërën prej atyre gjuhëve dhe, përveçse në rastet kur ka një marrëveshje kundërshtuese, ajo të jetë e certifikuar nga një zyrtar diplomatik ose një agjent konsullor të shtetit që ka bërë kërkesën ose nga një përkthyes i licencuar i shtetit të cilit i drejtohet kërkesa.

Për të përmbushur kushtet e përshkruara në paragrafin e dytë, nënparagrafët 1 dhe 2, është e mjaftueshme ose duke pasur një deklaratë nga ana e autoritetit kompetent të shtetit të origjinës që përcakton se vendimi ka fuqinë e *res judicata*, ose duke paraqitur dokumentet e duhura të legalizuara që tregojnë se vendimi ka fuqinë e *res judicata*. Kompetenca e autoritetit të përmendur më sipër, përveçse në rastet kur ka një marrëveshje kundërshtuese, duhet të certifikohet nga zyrtari më i lartë në detyrë i administratës së drejtësisë të shtetit të origjinës që ka bërë kërkesën. Deklarata dhe certifikata e përmendur më sipër duhet të përpilohen apo përkthehen në përputhje me rregullin e përshkruar në paragrafin e dytë, nënparagrafi 3.

Autoriteti kompetent për të vendosur në lidhje me kërkesën e detyrimit të zbatueshmërisë, duhet të vlerësojë nëse pala e interesuar kërkon një gjë të tillë në të njëjtën kohë, sasinë e shpenzimeve të vërtetimit, përkthimit dhe legalizimit që i referohen nënparagrafit 3 të paragrafit të dytë. Kjo kosto do të konsiderohet si kosto dhe shpenzime të procedimeve.

IV. ASISTENCA LIGJORE FALAS

Neni 20

Në çështjet civile dhe tregtare, shtetasve të shteteve kontraktuese do t'u jepet asistencë ligjore falas në të gjitha shtetet e tjera kontraktuese, mbi të njëjtat baza si shtetas të këtyre shteteve, në përputhje me legjislacionin e shtetit ku kërkohet kjo asistencë ligjore falas.

Në shtetet ku asistenca ligjore jepet për çështje administrative, dispozitat e paragrafit të mësipërm do të zbatohen gjithashtu edhe për çështjet gjyqësore që çohen në gjykatat kompetente për çështje të tilla.

Neni 21

Në të gjitha rastet, certifikata ose deklarata e kërkesës duhet të lëshohet, ose merret nga autoritetet e vendbanimit të përhershëm të personit të huaj, ose nëse jo prej tyre, nga ana e autoriteteve të vendbanimit aktual të tij. Nëse këto autoritete të fundit nuk i përkasin një shteti kontraktues dhe nuk lëshojnë ose marrin deklarata apo certifikata të këtij lloji, është e mjaftueshme të lëshohet një certifikatë ose deklaratë e dhënë apo marrë nga një zyrtar diplomatik, ose agjent konsullor i vendit të cilit personi i huaj i përket.

Nëse personi që bën kërkesën nuk banon në vendin nga është bërë kërkesa, certifikata ose deklarata e kërkesës legalizohet pa pagesë nga një zyrtar diplomatik ose agjent konsullor i vendit ku përgatitet ky dokument.

Neni 22

Autoriteti kompetent për lëshimin e certifikatës ose marrjen e deklaratës së kërkesës mund të sigurojë informacion në lidhje me gjendjen financiare të personit që bën kërkesën, nga autoritetet e shteteve të tjera kontraktuese.

Autoriteti përgjegjës për të vendosur në aplikimet për asistencë ligjore falas duhet të ketë të drejtën, brenda kufijve të autoritetit të tij, të verifikojë certifikatat, deklaratat dhe informacionin e dhënë atij, si dhe të kërkojë për verifikim dhe informacion të mëtejshëm.

Neni 23

Kur personi i interesuar, me të ardhura tepër të kufizuara, është në një vend të ndryshëm nga ai ku kërkohet asistencë ligjore falas, aplikimi i tij për asistencë ligjore falas, i shoqëruar me certifikatat, deklaratat e kërkesës dhe, aty ku është e nevojshme, edhe dokumente të tjera ndihmëse që mund të lehtësojnë shqyrtimin e aplikimit, mund të transmetohen nga konsulli i vendit të tij për autoritetin kompetent vendimmarrës për atë aplikim ose për autoritetin e caktuar nga shteti ku do të shqyrtohet aplikimi.

Për transmetimin e aplikimeve për asistencë ligjore falas, do të respektohen dispozitat në nenin 9, paragrafët 2, 3 dhe 4, dhe në nenet 10 dhe 12 më sipër, që kanë të bëjnë me letrat e kërkesës, si dhe shtojcat e tyre.

Neni 24

Nëse një shtetasi të një prej shteteve kontraktuese i është dhënë përfitim i asistencës ligjore, dërgimi i dokumenteve që kanë të bëjnë me rastin e tij në një shtet tjetër kontraktues, pavarësisht

metodës që ky dërgim do të kryhet, nuk do të shkaktojë rimbursime të shpenzimeve nga shteti i origjinës për shtetin të cilit i drejtohet kërkesa.

E njëjta gjë respektohet edhe për letrat e kërkesës, me përjashtim të tarifave që paguhen për ekspertët.

V. LËSHIM FALAS I DOKUMENTEVE NGA REGJISTRI I GJENDJES CIVILE

Neni 25

Personat e varfër që janë shtetas të një prej shteteve kontraktuese mund të marrin pa pagesë me të njëjtat kushte si shtetasit e shtetit të interesuar, dokumente nga regjistri i gjendjes civile. Dokumentet e nevojshme për martesat e tyre duhet të legalizohen pa pagesë nga ana e zyrtarit diplomatik ose agjentit konsullor të shteteve kontraktuese.

KAPITULLI VI
NDALIMI FIZIK

Neni 26

Ndalimi fizik, qoftë si mjet zbatimi ose thjesht si një masë e përkohshme, nuk do të përdoret në fushën civile dhe tregtare ndaj të huajve që janë shtetas të njërës prej palëve kontraktuese në rrethanat kur nuk do të mund të përdorej ndaj shtetasve të vetë atij shteti. Një fakt që mund të përdoret nga një shtetas me banim në këtë vend për t'i shpëtuar ndalimit fizik, mund të përdoret me të njëjtin efekt nga shtetas i një pale kontraktuese, edhe nëse ai fakt ka ndodhur jashtë vendit.

KAPITULLI VII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 27

Kjo konventë është e hapur për t'u firmosur nga shtetet anëtare të përfaqësuara gjatë sesionit të shtatë të Konferencës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private.

Kjo konventë do të ratifikohet dhe instrumentet e ratifikimit do të depozitohen pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta.

Çdo instrument ratifikimi që do të depozitohet, do të regjistrohet dhe një kopje e vërtetuar e këtij regjistrimi do t'i përcillet çdo shteti nënshkrues përmes kanaleve diplomatike.

Neni 28

Kjo Konventë do të hyjë në fuqi në ditën e gjashtëdhjetë pas depozitimit të instrumentit të katërt të ratifikimit siç parashikohet në paragrafin e dytë të nenit 27.

Konventa do të hyjë në fuqi për çdo shtet palë që e ratifikon atë në një datë të mëvonshme në ditën e gjashtëdhjetë pas depozitimit të instrumentit përkatës të ratifikimit.

Neni 29

Kjo Konventë do të zëvendësojë, në lidhje me shtetet që e kanë ratifikuar atë, Konventën mbi Procedurën Civile të nënshkruar në Hagë, më 17 korrik 1905.

Neni 30

Kjo Konventë do të zbatohet ligjërisht në territoret metropolitane të palëve kontraktuese.

Çdo shtet mund të deklarojë që kjo Konventë do të shtrihet në të gjithë territorin ose në një ose më shumë njësi territoriale të tij për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilëve ai është përgjegjës, përmes një dokumenti me shkrim që do të depozitohet pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta. Ministria e Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta do t'i përcjellë një kopje të vërtetuar të këtij dokumenti çdo shteti nënshkrues përmes kanaleve diplomatike.

Konventa do të hyjë në fuqi ndërmjet shteteve të cilët nuk kanë paraqitur ndonjë kundërshtim për këtë aderim brenda gjashtëdhjetë ditëve pas këtij komunikimi dhe territorit ose territoreve për marrëdheniet ndërkombëtare të të cilëve shteti në fjalë është përgjegjës dhe në lidhje me të cilin është bërë komunikimi i mësipërm.

Neni 31

Çdo shtet që nuk është përfaqësuar gjatë sesionit të shtatë të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private mund të aderojë në këtë Konventë, nëse asnjë nga shtetet të cilat e kanë ratifikuar atë nuk kanë paraqitur ndonjë kundërshtim në lidhje me këtë aderim brenda gjashtë muajve nga data e njoftimit prej Qeverisë së Vendeve të Ulëta për këtë aderim. Aderimi do të kryhet sipas mënyrës së parashikuar në paragrafin e dytë të nenit 27.

Shtetet të cilat e kanë ratifikuar atë, nuk kanë paraqitur ndonjë kundërshtim në lidhje me këtë aderim brenda gjashtë muajve nga data e njoftimit prej Qeverisë së Vendeve të Ulëta për këtë aderim. Aderimi do të kryhet sipas mënyrës së parashikuar në paragrafin e dytë të nenit 27.

Një aderim i tillë nuk do të mund të kryhet deri pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në përputhje me nenin 28, paragrafi i parë.

Neni 32

Çdo palë kontraktuese, gjatë firmosjes dhe ratifikimit të kësaj Konvente apo aderimit në të, mund të rezervojë të drejtën të kufizojë zbatimin e nenit 17 te shtetasit e palëve kontraktuese që kanë vendbanimin e përhershëm në territorin e tij.

Çdo shtet që shfrytëzon të drejtën e përmendur në paragrafin më sipër do të jetë në gjendje të pretendojë zbatimin e nenit 17 nga palët kontraktuese vetëm në emër të shtetasve të vet, të cilët kanë vendbanimin e përhershëm në territorin e palës tjetër kontraktuese përpara gjykatës së të cilës ata janë palë kërkuese ose palë të treta.

Neni 33

Kjo Konvente do të mbetet në fuqi për një periudhë 5-vjeçare nga dita e treguar në paragrafin e parë të nenit 28 të Konventës.

Kjo periudhë do të fillojë që nga ajo ditë edhe për shtetet që e kanë ratifikuar ose kanë aderuar në të në një datë të mëvonshme.

Në rast se nuk ka pasur asnjë denoncim, Konventa do të rinovohet në mënyrë të heshtur çdo pesë vjet. Çdo denoncim duhet t'i njoftohet të paktën 6 muaj përpara mbarimit të periudhës pesëvjeçare pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta, e cila do të informojë shtetet e tjera palë për këte denoncim.

Denoncimi mund të jetë i kufizuar në një territor ose territore të caktuara në të cilat zbatohet Konventa, përmes një njoftimi të dhënë në përputhje me nenin 30, paragrafi i dytë.

Denoncimi do të këtë efekt vetëm përsa i përket shtetit i cili e ka bërë atë. Konventa do të qëndrojë në fuqi për shtetet e tjera palë.

Në dëshmi të sa më sipër, nënshkruesit, të autorizuar posaçërisht, nënshkruajnë këtë Konventë.

Bërë në Hagë më 1 mars 1954, në një kopje të vetme, e cila depozitohet në arkivat e Qeverisë së Vendeve të Ulëta, prej së cilës një kopje e vërtetuar i dërgohet nëpërmjet kanaleve diplomatike çdo shteti të përfaqësuar në sesionin e shtatë të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private.

LIGJ
Nr.10 162, datë 15.10.2009

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ÇEKISË PËR BASHKËPUNIMIN NË LUFTËN KUNDËR KRIMIT"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekisë për bashkëpunimin në luftën kundër krimit", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6310, datë 28.10.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.150, faqe 6796

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ÇEKISË PËR BASHKËPUNIM NË LUFTËN KUNDËR KRIMIT

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Çekisë (të referuara më poshtë si "Palë kontraktuese"),

të ndërgjegjshme për rrezikun nga shtrirja e krimit ndërkombëtar, në veçanti nga përdorimi dhe trafikimi i drogave narkotike dhe substancave psikotrope në nivel ndërkombëtar;

të bindura se bashkëpunimi në luftën kundër krimit të organizuar, trafiqeve të paligjshme të drogave narkotike dhe substancave psikotrope, terrorizmit dhe formave të tjera të krimit ose në parandalimin e tyre, është i një rëndësie thelbësore;

të vetëdijshme mbi natyrën serioze të rritjes së migracionit të paligjshëm dhe rreziqet për sigurinë, të lidhura me të;

duke dëshiruar ta zhvillojnë në mënyrë efektive bashkëpunimin dypalësh;

në përputhje me detyrimet ndërkombëtare dhe legjislacionin e tyre kombëtar përkatës,

kanë rënë dakord për sa më poshtë:

Neni 1

1. Palët kontraktuese do të bashkëpunojnë në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar dhe detyrimet ndërkombëtare të shteteve të tyre në parandalimin dhe zbulimin e krimeve dhe autorëve të krimit, duke u fokusuar në luftën kundër krimit të organizuar.

2. Në përputhje me paragrafin 1, palët kontraktuese do të bashkëpunojnë për të luftuar:

a) krimet kundër jetës dhe shëndetit;

b) terrorizmin dhe financimin e tij;

c) trafikimin e qenieve njerëzore, shfrytëzimin e prostitucionit, trafikimin e paligjshëm të organeve dhe indeve të qenieve njerëzore;

d) abuzimin dhe pornografinë e fëmijëve;

e) manifestimin e ekstremizmit, urrejtjes raciale dhe ksenofobisë;

f) trafikun e paligjshëm të drogave narkotike dhe substancave psikotrope, në përputhje me Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe substancave psikotrope (Vjenë, 20 dhjetor 1988);

g) prodhimin e paligjshëm, mbledhjen, zotërimin, importimin, eksportimin, transportimin dhe tregtimin e paligjshëm të armëve, municioneve dhe lëndëve plasëse, materialeve kimike, biologjike, radioaktive dhe bërthamore, mallrave dhe teknologjive të një rëndësie strategjike dhe me materiale ushtarake, si edhe substanca të tjera me rrezik të lartë, duke përfshirë këtu edhe lëndët me mbetje të rrezikshme;

h) falsifikimin dhe qarkullimin e monedhave, mjeteve të pagesës jo me para në dorë, falsifikimin e dokumenteve zyrtare, pasaportave, vizave, vulave dhe letrave me vlerë;

i) transaksioneve financiare të paligjshme, legalizimin e pasurive që burojnë nga krimi;

j) korrupsionin dhe kontrabandën;

k) krimin që lidhet me objektet me vlerë kulturore dhe historike;

l) vjedhjen dhe përvetësimin e mjeteve motorike;

m) krimet kundër pronësisë intelektuale;

n) krimin kibernetik.

3. Palët kontraktuese do të bashkëpunojnë gjithashtu në luftën ndaj migracionit të paligjshëm, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar dhe detyrimet ndërkombëtare të shteteve të tyre.

4. Palët kontraktuese do të bashkëpunojnë gjithashtu në përgatitjen për luftën kundër krimit, brenda qëllimit të paragrafit 1 dhe 3.

5. Bashkëpunimi nën këtë Marrëveshje nuk do të përfshijë sigurimin e asistencës ligjore në çështje kriminale, gjë që është brenda kompetencave të organeve gjyqësore.

Neni 2

Gjatë bashkëpunimit, në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, palët kontraktuese, në veçanti:

a) Do të njoftojnë njëra-tjetrën mbi konkluzionet dhe të dhënat në lidhje me krimet, personat e dyshuar dhe të përfshirë në kryerjen e krimeve, lidhjet ndërmjet autorëve të krimit, informacion mbi organizimin dhe strukturën e grupeve që kryejnë krime, sjelljen tipike të autorëve të krimit dhe grupeve kriminale, mbi shkeljen e së drejtës penale dhe masat e miratuara për këtë qëllim;

b) Do t'i sigurojnë njëra-tjetrës informacion mbi aktet terroriste të planifikuara, të drejtuara kundër interesave të shteteve të palëve kontraktuese, dhe mbi grupet terroriste, anëtarët e të cilave planifikojnë, kryejnë ose kanë kryer krime në territorin e shteteve të palëve kontraktuese;

c) Do të bashkëpunojnë për kërkimin e personave që dyshojnë se kanë kryer krim, si edhe ata që përpiqen t'i shmangen përgjegjësisë penale ose t'i shmangen vuajtjes së dënimit;

d) Do të bashkëpunojnë për kërkimin e personave të humbur, përfshirë këtu edhe identifikimin e personave apo kufomave;

e) Do të bashkëpunojnë për identifikimin dhe sekuestrimin e përfitimeve të krimit dhe mjeteve të financimit të terrorizmit;

f) Do të bashkëpunojnë për kërkimin e sendeve;

g) Do të bashkëpunojnë për kryerjen e masave që janë zbatuar në lidhje me programet për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të personave të tjerë që ndodhen nën kërcënim fizik ose ndonjë rrezik tjetër serioz në lidhje me një procedim penal;

h) Do të bashkëpunojnë në monitorimin e dërgesave të kontrolluara për të zgjidhur një vepër penale;

i) Do t'i japin njëra-tjetrës asistencë personale, teknike dhe organizative për parandalimin e krimeve, si dhe zbulimin e autorëve të krimit;

j) Kur është e nevojshme, do të mblidhen në takime pune mbi çështjet penale konkrete nën hetim, si edhe për të përgatitur dhe koordinuar masat;

k) Do të shkëmbejnë informacion mbi rezultatet që dalin nga kërkimet penale dhe kriminologjike, në praktikat e hetimit, metodat dhe mjetet e punës;

l) Do të shkëmbejnë informacion mbi metodat dhe format e reja të kryerjes së krimeve që kalojnë kufijtë e shteteve të palëve kontraktuese;

m) Do t'i japin njëra-tjetrës informacion mbi objektet e përdorura si instrumente të krimit ose produkte të krimit, ose ekzemplarët e tyre;

n) Do të shkëmbejnë informacion dhe do të bashkëpunojnë në fushën e luftës kundër migracionit të paligjshëm;

o) Do të shkëmbejnë rregullore ligjore, dokumente analitike dhe konceptuale, dhe literaturë të specializuar;

p) Do të bashkëpunojnë në fushën e arsimit, edukimit dhe trajnimit të mëtejshëm të punonjësve të policisë dhe shkëmbimin e specialistëve me qëllim rritjen e njohurive të tyre profesionale, mbështetjen për shkëmbimin e përvojës dhe për të mësuar rreth mënyrave dhe metodave për luftimin e krimit.

Neni 3

Organet e mëposhtme do të jenë kompetente për bashkëpunimin nën këtë Marrëveshje brenda përgjegjësive të tyre (më poshtë referuar si "organet kompetente"):

Në Republikën e Shqipërisë:
a) Ministria e Brendshme,
b) Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
c) Ministria e Financave,
d) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Në Republikën Çeke:
a) Ministria e Brendshme,
b) Presidiumi Policor i Republikës Çeke,
c) Ministria e Financave-Seksioni i Financës dhe Analizës,
d) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Neni 4

1. Palët kontraktuese do t'i japin njëra-tjetrës adresa, numra telefoni dhe faksi dhe kontakte të tjera të organeve kompetente dhe departamenteve të tyre jo më vonë se data e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes. Organet kompetente do të njoftojnë menjëherë njëra-tjetrën për çdo ndryshim të këtyre të dhënave.

2. Palët kontraktuese do ta njoftojnë menjëherë njëra-tjetrën mbi çdo ndryshim që ka të bëjë me përgjegjësitë dhe emrat e organeve kompetente.

Neni 5

1. Asistenca, sipas kësaj Marrëveshjeje, do të sigurohet sapo të kërkohet. Kërkesa për informacion, mjete, ekzemplarë, si dhe miratimi për masa ose forma të tjera të asistencës, sipas kësaj Marrëveshjeje, do të dërgohet me shkrim, mundësisht me faks ose postë elektronike nëpërmjet organeve kompetente. Në raste urgjente, kërkesa mund të dërgohet verbalisht e pasuar më pas nga një konfirmim i menjëhershëm me shkrim, mundësisht me faks ose postë elektronike.

2. Organi kompetent i palës kontraktuese kërkuese do ta shqyrtojë kërkesën sipas paragrafit 1, pa vonesë. Organi kompetent i palës kontraktuese, të cilit i drejtohet kërkesa, mund të kërkojë informacione shtesë, nëse është e nevojshme, për të shqyrtuar kërkesën.

3. Në raste të veçanta, organet kompetente të palëve kontraktuese do t'i japin njëra-tjetrës informacion, pa paraqitjen e një kërkese, nëse mendojnë se informacioni është i rëndësishëm për palën tjetër kontraktuese, me qëllim parandalimin ose zbulimin e krimeve ose autorëve të krimeve.

Neni 6

1. Palët kontraktuese mund ta refuzojnë plotësisht ose pjesërisht kërkesën për asistencë apo formë tjetër bashkëpunimi, sipas kësaj Marrëveshjeje, nëse pranimi i saj mund të dhunojë sovranitetin e palës kontraktuese, sigurinë apo ndonjë interes tjetër të rëndësishëm ose nëse është në kundërshtim me rregullat kombëtare ligjore apo detyrimet e saj përkatëse ndërkombëtare të shtetit të saj.

2. Nëse kërkesa refuzohet pjesërisht ose plotësisht, palët kontraktuese do ta njoftojnë pa vonesë njëra-tjetrën mbi këtë fakt me shkrim.

3. Palët kontraktuese mund të caktojnë kushte për të pranuar kërkesën, që do të jetë detyruese për palën tjetër kontraktuese.

Neni 7

1. Në zbatim të kësaj Marrëveshjeje, organet kompetente të palëve kontraktuese do të përdorin gjuhën angleze, nëse nuk bien dakord ndryshe.

2. Organet kompetente të palëve kontraktuese do të vlerësojnë bashkëpunimin, sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 8

1. Pas një marrëveshjeje me palën tjetër kontraktuese, secila palë kontraktuese mund të dërgojë oficerë ndërlidhës tek organet kompetente të palës tjetër.

2. Në territorin e shtetit të palës tjetër kontraktuese, oficerët ndërlidhës do të japin asistencë dhe këshillim. Ata do të sigurojnë informacion dhe do të përmbushin detyrat e tyre duke zbatuar udhëzimet e dhëna nga pala kontraktuese që i dërgon. Ata do të japin asistencë për krijimin e kontakteve dhe do të marrin pjesë në organizimin e takimeve dypalëshe të punës.

3. Oficerët ndërlidhës të një pale kontraktuese që janë dërguar në një vend të tretë, pas një marrëveshjeje reciproke ndërmjet palëve kontraktuese dhe me miratim me shkrim të vendit të tretë, gjithashtu mund të përfaqësojnë interesat e palës tjetër kontraktuese.

Neni 9

Dispozitat e mëposhtme do të zbatohen për transferimin e të dhënave personale (më poshtë të referuara si "të dhëna"), si dhe për dorëzimin e tyre:

a) Pala kontraktuese marrëse mund t'i përdorë të dhënat vetëm për qëllim dhe sipas kushteve të përcaktuara nga pala kontraktuese dërguese. Të dhënat mund të përdoren për qëllime të tjera, vetëm me miratimin paraprak me shkrim të palës kontraktuese dërguese.

b) Me kërkesë të palës kontraktuese dërguese, pala kontraktuese marrëse do të japë informacion dhe do të përdorë të dhënat e marra dhe rezultatet e përftuara me ndihmën e të dhënave.

c) Të dhënat do t'u dërgohen, ekskluzivisht, organeve kompetente, sipas kësaj Marrëveshjeje dhe organeve të tjera kompetente në luftën ndaj krimit apo migracionit të paligjshëm. Zbulimi i të dhënave tek organe të tjera do të mundësohet nëse sigurohet një miratim me shkrim i palës kontraktuese dërguese.

d) Pala kontraktuese dërguese do të jetë e detyruar të sigurojë saktësinë e të dhënave të transferuara dhe të kontrollojë nëse transferimi është i nevojshëm dhe në përputhje me qëllimin për të cilin është vënë në dispozicion. Nëse konstatohet më vonë se janë transferuar të dhëna të gabuara ose të dhëna që nuk duhet të ishin transferuar, pala kontraktuese marrëse do të njoftohet menjëherë. Pala kontraktuese marrëse do të jetë e detyruar të korrigjojë të dhënat e gabuara ose t'i shkatërrojë ato, në rastin e të dhënave që nuk duhet të ishin transferuar.

e) Personit, të dhënat e të cilit janë transferuar, do t'i jepet me kërkesën e tij ose saj dhe me një miratim paraprak me shkrim të palës tjetër kontraktuese, informacion mbi të dhënat e transferuara dhe përdorimin e tyre të synuar, me kusht që rregullat kombëtare ligjore të palës kontraktuese, të cilës i është kërkuar informacion, të mos e pengojnë atë.

f) Pala kontraktuese marrëse do të jetë e detyruar të shkatërrojë të dhënat e marra nëse nuk i nevojiten më për qëllimin për të cilin ato janë transferuar. Në rast të mbarimit të afatit të kësaj Marrëveshjeje do të jetë e nevojshme të shkatërrohen të gjitha të dhënat e marra nën të, jo më vonë se data e mbarimit të afatit, nëse nuk zëvendësohet nga një marrëveshje e re.

g) Palët kontraktuese janë të detyruara të regjistrojnë transferimet, marrjet dhe shkatërrimet e të dhënave. Regjistrat duhet të përfshijnë informacion në lidhje me arsyet për transferimin e të dhënave, organet dërguese dhe marrëse, kohën e transferimit, shtrirjen e të dhënave, si dhe informacion mbi shkatërrimin e të dhënave.

h) Palët kontraktuese do të jenë të detyruara të mbrojnë në mënyrë efektive të dhënat e transferuara nga shkatërrimi aksidental apo i paautorizuar, humbja aksidentale, ndryshimi aksidental apo i paautorizuar, transferimin aksidental apo i paautorizuar, aksesin aksidental apo i paautorizuar, apo zbulimi aksidental apo i paautorizuar.

Neni 10

Nëse, sipas kësaj Marrëveshjeje, transferohet informacion i klasifikuar, do të zbatohen dispozitat e mëposhtme:

1. Informacioni, i cili sipas rregullave kombëtare ligjore të palës kontraktuese transferuese, i cili i nënshtrohet klasifikimit të sigurisë dhe mban shënimin sipas rregullave, do të jepet nga pala kontraktuese marrëse me mbrojtje të njëjtë me atë që i jepet informacionit që i nënshtrohet nivelit përkatës të klasifikimit të sigurisë sipas rregullave të tij kombëtare ligjore, në përputhje me tabelën e ekuivalencës së niveleve të klasifikimit të sigurisë të përfshirë në aneksin e kësaj Marrëveshjeje. Aneksi formon një pjesë përbërëse të kësaj Marrëveshjeje.

2. Pala kontraktuese transferuese do të njoftojë pa vonesë me shkrim palën kontraktuese marrëse mbi ndonjë riklasifikim apo deklasifikim të informacionit të klasifikuar të transferuar. Pala kontraktuese marrëse do të kryejë riklasifikimin ose deklasifikimin sipas njoftimit.

3. Informacioni i klasifikuar, i transferuar, do të përdoret vetëm në përputhje me qëllimin për të cilin është transferuar dhe do ta kenë vetëm personat që e kanë të nevojshëm ta njohin, të cilët janë autorizuar, sipas rregullave ligjore kombëtare, specifikisht, kur përmbushin kushtet për të pasur akses ndaj informacionit të klasifikuar të nivelit përkatës të klasifikimit të sigurisë.

4. Informacioni i klasifikuar, i transferuar, do të mundësohet edhe për organe të tjera kompetente, të përcaktuar në këtë Marrëveshje dhe për organe të tjera që merren me luftën kundër krimit dhe migracionit të paligjshëm, vetëm me një miratim me shkrim të palës kontraktuese transferuese.

5. Çdo shkelje e rregullave kombëtare ligjore të Palës kontraktuese marrëse në lidhje me mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, të transferuar, do t'i raportohet pa ndonjë vonesë palës kontraktuese transferuese, duke përfshirë informacion mbi rrethanat e shkeljes së rregullave ligjore, pasojat e saj dhe masat e marra për të zbutur pasojat dhe për të parandaluar të tilla shkelje në të ardhmen.

Neni 11

Informacioni dhe dokumentet e transferuara, përfshirë edhe informacionin e klasifikuar për vendet e treta dhe organizatat ndërkombëtare, do të sigurohen nëpërmjet miratimit me shkrim të palës kontraktuese transferuese.

Neni 12

Nëse organet kompetente të palës kontraktuese bien dakord paraprakisht:

a) Pala kontraktuese që kërkon asistencë do të mbulojë shpenzimet për zbatimin e bashkëpunimit sipas nenit 2.

b) Pala kontraktuese që i jep asistencë palët tjetër kontraktuese do të mbulojë të gjitha shpenzimet e zbatimit të formave të tjera të bashkëpunimit duke përcaktuar që palët kontraktuese do të tregojnë kujdes mbi balancimin e ndërsjellë dhe reciprocitetin e kostove.

Neni 13

Në rast nevoje, organet kompetente të palëve kontraktuese mund të lidhin protokolle zbatuese nën këtë Marrëveshje dhe në bazë të saj.

Neni 14

Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, do të zgjidhen nëpërmjet organeve kompetente të palëve kontraktuese. Nëse mosmarrëveshjet nuk zgjidhen me këto mjete, do të zgjidhen më tej ndërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 15

Kjo Marrëveshje nuk cenon detyrimet që rrjedhin nga marrëveshje të tjera ndërkombëtare dypalëshe ose shumëpalëshe, me të cilat shtetet e palëve kontraktuese janë të lidhura.

Neni 16

Palët, në çdo kohë, mund të pezullojnë përkohësisht, tërësisht ose pjesërisht, zbatimin e kësaj Marrëveshjeje në rast se do të jetë e nevojshme për sigurinë kombëtare, rendin publik ose shëndetin publik. Palët kontraktuese do të njoftojnë pa vonesë njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike, mbi miratimin apo tërheqjen e një mase të tillë. Pezullimi i zbatimit të kësaj Marrëveshjeje dhe tërheqja e saj do të hyjnë në fuqi në përfundim të 15 ditëve nga dhënia e një njoftimi të tillë palës tjetër kontraktuese.

Neni 17

1. Palët kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike për përmbushjen e kushteve ligjore kombëtare për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes. Marrëveshja hyn në fuqi ditën e parë të muajit të dytë pas marrjes që vjen pas marrjes së njoftimit të fundit.

2. Kjo Marrëveshje është lidhur për një periudhë të pacaktuar kohe. Secila palë kontraktuese mund ta denoncojë atë me shkrim në çdo kohë. Marrëveshja do të përfundojë gjashtë muaj pas datës së marrjes së këtij denoncimi nga pala tjetër kontraktuese.

Bërë në Pragë, më 27 prill 2009, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe, çeke dhe angleze. Në rast të mospërputhjeve në interpretim, do të mbizotërojë versioni në gjuhën angleze.

ANEKS

PËR MARRËVESHJEN NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS ÇEKE PËR BASHKËPUNIM NË LUFTËN KUNDËR KRIMIT

Në përputhje me nenin 10, a të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Çeke mbi bashkëpunimin në luftën kundër krimit dhe duke marrë në konsideratë rregullat e tyre kombëtare ligjore, palët kontraktuese kanë vendosur se nivelet e mëposhtme të klasifikimit të sigurisë janë në përputhje për nevojat e kësaj Marrëveshjeje.

E KUFIZUAR	VYHRAZENÉ	RESTRICTED
KONFIDENCIALE	DŮVERNÉ	CONFIDENTIAL
SEKRET	TAJNÉ	SECRET
TEPËR SEKRET	PŘISNĚ TAJNÉ	TOP SECRET

LIGJ
Nr.10 194, datë 10.12.2009

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN "PËR NJOHJEN DHE ZBATIMIN E VENDIMEVE TË HUAJA NË FUSHËN CIVILE DHE TREGTARE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në konventën "Për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja në fushën civile dhe tregtare", bërë në Hagë më 1 shkurt 1971 dhe që ka hyrë në fuqi më 20 gusht 1979, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6364, datë 29.12.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.184, faqe 8153

KONVENTA
PËR NJOHJEN DHE ZBATIMIN E VENDIMEVE TË HUAJA
NË FUSHËN CIVILE DHE TREGTARE
(përfunduar më 1 shkurt 1971
& hyrë në fuqi më 20 gusht 1979)

Shtetet palë në këtë Konventë,

duke dëshiruar të krijojnë dispozita të përbashkëta, në lidhje me njohjen dhe zbatimin e ndërsjellë të vendimeve gjyqësore të dhëna në vendet e tyre respektive,

vendosën të përfundojnë këtë Konventë dhe të merren vesh përsa u përket dispozitave të mëposhtme:

KAPITULLI I
FUSHA E VEPRIMIT TE KONVENTËS

Neni 1

Kjo Konventë do të zbatohet për vendimet e dhëna në çështjet civile ose tregtare nga gjykatat e shteteve kontraktuese.

Ajo nuk do të zbatohet për vendimet, objekti kryesor i të cilave është të vendosin:

1. Statusin ose kapacitetin e personave apo çështjeve të së drejtës familjare, duke përfshirë të drejtat personale ose financiare dhe detyrimet midis prindërve dhe fëmijëve apo midis bashkëshortëve;

2. Ekzistencën ose përbërjen e personave juridikë apo kompetencave të punonjësve të tyre;

3. Detyrimet e pensionit ushqimor, për sa kohë që nuk janë përfshirë në nënparagrafin (1) të këtij neni;

4. Çështje të trashëgimisë;

5. Çështje të falimentimit, marrëveshjeve ose procedimeve të ngjashme, duke përfshirë vendime që mund të rrjedhin nga kjo dhe që kanë lidhje me vlefshmërinë e akteve të debitorit;

6. Çështje të sigurimit shoqëror;

7. Çështje që kanë lidhje me dëmin në çështje familjare.

Kjo Konventë nuk zbatohet për vendimet në lidhje me pagesën e ndonjë takse doganore, tatimi ose gjobe.

Neni 2

Kjo Konventë do të zbatohet për të gjitha vendimet e dhëna nga gjykatat e një shteti kontraktues, pavarësisht nga emërtimi i dhënë nga ai shtet procedimeve që mundësuan vendimin ose të emërtimit të dhënë vetë vendimit si vendim gjyqësor, urdhër ose urdhër ekzekutimi.

Megjithatë, ajo nuk do të zbatohet as për vendimet që urdhërojnë masa të përkohshme ose mbrojtëse dhe as për vendimet e dhëna nga gjykatat administrative.

Neni 3

Kjo Konventë do të zbatohet pavarësisht nga kombësia e palëve.

KAPITULLI II
KUSHTET E NJOHJES DHE ZBATIMIT

Neni 4

Një vendim i dhënë në një prej shteteve kontraktuese do të ketë të drejtën e njohjes dhe zbatimit në një shtet tjetër kontraktues sipas kushteve të kësaj Konvente:

1. Nëse vendimi është dhënë nga një gjykatë që cilësohet të ketë juridiksion brenda kuptimit të kësaj Konvente, dhe

2. Nëse nuk është më objekt i formave të zakonshme të rishikimit në shtetin e origjinës.

Neni 5

Megjithatë, njohja ose zbatimi i një vendimi mund të refuzohet në ndonjë prej rasteve të mëposhtme:

1. Nëse njohja ose zbatimi i vendimit është në mospërputhje të hapur me politikën publike të shtetit dërgues ose nëse vendimi ka dalë nga procedime në mospërputhje me kërkesat e procesit të përshtatshëm ligjor ose nëse, në rrethana të caktuara, asnjë palë nuk ka pasur mundësi të mjaftueshme për të paraqitur çështjen e saj;

2. Nëse vendimi është marrë me anë të mashtrimit në kuptimin procedural;

3. Nëse procedimet midis palëve të njëjta, bazuar në të njëjtat fakte dhe duke pasur të njëjtin qëllim:

a) janë duke u shqyrtuar para një gjykate të shtetit dërgues dhe ato procedime kanë qenë të parat për t'u ndërmarrë, ose

b) kanë dalë në një vendim nga një gjykatë e shtetit dërgues, ose

c) kanë dalë në një vendim nga një gjykatë e një shteti tjetër, i cili do të kishte të drejtën e njohjes dhe zbatimit sipas ligjit të shtetit dërgues.

Neni 6

Pa cenuar dispozitat e nenit 5, një vendim i dhënë në mungesë nuk do të njihet apo zbatohet për sa kohë që pala në mungesë të ketë marrë njoftim për fillimin e procedimeve në përputhje me ligjin e shtetit të origjinës në kohë të mjaftueshme për t'i mundësuar atij mbrojtjen e procedimeve.

Neni 7

Njohja ose zbatimi mund të mos refuzohet për arsyen e vetme se gjykata e shtetit të origjinës ka zbatuar një ligj të ndryshëm nga ai që do të kishte qenë i zbatueshëm sipas rregullave të së drejtës ndërkombëtare private të shtetit dërgues.

Megjithatë, njohja ose zbatimi mund të refuzohet nëse, për të arritur vendimin e saj, gjykata e shtetit të origjinës duhet të vendoste një çështje që kishte lidhje me statusin ose kapacitetin e një pale ose të drejtat e tij në çështje të tjera të përjashtuara nga kjo Konventë nga nënparagrafët (1)-(4) të paragrafit të dytë të nenit 1 dhe ka arritur një rezultat të ndryshëm nga ai që do të ishte ndjekur nga zbatimi i asaj çështjeje të rregullave të së drejtës ndërkombëtare private të shtetit dërgues.

Neni 8

Pa cenuar këtë rishikim siç kërkohet nga kushtet e neneve paraardhëse, nuk do të ketë rishikim të themelit të vendimit të dhënë nga gjykata e origjinës.

Neni 9

Në çështjet që kanë lidhje me juridiksionin e gjykatës së shtetit të origjinës, autoriteti dërgues do të jetë i detyruar nga rezultatet e arsyetimit nga provat mbi të cilat ajo gjykatë ka bazuar juridiksionin e saj, për sa kohë që vendimi është dhënë në mungesë.

Neni 10

Gjykata e shtetit të origjinës do të cilësohet të ketë juridiksion për qëllime të kësaj Konvente:

1. Nëse i pandehuri, në kohën kur kanë filluar procedimet, kishte banesën e tij të përhershme në shtetin e origjinës ose, nëse i pandehuri nuk është person fizik, kishte pasur rezidencën e tij, vendin e tij të korporatës ose vendin e tij kryesor të biznesit në atë shtet;

2. Nëse i pandehuri, në kohën kur kanë filluar procedimet, kishte në shtetin e origjinës një firmë tregtare, industriale ose ndonjë biznes tjetër apo një zyrë lokale dhe ishte thirrur aty në procedimet që kanë lindur nga biznesi i kryer nga kjo firmë ose zyrë lokale;

3. Nëse padia kishte si objekt të saj vendosjen e një çështjeje në lidhje me pasurinë e paluajtshme të ndodhur në shtetin e origjinës;

4. Në rastin e dëmeve ndaj personit ose ndaj pasurisë së luajtshme, nëse faktet që shkaktuan dëmin kanë ndodhur në territorin e shtetit të origjinës dhe nëse autori i dëmit të shkaktuar ishte i pranishëm në atë territor në kohën kur kanë ndodhur ato fakte;

5. Nëse me anë të një marrëveshjeje me shkrim ose me anë të një marrëveshjeje verbale të konfirmuar me shkrim brenda një kohe të arsyeshme, palët kanë rënë dakord për t'i paraqitur juridiksionit të gjykatës së origjinës mosmarrëveshjet që kanë lindur ose që mund të lindin në lidhje me një marrëdhënie specifike të ligjshme, për sa kohë që ligji i shtetit të adresuar nuk do të lejonte këtë marrëveshje për shkak të thelbit të mosmarrëveshjes;

6. Megjithatë, nëse i pandehuri ka argumentuar themelin, pa sfiduar juridiksionin e gjykatës ose duke bërë rezerva në lidhje me të; ky juridiksion nuk do të njihet nëse i pandehuri ka argumentuar themelin me qëllim që të rezistojë ndaj konfiskimit të pasurisë ose të sigurojë lirimin e tij apo nëse njohja e këtij juridiksioni do të ishte në kundërshtim me ligjin e shtetit dërgues për shkak të thelbit të mosmarrëveshjes;

7. Nëse personi kundër të cilit kërkohet njohja ose zbatimi, ishte palë paditëse në procedimet në gjykatën e origjinës dhe nuk kishte sukses në ato procedime, përveçse kur njohja e këtij juridiksioni do të ishte në kundërshtim me ligjin e shtetit të adresuar për shkak të thelbit të mosmarrëveshjes.

Neni 11

Gjykata e shtetit të origjinës do të cilësohet të ketë juridiksion për qëllime të kësaj Konvente për të gjykuar një kundërpadi:

1. Nëse ajo gjykatë do të kishte pasur juridiksion për të gjykuar padinë, si një padi kryesore sipas nënparagrafëve (1)-(6) të nenit 10 ose

2. Nëse ajo gjykatë ka pasur juridiksion sipas nenit 10 për të gjykuar padinë kryesore dhe nëse kundërpadia ka lindur jashtë kontratës ose jashtë provave mbi të cilat ishte bazuar padia kryesore.

Neni 12

Juridiksioni i gjykatës së shtetit të origjinës nuk ka nevojë të njihet nga autoriteti dërgues në rastet e mëposhtme:

1. Nëse ligji i shtetit dërgues u jep gjykatave të tij juridiksion të posaçëm, për shkak të lëndës së padisë ose në bazë të një marrëveshjeje midis palëve për vendosjen e padisë që ka mundësuar vendimin e huaj;

2. Nëse ligji i shtetit dërgues njeh një juridiksion të posaçëm të ndryshëm për shkak të lëndës së padisë ose nëse autoriteti dërgues e konsideron veten të detyruar sipas ligjit ta njohë këtë juridiksion të posaçëm për shkak të një marrëveshjeje midis palëve;

3. Nëse autoriteti dërgues e konsideron veten të detyruar, sipas ligjit të njohë një marrëveshje me anë të së cilës u jepet juridiksion i posaçëm gjyqtarëve të arbitrazhit.

KAPITULLI III
PROCEDURAT E NJOHJES DHE ZBATIMIT

Neni 13

Pala që kërkon njohje ose aplikim për zbatim do të sigurojë:

1. një kopje të plotë dhe origjinale të vendimit;

2. nëse vendimi është dhënë në mungesë, kopjet origjinale ose të njehsuara me origjinalin të dokumenteve të kërkuara, për të vërtetuar se thirrja gjyqësore i është dhënë palës në mungesë ashtu siç duhet;

3. të gjitha dokumentet e kërkuara për të vërtetuar që vendimi përmbush kushtet e nënparagrafit (2) të paragrafit të parë të nenit 4 dhe sipas nevojës, të paragrafit të dytë të nenit 4;

4. për sa kohë që autoriteti dërgues nuk kërkon ndryshe, përkthimet e dokumenteve të referuara më sipër, të certifikuara si të sakta nga një agjent diplomatik ose konsullor ose nga një përkthyes i licencuar apo nga ndonjë person tjetër i autorizuar për këtë në secilin shtet.

Nëse kushtet e vendimit nuk e lejojnë autoritetin dërgues të verifikojë nëse kushtet e kësaj Konvente janë përmbushur, ai autoritet mund të kërkojë riprodhimin e çdo dokumenti tjetër të nevojshëm.

Nuk mund të kërkohet asnjë legalizim apo ndonjë formalitet tjetër i ngjashëm.

Neni 14

Procedura për njohjen ose zbatimin e vendimeve të huaja udhëhiqet nga ligji i shtetit dërgues, përveç rasteve kur kjo Konventë nuk parashikon ndryshe.

Nëse vendimi përmban dispozita që mund të ndahen, ndonjëra ose më shumë prej tyre mund të njihen apo zbatohen të ndara nga njëra-tjetra.

Neni 15

Njohja ose zbatimi i një vendimi arbitrazhi në lidhje me kostot ose shpenzimet gjyqësore mund të jepet në bazë të kësaj Konvente, vetëm nëse kjo Konventë është e zbatueshme për vendimin në themel.

Kjo Konventë do të zbatohet për vendime që kanë lidhje me kostot ose shpenzimet gjyqësore, edhe nëse këto vendime nuk procedohen nga një gjykatë, me kusht që ato të rrjedhin nga një vendim që mund të njihet ose zbatohet sipas kësaj Konvente dhe se vendimi në lidhje me kostot ose shpenzimet mund të kishte qenë objekt i rishikimit gjyqësor.

Neni 16

Një vendim për kostot ose shpenzimet, i dhënë në lidhje me dhënien ose refuzimin e njohjes ose zbatimit të një vendimi, mund të zbatohet sipas kësaj Konvente, vetëm nëse aplikanti në procedimet për njohje ose zbatim është mbështetur në këtë Konventë.

Neni 17

Megjithatë, asnjë siguracion, obligacion ose depozitë të emërtuara sipas ligjit të shtetit dërgues, nuk do të kërkohet në bazë të kombësisë ose vendbanimit të aplikantit për të garantuar pagesën e kostove ose shpenzimeve gjyqësore nëse aplikanti, duke qenë një person fizik, ka banesën e tij të përhershme në të ose duke mos qenë person fizik ka një qendër biznesi në një shtet, i cili ka lidhur një marrëveshje shtesë me shtetin dërgues, në përputhje me nenin 21.

Neni 18

Një pale që i është dhënë ndihmë ligjore në shtetin e origjinës do t'i jepet kjo ndihmë në përputhje me ligjin e shtetit dërgues në çdo procedim për njohje ose për zbatimin e një vendimi të huaj.

Neni 19

Marrëveshjet e bëra në gjykatë gjatë një procedimi në shqyrtim që mund të jetë zbatuar në shtetin e origjinës, do të jetë i zbatueshëm në shtetin dërgues sipas të njëjtave kushte si vendimet që hyjnë brenda fushës së veprimit të kësaj Konvente, për sa kohë që ato kushte zbatohen për marrëveshjet.

KAPITULLI IV
PADI TË NJËKOHSHME

Neni 20

Nëse dy shtete kanë lidhur një marrëveshje shtesë sipas nenit 21, autoritetet gjyqësore të secilit shtet mund të refuzojnë një padi të paraqitur para tyre ose mund ta shtyjnë këtë padi, kur procedime të tjera midis të njëjtave palë, bazuar në të njëjtat fakte dhe duke pasur të njëjtin qëllim, janë duke u shqyrtuar në një gjykatë të një shteti tjetër dhe këto procedime mund të rezultojnë në një vendim, të cilin autoritetet e shtetit në të cilin është paraqitur padia e përmendur për herë të parë, do ta njihnin sipas ligjit, në përputhje me kushtet e kësaj Konvente.

Megjithatë, autoritetet e këtyre shteteve mund të urdhërojnë masa të përkohshme ose mbrojtëse, pavarësisht procedimeve në një vend tjetër.

KAPITULLI V
MARRËVESHJE PLOTËSUESE

Neni 21

Vendimet e dhëna në një shtet kontraktues nuk do të njihen ose zbatohen në një shtet tjetër kontraktues në përputhje me dispozitat e neneve paraardhëse, përveç rasteve kur të dy shtetet, duke qenë palë në këtë Konventë, kanë lidhur një marrëveshje plotësuese për këtë qëllim.

Neni 22

Kjo Konventë nuk do të zbatohet për vendimet e dhëna para hyrjes në fuqi të marrëveshjes plotësuese të parashikuar në nenin 21, përveçse kur marrëveshja parashikon ndryshe.

Marrëveshja plotësuese do të vazhdojë të jetë e zbatueshme për vendime në lidhje me të cilat kanë filluar procedimet e njohjes ose zbatimit, para se një denoncim i asaj Marrëveshjeje të hyjë në fuqi.

Neni 23

Në marrëveshjet plotësuese të referuara në nenin 21, shtetet kontraktuese mund të bien dakord:

1. për të qartësuar kuptimin e shprehjes "çështje civile dhe tregtare", për të vendosur gjykatat, vendimet e të cilave do të njihen dhe zbatohen sipas kësaj Konvente, për të përcaktuar shprehjen "sigurime shoqërore" dhe për të përcaktuar shprehjen "vendbanim i përhershëm";

2. për të qartësuar kuptimin e termit "ligj" në shtetet me më shumë se një sistem ligjor;

3. për të përfshirë brenda fushës së veprimit të kësaj Konvente probleme që kanë lidhje me dëmin në çështje familjare;

4. për ta zbatuar këtë Konventë për vendimet që urdhërojnë masa të përkohshme ose mbrojtëse;

5. për të mos zbatuar këtë Konventë për vendime të dhëna gjatë procedimeve penale;

6. për të specifikuar rastet sipas të cilave një vendim nuk është më objekt i formave të zakonshme të rishikimit;

7.për të njohur dhe zbatuar vendimet për të cilat do të sigurohej zbatimi në shtetin e origjinës edhe nëse këto vendime janë ende objekt i formave të zakonshme të rishikimit dhe në këtë rast, për të përcaktuar kushtet, sipas të cilave është e mundur një shtyrje e procedimeve për njohje ose zbatim;

8. për të mos zbatuar nenin 6, nëse vendimi i dhënë në mungesë i është njoftuar palës në mungesë dhe kjo e fundit ka pasur mundësinë të bënte një apel në kohë kundër këtij vendimi;

8 bis që autoriteti dërgues nuk do të jetë i detyruar nga rezultatet e arsyetimit, nga provat mbi të cilat gjykata e shtetit të origjinës ka bazuar juridiksionin e saj;

9. për të konsideruar gjykatat e shtetit në të cilin i pandehuri ka pasur "vendbanimin" e tij me juridiksion në përputhje me nenin 10:

10. se gjykata e origjinës do të konsiderohet të kishte juridiksion sipas kushteve të kësaj Konvente, në rastet kur juridiksioni i saj është pranuar nga një Konventë tjetër në fuqi midis shtetit të origjinës dhe shtetit dërgues nëse Konventa tjetër nuk përmban rregulla specifike në lidhje me njohjen ose zbatimin e vendimeve të huaja;

11. se gjykata e origjinës do të konsiderohet të kishte juridiksion sipas kushteve të kësaj Konvente ose kur juridiksioni i saj është pranuar nga ligji i shtetit dërgues në lidhje me njohjen ose zbatimin e vendimeve të huaja ose për arsye të tjera, përveç atyre të parashtruara në nenin 10;

12. për të përcaktuar, për qëllime të zbatimit të nenit 12, bazat e juridiksionit të cilat janë të posaçme për shkak të lëndës së padisë;

13. për të përjashtuar, në rastet kur juridiksioni është bazuar në një marrëveshje midis palëve, zbatimin e nënparagrafit (1) të nenit 12, si dhe për të përjashtuar atë të nënparagrafit (3) të nenit 12;

14. për të rregulluar procedurën për sigurimin e njohjes ose zbatimit;

15. për të rregulluar zbatimin e vendimeve të tjera nga ato që urdhërojnë pagesën e një shume parash;

16. se zbatimi i një vendimi të huaj mund të refuzohet kur ka kaluar një periudhë e specifikuar nga data e saj;

17. për të fiksuar përqindjen e interesit të pagueshëm nga data e vendimit në shtetin e origjinës;

18. për të adaptuar në kërkesat e sistemeve të tyre ligjore listën e dokumenteve të kërkuara nga neni 13, por me objektin e vetëm për t'i mundësuar autoritetit dërgues të verifikojë nëse janë përmbushur kushtet e kësaj Konvente;

19. për të paraqitur dokumentet e referuara në nenin 13 për legalizim ose për një formalitet të ngjashëm;

20. për të devijuar nga dispozitat e nenit 17 dhe për të devijuar nga dispozitat e nenit 18;

21. për t'i bërë të detyrueshme dispozitat e paragrafit të parë të nenit 20;

22. për të përfshirë brenda fushës së veprimit të kësaj Konvente "actes authentiques", duke përfshirë dokumente në lidhje me të cilat mund të sigurohet zbatimi i menjëhershëm dhe për t'i specifikuar ato dokumente.

KAPITULLI VI
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 24

Kjo Konventë nuk do të cenojë konventat e tjera që kanë lidhje me njohjen dhe zbatimin e vendimeve në të cilat shtetet kontraktuese janë tashmë palë, për sa kohë që ato shtete nuk kanë lidhur një marrëveshje plotësuese sipas kushteve të nenit 21.

Për sa kohë që nuk është rënë dakord ndryshe, dispozitat e një marrëveshjeje plotësuese të lidhura sipas nenit 21 do të dominojnë mbi kushtet e ndonjë konvente të mëparshme në fuqi midis palëve, të cilat kanë të bëjnë me njohjen dhe zbatimin e vendimeve në shkallën që kushtet e tyre të jenë reciprokisht të mospërputhshme.

Neni 25

Me ose pa lidhjen e një marrëveshjeje plotësuese sipas nenit 21, shtetet kontraktuese nuk do të lidhin konventa të tjera midis tyre mbi njohjen dhe zbatimin e vendimeve brenda fushës së veprimit të kësaj Konvente, për sa kohë që ato nuk e çmojnë të nevojshme, në veçanti, për shkak të lidhjeve ekonomike ose për aspekte specifike të sistemeve të tyre ligjore.

Neni 26

Pavarësisht nga dispozitat e neneve 24 dhe 25, kjo Konventë dhe marrëveshjet plotësuese të lidhura në përputhje me nenin 21 nuk do të kenë përparësi mbi konventat e tjera në të cilat shtetet kontraktuese janë ose mund të bëhen palë në fusha të veçanta dhe të cilat përmbajnë dispozita për njohjen dhe zbatimin e vendimeve.

Neni 27

Kjo Konventë është e hapur për t'u firmosur nga shtetet anëtare të përfaqësuara gjatë sesionit të dhjetë të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private, si dhe për Qipron, Islandën dhe Maltën.

Kjo Konventë do të ratifikohet dhe instrumentet e ratifikimit do të depozitohen në Ministrinë e Punëvë të Jashtme të Vendeve të Ulëta.

Neni 28

Kjo Konventë do të hyjë në fuqi në ditën e gjashtëdhjetë pas depozitimit të instrumentit të dytë të ratifikimit.

Konventa do të hyjë në fuqi për çdo shtet palë që e ratifikon në një datë të mëvonshme, në ditën e gjashtëdhjetë pas depozitimit të instrumentit përkatës të ratifikimit.

Neni 29

Çdo shtet që nuk përfshihet në dispozitat e paragrafit të parë të nenit 27 mund të aderojë në këtë Konventë pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, në përputhje me nenin 28, paragrafi i parë. Instrumenti i aderimit do të depozitohet pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta.

Konventa do të hyjë në fuqi për këtë shtet, nëse asnjë nga shtetet, të cilat e kanë ratifikuar atë përpara depozitimit të instrumentit të aderimit, nuk paraqesin ndonjë kundërshtim pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta në lidhje me këtë aderim brenda gjashtë muajve nga data e njoftimit të tyre prej kësaj ministrie për këtë aderim.

Në mungesë të një kundërshtimi të tillë, Konventa do të hyjë në fuqi për këtë shtet aderues në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e periudhës më të fundit të përmendur në paragrafin e mësipërm.

Neni 30

Në momentin e nënshkrimit, ratifikimit ose aderimit, çdo shtet mund të deklarojë shtrirjen e efekteve të kësaj Konvente, në të gjithë territorin që ai përfaqëson në nivel ndërkombëtar, apo në një ose disa prej tyre. Kjo deklaratë do të hyjë në fuqi në momentin e hyrjes në fuqi të Konventës në atë shtet.

Në vazhdimësi, për çdo shtrirje të kësaj natyre do të njoftohet Ministria e Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta.

Konventa do të hyjë në fuqi për territoret e përmendura në këtë zgjerim në ditën e gjashtëdhjetë pas njoftimit të përmendur në paragrafin e mësipërm.

Palët në një marrëveshje plotësuese të lidhur në përputhje me nenin 21 do të vendosin vetë për zbatimin territorial të saj.

Neni 31

Kjo Konventë do të mbetet në fuqi për një periudhë 5-vjeçare nga dita e hyrjes në fuqi në përputhje me nenin 28, paragrafi i parë edhe përsa u përket shteteve që e kanë ratifikuar ose kanë aderuar në të në një datë të mëvonshme.

Në rast se nuk ka pasur asnjë denoncim, Konventa do të rinovohet në mënyrë të heshtur çdo pesë vjet

Çdo denoncim do të njoftohet të paktën 6 muaj përpara mbarimit të periudhës pesëvjeçare pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta.

Denoncimi mund të jetë i kufizuar për një territor ose territore të caktuara në të cilat zbatohet Konventa.

Denoncimi do të ketë efekt vetëm përsa i përket shtetit i cili e ka bërë atë. Konventa do të qëndrojë në fuqi për shtetet e tjera palë.

Neni 32

Çdo marrëveshje plotësuese e lidhur në përputhje me nenin 21 do të fillojë të ketë pasoja nga data e përcaktuar në këtë Marrëveshje; një përkthim ose një kopje në gjuhën angleze ose frënge të kësaj marrëveshjeje plotësuese do t'i komunikohet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Vendeve te Ulëta.

Çdo shtet kontraktues, pa denoncuar Konventën, mundet të denoncojë një marrëveshje plotësuese ose në përputhje me një dispozitë për këtë gjë në vetë atë marrëveshje ose, nëse kjo marrëveshje nuk e parashikon një gjë të tillë, duke i dërguar një njoftim me shkrim shtetit tjetër për një periudhë gjashtëmujore. Çdo shtet kontraktues që denoncon një marrëveshje plotësuese do t'ia komunikojë këtë edhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta.

Pavarësisht nga denoncimi i kësaj Konvente, ai do të vazhdojë të ketë pasoja ndërmjet shtetit denoncues dhe çdo shteti tjetër me të cilin kjo e fundit ka lidhur një marrëveshje plotësuese në përputhje me nenin 21, për sa kohë që kjo Marrëveshje nuk parashikon të kundërtën.

Neni 33

Ministria e Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta u njofton shteteve palë të përmenduara në nenin 27, si dhe shteteve që kanë aderuar në përputhje me nenin 29, sa më poshtë:

a) çdo nënshkrim dhe ratifikim të përmendur në nenin 27;

b) datën në të cilën kjo Konventë hyn në fuqi në përputhje me nenin 28, paragrafi i parë;

c) çdo aderim të përmendur në nenin 29 dhe datën në të cilën hyn në fuqi;

d) çdo zgjerim të parashikuar në nenin 30 dhe datën në të cilën hyn në fuqi;

e) një përkthim ose një kopje në gjuhën angleze ose frënge të marrëveshjeve plotësuese të lidhura në përputhje me nenin 21;

f) çdo denoncim të parashikuar në nenin 31, paragrafi i tretë dhe në nenin 32, paragrafi i dytë.

Në dëshmi të sa më sipër, nënshkruesit, të autorizuar posaçërisht nënshkruajnë këtë Konventë.

Bërë në Hagë, më 1 shkurt 1971 në dy gjuhë, anglisht dhe frëngjisht, të dy tekstet njësoj autentike të lidhura në një kopje të vetme, e cila depozitohet në arkivat e qeverisë së Vendeve të Ulëta, prej së cilës një kopje e vërtetuar i dërgohet nëpërmjet kanaleve diplomatike çdo shteti të përfaqësuar në sesionin e dhjetë të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private, si dhe Qipros, Islandës dhe Maltës.